

KURANI

Përkthimi i autorizuar në gjuhën shqipe

Verzion shqip i
Përkthimit të autorizuar të Kuranit në gjuhën angleze
nga Rashad Khalifa, Ph.D.
(1989)

Përktheu: Alban Fejza, M.Sc.

*Pa dyshim, kush beson,
qoftë nga Ortodoksët, Katolikët,
ose të konvertuarit;
kushdo që
(1) beson në Zotin, dhe
(2) beson në Ditën e Fundit, dhe
(3) çon jetë të drejtë,
do ta marrin shpërblimin e vet
prej Zotëruesit të tyre.
Nuk kanë pse të frikësohen,
e as nuk do të brengosen.*

(2:62, 5:69)

DEKLARATA

Një Fe të Bashkuar Për të Gjithë Njerëzit

Të gjitha fetë e botës – Jahudizmi, Krishterimi, Islami, Hinduizmi, Budizmi, dhe të tjerat – janë korruptuar së tepërmi nëpërmjet shpikjeve, traditave, dhe idolizimeve të njerëzve siç janë profetët dhe të shenjtët.

Plani i Zotit, siç thuhet në Besëlidhjen e Vjetër (Malakia 3:1), Besëlidhjen e Re (Luka 17:22-36 & Mateu 24:27), dhe në këtë Besëlidhje të Fundit (3:81), thërret për dërgimin e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes pasi që të gjitha shkrimet të jenë dorëzuar. Funkzioni kryesor i të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes është për të pastruar shkrimet dhe për t'i bashkuar ato në një lajm të përbotshtëm për këtë botë nga Krijuesi dhe Mbajtësi i kësaj bote.

Kjo profeci madhore e shkrimeve të shenjta tashmë është përmbushur. I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes ka arritur, i përkrahur me provë materiale të pakalueshme (shih Shtojcën Dy). Procesi i pastrimit dhe bashkimit tashmë ka filluar. Plani i Zotit përkrahet me forcat e padukshme të Zotit, dhe dimensionet vigane të këtij plani hyjnor manifestohen në demaskimin bashkëkohor të fetarëve të rrejshëm, dhe heqjes së barrierave anti-liri siç ishte Muri i Berlinit, Perdja e Hekurt, dhe perdja bambu.

Tash e tutje, është vetëm një fe e pranueshme për Zotin – Nënshtrimi.

Kushdo që i nënshtrohet Zotit dhe ia kushton adhurimin VETËM Zotit është “i Nënshtruar.” Pra, dikush mund të jetë i Nënshtruar Jahudi, i Nënshtruar i Krishterë, i Nënshtruar Budist, i Nënshtruar Hindu, ose i Nënshtruar Mysliman.

E vetmja fe e pranueshme nga Zoti është Nënshtrimi.

[3:19]

Kushdo që pranon tjetër pos Nënshtrimit si fe të tij, nuk do i pranohet, dhe në Përjetësi, do të jetë me dështakët.

[3:85]

(Rashad Khalifa, Nëntor, 1989)

Zotëruesi, Zoti juaj, do të rrisë një profet si unë nga mes të afërmve tuaj; atë ta dëgjoni. (Moisiu te Ligji i Përtërirë 18:15)

Unë do të rris për ta një profet si ti nga mes të afërmve të tyre, dhe do të vë fjalët e Mia në gojën e tij; ai do iu tregojë atyre të gjitha që e urdhëroj. Nëse cilido njeri nuk do të dëgjojë fjalët e Mia të cilat ai i flet në emrin Tim, Unë Vetë do i kërkoj llogari.
(Ligji i Përtërirë 18:18-19)

Unë do i lutem Atit, dhe Ai do t'ju japë juve një Ngushëllues tjetër – që të jetë me ju përgjithmonë: FRYMËN E SË VËRTETËS.
(Jezusi te Gjoni 14:16-17)

Kur SHPIRTI I SË VËRTETËS vjen te ju, ai do t'ju udhëzojë në çdo të vërtetë, dhe do t'ju lajmërojë juve gjërat që do të vijnë.
(Jezusi te Gjoni 16:13)

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

“Ja, unë po dërgoj të dërguarin Tim për të përgatitur rrugën para Meje; dhe papritmas do të vij në tempull Zotëruesi që e kërkon, dhe i dërguari i besëlidhjes të cilin e dëshironi.

Po, do të vijë, thotë Zotëruesi i ushtrive. Por kush do të mund të durojë ditën e ardhjes së tij? Dhe kush do të mund të qëndrojë kur ai shfaqet? Se ai është si zjarri i rafinuesit ... ai do të ulet duke pastruar” (Malakia 3:1-3)

Kur VETËM Zoti përmendet, zemrat e atyre që nuk besojnë në Përjetësi tkurren me neveri. Por kur të tjerët përmenden përveç Tij, ata janë të kënaqur. [39:45]

Në natën e 27 të Ramazanit, 13 Para Hixhrës (610 Pas Krishtit), profeti Muhamed (shpirti – personi i vërtetë – jo trupi) u mor në pikën më të lartë të mundshme, me miliona vjet drite nga planeti Tokë, dhe ky Kuran u vu në zemrën e tij (2:185, 17:1, 44:3, 53:1-18, 97:1).

Më pas, Kurani u lëshua në memorien e Muhamedit, me ndërmjetësimin e Gabrielit, gjatë një periudhe 23 vjeçare, prej 610 deri në 632 Pas Krishtit (17:106). Në momentin e lëshimit, Muhamedi me përpikëri e shkroi me vetë dorën e vet (Shtojca 28). Çka la Muhamedi ishte Kurani i plotë, i shkruar në renditjen kronologjike të shpalljes, me udhëzime për të renditur shpalljet në renditjen e vendosur nga Zoti.

Gjatë procesit të ri-renditjes, shkruesit që idolizuan Profetin shtuan dy strofa në fund të Sures 9, sures së fundit që u shpall në Medinë. Ky veprim blasfemues rezultoi në një luftë 50 vjeçare ndërmjet Ali Ibn Ebi Talibit dhe përkrahësve të tij në njërin anë dhe shtrembëruesve të Kuranit në anën tjetër. Lufta përfundoi kur Hussein ibn Ali dhe familja e tij ranë dëshmorë në Qerbela.

Ishte sunduesi Umajad, Maruan Ibn Al-Hakam (vdiq në 684 Pas Krishtit) që e shkatërroi Kuranin origjinal që u shkrua nga dora e Muhamedit, “nga frika se do të shpërthenin grindje të reja.”

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes ka paraqitur prova të pakalueshme që 9:128-129 nuk përkasin në Kuran (Shtojca 24). Me heqjen e këtyre strofave të rrejshme, Kurani më në fund është restauruar. Gjenerata e jonë është gjenerata e parë që pranon Kuranin në formën e tij të pastruar dhe përfunduar (shih Shtojcën 1 dhe 28).

PËRMBAJTJA

DEKLARATA	vi
HYRJE.....	x
Surja 1: Çelësi (El-Fatihah)	1
Surja 2: Mëshjtjerra (El-Bekare)	2
Surja 3: Amramitët (Al-Imran)	25
Surja 4: Gratë (En-Nisa)	37
Surja 5: Banketi (El-Ma'ideh)	51
Surja 6: Bagëtia (El-En'am)	61
Surja 7: Purgatori (El-A'raf).....	73
Surja 8: Plaçka e luftës (El-Enfal)	85
Surja 9: Ultimatum (Bera'ah).....	90
Surja 10: Jona (Junus).....	100
Surja 11: Hudi (Hud)	107
Surja 12: Jozefi (Jusuf)	114
Surja 13: Bubullima (Er-Rad).....	120
Surja 14: Ibrahim (Ibrahim).....	123
Surja 15: Lugina El-Hixhr (El-Hixhr).....	127
Surja 16: Bleta (En-Nahl)	130
Surja 17: Fëmijët e Izraelit (Beni Israel)	137
Surja 18: Shpella (El-Kehf)	144
Surja 19: Maria (Merjem)	150
Surja 20: T.H. (Ta Ha).....	154
Surja 21: Profetët (El-Enbija')	160
Surja 22: Shtegtimi (El-Haxh).....	165
Surja 23: Besimtarët (El-Mu'minun)	170
Surja 24: Drita (El-Nur)	174
Surja 25: Kodi ligjor (El-Furkan)	179
Surja 26: Poetët (Esh-Shu'ara').....	183
Surja 27: Milingona (An-Neml)	189
Surja 28: Histori (El-Kasas).....	193
Surja 29: Merimanga (El-'Ankebut)	199
Surja 30: Romakët (Er-Rum)	203
Surja 31: Llukmani (Lukman)	206
Surja 32: Përulja (Es-Sexhde).....	208
Surja 33: Grupet e armatosura (El-Ahzab)	210
Surja 34: Sheba (Sebe').....	215
Surja 35: Nismëtari (Fatir)	219
Surja 36: J.S. (Ja Sin)	222
Surja 37: Renditësit (Es-Saffat)	225
Surja 38: S. (Sad).....	230
Surja 39: Turmat (Ez-Zumer).....	233
Surja 40: Falësi (Gafir)	238
Surja 41: Hollësishtëm (Fussilet).....	243
Surja 42: Konsultimi (Esh-Shura)	246
Surja 43: Stolitë (El-Zuhruf)	250
Surja 44: Tymi (Ed-Duhan).....	254
Surja 45: Gjunjézimi (El-Xhathije)	255
Surja 46: Kodrat e rërës (El-Ahkaf)	257
Surja 47: Muhamedi (Muhammed)	260
Surja 48: Fitore (El-Fet'h).....	262
Surja 49: Muret (El-Huxhurat)	264
Surja 50: K. (Kaf).....	265
Surja 51: Drejtuesit e erërave (Edh-Dharijat)	267
Surja 52: Mali Sinai (Et-Tur)	268
Surja 53: Yjet (En-Nexhm).....	270
Surja 54: Hëna (El-Kamer)	272
Surja 55: Mirëbërësi (El-Rrahman)	273
Surja 56: E Pashmangshmja (El-Vakia).....	275
Surja 57: Hekuri (El-Hadid)	278
Surja 58: Debati (El-Muxhadile).....	280

Surja 59: Eksodi (El-Hashr).....	282
Surja 60: Testi (El-Mumtehineh).....	283
Surja 61: Kolona (Es-Saff).....	285
Surja 62: E Premtja (El-Xhumua).....	286
Surja 63: Hipokritët (El-Munafikun).....	286
Surja 64: Fajësim i dyanshëm (Et-Teghabun).....	287
Surja 65: Shkurorëzimi (Et-Talaq).....	288
Surja 66: Ndalesa (Et-Tahrim).....	289
Surja 67: Mbretërimi (El-Mulk).....	290
Surja 68: Lapsi (El-Kalem).....	291
Surja 69: E pakontestueshme (El-Hakah).....	293
Surja 70: Lartësitë (El-Me'arixh).....	294
Surja 71: Nuhu (Nuh).....	295
Surja 72: Xhinët (El-Xhinn).....	296
Surja 73: I Mbuluar (El-Muzzemmil).....	298
Surja 74: Sekreti i mbuluar (El-Muddeththir).....	298
Surja 75: Ringjallja (El-Kijame).....	300
Surja 76: Njeriu (El-Insan).....	301
Surja 77: Të Nisur (El-Murselat).....	302
Surja 78: Ngjarja (El-Nebe').....	303
Surja 79: Rrëmbyesit (El-Nazi`at).....	304
Surja 80: U Mrrrol (`Abese).....	306
Surja 81: Mbështjellja (Et-Tekuir).....	307
Surja 82: Çarja (El-Infitar).....	308
Surja 83: Mashtruesit (El-Mutaffifin).....	308
Surja 84: Plasja (El-Inshikak).....	309
Surja 85: Galaktikat (El-Buruxh).....	310
Surja 86: Ylli i ndritshëm (Et-Tarik).....	310
Surja 87: Më i Larti (El-A`la).....	311
Surja 88: Kaplimi (El-Ghashije).....	311
Surja 89: Agimi (El-Fexhr).....	312
Surja 90: Qyteza (El-Beled).....	313
Surja 91: Dielli (El-Shems).....	314
Surja 92: Nata (El-Lejl).....	314
Surja 93: Paraditja (Ed-Duha).....	315
Surja 94: Qetësimi shpirtëror (El-Inshirah).....	315
Surja 95: Fiku (Et-Tin).....	315
Surja 96: Embrioni (El-`Alak).....	316
Surja 97: Paracaktimi (El-Kadr).....	316
Surja 98: Prova (El-Bejjine).....	316
Surja 99: Dridhja (El-Zelzeleh).....	317
Surja 100: Vringëlluesit (El-`Adijat).....	317
Surja 101: Tronditja (El-Kari`ah).....	317
Surja 102: Grumbullim (Al-Takaathur).....	318
Surja 103: Pasdita (El-`Asr).....	318
Surja 104: Përgojuesi (El-Humezeh).....	318
Surja 105: Elefanti (El-Fil).....	318
Surja 106: Fisi Kurejsh (Kurejsh).....	319
Surja 107: Bamirësia (El-Ma`un).....	319
Surja 108: Dhurata (El-Keuther).....	319
Surja 109: Mosbesimtarët (El-Kafirun).....	319
Surja 110: Triumfi (En-Nasr).....	319
Surja 111: Ferrat (El-Mesed).....	320
Surja 112: Absolutësia (El-Ihlas).....	320
Surja 113: Agu (El-Felek).....	320
Surja 114: Njerëzit (El-Nas).....	320
SHTOJCAT.....	323

HYRJE

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

Ky është lajmi i fundit i Zotit për njerëzimin. Të gjithë profetët e Zotit kanë ardhur në këtë botë dhe të gjitha shkrimet janë dorëzuar. Ka ardhur koha për tu pastruar dhe konsoliduar të gjitha lajmet e dorëzuara nga profetët e Zotit në një lajm, dhe për të shpallur që tash e tutje, është vetëm një fe e pranueshme për Zotin, “Nënshtrimi” (3:19, 85). “Nënshtrimi” është feja me të cilën e njohim autoritetin absolut të Zotit, dhe arrijmë bindje të paluhatshme që VETËM Zoti posedon gjithë fuqinë; asnjë entitet tjetër nuk ka fuqi që është e pavarur prej Tij. Rrjedhoja e natyrshme e një perceptimi të tillë është përkushtimi i jetëve tona dhe adhurimit tonë absolutisht ndaj VETËM Zotit. Ky është Urdhri i Parë në të gjitha shkrimet, duke përfshirë Besëlidhjen e Vjetër, Besëlidhjen e Re, dhe Besëlidhjen e Fundit.

Dëgjo, o Izrael! Zoti, Zotëruesi ynë është Një Zot!
Prandaj ta adhurosh Zotin, Zotëruesin tënd
me gjithë zemër,
me gjithë shpirt,
me gjithë mendje,
dhe me gjithë forcën tënde.

[Ligji i Përtërirë 6:4-5, Luka 12:29-30, Kuran 3:18]

Le të meditojmë për Zotin, për vetitë e Tij madhështore, që i shkon të adhurohet si qenie e vetëdijshme vetë-ekzistuese i Gjithëpranishëm, i Gjithëfuqishëm, i Gjithëdijshëm, që heqë gjithë paditurinë dhe papastërtitë nga mendja dhe pastron dhe mprehë intelektin.

[Gajatri Mantra, Jajur Veda]

Përderisa çdo fe është prishur me shpikje, tradita, dhe doktrina të rreme idhujtareske, mund të ketë të “Nënshtruar” brenda secilës fe. Mund të ketë të Nënshtruar që janë të Krishterë, Jahudi, Mysliman, Hindu, Budist, ose çfarëdo tjetër. Këta të Nënshtruar, bashkërisht, përbëjnë të vetmen fe të pranueshme për Zotin. Siç theksohet nga tema në faqen e parë të këtij libri, të gjithë të Nënshtruarit që përkushtohen ndaj VETËM Zotit, dhe nuk ngritin idhuj përkrah Zotit, shpengohen në mbretërinë e përjetshme të Zotit (2:62). Kriteri i të nënshtruarve të vërtetë është që ata nuk do të gjejnë asgjë të kundërshtueshme në Kuran.

Me ardhjen e kësaj Besëlidhje, lajmi i Zotit për botën është tash i plotë. Tash i kemi marrë përgjigjet e pritura shumë gjatë për pyetjet tona më urgjente – kush jemi ne, qëllimi i jetës tonë, si erdhëm në këtë botë, ku shkojmë prej këtu, cila fe është e duhura, a ndodhi evolucioni apo krijimi, etj.

Disa mund të pyesin veten: “Pse priti Zoti gjithë këtë kohë për ta përkryer dhe konsoliduar lajmin e Tij? Çka është puna e të gjithë njerëzve që nga Ademi që nuk e pranuan shkrimin e plotë?” Kurani i përgjigjet kësaj pyetje në 20:52. Aq më shumë, është çështje e statistikore e thjeshtë që popullata e botës nga fillimi deri tani nuk i kaloi 7,000,000,000. Nga tani deri te fundi i botës, 2280 Pas Krishtit. (Shtojca 25), vlerësohet që popullsia totale e botës do i kalojë 75,000,000,000. Pra, shumica e gjerë e njerëzve janë të paracaktuar të pranojnë lajmin e pastruar dhe të konsoliduar të Zotit (shih diagramin).

Popullata e botës nga tani (1990) deri në fund të botës (2280).


[Pjesa e zezë paraqet popullatën e botës që nga Ademi deri në 1990]

Para zanafillës

E tëra filloi disa bilion vjet më parë kur një prej krijesave të Zotit me rang të lartë, Dreqi, zhvilloi një ide kryelartë që ai do të mund të drejtonte (udhëhiqte) një pushtet si zot i pavarur përveç Zotit. Kjo sfidë ndaj autoritetit absolut të Zotit jo vetëm që ishte blasfemuese, por ishte edhe e pasaktë. Dreqi ishte i padijshëm për faktin që vetëm Zoti posedon aftësinë të jetë zot, dhe që është punë më e madhe të jesh zot se sa që ia morri mendja atij. Ishte uni (egoja) – mendjemadhësi e përkrahur me padije – që çoi Dreqin të besojë që ai do të mund të kujdesej për një pushtet (fushëveprim) si zot, dhe ta drejtojë atë pa sëmundje, vuajtje, luftëra,

aksidente, dhe kaos. Shumica e gjerë e krijesave të Zotit nuk u pajtuan me Dreqin. Por, një pakicë shumë e vogël egoiste që u pajtua me të në shkallë të ndryshme ishin me biliona. Prandaj, një grindje e thellë shpërtheu brenda Shoqërisë Qiellore (38:69). Sfida e padrejtë e kryengritësve ndaj autoritetit absolut të Zotit u adresua dhe u zgjidh në mënyrën më efikase. Pas që iu dhanë kryengritësve raste të mjaftueshme për të dënuar krimin e tyre dhe për t’iu nënshtruar Atij, Zoti vendosi që t’i dëbojë kryengritësit më të rreptë në një anije kozmike të quajtur Tokë, dhe t’iu japë atyre edhe një rast tjetër që ta shpengojnë veten.

Nëse pretendon që mund të pilotosh një aeroplan, mënyra më e mirë për të testuar pretendimin tënd është të të jepet një aeroplan dhe të kërkohet nga ti që ta pilotosh atë. Kjo është saktësisht çka Zoti vendosi të bëjë si reagim ndaj pretendimit të Dreqit që ai do të mund të ishte zot; Zoti e caktoi atë zot të përkohshëm në këtë pikël shumë të vogël të quajtur Tokë (2:30, 36:60). Sa për ata që u pajtuan me Dreqin, atyre iu dha rasti që të vrasin unin e tyre dhe t’i nënshtrohen autoritetit absolut të Zotit. Përderisa shumica e gjerë e krijesave fajtoresh shfrytëzoi rastin, një pakicë shumë e vogël që përbëhet nga rreth 150 bilion krijesa nuk arriti të shfrytëzojë rastin nga kjo ofertë (33:72).



Grindja në Shoqërinë Qiellore çoi deri te klasifikimi i krijesave të Zotit në kategori të ndryshme:

(1) Engjëjt

Krijesat të cilat kurrë nuk e vunë në dyshim autoritetin absolut të Zotit u klasifikuan si engjëj; ata e dinin që vetëm Zoti posedon aftësinë dhe kualifikimet që të jetë zot. Shumica e gjerë e krijesave të Zotit – numra të panumërueshëm – përkasin në këtë kategori. Numri i engjëjve është aq i madh, madje edhe engjëjt nuk e dinë sa prej tyre ekzistojnë; vetëm Zoti e di numrin e tyre (74:31).

(2) Kafshët

Edhe pse engjëjt propozuan që kryengritësit dhe udhëheqësi i tyre duhet të dëbohen nga mbretëria e Zotit (2:30), i Mëshirshmi dëshiroi t’iu japë kryengritësve një rast për të dënuar krimin e tyre, të pendohen, dhe t’i nënshtrohen autoritetit absolut të Tij (33:72). Siç paraqitet në diagramin më lartë, shumica e gjerë e kryengritësve shfrytëzoi rastin nga oferta hirplotë e Zotit për të hyrë përsëri në mbretërinë e Tij. Ata u pajtuan t’i vrasin egot e tyre, të vijnë në këtë botë për të luajtur rol të nënshtruar, si shlyerje për blasfeminë e tyre. Si shpërblim për rolin e tyre të nënshtruar në këtë botë, këto krijesa shpengohen prapa në mbretërinë e përjetshme të Zotit (6:38). Kali, qeni, lisi, dielli, hëna, yjet, si edhe fëmijët e deformuar dhe ata të vonuarit në mendje janë mes krijesave inteligjente që dënuan krimin e tyre dhe u penduan:

A nuk e kupton që Zotit i bie në përlulje çdokush në qiej dhe tokë, dhe dielli, dhe hëna, dhe yjet, dhe malet, dhe lisat, dhe kafshët, dhe shumë njerëz? Shumë të tjerë mes njerëzve parashtrihen në dënim. (22:18)

Yjet dhe lisat përlulen. (55:6)

Kali nuk ka ego (un). Pronari i kalit mund të jetë i pasur ose i varfër, i gjatë ose i shkurtër, i trashë ose i hollë, i ri ose i vjetër, dhe kali do iu shërbejë të gjithëve. Qeni nuk ka ego; do të lëvizë bishtin për pronarin e tij, pa marrë parasysh sa i pasur ose i varfër pronari mund të jetë. Dielli lind dhe perëndon çdo ditë saktësisht në kohën e caktuar nga Zoti. Hëna ndjek orbitën e saj të sinkronizuar rreth tokës, pa as edhe devijimin më të vogël. Trupi i njeriut – veshje e përkohshme – i përket Tokës; si i tillë është i nënshtruar. Zemra, mushkëritë, veshkat, dhe organe të tjera, i kryejnë funksionet e tyre pa komandimin tonë.

(3) Njerëzit

Kryengritësit e rreptë – njerëzit dhe xhinët – refuzuan ta dënojnë krimin e tyre, dhe zgjedhën që të jenë dëshmitarë të demonstrimit të pretendimit të Dreqit. Këto krijesa egoiste që nuk arritën t’i nënshtrohen autoritetit absolut të Zotit, edhe kur iu dha rasti që të bëjnë ashtu, u ndanë në gjysmë. Gjysma që ishin më

pak të bindur me pikëvështrimin e Dreqit u bënë të kategorizuar si njerëz. Edhe pse ata ushqyen dyshime për pretendimin e Dreqit, ata nuk arritën të marrin vendim të palëkundur sa i përket autoritetit absolut të Zotit. Është egoja që i parandaloi këto krijesa nga vlerësimi i gjithëfuqishmërisë së Zotit, është egoja që i parandaloi ato nga nënshtrimi kur një rast i tillë iu ofrua atyre (33:72), dhe është egoja që qëndron ndërmjet shumicës prej nesh dhe shpengimit në mbretërinë e Zotit (25:43). Kjo është pse “Vrisnie egon tuaj” është një prej urdhrave të parë në Kuran (2:54).

(4) Xhinët

Gjysma tjetër e krijesave fajtohe, ato që anuan më afër pikëvështrimin të Dreqit dhe shfaqën egot më të mëdha, u klasifikuan si xhin. Ishte plani i Zotit që të caktojë një xhin për secilën qenie njerëzore nga lindja deri në vdekje. Shoqëruesi xhin përfaqëson Dreqin dhe vazhdimisht promovon pikëvështrimin e tij (50:23, 27). Edhe xhinin edhe njeriut iu jepet një rast i çmueshëm në këtë botë për të ri-arsimuar veten, dënuar egoizmin e tyre, dhe shpenguar veten duke iu nënshtruar autoritetit absolut të Zotit. Sa herë që një qenie njerëzore lindë, një xhin lindë dhe caktohet te njeriu i ri. Mësojmë nga Kurani që xhinët janë pasardhësit e Dreqit (7:27, 18:50). Kur një qenie xhin lindë dhe ai i caktohet një qenieje njerëzore, xhini mbetet shoqëruesi i vazhdueshëm i njeriut deri sa të vdesë njeriu. Xhini pastaj lirohet, dhe jeton për ca shekuj. Edhe nga njerëzit edhe nga xhinët kërkohet që të adhurojnë vetëm Zotin (51:56).

Zoti nuk do robotë

Grindja në Shoqërinë Qiellore siç thuhet në 38:69 dhe përshkruhet më lartë vërteton që krijesat e Zotit posedojnë lirinë e zgjedhjes; ata kanë mendje të veta. Kryengritja e një pakice shumë të vogël mes krijesave të Zotit ka shërbyer për të theksuar faktin e mrekullueshëm që krijesat e Zotit i shërbejnë Atij sepse e çmojnë madhësitinë e pakufi të Tij. Pa atë kryengritje, ne nuk do të kishim ditur që liria është dhurata e Zotit për krijesat e Tij.

Mirëbërësi, i Mëshirshmi

Madje edhe në dimensionin e botës tonë, cilado ndërmarrje pret nga punëtorët e saj që të jenë besnik dhe të përkushtuar ndaj mbarëvajtjes së ndërmarrjes. Nëse një punëtor nuk është krejtësisht i përkushtuar ndaj ndërmarrjes, ose tregohet që ka besnikëri të ndara, ai menjëherë largohet. Pasi që njerëzit dhe xhinët anuan kah Dreqi, pastaj refuzuan ofertën e Zotit për të rishikuar veprën e tyre kryengritëse, engjëjt pritën që Dreqi dhe aleatët e tij të dëboheshin nga mbretëria e Zotit (2:30). Ishte mëshirë e paanë nga Zoti që Ai na dha neve këtë rast shtesë që të dënojmë krimin tonë dhe që të shpengojmë veten.

Për të zbatuar këtë plan të shpengimit jashtëzakonisht të mëshirshëm, Zoti “krijoi vdekjen” (67:1-2). Planin hyjnor kishte nevojë për sjelljen e kryengritësve në një ekzistencë të re, ku ata nuk do të mbanin mend asgjë nga grindja qiellore. Nën rrethanat e kësaj jete, njerëzit dhe xhinët pranojnë edhe lajmet e Zotit edhe lajmet e Dreqit, pastaj zgjedhin lirisht cilëndo anë. Në bazë të vendimit të tyre me vetë vullnetin e lirë të tyre, ata ose shpengohen në mbretërinë e Zotit, ose bëhen përjetësisht të dëbuar me Dreqin.

Pushteti i përkohshëm i Dreqit

Për të theksuar sa shumë i parëndësishëm është pushteti i projektuar i Dreqit, Zoti krijoi një bilion galaktika, një bilion trilion yje, brenda një gjithësie të gjerë që shtrihet me biliona vjet dritë. Nëse udhëtojmë kah Dielli (rreth 150,000,000 km) me shpejtësinë e dritës, do të arrijmë te ai për 8 minuta. Nëse vazhdojmë, do të arrijmë në kufi të Galaktikës Rruga e Qumështit pas 50-70,000 vitesh me shpejtësi e drite. Për të arritur te galaktika më e afërt, do të na duhen 2,000,000 vite udhëtim me shpejtësinë e dritës, dhe ekzistojnë së paku 2,000,000,000 galaktika në “gjithësinë tonë.” Me teleskopin më të fuqishëm, toka është krejtësisht e padukshme nga fundi i galaktikës tonë, e le më nga fundi i gjithësisë tonë. Lëre më që Zoti krijoi gjithësinë tonë shumë të gjerë, por Ai krijoi edhe gjashtë të tjera, edhe më të mëdha që e mbështjellin gjithësinë tonë (2:29, 67:3). Zoti pastaj e njoftoi Dreqin që një pikël shumë e vogël përbrenda gjithësisë më të vogël dhe më të brendshme, e quajtur Tokë, do të jetë fushëveprimi (pushteti) i tij. Planin e Zotit i duheshin njerëzit dhe xhinët në një gjithësi që nuk mund të durojë praninë fizike të Tij (7:1430). Pra, Dreqi e sundon mbretërinë e imët të tij larg nga prania fizike e Zotit, edhe pse me njohurinë dhe drejtimin e plotë të Zotit. Gjithashtu

duhet të përmendet që numri i kryengritësve që u penduan ishte aq i madh, sa që planeti tokë nuk do të kishte mundur t'i strehojë të gjithë ata. Siç ndodhë, kafshët janë shumë më të shumta në numër se njerëzit në këtë planet. Do të duhej një tokë e pamenaxhueshme për të strehuar të gjithë kryengritësit e penduar. Për këtë arsye janë vendosur krijesa të panumërta në hapësirën kozmike.

Ademi dhe Eva

Trupi i qenies njerëzore të parë u formua në tokë nga engjëjt e Zotit, në përputhje me instruksionet e Zotit (7:11). Zoti pastaj ia caktoi personin e parë, Ademin, atij trupi. Kur Zoti i njoftoi engjëjt që ata do të iu shërbejnë njerëzve përgjatë periudhës së testimi – duke i ruajtur ata, duke lëvizur erërat, duke shpërndarë shiun dhe furnizimet, etj. – Dreqi ishte i vetmi që refuzoi “të bie në përlulje” (2:34, 15:31, 38:74). E shoqja e Ademit u klonua, me veti femërore, nga Ademi, dhe Zoti caktoi qenien njerëzore të dytë në trupin e saj. Përderisa trupat e zbrazët (pa shpirt) të Ademit dhe Evës mbetën këtu në tokë, shpirtrat e tyre, personat e vërtetë, banonin në Parajsë. Ademi dhe Eva mbetën në Parajsë për aq gjatë deri sa iu përmbajtën urdhrave të Zotit. Kur ata e dëgjuan Dreqin, ata pasqyruan natyrë njerëzore me të meta në të gjithë ne, dhe menjëherë i takuan pushtetit të Dreqit poshtë në Tokë – “trupat e tyre iu bënë të dukshëm atyre” (7:20, 20:121). Pjesa tjetër është histori.

Dreqi: Babai i të gjithë xhinëve

Që të vihen xhinët dhe njerëzit në test u desh që Dreqi të riprodhonte sa herë që një qenie njerëzore ishte e lindur. Siç përmendet më lartë, sa herë që një qenie njerëzore lindë, një qenie xhin lindë për të shërbyer si shoqërues i vazhdueshëm i personit njeri Secila qenie njerëzore është subjekt i përpjekjeve të pareshtura të përfaqësuesit të Dreqit që jeton në trupin e njëjtë nga lindja deri në vdekje. Përfaqësuesi i Dreqit mundohet ta bindë shoqëruesin njeri me pikëvështrimin e Dreqit: që vetëm Zoti nuk është mjaft. Në Ditën e Gjykimit, shoqëruesi xhin shërben si dëshmitar kundër homologut njeri (43:38, 50:23, 27). Shumë shoqërues xhin konvertohen në pikëvështrimin e Dreqit nga shoqëruesit njerëz.

Zoti nuk e la qenien njerëzore të papërgatitur. Për të ndihmuar njeriun në rastin e tyre të fundit për të rishikuar blasfeminë e tyre, secili person lindë me njohuri instiktive që VETËM Zoti, dhe askush tjetër, është Zotëruesi dhe Sunduesi ynë (7:172-173). Xhinëve nuk iu dha kjo njohuri instiktive, por atyre iu jepet një jetëgjatësi më e gjatë dhe mundësi më të mëdha për të studiuar shenjat e Zotit përgjatë gjithësisë më të brendshme. Pasi që ata përfaqësojnë pikëvështrimin e Dreqit, natyra e tyre instiktive anon fuqimisht në favor të politeizmit. Përveç instinktit të futur brenda nesh që të adhurojmë vetëm Zotin, Zoti dërgoi të dërguarë për të na ndihmuar neve që ta shpengojmë veten. Me të gjithë këta faktor parasysh, tash mund ta vlerësojmë faktin që krimi i vetëm i pafalshëm (nëse mbahet deri në vdekje) është adhurimi i idhujve: të besuarit që ndokush përveç Zotit ka ndonjë fuqi.

Dyzet vite periudhë hirësie

Qenies njerëzore i jepen dyzet vite për të studiuar, për të shikuar përreth, pasqyruar, dhe shqyrtuar të gjitha pikëvështrimet para se të marrë këtë më të rëndësishmin vendim – që t'i përmbahet pikëvështrimit të Dreqit, ose t'i përmbahet autoritetit absolut të Zotit. Kushdo që vdes para moshës dyzetvjeçare zgjidhet nga Zoti për shpengim për shkak të rrethanave që janë të njohura vetëm për Zotin. Kushdo që vdes para moshës 40 vjeçare shkon në Parajsë (46:15, Shtojca 32). Mëshira e paanë e Zotit është e evidente nga fakti që madje edhe atyre që besojnë në Kuran iu vjen vështirë të pranojnë një ligj hyjnor aq të mëshirshëm.

Të dërguarit e Zotit dorëzuan lajmet e mira për rastin tonë të dhënë nga Zoti që ta shpengojmë veten, dhe ata u përkrahën me shenja të mëdha. Kur Moisiu shkoi te Faraoni, ai u përkrah me mrekulli të tilla si shndërrimi i shkopit të tij në gjarpër. Jezusi krijoi zogj të gjallë nga balta me lejen e Zotit, i shëroi të lebrosurit dhe të verbrit me lejen e Zotit, dhe ngjalli të vdekurin me lejen e Zotit. Profeti Muhamed, i dërguari i Zotit që dorëzoi këtë Besëlidhje të Fundit, nuk shfaq mrekulli të tilla (10:20). Vetë Kurani ishte mrekullia që përkrahte misionin e Muhamedit (29:50-51). Ishte mençuria hyjnore që ndau Mrekullinë e Kuranit nga Muhamedi për 14 shekuj. Tash që i kuptojmë dimensionet e rëndësishme të mrekullisë matematikore të Kuranit (Shtojca 1), e kuptojmë që miliona njerëz do të kishin adhuruar Muhamedin si zot i mishëruar nëse kjo Mrekulli do të zbulohet nëpërmjet tij.

Provë e autorësisë: Materiale, e prekshme, e pakundërshtueshme.

Me ardhjen e epokës së kompjuterëve, zbulojmë që kodi matematikor i Kuranit është “Një prej mrekullive më të mëdha” siç thuhet në 74:30-35. Përderisa mrekullitë që u janë dhënë të dërguarve paraprak ishin të kufizuara në kohë dhe hapësirë, mrekullia e Kuranit është e përhershme. Vetëm disa njerëz ishin dëshmitarë të mrekullive të Moisiut dhe Jezusit, por mrekullia e Kuranit mund të shihet nga kushdo kurdo. Aq më shumë, mrekullia e Kuranit dokumenton dhe vërteton të gjitha mrekullitë paraprake (5:48).

Siç jepet hollësisht në Shtojcën 1, mrekullia matematikore e Kuranit është e bazuar në numrin “19.” Për t’ia treguar këtë mrekulli mbresëlënëse edhe lexuesit, fjala “Zot” përgjatë tekstit [Anglisht të Rashad Khalifës] është me shkronja të mëdha.. Ndodhja totale e kësaj fjale më të rëndësishme tregohet në fund të Kuranit që është 2698. Ky total është shumëfish i numrit 19. Plus, kur i mbledhin numrat që i janë caktuar secilës strofë ku ndodhet fjala “Zot”, totali del të jetë 118123, gjithashtu shumëfish i numrit 19 (19x6217).

Prova të autorësisë dhe vërtetësisë që të verifikohen nga lexuesi

Përveç hartimit të jashtëzakonshëm matematikor të Kuranit, gjejmë një numër të madh të fakteve Kuranore të cilat janë vërtetuar ose teorizuar nga shkencë moderne. Ja ku janë disa shembuj të informatave shkencore të përparuara:

1. Toka ka formën e vezës (39:5, 79:30).
2. Toka nuk është e palëvizshme; lëviz vazhdimisht (27:88).
3. Dielli është burim i dritës, përderisa hëna e reflekton atë (10:5, 25:61, 71:16).
4. Proporcioni i oksigjenit zvogëlohet përderisa ngjitemi drejt qiellit (6:125).
5. “Teoria e Bing Bangut (Eksplodimit të Madh) konfirmohet (21:30).
6. “Teoria e Zgjerimit të Gjithësisë” konfirmohet (51:47).
7. Gjithësia filloi si masë e gatzë (41:11).
8. Evolucioni është fakt; përbrenda llojeve të caktuara, evolucioni është proces i udhëhequr hyjnisht (21:30, 24:45, 32:7-9, 18:37, 15:28-29, 7:11, 71:13-14, Shtojca 31).
9. Fara e burrit e përcakton gjininë e bebes (53:45-46).

Asnjë gjejur

Gjithaq e mrekullueshme është mungesa e gjejurave në Kuran. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur marrim parasysh dominimin e paditurisë dhe besëtytnive në kohën e shpalljes së Kuranit. Për shembull, interpretimi më i respektuar mes Myslimanëve tradicional është ai i Ibn Kathir-it. Në këtë referencë të famshme, të shkruar me shekuj pas Profetit, lexojmë që toka bartet mbi 40,000 brirë të një demi gjigant, që qëndron mbi një balenë gjigante (shih interpretimin e Ibn Kathir-it të Strofës 68:1).

Madje edhe aq vonë sa në vitin 1975, dhe në të njëjtin vend ku u shpall Kurani, rektori i Universitetit Islamik të Medinës, në Arabinë Saudite, Sheikh Abdul Aziz Ben Baz, deklaroi që toka është e rrafshët dhe nuk lëvizë (shih shtesën)!!



Përkthim nga libri i Ben Baz-it, Faqe 23: “Sikur toka të ishte duke u rrotulluar siç pretendojnë ata, vendet, malet, lisat, lumenjtë, dhe oqeanet nuk do të kishin themel dhe njerëzit do të shihnin vendet e lindjes duke lëvizur kah perëndimi dhe vendet e perëndimit duke lëvizur kah lindja.”

Lumturi të përkryer: Tash dhe përgjithmonë

Njëri prej synimeve më të pakapshme të secilës qenie njerëzore është “Lumturia.” Kurani e zbulon sekretin e arritjes së lumturisë së përkryer në këtë jetë dhe përgjithmonë. Mësojmë nga Kurani që lumturia është veti e veçantë e shpirtit. Pra, një trup që arrin të gjitha sukseset materiale për të cilat digjet – para, fuqi, famë, etj. – shpesh i përket një personi të palumtur. Lumturia varet plotësisht nga shkalla e rritjes dhe zhvillimit të

arritur nga shpirti, personi i vërtetë. Kurani furnizon hartë të hollësishme drejt lumturisë së përkryer edhe për trupin edhe për shpirtin, edhe në këtë botë edhe në Përjetësinë e përhershme (Shtojca 5).

Në shumë strofa përgjatë kësaj Besëlidhjeje të vërtetuar, Zoti personalisht iu garanton besimtarëve lumturi, tash dhe përgjithmonë:

Absolutisht, aleatët e Zotit nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen. Ata janë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë. Për ta lumturi në këtë botë, dhe në Përjetësi. I tillë është ligji i pathyeshëm i Zotit. Ky është triumfi i vërtetë. [10:62-64]

Të gjithë besimtarët përbëjnë një fe të pranueshme

Siç pritet nga lajmi i fundit i Krijuesit, njëra prej temave të dukshme në Kuran është thirrja për bashkim mes të gjithë besimtarëve, dhe ndalimi i përsëritur i bërjes së dallimeve mes të dërguarve të Zotit. Nëse objekti i adhurimit është një dhe i njëjti, do të ketë unitet absolut mes të gjithë besimtarëve. Është faktori njeri, d.m.th. paragjykimet dhe përkushtimi ndaj njerëzve të tillë të pafuqi si Jezusit, Muhamedit, dhe të shenjtëve që shkaktojnë këto ndarje, urrejtje, dhe lufta të hidhura mes besimtarëve të keq-udhëzuar. Besimtari i udhëzuar është i përkushtuar ndaj VETËM Zotit, dhe kënaqet kur sheh ndonjë besimtar tjetër që është i përkushtuar ndaj VETËM Zotit, pa marrë parasysh se me çfarë emri e thërret besimtari i tillë fenë e vet.

Padyshim, kush beson, ata që janë Jahudi, të Krishterët, dhe të konvertuarit; kushdo që (1) beson në Zotin, (2) beson në Ditën e Fundit, dhe (3) çon jetë të drejtë, do të pranojnë shpërblimin e tyre nga Zotëruesi i tyre; nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen. [62, 5:69]

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

Siç paraqitet më hollësisht në Shtojcën 2, botimi i këtij libri shënon ardhjen e një epoke të re – epokës ku lajmet e Zotit, të dorëzuara nga të gjithë profetët e Tij, konsolidohen në një. Feja e vetme e Zotit, “Nënshtrimi,” do i dominojë të gjitha fetë e tjera (9:33, 48:28, dhe 61:9). Fetë e korruptuara të sotshme, duke përfshirë Jahudizmin, Krishterimin, Hinduizmin, Budizmin, dhe Islamin, thjeshtë do të shuhen, dhe “Nënshtrimi” do të mbizotërojë. Kjo nuk është shpresë e kotë e një qenieje njerëzore ose një grupi njerëzish; ky është ligji i pathyeshëm i Zotit (3:19, 9:33, 41:53, 48:28, 61:9, 110:1).

Rashad Khalifa
Tucson
Ramazan 26, 1409

Surja 1: Çelësi (El-Fatihah)

- [1] Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit.*
 [2] Lavdi Zotit, Zotëruesit të gjithësisë.
 [3] Mirëbërësit, të Mëshirshmit.
 [4] Sunduesit të Ditës së Gjykimit.
 [5] Vetëm Ty të adhurojmë, vetëm Ty të kërkojmë ndihmë.
 [6] Udhëzona në rrugën e drejtë;
 [7] në rrugën e atyre që i bekojnë, e jo të atyre që merituan zemërim, e as të humburve.

* 1:1 Strofa e parë në Kuran paraqet themelin mbi të cilin një mrekulli matematikore mbinjerëzore e bazuar në numrin 19 ndërtohet. Kjo thënie e rëndësishme përbëhet nga 19 shkronja arabe, dhe çdo fjalë në të ndodhet në tërë Kuranin në shumëfisha të 19-tës. (shih Shtojcat 1 & 29 për detajet).

*1:1-7 Surja 1 është dhuratë e Zotit për ne që të vendosim kontakt me Të përmes Lutjeve të Kontaktit, përditë. Ky fakt mbështetet nga një kompozicion matematikor tronditës, me kuptueshmëri të thjeshtë por imitim të pamundur që sfidon matematikanët më të mëdhenj në tokë, dhe i ndalë; është përtej aftësive njerëzore:

(1) Numri i sures, i pasuar nga numrat e strofave, njëri pas tjetrit, japin 1 1 2 3 4 5 6 7. Ky numër është shumëfish i 19-tës.

(2) Nëse e zëvendësojmë numrin e shkronjave për strofë në vend të numrave të strofave, atëherë del numri 1 19 17 12 11 19 18 43. Ky numër është gjithashtu shumëfish i 19-tës.

(3) Nëse fusim vlerën totale germore të çdo strofe, atëherë del numri 1 19 786 17 581 12 618 11 241 19 836 18 1072 43 6009. Ky numër është shumëfish i 19-tës.

Nr. i Strofës Nr. i Shkronjave Vlera Germore

1	19	786
2	17	581
3	12	618
4	11	241
5	19	836
6	18	1072
7	43	6009
Totalet	139	10143

(4) Numri i paraqitur më lart përfshinë të gjitha parametrat e Sures 1 dhe përbëhet nga 38 shifra (19x2).

(5) Vlen të përmendet se ky numër 38 shifror është i plotpjesëtueshëm me 19 edhe kur i shkruajmë përbërësit e tij në anën e kundërt, nga djathtas majtas, siç e praktikojnë arabët. Pra, 6009 43 1072 18 836 19 241 11 618 12 581 17 786 19 1 është gjithashtu shumëfish i 19-tës.

(6) Dukuritë matematikore të përmendura më lartë janë pjesë e shumë fenomeneve të jashtëzakonshme matematikore për t'i konfirmuar të gjitha detajet e pesë Lutjeve të përditshme të Kontaktit. (Shtojca 15).

(7) Më shumë dukuri mahnitëse jepen në Shtojcën Një. Pra, lexuesit i dorëzohet, që në hyrje, provë materiale që ky është lajmi i Zotit për botën.

Surja 2: Mështjerra (El-Bekare)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.M.*

[2] Ky shkrim është i pagabueshëm; fener për të drejtit;

Tre kategoritë e njerëzve

(1) Të drejtit

[3] që besojnë në të paparën, zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat),* dhe prej asaj që ne* i furnizojmë, japin.

[4] Dhe ata besojnë në atë që t'u shpall ty, dhe në atë që u shpall para teje,* dhe sa i përket Përjetësisë, janë plotësisht të sigurt.

[5] Janë të udhëzuar nga Zotëruesi i tyre; janë fituesit.

(2) Mosbesimtarët

[6] E sa për ata që nuk besojnë, është njëjtë për ta; i paralajmërove, apo nuk i paralajmërove, nuk mund të besojnë.*

[7] Zoti ua mbyll mendjet dhe dëgjimin, dhe sytë e tyre janë të mbuluar. Ata kanë vetëshkaktuar një ndëshkim të rëndë.

(3) Hipokritët (Dyfytyrëshat)

[8] E ka prej atyre që thonë, "Ne besojmë në Zotin dhe në Ditën e Fundit," përderisa nuk janë besimtarë.

[9] Përpiqen ta mashtrojnë Zotin dhe ata që besojnë, por e mashtrojnë vetëm veten pa e kuptuar.

[10] Në mendje kanë sëmundje. Si pasojë, Zoti ua shton sëmundjen. Ata i shkaktuan vetes ndëshkim që dhemb se gënjen.

[11] E kur u thuhet, "Mos bëni të këqija," thonë, "Por ne jemi të drejtë!"

[12] Në të vërtetë, ata janë keqbërës, por nuk e kuptojnë.

[13] E kur u thuhet, "Besoni si njerëzit që besuan," thonë, "A të besojmë si budallenjtë që besuan?" Në të vërtetë, ata janë budallenjtë, por nuk e dinë.

* 2:1 Këto iniziale (shkronja fillestare) mbetën fshehtësi e ruajtur hyjnisht për 1400 vjet. Tani, ne i njohim ato si përbërëse të rëndësishme të mrekullisë matematikore të Kuranit (shih Shtojcat 1, 2, 24, dhe 26). Kuptimi i shkronjave A.L.M tregohet në Strofën 2: "Ky shkrim është i pagabueshëm." Kjo është pa diskutim e vërtetuar nga fakti që shpeshësitë e ndodhjes së këtyre tre inizialeve në këtë sure janë 4502, 3202, dhe 2195, përkatësisht. Shuma e këtyre numrave është 9899, ose 19x521. Kështu, këto shkronja, më të shpeshtat e gjuhës arabe, janë të vendosura matematikisht sipas një strukture mbinjerëzore. Të njëjtat iniziale janë gjithashtu para Sureve 3, 29, 30, 31, dhe 32, dhe shpeshësitë e ndodhjes së tyre dalin tamam shumëfisha të numrit 19 në secilën prej këtyre sureve.

* 2:3 Pasi që Lutjet e Kontaktit duhet zbatuar pesë herë në ditë, ato përbëjnë burimin parësor të të ushqyerit për shpirtat tonë. Bashkë me të gjitha zakonet tjera në Nënshtrim, Lutjet e Kontaktit fillimisht u shfaqën nëpërmjet Ibrahimit (21:73, 22:78). Edhe pse këto pesë lutje ditore ishin zbatuar para shpalljes së Kuranit, çdo Lutje e Kontaktit është veç e veç e përmendur në Kuran (24:58, 11:114, 17:78, & 2:238). Shtojcat 1 & 15 japin dëshmi materiale që mbështesin TË GJITHA detajet e Lutjeve të Kontaktit, duke përfshirë numrin e njëjësive (Reqateve) dhe numrat e përkuljeve, përljeve, dhe Teshehudeve në secilën lutje.

** 2:3 Kur Zoti e përdorë shumësin (gramatikë), kjo do të thotë që përfshihen qenie të tjera, zakonisht engjëjt. Kur Zoti i foli Moisiut, u përdor njëjësi (20:12-14). Shih Shtojcën 10.

* 2:4 Pavarësisht nga ndryshimet e ashpra që iu shkaktuan shkrimeve të mëparshme, e vërteta e Zotit ende mund të gjendet në to. Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, që të dyja ende përkrahin devotshmëri absolute ndaj VETËM Zotit (Ligji i Përtërirë 6:4-5, Marku 12:29-30). Të gjitha ndryshimet janë lehtë të zbulueshme.

* 2:6-7 Ata që vendosin ta refuzojnë Zotin ndihmohen në atë drejtim; ndalohen nga Zoti që të shohin ndonjë dëshmi ose udhëzim përderisa e mbajnë një vendim të tillë. Pasoja e një vendimi të tillë katastrofik thuhet qartë në Strofën 7.

[14] Kur i takojnë besimtarët, thonë, "Ne besojmë," por kur veçohen me djajtë e tyre, thonë, "Ne jemi me ju, vetëm talleshim."

[15] Zoti i tallë ata, dhe i endë edhe më shumë drejt shkeljeve të tyre.

[16] Janë ata që e blenë humbjen në këmbim të udhëzimit. Tregtia e tillë nuk ka sukses, e as nuk marrin ndonjë udhëzim.

[17] Shembulli i tyre është si ata që ndezin një zjarr, dhe posa të fillojë tu bëjë dritë, Zoti ua shuan dritën, duke i lënë në errësi, e nuk mund të shohin.

[18] Të shurdhër, memecë, dhe të verbër; nuk arrijnë të kthehen.

[19] Shembull tjetër: Një shi me stuhi nga qielli me errësi, bubullimë, dhe vetëtimë. Ata vendosin gishtat e tyre në veshë, që t'i shmangen vdekjes. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mosbesimtarët.

Drita e besimit

[20] Vetëtima gati ua shkaput të pamit. Kur i ndriçon, ecin para, dhe kur errësohet, ndalen. Nëse do Zoti, Ai* mund t'ua merr të dëgjuarit dhe të pamurit. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[21] O njerëz, adhuroni vetëm Zotëruesin tuaj - Atë që ju krijoi juve dhe ata para jush – që të shpëtoheni.

[22] Atë që jua bëri tokën të banueshme, e qiellin mbulojë. E prej qiellit ju lëshon ujë, për të prodhuar lloj lloj frutash për jetesën tuaj. Mos i rivalizoni idhuj Zotit, pasi e dini.

Sfidë matematikore

[23] Nëse keni ndonjë dyshim rreth asaj që i shpallëm shërbëtorit tonë,* atëherë nxirrni një sure si këto, dhe thirrni dëshmitarët tuaj përkundrejt Zotit, nëse jeni të sigurtë.

Përshkrim alegorik i Ferrit

[24] Nëse nuk mund ta bëni këtë – e as që mund ta bëni ndonjëherë – atëherë ruajuni Zjarrit, që ushqehet me njerëz dhe gurë; i pret mosbesimtarët.

Përshkrim alegorik i Parajsës

[25] Jepu lajme të mira atyre që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë se do të kenë kopshte ku rrjedhin prroje. Kur u jepet ndonjë furnizim frutash, do të thonë, "Kjo është me të cilën u furnizua më parë." Pra, u ipen përshkrime alegorike. Aty do të kenë bashkëshorte të dëlira, dhe aty qëndrojnë përgjithmonë.

[26] Zoti nuk druan nga përmendja e çfarëdo alegorie,* që nga mushkonja e imët. Sa për ata që besojnë, ata e dinë që kjo është e vërteta prej Zotëruesit të tyre. E ata që nuk besojnë, ata thonë, "çka deshi të thotë Zoti me një shembull të tillë?" Ai me të çorienton shumë, dhe me të udhëzon shumë. Ai nuk çorienton me të, përveç shpirtligjeve,

[27] që shkelin besën ndaj Zotit pasi që e lidhin, e ndajnë atë që Zoti ka urdhëruar të jetë e bashkuar, dhe bëjnë të këqija. Këta janë dështakët.

*Dy vdekje dhe dy jetë për mosbesimtarët**

* 2:20 Në arabisht, fjalët "Ai" dhe "ajo" nuk nënkuptojnë domosdo gjini biologjike. (Shtojca 4).

* 2:23-24 Kodi i mrekullueshëm matematikor i Kuranit jep shumë prova përderisa e shqipton gërmë për gërmë emrin "Rashad Khalifa" si shërbëtor të Zotit të përmendur këtu. Disa gjigant letrar, duke përfshirë Al-Mutanabbin dhe Taha Husseinin, iu kanë përgjigjur sfidës letrare, por ata nuk ishin në dijeni për kompozicionin matematikor të Kuranit. Është kodi matematikor i Kuranit, i shpallur nëpërmjet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes, Rashad Khalifës, që është sfida e vërtetë - pasi që nuk mund të imitohet kurrë. Shih Shtojcat 1, 2, 24, & 26 për provat e hollësishme.

* 2:26 Shih Shtojcën 5 për shqyrtim të mëtejshëm të Parajsës dhe Ferrit.

* 2:28 Të drejtë nuk vdesin vërtetë; ata shkojnë drejtë në Parajsë. Kur e përbushin kohën e tyre në tokë, engjëjt e vdekjes thjesht i ftojnë që të shkojnë në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva dikur jetuan (2:154, 3:169, 8:24, 22:58,

[28] Si mund të mos besoni në Zotin kur ju ishit të vdekur dhe Ai ju dha jetë, mandej ju vdes, pastaj ju kthen në jetë, e pastaj tek Ai ktheheni përfundimisht?

[29] Ai është Ai që krijoi për ju çdo gjë në tokë, dhe iu kthye qiellit dhe përsosi shtatë gjithësi aty,* dhe Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë.

*Dreqi: Një "zot" i përkohshëm**

[30] Kujtohu kur Zotëruesi yt u tha engjëjve, "Unë po e vë një përfaqësues (një zot të përkohshëm) në Tokë." Ata thanë, "A do të vësh në te atë që do të përhapë të këqija dhe gjakderdhje, ndërsa ne këndojmë lëvdatat Tua, të madhërojmë, dhe i përmbahemi autoritetit Tënd absolut?" Ai tha, "Unë di çka nuk dini."

Testi fillon

[31] Ai ia mësoi Ademit të gjitha emrat*, pastaj ua prezantoi engjëjve, duke thënë, "Mi tregoni emrat e këtyre, nëse keni të drejtë."

[32] Thanë, "Qofsh i madhëruar, ne nuk kemi dije tjetër, përveç asaj që na e mësove. Ti je i Gjithëdijshmi, Më i Mençuri."

[33] Ai tha, "O Adem, tregojau emrat e tyre." Kur ua tregoi emrat, Ai tha, "A nuk ju thash që Unë i di fshehtësitë e qiejve dhe tokës? Di çka deklaroni dhe çka fshihni."

[34] Kur u thamë engjëjve, "Përujluni Ademit," ata u përuan, përveç Dreqit; ai refuzoi, u bë mendjemadh, dhe mosbesimtar.

[35] Thamë, "O Adem, jetoni me bashkëshorten tënde në Parajsë, dhe hani lirisht aty, kah të doni, por mos u afroni kësaj peme, se mëkatoni."

[36] Por djalli i mashtrroi, dhe shkaktoi dëbimin e tyre nga aty. Ne thamë, "Zbritni si armiq të njëri tjetrit. Në Tokë do të jetë vendbanimi dhe furnizimi juaj për ca kohë."

*Fjalë të posaçme**

[37] E Ademi prej Zotëruesit të tij pranoi fjalë, me çka Ai e fali. Ai është Shpenguesi, i Mëshirshmi.

[38] Ju thamë, "Zbritni prej aty, që të gjithë. Kur t'ju vijë udhëzimi prej Meje, ata që ndjekin udhëzimin Tim nuk do të kenë frikë, as nuk do brengosen.

[39] "E sa për ata që nuk besojnë dhe refuzojnë shpalljet tona, do të jenë banues të Ferrit, ku qëndrojnë përgjithmonë."

Urdhra Hyjnor për të gjithë Jahuditë: "Të besoni në këtë Kuran."

[40] O Fëmijet e Izraelit, përkujtoni të mirat e Mija, që jua dhurova, dhe përmbushni pjesën tuaj të besës, që ta përmbush Unë pjesën Time, dhe të më keni frikën Mua.

[41] Të besoni në këtë që kam shpallur këtu, që vërteton atë që keni; mos u bëni të parit që e refuzoni. Mos i ndërroni shpalljet e Mia për një çmim të vogël, dhe të ma keni dronë.

[42] Të mos e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën, as ta fshihni të vërtetën me dashje.

16:32, 36:20-27, 44:56, 89:27-30). Kështu, përderisa të drejtë përjetojnë vetëm vdekjen e parë pas mëkatit tonë fillestar, të padrejtë kalojnë nëpër dy vdekje (40:11). Në kohën e vdekjes, mosbesimtarët e dinë fatin e tyre të mjerë (8:50, 47:27), dhe pastaj vuajnë nga një ankth i vazhdueshëm që zgjatë deri sa të krijohet Ferri (40:46, 89:23, Shtojca 17).

* 2:29 Gjithësia jonë me biliona galaktika, e shtrirë në biliona vjet drite, është më e vogla dhe më e brendshmeja e shtatë gjithësive (Shtojca 6). Shih 41:10-11.

* 2:30-37 Këto strofa u përgjigjen pyetjeve aq vendimtare si: "Pse jemi këtu?" (Shih Shtojcën 7).

* 2:31 Këta janë emrat e kafshëve, automobil, nëndetës, satelitit hapësinor, televizorit, dhe të gjithë sendeve tjera që do i hasin njerëzit në Tokë.

* 2:37 Ngjashëm, Zoti na ka dhënë fjalë të posaçme, matematikisht të koduara, fjalët e Sures 1, që të vëmë kontakt me Të. (shih Shënimin 1:1 dhe Shtojcën 15).

[43] T'i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe të përkuleni me ata që përkulen.

[44] A i shtyni njerëzit që të jenë të drejtë, përderisa harroni veten, megjithëse e lexoni shkrimin. A nuk kuptoni?

[45] Të kërkonti ndihmë, përmes durimit dhe Lutjeve të Kontaktit (Salat). Vërtetë, kjo është vështirë, por jo për të ndershmit,

[46] që besojnë se do të takojnë Zotëruesin e tyre; se te Ai kthehen përfundimisht.

[47] O Fëmijët e Izraelit, përkujtoni të mirat që jua dhurova, dhe që ju bekova më shumë se çdo popull tjetër.

[48] Ruajuni ditës kur asnjë shpirt nuk mund t'i kryej punë tjetrit, asnjë ndërmjetësim nuk pranohet, as haraç nuk mund të paguhet, e as që mund të ndihmohet ndokush.

[49] Kujtohuni që ju shpëtuaam prej popullit të Faraonit që ju shkaktoi persekutimin më të rëndë, duke jua therur djemtë, dhe duke jua lënë vajzat gjallë. Ishte një test i vështirë prej Zotëruesit tuaj.

[50] Kujtohuni që ne e ndamë detin për ju; ju shpëtuaam dhe e mbytëm popullin e Faraonit para syve tuaj.

[51] Prapë-se-prapë, kur e thirrëm Moisiun (Musën) për dyzet net, në mungesë të tij e adhuruat viçin, dhe u bëtë shpirtligë.*

[52] Edhe pas kësaj, ju falëm që të jeni mirënjohës.

[53] Kujtohuni që ne i dhamë Moisiut shkrimin dhe kodin ligjor, që të udhëzoheni.

*Vritni egon tuaj**

[54] Kujtohuni që Moisiu i tha popullit të tij, "O populli im, me adhurimin e viçit i keni bërë keq vetes. Duhet të pendoheni para Krijuesit tuaj. T'i vritni egot tuaja. Kjo është më mirë për ju para Krijuesit tuaj." Ai ju shpengoi. Ai është Shpenguesi, i Mëshirshmi.

*Dëshmi materiale**

[55] Kujtohuni që thatë, "O Moisi, nuk do të besojmë pa e parë Zotin, fizikisht." Për këtë, ju goditi rrufeja, përderisa shikonit.

[56] Pasi që kishit vdekur, ju kthym në jetë, që të jeni mirënjohës.

Në Sinai

[57] Ne ju bëmë hije me re (në Sinai), dhe ju dhamë rrëshirë, dhe shkurtëza: "Hani nga të mirat që ju furnizuaam." Ata nuk na dëmtuan (me rezistencë); dëmtuan veç veten.

Mungesë besimi në Zotin: Refuzojnë të hynë në Jerusalem

[58] Kujtohuni që ju thamë: "Hyni në këtë qytezë, ku do të gjeni furnizime sa të doni. Hyni te porta kokulur, dhe silluni mirë ndaj njerëzve. Pastaj, do t'jua falim mëkatet, dhe besimtarëve t'ua shtojmë shpërblimin."

[59] Por të ligët mes tyre zbatuan urdhra krejtësisht ndryshe urdhrave të dhënë. E si pasojë e ligësisë së tyre, mbi shkelësit lëshuam dënim nga qielli.

* 2:51 Ky incident pasqyron tendencën idhujtareske të njeriut. Përkundër mrekullive të mëdha, ndjekësit e Moisiut e adhuruan viçin në mungesë të tij, dhe Moisiu përfundoi me vetëm dy besimtarë (5:23). Siç u përmend në Parathënie, njerëzit janë kryengritës që egot i kanë zota të tyre.

* 2:54 Është egoja që çoi deri te rënia e Dreqit. Është egoja që shkaktoi mërgimin tonë në këtë botë, dhe është egoja që po e mban shumicën prej neve nga kthimi në Mbretërinë e Zotit.

* 2:55 Vlen të përmendet se fjala "Zot" në këtë strofë është përsëritja e 19-të e kësaj fjale, dhe kjo është strofa ku njerëzit kërkonin "dëshmi materiale." Kodi matematikor i Kuranit, i bazuar në numrin 19, jep dëshmi materiale të tillë. Vini re që $2+55=57=19 \times 3$.

Më shumë mrekulli

[60] Kujtohuni që Moisiu kërkoi ujë për popullin e tij. E ne i thamë: "Bjeri shkëmbit me shkopin tënd." atëherë nga aty shpërthyen dymbëdhjetë burime. Anëtarët e secilit fis e dinin vendin e tyre të ujit. Hani dhe pini nga furnizimet e Zotit, dhe nëpër tokë mos silleni të korruptuar.

Izraeli ngre krye

[61] Kujtohuni që thatë, "O Moisi, nuk mund ta durojmë më vetëm një lloj ushqimi. Drejtoju Zotëruesit tënd të na prodhojë të mbjella si groshë, tranguj, hudhra, thjerrëza, dhe qepë." Ai tha, "A dëshironi ta ndërtoni atë që është e mirë me atë që është më e dobët? Zbritni në Egjipt, ku mund të gjeni çka kërkuat." Ata pësuan dënim, poshtërim, dhe turpërim, dhe i sollën vetes zemërimin e Zotit. Kjo është për arsye se ata refuzuan shpalljet e Zotit, dhe vranë profetët padrejtësisht. Kjo është për arsye të mosbindjes dhe shkeljes së tyre.

Bashkimi i gjithë të nënshtruarve

[62] Padyshim, ata që besojnë, ata që janë Jahudi, të Krishterët, dhe të konvertuarit; kushdo që (1) beson në Zotin, dhe (2) beson në Ditën e Fundit, dhe (3) çon jetë të drejtë, do të marrin shpërblimin e vet prej Zotëruesit të tyre. Nuk kanë pse të frikësohen, e as nuk do të brengosen.

Besëlidhje me Izraelin

[63] Ne lidhëm besën me ju, përderisa ngritëm mbi ju Malin Sinai: "T'i përmbaheni me vendosmëri asaj që jua dhamë, dhe të përkujtoni përmbajtjen e saj, që të shpëtoheni."

[64] Por më pas ia kthyet shpinën, dhe po të mos ishte mirësi e Zotit ndaj jush, dhe mëshira e Tij, ju do të ishit të përfunduar.

[65] Keni ditur për ata mes jush që nuk respektuan të Shtunën. U thamë, "Qofshi të përbuzur aq sa majmunët."

[66] I ujdisë si shembull për gjeneratën e tyre, si dhe për gjeneratat pasuese, dhe ndriçim për të drejtë.

*Mështjerra**

[67] Moisiu i tha popullit të tij, "Zoti ju urdhëron që ta flijoni një mështjerrë." Ata thanë, "A po na tallë?" Ai tha, "Mos e bëftë Zoti që të sillem si injorantët."

[68] Ata thanë, "Drejtoju Zotëruesit tënd të na tregojë cilën." Ai tha, "Ai thotë se ajo është një mështjerrë as shumë e vjetër, as shumë e re; mesatare. Tash, zbatoni atë që u urdhëruat."

[69] Ata thanë, "Drejtoju Zotëruesit tënd të na tregojë çfarë ngjyre ka." Ai tha, "Ai thotë se ajo është një mështjerrë e verdhë e çelët, kënaq shikuesit."

[70] Ata thanë, "Drejtoju Zotëruesit tënd të na tregojë cilën, se na duken të ngjashme, dhe në dashtë Zoti, do të gjejmë të vërtetën."

[71] Ai tha, "Ai thotë se ajo është një mështjerrë që nuk ka vuajtur nga lërimi i tokës ose ujitja e bimëve; është pa asnjë njollë apo të metë." Ata thanë, "Tash na e solle të vërtetën." Më në fund e flijuan, pas gjithë këtij ngurrimi.

Qëllimi i mështjerrës

[72] Ju kishit vrarë një njeri, dhe u grindët mes jush. Zoti kishte për ta nxjerr në shesh atë që u mundat ta fshihni.

* 2:67 Edhe pse kjo sure përmban ligje dhe urdhra të rëndësishme, duke përfshirë lutjet e kontaktit, agjërimin, shtegtimin Haxh, dhe ligjet e martesës, divorcit, etj., sures i është dhënë emri "Mështjerra." Kjo pasqyron rëndësinë vendimtare që t'i nënshtrohemi Zotit, dhe t'i bindemi menjëherë dhe pa luhatje Krijuesit tonë. Nënshtrimi i tillë vërteton besimin tonë në gjithëfuqishmërinë dhe autoritetin absolut të Zotit. Shih gjithashtu në Bibël, Librin Numrat, Kapitulli 19.

[73] Thamë, "Bjerni (viktimës) me një pjesë (të mëshjtjerrës)." Atëherë Zoti e ktheu viktimën në jetë, dhe jua tregoi shenjat paralajmëruese të Tij, që të kuptoni.

[74] Megjithatë, zemrat tuaja u ngurtësuan si gurë, apo edhe më shumë. Pasi që ka gurë prej të cilëve burojnë lumenj. Ka të tjerë që qahen dhe nxjerrin prroje të qeta, dhe të tjerë gurë përmbliidhen teposhtë nga respekti për Zotin. Zoti nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëni.

Shtrembërojnë fjalën e Zotit

[75] A prisni prej tyre të besojnë si ju, përdërisa disa prej tyre dëgjonin fjalën e Zotit, pastaj e shtrembëronin, me plot vetëdije dhe paramendim?

Fshehin fjalën e Zotit

[76] Dhe kur i takojnë besimtarët, thonë, "Ne besojmë," por kur mbliidhen së bashku, thonë, "Mos i njoftoni (besimtarët) për informatat që ju dhanë juve nga Zoti, sepse i furnizoni me mbështetje për argumentin e tyre lidhur me Zotëruesin tuaj. A nuk kuptoni?"

[77] A nuk e dinë që Zoti din gjithçka që fshehin, dhe gjithçka që deklarojnë?

[78] Mes tyre ka të pa shkrim që nuk e dinë shkrimin, përveç nëpërmjet thashethemeve, e pretendojnë që e dinë.

[79] Prandaj, mjerë ata që e shtrembërojnë shkrimin me duart e veta, e pastaj, për përfitime të vogla materiale, thonë, "Kjo është çka shpalli Zoti." Mjerë ata për shtrembërimin e tillë, dhe mjerë ata për përfitimet e tyre të paligjshme.

*Përjetësia e Parajsës dhe Ferrit**

[80] Disa madje thanë, "Nuk do të na kapë Ferri, përveç një numri të kufizuar ditësh." Thuaj, "A mos keni marrë zotim të tillë nga Zoti – Zoti nuk e prish zotimin e Tij – apo po thoni për Zotin çka nuk dini?"

[81] Me të vërtetë, ata që mbledhin mëkate dhe përmyten nga mëkatet e tyre do të jenë banues të Ferrit; në të qëndrojnë gjithmonë.

[82] Sa për ata që besojnë, dhe çojnë jetë të drejtë, do të jenë banues të Parajsës; aty qëndrojnë gjithmonë.

Urdhrat

[83] Ne lidhëm besën me Fëmijët e Izraelit: "Mos adhuroni askënd pos Zotit. Të nderoni prindërit dhe të keni kujdes ndaj të afërmve, jetimëve, dhe të varfërve. Të silleni me miqësi ndaj njerëzve. Të zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat)." Por ju u kthyet prapa, përveç një pakice, dhe u bëtë kundërshtarë.

[84] Lidhëm besën me ju, që mos ta derdhni gjakun tuaj, as mos ta dëboni njëri tjetrin nga shtëpitë tuaja. Ju u pajtuat dhe ishit dëshmitarë.

[85] Prapëseprapë, jeni duke vrarë njeri tjetrin, dhe duke dëbuar disa prej jush nga shtëpitë e tyre, duke u bashkuar kundër tyre mëkatnisht dhe djallëzisht. Edhe kur dorëzoheshin, kërkonit haraç prej tyre. Dëbimi i tyre ishte i ndaluar për ju, pikë së pari. A besoni në një pjesë të shkrimit dhe nuk besoni në tjetrën? Çfarë duhet të jetë ndëshkimi për ata mes jush që e bëjnë këtë, përveç poshtërim në këtë jetë, dhe një ndëshkim shumë më i rëndë në Ditën e Ringjalljes? Zoti nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëni.

* 2:80-82 Është besim i ngulitur ndër Myslimanët e korruptuar se ata do të vuajnë në Ferr vetëm në proporcion me numrin e mëkateve që kanë bërë, pastaj do të dalin nga Ferri dhe të shkojnë në Parajsë. Ata gjithashtu besojnë se Muhamedi do të ndërhyjë në emër të tyre dhe do i nxjerrë nga Ferri. Besime të tilla janë në kundërshtim me Kuranin (Shtojca 8).

[86] Janë ata që blenë këtë jetë të ulët, në këmbim të Përjetësisë. Si pasojë, atyre as nuk iu zbutet ndëshkimi kurrë, as nuk mund të ndihmohen.

Profetët e Izraelit

[87] Ne i dhamë Moisiut shkrimin, dhe pas tij dërguam të dërguarë tjerë, dhe i dhamë Jezusit (Isës), birit të Marisë (Merjemës), mrekulli të mëdha dhe e mbështetëm me Frymën e Shenjtë. A nuk është e vërtetë se sa herë ndonjë i dërguar shkoi tek ju me diçka që nuk ju pëlqeu, egoja juaj ju bëri kryelartë? Disa prej tyre i refuzuat, dhe disa prej tyre i vratë.

Konstatim tragjik: "Mendja ime është e kurdisur!"

[88] Disa thonë, "Mendjet tona janë të kurdisura!" Jo, është një mallkim prej Zotit, si pasojë e mosbesimit të tyre, që i mban larg nga besimi, me përjashtim të një pakice prej tyre.

Kurani përmbush të gjitha shkrimet

[89] Kur ky shkrim u erdhi atyre nga Zoti, dhe edhe pse konfirmon dhe është në pajtueshmëri me çka ata kanë, dhe edhe pse ata e parathonin në profecitë e tyre ardhjen e tij gjatë bisedës me mosbesimtarët, kur profecisë së tyre i erdhi koha, ata nuk i besuan. Në këtë mënyrë, dënimi i Zotit i kapë mosbesimtarët.

[90] Vërtetë e trishtueshme është ajo për çka i shitën shpirtat e tyre – të refuzojnë këto shpallje të Zotit nga zilia që Zoti dhuron mirësinë e Tij mbi këdo që Ai do nga shërbyesit e Tij. Si pasojë, ata vetëshkaktuan zemërim mbi zemërim. Mosbesimtarët kanë vetëshkaktuar një ndëshkim poshtërues.

[91] Kur u thuhet, "Besoni në këto shpallje të Zotit," thonë, "Ne besojmë vetëm në atë që na u dërgua neve." Pra, ata nuk besojnë në shpalljet e mëvonshme, edhe nëse është e vërteta nga Zotëruesi i tyre, edhe pse konfirmon çka ata kanë! Thuaj, "Pse pra i vratë profetët e Zotit, nëse ishit besimtarë?"

Mësim prej historisë së Izraelit

[92] Ju shkoi Moisiu me mrekulli të mëdha, por në mungesë të tij adhuroat viçin, dhe u bëtë shpirtligë.

[93] Ne lidhëm besën me ju, derisa mbi ju ngritëm Malin Sinai, duke thënë, "Të ju përmbaheni urdhrave që jua dhamë, me vendosmëri, dhe dëgjoni." Ata thanë, "Dëgjojmë, por nuk ju bindemi." Zemrat e tyre u mbushën me admirim ndaj viçit, për shkak të mosbesimit të tyre. Thuaj, "Vërtetë e trishtueshme është ajo që ju urdhëron besimi juaj, nëse keni ndonjë pikë besimi."

[94] Thuaj, "Nëse vendbanimi i Përjetësisë është i rezervuar për ju tek Zoti, duke përjashtuar të gjithë njerëzit e tjerë, atëherë ju duhet ta dëshironi vdekjen, nëse jeni të singertë."

[95] Ata nuk e dëshirojnë, për shkak të veprave të tyre të kryera. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për shpirtligjtë.

[96] Në fakt, më të mëdhenjtë lakmues për jetë do i gjesh ata; edhe më lakmues se idhujtarët. Një i tyre dëshiron të jetojë një mijë vjet. Por kjo nuk do e shpëtojë nga ndonjë ndëshkim, sado që të jetojë. Zoti është pamës i çdo gjëje që bëjnë.

Gabrieli ndërmjetëson shpalljen

[97] Thuaj, "Kushdo që kundërshton Gabrielin duhet ta di që ai ta ka zbritur këtë (Kuran) në zemër, sipas dëshirës së Zotit, që konfirmon shkrimet paraprake, dhe jep udhëzime dhe lajme të mira për besimtarët."

[98] Kushdo që kundërshton Zotin, dhe engjëjt e Tij, dhe të dërguarit e Tij, dhe Gabrielin dhe Mikaelin, duhet ta di që Zoti kundërshton mosbesimtarët.

[99] Ne të zbritëm ty të tilla shpallje të qarta, dhe vetëm shpirtligjtë do i refuzojnë.

[100] A nuk është fakt që kur ata lidhin besën dhe zotohen që do e mbajnë, disa prej tyre gjithmonë e shpërfillin? Në fakt, shumica e tyre nuk besojnë.

Shpërfillin shkrimin e Zotit

[101] Tash që një i dërguar prej Zotit u ka ardhur atyre,* edhe pse ai vërtetonte shkrimin e tyre, disa ndjekës të shkrimit (Jahuditë, të Krishterët, dhe Myslimanët) hedhin pas shpine shkrimin e Zotit, sikur të mos e kishin pasur kurrë.

Magjia dënohet

[102] Ata ndoqën çka i mësuari djajtë rreth mbretërisë së Salomonit (Sulejmanit). Mirëpo Salomoni nuk ishte mosbesimtar, por djajtë ishin mosbesimtarë. Ata ua mësonin njerëzve magjinë, dhe atë që zbriti nëpërmjet dy engjëjve në Babel, Harutit dhe Marutit. Këta dy nuk përhapnin njohuri të tillë pa ju thënë: "Ky është një test. Të mos e keqpërdorni një njohuri të tillë." Por njerëzit e përdorën në intriga të dëmshme siç është ndarja e martesave. Ata nuk mund ta dëmtojnë askënd kundër dëshirës së Zotit. Ata pra mësojnë çka i dëmton, e jo çka ju sjell dobi, dhe e dinë shumë mirë se kushdo që ushtron magji nuk do të ketë hise në Përjetësi. Vërtetë e trishtueshme është për çka i shesin shpirtrat e tyre, sikur veç ta dinin.

[103] Nëse besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, shpërblimi prej Zotit është shumë më i mirë, sikur veç ta dinin.

Përdredhin fjalët e Lutjes

[104] O ju që besoni, nuk duhet të thoni, "Raina"* (kujdestarona). Por të thoni, "Undhurna" (ruana), dhe dëgjoni. Mosbesimtarët kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

Xhelozia dënohet

[105] As mosbesimtarët mes ndjekësve të shkrimit, e as idhujtarët, nuk duan të shohin ndonjë bekim të zbres mbi ju nga Zotëruesi juaj. Megjithatë, Zoti derdh bekimet e Tij mbi këdo që Ai zgjedhë. Zoti posedon mirësi pakufi.

*Mrekullia përfundimtare: Kodi matematikor i Kuranit**

[106] Kur e shfuqizojmë çfarëdo mrekullie, ose e bëjmë të harrohet, e prodhojmë një edhe më të mirë, ose së paku të barabartë. A nuk e dini faktin që Zoti është i Plotfuqishëm?

[107] A nuk e njihni faktin që Zoti posedon mbretërimin e qiejve dhe tokës; që nuk keni askënd pos Zotit si Zotëruesi dhe Sundues tuajin?

[108] A dëshironi të kërkonin nga i dërguari juaj çka u kërkua nga Moisiu në të kaluarën? Kushdo që zgjedhë mosbesimin, në vend të besimit, vërtetë ka humbur rrugën e drejtë.

[109] Shumë ndjekës të shkrimit më me dëshirë do t'ju kishin parë duke ju rikthyer mosbesimit, tash që keni besuar. Kjo është për shkak të xhelozisë së tyre, pasi për ta e vërteta është bërë e evidente. T'i falni, dhe t'i lini rehat, deri sa Zoti ta sjellë drejtësinë e Tij. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[110] T'i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat). Çfarëdo të mire që e dërgoni për veten tuaj, do e gjeni te Zoti. Zoti sheh çdo gjë që bëni.

Të gjithë besimtarët shpengohen, pavarësisht nga emri i fesë së tyre

* 2:101 I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes parashikohet në profecitë në Besëlidhjen e Vjetër (Malakia 3:1-3), Besëlidhjen e Re (Luka 17:22-37), dhe këtu në Besëlidhjen e Fundit (3:81).

* 2:104 Fjala "Raina" keqpërdoret nga disa folës të Hebraishtes, dhe përdridhej që të tingëllonte si një fjalë e ndyrë. (shih gjithashtu 4:46).

* 2:106 Mrekullia matematikore e Kuranit është e përhershme & më e madhe se mrekullitë paraprahe (34:45, 74:35). Si vetë Kurani, ajo konfirmon, përmbush, dhe zëvendëson të gjitha mrekullitë paraprahe.

[111] Disa thanë, "Askush nuk do të hyjë në Parajsë përveç Jahudive ose të Krishterëve!" E tillë është ëndrra e tyre. Thuaj, "Paraqitna provat, nëse keni të drejtë."

Nënshtrimi: Feja e vetme

[112] Në të vërtetë, ata që ia nënshtrinë veten plotësisht vetëm Zotit, përderisa çojnë jetë të drejtë, do të marrin shpërblimin nga Zotëruesi i tyre; nuk kanë pse të frikësohen, e as nuk do të brengosen.*

[113] Jahuditë thanë, "Të Krishterët nuk bazohen në asgjë," e të Krishterët thanë, "Jahuditë nuk bazohen në asgjë." E që të dy e lexojnë shkrimin. Të tilla janë shprehjet e atyre që nuk kanë aspak dije. Zoti do i gjykojë në Ditën e Ringjalljes, lidhur me grindjet e tyre.

Ta frekuentoni vendlutjen

[114] Kush janë më të këqij se ata që bojkotojnë vendlutjet e Zotit, ku përkujtohet emri i Tij, dhe kontribuojnë në braktisjen e tyre? Ata nuk duhet të hynë në to përveç duke u frikësuar. Ata do të vuajnë poshtërim në këtë jetë, dhe në Përrjetësi do të vuajnë ndëshkim të tmerrshëm.

[115] E Zotit është lindja dhe perëndimi; kudo që shkoni aty do të jetë prania e Zotit. Zoti është i Gjithëpranishëm, i Gjithëdijshëm.

Blasfemi e tepërt

[116] Ata thanë, "Zoti ka lindur djalë!" Qoftë i madhëruar! Kurrë. E tij është gjithçka në qiej dhe tokë; gjithçka i është nënshtruar Atij.

[117] Nismëtari i qiejve dhe tokës: për të bërë çfarëdo Ai vetëm i thotë, "Ji," dhe është.

[118] Ata që nuk kanë aspak dije thonë, "Veç sikur Zoti të mund të na fliste, ose ndonjë mrekulli të mund të na vinte!" Të tjerët para tyre kanë shprehur thënie të ngjashme; mendjet e tyre janë të ngjashme. Ne i shfaqim mrekullitë për ata që janë të sigurt.

[119] Ne të kemi dërguar ty* me të vërtetën si bartës të lajmeve të mira, si dhe paralajmërues. Ti nuk përgjigjesh për ata që vetëshkaktojnë Ferrin.

[120] As jahuditë, as të krishterët, nuk do të pranojnë ty, po të mos e ndjekësh fenë e tyre. Thuaj, "Udhëzimi i Zotit është udhëzimi i vërtetë." Nëse përvetëson dëshirat e tyre, pavarësisht nga dija që ke pranuar, nuk do të gjesh asnjë aleat ose përkrahës të të ndihmojë kundër Zotit.

[121] Ata që pranuan shkrimin, dhe e njohin ashtu si duhet të njihet, do të besojnë në këtë. E sa për ata që nuk besojnë, ata janë dështakët.

[122] O Fëmijët e Izraelit, përkujtoni të mirat e Mia që jua dhurova, dhe që ju bekova më shumë se çdo popull tjetër.

[123] Ruajuni ditës kur asnjë shpirt nuk do i ndihmojë tjetrit, asnjë haraç nuk pranohet, asnjë ndërmjetësim nuk është i dobishëm, dhe askush nuk ndihmohet.

Ibrahimi

[124] Kujtohuni që Ibrahimi u vu në test nga Zotëruesi i tij, me disa urdhra dhe i përmbushi. (Zoti) tha, "Po të caktoj imam për njerëzit." Ai tha, "Edhe pasardhësit e mijë?" Ai tha, "Besëlidhja ime nuk i përfshinë shkelësit."

[125] Ne e kemi shndërruar faltoren (Qaben) në vatër kthimi, dhe strehë të sigurt. Ju mund ta përdorni faltoren e Ibrahimit si shtëpi lutjeje. Ne mandatuam Ibrahimin dhe Ismailin: "Pastronie

* 2:111-112 Shih 2:62 dhe 5:69.

* 2:119 Është obligim i imi që të tregoj se identiteti i këtij të dërguari konfirmohet të jetë "Rashad Khalifa," I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes. Duke mbledhur vlerën germore të "Rashad" (505), dhe vlerën germore të "Khalifa" (725), plus numrin e strofës (119), marrim 1349, shumëfish i 19-tës. Shih 3:81 dhe Shtojcën Dy.

shtëpinë Time për ata që e vizitojnë, ata që jetojnë atje, dhe ata që përkulen dhe përulen."

[126] Ibrahim i lut: "Zotëruesi im, bëje këtë një tokë paqësore, dhe furnizo njerëzit e saj me fruta. Furnizoj ata që besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit." (Zoti) tha, "Unë gjithashtu do i furnizoj ata që nuk besojnë. Do i lë të kënaqen, përkohësisht, pastaj do i mbyllë në ndëshkimin e Ferrit, dhe në fat të tmerrshëm."

Ibrahimi i dorëzoi të gjitha zakonet e Nënshtrimit (Islamit)

[127] Kur Ibrahim i ngrihte themelet e faltores, bashkë me Ismailin (u lutën): "Zotëruesi ynë, pranoje këtë prej nesh. Ti je Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[128] "Zotëruesi ynë, na bë të nënshtruar ndaj Teje, dhe prej pasardhësve tonë le të jetë një shoqëri e të nënshtruarve ndaj Teje. Mësona ritet e fesë tonë, dhe shpengona. Ti je Shpenguesi, i Mëshirshmi.

[129] "Zotëruesi ynë, dhe rrite mes tyre një të dërguar që t'ua recitojë atyre shpalljet Tua, t'ua mësojë shkrimin dhe mençurinë, dhe t'i pastrojë. Ti je i Plotfuqishmi, Më i Mençuri."

[130] Kush do të braktiste fenë e Ibrahimit, përveç dikujt që e mashtron veten? E zgjodhëm atë në këtë botë, dhe në Përjetësi ai është me të drejtë.

[131] Kur Zotëruesi i tij i tha, "Nënshtrohu," ai tha, "I nënshtrohem Zotëruesit të gjithësisë."

[132] Dhe Ibrahim i shtyu fëmijët e tij ta bëjnë të njëjtën, si edhe Jakobi (Jakubi): "O fëmijët e mi, Zoti e ka vënë në pah fenë për ju; mos vdisni ndryshe përveç si të nënshtruar."

[133] Sikur të ishit dëshmitarë të Jakobit në prag të vdekjes; ai u tha fëmijëve të vet, "Çka do të adhuron pasit të vdes?" Thanë, "Do të adhurojmë zotin tënd; zotin e baballarëve tu Ibrahimit, Ismailit, dhe Isakut; të vetmin zot. Atij i nënshtrohem."

[134] Ajo është një shoqëri nga e kaluara. Ata janë përgjegjës për çka ata mblodhën, dhe ju jeni përgjegjës për çka ju mblodhët. Ju nuk përgjigjeni për asgjë që ata kanë bërë.

*Nënshtrimi (islami): Feja e Ibrahimit**

[135] Ata thanë, "Duhet të jeni Jahudi ose të Krishterë, që të udhëzoheni." Thuaj, "Ne ndjekim fenë e Ibrahimit – monoteizmin – ai nuk ishte idhujtar."

Asnjë dallim në mes të të dërguarve të Zotit

[136] Thoni, "Besojmë në Zotin, dhe në çka na u shpall neve, dhe në çka iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Isakut, Jakobit, dhe Patriarkëve; dhe në çka iu dha Moisiut dhe Jezusit, dhe të gjithë profetëve nga Zotëruesi i tyre. Nuk bëjmë asnjë dallim ndërmjet asnjërit prej tyre. Vetëm Atij i nënshtrohem."

[137] Nëse ata besojnë si besoni ju, atëherë janë të udhëzuar. Por nëse refuzojnë, atëherë janë kundërshtarë. Zoti do të shpëtojë ty nga kundërshtimi i tyre; Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[138] I tillë është sistemi i Zotit, e sistemi i kujt është më i mirë se i Zotit? "Vetëm Atë e adhurojmë."

[139] Thuaj, "A grindeni me ne rreth Zotit, kur Ai është Zotëruesi ynë dhe Zotëruesi juaj? Ne jemi përgjegjës për veprat tona, dhe ju jeni përgjegjës për veprat tuaja. Vetëm Atij i kushtohemi."

[140] A thoni se Ibrahim, Ismaili, Isaku, Jakobi, dhe Patriarkët ishin Jahudi ose të Krishterë? Thuaj, "A e dini më mirë se Zoti? Kush është më i keq se ai që e fsheh një dëshmi që e ka mësuar prej Zotit? Zoti nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëni."

* 2:135 Kurani vazhdimisht na informon se Nënshtrimi është feja e Ibrahimit (3:95, 4:125, 6:161, 22:78). Ibrahim pranoi "shkrim" në praktikë (zakone), domethënë, të gjitha obligimet dhe zakonet e Nënshtrimit [Lutjet e Kontaktit (Salat), bamirësinë e obligueshme (Zeqat), agjërimin e Ramazanit, dhe shtegtimin Haxh]. Muhamedi ishte ndjekës i fesë së Ibrahimit, siç e shohim në 16:123; ai e dorëzoi këtë Besëlidhje të Fundit, Kurandin. I Dërguari i tretë i Nënshtrimit dorëzoi provën e vërtetësisë së fesë (shih 3:81 dhe Shtojcat 1, 2, 24, & 26).

[141] Ajo ishte një shoqëri nga e kaluara. Ata janë përgjegjës për çka ata mblodhën, dhe ju jeni përgjegjës për çka ju mblodhët. Ju nuk përgjigjeni për asgjë që ata bënë.

*Heqja e fanatizmit dhe paragjykimeve**

[142] Budallenjtë mes njerëzve do të thoshin, "Pse e ndërruan drejtimin e Kiblës së tyre?" Thuaj, "E Zotit është lindja dhe perëndimi; Ai udhëzon kë do në rrugë të drejtë."

[143] Kështu ju bëmë shoqëri të paanshme, që të shërbeni si dëshmitarë mes njerëzve, dhe i dërguari shërben si dëshmitar mes jush. E ndërruam drejtimin e Kiblës tuaj të parë vetëm që t'i veçojmë ata që me gatishmëri e ndjekin të dërguarin nga ata që kthehen prapa. Ishte test i vështirë, por jo për ata që janë të udhëzuar nga Zoti. Zoti nuk ta humb adhurimin. Zoti është i Dhembshëm ndaj njerëzve, i Mëshirshmi.

Kibla kthehet në Mekë

[144] Të kemi parë duke e kthyer fytyrën tënde nga qielli (duke kërkuar drejtimin e duhur). Ne tash caktojmë një Kibël që të kënaq ty. Tash e tutje, ta kthesh fytyrën nga Vendlutja e Shenjtë. Kudo që të jeni, të gjithë t'i ktheni fytyrat tuaja nga ajo. Ata që pranuan shkrimin paraprak e dinë që kjo është e vërteta nga Zotëruesi i tyre. Zoti nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëjnë.

[145] Edhe sikur t'iu shfaqësh ndjekësve të shkrimit çdo lloj mrekullie, ata nuk do të ndjekin Kiblën tënde. As ti mos ta ndjekësh Kiblën e tyre. Ata nuk e ndjekin as Kiblën e njëri tjetrit. Nëse përvetëson dëshirat e tyre, pas dijes që të ka ardhur, do të jesh me shkelësit.

Keqpërdorimi i shkrimit: Theksimi i përzgjedhur dhe fshehja

[146] Ata që pranuan shkrimin e njohin të vërtetën këtu, siç i njohin fëmijët e vet. Prapëseprapë, disa prej tyre e fshehin të vërtetën, me dashje.

[147] Kjo është e vërteta nga Zotëruesi yt; nuk duhet të dyshosh.

[148] Secili nga ju e zgjedh drejtimin për ta ndjekur; Të garoni drejt drejtësisë. Kudo që të jeni, Zoti do ju mbledhë të gjithëve. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Kibla kthehet në Mekë

[149] Kudo që shkon, ta kthesh fytyrën (gjatë Salatit) kah Vendlutja e Shenjtë.* Kjo është e vërteta nga Zotëruesi yt. Zoti nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që të gjithë ju bëni.

[150] Kudo që shkon, ta kthesh fytyrën (gjatë Salatit) kah Vendlutja e Shenjtë; kudo që të jeni, t'i ktheni fytyrat tuaja (gjatë Salatit) kah ajo. Kështu, njerëzit nuk do të kenë asnjë argument kundër jush, përveç shkelësve mes tyre. Mos iu frikësoni atyre, por frikësomuni Mua. Unë pastaj do i përkryej bekimet e Mia mbi ju, që të udhëzoheni.

[151] (Bekime) si dërgimin e një të dërguari nga mesi juaj t'ju recitojë shpalljet tona, t'ju pastrojë, t'jua mësojë shkrimin dhe mençurinë, dhe t'ju mësojë çka nuk dinit.

[152] Të më përkujtoni Mua, që t'ju përkujtoj juve, dhe të jeni falënderues ndaj Meje; mos u bëni mosmirënjohës.

[153] O ju që besoni, kërkonin ndihmë përmes durimit dhe Lutjeve të Kontaktit (Salat). Zoti është me ata që durojnë me këmbëngulje.

Ku shkojmë prej këtu?

* 2:142-145 "Kibla" është drejtimi kah i cili drejtohem gjatë Lutjeve të Kontaktit (Salat). Kur Gabrieli e shpuri te Muhamedi urdhrin që të drejtohen kah Jerusalemi në vend të Mekës, hipokritët u ekspozuan. Arabët kishin paragjykime të forta në favor të Qabes si "Kibël" të tyre. Vetëm besimtarët e vërtetë ishin në gjendje t'i tejkalonin paragjykimet e tyre; ata me gatishmëri iu bindën të dërguarit.

* 2:149 Provë e shkëlqyeshme e idhujtarisë që kryhet nga "Myslimanët" e sotëm është përcaktimi i varrit të Muhamedit si "Vendlutje e Shenjtë." Kurani përmend vetëm një "Vendlutje të Shenjtë."

[154] Mos thoni për ata që vriten për Zotin, "Janë të vdekur." Ata janë të gjallë te Zotëruesi i tyre, por nuk e kuptoni.*

[155] Ne padyshim do t'ju testojmë me ca frikë, uri, dhe humbje parash, jetësh dhe të korrash. Jepu lajme të mira durimtarëve.*

[156] Kur u bie ndonjë pikëllim, thonë, "Jemi të Zotit, dhe te Ai kthehemi."

[157] Këta kanë merituar bekime nga Zotëruesi i tyre dhe mëshirë. Këta janë të udhëzuarit.

Shtegtimi Haxh

[158] Brigjet e Safas dhe Merves janë ndër ritet e shpallura nga Zoti. Kushdo që zbaton Haxhin ose Umren nuk bën gabim duke e përshkuar distancën ndërmjet tyre. Nëse dikush vullnetarisht bën edhe më shumë punë të drejta, atëherë Zoti është Mirënjohës, i Gjithëdijshëm.

Kundërvajtje e tepërt

[159] Ata që fshehin shpalljet dhe udhëzimin tonë, pas shpalljes së tyre për njerëzit në shkrim, janë të mallkuar nga Zoti; janë të mallkuar nga të gjithë mallkuesit.

[160] E sa për ata që pendohen, përmirësohen, dhe i shpallin ato, Unë i shpengoj ata. Unë jam Shpenguesi, i Mëshirshmi.

[161] Ata që nuk besojnë dhe vdesin si mosbesimtarë, kanë vetëshkaktuar mallkimin e Zotit, engjëjve, dhe të gjithë njerëzve (në Ditën e Gjykimit).

[162] Përgjithmonë qëndrojnë aty. Nuk iu zbutet ndëshkimi kurrë, e as nuk iu shtyhet afati.

[163] Zot i juaji është një zot; nuk ka asnjë zot pos Tij, Mirëbërësit, Më të Mëshirshmit.

Shenja të jashtëzakonshme të Zotit

[164] Në krijimin e qiejve dhe tokës, në ndërrimin e natës dhe ditës, në anijet që lëvizin nëpër oqean për dobi të njerëzve, në ujin që Zoti e lëshon nga qielli për të rigjallëruar tokë të vdekur dhe për të përhapur në të çfarëdo lloj krijese, në manipulimin e erërave, dhe reve të vendosura ndërmjet qiellit dhe tokës, ka prova të mjaftueshme për njerëz që kuptojnë.

Idhujt mohojnë idhujtarët e tyre

[165] Prapëseprapë, disa njerëz i rivalizojnë idhuj Zotit, dhe i duan sikur të ishin Zoti. Ata që besojnë e duan Zotin më së shumti. Veç sikur shkelësit të mund ta shihnin veten kur e shohin ndëshkimin! Do e kuptojnë pastaj, që e tërë fuqia është e vetëm Zotit, dhe që ndëshkimi i Zotit është tmerrues.

[166] Ata që u ndoqën do i mohojnë ndjekësit e vet.* Do të shohin ndëshkimin, dhe të gjitha lidhjet mes tyre do të shpëputen.

[167] Ndjekësit do të thonë, "Nëse mund ta kemi një shans tjetër, do i mohojmë ata, ashtu si na kanë mohuar tash ata neve." Zoti pra ua shfaqë pasojat e punëve të tyre si asgjë pos brejtje ndërgjegjeje; ata nuk do të dalin nga Ferri kurrë.

Dreqi ndalon gjërat e lejuara

[168] O njerëz, hani nga prodhimet e tokës të gjitha që janë të lejuara dhe të mira, dhe mos ndiqni hapat e Dreqit; ai është armiku juaj më i flaktë.

[169] Ai vetëm ju urdhëron që të bëni të këqija dhe vese, dhe të thoni kundër Zotit çka nuk dini.

Mbajtja e statukuosë: Tragjedi njerëzore

* 2:154 Të drejtit nuk vdesin vërtetë; ata thjesht i lënë trupat e tyre këtu dhe shkojnë në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva dikur jetuan. Shih Shtojcën 17 për provat dhe detajet.

* 2:155 Testi është i përpiluar ashtu që të vërtetojë se e adhurojmë vetëm Zotin në të gjitha rrethanat (29:2).

* 2:165-166 Jezusi, Maria, Muhamedi, Aliu, dhe shenjtorët do i mohojnë idhujtarët e tyre në Ditën e Ringjalljes. Shih gjithashtu 16:86, 35:14, 46:6, dhe Ungjillin e Mateut 7:21-23.

[170] Kur u thuhet, "Ndiqui çka Zoti ka shpallur këtu," thonë, "Ne ndjekim vetëm çka i gjetëm prindërit tanë duke bërë." E çka nëse prindërit e tyre nuk kuptonin, dhe nuk ishin të udhëzuar?

[171] Shembulli i mosbesimtarëve të tillë është ai i papagajve që përsërisin zërat dhe thirrjet që dëgjojnë, pa i kuptuar. Të shurdhër, memecë, dhe të verbër; ata nuk mund të kuptojnë.

*Vetëm katër mishra ndalohen**

[172] O ju që besoni, hani nga gjërat e mira që ju furnizua, dhe jini falënderues ndaj Zotit, nëse e adhuron vetëm Atë.

[173] Ai ndalon për ju vetëm ngrënien e kafshëve që ngordhin vetë (pa ndërhyrje njerëzore), gjakun, mishin e derrit, dhe kafshët që dedikohen për tjetër pos Zotit. Nëse dikush detyrohet (t'i hajë këto), pa qëllim ose keqdashje, ai nuk shkakton asnjë mëkat. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

*Udhëheqësit fetar të korruptuar fshehin Mrekullinë e Kuranit**

[174] Ata që fshehin shpalljet e Zotit në shkrim, në këmbim të një përfitimi të vogël material, nuk hanë tjetër pos zjarr në barqet e tyre. Zoti nuk do tu flasë në Ditën e Ringjalljes, e as nuk do i pastrojë. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[175] Janë ata që zgjodhën humbjen në vend të udhëzimit, dhe ndëshkimin në vend të faljes. Si pasojë, ata do të duhet ta durojnë Ferrin.

[176] Kjo është për arsye se Zoti e ka shpallur këtë shkrim, që bartë të vërtetën, dhe ata që nuk pajtohen me shkrimin janë kundërshtarët më të flaktë.

Drejtësia definohet

[177] Drejtësi nuk është kthimi i fytyrave tuaja kah lindja ose perëndimi. Të drejtë janë ata që besojnë në Zotin, Ditën e Fundit, engjëjt, shkrimin, dhe profetët; dhe paratë ua japin, me gëzim, të afërmve, bonjakëve, nevojtarëve, udhëtarëve të huaj, lypësve, dhe për lirimin e skllëvërve; dhe i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat); dhe e mbajnë fjalën sa herë që premtojnë diçka; dhe këmbëngulin me durim përballë keqtrajtimit, varfërisë, dhe luftës. Këta janë të vërtetit; këta janë të drejtit.

*Shkurajimi i dënimit me vdekje**

[178] O ju që besoni, barazia është ligji i shpallur për ju kur keni të bëni me vrasje – i liri për të lirin, skllavi për skllavin, femra për femrën. Nëse dikush falet nga familja e viktimës, një reagim mirënjohës e ka radhën, dhe një kompensim me barazi të paguhet. Ky është një lehtësim nga Zotëruesi juaj dhe mëshirë. Kushdo që shkelë përtej kësaj vetëshkakton një ndëshkim që dhemb.

[179] Barazia është ligj që kursen jetë për ju, o ju që keni inteligjencë, që të jeni të drejtë.

Shkruani testament

[180] Është shpallur që kur të afrohet vdekja, të shkruani testament për të mirën e prindërve dhe të afërmve, me barazi. Ky është obligim për të drejtit.

[181] Nëse dikush e ndryshon testamentin që ka dëgjuar, mëkati i ndryshimit u bie atyre që janë përgjegjës për një ndryshim të tillë. Zoti është Dëgjues, Njohës.

* 2:172-173 Përgjatë gjithë Kuranit, vetëm katër mishra ndalohen (6:145, 16:115, Shtojca 16). Ndalesat ushqimore përtej këtyre të katërtave janë të barasvlershme me idhujtari (6:121,148,150; 7:32).

* 2:174-176 Pavarësisht nga dijenia e tyre për mrekullinë matematikore të Zotit në Kuran, udhëheqësit fetar të korruptuar u përpoqën për shumë vite ta fshehin këtë mrekulli mbresëlënëse. Shumë prej tyre e pranuan që ata nuk e duronin faktin që Rashad Khalifa, e jo ata, ishte bekuar me mrekullinë.

* 2:178 Kurani qartë e dekurajon dënimin me vdekje. Sillet çdo lloj arsyetimi që të kursehen jetë, duke përfshirë edhe jetën e vrasësit. Familja e viktimës mund ta llogarisë si më të mirë, në rrethana të caktuara, kursimin e jetës së vrasësit në këmbim të një kompensimi me barazi. Gjithashtu dënimi me vdekje nuk është i zbatueshëm nëse, për shembull, një femër vret një mashkull, ose e kundërta.

[182] Nëse dikush sheh padrejtësi të tepërt ose njëanshmëri nga testamentlënësi, dhe ndërmerr masa korigjuese që të kthejë drejtësinë në testament, ai nuk bën mëkat. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

*Agjërimi theksohet dhe modifikohet**

[183] O ju që besoni, agjërimi është shpallur për ju, siç është shpallur për ata para jush, që të arrini shpëtim.

[184] Ditë të posaçme (janë të caktuara për agjërim); nëse dikush është i sëmurë ose në udhëtim, një numër i barabartë i ditëve tjera mund të zëvendësohet. Ata që mund të agjërojnë, por me vështirësi të mëdha, mund ta zëvendësojnë atë me të ushqyerit e një personi të varfër për çdo ditë që e prishin agjërimin. Nëse dikush vullnetarisht (bën edhe më shumë punë të drejta), është edhe më mirë. Por agjërimi është më i mirë për ju, sikur veç ta dinit.

[185] Ramazani është muaji gjatë të cilit u shpall Kurani, që jep udhëzim për njerëzit, mësim të qarta, dhe kodin ligjor. Ata prej jush që kalojnë nëpër këtë muaj, të agjërojnë në të. Ata që janë të sëmurë ose duke udhëtuar mund ta zëvendësojnë me numër të njëjtë të ditëve tjera. Zoti ju dëshiron lehtësim, e jo vështirësi, që të përmbushni obligimet tuaja, dhe ta madhëroni Zotin për udhëzimin, dhe ta shprehni mirënjohjen tuaj.

Zoti ju përgjigjet lutjeve të "shërbëtorëve të Tij"

[186] Kur shërbëtorët e Mi të pyesin për Mua, Unë jam gjithmonë pranë. Unë ju përgjigjem lutjeve të tyre kur më luten. Njerëzit të më përgjigjen dhe të besojnë në Mua, që të udhëzohen.

[187] Të lejuara për ju janë marrëdhëniet seksuale me gratë tuaja gjatë netëve të agjërimit. Ato janë mbajtëset e fshehtësive tuaja, dhe ju jeni mbajtësit e fshehtësive të tyre. Zoti e dinte që ju i tradhtonit shpirtrat tuaj, dhe Ai ju ka shpenguar, dhe ju ka falur. Tash e tutje, ju mund të keni marrëdhënie me to, duke kërkuar atë që Zoti ju ka lejuar. Mund të hani dhe pini deri sa fija e bardhë e dritës të bëhet e dallueshme nga fija e errët e natës në agim. Pastaj, të agjëroni derisa të perëndon dielli. Marrëdhëniet seksuale janë të ndaluara nëse vendosni të strehoheni në vendlutje (gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit). Këto janë ligjet e Zotit; të mos i shkelni. Kështu Zoti sqaron shpalljet e Tij për njerëzit, që të mund të arrijnë shpëtim.

Ryshfeti, korrupsioni dënohen

[188] Të mos i merrni paratë e njëri tjetrit në mënyrë të paligjshme, e as tu jepni ryshfet zyrtarëve për t'ua hequr të tjerëve disa nga të drejtat në mënyrë të paligjshme, përderisa e dini.

Mos flisni rreth e rrotull

[189] Të pyesin për fazat e hënës! Thuaj, "Ato janë mjet për matjen e kohës, dhe përcaktojnë kohën e Haxhit." Nuk është e drejtë të flisni rreth e rrotull;* drejtësia arrihet duke ju përmbajtur urdhrave dhe duke qenë të drejtpërdrejtë. T'ia keni dronë Zotit, që të mund t'ia dilni.

*Rregullat e luftës**

[190] Mund të luftoni për Zotin kundër atyre që ju sulmojnë, por mos e teproni. Zoti nuk i do agresorët.

* 2:183-187 Si të gjitha obligimet në Nënshtrim, agjërimi po ashtu është shpallur nëpërmjet Ibrahimit (22:78, Shtojcat 9 & 15). Para shpalljes së Kuranit, marrëdhëniet seksuale ishin të ndaluara gjatë periudhës së agjërimit. Kjo rregull modifikohet në 2:187 për të lejuar marrëdhënie gjatë netëve të Ramazanit.

* 2:189 Idioma Kurane fjalë për fjalë thotë: "Mos hyni në shtëpi nga dyert e pasme." Pyetja për fazat e hënës është një shembull i të shprehurit rreth e rrotull; kishite motive të mëtutjeshme të këqija pas kësaj pyetje.

* 2:190 I gjithë luftimi rregullohet sipas rregullës themelore në 60:8-9. Luftimi lejohet vetëm për vetëmbrojtje, përderisa sulmi dhe shtypja dënohen rreptësisht përgjatë Kuranit.

[191] Ju mund t'i vritni ata që zhvillojnë luftë kundër jush, dhe mund t'i dëboni që kur ata ju dëbuan. Shtypja është më e keqe se vrasja. Mos i luftoni pranë Vendlutjes së Shenjtë, po të mos ju sulmojnë aty. Nëse ju sulmojnë, mund t'i vritni. Ky është ndëshkimi i drejtë për ata mosbesimtarë.

[192] Nëse heqin dorë, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[193] Ju gjithashtu mund t'i luftoni për ta eliminuar shtypjen, dhe për ta adhuruar Zotin lirisht. Nëse heqin dorë nga luftimi, të mos i sulmoni; agresioni lejohet vetëm kundër agresorëve.

[194] Gjatë Muajve të Shenjtë, agresionit mund t'i kundërviheni me një reagim të barabartë. Nëse ju sulmojnë, mund tu kundërpërgjigjeni duke iu shkaktuar ndëshkim të njëjtë. T'i keni dronë Zotit dhe ta dini që Zoti është me të drejtë.

[195] Të shpenzoni për Zotin; mos e hidhni veten me duart tuaja në shkatërrim. Të jeni bamirës; Zoti i do bamirësit.

*Shtegtimi Haxh dhe Umreh**

[196] T'i zbatoni të gjitha ritet e Haxhit dhe Umres për Zotin. Nëse pengoheni, ta dërgoni një sakrificë, dhe mos rifilloni t'i preni flokët tuaja deri sa sakrifica juaj ta ketë arritur cakun. Nëse jeni të sëmurë, ose duke vuajtur nga ndonjë lëndim koke (dhe detyroheni t'i preni flokët), ta shlyeni me agjërim, ose me bamirësi, ose me ndonjë formë tjetër të adhurimit. Gjatë Haxhit të rregullt, nëse e prishni gjendjen e Ihramit (shenjtërisë) ndërmjet Umres dhe Haxhit, ta shlyeni duke flijuar një sakrificë shtazore. Nëse nuk keni mundësi, të agjëroni tre ditë gjatë Haxhit dhe shtatë kur të ktheheni – komplet dhjetë – kjo vlen nëse nuk jetoni te Vendlutja e Shenjtë. T'ia keni dronë Zotit, dhe ta dini se Zoti është i saktë në zbatimin e ndëshkimit.

Katër muajt e Haxhit: (Dhyl-Hixhe, Muharrem, Safer, & Rebi I)

[197] Haxhi të zbatohet në muajt e caktuar.* Kushdo që niset të zbatojë Haxhin t'iu shmanget marrëdhënieve seksuale, sjelljeve të këqija, dhe grindjeve gjatë Haxhit. Çfarëdo të mire që bëni, Zoti është plotësisht i vetëdijshëm për të. Përderisa i përgatitni furnizimet për rrugë, furnizimi më i mirë është drejtësia. Të ma keni dronë Mua, o ju që posedoni inteligjencë.

[198] Nuk bëni gabim duke kërkuar furnizime nga Zotëruesi juaj (nëpërmjet tregtisë). Kur të hiqeni prej Arafatit, ta përkujtoni Zotin te Vendi i Shenjtë (Muzdelife). Ta përkujtoni Atë se ju udhëzoi; para kësaj, ishit të humbur.

[199] Të largoheni së bashku, me njerëzit e tjerë që largohen, dhe ta lutni Zotin për falje. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[200] Kur t'i kryeni ritet, të vazhdoni ta përkujtoni Zotin si i përkujtoni prindërit tuaj, ose edhe më mirë. Disa njerëz do të thoshin, "Zotëruesi ynë, na jep të mira në këtë botë," përderisa nuk kanë hise në Përjetësi.

[201] Të tjerët do të thoshin, "Zotëruesi ynë, na jep të mira në këtë botë, dhe të mira në Përjetësi, dhe ruana nga ndëshkimi i Ferrit."

[202] Secili nga këta do të marrin hisen që e kanë mbledhur. Zoti është më i shkathëti në llogaritje.

Mine: Ritet e fundit të Haxhit

[203] Ta përkujtoni Zotin për një numër ditësh (në Mine); kushdo që ngutet ta bëjë këtë për dy ditë nuk bën mëkat, dhe kushdo që rri më gjatë nuk bën mëkat, përderisa mbahet drejtësia. T'ia keni dronë Zotit, dhe ta dini se para Tij do të mblidheni.

* 2:196 Shih detajet e Haxhit dhe Umres në Shtojcën 15.

* 2:197 Haxhi mund të zbatohet në cilëndo kohë gjatë Muajve të Shenjtë; Dhyl-Hixhe Muharrem, Safer, dhe Rebi I. Qeveritë lokale e kufizojnë Haxhin në disa ditë të volitshme për ta. Shih 9:37

Pamja e jashtme mund të mashtrojë

[204] Mes njerëzish, dikush mund të të lë mbresa me shprehjet e tij në lidhje me këtë jetë, dhe madje mund t'i drejtohet Zotit të jetë dëshmitar i mendimeve të tij më të thella, përderisa ai është më i flakti kundërshtar.

[205] Posa të largohet, endet i korruptuar nëpër tokë, duke shkatërruar prona dhe jetë. Zoti nuk e do korrupsionin.

[206] Kur i thuhet, "Druaje Zotin," ai bëhet i zemëruar me mburrje. Si pasojë, fat i tij i vetëm është Ferri; çfarë vendbanimi i tmerrshëm.

[207] E ka nga njerëzit që dedikojnë jetën në shërbim të Zotit; Zoti është i dhembshëm ndaj adhuruesve të tillë.

[208] O ju që besoni, ta përqaftoni nënshtrimin e tërësishëm; mos i ndiqni hapat e Dreqit, pasi ai është armiku juaj më i flaktë.

[209] Nëse tërhiqeni, pasi që ju kanë ardhur provat e qarta, atëherë dijeni që Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[210] A po presin ata deri sa Vetë Zoti të vjen në re të dendura, bashkë me engjëjt? Kur të ndodhë kjo, e tërë çështja do të mbarojë, dhe te Zoti çdo gjë do të kthehet.*

*Mrekullitë Sjellin Përgjegjësi Më të Madhe**

[211] Pyeti Fëmijët e Izraelit sa mrekulli të thella ua kemi shfaqur! Për ata që shpërfillin bekimet e dhuruara mbi ta prej Zotit, Zoti është më i rrepti në ndëshkim.

Shkurtpamësia

[212] Jeta e kësaj bote është e zbukuruar në sytë e mosbesimtarëve, dhe ata i përqeshin ata që besojnë. Megjithatë, të drejtit do të jenë shumë më lart tyre në Ditën e Ringjalljes. Zoti e bekon këdo që Ai do, pa kufi.

Xhelozia shkatërrimtare

[213] Njerëzit dikur ishin një shoqëri kur Zoti dërgoi profetët si bartës lajmi të mirë, si dhe paralajmërues. Ai lëshoi me ta shkrimin, që bart të vërtetën, për të gjykuar në mes të njerëzve në grindjet e tyre. Për ironi, ata që pranuan shkrimin ishin ata që refuzuan cilindo shkrim të ri, përkundër provave të qarta që iu dhanë. Kjo është për shkak të xhelozisë nga ana e tyre. Zoti i udhëzon ata që besojnë në të vërtetën që polemizohet nga të gjithë tjerët, sipas vullnetit të Tij. Zoti udhëzon këdo që do në rrugë të drejtë.*

[214] A prisni të hyni në Parajsë pa u testuar si ata para jush? Ata u testuan me vështirësi dhe fatkeqësi, dhe u tronditën, deri sa i dërguari dhe ata që besuan me të thanë, "Ku është fitorja e Zotit?" Fitorja e Zotit është afër.

Pranuesit e bamirësisë

[215] Të pyesin për të dhënit: thuaj, "Bamirësia që jep duhet t'i shkojë prindërve, të afërmve, bonjakëve, të varfërve, dhe udhëtarit të huaj." Çfarëdo të mire që bën, Zoti është plotësisht i vetëdijshëm për të.

Besimtarët: Fituesit përfundimtar

* 2:210 Kjo botë është test; është shansi jonë i fundit që ta kthejmë veten prapë në mbretërinë e Zotit duke shpallë të pavlefshme idhujtarinë (shih HYRJEN). Nëse Zoti dhe engjëjt e Tij shfaqen, çdokush do të besojë, dhe testi nuk do të jetë i vlefshëm më.

* 2:211 Mrekullia matematikore e Kuranit është bekim i madh, dhe sjell me vete përgjegjësi mahnitëse (ju lutem shih 5:115).

* 2:213 Të gjithë adhuruesit e VETËM Zotit, nga të gjitha fetë, janë vërtetë të bashkuar.

[216] Luftimi mund t'ju imponohet, edhe pse nuk ju pëlqen. Por mund të mos ju pëlqejë diçka që është e mirë për ju, dhe mund t'ju pëlqejë diçka që është e keqe për ju. Zoti e di përderisa ju nuk e dini.

Shtypja dënohet

[217] Të pyesin për Muajt e Shenjtë dhe luftimin në ta: thuaj, "Luftimi në ta është përdhosje. Megjithatë, zbrapsja nga rruga e Zotit dhe mosbesimi në Të dhe në shenjtërinë e Vendlutjes së Shenjtë, dhe dëbimi i njerëzve të saj, janë përdhosje më të mëdha para Zotit. Shtypja është më e keqe se vrasja." Ata gjithmonë do t'ju luftojnë juve për t'ju mbrapsur nga feja juaj, nëse munden. Ata prej jush që zbrapsen nga feja e vet, dhe vdesin si mosbesimtarë, i kanë asgjësuar punët e tyre në këtë jetë dhe në Përjetësi. Këta janë banuesit e Ferrit, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[218] Ata që besojnë, dhe ata që emigrojnë dhe përpiqen për Zotin, kanë merituar mëshirën e Zotit. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

*Dehësit dhe bixhozi ndalohen**

[219] Të pyesin për dehësit dhe bixhozin: thuaj, "Në to ka mëkat të tepërt, dhe ca dobi për njerëzit. Por mëkatnia e tyre ia kalon dobisë shumë." Gjithashtu të pyesin çka duhet dhënë bamirësi: thuaj, "Tepricën." Kështu Zoti sqaron shpalljet për ju që të mund të pasqyroni,

[220] për këtë jetë dhe Përjetësinë. Dhe të pyesin ty për bonjakët: thuaj, "Edukimi i drejtë është më e mira që mund të bëni për ta. Nëse e përzieni pronën e tyre me tuajën, t'i trajtoni si anëtarë të familjes." Zoti i njeh të drejtit dhe shpirtligjtë. Sikur të donte Zoti, Ai ka mundur t'ju vë rregulla më të ashpra. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

Mos martoheni me idhujtare

[221] Të mos martoheni me idhujtare në mos besofshin ato; një besimtare është më e mirë se një idhujtare, edhe nëse të pëlqen. As të mos i martoni vajzat me idhujtarë, në mos besofshin ata. Një besimtar është më i mirë se një idhujtar, edhe nëse të pëlqen. Këta ftojnë në Ferr, derisa Zoti fton në Parajsë dhe falje, si do Ai. Ai sqaron shpalljet e Tij për njerëzit, që të mund të jenë të vëmendshëm.

Menstruacioni

[222] Të pyesin për menstruacionin: thuaj, "Dëmton; t'ju shmangeni marrëdhënieve seksuale me gratë gjatë menstruacionit; mos ju qasni atyre deri sa tu hiqet qafe. Kur tu hiqet qafe, mund të keni marrëdhënie me to në mënyrën e dizajnuar nga Zoti. Zoti i do ata që pendohen, dhe Ai i do ata që janë të pastër."

[223] Gratë tuaja janë bartëse të farës suaj. Pra, mund ta gëzoni këtë privilegj si të doni, përderisa e mbani drejtësinë. T'ia keni dronë Zotit, dhe dinie se do e takoni. Jepu lajme të mira besimtarëve.

Mos e merrni emrin e Zotit së Koti

[224] Të mos e përdorni emrin e Zotit në betë e rastësishme, për tu dukur të drejtë, fetar, ose për të arritur besueshmëri tek njerëzit. Zoti është Dëgjues, Njohës.

[225] Zoti nuk ju mban përgjegjës për të shprehurit e jashtëm të betimeve; Ai ju mban përgjegjës për qëllimet tuaja më të thella. Zoti është Falës, i Butë.

Ligjet e shkurorëzimit

* 2:219 Bota tash e kupton që dobitë ekonomike nga prodhimi i pijeve alkoolike dhe narkotikëve të paligjshëm nuk ia vlejnë për shkak të aksidenteve rrugore vdekjeprurëse, dëmtimeve trunore te fëmijët e nënave pijanece, krizat familjare, dhe pasojat e tjera katastrofike. Shqyrtohu me "Alcoholics Anonymous" dhe "Gamblers Anonymous" për më shumë informata. Shih gjithashtu 5:90-91.

[226] Ata që kanë ndërmend të shkurorëzohen nga gratë e tyre duhet të presin katër muaj (të ftohen); nëse e ndryshojnë mendjen dhe pajtohen, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[227] Nëse shkojnë deri në fund me shkurorëzimin, atëherë Zoti është Dëgjues, Njohës.

[228] Gratë e shkurorëzuara duhet të presin tre menstruacione (para martesës me tjetërkënd). Nuk është e ligjshme për to të fshehin çka Zoti krijon në mitrat e tyre, nëse besojnë në Zotin dhe në Ditën e Fundit. (Në rast shtatzënie,) dëshirat e burrit duhet të hynë në përdorim mbi ato të gruas, nëse ai dëshiron të rimartohet me të. Gratë kanë të drejta, si dhe obligime, barabartë. Kështu, dëshirat e burrit mbizotërojnë (në rast shtatzënie). Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[229] Shkurorëzimi mund të tërhiqet mbrapa dy herë. Gruaja e shkurorëzuar të lejohet të jetojë në shtëpinë e njëjtë miqësisht, ose të dal prej saj miqësisht. Nuk është e ligjshme për burrin që të marrë prapa çfarëdo që i ka dhënë asaj. Mirëpo, çifti mund të ketë frikë se mos e shkel ligjin e Zotit. Nëse ekziston frika se mund ta shkelin ligjin e Zotit, nuk bëjnë gabim nëse gruaja me dëshirë kthen çfarëdo që zgjedh ajo. Këto janë ligjet e Zotit; të mos i shkelni. Ata që shkelin ligjet e Zotit janë të padrejtë.

[230] Nëse shkurorëzohet nga ajo (për herë të tretë), është e paligjshme për atë që të rimartohet me të, në mos u martoftë ajo me një tjetër, e pastaj ai të shkurorëzohet nga ajo. Burri i parë pastaj mund të rimartohet me të, përderisa i zbaton ligjet e Zotit. Këto janë ligjet e Zotit; Ai i shpjegon ato për njerëzit që dinë.

Mos i hidhni të shkurorëzuarat në rrugë

[231] Nëse shkurorëzoheni nga gratë, kur ta përmbushin afatin (tre menstruacione), t'i lejoni të jetojnë në shtëpinë e njëjtë miqësisht, ose t'i leni të dalin miqësisht. Mos i detyroni të rrinë kundër dëshirës së tyre, si hakmarrje. Kushdo që e bën këtë i bën keq vetes. Mos i merrni shpalljet e Zotit si të kota. Përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju, dhe që Ai ju lëshoi shkrimin dhe mençuri që të ju shkollojë. T'ia keni dronë Zotit, dhe ta dini që Zoti është i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[232] Nëse shkurorëzoheni nga gratë, kur ta përmbushin afatin, mos i pengoni që të rimartohen me burrat e tyre, nëse pajtohen miqësisht. Këtë duhet ta kenë parasysh ata mes jush që besojnë në Zotin dhe në Ditën e Fundit. Kjo është më e pastër për ju, dhe më e drejtë. Zoti din, përderisa ju nuk dini.

[233] Nënata e shkurorëzuara duhet t'i ushqejnë foshnjat e tyre dy vjet të plota, nëse babai dëshiron ashtu. Babai duhet ta furnizojë ushqimin e nënës dhe veshmbathjen me barazi. Askush nuk duhet të ngarkohet përtej aftësisë së tij. Asnjë nënë nuk duhet të dëmtohet në llogari të foshnjës së saj, e as babai të dëmtohet për shkak të foshnjës së tij. (Nëse babai vdes), trashëguesi i tij duhet t'i marrë këto përgjegjësi. Nëse prindërit e foshnjës pajtohen në mënyrë të përbashkët të ndahen pas konsultimit të duhur, nuk bëjnë gabim nëse bëjnë ashtu. Nuk bëni gabim nëse punësoni gjidhënëse tjera, përderisa i paguani me barazi. T'ia keni dronë Zotit, dhe ta dini që Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

T'i zbatoni afatet paramartesore

[234] Ata që vdesin dhe lënë gra, të vejat e tyre duhet të presin katër muaj e dhjetë ditë (para se të rimartohen). Kur ta përmbushin afatin, nuk bëni gabim t'i lini të bëjnë çfarëdo pune të drejtë që dëshirojnë të bëjnë. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

[235] Nuk mëkatoni duke njoftuar tërheqjen tuaj ndaj grave, apo duke e mbajtur fshehtë. Zoti e di se do të mendoni për to. Mos i takoni fshehurazi, në mos paçi diçka të drejtë për të diskutuar. Mos e përmbushni martesën deri sa të përmbushet afati i tyre. Duhet ta dini se Zoti i di mendimet tuaja

më të thella, dhe t'ia keni dronë Atij. Duhet ta dini se Zoti është Falës, i Butë.

Prishja e fejesës

[236] Nuk bëni gabim duke u ndarë nga gratë para se t'i prekni, ose para se ta caktoni pajën për to. Në këtë rast, t'i kompensoni ato – i pasuri sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij – kompensim me barazi. Kjo është detyrë për të drejtit.

[237] Nëse ndaheni nga to para se t'i prekni, por pasi ta keni caktuar pajën, kompensimi duhet të jetë gjysma e pajës, po të mos e falin ato vullnetarisht të drejtën e tyre, ose pala përgjegjëse për shkaktimin e ndarjes zgjedhë që ta falë pajën. Të falni është më afër drejtësisë. Të vazhdoni t'i mbani marrëdhëniet miqësore mes jush. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

*T'i zbatoni Lutjet e Kontaktit**

[238] T'i zbatoni rregullisht Lutjet e Kontaktit, posaçërisht lutjen e mesme, dhe t'ia kushtoni veten plotësisht Zotit.

[239] Në rrethana të jashtëzakonshme, mund të luteni duke ecur ose ngarë. Kur të jeni të sigurt, ta përkujtoni Zotin ashtu si ju mësoi çka ju nuk dinit.

Mbështetje për të vejat dhe të shkurorëzuarat

[240] Ata që vdesin dhe lënë gra, një testament duhet t'i furnizojë gratë e tyre me mbështetje për një vjet, po që se ato rrinë në shtëpinë e njëjtë. Nëse dalin, nuk bëni mëkat t'i leni të bëjnë çfarëdo që dëshirojnë, përderisa mbahet drejtësia. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[241] Të shkurorëzuarat gjithashtu duhet furnizuar, me barazi. Kjo është detyrë për të drejtit.

[242] Zoti kështu ju shpjegon shpalljet e Tij, që të mund të kuptoni.

Përpjekja për Zotin

[243] A i ke vërejtur ata që ikën nga shtëpitë e tyre – edhe pse ishin me mijëra – nga frika prej vdekjes? Zoti u tha, "Vdisni," pastaj i ringjalli. Zoti lëshon mirësinë e Tij mbi njerëzit, por shumica e njerëzve janë jo-mirënjohës.

[244] Të luftoni për Zotin, dhe ta dini se Zoti është Dëgjues, Njohës.

[245] Kush do i jepte Zotit hua të drejtësisë, për t'iu kthyer e shumëfishuar? Zoti është Ai që furnizon dhe mban, dhe te Ai do të ktheheni.

*Sauli**

[246] A i keni vërejtur prijësit e Izraelit pas Moisiut? Ata i thanë profetit të tyre. "Nëse cakton një mbret për të na udhëhequr, do të luftojmë për Zotin." Ai tha, "A e keni ndërmend që, nëse luftimi shpallet për ju, nuk do të luftoni?" Ata thanë, "Pse të mos luftojmë për Zotin, kur na kanë hequr nga shtëpitë tona, dhe fëmijët tonë?" Prapëseprapë, kur luftimi u shpall për ta, ata refuzuan, përveç një pakice. Zoti është i vetëdijshëm për shkelësit.

Vënia në dyshim e mençurisë së Zotit

[247] Profeti i tyre u tha, "Zoti ka caktuar Talutin (Saulin) të jetë mbret i juaji." Ata thanë "Si mund të ketë ai mbretërim mbi ne kur ne jemi më meritore për mbretërim se ai; madje ai as nuk është i pasur?" Ai tha, "Zoti e ka zgjedhur atë mbi ju, dhe e ka bekuar me begati në dije dhe në trup." Zoti i

* 2:238 Të pesë lutjet gjenden në 2:238, 11:114, 17:78, & 24:58. Kur u shpall Kurani, Lutjet e Kontaktit (Salat) veç kishin qenë në ekzistencë (Shtojca 9). Detajet e të pesë lutjeve – çka të recitohet dhe numri i njëjësive (Reqateve) në lutje, etj. – janë matematikisht të konfirmuara. Për shembull, nëse e shkruajmë numrin e njëjësive të secilës nga pesë lutjet, nërin pranë tjetrit, fitojmë 24434, 19x1286. Gjithashtu, nëse përdorim [] për të përfaqësuar Suren 1 (El-Fatihah), ku []=numri i sures (1), i pasuar nga numri i secilës strofë, numri i shkronjave në secilën strofë, dhe vlera gormore e çdo shkronje, duke shkruar 2 [] [] 4 [] [] [] [] 4 [] [] [] [] 3 [] [] [] 4 [] [] [] [] jep shumëfish të 19-tës (shih 1:1).

* 2:246 E njëjta histori rrëfëhet në Bibël, Libri I i Samuelit, Kapitulli 9 dhe 10.

dhuron mbretërimin e Tij kujtdo që Ai do. Zoti është Bujar, i Gjithëdijshëm.

Arka e Besëlidhjes

[248] Profeti i tyre u tha, "Shenja e mbretërimit të tij është që Arka e Besëlidhjes do të ju kthehet juve, duke ju sjellë bindje nga Zotëruesi juaj, dhe relikte të lëna nga njerëzit e Moisiut dhe njerëzit e Aronit (Harunit). Do të bartet nga engjëjt. Kjo duhet të jetë shenjë që ju bind, nëse me të vërtetë jeni besimtarë."

Davidi dhe Goliathi

[249] Kur Sauli mori nën komandë trupat, ai tha, "Zoti po ju vë në test me anën e një përroi. Kushdo që pi prej tij nuk është me mua – vetëm ata që nuk e provojnë janë me mua – po të mos jetë veç një fyt." Ata pinë prej tij, përveç një pakice. Kur e kaloi me ata që besuan, ata thanë, "Tash na mungon fuqia të përballemi me Goliathin dhe trupat e tij." Ata që ishin të vetëdijshëm se do të takohen me Zotin thanë, "Sa e sa ushtri të vogla mposhtën ushtri të mëdha me lejen e Zotit. Zoti është me ata që durojnë me këmbëngulësi."

[250] Kur i dolën përballë Goliathit dhe trupave të tij, u lutën, "Zotëruesi ynë, dhurona durim, përforcona këmbët, dhe përkrahna kundër njerëzve mosbesimtarë."

[251] I mposhtën me lejen e Zotit, dhe Davidi (Davudi) vrau Goliathin. Zoti i dha mbretërim dhe mençuri, dhe e mësoi si Ai deshi. Po të mos ishte përkrahja e Zotit ndaj disa njerëzve kundër të tjerëve, do të ishte kaos në tokë. Por Zoti lëshon mirësinë e Tij mbi njerëzit.

[252] Këto janë shpalljet e Zotit. I recitojmë nëpërmjet teje,* vërtetë, se je një nga të dërguarit.

Shumë të dërguarë / Një lajm

[253] Këta të dërguarë; i bekuam disa prej tyre më shumë se tjerët. Për shembull, Zoti i foli njerit, dhe ngritëm disa prej tyre në rang më të lart. Dhe i dhamë Jezusit, birit të Marisë, mrekulli të mëdha dhe e mbështetëm me Frymën e Shenjtë. Po të kishte dashur Zoti, ithtarët e tyre nuk do të kishin luftuar me njëri tjetrin, pasi u kishin ardhur provat e qarta. Përkundrazi, ata u grindën në mes vete; disa prej tyre besuan, dhe disa nuk besuan. Po të kishte dashur Zoti, ata nuk do të kishin luftuar. Çdo gjë është në përputhje me vullnetin e Zotit.

*Asnjë ndërmjetësim**

[254] O ju që besoni, të jepni bamirësi nga furnizimet që jua dhamë, para se të vijë një ditë ku nuk ka shitblerje, as familjarizëm, as ndërmjetësim. Pabesimtarët janë të padrejtë.

[255] Zoti: nuk ka zot tjetër pos Tij, të Gjallit, të Përvetshmit. Atë nuk e zë as kotje as gjumë. E tij është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Kush do të mund të ndërmjetësonte me Të, përveç në përputhje me vullnetin e Tij? Ai e di të kaluarën e tyre, dhe të ardhmen e tyre. Askush nuk fiton ndonjë dije, përveç si dëshiron Ai. Pushteti i Tij përfshinë qiejt dhe tokën, dhe nuk i vjen rëndë të kujdeset për to. Ai është Më i Larti, i Madhi.

Jo fe me zor

[256] Nuk shkon feja me zor: e drejta tash është e dallueshme nga e gabuara. Kushdo që denoncon

* 2:252 Në përputhje me kompozicionin matematikor të Kuranit, Zoti ka dashur që emri i të dërguarit të përmendur këtu të jetë i shqiptuar matematikisht. Zbulimi i kodit të mbinatyreshëm matematikor të Kuranit të bazuar në 19 ka qenë i hyjnisht i rezervuar për të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes. Me mbledhjen e numrit të kësaj strofe (252), dhe vlerës germore të "Rashad" (505), plus vlerën germore të "Khalifa" (725) fitojmë $252+505+725 = 1482$, apo 19×78 . Ju lutem shihni Shtojcat 2 dhe 26 për detajet e plota në lidhje me identitetin e vërtetuar të të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes, të cilit edhe i referohet kjo strofë qartë.

* 2:254 Njëra nga dredhitë e shkathta të Dreqit është mveshja e fuqisë së ndërmjetësimit idhujve njerëz të pafuqi si Jezusit dhe Muhamedit. (Shtojca 8).

djallin dhe beson në Zotin ka kapur lidhjen më të fortë; një që nuk këputet. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.

[257] Zoti është Zotërues i atyre që besojnë; i nxjerr nga errësira në dritë. Sa për ata që nuk besojnë, zotërues të tyre janë idhujt e tyre; i fusin nga drita në errësirë – këta do të jenë banuesit e Ferrit; ata qëndrojnë në të përgjithmonë.

Diskutimi i guximshëm i Ibrahimit

[258] A e ke vërejtur atë që polemizoi me Ibrahimin rreth Zotëruesit të tij, edhe pse Zoti i kishte dhënë mbretërim? Ibrahim tha, "Zotëruesi im dhuron jetë dhe vdekje." Ai tha, "Unë jap jetë dhe vdekje." Ibrahim tha, "Zoti e sjell diellin nga lindja, a mund ta sjellësh ti nga perëndimi?" Mosbesimtari mbeti. Zoti nuk i udhëzon shpirtligjtë.

*Mësim për vdekjen**

[259] Merre parasysh atë që kaloi pranë një qyteti të vdekur dhe pyeti veten, "Si mund Zoti ta ringjall këtë pasi që ka vdekur?" Zoti pastaj e vuri në vdekje për njëqind vjet, pastaj e ringjalli, dhe i tha, "Sa ke qëndruar këtu?" Ai tha, "Kam qenë këtu një ditë, ose një pjesë të ditës." Ai tha, "Jo! Ti ke qenë këtu njëqind vjet. E shiko ushqimin dhe pijen tënde; nuk janë prishur. E shiko gomarin tënd – kështu ne të shndërrojmë ty në mësim për njerëzit. Tani, shiko si i ndërtojmë eshtrat, pastaj i mbështjellim me mish." Kur ai e kuptoi çka kishte ndodhur, ai tha, "Tani e di se Zoti është i Gjithëfuqishëm."

Çdo besimtar ka nevojë për bindje

[260] Ibrahim tha, "Zotëruesi im, tregomë si i ringjall të vdekurit." Ai tha, "A nuk beson?" Ai tha, "Po, por dua ta bindë edhe një herë zemrën time." Ai tha "Merri katër zogj, ua mbaj mend shenjat, vendose nga një pjesë të secilit zog në maje të një kodre, pastaj thirri te ti. Do të vijnë te ti fluturimthi. Ta dish se Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri."

Investimi më i mirë

[261] Shembulli i atyre që shpenzojnë paratë për Zotin është si i një kokrre që prodhon shtat kallinj, me nga njëqind kokrra në secilin kalli. Zoti e shumëfishon këtë për këdo që Ai do. Zoti është Bujar, i Dijshëm.

[262] Ata që shpenzojnë paratë e tyre për Zotin, pastaj nuk e shoqërojnë bamirësinë me ofendim ose lëndim, do të marrin shpërblimin e tyre nga Zotëruesi i tyre; ata nuk kanë pse të frikësohen, e as nuk do të brengosen.

[263] Fjalët e mira dhe keqardhja janë më të mira se një bamirësi e shoqëruar me ofendim. Zoti është i Pasur, i Butë.

[264] O ju që besoni, mos i anuloni bamirësitë tuaja me qortim dhe ofendim, sikur njëri që i shpenzon paratë e tij për tu treguar, përderisa nuk beson në Zotin dhe në Ditën e Fundit. Shembulli i tij është si një shkëmb i mbuluar me një shtresë të hollë dheu; posa të bie një shi i madh, e lanë dheun, duke e lënë atë shkëmb të papërdorshëm. Ata nuk fitojnë asgjë nga përpjekjet e tyre. Zoti nuk udhëzon njerëz mosbesimtarë.

Bamirësia

[265] Shembulli i atyre që japin paratë e tyre duke kërkuar kënaqësinë e Zotit, nga bindja e singertë, është si i një kopshti në tokë të lartë pjellore; kur bie shi i madh, ajo jep dy herë më shumë të korra. Nëse nuk bie shi i madh, mjafton një rigë. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

* 2:259 Mësimi që mësojmë këtu është që periudha e vdekjes – vetëm të padrejtit vdesin; të drejtit shkojnë drejt në Parajsë – kalon si një ditë (shih 18:19-25 dhe Shtojcën 17).

[266] A dëshiron ndokush prej jush të ketë një kopsht me palma dhe hardhi, me proje që rrjedhin dhe fruta me bollëk, pastaj, posa të plakët, dhe përderisa fëmijët e tij janë ende të varur nga ai, një kërdi ia godet dhe shkruan kopshtin? Zoti kështu jua sqaron shpalljet, që të mund të paramendonit.

Çka të jepni

[267] O ju që besoni, të jepni bamirësi nga gjërat e mira që i fitoni, dhe nga ajo që kemi prodhuar për ju nga toka. Mos e zgjidhni të keqen nga aty për ta falur, kur as vet nuk e pranoni atë pa i pasur sytë e mbyllur. Ta dini se Zoti është i Pasur, i Falënderuar.

[268] Djalli ju premtos varfëri dhe ju urdhëron të bëni të këqija, përderisa Zoti ju premtos falje nga Ai dhe mirësi. Zoti është Bujar, i Gjithëdijsëm.

Mençuria: Thesar i madh

[269] Ai dhuron mençuri mbi këdo që Ai zgjedh, dhe kushdo që arrin të jetë i mençur, ka arritur një dhuratë të madhe. Vetëm ata që kanë inteligjencë do të jenë të vëmendshëm.

Bamirësia anonime, më e mirë

[270] Çfarëdo bamirësie që jep, ose premtim bamirësie që përmbush, Zoti është tërësisht i vetëdijsëm për të. Sa për shpirtligjtë, ata nuk do të kenë ndihmues.

[271] Nëse i deklaroni bamirësitë, ato janë ende të mira. Por nëse i mbani anonime, dhe ua jepni të varfërve, është më mirë për ju, dhe jua largon më shumë nga mëkatet tuaja. Zoti është Njohës i tërësisëm i çdo gjëje që bëni.

Zoti është i vetmi që udhëzon

[272] Ti nuk je përgjegjës për të udhëzuar ndokënd. Zoti është i vetmi që udhëzon atë që zgjedhë (të udhëzohet). Çfarëdo bamirësie që jepni është për të mirën tuaj. Çfarëdo bamirësie që jepni duhet të jetë për hatër të Zotit. Çfarëdo bamirësie që jepni do të ju kthehet, pa as më të voglën padrejtësi.

[273] Bamirësia duhet t'u shkojë të varfërve që janë duke vuajtur për Zotin, dhe nuk mund të emigrojnë. Të pavetëdijsmit mund të mendojnë që ata janë të pasur, për shkak të dinjitetit të tyre. Por ju mund t'i njihni ata nga shenja të caktuara; ata nuk lypin prej njerëzve vazhdimisht. Çfarëdo bamirësie që jepni, Zoti është tërësisht i vetëdijsëm për të.

[274] Ata që japin bamirësi natën dhe ditën, fshehtë dhe haptas, marrin shpërblimin e tyre nga Zotëruesi i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen, e as nuk do të brengosen.

*Fajdeja ndalohe**

[275] Ata që marrin fajde janë në pozitë të njëjtë si ata me dyzginë nga ndikimi i djallit. Kjo është për shkak se ata pretendojnë që fajdeja është njëjtë si tregtia. Megjithatë, Zoti lejon tregtinë, dhe ndalon fajdenë. Pra, kushdo që i vë veshin këtij urdhri nga Zotëruesi i tij, dhe heq dorë nga fajdeja, ai mund t'i mbaj fitimet e kaluara, dhe gjykimi i tij mbetet me Zotin. Sa për ata që vazhdojnë me fajde, ata vetëshkaktojnë Ferrin, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[276] Zoti dënon fajdenë, dhe bekon bamirësinë. Zotit nuk i pëlqen asnjë mosbesimtar, fajtor.

Garanci Hyjnore

[277] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, dhe zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe japin

* 2:275-278 Është parim i themeluar ekonomik që interesi ose kamata e tepruar në huadhënie mund ta shkatërrojë krejtësisht një vend të tërë. Gjatë disa viteve të fundit, kemi qenë dëshmitarë të shkatërrimit të ekonomive të shumë shteteve ku ngarkohet interesi i tepërt. Interesi normal – më i vogël se 20% – ku askush nuk viktimizohet dhe të gjithë ndahen të kënaqur, nuk është fajde.

bamirësinë e obligueshme (Zeqat), ata marrin shpërblimin e tyre nga Zotëruesi i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen.

[278] O ju që besoni, t'ia keni dronë Zotit dhe të hiqni dorë nga të gjitha llojet e fajdesë, nëse jeni besimtarë.

[279] Nëse jo, atëherë prisni luftë nga Zoti dhe i dërguari i Tij. Por nëse pendoheni, mund ta mbani kapitalin, pa shkaktuar padrejtësi, ose pësuar padrejtësi.

[280] Nëse borxhliu nuk është në gjendje të paguaj, prisni për një kohë më të mirë. Nëse ia leni huan si bamirësi, do të ishte më mirë për ju, sikur veç ta dinit.

[281] Ruajuni ditës kur ktheheni te Zoti, dhe çdo shpirt paguhet për gjithçka që ka bërë, pa më të voglën padrejtësi.

Shënoni transaksionet financiare

[282] O ju që besoni, kur merrni hua për çfarëdo afati, ta shënoni. Një shkruer i paanshëm duhet ta shkruaj. Asnjë shkruer nuk duhet të refuzojë ta bëjë këtë shërbim, në përputhje me mësimet e Zotit. Ai duhet të shkruaj, përderisa borxhliu i dikton kushtet. Ai duhet t'ia ketë dronë Zotit Zotëruesit të tij dhe të mos bëjë hile. Nëse borxhliu është i paaftë mentalisht, ose i pazoti, ose nuk mund të diktojë, kujdestari i tij duhet të diktojë me barazi. Dy burra duhet të jenë dëshmitarë; nëse jo dy burra, atëherë një burrë dhe dy gra dëshmia e të cilëve pranohet nga të gjithë.* Kështu, nëse njëra grua bëhet e njëanshme, tjetra do të ia kujtojë. Është obligim i dëshmitarëve që të dëshmojnë kur të thirren për të bërë ashtu. Të mos përtoni t'i shkruani detajet, pa marrë parasysh sa të gjata janë, përfshirë edhe kohën e kthimit të huasë. Kjo është e barabartë para syve të Zotit, siguron dëshmim më të mirë, dhe eliminon ndonjë dyshim që mund ta keni. Shitblerjet që i kryeni aty për aty nuk ka nevojë të shënohen, por le të jenë të dëshmuara. Asnjë shkruer ose dëshmitar nuk duhet të dëmtohet në llogari të shërbimit të tij. Nëse i dëmtoni, do të ishte ligësi nga ana juaj. T'ia keni dronë Zotit, dhe Zoti do t'ju mësojë. Zoti është i Gjithëdijshëm.

[283] Nëse jeni duke udhëtuar, dhe asnjë shkruer nuk është në dispozicion, të lëshohet një hipotekë për të garantuar kthimin e huasë. Nëse dikujt i zihet besë në këtë mënyrë, ai duhet ta kthejë hipotekën në kohën e duhur, dhe t'ia ketë dronë Zotit Zotëruesit të tij. Mos dëshmoni duke fshehur atë për të cilën keni qenë dëshmitarë. Kushdo që fsheh një dëshmi është mëkatar në zemër. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëni.

[284] E Zotit është çdo gjë në qiej dhe tokë. Pa marrë parasysh a i deklaroni mendimet tuaja më të thella, apo i mbani të fshehta, Zoti ju mban përgjegjës për to. Ai fal këdo që Ai do, dhe ndëshkon këdo që Ai do. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Të mos bëni asnjë dallim në mes të të dërguarve të Zotit

[285] I dërguari ka besuar në atë që iu zbrit nga Zotëruesi i tij, si edhe besimtarët. Ata besojnë në Zotin, engjëjt e Tij, shkrimin e Tij, dhe të dërguarit e Tij; "Ne nuk bëjmë asnjë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij." Ata thonë, "Dëgjojmë, dhe të bindemi.* Falna, Zotëruesi ynë. Te Ti është

* 2:282 Transaksionet financiare janë situatat e VETME ku dy gra mund ta zëvendësojnë një burrë si dëshmitar. Kjo është për të na mbrojtur kundër mundësisë reale që njëri dëshmitar mund të martohet me dëshmitaren, dhe kështu ta bëjë atë të jetë e njëanshme. Është fakt i njohur se gratë janë më shumë të cenueshme emocionalisht se burrat.

* 2:285 Njëri nga urdhrat e rëndësishëm është: "Mos bëni asnjë dallim mes të dërguarve të Zotit" (2:136, 3:84, 4:150). Besimtarët reagojnë duke thënë, "Dëgjojmë dhe bindemi," përderisa idhujtarët polemizojnë për ta arsyetuar insistimin e tyre për përmendjen e emrit të Muhamedit pranë të Zotit, duke i përjashtuar të gjithë të dërguarit e tjerë. Myslimanët e korruptuar e përmendin Muhamedin në shprehjen e tyre të besimit (Shehadet) dhe gjatë Lutjeve të Kontaktit të tyre (shih 72:18).

fati ynë përfundimtar. "

[286] Zoti nuk e ngarkon asnjë shpirt përtej mundësive të tij; për të mirë të tij është çka fiton ai, dhe kundër tij është në çka ai bie. "Zotëruesi ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë. Zotëruesi ynë, dhe mbrona që të mos blasfemojmë kundër Teje, siç kanë bërë ata para nesh. Zotëruesi ynë, mbrona nga mëkatimi para se të na bëhet shumë vonë për tu penduar. Falna, dhe shlyena mëkatet. Ti je Zotëruesi dhe Mbizotëruesi ynë. Dhurona fitore kundër njerëzve mosbesimtarë."

Surja 3: Amramitët (Al-Imran)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.M.*

[2] Zoti: nuk ka asnjë zot pos Tij; të Gjallit, të Përjetshmit.

[3] Ai e zbriti këtë shkrim tek ju, vërtetë, që vërteton të gjitha shkrimet paraprake, dhe Ai e zbriti Torahn dhe Ungjillin

[4] para kësaj, që t'i udhëzojë njerëzit, dhe Ai zbriti kodin ligjor. Kush nuk beson në shpalljet e Zotit vetëshkakton ndëshkim të rëndë. Zoti është i Plotfuqishëm, Shpagues.

[5] Asgjë nuk është e fshehur prej Zotit, as në tokë, e as në qiell.

[6] Ai është Ai që ju formon në mitra si do Ai. Nuk ka tjetër zot pos Tij; të Plotfuqishmit, Më të Mençurit.

[7] Ai jua zbriti këtë shkrim, që përmban strofa të drejtpërdrejta – që përbëjnë esencën e shkrimit – si dhe strofa me shumë kuptime ose alegorike. Ata që ushqejnë dyshime në zemrat e tyre do t'u qepen strofave shumë-kuptimshe për të ngjall huti, dhe për të shpëputur një kuptim të caktuar. Askush nuk e di kuptimin e vërtetë të tyre përveç Zotit dhe atyre fort të bazuar në dijeni. Ata thonë, "Ne besojmë në këtë – e gjitha vjen prej Zotëruesit tonë." Vetëm ata që kanë inteligjencë do të marrin vesh.

[8] "Zotëruesi ynë, mos na i lë zemrat të na luhaten, tash që na ke udhëzuar. Lëshona mëshirën Tënde; Ti je Dhuruesi.

[9] "Zotëruesi ynë, Ti padyshim se do i mbledhësh njerëzit në një ditë që është e pashmangshme. Zoti nuk e shkelë premtimin."

[10] Ata që nuk besojnë nuk do të ndihmohen nga paratë e tyre, e as nga fëmijët e tyre, kundër Zotit. Ata do të jenë lëndë djegëse e Ferrit.

[11] Si populli i Faraonit dhe ata para tyre, refuzuan shpalljet tona dhe, si pasojë, Zoti i ndëshkoi për mëkatet e tyre. Zoti është i rreptë në zbatimin e ndëshkimit.

[12] Thuaju atyre që nuk besojnë, "Ju do të mposhteni, pastaj do të mblidheni në Ferr; çfarë vendbanimi i tmerrshëm!"

Besimtarët: Fituesit përfundimtar

[13] Është vënë për ju një shembull nga dy ushtritë që u ndeshën – njëra ishte duke luftuar për Zotin, përderisa tjetra ishte duke mos besuar. Ata e panë me sytë e vet se ishin dy herë më shumë. Zoti mbështetë me fitoren e Tij këdo që Ai do. Kjo duhet të japë siguri për ata që kanë vizion.

Prioritete të ndryshme

[14] Të zbukuruara për njerëzit janë kënaqësitë e botës, siç janë gratë, lindja e fëmijëve, grumbujt e arit dhe argjendit, kuajt e stërvitur, bagëtia, e bujqësia. Këto janë kënaqësitë materiale të kësaj

* 3:1 Shih Shënimin 2:1 dhe Shtojcën Një.

bote. Një vendbanim shumë më i mirë është i rezervuar te Zoti.

[15] Thuaj, "A t'ju kallëzoj për diçka më të mirë: për ata që çojnë jetë të drejtë, të rezervuara te Zotëruesi i tyre, janë kopshte me proje që rrjedhin, dhe bashkëshorte të çiltra, dhe gëzim në bekimet e Zotit." Zoti është Pamës i adhuruesve të Tij.

[16] Thonë, "Zotëruesi ynë, ne kemi besuar, prandaj falna mëkatet, dhe ruana nga agonja e zjarrit."

[17] Ata janë të palëkundshëm, të singertë, të nënshtruar, bamirës, dhe meditues në agim.

*Urdhri më i rëndësishëm**

[18] Zoti dëshmon se nuk ka zot përveç Tij, e ashtu dëshmojnë edhe engjëjt dhe ata që kanë dije. Singërisht dhe me të drejtë, Ai është zoti absolut; nuk ka tjetër zot pos Tij, të Plotfuqishmit, Më të Mençurit.

Nënshtrimi: E vetmja fe

[19] E vetmja fe e aprovuar nga Zoti është "Nënshtrimi." Ironikisht, ata që kanë pranuar shkrimin janë ata që e polemizojnë këtë fakt, përkundër diturisë që e kanë pranuar, për shkak të xhelozisë. Për refuzuesit e tillë të shpalljeve të Zotit, Zoti është më i rrepti në llogaritje.

[20] Nëse ata polemizojnë me ty, atëherë thuaj, "Unë thjeshtë ia kam nënshtruar veten Zotit; Unë dhe ata që më ndjekin mua." Të deklaroni para atyre që e pranuan shkrimin, si dhe atyre që nuk e pranuan, "A nënshtroheni?" Nëse nënshtrohen, atëherë janë udhëzuar, por nëse refuzojnë, misioni yt i vetëm është ta dorëzosh këtë mesazh. Zoti është Pamës i gjithë njerëzve.

[21] Ata që kanë refuzuar shpalljet e Zotit, dhe vranë profetët padrejtësisht, dhe vranë ata që përkrahën drejtësinë mes njerëzve, premtu atyre një ndëshkim që dhemb.

[22] Punët e tyre janë asgjësuar, edhe në këtë jetë edhe në Përjetësi, dhe ata nuk do të kenë ndihmues.

[23] A i ke vërejtur ata që u është dhënë një pjesë e shkrimit dhe si ata ftohen që t'i përmbahen këtij shkrimi të Zotit, dhe ta zbatojnë në jetët e tyre, pastaj disa prej tyre refuzojnë me neveri?

[24] Kjo është për shkak se ata thanë, "Nuk do të na kapë zjarri, përveç disa ditësh." Ata pra janë mashtruar në fenë e tyre nga trillimet e veta.

[25] Si do të jetë për ta, kur t'i mbledhim në atë të pashmangshmen ditë? Secili shpirt do të paguhet për çfarëdo që mblodhi, pa as më të voglën padrejtësi.

Vetitë e Zotit

[26] Thuaj, "I yni zot: posedues i gjithë sovranitetit. Ti i dhuron sovranitet kujtdo që Ti zgjedhë, Ti i heq sovranitetin kujtdo që Ti zgjedhë. Ti i dhuron dinjitet kujtdo që Ti zgjedhë, dhe e poshtëron këdo që Ti zgjedhë. Në dorën Tënde janë të gjitha furnizimet. Ti je i Gjithëfuqishëm.

[27] "Ti e shkrinë natën në ditë, dhe e shkrinë ditën në natë. Ti e prodhon të gjallin nga i vdekuri, dhe e prodhon të vdekurin nga i gjalli, dhe Ti furnizon për këdo që Ti zgjedhë, pa kufi."

Zgjidhni shokët tuaj me kujdes

[28] Besimtarët nuk iu bashkohen mosbesimtarëve, në vend të besimtarëve. Kushdo që bën këtë është i dëbuar prej Zotit, me përjashtim të atyre që detyrohen ta bëjnë këtë për t'iu shmangur

* 3:18 Deklarata e besimit (Shehadeti) që është deklaruar nga Zoti është; "Nuk ka zot përveç Zotit," në arabisht "La ilahe illa Allah" (shih gjithashtu 37:35, 47:19). Myslimanët e korruptuar insistojnë në shtimin e një "Shehadeti" të dytë duke deklaruar se Muhamedi është i dërguari i Zotit. Kjo është kategorikisht "Shirk" (idhujtari) dhe haptazi mospërfillje e Zotit dhe të dërguarit të Tij. Veç kësaj, kjo i shkel urdhrat e rëndësishëm që gjenden në 2:136, 2:285, 3:84, & 4:150-152 që ndalojnë bërjen e dallimeve në mes të të dërguarve të Zotit. Duke deklaruar se "Muhamedi është i dërguar i Zotit," dhe duke mos arritur që të bëhet e njëjta deklaratë për të dërguarë të tjerë si Ibrahim, Moisiu, Jezusi, Salihu, dhe Jona, bëhet dallim dhe shkelet një urdhër i rëndësishëm.

persekutimit. Zoti ju alarmon që ju duhet t'ia keni dronë vetëm Atij. Te Zoti është fati përfundimtar.

[29] Thuaj, "E fshehët mendimin tuaj më të thellë, apo e deklaruat, Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të." Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë në qiej dhe tokë. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[30] Do të vijë dita kur çdo shpirt do i gjejë të gjitha veprat e mira që i ka bërë të sjella përpara. Sa për veprat e këqija, do të dëshirojë që ato të ishin larg e më larg. Zoti ju porositi t'ia keni dronë vetëm Atij. Zoti është i Dhembshëm ndaj njerëzve.

[31] Deklaro: "Nëse e doni Zotin, duhet të vini pas meje." Zoti atëherë do të ju dojë juve, dhe t'ua falë mëkatet. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[32] Deklaro: "T'i bindeni Zotit dhe të dërguarit." Nëse refuzojnë, Zoti nuk i do mosbesimtarët.

Lindja e Marisë

[33] Zoti ka zgjedhur Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit, dhe familjen e Amramit (si të dërguarë) për njerëzit.

[34] Ata janë pasardhës njëri pas tjetrit. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.

[35] Gruaja e Amramit tha, "Zotëruesi im, unë ta kam dedikuar (beben) në bark vetëm Ty, kështu që pranoje prej meje. Ti je Dëgjues, i Gjithëdijshëm."

[36] Kur ajo e lindi, tha, "Zotëruesi im, unë kam lindur vajzë" – Zoti ishte tërësisht i vetëdijshëm për atë që ajo lindi. – "Mashkulli nuk është i njëjtë si femra. Ia dhashë emrin Mari, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde për të dhe pasardhësit e saj nga djalli i mallkuar."

[37] Zotëruesi i saj ia pranoi një pranim të hirshëm, dhe ia rriti me edukatë të mirë, nën kujdestarinë e Zekerias. Kurdo që Zekeria hynte në faltoren e saj ai gjente furnizime me të. E pyeste, "Mari, prej ku e ke marrë këtë?" Ajo thoshte, "Është prej Zotit. Zoti furnizon për këdo që Ai zgjedhë, pa kufi."

Lindja e Gjonit

[38] Atëherë Zekeria iu përgjërua Zotëruesit të tij: "Zotëruesi im, më dhuro mua një fëmijë të mirë të tillë; Ti je Dëgjuesi i lutjeve."

[39] Engjëjt e thirrën kur ishte duke u lutur në faltore: "Zoti të jep lajme të mira për Gjonin; besimtar në fjalën e Zotit, i ndershëm, i moralshëm, dhe profet i drejtë."

[40] Ai tha, "Si mund të kem djalë, kur unë jam aq i vjetër, dhe gruaja ime është sterile?" Ai tha, "Zoti bën çfarëdo që Ai do."

[41] Ai tha, "Zotëruesi im, më jep një shenjë." Ai tha, "Shenja jote është që nuk do të flasësh me njerëzit për tre ditë, përveç me shenja. Përkujto shpesh Zotëruesin tënd; dhe medito natë e ditë."

Maria dhe Jezusi

[42] Engjëjt thanë, "O Mari, Zoti të ka zgjedhur dhe të ka pastruar. Ai të ka zgjedhur ty nga të gjitha femrat.

[43] "O Mari, t'i nënshtrohesh Zotëruesit tënd, të përulesh dhe të përkulesh me ata që përkulen."

[44] Këto janë lajme nga e kaluara që t'i shpallim ty. Ti nuk ishe aty kur ata hoqën short për ta zgjedhur kujdestarin e Marisë. Ti nuk ishe i pranishëm kur ata u grindën me njëri tjetrin.

[45] Engjëjt thanë, "O Mari, Zoti të jep myzhde: Fjalë prej Tij emri i të cilit është 'Mesia, Jezu bir i Marisë. Ai do të jetë i famshëm në këtë jetë dhe Përjetësi, dhe një prej më të afërmve të Mi.'

[46] "Ai do tu flasë njerëzve që nga djepi, si dhe si i rritur; ai do të jetë njëri prej të drejtëve."

[47] Ajo tha, "Zotëruesi im, si mund të kem djalë, kur asnjë burrë nuk më ka prekur?" Ai tha, "Zoti

kështu krijon çfarëdo që Ai do. Për të bërë diçka, Ai thjeshtë i thotë, 'Ji,' dhe është.

[48] "Ai do i mësojë atij shkrimin, mençuri, Torah, dhe Ungjillin."

[49] Si i dërguar tek Fëmijët e Izraelit: "Unë vi te ju me një shenjë prej Zotëruesit tuaj – unë bëj për ju një formë zogu nga balta, pastaj fryj në të, dhe bëhet zog i gjallë me lejen e Zotit. Ua kthej të pamit të verbërve, shëroj të lebrosurit, dhe ngjall të vdekurit me lejen e Zotit. Unë mund t'ju tregoj çka hani, dhe çka depononi në shtëpitë tuaja. Kjo duhet të jetë provë për ju, nëse jeni besimtarë.

[50] "Unë konfirmoj shkrimin e mëparshëm – Torah – dhe anuloi ndalesa të caktuara të vëna mbi ju. Unë vi tek ju me provë të mjaftueshme nga Zotëruesi juaj. Prandaj, t'ia keni dronë Zotit, dhe të më bindeni.

[51] "Zoti është Zotëruesi im dhe Zotëruesi juaj;* ta adhuroni vetëm Atë. Kjo është rruga e drejtë."

[52] Kur Jezusi nuhati mosbesimin e tyre, tha, "Kush janë përkrahësit e mi për te Zoti?" Dishepujt thanë, "Ne jemi përkrahësit e Zotit; ne besojmë në Zotin, dhe ji dëshmitar se jemi të nënshtruar."

[53] "Zotëruesi ynë, ne kemi besuar në çka na zbritte, dhe e kemi ndjekur të dërguarin; llogaritna mes dëshmitarëve."

*Vdekja e Jezusit**

[54] Ata thurën kurthe dhe planifikuan, por edhe Zoti, e Zoti është planifikuesi më i mirë.

[55] E Zoti tha, "O Jezu, Unë po ta ndërpres jetën në tokë, po të ngris te Unë, dhe po të heqë qafe prej mosbesimtarëve. Unë do i lartësoj ata që të ndjekin mbi ata që nuk besojnë, deri në Ditën e Ringjalljes. Pastaj te Unë është fati përfundimtar i të gjithë juve, pastaj do të gjykoj mes jush në lidhje me grindjet tuaja.

[56] "Sa për ata që nuk besojnë, do i parashtroj në ndëshkim që dhemb në këtë botë, edhe në Përjetësi. Ata nuk do të kenë ndihmues."

[57] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, Ai do i shpërblejë tërësisht. Zoti nuk i do të padrejtë.

[58] Këto janë shpalljet që po t'i recitojmë, që japin lajm plot mençuri.

*Konfirmim matematikor**

[59] Shembulli i Jezusit, për Zotin, është i njëjtë si i Ademit; Ai e krijoi atë nga dheu, pastaj i tha, "Ji," dhe ai ishte.

[60] Kjo është e vërteta nga Zotëruesi yt; mos ushqe asnjë dyshim.

Sfidë mosbesimtarëve

[61] Nëse ndokush grindet me ty, përkundër dijes që ke pranuar, atëherë thuaj, "Le t'i mbledhim fëmijët tonë dhe fëmijët tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju, dhe le ta kërkojmë mallkimin e Zotit mbi gënjeshtarët."

[62] Absolutisht, ky është tregimi i të vërtetës. Absolutisht, nuk ka zot përveç Zotit. Absolutisht, Zoti është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[63] Nëse ata refuzojnë, atëherë Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për keqbërësit.

* 3:51 Kjo është saktësisht çka Jezusi citohet të ketë thënë përgjatë Besëlidhjes së Re. Shih për shembull Ungjillin e Gjonit 20:17, dhe librin "Jezusi: Mitet dhe Mesazhi" nga Lisa Spray, Kapitulli 4 (Universal Unity, Fremont, Kaliforni, 1992).

* 3:54-55 Mësojmë se shpirti i Jezusit, personi i vërtetë, u ngrit lart, domethënë, jeta e Jezusit në tokë përfundoi, përpara arrestimit, torturës, dhe kryqëzimit të trupit të tij të gjallë fiziologjikisht, e të zbrazët, pa shpirt (Shih detajet në Shtojcën 22).

* 3:59 "Barazia" e krijimit të Jezusit dhe Ademit është e konfirmuar matematikisht; Jezusi dhe Ademi janë të përmendur në Kuran në numër të njëjtë, 25 herë secili.

Ftesë të gjithë besimtarëve

[64] Thuaj, "O ndjekës të shkrimit, ejani të vijmë në pajtim logjik mes nesh dhe jush; që të mos adhurojmë përveç Zotit; që të mos kemi asnjë objekt adhurimi pos Tij, e as të mos ngremë asnjë prej qenieve njerëzore si zotëruesë përkrah Zotit." Nëse nuk pranojnë, thuaj, "Jini dëshmitarë se jemi të nënshtruar."

[65] O ndjekës të shkrimit, pse shtyheni me fjalë rreth Ibrahimit, kur Torah dhe Ungjilli nuk u shfaqën deri pas tij? A nuk kuptoni?

[66] Jeni shtyrë rreth gjërave që i dinit; pse shtyheni rreth gjërave që nuk i dini? Zoti di, përderisa ju nuk dini.

[67] Ibrahimit nuk ishte as Jahudi, as i Krishterë; ai ishte i nënshtruar monoteist. Nuk ishte idhujtar.

[68] Njerëzit më të merituar për Ibrahimin janë ata që ndoqën atë, dhe ky profet, dhe ata që besojnë. Zoti është Zotëruesi dhe Sunduesi i besimtarëve.

[69] Disa ndjekës të shkrimit dëshirojnë të ju largojnë nga rruga e drejtë, por e largojnë veç veten, pa e kuptuar.

[70] O ndjekës të shkrimit, pse i refuzoni këto shpallje të Zotit kur jeni dëshmitarë (që kjo është e vërteta)?

[71] O ndjekës të shkrimit, pse e ngatëroni të vërtetën me të pavërtetën, dhe e fshihni të vërtetën, me vetëdije?

[72] Disa ndjekës të shkrimit thonë, "Besoni në çka u është zbritur besimtarëve në mëngjes, dhe refuzoni në mbrëmje; ndoshta një ditë do të kthehen prapa.

[73] "Dhe mos besoni ndryshe përveç si ata që ndjekin fenë tuaj." Thuaj, "Udhëzimi i vërtetë është udhëzimi i Zotit." Nëse pretendojnë se edhe ata e kanë udhëzimin e njëjtë, ose polemizojnë me ju rreth Zotëruesit tuaj, thuaj, "E tërë e mira është në dorë të Zotit; Ai ia dhuron atë kujtdo që Ai do." Zoti është Bujar, i Gjithëdijshëm.

[74] Ai veçon mëshirën e Tij për këdo që Ai do; Zoti posedon pakufi mirësi.

Ji i sinqertë me të gjithë njerëzit

[75] Ca ndjekësve të shkrimit mund tu besohet sasi e madhe, dhe do e kthejnë. Të tjerëve mes tyre nuk mund tu besohet as një dinar; nuk do t'jua kthejnë pa ju vënë pas. Kjo është për shkak se ata thonë, "Nuk duhet të jemi të sinqertë kur kemi të bëjmë me ata të pa shkrim!"* Kështu, ata i mveshin gënjeshtër Zotit, me vetëdije.

[76] Vërtetë, ata që i përmbushin obligimet dhe çojnë jetë të drejtë, Zoti i do të drejtit.

[77] Sa për ata që shkëmbejnë besëlidhjen e Zotit, dhe obligimet e tyre, për një çmim të vogël, ata nuk marrin hise në Përjetësi. Zoti nuk do tu flasë, e as t'i shikojë, në Ditën e Ringjalljes, e as nuk do i pastrojë. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[78] Mes tyre janë ata që e përdredhin gjuhën për ta imituar shkrimin, që të mendoni se është prej shkrimit, kur nuk është prej shkrimit, dhe pohojnë se është prej Zotit, kur nuk është prej Zotit. Kështu, ata shprehin gënjeshtër dhe ia veshin Zotit, me vetëdije.

[79] Asnjë qenie njerëzore që e bekoi Zoti me shkrim dhe profetësi nuk do tu thoshte njerëzve, "Adhuro mëni mua përkrah Zotit." Por, (do tu thoshte), "Kushtojani veten absolutisht vetëm

* 3:75 Para zbulimit të kodit matematikor të Kuranit, disa studiues gabimisht pohan se Muhamedi ishte njeri analfabet që nuk do të mund të shkruante një libër aq të madh. Ata e shtrembëruan domethënien e fjalës "Ummi," duke pretenduar se ajo do të thotë "analfabet." Kjo strofë vërteton se "Ummijin" do të thotë "i pa shkrim" (Shih gjithashtu 62:2 & Shtojcën 28).

Zotëruesit tuaj." sipas shkrimit që predikoni dhe mësimëve që mësoni.

[80] E as nuk do t'ju urdhëronte t'i adhuronit engjëjt dhe profetët si zotëruesë. A do t'ju shtynte ai të mos besoni pasi u bëtë të nënshtruar?

*Përbushet profeci madhore * I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes*

[81] Zoti lidhi besën me profetët, duke thënë, "Unë do t'ju jap shkrimin dhe mençuri. Pastaj, një i dërguar do të vijë t'i konfirmojë të gjitha shkrimet ekzistuese. Të besoni në atë dhe ta përkrahni." Tha, "A pajtoheni me këtë, dhe betoheni ta përbushni këtë besëlidhje?" Ata thanë, "Pajtohemi." Tha, "Keni qenë pra dëshmitarë, dhe jam dëshmitar bashkë me ju."

Refuzuesit e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes janë mosbesimtarë

[82] Ata që e refuzojnë këtë (profeci Kuranore) janë të këqijtë.

[83] A po kërkojnë ata tjetër pos fesë së Zotit, kur çdo gjë në qiej dhe tokë i është nënshtruar Atij, me dëshirë dhe pa dëshirë, dhe te Ai do të kthehen?

Mos bëni asnjë dallim mes të dërguarve të Zotit

[84] Thuaj, "Ne besojmë në Zotin, dhe në çka na u zbrit, dhe në çka iu zbrit Ibrahimit, Ismailit, Isakut, Jakobit, dhe Patriarkëve, dhe në çka iu dha Moisiut, Jezusit, dhe profetëve nga Zotëruesi i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim mes asnjërit prej tyre. Vetëm te Ai jemi të nënshtruar."

Vetëm një fe e aprovuar nga Zoti

[85] Kushdo që pranon tjetër pos Nënshtrimit si fe të tij, nuk do i pranohet, dhe në Përjetësi, do të jetë me dështakët.

[86] Pse duhet Zoti t'i udhëzojë njerëzit që nuk besuan pas besimit, dhe pas të qenit dëshmitarë se i dërguari është i vërtetë, dhe pasi u janë dhënë prova* të qëndrueshme? Zoti nuk i udhëzon shpirtligjtë.

[87] Këta kanë vetëshkaktuar mallkim nga Zoti, dhe engjëjt, dhe të gjithë njerëzit.

[88] Përgjithmonë qëndrojnë aty; nuk u zbutet ndëshkimi kurrë, e as nuk do tu shtyhet afati.

[89] Me përjashtim të atyre që pendohen pas asaj, dhe reformohen. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

Kur pendimi është i papranueshëm

[90] Ata që nuk besojnë pas besimit, pastaj zhyten edhe më thellë në mosbesim, atyre pendimi nuk do tu pranohet; ata janë të humburit e vërtetë.

[91] Ata që nuk besojnë dhe vdesin si mosbesimtarë, një tokë plot me ar nuk do të pranohet nga asnjëri prej tyre, edhe sikur një haraç i tillë të ishte i mundur. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb; nuk do të kenë asnjë ndihmues.

[92] Nuk mund të arrini drejtësinë pa dhënë bamirësi nga gjërat që i doni. Çfarëdo që jep bamirësi, Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të.

* 3:81 Kjo profeci madhore tani është e përbushur. I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes, siç profetizohet, në këtë strofë dhe Malakian e Biblës 3:1-21, Lukën 17:22-36 & Mateun 24:27, pastroi dhe bashkoi lajmet e Zotit që ishin dorëzuar nga profetët e Zotit. Judaizmi, Krishterimi, Islami, Hinduizmi, Budizmi, etj. janë korruptuar tepër. Është dëshira e Zotit të Plotfuqishëm që t'i pastroj dhe t'i unifikoj nën emblemën e adhurimit të vetëm Atij. Prova të pakalueshme janë furnizuar nga Zoti në përkrahje të të Dërguarit të Tij të Besëlidhjes, emri i të cilit është pa diskutim i specifikuar në kodin matematikor të Kuranit si "Rashad Khalifa." Për shembull, duke mbledhur vlerën germore të "Rashad" (505), dhe vlerën e "Khalifa" (725), dhe numrin e strofës (81) fitojmë 1311, apo 19x69 (shih Shtojcën 2 për provat e hollësishtme).

* 3:86 Strofat 3:82-90 na informojnë se ata që refuzojnë të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes nuk janë të nënshtruar (Mysliman) më, meqenëse ata nuk i besojnë më Kuranit. Provat e përmendura në 3:86 i referohen kodit matematikor të Kuranit, i cili u shpall nëpërmjet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes. Edhe 3:86 edhe 3:90 flasin për "mosbesimin pas besimit."

Mos ndaloni çka është e lejueshme

[93] I gjithë ushqimi ishte dikur i lejueshëm për Fëmijët e Izraelit, deri sa Izraeli i vuri ndalesa të caktuara vetvetes para se të zbriste Torah. Thuaj, "Silleni Torahn dhe lexonie, nëse jeni të singertë."

[94] Ata që trillojnë ndalesa të rreme pas kësaj, dhe ia mveshin Zotit, janë vërtetë shpirtligë.

[95] Thuaj, "Zoti e ka deklaruar të vërtetën: Ta ndiqni fenë e Ibrahimit – monoteizmin. Ai nuk ishte idhujtar."

[96] Faltorja më e rëndësishme e ngritur për njerëzit është ajo në Bekë,* fener i bekuar për të gjithë njerëzit.

[97] Në të ka shenja të qarta: stacioni i Ibrahimit. Kushdo që hyn në të duhet t'i jepet leje kalimi të sigurt. Njerëzit ia kanë borxh Zotit që të zbatojnë Haxhin te kjo faltore, kur të kenë mundësi. Sa për ata që nuk besojnë, Zotit nuk i nevojitet askush.

[98] Thuaj, "O ndjekës të shkrimit, pse i refuzoni këto shpallje të Zotit, kur Zoti është dëshmitar i çdo gjëje që bëni?"

[99] Thuaj, "O ndjekës të shkrimit, pse i pengoni nga rruga e Zotit ata që dëshirojnë të besojnë, dhe kërkoni ta shtrembëroni, edhe pse jeni dëshmitarë?" Zoti nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëni.

[100] O ju që besoni, nëse iu bindeni disave që iu dha shkrimi, ata do t'ju kthejnë mbrapa, pas besimit, në mosbesimtarë.

[101] Si mund të mos besoni, kur këto shpallje të Zotit ju janë recituar, dhe i dërguari i Tij ju ka ardhur? Kushdo që lidhet te Zoti do të udhëzohet në rrugën e drejtë.

[102] O ju që besoni, t'ia keni dronë Zotit si duhet t'i kihet, dhe mos vdisni ndryshe përveç si të Nënshtruar.

Besimtarët janë të bashkuar

[103] Të lidheni në litarin e Zotit, të gjithë ju, dhe mos u përçani. Kujtoni bekimet e Zotit mbi ju – ju ishit të armiqësuar dhe Ai jua pajtoi zemrat. Me mirësinë e Tij, u bëtë vëllezër. Ju ishit në buzë të greminës së zjarrtë, dhe Ai ju shpëtoi prej saj. Zoti kështu jua shpjegon shpalljet e Tij, që të mund të udhëzoheni.

[104] Le të jetë një shoqëri nga ju që ftoni në çka është e dobishme, përkrahni drejtësinë, dhe ndaloni të këqijat. Këta janë fituesit.

[105] Mos u bëni si ata që u bënë të përçarë dhe grindavecë, pavarësisht provave të qarta që iu dhanë atyre. Se ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të tmerrshëm.

[106] Do të vij dita kur disa fytyra do të zdriten (me gëzim), derisa të tjera fytyra do të ngrysen (me trishtim). Sa për ata që fytyrat iu ngrysen, do të pyeten, "A nuk u bëtë mosbesimtarë pas besimit? Prandaj, vuanie ndëshkimin për mosbesimin tuaj."

[107] Sa për ata që fytyrat iu zdriten, ata do të kënaqen në mëshirën e Zotit; ata qëndrojnë aty përgjithmonë.

[108] Këto janë shpalljet e Zotit; po t'i recitojmë, sinqerisht. Zoti nuk dëshiron vështirësi për njerëzit.

[109] E Zotit është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë, dhe të gjitha çështjet drejtohen nga Zoti.

* 3:96 Kjo është Sure me inicial M, dhe ky shqiptim i pazakontë i "Mekës" si "Bekë" shkaktonte shpesh tështësinë e ndodhjes së "M"-së të përputhet me kodin matematikor të Kuranit. Shqiptimi normal "Mekë" do të kishte rritur tështësinë e ndodhjes së "M"-së (Shtojca 1).

Shoqëria më e mirë

[110] Ju jeni shoqëria më e mirë që ndonjëherë është ngritur mes njerëzish: ju përkrahni të drejtën dhe ndaloni të këqijat, dhe besoni në Zotin. Sikur ndjekësit e shkrimit të besonin, do të ishte më mirë për ta. Disa prej tyre besojnë, por shumica e tyre janë shpirtligë.

[111] Ata nuk mund t'ju dëmtojnë, përtej fyerjes. Nëse ju luftojnë, ata do të kthehen dhe të ikin. Ata nuk mund të fitojnë.

[112] Ata duhet poshtëruar kudo që i ndeshni, në mos e mbajtshin të lidhur besën e Zotit, si dhe besëlidhjet e tyre për paqe me ju. Ata kanë vetëshkaktuar zemërim prej Zotit, dhe, si pasojë, ata i parashtrohen turpërimit. Kjo është për shkak se ata refuzuan shpalljet e Zotit, dhe vranë profetët padrejtësisht. Kjo është për shkak të mosbindjes dhe shkeljes së tyre.

Jahudi & të krishterë të drejtë

[113] Ata nuk janë të gjithë të njëjtë; mes ndjekësve të shkrimit, ka që janë të drejtë. Ata i recitojnë shpalljet e Zotit gjatë natës, dhe përuken.

[114] Ata besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit, përkrahin të drejtën dhe ndalojnë të keqen, dhe nxitojnë të bëjnë punë të drejta. Këta janë të drejtë.

[115] Çfarëdo të mire që bëjnë nuk do të mbetet pa shpërblyer. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të drejtë.

[116] Ata që nuk besuan nuk mund të ndihmohen nga paratë e tyre ose fëmijët e tyre kundër Zotit. Kanë vetëshkaktuar Ferr, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[117] Shembulli i arritjeve të tyre në këtë jetë është si një erë e fortë që godet të mbjellat e njerëzve që i kanë bërë keq vetes, dhe i fshinë. Zoti nuk u bëri keq; janë ata që i bënë keq vetvetes.

Mos zini shokë hipokritë

[118] O ju që besoni, mos i zini shokë të jashtëmit që nuk pushojnë duke jua dashur të keqen. Madje dëshirojnë t'ju shohin duke vuajtur. Urrejtje rrjedh nga gojë e tyre dhe çka fshehin në gjokset e tyre është edhe më e keqe. Ne kështu sqarojmë shpalljet për ju, nëse kuptoni.

[119] Ja, ju po i doni, përderisa ata nuk ju duan, dhe ju besoni në të gjithë shkrimin. Kur ju takojnë juve ata thonë, "Ne besojmë," por sapo të largohen, i kafshojnë gishtat nga mllëfi ndaj jush. Thuaj, "Vdisni në mllëfin tuaj." Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[120] Kur diçka e mirë ju vjen juve ata dëshpërohen, dhe kur diçka e keqe ju ndodh juve ata gëzohen. Nëse duroni me këmbëngulësi, dhe vazhdoni të drejtën, kurthet e tyre nuk do t'ju dëmtojnë. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëjnë.

Beteja e Bedrit

[121] Kujtohu që ti (Muhamed) ishe mes njerëzve tuaj kur dole t'ua caktosh besimtarëve pozitat e tyre për betejë. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.

[122] Dy grupe mes jush gati dështuan, por Zoti ishte Zotëruesi i tyre. Në Zotin besimtarët duhet të kenë besim.

[123] Zoti ju dhuroi fitore në Bedr, pavarësisht nga dobësia juaj. Prandaj, t'ia keni dronë Zotit, si mirënjohje.

Engjëjt e Zotit ndihmojnë besimtarët

[124] Ti ju the besimtarëve, "A nuk mjafton që Zotëruesi juaj ju përkrahë me tre mijë engjëj, të zbritur?"

[125] Me të vërtetë, nëse duroni me këmbëngulësi dhe vazhdoni të jeni të drejtë, pastaj ata ju

sulmojnë papritmas, Zotëruesi juaj do t'ju përkrahë me pesë mijë* engjëj, të ushtruar mirë.

[126] Zoti kështu ju njofton, për t'ju dhënë lajme të mira, dhe t'ju bindë zemrën. Fitorja vjen veç prej Zotit, të Plotfuqishmit, Më të Mençurit.

[127] Ai kështu qëron disa mosbesimtarë, ose i neutralizon; ata gjithmonë përfundojnë humbës.

[128] Nuk varet prej teje; Ai mund t'i shpengojë, ose Ai mund t'i ndëshkojë për shkeljet e tyre.

[129] E Zotit është çdo gjë në qiej dhe tokë. Ai fal këdo që Ai do, dhe ndëshkon këdo që Ai do. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

*Fajdeja ndalohe**

[130] O ju që besoni, të mos jepni me fajde, të shtuar mbi e për mbi. Kini dronë Zotit, që të mund t'ia dilni.

[131] Ruajuni zjarrit që pret mosbesimtarët.

[132] T'i bindeni Zotit dhe të dërguarit, që të arrini mëshirë.

Vetitë e të drejtëve

[133] Duhet të garoni me nxitim drejt faljes nga Zotëruesi juaj dhe një Parajse gjerësia e të cilës rrethon qiejt dhe tokën; i pret të drejtit,

[134] që japin bamirësi në kohë të mira, si dhe në kohë të vështira. Ata janë që e frenojnë mllëfin, dhe i falin njerëzit. Zoti i do bamirësit.

[135] Nëse bëjnë mëkat ose i bëjnë keq vetes, ata përkujtojnë Zotin dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre – e kush i falë mëkatet përveç Zotit – dhe ata nuk vazhdojnë në mëkate, me vetëdije.

[136] Shpërblimi i tyre është falje prej Zotëruesit të tyre, dhe kopshte me proje që rrjedhin; ata qëndrojnë aty përgjithmonë. Sa shpërblim i bekuar për punëtorët!

Fitore për të drejtit

[137] Janë vënë precedentë për ju në të kaluarën; Enduni nëpër tokë dhe vëreni pasojat për pabesimtarët.

[138] Kjo është deklaratë për njerëzit, dhe udhëzim dhe ndriçim për të drejtit.

[139] Të mos luhateni, e as të brengoseni, se jeni fituesit përfundimtar, nëse jeni besimtarë.

[140] Nëse përjetoni vështirësi, armiku gjithashtu vuan vështirësi të njëjtë. Ne i ndërrojmë ditët e fitores dhe disfatës mes njerëzve. Zoti kështu i shquan besimtarët e vërtetë, dhe bekon disa prej jush dëshmorë. Zotit nuk i pëlqen padrejtësia.

[141] Zoti kështu kalit ata që besojnë dhe poshtëron mosbesimtarët.

Pohimet tona duhet të testohen

[142] A prisni të hyni në Parajsë pa i klasifikuar Zoti ata mes jush që përpiqen, dhe pa i klasifikuar ata që janë të durueshëm?

[143] Ju dikur e dëshironit vdekjen para se të ballafaqoheshit me të. Tani i jeni përballë, mu para syve tuaj.

[144] Muhamedi nuk ishte asgjë më shumë se i dërguar si të dërguarit para tij. Po të vdesë ose të vritet, a do të ktheheshit prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk e dëmton Zotin aspak. Zoti shpërblen ata që janë mirënjohës.

Koha e vdekjes e paracaktuar

* 3:124-125 Tridhjetë numra të ndryshëm përmenden në Kuran. Shuma e tyre është 162146, 19x8534. Kjo përputhet me mrekullinë matematikore të Kuranit (Shih Shtojcën Një).

* 3:130 Interesi në depozitimet bankare dhe interesi në kredi janë të ligjshëm nëse nuk janë të tepruar (5-15%). Bankat investojnë dhe fitimet e tyre u kalohen depozituesve. Pasi që të gjitha palët ndahen të kënaqur dhe askush nuk viktimizohet, është krejtësisht e ligjshme të merret interes nga banka (shih 2:275).

[145] Askush nuk vdes përveç me lejen e Zotit, në një kohë të paracaktuar. Kushdo që kërkon kotësitë e kësaj bote, ne ia japim, dhe kushdo që kërkon shpërblimet e Përjetësisë, ne e bekojmë me to. Ne shpërblejmë ata që janë mirënjohës.

[146] Sa profetë patën njerëz të devotshëm bashkë me ta të luftonin, pa u tundur kurrë nën presion në rrugën e Zotit, e as nuk ngurruan ose të dekurajohen. Zoti i do durimtarët.

[147] Shprehja e vetme e tyre ishte, "Zotëruesi ynë, falna mëkatet, dhe shkeljet tona, përforcona këmbët, dhe dhurona fitore mbi mosbesimtarët."

[148] Rrjedhimisht, Zoti ua dhuroi shpërblimet e kësaj bote, dhe shpërblimet më të mira të Përjetësisë. Zoti i do punëmirët.

[149] O ju që besoni, nëse ju bindeni atyre që nuk besojnë, do të ju kthejnë prapa, pastaj përfundoni të dështuar.

[150] Vetëm Zoti është Zotëruesi dhe Sundues i juaji, dhe Ai është përkrahësi më i mirë.

Zoti dirigjon armiqtë tuaj

[151] Ne do të hedhim tmerr në zemrat e atyre që nuk besuan, pasi që ata ngrenë pos Zotit idhuj të pafuqi. Fati i tyre është në Ferr; Sa vendbanim i tmerrshëm për shkelësit!

Beteja e Uhudit

[152] Zoti e ka përmbushur premtimin e Tij ndaj jush, dhe ju i mundët ata me lejen e Tij. Por pastaj u luhatët, u përçatë mes vete, dhe nuk iu bindët pasi Ai jua kishte shfaqur (fitoren) që e dëshironit. Por pastaj, disave prej jush ju tërhoq vëmendja nga plaçkat e kësaj bote, përderisa të tjerëve me të drejtë ju intereso i Përjetësia. Ai pastaj ju largoi nga ata që të ju testojë. Ai ju ka falur. Zoti derdh në besimtarët hirësinë e Tij.

[153] Kujtohuni që u turrët (pas plaçkave), duke mos ia vënë veshin askujt, madje edhe kur i dërguari ju thërriste nga përmbas. Si pasojë, Ai zëvendësoi një mjerim me tjetrin, që të mos brengoseni për çfarëdo që ju shpëtoi, ose të jeni në agoni për vështirësitë që i kishit përjetuar. Zoti është Njohës i çdo gjëje që bëni.

Momenti i vdekjes i paracaktuar

[154] Pas tërheqjes, Ai lëshoi mbi ju kotje të qetë që qetësoi disa prej jush. Të tjerët mes jush merakoseshin veç për veten. Ata ushqyen mendime për Zotin që nuk ishin të drejta – të njëjtat mendime që i kishin ushqyer gjatë ditëve të injorancës. Kështu, ata thanë, "A varet diçka prej nesh?" Thuaj, "Çdo gjë varet prej Zotit." Fshehën në vetvete atë që nuk ta shfaqën. Thanë, "Sikur të varej prej nesh, asnjë prej nesh nuk do të vritej në këtë betejë." Thuaj, "Sikur të rrrinit në shtëpitë tuaja, ata që kishin fatin të vriten do të zvarriteshin në shtratin e tyre për vdekje." Zoti kështu ju futë në test që t'i nxjerrë jashtë bindjet tuaja të vërteta, dhe të testojë çka keni në zemrat tuaja. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[155] Padyshim, ata mes jush që u zbrapsën ditën që dy ushtritë u ndeshën qenë mashtruar prej djallit. Kjo pasqyron disa nga punët (e këqija) që kishin bërë. Zoti i ka falur. Zoti është Falës, i Butë.

[156] O ju që besoni, mos u bëni si ata që nuk besuan dhe thanë për të afërmit e tyre që shkuan ose u mobilizuan për luftë, "Sikur të kishin qëndruar me ne, ata nuk do të kishin vdekur ose të ishin vrarë." Zoti e shndërron këtë në burim pikëllimi në zemrat e tyre. Zoti drejton jetë dhe vdekje. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

[157] U vratë ose vdiqët për Zotin, falja prej Zotit, dhe mëshira janë shumë më të mira se çfarëdo që ata grumbullojnë.

[158] Vdiqët ose u vratë, do të mblidheni para Zotit.

Dashamirësia e të dërguarit

[159] Ishte mëshirë prej Zotit që ti u bëre i dhembshëm ndaj tyre. Po të ishe i ashpër dhe zemërngushtë, do të kishin braktisur. Prandaj, t'i falësh dhe të kërkosh ndjesë për ta, dhe konsultohu me ta. Kur të vendosësh, zbatoje planin dhe kij besim te Zoti. Zoti i do ata që kanë besim në Atë.*

[160] Nëse ju përkrahë Zoti, askush nuk mund t'ju mund. E nëse ju braktis, kush tjetër mund t'ju përkrahë? Në Zotin besimtarët duhet të kenë besim.

Askush mbi ligjin

[161] As profeti nuk mund të marrë më shumë nga plaçkat e luftës sesa që i takon. Kushdo që merr më shumë sesa hisja që i takon me të drejtë do të japë llogari për të në Ditën e Ringjalljes. Atëherë çdo shpirt paguhet për çfarëdo që ka fituar, pa as më të voglën padrejtësi.

[162] A është ai që është në kërkim të kënaqësisë së Zotit i njëjtë si ai që vetëshkakton zemërim nga Zoti dhe fat e ka Ferrin, vendbanimin më të tmerrshëm?

[163] Ata padyshim zënë rangje të ndryshme te Zoti. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëjnë.

[164] Zoti i ka bekuar besimtarët duke çuar ndër ta një të dërguar nga mesi i tyre, që të recitojë për ta shpalljet e Tij, dhe t'i pastrojë, dhe tu mësojë shkrimin dhe mençuri. Para kësaj, ata kishin humbur krejtësisht.

[165] Tani që keni vuajtur zbrapsje, dhe edhe pse ju iu sollët dy herë më shumë vuajtje (armiëve), ju thatë, "Pse na ndodhi kjo?" Thuaj, "Kjo është pasojë e vet veprave tuaja." Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[166] Ajo që ju goditi juve ditën që dy ushtritë u ndeshën ishte në pajtim me vullnetin e Zotit, dhe që të dallohen besimtarët.

[167] Dhe të ekspozohen hipokritët që u ishte thënë, "Ejani luftoni për Zotin, ose kontribuoni." Ata thanë, "Sikur të kishim ditur si të luftojmë, do të ju kishim bashkangjitur." Ata ishin më afër mosbesimit se besimit. Ata shprehën me gojët e tyre çka nuk ishte në zemrat e tyre. Zoti e di çka ata fshehin.

[168] Ata thanë për të afërmit e tyre, përderisa ndejën pas, "Po të na u kishin bindur, nuk do të ishin vvarë." Thuaj, "Atëherë, parandaloni vdekjen tuaj, nëse jeni të sinqertë."

*Të drejtit nuk vdesin vërtetë**

[169] Mos mendoni se ata që janë vvarë për Zotin janë të vdekur; ata janë të gjallë te Zotëruesi i tyre, duke u kënaqur me furnizimet e Tij.

[170] Ata kënaqen në mirësinë e Zotit, dhe kanë lajme të mira për bashkëluftëtarët që nuk vdiqën me ta, se ata nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen.

[171] Ata kanë lajme të mira për bekimet dhe hirësinë e Zotit, dhe se Zoti nuk ngec së shpërblyeri besimtarët.

[172] Për ata që i përgjigjen Zotit dhe të dërguarit, pavarësisht nga keqtrajtimet që i vuajnë, dhe vazhdojnë punët e tyre të mira, dhe çojnë jetë të drejtë, shpërblim i madh.

[173] Kur njerëzit ju thonë, "Njerëzit janë mobilizuar kundër jush; duhet t'ua keni frikën," kjo vetëm sa ua shton besimin, dhe thonë, "Zoti na mjafton; Ai është Mbrojtësi më i mirë."

* 3:159 Monedha e SH.B.A-së është monedha e vetme që bartë frazën: "Në Zotin kemi besim." Është fakt që dollari Amerikan ka qenë monedha më e fortë në botë, dhe standardi me anë të cilit të gjithë monedhat maten.

* 3:169 Ne mësojmë prej Kuranit se të drejtit nuk vdesin vërtetë; ata thjeshtë i lënë trupat e kësaj bote dhe shkojnë drejtë e në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva dikur jetuan (2:154, 8:24, 16:32, 22:58, 44:56, & 36:26-27; shih gjithashtu Shtojcën 17).

[174] Ata i kanë merituar bekimet dhe mirësinë e Zotit. Kurrë asnjë dëm nuk i prekë, se e kanë arritur miratimin e Zotit. Zoti posedon mirësi pa kufi.

Frika: Vegël e Djallit

[175] Është metodë e djallit të rrënjosë frikë në subjektet e tij. Mos iu frikësoni atyre e frikësomuni Mua, nëse jeni besimtarë.

[176] Mos u dëshpëro nga ata që nxitojnë të mos besojnë. Ata nuk e dëmtojnë Zotin aspak. Por, Zoti ka dashur që ata të mos kenë hise në Përjetësi. Ata kanë vetëshkaktuar një ndëshkim të tmerrshëm.

[177] Ata që zgjedhin mosbesim, në vend të besimit, nuk e dëmtojnë Zotin aspak; ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[178] Le të mos mendojnë mosbesimtarët se i çojmë në të mirë të tyre. Ne vetëm i çojmë në konfirmimin e mëkatit të tyre. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim poshtërues.

[179] Zoti nuk është për t'i lënë besimtarët ashtu siç jeni, pa e dalluar të keqin prej të mirit. As nuk ju informon Zoti për të ardhmen, por Zoti dhuron dituri të tillë mbi këdo që Ai zgjedhë nga mesi i të dërguarve të Tij.* Prandaj, të besoni në Zotin dhe të dërguarit e Tij. Nëse besoni dhe çoni jetë të drejtë, pranoni shpërblim të madh.

[180] Le të mos mendojnë ata dorështrënguarit që mbledhin furnizimet e Zotit se kjo është mirë për ta; është keq për ta. Se do i bartin ato që mbledhin në Ditën e Ringjalljes rreth qafës. Zoti është trashëguesi përfundimtar i qiejve dhe tokës. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

Njerëzit vazhdojnë t'i hedhin haptazi sfidë Zotit

[181] Zoti i ka dëgjuar shprehjet e atyre që thanë, "Zoti është i varfër, e ne jemi të pasur." Ne do të incizojmë çdo gjë që thanë, ashtu siç i incizua kur vrisnin profetët padrejtësisht, dhe do tu themi, "Vuanie ndëshkimin e Ferrit.

[182] "Kjo është pasoja e vet punëve tuaja." Zoti nuk është i padrejtë ndaj njerëzve.

[183] Janë ata që thanë, "Zoti ka lidhur besën me ne që të mos besojmë në asnjë të dërguar, në mos na sjellte një flijim që gëlltitet nga zjarri." Thuaj, "Të dërguarë para meje kanë ardhur me prova të qarta, duke përfshirë edhe atë që sapo kërkuat. Pse atëherë i vratë, nëse jeni të sinqertë?"

[184] Nëse të refuzojnë, të dërguarë para teje janë refuzuar, edhe pse sollën prova, Psalmet, dhe shkrimin ndriçues.

Triumf i vërtetë

[185] Çdo njeri e shijon vdekjen, pastaj e pranoni çmimin tuaj në Ditën e Ringjalljes. Kushdo që i shmanget Ferrit, për një fije floku, dhe ia del në Parajsë, ka arritur triumf të vërtetë. Jeta e kësaj bote nuk është asgjë më shumë se një iluzion.

*Testi i pashmangshëm**

[186] Ju patjetër do të testoheni, me paratë tuaja dhe jetët tuaja, dhe do të dëgjoni prej atyre që pranuan shkrimin, dhe prej idhujtarëve, shumë ofendime. Nëse duroni me këmbëngulësi dhe çoni jetë të drejtë, kjo do të vërtetojë shkallën e besimit tuaj.

[187] Zoti mori besën prej atyre që pranuan shkrimin: "T'ua tregoni njerëzve, dhe kurrë mos ta

* 3:179 Fundi i botës është një shembull i ngjarjeve të të ardhmes që iu zbulua të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes. Shih Shënimin 72:27.

* 3:186 Pasi kalojnë provimin pranues, adhuruesit e vërtetuar të VETËM Zotit gëzojnë jetë perfekte, tani dhe përgjithmonë. Shih 29:2-3, 10:62, dhe 24:55.

fshihni." Por ata e hodhën pas shpine, dhe e shkëmbyen me një çmim të vogël. Çfarë tregtie e tmerrshme.

[188] Ata që lavdërohen për punët e tyre, dhe dëshirojnë të jenë të lavdëruar për diçka që në të vërtetë nuk e kanë bërë, nuk duhet të mendojnë se mund t'i shmangen ndëshkimit. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[189] I Zotit është sundimi i qiejve dhe tokës. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Ata që kanë inteligjencë

[190] Në krijimin e qiejve dhe tokës, dhe ndërrimin e natës dhe ditës, ka shenja për ata që kanë inteligjencë.

[191] Ata përkujtojnë Zotin përderisa qëndrojnë në këmbë, ulur, dhe mbështetur anash, dhe mendojnë* për krijimin e qiejve dhe tokës: "Zotëruesi ynë, Ti nuk e krijove tërë këtë kot. Qofsh i madhëruar. Shpëtona prej ndëshkimit të Ferrit.

[192] "Zotëruesi ynë, këdo që Ti e fut në Ferr e ke braktisur. Shkelësit e tillë janë pa ndihmës.

[193] "Zotëruesi ynë, kemi dëgjuar një thirrës duke thirrur në besim duke deklaruar: 'Të besoni në Zotëruesin tuaj,' dhe kemi besuar. Zotëruesi ynë, falna shkeljet tona, largona mëkatet tona, dhe lërna të vdesim si besimtarë të drejtë.

[194] "Zotëruesi ynë, derdhna bekimet që na premtove nëpërmjet të dërguarve Tu, dhe mos na braktis në Ditën e Ringjalljes. Ti nuk e thyen premtimin."

Zoti përgjigjet

[195] Zotëruesi i tyre iu përgjigj: "Unë kurrë nuk ngec së shpërblyeri cilindo punëtor për cilëndo punë që bëni, qofshi mashkull apo femër - ju jeni të barabartë për njëri tjetrin. Pra, ata që shpërngulen, dhe dëbohen prej shtëpive të tyre, dhe keqtrajtohen për shkak Meje, dhe luftojnë dhe vriten, Unë padyshim do t'ua largoj mëkatet e tyre dhe t'i pranoj në kopshte me proje që rrjedhin." I tillë është shpërblimi prej Zotit. Zoti posedon shpërblimin përfundimtar.

[196] Mos u magjeps nga çka duket si sukses i mosbesimtarëve.

[197] Ata vetëm kënaqen përkohësisht, pastaj mbarojnë në Ferr; çfarë fati i tmerrshëm!

[198] Sa për ata që ia kushtojnë vëmendjen Zotëruesit të tyre, kanë merituar kopshte me proje që rrjedhin; ata banojnë aty përgjithmonë. I tillë është vendbanimi që u ipet nga Zoti. Çka Zoti ka është shumë më e mirë për të drejtë.

Jahuditë dhe të krishterët e drejtë

[199] Po; disa ndjekës të shkrimeve paraprake besojnë në Zotin, dhe në çka të është shpallur ty, dhe në çka u është shpallur atyre. Ata ia kanë frikën Zotit, dhe nuk i shkëmbejnë shpalljet e Zotit për një çmim të vogël. Këta do të marrin shpërblimin e tyre nga Zotëruesi i tyre. Zoti është më i shkathëti në llogaritje.

[200] O ju që besoni, të jeni durimtarë, të këmbëngulni, të jeni të bashkuar, t'ia keni dronë Zotit, që t'ia dilni.

Surja 4: Gratë (En-Nisa)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] O njerëz, kini dronë Zotëruesit tuaj; Atij që ju krijoi nga një qenie, dhe krijoi prej tij shoqen e tij, pastaj prej çiftit përhapit shumë burra dhe gra. Të keni kujdes ndaj Zotit, në të cilin bëni be, dhe të

* 3:191 Zoti yt është kushdo apo çfarëdo që nuk të hiqet prej mendjes shumicën e kohës. Besimtarët e vërtetë janë ata që përkujtojnë Zotin shumicën e kohës. Shih 23:84-89 dhe Shtojcën 27.

keni kujdes ndaj prindërve. Zoti është duke ju ruajtur.*

Kujdes ndaj jetimëve

[2] T'ua dorëzoni jetimëve pronat që iu takojnë. Mos e zëvendësoni të mirën me të keqën, dhe mos i konsumoni pronat e tyre duke i bashkuar me tuajat. Kjo do të ishte padrejtësi e tepërt.

*Bazat për poligami**

[3] Nëse jeni të mendimit se është më së miri për jetimët, mund të martoheni me nënat e tyre – mund të martoheni me dy, tri, ose katër. Nëse keni frikë se mos bëheni të padrejtë, atëherë duhet të jeni të kënaqur me vetëm një, ose me ato që tashmë i keni. Veç kësaj, kështu me siguri do të shmangeni vështirësive financiare.

[4] Tua jepni grave pajën* e tyre të duhur, me barazi. Nëse me dëshirë falin diç, atëherë mund ta pranoni; është me të drejtë e juaja.

[5] Mos ua jepni jetimëve të papjekur pronat që Zoti jua ka besuar juve si kujdestarë. T'i furnizoni prej tyre, t'i vishni, dhe t'i trajtoni mirë.

[6] T'i testoni jetimët kur të arrijnë pubertetin. Sapo të vëreni mjaft pjekuri te ta, ua jepni pronën e tyre. Mos e konsumoni në mënyrë të tepruar dhe me ngut, para se të rriten. Kujdestari i pasur të mos kërkojë pagë, por kujdestari i varfër mund të kërkojë me barazi. Kur t'ua jepni pronën, të keni dëshmitarë. Zoti mjafton si Llogaritës.

Të drejtat e grave në trashëgimi

[7] Burrat marrin hise prej asaj që prindërit dhe të afërmit lënë pas. Gratë gjithashtu të marrin hise prej asaj që prindërit dhe të afërmit lënë pas. Qoftë trashëgimi e vogël apo e madhe, (gratë duhet të marrin) hise të caktuar.

[8] Gjatë shpërndarjes së pasurisë, nëse të afërmit, jetimët, dhe nevojtarët janë të pranishëm, tu jepni prej saj, dhe t'i trajtoni mirë.

[9] Ata që merakosen për fëmijët e vet, në rast se i lënë pas, t'i kenë dronë Zotit dhe të flasin me barazi.

[10] Ata që konsumojnë pronat e jetimëve padrejtësisht, hanë zjarr në barqet e tyre, dhe do të vuajnë në Ferr.

*Nëse nuk lihet testament**

[11] Zoti shpallë testament për të mirën e fëmijëve tuaj; mashkulli merr dy herë hise sa femra. Nëse trashëgimtarët janë vetëm gra, më shumë se dy, ato marrin dy të tretat e asaj që trashëgohet. Nëse lihet vetëm një vajzë, ajo merr gjysmën. Prindërit e të vdekurit marrin një të gjashtën e trashëgimisë secili, nëse i vdekuri ka lënë ndonjë fëmijë. Nëse nuk ka lënë asnjë fëmijë, dhe prindërit e tij janë trashëgimtarët e vetëm, nëna merr një të tretën. Nëse ka vëllezër a motra, atëherë nëna merr një të gjashtën. E gjithë kjo, pas përmbushjes së ndonjë testamenti që ka lënë i vdekuri, dhe pasi të lahen të gjitha borxhet. Sa për prindërit dhe fëmijët tuaj, nuk e dini cili prej tyre është më i miri për ju dhe më i dobishmi. Ky është ligji i Zotit. Zoti është i Gjithëdijsëm, Më i

* 4:1 Kjo është surja e dytë për nga gjatësia, dhe titulli tregon që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të grave. Cilido interpretim duhet të jetë në favor të të drejtave të grave, e jo e kundërta.

* 4:3 Shih Shtojcën 30 për shqyrtim të hollësishëm mbi poligaminë.

* 4:4 Paja është vlerë materiale që caktohet ta japë burri që martohet.

* 4:11 Në përgjithësi, i biri është përgjegjës për familjen, përderisa e bija është nën kujdesin e burrit. Megjithatë, Kurani rekomandon në 2:180 që një testament të lihet për t'iu përshtatur rrethanave të posaçme të të vdekurit. Për shembull, nëse i biri është i pasur dhe e bija është e varfër, mund të lihet testamenti për t'i dhënë të bijës çdo gjë, ose dy herë më shumë se të birit.

Mençuri.

Trashëgimia bashkëshortore

[12] Ju merrni gjysmën e asaj që lënë pas gratë tuaja, nëse nuk kishin fëmijë. Nëse kishin fëmijë, ju merrni një të katërtën e asaj që lënë. E gjithë kjo, pas përmbushjes së ndonjë testamenti që kanë lënë, dhe pas larjes së të gjitha borxheve. Ato marrin një të katërtën e asaj që leni pas, nëse nuk kishit fëmijë. Nëse kishit fëmijë, ato marrin një të tetën e asaj që leni trashëgim. E gjithë kjo, pas përmbushjes së ndonjë testamenti që keni lënë, dhe pas larjes së të gjitha borxheve. Nëse i vdekuri apo e vdekura kishte vetëm vëllezër dhe/ose motra, atëherë ata pa dallim gjinie ndajnë në mënyrë të barabartë një të tretën e trashëgimisë. Po të ketë vetëm një prej tyre, ai ose ajo merr një të gjashtëm. E gjithë kjo, pas përmbushjes së ndonjë testamenti, dhe pas larjes së të gjitha borxheve, kështu që askush të mos dëmtohet. Ky është testament i shpallur nga Zoti. Zoti është i Gjithëdijshëm, i Butë.

Zoti komunikon me ne nëpërmjet të dërguarit të Tij

[13] Këto janë ligjet e Zotit. Ata që i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij, Ai do i pranojë në kopshte me prroje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë. Ky është triumfi më i madh.

[14] Sa për atë që nuk i bindet Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe shkelë ligjet e Tij, Ai do e shpie në Ferr, ku qëndron përgjithmonë. Ka vetëshkaktuar ndëshkim të turpshëm.

Karantinë shëndeti

[15] Ato prej grave tuaja që bëjnë marrëdhënie jashtëmartesore, duhet të keni katër dëshmitarë kundër tyre, nga mesi juaj. Nëse ata dëshmojnë, atëherë t'i mbani gratë e tilla në shtëpitë e tyre deri sa të vdesin, ose deri sa Zoti të krijojë një rrugëdalje për to.*

[16] Çifti që bënë marrëdhënie jashtëmartesore të ndëshkohet.* Nëse pendohen dhe përmirësohen, t'i lëni rehat. Zoti është Shpengues, i Mëshirshmi.

Pendimi

[17] Pendimi është i pranueshëm nga Zoti prej atyre që bien në mëkat nga padituria, pastaj pendohen menjëherë pas kësaj. Zoti i shpengon ata. Zoti është i Gjithëdijshëm, Më i Mençuri.

[18] Nuk është i pranueshëm pendimi i atyre që bëjnë mëkate deri sa tu vijë vdekja, pastaj thonë, "Tash pendohem." As nuk është i pranueshëm prej atyre që vdesin si mosbesimtarë. Për këta kemi përgatitur ndëshkim që dhemb.

[19] O ju që besoni, nuk është e ligjshme për ju të trashëgoni çka lënë gratë pas, kundër vullnetit të tyre. Mos i detyroni të heqin dorë nga çfarëdo që ju keni dhënë, në mos bëfshin marrëdhënie jashtëmartesore të vërtetuar. T'i trajtoni mirë. Nëse nuk ju pëlqejnë, mund të mos ju pëlqejë diçka ku Zoti ka vënë shumë të mira.

Mbrojtje për gratë

[20] Nëse dëshironi të martoheni me një grua tjetër, në vend të gruas së tanishme, dhe i keni dhënë cilësdo prej tyre një shumë të madhe, të mos merrni prapa asgjë që i keni dhënë asaj. A do e merrnit me hile, keqdashje, dhe mëkat?

[21] Si mund ta merrni prapa, pas intimitetit me njëri tjetrin, dhe pasi kanë marrë prej jush zotim solemn?

* 4:15 Një grua e parë nga katër dëshmitarë në vepër të bërjes së marrëdhënies jashtëmartesore në katër raste të ndryshme, me katër partnerë të ndryshëm, paraqet rrezik për shëndetin publik. Një grua e tillë është depo mikrobesh, dhe një karantinë shëndeti e mbron shoqërinë prej saj. Një shembull i mirë i një rrugëdalje që e shpëton një grua të mbyllur ashtu është martesë – dikush mund të dëshirojë të martohet me të, dhe kështu ta mbrojë atë dhe shoqërinë.

* 4:16 Ekspozimi publik i mëkatarëve është frenues i madh, siç shihet në 5:38 dhe 24:2.

Respekt për babanë

[22] Mos u martoni me gratë që më parë ishin të martuara me baballarët tuaj – martesat ekzistuese përjashtohen dhe të mos prishen – se është fyerje e tepërt, dhe vepër e urryer.

Gjaktrazimi ndalohet

[23] Të ndaluara për ju (për martesë) janë nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, motrat e baballarëve tuaj, motrat e nënave tuaja, bijat e vëllait tuaj, bijat e motrës tuaj, Nënat gjdhënëse tuaja, vajzat që morën gji nga e njëjta grua si ju, nënat e grave tuaja, bijat e grave tuaja me të cilat keni përmbushur martesën – nëse martesë nuk është përmbushur, mund të martoheni me të bijën e saj. Gjithashtu të ndaluara për ju janë gratë që ishin të martuara me bijtë tuaj gjenetik. Gjithashtu, të mos jeni të martuar me dy motra në të njëjtën kohë – por mos i prishni martesat ekzistuese. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

Pëlqim i dyanshëm dhe pajë

[24] Gjithashtu janë të ndaluara gratë që janë tashmë të martuara, përveç nëse shpëtojnë nga burrat e tyre mosbesimtarë që janë në luftë me ju.* Këto janë urdhrat e Zotit për ju. Të gjitha kategoritë e tjera janë të lejuara për ju për martesë, përderisa ua paguani pajën e duhur. Mbani moralin, duke mos bërë marrëdhënie jashtëmartesore. Pra, cilado që ju pëlqen prej tyre, tu paguani pajën e shpallur për to. Nuk bëni gabim me pajtim të dyanshëm për çfarëdo ndreqje të pajës. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

[25] Ata mes jush që nuk kanë mundësi të martohen me gra besimtare të lira, mund të martohen me gra besimtare skllave. Zoti din më së miri për besimin tuaj, dhe ju jeni të barabartë për njëri tjetrin sa i përket besimit. Të merrni leje nga kujdestarët e tyre para se të martoheni me to, dhe t'ua paguani pajën e duhur me barazi. Ato duhet të mbajnë sjellje të moralshme, duke mos bërë marrëdhënie jashtëmartesore, ose pasur dashnorë sekret. Kur ato të lirohen nëpërmjet martesës, nëse bëjnë marrëdhënie jashtëmartesore, ndëshkimi për to të jetë sa gjysma e atij për gratë e lira.* Martesa me skllave duhet të jetë alternativa e fundit për ata që nuk mund të presin. Të jeni të durueshëm është më mirë për ju. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[26] Zoti do që t'ju shpjegojë gjërat, dhe t'ju udhëzojë nëpërmjet precedentëve të kaluar, dhe t'ju shpengojë. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

Mëshira e Zotit

[27] Zoti dëshiron t'ju shpengojë, përderisa ata që ndjekin epshet dëshirojnë që ju të devijoni në devijim të madh.

[28] Zoti dëshiron t'ju lehtësojë barrën, se qenia njerëzore është krijuar e dobët.

Vrasja, vetëvrasja, dhe përfitimet e paligjshme ndalohen

[29] O ju që besoni, mos e konsumoni pronën e njëri tjetrit në mënyrë të paligjshme – vetëm shitblerjet me pajtim të dyanshëm lejohen. Mos u vrisni. Zoti është i Mëshirshëm ndaj jush.

[30] Kushdo që kryen këto shkelje, me keqdashje dhe paramendim, do e flakim në Ferr. Kjo është lehtë për Zotin.

[31] Nëse shmangeni nga bërja e mëkateve të tepërta që janë të ndaluara për ju, do t'ua heqim

* 4:24 Nëse gratë besimtare ju ikin burrave të tyre mosbesimtarë që janë në luftë me besimtarët, ato nuk kanë nevojë të kenë vërtetim divorci para rimartesës. Shih 60:10.

* 4:25 Ky ligj vërteton që ndëshkimi për marrëdhënie jashtëmartesore nuk ka mundësi të jetë vdekja me gurë siç pohohet në ligjet e Myslimanëve të korruptuar (shih 24:2).

mëkatet, dhe t'ju pranojmë pranim të ndershëm.

Burrat dhe gratë të pajisur me cilësi të veçanta

[32] Të mos i lakmoni cilësitë e dhuruara mbi njëri tjetrin nga Zoti; burrat gëzojnë cilësi të caktuara, dhe gratë gëzojnë cilësi të caktuara. Mund t'i luteni Zotit t'ju lëshojë mirësinë e Tij. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Mos kundërshtoni ligjet e trashëgimit të propozuara nga Zoti

[33] Për secilin nga ju, ne kemi përcaktuar hise nga trashëgimia e lënë nga prindërit dhe të afërmit. Gjithashtu të afërmve nga martesja, t'ua jepni hisen e duhur. Zoti është dëshmitar i të gjitha gjërave.

*Mosrrahja e gruas**

[34] Burrat janë përgjegjës për gratë,* dhe Zoti i ka pajis me cilësi të caktuara, dhe i ka bërë furnizues. Gratë e drejta do të pranojnë me gëzim këtë rregullim, pasi që është urdhri i Zotit, dhe t'i nderojnë burrat e tyre gjatë mospranisë së tyre. Nëse përjetoni kryengritje nga gratë, së pari të flisni me to, pastaj (mund të përdorni nxitje negative si) braktisja në shtrat, pastaj mund (si mundësi e fundit) t'i rrihni. Nëse ju binden, nuk lejoheni të bëni shkelje kundër tyre. Zoti është Më i Larti, Madhështor.

Arbitër martesor

[35] Nëse një çift i frikësohet ndarjes, të caktoni një arbitër nga familja e tij dhe një arbitër nga familja e saj; nëse vendosin të pajtohen, Zoti do tu ndihmojë të bashkohen. Zoti është i Gjithëdijshëm, Njohës.

Urdhra të mëdha

[36] Të adhuronit vetëm Zotin – mos shoqëroni asgjë me Të. Të keni kujdes ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjit farefisnor, fqinjit jo-farefisnor, kolegut të ngushtë, udhëtarit të huaj, dhe shërbëtorëve tuaj. Zotit nuk i pëlqejnë mburravecët e mendjemëdhenjtë.

[37] Ata që janë dorështrënguar, i nxisin njerëzit të jenë dorështrënguar, dhe fshehin çka Zoti u ka dhuruar nga dhuratat e Tij. Për mosbesimtarët kemi përgatitur ndëshkim të turpshëm.

[38] Ata japin para për bamirësi sa për tu parë, përderisa nuk besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit. Nëse shoqërues i dikujt është djalli, ai është shoqëruesi më i keq.

[39] Pse të mos besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit, dhe të japin prej furnizimeve të Zotit te ta? Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për ta.

Drejtësi Hyjnore

[40] Zoti nuk shkakton padrejtësi as sa pesha e atomit. Në të kundërtën, Ai e shumëfishon shpërblimin për veprën e drejtë, dhe nga Vetja jep shpërblim shumë të madh.

[41] Pra, kur vjen dita (e gjykimit), do të thërrasim një dëshmitar nga secila shoqëri, dhe ti do të shërbesh si dëshmitar mes tyre.

* 4:34 Zoti ndalon rrahjen e gruas duke përdorur qasjen më të mirë psikologjike. Për shembull nëse nuk dua që ti të bësh pazar në Tregun X, do të kërkoj nga ti që të bësh pazar në Tregun Y, pastaj në Tregun Z, pastaj, si mundësi e fundit, në Tregun X. Kjo do të ndalojë efektshëm që të bësh pazar në Tregun X, pa të ofenduar. Ngjashëm, Zoti na jep mundësi tjera nga rrahja e gruas; argumentimi me të së pari, pastaj futja në përdorim e nxitjeve negative të caktuara. Mbani mend se tema e kësaj sure është mbrojtja e të drejtave të grave dhe kundërshtimi i shtypjes së përhapur ndaj grave. Çfarëdo interpretimi i strofave të kësaj sure duhet të jetë në favor të grave. Tema e kësaj sure është "mbrojtja e grave."

* 4:34 Kjo shprehje thjeshtë do të thotë se Zoti po e cakton burrin si "kapiten të anijes." Martesa është si një anije, dhe kapiteni e drejton pas këshillimit të duhur me oficerët. Një grua besimtare me gatishmëri e pranon caktimin e Zotit, pa kryengritje.

[42] Në atë ditë, ata që nuk besuan dhe nuk iu bindën të dërguarit do të dëshirojnë të jenë rrafsh me tokë; asnjë shprehje të vetme nuk do mund ta fshehin prej Zotit.

Çka asgjëson avdesin

[43] O ju që besoni, të mos i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) duke qenë të dehur, që ta dini çka jeni duke thënë. As pas orgazmës seksuale pa u larë, pos nëse jeni në rrugëtim; nëse jeni të sëmurë ose duke udhëtuar, ose patët jashtëqitje urinore apo fekale (p.sh. gaz), ose patët kontakt (seksual) me gratë, dhe nuk mund të gjeni ujë, të zbatoni Tejemum (avdes të thatë) duke prekur dhe të pastër të thatë, dhe duke fshirë fytyrat dhe duart me të. Zoti është Shlyes Mëkatesh, Falës.

[44] A i ke vërejtur ata që morën një pjesë të shkrimit, dhe si zgjedhin të humben, dhe dëshirojnë që ju të humbeni nga rruga?

[45] Zoti e di më së miri kush janë armiqtë tuaj. Zoti është Zotëruesi dhe Sunduesi i vetëm. Zoti është i vetmi Përkrahës.

[46] Mes atyre që janë Jahudi, disa i shtrembërojnë fjalët përtej të vërtetës, dhe thonë, “Dëgjojmë, por nuk bindemi,” dhe “Fjalët tua po bien në veshë të shurdhër,” dhe “Raina* (kujdestarona),” përderisa përdredhin gjuhët e tyre për ta përqeshur fenë. Sikur të thoshin, “Dëgjojmë, dhe bindemi,” dhe “Të dëgjojmë,” dhe “Undhurna (ruana),” do të ishte më mirë për ta, dhe më e drejtë. Por, ata kanë vetëshkaktuar mallkim prej Zotit për shkak të mosbesimit të tyre. Si pasojë, shumica e tyre nuk mund të besojnë.

[47] O ju që morët shkrimin, të besoni në çka shpallëm këtu, që vërteton atë që e keni, para se të dëbojmë fytyra të caktuara në dëbim, ose t’i mallkojmë siç mallkuam ata që nuk respektuan të Shtunën. Urdhri i Zotit kryhet.

Mëkati i pafalshëm

[48] Zoti nuk falë idhujtarinë,* por Ai ia falë krimet më të vogla kujtdo që Ai do. Kushdo që ngrit idhuj përkrah Zotit, ka sajuar një krim të madh.

[49] A i ke vërejtur ata që lartësojnë veten? Jo, Zoti është Ai që lartëson kë do Ai, pa as më të voglën padrejtësi.

[50] Vëreni si trillojnë gënjeshtër për Zotin; sa krim i tepruar është ky!

[51] A i ke vërejtur ata që pranuan një pjesë të shkrimit, dhe si ata besojnë në idhujtari dhe doktrinë të rreme, e thonë, “Mosbesimtarët janë më mirë të udhëzuar se besimtarët?!”

[52] Janë ata që vetëshkaktuan mallkimin e Zotit, e këdo që Zoti mallkon, nuk do të gjeni ndonjë ndihmues për të.

[53] A zotërojnë ata hise të sovranitetit? Sikur të zotëronin, nuk do tu jepnin njerëzve as sa një kokërr.

[54] A ua kanë zili njerëzve për shkak se Zoti u ka derdhur atyre bekimet e Tij? I kemi dhënë familjes së Ibrahimit shkrimin, dhe mençuri; u dhamë autoritet të madh.

[55] Disa prej tyre besuan në të, dhe disa prej tyre e refuzuan; Ferri është i vetmi ndëshkim i drejtë për këta.

Përshkrim alegorik i Ferrit

[56] Padyshim, ata që nuk besojnë në shpalljet tona, do i flakim në zjarr. Kurdo që u digjen lëkurat, do tu japim lëkura të reja. Kështu, ata do të vuajnë vazhdimisht. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i

* 4:46 Fjala “Raina” shtrembërohej nga disa folës të Hebraitës për të tingëlluar si fjalë e ndyrë. Shih 2:104.

* 4:48 Adhurimi i idhujve nuk është i falshëm, nëse mbahet deri në vdekje. Një person mund gjithmonë të pendohet për cilindo krim, përfshirë idhujtarinë, para se të vijë vdekja (shih 4:18 & 40:66).

Mençuri.

[57] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, do i pranojmë në kopshte me proje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë. Aty do të kenë bashkëshorte të çiltra. Do i pranojmë në hije të hareshme.

Sinqeriteti & drejtësia përkrahen

[58] Zoti ju urdhëron të ktheni çfarëdo që njerëzit jua kanë besuar. Nëse gjykoni mes njerëzve, të gjykoni me barazi. Këshilla më e mirë është vërtetë ajo e Zotit. Zoti është Dëgjues, Pamës.

[59] O ju që besoni, t'i bindeni Zotit, dhe t'i bindeni të dërguarit, dhe të autorizuarve mes jush. Nëse grindeni për ndonjë çështje, t'ia drejtoni Zotit dhe të dërguarit, nëse besoni në Zotin dhe Ditën e Fundit. Kjo është më mirë për ju, dhe ju furnizon me zgjidhjen më të mirë.

Besimtarë apo hipokritë?

[60] A i ke vërejtur ata që pretendojnë që besojnë në çka tu shpall ty, dhe në çka u shpall para teje, dhe pastaj mbështeten në ligjet e padrejta të idhujve të tyre? Ata u urdhëruan t'i refuzojnë ligjet e tilla. Është vet dëshira e djallit për t'i çuar larg në humbje.

[61] Kur u thuhet, "Ejani te çka Zoti ka shpallur, dhe te i dërguari," i sheh hipokritët duke tu shmangur plotësisht.

[62] Si do të jetë atëherë kur një katastrofë i godet ata, si pasojë e vet veprave të tyre? Atëherë do të vinë te ti dhe të bëjnë be në Zot: "E patëm me qëllim të mirë dhe të drejtë!"

[63] Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për qëllimet e tyre më të thella. Të mos i përfillësh, t'i këshillosh, dhe tu japësh sqarim të mirë që mund t'ua shpëtojë shpirtrat.

Nënshtrimi i plotë: Cilësi e besimtarëve të vërtetë

[64] Ne nuk dërguam asnjë të dërguar përveç që t'i binden në pajtim me vullnetin e Zotit. Kur ata i bënë keq vetes, po të vinin te ti dhe t'i luteshin Zotit për falje, dhe i dërguari të lutej për faljen e tyre, do e gjenin Zotin Shpengues, Më të Mëshirshmin.

[65] Jo, për Zotëruesin tënd; ata nuk janë besimtarë po të mos vijnë te ti për të gjykuar në grindjet e tyre, dhe të mos gjejnë asnjë hezitim në zemrat e tyre çfarëdo qoftë ai në pranimin e gjykimit tënd. Duhet të nënshtrohen nënshtrim total.

Testet e Zotit nuk janë të paarsyeshme

[66] Sikur tu shpallnim atyre: "Duhet ta sakrifikoni jetën," ose "T'i dorëzoni shtëpitë," nuk do e kishin bërë, përveç një pakice nga ta. (Edhe sikur një urdhër i tillë të lëshohej,) sikur ta bënëin atë që u urdhëruan ta bënëin, do ishte më mirë për ta, dhe do e vërtetonte forcën e besimit të tyre.

[67] Dhe do u dhuronim shpërblim të madh.

[68] Dhe do i udhëzonim në rrugën e drejtë.

Barazia e besimtarëve

[69] Ata që i binden Zotit dhe të dërguarit përkasin me ata të bekuarit nga Zoti – profetët, të shenjtët, dëshmorët, dhe të drejtit. Janë shoqëria më e mirë.

[70] I tillë është bekimi prej Zotit; Zoti është më i miri Njohës.

[71] O ju që besoni, të rriini në gatishmëri, dhe të mobilizoheni veç e veç, ose të mobilizoheni të gjithë së bashku.

[72] Padyshim, ka prej tyre mes jush që ngadalësohen, pastaj, nëse ju godet ndonjë pengesë, do të thoshin, "Zoti më ka bekuar që nuk rashë dëshmorë me ta."

[73] Por nëse arrini bekim nga Zoti, do të thoshin, sikur të mos ketë pasur miqësi në mes juve dhe atyre, "Ah sikur të isha me ta, që të fitoja edhe unë një fitore të tillë të madhe."

[74] Ata që luftojnë me gatishmëri për Zotin janë ata që heqin dorë nga kjo botë për Përjetësinë. Kushdo që lufton për Zotin, pastaj e vrasin, ose ai arrin fitore, padyshim do i dhurojmë një shpërblim shumë të madh.

Besimtarët janë trima

[75] Pse të mos luftoni për Zotin kur fëmijët, gratë, dhe burrat e dobët janë duke u lutur: “Zotëruesi ynë, çlirona nga kjo shoqëri njerëzitet e të cilës janë shtypës, dhe qofsh Ti Zotëruesi dhe Sunduesi ynë.”

[76] Ata që besojnë po luftojnë për Zotin, kurse ata që nuk besojnë po luftojnë për tirani. Prandaj, të luftoni kundër aleatëve të djallit; fuqia e djallit është zero.

[77] A i ke vërejtur ata që u është thënë, “Nuk keni nevojë të luftoni; e tëra që duhet të bëni është të zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat),” pastaj, kur luftimi u shpall për ta, ata iu frikësuan njerëzve po aq sa iu frikësuan Zotit, ose edhe më shumë? Thanë, “Zotëruesi ynë, pse na detyrove këtë luftë neve? Sikur vetëm të na shtyje këtë për pak më vonë!” Thuaj, “Pajisjet e kësaj bote janë zero, ndërsa Përjetësia është shumë më e mirë për të drejtin, dhe nuk vuani as padrejtësinë më të vockël.”

*Zoti është bërës i çdo gjëje**

[78] Kudo që jeni, vdekja do t’ju zë, edhe nëse jetoni në kështjella të fortifikuara. Kur diçka e mirë u ndodhë atyre, thonë, “Kjo është prej Zotit,” dhe kur diçka e keqe i godet, të fajësojnë ty. Thuaj, “Çdo gjë vjen prej Zotit.” Pse këta njerëz e keqkuptojnë pothuajse çdo gjë?

Asgjë e keqe nuk vjen prej Zotit

[79] Çfarëdo e mire që të ndodhë është prej Zotit, dhe çfarëdo e keqe që të ndodhë është prej teje. Të kemi dërguar si të dërguar te njerëzitet,* dhe Zoti mjafton si dëshmitar.

[80] Kushdo që i bindet të dërguarit i bindet Zotit. Sa për ata që refuzojnë, ne nuk të dërguam si roje të tyre.

[81] Ata thonë se binden, por sapo të largohen, disa prej tyre ushqejnë mendime në kundërshtim me atë që thonë. Zoti i incizon mendimet e tyre më të thella. Shpërfilli ata, dhe kij besim në Zotin. Zoti mjafton si mbrojtës.

Provë e autorësisë Hyjnore

[82] Pse nuk e studiojnë Kuranin me vëmendje? Sikur të ishte prej tjetër pos Zotit, do të gjenin në të kundërtënie të shumta.*

Ruajuni nga thashethemet e Djallit

[83] Kur ndonjë thashetheme që prekë sigurinë kalon pranë tyre, ata e përhapin. Sikur t’i drejtoheshin për këtë të dërguarit, dhe të autorizuarve mes tyre, ata që i kuptojnë këto çështje do i informonin. Sikur të mos ishte mirësi e Zotit ndaj jush, dhe mëshira e Tij, do të ndiqnit djallin, përveç një pakice.

[84] Të luftosh për Zotin; je përgjegjës vetëm për shpirtin tënd, dhe nxiti besimtarët të bëjnë të njëjtën. Zoti do të neutralizojë fuqinë e atyre që nuk besojnë. Zoti është shumë më i fuqishëm, dhe

* 4:78 Gjërat e këqija janë pasojë e vet veprave tona (42:30, 64:11), ndonëse Zoti është bërës i çdo gjëje (8:17). Zoti e krijoi zjarrin për të na shërbyer, por mund të vendosni ta fusni gishtin në të. Kështu ne e dëmtojmë veten. Është ligj i Zotit që nëse e fut gishtin në zjarr, do të dhemb.

* 4:79 Muhamedit nuk i është dhënë ndonjë provë e profetllëkut. Prandaj është shkruar shprehja “Zoti mjafton si dëshmitar” (29:51-52). Vlera gërmore e fjalës “Muhamed” është 92, dhe 92+79=171=19x9.

* 4:82 Edhe pse Kurani u shpall gjatë kohëve të errëta të mesjetës së hershme, nuk mund të gjeni asnjë absurditet në të; një tjetër provë e autorësisë hyjnore (shih Hyrjen dhe Shtojcën Një).

shumë më i efektshëm.

Përgjegjësia

[85] Kushdo që ndërmjetëson një vepër të mirë është pjesëmarrës i saj, dhe kushdo që ndërmjetëson një punë të keqe, i shkakton vetes një pjesë të saj. Zoti drejton të gjitha gjërat.

Të jeni të sjellshëm

[86] Kur ju përshëndesin me përshëndetje, reagoni me një përshëndetje më të mirë ose së paku një të barabartë. Zoti i llogarit të gjitha gjërat.

[87] Zoti: nuk ka zot përveç Tij. Ai padyshim do t'ju mbledhë në Ditën e Ringjalljes – ditën e pashmangshme. Tregimi i kujt është më i vërtetë se i Zotit?

Si të silleni me hipokritët

[88] Pse duhet të ndaheni në dy grupe sa i përket hipokritëve (mes jush)? Zoti është ai që i mallkoi se e merituan. A dëshironi t'i udhëzoni ata që janë dërguar në humbje nga Zoti? Këdo që Zoti e dërgon në humbje, nuk mund të gjeni mënyrë për ta udhëzuar.

[89] Ata dëshirojnë që ju të mos besoni ashtu si nuk kanë besuar ata, dhe të bëheni të barabartë. Mos i konsideroni shokë, në mos u mobilizofshin me ju për Zotin. Nëse kthehen kundër jush, t'i luftoni, dhe mund t'i vrisni kur hasni në ta në luftë. Të mos i pranoni si shokë, ose aleat.*

[90] Me përjashtim të atyre që ju bashkëngjiten njerëzve me të cilët keni nënshkruar traktat paqeje, dhe të atyre që vijnë te ju duke dashur të mos ju luftojnë, as t'i luftojnë të afërmit e tyre. Sikur të donte Zoti, Ai do i kishte lejuar të luftojnë kundër jush. Prandaj, nëse ju lënë rehat, ndalojnë të ju luftojnë, dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Zoti nuk ju jep asnjë justifikim për t'i luftuar.

[91] Do të gjeni të tjerë që dëshirojnë të bëjnë paqe me ju, dhe gjithashtu me njerëzit e tyre. Mirëpo, posa të shpërthejë lufta, luftojnë kundër jush. Nëse këta njerëz nuk ju lënë rehat, nuk ju ofrojnë paqe, dhe nuk ndalen së ju luftuari, mund t'i luftoni kur ndesheni me ta. Kundër këtyre, ju japim autorizim të qartë.

Të mos vrisni

[92] Asnjë besimtar të mos vrasë besimtarin tjetër, pos nëse është aksident. Nëse dikush vret një besimtar aksidentalisht, të laj fajin duke liruar një skllav besimtar, dhe duke i paguar kompensim familjes së viktimës, nëse ata nuk e falin kompensimin e tillë si bamirësi. Nëse viktimja i takonte njerëzve që janë në luftë me ju, ndonëse ishte besimtar, të lani fajin duke liruar një skllav besimtar. Nëse i takonte njerëzve me të cilët keni nënshkruar traktat paqeje ta paguani kompensimin plus të lironi një skllav besimtar. Nëse nuk gjeni* skllav për të liruar, të lani fajin duke agjëruar dy muaj rresht, për t'ju shpenguar Zoti. Zoti është Njohës, Më i Mençuri.

Krim i pafalshëm

[93] Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkim i tij është Ferri, ku qëndron përgjithmonë, Zoti është i zemëruar me të, dhe e mallkon, dhe ka përgatitur për të ndëshkim të tmerrshëm.

[94] O ju që besoni, nëse sulmoni për Zotin, të jeni absolutisht të sigurt. Mos i thoni atij që ju ofron paqe, "Ti nuk je besimtar," duke kërkuar plaçkat e kësaj bote. Se Zoti posedon pakufi plaçka. Mbani mend që edhe ju ishit si ata, dhe Zoti ju bekoi. Prandaj, të jeni absolutisht të sigurt (para se të sulmoni). Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

Rangje më të larta për ata që përpiqen

[95] Nuk janë të barabartë ata që rrinë mes besimtarëve e nuk janë invalid, dhe ata që përpiqen

* 4:89 Rregulla themelor e të gjitha luftimeve thuhet në 60:8-9.

* 4:92 Pasi që skllavëria nuk ekziston, kundërvajtësi duhet të lajë fajin duke agjëruar dy muaj rresht.

për Zotin me paratë dhe jetën e tyre. Zoti i lartëson ata që përpiqen me paratë dhe jetën e tyre mbi ata që rrinë. Për të dyja, Zoti premtun shpëtim, por Zoti i lartëson ata që përpiqen mbi ata që rrinë me një shpërblim shumë të madh.

[96] Rangjet e larta, si dhe falja dhe mëshira vijnë nga Ai. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

Përtacia dënohet

[97] Ata jetët e të cilëve përfundohen nga engjëjt, përderisa janë në rrugë të gabuar, engjëjt do i pyesin, “Çka ishte problemi me ju?” Do të thonë, “Ne ishim të shtypur në tokë.” Ata do të thonë, “A nuk ishte toka e Zotit mjaft e gjerë për ju që të emigroni aty?” Për këta, vendbanimi i fundit është Ferri, dhe një fat i trishtueshëm.

[98] Me përjashtim të fëmijëve, grave, dhe burrave të dobët që nuk posedojnë forcën, as mjetet për të gjetur një rrugëdalje.

[99] Këta mund të falen nga Zoti. Zoti është Shlyes Mëkatesh, Falës.

[100] Kushdo që emigron për Zotin do të gjejë në tokë dhurata dhe pasuri të shumta. Kushdo që lë shtëpinë e tij, duke emigruar te Zoti dhe i dërguari i Tij, dhe pastaj e zë vdekja, shpërblimi i tij është me Zotin. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[101] Kur udhëtoni, gjatë luftës, nuk bëni gabim me shkurtimin e Lutjeve tuaja të Kontaktit (Salat), nëse keni frikë se mosbesimtarët mund t’ju sulmojnë. Padyshim mosbesimtarët janë armiqtë tuaj të flaktë.

Masa paraprake të luftës

[102] Kur të jesh me ta, dhe të udhëheqësh Lutjen e Kontaktit (Salat) për ta, le të qëndrojnë disa prej jush roje; le t’i mbajnë armët e tyre, dhe le të qëndrojnë pas jush përderisa përukeni. Pastaj, grupi tjetër që nuk është lutur le ta marrë radhën të luten me ty, përderisa të tjerët qëndrojnë roje dhe i mbajnë armët e tyre. Ata që nuk besojnë dëshirojnë të ju shohin duke lënë armët dhe pajisjet pas dore, për t’ju sulmuar një herë e përgjithmonë. Nuk bëni gabim, nëse pengoheni nga shiu ose ndonjë lëndim, dhe i lëshoni armët tuaja, përderisa vazhdoni të jeni në gatishmëri. Zoti ka përgatitur për mosbesimtarët ndëshkim të turpshëm.

Lutjet e Kontaktit

[103] Kur ta kryeni Lutjen e Kontaktit (Salat), ta kujtoni Zotin ndërsa jeni në këmbë, të ulur, ose të shtrirë.* Kur të përfundojë lufta, t’i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat); Lutjet e Kontaktit (Salat) janë shpallur për besimtarët në kohë të posaçme.

[104] Mos u luhadni për të ndjekur armikun. Nëse ju vuani, ata gjithashtu vuajnë. Megjithatë, ju prisni nga Zoti çka ata nuk presin. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

[105] E kemi zbritur shkrimin te ti, me të vërtetë, për të gjykuar mes njerëzve sipas asaj që Zoti ta tregoi. Të mos anosh nga tradhtarët.

[106] T’i lutesh Zotit për falje. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

Mos mbroj shkelësit

[107] Mos polemizoni në emër të atyre që mashtrojnë veten; Zoti nuk do tradhtarë, fajtorë.

[108] Ata fshihen prej njerëzve, dhe nuk mërzhiten të fshihen prej Zotit, edhe pse Ai është me ta përderisa ushqejnë ide që nuk i pëlqejnë Atij. Zoti është tërësisht i vetëdijshtëm për çdo gjë që

* 4:103 Zoti yt është kushdo apo çfarëdo që ta preokupon mendjen shumicën e kohës. Për t’i takuar mbretërisë së Zotit, dhe gëzuar mirësinë dhe kujdesin e Tij, Kurani na nxit që ta kujtojmë Zotin “gjithmonë” (2:152 & 200, 3:191, 33:41-42). Ky fakt i madh i shpjegon strofat e shumta që pohojnë se “shumica” e atyre që besojnë në Zotin po shkojnë në Ferr (12:106, 23:84-89, 29:61-63, 31:25, 39:38, 43:87). Shih Shënimin Plotësues të 3:191 dhe Shtojcën 27.

bëjnë.

Nuk ju ndihmon duke qenë "i sjellshëm"

[109] Ja ku jeni duke polemizuar në emër të tyre në këtë botë; kush do të polemizojë me Zotin në emër të tyre në Ditën e Ringjalljes? Kush do të jetë mbrojtësi i tyre?

[110] Kushdo që bën të këqija, ose mashtron veten, pastaj i lutet Zotit për falje, do e gjejë Zotin Falës, Më të Mëshirshmin.

[111] Kushdo që mbledhë një mëkat, e mbledhë në dëm të shpirtit të vet. Zoti është i Gjithëdijshmi, Më i Mençuri.

[112] Kushdo që mbledhë një mëkat, pastaj e akuzon një person të pafajshëm për të, ka kryer blasfemi dhe krim të tepërt.

[113] Po të mos ishte mirësi e Zotit ndaj teje, dhe mëshira e Tij, disa prej tyre do të kishin çorientuar. Ata vetëm e çorientojnë veten, dhe nuk mund të të dëmtojnë aspak. Zoti të ka zbritur shkrimin dhe mençuri, dhe Ai të ka mësuar çka nuk e ke ditur kurrë. Vërtetë, bekimet e Zotit mbi ty kanë qenë shumë të mëdha.

[114] Asgjë nuk i bën të mira konferencat e tyre private, përveç atyre që përkrahin bamirësinë, ose veprat e drejta, ose paqen në mes të njerëzve. Kushdo që bën këtë, si reagim ndaj mëtimeve të Zotit, do i dhurojmë një shpërblim shumë të madh.

[115] Sa për atë që e kundërshton të dërguarin, pasi që udhëzimi është bërë i qartë për të, dhe ndjekë rrugë përveç asaj të besimtarit, do e lëmë kah drejtimi që e ka zgjedhur, dhe e fusim në Ferr; çfarë fati i tmerrshëm!

Mëkati i pafalshëm

[116] Zoti nuk falë adhurimin e idhujve (nëse mbahet deri në vdekje),* dhe Ai falë krime më të vogla për këdo që Ai do. Kushdo që idhujtarizon ndonjë idhull përkrah Zotit ka humbur larg në humbje.

[117] Ata madje adhurojnë perëndesha përveç Tij; në realitet po adhurojnë vetëm djallin kryengritës.

[118] Që e ka mallkuar Zoti, dhe që tha, "Patjetër do e rekrutoj një pjesë të caktuar të adhuruesve Tënd.*"

[119] "Unë do i çorientoj, do i joshë, do i urdhëroj të (ndalojnë ngrënien e mishrave të caktuar duke) shënuar veshët e bagëtisë, dhe do i urdhëroj të shtrembërojnë krijesat e Zotit." Kushdo që e pranon djallin si zotëruar, në vend të Zotit, ka vetëshkaktuar humbje marramendëse.

[120] Ai u premtonte dhe i joshë ata; çka premtonte djalli nuk është asgjë më shumë se një iluzion.

[121] Të tillët kanë vetëshkaktuar Ferr si vendbanim përfundimtar, dhe nuk mund t'i shmangen kurrë.

[122] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, do i pranojmë në kopshte me proje që rrjedhin, ku jetojnë përgjithmonë. I tillë është premtimi i sigurtë i Zotit. Shprehjet e kujt janë më të vërteta se të Zotit?

[123] Nuk bëhet sipas dëshirave tuaja, apo dëshirave të njerëzve të shkrimit: kushdo që bën keq paguan për të, dhe nuk do të ketë asnjë ndihmues ose përkrahës kundër Zotit.

[124] Sa për ata që çojnë jetë të drejtë, qoftë mashkull apo femër, përderisa besojnë, ata hyjnë në Parajsë; pa as më të voglën padrejtësi.

* 4:116 Definicion i thjeshtë i idhujtarisë: Të besosh që diçka përkrah Zotit mund të të ndihmojë.

* 4:118 Shumica e besimtarëve në Zot bien në idhujtari (12:106).

*Ibrahimi: I dërguari i parë i Islamit**

[125] Kush është më mirë i udhëzuar në fenë e tij se ai që i nënshtrohet plotësisht Zotit, çon jetë të drejtë, sipas kredos së Ibrahimit: monoteizmit? Zoti e ka zgjedhur Ibrahimin si shok të dashur.

[126] Zotit i takon çdo gjë në qiej dhe tokë. Zoti i ka krejt gjërat në dorë.

[127] Konsultohen me ty rreth grave: thuaj, “Zoti ju këshillon në lidhje me to, siç ju recitohet në shkrim. T’i riparoni të drejtat e jetimeve të cilave ju bëni hile në pajën e duhur kur dëshironi të martoheni me to: Të mos e keqpërdorni rastin. Edhe të drejtat e jetimave duhet gjithashtu të mbrohen. T’i trajtoni jetimët me barazi. Çfarëdo të mire që bëni, Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të.”

Shkurorëzimi dekurajohet

[128] Nëse një grua ndjenë shtypje ose braktisje nga bashkëshorti, çifti të provojë t’i pajtojë dallimet, se pajtimi është më së miri për ta. Të qenit vetjak është tipar i njeriut, dhe nëse e çoni mirë dhe çoni jetë të drejtë, Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

*Poligamia dekurajohet**

[129] Nuk mundeni kurrë të silleni me barazi me më shumë se një bashkëshorte, pavarësisht sa përpiqeni. Prandaj, mos u bëni aq të njëanshëm sa që ta lëni njërën pezull (as ta gëzojë martesën, as të lihet të martohet me dikë tjetër). Nëse e përmirësoni këtë situatë dhe mbani drejtësinë, Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[130] Nëse çifti duhet të vendosë të ndahet, Zoti do të furnizojë secilin prej tyre nga dhuratat e Tij. Zoti është Bujar, Më i Mençuri.

[131] E Zotit është çdo gjë në qiej dhe tokë, dhe i kemi porositur ata që pranuan shkrimin para juve, dhe ju porositëm juve, që t’ia keni dronë Zotit. Nëse nuk besoni, atëherë e Zotit është çdo gjë në qiej dhe në tokë. Zoti nuk ka nevojë për asgjë, i Falënderuar.

[132] E Zotit është gjithçka në qiej dhe tokë, dhe Zoti është i vetmi Mbrojtës.

[133] Nëse Ai do, mundet t’ju asgjësojë, o njerëz, dhe t’ju zëvendësojë me tjerë. Zoti është padyshim i zoti ta bëjë këtë.

[134] Kushdo që kërkon shpërblimet e kësaj bote le ta di se Zoti i posedon edhe shpërblimet e kësaj bote edhe të Përjetësisë. Zoti është Dëgjues, Pamës.

Mos dëshmoni rrejshëm

[135] O ju që besoni, të jeni absolutisht të drejtë, dhe t’ia keni dronë Zotit, kur shërbeni si dëshmitarë, madje edhe kundër vetes, ose prindërve, ose të afërmve. Pa marrë parasysh nëse i akuzuari është i pasur apo i varfër, Zoti i trajton që të dy. Prandaj, mos jini të njëanshëm nga dëshirat tuaja personale. Nëse devijoni ose shpërfillni (këtë urdhër), atëherë Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

[136] O ju që besoni, të besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe në shkrimin që ka shpallur nëpërmjet të dërguarit të Tij, dhe në shkrimin që ka shpallur para atij. Kushdo që refuzon të besojë në Zotin, dhe engjëjt e Tij, dhe shkrimin e Tij, dhe të dërguarit e Tij, dhe Ditën e Fundit, ka humbur vërtetë larg në humbje.

[137] Padyshim, ata që besojnë, pastaj nuk besojnë, pastaj besojnë, pastaj nuk besojnë, pastaj futen më thellë në mosbesim, Zoti nuk do i falë, as nuk do i udhëzoj në asnjë mënyrë.

* 4:125 Të gjithë të dërguarit që nga Ademi kanë predikuar një dhe të njëjtën fe. Ibrahim ishte i dërguari i parë i kredos së quajtur “Islam” (22:78, Shtojca 26). “Islami” nuk është emër, por përshkrim që do të thotë “Nënshttrim.”

* 4:129 Shih Shtojcën 30, të titulluar “Poligamia.”

[138] Njoftoj hipokritët se kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[139] Ata janë ata që iu bashkohen mosbesimtarëve në vend të besimtarëve. A po kërkojnë dinjitet me ta? I gjithë dinjiteti është me Zotin.

[140] Ai ju ka dërguar fjalë në shkrim që: nëse dëgjoni përqeshje dhe tallje të shpalljeve të Zotit, të mos uleni me ta, në mos u futshin në bisedë tjetër. Përndryshe, do jeni po aq fajtorë sa ata. Zoti do i mbledhë hipokritët dhe mosbesimtarët së bashku në Ferr.

Hipokritët

[141] Ata ju vëzhgojnë dhe presin; nëse arrini fitore nga Zoti, ju thonë, “A nuk ishim me ju?” Por nëse mosbesimtarët kanë rastin, u thonë, “A nuk anuam kah ju, dhe ju mbrojtëm nga besimtarët?” Zoti do të gjykojë mes jush në Ditën e Ringjalljes. Zoti nuk do i lejojë mosbesimtarët të triumfojnë mbi besimtarët.

[142] Hipokritët mendojnë se po e mashtrojnë Zotin, por Ai është Ai që i sillë. Kur ata ngriten për Lutjet e Kontaktit (Salat), ngriten me përtaci. Kjo është për shkak se ata vetëm po dëftohen para njerëzve, dhe rrallë ju bie në mend Zoti.

[143] Luhaten në mes, duke mos i takuar as këtij grupi, as atij grupi. Këdo që Zoti e dërgon në humbje, nuk do të gjeni mënyrë për ta udhëzuar.

[144] O ju që besoni, të mos u bashkoheni mosbesimtarëve, në vend të besimtarëve. A dëshironi ta furnizoni Zotin me provë të qartë kundër jush?

Ata mendojnë që janë besimtarë

[145] Hipokritët do të mbyllen në nivelin më të ulët të Ferrit, dhe nuk do të gjeni askënd t’iu ndihmojë atyre.

[146] Vetëm ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten te Zoti, dhe ia kushtojnë fenë e tyre absolutisht vetëm Zotit, do të numërohen me besimtarët. Zoti do i bekojë besimtarët me shpërblim shumë të madh.

[147] Çfarë do të fitonte Zoti me ndëshkimin tuaj, po të bëheshit mirënjohës dhe të besonit? Zoti është Mirënjohës, i Gjithëdijshëm.

Pastroje fjalorin

[148] Zotit nuk i pëlqen shprehja e sharjeve, përveç atij që trajtohet me padrejtësi të tepërt. Zoti është Dëgjues, Njohës.

[149] Nëse punoni drejt – qoftë haptas apo fshehtë – ose falni një shkelje, Zoti është Falës, i Gjithëfuqishëm.

Të mos bëni asnjë dallim mes të dërguarve të Zotit

[150] Ata që nuk besojnë në Zotin dhe të dërguarit e Tij, dhe kërkojnë të bëjnë dallim mes Zotit dhe të dërguarve të Tij, dhe thonë, “Ne besojmë në disa e i refuzojmë disa,” dhe dëshirojnë të ndjekin një rrugë të ndërmjetme;

[151] këta janë mosbesimtarët e vërtetë. Kemi përgatitur për mosbesimtarët ndëshkim të tmerrshëm.

[152] Sa për ata që besojnë në Zotin dhe të dërguarit e Tij, dhe nuk bëjnë asnjë dallim mes tyre, Ai do t’ua dhurojë shpërblimin e tyre. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

Mësime nga Izraeli

[153] Njerëzit e shkrimit të sfidojnë ty t’iu zbresësh atyre një libër nga qielli! Ata kanë kërkuar nga Moisiu edhe më shumë, duke thënë, “Na trego Zotin, fizikisht.” Rrjedhimisht, i goditi rrufeja, si pasojë e kokë-krisjes së tyre. Veç kësaj, ata e adhuruan viçin, pas të gjitha mrekullive që i kishin

parë. Prapëseparë, ua falëm. E përkrahëm Moisiun me mrekulli të mëdha.

[154] Dhe e ngritëm Malin Sinai mbi ta, përderisa na dhanë besën e tyre. Dhe u thamë, “Hyni te porta kokulur.” Dhe u thamë, “Mos e thyeni të Shtunën.” Prej tyre morëm besë solemne.

[155] (Vetëshkaktuan mallkim se) e shkelën besën e tyre, i refuzuan shpalljet e Zotit, i vranë profetët padrejtësisht, dhe thanë, “Mendjet tona janë të kurdisura!” Në të vërtetë, Zoti është Ai që ua mbylli mendjet, për shkak të mosbesimit të tyre, dhe kjo është arsyeja pse ata nuk arrijnë të besojnë, përveç rrallë.

[156] (Ata janë të mallkuar) se nuk besuan dhe shprehën një rrenë të tepërt rreth Marisë.

*Kryqëzimi i “trupit” të Jezusit**

[157] Se pretenduan se e vranë Mesinë, Jezusin, të birin e Marisë, të dërguarin e Zotit. Në të vërtetë, nuk e vranë, nuk e kryqëzuan – u bënë të mendojnë se po. Të gjitha grupet që debatojnë për këtë çështje janë plot me dyshim sa i përket kësaj çështje. Nuk kanë njohuri; vetëm supozojnë. Një gjë është e sigurt: nuk e vranë.

[158] Po, Zoti e ngriti atë te Vetja; Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[159] Nga të gjithë mes njerëzve të shkrimit lypsej të besojnë në të para vdekjes së tij. Në Ditën e Ringjalljes, ai do të dëshmojë kundër tyre.

[160] Për shkak të shkeljeve të tyre, ndalua për Jahuditë ushqime të mira që dikur ishin të ligjshme për ta; gjithashtu për shkak të zbrapsjeve të vazhdueshme nga rruga e Zotit.

[161] Dhe ushtrimit të fajdesë, e cila ishte e ndaluar, dhe konsumimit të parave të njerëzve në mënyrë të paligjshme. Ne kemi përgatitur për mosbesimtarët mes tyre ndëshkim që dhemb.

[162] Sa për ata mes tyre që janë të bazuar mirë në dituri, dhe besimtarët, ata besojnë në çka t’u shpall ty, dhe në çka u shpall para teje. Janë zbatues të Lutjeve të Kontaktit (Salat), dhe dhënës të bamirësisë së obligueshme (Zeqat); janë besimtarë në Zotin dhe në Ditën e Fundit. Këtyre u dhurojmë shpërblim shumë të madh.

Të dërguarit e Zotit

[163] Të frymëzua ty, si e frymëzua Nuhun dhe profetët pas tij. Dhe e frymëzua Ibrahimin, Ismailin, Isakun, Jakobin, Patriarkët, Jezusin, Jobin, Jonan, Aronin, dhe Salomonin. Dhe i dhamë Davidit Psalmet.

[164] Të dërguarë për të cilët të kemi treguar, dhe të dërguarë për të cilët nuk të kemi treguar. Dhe Zoti i foli Moisiut drejtpërdrejt.

[165] Të dërguarë për të dhënë lajme të mira, si dhe paralajmërime. Kështu njerëzit nuk do të kenë asnjë arsytim kur të dalin para Zotit, pasi që të gjithë këta të dërguarë kanë ardhur te ta. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[166] Por Zoti dëshmon në lidhje me çka të ka shpallur ty; E ka shpallur me dijen e Tij. Dhe engjëjt dëshmojnë po ashtu, por Zoti mjafton si dëshmitar.

[167] Padyshim, ata që nuk besojnë dhe kthejnë mbrapa nga rruga e Zotit kanë humbur larg në humbje.

[168] Ata që nuk besojnë dhe bëjnë shkelje, Zoti nuk do i falë, as nuk do i udhëzojë në asnjë mënyrë.

[169] përveç për në Ferr, ku qëndrojnë përgjithmonë. Kjo është lehtë për Zotin.

[170] O njerëz, i dërguari ju ka ardhur me të vërtetën prej Zotëruesit tuaj. Prandaj, të besoni për të

* 4:157-158 Jezusi, personi i vërtetë, shpirti, u ngrit në mënyrën e njëjtë si në vdekjen e cilitdo person të drejtë. Më pas, armiqët e tij e arrestuan, e torturuan, dhe e kryqëzuan trupin e tij të gjallë, por të zbrazët. Shih Shtojcat 17 & 22.

mirën tuaj. Nëse nuk besoni, atëherë e Zotit është gjithçka në qiej dhe tokë. Zoti është i Gjithëdijshëm, Më i Urti.

Trinia: Doktrinë e rreme

[171] O njerëz të shkrimit, mos i tejkaloni kufijtë e fesë suaj, dhe mos thoni për Zotin përveç të vërtetës. Mesia, Jezusi, i biri i Marisë, ishte i dërguar i Zotit, dhe fjala e Tij që Ai i kishte dërguar Marisë, dhe shpallje prej Tij. Prandaj, të besoni në Zotin dhe të dërguarit e Tij. Të mos thoni, "Trini." Të ndaloni së bëri këtë për të mirën tuaj. Zoti është vetëm një zot. Qoftë i madhëruar; Është tepër shumë i madhëruar për të pasur djalë. E tij është gjithçka në qiej dhe gjithçka në tokë. Zoti mjafton si Zotërues dhe Sundues.

[172] Mesia kurrë nuk do të neveritej nga të qenit shërbëtor i Zotit, e as engjëjt më të afërt. Ata që neveriten nga adhurimi i Tij, dhe janë tepër mendjemëdhenj për tu nënshtruar, Ai do i mbledhë të gjithë para Tij.

[173] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, Ai do i shpërblejë tërësisht dhe do tu derdhë përsipër mirësinë e Tij. E sa për ata që neveriten dhe bëhen mendjemëdhenj, Ai do i mbyllë në ndëshkim që dhemb. Ata nuk do të gjejnë asnjë zotërues përkrah Zotit, as shpëtimtarë.

Kodi Matematikor i Kuranit: Provë materiale e pakundërshtueshme

[174] O njerëz, një provë ju ka ardhur prej Zotëruesit tuaj; e kemi zbritur te ju një fener të dukshëm.

[175] Ata që besojnë në Zotin, dhe mbështeten në Të, Ai do i pranojë në mëshirë prej Tij, dhe mirësi, dhe do i udhëzojë për te Ai në rrugë të drejtë.

[176] Konsultohen me ty; thuaj, "Zoti ju këshillon në lidhje me personin beqar. Nëse dikush vdes dhe nuk lë fëmijë, dhe ka motër, ajo e merr gjysmën e trashëgimisë. Nëse ajo vdes e para, ai trashëgon prej saj, nëse ajo nuk ka lënë fëmijë. Nëse janë dy motra, ato marrin dy të tretat e trashëgimisë. Nëse janë vëllezër e motra, mashkulli merr dy herë hise sa femra." Zoti kështu ju këshillon, që të mos humbni. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Surja 5: Banketi (El-Ma'ideh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] O ju që besoni, t'i përmbushni besëlidhjet tuaja. Të lejuara për ju për ngrënie janë bagëtitë, përveç atyre që saktësisht ndalohen këtu. Të mos lejoni gjuetinë gjatë shtegtimt Haxh. Zoti shpallë çfarëdo që Ai do.

[2] O ju që besoni, mos i shkëlpi ritet e themeluara nga Zoti, as Muajt e Shenjtë, as kafshët që do flijohen, as qaforet e tyre shënjuese, as njerëzit që shkojnë kah Faltorja e Shenjtë (Qabja) duke kërkuar bekime nga Zotëruesi i tyre dhe pëlqimin e Tij. Kur ta përfundoni shtegtimin, mund të gjuani.* Mos u provokoni në dhunë nga urrejtja e njerëzve që dikur ju pengonin të shkoni te Vendlutja e Shenjtë. Të bashkëpunoni në çështje të drejta dhe të mbara; mos bashkëpunoni në çështjet që janë mëkat dhe të këqija. T'ia keni dronë Zotit. Zoti është i rreptë në ndëshkim.

Vetëm katër mishra ndalohen: "Definimi i kafshëve që ngordhin vetë"

[3] Të ndaluara për ju janë kafshët që ngordhin vetë, gjaku, mishi i derrave,* dhe kafshët e

* 5:2 Gjuetia dhe prerja e bimëve janë të ndaluara gjatë shtegtimt që të ruhen burimet natyrore. Pasi që mijëra shtegtarë mbledhen në Mekë, po të ishte gjuetia e lejuar, vendi shumë shpejtë do të zhvishej nga burimet e tij natyrore. Flijimet e kafshëve janë bërë pjesë e shtegtimt për t'i furnizuar shtegtarët që mbledhen, si dhe për popullatën e vendit, dhe për të rimbushur ndonjë furnizim të shterur. Shih 2:196.

* 5:3 "Mishi" i dërrit është i ndaluar jo "dhjami". Çfarëdo që nuk është saktësisht e ndaluar në Kuran duhet të

kushtuara për tjetër pos Zotit. (Kafshët që ngordhin vetë përfshijnë) të fururat, të goditurat me një objekt, të rënat nga lart, të shpuarat nga një bri, të ngrënat nga një kafshë e egër – në mos e shpëtofshi kafshën tuaj para se të ngordhë – dhe kafshët e flijuara në altarë. Gjithashtu është e ndaluar ndarja e mishit nëpërmjet ndonjë loje fati; kjo është e neveritshme. Sot, mosbesimtarët humbën shpresën sa i përket (çrrënjësjes së) fesë tuaj. Mos ju frikësoni atyre por frikësomuni Mua. Sot, Unë e kam përkryer fenë tuaj, i kam përkryer bekimet e Mija mbi ju, dhe e kam shpallur Nënshtrimin fe tuajën. Nëse dikush detyrohet nga uria (të hajë ushqim të ndaluar), pa qenë qëllimisht mëkatues, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[4] Konsultohen me ty për çka është e ligjshme për ta; thuaj, “Të ligjshme për ju janë të gjitha gjërat e mira, duke përfshirë çka qentë dhe skifterët e stërvitur zënë për ju.” I stërvitni sipas mësimëve të Zotit. Mund të hani çka zënë për ju, dhe përmendnie emrin e Zotit mbi to. T’ia keni dronë Zotit. Zoti është më i shkathëti në llogaritje.

[5] Sot, i gjithë ushqimi i mirë është bërë i ligjshëm për ju. Ushqimi i njerëzve të shkrimit është i ligjshëm për ju, dhe ushqimi juaj është i ligjshëm për ta. Gjithashtu, mund të martoheni me gratë e dëlira mes besimtareve, si dhe gratë e dëlira mes ndjekësve të shkrimit paraprak, me kusht që t’ua paguani pajën e duhur. Të mbani dëlirësinë, e jo marrëdhënie jashtëmartesore, as dashnore sekrete. Kushdo që refuzon besimin, e gjithë puna e tij do të jetë e kotë, dhe në Përrjetësi ai do të jetë me dështakët.

Avdesi

[6] O ju që besoni, kur t’i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat), t’i: (1) lani fytyrat tuaja, (2) lani duart tuaja deri në bërryla, (3) fërkoni kokat tuaja, dhe (4) lani këmbët tuaja deri në zogj. Nëse ishit të papastër nga orgazma seksuale, të laheni. Nëse jeni të sëmurë, ose duke udhëtuar, ose patët jashtëqitje (urinore, fekale, ose gaz), ose patët kontakt (seksual) me gratë, dhe nuk mund të gjeni ujë, të zbatoni avdesin e thatë (Tejemum) duke prekur dhe të pastër të thatë, dhe pastaj duke fërkuar fytyrat dhe duart. Zoti nuk dëshiron ta bëjë fenë të vështirë për ju. Ai dëshiron t’ju pastrojë dhe të përkryej bekimet e Tij mbi ju, që të mund të jeni mirënjohës.

[7] Përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju, dhe besëlidhjen e Tij që e lidhi me ju: ju thatë, “Dëgjojmë dhe bindemi.” T’ia keni dronë Zotit; Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

Të mos dëshmoni rrejshëm

[8] O ju që besoni, të jeni absolutisht të drejtë, dhe t’ia keni dronë Zotit, kur shërbeni si dëshmitarë. Mos u nxitni nga konfliktet tuaja me disa njerëz e të kryeni padrejtësi. Të jeni absolutisht të paanshëm, se është më e drejtë. T’ia keni dronë Zotit. Zoti është Njohës i tërësishtëm i çdo gjëje që bëni.

[9] Zoti iu premtonte atyre që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë falje dhe shpërblim shumë të madh.

[10] Sa për ata që nuk besojnë dhe refuzojnë shpalljet tona, ata janë banuesit e Ferrit.

Zoti i mbron besimtarët

[11] O ju që besoni, përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju; kur disa njerëz i zgjatën duart e tyre për t’ju sulmuar, Ai ju mbrojti dhe ua mbajti duart atyre. T’ia keni dronë Zotit; në Zotin besimtarët të kenë besim.

*Kushtet për të qëndruar brenda mbrojtjes së Zotit**

konsiderohet e ligjshme. Shih: 6:145-146.

* 5:12 Nëse ti i përmbush kushtet e pohuara në këtë strofë, Zoti do ta bëjë me dije se Ai është me ty; nuk do të kesh asnjë dyshim për këtë. Mes shenjave të Zotit janë të spikatura shenjat matematikore për ata që e kuptojnë mrekullinë

[12] Zoti mori besën nga Fëmijët e Izraelit, dhe ne ngritëm mes tyre dymbëdhjetë patriarkë. Dhe Zoti tha, “Unë jam me ju, përderisa i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat), jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe besoni në të dërguarit e Mi dhe i respektoni, dhe vazhdoni t’i jepni Zotit hua të drejtësisë. Kushdo që nuk beson pas kësaj, ka humbur nga rruga e drejtë vërtetë.”

Pasojat e shkeljes së besëlidhjes së Zotit

[13] Ishte si pasojë e shkeljes së tyre të besëlidhjes që i mallkuam ata, dhe ne i bëmë zemrat e tyre të bëhen të ngurtësuar. Si pasojë, ata i morën fjalët jashtë kontekstit dhe shpërfillën disa prej urdhrave që u ishin dhënë. Ti do të vazhdosh të jesh dëshmitar i tradhtisë nga ta, përveç një pakice të tyre. T’i falësh, dhe të mos i përfillësh. Zoti i do ata që janë mirëdashës.

Të krishterët gjithashtu duhet t’i binden të dërguarit të Zotit

[14] Gjithashtu, prej atyre që thanë, “Ne jemi të Krishterë,” ne morëm besën. Por ata i shpërfillën disa nga urdhrat që u ishin dhënë. Si pasojë, i mallkuam në armiqësi dhe urrejtje në mes vete, deri në Ditën e Ringjalljes. Zoti pastaj do i njoftojë për të gjitha që kishin bërë.

Kurani: Lajmi i Zotit për jahuditë dhe të krishterët

[15] O njerëz të shkrimit, i dërguari ynë ka ardhur te ju që të shpallë për ju shumë gjëra që i keni fshehur në shkrim, dhe t’ju falë shumë shkelje të tjera që i keni kryer. Ka ardhur një fener te ju prej Zotit, dhe një shkrim i qartë.

[16] Me të, Zoti udhëzon ata që kërkojnë pëlqimin e Tij. I udhëzon në rrugët e paqes, i çon nga errësira në dritë me lejen e Tij, dhe i udhëzon në rrugë të drejtë.

Blasfemi e tepërt

[17] Pagan janë ata që thonë se Zoti është Mesia, i biri i Marisë. Thuaj, “Kush do të mund ta kundërshtonte Zotin sikur Ai të dëshironte ta asgjësonte Mesinë, të birin e Marisë, dhe nënën e tij, dhe të gjithë në tokë?” I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës, dhe çdo gjë në mes tyre. Ai krijon çfarëdo që do Ai. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

I Dërguari i Zotit për Jahuditë, të Krishterët dhe Myslimanët

[18] Jahuditë dhe të Krishterët thanë, “Ne jemi fëmijët e Zotit dhe të dashurit e Tij.” Thuaj, “Pse atëherë Ai ju ndëshkon për mëkatet tuaja? Ju jeni vetëm njerëz si njerëzit e tjerë që i krijoi Ai.” Ai e falë kë do Ai dhe e ndëshkon kë vendos Ai. I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës, dhe çdo gjë në mes tyre, dhe te Ai është fati përfundimtar.

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[19] O njerëz të shkrimit, i dërguari ynë ka ardhur te ju, për të shpjeguar gjërat për ju, pas një periudhe kohore pa të dërguarë, që të mos thoni, “Nuk na erdhi ndonjë predikues ose paralajmërues.” Një predikues dhe paralajmërues tash ka ardhur te ju. Zoti është i Gjithëfuqishëm.*

[20] Kujtohu që Moisiu u tha njerëzve të tij, “O njerëzit e mi, përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju: Ai caktoi profetë nga mesi juaj, ju bëri mbretër, dhe ju dhuroi çka nuk i ka dhuruar asnjë populli tjetër.

Zoti i jep Tokën e Shenjtë Izraelit

e Kuranit (Shtojca Një).

* 5:19 Kjo strofë raporton përmbushjen e profecisë biblike dhe Kuranore në lidhje me ardhjen e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes (Malakia 3:1, Kurani 3:81). Emri i këtij të dërguari është matematikisht i koduar në Kuran si “Rashad Khalifa.” Kjo strofë shumë e veçantë siguron paraqitjen e provave të posaçme. Duke mbledhur vlerën gërmore të “Rashad” (505), plus vlerën e “Khalifa” (725), plus numrin e sures (5), plus numrin e strofës (19), marrim shumën 505+725+5+19=1254, ose 19x66. Nëntëmbëdhjeta është plotpjesëtuesi i përbashkët i Kuranit, i cili u shpall nëpërmjet Rashad Khalifës. Prova më të shumta dhe detajet janë në Shtojcën Dy.

[21] "O njerëzit e mi, hyni në tokën e shenjtë që Zoti e ka shpallur për ju, dhe mos kundërshtoni, se bëheni humbës."

[22] Ata thanë, "O Moisi, në të ka njerëz të fuqishëm, dhe nuk do të hymë në të, në mos dalshin. Nëse ata dalin, ne hymë."

[23] Dy burra që ishin të urtë dhe të bekuar nga Zoti thanë, "Thjeshtë hyni te porta. Nëse hyni në të, padyshim do të jeni fitimtarë. Duhet të keni besim në Zotin, nëse jeni besimtarë."

Përkundër të gjitha mrekullive që kanë

[24] Thanë, "O Moisi, nuk do të hymë në të, sa të jenë ata aty. Prandaj, shko – ti dhe Zotëruesi yt – dhe luftoni. Ne po rrimë këtu."

[25] Ai tha, "Zotëruesi im, unë mund ta komandoj vetëm veten dhe vëllanë tim. Pra, na lejo të ndahemi prej njerëzve shpirtligj."

[26] Ai tha, "Tash e tutje, është e ndaluar për ta për dyzet vjet, gjatë të cilave ata do të enden nëpër tokë. Mos u pikëllo për njerëz të tillë shpirtligj."

*Vrasja e parë**

[27] Recitoju atyre historinë e vërtetë të dy bijve të Ademit. Secili prej tyre bëri flijim, dhe u pranua nga njëri prej tyre, por jo nga tjetri. Ai tha, "Unë do të vras ty." Ai tha, "Zoti pranon vetëm prej të drejtëve.

[28] "Nëse ti e zgjatë dorën tënde për të më vrarë mua, unë nuk po e zgjas dorën time për të të vrarë ty. Se ia kam dronë Zotit, Zotëruesit të gjithësisë.

[29] "Unë dua që ti, e jo unë, të bartësh mëkatin tim dhe mëkatin tënd, pastaj ti do të përfundosh me banuesit e Ferrit. E tillë është paga për shkelësit."

[30] Egoja e tij e shtyu në vrasjen e vëllait të vet. E vrau, dhe përfundoi me dështakët.

[31] Zoti pastaj dërgoi një korb që ta gërricë dheun, për ta mësuar atë si ta varrosë kufomën e vëllait. Ai tha, "Mjerë unë; nuk arrita të jem aq inteligjent sa ky korb, dhe ta mbuloj kufomën e vëllait tim." E brejti ndërgjegjja.

Sa e keqe vrasja

[32] Për këtë arsye, ne shpallëm për Fëmijët e Izraelit që kushdo që vret ndonjë njeri që nuk ka kryer vrasje ose krime të tmerrshme, të jetë sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe kushdo që kursen një jetë, të jetë sikur të ketë kursyer jetët e të gjithë njerëzve. Të dërguarit tanë shkuan te ta me prova të qarta dhe shpallje, por shumica e tyre, pas gjithë kësaj, prapëseprapë janë duke shkelur.

Dënimi me vdekje: Kur është i arsyeshëm?

[33] Ndëshkimi i drejtë për ata që luftojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe kryejnë krime të tmerrshme, është të vriten, ose të kryqëzohen, ose tu priten duart dhe këmbët në anë të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo është për t'i poshtëruar në këtë jetë, e pastaj vuajnë ndëshkim shumë më të rëndë në Përjetësi.

[34] Me përjashtim të atyre që pendohen para se t'i zaptoni. Duhet ta dini se Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[35] O ju që besoni, t'ia keni dronë Zotit dhe të kërkonit rrugë për te Ai, dhe të përpiqeni për Atë, që t'ia dilni.

Çmimi i mosbesimit

* 5:27-31 Emrat e dy bijve të përfshirë në vrasje e parë nuk janë të rëndësishëm. Por ata jepen në Bibël si Abeli dhe Kaini (Zanafilla 4:2-9).

[36] Padyshim, ata që nuk besojnë, po të kishin gjithçka në tokë, madje dy herë më shumë, dhe ta ofronin si haraç për t'i kursyer nga ndëshkimi në Ditën e Ringjalljes, nuk do të pranohej prej tyre; kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[37] Do të duan të dalin nga Ferri, por jo, nuk mund të dalin kurrë nga aty; ndëshkohen përgjithmonë.

Drejtësia Kuranore mbështetet me provë matematikore

[38] Vjedhësit dhe vjedhëses, t'ua shënori duart* si ndëshkim për krimin e tyre, dhe për të shërbyer si shembull nga Zoti. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[39] Nëse dikush pendohet pas kryerjes së këtij krimi, dhe përmirësohet, Zoti e shpengon atë. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[40] A nuk e dini se Zoti posedon sovranitetin e qiejve dhe tokës? Ai ndëshkon këdo që vendos Ai, dhe falë kë do Ai. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[41] O ti i dërguar, mos u dëshpëro nga ata që nxitojnë të mos besojnë mes atyre që thonë, "Ne besojmë," me gojët e tyre, përderisa zemrat e tyre nuk besojnë. Mes Jahudive, disa i dëgjojnë rrenat. Ata i dëgjojnë njerëzit që nuk u takuan me ty, dhe që i shtrembëruan fjalët jashtë kontekstit, pastaj thanë, "Nëse ju jepet kjo, pranoni, por nëse ju jepet ndonjë gjë ndryshe, ruheni." Këdo që Zoti do që ta devijojë, nuk mund të bësh asgjë për ta ndihmuar kundër Zotit. Zoti nuk dëshiron t'i pastrojë zemrat e tyre. Ata kanë vetëshkaktuar poshtërim në këtë botë, dhe në Përrjetësi do të vuajnë një ndëshkim të tmerrshëm.

[42] Ata janë përkrahës të rrenave, dhe ngrënës të përfitimeve të paligjshme. Nëse vinë te ti për të gjykuar mes tyre, mund të gjykosh mes tyre, ose mund të mos i përfillësh. Nëse zgjedh të mos i përfillësh, nuk mund të të dëmtojnë aspak. Por nëse gjykon mes tyre, të gjykosh me barazi. Zoti i do ata që janë të drejtë.

[43] Pse të pyesin ata të gjykosh mes tyre, kur ata e kanë Torah, që përmban ligjin e Zotit, dhe ata zgjedhin ta shpërfillin? Nuk janë besimtarë.

Nderimi i shkrimeve paraprake

[44] Ne e kemi zbritur Torah, * që përmban udhëzim dhe dritë. Sundues në përputhje me të ishin profetët Jahudi, si dhe rabinët dhe priftërinjtë, siç u është diktuar në shkrimin e Zotit, dhe siç ishin dëshmitarë të saj. Prandaj, mos iu frikësoni qenieve njerëzore, por të më frikësoheni Mua. Dhe mos i shkëmbeni shpalljet e Mia për një çmim të vogël. Ata që sundojnë jo në përputhje me shpalljet e Zotit janë mosbesimtarët.

Ligj me barazi

[45] Dhe shpallëm për ta në të që: jeta për jetën, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, dhe një lëndim i barabartë për lëndimin. Nëse dikush falë çka ia kanë hak, si bamirësi, do të jetë larëse e mëkateve të tij. Ata që nuk sundojnë në përputhje me shpalljet e Zotit janë të padrejtë.

* 5:38 Zakoni i cungimit të dorës së vjedhësit, siç është shpallur nga Myslimanët e rrejshëm, është zakon djallëzor pa baza Kuranore. Për shkak të rëndësisë së veçantë të këtij shembulli, Zoti ka dhënë provë materiale në mbështetje të shënimit të dorës së vjedhësit, në vend të cungimit të saj. Strofa 12:31 përmend gratë që e admiran aq shumë Jozefin sa që "prenë" duart e tyre. Është e evidente se ato nuk i "cunguan" duart e tyre; askush nuk mundet. Shuma e numrave të sures dhe strofës është e njëjtë si për 5:38 ashtu edhe për 12:31, pra, 43. Është gjithashtu vullneti dhe mëshira e Zotit që kjo lidhje matematikore përputhet me kodin Kuranor të bazuar në 19. Nëntëmbëdhjetë strofa pas 12:31 e gjejmë fjalën e njëjtë (12:50).

* 5:44 Torah është grumbulli i të gjitha shkrimeve të shpallura nëpërmjet të gjithë profetëve të Izraelit para Jezu Krishtit, e që është Testamenti i Vjetër. Askund në Kuran nuk e gjejmë se Torah i është dhënë Moisiut.

Ungjilli i Jezusit: Udhëzim dhe dritë

[46] Në vazhdim pas tyre, dërguam Jezusin, të birin e Marisë, duke konfirmuar shkrimin paraprak, Torah. I dhamë Ungjillin, që përmban udhëzim dhe dritë, dhe konfirmon shkrimet paraprake, Torah, dhe shton udhëzimin dhe dritën e saj, dhe që të ndriçojë të drejtit.

[47] Njerëzit e Ungjillit le të sundojnë në përputhje me shpalljet e Zotit në të. Ata që nuk sundojnë në përputhje me shpalljet e Zotit janë shpirtligjtë.

Kurani: Shkrimi përfundimtar

[48] Pastaj ta shpallëm ty këtë shkrim, me të vërtetën, që konfirmon shkrimet paraprake, duke i mbizotëruar ato. Të sundosh mes tyre në përputhje me shpalljet e Zotit, dhe mos shko sipas dëshirave të tyre nëse dallojnë nga e vërteta që të erdh ty. Për secilin prej jush, ne kemi shpallur ligje dhe rite të ndryshme. Po të donte Zoti, Ai do t'ju bënte të ishit një asamble. Por Ai kështu ju vë në test nëpërmjet shpalljeve që Ai i ka dhënë secilit prej jush. Të garoni në drejtësi. Te Zoti është fati përfundimtar i të gjithë juve. Pastaj Ai do t'ju informojë për të gjitha gjërat që ishit grindur.

[49] Të sundosh mes tyre në përputhje me shpalljet e Zotit te ti. Mos shko pas dëshirave të tyre, dhe ruaju që të mos shmangin ty prej disa prej shpalljeve të Zotit te ti. Nëse ata refuzojnë, atëherë dije se Zoti dëshiron t'i ndëshkojë për disa prej mëkateve të tyre. Vërtetë, shumë njerëz janë shpirtligj.

[50] A janë ligjet e ditëve të paditurisë që ata kërkojnë për t'iu përmbajtur? Ligji i kujt është më i mirë se i Zotit për ata që kanë arritur të jenë të sigurt?

*Jahudi dhe të Krishterë të caktuar s'mund të jenë shokë**

[51] O ju që besoni, mos i bëni aleat Jahuditë dhe të Krishterët e caktuar; këta janë aleat të njëri tjetrit. Ata mes jush që iu bashkohen këtyre përkasin me ta. Zoti nuk i udhëzon shkelësit.

[52] Do i shihni ata që ushqejnë dyshime në zemrat e tyre duke nxituar t'iu bashkohen atyre, duke thënë, "Kemi frikë se mos po mundemi." Zoti mund të sjellë fitore, ose urdhër prej Tij, që i bën ata pishman për mendimet e tyre të fshehta.

[53] Besimtarët pastaj do të thonë, "A janë këta të njëjtit njerëz që solemnisht u betuan në Zotin se ishin me ju?" Punët e tyre janë asgjësuar, ata janë humbësit.

[54] O ju që besoni, nëse ia ktheni shpinën fesë suaj, atëherë Zoti do t'ju zëvendësoj me njerëz që Ai i do dhe që e duan. Ata do të jenë të dashur me besimtarët, të ashpër me mosbesimtarët, dhe do të përpiqen për Zotin pa frikë nga ndonjë fajësim. I tillë është bekimi i Zotit. Ai dhuron mbi këdo që Ai do. Zoti është Bujar, i Gjithëdijsëm.

[55] Aleatët tuaj të vërtetë janë Zoti dhe i dërguari i Tij, dhe besimtarët që i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe përkulen.

[56] Ata që i bashkohen Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe atyre që besojnë, i përkasin palës së Zotit; patjetër, ata janë fituesit.

Cilët Jahudi dhe të Krishterë

[57] O ju që besoni, mos i zini shokë ata mes pranuesve të shkrimit paraprak që përqeshin dhe tallin fenë tuaj, as të mos i zini shokë mosbesimtarët. T'ia keni dronë Zotit, nëse jeni vërtetë besimtarë.

Pranuesit e shkrimeve shkelin

* 5:51 Marrëdhëniet me njerëz tjerë rregullohen me rregullën themelore në 5:57 & 60:8-9. Jahuditë dhe të Krishterët që nuk mund të jenë shokë përmenden në veçanti në 5:57; ata janë ata që i përqeshin dhe tallin besimtarët, ose i sulmojnë.

[58] Kur bëni thirrjen për Lutje të Kontaktit (Salat), ata e përqeshin dhe e tallin. Kjo është për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

[59] Thuaj, “O njerëz të shkrimit, a nuk na urreni sepse besojmë në Zotin, dhe në çka na është shpallur, dhe në çka është shpallur para nesh, dhe sepse shumica e juve nuk jeni të drejtë?”

[60] Thuaj, “Më lejoni t’ju tregoj kush janë më të këqij para Zotit: ata që mallkohen nga Zoti pas vetëshkaktimit të zemërimit të Tij derisa Ai i bëri (të përbuzur aq sa) majmunët dhe derrat, dhe adhuresit e idhujve. Këta janë shumë më të këqij, dhe shumë më larg nga rruga e drejtë.”

[61] Kur ata vijnë te ti, thonë, “Ne besojmë,” edhe pse ata ishin plot me mosbesim kur hynë, dhe janë plot me mosbesim kur dalin. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat që i fshehin.

[62] I sheh shumë prej tyre duke kryer të këqija dhe shkelje me gatishtëri, dhe duke ngrënë nga përfitimet e paligjshme. E trishtueshme vërtetë është çka ata bëjnë.

[63] Vetëm sikur rabinët dhe priftërinjtë t’i ndalnin prej shprehjeve të tyre mëkatuese dhe përfitimeve të paligjshme! E trishtueshme vërtetë është çka ata kryejnë.

Blasfemojnë kundër Zotit

[64] Jahuditë madje thanë, “Zoti është dorështrënguar!” Janë duart e tyre që janë të shtrënguara. Ata janë të mallkuar për shprehjen e një blasfemie të tillë. Jo, duart e Tij janë të hapura, duke furnizuar si do Ai. Padyshim, shpalljet e Zotëruesit tënd te ti do i bëjnë shumë prej tyre të futen më thellë në shkelje dhe mosbesim. Si pasojë, i kemi parashtruar në armiqësi dhe urrejtje mes tyre deri në Ditën e Ringjalljes. Sa herë që i ndezin flakët e luftës, Zoti i shuan ato. Ata enden nëpër tokë keq, dhe Zotit nuk i pëlqejnë keqbërësit.

Shpëtim për Jahuditë dhe të Krishterët

[65] Vetëm sikur njerëzit e shkrimit të besonin dhe të çonin jetë të drejtë, atëherë ne do t’ua largojmë mëkatet e tyre, dhe t’i pranojmë në kopshte me hare.

Ata duhet të besojnë në këtë Kuran

[66] Vetëm sikur t’i përmbaheshin Torahs dhe Ungjillit, dhe çka u është zbritur këtu prej Zotëruesit të tyre, do tu derdreshin bekime nga sipër dhe nga poshtë këmbëve të tyre. Disa prej tyre janë të drejtë, por shumë prej tyre janë keqbërës.

I dërguari duhet të japë lajmet

[67] O ti i dërguar, komunikoje çka të është shpallur ty nga Zotëruesi yt – deri sa ta bësh, nuk e ke komunikuar lajmin e Tij – dhe Zoti do të mbrojë prej njerëzve. Zoti nuk i udhëzon njerëzit mosbesimtarë.

[68] Thuaj, "O njerëz të shkrimit, nuk jeni të bazuar në asgjë pa iu përmbajtur Torahs, dhe Ungjillit, dhe çka u është zbritur juve këtu prej Zotëruesit tuaj." Padyshim, këto shpallje prej Zotëruesit tënd do i bëjnë shumë prej tyre të futen më thellë në shkelje dhe mosbesim. Prandaj, mos të të vijë keq për njerëzit mosbesimtarë.

Kushtet minimale për shpëtim

[69] Padyshim, ata që besojnë, ata që janë Jahudi, të konvertuarit, dhe të Krishterët; cilido prej tyre që (1) beson në Zotin dhe (2) beson në Ditën e Fundit, dhe (3) çon jetë të drejtë, nuk ka pse të frikësohet, as nuk do brengoset.

[70] Kemi marrë besën prej Fëmijëve të Izraelit, dhe u kemi dërguar të dërguarë. Sa herë që ndonjë i dërguar u shkonte atyre me ndonjë gjë që nuk u pëlqente, disa prej tyre i refuzonin, dhe disa prej tyre i vritnin.

[71] Ata menduan se nuk do të testoheshin, kështu që u bënë të verbër dhe të shurdhër, pastaj

Zoti i shpengoi, por pastaj shumë prej tyre u bënë të verbër dhe të shurdhër përsëri. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëjnë.

*Krishterimi i sotshëm jo feja e Jezusit**

[72] Pagan vërtetë janë ata që thonë se Zot është Mesia, i biri i Marisë. Mesia vetë tha, “O Fëmijë të Izraelit, ta adhuroni Zotin; Zotëruesin tim dhe Zotëruesin tuaj.” Kushdo që ngritë ndonjë idhull përkrah Zotit, Zoti ia ka ndaluar Parajsën, dhe fati i tij është Ferri. Shpirtligjtë nuk kanë asnjë ndihmues.

[73] Paganë vërtetë janë ata që thonë se Zoti është i treti i trinisë. Nuk ka zot përveç një zoti. Në mos u ndalshin së thëni këtë, ata që nuk besojnë mes tyre do të pësojnë ndëshkim që dhemb.

[74] A nuk do të pendohen dhe të kërkojnë faljen e Zotit? Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[75] Mesia, i biri i Marisë, nuk është asgjë më shumë se si dërguar si të dërguarit para tij, dhe nëna e tij ishte shenjtëreshë. Të dy ata dikur hanin ushqim. Vëreni se si i shpjegojmë shpalljet për ta, dhe vëreni se si ata prapëseprapë devijojnë!

[76] Thuaj, “A do të adhuroni përkrah Zotit idhuj të pafuqi që as nuk mund t’ju dëmtojnë, as t’ju sjellin dobi? Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.”

Zgjedhi shokët me kujdes

[77] Thuaj, “O njerëz të shkrimit, mos i tejkaloni kufijtë e fesë suaj përtej së vërtetës, dhe mos i ndiqni mendimet e njerëzve që janë të humbur, dhe kanë çorientuar mori njerëzish; ata janë të humbur larg nga rruga e drejtë.”

[78] Të mallkuar janë ata që nuk besuan mes Fëmijëve të Izraelit, nga gjuha e Davidit dhe e Jezusit, të birit të Marisë. Kjo është për shkak se ata nuk dëgjuan, dhe shkelën.

Plogështia dënohet

[79] Ata nuk e ndalnin njëri tjetrin nga kryerja e të këqijave. Vërtetë e trishtueshme është çka ata bënë.

[80] Do i shihnit shumë prej tyre duke e bashkuar veten me ata që nuk besojnë. Vërtetë të trishtueshme janë veprat e tyre të kryera nga vetë ata. Zoti është i zemëruar me ta dhe, si pasojë, ata do të qëndrojnë përgjithmonë në ndëshkim.

[81] Po të besonin në Zotin, dhe profetin, dhe në çka i është shpallur atij këtu, nuk do të ishin shoqëruar me ta. Por shumë prej tyre janë të këqij.

Fakt

[82] Do të gjesh se armiqtë më të këqij të besimtarëve janë Jahuditë dhe adhuruesit e idhujve. Dhe do të gjesh se njerëzit më të afërt në shoqëri me besimtarët janë ata që thonë, “Ne jemi të Krishterë.” Kjo është për shkak se ata kanë priftërinj dhe murgj mes tyre, dhe nuk janë mendjemëdhenj.

[83] Kur dëgjojnë çka i është shpallur të dërguarit, i sheh sytë e tyre të vërshuar me lot përderisa e njohin të vërtetën aty, dhe thonë, “Zotëruesi ynë, kemi besuar, pra llogaritna mes dëshmitarëve.

[84] “Pse të mos besojmë në Zotin, dhe në të vërtetën që na ka ardhur, dhe të shpresojmë që

* 5:72-76 Në librin e Gjonit 20:17, shohim se Jezusi i mësonte se ai as nuk ishte Zoti, as i biri i Zotit. Shumë teolog kanë ardhur në përfundim, pas hulumtimeve me kujdes, se Krishterimi i sotshëm nuk është Krishterimi i njëjtë me atë që Jezusi ua mësonte. Dy libra të shquar për këtë temë janë “The Myth of God Incarnate” (Miti i Zotit të Mishëruar) (The Westminster Press, Philadelphia, 1977) dhe “The Mythmaker” (Mit-bërësi) (Harper & Row, New York, 1986). Në kopertinën e parë të “Mit-bërësit” lexojmë pohimin në vijim: “...Hyam Maccoby paraqet argumente të reja që mbështesin pikëpamjen se Pali, e jo Jezusi, ishte themeluesi i Krishterimit....ishte vetë Pali ai që krijoi një fe të re nëpërmjet vizionit të tij për Jezusin si Shpëtues hyjnor që vdiq për ta shpëtuar njerëzimin.”

Zotëruesi ynë të na pranojë me njerëzit e drejtë?”

[85] Zoti i ka shpërblyer se e thanë këtë; Ai do i pranojë në kopshte me proje që rrjedhin. Qëndrojnë aty përgjithmonë. I tillë është shpërblimi për të drejtë.

[86] Sa për ata që nuk besojnë dhe i refuzojnë shpalljet tona, ata janë banuesit e Ferrit.

Mos ddaloni gjëra të lejuara

[87] O ju që besoni, mos i ndaloni gjërat e mira që janë bërë të lejuara nga Zoti, dhe mos jini agresiv; Zotit nuk i pëlqejnë agresorët.

[88] Dhe hani prej gjërave të mira dhe të lejuara që Zoti ka furnizuar për ju. T’ia keni dronë Zotit, në të cilin besoni.

Mos e përmendni emrin e Zotit së koti

[89] Zoti nuk ju mbanë përgjegjës për të shprehurit e jashtëm të betimeve; Ai ju mbanë përgjegjës për qëllimet tuaja të vërteta. Nëse e shkelni një betim, ta lani fajin duke ushqyer dhjetë njerëz të varfër nga ushqimi i njëjtë që i ofroni familjes tuaj, ose duke i veshur, ose duke liruar një skllav. Nëse nuk keni mundësi, atëherë të agjëroni tre ditë. Kjo është larja e fajit për shkeljen e betimeve që jeni betuar t’i mbani. T’i përmbushni betimet tuaja. Zoti kështu u shpjegon juve shpalljet e tij, që të mund të jeni mirënjohës.

Dehësit dhe bixhozi ndalohen

[90] O ju që besoni, dehësit, dhe bixhozi, dhe altarët e idhujve, dhe lojërat e fatit janë fyerje të prodhuara nga djalli; t’ju shmangeni atyre, që t’ia dilni.

[91] Djalli dëshiron të nxisë armiqësi dhe urrejtje mes jush nëpërmjet dehësve dhe bixhozit, dhe t’ju heqë mendjen larg prej përkujtimit të Zotit, dhe prej zbatimit të Lutjeve të Kontaktit (Salat). A do e ndërprisni?

[92] T’i bindeni Zotit, dhe t’i bindeni të dërguarit, dhe ruajuni. Nëse refuzoni, atëherë dijeni se detyra e vetme e të dërguarit tonë është të japë lajmin me efikasitet.

[93] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë nuk kanë faj për ngrënien e ushqimit, përderisa i zbatojnë urdhrat, besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, pastaj mbajnë devotshmërinë dhe besimin, dhe vazhdojnë të jenë të devotshëm dhe të drejtë. Zoti i do të drejtë.

Ruajtja e kafshëve të egra

[94] O ju që besoni, Zoti do t’ju testojë me ca gjah të arritshëm për duart dhe shigjetat tuaja (gjatë shtegtimit tuaj). Zoti kështu i dallon ata mes jush që ia kanë dronë Atij kur janë vetë. Ata që shkelin pas kësaj kanë vetëshkaktuar një ndëshkim që dhemb.

[95] O ju që besoni, mos vrisni gjah gjatë shtegtimit tuaj. Kushdo që vret gjah me qëllim, gjoba e tij të jetë një numër i kafshëve shtëpiake i barabartë me kafshët e gjahut që vrau. Gjykimi të vendoset nga dy njerëz të drejtë mes jush. Ata duhet të sigurohen që flijimet arrijnë Qaben. Përndryshe, ai mund të shpaguhet duke ushqyer njerëz të varfër, ose me agjërim me barazi që të lajë fajin e kundërvajtjes. Zoti i ka falur kundërvajtjet e mëparshme. Por nëse dikush i kthehet një kundërvajtjeje të tillë, Zoti do të hakmerret për të. Zoti është i Plotfuqishëm, Hakmarrës.

Të gjitha krijesat e detit të lejuara për ngrënie

[96] Të gjithë peshqit e detit u janë bërë juve të lejueshëm për ngrënie. Gjatë shtegtimit, mund t’ju furnizojnë gjatë udhëtimit. Të mos gjuani gjah gjatë shtegtimit. T’ia keni dronë Zotit, para të cilit do të mblidheni.

[97] Zoti e ka caktuar Qaben, Vendlutjen e Shenjtë,* që të jetë strehimore për njerëzit, dhe

* 5:97 Myslimanët idhuj-adhures i kanë bërë zakon dy “Vendlutje të Shenjta” duke e shenjtëruar varrin e Profetit.

gjithashtu Muajt e Shenjtë, flijimet (te Vendlutja e Shenjtë), dhe qaforet shënjuese të tyre. Duhet ta dini se Zoti e din çdo gjë në qiej dhe tokë, dhe se Zoti është i Gjithëdijshëm.

[98] Ta dini se Zoti është i rreptë në zbatimin e ndëshkimit, dhe se Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[99] Detyra e vetme e të dërguarit është të japë lajmin, dhe Zoti e di çdo gjë që deklaroni dhe çdo gjë që fshihni.

[100] Shpall: “E keqja dhe e mira nuk janë të njëjta, edhe nëse bollëku i të keqes të lë mbresa. T’ia keni dronë Zotit, (edhe nëse jeni pakicë) o ju që posedoni inteligjencë, që t’ia dilni.”

[101] O ju që besoni, mos pyesni për çështje të cilat, nëse ju shpallen para kohe, do t’ju dëmtonin. Nëse pyesni për to në dritë të Kuranit, do t’ju bëhen të dukshme. Zoti me qëllim i ka tejkaluar. Zoti është Falës, i Butë.

[102] Të tjerë para jush kanë bërë të njëjtat pyetje, pastaj u bënë mosbesimtarë në të.

[103] Zoti nuk ndaloi bagëtinë që lindë kombinim të caktuar të meshkujve dhe femrave, as bagëtinë të liruar me be, as atë që lindë dy meshkuj rresht, as demin që ndërzen dhjetë herë. Janë mosbesimtarët ata që trilluan rrena të tilla në lidhje me Zotin. Shumica e tyre nuk kuptojnë.

Mos e ndiqni fenë e prindërve tuaj qorrazi

[104] Kur u thuhet atyre, “Ejani te çka Zoti ka shpallur, dhe te i dërguari,” ata thonë, “Atë që i gjetëm prindërit tanë duke bërë na mjafton.” Çka nëse prindërit e tyre nuk dinin asgjë, dhe nuk ishin të udhëzuar?

[105] O ju që besoni, ju duhet të kujdeseni vetëm për shpirtin tuaj. Nëse të tjerët humbin, ata nuk mund t’ju dëmtojnë, përderisa ju jeni të udhëzuar. Te Zoti është fati përfundimtar i të gjithë juve, pastaj Ai do t’ju informojë për çdo gjë që keni bërë.

Dëshmim testamenti

[106] O ju që besoni, dëshmimi i testamentit kur ndonjë prej jush është duke vdekur të bëhet nga dy njerëz të drejtë mes jush. Nëse jeni duke udhëtuar, atëherë dy të tjerë mund ta bëjnë dëshmimin. Pas zbatimit të Lutjes së Kontaktit (Salat), le të betohen dëshmuesit në Zotin, që të lehtësojnë dyshimet tuaja: “Ne nuk do të përdorim këtë për përfitime personale, edhe nëse testamentlënësi është i afërmi ynë. As nuk do të fshehim dëshminë e Zotit. Përndryshe, ne do të ishim mëkatarë.”

[107] Nëse dëshmuesit gjenden të jenë fajtor për njëanshmëri, atëherë të kërkohet nga dy të tjerë që të zënë vendin e tyre. Zgjidhni dy persona që ishin viktimë të dëshmitarëve të parë, dhe le të betohen në Zotin: “Dëshmia jonë është më e vërtetë se e tyre; ne nuk do të jemi të njëanshëm. Përndryshe, ne do të jemi shkelës.”

[108] Kjo është më premtuese për të inkurajuar dëshmi të sinqertë nga ana e tyre, nga frika se betimi i tyre mund të shpërfillet si ai i dëshmitarëve paraprak. T’ia keni dronë Zotit dhe të dëgjoni. Zoti nuk i udhëzon shpirtligjtë.

Të dërguarit e vdekur nuk janë në dijeni

[109] Do të vij dita kur Zoti do të mbledhë të dërguarit dhe t’i pyes, “Si ishte reagimi ndaj jush?” Ata do të thonë, “Ne nuk kemi njohuri. Ti je Njohësi i të gjitha të fshehtave.”

[110] Zoti do të thotë, “O Jezu, i biri i Marisë, përkujto bekimet e mia mbi ty dhe nënën tënde. Të përkraha me Frymën e Shenjtë, për të të mundësuar t’iu flasësh njerëzve që nga djepi, si dhe si i rritur. Të mësova shkrimin, mençuri, Torah, dhe Ungjillin. Kujto që krijove nga balta një formë zogu me lejen Time, pastaj fryve në të, dhe u bë zog i gjallë me lejen Time. I shërove të verbrit dhe

të lebrosurit me lejen Time, dhe ngjalle të vdekurit me lejen Time. Kujto që të mbrojta nga Fëmijët e Izraelit që donin të të lëndonin, përkundër mrekullive të qarta që iu kishe shfaqur. Mosbesimtarët mes tyre thanë, ‘Kjo është qartazi magji.’

[111] “Kujto që i frymëzova dishepujt: ‘Të besoni në Mua dhe të dërguarin Tim.’ Ata thanë, ‘Kemi besuar, dhe dëshmojmë se jemi të nënshtruar.’”

Banketi

[112] Kujto që dishepujt thanë, “O Jezu, i biri i Marisë, a mundet Zotëruesi yt të na zbresë një banket nga qielli?” Ai tha, “Duhet t’ia keni dronë Zotit, nëse jeni besimtarë.”

[113] Ata thanë, “Dëshirojmë që të hamë prej tij, dhe të bindim zemrat tona, dhe të dimë sigurt se na ke thënë të vërtetën. Do të shërbejmë si dëshmitarë të tij.”

Mrekullitë më të mëdha sjellin përgjegjësi më të madhe

[114] Tha Jezusi, i biri i Marisë, “zoti ynë, Zotëruesi ynë, zbritna një banket nga qielli. Le të sjellë me bollëk për secilin, prej të parit deri të fundit, dhe një shenjë prej Teje. Furnizona; Ti je Furnizuesi më i mirë.”

[115] Zoti tha, “Po e zbres. Cilido prej jush që nuk beson pas kësaj, do e ndëshkoj si nuk e kam ndëshkuar askënd tjetër.”*

Në Ditën e Ringjalljes

[116] Zoti do të thotë, “O Jezu, i biri i Marisë,* a iu the njerëzve, ‘Më bëni mua dhe nënën time idhuj përkrah Zotit?’” Ai do të thotë, “Qofsh i madhëruar. Nuk do të mundja të shprehë çka nuk është e drejtë. Po të kisha thënë atë, atëherë Ti do e kishe ditur. Ti i di mendimet e mija, dhe unë nuk i di mendimet Tua. Ti i di të gjitha fshehtësitë.”

[117] “Unë u thashë atyre vetëm çka më ke urdhëruar të them, që: ‘Ta adhuroni Zotin, Zotëruesin tim dhe Zotëruesin tuaj.’ Isha dëshmitar mes tyre deri sa jetova me ta. Kur ma përfundove jetën në tokë, Ti u bërë Ruajtës i tyre. Ti je dëshmitar i të gjitha gjërave.”

[118] “Nëse i ndëshkon, ata të takojnë Ty. Nëse i falë, Ti je i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.”

[119] Zoti do të shpallë, “Kjo është një ditë kur të çiltrit do të shpëtohen nga çiltërsia e tyre.” Ata kanë merituar kopshte me prroje që rrjedhin. Qëndrojnë aty përgjithmonë. Zoti është i kënaqur me ta, dhe ata janë të kënaqur me Të. Ky është më i madhi triumf.

[120] I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës, dhe gjithçka në to, dhe Ai është i Gjithëfuqishëm.

Surja 6: Bagëtia (El-En'am)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] I lartmadhëruar qoftë Zoti, i cili krijoi qiejt dhe tokën, dhe bëri errësirën dhe dritën. Prapëseprapë, ata që nuk besojnë në Zotëruesin e tyre vazhdojnë të devijojnë.

[2] Ai është Ai që ju krijoi juve prej balte, pastaj paracaktoi jetëgjatësinë tuaj, jetëgjatësi e cila është e ditur vetëm te Ai. Prapëseprapë, vazhdoni të dyshoni.

[3] Ai është ai Zoti në qiej dhe tokë. Ai i di të fshehtat tuaja dhe deklarimet tuaja, dhe Ai di çdo gjë që mblidhni.

[4] Pa marrë parasysh çfarë lloji i provës u vjen atyre nga Zotëruesi i tyre, ata ia kthejnë shpinën

* 5:114-115 Mrekullia e jashtëzakonshme e Kuranit (Shtojca Një) përshkruhet në 74:35 si “Njëra prej mrekullive më të mëdha,” dhe sjell me vete përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe.

* 5:116 Ia vlen të përmendet se Kurani vazhdimisht e thërret Jezusin “i biri i Marisë” dhe Bibla e thërret “i biri i njeriut”. Zoti e dinte se disa do të blasfemonin dhe ta thërrisnin “i biri i Zotit”!

asaj, me neveri.

[5] Pasi që e refuzuan të vërtetën kur u erdhi atyre, kanë vetëshkaktuar pasojat e moskujdesit të tyre.

[6] A nuk e kanë parë se si shumë gjenerata para tyre i kemi asgjësuar? I vumë ata në tokë më fort se ju, dhe u derdhëm atyre bekime me bollëk, dhe i furnizuam me prroje që rrjedhin. Pastaj i asgjësuaam për shkak të mëkateve të tyre, dhe në vend të tyre sollëm gjeneratë tjetër.

[7] Edhe sikur të zbritnim te ta libër material, të shkruar në letër, dhe ata ta preknin me duart e tyre, ata që nuk besuan do të kishin thënë, “Kjo është qartazi magji e shkathët.”

[8] Ata gjithashtu thanë, “Vetëm sikur një engjëll të mund të zbriste me të!” Sikur ta dërgonim një engjëll, e tërë çështja do të ishte përfunduar, dhe atyre nuk do tu shtyhej afati më.

Kushtet e testit

[9] Sikur ta dërgonim një engjëll, do e kishim dërguar në formë njeriu, dhe do i kishim mbajtur po aq të hutuar sa janë të hutuar tani.

[10] Të dërguarë para teje janë përqeshur. Ata që talleshin me ta vuajtën pasojat e përqeshjes.

[11] Thuaj, “Enduni nëpër tokë dhe vëreni pasojat për refuzuesit.”

[12] Thuaj, “E kujt është çdo gjë në qiej dhe tokë?” Thuaj, “E Zotit.” Ai ka shpallur që mëshira është vetia e Tij. Ai padyshim do ju mbledhë të gjithëve në Ditën e Ringjalljes, që është e pashmangshme. Ata që humbin shpirtrat e tyre janë ata që nuk besojnë.

[13] E Tij është çdo gjë që rron natën dhe ditën. Ai është Dëgjuesi, Njohësi.

[14] Thuaj, “A të pranoj pos Zotit si Zotërues dhe Sundues, kur Ai është Nismëtari i qiejve dhe tokës, dhe Ai ushqen por nuk ushqehet?” Thuaj, “Jam urdhëruar të jem i nënshtruar më i devotshëm, dhe të mos jem adhurues idhujsh.”

[15] Thuaj, “I frikësohem ndëshkimit të një dite tmerruese, nëse nuk i bindem Zotëruesit tim.

[16] “Kushdo që kursehet (nga ndëshkimi), atë ditë, ka arritur mëshirën e Tij. Dhe ky është triumfi më i madh.”

Vetëm Zoti e ka në dorë lumturinë

[17] Nëse Zoti ju prekë me fatkeqësi, askush nuk mund t’ju lirojë prej saj përveç Tij. Dhe nëse Ai ju prekë me bekime, Ai është i Gjithëfuqishëm.

[18] Ai është Suprem mbi krijesat e Tij. Ai është Më i Mençuri, Njohësi.

Kuranin, tërë Kurani, dhe asgjë përveç Kuranit

[19] Thuaj, “Dëshmia e kujt është më e madhja?” Thuaj, “E Zotit. Ai është dëshmitar mes meje e teje se ky Kuran* më është frymëzuar mua, që t’jua predikoj juve dhe kujt do që i arrin. Vërtetë, ju dëshmoni se ka zota tjerë përkrah Zotit.” Thuaj, “Unë nuk dëshmoj si ju; është vetëm një zot, dhe unë mohoj idhujtarinë tuaj.”

[20] Atyre të cilëve u kemi dhënë shkrimin e njohin këtë siç i njohin fëmijët e vet. Ata që humbin shpirtrat e tyre janë ata që nuk besojnë.

[21] Kush është më i keq se dikush që gënjen në lidhje me Zotin, ose i refuzon shpalljet e tij? Shkelësit nuk kanë sukses.

Adhuresit e idhujve mohojnë idhujtarinë e tyre

[22] Në ditën kur t’i mbledhim të gjithë ata, do i pyesim adhuresit e idhujve, “Ku janë idhujt që i ngritnit?”

* 6:19 Kjo strofë shpallë Kuranin si të vetmin burim të udhëzimit fetar. Ata që përkrahin burime shtesë, si Hadithin & Sunet (rrena të mvëshura Profetit), definojnë si idhujtarë.

[23] Përgjigjja e tyre shkatërruese do jetë, “Pasha Zotin Zotëruesin tonë, ne nuk ishim adhures idhujsh.”*

[24] Vëreni se si e mashtruan vetveten, dhe si idhujt që i kishin trilluar i kanë braktisur.

[25] Disa prej tyre të vënë veshin ty, por ne vendosim mbulesa mbi zemrat e tyre për t’i parandaluar të kuptojnë, dhe shurdhim në veshët e tyre. Pra, pa marrë parasysh çfarë lloj prove shohin, nuk mund të besojnë. Pra, kur vinë të grinden me ju, mosbesimtarët thonë, “Këto janë përralla të moçme.”

[26] I kthejnë prapa tjerët nga ky (Kuran), ashtu si rrinë vetë larg prej tij, dhe kështu vetëm e shkatërrojnë vetveten pa e kuptuar.

[27] Vetëm sikur t’i shihje kur ballafaqohen me zjarrin! Atëherë do të thonë, “Mallkuar qofshim. Ah, sikur të mund të ktheheshim prapa, dhe të mos i refuzojmë shpalljet e Zotëruesit tonë, dhe t’iu bashkohemi besimtarëve.”

[28] Në fakt, (ata vetëm e thonë këtë sepse) fshehtësitë e tyre u nxorën në shesh. Nëse kthehen, do të kryejnë saktësisht të njëjtat krime* se janë gënjeshtarë.

[29] Thoshin, “Jetojmë vetëm këtë jetë; nuk do ringjallemi.”

[30] Vetëm sikur t’i shihje ata kur qëndrojnë para Zotëruesit të tyre! Ai u thotë, “A nuk është kjo e vërteta?” Ata do të thonë, “Po, për Zotëruesin tonë.” Ai u thotë, “Me mosbesimin tuaj keni vetëshkaktuar ndëshkim.”

[31] Humbës vërtetë janë ata që nuk besojnë se do e takojnë Zotin, derisa Ora u vjen atyre papritmas, pastaj thonë, “I biem shumë pishman që e shpërfillëm.” Ata do të bartin barra të mëkateve të tyre në shpinat e tyre; çfarë barre e keqe!

Ri-rregullimi i prioriteteve tona

[32] Jeta e kësaj bote nuk është asgjë më shumë se një iluzion dhe kotësi, përderisa vendbanimi i Përjetësisë është shumë më i mirë për të drejtin. A nuk kuptoni?!

[33] E dimë se mund të dëshpërohesh nga çka ata thonë. Ta dish se nuk je ti ai që e refuzojnë; janë shpalljet e Zotit që shpirtligjtë i shpërfillin.

[34] Të dërguarë para teje janë refuzuar, dhe duruan me këmbëngulje përballë refuzimit. U keqtrajtuat derisa fitorja jonë u erdhi atyre. I tillë është sistemi i Zotit që nuk do të ndryshojë. Kështu historia e të dërguarve të Mi vë precedentë për ty.

[35] Nëse refuzimi i tyre fillon të jetë shumë për ty, ta dish se edhe nëse mih një tunel në tokë, ose ngjitesh me shkallë në qiell, dhe prodhon një mrekulli për ta (ata prapëseprapë nuk do të besonin). Sikur të donte Zoti, do të kishte mundur t’i udhëzojë, unanimisht. Prandaj, mos u sill si të padijshmit.

[36] Të vetmit që i përgjigjen thirrjes janë ata që dëgjojnë. Zoti i ringjall të vdekurit; përfundimisht kthehen te Ai.

[37] Ata thanë, “Vetëm sikur një shenjë e caktuar të mund t’i zbriste atij nga Zotëruesi i tij!” Thuaj, “Zoti është i aftë të zbresë një shenjë, por shumica e tyre nuk dinë.”

*Kafshët dhe shpezët: Krijesa të nënshtruara**

* 6:23 Tani dhe përgjithmonë, adhuresit e idhujve e mohojnë me furi se janë idhujtarë.

* 6:28 Është kështu sepse sapo të hyjmë në dimensionin e kësaj bote, ne bëhemi plotësisht të pavetëdijshëm për ngjarjet në dimensionin e shpirtave, ku Zoti dhe engjëjt e Tij, dhe Paraja dhe Ferri, mund të shihen. Kështu, fajtorët nuk do i ndryshojnë sjelljet e tyre, edhe pasi ta shohin atë dimensionin e përhershëm.

* 6:38 Kafshët ishin mes krijesave që shfrytëzuan rastin dhe përfituan nga oferta e Zotit për tu penduar pas kryerjes së mëkatit fillestarë (shih Hyrjen).

[38] Të gjitha krijesat në tokë, dhe të gjithë zogjtë që fluturojnë me krahë, janë shoqëri si ju. Nuk lam asgjë jashtë këtij libri.* Te Zotëruesi i tyre, të gjitha këto krijesa do të mblidhen.

Mrekulli e jashtëzakonshme e Kuranit

[39] Ata që refuzojnë provat tona janë të shurdhër dhe memecë, në errësirë të plotë. Këdo që Zoti vendos, e dërgon në humbje, dhe këdo që do, e çon në rrugë të drejtë.

[40] Thuaj, “Po sikur ndëshkimi i Zotit t’ju vinte, ose Ora t’ju vinte: a do i luteshit dikujt pos Zotit, nëse jeni të sinqertë?”

[41] Jo. Vetëm Atij do i luteshit, dhe Ai i përgjigjet lutjes suaj, nëse Ai do, dhe i harroni idhujt tuaj.

[42] Kemi dërguar (të dërguarë) te shoqëritë para teje, dhe i vumë në test nëpërmjet fatkeqësive dhe vështirësive, që të mund të përgjërohen.

[43] Vetëm sikur të përgjëroheshin kur testi ynë u erdh atyre! Në vend të kësaj, zemrat e tyre u ngurtësuan, dhe djalli ua zbukuroi punët e tyre para syve të tyre.

*Metoda**

[44] Kur ata pra e shpërfillin lajmin që u është dhënë, hapim për ta portat e çdo gjëje. Pastaj, tamam kur dëfrehen me çka u është dhënë, i ndëshkojmë papritmas; bëhen kryekëput të shtangur.

[45] Shpirtligjtë kështu asgjësohen. I lartmadhëruar qoftë Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.

Vetëm Zoti ia vlen të adhurohet

[46] Thuaj, “Çka nëse Zoti jua merr të dëgjuarit dhe të pamit, dhe jua mbyll mendjet; cili zot, përveç Zotit, mund t’jua kthejë këto?” Vëreni se si i shpjegojmë shpalljet, dhe vëreni se si prapëseprapë devijojnë!

[47] Thuaj, “Çka nëse ndëshkimi i Zotit ju vjen papritmas, ose pas një lajmërimi, a nuk janë shpirtligjtë vetëshkaktues të asgjësimit?”

Roli i të dërguarve

[48] Nuk i dërgojmë të dërguarit përveç si dërgues të lajmeve të mira, si dhe si paralajmërues. Ata që besojnë dhe përmirësohen nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen.

[49] Sa për ata që i refuzojnë shpalljet tona, e vetëshkaktajnë ndëshkimin me shpirtligësinë e tyre.

[50] Thuaj, “Unë nuk po ju them se i posedoj thesaret e Zotit. As nuk e di të ardhmen. As nuk ju them se jam engjëll. Unë thjeshtë e ndjekë atë që më është shpallur.” Thuaj, “A është i verbëri i njëjtë si parësi? A nuk pasqyrojnë?”

[51] Dhe u prediko me këtë (Kuran) atyre që ia kanë dronë mbledhjes para Zotëruesit të tyre – ata nuk kanë asnjë përveç Tij si Zotërues dhe Sundues, as ndërmjetësues – që të mund të arrijnë shpëtim.

[52] Dhe mos i përzë ata që i luten Zotëruesit të tyre ditë e natë, duke ia kushtuar veten vetëm Atij. Ti nuk je përgjegjës për llogaridhënien e tyre, as ata nuk janë përgjegjës për llogaridhënien tënde. Nëse i përzë, do të jesh shkelës.

[53] Kështu pra i testojmë njerëzit me njëri tjetrin, që t’i lëmë të thonë (me tallje), “A janë këta njerëzit mes nesh që janë të bekuar nga Zoti?” A nuk është Zoti i vetëdijshëm për mirënjohësit?

[54] Kur ata që besojnë në shpalljet tona vijnë te ti, të thuash, “Selamun Alejkum (Paqja qoftë me ju). Zotëruesi juaj ka shpallur se mëshira është veti e Tij. Pra, kushdo mes jush që kryen një shkelje

* 6:38 Të gjitha informatat relevante për jetën tonë të përjetshme janë të përfshira në Kuran. Besimtarët e vërtetë e pranojnë, pa hezitim, pohimin e Zotit: “Nuk lam asgjë jashtë këtij libri.” Rëndësia e këtij pohimi, dhe pohimeve të ngjashme, pasqyrohet në faktin se secila prej tyre përmban 19 shkronja arabe (Shtojca 19).

* 6:44 Para se të hidhen fajtorët prej dritares, ata dërgohen te një kat i lartë.

nga padituria, dhe pastaj pendohet dhe përmirësohet, pastaj Ai është Falës, i Mëshirshmi.”

[55] Kështu i shpjegojmë shpalljet, dhe i nxjerrim në pah rrugët e shpirtligjve.

[56] Thuaj, “Më është ndaluar adhurimi i asaj që adhuron përveç Zotit.” Thuaj, “Unë nuk do i ndjek mendimet tuaja. Përndryshe, do të humbë, dhe nuk do udhëzohem.”

[57] Thuaj, “Kam provë të sigurt nga Zotëruesi im, dhe ju e keni refuzuar. Unë nuk e kam në dorë ndëshkimin që më sfidoni ta sjell. Gjykimi i takon vetëm Zotit. Ai tregon të vërtetën, dhe Ai është gjykatësi më i mirë.”

[58] Thuaj, “Sikur ta kisha në dorë ndëshkimin që më sfidoni ta sjell, e tërë çështja do të kishte përfunduar qysh moti. Zoti di më së miri kush janë shpirtligjtë.”

I plotfuqishmi Zot

[59] Me të janë çelësat e të gjitha fshehtësive; askush nuk i din përveç Tij. Ai di çdo gjë në tokë dhe në det. Asnjë gjeth nuk bie pa dijeninë e Tij. As nuk gjendet ndonjë kokërr gruri në thellësi të dheut. As nuk gjendet ndonjë gjë e lagët apo e thatë, që nuk është e regjistruar në një regjistër të qartë.

*Vdekje dhe ringjallje: Çdo ditë**

[60] Ai është Ai që ju vë në vdekje gjatë natës, dhe e di madje edhe veprën tuaj më të vogël gjatë ditës. Ai ju ringjallë çdo mëngjes, derisa të përmbushet afati i jetës suaj, pastaj te Ai është kthimi juaj përfundimtar. Ai pastaj do ju njoftojë për çdo gjë që kishit bërë.

[61] Ai është Suprem mbi krijesat e Tij, dhe cakton roje për t’ju mbrojtur. Kur koha e paracaktuar e vdekjes vjen te cilido prej jush, të dërguarit tonë e vënë në vdekje pa vonesë.

[62] Pastaj të gjithë kthehen te Zoti, Zotëruesi dhe Sunduesi i tyre i drejtë. Ai është gjyqtari absolut; Ai është llogaritësi më i saktë.

[63] Thuaj, “Kush mund t’ju shpëtojë nga errësira e tokës ose detit?” I luteni Atij me zë dhe në të fshehtë: “Nëse na shpëton këtë herë, ne do të jemi mirënjohës përgjithmonë.”

[64] Thuaj, “Zoti ju shpëton këtë herë, si dhe tjera herë, pastaj prapëseprapë ju ngritni idhuj përveç Tij.”

[65] Thuaj, “Ai mund të derdhë mbi ju ndëshkim nga lart, ose nga poshtë këmbëve tuaja. Ose Ai mund t’ju ndajë në fraksione dhe t’ju bëjë të shijoni tiraninë e njëri tjetrit. Vëreni se si i shpjegojmë shpalljet, që të mund të kuptojnë.”

[66] Njerëzit e tu e kanë refuzuar këtë, edhe pse është e vërteta. Thuaj, “Unë nuk jam kujdestar mbi ju.”

[67] Çdo profecie këtu i vjen koha, dhe padyshim do e merrni vesh.

Respekt për fjalën e Zotit

[68] Nëse i sheh ata që përqeshin shpalljet tona, t’iu shmangesh atyre derisa të futen në një temë tjetër. Nëse djalli të bën të harrosh, pastaj, sapo të kujtohesh, mos u ul me njerëz të tillë të këqij.

[69] Të drejtit nuk janë përgjegjës për shprehjet e atyre njerëzve, por mund të ndihmojë t’ua kujtosh; ndoshta shpëtohen.

[70] Të mos i përfillësh ata që e marrin fenë e tyre si të kotë, sikur të ishte punë shoqërimi, dhe janë plotësisht të zhytur në jetën e kësaj bote. Ua përkujto me këtë (Kuran), se mos ndonjë shpirt vuan pasojat e veprave të veta të këqija. Ai nuk ka përkrah Zotit si Zotëruesi dhe Sundues, as

* 6:60 Të drejtit nuk vdesin vërtetë; ata shkojnë drejtë e në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva jetuan dikur. Të padrejtët vdesin dhe përjetojnë ankth që zgjatë deri në Ditën e Ringjalljes (shih 2:154, 3:169, 8:24, 16:32, 22:58, 36:26-27, 40:46, 44:56, dhe Shtojcën 17).

ndërmjetësues. Sikur të mund të ofronte çfarëdo lloj haraçi, nuk do të pranohej. Ata vuajnë pasojat e punëve të këqija që mblodhën; kanë vetëshkaktuar pije ferri, dhe një ndëshkim që dhemb sepse nuk besuan.

[71] Thuaj, “A t’i lutemi, përkrah Zotit, çka nuk posedon aspak fuqi të na sjellë dobi as të na dëmtojë, dhe të kthehemi prapa pasi Zoti na ka udhëzuar? Në atë rast, ne do iu bashkëngjiteshim atyre të pushtuarve nga djajtë, dhe të shndërruarve në të çoroditur tërësisht, përderisa shokët e tyre mundohen t’i shpëtojnë: ‘Rrini me ne në rrugën e drejtë.’” Thuaj, “Udhëzimi i Zotit është udhëzimi i drejtë. Ne jemi të urdhëruar t’i nënshtrohemi Zotëruesit të gjithësisë.

[72] “Dhe të zbatojmë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe t’ia kemi dronë Atij – Ai është Ai para të cilit do të mblidheni (për llogaridhënie).”

[73] Ai është që krijoi qiejt dhe tokën, me qëllim. Kurdo që Ai thotë, “Ji,” është. Fjala e tij është e vërteta absolute. I gjithë sovraniteti është i Tij ditën kur i bihet bririt. Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe të hapëtave, Ai është Më i Mençuri, Njohësi.

Ibrahimi debaton me adhuruesit e idhujve

[74] Kujtohu që Ibrahim i tha babait të vet Azerit, “Si mundesh të adhurosh statuja si zota? E shoh se ti dhe njerëzit e tu kanë shkuar larg në humbje.”

[75] Ne i treguam Ibrahimit çuditë e qiejve dhe tokës, dhe e bekuam me bindje të plotë:

[76] Kur ra nata, ai pa një planet të ndritshëm. “Ndoshta ky është Zotëruesi im,” tha ai. Kur u zhduk, tha, “Mua nuk më pëlqejnë (zotat) që zhduken.”

[77] Kur e pa hënë duke lindur, tha, “Ndoshta kjo është Zotëruesi im!” Kur u zhduk, tha, “Në mos më udhëzoftë Zotëruesi im, do të jem me të humburit.”

[78] Kur e pa diellin duke lindur, tha, “Ky duhet të jetë Zotëruesi im. Ky është më i madhi.” Por kur perëndoi, tha, “O njerëzit e mi, unë e refuzoj idhujtarinë tuaj.

[79] “Unë ia kam kushtuar veten absolutisht Atij që e filloi qiellin dhe tokën; Unë nuk do të jem adhurues idhujsh.”

[80] Njerëzit e tij u grindën me të. Ai tha, “A grindeni me mua në lidhje me Zotin, pasi që Ai më ka udhëzuar? Unë nuk kam frikë nga idhujt që i ngritni. Asgjë nuk mund të më ndodhë, në mos dashtë Zotëruesi im. Dituria e Zotëruesit tim përfshinë të gjitha gjërat. A nuk jeni të vëmendshëm?”

[81] “Pse të kem frikë nga idhujt tuaj? Ju jeni ata që duhet të keni frikë, pasi që ju adhuroni në vend të Zotit idhujt që janë krejtësisht të pafuqi t’ju ndihmojnë. Cila palë është më meritore e sigurisë, nëse dini?”

Siguri e përsosur për besimtarët

[82] Ata që besojnë, dhe nuk e ndotin besimin e tyre me adhurim idhujsh, kanë merituar sigurinë e përsosur, dhe janë vërtetë të udhëzuar.

[83] I tillë ishte argumenti ynë, me të cilin e përkrahëm Ibrahimin kundër njerëzve të tij. Ne lartësojmë këdo që dëshirojmë në rangje më të larta. Zotëruesi yt është Më i Mençuri, i Gjithëdijshmi.

[84] Dhe ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakobin, dhe i udhëzuam të dy. Ngjashëm, ne e udhëzuam Nuhun para tyre, dhe prej pasardhësve të tij (udhëzuam) Davidin, Salomonin, Jobin, Jozefin, Moisiun, dhe Aronin. Kështu i shpërblejmë të drejtë.

[85] Gjithashtu, Zekerian, Gjonin, Jezusin, dhe Iljazin; të gjithë ishin të drejtë.

[86] Dhe Ismailin, Eliseun, Jonan, dhe Lutin; secilin prej tyre e dalluam mbi të gjithë njerëzit.

[87] Nga paraardhësit e tyre, pasardhësit e tyre, dhe vëllezërit e tyre, ne zgjodhëm shumë, dhe i

udhëzuan në rrugë të drejtë.

[88] I tillë është udhëzimi i Zotit, me të cilin Ai udhëzon këdo që Ai zgjedh prej shërbëtorëve të Tij. Po të kishin rënë cilido prej tyre në idhujtari punët e tyre do të ishin asgjësuar.

[89] Ata ishin ata që u dhamë shkrimin, mençuri, dhe profetllëk. Nëse këta njerëz nuk besojnë, do i zëvendësojmë me të tjerë, dhe njerëzit e ri nuk do të jenë mosbesimtarë.

[90] Këta janë ata që u udhëzuan nga Zoti; të udhëzohesh pas tyre. Thuaj, “Unë nuk po ju kërkoj pagë. Ky nuk është tjetër pos një lajm për të gjithë njerëzit.”

Lajmet e Zotit për botën

[91] Ata nuk e vlerësuan Zotin siç duhet vlerësuar. Kështu, ata thanë, “Zoti nuk i shpallë asgjë asnjë njeriu.” Thuaj, “Kush pra e shpalli shkrimin që solli Moisiu, me dritë dhe udhëzim për njerëzit?” Ju e shënuat në letër për ta deklaruar, përderisa e fshehët një pjesë të madhe të tij. Jeni mësuar çfarë nuk ditët kurrë më parë – ju dhe prindërit tuaj. Thuaj “Zoti (është Ai që e shpalli),” dhe lëri të luajnë në moskujdesin e tyre.

[92] Ky gjithashtu është shkrim i bekuar, që konfirmon shkrimet paraprake, që të mund të paralajmëroni shoqërinë më të rëndësishme* dhe të gjitha ato rreth saj. Ata që besojnë në Përjetësinë do të besojnë në këtë (shkrim), dhe do i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat).

Të dërguarit e rremë të mallkuar

[93] Kush është më i keq se ai që trillon rrena dhe ia mvëshë Zotit, ose thotë, “Kam pranuar frymëzim hyjnor,” kur asnjë frymëzim i tillë nuk i është dhënë, ose thotë, “Unë mund të shkruaj njëjtë si shpalljet e Zotit?” Vetëm sikur t’i shihnit shkelësit në kohën e vdekjes! Engjëjt i zgjasin duart drejt tyre, duke thënë, “Lëshojini shpirtat tuaj. Sot, keni vetëshkaktuar ndëshkim të turpshëm se thatë në lidhje me Zotin tjetër pos të vërtetës, dhe se ishit shumë mendjemëdhenj që t’i pranoni shpalljet e Tij.

[94] “Jeni kthyer te ne si individë, ashtu si ju krijuam së pari, dhe keni lënë prapa çfarë ju furnizua. Nuk i shohim me ju ndërmjetësuesit që idhujtarizonit dhe pretendonit se do ju ndihmojnë. Të gjitha lidhjet mes jush janë këputur; idhujt që i ngritët ju kanë braktisur.”

Madhështia e Zotit

[95] Zoti është Ai që i bën drithërat dhe farat të plasin dhe mbijnë. Ai e prodhon të gjallin nga i vdekuri, dhe të vdekurin nga i gjalli. I tillë është Zoti; si mund të devijoni!

[96] Në shpërthim të agimit, Ai e bën mëngjesin të dalë. Ai e bëri natën të qetë, dhe Ai e bëri diellin dhe hënën për të shërbyer si mjete për llogaritje. I tillë është dizajni i të Plotfuqishmit, të Gjithëdijshmit.

[97] Dhe Ai është që i bëri yjet të ju udhëzojnë gjatë errësirës, në tokë dhe det. Kështu pra i sqarojmë shpalljet për njerëzit që dinë.

[98] Ai ju nisi nga një vetë, dhe e vendosi rrugën tuaj, si dhe fatin tuaj përfundimtar. Kështu pra i sqarojmë shpalljet për njerëzit që kuptojnë.

[99] Ai është Ai që zbret ujë nga qielli, me të cilin prodhojmë lloj lloj bimësh. Ne prodhojmë nga lënda e blertë mori drithërash komplekse, palma me kalaveshë të varur, dhe kopshte me hardhi, ullinj dhe shegë; fruta që janë të ngjashëm, por jo edhe të ngjashëm. Vëreni frutat e tyre se si rriten dhe pihen. Këto janë shenja për njerëzit që besojnë.

* 6:92 “Shoqëria më e rëndësishme” e tanishme është shoqëria e internetit. Gjatë kohës së Rashad Khalifës, shoqëria më e rëndësishme ishte Amerika, ku lajmi i Zotit u riparua. Kur Kurani u shpall, Meka ishte shoqëria më e rëndësishme.

[100] Prapëseprapë, ata ngritin nga xhinët idhuj përkrah Zotit, edhe pse Ai është Ai që i krijoi ata. Ata madje i mveshin Atij djem dhe vajza, pa aspak dijeni. Qoftë i madhëruar. Ai është Më i Larti, shumë larg pretendimeve të tyre.

[101] Nismëtari i qiejve dhe tokës. Si mund të ketë Ai djalë, kur Ai kurrë nuk pati bashkëshorte? Ai i krijoi të gjitha gjërat, dhe Ai është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Zoti

[102] I tillë është Zoti, Zotëruesi juaj, nuk ka zot përveç Tij, Krijuesit të të gjitha gjërave. Ta adhuroni vetëm Atë. Ai e ka në dorë çdo gjë.

[103] Asnjë përfytyrim nuk mund ta përfshijë Atë, por Ai i përfshinë të gjitha përfytyrimet. Ai është i Dhembshuri, Njohësi.

[104] Ndrichime ju kanë ardhur nga Zotëruesi juaj. Sa për ata që mund të shohin, ata shohin për të mirën e tyre, e ata që bëhen qorra, bëhen në dëm të vetes. Unë nuk jam kujdestari juaj.

[105] Kështu i shpjegojmë shpalljet, për të vërtetuar se ke pranuar dituri, dhe për t'i sqaruar për njerëzit që dinë.

[106] Ndiq çka tu shpall nga Zotëruesi yt, nuk ka zot përveç Tij, dhe shpërfilli adhuresit e idhujve.

[107] Sikur të donte Zoti, ata nuk do të kishin adhuroar idhuj. Ne nuk të caktuam si kujdestar të tyre, as nuk je mbrojtësi i tyre.

[108] Mos i shani idhujt që ata i ngritin përkrah Zotit, se mos blasfemojnë dhe e shajnë Zotin, nga padituria. Ne i kemi zbkuruar punët e secilit grup para syve të tyre. Përfundimisht, ata kthehen te Zotëruesi i tyre, pastaj Ai i informon për çdo gjë që kishin bërë.

[109] Ata bënë be në Zotin, solemnisht, që po tu vinte një mrekulli atyre, patjetër do të besonin. Thuaj, "Mrekullitë vijnë vetëm nga Zoti." Në doni ta dini, nëse një mrekulli iu vjen atyre, do vazhdonin të mos besonin.

[110] Ne ua sillim mentë dhe zemrat e tyre. Kështu, pasi që vendimi i tyre është të mos besojnë, ne i lëmë të enden në shkeljet e tyre.

Pasojë e vetë vendimit të tyre

[111] Edhe sikur t'i zbritnim engjëjt te ta; edhe sikur të vdekurit t'iu flisnin atyre; edhe sikur të mblidhnim çdo mrekulli para tyre; ata nuk mund të besojnë në mos dashtë Zoti. Vërtetë, shumica e tyre janë të padijshëm.

Hadithi & Suneti: Trillime nga armiqtë e Profetit

[112] I kemi lejuar armiqtë e secilit profet – djajtë njerëz dhe xhin – që të inspirojnë në njëri tjetrin fjalë të lustruara, në mënyrë që të mashtrojnë. Sikur të donte Zotëruesi yt, ata nuk do e bënë atë. T'i shpërfillësh ata dhe trillimet e tyre.

Kriter i rëndësishëm

[113] Kjo është për t'i lënë mendjet e atyre që nuk besojnë në Përjetësinë t'i dëgjojnë trillimet e tilla, dhe t'i pranojnë, dhe kështu t'i nxjerrin në shesh bindjet e tyre të vërteta.*

*Kurani: Krejtësisht i hollësishëm**

[114] A të kërkoj pos Zotit si burim ligji, kur Ai ju ka shpallur këtë libër krejtësisht të hollësishëm? Ata që e pranuan shkrimin e dinë që është shpallur prej Zotëruetit tënd me të vërtetë. Të mos

* 6:113 Kurani na jep kritere që na tregojnë nëse vërtetë besojmë në Përjetësinë apo vetëm po themi fjalë goje. Këto kritere të rëndësishme thuhën këtu, dhe në 17:45-46 dhe 39:45. 6:113-115 Mbështetja në cilindo burim përkrah Kuranit pasqyron mosbesim në Kuran (Shtojca 18).

* 6:113-115 Mbështetja në çfarëdo burimi përkrah Kuranit pasqyron mosbesim në Kuran (Shtojca 18).

ushqesh asnjë dyshim.

[115] Fjala e Zotëruesit tënd është e plotë, në të vërtetë dhe drejtësi. Asgjë të mos i shfuqizojë fjalët e Tij. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[116] Nëse iu bindesh shumicës së njerëzve në tokë, do të të largojnë nga rruga e Zotit. Ata ndjekin vetëm supozime; vetëm hamenden.

[117] Zotëruesi yt është tërësisht i vetëdijshëm për ata që humbin nga rruga e Tij, dhe Ai është tërësisht i vetëdijshëm për ata që janë të udhëzuar.

[118] Të hani nga ajo mbi të cilën emri i Zotit është përmendur, nëse vërtetë besoni në shpalljet e Tij.

Rast për përkujtimin e Zotit: Përmende emrin e Zotit para ngrënies

[119] Pse mos të hash nga ajo mbi të cilën emri i Zotit është përmendur? Ai jua ka shpjeguar hollësisht çka është e ndaluar për ju, në mos qofshi të detyruar. Vërtetë, shumë njerëz i çorientojnë të tjerët me mendimet e veta personale, pa dije. Zotëruesi yt është plotësisht i vetëdijshëm për shkelësit.

[120] T'iu shmangeni mëkateve të dukshme, si dhe atyre të fshehtave. Ata që kanë mbledhur mëkate do të paguajnë për shkeljet e tyre.

[121] Mos hani prej asaj mbi të cilën emri i Zotit nuk është përmendur, se është e neveritshme. Djajtë i inspirojnë aleatët e tyre që të grinden me ju; nëse iu bindeni, do të jeni adhures idhujsh.*

[122] A është ai që ishte i vdekur dhe i dhuruam jetë, dhe e furnizua me dritë e cila i mundëson të lëvizë mes njerëzve, i barabartë me atë në errësirë të plotë nga e cila nuk mund të dalë? Punët e mosbesimtarëve kështu janë të zbuluara në sytë e tyre.

[123] I lejojmë kriminelët kryesor të secilës shoqëri që të thurin kurthe dhe planifikojnë. Por ata vetëm thurin kurthe dhe planifikojnë kundër shpirtave të vet, pa e kuptuar.

E vënë në dyshim mençurinë e Zotit

[124] Kur ndonjë provë e fuqishme u vjen atyre, thonë, “Nuk do të besojmë, në mos na u dhëntë çka u është dhënë të dërguarve të Zotit!” Zoti e di saktësisht kush është më së miri i kualifikuar për ta dhënë lajmin e Tij.* Kriminelët e tillë do të vuajnë poshtërim te Zoti, dhe ndëshkim të tmerrshëm si pasojë e planifikimit të tyre djallëzor.

*Dituria Kuranore shumë përpara përparimit njerëzor**

[125] Këdo Zoti do që ta udhëzojë, Ai ia bën kraharorin të hapur ndaj Nënshtrimit. Dhe këdo Ai do që ta dërgojnë në humbje, ia bën kraharorin të padurueshëm dhe të kufizuar, sikur dikujt që ngjitet drejt qiellit. Zoti kështu vë mallkim mbi ata që refuzojnë të besojnë.

[126] Kjo është rruga e drejtë për te Zotëruesi yt. Ne i kemi shpjeguar shpalljet për njerëzit e vëmendshëm.

[127] Ata e kanë merituar vendbanimin e paqes te Zotëruesi i tyre; Ai është Zotëruesi dhe Sunduesi i tyre, si shpërblim për punët e tyre.

[128] Do të vijë dita kur Ai i mbledhë të gjithë ata (e thotë): “O ju xhinë, keni bërë për vete mori njerëzish.” Shoqëruesit e tyre njerëzor do të thonë, “Zotëruesi ynë, ne u kënaqëm me shoqërinë e

* 6:121 Ndalesat ushqimore të themeluar nga tjetërkush pos Zotit paraqesin idhujtari.

* 6:124 Xhelozia dhe egoja janë veti të njeriut që nxitin disa njerëz ta vënë në dyshim mençurinë e Zotit në përzgjedhjen e të dërguarve të Tij. Shkollarë të korruptuar Mysliman e kanë shprehur këtë të njëjtën shprehje në lidhje me shpalljen e kodit matematikor të Kuranit nëpërmjet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes.

* 6:125 Me shekuj pas shpalljes së Kuranit, mësuam se përpjesëtimi i oksigjenit zvogëlohet përdërisa ngjitemi drejt qiellit, dhe gulçojmë për ajër.

njëri tjetrit deri sa na kaloi jetëgjatësia që na kishe caktuar.” Ai do të thotë, “Ferri është destinacioni juaj.” Ata qëndrojnë në të përgjithmonë, në përputhje me vullnetin e Zotit. Zotëruesi yt është i Mençur, i Gjithëdijsëm.

[129] Ne kështu i përshtatim shpirtligjtë të jenë shoqërues të njëri tjetrit, si ndëshkim për shkeljet e tyre.

[130] O ju xhinë dhe njerëz, a nuk pranuat të dërguarë nga mesi juaj, që ju kallëzuan juve shpalljet e Mia, dhe ju paralajmëruan për takimin e kësaj dite? Ata do të thonë, “Ne jemi dëshmitarë kundër vetes.” Ata ishin plotësisht të preokupuar me jetën e kësaj bote, dhe do të dëshmojnë kundër vetes që ishin mosbesimtarë.

[131] Kjo është për të treguar se Zotëruesi yt nuk asgjëson ndonjë shoqëri padrejtësisht, derisa njerëzit e saj janë të pavetëdijsëm.

[132] Çdonjëri do të arrijë një shkallë sipas veprave të tij. Zotëruesi yt nuk është i pavetëdijsëm për çfarëdo që bëjnë.

[133] Zotëruesi yt është i Pasuri; poseduesi i të gjithë mëshirës. Nëse ai do, Ai mund t’ju heqë, dhe t’ju zëvendësojë me këdo që Ai do, ashtu si ju prodhoi juve nga soji i njerëzve tjerë.

[134] Çka ju është premtuar do të vijë, dhe nuk mund t’i shmangeni.

[135] Thuaj, “O njerëzit e mi, bëni sa mundeni, edhe unë do bëj. Padyshim se do e merrni vesh kush janë fituesit përfundimtarë.” Patjetër, shpirtligjtë nuk do ia dalin.

Shpërdorjnë furnizimet e Zotit

[136] Ata madje e lënë mënjanë një pjesë të furnizimeve nga të korrat dhe bagëtitë e Zotit, duke thënë “Kjo pjesë i takon Zotit,” sipas pretendimeve të tyre, “dhe kjo pjesë i takon idhujve tanë.” Megjithatë, ajo që u la mënjanë për idhujt e tyre nuk arrin te Zoti, ndërsa pjesa që e lan mënjanë për Zotin shkon te idhujt e tyre. Vërtetë i tmerrshëm është gjykimi i tyre.

[137] Kështu adhuresit e idhujve u mashtruan nga idhujt e tyre, aq sa i vrasin fëmijët e vet.* Në fakt, idhujt e tyre iu shkaktojnë dhimbje të mëdha atyre, dhe ua turbullojnë fenë. Sikur të donte Zoti, nuk do e kishin bërë këtë. T’i shpërfillësh ata dhe trillimet e tyre.

Shpikjet fetare dënohen

[138] Ata thanë, “Këto janë bagëti dhe të korra që janë të ndaluara; askush të mos i hajë përveç atyre që i lejojmë,” kështu pretenduan. Ata gjithashtu ndaluan ngasjen e bagëtive të caktuara. Madje edhe bagëtitë që i hanin, ata nuk e përmendnin emrin e Zotit kur i thernin. Të tilla janë shpikjet e mveshura Atij. Ai padyshim do i dënojë për shpikjet e tyre.

[139] Ata gjithashtu thanë, “Çka është në barqet e këtyre bagëtive është e rezervuar vetëm për meshkujt mes nesh, dhe e ndaluar për gratë tona.” Por nëse dilte ngordhësirë, ata i lejonin gratë e tyre të marrin pjesë. Ai padyshim do i dënojë për shpikjet e tyre. Ai është Më i Mençuri, i Gjithëdijsëm.

[140] Humbës vërtetë janë ata që i vranë fëmijët e vet marrëzisht, nga padituria e tyre, dhe ndaluan çka Zoti ka furnizuar për ta, dhe ndoqën shpikje të mveshura Zotit. Ata kanë humbur; nuk janë të udhëzuar.

*Zeqati duhet të jepet “në ditën e korrjes”**

* 6:137 Shembull i përsosur është incidenti i turpshëm ndërkombëtarë i ekzekutimit (vrasjes) të një princeshe të arabisë Saudite në 1978 për gjoja marrëdhënie jashtëmartesore. Ligji i Zotit vendos fshikullimin, e jo ekzekutimin, si ndëshkim për marrëdhënie jashtëmartesore (24:1-2), përderisa ligjet idhujtareske përcaktojnë ekzekutimin. Siç ceket në 42:21, tradicionalistët ndjekin një fe që nuk është e autorizuar nga Zoti.

* 6:141 Bamirësia Zeqatë është aq e rëndësishme, sa që i Mëshirshmi e ka rezervuar mëshirën e Tij për ata që e japin

[141] Ai është që rrënjosi kopshte, të kacavjerruna dhe jo-kacavjerruna, dhe palma, dhe drithëra me shije të ndryshme, dhe ullinj, dhe shegë – fruta të ngjashme, por jo edhe të ngjashme. Hani prej frutave të tyre, dhe jepni lëmoshën e caktuar në ditën e korrjes, dhe mos e shkoni kot asgjë. Ai nuk i do shpërdoruesit.

[142] Ca bagëti ju pajisin me transportim, si dhe shtrojsa. Hani prej furnizimeve të Zotit për ju, dhe mos i ndiqni hapat e Dreqit; ai është armiku juaj më i flaktë.

Ndalesat e shpikura ushqimore dënohen

[143] Tetë lloje bagëtish: sa i përket dy llojeve të deveve, dhe dy llojeve të dhive, thuaj, “A ndaloi dy meshkujt, apo dy femrat, apo ngarkesat e mitrave të dy femrave? Më tregoni çka dini, nëse jeni të singertë.”

[144] Sa i përket dy llojeve të deveve, dhe dy llojeve të lopëve, thuaj, “A ndaloi dy meshkujt, apo dy femrat, apo ngarkesat e mitrave të dy femrave? A ishit dëshmitarë kur Zoti shpalli ndalesa të tilla për ju? Kush është më i keq se ata që shpikin gënjeshtër të tilla dhe ia mveshin Zotit? Ata kështu i çorientojnë njerëzit pa dijeni. Zoti nuk udhëzon njerëzit e tillë të këqij.”

*Ndalesat e vetme ushqimore**

[145] Thuaj, “Unë nuk gjejë në shpalljet që më janë dhënë asnjë ushqim të ndaluar për ndonjë ngrënës përveç: (1) cofëtinës, (2) gjakut që rrjedh, (3) mishit të derrit, se është i ndyrë, dhe (4) mishit të kafshëve që i janë kushtuar tjetër pos Zotit.” Nëse dikush detyrohet (t’i hajë), pa qenë me qëllim apo keqdashje, atëherë Zotëruesi yt është Falës, i Mëshirshmi.

[146] Për ata që janë Jahudi ndaluam kafshët me thundra jo të ndara; dhe nga lopët dhe delet ndaluam dhjamin, përveç atij që gjendet në kurrizet e tyre, ose në rropulli, ose i përzier me eshtra. Ishte ndëshkim për shkeljet e tyre, dhe ne jemi të singertë.

[147] Nëse nuk të besojnë, thuaj, “Zotëruesi juaj posedon mëshirë pakufi, por ndëshkimi i Tij është i pashmangshëm për njerëzit fajtorë.”

[148] Adhuresit e idhujve thonë, “Sikur të donte Zoti, nuk do të ushtronim idhujtari, as ne as prindërit tanë, as nuk do të ndalonim ndonjë gjë.” Kështu edhe ata para tyre nuk besuan, derisa vetëshkaktuan ndëshkimin tonë. Thuaj, “A keni ndonjë njohuri të vërtetuar që mund të na tregoni? Ju nuk ndiqni asgjë pos supozime; vetëm hamendeni.”

*Argumenti më i fuqishëm**

[149] Thuaj, “Zoti posedon argumentin më të fuqishëm; po të donte Ai mund t’ju udhëzonte të gjithëve.”

[150] Thuaj, “Sillni dëshmitarët tuaj që do të dëshmonin që Zoti ka ndaluar këtë apo atë.” Nëse dëshmojnë, mos dëshmo me ta. As të mos i ndjekësh mendimet e atyre që refuzojnë shpalljet tona, as të atyre që nuk besojnë në Përjetësi, as të atyre që humbin larg nga Zotëruesi i tyre.

Urdhrat madhore

[151] Thuaj, “Ejani le t’ju tregoj çka Zotëruesi juaj ka urdhëruar me të vërtetë për ju: Të mos ngritni

(7:156). E, Myslimanët e korruptuar e kanë humbur këtë më të rëndësishmin urdhër; ata japin Zeqatë vetëm një herë në vit. Ne shohim këtu që Zeqati duhet të jepet “në ditën që pranojmë të ardhurat.” Përpjesëtimi që na erdhi nëpërmjet Ibrahimit është 2.5% e të ardhurave neto.

* 6:145-146 Vetëm katër lloje të produkteve shtazore janë të ndaluara: kafshët që cofin vetë, gjaku që rrjedh (jo i zënë brenda mishit), mishi i derrit, dhe kafshët që i kushtohen tjetër pos Krijuesit të tyre. Strofa 146 na njofton se ndalesat e tilla janë shumë të posaçme; Zoti ndalon ose “mishin” ose “dhjamin” ose të dyja, nëse Ai do ashtu.

* 6:149 Kodi matematikor i Kuranit është provë e prekshme dhe krejtësisht e pakundërshtueshme që ky është lajmi i Zotit për botën. Nevojitet ndërhyrje hyjnore për ta ndaluar ndonjë lexues ta çmojë këtë fenomen të jashtëzakonshëm, dhe të bie në përulje, dhe ta pranojë këtë mrekulli të pakalueshme (shih 17:45-46, 18:57, 56:79, dhe Shtojcën Një).

idhuj përveç Tij. T'i nderoni prindërit tuaj. Të mos i vritni fëmijët tuaj nga frika prej varfërisë – ne furnizojmë për ju dhe për ta. Të mos kryeni mëkate të tepërta, as të dukshme as të fshehta. Të mos vritni – Zoti e ka bërë jetën të shenjtë – përveç për drejtësi. Këto janë urdhrat e Tij për ju, që të mund të kuptoni.”

Urdhra plotësuese

[152] Të mos i prekni paratë e jetimëve përveç në mënyrën më të drejtë, derisa të arrijnë pjekurinë. Të jepni sasi të plotë dhe masë të plotë gjatë shitblerjes, me barazi. Nuk e ngarkojmë asnjë shpirt përtej mundësive të tij. Të jeni krejtësisht të drejtë kur dëshmoni, madje edhe kundër të afërmve tuaj. Ta përmbushni besëlidhjen tuaj me Zotin. Këto janë urdhrat e Tij për ju, që të jeni të vëmendshëm.

[153] Kjo është rruga Ime – e drejtë. Ta ndiqni atë, dhe të mos ndiqni ndonjë rrugë tjetër, se mos ju shmangin nga rruga e Tij. Këto janë urdhrat e Tij për ju, që të mund të shpëtoheni.

[154] Dhe ne i dhamë Moisiut shkrimin, komplet me urdhrat më të mira, dhe sqarimet e çdo gjëje, dhe fener dhe mëshirë, që të mund të besojnë në takimin me Zotëruesin e tyre.

[155] Edhe ky është shkrim i bekuar që e kemi shpallur; ta ndiqni atë dhe të çoni jetë të drejtë, që të mund të arrini mëshirë.

[156] Tash nuk mund të thoni më, “shkrimi iu zbrit dy grupeve para nesh, dhe nuk ishim të vetëdijshëm për mësimet e tyre.”

*Matematika: Prova përfundimtare**

[157] As nuk mund të thoni, “Vetëm sikur një shkrim të mund të na zbriste, do të udhëzoheshim më mirë se ata.” Një shkrim i vërtetuar ka ardhur tash te ju nga Zotëruesi juaj, dhe fener, dhe mëshirë. Tash, kush është më i keq se ai që i refuzon këto prova nga Zoti, dhe i shpërfillë? Ne do i parashtrijmë ata që i shpërfillin provat tona në ndëshkimin më të keq për shkak të moskujdesit të tyre.

Kushtet e testit

[158] A po presin t’iu vijnë engjëjt, ose Zotëruesi yt, ose ndonjë manifestim material i Zotëruesit tënd? Dita kur kjo ndodhë, asnjë shpirt nuk do të ketë dobi nga besimi nëse nuk ka besuar para saj, dhe nëse nuk i ka korrë dobitë e besimit duke çuar jetë të drejtë.* Thuaj, “Vazhdoni të prisni; edhe ne po presim.”

Sektet fetare dënohen

[159] Ata që ndajnë veten në sekte nuk besojnë me ju. Gjykimi i tyre është me Zotin, pastaj Ai do i njoftojë për çdo gjë që kishin bërë.

[160] Kushdo që bën një punë të mirë pranon shpërblimin për dhjetë të tilla, dhe ai që bën një mëkat dënohet për vetëm një. Askush nuk vuan as më të voçklën padrejtësi.

[161] Thuaj, “Zotëruesi im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë – fenë e përsosur të Ibrahimit, monoteizmin. Ai nuk ishte adhures idhujsh.”

[162] Thuaj, “Lutjet e mia të Kontaktit (Salat), zbatimet e mia të adhurimit, jeta ime dhe vdekja ime, të gjitha i janë kushtuar absolutisht vetëm Zotit, Zotëruesit të gjithësisë.

[163] “Ai nuk ka partner. Kjo është çka jam urdhëruar të besoj, dhe jam i pari të nënshtrohem.”

[164] Thuaj, “A të kërkoj tjetër pos Zotit si zotërues, kur Ai është Zotëruesi i të gjitha gjërave? Asnjë

* 6:157 Funkcioni i kodit matematikor të Kuranit është i qartë nga fakti se shuma e numrit të strofës (157) dhe vlerës germore të “Rashad Khalifa” (1230), nëpërmjet të cilit është zbuluar kodi, jep 1387, ose 19x73.

* 6:158 Pas besimit, shpirti duhet të rritet dhe të zhvillohet me anë të ushtrimeve të adhurimit të porositura nga Zoti.

shpirt nuk ka dobi përveç nga punët e veta, dhe askush nuk e bartë barrën e tjetrit. Përfundimisht, ktheheni te Zotëruesi juaj, pastaj Ai ju njofton për grindjet tuaja.”

[165] Është Ai që ju bëri trashëgues të tokës, dhe Ai ngriti disa prej jush në një shkallë më të lartë se të tjerët, për t’ju testuar në përputhje me çka ju ka dhënë. Padyshim, Zotëruesi yt është i shkathët në zbatimin e ndëshkimit, dhe Ai është Falës, i Mëshirshmi.

Surja 7: Purgatori (El-A'raf)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A. L. M. S.*

[2] Ky shkrim të është shpallur ty – të mos ushqesh dyshim për të në zemrën tënde – që të mund të paralajmërosh me të, dhe t’ua kujtosh besimtarëve.

[3] Të gjithë ju të ndiqni çka ju është shpallur prej Zotëruesit tuaj; mos ndiqni asnjë idhull përveç Tij. Rrallë merrni vesh.

[4] Sa e sa shoqëri i kemi asgjësuar; ata vetëshkaktuan ndëshkimin tonë derisa ishin në gjumë, ose të zgjuar.

[5] Shprehja e tyre kur ndëshkimi ynë u erdhi atyre ishte: “Vërtetë, kemi qenë shkelës.”

[6] Padyshim do i marrim në pyetje ata që pranuan lajmin, dhe do i marrim në pyetje të dërguarit.

[7] Do i njoftojmë me dijen se nuk mungonim.

[8] Peshoret do të fiksohen atë ditë, me barazi. Ata peshat e të cilëve janë të rënda do të jenë fituesit.

[9] Sa për ata peshat e të cilëve janë të lehta, do të jenë ata që i humbën shpirtat e tyre* si pasojë e shpërfilljes së shpalljeve tona, padrejtësisht.

[10] Ju themeluan në tokë, dhe ju kemi furnizuar me mjete të jetesës në të. Rrallë jeni mirënjohës.

[11] Ju krijuam, pastaj ju formësuam, pastaj iu thamë engjëjve, “Përluljuni Ademit.” Ata u përlulën, përveç Iblisit (Dreqit); ai nuk ishte me ata që u përlulën.

Testi fillon

[12] Ai tha, “Çka të pengoi të përulesh kur të porosita?” Ai tha, “Unë jam më i mirë se ai; Mua më krijove prej zjarri, e atë e krijove prej balte.”

[13] Tha, “Prandaj, duhet të zbresësh, se nuk ke për të qenë mendjemadh këtu. Dil; je poshtëruar.”

[14] Tha, “Shtyma afatin, deri në Ditën e Ringjalljes.”

[15] Tha, “Të është shtyrë afati.”

[16] Tha, “Pasi që Ti ke dashur që unë të humbë,* unë do iu dal atyre tinëz në rrugën Tënde të drejtë.

[17] “Do iu mësyhem nga para tyre, dhe nga mbrapa tyre, dhe nga e djathta e tyre, dhe nga e majta e tyre, dhe do e gjesh se shumica e tyre janë mosmirënjohës.”

[18] Tha, “Dil nga aty, i përbuzur dhe i mposhtur. Ata prej tyre që të ndjekin, do e mbushë Ferrin me ju të gjithë.

[19] “Sa për ty, Adem, bano me gruan tënde në Parajsë, dhe hani aty kah të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se bini në mëkat.”

[20] Djalli iu pëshpëriti atyre, për t’ua zbuluar trupat e tyre, që ishin të padukshëm për ta. Tha,

* 7:1 Shih Shtojcën 1 për funksionin e këtyre inicialeve në mrekullinë matematikore të Kuranit.

* 7:9 Dështimi që “t’ia vëmë veshin” Krijuesit tonë çon në uri shpirtërore dhe dikur në “humbje” të shpirtit.

* 7:16 Dreqi është gënjeshtar i vërtetuar, e edhe ata që i takojnë atij (shih 2:36, 6:22-23, & 7:20-22).

“Zotëruesi juaj nuk ju ndaloi nga ky lis, përveç që t’ju pengojë të bëheni engjëj, dhe të arrini ekzistencë të përjetshme.”

[21] Ai iu bëri be, “Unë po ju jap këshillë të mirë.”

[22] Kështu i mashtroi me gënjeshtër. Sapo e shijuan pemën, trupat e tyre u bënë të dukshëm për ta, dhe ata u munduan ta mbulojnë veten me gjethet e Parajsës. Zotëruesi i tyre u thirri: “A nuk ju ndalova nga ajo pemë, dhe ju paralajmërova që djalli është armiku juaj më i flaktë?”

[23] Thanë, “Zotëruesi ynë, i kemi bërë keq shpirttrave tonë, dhe po të mos na falësh dhe të kesh mëshirë ndaj nesh, do të jemi humbës.”

[24] Tha, “Zbritni si armiq të njëri tjetrit. Në tokë të jetë vendbanimi dhe furnizimi juaj për ca kohë.”

[25] Tha, “Në të do të jetoni, në të do të vdisni, dhe prej saj do të nxirreni.”

[26] O fëmijët e Ademit, ju kemi furnizuar me veshje për ta mbuluar trupin tuaj, si dhe për salltanet. Por veshja më e mirë është veshja e drejtësisë. Këto janë disa nga shenjat e Zotit, që të mund të marrin vesh.

[27] O fëmijët e Ademit, mos e lejoni djallin t’ju mashtrojë si ju mashtroi kur shkaktoi dëbimin e prindërve tuaj nga Parajsa, dhe heqjen e veshjeve të tyre për t’ua ekspozuar trupat e tyre. Ai dhe fisi i tij ju shohin, përderisa ju nuk i shihni. Ne i caktojmë djajtë si shoqërues të atyre që nuk besojnë.

Ekzamino të gjitha informatat e trashëguara

[28] Ata kryejnë një mëkat të tepërt, thonë, “Ne i gjetëm prindërit tanë duke bërë kështu, dhe Zoti na ka urdhëruar që ta bëjmë.” Thuaj, “Zoti nuk përkrahë mëkat. A po thoni për Zotin çka nuk dini?”

[29] Thuaj, “Zotëruesi im përkrahë drejtësinë, dhe devotshmërinë ndaj vetëm Atij në secilin vend të adhurimit. T’ia kushtoni adhurimin tuaj plotësisht vetëm Atij. Ashtu si ju nisi juve, ju përfundimisht do të ktheheni te Ai.”

Ruaju: Ata besojnë se janë të udhëzuar

[30] Disa i udhëzoi, përderisa të tjerët janë të parashtruar në humbje. Ata i kanë marrë djajtë si sundues të tyre, në vend të Zotit, e prapëseprapë besojnë se janë të udhëzuar.

Vishuni mirë për në vendlutje (Xhami)

[31] O fëmijët e Ademit, të jeni të pastër dhe të visheni mirë kur shkoni në vendlutje. Dhe hani e pini pa e tepruar; Me të vërtetë, Ai nuk i do grykësit.

Ndalesat e shpikura dënohen

[32] Thuaj, “Kush i ndaloi gjërat e mira që Zoti i ka krijuar për krijesat e Tij, dhe furnizimet e mira?” Thuaj, “Furnizimet e tilla janë për t’i kënaqur ata që besojnë. Plus, furnizimet e mira do të jenë veçanërisht për ta në Ditën e Ringjalljes.” Kështu i shpjegojmë shpalljet për njerëzit që dinë.

[33] Thuaj, “Zotëruesi im ndalon vetëm veprat e këqija, qofshin haptas apo fshehtas, dhe mëkatet, dhe agresionin e padrejtë, dhe ngritjen e idhujve të pafuqi përkrah Zotit, dhe thëniet për Zotin që nuk janë të bazuara në dije.”

[34] Për secilën shoqëri është afati i paracaktuar. Kur kohës së tyre i vjen fundi, ata nuk mund ta shtyjnë as për një orë, e as ta ngusin.

Të dërguarë nga mesi juaj

[35] O fëmijët e Ademit, kur të dërguarë vijnë te ju nga mesi juaj, dhe jua recitojnë shpalljet e Mia, ata që marrin vesh dhe çojnë jetë të drejtë, nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen.

[36] Sa për ata që refuzojnë shpalljet tona, dhe janë shumë mendjemëdhenj për t’iu përmbajtur

atyre, kanë vetëshkaktuar Ferr, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[37] Kush është më i keq se ata që shpikin gënjeshtër për Zotin, ose refuzojnë shpalljet e Tij? Këta do të marrin hisen e tyre, në përputhje me shkrimin, pastaj, kur të dërguarit tanë vijnë t'i përfundojnë jetët e tyre, do të thonë, "Ku janë idhujt që dikur iu luteshit përkrah Zotit?" Ata do të thonë, "Na kanë braktisur." Do të dëshmojnë kundër vetes se ishin mosbesimtarë.

Fajësime të dyanshme

[38] Ai do të thotë, "Hyni me shoqëritë paraprake të xhinëve dhe njerëzve në Ferr." Sa herë që ndonjë grup hyn, do e mallkojnë grupin paraardhës. Kur të jenë të gjithë brenda, më i vonshmi grup do të thotë për paraprakun, "Zotëruesi ynë, këta janë ata që na çorientuan. Jepu dyfish ndëshkim të Ferrit." Ai do të thotë, "Secili pranon dyfish, por nuk e dini."

[39] Grupi paraardhës do i thotë grupit të mëvonshëm, "Pasi që kishit përparësi ndaj nesh, shijojeni ndëshkimin për vetë mëkatet tuaja."

Refuzimi i shpalljeve të Zotit: Krim i pafalshëm

[40] Padyshim, ata që refuzojnë shpalljet tona dhe janë shumë mendjemdhenj për t'iu përmbajtur atyre, portat e qiellit nuk do të hapen për ta, as nuk do të hyjnë në Parajsë në mos kaloftë deveja përmes vrimës së gjilpërës. Kështu i paguajmë fajtorët.

[41] Ata kanë vetëshkaktuar Ferr si vendbanim; do të kenë barriera mbi ta. Kështu i paguajmë shkelësit.

[42] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë – nuk e ngarkojmë asnjë shpirt përtej mundësive të tij – këta do të jenë banuesit e Parajsës. Ata rrojnë aty përgjithmonë.

Me hirësinë e Zotit

[43] Ne do të heqim krejt xhelozinë nga zemrat e tyre. Lumenj do të rrjedhin nën ta, dhe ata do të thonë, "Qoftë i lartmadhëruar Zoti se na udhëzoi. Kurrsesi nuk do të udhëzoheshim, po të mos na kishte udhëzuar Zoti. Të dërguarit e Zotëruesit tonë të vërtetën na sollën." Atyre do tu thirret: "Kjo është Parajsa juaj. E keni trashëguar, si shpërblim për punët tuaja."

[44] Banuesit e Parajsës do tu thërrasin banuesve të Ferrit: "Ne e kemi gjetur premtimin e Zotëruesit tonë të jetë e vërteta; a e keni gjetur ju premtimin e Zotëruesit tuaj të jetë e vërteta?" Ata do të thonë, "Po." Një shpallës mes tyre do të shpallë: "Dënimi i Zotit iu ka rënë shkelësve;

[45] "që zmrapsin nga rruga e Zotit, dhe përpiqen ta bëjnë të shtrembët, dhe, sa i përket Përjetësisë, ata janë mosbesimtarë."

[46] Një barrierë i ndanë ata, përderisa Purgatori* është i zënë nga njerëz që e njohin secilën anë nga pamja e tyre. Ata do tu thërrasin banuesve të Parajsës: "Paqja qoftë mbi ju." Ata nuk hynë (në Parajsë) me anë të shpresave të kota.

[47] Kur ata i kthejnë sytë e tyre drejt banuesve të Ferrit, do të thonë, "Zotëruesi ynë, mos na vendos me këta njerëz të këqij."

Shumica të mallkuar

[48] Banuesit e Purgatorit do tu thërrasin njerëzve që i njohin nga pamja e tyre, duke thënë, "Numri juaj i madh nuk ju bëri dobi në asnjë mënyrë, e as mendjemadhësia juaj.

[49] "A janë ata njerëzit që bënit be që Zoti nuk do i prekë me mëshirë?" (Njerëzve në Purgator pastaj do tu thuhet,) "Hyni në Parajsë; nuk keni pse të frikësoheni, as nuk do të brengoseni."

[50] Banuesit e Ferrit do tu thërrasin banuesve të Parajsës: "Lëreni të rrjedhë drejt nesh pak nga uji

* 7:46-49 Fillimisht, do të jenë 4 vende: (1) Qielli (Parajsa) i Lartë, (2) Qielli (Parajsa) i Ulët, (3) Purgatori, dhe (4) Ferri. Purgatori do i bashkëngjitet Qiellit të Ulët.

juaj ose nga furnizimet e Zotit për ju.” Ata do të thonë, “Zoti i ka ndaluar ato për mosbesimtarët.”

[51] Ata që nuk e marrin fenë e tyre seriozisht, dhe janë plotësisht të preokupuar me jetën e kësaj bote, ne i harrojmë atë ditë, sepse ata e harruan atë ditë, dhe sepse ata mohuan shpalljet tona.

Kurani: Krejtësisht i hollësishëm

[52] Ne u kemi dhënë atyre një shkrim që është krejtësisht i hollësishëm, me dituri, udhëzim, dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.

[53] A po presin derisa të gjitha (profecitë) të përmbushen? Ditën kur përmbushja e tillë vjen, ata që e shpërfillën në të kaluarën do të thonë, “Të dërguarit e Zotëruesit tonë e kanë sjellë të vërtetën. A ka ndonjë ndërmjetësues për të ndërmjetësuar për ne? A do të na dërgoni prapa, që ta ndryshojmë sjelljen tonë, dhe të bëjmë punë më të mira se ato që i bëmë?” Ata i kanë humbur shpirtat e tyre, dhe vetë shpikjet e tyre e kanë shkaktuar mallkimin e tyre.

[54] Zotëruesi juaj është ai Zoti, që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë,* dhe mori çdo gjë në dorë. Nata e kaplon ditën, përderisa e ndjekë vazhdimisht, dhe dielli, hëna dhe yjet janë bërë të shërbejnë me urdhrin e Tij. Absolutisht, Ai i ka nën kontroll të gjitha krijesat dhe të gjitha urdhrat. Më i Lartësuari është Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.

[55] Ta adhuron Zotëruesin tuaj publikisht dhe privatisht; Ai nuk i do shkelësit.

[56] Mos e korruptoni tokën pasi që është rregulluar, dhe adhuronie Atë nga druajtja dhe shpresa. Padyshim, mëshira e Zotit është e arritshme për të drejt.

[57] Është Ai që dërgon erërat me myzhde, si mëshirë prej duarve të Tij. Kur ato mbledhin re të rënduara, i dërgojmë ato në tokë të vdekur, dhe lëshojmë ujë nga to, për të prodhuar me të të gjitha llojet e frutave. Kështu i ringjallim të vdekurit, që të mund të jeni të vëmendshëm.

[58] Toka e mirë me të mirë prodhon bimët e saj me lejen e Zotëruesit të saj, kurse toka e keqe vështirë se prodhon ndonjë gjë të përdorshme. Kështu i shpjegojmë shpalljet për njerëzit që janë mirënjohës.

Nuhu

[59] Ne dërguam Nuhun te njerëzit e tij, duke thënë, “O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; nuk keni asnjë zot tjetër përkrah Tij. Kam frikë se do të ndëshkoheni në ditën e hatashme.”

[60] Udhëheqësit mes njerëzve të tij thanë, “Po e shohim se je larg në humbje.”

[61] Ai tha, “O njerëzit e mi, nuk jam i humbur; jam i dërguar nga Zotëruesi i gjithësisë.

[62] “Unë ju sjell juve lajmin e Zotëruesit tim, dhe ju këshilloj, dhe unë di prej Zotit çka ju nuk dini.

[63] “A shumë çudi po ju duket që një paralajmërim të vijë te ju nga Zotëruesi juaj, nëpërmjet një njeriu si ju, për t’ju paralajmëruar, dhe për t’ju çuar në drejtësi, që të mund të arrini mëshirë?”

[64] Ata e refuzuan atë. Si pasojë, ne e shpëtuan atë dhe ata që ishin me të në arkë, dhe i përmbytëm ata që refuzuan shpalljet tona; ata ishin të verbër.

Hudi

[65] Te Adi dërguam vëllanë e tyre Hudin. Tha, “O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; nuk keni asnjë zot tjetër përkrah Tij. Pra, a do të zbatoni drejtësinë?”

[66] Udhëheqësit që nuk besuan mes njerëzve të tij thanë, “Po e shohim që sillesh si i marrë, dhe ne mendojmë se je gënjeshtar.”

[67] Tha, “O njerëzit e mi, nuk ka aspak marrëzi në mua; jam i dërguar nga Zotëruesi i gjithësisë.

[68] “Unë sjell te ju lajmin e Zotëruesit tim, dhe sinqerisht po ju këshilloj.

* 7:54 Gjashtë ditët e krijimit janë alegorike; ato shërbejnë si metër për të na lejuar të dimë ndërlikueshmërinë relative të planetit Tokë pambarimisht të vogël – ajo është krijuar për “4 ditë” (shih 41:10).

[69] "A shumë çudi po ju duket që një lajm të vijë te ju nga Zotëruesi juaj, nëpërmjet të një njeriu si ju, për t'ju paralajmëruar? Kujtohuni se si Ai ju bëri trashëgimtarë pas njerëzve të Nuhut, dhe e shumëfishoi numrin tuaj. Përkujtoni bekimet e Zotit, që të mund t'ia dilni."

Ndjekja e prindërve verbërisht: Tragjedia e njeriut

[70] Ata thanë, "A ke ardhur të na bësh të adhurojmë vetëm Zotin, dhe të braktisim çka prindërit tanë dikur adhuronin? Ne të sfidojmë ty të sjellësh dënimin me të cilin na kërcënon, nëse je i sinqertë."

[71] Ai tha, "Keni vetëshkaktuar mallkim dhe zemërim nga Zotëruesi juaj. A grindeni me mua në mbrojtje të shpikjeve që i keni trilluar – ju dhe prindërit tuaj – të cilat kurrë nuk u autorizuan nga Zoti? Prandaj, prisni edhe unë bashkë me ju po pres."

[72] Ne pastaj e shpëtuam atë dhe ata me të, me mëshirë prej nesh, dhe i asgjësuam ata që refuzuan shpalljet tona dhe refuzuan të jenë besimtarë.

Salihu

[73] Te Themudi dërguam vëllanë e tyre Salihun. Tha, "O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; nuk keni asnjë zot tjetër për krahas Tij. Provë u është dhënë juve nga Zotëruesi juaj: ja ku është deveja e Zotit, për të shërbyer si një shenjë për ju. Lëreni të hajë prej tokës së Zotit, dhe mos i shkaktoni ndonjë lëndim, se mos vetëshkaktoni ndëshkim që dhemb."

[74] "Kujtohuni që ju bëri trashëgimtarë pas Adit, dhe ju themeloi në tokë, duke ndërtuar pallate në fushat e saj, dhe duke gdhendur shtëpi prej maleve të saj. T'i përkujtoni bekimet e Zotit, dhe mos endeni të korruptuar nëpër tokë."

Lajmi i dërguar: Provë e dërguarësisë

[75] Udhëheqësit mendjemëdhenj mes njerëzve të tij u thanë njerëzve të rëndomtë që besuan, "Si e dini që Salihu është dërguar nga Zotëruesi i tij?" Ata thanë, "Lajmi që solli na bëri besimtarë."

[76] Mendjemëdhenjtë thanë, "Ne nuk besojmë në atë që ju besoni."

[77] Më pas, ata e therën devenë, bënë kryengritje kundër urdhrin të Zotëruesit të tyre, dhe thanë, "O Salih, sille dënimin me të cilin na kërcënon, nëse vërtetë je i dërguar."

[78] Si pasojë, tërmeti i asgjësoi, duke i lënë të vdekur në shtëpitë e tyre.

[79] Ai ua ktheu shpinën atyre, duke thënë, "O njerëzit e mi, unë e kam sjellë lajmin e Zotëruesit tim te ju, dhe ju këshillova, por juve nuk ju pëlqen asnjë këshillues."

Luti: Homoseksualizmi dënohet

[80] Luti i tha njerëzve të tij "Ju kryeni neveri të tillë; askush në botë nuk e ka bërë më parë!

[81] "Ju praktikoni seks me burra, në vend të grave. Vërtetë ju jeni popull shkelës."

[82] Njerëzit e tij reagon duke thënë, "Dëboni nga qyteza juaj. Ata janë njerëz që dëshirojnë të jenë të pastër."

[83] Si pasojë, e shpëtuam atë dhe familjen e tij, por jo gruan e tij; ajo ishte me të dënuarit.

[84] U lëshuam atyre një breshëri të caktuar; vëreni pasojat për fajtorët.

Shuajbi: Hilja, mashtrimi dënohen

[85] Në Medjen dërguam vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha, "O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; nuk keni asnjë zot tjetër për krahas Tij. Ju ka ardhur provë nga Zotëruesi juaj. Të jepni peshë të plotë dhe sasi të plotë gjatë shitblerjes. Mos ua merrni njerëzve të drejtën e tyre. Mos e korruptoni tokën pasi që është rregulluar. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë."

[86] "Ndaloni së bllokuari secilën rrugë, duke kërkuar t'ia ktheni prapa prej rrugës së Zotit ata që besojnë, dhe mos e bëni atë të shtrembëruar. Përkujtoni që dikur ishit pak dhe ju shtoi në numër."

Kujtoni pasojat për shpirtligjtë.

[87] "Tash që disa prej jush kanë besuar në atë me të cilën isha dërguar, dhe disa nuk kanë besuar, prisni derisa Zoti nxjerr vendimin e Tij mes nesh; Ai është gjykatësi më i mirë."

[88] Udhëheqësit mendjemëdhenj mes njerëzve të tij thanë, "Do të dëbojmë ty, o Shuajb, së bashku me ata që besojnë me ty, nga qyteza jonë, në mos u kthefsh prapa në fenë tonë." Ai tha, "A do të na detyroni?"

[89] "Do të blasfemoni kundër Zotit po të ktheheshim në fenë tuaj pasi që Zoti na ka shpëtuar prej saj. Si mund të kthehemi prapa te ajo kundër vullnetit të Zotit Zotëruesit tonë? Dituria e Zotëruesit tonë përfshinë të gjitha gjërat. Ne kemi besim te Zoti. Zotëruesi ynë, dhurona një fitore vendimtare mbi njerëzit tanë. Ti je përkrahësi më i mirë."

[90] Udhëheqësit mosbesimtarë mes njerëzve të tij thanë, "Nëse e ndiqni Shuajbin, do të jeni humbës."

[91] Tërmeti i asgjësoi ata, duke i lënë të vdekur në shtëpitë e tyre.

[92] Ata që refuzuan Shuajbin u zhdukën, sikur të mos kishin ekzistuar kurrë. Ata që refuzuan Shuajbin ishin humbësit.

[93] Ai ua ktheu shpinën atyre, duke thënë, "O njerëzit e mi, unë u kam sjellë juve lajmin e Zotëruesit tim, dhe ju kam këshilluar. Si mund të brengosem për njerëzit mosbesimtarë."

[94] Kurdo që dërguam profet te ndonjë shoqëri, ne i prekëm njerëzit e saj me fatkeqësi dhe vështirësi, që të përgjërohen.

[95] Pastaj e zëvendësuam atë vështirësi me paqe dhe përparim. E, ata u bënë të pavëmendshëm dhe thanë, "Ishin prindërit tanë ata që përjetuan atë vështirësi para përparimit." Si pasojë, i ndëshkuam papritmas kur më së paku e pritnin.

Shumica e njerëzve marrin vendimin e gabuar

[96] Sikur njerëzit e atyre shoqërive të kishin besuar dhe të ishin bërë të drejtë, do tu derdhnim atyre bekime nga qielli dhe toka. Pasi që ata vendosën të mos besojnë, i ndëshkuam për atë që mblodhën.

[97] A kanë garantuar njerëzit e shoqërive të sotshme që ndëshkimi ynë nuk do u vijë natën përderisa flejnë?

[98] A kanë garantuar njerëzit e shoqërive të sotshme që ndëshkimi ynë nuk do tu vijë ditën përderisa luajnë?

[99] A e kanë marrë ata planin e Zotit si të kotë? Askush nuk i çvlerëson planet e Zotit përveç humbësve.

[100] A u shkon ndonjëherë ndërmend atyre që trashëgojnë tokën pas gjeneratave paraprake se, nëse dëshirojmë, mund t'i ndëshkojmë për mëkatet e tyre, dhe t'ua mbyllim zemrat, e t'i bëjmë të bëhen të shurdhët?

[101] Ty të kallëzojmë historinë e atyre shoqërive: të dërguarit e tyre u shkuan atyre me prova të qarta, por ata nuk kishin për të besuar në çka e kishin refuzuar më parë. Zoti kështu i mbyll zemrat e mosbesimtarëve.

[102] Gjetëm se shumica e tyre shpërfillin besëlidhjen e tyre; i gjetëm shumicën e tyre shpirtligj.*

Moisiu

[103] Pas (atyre të dërguarve,) dërguam Moisiun me shenjat tona për Faraonin dhe njerëzit e tij,

* 7:102 Kjo jetë është mundësia jonë e fundit për ta shpënuar veten, por shumica e njerëzve janë vërtetuar të jenë kryengritës kokëfortë dhe të këqij (shih HYRJEN).

por ata u bënë shkelës. Vini re pasojat për shpirtligjtë.

[104] Moisiu tha, "O Faraon, unë jam i dërguar nga Zotëruesi i gjithësisë.

[105] "Jam caktuar që të mos them për Zotin përveç të vërtetës. Unë vij te ju me një shenjë nga Zotëruesi juaj; lërimi Fëmijët e Izraelit të shkojnë."

[106] Ai tha, "Nëse ke një shenjë, atëherë prodhoje, nëse je i sinqertë."

[107] Ai e hodhi shkopin e tij, dhe u shndërrua në gjarpër të llahtarshëm.

[108] E nxori dorën e tij, dhe ishte e bardhë për spektatorët.

[109] Udhëheqësit mes njerëzve të Faraonit thanë, "Ky nuk është asgjë më shumë se magjistar i shkathët.

[110] "Ai dëshiron t'ju nxjerrë nga toka juaj; çka rekomandoni?"

[111] Thanë, "Jepi afat atij dhe vëllait të tij, dhe dërgoni mbledhës në çdo qytet.

[112] "Le të mbledhin çdo magjistar me përvojë."

[113] Magjistarët erdhën te Faraoni dhe thanë, "A paguhemi nëse jemi fitues?"

[114] Tha, "Po; madje do të bëheni të afërmit e mi."

[115] Thanë, "O Moisi, ose hidh ti, ose ne po hedhim."

[116] Tha, "Hidhni ju." Kur ata hodhën, i futën në dredhi sytë e njerëzve, i trembën, dhe prodhuan një magji të madhe.

[117] Ne pastaj e frymëzuam Moisiun: "Hidhe shkopin tënd," ku gëlltiti çfarëdo që trilluan ata.

E Vërteta njihet nga ekspertët

[118] Kështu, e vërteta triumfoi, dhe çka ata bënë u asgjësua.

[119] Ata u mposhtën aty dhe atëherë; u poshtëruan.

[120] Magjistarët ranë në përulje.

[121] Thanë, "Ne besojmë në Zotëruesin e gjithësisë.

[122] "Zotëruesin e Moisiut dhe të Aronit."

[123] Faraoni tha, "A besuat në të pa lejen time? Ky duhet të jetë një komplot që e thurët në qytet, në mënyrë që t'i nxirrni njerëzit e tij. Do e shihni çka ju gjen.

[124] "Do t'ju pres duart dhe këmbët në anët e kundërta, pastaj do t'ju kryqëzoj të gjithëve."

[125] Thanë, "Atëherë ne do të kthehemi te Zotëruesi ynë.

[126] "Ti na persekuton vetëm sepse ne besuam në provat e Zotëruesit tonë kur ato na erdhën." "Zotëruesi ynë, na dhuro durim, dhe le të vdesim si të nënshtruar."

[127] Udhëheqësit mes njerëzve të Faraonit thanë, "A do e lejosh Moisiun dhe njerëzit e tij ta korruptojnë tokën, dhe të heqin dorë nga ti dhe zotat e tu?" Ai tha, "Do i vrasim bijtë e tyre, dhe t'i kursejmë bijat e tyre. Ne jemi shumë më të fuqishëm se ata."

[128] Moisiu i tha njerëzve të tij, "Kërkoni ndihmën e Zotit, dhe këmbëngulni me durim. Toka është e Zotit, dhe Ai ia dhuron kujtdo që Ai zgjedhë mes shërbyesve të Tij. Fitorja përfundimtare i takon të drejtëve."

[129] Ata thanë, "Ne u persekutuam para se të vije te ne, dhe pasi që erdhe te ne." Ai tha, "Zotëruesi juaj do të asgjësojë armikun tuaj dhe t'ju themelohë juve në tokë, pastaj do të shohë si silleni ju."

Fatkeqësitë

[130] Pastaj i leqendisëm njerëzit e Faraonit me thatësi, mungesë të të korrave, që të mund të marrin vesh.

[131] Kur shenja të mira kalonin kah ta, thoshin, "E kemi merituar këtë," por kur ndonjë vështirësi i

legendiste, e fajësonin Moisiun dhe ata me të. Në fakt, të mirat e tyre caktohen vetëm nga Zoti, por shumica e tyre nuk e dinë.

[132] Ata thanë, “Çfarëdo shenje që na tregon për të na mashtruar me magjinë tënde, ne nuk do të besojmë.”

Paralajmërimet kalojnë pa ua vënë veshin

[133] Si pasojë, ne dërguam mbi ta vërshimin, karkalecat, morrat, bretkosat, dhe gjakun – shenja të qarta. Por ata vazhduan mendjemadhësinë e tyre. Ata ishin njerëz të këqij.

[134] Sa herë që një bela i zinte, thoshin, “O Moisi, lutju Zotëruesit tënd – ti je i afërt me Të. Nëse na heqë këtë bela, ne do të besojmë me ty, dhe do i dërgojmë Fëmijët e Izraelit me ty.”

[135] Prapëseprapë, kur ua hoqëm belanë për ndonjë gjatësi kohe, ata e shkelën zotimin e tyre.

Ndëshkimi i pashmangshëm

[136] Si pasojë, u hakmorëm për veprat e tyre, dhe i mbytëm në det. Kjo është për shkak se ata refuzuan shenjat tona, dhe nuk ua vunë veshin aspak.

[137] E njerëzit e shtypur i lejuam ta trashëgojnë tokën, lindje e perëndim, dhe e bekuam. Kështu u përmbushën urdhrat e bekuara të Zotëruesit tënd për Fëmijët e Izraelit, për t’i shpërblyer për durimin e tyre, dhe i asgjësuar punët e Faraonit dhe njerëzve të tij dhe çdo gjë që vjelën.

Pas gjithë atyre mrekullive

[138] I çuam Fëmijët e Izraelit matanë detit. Kur kaluan kah njerëz që po adhuronin statuja, thanë, “O Moisi, bëje një zot për ne, sikur zotat që kanë ata.” Ai tha, “Vërtetë jeni njerëz të padijshëm.

[139] “Këta njerëz janë duke bërë blasfemi, se ajo çka po bëjnë është shkatërrimtare për ta.

[140] “A të kërkoj për ju tjetër pos Zotit të jetë zoti juaj, kur Ai ju ka bekuar juve më shumë se cilindo tjetër në botë?”

Kujtim për Fëmijët e Izraelit

[141] Kujtohuni që ju çliruam nga njerëzit e Faraonit, që shkaktuan persekutimin më të keq mbi ju, duke jua vrarë djemtë dhe kursyer vajzat. Ishte një provë e vështirë për ju prej Zotëruesit tuaj.

Bota jonë nuk mund ta durojë praninë fizike të Zotit

[142] E thirrëm Moisiun për tridhjetë net, dhe i plotësuam ato duke shtuar dhjetë. Pra, dëgjimi me Zotëruesin e tij zgjati dyzet* net. Moisiu i tha vëllait të tij Aronit, “Rri këtu me njerëzit e mi, mbaje drejtësinë, dhe mos i ndiq rrugët e korruptuesve.”

[143] Kur Moisiu erdhi në kohën tonë të caktuar, dhe Zotëruesi i tij foli me të, ai tha, “Zotëruesi im, më le të shikoj dhe të të shoh Ty.” Ai tha, “Nuk mund të më shohësh Mua. Shikoje malin; nëse rri në vendin e vet, atëherë mund të më shohësh Mua.” Pastaj, Zotëruesi i tij ia shfaqti Veten malit, dhe kjo e bëri të thërrmohet. Moisiut i ra të fikët. Kur erdhi në vete, tha, “Qofsh i madhëruar. Pendo hem para teje, dhe jam besimtari më i bindur.”

[144] Ai tha, “O Moisi, të kam zgjedhur, nga të gjithë njerëzit, me lajmet e Mia dhe duke të folur ty. Prandaj, merr çka të kam dhënë dhe ji mirënjohës.”

[145] Ne shkruam për të në pllaka të gjitha llojet e këshillave dhe hollësitat e çdo gjëje: “T’i përmbahesh fort këtyre mësimëve, dhe nxiti njerëzit e tu t’iu përmbahen atyre – këto janë mësimet më të mira. Do të nxjerr në pah për ju fatin e shpirtligjve.”

Ndërrhyrja Hyjnore mbanë mosbesimtarët në errësi

[146] Do i largoj nga shpalljet e Mia ata që janë padrejtësisht mendjemëdhenj në tokë. Si pasojë,

* 7:142 Mënyra në të cilën këta numra janë përmendur është domethënëse. Siç tregohet në hollësi në Shtojcën 1, të gjithë numrat e përmendur në Kuran japin shumën 162146, 198534.

kur të shohin çdo lloj prove nuk do të besojnë. Dhe kur ta shohin rrugën e udhëzimit nuk do e përvetësojnë si rrugë të tyre, por kur e shohin rrugën e humbjes do e përvetësojnë si rrugë të tyre. Kjo është pasoja e refuzimit të tyre të provave tona, dhe të qenit e tyre plotësisht të pavëmendshëm për to.

[147] Ata që refuzojnë shpalljet tona dhe takimin e Përjetësisë, punët e tyre janë asgjësuar. A paguhen veç për çka bënë?

Viçi i artë

[148] Gjatë mungesës së Moisiut, njerëzit e tij bënë prej stolive të tyre statujën e një viçi, komplet me zë viçi.* A nuk e panë se nuk mund tu fliste, ose t'i udhëzonte në ndonjë rrugë? E adhuruan, dhe kështu u bënë shpirtligj.

[149] Kur më në fund i ranë pishman për veprën e tyre, dhe e kuptuan se kishin humbur rrugën, thanë, "Po të mos na shpengojë Zotëruesi ynë me mëshirën e Tij, dhe të na falë, do të jemi humbës."

[150] Kur Moisiu u kthye te njerëzit e tij, i zemëruar dhe i zhgënjyer, tha, "Çfarë gjëje të tmerrshme keni bërë në mungesë timen! A nuk mund të prisnit për urdhrat e Zotëruetit tuaj?" Pastaj i hodhi pllakat, dhe e kapi vëllanë e vet për koke, duke e tërhequr kah vetja. (Aroni) tha, "Bir i nënës sime, njerëzit e keqpërdorën dobësinë time, dhe pothuajse më vranë. Le të mos gëzohen armiqtë e mi, dhe mos më llogarit me njerëzit shkelës."

[151] (Moisiu) tha, "Zotëruesi im, na fal mua dhe vëllanë tim, dhe pranona në mëshirën Tënde. Nga gjithë të mëshirshmit, Ti je më i Mëshirshmi."

[152] Patjetër, ata që idolizuan viçin kanë vetëshkaktuar zemërim prej Zotëruetit të tyre, dhe poshtërim në këtë jetë. Kështu i paguajmë shpikësit.

[153] Sa për ata që kryen mëkate, pastaj u penduan më pas dhe besuan, Zotëruesi yt – pas kësaj – është Falës, i Mëshirshmi.

[154] Kur zemërimi i Moisiut ra, ai mblodhi pllakat, që përmbanin udhëzim dhe mëshirë për ata që ia kanë dronë Zotëruetit të tyre.

[155] Moisiu pastaj zgjodhi shtatëdhjetë burra mes njerëzve të tij, për të ardhur te audienca që caktuam. Kur i dridhi tërmeti, ai tha, "Zotëruesi im, Ti ke mundur t'i asgjësosh ata në të kaluarën, së bashku me mua, po të doje. A do të na asgjësosh për veprat e atyre mes nesh që janë të pamend? Ky duhet të jetë testi që ke përgatitur për ne. Me të, e dënon këdo që vendos, dhe e udhëzon këdo që do. Ti je Zotëruesi dhe Sunduesi ynë, prandaj falna, derdhna mëshirën Tënde; Ti je Falësi më i mirë.

Kushtet për arritjen e mëshirës së Zotit: Rëndësia e Zeqatit

[156] "Dhe vendos për ne drejtësinë në këtë botë, dhe në Përjetësi. Jemi penduar te Ti." Ai tha, "Ndëshkimi Im i bie kujtdo që Unë vendos. Por mëshira Im e përfshinë të gjitha gjërat. Megjithatë, Unë do e përcaktoj për ata që (1) çojnë jetë të drejtë, (2) japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat),* (3) besojnë në shpalljet tona, dhe

[157] "(4) ndjekin të dërguarin, profetin e pa shkrim (Muhamedin), që e gjejnë të shkruar në Torah dhe Ungjillin e tyre.* Ai i nxit ata të jenë të drejtë, ua ndalon keqberjen, ua lejon të gjitha

* 7:148 Se si viçi i artë mori zërin e një viçi shpjegohet në Shënimin Shtesë 20:96.

* 7:156 Rëndësia e bamirësisë së obligueshme (Zeqat) nuk ka mundësi të mbivlerësohet. Siç thuhet në 6:141, Zeqati duhet të jepet ditën e pranimit të të ardhurave – 2.5 % të të ardhurave neto duhet t'i jepen prindërve, të afërmeve, jetimëve, të varfërve, dhe udhëtarit të huaj, në këtë rend (shih 2:215).

* 7:157 Muhamedi është i profetizuar te Ligji i Përtërirë 18:15-19 dhe Gjoni 14:16-17 & 16:13.

ushqimet e mira, dhe ndalon atë që është e keqe, dhe ua shkarkon barrët dhe prangat e vëna mbi ta. Ata që besojnë në të, e respektojnë, e përkrahin, dhe ndjekin dritën që erdhi me të janë të suksesshmit.”

[158] Thuaj, “O njerëz, jam i dërguar i Zotit për të gjithë ju. I Tij është sovraniteti i qiejve dhe tokës. Nuk ka asnjë zot përveç Atij. Ai e ka në dorë jetën dhe vdekjen.” Prandaj, të besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij, profetin e pa shkrim, që beson në Zotin dhe fjalët e Tij. Ta ndiqni atë, që të jeni të udhëzuar.

Jahuditë e udhëzuar

[159] Mes ndjekësve të Moisiut ka që udhëzojnë në përputhje me të vërtetën, dhe e vërteta i bën të drejtë.

Mrekulli në Sinai

[160] I ndamë në dymbëdhjetë shoqëri fisnore, dhe Moisiun e frymëzua kur njerëzit e tij i kërkuan ujë: “Bjeri shkëmbit me shkopin tënd,” prej ku shpërthyen dymbëdhjetë burime. Pra, secila shoqëri e dinte ujin e saj. Dhe iu bëmë hije me re, dhe iu lëshuam rrëshirë dhe shkurtëza: “Hani nga gjërat e mira që ju furnizua.” Nuk na bënë keq neve; janë ata që i bënë keq vetvetes.

Kryengritje përkundër mrekullive

[161] Kujtohuni që u ishte thënë, “Hyni në këtë qytezë për të jetuar, dhe hani aty si të keni qejf, trajtoni njerëzit mirë, dhe hyni te porta kokulur. Pastaj do t’ju falim shkeljet. Do e shumëfishojmë shpërblimin për të drejt.”

[162] Por të këqij të tyre i zëvendësuan urdhrat që u ishin dhënë me urdhra të tjera. Si pasojë, dërguam mbi ta dënim nga qielli, për shkak të shpirtligësisë së tyre.

Zbatimi i urdhrave sjell përparim

[163] Ua kujto atyre shoqërinë pranë detit, që nuk respektuan të Shtunën. Kur e zbatonin të Shtunën, peshqit iu vinin me bollëk. Dhe kur e prishnin të Shtunën, peshqit nuk iu vinin. Kështu pra i molisëm, si pasojë e shkeljes së tyre.

Përqeshin lajmin e Zotit

[164] Kujtohuni që një grup prej tyre tha, “Pse duhet t’iu predikoni njerëzve që Zoti do i asgjësojë ose do i ndëshkojë rreptë?” Ata u përgjigjën, “Kërkoni falje Zotëruesit tuaj,” që të mund të shpëtohen.

[165] Kur e shpërfillën atë me të cilën ishin kujtuar, i shpëtua ata që ndaluan të keqen, dhe i molisëm keqbërësit me ndëshkim të tmerrshëm se ishin shpirtligj.

[166] Kur vazhduan t’i hedhin sfidë haptazi urdhrave, iu thamë atyre, “Qofshi majmunë të përbuzur.”

[167] Plus, Zotëruesi yt ka shpallur që do të ngritë kundër tyre njerëz që do të shkaktojnë keqtrajtime të rrepta mbi ta, deri në Ditën e Ringjalljes. Zotëruesi yt është më i shkathëti në zbatimin e ndëshkimit, dhe Ai është padyshim Falësi, i Mëshirshmi.

[168] I shpërndamë mes shumë shoqërive nëpër tokë. Disa prej tyre ishin të drejtë, dhe disa ishin më pak se të drejtë. I testuam me përparim dhe vështirësi, që të mund të kthehen.

[169] Pas tyre, zëvendësuam gjenerata të reja që e trashëguan shkrimin. Por në vend të kësaj ata u kapën pas jetës së kësaj bote, duke thënë, “Do të falemi.” Por pastaj vazhduan të kapen pas kënaqësive materiale të kësaj bote. A nuk e dhanë besën se do i përmbahen shkrimit, dhe të mos thonë për Zotin përveç të vërtetës? A nuk e studiuam shkrimin? Padyshim, vendbanimi i Përjetësisë është shumë më i mirë për ata që i përmbahen drejtësisë. A nuk kuptoni?

[170] Ata që i përmbahen shkrimit, dhe zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), nuk ngecim së shpërblyeri besimtarët.

[171] E ngritëm malin mbi ta si një çadër, dhe menduan se do tu binte përmbi: “T’i përmbaheni asaj që ju dhamë, me vendosmëri, dhe përkujtoni përmbajtjen e saj, që të mund të shpëtoheni.”

*Jemi të lindur me dije instiktive për Zotin**

[172] Kujtohu kur Zotëruesi yt i mblodhi të gjithë pasardhësit e Ademit, dhe i bëri të dëshmojnë për vete: “A nuk jam Zotëruesi juaj?” Ata të gjithë thanë, “Po. Dëshmojmë.” Pra, nuk mund të thoni në Ditën e Ringjalljes, “Nuk ishim të vetëdijshëm për këtë.”

[173] As nuk mund të thoni, “Ishin prindërit tanë që praktikonin idhujtari, dhe ne thjeshtë ndoqëm hapat e tyre. A do të na ndëshkosh për shkak të asaj që të tjerët e shpikën?”

[174] Kështu pra i shpjegojmë shpalljet, që t’iu mundësojmë njerëzve ta shpengojnë veten.*

[175] Ua recito lajmin e atij që iu dhanë provat tona, por zgjodhi t’i shpërfillë. Si pasojë, djalli e ndoqi, deri sa u bë humbës.

[176] Sikur të donim, ne do e kishim lartësuar me të, por ai ngulte këmbë, dhe ndiqte mendimet e veta. Pra, ai është si qeni; e përkëdhele apo e përzure, ai e nxjerr gjuhën. I tillë është shembulli i njerëzve që refuzojnë provat tona. Kallëzo këto kallëzime, që të mund ta marrin me mend.

[177] I keq vërtetë është shembulli i njerëzve që refuzojnë provat tona; vetëm vetes i bëjnë keq.

[178] Këdo që Zoti e udhëzon është vërtetë i udhëzuar, dhe këdo që Ai e parashtron në humbje, këta janë humbësit.

Dreqi i hipnotizon përbërësit e tij

[179] Kemi parashtruar në Ferr mori xhinësh dhe njerëzish. Ata kanë mendje me të cilat nuk kuptojnë, sy me të cilat nuk shohin, dhe veshë me të cilat nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët; jo, janë shumë më të këqij – janë plotësisht të pavetëdijshëm.

[180] Të Zotit janë emrat më të bukur; thirreni Atë me to, dhe shpërfillni ata që shtrembërojnë emrat e Tij. Ata do të paguhen për mëkatet e tyre.

[181] Mes krijesave tona, ka prej tyre që udhëzojnë me të vërtetën, dhe e vërteta i bën të drejtë.

[182] Sa për ata që refuzojnë shpalljet tona, i çojmë në rrugën e tyre pa e kuptuar ata.

[183] Madje do i inkurajoj; Planifikimi Im është i fortë.

[184] Pse nuk reflektojnë mbi shokun e tyre (të dërguarin)? Ai nuk është i çmendur. Ai është thjeshtë një paralajmërues sqarues.

[185] A nuk e kanë shikuar pushtetin e qiejve dhe tokës, dhe të gjitha gjërave që ka krijuar Zoti? A u shkon ndërmend atyre se fundi i jetës së tyre mund të jetë afër? Në cilin Hadith, përkrah këtij, besojnë ata?

[186] Këdo që Zoti e parashtron në humbje, nuk ka asnjë mënyrë për ta udhëzuar ndokush. Ai i lë ata të enden në mëkatet e tyre.

[187] Të pyesin për orën (fundin e botës*), dhe kur do i vij koha. Thuaj, “Njohuria për të është me Zotëruesin tim. Vetëm Ai e zbulon kohën e saj. Rëndë është në qiej dhe tokë. Nuk do t’ju vijë juve përveç papritmas.”* Të pyesin nëse e ke atë në dorë. Thuaj, “Njohuria për të është me Zotin,” por shumica e njerëzve nuk e dinë.

* 7:172 Pra, çdo qenie njerëzore është e lindur me dije instiktive për Zotin.

* 7:174 Kjo jetë është mundësia jonë e fundit që të kthehemi në Mbretërinë e Zotit (Shih HYRJEN).

* 7:187 Koha e duhur për ta zbuluar këtë njoftim është paracaktuar të jetë viti 1980 Pas Lindjes së Krishtit., nëpërmjet të të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes (Shih 15:87, 72:27, dhe Shtojcat 2 & 11).

* 7:187 “Ora” u vjen “papritmas” vetëm mosbesimtarëve (Shih Shtojcën 11).

Të dërguarit janë të pafuqi; nuk e dinë të ardhmen

[188] Thuaj, “Unë nuk kam fuqi t’i bëj dobi ose dëm vetes. Mua më ndodhë vetëm çka Zoti do. Sikur të dija të ardhmen, do të shtoja pasurinë time, dhe asnjë e keqe nuk do të më ndodhte. Unë nuk jam asgjë më shumë se një paralajmërues, dhe bartës i lajmeve të mira për ata që besojnë.”

Fëmijët tanë mund të jenë idhuj

[189] Ai ju krijoi juve prej një vete (Ademit). Më pas, Ai i jep burrit të shoqen që të gjejë qetësi me të. Ajo pastaj bartë një barrë të lehtë që mezi e vëren. Përderisa barra bëhet më e rëndë, ata i luten Zotit, Zotëruesit të tyre: “Nëse na jep një bebe të mirë, do të jemi mirënjohës.”

[190] Por kur Ai ua jep një bebe të mirë, e shndërrojnë dhuratën e Tij në idhull që e rivalizon Atë. I lartësuar qoftë Zoti, shumë larg nga ndonjë ortakëri.

[191] A nuk është e vërtetë se ata po idhujtarizojnë idhuj që nuk krijojnë asgjë, dhe janë vetë të krijuar?

[192] Idhuj që as nuk mund t’iu ndihmojnë, madje as t’i ndihmojnë vetes?

[193] Kur i ftoni në udhëzim, nuk ju ndjekin. Pra, është njëjtë për ta, i ftuat apo heshtët.

[194] Idhujt që kërkoni përveç Zotit janë krijesa si ju. Lirisht thirrni; le t’ju përgjigjen, nëse keni të drejtë.

[195] A kanë këmbë me të cilat ecin? A kanë duar me të cilat mbrohen? A kanë sy me të cilët shohin? A kanë veshë me të cilët dëgjojnë? Thuaj, “Thirrni idhujt tuaj, dhe u thoni të më asgjësojnë pa vonesë.

[196] "Zoti është Zotëruesi dhe Sunduesi im i vetëm; Ai që e shpalli këtë shkrim. Ai i mbron të drejtit.

[197] "Sa për idhujt që i ngritni përkrah Tij, ata nuk mund t’ju ndihmojnë, as nuk mund t’i ndihmojnë vetes.”

[198] Kur i ftoni në udhëzim, nuk dëgjojnë. Dhe i shihni duke ju shikuar, por nuk shohin.

[199] Ji i ndjeshëm, përkrahe tolerancën, dhe shpërfilli të padijshmit.

[200] Kur djalli të pëshpëritë ndonjë pëshpëritje, kërko strehim te Zoti; Ai është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.

[201] Ata që janë të drejtë, sa herë që djalli iu qaset me ndonjë ide, ata përkujtojnë, ku edhe bëhen pamës.

[202] Vëllazëria e tyre pandarë i joshin për të shkuar në humbje.

[203] Nëse ti nuk e prodhon ndonjë mrekulli që e kërkojnë, ata thonë, “Pse nuk po e kërkon atë?” Thuaj, “Unë thjeshtë e ndjek atë që më është shpallur nga Zotëruesi im.” Këto janë ndriçime nga Zotëruesi juaj, dhe udhëzim, dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.

[204] Kur Kurani recitohet, ta dëgjoni dhe jini të vëmendshëm, që të mund të arrini mëshirë.

[205] Ta përkujtosh Zotëruesin tënd përbrenda vetes, publikisht, privatisht, në heshtje, ditë e natë; mos u bë i pavetëdijshëm.*

[206] Ata te Zotëruesi yt kurrë nuk janë tepër krenarë për ta adhuruar Atë; ata e madhërojnë Atë dhe bien në përlulje para Tij.

* 7:205 Zoti yt është kushdo apo çfarëdo ta preokupon mendjen shumicën e ditës. Kjo e shpjegon faktin se shumica e atyre që besojnë në Zotin janë të paracaktuar për Ferr (Shih 12:106, 23:84-90, dhe Shtojcën 27).

Surja 8: Plaça e luftës (El-Enfal)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Këshillohen me ty rreth plaçkës së luftës. Thuaj, "Plaça e luftës i takon Zotit dhe të dërguarit." T'ia keni dronë Zotit, ta nxitni njëri tjetrin për të qenë të drejtë, dhe t'i bindeni Zotit dhe të dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë.

Besimtarët e vërtetë

[2] Besimtarët e vërtetë janë ata zemrat e të cilëve dridhen kur Zoti përmendet, dhe kur shpalljet e Tij iu recitohen, besimi i tyre forcohet, dhe ata kanë besim në Zotëruesin e tyre.

[3] Ata i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe nga furnizimet tona te ta, ata japin bamirësi.

[4] Të tillë janë besimtarët e vërtetë. Ata arrijnë rangje të larta te Zotëruesi i tyre, si dhe falje dhe furnizim me bollëk.

Besimtarët e dobët

[5] Kur Zotëruesi yt dëshiroi që ta lësh shtëpinë tënde, për të përmbushur një plan të posaçëm, disa besimtarë dolën në shesh si besimtarë ngurrues.

[6] Ata u grindën me ty kundër të vërtetës, edhe pasi që çdo gjë u ishte shpjeguar atyre. Ata u sillën sikur po çoheshin në vdekje të sigurt.

[7] Kujtohuni që Zoti ju premtoi fitore mbi një grup të caktuar, por ju prapëseprapë deshët të përballeni me grupin e dobët. Plani i Zotit ishte që ta themelojë të vërtetën me fjalët e Tij, dhe t'i mposhtë mosbesimtarët.

[8] Se Ai ka shpallur që e vërteta do të triumfojë, dhe e pavërteta do të zhduket, përkundër keqbërësve.

Ushtarët e padukshëm të Zotit

[9] Pra, kur iu lutët Zotëruesit tuaj t'ju shpëtojë, Ai ju përgjigj juve: "Unë po ju përkrahë me njëmijë engjëj varg."

Fitorja e garantuar për besimtarët

[10] Zoti jua dha këtë lajm të mirë për t'ju forcuar zemrat. Fitorja vjen vetëm prej Zotit. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[11] Ai bëri që një kotje e qetë t'ju kaplojë dhe t'ju qetësojë, dhe Ai lëshoi ujë nga qielli për t'ju larë me të. Ai ju mbrojti nga mallkimi i djallit, jua bindi prapë zemrat dhe jua përforcoi këmbët.

*Mësime nga historia**

[12] Kujtohu që Zotëruesi yt i frymëzoi engjëjt: "Unë jam me ju; prandaj përkrahni ata që besuan. Unë do të hedhë tmerr në zemrat e atyre që nuk besuan. Ju mund t'iu bini atyre mbi qafë, dhe mund t'i bini madje edhe çdo gishti të tyre."

[13] Kjo është çka ata kanë vetëshkaktuar duke e luftuar Zotin dhe të dërguarin e Tij. Për ata që luftojnë kundër Zotit dhe të dërguarit të Tij, ndëshkimi i Zotit është i rëndë.

[14] Kjo është për t'i dënuar mosbesimtarët; ata kanë vetëshkaktuar ndëshkimin e Ferrit.

[15] O ju që besoni, nëse ndesheni me mosbesimtarët që janë mobilizuar kundër jush, mos u ktheni prapa e të ikni.

[16] Kushdo që kthehet prapa në atë ditë, përveç për të bartur plan beteje, ose për t'iu bashkangjitur grupit të tij, ka vetëshkaktuar zemërim nga Zoti, dhe vendbanimi i tij është Ferri; çfarë fati i tmerrshëm!

* 8:12-16 Të gjitha luftërat janë të rregulluara me rregullin themelor në 60:8-9.

*Zoti po bën çdo gjë**

[17] Nuk ishit ju ata që i vratë; Zoti është Ai që i vrau. Nuk ishe ti ai që gjuajte kur gjuajte; Zoti është Ai që gjuajti. Por Ai kështu ua jep besimtarëve rastin për të merituar shumë të mira. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.

[18] Aq më shumë, Zoti i asgjëson kurthet e mosbesimtarëve.

[19] Kërkuat fitore (o mosbesimtarë), dhe fitorja erdhi; iu takoi besimtarëve. Nëse hiqni dorë (nga agresioni) do të ishte më mirë për ju, por nëse ktheheni, edhe ne kthehemi. Ushtritë tuaja nuk do t'ju ndihmojnë, pa marrë parasysh sa të mëdha. Se Zoti është në anën e besimtarëve.

[20] O ju që besoni, t'i bindeni Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe mos e shpërfillni atë përderisa dëgjoni.

Mosbesimtarëve ju ndalohet dëgjimi

[21] Mos u bëni si ata që thonë, "Dëgjojmë," kur nuk dëgjojnë.

[22] Krijesat më të këqija para Zotit janë të shurdhrit dhe memecët, që nuk kuptojnë.

[23] Sikur Zoti të njihte ndonjë të mirë në ta, Ai do i bënte dëgjues. Edhe sikur t'i bënte dëgjues, ata ende do refuzonin me neveri.

*Të drejtit nuk vdesin vërtetë**

[24] O ju që besoni, t'i përgjigjeni Zotit dhe të dërguarit kur ai ju fton në çka ju jep jetë. Duhet ta dini se Zoti është më afër jush se zemra juaj, dhe se para Tij do të mblidheni.

[25] Ruajuni nga një ndëshkim që mund të mos jetë i kufizuar vetëm te keqbërësit mes jush.* Duhet ta dini se ndëshkimi i Zotit është i rreptë.

Zoti i përkrahë besimtarët

[26] Përkujtoni që dikur ishit pak dhe të shtypur, dhe frikësoheshit mos njerëzit po ju rrëmbejnë, dhe Ai u dhuroi juve strehë të sigurt, ju përkrahu me fitoren e Tij, dhe ju furnizoi me furnizime të mira, që të mund të jeni mirënjohës.

[27] O ju që besoni, mos e tradhtoni Zotin dhe të dërguarin, dhe mos i tradhtoni ata që kanë besim në ju, tash që e dini.

Paratë dhe fëmijët janë test

[28] Duhet ta dini se paratë tuaja dhe fëmijët tuaj janë test, dhe se Zoti posedon shpërblim shumë të madh.

[29] O ju që besoni, nëse ia keni dronë Zotit, Ai do t'ju ndriçojë, do i heqë mëkatet tuaja, dhe t'ju falë. Zoti posedon hirësi pakufi.

Zoti e mbron të dërguarin e tij

[30] Mosbesimtarët thurin kurthe dhe planifikojnë t'ju neutralizojnë, ose t'ju vrasin, ose t'ju dëbojnë. Megjithatë, ata thurin kurthe dhe planifikojnë, por edhe Zoti planifikon. Zoti është planifikuesi më i mirë.

[31] Kur shpalljet tona iu recitohen atyre, thonë, "Kemi dëgjuar. Sikur të donim, do të kishim mundur t'i thoshim të njëjtat gjëra. Këto nuk janë asgjë më shumë se përralla të moçme!"

[32] Ata gjithashtu thanë, "zoti ynë, nëse kjo është vërtetë e vërteta nga Ti, atëherë lëshona një rrebesh gurësh nga qielli, ose derdh mbi ne një ndëshkim që dhemb."

* 8:17 Të besuarit në Zotin domosdo kërkon besimin në cilësitë e Tij, njëra prej të cilave është se Ai po bën çdo gjë. Pa e njohur Zotin, nuk ka aspak besim (23:84-90). Gjërat e këqija vetëshkaktohen nga ne, dhe zbatohen nga Dreqi, në përputhje me ligjet e Zotit (4:78-79, 42:30).

* 8:24 Shih Shtojcën 17. Kur të drejtit dalin prej trupave të tyre, ata shkojnë drejt në Parajsë.

* 8:25 Një shoqëri që toleron homoseksualitetin, për shembull, mund të goditet nga ndonjë termet.

[33] Megjithatë, Zoti nuk ka për t'i ndëshkuar ata përderisa ti je në mesin e tyre; Zoti nuk ka për t'i ndëshkuar përderisa janë duke kërkuar falje.

[34] A nuk e kanë merituar ndëshkimin e Zotit, duke i kthyer prapa të tjerët nga Vendlutja e Shenjtë, edhe pse ata nuk janë kujdestar të saj? Kujdestarët e vërtetë të saj janë të drejtit, por shumica e tyre nuk e dinë.

*Lutjet e Kontaktit (Salat) ekzistonin para Kuranit**

[35] Lutjet e tyre të Kontaktit (Salat) te faltarja (Qabja) nuk ishin asgjë më shumë se tallje dhe mënyrë për t'i kthyer njerëzit prapa (duke ua zënë turma rrugën). Prandaj, vuani ndëshkimin për mosbesimin tuaj.

*Shpenzojnë paratë e tyre për ta luftuar Zotin**

[36] Ata që nuk besojnë i shpenzojnë paratë e tyre për t'i kthyer prapa të tjerët nga rruga e Zotit. Ata do i shpenzojnë, dhe do tu shndërrohen në dhimbje dhe brejtje ndërgjegjeje. Përfundimisht, do të mposhten, dhe të gjithë mosbesimtarët do të mblidhen në Ferr.

[37] Zoti do të ndajë të keqen nga e mira, pastaj të këqijtë do i grumbulloj njërin mbi tjetrin, të gjithë në një turrë, pastaj do i hedhë në Ferr. Të tillë janë humbësit.

[38] Thuaju atyre që nuk besuan: nëse ndalen, e gjithë e kaluara e tyre do të falet. Por nëse kthehen prapa, do të vetëshkaktojnë fatin e njëjtë si homologët e tyre paraprak.

[39] T'i luftoni ata për ta hequr shtypjen, dhe për ta praktikuar fenë tuaj të kushtuar vetëm Zotit. Nëse ata përmbahen nga agresioni, atëherë Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëjnë.

[40] Nëse kthehen, atëherë duhet ta dini se Zoti është Zotëruesi dhe Sunduesi juaj, Zotëruesi dhe Sunduesi më i mirë, përkrahësi më i mirë.

[41] Duhet ta dini se nëse fitoni ndonjë plaçkë në luftë, një e pesta t'i shkojë Zotit dhe të dërguarit, për t'iu dhënë të afërmve, jetimëve, të varfërve, dhe udhëtarit të huaj. Do e bëni këtë nëse besoni në Zotin dhe në çka i shpallëm shërbëtorit tonë në ditën e vendimit, ditën kur dy ushtritë u ndeshën. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Zoti e ka në dorë çdo gjë dhe planifikon për besimtarët

[42] Kujtohuni që ju ishit në këtë anë të luginës, përderisa ata ishin në anën tjetër. Pastaj karvanit të tyre iu desh të lëvizte në terren më të ulët. Sikur ta planifikonit kështu, nuk do të mund ta kishit bërë. Por Zoti kishte për të kryer një çështje të paracaktuar, me të cilën ata që ishin paracaktuar të asgjësohen u asgjësuan për arsye të qartë, dhe ata që ishin paracaktuar të shpëtoheshin u shpëtuan për arsye të qartë. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijsëm.

[43] Zoti i bëri ata të duken në ëndrrën tënde (o Muhamed) më pak në numër. Sikur t'i bënte të dukeshin më të shumtë, do të dështonit, dhe do të grindeshit mes vete. Por Zoti ju nxorri nga një situatë e tillë. Ai është Njohësi i mendimeve më të thella.

[44] Dhe kur koha erdhi dhe ju u përballët me ta, Ai i bëri ata të duken më të paktë në sytë tuaj, dhe ju bëri juve të dukeni më të paktë në sytë e tyre po ashtu. Se Zoti deshi që ta kryej një plan të caktuar. Të gjitha vendimet merren nga Zoti.

[45] O ju që besoni, kur ndesheni me ndonjë ushtri, të keni durim dhe ta përkujtoni Zotin shpesh,

* 8:35 Të gjitha ritet fetare në Islam na erdhën nëpërmjet Ibrahimit; kur Kurani u shpall, të gjitha ritet në "Nënshtrim" ishin tashmë në ekzistencë (21:73, 22:78).

* 8:36 Udhëheqësit adhuroes idhujsh të Islamit të korruptuar, Arabia Saudite, kanë ndarë shumta të mëdha parash për ta luftuar Zotin dhe mrekullinë e Tij. Për shembull, shtëpia botuese e famshme "Dr Al-'Ilm Lil-Malyn" (Njohuri për Miliona) botoi versionin në arabisht të librit "Mrekullia e Kuranit" në Mars, 1983. Sauditët blenë të gjitha kopjet dhe i shkatërruan.

që të mund t'ia dilni.

[46] T'i bindeni Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe mos u grindni mes vete, se mos dështoni dhe e shpërndani forcën tuaj. Të duroni me këmbëngulje. Zoti është me ata që durojnë me këmbëngulje.

[47] Mos u bëni si ata që i lan shtëpitë e tyre me hezitim, vetëm për tu treguar, dhe në fakt i dekurajuan të tjerët nga ndjekja e rrugës së Zotit. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëjnë.

Djalli i sheh ushtarët e padukshëm të Zotit

[48] Djalli i kishte zbukuruar punët e tyre në sytë e tyre, dhe tha, "Nuk mund të mposhteni nga asnjë popull sot," dhe "Unë do të luftoj së bashku me ju." Por sapo të dy ushtritë u përballën me njëra tjetrën, ai ua ktheu shpinën dhe iku, duke thënë, "Unë nuk ju njoh. Unë shoh çka ju nuk shihni. Unë i frikësohem Zotit. Ndëshkimi i Zotit është tmerrues."

[49] Hipokritët dhe ata që ushqyen dyshim në zemrat e tyre thanë, "Këta njerëz janë mashtruar nga feja e tyre." Megjithatë, nëse dikush ka besim te Zoti, atëherë Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[50] Vetëm sikur t'i shihje ata që nuk besuan kur engjëjt i vënë në vdekje! Do i rrahin në fytyrat e tyre dhe në prapnicat e tyre; "Shijojeni ndëshkimin e Ferrit.

[51] "Kjo është pasojë e asaj që vepruat ju. Zoti nuk është i padrejtë ndaj krijesave."

[52] Ky është fat i njëjtë si ai i njerëzve të Faraonit dhe atyre që nuk besuan para tyre. Ata refuzuan shpalljet e Zotit, dhe Zoti i ndëshkoi për mëkatet e tyre. Zoti është i fuqishëm, dhe ndëshkimi i Tij është i rreptë.

Ndëshkimi: Pasoje e mëkatit

[53] Zoti nuk e ndryshon bekimin që e ka dhuruar mbi njerëz në mos vendosshin ata vetë të ndryshojnë. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshëm.

[54] I tillë ishte rasti me njerëzit e Faraonit dhe të tjerët para tij. Ata së pari i refuzuan shenjat e Zotëruesit të tyre. Si pasojë, i asgjësua për mëkatet e tyre. I mbytëm njerëzit e Faraonit; krejt shpirtligjtë u ndëshkuan.

[55] Krijesat më të këqija para Zotit janë ato që nuk besojnë; nuk mund të besojnë.

[56] Ti arrin marrëveshje me ta, por ata i shkelin marrëveshjet e tyre secilën herë; nuk janë të drejtë.

[57] Prandaj, nëse i ndeshni në luftë, t'i bëni si shembull tmerrues për ata që vijnë pas tyre, që të mund të marrin vesh.

[58] Kur tradhtoheni nga një grup njerëzish, të mobilizoheni kundër tyre në mënyrën e njëjtë. Zoti nuk i do tradhtarët.

[59] Le të mos mendojnë ata që nuk besojnë se mund të shpëtojnë; nuk mund të shpëtojnë.

Të jeni të përgatitur: Urdhër Hyjnore

[60] Të përgatitni për ta krejt fuqinë që mund të grumbulloni, dhe të gjitha pajisjet që mund t'i mobilizoni, që të mund t'i frikësoni armiqtë e Zotit, armiqtë tuaj, si dhe të tjerët që nuk i njihni; Zoti i njeh ata. Çfarëdo që të shpenzoni për Zotin do t'ju paguhet juve me bujari, pa as më të voglën padrejtësi.

[61] Nëse strehohen në paqe, edhe ju të bëni ashtu, dhe të keni besim te Zoti. Ai është Dëgjuesi, Më i Dijshmi.

Zoti iu mjafton besimtarëve

[62] Nëse dëshirojnë të të mashtrojnë, atëherë Zoti do të të mjaftojë. Ai do të të ndihmojë me

përkrahjen e Tij, dhe me besimtarët.

[63] Ai i ka pajtuar zemrat (e besimtarëve). Sikur t'i shpenzoje të gjitha paratë në tokë, nuk do të mund t'i pajtoje zemrat e tyre. Por Zoti i pajtoi ato. Ai është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[64] O ti profet, i mjaftueshëm për ty është Zoti dhe besimtarët që të kanë ndjekur.

[65] O ti profet, t'i nxisësh besimtarët për të luftuar. Nëse janë njëzet prej jush që janë të durueshëm, ata mund t'i mundin dyqind, dhe njëqind prej jush mund t'i mundin njëmijë prej atyre që nuk besojnë. Kjo është për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

[66] Tash (që shumë njerëz të ri ju bashkëngjitën juve) Zoti e ka bërë më të lehtë për ju, se Ai e di se nuk jeni aq të fortë sa dikur. Tash e tutje, njëqind besimtarë të durueshëm mund të mundin dyqind, dhe njëmijë prej jush mund të mundni dy mijë me lejen e Zotit. Zoti është me ata që durojnë me këmbëngulje.

[67] Nuk i takoi asnjë profeti të marrë rob të luftës, nëse nuk morri pjesë në luftë. Ju njerëz po kërkonit gjërat materiale të kësaj bote, përderisa Zoti përkrahë Përjetësinë. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[68] Po të mos ishte për paracaktimin prej Zotit, ju do të vuanit, në llogari të asaj që morët, një ndëshkim të tmerrshëm.

[69] Prandaj, hani nga plaçkat që i keni fituar, ato që janë të ligjshme dhe të mira, dhe ia keni dronë Zotit. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[70] O ti profet, tregojë të burgosurve të luftës që janë në duart tuaja, "Sikur Zoti të dinte ndonjë të mirë në zemrat tuaja, Ai do t'ju jepte më mirë se çfarëdo që keni humbur, dhe do t'ju falte. Zoti është Falës, i Mëshirshmi."

[71] Dhe nëse ata dëshirojnë të të tradhtojnë, ata veç e kanë tradhtuar Zotin. Për këtë Ai i bëri ata humbësit. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

[72] Padyshim, ata që besuan, dhe emigruan, dhe u përpoqën me paratë e tyre dhe jetët e tyre për Zotin, si dhe ata mikpritësit dhe strehuesit e tyre, dhe përkrahësit e tyre, ata janë aleat të njëri tjetrit. Sa për ata që besojnë, por nuk emigrojnë me ju, nuk iu detyrohemi me ndonjë përkrahje, derisa ata të emigrojnë. Megjithatë, nëse kanë nevojë për ndihmën tuaj, si vëllezër në besim, t'iu ndihmoni, përveç kundër njerëzve me të cilët keni nënshkruar traktat paqeje. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

[73] Ata që nuk besuan janë aleat të njëri tjetrit. Po të mos iu përmbaheni këtyre urdhrave, do të ketë kaos në tokë, dhe korrupsion të tmerrshëm.

[74] Ata që besuan dhe emigruan, dhe u përpoqën për Zotin, si dhe mikpritësit dhe strehuesit e tyre, dhe përkrahësit e tyre, këta janë besimtarët e vërtetë. Kanë merituar falje dhe shpërblim bujarë.

[75] Ata që besuan më pas, dhe emigruan, dhe u përpoqën me ju, ata përkasin me ju. Ata që janë të afërm me njëri tjetrin të jenë të parët që përkrahin njëri tjetrin, në përputhje me urdhrat e Zotit. Zoti është tërësisht i vetëdijshtëm për të gjitha gjërat.

Surja 9: Ultimatum (Bera'ah)

*Pa Bismilah**

[1] Një ultimatum është lëshuar këtu nga Zoti dhe i dërguari i Tij për adhuruesit e idhujve që futen në traktat me ju.

[2] Prandaj, enduni nëpër tokë lirshëm për katër muaj, dhe ta dini se nuk mund të ikni prej Zotit, dhe se Zoti i poshtëron mosbesimtarët.

[3] Një shpallje është lëshuar këtu nga Zoti dhe i dërguari i Tij për të gjithë njerëzit në ditën e madhe të shtegtimit, se Zoti i ka bërë hasha adhuruesit e idhujve, dhe ashtu bëri edhe i dërguari i Tij. Prandaj, nëse pendoheni, do të jetë më mirë për ju. Por nëse prapësoheni, atëherë ta dini se nuk mund të ikni prej Zotit. Premtoju atyre që nuk besojnë ndëshkim që dhemb.

[4] Nëse adhuruesit e idhujve nënshkruajnë traktat paqeje me ju, dhe nuk e shkelin, e as nuk bashkohen me të tjerët kundër jush, ta përmbushni traktatin tuaj me ta deri në datën e skadimit. Zoti i do të drejtit.

[5] Kur të kalojnë Muajt e Shenjtë, (dhe ata refuzojnë të bëjnë paqe) mund t'i vrisni adhuruesit e idhujve kur të ndesheni me ta, t'i ndëshkoni, dhe të rezistoni çdo lëvizje që bëjnë. Nëse pendohen dhe zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), t'i lëni të shkojnë. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[6] Nëse një nga adhuruesit e idhujve kërkon kalim të sigurt me ty, t'i japësh atij kalim të sigurt, kështu që ai ta dëgjojë fjalën e Zotit, pastaj ta dërgoni prapa te vendi i tij i sigurisë. Kjo është për shkak se ata janë njerëz që nuk dinë.

[7] Si mund adhuruesit e idhujve të kërkojnë ndonjë zotim nga Zoti dhe i dërguari i Tij? Përjashtim bëjnë ata që kanë nënshkruar traktat paqeje me ju te Vendlutja e Shenjtë. Nëse e respektojnë dhe i përmbahen një traktati të tillë, t'i përmbaheni gjithashtu. Zoti i do të drejtit.

[8] Si mund (të kërkojnë zotim) kur ata nuk respektojnë ndonjë të drejtë të lidhjeve familjare mes jush dhe tyre, as ndonjë besëlidhje, nëse ju jepej rasti të mbizotëronin. Ata bënë paqe me ju me fjalë goje, përderisa zemrat e tyre janë në opozitë, dhe shumica e tyre janë shpirtligj.

[9] Ata i ndërruan shpalljet e Zotit për një çmim të vogël. Si pasojë, ata i zbrapsën njerëzit nga rruga e Tij. E trishtueshme vërtetë është çka ata bënë!

[10] Ata nuk respektojnë ndonjë të drejtë të lidhjeve familjare ndaj ndonjë besimtari, e as nuk iu përmbahen besëlidhjeve të tyre; janë shkelësit e vërtetë.

Pendimi: Fillim i ri

[11] Nëse pendohen dhe zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), atëherë ata janë vëllëzërit tuaj në fe. Kështu i shpjegojmë shpalljet për njerëz që dinë.

[12] Nëse i shkelin betimet e tyre pasi që të jenë zotuar se do i mbajnë besët e tyre, dhe e sulmojnë

* 9:1 Mungesa e Bismilahut nga kjo sure nuk është vetëm një shenjë e qartë nga Autori i Plotfuqishëm i Kuranit se në këtë sure i kanë futur njerëzit duart, por gjithashtu paraqet një mrekulli mbresëlënëse me vend. Shih hollësitat në Shtojcat 24 & 29. 9:1 & 9:127 Kjo është e vetmja sure që nuk e ka parashtesën Bismilah. Ky fenomenin ka qenë mister për studiuesit e Kuranit për 14 shekuj, dhe janë nxjerrë teori për ta shpjeguar. Tash e kuptojmë se mungesa e dukshme e Bismilahut ka tri funksione: (1) Pasqyron shpallje hyjnore që më parë se adhuruesit e idhujve ishin paracaktuar t'i fusnin duart në Kuran duke shtuar 2 strofa të rrejshme (9:128-129). (2) Shpjegon një nga funksionet e kodit matematikor të Zotit në Kuran, domethënë, për ta ruajtur Kuranin kundër çfarëdo ndryshimi. (3) Furnizon veçori të mrekullueshme shtesë të kodit të Kuranit. Për shkak të rëndësisë jashtëzakonisht të madhe të tyre, detajet jepen në Shtojcat 24 dhe 29. Një vërtetim i menjëhershëm është se numri i ndodhjes së fjalës "Zot" në fund të Sures 9 është 1273 (1967). Nëse dy strofat e rrejshme 128 & 129 përfshihen, ky fenomen – dhe shumë të tjerë – do të zhduken.

fenë tuaj, atëherë mund t'i luftoni udhëheqësit e paganizmit – nuk jeni më të kufizuar nga besëlidhja juaj me ta – që të mund të përmbahen.

[13] A nuk do i luftonit njerëzit që i shkelën traktatet e tyre, u munduan ta dëbojnë të dërguarin, dhe ata janë që e filluan luftën pikë së pari? A po frikësoheni prej tyre? Zoti është Ai të cilit duhet t'i frikësoheni, nëse jeni besimtarë.

[14] T'i luftoni ata, se Zoti do i ndëshkojë në duart tuaja, t'i poshtërojë, t'ju dhurojë juve fitore mbi ta, dhe t'i qetësojë gjokset e besimtarëve.

[15] Ai gjithashtu do të heqë mllëfin nga zemrat e besimtarëve. Zoti shpengon këdo që Ai do. Zoti është i Gjithëdijshëm, Më i Mençuri.

Testi i pashmangshëm

[16] A menduat se do të liheni rehat pa i dalluar Zoti ata mes jush që përpiqen, dhe nuk e bashkojnë veten me armiqtë e Zotit, ose me armiqtë e të dërguarit të Tij, ose me armiqtë e besimtarëve? Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

[17] Adhuresit e idhujve nuk kanë për t'i frekuentuar vendlutjet e Zotit, përderisa e pranojnë mosbesimin e tyre. Ata i kanë asgjësuar punët e tyre, dhe do të qëndrojnë përgjithmonë në Ferr.

[18] Të vetmit njerëz për t'i frekuentuar vendlutjet e Zotit janë ata që besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit, dhe zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe nuk i frikësohen përveç Zotit. Këta padyshim do të jenë mes të udhëzuarve.

Pyetje për arabët

[19] A e keni konsideruar dhënien e ujit shtegtarëve dhe kujdesin për Vendlutjen e Shenjtë zëvendësim për besimin në Zotin dhe Ditën e Fundit, dhe përpjekjen për Zotin? Ata nuk janë të barabartë përpara Zotit. Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

Myzhde

[20] Ata që besojnë, dhe emigrojnë, dhe përpiqen për Zotin me paratë e tyre dhe jetët e tyre, janë shumë më të mëdhenj në gradë për Zotin. Janë fituesit.

[21] Zotëruesi i tyre iu jep atyre myzhde: mëshirë dhe miratim prej Tij, dhe kopshte ku ata kënaqen në hare të përhershme.

[22] Përjetësisht qëndrojnë aty. Zoti posedon shpërblim shumë të madh.

Nëse duhet të zgjedhësh

[23] O ju që besoni, mos e shoqëroni veten madje as me prindërit tuaj dhe vëllezërit tuaj, nëse parapëlqejnë mosbesimin mbi besimin. Ata mes jush që e shoqërojnë veten me ta janë duke bërë shkelje.

[24] Deklaroni: "Nëse prindërit tuaj, fëmijët tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, familja juaj, paratë që i keni fituar, ndonjë punë për të cilën brengoseni, dhe shtëpitë që i gëzoni janë më të dashura për ju se Zoti dhe i dërguari i Tij,** dhe përpjekja për Të, atëherë pritni derisa Zoti ta sjellë gjykimin e Tij." Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

* 9:24 Pasi që shanset janë shumë të vogla që ndonjë qenie njerëzore të besojë vërtetë dhe që të ia kushtojë adhurimin vetëm Zotit (12:103, 106), është gati e pamundur të shihet një familje e tërë që besojnë. Pra, shumica e besimtarëve janë përballur me zgjedhjen: "Ose mua ose Zotin dhe të dërguarin e Tij." Kjo zgjedhje vazhdimisht thuhet nga bashkëshortet/bashkëshortët e besimtarëve, ose prindërit e tyre, fëmijët e tyre, etj. Vazhdimisht, besimtarët e bënë zgjedhjen e duhur. Ky është test i detyrueshëm për të gjithë besimtarët (29:2).

* 9:24 Evidenca matematikore Kuranore tregon veçanërisht drejt të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes. Duke mbledhur vlerën germore të "Rashad" (505), plus vlerën e "Khalifa" (725), plus numrin e strofës (24) marrim $505 + 725 + 24 = 1254 = 1966$.

[25] Zoti ju ka dhuruar fitore në shumë situata. Por në ditën e Hunejnit, u bëtë tepër krenarë me numrin tuaj të madh. Si pasojë, kjo nuk ju ndihmoi aspak, dhe toka e gjerë u bë aq e ngushtuar rreth jush, sa që u kthyet dhe ikët.

[26] Pastaj Zoti lëshoi qetësim mbi të dërguarin e Tij dhe mbi besimtarët. Dhe Ai lëshoi ushtarë të padukshëm; Ai kështu i ndëshkoi ata që nuk besuan. Kjo është pagesa për mosbesimtarët.

[27] Përfundimisht, Zoti e shpengon këdo që Ai do. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[28] O ju që besoni, adhuresit e idhujve janë të ndotur; ata të mos lejohen t'i afrohen Vendlutjes së Shenjtë pas këtij viti. Nëse keni frikë se humbni të ardhura, Zoti do të derdhë mbi ju furnizimet e Tij, në përputhje me vullnetin e Tij. Zoti është i Gjithëfuqishëm, Më i Mençuri.

[29] T'i luftoni prapa ata që nuk besojnë në Zotin, as në Ditën e Fundit, as nuk ndalojnë çka Zoti dhe i dërguari i Tij kanë ndaluar, as nuk pajtohen me fenë e të vërtetës – mes atyre që e pranuan shkrimin – derisa ta paguajnë tatimin e duhur, me dëshirë apo pa dëshirë.

Blasfemi

[30] Jahuditë thanë, “Esdra është i biri i Zotit,” përderisa të Krishterët thanë, “Jezusi është i biri i Zotit!” Këto janë blasfemi të shprehura me gojët e tyre. Ato kështu përputhen me blasfemitë e atyre që nuk kanë besuar në të kaluarën. Zoti i mallkon ata. Ata patjetër kanë devijuar.

I përmbahen mësimëve të udhëheqësve fetarë, në vend të mësimëve të Zotit

[31] Ata i kanë ngritur udhëheqësit e tyre fetarë dhe shkollarët si zotërues,* në vend të Zotit. Të tjerët e hyjnizuan Mesinë, të birin e Marisë. Ata të gjithë u urdhëruan ta adhurojnë vetëm një zot. Nuk ka zot tjetër përveç Tij. Qoftë i madhëruar, larg nga çka i shoqërojnë.

[32] Ata dëshirojnë ta shuajnë dritën e Zotit me gojët e tyre, por Zoti insiston që ta përkryej dritën e Tij, përkundër mosbesimtarëve.

“Nënshtrimi” është paracaktuar të mbizotërojë

[33] Ai është Ai që e dërgoi të dërguarin e Tij* me udhëzimin dhe fenë e të vërtetës, dhe do e bëjë atë të dominojë mbi të gjitha fetë, përkundër adhuresve të idhujve.

Ruaju nga hoxhallarët dhe homologët e Tyre

[34] O ju që besoni, shumë udhëheqës fetar dhe predikues i marrin paratë e njerëzve në mënyrë të paligjshme, dhe i zmbrafsin nga rruga e Zotit. Ata që e mbledhin arin dhe argjendin, dhe nuk i shpenzojnë për Zotin, premtuju atyre ndëshkim që dhemb.

[35] Do të vij dita kur ari dhe argjendi i tyre do të nxehet në zjarrin e Ferrit, pastaj të përdoret për të ua djegur ballin e tyre, anët e tyre, dhe shpinat e tyre: “Kjo është çka mbledhët për vete, prandaj shijoni çka keni mbledhur.”

Sistemi i Zotit: Dymbëdhjetë muaj në vjet

* 9:31 Nëse konsultohesh me “Shkollarët Mysliman” për adhurimin e vetëm Zotit, dhe zbatimin e fjalës të vetëm Zotit, siç mësohet në këtë shkrim të vërtetuar, ata do të të këshillojnë kundër saj. Nëse konsultohesh me Papën për identitetin e Jezusit, ai do të të këshillojë t'i përmbahesh trinisë. Nëse iu bindesh “Shkollarëve Mysliman” këshilla e të cilëve është në kundërshtim me mësimet e Zotit, ose nëse e merr këshillën e Papës në vend të Zotit, ti i ke ngritur këta udhëheqës fetar si zota në vend të Zotit.

* 9:33 Ky pohim, shkronjë për shkronje, ndodhet këtu dhe në 61:9. Nëse e shkruajmë vlerën germore të “Rashad” (505), të ndjekur me vlerën e “Khalifa” (725), të ndjekur me numrat e sureve dhe strofave ku ky pohim gjendet (9:33 & 61:9), marrim 505 725 9 33 61 9, shumëfish i 19-tës. Kjo konfirmon se i dërguari këtu është Rashad Khalifa. Plus, numri i strofave nga 9:33 deri te 61:9 (3902)+9+33+61+9+vlera e “Rashad Khalifa” (1230) jep 5244, gjithashtu shumëfish i 19-tës. Vlera germore e 9:33 & 61:9, e llogaritur duke mbledhur vlerat e secilës shkronjë, është 7858. Duke e mbledhur këtë numër, plus numrin e shkronjave në të dy strofat (12), plus numrin e strofave prej 9:33 deri te 61:9 (3902), plus vlerën e “Rashad Khalifa” (1230), marrim 7858 + 120 + 3902 + 1230 = 13110 = 19 x 690. Shih Shtojcat 1, 2, dhe 26.

[36] Numërimi i muajve, sa i përket Zotit, është dymbëdhjetë.* Ky ka qenë ligji i Zotit që nga dita kur Ai krijoi qiejt dhe tokën. Katër prej tyre janë të shenjtë. Kjo është feja e përkryer. Të mos i bëni keq vetes (duke luftuar) gjatë Muajve të Shenjtë. Megjithatë, ju mund të shpallni luftë të përgjithshme kundër adhuruesve të idhujve (edhe gjatë Muajve të Shenjtë), kur ata shpallin luftë të përgjithshme kundër jush, dhe ta dini se Zoti është në anën e të drejtëve.

*Ndryshimi i Muajve të Shenjtë**

[37] Ndryshimi i Muajve të Shenjtë është shenjë mosbesimi të tepërt; ai e shton humbjen e atyre që nuk kanë besuar. Ata i ndërrojnë Muajt e Shenjtë dhe muajt e zakonshëm, përderisa ruajnë numrin e muajve të shenjtë nga Zoti. Kështu ata shkëlin çka Zoti ka shenjtëruar. Punët e tyre u janë zburuar në sytë e tyre. Zoti nuk i udhëzon njerëzit mosbesimtarë.

[38] O ju që besoni, kur ju thuhet, “Mobilizohuni për Zotin,” pse bëheni të lidhur rëndë për toke? A e keni zgjedhur jetën e kësaj bote në vend të Përjetësisë? Gjërat materiale të kësaj bote, në krahasim me Përjetësinë, janë zero.

[39] Po të mos mobilizoheni, Ai do t’ju parashtrojë në ndëshkim që dhemb dhe t’ju zëvendësojë me njerëz tjerë; ju nuk mund ta dëmtoni Atë aspak. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Ushtarët e padukshëm të Zotit

[40] Nëse dështoni së përkrahuri atë (të dërguarin), Zoti veç e ka përkrahur atë. Kështu kur mosbesimtarët e ndoqën atë, dhe ai ishte njëri prej dyve në shpellë, i tha shokut të tij, “Mos u bë merak; Zoti është me ne.” Zoti pastaj lëshoi qetësim dhe siguri mbi të, dhe e përkrahu me ushtarë të padukshëm. Ai e bëri fjalën e mosbesimtarëve të ulët. Fjala e Zotit mbretëron. Zoti është i Plotfuqishëm. Më i Mençuri.

Besimtarët e dalluar përpiqen për Zotin

[41] Të mobilizoheni me gatishmëri, lehtë apo rëndë, dhe përpiqeni me paratë tuaja dhe jetët tuaja për Zotin. Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit.

Përtacët

[42] Sikur të kishte ndonjë fitim material të shpejtë, dhe ndonjë udhëtim të shkurtër, ata do të ndiqnin ty. Por përpjekja është thjeshtë e tepërt për ta. Ata bëjnë be në Zotin: “Po të mundnim, do të mobilizoheshim me ju.” Kështu ata e dëmtojnë vetveten, dhe Zoti e din se ata janë gënjeshtarë.

[43] Zoti të ka falur ty; pse iu dhe leje atyre (për të qëndruar mbrapa), para se t’i dalloje ata që janë të sinqertë prej gënjeshtarëve?

[44] Ata që sinqerisht besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit nuk kërkojnë leje për t’iu shmangur shansit që të përpiqen me paratë dhe jetët e tyre. Zoti është tërësisht i vetëdijsëm për të drejtë.

[45] Të vetmit njerëz që kërkojnë leje janë ata që nuk besojnë vërtetë në Zotin dhe Ditën e Fundit. Zemrat e tyre janë plot dyshim, dhe dyshimi i tyre i bën të luhaten.

[46] Po të donin ata vërtetë të mobilizoheshin, do të përgatiteshin mirë për të. Por Zotit nuk i pëlqen pjesëmarrja e tyre, kështu që Ai i dekurajon ata; atyre iu tha, “Rrini mbrapa me ata që po rrinë mbrapa.”

[47] Sikur të mobilizoheshin me ju, do të krijonin huti, dhe do të shkaktonin grindje dhe përçarje mes jush. Disa prej jush kishit prirje për t’i dëgjuar ata. Zoti është tërësisht i vetëdijsëm për

* 9:36 Fjala “muajt” përmendet në Kuran 12 herë, dhe “dita” 365 herë.

* 9:37 Muajt e Shenjtë sipas Botës Myslimane të korruptuar janë Rexheb, Dhyl-Ka’de, Dhyl-Hixhxhe, dhe Muharrem (muaji i shtatë, i njëmbëdhjetë, i dymbëdhjetë, dhe i parë i Kalendarit Islamik). Një studim me kujdes i Kuranit, megjithatë, zbulon se ata duhet të jenë Dhyl-Hixhxhe, Muharrem, Safer, dhe Rebi I (muaji i dymbëdhjetë, i parë, i dytë, dhe i tretë). Shih Shtojcën 15.

shkelësit.

[48] Ata kërkuan të përhapin huti mes jush në të kaluarën, dhe i ngatërronin çështjet për ju. Megjithatë, e vërteta përfundimisht mbizotëron, dhe plani i Zotit zbatohet, përkundër tyre.

[49] Disa prej tyre do të thoshin, “Më jep leje (të rri mbrapa); mos ma impono një vështirësi të tillë.” Por pikërisht kështu kanë vetëshkaktuar një vështirësi të tmerrshme; Ferri po i rrethon mosbesimtarët.

[50] Nëse diçka e mirë të ndodhë, dëshpërohen, dhe nëse ndonjë fatkeqësi të ndodhë, thonë, “A të thamë?” përderisa largohen të gëzuar.

[51] Thuaj, “Asgjë nuk na ndodhë, përveç çka Zoti ka vendosur për ne. Ai është Zotëruesi dhe Sunduesi ynë. Në Zotin besimtarët të kenë besim.”

[52] Thuaj, “Ju mund të prisni për ne njëën prej dy gjërave të mira (fitore ose rënie dëshmorë), përderisa ne presim për ju mallkim prej Zotit dhe ndëshkim prej Tij, ose në duart tona. Prandaj, prisni, dhe ne do të presim së bashku me ju.”

[53] Thuaj, “Shpenzoni, me dashje apo pa dashje. Asgjë nuk do të pranohet prej jush, se jeni njerëz të këqij.”

Lutjet e Kontaktit ekzistonin para Muhamedit

[54] Çka e parandaloi pranimin e shpenzimit të tyre është se ata nuk besuan në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe kur i zbatuan Lutjet e Kontaktit (Salat),* i zbatuan me përtaci, dhe kur dhanë bamirësi, e bënë atë me mosdashje.

Suksesi i kësaj bote mund të mashtrojë

[55] Mos u impresiono me paratë e tyre, dhe fëmijët e tyre. Zoti i bën këto të jenë burime ndëshkimi për ta në këtë jetë, dhe (kur ata të vdesin) shpirtat e tyre i lënë përderisa janë mosbesimtarë.

[56] Bëjnë be në Zotin se përkasin me ju, përderisa nuk përkasin me ju; ata janë njerëz përçarës.

[57] Sikur të mund të gjenin strehim, ose shpella, ose ndonjë vend për tu fshehur, do të shkonin te ai, me nxitim.

[58] Disa prej tyre e kritikojnë shpërndarjen tënde të bamirësisë; nëse iu jepet atyre nga ajo, janë të kënaqur, por nëse nuk iu jepet nga ajo, bëhen kundërshtarë.

[59] Ata duhet të jenë të kënaqur me çka Zoti dhe i dërguari i Tij iu kanë dhënë. Është dashur të thonë, “Zoti na mjafton. Zoti do të na furnizojë nga dhuratat e Tij, dhe gjithashtu i dërguari i Tij. E kërkojmë vetëm Zotin.”

Sistemi i shpërndarjes së bamirësisë

[60] Bamirësitë të shkojnë te të varfrit, nevojtarët, punëtorët që i mbledhin, të konvertuarit e rinj, për lirim e skllëvërve, te ata që ngarkohen me shpenzime të papritura, në rrugën e Zotit, dhe te udhëtarit i huaj. I tillë është urdhri i Zotit. Zoti është i Gjithëdijsëm, Më i Mençuri.

[61] Disa prej tyre e lëndojnë profetin duke thënë, “Ai i hapë veshtë shumë!” Thuaj, “Është më mirë për ju që ai të dëgjojë. Ai beson në Zotin, dhe ka besim te besimtarët. Ai është një mëshirë për ata mes jush që besojnë.” Ata që e lëndojnë të dërguarin e Zotit kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[62] Ata ju bëjnë be në Zotin, për t’ju kënaqur juve, kur Zoti dhe i dërguari i Tij ia vlejné më shumë

* 9:54 Kjo është një provë tjetër se Lutjet e Kontaktit (Salat) ekzistuan para Kuranit, dhe u dorëzuan nga Ibrahim (shih 21:73). Gjithashtu, nga kjo mbesin të cunguar ata që e sfidojnë pohimin e Zotit që Kurani është komplet dhe plotësisht i detajuar kur ata pyesin, “Ku mund t’i gjejmë detajet e Lutjeve të Kontaktit në Kuran” (6:19, 38, 114).

për tu kënaqur, nëse ata janë vërtetë besimtarë.

Ndëshkim për kundërshtimin e Zotit dhe të dërguarit të Tij

[63] A nuk e dinë ata se kushdo që i kundërshton Zotit dhe të dërguarit të Tij ka vetëshkaktuar zjarrin e Ferrit përgjithmonë? Ky është poshtërimi më i keq.

Hipokritët

[64] Hipokritët bëhen merak se mos ndonjë sure mund të shpallet e të ua nxjerrë në shesh çka është brenda në zemrat e tyre. Thuaj, “Lirisht talluni. Zoti do të nxjerrë në shesh atë që i frikësoheni.”

[65] Nëse i pyet, do të thoshin, “Vetëm talleshim dhe luanim.” Thuaj, “A e kuptoni se po tallni Zotin, dhe shpalljet e Tij, dhe të dërguarin e Tij?”

[66] Mos kërkoni falje. Keni kaluar në mosbesim pasi që keni besuar. Nëse i falim disa prej jush, do i ndëshkojmë të tjerët, si pasojë e shpirtligësisë së tyre.

[67] Burrat hipokritë dhe gratë hipokrite përkasin me njëri tjetrin – ata përkrahin të këqijat dhe ndalojnë të drejtën, dhe janë dorështrënguar. Ata e harruan Zotin, prandaj Ai i harroi ata. Hipokritët janë vërtetë shpirtligj.

[68] Zoti iu premtonte hipokritëve dhe hipokriteve, si dhe mosbesimtarëve, zjarrin e Ferrit, ku qëndrojnë përgjithmonë. Iu mjafton atyre. Zoti i ka mallkuar; ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të përhershëm.

Sistemi i Zotit nuk ndryshon

[69] Disa prej tyre para jush ishin më të fortë se ju, dhe poseduan më shumë para dhe fëmijë. Ata u preokupuan me posedimet e tyre materiale. Ngjashëm, po preokupoheni me posedimet tuaja materiale, sikur ata para jush që ishin preokupuar. Jeni bërë plotësisht të pavëmendshëm, sikur ata që ishin të pavëmendshëm. Të tillë janë njerëzit që i asgjësojnë punët e tyre, edhe në këtë botë edhe në Përjetësi; ata janë humbësit.

Humbësit

[70] A nuk kanë mësuar asgjë prej gjeneratave paraprake; njerëzve të Nuhut, Adit, Themudit, njerëzve të Ibrahimit, banuesve të Medjenit, dhe keqbërësve (të Sodomës dhe Gomorës)? Të dërguarit e tyre iu shkuan atyre me prova të qarta. Zoti nuk iu bëri keq atyre; janë ata që i bënë keq shpirtave të vet.

Fituesit

[71] Burrat dhe gratë besimtarë janë aleat të njëri tjetrit. Ata përkrahin drejtësi dhe ndalojnë keqbërje, i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe e japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij. Mbi këta do të derdhet mëshira e Zotit. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[72] Zoti iu premtonte burrave besimtarë dhe grave besimtare kopshte me prroje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë, dhe pallate të mrekullueshme në kopshtet e Edenit. Dhe bekimet dhe miratimet e Zotit janë edhe më të mëdha. Ky është triumfi më i madh.

Të jeni të rreptë me mosbesimtarët

[73] O ti profet, përpiku kundër mosbesimtarëve dhe hipokritëve, dhe ji i rreptë kur merresh me ta. Fat i tyre është Ferri; çfarë vendbanimi i tmerrshëm!

[74] Ata bëjnë be në Zotin që nuk e kanë thënë, edhe pse e kanë shprehur fjalën e mosbesimit; ata kanë kundërshtuar pas nënshtrimit. Në fakt, ata hoqën dorë nga ajo që nuk e kishin. Ata janë rebeluar edhe pse Zoti dhe i dërguari i Tij iu lëshuan atyre hirësinë dhe furnizimet e Tij. Nëse

pendohen, do të ishte më së miri për ta. Por nëse refuzojnë, Zoti do i parashtrojë në ndëshkim që dhemb në këtë jetë dhe në Përjetësi. Ata nuk do të gjejnë askënd në tokë që të jetë zotërues dhe sundues i tyre.

[75] Disa prej tyre madje edhe u betuan: “Nëse Zoti derdhë mbi ne hirësinë e Tij, do të ishim bamirës, dhe do të çonim jetë të drejtë.”

[76] Por kur ai derdhi mbi ta furnizimet e Tij, ata u bënë dorështrënguar, dhe refuzuan me neveri.

[77] Si pasojë, Ai i pllakosi me hipokrizi në zemrat e tyre, deri në ditën që ata e takojnë Atë. Kjo është për shkak se ata thyen premtimin e tyre ndaj Zotit, dhe për shkak të gënjeshtreve të tyre.

[78] A nuk e kuptojnë se Zoti i di të fshehtat e tyre, dhe komplotet e tyre, dhe se Zoti është Njohësi i të gjitha të fshehtave?

[79] Ata që i kritikojnë besimtarët bujarë se po japin tepër, dhe i përqeshin besimtarët e varfër se po japin pak, Zoti i përbuzë. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

*Karremi më i efektshëm i Dreqit: Miti i ndërmjetësismit**

[80] Kërkove apo nuk kërkove falje për ta – edhe nëse kërkon falje për ta shtatëdhjetë herë – Zoti nuk do i falë. Kjo është për shkak se ata nuk besuan në Zotin dhe të dërguarin e Tij. Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

[81] Ata që ndejën u gëzuan që qëndruan mbrapa të dërguarit të Zotit, dhe nuk dëshironin që të përpiqeshin me paratë e tyre dhe jetët e tyre për Zotin. Thanë, “Le të mos mobilizohemi në këtë nxehtësi!” Thuaj, “Zjarri i Ferrit është shumë më i nxehtë,” vetëm sikur të mund ta paramendonin.

[82] Le të qeshin pak, dhe të qajnë shumë. Kjo është pagesa për mëkatet që i kanë mbledhur.

[83] Nëse Zoti të kthen në situatë ku ata kërkojnë lejen tënde për tu mobilizuar me ju, të thuash, “Kurrë më nuk do të mobilizoheni me mua, e as kurrë më nuk do të luftoni me mua kundër ndonjë armiku. Se keni zgjedhur të jeni me ndenjësit pikë së pari. Prandaj, duhet të rrini me ndenjësit.”

[84] Të mos e zbatosh lutjen e varrimit për asnjë prej tyre kur ai të vdesë, as të mos qëndrosh te varri i tij. Ata nuk kanë besuar në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe vdiqën përderisa ishin shpirtligj.

Gjërat materiale të kësaj bote janë zero

[85] Mos u magjeps nga paratë e tyre ose fëmijët e tyre; Zoti i bën këto të jenë burime vuajtjesh për ta në këtë botë, dhe shpirtrat e tyre i lënë si mosbesimtarë.

[86] Kur një sure shpallet, duke shpallur: “Besoni në Zotin, dhe përpiquni me të dërguarin e Tij,” edhe të fortit mes tyre thonë, “Le të rrimë mbrapa!”

[87] Ata zgjedhën të jenë me ndenjësit. Si pasojë, zemrat e tyre u mbyllën, dhe kështu, ata nuk mund të kuptojnë.

Besimtarët e vërtetë përpiqen

[88] Sa për të dërguarin dhe ata që besuan me të, ata përpiqen me nxitim me paratë e tyre dhe jetët e tyre. Këta kanë merituar të gjitha gjërat e mira; ata janë fituesit.

[89] Zoti ka përgatitur për ta kopshte me proje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë. Ky është triumfi më i madh.

[90] Arabët shpikën arsyetime, dhe erdhën për të kërkuar leje për të qëndruar mbrapa. Ky është tregues i refuzimit të tyre të Zotit dhe të dërguarit të Tij – ata qëndrojnë mbrapa. Vërtetë, ata që nuk besojnë mes tyre kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

* 9:80 Nëse Muhamedi nuk mundi të ndërmjetësojë për xhaxhain dhe kushërinjtë e vet, çka i bën të huajt që kurrë nuk e kanë takuar të mendojnë se ai do të ndërmjetësojë për ta? Ibrahim i nuk mundi të ndërmjetësojë për babanë e tij, e as Nuhu nuk mundi të ndërmjetësojë për të birin e tij (11:46 & 60:4).

[91] Nuk janë për tu fajësuar ata që janë të dobët, të sëmurë, ose nuk gjejnë asgjë për të ofruar, përderisa mbeten të devotshëm ndaj Zotit dhe të dërguarit të Tij. Të drejtit mes tyre të mos fajësohen. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[92] Gjithashtu të falur janë ata që vijnë te ti duke dashur të përfshihen me ty, por iu thua, “Nuk kam në çka t’ju bartë.” Ata pastaj kthehen me lot në sy, sinqerisht të pikëlluar që nuk kishin mundësi të kontribuojnë.

[93] Me faj janë ata që kërkojnë leje nga ti për të qëndruar mbrapa, edhe pse nuk kanë asnjë arsye. Ata kanë zgjedhur të jenë me ndenjësit. Si pasojë, Zoti i ka mbyllur zemrat e tyre, dhe kështu, ata nuk arrijnë asnjë njohuri.

Kohët e vështira shërbejnë për të ekspozuar hipokritët

[94] Ata ju kërkojnë falje kur ktheheni te ta (nga beteja). Thuaj, “Mos na kërkonit falje; nuk ju zëmë besë më. Zoti na ka njoftuar për ju.” Zoti do i shohë punët tuaja, dhe gjithashtu edhe i dërguari, pastaj do të ktheheni te Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve, pastaj Ai do t’ju njoftojë për të gjitha gjërat që kishit bërë.

[95] Ata do t’ju bëjnë be në Zot, kur ktheheni te ta, që t’i shpërfillni. Shpërfillni. Ata janë të ndotur, dhe fat i tyre është Ferri, si pagesë për mëkatet që kanë mbledhur.

[96] Ju bëjnë be, që t’i falni. Edhe nëse i falni, Zoti nuk falë njerëz të tillë shpirtligj.

Arabët

[97] Arabët janë më të këqijtë në mosbesim dhe hipokrizi, dhe më të prirët për të injoruar ligjet që Zoti ka shpallur te i dërguari i Tij. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

[98] Disa arabë e konsiderojnë shpenzimin e tyre (për Zotin) humbje, dhe madje presin pa durim që ndonjë fatkeqësi të ju godasë juve. Janë ata që do të vetëshkaktojnë fatkeqësinë më të keqe. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshtëm.

[99] Arab të tjerë besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit, dhe e konsiderojnë shpenzimin e tyre mjet drejt Zotit, dhe mjet për ta përkrahur të dërguarin. Vërtetë, do i sjellë më afër; Zoti do i pranojë në mëshirën e Tij. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[100] Sa për pionierët e hershëm që emigruan (Muhaxhirët), dhe përkrahësit që iu dhanë strehë atyre (Ensarët) dhe ata që i ndoqën në drejtësi, Zoti është i kënaqur me ta, dhe ata janë të kënaqur me Të. Ai ka përgatitur për ta kopshte me proje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë. Ky është triumfi më i madh.

*Ndëshkimi dyfishohet për hipokritët**

[101] Mes arabëve mes jush, ka hipokritë. Gjithashtu, mes banuesve të qytetit ka që janë të mësuar me hipokrizi. Ju nuk i njihni ata, por ne i njohim. Do të dyfishojmë ndëshkimin për ta, pastaj ata përfundojnë të parashtruar në ndëshkim të tmerrshëm.

[102] Ka të tjerë që i kanë pranuar mëkatet e tyre; ata i kanë përzier veprat e mira me vepra të këqija. Zoti do i shpengojë ata, se Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[103] Merr prej parave të tyre bamirësi për t’i pastruar ata dhe për t’i shenjtëruar. Dhe inkurajoi ata, se inkurajimi yt i qetëson ata. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijshtëm.

[104] A nuk e kuptojnë se Zoti pranon pendimin e adhuruesve të Tij, dhe merr bamirësitë, dhe se Zoti është Shpengues, i Mëshirshmi?

[105] Thuaj, “Punoni drejtësi; Zoti do të shohë punën tuaj, dhe gjithashtu i dërguari i Tij dhe

* 9:101 Hipokritët ulen mes besimtarëve, dëgjojnë lajmin dhe provat, pastaj i përhapin dyshimet e tyre helmuese. Është ligj Kuranor që ata të pranojnë ndëshkim të dyfishtë, tash dhe përgjithmonë.

besimtarët. Përfundimisht, do të ktheheni te Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve, pastaj Ai do t'ju njoftojë për të gjitha gjërat që kishit bërë.”

[106] Të tjerë po presin për vendimin e Zotit; Ai mund t'i ndëshkojë ata, ose mund t'i shpengojë ata. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

*Xhamitë që kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij**

[107] Ka që e shpërdorjnë vendlutjen duke praktikuar adhurim idhujsh, duke i ndarë besimtarët, dhe duke furnizuar rehati për ata që kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij. Ata bëjnë be solemnisht; “Qëllimet tona janë të ndershme!” Zoti është dëshmitar që ata janë gënjeshtarë.

Mos u lutni në ato xhami

[108] Të mos luteni kurrë në vendlutje të tillë. Një vendlutje që është e themeluar në baza të drejtësisë që nga dita e parë ia vlen më shumë që të luteni në të. Në të ka njerëz që duan të pastrohen. Zoti i do ata që e pastrojnë veten.

[109] A është ai që e themelon ndërtesën e tij në bazament të nderimit të Zotit dhe për të fituar miratimin e Tij më i mirë, apo ai që themelon ndërtesën e tij buzë një shkëmbi të thërrmuar, që bie poshtë me të në zjarrin e Ferrit? Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

[110] Një ndërtesë e tillë që e kanë themeluar mbetet burim dyshimi në zemrat e tyre, derisa t'iu ndalen zemrat. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

Investimi më fitimprurës

[111] Zoti ka blerë nga besimtarët jetët e tyre dhe paratë e tyre në këmbim të Parajsës. Kështu, ata luftojnë për Zotin, të gatshëm për të vrarë dhe për tu vrarë. I tillë është zotimi i sinqertë i Tij në Torah, Ungjill, dhe Kuran – dhe kush e përmbush zotimin e Tij më mirë se Zoti? Të gëzoheni për një këmbim të tillë. Ky është triumfi më i madh.

Besimtarët

[112] Ata janë që pendohen, adhuresit, lartmadhëruesit, medituesit, përkulësit dhe përlulësit, përkrahësit e drejtësisë dhe ndaluesit e të këqijave, dhe mbajtësit e ligjeve të Zotit. Jepuni lajme të mira besimtarëve të tillë.

Bëni hasha armiqtë e Zotit - Ibrahim i bëri hasha babanë e tij

[113] As profeti, as ata që besojnë të mos kërkojnë falje për adhuresit e idhujve, edhe sikur ata të ishin më të afërmit e tyre, pasi që ta kuptojnë se ata janë të paracaktuar për Ferr.

[114] E vetmja arsye pse Ibrahim kërkojë falje për babanë e tij ishte se ai i kishte premtuar se do të bënte ashtu. Por sapo e kuptoi që ai ishte armik i Zotit, ai e bëri hasha atë. Ibrahim ishte jashtëzakonisht i dashur, i butë.

[115] Zoti nuk e dërgon në humbje asnjë popull, pasi që ta ketë udhëzuar, pa u treguar atyre çka i pret. Zoti është tërësisht i vetëdijshtëm për të gjitha gjërat.

[116] I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës. Ai e ka në dorë jetën dhe vdekjen. Nuk keni asnjë përkrah Zotit si Zotërues dhe Sundues.

[117] Zoti e ka shpenguar profetin, dhe emigruesit (Muhaxhirët) dhe përkrahësit që i mikpritën dhe iu dhanë strehë (Ensarët), që e ndoqën atë gjatë kohëve të vështira. Atëherë zemrat e disa prej tyre gati u luhatën. Por Ai i ka shpenguar ata, se Ai është i Dhembshëm ndaj tyre, i Mëshirshmi.

* 9:107 Cilado xhami ku praktikant nuk i kushtohen absolutisht VETËM Zotit i takon Dreqit, jo Zotit. Për shembull, përmendja e emrave të Ibrahimit, Muhamedit, dhe/ose Aliut në Ezan dhe/ose në lutjet Salat shkelë urdhrat e Zotit në 2:136, 2:285, 3:84, & 72:18. Fatkeqësisht, kjo është praktikë e zakonshme idhujtareske përgjatë botës së korruptuar Myslimane.

Mos e braktisni të dërguarin

[118] Gjithashtu (u shpënguan) të tre që qëndruan mbrapa. Toka e gjerë u bë aq e ngushtuar për ta, sa që gati i humbën të gjitha shpresat për vete. Më në fund, e kuptuan se nuk kishte ikje nga Zoti, përveç te Ai. Ai pastaj i shpengoi ata që të mund të pendohen. Zoti është Shpenguesi, i Mëshirshmi.

[119] O ju që besoni, t'ia keni dronë Zotit, dhe jini mes të sigurtëve.

[120] As banuesit e qytetit, as arabët rreth tyre, të mos kërkojnë të rrinë mbrapa të dërguarit të Zotit (kur ai mobilizohet për luftë). As nuk duhet t'i japin përparësi çështjeve të tyre mbi përkrashjen e tij. Kjo është për shkak se ata nuk vuajnë ndonjë etje, ose ndonjë mundim, ose uri për Zotin, ose bëjnë një hap të vetëm që i tërbon mosbesimtarët, ose nuk shkaktojnë ndonjë vështirësi mbi armikun, pa e pasur të shkruar për ta si të mirë. Zoti nuk ngelë së shpërblyeri ata që punojnë drejtësi.

[121] As nuk pësojnë ndonjë shpenzim, të vogël apo të madh, as nuk e kalojnë ndonjë luginë, pa iu shkruar atyre e mira. Zoti padyshim do i shpërblejë me bollëk për punët e tyre.

Rëndësia e edukimit fetar

[122] Kur besimtarët të mobilizohen, jo të gjithë të bëjnë ashtu. Një pakicë nga secili grup të mobilizohet duke ia kushtuar kohën e tyre studimit të fesë. Kështu, ata mund ta përcjellin njohurinë te njerëzit e tyre kur ata të kthehen, që të mund të mbeten të informuar për nga feja.

Mosbesimtarët

[123] O ju që besoni, t'i luftoni mosbesimtarët që ju sulmojnë juve – le të ju gjejnë të rreptë – dhe ta dini se Zoti është me të drejtë.

Hipokritët

[124] Kur një sure u shpall, disa prej tyre do të thoshin, "A e forcoi kjo sure besimin e ndonjërit mes jush?" Në të vërtetë, ajo e forcoi besimin e atyre që besuan, dhe ata gëzohen me cilëndo shpallje.

[125] Sa për ata që ushqyen dyshime në zemrat e tyre, ajo faktikisht shtoi papastërti mbi papastërtinë e tyre, dhe ata vdiqën si mosbesimtarë.

[126] A nuk e shohin se vuajnë nga prova të vështira çdo vit një herë apo dy herë? Prapëseprapë, ata vazhdimisht nuk arrijnë të pendohen, dhe nuk arrijnë të marrin vesh?

*Zbulohet krim historik:**Futja e duarve në fjalën e Zotit.***Zoti jep prova të pakontestueshme*

[127] Sa herë që një sure u shpall, disa prej tyre do të shikonin njëri tjetrin sikur donin të thoshin: "A po ju sheh ndokush?" Pastaj ata u larguan. Kështu, Zoti i ka ndryshuar zemrat e tyre, se ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

* 9:1 & 9:127 Kjo është e vetmja sure që nuk e ka parashtesën Bismilah. Ky fenomen ka qenë mister për studiuesit e Kuranit për 14 shekuj, dhe shumë teori u nxorën për ta shpjeguar. Tash e kuptojmë se mungesa e dukshme e Bismilahut shërben për tri qëllime: (1) Paraqet shpallje hyjnore të parakohshme që adhuresit e idhujve ishin të paracaktuar t'i fusin duart në Kuran duke shtuar dy strofa të rrejshme (9:128-129). (2) Demonstron një nga funksionet e kodit matematikor të Zotit në Kuran, d.m.th, për ta ruajtur Kuranin ndaj ndonjë ndryshimi. (3) Furnizon veçori shtesë të mrekullueshme të kodit të Kuranit. Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të tyre, hollësitat jepen në Shtojcat 24 dhe 29. Një vrojtim i menjëhershëm është që numri i ndodhjes së fjalës "Zot" në fund të Sures 9 është 1273 (1967). Nëse dy strofat e rrejshme 128 & 129 përfshihen, ky fenomen – dhe shumë të tjerë – do të zhduken.

Surja 10: Jona (Junus)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.R.* Këto (shkronja) janë provat e këtij libri të mençurisë.

[2] A është shumë çudi për njerëzit që e frymëzuan një njeri si ta? Ai (u frymëzua të thotë), “T’i paralajmërosh njerëzit, dhe jepu myzhde atyre që besojnë se ata kanë arritur pozita të ngritura te Zotëruesi i tyre.” Mosbesimtarët thanë, “Ky është magjistar i shkathët!”

[3] Zotëruesi juaj i vetëm është Zoti; Ai që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë, dhe mori gjithçka në dorë. Ai komandon të gjitha çështjet. Nuk ka asnjë ndërmjetësues, përveç në përputhje me vullnetin e Tij. I tillë është Zoti Zotëruesi juaj. Ta adhuroni Atë. A nuk doni të merrni vesh?

[4] Te Ai është kthimi juaj përfundimtar, i të gjithë juve. Ky është premtimi i vërtetë i Zotit. Ai e nisë krijimin, pastaj e përsëritë, në mënyrë që t’i shpërblejë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, me barazi. Sa për ata që nuk besojnë, ata vetëshkaktojnë pije ferri, dhe ndëshkim që dhemb se nuk besuan.

[5] Ai është Ai që e bëri diellin rrezatues, dhe hënën dritë, dhe Ai dizajnoi fazat e saj që të mund të mësoni t’i numëroni vitet dhe të llogaritni. Zoti nuk e krijoi gjithë këtë, përveç për një qëllim të posaçëm. Ai shpjegon shpalljet për njerëzit që dinë.

[6] Natyrisht, në ndryshimin e natës dhe ditës, dhe çka Zoti krijoi në qiej dhe tokë, ka prova për njerëzit që janë të drejtë.

Preokupimi me këtë botë

[7] Ata që nuk presin të na takojnë neve, dhe janë të preokupuar me jetën e kësaj bote, dhe të kënaqur me të, dhe refuzojnë të jenë të vëmendshëm ndaj provave tona,

[8] kanë vetëshkaktuar Ferr si vendbanim të tyre përfundimtar, si pasojë e vet punëve të tyre.

Zoti i udhëzon besimtarët

[9] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, Zotëruesi i tyre i udhëzon ata, për arsye të besimit të tyre. Lumenj do të rrjedhin poshtë tyre në kopshtet e haresh.

[10] Lutja e tyre aty është: “Qofsh i madhëruar, zoti ynë,” përsëritetja e tyre aty është, “Paqe,” dhe lutja e tyre përfundimtare është: “I lartmadhëruar qoftë Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.”

[11] Sikur Zoti ta nguste ndëshkimin e vetëshkaktuar nga njerëzit, ashtu si i kërkojnë furnizimet, ata do të kishin qenë të asgjësuar shumë kohë më parë. Megjithatë, ne i lëmë ata që nuk presin të takohen me ne në shkeljet e tyre, duke u endur.

[12] Kur e keqja prekë njeriun, ai na lutet përderisa është shtrirë, ose ulur, ose duke qëndruar në këmbë. Por sapo t’ia lehtësojmë të keqen, ai vazhdon sikur të mos na ketë lutur për t’ia hequr ndonjë të keqe! Punët e shkelësve kështu zbukurohen para syve të tyre.

Mësime nga e kaluara

[13] Mori gjeneratash i kemi asgjësuar para jush kur ata shkelën. Të dërguarit e tyre shkuan te ta me prova të qarta, por ata refuzuan të besojnë. Kështu i paguajmë njerëzit fajtorë.

Tash është radha juaj

[14] Pastaj ju bëme trashëgimtarë të tokës pas tyre, për të parë se si do të vepronin ju.

Çdo shkronjë është e llogaritur dhe Hyjnisht e dizajnuar

[15] Kur shpalljet tona iu recitohen atyre, ata që nuk presin të takohen me ne thonë, “Sille një

* 10:1 Këto shkronja janë pjesë e madhe të kodit matematikorë mbresëlënës të Kuranit dhe provë e autorësisë hyjnore. Shih Shtojcën 1 për hollësi.

Kuran* tjetër pos këtij, ose ndryshoje atë!” Thuaj, “Unë as që mund ta ndryshoj vetë. Unë thjeshtë ndjek çka më është shpallur. I frikësohem, nëse nuk i bindem Zotëruesit tim, ndëshkimit të një dite të hatashme.”

[16] Thuaj, “Sikur të donte Zoti, unë nuk do t’ua recitoja juve, as nuk do të dinit ndonjë gjë për të. Unë kam jetuar mes jush një jetë të tërë para kësaj (dhe më keni njohur si person i sinqertë dhe i arsyeshëm). A nuk kuptoni?”

[17] Kush është më i keq se ai që trillon gënjeshtër për Zotin, ose i refuzon shpalljet e Tij. Padyshim, shkelësit nuk ia dalin.

[18] Ata adhurojnë përkrah Zotit idhuj që nuk posedojnë aspak fuqi për t’i dëmtuar ose për t’iu bërë dobi, dhe ata thonë, “Këta janë ndërmjetësuesit tanë te Zoti!” Thuaj, “A mos po e informoni Zotin për diçka që Ai nuk e di në qiej dhe tokë?” Qoftë i madhëruar Ai. Ai është Më i Larti; larg nga nevoja për partnerë.

[19] Njerëzit dikur ishin një asamble, pastaj ata u grindën. Po të mos ishte për një fjalë të paracaktuar nga Zotëruesi yt, ata do të ishin gjykuar menjëherë në lidhje me grindjet e tyre.

*Mrekullia e Kuranit për tu zbuluar pas Muhamedit**

[20] Ata thonë, “E si nuk i zbriti atij asnjë mrekulli nga Zotëruesi i tij?” Thuaj, “E ardhmja i takon Zotit; pra pritni, edhe unë jam duke pritur së bashku me ju.”

Njerëz kryengritës

[21] Kur dhurojmë mëshirë mbi njerëzit, pasi që t’i ketë pllakosur fatkeqësia, ata menjëherë planifikojnë kundër shpalljeve tona! Thuaj, “Planifikimi i Zotit është shumë më i efektshëm. Se të dërguarit tanë janë duke regjistruar çdo gjë që planifikoni.”

[22] Ai është Ai që ju lëvizë nëpër tokë dhe det. Ju hipni në anije, dhe lundrojnë qetë në një fllad të këndshëm. Pastaj, përderisa kënaqen aty, frynë erë e fortë, dhe valët i rrethojnë nga çdo anë. Kjo është kur ata i luten Zotit, sinqerisht duke ia kushtuar lutjet e tyre vetëm Atij: “Nëse vetëm na shpëton këtë herë, do të jemi mirënjohës përgjithmonë.”

[23] Por sapo Ai i shpëton, ata shkelin në tokë, dhe e kundërshtojnë të vërtetën. O njerëz, shkelja juaj është vetëm për të keqen e shpirtrave tuaj. Ju vazhdoni të jeni të preokupuar me jetën e kësaj bote, pastaj te ne është kthimi juaj përfundimtar, pastaj ne ju njoftojmë për çdo gjë që kishit bërë.

[24] Shembulli i jetës së kësaj bote është kështu: ne zbrisim shi nga qielli për të prodhuar me të të gjitha llojet e bimëve nga toka, dhe për të furnizuar ushqim për njerëzit dhe kafshët. Pastaj, pikërisht ndërsa toka është krejt e stolisur, dhe njerëzit e saj mendojnë se ata i kanë gjërat në dorë, gjykimi ynë vjen natën ose ditën,* duke e lënë atë krejtësisht shterpë, sikur të mos ketë ekzistuar asgjë ditën paraprake. Ne kështu shpjegojmë shpalljet për njerëzit që pasqyrojnë.

[25] Zoti fton për te vendbanimi i paqes, dhe udhëzon këdo që dëshiron (të udhëzohet) në rrugë të drejtë.

Parajsa dhe Ferri janë të përhershme

* 10:15 Fjala “Kuran” përmendet në Kuran 58 herë, por pasi që kjo strofë përmendë një “Kuran tjetër,” ai duhet të përjashtohet; “Ky Kuran” përmendet në Kuran 57 herë, 193.

* 10:20 Në prapavështrim, ne shohim tani se mrekullia e Kuranit, në fakt “Njëra prej mrekullive më të mëdha” (74:30-35), ishte paracaktuar hyjnisht për tu zbuluar 14 shekuj pas Muhamedit. Po të marrim parasysht gjendjen e tanishme të Myslimanëve tradicional, nëse Muhamedit do i jepej kjo mrekulli, ata Mysliman, që tashmë po e idolizojnë Muhamedin përkrah Zotit, do e adhuronin atë si një Zot të mishëruar. Aq më shumë, kjo mrekulli siç shihet është dizajnuar për epokën e kompjuterëve, dhe për tu vlerësuar nga gjeneratat matematikisht të sofistikuar.

* 10:24 Zoti, natyrisht, e din nëse gjykimi i Tij do të vij gjatë ditës, apo gjatë natës, Por thjeshtë ndodhë që toka do të jetë gjysma ditë dhe gjysma natë kur vjen fundi i botës. Një tjetër “mrekulli shkencore” e Kuranit.

[26] Për të drejtit, shpërblimi do shumëfishohet shumëfish. Fytyrat e tyre nuk do të përjetojnë ndonjë humbje apo turp. Këta janë banuesit e Parajsës; ata qëndrojnë aty përgjithmonë.

[27] Sa për ata që mblodhën mëkate, pagesa e tyre është e barabartë me mëkatet e tyre. Poshtërimi është ngastra e tyre, dhe askush përkrah Zotit nuk mund t'i mbrojë ata. Fytyrat e tyre do të duken të pushtuara nga togje nate të errët. Ata do të jenë banuesit e Ferrit; në të qëndrojnë përgjithmonë.

Idhujt mohojnë adhuruesit e tyre

[28] Në ditën kur t'i mbledhim të gjithë ata, do tu themi atyre që adhuruan idhuj, "Ju kemi mbledhur, së bashku me idhujt tuaj." Ne do i bëjmë ata të ballafaqohen me njëri tjetrin, dhe idhujt e tyre do tu thonë atyre, "Nuk e dinim fare që na adhuruat.

[29] "Zoti mjafton si dëshmitar mes nesh dhe jush, që ne ishim plotësisht të pavetëdijshëm që na adhuruat."

[30] Atë herë secili shpirt do të ekzaminojë çdo gjë që kishte bërë. Ata do të kthehen te Zoti, Zotëruesi dhe Sunduesi i tyre me të drejtë, dhe idhujt që i kishin trilluar do i mohojnë.

[31] Thuaj, "Kush ju furnizon prej qiellit dhe tokës? Kush e ka në dorë krejt dëgjimin dhe shikimin? Kush e prodhon të gjallin nga i vdekuri, dhe të vdekurin nga i gjalli? Kush i ka në dorë të gjitha gjërat?" Ata do të thoshin, "Zoti." Thuaj, "Pse atëherë nuk i zbatoni urdhrat?"

[32] I tillë është Zoti, me të drejtë Zotëruesi juaj. Çka ka pas së vërtetës, përveç rrenës? Si mund ta shpërfillni gjithë këtë?

[33] Kjo është çka vendimi i Zotëruesit tuaj iu bën atyre që zgjedhin të jenë shpirtligj; ata nuk mund të besojnë.

Pasqyroni në idhujt tuaj

[34] Thuaj, "A mund ndonjëri prej idhujve tuaj të nisë krijim, dhe pastaj ta përsërisë?" Thuaj, "Zoti e nisë krijimin, pastaj e përsëritë."

[35] Thuaj, "A udhëzon ndonjëri prej idhujve tuaj për te e vërteta?" Thuaj, "Zoti udhëzon për te e vërteta. A ia vlen më shumë të ndiqet dikush që udhëzon për te e vërteta, apo dikush që nuk udhëzon, dhe vetë ka nevojë për udhëzim? Çka nuk është në rregull me vlerësimin tuaj?"

[36] Shumica e tyre nuk ndjekin asgjë pos hamendje, dhe hamendja nuk mund ta zëvendësojë të vërtetën. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëjnë.

Vetëm Zoti mund të jetë autor i Kuranit

[37] Nuk ka shans që tjetër pos Zotit të jetë autor i këtij Kurani. I konfirmon të gjitha lajmet paraprake, dhe furnizon shkrim tërësisht të hollësishëm. Është i pagabueshëm, se vjen prej Zotëruesit të gjithësisë.

[38] Nëse thonë, "Ai e trilloi atë," thuaj, "Atëherë prodhoni një sure si këto, dhe ftoni këdo që dëshironi, pos Zotit, nëse jeni të sinqertë."

[39] Vërtetë, ata e kanë refuzuar këtë pa e studiuar dhe ekzaminuar, dhe para se ta kuptojnë. Kështu edhe ata para tyre nuk besuan. Prandaj, vëreni pasojat për shkelësit.

[40] Disa prej tyre i besojnë (këtij shkrimi), përderisa të tjerët nuk i besojnë. Zotëruesi yt është tërësisht i vetëdijshëm për keqbërësit.

[41] Nëse të refuzojnë, atëherë thuaj, "Unë kam punët e mia, dhe ju i keni punët tuaja. Ju nuk jeni fajtorë për asgjë që bëj, dhe unë nuk jam fajtor për asgjë që bëni."

[42] Disa prej tyre të vënë veshin ty, por a mund t'i bësh shurdhat të dëgjojnë, edhe pse nuk mund të kuptojnë?

Njerëzit e zgjedhin rrugën e tyre lirisht

[43] Disa prej tyre të shikojnë ty, por a mund t'i udhëzosh të verbrit, edhe pse ata nuk shohin?

[44] Zoti nuk iu bën keq njerëzve; janë njerëzit ata që i bëjnë keq shpirttrave të tyre.

[45] Në ditën kur Ai i mbledhë të gjithë ata, ata do të ndihen sikur të kenë zgjatur në këtë botë një orë të ditës, gjatë të cilës ata takohen. Humbës vërtetë janë ata që nuk besojnë në takimin me Zotin; dhe zgjedhin të jenë të kequdhëzuar.

[46] Qoftë të treguam pak (nga ndëshkimi) që u premtuam atyre, ose ta përfunduam jetën tëndë para saj, te ne është kthimi i tyre përfundimtar. Zoti është dëshmitar i çdo gjëje që bëjnë.

[47] Për secilën shoqëri, një të dërguar. Pasi që të vij i dërguari i tyre, ata gjykohen me barazi, pa as më të voglën padrejtësi.

[48] Ata sfidojnë: “Kur do i vij koha kësaj profecie, nëse jeni duke e treguar të vërtetën?”

I dërguari nuk posedon fuqi

[49] Thuaj, “Unë nuk posedoj fuqi për ta dëmtuar veten, ose për t'i sjellë dobi vetes; vetëm çka Zoti do ngjanë.” Secila shoqëri ka afat të paracaktuar. Kur afatit të tyre i vjen fundi, ata nuk mund ta shtyjnë as për një orë, e as ta përshpejtojnë.

[50] Thuaj, “Qoftë erdh ndëshkimi i Tij te ju natën ose ditën, pse po nguten shkelësit aq shumë?”

[51] “Nëse ndodhë, a do të besoni atëherë? Pse duhet të besoni atëherë? Ju dikur e sfidonit që të vijë?”

[52] Do tu thuhet shkelësve, “Shijojeni ndëshkimin e përhershëm. A nuk po paguheni saktësisht për çka keni mbledhur?”

[53] Ata të sfidojnë ty që të profetizosh: “A vërtetë kështu do të ndodhë?” Thuaj, “Po vërtetë, pasha Zotëruesin tim, kjo është e vërteta, dhe nuk do të mund t'i ikni.”

Çfarë çmimi besimi

[54] Sikur cilido shpirtligë të posedonte çdo gjë në tokë, do e ofronte me gatishmëri. Ata do i brejë ndërgjegjja kur e shohin ndëshkimin. Ata do të gjykohen me barazi, pa as më të voglën padrejtësi.

[55] Absolutisht, e Zotit është çdo gjë në qiej dhe tokë. Absolutisht, premtimi i Zotit është e vërteta, por shumica e tyre nuk dinë.

[56] Ai e ka në dorë jetën dhe vdekjen, dhe te Ai do të ktheheni.

[57] O njerëz, ndriçim ka ardhur te ju këtu prej Zotëruesit tuaj, dhe shërim për çfarëdo që ua shqetëson zemrën, dhe udhëzim, dhe mëshirë për besimtarët.

Gëzim për besimtarët

[58] Thuaj, “Me hirësinë e Zotit dhe me mëshirën e Tij do të gëzohen.” Kjo është shumë më e mirë se çfarëdo pasurie që mund ta mbledhin.

Ndalesa ushqimore të trilluara nga njerëzit

[59] Thuaj, “A e keni vërejtur se si Zoti zbrit te ju të gjitha llojet e furnizimeve, pastaj ju i bëni disa prej tyre jo të ligjshme, dhe disa të ligjshme?” Thuaj, “A ju dha Zoti leje për ta bërë këtë? Apo, po trilloni rrena dhe po ia mvëshni Zotit?”

[60] A nuk iu shkon mendja atyre që trillojnë rrena për Zotin që atyre do iu duhet të përballen me Të në Ditën e Ringjalljes? Padyshim, Zoti derdhë mbi njerëzit hirësinë e Tij, por shumica e tyre janë mosmirënjohës.

Të njohurit e Zotit

[61] Ti nuk hasë në ndonjë situatë, as nuk reciton ndonjë Kuran, as nuk bëni asgjë, pa qenë ne dëshmitarë aty përderisa ju e bëni atë. Madje as një peshë atomi nuk është jashtë kontrollit të

Zotëruesit tuaj, qoftë ajo në qiej apo tokë. As nuk ka ndonjë gjë më të vogël se një atom, as më të madhe, që nuk është e regjistruar në një regjistër të qartë.

*Lumturi: Tash dhe përgjithmonë**

[62] Absolutisht, aleatët e Zotit nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen.

[63] Ata janë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë.

[64] Për ta, gëzim dhe lumturi në këtë botë, si dhe në Përjetësi. Ky është ligji i pandryshueshëm i Zotit. I tillë është triumfi më i madh.

[65] Mos u dëshpëro nga shprehjet e tyre. E gjithë fuqia është e Zotit. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[66] Absolutisht, i Zotit është çdokush në qiej dhe çdokush në tokë. Ata që ngritin idhuj përkrah Zotit janë në fakt duke mos ndjekur asgjë. Ata vetëm mendojnë që janë duke ndjekur diçka. Ata vetëm hamenden.

[67] Ai është Ai që e bëri natën për pushimin tuaj, dhe e bëri ditën të ndriçuar. Këto janë prova për njerëzit që mund të dëgjojnë.

Blasfemia e tepërt

[68] Ata thanë, "Zoti ka lindur djalë!" Qoftë i madhëruar Ai. Ai është Më i Pasuri. E Tij është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Ju nuk keni asnjë provë për të përkrahur një blasfemi të tillë. A po thoni për Zotin çka nuk dini?

[69] Deklaro: "Ata që trillojnë rrena për Zotin nuk do ia dalin."

[70] Ata e marrin hisen e tyre të përkohshme në këtë botë, pastaj te ne është kthimi i tyre përfundimtar, pastaj i parashtrijmë në ndëshkim të rreptë për mosbesimin e tyre.

Nuhu

[71] Recito për ta historinë e Nuhut. Ai u tha njerëzve të tij, "O njerëzit e mi, nëse e gjeni pozicionin tim dhe tërheqjen time të vërejtjes ndaj jush në lidhje me shpalljet e Zotit të tepërta për ju, atëherë unë mbështetem te Zoti. Ju duhet të mblidheni me udhëheqësit tuaj, të pajtoheni në një vendim të fundit mes jush, dhe pastaj më lejoni ta di atë pa vonesë.

[72] Nëse refuzoni, atëherë unë nuk kam kërkuar nga ju ndonjë pagë. Paga ime vjen prej Zotit. Unë jam urdhëruar që të jem i nënshtruar."

[73] Ata e refuzuan atë dhe, si pasojë, ne e shpëtuan atë dhe ata që iu bashkangjitën atij te arka; i bëmë ata trashëgimtarë. Dhe i mbytëm ata që refuzuan shpalljet tona. Vini re pasojat; ata kanë qenë të paralajmëruar.

Njerëzit insistojnë në mëkatën e tyre fillestar

[74] Pastaj dërguam pas tij të dërguarë te njerëzit e tyre, dhe ata u treguan atyre prova të qarta. Por ata nuk kishin për të besuar në çka e kishin refuzuar më parë. Kështu i mbyllim zemrat e shkelësve.

Moisiu dhe Aroni

[75] Pastaj ne dërguam pas tyre Moisiun dhe Aronin te Faraoni dhe grupi i tij, me provat tona. Por ata u bënë mendjemëdhenj; dhe ishin njerëz shkelës.

[76] Kur e vërteta u erdhi atyre nga ne, thanë, "Kjo është qartazi magji!"

* 10:62-64 Shumica e njerëzve mendojnë se atyre iu duhet të presin deri në Ditën e Ringjalljes para se t'i pranojnë shpërblimet e tyre për drejtësi, ose ndëshkimin për shpirtligësi. Por Kurani vazhdimisht i siguron besimtarët që atyre u është garantuar lumturi e përsosur këtu në këtë botë, tash dhe përgjithmonë. Në fund të afatit të tyre këtu, ata shkojnë drejtë në Parajsë (shih Shtojcën 17).

[77] Moisiu tha, “A kështu e përshkruani të vërtetën kur ajo vjen te ju? A është kjo magji? Si mundet ndonjë magjistar të mbizotërojë?”

[78] Ata thanë, “A erdhe të na largosh nga çka i gjetëm prindërit tanë duke bërë, dhe për të arritur pozita dominimi për vete? Ne kurrë nuk do të bashkangjitemi ty si besimtarë.”

E vërteta mbizotëron

[79] Faraoni tha, “Më sillni mua çdo magjistarë me përvojë.”

[80] Kur erdhën magjistarët, Moisiu u tha atyre, “Hidhni çfarë do të hidhni.”

[81] Kur ata hodhën, Moisiu tha, “Çka keni prodhuar ju është magji, dhe Zoti do e bëjë të dështojë. Zoti nuk i përkrahë punët e shkelësve.”

[82] Zoti e vendosë të vërtetën me fjalët e Tij, përkundër kriminelëve.

[83] Askush nuk besoi me Moisiun përveç një pakice nga njerëzit e tij, përderisa i frikësoheshin tiranisë së Faraonit dhe këshilltarëve të tij. Padyshim, Faraoni ishte tepër mendjemadh në tokë, dhe një tiran i vërtetë.

[84] Moisiu tha, “O njerëzit e mi, nëse vërtetë keni besuar në Zotin, atëherë kini besim te Ai, nëse vërtetë jeni të nënshtruar.”

[85] Ata thanë, “Ne kemi besim te Zoti. Zotëruesi ynë, shpëtona nga persekutimi i këtyre njerëzve shtypës.

[86] “Çlirona, me mëshirën Tënde, nga njerëzit mosbesimtarë.”

[87] E frymëzua Moisiun dhe vëllanë e tij. “Mbani shtëpitë tuaja në Egjipt tash për tash, shndërroni shtëpitë tuaja në sinagoga, dhe mbani Lutjet e Kontaktit (Salat). Jepu myzhde besimtarëve.”

[88] Moisiu tha, “Zotëruesi ynë, i ke dhënë Faraonit dhe këshilltarëve të tij luks dhe pasuri në këtë botë. Zotëruesi ynë, ata vetëm i përdorin ato për t’i zbrapsur të tjerët prej rrugës Tënde. Zotëruesi ynë, fshijau pasurinë e tyre, dhe ua ngurtëso zemrat për t’i parandaluar nga besimi, derisa ta shohin ndëshkimin që dhemb.”

[89] Ai tha, “Lutja juaj ka marrë përgjigje (o Moisi dhe Aron), pra jini të durueshëm, dhe mos i ndiqni rrugët e atyre që nuk dinë.”

[90] I dërguam Fëmijët e Izraelit matanë detit. Faraoni dhe trupat e tij i ndoqën, mizorisht dhe mëkatnisht. Kur mbytja u bë realitet për të, tha, “Besoj që nuk ka zot përveç Atij në të cilin kanë besuar Fëmijët e Izraelit; Unë jam i nënshtruar.”

[91] “Tepër vonë!* Se tashmë je rebeluar, dhe zgjodhe të jesh shkelës.

*Trupi i Faraonit ruhet**

[92] “Sot, ne do të ruajmë trupin tënd, për të të bërë mësim për gjeneratat e ardhshme.” Fatkeqësisht, shumë njerëz nuk janë të vëmendshëm për shenjat tona.

[93] I kemi pajisur Fëmijët e Izraelit me pozitë të ndershme, dhe i bekuam ata me furnizime të mira. Prapëseprapë, ata u grindën kur kjo njohuri erdhi te ta. Zotëruesi yt do i gjykojë ata në Ditën e Ringjalljes sa i përket çdo gjëje për të cilën u grindën.

Dyshimi i të dërguarit

[94] Nëse ke ndonjë dyshim në lidhje me çka të është zbuluar nga Zotëruesi yt, atëherë pyeti ata që

* 10:91 Besimi në Zotin është hapi i parë. Pas kësaj, duhet të ushqehet dhe të zhvillohet shpirti nëpërmjet praktikave të adhurimit (shih Shtojcën 15).

* 10:92 Zoti i pajisi Egjiptasit me njohurinë e veçantë të mumifikimit. Sot, trupi i mumifikuar i Faraonit është në ekspozitë në Muzeun e Kajros.

lexojnë shkrimin paraprak. Vërtetë, e vërteta ka ardhur te ti prej Zotëruesit tënd. Mos ji me dyshuesit.

[95] As mos iu bashkëngjit atyre që refuzojnë shpalljet e Zotit, se mos bëhesh me humbësit.

[96] Padyshim, ata që janë të mallkuar me vendim nga Zotëruesi yt nuk mund të besojnë.

[97] Pa marrë parasysh çfarë prove iu tregon atyre, (ata nuk mund të besojnë), derisa ta shohin ndëshkimin që dhemb.

Kombet besimtare përparojnë

[98] Cilado shoqëri që beson padyshim do të shpërblehet për besimin. Për shembull, njerëzit e Jonas: kur ata besuan, ne e hoqëm ndëshkimin poshtërues që ata kishin qenë duke e vuajtur në këtë botë, dhe i bëmë përparimtarë.

*Mosbesimtarët bllokohen**

[99] Sikur të donte Zotëruesi yt, të gjithë njerëzit në tokë do të kishin besuar. A dëshiron t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?

[100] Asnjë shpirt nuk mund të besojë përveç në përputhje me vullnetin e Zotit. Se Ai e vë një mallkim mbi ata që refuzojnë të kuptojnë.

[101] Thuaj, "Shikoni të gjitha shenjat në qiej dhe tokë." Të gjitha provat dhe të gjitha paralajmërimet nuk mund t'i ndihmojnë njerëzit që vendosën të mos besojnë.

[102] A mund të presin ata tjetër pos fatit të homologëve të tyre në të kaluarën? Thuaj, "Pritni, dhe, së bashku me ju, po pres edhe unë."

Fitore e garantuar

[103] Përfundimisht i shpëtojmë të dërguarit tonë dhe ata që besojnë. Është ligj i pandryshueshëm i yni që t'i shpëtojmë besimtarët.

[104] Thuaj, "O njerëz, nëse keni ndonjë dyshim sa i përket fesë sime, unë nuk adhuroj çka ju adhuron përkrah Zotit. Unë e adhuroj vetëm Zotin; Atë që do i përfundojë jetët tuaja. Unë jam urdhëruar të jem besimtar."

[105] Jam urdhëruar: "Mbaje veten të përkushtuar ndaj fesë monoteiste; të mos praktikosh adhurim idhujsh.

[106] "Të mos adhurosh përkrah Zotit çka nuk posedon aspak fuqi të të sjellë dobi apo të të dëmtojë. Nëse po, atëherë do të jesh shkelës."

E gjithë fuqia është e Zotit

[107] Nëse Zoti të prekë me vështirësi, askush nuk mund ta lehtësojë përveç Atij. Dhe kur Ai të bekon ty, asnjë forcë nuk mund ta pengojë hirësinë e Tij. Ai e dhuron atë mbi këdo që Ai zgjedhë nga mesi i shërbëtorëve të Tij. Ai është Falësi, i Mëshirshmi.

[108] Deklaro: "O njerëz, e vërteta ka ardhur këtu nga Zotëruesi juaj. Kushdo që udhëzohet është i udhëzuar për të mirën e vet. Dhe kushdo që shkon në humbje, shkon në humbje në dëm të vetes. Unë nuk jam kujdestar i juaji."

[109] Ndiq çka të është shpallur ty, dhe ji i durueshëm derisa Zoti të nxjerrë gjykimin e Tij; Ai është gjykatësi më i mirë.

* 10:99-101 Testi kërkon që ta flakim idhujtarinë vetë, pa ndërhyrje hyjnore në vendimin tonë fillestar. Zoti i bllokoi ata që zgjedhin të mos besojnë.

Surja 11: Hudi (Hud)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.R. Ky është shkrim strofat e të cilit janë të përsosura, dhe të sqaruara.* Vjen nga Më i Mençuri, Më Njohësi.

Kurani: I dërguari i Zotit

[2] Duke shpallur: “Të mos adhuroni përveç Zotit. Unë vij te ju prej Tij si paralajmërues, si dhe si bartës i lajmeve të mira.

[3] “Të kërkoni faljen e Zotëruesit tuaj, pastaj të pendoheni te Ai. Ai pastaj do t’ju bekojë bujarisht për një kohë të paracaktuar, dhe të dhurojë hirësinë e Tij mbi ata që e meritojnë atë. Nëse refuzoni, atëherë kinie frikë ndëshkimitin e një dite të hatashme.”

[4] Te Zoti është kthimi juaj përfundimtar, dhe Ai është i Gjithëfuqishëm.

[5] Vërtetë, ata i fshehin mendimet e tyre më të thella, sikur ta mbanin Atë larg nga dija për to. Në fakt, përderisa e mbulojnë veten me rrobat e tyre, Ai i din të gjitha të fshehtat e tyre dhe deklarimet. Ai i din mendimet më të thella.

Furnizimet të garantuara

[6] Nuk ka asnjë krijesë në tokë furnizimi i të cilës nuk është i garantuar nga Zoti. Dhe Ai e din rrugën e saj dhe fatin përfundimtar. Të gjitha janë të regjistruara në një regjistër të qartë.

[7] Ai është Ai që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë - * dhe pushteti (tokësor) i Tij ishte krejtësisht i mbuluar me ujë - * për t’ju testuar juve, për t’i dalluar ata mes jush që punojnë drejtësi. Prapëseprapë, kur thoni, “Ju do të ringjalleni pas vdekjes,” ata që nuk besojnë do të thoshin, “Kjo është haptazi trillim.”

[8] Dhe nëse e vonojmë ndëshkimin që ata e kanë vetëshkaktuar – se ne e rezervojmë për një shoqëri të posaçme – ata thonë, “Çka po e mbanë Atë?” Në fakt, kur t’iu vijë atyre, askush nuk mund ta ndalë, dhe tallja e tyre do iu kthehet për t’i kapluar.

[9] Sa herë që e bekojmë qenien njerëzore me mëshirë nga ne, pastaj e heqim atë, ai bëhet i dëshpëruar, mosmirënjohës.

[10] Sa herë që e bekojmë atë, pasi që fatkeqësia e ka pllakosur atë, thotë, “E gjithë fatkeqësia është larguar nga unë;” ai bëhet i ngazëllyer, krenar.

[11] Sa për ata që durojnë me këmbëngulje, dhe çojnë jetë të drejtë, ata meritojnë falje dhe pagesë bujare.

Shpallja e Zotit është e rëndë

[12] Ti mund të dëshirosh të shpërfillësh diçka nga ajo që të është shpallur ty, dhe mund të zemërohesh nga ajo. Gjithashtu, ata mund të thonë, “E si asnjë thesar nuk po i zbret atij, ose ndonjë engjëll?” Ti je vetëm paralajmërues; Zoti i ka në dorë të gjitha gjërat.

Kurani: E pamundur të lmitohet

* 11:1 Gjenerata jonë ka fatin të jetë dëshmitare e dy fenomeneve mbresëlënëse në Kuran: (1) një kod të jashtëzakonshëm matematikor (Shtojca 1), dhe (2) një mrekulli letrare të përmasave të jashtëzakonshme. Nëse njerëzit provojnë të shkruajnë një punim matematikisht të ndërtuar, manipulimet numerike do të dëmtojnë tepër cilësinë letrare. Kurani vendosë standardin për përsosmëri letrare.

* 11:7 Gjashtë ditët janë thjeshtë ‘metër’ matëse që na jep neve shumë informata. Kështu, mësojmë se universi fizik i gjerë i pajetë u krijuar për dy ditë, përderisa grimca e vogël e quajtur “Tokë” u krijua për katër ditë (41:10-12). Furnizimi i ushqimit, ujit, dhe oksigjenit për banorët e tokës u deshtë të llogaritet saktësisht dhe të rregullohet.

* 11:7 Toka ishte fillimisht e mbuluar me ujë. Më pas, masa tokësore u shfaq, dhe kontinentet u larguan nga njëri tjetri.

[13] Nëse thonë, “Ai e trilloi (Kuranin),” thuaju, “Atëherë prodhoni dhjetë sure si këto, të trilluara, dhe ftoni këdo që mundeni, tjetër pos Zotit, nëse jeni të sinqertë.”*

[14] Nëse nuk arrijnë ta përmbushin sfidën, atëherë dijeni se ky është i shpallur me dijen e Zotit, dhe se nuk ka asnjë zot përveç Tij. A do të nënshtroheni atëherë?

[15] Ata që e ndjekin jetën e kësaj bote dhe kotësitë materiale të saj, ne do i paguajmë ata për punët e tyre në këtë jetë, pa as më të voglin zvogëlim.

[16] Janë ata që hoqën dorë nga hisja e tyre në Përjetësi, dhe, si pasojë, Ferri është ngastër e tyre. Të gjitha punët e tyre janë të kota; çdo gjë që kanë bërë është asgjësuar.

Kodi Matematikor i Kuranit

[17] Sa për ata që iu jepet provë e qëndrueshme* nga Zotëruesi i tyre, e raportuar nga një dëshmitar prej Tij, dhe para kësaj, libri i Moisiut ka vënë precedent dhe mëshirë,* ata padyshim do të besojnë. Sa për ata që nuk besojnë mes grupeve të ndryshme, Ferri po i pret. Mos ushqe asnjë dyshim; kjo është e vërteta nga Zotëruesi yt, por shumica e njerëzve nuk besojnë.

[18] Kush janë më të këqij se ata që trilluan rrena për Zotin? Ata do të paraqiten para Zotëruesit të tyre, dhe dëshmitarët do të thonë, “Këta janë ata që gënjyen për Zotëruesin e tyre. Dënimi i Zotit ka rënë mbi shkelësit.”

[19] Ata zmbarsen nga rruga e Zotit dhe kërkojnë ta bëjnë të shtrembër, dhe nuk besojnë në Përjetësinë.

Mosbesimtarët

[20] Ata nuk do të shpëtojnë, as nuk do të gjejnë asnjë zotëruer apo sundues për t’iu ndihmuar atyre kundër Zotit. Ndëshkimi do të dyfishohet për ta. Ata nuk kanë arritur të dëgjojnë, dhe nuk kanë arritur të shohin.

[21] Këta janë ata që humbin shpirtrat e tyre, dhe idhujt që i kanë trilluar do i bëjnë hasha.

[22] Nuk ka asnjë dyshim se, në Përjetësi, ata do të jenë humbësit më të këqij.

Besimtarët

[23] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, dhe ia kushtojnë veten Zotëruesit të tyre, ata janë banuesit e Parajsës; aty qëndrojnë përgjithmonë.

[24] Shembulli i këtyre dy grupeve është si i verbëri dhe shurdhi, krahasuar me pamësin dhe dëgjuesin. A janë të barabartë? A nuk po merrni vesh?

Nuhu

[25] E dërguam Nuhun te njerëzit e tij, duke thënë, “Unë vij te ju si paralajmërues i qartë.

[26] “Të mos adhuroni përveç Zotit. Kam frikë për ju ndëshkimin e një dite që dhemb.”

[27] Udhëheqësit që nuk besuan mes njerëzve të tij thanë, “E shohim se ti nuk je asgjë më shumë se një qenie njerëzore si ne, dhe e shohim se njerëzit që të ndjekin ty janë më të këqijtë mes nesh. E shohim se ju nuk keni ndonjë përparësi ndaj nesh. Vërtetë, mendojmë se jeni gënjeshtarë.”

[28] Ai tha, “O njerëzit e mi, çka nëse kam prova të qëndrueshme nga Zotëruesi im? Çka nëse Ai më ka bekuar për shkak të mëshirës së Tij, edhe pse ju nuk po mund ta shihni? A do t’ju detyrojmë juve që të besoni në të?

[29] “O njerëzit e mi, unë nuk ju kërkoj para; rroga ime vjen vetëm prej Zotit. Unë nuk po i largoj

* 11:13 Mrekullia matematikore e Kuranit është e paimitueshme (Shih Shtojcën 1).

* 11:17 Kodi matematikor i Kuranit i bazuar në 19 është provë e autorësisë hyjnore. Ia vlen të përmendet që fjala “Bajinah” (provë) përmendet në Kuran 19 herë.

* 11:17 Siç del, libri i Moisiut ishte gjithashtu i hartuar matematikisht, me “19-shin” si emërues të përbashkët. Shih Shënimin 46:10 dhe Shtojcën 1.

ata që besuan; ata do të takojnë Zotëruesin e tyre (dhe vetëm Ai do i gjykojë ata). E shoh se jeni njerëz të padijshëm.

[30] "O njerëzit e mi, kush mund të më përkrahë mua kundër Zotit, nëse i largoj ata? A nuk po merrni vesh?"

E gjithë fuqia është e Zotit

[31] "Unë nuk po pretendoj që i posedoj thesaret e Zotit, as nuk e di të ardhmen, as nuk po pretendoj që jam engjëll. As nuk iu them atyre që janë të përbuzur nga sytë e juaj që Zoti nuk do dhurojë ndonjë bekim mbi ta. Zoti e di më së miri çka ka në mendimet e tyre më të thella. (Sikur ta bëja këtë,) do të isha shkelës."

[32] Ata thanë, "O Nuh, je grindur me ne, dhe vazhdove të grindesh. Të sfidojmë ty të na sjellësh fundin me të cilin po na kërcënon, nëse je i singhtë."

[33] Ai tha, "Zoti është Ai që e sjell atë te ju, nëse Ai do, pastaj ju nuk mund të shpëtoni.

[34] "Edhe nëse ju këshilloj juve, këshilla ime nuk mund të ju bëjë dobi juve nëse vullneti i Zotit është të ju dërgojë në humbje. Ai është Zotëruesi juaj, dhe te Ai do të ktheheni."

[35] Nëse thonë, "Ai e trilloi këtë tregim," atëherë thuaj, "Nëse e trillova, atëherë unë jam përgjegjës për krimin tim, dhe unë jam i pafajshëm për cilindo krim që ju kryeni."

[36] Nuhu u frymëzua; "Askush tjetër nga njerëzit e tu nuk do të besojnë, përveç atyre që kanë besuar tashmë. Mos u pikëllo nga veprimet e tyre.

[37] "Ndërtoje arkën nën sytë tonë vigjilues, dhe me frymëzimin tonë, dhe mos m'u lut Mua në emër të atyre që kanë shkelur; ata janë paracaktuar të mbyten."

Kush qeshë i fundit qeshë më mirë

[38] Përderisa ai ishte duke e ndërtuar arkën, sa herë që disa nga njerëzit e tij kaluan pranë tij ata qeshën me të. Ai tha, "Ju mund të qeshni me ne, por ne po qeshim me ju, ashtu si po qeshni edhe ju.

[39] "Gjithsesi do e merrni vesh kush do të vuaj ndëshkim të turpshëm, dhe të pësojë ndëshkim të përhershëm."

[40] Kur gjykimi jonë erdhi, dhe atmosfera vloi, thamë, "Mbart në të një çift të secilit lloj* së bashku me familjen tënde, përveç atyre që janë të mallkuar. Mbart me vete ata që kanë besuar." Dhe vetëm një pakicë kanë besuar me të.

[41] Ai tha, "Hipni në të. Në emër të Zotit të jetë lundrimi i saj, dhe ankorimi i saj. Zotëruesi im është Falës, i Mëshirshmi."

[42] Përderisa lundroi me ta në valë si kodra, Nuhu e thirri të birin e tij, që ishte izoluar: "O djali im, hip bashkë me ne; mos ji me mosbesimtarët."

[43] Ai tha, "Unë do të strehohem në maje të një kodre, për të më mbrojtur nga uji." Ai tha, "Asgjë nuk mund të mbrojë askënd sot prej gjykimit të Zotit; vetëm ata që meritojnë mëshirën e Tij (do të ruhen)." Valët i ndanë ata, dhe ai ishte mes atyre që u mbytën.

Ku u ndal arka (anija)

[44] U deklarua: "O tokë, përpije ujin tënd," dhe "O qiell, mjaft më." Uji pastaj ra; gjykimi u përmbush. Arka më në fund u ndal mbi kodrat e Judeas. Pastaj u deklarua: "Shkelësit kanë mbaruar."

* 11:40 & 44 Kjo është e vërteta e vërtetuar e Zotit; Arka e Nuhut u bë nga dru, të lidhur së bashku me litarë primitiv (54:13). Përkundër besimit të zakonshëm, vërshimi u kufizua në hapësirën rreth Detit të Vdekur të sotshëm, dhe kafshët ishin kafshët shtëpiake të Nuhut; e jo të gjitha kafshët që jetuan në tokë.

[45] Nuhu iu përgjërua Zotëruesi të tij: “Zotëruesi im, djali im është anëtar i familjes time, dhe premtimi Yt është i vërtetë. Ti je më i mençuri i të mençurve.”

Miti i ndërmjetësimit

[46] Ai tha, “O Nuh, ai nuk është prej familjes tënde. Është e padrejtë të më kërkosh diçka që nuk e din.* Unë të këshilloj ty, që të mos jesh si të padijshmit.”

[47] Ai tha, “Zotëruesi im, kërktoj strehim te Ti, që të mos të të përgjërohem përsëri për diçka që unë nuk di. Po të mos më falësh, dhe të kesh mëshirë ndaj meje, do të jem me humbësit.”

[48] U deklarua: “O Nuh, zbarko, me paqe dhe bekime mbi ju, dhe mbi kombet që do të rrjedhin nga bashkudhëtarët tu. Sa për kombet tjera që rrjedhin prej teje, do i bekojmë për një kohë të shkurtër, pastaj do i parashtrojmë në ndëshkim që dhemb.”

[49] Ky është lajm nga e kaluara që të shpallim ty. Ti nuk ishe aspak në dijeni për ta – as ti, as njerëzit e tu – para kësaj. Prandaj, ji i durueshëm. Fitorja përfundimtare i takon të drejtëve.

Hudi: Një dhe i njëjti lajm

[50] Te Adi dërguam vëllanë e tyre Hudin. Ai tha, “O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; ju nuk keni asnjë zot tjetër përveç Tij. Jeni duke shpikur.

[51] O njerëzit e mi, nuk po ju kërktoj ndonjë pagë. Rroga ime vjen vetëm prej Atij që më nisi mua. A nuk kuptoni?

[52] “O njerëzit e mi, kërkoni falje prej Zotëruesit tuaj, pastaj pendohuni te Ai. Ai pastaj do të derdhë mbi ju furnizimet nga qielli, dhe t’jua shtojë forcën tuaj. Mos u shndërroni prapë në shkelës.”

[53] Thanë, “O Hud, ti nuk na tregove asnjë shenjë, dhe ne nuk e kemi ndërmend t’i braktisim zotat tanë për arsye të asaj që po thua. Kurrë nuk do të jemi besimtarë me ty.

[54] “Ne besojmë se disa nga zotat tanë të kanë pllakosur me ndonjë mallkim.” Tha, “Jam dëshmitar para Zotit, dhe ju jeni dëshmitarë po ashtu, që unë i bëj hasha idhujt që i keni ngritur -

[55] “përkrah Tij. Pra, më jepni vendimin tuaj të përbashkët, pa vonesë.

[56] “Unë kam besim te Zoti, Zotëruesi im dhe Zotëruesi juaj. Nuk ka asnjë krijesë që Ai nuk e ka në dorë. Zotëruesi im është në rrugën e drejtë.

[57] “Nëse ktheheni, unë e kam sjellë te ju atë me të cilën jam dërguar. Zotëruesi im do të zëvendësojë njerëz të tjerë në vendin tuaj; nuk mund ta dëmtoni Atë as edhe pak. Zotëruesi im i ka në dorë të gjitha gjërat.”

[58] Kur gjykimi ynë iu erdhi atyre, e shpëtuam Hudin dhe ata që besuan me të, me mëshirë prej nesh. I shpëtuam nga një ndëshkim i tmerrshëm.

[59] I tillë ishte Adi – i shpërfillën shpalljet e Zotëruesit të tyre, nuk iu bindën të dërguarve të Tij, dhe ndoqën rrugët e çdo tirani kokëfortë.

[60] Si pasojë, ata vetëshkaktuan mallkim në këtë botë, dhe në Ditën e Ringjalljes. Vërtetë, Adi e refuzuan Zotëruesin e tyre. Vërtetë, Adi, njerëzit e Hudit, kanë mbaruar.

Salihu: Një dhe i njëjti Lajm

[61] Te Themudi dërguam vëllanë e tyre Salihun. Ai tha, “O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; ju nuk keni asnjë zot tjetër përkrah Tij. Ai ju nisi juve nga toka, pastaj ju vendosi në të. Ta kërkoni faljen e Tij, pastaj pendoheni te Ai. Zotëruesi im është gjithmonë afër, reagon.”

* 11:46 Ndërmjetësimi është karremi më efikas i Drejt për t’i joshur njerëzit në adhurim idhujsh. Megjithatë, Ibrahim i nuk mundi t’i ndihmojë babait të vet, as Nuhu t’i ndihmojë djalit të tij, as Muhamedi t’i ndihmojë të afërmit e vet (2:254, 9:80 & 114).

[62] Ata thanë, “O Salih, ti dikur ishe i popullarizuar mes nesh para kësaj. A po na ndalon neve nga adhurimi i asaj që adhurojnë prindërit tanë? Jemi plot dyshim në lidhje me çdo gjë që na ke treguar.”

Mosbesimtarët gjithmonë humbës

[63] Ai tha, “O njerëzit e mi, çka nëse kam prova të qëndrueshme prej Zotëruesit tim, dhe mëshirë prej Tij? Kush do të më përkrahte mua kundër Zotit, nëse nuk i bindem Atij? Ju nuk mund të më sillni diçka tjetër përveç humbjes time.

[64] “O njerëzit e mi, kjo është deveja e Zotit që të shërbejë si provë për ju. Ta lini të hajë prej tokës së Zotit, dhe mos e prekni me ndonjë dëm, se vetëshkaktoni ndëshkim të menjëhershëm.”

[65] Ata e therën atë. Ai pastaj tha, “Keni vetëm tre ditë për të jetuar. Kjo është profeci që është e pashmangshme.”

[66] Kur erdh gjykimi ynë, e shpëtuam Salihun dhe ata që besuan me të me mëshirë prej nesh, nga poshtërimi i asaj dite. Zotëruesi juaj është Më i Fuqishmi, i Plotfuqishmi.

[67] Ata që shkelën u asgjësuan nga katastrofa, duke i lënë ata në shtëpitë e tyre, të vdekur.

[68] Ishte sikur të mos kishin jetuar kurrë atje. Vërtetë, Themudi e kanë refuzuar Zotëruesin e tyre. Absolutisht, Themudi e kanë vetëshkaktuar asgjësimin e tyre.

Ibrahimi dhe Luti

[69] Kur të dërguarit tonë shkuan te Ibrahimi me myzhde, thanë, “Paqe.” Tha, “Paqe,” dhe së shpejti solli një viç të pjekur.

[70] Kur ai e pa që duart e tyre nuk e prekën, ai u çudit dhe u frikësua nga ta. Thanë, “Mos u frikëso, ne jemi duke u dërguar te njerëzit e Lutit.”

[71] Gruaja e tij ishte në këmbë, dhe ajo qeshi kur ata i dhanë asaj myzhdenë për Isakun, dhe pas Isakut, Jakobin.

[72] Ajo tha, “E mjera unë, si mund të kem fëmijë në moshën time, dhe ja ku është burri im, plak? Kjo është vërtetë e çuditshme!”

[73] Ata thanë, “A po të duket e çuditshme për Zotin? Zoti e ka dhuruar mëshirën dhe bekimet e Tij mbi ju, o banuesit e faltores. Ai është i Falënderuar, i Madhëruar.”

[74] Kur frika e Ibrahimit u ul, dhe myzhdeja iu dërgua atij, ai vazhdoi të grindet me ne në emër të njerëzve të Lutit.

[75] Vërtetë, Ibrahimi ishte i butë, jashtëzakonisht i dashur, dhe i dëgjueshëm.

[76] “O Ibrahim, mjaft me këtë. Gjykimi i Zotëruesit tënd është vendosur; ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të pashmangshëm.”

Homoseksualiteti dënohet

[77] Kur të dërguarit tonë shkuan te Luti, u keqtrajtuan, dhe ai u turpërua nga prania e tyre. Tha, “Kjo është ditë e vështirë.”

[78] Njerëzit e tij erdhën me nxitim; ishin mësuar me veprat e tyre mëkatore. Tha, “O njerëzit e mi, do të ishte më pastër për ju, nëse i merrni të bijat e mia. T’ia keni dronë Zotit; mos më turpëroni me mysafirët e mi. A nuk keni asnjë njeri të arsyeshëm mes jush?”

[79] Thanë, “Ti e din mirë që ne nuk kemi nevojë për bijat tua; ti e din saktësisht çka duam.”

[80] Tha, “Ah sikur të isha mjaft i fortë, ose të kisha një aleat të fortë!”

[81] (Engjëjt) thanë, “O Lut, ne jemi të dërguarit e Zotëruesit tënd, dhe këta njerëz nuk mund të të prekin. Të largohesh me familjen tënde gjatë natës, dhe le të mos shikojë askush prej jush mbrapa, përveç gruas tënde; ajo është e mallkuar së bashku me ata që janë të mallkuar. Koha e tyre e

caktuar është mëngjesi. A nuk është mëngjesi mjaft shpejt?”

Sodoma dhe Gomora të shkatërruar

[82] Kur gjykimi ynë erdhi, e përmbysëm, dhe i derdhëm rrebesh gurësh të fortë, shkatërrues.

[83] Gurë të tillë ishin dizajnuar nga Zotëruesi yt për t'i goditur shkelësit.

Shuajbi: Një dhe të njëjtin lajm

[84] Te Medjeni dërguam vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha, “O njerëzit e mi, adhuronie Zotin; nuk keni asnjë zot tjetër përkrah Tij. Mos mashtroni kur matni ose peshoni. E shoh se keni përparuar, dhe kam frikë për ju ndëshkimin e një dite të jashtëzakonshme.

[85] “O njerëzit e mi, të jepni masë të plotë dhe peshë të plotë, me barazi. Mos i mashtroni njerëzit nga të drejtat e tyre, dhe mos u endni nëpër tokë në mënyrë të korruptuar.

[86] “Çfarëdo që Zoti furnizon për ju, pa marrë parasysh sa e vogël, është shumë më mirë për ju, nëse jeni vërtetë besimtarë. Unë nuk jam mbikëqyrës i juaji.”

[87] Ata thanë, “O Shuajb, a të urdhëron feja jote që ne duhet ta braktisim fenë e prindërve tanë, ose të kryejmë punët në cilëndo mënyrë që zgjedhim? Padyshim, ti njihesh për të qenit i butë, i mençur.”

[88] Ai tha, “O njerëzit e mi, çka nëse kam provë të qëndrueshme nga Zotëruesi im; çka nëse Ai më ka furnizuar me bekim të madh? Nuk është dëshira ime që të kryej atë që ua ndaloj juve. Unë vetëm dëshiroj të ndreqë sa më shumë gabime që mundem. Udhëzimi im varet plotësisht nga Zoti; Unë kam besim në Të. Atij i jam nënshtruar plotësisht.

[89] “Dhe, o njerëzit e mi, mos u shtyni nga kundërshtimi i juaj ndaj meje që të vetëshkaktoni fatkeqësitë e njëjta si të njerëzve të Nuhut, ose të njerëzve të Hudit, ose të njerëzve të Salihut; dhe njerëzit e Lutit nuk janë shumë larg jush.

[90] “T'i luteni Zotëruesit tuaj për falje, pastaj të pendoheni te Ai. Zotëruesi im është i Mëshirshmi, i Dashur.”

[91] Ata thanë, “O Shuajb, ne nuk i kuptojmë shumë nga gjërat që po na tregon, dhe po shohim se ti je i pafuqi mes nesh. Po të mos ishte për fisin tënd, do të kishim gjuajtur me gurë për vdekje. Ti nuk ke aspak vlerë për ne.”

[92] Ai tha, “O njerëzit e mi, a keni më shumë respekt ndaj fisit tim sesa Zotit? A për këtë keni qenë të pavëmendshëm ndaj Tij? Zotëruesi im është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëni.

[93] “O njerëzit e mi, vazhdoni të bëni çka të dëshironi, edhe unë do të bëj ashtu. Ju padyshim do e shihni se cili prej nesh do të pësojë ndëshkim që dhemb; do e shihni se kush është gënjeshtari. Thjeshtë pritni, dhe unë do të pres së bashku me ju.”

[94] Kur gjykimi ynë erdhi, e shpëtua Shuajbin dhe ata që besuan me të, me mëshirë prej nesh. Sa për shpirtligjtë, ata u goditën nga një katastrofë që i la ata të vdekur në shtëpitë e tyre.

[95] Ishte sikur të mos kishin ekzistuar kurrë. Kështu, Medjeni mbaroi, ashtu si Themudi ka mbaruar më parë.

Moisiu

[96] E dërguam Moisiun me shenjat tona dhe autoritet të qartë.

[97] Te Faraoni dhe këshilltarët e tij. Por ata ndoqën urdhrin e Faraonit, dhe urdhri i Faraonit nuk ishte i mençur.

[98] Do i çojmë njerëzit e tij në Ditën e Ringjalljes, deri në fund në Ferr; çfarë vendbanimi i tmerrshëm për të jetuar!

[99] Ata kanë vetëshkaktuar dënim në këtë jetë, si dhe në Ditën e Ringjalljes; çfarë rruge e

tmerrshme për ta ndjekur!

Mësime për tu mësuar

[100] Këto janë lajme nga shoqëritë e kaluara që t'i recitojmë ty. Disa ende janë duke qëndruar, dhe disa janë zhdukur.

[101] Ne nuk iu bëmë keq atyre; ata i bënë keq shpirtave të vetë. Zotat e tyre, që i kërkonin përkrah Zotit, nuk mund t'iu ndihmonin atyre aspak kur erdhi vendimi i Zotëruesit tënd. Në fakt, ata vetëm e siguruan dënimin e tyre.

[102] I tillë ishte ndëshkimi i zbatuar nga Zotëruesi yt kur shoqëritë shkelën. Vërtetë, ndëshkimi i Tij dhemb, shkretot.

[103] Ky duhet të jetë mësim për ata që i frikësohen ndëshkimit të Përjetësisë. Ajo është ditë kur të gjithë njerëzit do të mbliidhen – ditë për tu dëshmuar.

[104] Kemi paracaktuar kohë specifike për të që të ndodhë.

[105] Ditën kur i vjen koha, asnjë shpirt nuk do të shprehë asnjë fjalë, përveç në përputhje me vullnetin e Tij. Disa prej tyre do të jenë në vuajtje, të tjerët do të jenë të lumtur.

[106] Sa për ata në vuajtje, ata do të jenë në Ferr, ku rënkojnë dhe kuisin.

[107] Përgjithmonë qëndrojnë aty, sa të ketë qiej dhe tokë, në përputhje me vullnetin e Zotëruesit tënd. Zotëruesi yt është bërës i çdo gjëje që Ai do.

[108] Sa për ata me fat, ata do të jenë në Parajsë. Përgjithmonë qëndrojnë aty, sa të ketë qiej dhe tokë, në përputhje me vullnetin e Zotëruesit tënd – shpërblim i përhershëm.

Ndjekja e prindërve tanë verbërisht tragjedi e madhe njerëzore

[109] Mos ki asnjë dyshim sa i përket asaj që këta njerëz adhurojnë; ata adhurojnë saktësisht ashtu siç i gjetën prindërit e tyre duke adhuruar. Do i paguajmë ata me hisen e tyre plotësisht, pa asnjë zvogëlim.

[110] I kemi dhënë Moisiut shkrimin, por u polemizua, dhe po të mos ishte për një fjalë të paracaktuar të vendosur nga Zotëruesi yt, ata do të ishin gjykuar menjëherë. Ata janë plot dyshim për këtë.

[111] Zotëruesi yt padyshim do të paguaj secilin për punët e tij. Ai është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëjnë.

[112] Prandaj, vazhdo në rrugën që je urdhëruar ta ndjekësh, së bashku me ata që u penduan me ty, dhe mos shkel. Ai është Pamës i çdo gjëje që bëni.

[113] Mos u anoni kah ata që kanë shkelur, se mos vetëshkaktoni Ferr, dhe nuk gjeni asnjë shok për t'ju ndihmuar juve kundër Zotit, pastaj përfundoni humbës.

Tre nga pesë Lutjet

[114] T'i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) në të dy skajet e ditës, dhe gjatë natës. Punët e drejta i fshijnë punët e këqija. Ky është kujtim për ata që do të merrnin vesh.

[115] Të duroni me këmbëngulje, se Zoti nuk ngelë së shpërblyeri të drejtit.

[116] Vetëm sikur disa prej atyre mes gjeneratave paraprake të posedonin mjaft inteligjencë për të ndaluar të këqijat! Vetëm një pakicë e tyre merituan të shpëtohen nga ne. Sa për shpirtligjtë, ata ishin të preokupuar me lukset e tyre materiale; ata ishin fajtorë.

[117] Zotëruesi yt nuk asgjëson ndonjë shoqëri padrejtësisht, përderisa njerëzit e saj janë të drejtë.

Pse u krijuam

[118] Sikur të donte Zotëruesi yt, të gjithë njerëzit do të kishin qenë një asamble (e besimtarëve). Por ata gjithmonë do të polemizojnë (të vërtetën).

[119] Vetëm ata të bekuarit me mëshirë nga Zotëruesi yt (nuk do e polemizojnë të vërtetën). Kjo është pse Ai i krijoi ata* Gjykimi i Zotëruesit tënd tashmë është lëshuar: “Unë do e mbushë Ferrin me xhin dhe njerëz, të gjithë së bashku.”*

[120] Të kallëzojmë ty mjaft histori të të dërguarve për të ta përforcuar zemrën. E vërteta ka ardhur te ti këtu, si dhe ndriçime dhe kujtime për besimtarët.

[121] Thuaju atyre që nuk besojnë, “Bëni çka të mundeni, edhe unë do të bëj ashtu.

[122] “Dhe prisni; edhe ne do të presim.”

[123] E Zotit është e ardhmja e qiejve dhe tokës, dhe të gjitha çështjet i ka në dorë Ai. Ta adhuroni Atë dhe të keni besim në Të. Zotëruesi yt nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëni.

Surja 12: Jozefi (Jusuf)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.R. Këto (shkronja) janë prova të këtij shkrimi të qartë.*

[2] E kemi shpallur Kuran arabisht, që të mund të kuptoni.*

[3] Të kallëzojmë ty historinë më të saktë nëpërmjet shpalljes së këtij Kurani. Para kësaj, nuk ishe aspak në dijeni.

[4] Kujtohu që Jozefi i tha babait të tij, “O babai im, pashë njëmbëdhjetë planetë, dhe diellin, dhe hënën; I pashë duke u përulur para meje.”

[5] Ai tha, “Djali im, mos iu trego vëllezërve tu për ëndrrën tënde, se mos po thurin kurthe dhe planifikojnë kundër teje. Padyshim, djalli është armiku më i keq i njeriut.

[6] “Zotëruesi yt kështu të ka bekuar, dhe të ka dhënë myzhde nëpërmjet ëndrrës tënde. Ai i ka përsosur bekimet e Tij mbi ty dhe mbi familjen e Jakobit, ashtu siç bëri për paraardhësit tu Ibrahimin dhe Isakun më parë. Zotëruesi yt është i Gjithëdijshëm, Më i Mençuri.”

[7] Në Jozefin dhe vëllezërit e tij ka mësim për ata që i kërkojnë.

[8] Ata thanë, “Jozefi dhe vëllai i tij po parapëlqehen nga babai ynë, dhe ne jemi në shumicë. Vërtetë, babai ynë është i humbur larg.

Fati i Jozefit veç i vendosur nga Zoti

[9] “Le ta vrasim Jozefin, ose ta dëbojmë, që t’jua kushtojë vëmendjen babai juaj. Pastaj, mund të bëheni njerëz të drejtë.”*

[10] Njëri prej tyre tha, “Mos e vrisni Jozefin; le ta hedhim në fund të pusit. Ndoshta ndonjë karvan mund ta marrë, nëse kjo është çka vendosni të bëni.”

[11] Thanë, “Babai ynë, pse nuk na e beson Jozefin? Ne do të kujdesemi mirë për të.

[12] “Dërgoje me ne nesër për të vrapuar dhe luajtur. Do e ruajmë.”

[13] Ai tha, “Bregosem se mos largoheni me të, pastaj mund ta hajë ujku përderisa nuk jeni duke e këqyrur.”

[14] Ata thanë, “Vërtetë, nëse ujku e ha, me kaq shumë prej nesh përreth, atëherë ne jemi vërtetë

* 11:119 i Mëshirshmi na ka krijuar në këtë tokë për të na dhënë edhe një shans që ne ta mohojmë krimin tonë fillestar dhe të shpengohemi (shih Hyrjen dhe Shtojcën 7).

* 11:119 Zoti nuk e vë asnjë person në Ferr; ata zgjedhin dhe insistojnë që të shkojnë në Ferr.

* 12:1 Inicialet Kuranore janë përbërës madhor të një mrekullie të madhe (Shtojca 1).

* 12:2 Pse u shpall Kurani në arabisht? Shih 41:44 dhe Shtojcën 4.

* 12:9 Mësojmë nga ëndrra e Jozefit që ai ishte paracaktuar për të ardhme të ndritshme. Kështu, përderisa vëllezërit e tij u takuan për ta vendosur fatin e tij, fati i tij veç ishte vendosur nga Zoti. Çdo gjë bëhet nga Zoti (8:17), dhe veç është e regjistruar (57:22).

humbës.”

Besimtarët bekohen me sigurimet e Zotit

[15] Kur ata u larguan me të, dhe njëzëshëm vendosën ta hedhim në fund të pusit, e frymëzuam; “Një ditë, do iu tregosh atyre për të gjithë këtë, përderisa ata nuk e kanë idenë.”

[16] Ata u kthyen te babai i tyre në mbrëmje, duke qarë.

[17] Thanë, “Babai ynë, ne shkuam të garojmë me njëri tjetrin, duke e lënë Jozefin me pajisjet tona, dhe e hëngri ujku. Nuk do të na besosh, edhe sikur të ishim duke treguar të vërtetën.”

[18] Ata erdhën me këmishën e tij me gjak të rrejtshëm. Ai tha, “Vërtetë, keni bërë komplot me njëri tjetrin për të kryer një plan të caktuar. Krejt çka mund të bëj është të strehohem në durim të qetë. Le të më ndihmojë Zoti përballë komplotit tuaj.”

Jozefin e marrin në Egjipt

[19] Një karvan kaloi andej pari, dhe së shpejti dërguan ujëmbartësin e tyre. Ai e lëshoi kovën e tij, pastaj tha, “Çfarë fati! Qenka një djalë këtu!” Ata e morën atë me vete si mall tregtie, dhe Zoti ishte tërësisht i vetëdijshëm çka bënë ata.

[20] Ata e shitën atë për një çmim të lirë – disa dirhemë – se nuk kishin nevojë për të.

[21] E ai që e bleu në Egjipt i tha të shoqes së vet, “Kujdesu mirë për të. Ndoshta mund të na ndihmojë, ose ndoshta mund ta adoptojmë.” Kështu e vendosëm Jozefin në tokë, dhe ia mësuam interpretimin e ëndrrave. Urdhri i Zotit gjithmonë bëhet, por shumica e njerëzve nuk dinë.

[22] Kur ai arriti maturinë, e pajisëm me mençuri dhe njohuri. Kështu i shpërblejmë të drejtit.

Zoti i mbron besimtarët nga mëkati

[23] Gruaja e shtëpisë ku ai jetoi tentoi ta joshë. Ajo i mbylli dyert dhe tha, “Eja merrmë.” Ai tha, “Më ruajt Zoti. Ai është Zotëruesi im, që më dha shtëpi të mirë.* Shkelësit nuk kanë sukses.”

[24] Dhe ajo gati u dha kah ai, dhe ai gati u dha kah ajo, po të mos ishte që ai pa provë nga Zotëruesi i tij. Kështu e larguam të keqen dhe mëkatin larg prej tij, se ai ishte njëri prej shërbëtorëve tonë të devotshëm.

[25] Ata të dy u turrën kah dera, dhe, gjatë procesit, ajo e grisi veshjen e tij nga mbrapa. Ata e gjetën burrin e saj te dera. Ajo tha, “Cili duhet të jetë dënimi për dikë që deshi ta shpërdorojë gruan tënde, përveç burgimit ose ndëshkimit që dhemb?”

[26] Ai tha, “Ajo është ajo që tentoi të më joshë.” Një dëshmitar nga familja e saj sugjeroi: “Nëse veshja e tij është e grisur nga para, atëherë ajo është duke e treguar të vërtetën dhe ai është gënjeshtar.

[27] “Dhe nëse veshja e tij është e grisur nga prapa, atëherë ajo gënjeu, dhe ai po e tregon të vërtetën.”

[28] Kur burri i saj pa që veshja e tij ishte grisur nga prapa, ai tha, “Ky është planifikim gruaje. Vërtetë, planifikimi juaj është i fortë.

[29] “Jozef, shpërfille këtë incident. Sa për ty (gruaja ime), ti duhet të kërkosh falje për mëkatin tënd. Ke bërë gabim.”

[30] Disa gra në qytet përgojuan: “Gruaja e kryetarit po tenton ta joshë shërbëtorin e saj. Ajo ka rënë thellë në dashuri me të. E shohim se ka humbur.”

[31] Kur ajo dëgjoji për përgojimin e tyre, ajo i ftoi ato, përgatiti për to një vend të rehatshëm, dhe i dha secilës prej tyre një thikë. Ajo pastaj i tha atij, “Hy në dhomën e tyre.” Kur ato e panë atë, aq

* 12:23 Jozefi e formuloi këtë thënie në mënyrë të tillë sa që e shoqja e kryetarit mendoi se ai po fliste për të shoqin e sajë, kur ai në fakt po fliste për Zotin.

shumë e admiruan, sa që i prenë duart e tyre.* Ato thanë, “I madhëruar qoftë Zoti, ky nuk është genie njerëzore; ky është engjëll i nderuar.”

[32] Ajo tha, “Ky është ai për të cilin më fajësuar se rashë në dashuri. Po, unë tentova ta josh, dhe ai refuzoi. Në mos bëftë çka e urdhëroj të bëjë, ai patjetër do të shkojë në burg, dhe do të poshtërohet.”

[33] Ai tha, “Zotëruesi im, burgu është më mirë sesa t’iu jepem atyre. Në mos e largofsh planifikimin e tyre nga unë, mund t’i dëshiroj dhe të sillem si të padijshmit.”

[34] Zotëruesi i tij iu përgjigj lutjes së tij dhe e largoi planifikimin e tyre nga ai. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[35] Më vonë, iu ra ndërmend, përkundër provave të qarta, që duhet ta burgosin për një kohë.

[36] Dy burra të ri ishin në burg me të. Njëri prej tyre tha, “Pashë (në ëndërr) që isha duke prodhuar verë,” dhe tjetri tha, “E pashë veten duke bartur bukë mbi kokën time, prej të cilës zogjtë hanin. Njoftona për interpretimin e këtyre ëndrrave. E shohim se je i drejtë.”

[37] Ai tha, “Nëse ndonjë ushqim ju furnizohet juve, unë mund t’ju njoftoj për të para se ta pranoni. Kjo është pak nga njohuria me të cilën më ka pajisur Zotëruesi im. E kam braktisur fenë e njerëzve që nuk besojnë në Zotin, dhe sa i përket Përjetësisë, ata janë vërtetë mosbesimtarë.”

[38] “Dhe unë ndjekë fenë e stërgjyshërve të mi, Ibrahimit, Isakut, Jakobit. Ne nuk ngrisim asnjë idhull përkrah Zotit. I tillë është bekimi nga Zoti mbi ne dhe mbi njerëzit, por shumica e njerëzve janë mosmirënjohës.

[39] “O shokët e mi të burgut, a janë disa zota më mirë, apo vetëm Zoti, i Vetmi, Supremi?”

[40] “Ju nuk adhuroni përkrah Tij përveç shpikjeve që i keni trilluar, ju dhe prindërit tuaj. Zoti kurrë nuk ka autorizuar idhuj të tillë. I tërë sundimi i takon Zotit, dhe Ai ka vendosur që të mos adhuroni përveç Tij. Kjo është feja e përkryer, por shumica e njerëzve nuk dinë.

[41] “O shokët e mi të burgut, njëri prej jush do të jetë shërbyesi i verës për zotëruenin e tij, përderisa tjetri do të kryqëzohet – zogjtë do të hanë prej kokës së tij. Kjo e zgjidhë çështjen për të cilën keni pyetur.”

[42] Ai pastaj i tha atij që do të shpëtohej “Më përkujto te Zotëruesi yt.”* Kështu, djalli e bëri ta harrojë Zotëruenin e tij, dhe, si pasojë, ai mbeti në burg edhe disa vite.

Ëndrra e mbretit

[43] Mbreti tha, “Pashë shtatë lopë të majme duke u ngrënë nga shtatë lopë të dobëta, dhe shtatë kallinj të gjelbër (gruri), dhe të tjerët të tharë. O këshilltarët e mi, më këshilloni në lidhje me ëndrrën time, nëse dini si t’i interpretoni ëndrrat.”

[44] Ata thanë, “Ëndrra të ngatërruara. Kur vjen puna te interpretimi i ëndrrave, ne nuk kemi njohuri.”

[45] Ai që ishte shpëtuar (nga burgu) tha, tash që më në fund iu kujtua, “Unë mund t’jua tregoj interpretimin e saj, prandaj më dërgoni (te Jozefi).”

Jozefi interpreton ëndrrën e mbretit

* 12:31 Kjo është e njëjta fjalë që përdoret në 5:38 sa i përket dorës së vjedhësit, dhe shuma e numrave të sures dhe strofës (12+31 dhe 5+38) janë të njëjta. Prandaj, dora e vjedhësit duhet të shënohet, e jo të cungohet siç praktikohet nga Islami i korruptuar (shih Shënimin 5:38).

* 12:42 Kur Jozefi iu lut shoqëruesit të tij të ndërmjetësojë te mbreti në emër të tij, ai shfaqti varësi në tjetër pos Zotit që ta shpëtojë nga burgu. Kjo nuk i shkon besimtarit të vërtetë, dhe një lëshim aq serioz i kushtoi Jozefit disa vite në burg. Mësojmë nga Kurani që vetëm Zoti mund ta heqë ndonjë vështirësi që mund të na bie. Besimtari i vërtetë ka besim në Zotin dhe mbështetet plotësisht te vetëm Ai (1:5, 6:17, 8:17, 10:107).

- [46] "Jozef shoku im, na njofto për shtatë lopë të majme duke u ngrënë nga shtatë lopë të dobëta, dhe shtatë kallinj të gjelbër, dhe të tjerët të tharë. Dëshiroj të kthehem me njoftim për njerëzit."
- [47] Ai tha, "Çka kultivoni gjatë shtatë viteve të ardhshme, kur koha e korrjes të vij, lërimi kokrrat në kallinj të tyre, përveç çka hani."
- [48] "Pas asaj, shtatë vjet thatësire do të vijnë, që do të harxhojnë shumicën e asaj që e keni kursyer për ta."
- [49] "Pas asaj, do të vijë një vit që sjell lehtësim për njerëzit, dhe ata, përsëri do të shtrydhin lëng frutash."
- [50] Mbreti tha, "Silleni te unë." Kur i dërguari erdhi te ai, ai tha, "Kthehu te zotëruesi yt dhe pyete që t'i hetojë gratë që i prenë duart e tyre. Zotëruesi im është tërësisht i vetëdijshëm për planifikimet e tyre."
- [51] (Mbreti) iu tha (grave), "Çka dini për incidentin kur ju tentuat ta joshni Jozefin?" Ata thanë, "Zoti na ruajt; ne nuk ditëm për asgjë të keqe të kryer nga ai." E shoqja e kryetarit tha, "Tash e vërteta ka mbizotëruar. Unë jam ajo që tentoi ta joshë atë, dhe ai ishte i sinqerti."
- [52] "Shpresoj që ai do të kuptojë që unë nuk e tradhtova në mungesë të tij, se Zoti nuk i bekon planet e tradhtarëve."
- [53] "Nuk pretendoj të jem i pafajshëm unë. Vetja është përkrahëse e veseve, përveç atyre që kanë arritur mëshirë nga Zotëruesi im. Zotëruesi im është Falës, i Mëshirshmi."

Jozefi arrin pushtetin

- [54] Mbreti tha, "Silleni te unë, që të mund ta punësoj të punojë për mua." Kur ai bisedoi me të, tha, "Sot, ti ke një pozitë pushtetmbajtëse me ne."
- [55] Ai tha, "Më bë thesarmbajtës, se kam përvojë dhe njohuri në këtë fushë."
- [56] Kështu e vendosëm Jozefin në tokë, duke sunduar si dëshironte. E derdhim mëshirën tonë mbi këdo që dëshirojmë, dhe nuk ngelim së shpërblyeri të drejtit.
- [57] Aq më shumë, shpërblimi në Përjetësi është edhe më i mirë për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë.
- [58] Vëllezërit e Jozefit erdhën; kur hynë, ai i njohu, kurse ata nuk e njohën.
- [59] Pasi që i furnizoi me furnizimet e tyre, ai tha, "Herën e ardhshme, sillnie me vete vëllanë tuaj nga babai. A nuk e shihni që jap masë të plotë, dhe ju trajtoj me bujari?"
- [60] "Nëse nuk arrini ta sillni te unë, nuk do të merrni racion nga unë; madje as nuk do të afroheni."
- [61] Ata thanë, "Do të provojmë ta marrim nga babai i tij. Gjithsesi do e bëjmë."
- [62] Ai pastaj i porositi ndihmësit e tij: "Vini mallrat e tyre prapa në torbat e tyre. Kur t'i gjejnë kur të kthehen te familja e tyre, mund të kthehen më shpejt."
- [63] Kur u kthyen te babai i tyre, thanë, "Babai ynë, nuk mund të marrim më furnizime, në mos e dërgofsh vëllanë tonë me ne. Do të kujdesemi mirë për të."
- [64] Ai tha, "A t'jua besoj atë, ashtu si jua besova vëllanë e tij më parë? Zoti është Mbrojtësi më i mirë, dhe, nga të gjithë të mëshirshmit, Ai është i Mëshirshmi."
- [65] Kur i hapën torbat e tyre, i gjetën mallrat e tyre të kthyera te ta. Thanë, "Babai ynë, çka mund të kërkojmë më shumë? Ja ku janë mallrat tona të kthyera te ne. Kështu mund ta furnizojmë familjen tonë, ta mbrojmë vëllanë tonë, dhe të pranojmë edhe një ngarkesë deveje. Kjo është padyshim masë e lehtë."
- [66] Ai tha, "Nuk do e dërgoj me ju, në mos më dhënsi zotim solemn para Zotit që do e ktheni,

përveç nëse jeni krejtësisht të pushtuar.” Kur ata i dhanë atij zotimin e tyre solemn, ai tha, “Zoti është dëshmitar i çdo gjëje që themi.”

[67] Dhe ai tha, “O djemtë e mi, mos hyni nga një derë; hyni nëpërmjet dyerve të ndryshme. Megjithatë, unë nuk mund t’ju ruaj nga asgjë që është e paracaktuar nga Zoti. Të Zotit janë të gjitha gjykimet. Kam besim në Të, dhe te Ai duhet të gjithë besimtarët të kenë besim.”

Jakobi e nuhatë Jozefin

[68] Kur ata shkuan (te Jozefi), hynë në përputhje me porosinë e babait të tyre. Edhe pse kjo nuk mund të ndryshonte asgjë të vendosur nga Zoti, Jakobi kishte arsye të veten që kërkoi nga ta të bëjnë kështu. Se ai kishte njohuri të caktuar që ia mësuam, por shumica e njerëzve nuk e dinë.

Prapë në Egjipt

[69] Kur ata hynë te Jozefi, ai e solli vëllanë e vet afër vetes dhe tha, “Unë jam vëllai yt; mos u pikëllo nga veprat e tyre.”

Jozefi e mbanë vëllanë e vet

[70] Kur ai i furnizoi me furnizimet e tyre, ai vuri gotën në torbën e vëllait të vet, pastaj një folës foli: “Pronarët e këtij karvani janë vjedhës.”

[71] Ata thanë, përderisa erdhën drejt tyre, “Çka humbët?”

[72] Ata thanë, “E humbëm gotën e mbretit. Kushdo që e kthen do të pranojë një ngarkesë deveje shtesë; E garantoj vetë këtë.”

[73] Ata thanë, “Pasha Zotin, ju e dini fare mirë që nuk kemi ardhur këtu për të bërë të këqija, e as nuk jemi vjedhës.”

[74] Ata thanë, “Cili është ndëshkimi për vjedhësin, nëse jeni gënjeshtarë?”

[75] Ata thanë, “Ndëshkimi, nëse gjendet në torbën e tij, është që vjedhësi ju takon juve. Ne kështu i ndëshkojmë fajtorët.”

[76] Ai pastaj filloi t’ua kontrollojë thasët e tyre, para se të arrinte te thesi i vëllait të tij, dhe ai e nxori atë nga thesi i vëllait të tij. Kështu e përkryem planifikimin për Jozefin; ai nuk do të kishte mundur të mbajë vëllanë e tij nëse do të zbatonte ligjin e mbretit. Por ishte vullneti i Zotit. E lartësojmë këdo që zgjedhim në rangje më të larta. Mbi secilin të dijshtëm, është dikush që është edhe më i dijshtëm.

[77] Ata thanë, “Nëse ai vodhi, ashtu bëri edhe një vëlla i tij në të kaluarën.” Jozefi i mbajti brenda në vete ndjenjat e tij, dhe nuk ua zbuloi atyre. Ai tha (më vete), “Ju jeni vërtetë të këqij. Zoti është tërësisht i vetëdijshtëm për akuzat tuaja.”

[78] Ata thanë, “O ti i nderuar, ai ka një baba të moshuar; a e merr një prej nesh në vend të tij? E shohim që je njeri i dashur.”

[79] Ai tha, “Mos e bëftë Zoti që ne të marrim tjetër pos atij nën posedim të të cilit i gjetëm mallrat tona. Përndryshe, do të ishim të padrejtë.”

[80] Kur humbën shpresën se do ia ndërrojnë mendjen, diskutuan së bashku. Më i vjetri i tyre tha, “A nuk e kuptoni që babai juaj ka marrë zotim solemn prej jush para Zotit? Në të kaluarën e humbët Jozefin. Unë nuk largohem nga ky vend derisa babai im të më japë leje, ose derisa Zoti të gjykojë për mua; Ai është Gjykatësi më i mirë.

Prapë në Palestinë

[81] “Kthehuni te babai juaj dhe i tregoni... ‘Babai ynë, djali yt ka kryer vjedhje. E dimë sigurt, sepse kemi qenë dëshmitarë për këtë. Kjo ishte ndodhi e papritur.

[82] `Mund ta pyesësh shoqërinë ku ishim, dhe karvanin që u kthye me ne. Po e themi të

vërtetën.”

[83] Ai tha, “Në të vërtetë, keni bërë komplot për të zbatuar një plan të caktuar. Durimi i qetë është ngushëllimi im i vetëm. Le t’i kthejë Zoti ata të gjithë te unë. Ai është i Gjithëdijshmi, Më i Mençuri.”

[84] Ai ua ktheu shpinën atyre, duke thënë, “Jam i pikëlluar për Jozefin.” Sytë e tij u bënë të bardhë nga pikëllimi aq i madh; ai ishte vërtetë i pikëlluar.

[85] Ata thanë, “Pasha Zotin, do të vazhdosh të pikëllohesh për Jozefin deri sa të sëmuresh, ose derisa të vdesësh.”

[86] Ai tha, “Unë thjeshtë qahem te Zoti për dilemën dhe pikëllimin tim, se unë di nga Zoti çka ju nuk dini.

[87] “O djemtë e mi, shkoni gjejeni Jozefin dhe vëllanë e tij, dhe kurrë mos humbni shpresat nga hirësia e Zotit. Askush nuk i humbë shpresat nga hirësia e Zotit përveç njerëzve mosbesimtarë.”

Izraeli shkon në Egjipt

[88] Kur ata hynë te ai (Jozefi), thanë, “O ti i nderuar, kemi vuajtur shumë vështirësi, së bashku me familjen tonë, dhe kemi sjellë mallra inferiore. Por shpresojmë që do të na japësh masë të plotë dhe të jesh bamirës ndaj nesh. Zoti i shpërblen bamirësit.”

[89] Ai tha, “A ju kujtohet çka i bëtë Jozefit dhe vëllait të tij kur ishit të paditur?”

[90] Ata thanë, “A qenke ti Jozefi?” Ai tha, “Unë jam Jozefi, dhe ja ku është vëllai im. Zoti na ka bekuar. Kjo është për shkak se nëse dikush çon jetë të drejtë, dhe duron me këmbëngulje, Zoti nuk ngelë së shpërblyeri të drejtit.”

[91] Ata thanë, “Pasha Zotin, Zoti vërtetë të ka parapëlqyer ty mbi ne. Ishim vërtetë gabim.”

[92] Ai tha, “Nuk keni për tu fajësuar sot. Le të ju falë Zoti. Nga gjithë të mëshirshmit, Ai është i Mëshirshmi.

[93] “Merreni këtë këmishën time; dhe kur ta hidhni mbi fytyrën e babait tim, shikimi i tij do i kthehet. Silleni krejt familjen tuaj dhe kthehuni te unë.”*

[94] Edhe para se të arrinte karvani, babai i tyre tha, “Mund ta nuhas aromën e Jozefit. A do të më ndriçojë ndokush?”

[95] Ata thanë, “Pasha Zotin, ti je ende në humbjen tënde të vjetërsisë.”

[96] Kur bartësi i lajmeve të mira arriti, ai e hodhi (këmishën) mbi fytyrën e tij, ku shikimi i tij u kthye. Ai tha, “A nuk ju thash që unë dija nga Zoti çka ju nuk dinit?”

[97] Ata thanë, “Babai ynë, lutu për faljen tonë; ishim vërtetë gabim.”

[98] Ai tha, “Unë do i lutem Zotëruesit tim t’ju falë; Ai është Falësi, i Mëshirshmi.”

Në Egjipt

[99] Kur ata hynë te Jozefi, ai përqafoi prindërit e tij, duke thënë, “Mirëserdhët në Egjipt. Dashtë Zoti, do të jeni të sigurt këtu.”

[100] Ai i ngriti prindërit e tij mbi fron. Ata ranë në përulje para tij. Ai tha, “O babai im, kjo është përmbushja e ëndrrës time të vjetër. Zotëruesi im e ka bërë të realizohet. Ai më ka bekuar, më ka çliruar nga burgu, dhe ju ka sjellë nga shkretëtira, pasi që dreqi kishte futur përçarje mes meje dhe vëllezërve të mi. Zotëruesi im është Më i Dashuri ndaj kujtdo që Ai do. Ai është Njohësi, Më i Mençuri.”

[101] “Zotëruesi im, Ti më ke dhënë mbretërim dhe më ke mësuar interpretimin e ëndrrave. Nismëtari i qiejve dhe tokës; Ti je Zotëruesi dhe Sunduesi im në këtë jetë dhe në Përjetësi. Le të

* 12:93 Kjo shënon fillimin e Fëmijëve të Izraelit në Egjipt. Moisiu i nxori nga Egjipti disa shekuj më vonë.

vdes si i nënshtruar, dhe më llogarit me të drejtit.”

[102] Këto janë lajme nga e kaluara që t’i shpallëm ty. Ti nuk ishe i pranishëm kur ata morën vendimin e tyre të përbashkët (për ta hedhur Jozefin në pus), përderisa bënë komplot së bashku.

Shumica e njerëzve nuk besojnë

[103] Shumica e njerëzve, pa marrë parasysh çka bën, nuk do të besojnë.

[104] Ti nuk po ju kërkon atyre para; ti thjeshtë e çon këtë kujtesë për të gjithë njerëzit.

[105] Sa e sa prova në qiej dhe tokë iu jepen atyre, por ata kalojnë pranë tyre, pa vëmendje!

Shumica e besimtarëve të paracaktuar për Ferr

[106] Shumica e atyre që besojnë në Zotin nuk bëjnë ashtu pa rënë në adhurim idhujsh.

[107] A kanë garantuar ata që një ndëshkim tronditës nga Zoti nuk do i godasë ata, ose Ora nuk do iu vijë atyre papritmas, kur ata më së paku e presin?

[108] Thuaj, “Kjo është rruga ime: Ftoj te Zoti, me provë të qartë, dhe ashtu bëjnë ata që më ndjekin mua. Qoftë i madhëruar Zoti. Unë nuk jam adhurues idhujsh.”

[109] Nuk dërguam para teje përveç burra që i frymëzua, të zgjedhur nga njerëzit e shoqërive të ndryshme. A nuk janë endur nëpër tokë dhe kanë parë pasojat e atyre para tyre? Vendbanimi i Përjetësisë është shumë më i mirë për ata që çojnë jetë të drejtë. A do të kuptoni atëherë?

Fitorja, përfundimisht, i takon besimtarëve

[110] Pikërisht kur të dërguarit humbin shpresën, dhe mendojnë që janë refuzuar, fitorja jonë iu vjen atyre. Ne pastaj shpëtojmë këdo që zgjedhim, përderisa ndëshkimi ynë për njerëzit fajtorë është i pashmangshëm.

Kurani është krejt çka na nevojitet

[111] Në historinë e tyre ka mësim për ata që posedojnë inteligjencë. Ky nuk është Hadith i trilluar; ky (Kuran) konfirmon të gjitha shkrimet paraprake, furnizon hollësitat e të gjitha gjërave, dhe është fener dhe mëshirë për ata që besojnë.

Surja 13: Bubullima (Er-Rad)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A. L. M. R.* Këto (shkronja) janë provat e këtij shkrimi. Çka të është shpallur nga Zotëruesi yt është e vërteta, por shumica e njerëzve nuk besojnë.

[2] Zoti është Ai që i ngriti qiejt pa shtylla që të mund të shihni, dhe mori gjithçka në dorë. Ai e bëri diellin dhe hënën, secili duke udhëtuar (në orbitën e vet) për një kohë të paracaktuar. Ai drejton të gjitha gjërat, dhe shpjegon shpalljet, që të mund të arrini siguri për takimin me Zotëruenin tuaj.

[3] Ai është Ai që ndërtoi tokën dhe vuri në të male dhe lumenj. Dhe nga llojet e ndryshme të frutave, Ai i bëri ato në çifte – meshkuj dhe femra. Nata e kaplon ditën. Këto janë prova të qëndrueshme për njerëz që mendojnë.

[4] Në tokë, ka ngastra të afërta që prodhojnë kopshte hardhish, të mbjella, palma – dioike dhe jodioike. Edhe pse ato ujiten me ujin e njëjtë, disa prej tyre i parapëlqejmë në ngrënie. Këto janë prova të qëndrueshme për njerëzit që kuptojnë.

Besimi në Përjetësinë i nevojshëm për shpëtim

[5] Nëse habitesh, habia e vërtetë është thënia e tyre: “Pasi të shndërrohemi në pluhur, a krijohemi sërish?” Këta janë ata që nuk kanë besuar në Zotëruenin e tyre. Këta janë ata që kanë

* 13:1 Këto iniciale përbëjnë një pjesë të madhe të provës së autorësisë hyjnore brenda në Kuran, pra kodit të mrekullueshëm matematikor. Shih Sht 1.

vetëshkaktuar pranga rreth qafave të tyre. Këta janë ata që kanë vetëshkaktuar Ferr, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[6] Ata të sfidojnë ty që t'ua sjellësh dënimin, në vend që të bëhen të drejtë! Precedentë të mjaftueshëm janë ujdurur për ta në të kaluarën. Vërtetë, Zotëruesi yt është plot falje ndaj njerëzve, përkundër shkeljeve të tyre, dhe Zotëruesi yt është gjithashtu i rreptë në zbatimin e ndëshkimit.

[7] Ata që nuk besuan thanë, “Vetëm sikur një mrekulli të mund t'i zbriste atij nga Zotëruesi i tij (pastaj do të besonim).” Ti je thjeshtë një paralajmërues – secila shoqëri pranon një mësues udhëzues.

[8] Zoti e di çka çdo femër bartë, dhe çka çdo mitër lëshon, ose fiton. Çdo gjë që Ai bën është e matur krejtësisht.

[9] Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve; Supremi, Më i Larti.

[10] Është njëjtë qoftë i fshehët mendimet tuaja, ose i deklaruar, ose fshiheni në errësirën e natës, ose veproni në dritë të ditës.

[11] Ndërrime (engjëjsh) ndërrohen, duke qëndruar me secilin prej jush – ata janë para jush dhe prapa jush. Ata qëndrojnë me ju, dhe ju ruajnë në përputhje me urdhrat e Zotit. Kështu, Zoti nuk e ndryshon gjendjen e asnjë populli në mos e marrshin ata vendimin vet që të ndryshojnë. Nëse Zoti dëshiron ndonjë vështirësi për ndonjë popull, asnjë forcë nuk mund ta ndalë. Se ata nuk kanë asnjë përkrah Tij si Zotërues dhe Sundues.

[12] Ai është Ai që jua shfaqë vetëtimën si burim frike, si dhe shprese, dhe Ai i nisë retë e ngarkuara.

[13] Rrufeja lavdëron madhërinë e Tij, dhe po ashtu bëjnë edhe engjëjt, nga respekti për Të. Ai dërgon rrufetë, që godasin në përputhje me vullnetin e Tij. Prapëseprapë, ata grinden në lidhje me Zotin, edhe pse fuqia e Tij është mbresëlënëse.

[14] Lutja ndaj Tij është lutja e vetme e ligjshme, përderisa idhujt që ata i lusin përkrah Tij nuk mund të reagojnë kurrë. Kështu, ata janë si ata që i zgjasin duart e tyre kah uji, por asgjë nuk arrin në gojë të tyre. Lutjet e mosbesimtarëve janë të kota.

Të gjitha krijesat i janë nënshtruar Zotit

[15] Zotit i përuken të gjithë në qiej dhe tokë, me dëshirë ose pa dëshirë, dhe ashtu bëjnë edhe hijet e tyre në mëngjese dhe mbrëmje.*

[16] Thuaj, “Kush është Zotëruesi i qiejve dhe tokës?” Thuaj, “Zoti.” Thuaj, “Pse atëherë ngritni përveç Tij sundues që nuk kanë aspak fuqi për të sjellë dobi ose dëmtuar madje as veten?” Thuaj, “A është i verbëri i njëjtë si pamësi? A është errësira e njëjtë si drita?” A kanë gjetur ata idhujt përveç Zotit që krijuan krijesat të ngjashme me krijesat e Tij, deri në pikën e mos dallimit të dy krijesave? Thuaj, “Zoti është Krijuesi i të gjitha gjërave, dhe Ai është i Vetmi, Supremi.”

E vërteta kundër të pavërtetës

[17] Ai zbret ujë nga qielli, duke i bërë luginat të rrjedhin vadë, pastaj pjerrësitat prodhojnë shkumë të bollshme. Ngjashëm, kur ata përdorin zjarr për të rafinuar metalet për stolitë ose pajisjet e tyre, prodhohet shkuma. Zoti kështu përmendë analogjitë për të vërtetën dhe të pavërtetën. Sa për shkumën, ajo humbet, përderisa ajo që iu sjell dobi njerëzve rri pranë tokës.

* 13:15 Edhe mosbesimtarët përuken; ata nuk munden, për shembull, t'i kontrollojnë rrahjet e zemrave të tyre, ose mushkëritë e tyre. Hijet janë të paracaktuara nga dizajni i Zotit për orbitat diellore dhe lunare, dhe nga forma karakteristike e planetit tokë e cila shkakton katër stinët. Saktësia e përkryer e marrëdhënies diell/tokë vërtetohet nga zbulimi i orëve diellore dhe hijeve të tyre.

Zoti kështu përmendë analogjitë.

[18] Ata që i përgjigjen Zotëruesit të tyre meritojnë shpërblimet e mira. Sa për ata që nuk arritën t'i përgjigjen Atij, sikur të kishin çdo gjë në tokë – madje edhe dy herë aq – ata me gatishmëri do e jepnin si haraç. Ata kanë vetëshkaktuar llogaritjen më të keqe, dhe vendbanimi i tyre përfundimtar është Ferr; çfarë vendbanimi i tmerrshëm.

Besimtarët

[19] A është dikush që e kupton që shpalljet e Zotëruesit tënd te ti janë e vërteta i barabartë me dikë që është i verbër? Vetëm ata që posedojnë inteligjencë do të jenë të vëmendshëm.

[20] Ata janë ata që i përmbushin zotimet e tyre ndaj Zotit, dhe nuk e shkelin besën.

[21] Ata bashkojnë çka Zoti ka urdhëruar të jetë e bashkuar, ia kanë dronë Zotëruesit të tyre, dhe i frikësohen llogaridhënies së llahtarshme.

[22] Ata durojnë me këmbëngulje në kërkimin e Zotëruesit të tyre, zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), shpenzojnë nga furnizimet tona te ta fshehtë dhe publikisht, dhe e kundërshtojnë të keqen me të mirë. Këta kanë merituar vendbanimin më të mirë.

[23] Ata hynë te kopshtet e Edenit, së bashku me të drejtë mes prindërve të tyre, bashkëshorteve të tyre, dhe fëmijëve të tyre. Engjëjt do të hynë te ta nga çdo derë.

[24] "Paqe qoftë mbi ju, sepse duruat me këmbëngulje. Çfarë përfundimi i gëzueshëm."

Mosbesimtarët

[25] Sa për ata që shkelin besën e Zotit pasi që zotohen se do e mbajnë, dhe ndajnë çka Zoti ka urdhëruar të jetë e bashkuar, dhe bëjnë të këqija, ata kanë vetëshkaktuar dënim; ata kanë vetëshkaktuar përfundimin më të keq.

Zoti i ka në dorë të gjitha furnizimet

[26] Zoti është Ai që shton furnizimet për këdo Ai do, ose mbanë ato. Ata janë bërë të preokupuar me këtë jetë; dhe kjo jetë, në krahasim me Përjetësinë, është zero.

[27] Ata që nuk besojnë do të thoshin, "Vetëm sikur një mrekulli të mund t'i zbriste atij nga Zotëruesi i tij (atëherë do të besonim)." Thuaj, "Zoti e çon në humbje këdo Ai vendosë, dhe udhëzon për te Ai vetëm ata që binden."

[28] Ata janë ata zemrat e të cilëve kënaqen me përkujtimin e Zotit. Absolutisht me përkujtimin e Zotit, zemrat kënaqen.

[29] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë kanë merituar lumturi dhe përfundim të gëzueshëm.

*I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes**

[30] Të kemi dërguar ty te kjo shoqëri, ashtu siç bëmë me shoqëritë e tjera në të kaluarën. T'ua recitosh atyre çka të shpallim ty, se ata nuk kanë besuar në Mirëbërësin. Thuaj, "Ai është Zotëruesi im. Nuk ka asnjë zot përveç Tij. Kam besim vetëm te Ai; te Ai është fati im përfundimtar."

Mrekullia Matematikore e Kuranit

[31] Edhe sikur një Kuran t'i bënte malet të lëvizin, ose tokën të grisej copë copë, ose të vdekurit të flasin (ata nuk do të besojnë). Zoti drejton të gjitha gjërat. A nuk është koha për besimtarët të dorëzohen dhe ta kuptojnë që po të donte Zoti, Ai do të kishte mundur t'i udhëzojë të gjithë njerëzit? Mosbesimtarët do të vazhdojnë të vuajnë fatkeqësi, si pasojë e vet punëve të tyre, ose të kenë fatkeqësi që godasin afër tyre, derisa premtimi i Zotit të përmbushet. Zoti nuk do e ndryshojë

* 13:30 Nëse mbledhim vlerën germore të "Rashad" (505), plus vlerën e "Khalifa" (725), plus numrin e sures (13), plus numrin e strofës (30), marrim $505+725+13+30=1273=19 \times 67$. Zoti pra e specifikon emrin e të dërguarit të Tij (shih Shtojcën 2 për hollësitat).

fatim e paracaktuar.

Të gjithë të dërguarit duhet të përqeshen

[32] Të dërguarë para teje janë përqeshur; i lejova mosbesimtarët të vazhdojnë, pastaj i ndëshkova. Sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im!

[33] A ka ndonjë të barabartë me Atë që drejton secilin shpirt? Prapëseprapë, ata ngritin idhuj për ta rivalizuar Zotin. Thuaj, “Emërtoni ata. A po e informoni Atë për diçka në tokë që Ai nuk di? Ose, po trilloni fjalë boshe?” Vërtetë, planet e atyre që nuk besojnë janë të zbukuruara në sytë e tyre. Ata pra janë të larguar nga rruga e drejtë. Këdo që Zoti e çon në humbje nuk mund të gjejë mësues udhëzues.

[34] Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim në këtë jetë, dhe ndëshkimi në Përrjetësinë është shumë më i keq. Asgjë nuk mund t’i mbrojë ata kundër Zotit.

Parajsa e përshkruar alegorikisht

[35] Alegoria e Parajsës, e cila iu është premtuar të drejtëve, është proje që rrjedhin, furnizime të pashtershme, dhe hije fllad. I tillë është përfundimi për ata që zbatojnë drejtësi, përderisa përfundimi për mosbesimtarët është Ferr.

[36] Ata që pranuan shkrimin gëzohen me çka të është shpallur ty; disa të tjerë mund të refuzojnë pjesë të tij. Thuaj, “Unë jam thjeshtë i urdhëruar ta adhuroj Zotin, dhe kurrë të mos i shoqëroj asnjë idhull Atij. Ftoj te Ai, dhe te Ai është fati im përfundimtar.”

*Autorizim Hyjnor i Kodit Matematikor të Kuranit**

[37] I kemi shpallur këta ligje arabisht, nëse iu bindesh dëshirave të tyre, pasi që kjo njohuri ka ardhur te ti, nuk do të kesh asnjë aleat, as mbrojtës, kundër Zotit.

[38] Kemi dërguar të dërguarë para teje, dhe i bëmë ata burra me bashkëshorte dhe fëmijë. Asnjë i dërguar nuk mund të prodhojë mrekulli pa autorizimin e Zotit, dhe pa qenë në përputhje me një kohë specifike të paracaktuar.

[39] Zoti fshinë çka do Ai, dhe ndreqë (çka do Ai). Me Të është Regjistri Udhëzues origjinal.

[40] Qoftë të tregojmë ty çka iu premtojmë atyre, ose ta përfundojmë jetën para saj, misioni yt i vetëm është të japësh (lajmin). Jemi ne ata që do i thërrasim në llogaridhënie.

[41] A nuk e shohin që çdo ditë në tokë, i sjell më afër fundit, dhe që Zoti vendosë jetëgjatësinë e tyre, pakthyesëm? Ai është Llogaritësi më i shkathët.

[42] Të tjerë para tyre kanë planifikuar, por Zotit i takon i gjithë planifikimi. Ai di çka bën çdokush. Mosbesimtarët do e marrin vesh kush janë fituesit përfundimtar.

[43] Ata që nuk besuan do thonë, “Ti nuk je i dërguar!” Thuaj, “Zoti mjafton si dëshmitar mes meje dhe jush, dhe ata që posedojnë njohuri shkrimi.”

Surja 14: Ibrahim (Ibrahim)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.R. * Shkrim që e shpallëm te ti, për t’i udhëhequr njerëzit nga errësira në dritë – në përputhje me vullnetin e Zotëruesit të tyre – te rruga e të Plotfuqishmit, të Falënderuarit.

[2] (Rruga) E Zotit; e Atij që posedon çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Mjerë mosbesimtarët;

* 13:37-38 Numri i strofës (38) = 19x2. Vendosja e vlerës së “Rashad” (505) dhe “Khalifa” (725) afër 13:37-38, jep 505 725 13 37 38, ose 19x26617112302 (Shtojca 2).

* 14:1 Këto iniciale mbetën sekret i ruajtur hyjnisht deri sa kodi matematikor i Kuranit u zbulua në vitin 1974 Pas Lindjes së Krishtit. Shih Shtojcën 1 për rëndësinë e këtyre inicialeve.

kanë vetëshkaktuar ndëshkim të tmerrshëm.

Cili është prioriteti yt?

[3] Ata janë ata që i japin përparësi kësaj jete mbi Përjetësinë, zmbropsin nga rruga e Zotit, dhe kërkojnë ta bëjnë të shtrembër; ata kanë shkuar larg në humbje.

Gjuha e të dërguarit

[4] Nuk dërguam asnjë të dërguar përveç (që të predikojë) në gjuhën e njerëzve të vet, në mënyrë që të sqarojë gjërat për ta. Zoti pastaj dërgon në humbje këdo Ai vendosë, dhe udhëzon kë do Ai. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Moisiu

[5] Kështu, e dërguam Moisiun me mrekullitë tona, duke thënë, “Udhëhiqi njerëzit e tu nga errësira në dritë, dhe ua kujto ditët e Zotit.” Këto janë mësimet për çdo person të durueshëm dhe mirënjohës.

Rëndësia e të qenit mirënjohës

[6] Kujtohu që Moisiu i tha njerëzve të tij, “Përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju. Ai ju shpëtoi nga njerëzit e Faraonit që shkaktuan persekutimin më të keq mbi ju, duke jua therur djemtë dhe kursyer vajzat tuaja. Ishte një provë e vështirë prej Zotëruesit tuaj.”

Mirënjohës a mosmirënjohës

[7] Zotëruesi juaj ka shpallur: “Sa më shumë që më falënderoni, aq më shumë ju jap.” Por nëse bëheni mosmirënjohës, atëherë ndëshkimi Im është i rëndë.

[8] Moisiu tha, “Nëse nuk besoni, bashkë me të gjithë njerëzit në tokë, Zoti, i Falënderuari, nuk ka nevojë.”

Mohimi me egoizëm: Tipar njerëzor

[9] A nuk keni dëgjuar për ata para jush – njerëzit e Nuhut, Adit, Themudit, dhe të tjerëve që erdhën pas tyre dhe të njohur vetëm për Zotin? Të dërguarit e tyre shkuan te ta me prova të qarta, por ata i trajtuan me përbuzje dhe thanë, “Nuk besojmë në atë me çka jeni dërguar. Jemi skeptik për lajmin tuaj; plot dyshime.”

Ndjekja e prindërve tanë verbërisht: Tragjedi e madhe e njeriut

[10] Të dërguarit e tyre thanë, “A keni dyshime në lidhje me Zotin; Nismëtarin e qiejve dhe tokës? Ai ju fton vetëm për t’i falur mëkatet tuaja, dhe për t’ju dhënë edhe një shans që ta shpengoni veten.” Ata thanë, “Ju nuk jeni asgjë më shumë se njerëz si ne, që dëshironi të na zmbropsni nga mënyra që prindërit tanë dikur adhuronin. Na tregoni autorizim të qartë.”

[11] Të dërguarit e tyre iu thanë, “Ne nuk jemi asgjë më shumë se njerëz si ju, por Zoti bekon këdo që Ai zgjedhë nga shërbëtorët e Tij. Ne nuk ka shanse t’ju tregojmë asnjë lloj autorizimi, përveç në përputhje me vullnetin e Zotit. Në Zotin besimtarët të kenë besim.

[12] “Pse të mos kemi besim në Zotin, kur Ai na ka udhëzuar në rrugën tonë? Ne do të durojmë me këmbëngulje para keqtrajtimit tuaj. Në Zotin të gjithë besimtarët të kenë besim.”

[13] Ata që nuk besuan iu thanë të dërguarve të tyre, “Do t’ju dëbojmë nga toka jonë, në mos u kthefshi në fenë tonë.” Zotëruesi i tyre i frymëzoi: “Ne patjetër do i asgjësojmë shkelësit.

[14] “Dhe do t’ju lëmë të rroni në tokën e tyre pas tyre. Ky është (shpërblimi) për ata që i kanë dronë madhësisë Sime, dhe ia kanë dronë premtimit Tim.”

[15] Ata kërkuar sfidë, dhe si pasojë, çdo tiran kokëfortë përfundoi i dënuar.

[16] Duke e pritur atë është Ferri, ku ai do të pijë ujë të qelbur.

[17] Ai do e gëlltitë, edhe pse nuk mund ta durojë, përderisa vdekja vjen te ai nga secili drejtim, por

ai kurrë nuk do të vdesë. Duke e pritur atë është një ndëshkim i tmerrshëm.*

[18] Alegoria e atyre që nuk besojnë në Zotëruesin e tyre: punët e tyre janë si pluhur në një erë të fortë, në një ditë me stuhi. Nuk arrijnë asgjë nga çfarëdo që fitojnë; e tillë është humbja më e largët.

Adhuroje vetëm të gjithëfuqishmin

[19] A nuk e kupton që Zoti ka krijuar qiejt dhe tokën për një qëllim të veçantë? Nëse Ai do, Ai mund t'ju heqë, dhe t'ju zëvendësojë me krijim të ri.

[20] Kjo nuk është fort vështirë për Zotin.

Në Ditën e Ringjalljes

[21] Kur ata të gjithë qëndrojnë para Zotit,* ndjekësit do iu thonë udhëheqësve, "Dikur ju ndiqnim. A mund të na hiqni madje edhe krejt pak nga ndëshkimi i Zotit?" Ata do të thonë, "Sikur të na udhëzonte Zoti, ne do t'ju udhëzonim juve. Tash është tepër vonë, pa marrë parasysh a ankohe mi apo bëjmë durim, nuk ka dalje për ne."

Dreqi i mohon ndjekësit e tij

[22] Dhe dreqi do të thotë, pasi që gjykimi të jetë marrë, "Zoti ju ka premtuar premtimin e vërtetë, dhe unë ju premtova, por e theva premtimin. Nuk kisha aspak fuqi mbi ju; Unë thjeshtë ju ftova, dhe ju pranuat ftesën time. Prandaj, mos më fajësoni mua, dhe fajësojeni veten tuaj. Ankimi im nuk mund t'ju ndihmojë, as ankimi juaj nuk mund të më ndihmojë. Unë mohoj idhujtarizimin që më bëtë mua. Shkelësit kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb."

[23] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ata do të pranohen në kopshte me prroje që rrjedhin. Ata qëndrojnë aty përgjithmonë, në përputhje me vullnetin e Zotëruesit të tyre.

Përshëndetja e tyre aty është: "Paqe."

E vërteta a e pavërteta

[24] A nuk e sheh që Zoti ka përmendur shembullin e fjalës së mirë si një pemë rrënja e të cilës është e futur thellë, dhe degët e saj janë lart në qiell?

[25] I prodhon frutat e saj çdo stinë, siç është planifikuar nga Zotëruesi i saj. Zoti kështu përmendë shembujt për njerëzit, që të mund të jenë të vëmendshëm.

[26] Dhe shembulli i fjalës së keqe është ai i pemës së keqe të çrrënjësuar nga dheu; nuk ka rrënjë për ta mbajtur të qëndrueshme.

[27] Zoti i përforcon ata që besojnë me fjalën e vërtetuar, në këtë jetë dhe në Përjetësi. Dhe Zoti i dërgon shkelësit në humbje. Çdo gjë është në përputhje me vullnetin e Zotit.

Ata i largojnë familjet e tyre nga mbrojtja e Zotit

[28] A i ke vërejtur ata që iu përgjigjën bekimeve të Zotit duke mos besuar, dhe kështu sollën fatkeqësi mbi familjet e veta?

[29] Ferr është përfundimi i tyre, ku digjen; çfarë fundi i tmerrshëm!

Adhurimi i idhujve: Nëna e të gjitha të këqijave

[30] Ata ngritin idhuj për ta rivalizuar Zotin dhe për t'i larguar të tjerët nga rruga e Tij. Thuaj,

* 14:17 Kur u rebeluam kundër Zotit, dhe u pajtuam me Dreqin gjatë grindjes së madhe (38:69), engjëjt propozuan që ne duhet të dëbohem në Ferr (Shtojca 7). Por i Mëshirshmi vendosi të na japë një shans tjetër që ta shpengojmë veten. Ai iu tha engjëjve, "Unë di çka ju nuk dini" (2:30). Zoti e dinte që shumë njerëz do të protestonin që ata nuk e dinin sa i keq ishte Ferri. Përshkrimi mbresëlënës i Ferrit në 14:17 dhe në 22:19-22 e anulon një protestë të tillë. Tash e kemi një mendim shumë të qartë sa i tmerrshëm është Ferri.

* 14:21 Shpesh, Kurani flet për Përjetësinë në kohën e shkuar. Kjo është sepse ato janë ngjarje të të ardhmes që veç janë parë nga Zoti, dhe patjetër do iu vijë koha.

“Kënaquni për pak kohë; fati juaj përfundimtar është Ferr.”

Urdhra të rëndësishme

[31] Nxiti shërbëtorët e Mi që besuan që t'i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe të japin (bamarësi) nga furnizimet tona te ta, fshehtë dhe publikisht, para se të vij një ditë ku nuk ka as tregti, as familjarizëm.

[32] Zoti është Ai që krijoi qiejt dhe tokën, dhe Ai zbret nga qielli ujë për të prodhuar të gjitha llojet e frutave për jetesën tuaj. Ai i ka bërë anijet që t'ju shërbejnë në det në përputhje me urdhrin e Tij. Ai i ka bërë lumenjtë gjithashtu që t'ju shërbejnë.

[33] Ai ka parashtruar diellin dhe hënën në shërbimin tuaj, vazhdimisht. Ai ka parashtruar natën dhe ditën që t'ju shërbejnë.

[34] Dhe Ai ju jep lloj lloj gjërash për të cilat i luteni Atij. Nëse i numëroni bekimet e Zotit, kurrë nuk mund t'i përfshini të gjitha ato. Në të vërtetë, qenia njerëzore është shkelës, mosmirënjohës.

Ibrahimi

[35] Kujtohu që Ibrahim tha, “Zotëruesi im, bëje këtë një tokë paqësore, dhe më mbrojtë mua dhe fëmijët e mi nga adhurimi i idhujve.

[36] "Zotëruesi im, ata kanë çorientuar aq shumë njerëz. Sa për ata që më ndjekin mua, ata përkasin me mua. Sa për ata që nuk më binden, Ti je Falës, i Mëshirshmi.

[37] "Zotëruesi ynë, e kam vendosur një pjesë të familjes sime në këtë luginë pa bimë, te Shtëpia Jote e Shenjtë. Zotëruesi ynë, ata janë për t'i zbatuar Lutjet e Kontaktit (Salat), pra le të mblidhen turma njerëzish te ta, dhe furnizo për ta lloj lloj frutash, që të mund të jenë mirënjohës.

[38] "Zotëruesi ynë, Ti di çfarëdo që fshehim dhe çfarëdo që deklarojmë – asgjë nuk është e fshehur nga Zoti në tokë, as në qiej.

[39] "I lartmadhëruar qoftë Zoti se më ka dhuruar, përkundër moshës time të vjetër, Ismailin dhe Isakun. Zotëruesi im iu përgjigjet lutjeve.

Lutjet e Kontaktit: Dhuratë nga Zoti

[40] "Zotëruesi im, më bë mua njeri që zbaton rregullisht Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe gjithashtu fëmijët e mi. Zotëruesi ynë, të lutem përgjigju lutjeve të mia.

[41] "Zotëruesi im, më fal mua dhe prindërit e mi, dhe besimtarët, në ditën kur bëhet llogaritja.”

[42] As mos mendo që Zoti nuk është i vetëdijsëm çka po bëjnë shkelësit. Ai vetëm iu jep afat atyre deri në një ditë kur sytë shikojnë në llahtar.

[43] Përderisa me ngut (dalin nga varret), fytyrat e tyre do të jenë duke shikuar lart, sytë e tyre as nuk do të kapsitin, dhe mendjet e tyre do të jenë të tmerruara.

Zoti dërgon urdhrat e Tij nëpërmjet të dërguarve të Tij

[44] Paralajmëroi njerëzit për ditën kur ndëshkimi iu vjen atyre. Ata që shkelën do të thonë, “Zotëruesi ynë, na shtyj edhe një herë afatin. Atëherë do i përgjigjemi thirrjes Tënde dhe t'i ndjekim të dërguarit.” A nuk bëtë be në të kaluarën se do të zgjatni përgjithmonë?

[45] Banuat në shtëpitë e atyre para jush, që i bënë keq vetes, dhe e keni parë qartë çka iu bëmë atyre. Kemi ujdísur shumë precedentë për ju.

[46] Ata planifikuan planet e tyre, dhe Zoti është tërësisht i vetëdijsëm për planet e tyre. Në të vërtetë, planet e tyre ishin të mjaftueshme për të fshirë male.

Fitore e garantuar për të dërguarit e Zotit

[47] As mos mendo që Zoti do të thyej premtimin e Tij ndaj të dërguarve të Tij. Zoti është i Plotfuqishëm, Hakmarrës.

*Qiej të ri dhe tokë e re**

[48] Do të vij dita kur kjo tokë do të zëvendësohet me tokë të re, dhe gjithashtu edhe qiejt, dhe çdokush do të silltet para Zotit, të Vetmit, Supremmit.

[49] Dhe do i shohësh fajtorët atë ditë të lidhur në pranga.

[50] Veshjet e tyre do të jenë nga zifti, dhe zjarr do i kaplojë fytyrat e tyre.

[51] Se Zoti do të paguaj secilin shpirt për çfarëdo që ka mbledhur ai; Zoti është llogaritësi më i shkathët.

[52] Kjo është shpallje për njerëzit, që të paralajmërohen me të, dhe t'ua bëjmë atyre me dije që Ai është vetëm një zot, dhe që njerëzit që kanë mendë të mund të marrin vesh.

Surja 15: Lugina El-Hixhr (El-Hixhr)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A.L.R. Këto (shkronja) janë prova të këtij shkrimi; Kuran i qartë.

[2] Padyshim, ata që nuk besuan do të dëshirojnë të ishin të nënshtruar.

[3] Le të hanë, kënaqen, dhe të mbesin të verbër me ëndrra me sy çelë; do e shohin.

[4] Nuk asgjësua asnjë shoqëri, përveç në përputhje me një kohë të paracaktuar.

[5] Fundi i cilësdo shoqëri nuk mund të shpejtohet, as të shtyhet.

[6] Ata thanë, "O ti që pranove këtë kujtesë, ti je i çmendur.

[7] "Pse nuk po i sjell ti engjëjt, nëse je i sinqertë?"

[8] Ne nuk i zbresim engjëjt përveç për punë specifike. Përndryshe, askujt nuk do i jepej afat.

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[9] Absolutisht, e kemi shpallur këtë kujtesë, dhe, absolutisht, do e ruajmë.*

[10] Kemi dërguar (të dërguarë) para teje te shoqëritë në të kaluarën.

[11] Sa herë që një i dërguar shkoi te ta, ata e përqeshën atë.

[12] Kështu i komandojmë mendjet e fajtorëve.

[13] Si pasojë, ata nuk mund të besojnë në të. Kjo ka qenë metoda që nga gjeneratat e kaluara.

[14] Edhe sikur të hapnim për ta një portë në qiell, nëpër të cilën ata ngjiten;

[15] do të thonë, "Po na bëjnë sytë. Jemi magjepsur."

[16] Vendosëm galaktika në qiell, dhe e zbukuruam atë për shikuesit.

[17] Dhe e mbrojtëm atë nga çdo djall i përjashtuar.

[18] Nëse cilido prej tyre përvidhet për të dëgjuar, një zjarr i ndritshëm do i gjuhet prapa.

[19] Sa për tokën, e ndërtoam atë, dhe vendosëm në të stabilizues (male), dhe rritëm në të ekulibër të përkryer të çdo gjëje.

[20] E bëmë të banueshme për ju,* dhe për krijesa për të cilat nuk furnizoni ju.

[21] Nuk ka asgjë që nuk kemi pakufi nga ajo. Por e zbresim në masë të caktuar.

[22] Dhe i dërgojmë erërat si polenizuese, dhe e bëjmë ujin të zbrësë nga qielli për ju ta pini.

* 14:48 Kjo profeci gjithashtu gjendet në Besëlidhjen e Vjetër (Isaia 65:17 & 66:22) dhe Besëlidhjen e Re: "Ajo që presim ne janë qiej të ri dhe tokë e re ku do të mbizotërojë drejtësia e Zotit, sipas premtimit të tij."

* 15:1 & 15:9 Burimi hyjnor dhe ruajtja e përkryer e Kuranit vërtetohen nga kodi matematikor i Kuranit (Shtojca 1). I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes ishte paracaktuar që ta zbulojë këtë mrekulli të madhe. Fjala "Dhikr" tregon për kodin e Kuranit në disa strofa (5:6, 21:2, 26:5, 38:1, 38:8, 74:31). Vlera e "Rashad Khalifa" (1230)+15+9=1254, 19x66.

* 15:20 Kur dërgojmë astronautë në hapësirë, i furnizojmë ata me sasi ushqimi, ujë, dhe oksigjen, të matura saktësisht. Zoti krijoi anijen kozmike Toka me bilionë astronautë që punojnë dhe riprodhohen; Ai i furnizoi ata me sistem vet-mbështetës që prodhon oksigjen, ujë të pastër, dhe llojllojshmëri shumë të madhe të ushqimeve dhe pijeve të shijshme.

Përndryshe, nuk do të kishit mundur ta mbani të pijshëm.

[23] Jemi ne ata që drejtojmë jetë dhe vdekje, dhe ne jemi trashëgimtarët përfundimtarë.

[24] Dhe ne i njohim tërësisht ata mes jush që përparojnë, dhe njohim tërësisht ata që shkojnë prapa.

[25] Zotëruesi yt padyshim do i mbledhë ata. Ai është Më i Mençuri, i Gjithëdijshëm.

Raca njerëzore

[26] E krijuam qenien njerëzore nga balta e tharë, si balta e poçarit.

[27] Sa për xhinët, i krijuam ata, para asaj, nga zjarri flakë.

[28] Zotëruesi yt iu tha engjëjve, “Unë po krijoj një qenie njerëzore nga balta e tharë, si balta e poçarit.

[29] “Kur Unë ta përkryej atë, dhe të fry në të nga fryma Ime, të bini në përlulje para tij.”

[30] Engjëjt ranë në përlulje; të gjithë ata,

[31] përveç Iblisit (Dreqit). Ai refuzoi të jetë me të përlulurit.

[32] Ai tha, “O Iblis (Dreq), pse nuk je me të përlulurit?”

[33] Ai tha, “Unë nuk kam për tu përlulur para një qenieje njerëzore, të cilën Ti e krijove nga balta e tharë, si balta e poçarit.”

[34] Ai tha, “Prandaj, duhet të dalësh; je i dëbuar.

[35] “Ke vetëshkaktuar mallkimin Tim deri në Ditën e Gjykimit.”

[36] Ai tha, “Zotëruesi im, më jep afat deri në ditën kur ata ringjallen.”

[37] Ai tha, “Të jepet afat.

[38] “Deri në ditën dhe kohën e caktuar.”

[39] Ai tha, “Zotëruesi im, pasi që Ti ke vendosur që unë të shkoj në humbje, unë patjetër do i joshë ata në tokë; do i dërgoj të gjithë në humbje.

[40] “Përveç atyre mes adhuresve Tënd që të janë kushtuar absolutisht vetëm Ty.”

[41] Ai tha, “Ky është ligj që është i pashkelshëm.

[42] “Ti nuk ke aspak fuqi mbi shërbëtorët e Mi. Ti vetëm ke fuqi mbi humbësit që të ndjekin ty.

[43] “Dhe Ferri i pret të gjithë ata.

[44] “Do të ketë shtatë porta. Secila portë do të marrë një pjesë të caktuar të tyre.”

[45] Sa për të drejtin, ata do gëzojnë kopshte dhe burime.

[46] Hyni aty, të qetë dhe të sigurt.

[47] Heqim krejt xhelozinë nga zemrat e tyre. Si një familje, ata do të jenë në mobilie afër.

[48] Kurrë nuk do të vuajnë ndonjë lodhje aty, kurrë nuk do të dëbohen prej aty.

[49] Informoj shërbëtorët e mi që Unë jam Falësi, i Mëshirshmi.

[50] Dhe ndëshkimi Im është ndëshkimi që dhemb më së shumti.

Engjëjt vizitojnë Ibrahimin

[51] Njoftoj ata për mysafirët e Ibrahimit.

[52] Kur ata hynë në oborr të tij, ata thanë, “Paqe.” Ai tha, “Jemi të shqetësuar nga ju.”

[53] Ata thanë, “Rri rehat. Kemi lajm të mirë për ty: një djalë të ndriçuar.”

[54] Ai tha, “Si mund të më jepni asi lajmi të mirë, kur unë jam aq i vjetër? A më jepni ende kësi lajmi të mirë?”

[55] Ata thanë, “Lajmi i mirë që të japim ty është i vërtetë; mos hiq dorë nga shpresa.”

[56] Ai tha, “Askush nuk heqë dorë nga shpresa e mëshirës së Zotëruesit të tij, përveç humbësve.”

[57] Ai tha, “Cili është misioni juaj, o të dërguarë?”

[58] Thanë, "Ne jemi nisur për te njerëz fajtorë.

[59] "Sa për familjen e Lutit, do i shpëtojmë.

[60] "Por jo gruan e tij; ajo është e paracaktuar që të jetë me të dënuarit."

Luti

[61] Të dërguarit shkuan te qyteza e Lutit.

[62] Ai tha, "Ju jeni njerëz të panjohur."

[63] Ata thanë, "Sjellim te ti atë për të cilën kanë dyshuar ata.

[64] "Sjellim te ti të vërtetën; e kemi me gjithë mend.

[65] "Ta marrësh familjen tënde gjatë natës. Rri pas tyre, dhe sigurohu që askush prej jush të mos shikojë prapa. Shkoni drejt siç jeni urdhëruar."

[66] E çuam te ai këtë urdhër: këta njerëz kanë për tu asgjësuar në mëngjes.

[67] Njerëzit e qytetit erdhën me gëzim.

[68] Ai tha, "Këta janë mysafirët e mi; mos më turpëroni.

[69] "Frikësojuni Zotit, dhe mos më marroni."

[70] Ata thanë, "A nuk ta kemi ndaluar t'i takosh të tjerët?"

[71] Ai tha, "Ja ku janë vajzat e mia, nëse vetëm duhet."

[72] Por, vaj, ata ishin verbuar plotësisht nga epshi i tyre.

[73] Si pasojë, katastrofa i goditi ata në mëngjes.

[74] E kthyem përmbys, dhe iu derdhëm atyre rrebesh gurësh shkretues.

[75] Ky është mësim për ata që posedojnë inteligjencë.

[76] Ky do të jetë gjithmonë sistemi.

[77] Kjo është shenjë për besimtarët.

[78] Njerëzit e pyllit gjithashtu ishin shkelës.

[79] Si pasojë, i pastruam-hesapet me ta, dhe të dy shoqëritë janë plotësisht të dokumentuara.

[80] Njerëzit e El-Hixhrës nuk iu besuan të dërguarve.

[81] Iu dhamë atyre shpalljet tona, por i shpërfillën.

[82] Ata dikur gdhendnin shtëpi të sigurta prej malesh.

[83] Katastrofa i goditi ata në mëngjes.

[84] Çka ata mblodhën nuk iu ndihmoi.

*Fundi i botës zbulohet**

[85] Nuk krijuam qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë mes tyre, përveç për një qëllim specifik. Ora do të vij, prandaj i trajto me shpërfillje mirësjellëse.

[86] Zotëruesi yt është Krijuesi, i Gjithëdijsmi.

[87] Të kemi dhënë shtatë palët, dhe Kuranin e mrekullueshëm.

[88] Mos ji xheloz në çka i kemi dhuruar të tjerëve (të dërguarë), dhe mos u pikëllo (nga mosbesimtarët), dhe ji i butë me besimtarët.

[89] Dhe thuaj: "Unë jam paralajmëruesi sqarues."

[90] Ne do të merremi me ndarësit.

[91] Ata e pranojnë Kuranin vetëm pjesërisht.

[92] Pasha Zotëruenin tënd, do i parashtrajmë në pyetje të gjithë ata,

[93] për çdo gjë që kanë bërë.

* 15:85-88 Një prej funksioneve të të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes është që ta shpërndajë konkluzionin që bota do të përfundojë në vitin 2280 Pas Lindjes së Krishtit (20:15, 72:27 & Shtojca 25).

[94] Prandaj, i zbotat urdhrat që të janë dhënë, dhe shpërfilli adhuruesit e idhujve.

[95] Ne do të të kursejmë nga tallësit,

[96] që ngritin zot tjetër përkrah Zotit. Ata padyshim do e marrin vesh.

[97] E dimë fare mirë që mund të zemërohesh nga shprehjet e tyre.

[98] T'i këndosh lavdet e Zotëruesit tënd, dhe të jesh me të përlurrit.

[99] Dhe adhuroje Zotëruesin tënd, për të arritur siguri.*

Surja 16: Bleta (En-Nahl)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Urdhri i Zotit tashmë është lëshuar (dhe çdo gjë tashmë është shkruar), prandaj mos e ngutni.* Qoftë i madhëruar Ai; Më i Larti, larg nga ndonjë idhull që ata ngritin.

[2] Ai zbret engjëjt me shpalljet, që çojnë urdhrat e Tij, te kushdo që Ai zgjedhë nga mesi i shërbëtorëve të Tij: "Të predikoni që nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Meje; Të më keni dronë Mua."

[3] Ai krijoi qiejt dhe tokën për një qëllim specifik. Ai është fort Lart, larg nga ndonjë idhull që ata ngritin.

[4] Ai krijoi njeriun nga një pikël, pastaj ai bëhet armik i flaktë.

[5] Dhe Ai krijoi bagëtinë për ju, për t'ju furnizuar me ngrohtësi, dhe shumë dobi të tjera, si dhe për ushqim.

[6] Ato gjithashtu ju furnizojnë me luks gjatë rehatisë suaj, dhe kur udhëtoni.

Bekimet e Zotit

[7] Dhe ata bartin ngarkesat tuaja në toka në të cilat nuk do të kishit mundur të arrini pa vështirësi të madhe. Padyshim, Zotëruesi juaj është i Dhembshëm, i Mëshirshmi.

[8] Dhe (Ai krijoi) kuajt, mushkat, gomarët për ju t'i ngisni, dhe për salltanet. Aq më tepër, Ai krijon çka ju nuk dini.

[9] Zoti tregon rrugët, duke përfshirë edhe të gabueshmet. Po të donte Ai, do të kishte mundur t'ju udhëzonte të gjithëve.

[10] Ai zbret nga qielli ujë për pijen tuaj, dhe për të rritur lisa për dobinë tuaj.

[11] Me të, Ai rritë për ju të mbjellat, ullinj, palma hurmash, hardhi, dhe të gjitha llojet e frutave. Kjo është provë (e mjaftueshme) për njerëzit që mendojnë.

[12] Dhe Ai parashtron, në shërbimin tuaj, natën dhe ditën, si dhe diellin dhe hënën. Gjithashtu, yjet janë të parashtruar me urdhrin e Tij. Këto janë prova (të mjaftueshme) për njerëzit që kuptojnë.

[13] Dhe (Ai krijoi) për ju në tokë gjëra ngjyrash të ndryshme. Kjo është provë (e mjaftueshme) për njerëzit që janë të vëmendshëm.

[14] Dhe Ai parashtrroi detin për t'ju shërbyer; ju hani prej tij mish të butë, dhe nxirrni stoli që i mbani. Dhe i shihni anijet duke u endur nëpër të për dobitë tuaja komerciale, përderisa i kërkoni dhuratat e Tij, që të mund të jeni mirënjohës.

[15] Dhe Ai vuri stabilizues (male) në tokë, se mos gremiset me ju, si dhe lumenj dhe rrugë, që të mund të udhëzoheni.

[16] Dhe shenja, si dhe yjet; për tu përdorur për orientim.

[17] A është Ai që krijon si ai që nuk krijon? A nuk do të merrni vesh?

* 15:99 Zakonet e adhurimit janë mënyrat tona për të arritur siguri (Shtojca 15).

* 16:1 Çdo gjë tashmë është regjistruar (57:22). Shih gjithashtu Shtojcën 14.

[18] Nëse i numëroni bekimet e Zotit, nuk ka shanse që t'i përfshini të gjitha. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[19] Dhe Zoti di çfarëdo që fshihni dhe çfarëdo që deklaroni.

Të shenjtët dhe profetët e vdekur

[20] Sa për idhujt që ata ngritin përkrah Zotit, ata nuk krijojnë asgjë; vetë ishin të krijuar.

[21] Ata janë të vdekur, jo të gjallë, dhe nuk e kanë idenë si dhe kur do të ringjallen.

[22] Zoti juaj është një zot. Sa për ata që nuk besojnë në Përjetësinë, zemrat e tyre nuk e pranojnë, dhe janë mendjemëdhenj.

[23] Absolutisht, Zoti di çfarëdo që fshehin dhe çfarëdo që deklarojnë. Ai nuk i do ata që janë mendjemëdhenj.

[24] Kur ata pyeten, "Çka mendoni për këto shpallje nga Zotëruesi juaj," thonë, "Përralla të moçme."

[25] Ata do të mbahen përgjegjës për mëkatet e tyre në Ditën e Ringjalljes, të gjithë ata, plus për mëkatet e të gjithë atyre që i çorientuan me paditurinë e tyre. Çfarë barre e tmerrshme!

[26] Të tjerë si ata kanë planifikuar në të kaluarën, dhe si pasojë, Zoti shkatërroi ndërtesat e tyre në themel, duke e bërë tavanin të bie mbi ta. Ndëshkimi i goditi ata kur më së paku e prisnin.

[27] Pastaj, në Ditën e Ringjalljes, Ai do i turpërojë ata dhe të pyesë, "Ku janë ortakët e mi që ju i kishit ngritur përkrah Meje, dhe më kishit kundërshtuar për hatër të tyre?" Të bekuarit me dituri do të thonë, "Sot, turpi dhe vuajtja iu kanë rënë mosbesimtarëve."

Vdekje për mosbesimtarët

[28] Engjëjt i vënë ata në vdekje përderisa janë në rrugë të gabuar. Atëherë ata më në fund nënshtrohen, dhe thonë, "Nuk kemi bërë asgjë të keqe!" Jo. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për gjithçka që keni bërë.

[29] Prandaj, hyni në portat e Ferrit, ku qëndroni përgjithmonë. Çfarë fati i tmerrshëm për mendjemëdhentë.

Besimtarët nuk vdesin vërtetë

[30] Sa për të drejtin, kur ata pyeten, "Çka mendoni për këto shpallje prej Zotëruetit tuaj," thonë, "Të mira." Për ata që çojnë jetë të drejtë, lumturi; e vendbanimi i Përjetësisë është edhe më i mirë. Çfarë vendbanimi i mirë për të drejtin.

[31] Kopshtet e Edenit janë të rezervuara për ta, ku rrjedhin lumenj. Ata kanë çfarëdo që dëshirojnë aty. Zoti kështu i shpërblen të drejtin.

Ata shkojnë drejt e në Parajsë

[32] Engjëjt i përfundojnë jetët e tyre përderisa janë të drejtë, duke thënë, "Paqe qoftë mbi ju. Hyni (tani) në Parajsë si shpërblim për punët tuaja."*

Mosbesimtarët

[33] A po presin ata që engjëjt të vinë te ta, ose t'i vij koha gjykimit të Zotëruetit tënd? Ata para tyre bënë të njëjtën gjë. Zoti nuk është Ai që iu bëri keq; janë ata që i bënë keq shpirtrave të vet.

[34] Ata kanë vetëshkaktuar pasojat e punëve të tyre të këqija, dhe pikërisht ato gjëra që i përqeshën iu kthyen atyre për t'i kapluar.

Arsyetim i famshëm

* 16:30-32 Të drejtin shijojnë vetëm vdekjen e parë, e cila tashmë është përjetuar nga të gjithë ne (shih 44:56). Në fund të afatit të tyre në këtë botë, engjëjt e vdekjes thjeshtë i ftojnë ata të vazhdojnë jetën në Parajsën ku Ademi dhe Eva dikur jetuan (2:154, 3:169, 8:24, 22:58, 36:26-27).

[35] Adhuresit e idhujve thonë, “Sikur të donte Zoti, nuk do të adhuronim idhuj përveç Tij, as ne as prindërit tanë. As nuk do të ndalonim asgjë përveç ndalesave të Tij.” Ata para tyre e kanë bërë të njëjtën gjë. A mund të dërguarit të bëjnë ndonjë gjë pos përçimit të krejt lajmit?

[36] Kemi dërguar të dërguar te secila shoqëri, duke thënë, “Ta adhuroni Zotin, dhe t’i shmangeni idhujtarisë.” Më pas, disa u udhëzuan nga Zoti, përderisa të tjerët u parashtruan në humbje. Enduni nëpër tokë dhe vëreni pasojat për refuzuesit.

[37] Pa marrë parasysh sa mundoheni t’i udhëzoni, Zoti nuk i udhëzon ata që Ai i ka parashtruar në humbje. Pra, askush nuk mund t’iu ndihmojë atyre.

Thellë në mendjet e tyre

[38] Bënë be solemnisht në Zotin: “Zoti nuk do i ringjallë të vdekurit.” Por jo! I tillë është premtimi i pakthyesëm i Tij, por shumica e njerëzve nuk dinë.

[39] Ai pastaj do t’ua tregojë të gjithëve të gjitha gjërat për të cilat u grindën, dhe do i lë ata që nuk besuan ta dinë që ishin gënjeshtarë.

Për t’i ringjallur të vdekurit

[40] Për të bërë diçka, ne thjeshtë i themi, “Ji,” dhe është.

[41] Ata që emigruan për hatër të Zotit, për shkak se u keqtrajtuan, ne patjetër do i japim banesë të mirë në këtë botë, dhe shpërblimi i Përjetësisë është madje edhe më i madh, veç sikur ta dinin.

[42] Kjo është për shkak se ata këmbëngulin me durim, dhe kanë besim në Zotëruesin e tyre.

[43] Nuk dërguam para teje përveç burra që i frymëzuam. Pyetni ata që dinë shkrimin, nëse nuk e dini.

[44] I furnizuar me prova dhe shkrim. Dhe të zbritëm ty këtë lajm, për të shpallur për njerëzit çdo gjë që është zbritur te ta, mbase do të pasqyrojnë.

[45] A garantojnë ata që planifikojnë planifikime djallëzore që Zoti nuk do e bëjë tokën t’i gëlltisë, ose që ndëshkimi nuk do iu vij atyre kur më së paku e presin?

[46] Mund t’i godasë ata përderisa janë në gjumë; nuk mund të shpëtojnë.

[47] Ose mund t’i godasë ata përderisa janë duke e pritur me frikë. Zotëruesi yt është i Dhembshëm, i Mëshirshmi.

[48] A nuk i kanë parë të gjitha gjërat e krijuara nga Zoti? Hijet i rrethojnë djathtas e majtas, në nënshtrim të plotë ndaj Zotit, dhe me vullnet.

[49] Zotit i përulet çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë – çdo krijesë – dhe po ashtu bëjnë edhe engjëjt; pa as më të voglën mendjemadhësi.*

[50] Ata ia kanë dronë Zotëruesit të tyre mbi ta, dhe bëjnë çka urdhërohen të bëjnë.

[51] Zoti ka shpallur: “Mos i adhuroni dy zota; është vetëm një zot. Të ma keni dronë vetëm Mua.”

[52] E Atij është çdo gjë në qiej dhe tokë dhe prandaj, feja t’i kushtohet absolutisht vetëm Atij. A do të adhuronit tjetër pos Zotit?

[53] Çfarëdo bekimi që gëzoni është prej Zotit. Prapëseprapë, kur vetëshkaktoni ndonjë fatkeqësi menjëherë i ankoheni Atij.

[54] Prapëseprapë, sapo Ai lehtëson fatkeqësinë tuaj, disa prej jush riktheheni në adhurim idhujsh.

[55] Le të mos besojnë në çka iu kemi dhënë atyre. Vazhdoni dhe kënaquni përkohësisht; patjetër do e merrni vesh.

[56] Ata caktojnë për idhujt e tyre që i ngritin nga padituria, një hise të furnizimeve që kemi

* 16:49 Trupi i njeriut, qoftë i takoi një besimtari ose mosbesimtari, i nënshtrohet Zotit; rrahjet e zemrës, dhe lëvizja e mushkërive ilustrojnë këtë nënshtrim.

dhuruar mbi ta. Pasha Zotin, do të mbaheni përgjegjës për shpikjet tuaja.

Njëanshmëri fanatike kundër foshnjave vajza

[57] Ata madje i caktojnë vajza Zotit, i madhëruar qoftë Ai, përderisa ata parapëlqejnë për vete atë që dëshirojnë.

[58] Kur një prej tyre kupton që ka foshnje vajzë, fytyra e tij bëhet e errësuar me pikëllim tronditës.

[59] I turpëruar, ai fshihet nga njerëzit, për shkak të lajmit të keq që i është dhënë. Ai madje edhe mendon: a ta mbaj foshnjën kundër dëshirës, apo ta varrosë në dhe. I trishtueshëm vërtetë është gjykimi i tyre.

[60] Ata që nuk besojnë në Përjetësi janë shembulli më i keq, përderisa Zotit i përkasin shembujt më madhështor. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Mëkati fillestar

[61] Po t'i ndëshkonte Zoti njerëzit për shkeljet e tyre, Ai do të kishte asgjësuar çdo krijesë në tokë. Por ai u jep afat atyre për një kohë specifike, të paracaktuar. Kur afatit të tyre i vjen fundi, ata nuk mund ta shtynë as për një orë, as ta shpejtojnë.

[62] Ata i mveshin Zotit çka nuk iu pëlqen vet atyre, pastaj e shprehin gënjeshtrenë me gjuhët e tyre kinse janë të drejtë! Pa asnjë dyshim, kanë vetëshkaktuar Ferr, se kanë ngritur krye.

[63] Pasha Zotin, kemi dërguar (të dërguarë) te shoqëritë para teje, por djalli i zbukuroi punët e tyre në sytë e tyre. Si pasojë, ai tash është zotërues i tyre, dhe ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[64] E kemi shpallur këtë shkrim te ti, për t'iu shpjeguar atyre gjërat për të cilat grinden, dhe për të furnizuar udhëzim dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.

Prova shtesë nga Zoti

[65] Zoti zbret nga qielli ujë për të ngjallur tokën pasi të ketë vdekur. Kjo duhet të jetë provë (e mjaftueshme) për njerëz që dëgjojnë.

[66] Dhe në bagëtinë ka mësim për ju: ju furnizojmë me një pije nga barqet e tyre. Nga mes ushqimit të tretur dhe gjakut, merrni qumësht të pastër, të shijshëm për pirësit.

[67] Dhe nga frutat e palmave të hurmave dhe hardhive prodhoni dehës, si dhe furnizime të mira. Kjo duhet të jetë provë (e mjaftueshme) për njerëz që kuptojnë.

Bleta

[68] Dhe Zotëruesi yt e frymëzoi bletën: ndërto shtëpi në male dhe lisa, dhe në (zgjojet) që ata ndërtojnë.

[69] Pastaj ha nga të gjitha frutat, duke ndjekur përcaktimin e Zotëruesit tënd, saktësisht. Nga barqet e tyre del pije ngjyrash të ndryshme, ku ka shërim për njerëzit. Kjo duhet të jetë provë (e mjaftueshme) për njerëzit që pasqyrojnë.*

[70] Zoti ju krijoi, pastaj Ai i përfundon jetët tuaja. Ai lë disa prej jush deri në moshën më të vjetër, vetëm për ta kuptuar që ka një kufi në njohurinë që ata mund ta fitojnë. Zoti është i Gjithëdijshëm, i Gjithëfuqishëm.

Asnjë ortak me Zotin

[71] Zoti ka furnizuar për disa prej jush më shumë se për të tjerët. Atyre që u jepet me bollëk nuk do t'ua jepnin pronat e tyre nënrenditësve të tyre deri në atë shkallë sa që t'i bënin ata ortakë. A

* 16:69 Përveç vlerës së ditur ushqimore të saj, mjalti është vërtetuar shkencërisht si ilaç shërues i alergjive dhe sëmundjeve të tjera të caktuara.

do të hiqnin dorë ata nga bekimet e Zotit?*

[72] Dhe Zoti krijoi për ju të shoqe nga vetë ju, dhe prodhoi për ju nga të shoqet tuaja fëmijë dhe nipa, dhe ju furnizoi me furnizime të mira. A duhet të besojnë ata në gënjeshtër, dhe të bëhen mosmirënjohës për bekimet e Zotit?

Adhurimi i idhujve: Budallallëk

[73] Prapëseprapë, ata adhurojnë përkrah Zotit çka nuk posedon asnjë furnizim për ta në qiej, as në tokë, as nuk mund t'i furnizojë ata me asgjë.

[74] Prandaj, mos ia tregoni ju shembujt Zotit; Zoti di përderisa ju nuk dini.

Besimtari i pasur më i mirë se besimtari i varfër

[75] Zoti përmendë shembullin e një skllavi që është i zotëruar, dhe është krejtësisht i pafuqi, në krahasim me dikë që e bekuam me furnizime të mira, prej të cilave ai jep bamirësi fshehtë dhe publikisht. A janë të barabartë? Lavdi Zotit, shumica e tyre nuk dinë.

[76] Dhe Zoti përmendë shembullin e dy burrave: njëri është memec, i mungon aftësia për të bërë diçka, është krejtësisht i varur në zotërinë e tij – në cilindo drejtim që e dërgon ai nuk mund të prodhojë asgjë të mirë. A është ai i barabartë me dikë që sundon me drejtësi, dhe është i udhëzuar në rrugën e drejtë?

Kjo jetë është shumë e shkurtë

[77] E Zotit është e ardhmja e qiejve dhe tokës. Sa i përket Atij, Ora është afër sa çel e mbyll sytë, ose edhe më afër. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[78] Zoti ju nxori nga barqet e nënave tuaja përderisa nuk dinit asgjë, dhe Ai ju dha dëgjimin, shikimin, dhe trutë, që të mund të jeni mirënjohës.

[79] A nuk i shohin zogjtë që vihen në fluturim në atmosferë të qiellit? Askush nuk i mbanë ata lart në ajër përveç Zotit. Kjo duhet të jetë provë (e mjaftueshme) për njerëzit që besojnë.

[80] Dhe Zoti furnizoi për ju shtëpi të palëvizshme ku mund të jetoni. Dhe furnizoi për ju shtëpi të lëvizshme të bëra nga lëkurat e bagëtive, që të mund t'i përdorni kur udhëtoni, dhe kur qetësoheni. Dhe nga leshi, gëzofi, dhe flokët e tyre, ju bëni orendi dhe lukse për një kohë të shkurtër.

[81] Dhe Zoti furnizoi për ju hije me gjëra të cilat i krijoi Ai, dhe furnizoi për ju strehë në male, dhe furnizoi për ju veshje që ju mbrojnë nga të nxehtit, dhe veshje që ju mbrojnë kur luftoni në luftëra. Ai kështu i përkryen bekimet e Tij mbi ju, që të mund të nënshtroheni.

[82] Nëse prapëseprapë kthehen prapa, atëherë misioni yt i vetëm është dorëzimi i qartë (i lajmit).

Mosbesimtarët mosmirënjohës

[83] Ata tërësisht i njohin bekimet e Zotit, pastaj i mohojnë; shumica e tyre janë mosbesimtarë.

Në Ditën e Ringjalljes

[84] Do të vij dita kur ngrisim nga secila shoqëri një dëshmitar, pastaj ata që nuk besuan nuk do të lejohen (të flasin), as nuk do të shfajësohen.

[85] Kur ata që shkelën e shohin ndëshkimin, do të jetë tepër vonë; nuk do iu zbutet, as nuk do iu shtyhet afati.

Idhujt bëjnë hasha idhujtarizuesit e tyre

[86] Dhe kur ata që bënë adhurim idhujsh shohin idhujt e tyre, do të thonë, "Zotëruesi ynë, këta janë idhujt që i kishim ngritur përkrah Teje." Idhujt pastaj do të ballafaqohen me ta dhe të thonë,

* 16:71 Nëse njerëzit nuk do të hiqnin dorë nga fuqia e tyre deri në atë shkallë, pse presin ata që Zoti ta bëjë këtë, dhe të krijojë ortakë për Vetën?

“Ju jeni gënjeshtarë.”

[87] Ata do i nënshtrohen totalisht Zotit në atë ditë, dhe idhujt që ata kishin shpikur do i bëjnë hasha.

[88] Për ata që nuk besojnë dhe zbrapsin nga rruga e Zotit, e shtojmë ndëshkimin e tyre me më shumë ndëshkim, për shkak të shkeljeve të tyre.

[89] Do të vij dita kur do ngrisim nga secila shoqëri një dëshmitar nga mesi i tyre, dhe të sjellim ty si dëshmitar të këtyre njerëzve. Kemi shpallur te ti këtë libër për të furnizuar shpjegime për çdo gjë, dhe udhëzim, dhe mëshirë, dhe lajm të mirë për të nënshtroarit.

[90] Zoti përkrahë drejtësi, bamirësi dhe kujdes ndaj të afërmeve. Dhe Ai ndalon të keqen, vesin, dhe shkeljen. Ai ju ndriçon, që të mund të jeni të vëmendshëm.

Ta mbash fjalën

[91] Ta përmbushni besëlidhjen tuaj me Zotin kur bëni një besëlidhje të tillë. Të mos i shkelni betimet pasi që të betoheni (në Zotin) që do i zbatoni, se e keni bërë Zotin garantues për ju. Zoti di çdo gjë që bëni.

[92] Mos u bëni si thurësja që e shtur thurjen e fortë të saj në grupe fijesh të holla. Ky është shembulli i juaj nëse i shpërdoroni betimet për të pasur epërsi mbi njëri tjetrin. Nëse një grup është më i madh se tjetri, Zoti kështu ju vë në test. Ai padyshim do t'ju tregojë në Ditën e Ringjalljes çdo gjë për të cilën ishit grindur.

[93] Po të donte Zoti, Ai do të kishte mundur të ju bëjë një asamble. Por Ai dërgon në humbje këdo që zgjedhë të shkojë në humbje, dhe Ai udhëzon këdo që dëshiron të jetë i udhëzuar.* Ju padyshim do të pyeteni për çdo gjë që keni bërë.

Shkelja e betimit: Shkelje serioze

[94] Mos i keqpërdorni betimet mes jush, se mos rrëshqitni mbrapa pas përforcimit të këmbëve tuaja, pastaj vetëshkaktoni vuajtje. E tillë është pasoja e zbrapsjes nga rruga e Zotit (duke vënë shembull të keq); ju vetëshkaktoni ndëshkim të tmerrshëm.

[95] Mos e shitni besëlidhjen e Zotit për pak. Çka Zoti posedon është shumë më e mirë për ju, veç sikur ta dinit.

[96] Çka ju posedoni harxhohet, por çka Zoti posedon zgjatë përgjithmonë. Ne padyshim do i shpërblejmë ata që durojnë me këmbëngulje; do i shpërblejmë ata për punët e tyre të drejta.

Lumturi e garantuar tash dhe përgjithmonë

[97] Kushdo që punon drejtësi, mashkull ose femër, përderisa beson, ne patjetër do i dhurojmë jetë të lumtur në këtë botë, dhe patjetër do t'ua paguajmë shpërblimin e plotë (në Ditën e Ringjalljes) për punët e tyre të drejta.

*Urdhër i rëndësishëm**

[98] Kur ta lexosh Kuranin, të kërkosh strehim te Zoti prej Dreqit të mallkuar.

[99] Ai nuk ka aspak fuqi mbi ata që besojnë dhe kanë besim në Zotëruetin e tyre.

[100] Ai ka fuqi vetëm mbi ata që e zgjedhin atë si sundues të tyre, që e zgjedhin atë si zot të tyre.

[101] Kur ne zëvendësojmë një shpallje në vend të tjetrës, dhe Zoti është tërësisht i vetëdijshtëm për atë që Ai shpallë, ata thonë, “E trillove këtë!” Në të vërtetë, shumica e tyre nuk dinë.

* 16:93 Zoti i njej besimtarët e vërtetë mes nesh që meritojnë të shpengohen. Në përputhje me këtë, Ai i udhëzon ata, përderisa i lë jashtë ata që zgjedhin të mos besojnë.

* 16:98 Shpëtimi ynë arrihet duke e njohur lajmin e Zotit, Kuranin, dhe Dreqi do të bëjë aq sa mundet që të na mbajë larg nga të shpënguarit. Për këtë arsye thuhet ky urdhër.

[102] Thuaj, “Shpirti i Shenjtë e ka sjellë këtë nga Zotëruesi yt, sinqerisht, për t’i siguruar ata që besojnë, dhe për të furnizuar fener dhe lajm të mirë për të nënshtruarit.”

Kurani nuk është i kopjuar nga Bibla

[103] Ne jemi tërësisht të vetëdijshëm që ata thonë, “Një qenie njerëzore po ia mëson!” Gjuha e atij në të cilin bëjnë aluzion është jo-arabe, dhe kjo është gjuhë arabe e përkryer.

[104] Padyshim, ata që nuk besojnë në shpalljet e Zotit, Zoti nuk i udhëzon. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[105] Të vetmit që trillojnë doktrina të rreme janë ata që nuk besojnë në shpalljet e Zotit; ata janë gënjeshtarët e vërtetë.

Fjalë goje nuk llogaritet

[106] Ata që nuk besojnë në Zotin, pasi që të kenë arritur besim, dhe bëhen tërësisht të kënaqur me mosbesim, kanë vetëshkaktuar zemërim nga Zoti. Të vetmit që shfajësohen janë ata që detyrohen të deklarojnë mosbesim, përderisa zemrat e tyre janë plot besim.*

Preokupimi me këtë jetë çon në dëbim nga Zoti

[107] Kjo është për shkak se i kanë dhënë përparësi kësaj jete mbi Përjetësinë, dhe Zoti nuk udhëzon njerëz të tillë mosbesimtarë.

[108] Ata janë ata zemrat e të cilëve i ka mbyllur Zoti, dhe dëgjimin e tyre, dhe të pamit e tyre. Si pasojë, mbesin të pavëmendshëm.

[109] Patjetër, ata do të jenë humbësit në Përjetësi.

[110] Sa për ata që emigrojnë sepse keqtrajtohen, pastaj vazhdojnë të përpiqen dhe durojnë me këmbëngulje, Zotëruesi yt, për shkak të gjithë kësaj, është Falës, i Mëshirshmi.

[111] Do të vij dita kur çdo shpirt do të shërbej si avokat i veti, dhe çdo shpirt do të paguhet tërësisht për çfarëdo që kishte bërë, pa as më të voglën padrejtësi.

Ndalimi i ushqimit të ligjshëm sjell humbje

[112] Zoti përmendë shembullin e një shoqërie që dikur ishte e sigurt dhe përparimtare, me furnizime që vinin te ajo nga gjithkrah. Por pastaj, u bë mosmirënjohëse e bekimeve të Zotit. Si pasojë, Zoti i bëri ata të vuajnë vështirësitë e urisë dhe pasigurisë. E tillë është pagesa për çka bënë ata.

[113] Një i dërguar kishte shkuar te ta nga mesi i tyre, por ata e refuzuan atë. Si pasojë, ndëshkimi i goditi për shkeljen e tyre.

[114] Prandaj, të hani prej furnizimeve të Zotit gjithçka që është e ligjshme dhe e mirë, dhe të jeni mirënjohës për bekimet e Zotit, nëse e adhuroni vetëm Atë.

Vetëm katër ushqime ndalohen

[115] Ai ndalon për ju vetëm kafshët e ngordhura, gjakun, mishin e derrit,* dhe ushqim që i dedikohet tjetër pos Zotit. Nëse dikush detyrohet (t’i hajë këto), pa qenë me qëllim ose keqdashje, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[116] Të mos shprehni gënjeshtria me gjuhët tuaja duke thënë: “Kjo është e ligjshme, dhe kjo nuk është e ligjshme,” për të trilluar rrena dhe mvëshur ato Zotit. Padyshim, ata që trillojnë rrena dhe ia mvëshin Zotit nuk do ia dalin kurrë.

* 16:106 Mençuria e Zotit shpallë që nëse dikush mbanë një armë në kokën tënde dhe të urdhëron që të deklarojë që nuk beson në Zotin, mund t’ia plotësosh dëshirën. Çka ke brenda në zemër është çka llogaritet.

* 16:115 & 118 Paraziti më shkatërrues *Trichinos*, *Trichinella spiralis*, (gjithashtu shiriti i derrit *Tania solium*) mbijeton në mishin e derrit, e jo në yndyrë. Më shumë se 150,000 njerëz janë infektuar për çdo vit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shih 6:145-146, dhe Shtojcën 16.

[117] Ata kënaqen shkurt, pastaj vuajnë ndëshkim që dhemb.

[118] Për Jahuditë, ndaluar çka të kallëzuar paraprakisht. Nuk jemi ne ata që iu bëmë keq atyre; ata janë ata që i bënë keq shpirttrave të vet.

[119] Prapëseprapë, sa për ata që bien në mëkat nga padituria pastaj pendohen më pas dhe përmirësohen, Zotëruesi yt, pas asaj, është Falës, i Mëshirshmi.

Ibrahimi

[120] Ibrahimi ishte vërtetë pionier shembullor në nënshtrimin e tij ndaj Zotit, një monoteist që nuk adhuroi idhuj kurrë.

[121] Për shkak se ai ishte mirënjohës i bekimeve të Zotëruesit të tij, Ai e zgjodhi atë dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë.

[122] I dhamë atij lumturi në këtë jetë, dhe në Përjetësi ai do të jetë me të drejtë.

*Muhamedi: Ndjekës i Ibrahimit**

[123] Pastaj të frymëzuar ty (Muhamed) që të ndjekësh fenë e Ibrahimit, monoteistit; ai nuk ishte adhures idhujsh.

E Shtuna shfuqizohet

[124] E Shtuna ishte shpallur vetëm për ata që përfunduan duke e polemizuar (Jahuditë & të Krishterët). Zotëruesi yt është Ai që do i gjykojë ata në Ditën e Ringjalljes sa i përket polemikave të tyre.

Si të përhapësh lajmin e Zotit

[125] Të ftosh te rruga e Zotëruesit tënd me urtësi edhe ndriçim të sjellshëm, dhe debato me ta në mënyrën më të mirë të mundshme. Zotëruesi yt di më së mirë kush ka humbur larg nga rruga e Tij, dhe Ai di më së miri kush janë të udhëzuarit.

[126] Dhe nëse ndëshkoni, të shkaktoni ndëshkim të barabartë. Por nëse strehoheni në durim (në vend të hakmarrjes), do të ishte më mirë për të durueshmit.

[127] Të strehohesh në durim – dhe durimi yt është i arritshëm vetëm me ndihmën e Zotit. Mos u pikëllo për ta, dhe mos u inatos nga planet e tyre.

[128] Zoti është me ata që çojnë jetë të drejtë, dhe ata që janë bamirës.

Surja 17: Fëmijët e Izraelit (Beni Israel)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Më i madhëruari është Ai që mblodhi shërbëtorin e Tij (Muhamedin) gjatë natës, nga Vendlutja e Shenjtë (e Mekës) te vendi më i largët i përlules,* mjediset e të cilës i kemi bekuar, në mënyrë që t'i tregojmë atij disa nga shenjat tona. Ai është Dëgjuesi, Pamësi.

[2] Ngjashëm, i dhamë Moisiut shkrimin, dhe e bëmë fener për Fëmijët e Izraelit që: "Të mos ngritni asnjë idhull si Zotëruesi dhe Sundues përkrah Meje."

[3] Ata janë pasardhës të atyre që i bartëm me Nuhun; ai ishte shërbëtor mirënjohës.

[4] Iu drejtuar Fëmijëve të Izraelit në shkrim: "Do të bëni të këqija të tepërta në tokë, dy herë. Jeni të paracaktuar të bini në lartësi të mëdha mendjemadhësie.

[5] "Kur t'i vij koha herës së parë, do të dërgojmë kundër jush shërbëtorë tanë që posedojnë fuqi të

* 16:123 Kjo na informon që të gjitha zakonet fetare, të cilat na erdhën nëpërmjet Ibrahimit, veç ishin në ekzistencë në kohën e Muhamedit (shih 22:78 dhe Shtojcën 9).

* 17:1 "Mesxhid Aksa" do të thotë "vendi më i largët ku ka përlule," me biliona Vjet Drite larg. Kjo strofë na njofton që Muhamedi, shpirti, u mor në Qiellin më të lartë për t'iu dhënë Kurani (2:185, 44:3, 53:1-18, & 97:1).

madhe, dhe ata do i pushtojnë shtëpitë tuaja. Kjo është profeci që duhet të kalojë.

[6] "Pas asaj, do t'ju japim juve anën e epërme, dhe do t'ju furnizojmë me shumë pasuri dhe fëmijë; do t'ju japim shtim më të madh.

[7] "Nëse punoni drejtësi, ju punoni drejtësi për të mirën tuaj, por nëse bëni të këqija bëni ashtu në dëm të vetes. Kështu, kur herës së dytë i vjen koha, ata do t'ju mposhtin juve dhe të hynë në xhami, ashtu si bënë herën e parë. Ata do i fshijnë të gjitha fitimet që i kishit arritur."

[8] Zotëruesi juaj derdhë mbi ju mëshirën e Tij. Por nëse riktheheni në shkelje, do t'ua kthejmë me ndëshkim. E kemi përcaktuar Xhehenemin si vendbanim përfundimtar për mosbesimtarët.

Kurani: Mënyra jonë për shpëtim

[9] Ky Kuran udhëzon te rruga më e mirë, dhe iu sjell lajme të mira besimtarëve që çojnë jetë të drejtë, që ata kanë merituar shpërblim shumë të madh.

[10] Sa për ata që nuk besojnë në Përjetësi, kemi përgatitur për ta ndëshkim që dhemb.

[11] Qenia njerëzore shpesh lutet për diçka që mund ta lëndojë atë, duke menduar se po lutet për diçka të mirë. Qenia njerëzore është e paduruar.

[12] E bëmë natën dhe ditën dy shenja. E bëmë natën errësirë, dhe ditën të ndriçuar, që të mund të kërkojnë furnizime nga Zotëruesi i tyre aty. Kjo gjithashtu vë për ju sistem njehsimi të kohës, dhe mënyrë llogaritjeje. Kështu pra e shpjegojmë çdo gjë hollësisht.

*Video kaset**

[13] E kemi incizuar fatin e secilës qenie njerëzore; është i lidhur për qafës së tij. Në Ditën e Ringjalljes do i dorëzojmë atij një regjistër që është i hapur.

[14] Lexoje regjistrin tënd. Sot, ti mjafton si llogaritës i vetes.

[15] Kushdo që udhëzohet, udhëzohet për të mirën e vet, dhe kushdo që shkon në humbje bën ashtu në dëm të vetes. Asnjë mëkatar nuk do i bartë mëkatet e askujt tjetër. Ne nuk ndëshkojmë pa dërguar të dërguar së pari.

[16] Nëse kemi për ta asgjësuar ndonjë shoqëri, i lëmë udhëheqësit të bëjnë korrupsion të madh aty. Kur ata arrijnë në pikën për të merituar ndëshkim, e asgjësojmë krejtësisht.

[17] Mori gjeneratash i kemi asgjësuar pas Nuhut. Zotëruesi yt është më i shkathëti në marrjen me mëkatet e shërbëtorëve të Tij; Ai është Njohës i tërësishëm, Pamës.

Zgjidhi prioritetet me kujdes:

Kjo jetë

[18] Kushdo që zgjedhë këtë jetë të shkurtër si prioritet të tij, do të ngusim te ai çka kemi vendosur t'i japim, pastaj e parashtrojmë atë në Xhehenem, ku ai vuan përgjithmonë, i përbuzur dhe i mposhtur.

Përjetësia

[19] Sa për ata që zgjedhin Përjetësinë si prioritet të tyre, dhe veprojnë drejt, përderisa besojnë, përpjekjet e tyre do të çmohen.

[20] Për secilin prej tyre furnizojmë; furnizojmë për ata dhe këta nga dhuratat e Zotëruetit tënd. Dhuratat e Zotëruetit tënd janë të pashtershme.

[21] Vini re se si i preferuam disa njerëz mbi të tjerët (në këtë jetë). Dallimet në Përjetësi janë shumë më të mëdha dhe shumë më të shquara.

Urdhra madhore

* 17:13 Jeta jote tashmë është e incizuar, sikur në video kasetë, nga lindja deri në vdekje. Ky i njëjti regjistër do të jetë i hapur për ne kur ringjallemi. Shih 57:22 & Shtojcën 14.

[22] Të mos ngritësh asnjë zot përkrah Zotit, se mos përfundon ti i përbuzur dhe i turpëruar.

[23] Zotëruesi yt ka shpallur që të mos adhuronit përveç Atij, dhe prindërit tuaj të nderohen. Për aq sa njëri apo të dy prej tyre jetojnë, të mos u thoni atyre, “Uf” (gjestin më të vogël të bezdisë), as të mos iu bërtisni; t’i trajtoni miqësisht.

[24] Dhe ul për ta krahët e përluljes, dhe dashamirësisë, dhe thuaj, “Zotëruesi im, kij mëshirë mbi ta, se më kanë rritur nga foshnjëria.”

[25] Zotëruesi juaj është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet tuaja më të thella. Nëse vazhdoni të jeni të drejtë, Ai është Falës i atyre që pendohen.

[26] T’i jepni lëmshën e caktuar të afërmve, nevojtarëve, të varfërve, dhe udhëtarit të huaj, mos jini të tepërt, dorëshpuar.

[27] Dorëshpuarit janë vëllezër të djajve, dhe djalli është mosmirënjohës i Zotëruesit të tij.

[28] Edhe nëse duhet t’ua kthesh shpinën atyre, përderisa e ndjek mëshirën e Zotëruesit tënd, t’i trajtosh ata në mënyrën më të këndshme.

Dorështrënguarsia dënohet

[29] Të mos e mbash dorën të shtrënguar për qafës tënde, e as të mos e hapësh me mendjelehtësi, se përfundon i fajësuar dhe i mjerë.

[30] Se Zotëruesi yt shton furnizimin për këdo Ai zgjedhë, dhe e zvogëlon atë. Ai është Njohës i tërësishtëm i krijesave të Tij, Pamës.

Abortimi është vrasje

[31] Të mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika prej varfërisë. Ne furnizojmë për ta, si edhe për ju. Vrasja e tyre është shkelje e tepërt.

[32] Të mos bëni marrëdhënie jashtëmartesore; është mëkat i tepërt, dhe sjellje e keqe.

[33] Të mos vrisni asnjë person – se Zoti e ka bërë jetën të shenjtë – përveç për drejtësi. Nëse dikush vritet padrejtësisht, atëherë ne i japim trashëgimtarit të tij autoritet për të zbatuar drejtësinë. Pra, ai të mos i tejkalojë kufijtë në shpagimin e vrasjes; ai do të ndihmohet.

[34] Të mos i prekni paratë e jetimëve përveç për të mirën e tyre, derisa të arrijnë pjekurinë. T’i përmbushni besëlidhjet tuaja, se besëlidhja është përgjegjësi e madhe.

[35] Të jepni masë të plotë kur bëni shitblerje, dhe të peshoni me barazi. Kjo është më mirë dhe më e drejtë.

Këshillë kyçe

[36] Të mos pranosh asnjë informatë, në mos e verifikofsh vetë. Ju kam dhënë dëgjimin, shikimin, dhe mendjen, dhe ju jeni përgjegjës për t’i përdorur.

[37] Të mos ecësh me krenari në tokë – nuk mund të përbirosh tejpertej tokës, as nuk mund të jesh i gjatë sa malet.

[38] E gjithë sjellja e keqe dënohet nga Zotëruesi yt.

Kurani është mençuri

[39] Kjo është ca nga mençuria që të është frymëzuar ty nga Zotëruesi yt. Të mos ngritësh zot tjetër përkrah Zotit, se mos përfundon në Xhehenem, i fajësuar dhe i mposhtur.

[40] A ju ka dhënë Zotëruesi juaj juve djem, përderisa i ka dhënë Vetes engjëjt si vajza?! Si mund të shprehni një blasfemi të tillë?

[41] Kemi përmendur në këtë Kuran (të gjitha llojet e shembujve), që të mund të marrin vesh. Por kjo vetëm ua shton neverinë e tyre.

[42] Thuaj, “Po të kishte zota tjerë përkrah Tij, siç pretendojnë ata, ata do të kishin tentuar ta

përmbysin Poseduesin e fronit.”

[43] I madhëruar qoftë Ai, Ai është tepër i lartësuar, larg nga shprehjet e tyre.

Çdo gjë e madhëron Zotin

[44] Duke e madhëruar Atë janë të shtatë gjithësitë, toka, dhe çdokush në to. Nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, por ju nuk e kuptoni madhërimin e tyre. Ai është i Butë, Falës.

Mosbesimtarët nuk mund ta kuptojnë Kurandin

[45] Kur ta lexosh Kurandin, ne vëmë ndërmjet teje dhe atyre që nuk besojnë në Përjetësinë një barrierë të padukshme.

Kurani: I VETMI burim

[46] Ne vëmë mburoja rreth mendjeve të tyre, për t'i parandaluar nga të kuptuarit e tij, dhe shurdhim në veshët e tyre. Dhe kur ti predikon për Zotëruesin tënd, duke e përdorur vetëm Kurandin,* ata largohen me neveri.

[47] Jemi tërësisht të vetëdijshëm çka ata dëgjojnë, kur ata të dëgjojnë ty, dhe kur bisedojnë fshehtë – mosbesimtarët thonë, “Po ndiqni një njeri të çmendur.”

[48] Vëreje se si të përshkruajnë, dhe si kjo i bënë ata të largohen nga rruga.

[49] Ata thanë, “Pasi që të shndërrohemi në eshtra dhe copa, a ringjallemi sërish?!”

[50] Thuaj, “Madje edhe nëse shndërrohemi në gurë ose hekur.

[51] “Madje edhe nëse shndërrohemi në cilindo lloj krijimi që e konsideroni të pamundur.” Ata pastaj do të thonë, “Kush do të na kthejë prapa?” Thuaj, “Ai që ju krijoi juve pikë së pari.” Ata pastaj do i tundin kokat e tyre dhe të thonë, “Kur do të jetë ajo?” Thuaj, “Mund të jetë më afër sesa që mendoni.”

[52] Ditën që Ai ju mbledhë, do të reagoni duke e lartmadhëruar Atë, dhe atëherë do të kuptoni që kishit zgjatur në këtë jetë fare pak.

Trajtojeni njëri tjetrin miqësisht

[53] Tregoju shërbëtorëve të Mi ta trajtojnë njëri tjetrin në mënyrën më të mirë të mundshme, se djalli gjithmonë do të mundohet që të fusë përçarje mes tyre. Padyshim, djalli është armiku më i flaktë i njeriut.

[54] Zotëruesi juaj ju njeh më së miri. Sipas njohurisë së Tij, Ai mund të derdhë mbi ju mëshirë, ose Ai mund t’ju paguaj. Nuk të dërguam ty të jesh avokati i tyre.

[55] Zotëruesi yt është njohësi më i mirë i çdonjërit në qiej dhe tokë. Në përputhje me njohurinë e tij, i preferuam disa profetë mbi të tjerët. Për shembull, i dhamë Davidit Psalmet.

[56] Thuaj, “Lutjuni cilëve do idhuj që i keni ngritur përkrah Tij.” Ata nuk kanë aspak fuqi që të heqin fatkeqësitë tuaja, as nuk mund t’i parandalojnë.

Idhujt e drejtë adhurojnë vetëm Zotin

[57] Madje edhe idhujt të cilëve ata iu luten janë duke kërkuar rrugët dhe mënyrat drejt Zotëruesit të tyre. Ata luten për mëshirën e Tij, dhe i frikësohen ndëshkimit të Tij. Padyshim, ndëshkimi i Zotëruesit tënd është i llahtarshëm.

[58] Nuk ka asnjë shoqëri që nuk do e asgjësojmë para Ditës së Ringjalljes, ose të shkaktojmë ndëshkim të rëndë mbi ta. Kjo tashmë është e shkruar në libër.

Lloji i mrekullive të vjetra është bërë bajat

* 17:46 Fjala arabe “vetëm” i referohet Zotit në 7:70, 39:45, 40:12 & 84, dhe 60:4. Nëse i mbledhë këta numra merr 361, 19x19. Por nëse përfshin 17:46, e cila i referohet Kuranit, shuma nuk është shumëfish i 19-tës. “Vetëm,” pra i referohet Kuranit në 17:46 (Shtojca 18).

[59] Çka na ndaloi neve që të dërgojmë mrekullitë është që gjeneratat paraprake i kanë refuzuar ato. Për shembull, i treguam Themudit devenë, (mrekulli) e qartë, por ata shkelën kundër saj. I dërguam mrekullitë vetëm për të rrënjosur drojë.

[60] Të njoftuam ty që Zotëruesi yt tërësisht i ka në dorë njerëzit, dhe e bëmë vizionin që të treguam ty test për njerëzit, dhe lisin që është i mallkuar në Kuran*. Iu treguam atyre prova të qëndrueshme për të rrënjosur drojë në ta, por kjo vetëm e shtoi kundërshtimin e hapur të tyre.

Dreqi i mashtron njerëzit

[61] Kur iu thamë engjëjve, "Bini në përlje para Ademit," ata ranë në përlje, përveç Dreqit. Ai tha, "A t'i përulem atij që Ti e krijove nga balta?"

[62] Ai tha, "Pasi që Ti e ke nderuar atë mbi mua, nëse më jep afat deri në Ditën e Ringjalljes, unë do i zotëroj të gjithë pasardhësit e tij, përveç një pakice."

[63] Ai tha, "Atëherë shko; ti dhe ata që të ndjekin ty do të përfundoni në Ferr si pagesë e juaja; pagesë me barazi.

[64] "Mund t'i joshësh ata me zërin tënd, dhe të mobilizosh të gjitha forcat tua dhe të gjithë njerëzit e tu kundër tyre, dhe të kesh hise në paratë dhe fëmijët e tyre, dhe t'iu premtosh atyre. Çfarëdo që djalli premtos nuk është asgjë më shumë se një iluzion.

[65] "Sa për shërbëtorët e Mi, nuk ke aspak fuqi mbi ta." Zotëruesi yt mjafton si mbrojtës.

[66] Zotëruesi juaj është Ai që i bën anijet të lundrojnë nëpër oqean,* që të mund t'i kërkoni dhuratat e Tij. Ai është i Mëshirshmi ndaj jush.

[67] Nëse leqendiseni në mes të detit, i harroni idhujt tuaj dhe sinqerisht i luteni vetëm Atij. Por sapo t'ju shpëtojë Ai juve në bregdet, ju prapësoheni. Vërtetë, qenia njerëzore është mosmirënjohëse.

[68] A keni garantuar që Ai nuk do e bëjë tokën, në bregdet, t'ju gëlltisë? Ose, që Ai nuk do të dërgojë mbi ju një stuhi, pastaj ju nuk gjeni asnjë mbrojtës?

[69] A keni garantuar që Ai nuk do t'ju kthejë në det edhe një herë, pastaj t'ju dërgojë një furtunë që ju mbytë për shkak të mosbesimit tuaj? Kur kjo ndodhë, ne nuk do t'ju japim juve një shans tjetër.

[70] I kemi nderuar fëmijët e Ademit, dhe i bartim ata në udhëtim në tokë dhe në det. Furnizuam për ta furnizime të mira, dhe iu dhamë atyre përparësi më të mëdha sesa shumë krijesa tonat.

[71] Do të vij dita kur e mbledhim çdo popull, së bashku me regjistrin e tyre. Sa për ata që iu jepet regjistër i drejtësisë, ata do të lexojnë regjistrin e tyre dhe nuk do të vuajnë as më të voglën padrejtësi.

[72] Sa për ata që janë të verbër në këtë jetë, ata do të jenë të verbër në Përjetësi, madje edhe më keq.

Zoti e përkrahë të dërguarin

[73] Ata gati të larguan ty nga shpalljet që të kemi dhënë ty. Ata deshën që ti të sajoje diçka tjetër, në mënyrë që të të konsiderojnë ty shok.

[74] Nëse nuk do të kishim përforcuar ty, gati sa nuk anove kah ta vetëm pak.

[75] Po ta bëje atë, ne do të kishim dyfishuar ndëshkimin për ty në këtë jetë, dhe pas vdekjes, dhe

* 17:60 Udhëtimi i Muhamedit te qielli më i lartë për të pranuar Kuranin, siç thuhet në 17:1 dhe 53:1-18, është test sepse njerëzve iu desh t'i besojnë Muhamedit në mirëbesim.

* 17:66 Tash mësojmë nga fizika dhe kimia fizike që uji ka cilësi të veçanta që e bëjnë atë krejtësisht të përshtatshëm për të shërbyer për nevojat tona të ndryshme.

nuk do të kishe gjetur askënd për të të ndihmuar kundër nesh.

[76] Ata gati të dëbuan nga toka për të të hequr qafe, që të mund të ktheheshin prapa sapo të largohesh.

[77] Ky ka qenë vazhdimisht rasti me të gjithë të dërguarit që i kemi dërguar para teje, dhe do e gjesh që sistemi ynë nuk ndryshon.

Lutja e mesditës

[78] T'i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) kur dielli zbret nga pika më e lartë e tij në mesditë, përderisa lëvizë kah perëndimi. Gjithashtu të zbatosh (recitimin e) Kuranit në agim. (Recitimi) i Kuranit në agim dëshmohet.

Meditimi

[79] Gjatë natës, të meditosh për ngritje (shpirtërore) shtesë, që Zotëruesi yt të mund të të ngritë në një shkallë të nderuar.

[80] Dhe thuaj, "Zotëruesi im, më prano një pranim të nderuar, dhe më lejo të nisem në një nisje të nderuar, dhe më dhuro nga Ti një përkrahje të fuqishme."

[81] Shpall, "E vërteta ka ngadhënjyer, dhe e pavërteta është zhdukur; e pavërteta patjetër do të zhduket."

Shërim dhe mëshirë

[82] Ne zbritëm në Kuran shërim dhe mëshirë për besimtarët. Në të njëjtën kohë, vetëm e rritë shpirtligësinë e shkelësve.

[83] Kur e bekojmë qenien njerëzore, ai bëhet i prapë dhe i pavëmendshëm. Por kur fatkeqësi e godet atë, ai bëhet i dëshpëruar.

[84] Thuaj, "Çdokush punon në përputhje me besimin e tij, dhe Zotëruesi juaj di më së miri cilët janë të udhëzuar në rrugën e drejtë."

Shpallja Hyjnore: Burim i krejt dijes

[85] Të pyesin për shpalljen. Thuaj, "Shpallja vjen nga Zotëruesi im. Njohuria e dhënë juve është shumë e vockël."

[86] Nëse duam, ne mund ta marrim prapa çka të shpallëm, atëherë nuk do të gjesh asnjë mbrojtës kundër nesh.

[87] Po kjo është mëshirë nga Zotëruesi yt. Bekimet e tij mbi ty kanë qenë të mëdha.

Hartim matematikor i Kuranit

[88] Thuaj, "Sikur të gjithë njerëzit dhe të gjithë xhinët të bashkoheshin për të prodhuar një Kuran si ky, ata nuk do të kishin mundur të prodhojnë asgjë si ai, pa marrë parasysh sa ndihmë i japin njëri tjetrit."

[89] Kemi përmendur për njerëzit në këtë Kuran të gjitha llojet e shembujve, por shumica e njerëzve këmbëngulin që të mos besojnë.

Të dërguarit e Zotit sfidohen

[90] Ata thanë, "Nuk do të besojmë ty në mos e bëfsh një burim të shpërthejë nga toka.

[91] "Ose në mos e paç një kopsht me palma hurmash dhe hardhi, me lumenj që rrjedhin nëpër të.

[92] "Ose në mos shkaktosh masa nga qielli, siç pretendove, të bien mbi ne. Ose në mos sjellsh Zotin dhe engjëjt para syve tanë.

[93] "Ose në mos e paç një pallat luksoz, ose në mos u ngjitsh në qiell. Edhe nëse ngjitesh, ne nuk do të besojmë në mos e sjellsh një libër që mund ta lexojmë."* Thuaj, "I madhëruar qoftë Zotëruesi

* 17:93 | Dërguari i Zotit i Besëlidhjes, Rashad Khalifa, u sfidua kështu, duke përfshirë sfidën për të sjellë një libër të ri,

im. Unë nuk jam asgjë më shumë se një i dërguar njeri?”

Të dërguarit: Test thelbësor

[94] Çka i parandaloi njerëzit nga besimi kur udhëzimi iu erdhi atyre është thënia e tyre, “A dërgoi Zoti një qenie njerëzore si të dërguar?”

[95] Thuaj, “Sikur toka të ishte e banuar nga engjëjt, ne do të kishim zbritur te ta prej qielli një të dërguar engjëll.”

Zoti është dëshmitar i imi

[96] Thuaj, “Zoti mjafton si dëshmitar ndërmjet meje dhe jush. Ai është Njohës i tërësishëm i adhuruesve të Tij, Pamës.”

[97] Këdo që Zoti e udhëzon është vërtetë i udhëzuar. Dhe këdo që Ai e dërgon në humbje, nuk do të gjeni për ta asnjë zotërues dhe sundues përkrah Tij. Do i mbledhim ata në Ditën e Ringjalljes me dhunë; të verbër, memecë, dhe të shurdhër. Përfundimi i tyre është Ferr; sa herë që pakësohet, do të rrisim zjarrin e tyre.

Mendimet e tyre më të thella

[98] I tillë është ndëshkimi i tyre i drejtë, pasi që ata i refuzuan shpalljet tona. Ata thanë, “Pasi që të shndërrohemi në eshtra dhe copa, a ringjallemi në krijim të ri?”

[99] A nuk mund ta shihnin ata që Zoti që krijoi qiejt dhe tokën është i aftë të krijojë krijimin e njëjtë, dhe që Ai ka paracaktuar për ta një kohëzgjatje të jetës të pakthyeshme? Prapëseprapë, mosbesimtarët këmbëngulin që të mos besojnë.

[100] Shpall, “Sikur t’i posedonit thesaret e mëshirës së Zotëruesit tim, do i kishit mbajtur ato, duke u frikësuar se mos po i harxhoni. Qenia njerëzore është dorështrënguar.”

Moisiu dhe Faraoni

[101] E përkrahëm Moisiun me nëntë mrekulli të qarta – pyetni Fëmijët e Izraelit. Kur ai shkoi te ta, Faraoni i tha atij, “Unë mendoj që ti, Moisi, je magjepsur.”

[102] Ai tha, “Ti e di fare mirë që askush nuk mund t’i manifestojë këto përveç, natyrisht, Zotëruesit të qiejve dhe tokës. Unë mendoj që ti, Faraon, je i mallkuar.”

[103] Kur ai i ndoqi ata, përderisa i ndoqi jashtë vendit, e mbytëm atë, së bashku me ata që anuan kah ai, të gjithë ata.

[104] Dhe iu thamë Fëmijëve të Izraelit më pas, “Shkoni jetoni në këtë vend. Kur t’i vij koha profecisë së fundit, ne do t’ju mbledhim juve të gjithëve në një grup.”

Kurani lëshohet ngadalë për të ndihmuar kujtesën

[105] Singërisht, e zbritëm, dhe me të vërtetën zbriti. Nuk të dërguam ty përveç si bartës të lajmeve të mira, si dhe si paralajmërues.

[106] Kuran që e kemi lëshuar ngadalë, në mënyrë që t’ua lexosh njerëzve përgjatë një kohe të gjatë, edhe pse e zbritëm atë krejt përnjëherë.

[107] Shpall, “Besoni në të, ose mos besoni në të.” Ata që kanë njohuri nga shkrimet paraprake, kur ai iu recitohet atyre, bien me fytyra poshtë, duke u përulur.

[108] Ata thonë, “I madhëruar qoftë Zotëruesi ynë. Kjo përmbush profecinë e Zotëruesit tonë.”

[109] Ata bien me fytyra poshtë, duke u përulur dhe qarë, se ua shton drojën e tyre.

Lartësia e zërit gjatë Lutjeve të Kontaktit (Salat)

[110] Thuaj, “Thërrisnie Zot, ose thërrisnie Mirëbërësi; cilindo emër që përdorni, Atij i përkasin

emrat më të mirë.” Të mos i shprehni Lutjet tuaja të Kontaktit (Salat) me zë shumë të lartë, as pa zë; përdorni zë mesatar.

[111] Dhe shpall: “I lartmadhëruar qoftë Zoti, që kurrë nuk ka lindur djalë, e as nuk ka Ai ndonjë ortak në mbretërimin e Tij, as nuk ka nevojë për ndonjë aleat për shkak të dobësisë,” dhe lartësoje Atë vazhdimisht.

Surja 18: Shpella (El-Kehf)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Lavdi Zotit, që shpalli te shërbëtori i Tij këtë shkrim, dhe e bëri të patëmetë.

[2] (Shkrim) i përkryer për të paralajmëruar ndëshkim të rëndë nga Ai, dhe për të çuar lajm të mirë te besimtarët që çojnë jetë të drejtë, që ata kanë fituar shpërblim bujar.

[3] Ku qëndrojnë përgjithmonë.

[4] Dhe për t'i paralajmëruar ata që thanë, “Zoti ka lindur djalë!”

[5] Ata nuk kanë njohuri për këtë, e as prindërit e tyre. Çfarë blasfemie po del nga gojët e tyre! Çka ata shprehin është gënjeshtër e tepërt.

[6] Mund ta fajësosh veten në llogari të reagimit të tyre ndaj këtij kallëzimi, dhe mosbesimit të tyre në të; mund të pikëllosh.

Fundi i botës

[7] Kemi zbukuruar çdo gjë në tokë, në mënyrë që t'i testojmë ata, dhe kështu t'i shquajmë ata mes tyre që punojnë drejtësi.

[8] Patjetër, do të fshijmë çdo gjë në të, duke e lënë atë krejtësisht shterp.*

Banuesit e shpellës

[9] Çka po ta merr mendja, pse tjetër po të tregojmë për njerëzit e shpellës, dhe numrat e ndërldhur me ta? Ata janë mes shenjave tona të mahnitshme.

[10] Kur të rinjtë u strehuan në shpellë, thanë, “Zotëruesi ynë, derdh mbi ne mëshirën Tënde, dhe na beko çështjet tona me udhëzimin Tënd.”

[11] Ne pastaj ua mbyllëm veshët në shpellë për një numër të paracaktuar vitesh.

[12] Pastaj i ringjallëm për të parë cila nga dy palët mund të numërojë kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre aty.

[13] Të tregojmë ty historinë e tyre, singërisht. Ata ishin të rinj që besuan në Zotëruesin e tyre, dhe ne ua shtuam udhëzimin e tyre.

[14] Ua përforcuam zemrat e tyre kur ata u ngritën dhe thanë: “Zotëruesi ynë i vetëm është Zotëruesi i qiejve dhe tokës. Ne nuk do të adhurojmë asnjë zot tjetër për krahas Tij. Përndryshe, do të ishim larg në humbje.

[15] "Ja ku janë njerëzit tanë duke ngritur zota për krahas Tij. Sikur të mund të furnizonin ata ndonjë provë për të mbështetur qëndrimin e tyre! Kush është më i keq se dikush që trillon rrena dhe ia mveshë ato Zotit?

*Shtatë gjumashët e Efesit**

* 18:8-9 Siç del, historia e këtyre besimtarëve të Krishterë, Shtatë Gjumashëve të Efesit, është drejtpërdrejt e lidhur me fundin e botës siç thuhet në 18:9 & 21. Roli i këtyre besimtarëve në zbulimin e fundit të botës është i detajuar në Shtojcën 25.

* 18:16-20 Efesi gjendet rreth 300 km në jug të Nicës antike, dhe rreth 50 km në jug të Izmirit të sotëm në Turqi. Banuesit e shpellës ishin të Krishterë të ri që donin të ndjekin mësimet e Jezusit, dhe të adhuronin vetëm Zotin. Ata ishin duke i ikur keqtrajtimit të neo-krishterëve që shpallën një Krishterim të korruptuar tre shekuj pas Jezusit, në

[16] "Pasi që dëshironi t'iu shmangeni atyre, dhe adhurimit të tyre të tjetër pos Zotit, le të strehohemi në shpellë. Le të derdhë mbi ju Zotëruesi juaj mëshirën e Tij dhe t'ju drejtojë në vendimin e drejtë."

Një mësues udhëzues është parakusht

[17] Mund ta shihje diellin kur lindi duke ardhur nga ana e djathtë e shpellës së tyre, dhe kur perëndoi, ndriçoi mbi ta nga e majta, përderisa ata fjetën në zgavër aty. Kjo është njëra prej shenjave të Zotit.* Këdo që Zoti e udhëzon është vërtetë i udhëzuar, dhe këdo që Ai e dërgon në humbje, nuk do të gjesh për të asnjë mësues udhëzues.

[18] Do të mendoje që ishin të zgjuar, kur në fakt ishin në gjumë. I kthjem në anën e djathtë dhe në anën e majtë, përderisa qeni i tyre i zgjati para këmbët e tij mes tyre. Po t'i shihje ata, do të kishe ikur prej tyre, i goditur me llahtari.

[19] Kur i ringjallëm ata, e pyetën njëri tjetrin, "Sa gjatë keni qenë këtu?" "Kemi qenë këtu një ditë ose një pjesë të ditës," ata u përgjigjën. "Zotëruesi juaj e di më së miri sa gjatë kemi qëndruar këtu, pra le të dërgojmë njërin prej nesh me këto monedha në qytet. Le të gjejë ushqimin më të pastër, dhe të blejë pak për ne. Le të ketë kujdes të mos vërehet shumë, dhe të mos tërheqë vëmendjen e të tjerëve.

[20] "Nëse ju zbulojnë, do t'ju gurëzojnë për vdekje, ose t'ju detyrojnë të ktheheni prapa në fenë e tyre, atëherë nuk mund t'ia dilni."

*Lidhja me fundin e botës**

[21] I bëmë të zbulohen, për t'ia bërë me dije të gjithëve që premtimi i Zotit është i vërtetë, dhe për të hequr krejt dyshimin në lidhje me fundin e botës. Njerëzit pastaj u grindën mes vete sa i përket atyre. Disa thanë, "Le të ndërtojmë një ndërtesë rreth tyre." Zotëruesi i tyre është njohësi më i mirë i tyre. Ata që mbizotëruan thanë, "Do të ndërtojmë një vend adhurimi rreth tyre."

[22] Disa do të thoshin, "Ata ishin tre; i katërti qeni i tyre," përderisa të tjerë do të thoshin, "Pesë; i gjashti qeni i tyre," përderisa supozonin. Të tjerë thanë, "Shtatë," dhe i teti ishte qeni i tyre. Thuaj, "Zotëruesi im di më së miri për numrin e tyre." Vetëm një pakicë e diti numrin e saktë. Prandaj, mos u shty me ta; bëua rrafsh. Nuk ke nevojë të konsultosh askënd për këtë.

Përkujtojmë zotin në çdo rast që na jepet

[23] Të mos thuash që do të bësh diçka në të ardhmen,

[24] pa thënë, "dashtë Zoti."* Nëse harron të bësh këtë, duhet menjëherë të përkujtosh Zotëruesin tënd dhe të thuash, "Më udhëzoftë Zotëruesi im të bëj më mirë herën e ardhshme."

300 + 9.

[25] Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vite, plus nëntë.*

[26] Thuaj, "Zoti është njohësi më i mirë se sa gjatë qëndruan ata atje." Ai i di të gjitha fshehtësitë në qiej dhe tokë. Nga hirësia e Tij mund të shihni; nga hirësia e Tij mund të dëgjoni. Nuk ka asnjë përkrah Tij si Zotëruesi dhe Sundues, dhe Ai kurrë nuk lejon asnjë ortak të ketë hise në mbretërimin

pasim të Konferencave të Nicës, kur doktrina e Trinisë u shpall. Në vitin 1928, Franz Miltner, një arkeolog Austrian zbuloi varrin e shtatë gjumashëve të Efesit. Historia e tyre është mirë e dokumentuar në disa enciklopedi.

* 18:17 Kjo shenjë, aluzion, na tregon që shpella ishte e drejtuar kah veriu.

* 18:21 Siç detajohet në Shtojcën 25, ky tregim ndihmoi në gjetjen e fundit të botës.

* 18:24 Ky urdhër i rëndësishëm na jep mundësi ditore për ta përkujtuar Zotin.

* 18:25 Ndryshimi në mes të 300 viteve diellore dhe 300 viteve hënore është nëntë vjet. Kështu, zbulimi i fundit të botës ishte paracaktuar nga i Plotfuqishmi të ndodhte në vitin 1980 Pas Lindjes së Krishtit (1400 Pas Hixhrës), 300 vite (309 vite hënore) para fundit të botës (shih 72:27 dhe Shtojcën 25).

e Tij.

[27] Të recitosh çka të është shpallur nga shkrimi i Zotëruesit tënd. Asgjë të mos i shfuqizojë fjalët e Tij, dhe të mos gjeni asnjë burim tjetër përkrah tij.

Grupet e mësimimit të Kuranit

[28] Ta shtysh veten të jesh me ata që adhurojnë Zotëruesin e tyre ditë e natë, duke e kërkuar vetëm Atë. Mos i kthe sytë larg prej tyre, duke kërkuar kotësitë e kësaj bote. As të mos i bindesh dikujt zemrën e të cilit e bëmë të pavëmendshme ndaj lajmit tonë; dikujt që ndjek dëshirat e veta, dhe prioritetet e të cilit janë të pështjelluara.

Liri absolute e fesë

[29] Shpall: "Kjo është e vërteta nga Zotëruesi juaj," dhe kush do le të besojë, dhe kush do le të mos besojë. Kemi përgatitur për shkelësit zjarr që krejtësisht do i mbështjellë ata. Kur ata bërtasin për ndihmë, do iu jepet lëng si acid i përqendruar që i djeg fytyrat. Çfarë pije e tmerrshme! Çfarë fati i tmerrshëm!

[30] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ne nuk ngelim së shpërblyeri ata që punojnë drejtësi.

[31] Ata kanë merituar kopshte Edeni ku rrjedhin lumenj. Ata do të zbukurohen aty me byzylykë ari, dhe do të veshin rroba mëndafshi dhe kadifeje të gjelbra, dhe do të çlirohen në mobilie të rehatshme. Çfarë shpërblimi i mrekullueshëm; çfarë banese e mrekullueshme!

*Prona si idhull**

[32] Përmend për ta shembullin e dy burrave: i dhamë njërit prej tyre dy kopshte hardhish, të rrethuara me palma hurmash, dhe vumë të mbjella të tjera ndërmjet tyre.

[33] Të dy kopshtet i prodhuan frutat e tyre me kohë, dhe me bollëk, se ne e bëmë një lum që të rrjedhë përmes tyre.

[34] Një herë, pas të vjelave, ai me mburrje i tha shokut të tij: "Unë jam shumë më përparimtar se ti, dhe zotëroj më shumë respekt nga njerëzit."

[35] Kur ai hyri në kopshtin e vet, i bëri keq vetes duke thënë, "Nuk mendoj se do të përfundojë kjo ndonjëherë."

[36] "Aq më shumë, mendoj që s'ka tjetër; Nuk mendoj që Orës (Përjetësisë) do i vij koha ndonjëherë. Edhe nëse kthehem te Zotëruesi im, do të (jem mjaft i zgjuar që të) kem një edhe më të mirë atje."

[37] Shoku i tij i tha, përderisa diskutoi me të, "A nuk ke besuar në Atë që të krijoi nga dheu, pastaj nga një pikël, pastaj të përkreu në një burrë?"

[38] "Sa për mua, Zoti është Zotëruesi im, dhe unë nuk do të ngritë asnjë zot përveç Zotëruesit tim."

Urdhër i rëndësishëm

[39] "Kur hyre në kopshtin tënd, është dashur të kesh thënë, 'Kjo është çka Zoti më ka dhënë (Ma Sha Allah). Askush nuk ka fuqi përveç Zotit (La Kuvete Ila Billah).' Ti mund të shohësh që unë kam më pak para dhe më pak fëmijë se ti."

[40] "Zotëruesi im mund të më japë më mirë se kopshti yt. Ai mund të dërgojë një stuhi të fortë nga qielli që e fshinë kopshtin tënd, duke e lënë krejtësisht shterpë."

[41] "Ose, uji i tij mund të fundoset më thellë, larg nga arritja jote."

* 18:32-42 Kurani përmendë shumë shembuj të zotave të ndryshëm që njerëzit i adhurojnë përkrah Zotit; ato përfshijnë fëmijët (7:190), udhëheqësit dhe shkollarët fetarë (9:31), pronën (18:42), të shenjtit dhe profetët e vdekur (16:20-21, 35:14 & 46:5-6), dhe unin (25:43, 45:23).

[42] Vërtetë, të mbjellat e tij u fshinë, dhe ai përfundoi me brejtje ndërgjegjeje, duke u qarë për çka kishte shpenzuar për të së koti, përderisa prona e tij shtrihej shterpë. Ai më në fund tha, “Ah sikur të mos e kisha ngritur pronën time si zot përkrah Zotëruesit tim.”

[43] Asnjë forcë në tokë nuk do të kishte mundur ta ndihmojë atë kundër Zotit, as nuk ishte e mundur për të që të pranojë ndonjë ndihmë.

[44] Kjo është për shkak se i vetmi Zotërues dhe sundues i vërtetë është Zoti; Ai furnizon shpërblimin më të mirë, dhe me Të është përfundimi më i mirë.

[45] Përmend për ta shembullin e kësaj jete si ujë që e zbresim nga qielli për të prodhuar bimët e tokës, pastaj ato shndërrohen në kashtë që bahet nga era. Zoti është i zoti t'i bëjë të gjitha gjërat.

Rirregullimi i prioriteteve tona

[46] Paratë dhe fëmijët janë gëzimet e kësaj jete, por punët e drejta furnizojnë shpërblim të përjetshëm nga Zotëruesi yt, dhe shpresë shumë më të mirë.

[47] Do të vij dita kur i fshijmë malet, dhe do të shohësh tokën shterpë. Do i mbledhim të gjithë ata, duke mos lënë asnjë prej tyre.

[48] Ata do të paraqiten para Zotëruesit tënd rresht. Keni ardhur te ne si individ, ashtu si ju krijuam në fillim. Në të vërtetë, kjo është çka ju pretenduat që nuk do të ndodhë kurrë.

[49] Regjistri do të paraqitet, dhe do i shohësh fajtorët të frikësuar nga përmbajtjet e tij. Ata do të thonë, “Mjerë ne. Si është e mundur që ky libër nuk lë asgjë, as të vogël as të madhe, pa e numëruar?” Ata do të gjejnë çdo gjë që e kishin bërë të sjellë përpara. Zotëruesi yt nuk është kurrë i padrejtë ndaj askujt.

Klasifikimi i krijesave të Zotit

[50] Iu thamë engjëjve, “Bini në përlulje para Ademit.” Ata ranë në përlulje, përveç Dreqit. Ai u bë xhin, se nuk iu bind porosisë së Zotëruesit të Tij.* A do të zgjedhni atë dhe pasardhësit e tij si zotërues në vend të Meje, edhe pse ata janë armiq të tuaj? Çfarë zëvendësimi i tmerrshëm!

[51] Nuk i lejova që të jenë dëshmitarë të krijimit të qiejve dhe tokës, as të krijimit të vetë atyre. As nuk i lejoj shpirtligjtë të punojnë në mbretërinë Time.*

[52] Do të vij dita kur Ai thotë, “Thirrni ortakët e Mi, të cilët pretenduat të jenë zota përkrah Meje,” ata do i thërrasin ata, por nuk do iu përgjigjen. Një barrierë e pakalueshme do i ndajë ata nga njëri tjetri.

[53] Fajtorët do të shohin Ferrin, dhe do e kuptojnë që do të bien në të. Ata nuk do të kenë asnjë shpëtim nga aty.

Mosbesimtarët refuzojnë të pranojnë plotësinë e Kuranit

[54] Kemi përmendur në këtë Kuran çdo lloj shembulli, por qenia njerëzore është krijesa më grindavece.

[55] Asgjë nuk i parandaloi njerëzit nga besimi, kur udhëzimi iu erdhi atyre, dhe nga kërkimi i faljes së Zotëruesit të tyre, përveç që ata kërkuan të shohin të njëjtin (lloj të mrekullive) si gjeneratat paraprake, ose sfiduan të shohin ndëshkimin para tyre.

[56] Ne vetëm i dërgojmë të dërguarit thjeshtë si bartës të lajmeve të mira, si dhe si paralajmërues. Ata që nuk besojnë argumentojnë me shpifje për ta mposhtur të vërtetën, dhe i marrin provat dhe

* 18:50 Kur grindja e madhe në shoqërinë qiellore ndodhi (38:69), të gjitha krijesat u klasifikuan në engjëj, xhin, dhe njerëz (Shtojca 7).

* 18:51 Zoti e dinte që Dreqi dhe përkrahësit e tij (xhinët dhe njerëzit) do të merrnin vendimin e gabuar. Prandaj ndodhi përjashtimi i tyre nga të qenit dëshmitarë të procesit të krijimit.

paralajmërimet e Mia si të kota.

Ndërhyrje Hyjnore

[57] Kush janë më të këqij se ata që iu kujtohen provat e Zotëruesit të tyre, pastaj i shpërfillin, pa e kuptuar çka janë duke bërë. Si pasojë, ne vëmë mburoja mbi zemrat e tyre për t'i parandaluar nga të kuptuarit (e Kuranit), dhe shurdhim në veshët e tyre. Pra, pa marrë parasysh çka ti bën për t'i udhëzuar ata, kurrë asnjëherë nuk udhëzohen.

[58] Prapëseprapë, Zotëruesi yt është Falës, plot mëshirë. Po t'i thërriste Ai ata në llogaridhënie për punët e tyre, Ai do i asgjësonte ata mu aty dhe atëherë. Por, Ai iu jep atyre një afat deri në një kohë specifike të paracaktuar; pastaj ata nuk mund të ikin.

[59] Mori shoqëri i kemi asgjësuar për shkak të shkeljeve të tyre; kemi caktuar kohë specifike për asgjësimin e tyre.

Mësime të vlefshme prej Moisiut dhe mësuesit të tij

[60] Moisiu i tha shërbëtorit të tij, "Nuk do të pushoj derisa të arrij në vendin ku dy lumenjtë takohen, pa marrë parasysh sa do të zgjasë."

[61] Kur ata arritën te vendi ku ata u takuan, ata harruan peshkun e tyre, dhe ai e gjeti rrugën prapa për te lumi, tinëzisht.

[62] Kur ata e kaluan atë vend, ai i tha shërbëtorit të tij, "Le të hamë drekë. I gjithë ky rrugëtim na ka rraskapitur."

[63] Ai tha, "A të kujtohet kur u ulëm pranë shkëmbit atje? Nuk i kushtova vëmendje peshkut. Ishte djalli që më bëri të harroj, dhe e gjeti rrugën prapa për në lum, çuditërisht."

[64] (Moisiu) tha, "Ai ishte vendi që po e kërkonim." Ata u kthyen nëpër hapa të vet.

[65] Ata gjetën një nga shërbëtorët tanë, të cilin e bekuam me mëshirë, dhe dhuruam mbi të nga vetë dituria jonë.

[66] Moisiu i tha atij, "A mund të vij pas teje, që të më mësosh pak nga dituria dhe udhëzimi që të është dhënë ty?"

[67] Ai tha, "Nuk mund të kesh durim me mua.

[68] "Si mund të durosh për diçka që nuk di?"

[69] Ai tha, "Do të më gjesh, dashtë Zoti, të durueshëm. Nuk do të kundërshtoj asnjë urdhër që më jep ti."

[70] Ai tha, "Nëse më ndjek mua, atëherë të mos më pyesësh për asgjë, në mos zgjedhsha unë të të tregoj për atë."

[71] Kështu ata të dy shkuan. Kur hipën në një anije, ai bëri një birë në të. Ai tha, "A bëre birë për t'i mbytur njerëzit e saj? Ke bërë diçka të tmerrshme."

[72] Ai tha, "A nuk thash që nuk mund të kesh durim të jesh me mua?"

[73] Ai tha, "Pahiri. Mos më dëno se harrova; mos ji shumë i rreptë me mua."

[74] Kështu vazhduan rrugën. Kur takuan një djalë të ri, e vrau. Tha, "Pse e vrave një njeri aq të pafajshëm, që nuk ka vrarë askënd? Ke bërë diçka të urreyer."

[75] Ai tha, A nuk të thash që nuk mund të kesh durim të jesh me mua?"

[76] Ai tha, "Nëse të pyes për diçka tjetër, atëherë mos më mbajë me ty. Ke parë mjaftë arsyetime nga unë."

[77] Kështu ata vazhduan rrugën. Kur arritën në një shoqëri të caktuar, ata kërkuan ushqim nga njerëzit, por ata refuzuan të jenë mikpritës. Pas pak, ata gjetën një mur gati duke u rrëzuar, dhe ai e ndreqi atë. Ai tha, "Ti ke mundur të kërkosh pagë për atë!"

Ka arsye të mirë për gjithçka

[78] Ai tha, "Tash na duhet të ndahemi. Por unë do të shpjegoj ty çdo gjë për të cilën nuk pate durim.

[79] "Sa për anijen, ishte e peshkatarëve të varfër, dhe dëshirova ta bëj të dëmtuar. Ishte një mbret që po vinte pas tyre, që po e konfiskonte çdo anije, me forcë.

[80] "Sa për djalin, prindërit e tij ishin besimtarë të mirë, dhe e pamë që ai do i rëndonte ata me shkeljen dhe mosbesimin e tij.*

[81] "Deshëm që Zotëruesi yt të zëvendësojë në vend të tij një djalë tjetër; një që është më i mirë në drejtësi dhe dashamirësi.

[82] "Sa për murin, ishte i dy jetimëve në qytet. Nën të, ishte një thesar që iu takonte atyre. Për shkak se babai i tyre ishte njeri i drejtë, Zotëruesi yt deshë që ata të rriten dhe të arrijnë forcë të plotë, pastaj ta nxjerrin thesarin e tyre. E tillë është mëshira prej Zotëruesit tënd. Nuk e bëra asnjërin prej tyre nga vullneti im. Ky është shpjegimi i gjërave për të cilat nuk pate durim."

Dhul-Kernejni: Ai me dy brirët ose dy gjeneratat

[83] Të pyesin për Dhul-Kernejin. Thuaj, "Do t'ju kallëzoj ca nga historia e tij."

[84] I dhamë atij autoritet në tokë, dhe e furnizua atë me lloj lloj mjetesh.

[85] Pastaj, ai e ndoqi një rrugë.

[86] Kur arriti perëndimin e largët, e gjeti diellin duke perënduar në një oqean të gjerë, dhe gjeti njerëz atje. Ne thamë, "O Dhul-Kernejn, mund të sundosh si të duash; ose ndëshko, ose ji i sjellshëm me ta."

[87] Ai tha, "Sa për ata që shkelin, do i ndëshkojmë; pastaj, kur kthehen te Zotëruesi i tyre, Ai do i parashtrorë në më shumë ndëshkim.

[88] "Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ata pranojnë shpërblim të mirë; do i trajtojmë mirë."

[89] Pastaj ai ndoqi një rrugë tjetër.

[90] Kur arriti në lindjen e largët, ai e gjeti diellin duke lindur në njerëz që nuk kishin asgjë për t'i strehuar prej tij.

[91] Natyrisht që ne ishim tërësisht të vetëdijshëm për çdo gjë që ai gjeti.

[92] Ai pastaj ndoqi një rrugë tjetër.

[93] Kur ai arriti në luginën ndërmjet dy vargmaleve, ai gjeti njerëz gjuha e të cilëve ishte mezi e kuptueshme.

*Gogu dhe Magogu**

[94] Ata thanë, "O Dhul-Kernejn, Gogu dhe Magogu janë korruptues të tokës. A mund të të paguajmë që të krijosh një barrierë ndërmjet neve dhe atyre?"

[95] Ai tha, "Zotëruesi im më ka dhënë dhurata të mëdha. Nëse bashkëpunoni me mua, do të ndërtoj një pendë ndërmjet juve dhe atyre.

[96] "Më sillni masa hekuri." Kur ai e mbushi hapësirën ndërmjet dy vargmaleve, ai tha, "Fryni." Kur

* 18:80 Adolf Hitleri ishte një fëmijë tërheqës dhe në dukje i pafajshëm. Sikur të vdiste si fëmijë, shumë do të ishin vrerosur, dhe shumë do të kishin parashtruar në pyetje mençurinë e Zotit. Mësojmë nga këto mësimë të thella që ka arsye të mirë pas çdo gjëje.

* 18:94-98 Njëra prej detyrave të të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes ishte që të thotë që Gogu dhe Magogu, shenja e fundit para fundit të botës, do të rishfaqet në vitin 2270 Pas Lindjes së Krishtit (1700 Pas Hixhrës), vetëm 10 vjet para fundit. Vini re që Gogu dhe Magogu ndodhin në Suret 18 dhe 21, saktësisht 17 strofa para fundit të secilës sure, duke përfaqësuar 17 shekuj hënor (shih 72:27 dhe Shtojcën 25).

u skuq nga nxehti, ai tha, "Më ndihmoni të derdhë tunxh mbi të."

[97] Pra, ata nuk mund të ngjiteshin në të, e as të bënin bira në të.

[98] Ai tha, "Kjo është mëshirë nga Zotëruesi im. Kur t'i vij koha profecisë së Zotëruesit tim, Ai do e bëjë pendën të rrënohet. Profecia e Zotëruesit tim është e vërtetë."

[99] Në atë kohë, do i lëmë ata ta pushtojnë njëri tjetrin, pastaj do i bihet bririt, dhe do i mbledhim ata të gjithë së bashku.

[100] Do t'ua paraqesim Ferrin, në atë ditë, mosbesimtarëve.

[101] Ata janë ata sytë e të cilëve ishin tepër të mbuluar për të parë lajmin Tim. As nuk mund të dëgjonin.

[102] A mendojnë ata që nuk besojnë se mund të shpëtojnë me ngritjen e shërbëtorëve të Mi si zota përkrah Meje? Kemi përgatitur për mosbesimtarët Ferr si vendbanim të përhershëm.

Këqyrne veten

[103] Thuaj, "A t'ju tregoj kush janë humbësit më të këqij?"

[104] "Ata janë ata punët e të cilëve në këtë jetë janë krejtësisht të humbura, por ata mendojnë se po bëjnë mirë."

[105] Të tillë janë ata që nuk besuan në shpalljet e Zotëruesit të tyre dhe në takimin me Të. Prandaj, punët e tyre janë të kota; në Ditën e Ringjalljes, ata nuk kanë peshë.

[106] Pagesa e tyre e drejtë është Ferr, si kompensim për mosbesimin e tyre, dhe për që i tallën shpalljet e Mia dhe të dërguarit e Mi.

[107] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ata kanë merituar Parajsë të hareshme si banesë të tyre.

[108] Përgjithmonë banojnë aty; ata kurrë nuk do të dëshirojnë ndonjë zëvendësim tjetër.

Kurani: Krejt çka na duhet

[109] Thuaj, "Sikur të ishte oqeani ngjyrë për fjalët e Zotëruesit tim, oqeani do të harxhohej, para se fjalët e Zotëruesit tim të harxhoheshin, edhe nëse e dyfishojmë furnizimin e ngjyrës."

[110] Thuaj, "Unë nuk jam asgjë më shumë se një njeri si ju, që është frymëzuar që zoti juaj është një zot. Ata që shpresojnë ta takojnë Zotëruesin e tyre të punojnë drejtësi, dhe kurrë të mos adhurojnë asnjë tjetër zot përkrah Zotëruesit të tij."

Surja 19: Maria (Merjem)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Q. H. J. `A. S.* (Qaf Ha Ja `Ajn Sad)

Zekeria

[2] Kallëzim në lidhje me mëshirën e Zotëruesit tënd ndaj shërbëtorit të Tij Zekerias.

[3] Ai e thirri Zotëruesin e tij, thirrje të fshehtë.

[4] Ai tha, "Zotëruesi im, eshtrat më janë bërë të brishta në trupin tim, dhe flokët e mia flakërojnë me thinja. Përderisa të lutem Ty, Zotëruesi im, unë nuk i humbë shpresat.

[5] "Po merakosem për të mvarurit pas meje, dhe gruaja ime ka qenë sterile. Më dhuro, nga Ti, një trashëgues.

* 19:1 Ky është numri më i madh i Inicialeve Kuranore, sepse kjo sure merret me çështje aq kritike si lindja e mrekullueshme e Gjonit dhe lindja e Jezusit nga virgjëresha, dhe kundërshton fort blasfeminë e tepërt që e konsideron Jezusin të jetë i bir i Zotit. Pesë inicialet furnizojnë evidencë të fuqishme materiale për të mbështetur këto çështje. (Shih Shtojcat 1 & 22).

- [6] "Le të jetë ai trashëgues i imi dhe trashëgues i fisit të Jakobit, dhe bëje atë, Zotëruesi im, të mirëpritur."
- [7] "O Zekeria, të japim lajm të mirë; një djalë emri i të cilit të jetë Gjon (Jahja). Nuk krijuam askënd si ai më parë."
- [8] Ai tha, "Zotëruesi im, a do të kem djalë përkundër sterilitetit të gruas sime, dhe përkundër moshës time të vjetër?"
- [9] Ai tha, "Kështu tha Zotëruesi yt: 'Është lehtë për Mua që ta bëj. Unë të krijova ty para kësaj, dhe ti nuk ishe asgjë.'"
- [10] Ai tha, "Zotëruesi im, më jep një shenjë." Ai tha, "Shenja jote është se nuk do iu flasësh njerëzve për tre net rresht."
- [11] Ai doli te familja e tij, nga faltorja, dhe ua bëri me shenjë: "Meditoni (në Zotin) ditë e natë."
- [12] "O Gjon, t'i përmbahesh shkrimit, fort." E pajisëm atë me mençuri, madje edhe në rininë e tij.
- [13] Dhe (e pajisëm atë me) dashamirësi prej nesh dhe pastërti, se ai ishte i drejtë.
- [14] Ai i nderoi prindërit e tij, dhe nuk ishte tiran i pabindur.
- [15] Paqe qoftë mbi të ditën që u lind, ditën që ai vdes, dhe ditën që ringjallet prapë në jetë.

Maria

- [16] Përmende në shkrim Marinë. Ajo e izoloi veten nga familja e saj, në një vend lindor.
- [17] Përderisa një barrierë e ndau atë nga ata, dërguam te ajo Frymën tonë. Ai shkoi te ajo në formë genieje njerëzore.
- [18] Ajo tha, "Kërkoj strehim te Mirëbërësi, që të mund të jesh i drejtë."
- [19] Ai tha, "Unë jam i dërguari i Zotëruesit tënd, për të të dhuruar ty një djalë të dëlirë."
- [20] Ajo tha, "Si mund të kem djalë, kur asnjë burrë nuk më ka prekur; nuk kam qenë e padëlirë."
- [21] Ai tha, "Kështu tha Zotëruesi yt, 'Është lehtë për Mua. Do e bëjmë atë një shenjë për njerëzit, dhe mëshirë prej nesh. Kjo është çështje e paracaktuar.'"

Lindja e Jezusit

- [22] Kur ajo u ngarkua me të, e izoloi veten në një vend të largët.
- [23] Procesi i lindjes erdhi te ajo pranë një trungu të një palme. Ajo tha, "(Sa e turpëruar jam;) Ah sikur të isha e vdekur para se të ndodhte kjo, dhe të isha harruar krejt."
- [24] (Foshnja) e thirri atë nga poshtë saj, duke thënë, "Mos u pikëllo. Zotëruesi yt të ka furnizuar me një burim.
- [25] "Nëse e shkund trungun e kësaj palme; do të bien hurme të pjekura për ty.*
- [26] "Ha dhe pi, dhe ji e lumtur. Kur e sheh ndokënd, thuaj, 'Kam bërë zotim heshtjeje; Nuk flas sot me askënd.'"
- [27] Ajo erdhi te familja e saj, duke e bartur atë. Ata thanë, "O Mari, ti ke bërë diçka që është plotësisht e papritur.
- [28] "O pasardhëse e Aronit, babai yt nuk ishte njeri i keq, e as nuk ishte nëna jote e padëlirë."

Foshnja flet

- [29] Ajo bëri me gisht kah ai. Ata thanë, "Si mund të flasim me një foshnje në grazhd?"
- [30] (Foshnja foli dhe) tha, "Unë jam shërbëtor i Zotit. Ai më ka dhënë mua shkrimin, dhe më ka emëruar profet.
- [31] "Ai më bëri të bekuar kudo që unë shkoj, dhe më urdhëroi t'i zbatoj Lutjet e Kontaktit (Salat)

* 19:25 Pra, Jezusi u lind kah fundi i Shtatorit ose fillimi i Tetorit. Kjo është koha kur piqen hurmat në Lindjen e Mesme deri në pikën për të rënë nga pema.

dhe bamirësinë e obligueshme (Zeqat) për sa të jem gjallë.

[32] "Kam për ta nderuar nënën time, Ai nuk më bëri kryengritës të pabindur.

[33] Dhe paqe qoftë mbi mua ditën që u linda, ditën që unë vdes, dhe ditën që ringjallem."

E vërteta e vërtetuar

[34] Ai ishte Jezusi, i biri i Marisë, dhe kjo është e vërteta për këtë çështje, për të cilën vazhdojnë të kenë dyshime.

[35] Nuk i ka hije Zotit që Ai të lindë djalë, i madhëruar qoftë Ai. Për të pasur çfarëdo të kryer, Ai thjeshtë i thotë, "Ji," dhe është.

[36] Ai gjithashtu tha, "Zoti është Zotëruesi im dhe Zotëruesi juaj; ta adhuroni vetëm Atë. Kjo është rruga e drejtë."*

[37] Palët e ndryshme u grindën mes vete (sa i përket identitetit të Jezusit). Prandaj mjerë ata që nuk besojnë nga pamja e një dite të tmerrshme.

[38] Prit derisa t'i dëgjosh dhe shohësh kur ata vijjnë përballë nesh. Shkelësit në atë ditë do të jenë plotësisht të humbur.

[39] Paralajmëroi ata për ditën e brejtjes së ndërgjegjes, kur gjykimi do të lëshohet. Ata janë plotësisht të pavëmendshëm; nuk besojnë.

[40] Ne jemi ata që e trashëgojmë tokën dhe të gjithë në të; te ne të gjithë do të kthehen.

Ibrahimi

[41] Përmend në shkrim Ibrahimin; ai ishte i shenjtë, profet.

[42] Ai i tha babait të tij, "O babai im, pse adhuron çka as nuk mund të dëgjojë, as të shohë, as të të ndihmojë në asnjë mënyrë?"

[43] "O babai im, kam pranuar njohuri të caktuar që ti nuk ke pranuar. Më ndiq, dhe do të të udhëzoj në rrugë të drejtë.

[44] "O babai im, mos e adhuro djallin. Djalli është kryengritës kundër Mirëbërësit.

[45] "O babai im, kam frikë se mos ti vetëshkakton ndëshkim nga Mirëbërësi, dhe bëhesh aleat i djallit."

[46] Ai tha, "A ke hequr dorë nga zotat e mi, o Ibrahim? Në mos u ndalsh, do të gurëzoj. Më lër rehat."

[47] Ai tha, "Paqe qoftë mbi ty. Do i lutem Zotëruetit tim të të falë ty; Ai ka qenë Më i Dashuri për mua.

[48] "Unë do t'ju braktisë juve dhe zotat që i adhuroni përkrah Zotit. Unë do të adhuroj vetëm Zotëruetin tim. Duke e adhuro vetëm Zotëruetin tim, unë nuk mund të gaboj."

[49] Për shkak se ai i braktisi ata dhe zotat që ata adhuruan përkrah Zotit, i dhuroam atij Isakun dhe Jakobin, dhe e bëmë secilin prej tyre profet.

[50] Derdhëm mbi ta mëshirën tonë, dhe i dhuroam atyre një pozitë të nderuar në histori.

Moisiu

[51] Përmend në shkrim Moisiun. Ai ishte i devotshëm, dhe ishte i dërguar profet.

[52] E thirrëm atë nga ana e djathtë e Malit Sinai. E sollëm atë afër, që të diskutojmë me të.

[53] Dhe i dhamë atij, nga mëshira jonë, vëllanë e tij Aronin si profet.

[54] Dhe përmend në shkrim Ismailin. Ai ishte i sinqertë kur jepte premtim, dhe ai ishte i dërguar profet.

[55] Ai e urdhëronte familjen e vet t'i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe bamirësinë e

* 19:36 Ky është i ngjashëm me pohimin që thuhet nga Jezusi në Ungjillin e Gjonit 20:17.

obligueshme (Zeqat); ai ishte i mirëpritur te Zotëruesi i tij.

[56] Dhe përmend në shkrim Idrizin. Ai ishte i shenjtë, profet.

[57] E ngritëm në shkallë të nderuar.

[58] Këta janë disa nga profetët të cilët i bekoji Zoti. Ata u zgjodhën nga mes pasardhësve të Ademit, dhe pasardhësve të atyre që i bartëm me Nuhun, dhe pasardhësve të Ibrahimit dhe Izraelit, dhe nga mes atyre të cilët i udhëzuam dhe zgjodhëm. Kur shpalljet e Mirëbërësit iu recitohen atyre, bien në përlulje, duke qarë.

Humbja e Lutjeve të Kontaktit (Salat)

[59] Pas tyre, Ai zëvendësoi gjenerata që humbën Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe ndoqën epshtet e tyre. Ata do të vuajnë pasojat.

[60] Vetëm ata që pendohen, besojnë, dhe çojnë jetë të drejtë do të hynë në Parajsë, pa as më të voglën padrejtësi.

[61] Kopshtet e Edenit i presin ata, siç është premtuar nga Mirëbërësi për ata që e adhurojnë Atë, edhe kur janë vetë. Padyshim, premtimit të Tij do i vij koha patjetër.

[62] Ata nuk do të dëgjojnë asnjë gjepur aty; vetëm paqe. Ata pranojnë furnizimet e tyre aty, ditë e natë.

[63] E tillë është Parajsa; ia dhurojmë atyre mes shërbëtorëve tanë që janë të drejtë.

[64] Ne nuk zbresim përveç me urdhër të Zotëruesit tënd. Atij i takon e kaluara jonë, e ardhmja jonë, dhe çdo gjë ndërmjet tyre. Zotëruesi yt nuk është harraq.

[65] Zotëruesi i qiejve dhe tokës, dhe çdo gjë ndërmjet tyre; ta adhuroni Atë dhe duroni me këmbëngulje në adhurimin e Tij. A njeh ti ndonjë që është i barabartë me Të?

[66] Qenia njerëzore pyet, “Pasi që të vdes, a kthehem sërish në jetë?”

[67] A harroi qenia njerëzore që ne veç e kemi krijuar, dhe ai nuk ishte asgjë?

Paralajmërim i veçantë për udhëheqësit

[68] Pasha Zotëruesin tënd, ne padyshim do i mbledhim ata, së bashku me djajtë, dhe do i mbledhim rreth Ferrit, të poshtëruar.

[69] Pastaj do shkulim nga secili grup kundërshtarin më të flaktë të Mirëbërësit.

[70] I njohim fare mirë ata që janë më meritator për tu djegur aty.

*Secili e sheh Ferrin**

[71] Secili nga ju duhet ta shohë atë; ky është vendim i pakthyesëm i Zotëruesit tënd.

[72] Pastaj i shpëtojmë të drejtit, dhe i lëmë shkelësit në të, të poshtëruar.

Shumica

[73] Kur shpalljet tona iu recitohen atyre, qartë, ata që nuk besojnë iu thonë atyre që besojnë, “Cili prej nesh është më përparimtar? Cili prej nesh është në shumicë?”

[74] Mori gjeneratash i kemi asgjësuar para tyre; ata ishin më të fuqishëm, dhe më përparimtarë.

[75] Thuaj, “Ata që zgjedhin të shkojnë në humbje, Mirëbërësi do i çojë andej, derisa ta shohin çka u është premtuar atyre – ose ndëshkimin ose Orën. Atëherë e marrin vesh ata kush është më keq, dhe më i dobët në fuqi.”

[76] Zoti e shton udhëzimin e atyre që zgjedhin të udhëzohen. Se veprat e mira shpërblehen përjetësisht nga Zotëruesi yt, dhe sjellin fitime më të mira.

* 19:71 Siç detajohet në Shtojcën 11, ne do të ringjallemi përpara arritjes fizike të Zotit në gjithësinë tonë. Ajo do të jetë shijim i përkohshëm i Ferrit, pasi që mungesa e Zotit është Ferr. Kur të vij Zoti (89:22), të drejtit do të shpëtohen. Shih 19:72.

[77] A e ke vënë re atë që refuzoi shpalljet tona pastaj tha, “Mua do të më jepen pasuri dhe fëmijë”?!
 [78] A e ka parë të ardhmen? A ka marrë një premtim të tillë nga Mirëbërësi?
 [79] Në të vërtetë, ne do të regjistrojmë çka ai shprehë, pastaj ta parashtrojmë atë në ndëshkim që rritet vazhdimisht.
 [80] Pastaj ne e trashëgojmë çdo gjë që ai kishte, dhe ai kthehet te ne krejt vetë.
 [81] Ata adhurojnë përkrah Zotit zota tjerë që (ata mendojnë) mund të iu vinë atyre në ndihmë.

Idhujt i mohojnë adhuruesit e vet

[82] Përkundrazi, ata do të mohojnë idhujtarinë e tyre, dhe do të jenë armiq të tyre.
 [83] A nuk e sheh si i lëshojmë djajtë mbi mosbesimtarët për t’i turbulluar?
 [84] Mos ji i padurueshëm; ne po përgatisim për ta ca përgatitje.
 [85] Do të vij dita kur i mbledhim të drejtit para Mirëbërësit në një grup.
 [86] Dhe do i shtyjmë fajtorët në Ferr, për të qenë vendbanimi i tyre i përhershëm.
 [87] Askush nuk do të ketë fuqinë të ndërmjetësojë, përveç atij që shkon sipas ligjeve të Mirëbërësit.

Blasfemi e tepërt

[88] Ata thanë, “Mirëbërësi ka lindur djalë”!
 [89] Keni shprehur një blasfemi të tepërt.
 [90] Qiejt gati sa nuk shkatërrohen, toka gati sa nuk çahet, dhe malet gati sa nuk thërrmohen.
 [91] Sepse ata pretenduan që Mirëbërësi ka lindur djalë.
 [92] Nuk i ka hije Mirëbërësit që Ai të lindë djalë.
 [93] Secili në qiej dhe tokë është shërbëtor i Mirëbërësit.
 [94] Ai i ka përfshirë ata, dhe i ka numëruar një nga një.
 [95] Të gjithë ata do të vijnë para Tij në Ditën e Ringjalljes si individë.
 [96] Padyshim, ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, Mirëbërësi do të derdhë mbi ta dashuri.
 [97] Kështu e bëmë këtë (Kuran) të kthjellët në gjuhën tënde, për t’iu çuar lajme të mira të drejtëve, dhe për t’i paralajmëruar me të kundërshtarët.
 [98] Mori gjeneratash para tyre i asgjësuar; a mund ta vësh në donjë prej tyre, ose të dëgjosh prej tyre donjë zë?

Surja 20: T.H. (Ta Ha)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] T. H.*
 [2] Nuk e shpallëm Kuranin te ti, për të të shkaktuar ndonjë vështirësi.
 [3] Por për t’ua kujtuar të ndershmëve.
 [4] Shpallje nga Krijuesi i tokës dhe qiejve të lartë.
 [5] Mirëbërësi; Ai i ka të gjitha gjërat në dorë.
 [6] Të Tij janë të gjitha gjërat në qiej, dhe tokë, dhe gjithçka mes tyre, dhe gjithçka nën tokë.
 [7] Qoftë i deklarove bindjet tua (ose jo) Ai e di sekretin, dhe çka është madje edhe më e fshehur.
 [8] Zoti: nuk ka zot tjetër përveç Tij. Atij i takojnë emrat më të bukur.
 [9] A e ke vërejtur historinë e Moisiut?

* 20:1 Roli i këtyre inicialeve Kuranore si pjesë përbërëse të mrekullisë mbresëlënëse matematikore të Kuranit jepet në detaje në Shtojcën 1.

- [10] Kur e pa një zjarr, i tha familjes së vet, “Rrini këtu. Kam parë një zjarr. Ndoshta mund t’ju sjell pak nga aty, ose të gjejë pak udhëzim te zjarri.”
- [11] Kur ai erdhi te ai, u thirr, “O, Moisi.
- [12] “Unë jam Zotëruesi yt; Hiqi sandalet se je në luginën e shenjtë Tuva.
- [13] “Të kam zgjedhur ty, prandaj dëgjo çka po shpallet.
- [14] “Unë jam Zoti; nuk ka zot tjetër përkrah Meje. Të më adhurosh vetëm Mua, dhe zbatoji Lutjet e Kontaktit (Salat) për të më përkujtuar Mua.
- Fundi i botës nuk është i fshehur**
- [15] “Ora po vjen gjithsesi; Unë do e mbaj gati të fshehur, se secili shpirt duhet të paguhet për punët e tij.
- [16] “Mos të të hiqet vëmendja prej saj nga ata që nuk besojnë në të – ata që ndjekin mendimet e veta – se ti bie.
- [17] “Çka është kjo në dorën tënde të djathtë, Moisi?”
- [18] Tha, “Ky është shkopi im. Mbështetem në të, i kullos dhentë me të, dhe e përdorë për qëllime tjera.”
- [19] Tha, “Hidhe poshtë, Moisi.”
- [20] Ai e hodhi, ku u shndërrua në gjarpër të lëvizshëm.
- [21] Tha, “Kape; mos u frikëso. Do e kthejmë në gjendjen e tij të mëparshme.
- [22] “Dhe fute dorën tënde nën krahun tënd; do të dalë e bardhë pa asnjë njollë; edhe një provë.
- [23] “Kështu të tregojmë disa nga shenjat tona të mëdha.
- [24] “Shko te Faraoni, se ai ka shkelur.”
- [25] Tha, “Zotëruesi im, qetësoma shpirtin.
- [26] “Dhe bëje këtë çështje të lehtë për mua.
- [27] “Dhe zgjidhja nyjën nga gjuha ime.
- [28] “Që ta kuptojnë fjalimin tim.
- [29] “Dhe cakto një ndihmës për mua nga familja ime.
- [30] “Vëllanë tim Aronin.
- [31] “Më përforco me të.
- [32] “Le të jetë ai ortaku im në këtë çështje.
- [33] “Që të mund të të madhërojmë shpesh.
- [34] “Dhe të të përkujtojmë shpesh.
- [35] “Ti je Pamës i yni.”
- [36] Ai tha, “Kërkesa jote është përmbushur, o Moisi.
- [37] “Të kemi bekuar edhe një herë.
- [38] “Kur shpallëm te nëna jote çka shpallëm.
- [39] “Duke thënë: ‘fute në kuti, dhe hidhe në lum. Lumi do e hedhë në breg, për tu marrë nga një armik i Imi dhe armik i tij.’ Hodha mbi ty dashuri prej Meje, dhe të bëra para syve të Mi vigjilent.
- [40] “Motra jote eci te ta dhe tha, ‘Unë mund t’ju tregoj për një nënë gjidhënëse që mund të kujdeset mirë për të.’ Ne kështu të kthym ty te nëna jote, që ajo të mund të jetë e lumtur dhe të mos brengoset më. Dhe kur ti vrave një njeri, të shpëtuam nga pasojat e mërziisë; vërtetë të testuam hollësisht. Ndenje me vite me njerëzit e Medjenit, dhe tash je kthyer në përputhje me një plan të përpiktë.

* 20:15 Fundi i botës jepet në Kuran, në lajmin e fundit të Zotit (15:87).

- [41] "Të kam bërë tamam për Mua.
- [42] "Shko me vëllanë tënd, i përkrahur me shenjat e Mia, dhe mos u luhat në përkujtimin Tim.
- [43] "Shko te Faraoni, se ka shkelur.
- [44] "Fol me të sjellshëm; ndoshta merr vesh, ose bëhet i ndershëm."
- [45] Ai tha, "Zotëruesi ynë, frikësohemi se mos na sulmon ai, ose shkelë."
- [46] Ai tha, "Mos u frikëso, se Unë do jem me ju, duke dëgjuar dhe shikuar.
- [47] "Shko te ai dhe thuaj, "Ne jemi dy të dërguarë nga Zotëruesi yt. Lëri Fëmijët e Izraelit të shkojnë. Duhet të ndalosh së keqtrajtuari ata. Ne sjellim një shenjë nga Zotëruesi yt, dhe paqja është ngastra e atyre që marrin vesh udhëzimin.
- [48] "Ne jemi frymëzuar që ndëshkimi do i pllakosë patjetër ata që nuk besojnë dhe refuzojnë."
- [49] Tha, "Kush është Zotëruesi juaj, o Moisi."
- [50] Tha, "Zotëruesi ynë është Ai që ia dhuroi ekzistencën çdo gjëje, dhe udhëzimin."
- [51] Tha, "Çka me gjeneratat e mëparshme?"
- [52] Tha, "Njohuria për ta është me Zotëruesin tim në një regjistër. Zotëruesi im kurrë nuk gabon, as nuk harron."
- [53] Ai është Ai që e bëri tokën të banueshme për ju, dhe i shtroi rrugët e saj për ju. Dhe Ai zbret nga qielli ujë me të cilin prodhojmë shumë lloje të ndryshme të bimëve.
- [54] Hani dhe rritni bagëtitë tuaja. Këto janë prova të mjaftueshme për ata që posedojnë inteligjencë.*
- [55] Prej saj ne ju krijuam, në të ju kthejmë, dhe prej saj ju nxjerrim edhe një herë.
- [56] Ne ia treguam atij të gjitha shenjat tona, por ai nuk besoi dhe refuzoi.
- [57] Ai tha, "A ke ardhur këtu për të na nxjerrë nga toka jonë me magjinë tënde, o Moisi?"
- [58] "Ne padyshim do të të tregojmë magji të ngjashme. Prandaj, cakto një takim që as ne, as ti nuk do e thyejmë; në një vend neutral."
- [59] Ai tha, "Takimi me ju le të jetë dita e festimit. Le të takohemi të gjithë paradite."
- [60] Faraoni i mbledhi forcat e tij, pastaj erdhi.
- [61] Moisiu iu tha atyre, "Turp ju qoftë. A trilloni rrena për ta luftuar Zotin dhe kështu të vetëshkaktoni ndëshkimin e Tij? Trilluesit e tillë do të dështojnë patjetër."
- [62] Ata u grindën mes vete, përderisa u morën vesh fshehtë.
- [63] Ata thanë, "Këta dy nuk janë asgjë më shumë se magjistarë që dëshirojnë t'ju nxjerrin nga toka juaj me magjinë e tyre, dhe të shkatërrojnë mënyrën ideale të jetesës suaj.
- [64] "Le të biem dakord për një plan dhe t'iu dalim përballë si një front i bashkuar. Fituesi sot do të ketë epërsi."
- [65] Ata thanë, "O Moisi, ose hidh, ose ne do të jemi të parit për të hedhur."
- [66] Ai tha, "Ju hidhni." Ku, litarët dhe thuprat e tyre iu dukën atij, për shkak të magjisë së tyre, sikur të ishin duke lëvizur.
- [67] Moisiu ushqeu pak frikë.
- [68] Ne thamë, "Mos kij frikë, Do të triumfosh.
- [69] "Hidh çka po mban në dorën tënde të djathtë, dhe do të gëlltisë çka trilluan. Çka ata trilluan

* 20:54 Ata që posedojnë inteligjencë e vlerësojnë faktin që ne jemi astronaut që ishim të lëshuar në hapësirë në 'Anijen Kozmike Toka'. Zoti na furnizoi me ushqim, ujë, kafshë, bagëti që ripërtërihen përderisa ne hipim në këtë odise të përkohshme në hapësirë. Krahaso furnizimet e Zotit në 'Anijen Kozmike Toka' me furnizimet që ne ua japim astronautëve tanë (Shtojca 7).

nuk është asgjë më shumë se planifikim magjistari. Puna e magjistarit nuk do të ketë sukses.”

Ekspertët e njohin të vërtetën

[70] Magjistarët ranë në përlulje, duke thënë, “Ne besojmë në Zotëruesin e Aronit dhe Moisiut.”

[71] Ai tha, “A besuat në të pa lejen time? Ai duhet të jetë shefi juaj; ai që u mësoi magji. Unë padyshim do t’jua cungoj duart dhe këmbët në anë të kundërta. Do t’ju kryqëzoj në trungjet e palmave. Do e shihni cili prej nesh mund të shkaktojë ndëshkimin më të keq, dhe kush është më i zoti.”

[72] Ata thanë, “Ne nuk do të preferojmë ty mbi provat e qarta që na erdhën, dhe mbi Atë që na krijoi. Prandaj, lësho çfarëdo vendimi që dëshiron të lëshosh. Ti vetëm mund të sundosh në këtë jetë të ulët.

[73] “Kemi besuar te Zotëruesi ynë, që të na falë mëkatet tona, dhe magjinë që na detyrove ta bëjmë. Zoti është shumë më i mirë dhe i Përjetshëm.”

[74] Kushdo që vjen fajtor te Zotëruesi i tij do të pësojë Ferr, ku nuk vdes kurrë, as nuk rri i gjallë.

[75] Sa për ata që vijnë te Ai si besimtarë që kishin çuar jetë të drejtë, ata i arrijnë rangjet e larta.

[76] Kopshtet e Edenit, nën të cilat rrjedhin lumenj, do të jenë vendbanimi i tyre përgjithmonë. I tillë është shpërblimi për ata që e pastrojnë veten.

[77] E frymëzua Moisiun: “Udhëhiqi shërbëtorët e Mi, dhe hap për ta një rrugë të thatë nëpër det. Të mos frikësohesh që mund të të zënë, as të mos brengosesh.”

[78] Faraoni i ndoqi ata me trupat e tij, por deti i kaploi ata, siç ishte paracaktuar t’i kaplojë.

[79] Kështu, Faraoni i humbi njerëzit e vet; nuk i udhëzoi ata.

[80] O Fëmijët e Izraelit, ju çlirua nga armiku juaj, ju mblodhëm në anën e djathtë të Malit Sinai, dhe zbritëm te ju rrëshirë dhe shkurtëza.

[81] Hani prej gjërave të mira që ju furnizua, dhe mos shkelni, se mos vetëshkaktoni zemërimin Tim. Kushdo që vetëshkakton zemërimin Tim ka rënë.

[82] Unë jam padyshim Falës për ata që pendohen, besojnë, çojnë jetë të drejtë, dhe me durim mbeten të udhëzuar.

Fëmijët e Izraelit ngrenë krye

[83] “Pse nxitove larg nga njerëzit e tu, o Moisi?”

[84] Ai tha, “Ata janë afër pas meje. Nxitova te Ti Zotëruesi im, që të jesh i kënaqur.”

[85] Ai tha, “I kam vënë njerëzit e tu në test pasi që u largove, por Samariu i çorientoi ata.”

[86] Moisiu u kthye te njerëzit e tij, i inatosur dhe i zhgënjyer, duke thënë, “O njerëzit e mi, a nuk iu premtoi Zotëruesi juaj premtim të mirë? A nuk mundët të prisni? A dëshiruat të vetëshkaktoni zemërim nga Zotëruesi juaj? A është kjo pse e thyet marrëveshjen tuaj me mua?”

[87] Ata thanë, “Ne nuk e thym marrëveshjen tonë me ty me qëllim. Por ishim të stërngarkuar me stoli, dhe vendosëm t’i hedhim aty. Kjo është çka Samariu sugjeroi.”

[88] Ai prodhoi për ta një viç të gdhendur, bashkë me zë viçi.* Ata thanë, “Ky është zoti juaj, dhe zoti i Moisiut.” Kështu, ai harroi.

[89] A nuk e panë ata se as nuk iu përgjigjej atyre, as nuk kishte ndonjë fuqi për t’i dëmtuar, apo për t’iu bërë dobi?

[90] Dhe Aroni iu kishte treguar, “O njerëzit e mi, ky është test për ju. I vetmi Zotërues i juaji është Mirëbërësi, prandaj më ndiqni, dhe bindjuni urdhrave të mia.”

* 20:88 & 96 Samariu shkoi te vendi ku Zoti i foli Moisiut, dhe kapi një grusht dhe mbi të cilin jehona e zërit të Zotit kishte rënë. Ky dhe, kur u përzi me arin e shkrirë, e bëri statujën e artë të marrë zë viçi.

[91] Ata thanë, “Ne do të vazhdojmë ta adhurojmë atë, derisa të kthehet Moisiu.”

[92] (Moisiu) tha, "O Aron, çka të ndaloi ty, kur i pe që kishin humbur,

[93] "nga ndjekja e urdhrave të mia? A ke ngritur krye kundër meje?"

[94] Ai tha, “O djali i nënës sime; mos më tërhiq edhe për mjekre edhe për koke. Isha i frikësuar që mund të thuash, ‘I ke përçarë Fëmijët e Izraelit, dhe nuk iu ke bindur urdhrave të mia.’”

[95] Ai tha, “Çka është puna jote, o Samari?”

[96] Ai tha, “Unë pashë çka ata nuk mund të shihnin. Morra një grusht (dhe) nga vendi ku i dërguari qëndroi, dhe e përdora (për ta përzier me viçin e artë). Kjo është çka mendja ime më frymëzoi të bëj.”

[97] Ai tha, “Atëherë shko, gjatë gjithë jetës tënde, as mos u afro. Ke një kohë të caktuar (për gjykimin tënd përfundimtar) që nuk mund t’i shmangesh. Shikoje zotin tënd që e adhuroje; do e djegim dhe ta hedhim në det, për të qëndruar atje poshtë përgjithmonë.”

Ti nuk ke pos një Zoti

[98] I vetmi zot i juaji është Zoti; Ai përkrah të cilit nuk ka asnjë zot tjetër. Njohuria e tij i përfshinë të gjitha gjërat.

[99] Kështu të kallëzojmë ca lajme nga gjeneratat e kaluara. Kemi shpallur te ti lajm prej nesh.

[100] Ata që e shpërfillin do të bartin barrë (mëkatesh) në Ditën e Ringjalljes.

[101] Përgjithmonë qëndrojnë aty; çfarë barre e keqe në Ditën e Ringjalljes!

[102] Ajo është dita kur i bihet bririt, dhe i mbledhim fajtorët të mërëzitur atë ditë.

[103] Duke u pëshpëritur mes vete, do të thonë, “Nuk keni qëndruar (në jetën e parë) më shumë se dhjetë ditë!”

[104] Jemi tërësisht të vetëdijshëm për shprehjet e tyre. Më i sakti mes tyre do të thotë, “Nuk keni qëndruar më shumë se një ditë.”

Në Ditën e Ringjalljes

[105] Të pyesin për malet. Thuaj, “Zotëruesi im do i fshijë.

[106] "Ai do e lë tokën si tokë të rrafshët, shterpë.

[107] "As edhe kodrën më të vogël nuk do të shohësh aty, as ultësirë.”

[108] Në atë ditë, secili do të ndjekë thirrësin, pa as devijimin më të vogël. Të gjitha zërat do të heshtin para Më të Mëshirshmit; nuk do të dëgjosh asgjë pos pëshpëritjeve.

[109] Atë ditë, ndërmjetësimi do të jetë i papërdorshëm, përveç atyre që lejohen nga i Mëshirshmi, dhe shprehjet e të cilëve janë në përputhje me vullnetin e Tij.

[110] Ai di të kaluarën e tyre dhe të ardhmen e tyre, përderisa askush nuk mund ta marrë me mend njohurinë e Tij

[111] Të gjitha fytyrat do i nënshtrohen të Gjallit, të Përrjetshmit, dhe ata që janë të ngarkuar me shkeljet e tyre do të dështojnë.

[112] Sa për ata që punuan drejtësi, përderisa besonin, ata nuk do të kenë aspak frikë nga padrejtësia ose fatkeqësia.

[113] Ne kështu e shpallim, Kuran arabisht, dhe përmendim në të të gjitha llojet e profecive, që të mund të shpëtohen, ose t’i bëjë të jenë të vëmendshëm.

[114] Më i Lartësuar është Zoti, i vetmi Mbret i vërtetë. Mos u ngut në të shprehurit e Kuranit para se të shpallet ty, dhe thuaj, “Zotëruesi im, rritma dijen.”

*Njerëzit nuk arrijnë të marrin qëndrim të palëkundur**

* 20:115 Kur Dreqi sfidoi autoritetin absolut të Zotit (38:69), ti dhe unë nuk morëm qëndrim të palëkundur kundër

[115] E testuam Ademin në të kaluarën, por ai harroi, dhe e gjetëm të pavendosur.

[116] Kujtohu që i thamë engjëjve, “Bini në përulje para Ademit.” Ata ranë në përulje, përveç Dreqit; ai refuzoi.

[117] Pastaj thamë, “O Adem, ky është armik i yti dhe i gruas tënde. Mos e lë t’ju dëbojë nga Parajsa, se mos bëheni të mjerë.

[118] “Jeni të garantuar që të mos jeni të uritur aty, as të mbetni pa strehë.

[119] “As nuk do të keni etje aty, as nuk do të vuani nga ndonjë nxehtësi.”

[120] Por djalli i pëshpëriti atij, duke i thënë, “O Adem, më le të të tregoj ty pemën e përjetësisë dhe mbretërimit të pafund.”

[121] Ata hëngrën prej saj, ku trupat e tyre u bënë të dukshëm për ta, dhe u përpoqën ta mbulonin veten me gjethet e Parajsës. Ademi pra nuk iu bind Zotëruesit të tij, dhe ra.

[122] Më pas, Zotëruesi i tij e zgjodhi atë, e shpengoi, dhe e udhëzoi.

[123] Ai tha, “Zbritni prej aty, të gjithë ju. Jeni armiq të njëri tjetrit. Kur udhëzimi të vijë te ju prej Meje, kushdo që e ndjek udhëzimin Tim nuk do të humbë, as nuk do të vuajë.

Për mosbesimtarët: Jeta e keqe e pashmangshme

[124] “Sa për atë që shpërfillë lajmin Tim, ai do të ketë jetë të vështirë, dhe e ringjallim, në Ditën e Ringjalljes, të verbër.”

[125] Ai do të thotë, “Zotëruesi im, pse më mblodhe të verbër, kur dikur isha pamës?”

[126] Ai do të thotë, “Për shkak se i harrove shpalljet tona kur ato erdhën te ti, tash je i harruar.”

[127] Kështu i paguajmë ata që shkelin dhe refuzojnë të besojnë në shpalljet e Zotëruesit të tyre. Ndëshkimi në Përjetësi është shumë më i keq dhe i përhershëm.

[128] A u shkon mendja atyre sa gjenerata paraprake i kemi asgjësuar? Ata tash po ecin në shtëpitë e atyre para tyre. Këto janë shenja për ata që posedojnë inteligjencë.

[129] Po të mos ishte për planin e paracaktuar të Zotëruesit tënd, ata do të ishin gjykuar menjëherë.

[130] Prandaj, ji i qetë përballë shprehjeve të tyre, dhe lartmadhëroje dhe madhëroje Zotëruesin tënd para lindjes së diellit dhe para perëndimit të diellit. Dhe gjatë natës madhëroje Atë, si dhe në të dy skajet e ditës, që të jesh i lumtur.

[131] Dhe mos lakmo çka i kemi dhuruar ndokujt tjetër. Të tilla janë zbukurimet e përkohshme të kësaj jete, me të cilat i vëmë në test. Çka Zotëruesi yt të furnizon është shumë më e mirë, dhe e përhershme.

Përgjegjësia e prindërve

[132] Ta shtysh familjen tënde t’i zbatojë lutjet e kontaktit (Salat), dhe me durim këmbëngul të bësh ashtu. Ne nuk ju kërkojmë juve asnjë furnizim; ne jemi ata që furnizojmë për ju. Triumfi përfundimtar iu takon të drejtëve.

Pse të dërguarë?

[133] Ata thanë, “Vetëm sikur të mund të na tregonte ai një mrekulli nga Zotëruesi i tij!” A nuk kanë pranuar ata mrekulli të mjaftueshme me lajmet paraprake?

[134] Sikur t’i asgjësonim para kësaj, do të kishin thënë, “Zotëruesi ynë, sikur ta kishe dërguar një të dërguar te ne, ne do i kishim ndjekur shpalljet Tua, dhe do iu kishim shmangur këtij turpërimi dhe poshtërimi.

[135] Thuaj, “Të gjithë ne po presim, prandaj pritni; padyshim do e merrni vesh kush janë në rrugën e drejtë, dhe kush janë vërtetë të udhëzuar.”

Surja 21: Profetët (El-Enbija')

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Shpejt po afrohet shpagimi për njerëzit, por ata janë të pavëmendshëm, kundërshtues.

Kundërshtimi i provave të reja

[2] Kur një provë vjen te ta nga Zotëruesi i tyre, që është e re, e dëgjojnë pa vëmendje.

[3] Mendjet e tyre janë të pavëmendshme. Dhe shkelësit diskutojnë fshehtë: A nuk është ai thjeshtë një qenie njerëzore si ju? A do e pranoni magjinë që ju prezantohet?*

[4] Ai tha, “Zotëruesi im e di çdo mendim në qiej dhe tokë. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.”

[5] Ata madje thanë, “Halucinacione,” “E trilloi,” dhe “Është poet. Le të na tregojë një mrekulli si ato të të dërguarve paraprak.”

[6] Nuk asgjësuam shoqëri besimtare në të kaluarën. A janë këta njerëz besimtarë?

[7] Nuk dërguam para teje përveç burra që i frymëzuam. Pyetni ata që dinë shkrimin, nëse nuk dini.

[8] Nuk iu dhamë atyre trupa që nuk hanin, as nuk ishin të pavdekshëm.

[9] E përmbushëm premtimin ndaj tyre; i shpëtuam ata së bashku me këdo që dëshiroam, dhe i asgjësuam shkelësit.

[10] Zbritëm te ju shkrim që përmban lajmin tuaj. A nuk kuptoni?

[11] Mori shoqëri i përfunduar për shkak të shkeljes së tyre, dhe zëvendësuam njerëz tjerë në vend të tyre.

[12] Kur pagesës sonë i erdh koha, ata filluan të vrapojnë.

[13] Mos vraponi, dhe kthehuni te lukset tuaja dhe pallatet tuaja, se duhet të jepni llogari.

[14] Ata thanë, “Mjerë ne. Ishim vërtetë shpirtligj.”

[15] Kjo vazhdoi të ishte thirrja e tyre, derisa i fshimë krejtësisht.

[16] Nuk krijuam qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë mes tyre vetëm për tu dëfryer.

[17] Sikur të kishim nevojë për dëfrim, do të kishim mundur ta nisim atë pa asnjë prej kësaj, nëse kjo është çka do të dëshironim të bënim.

[18] Në të vërtetë, është plani ynë që ta përkrahim të vërtetën kundër të pavërtetës, për ta mposhtur. Mjerë ju për shprehjet që shprehni.

[19] I Tij është çdokush në qiej dhe tokë, dhe ata te Ai nuk janë tepër mendjemëdhenj për ta adhuruar Atë, as nuk mërzhiten.

[20] Ata madhërojnë natë e ditë, pa u lodhur kurrë.

Një Zot

[21] A kanë gjetur zota në tokë që mund të krijojnë?

[22] Sikur të kishte në (qiej dhe tokë) tjerë zota përkrah Zotit, do të ishte kaos. I madhëruar qoftë Zoti; Zotëruesi me autoritet absolut. Ai është larg nga pretendimet e tyre.

Kurrë mos e vë në dyshim mençurinë e Zotit

[23] Ai nuk ka për tu pyetur për çfarëdo që bënin Ai, përderisa të gjithë të tjerët pyeten.

* 21:3 Edhe pse Bibla (Malakia 3:1) dhe Kurani (3:81) profetizojnë ardhjen e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes, kur ai u shfaq, i përkrahur me ‘njërën nga mrekullitë më të mëdha’ (74:30-35), ai u përball me mosvëmendje dhe kundërshti. Pohimi hyjnor që çdo provë e ‘re’ kundërshtohet është vërtetuar nga kundërshtimi i arabëve ndaj mrekullisë së Kuranit. (Shtojcat 1 & 2).

[24] A kanë gjetur zota tjerë përkrah Tij? Thuaj, “Tregomëni provën tuaj. Ky është lajmi për gjeneratën time, duke i përbushur të gjitha lajmet paraprake.” Vërtetë, shumica e tyre nuk e njohin të vërtetën; kjo është pse ata janë aq armiqtësorë.

Një Zot/ Një lajm/ Një fe

[25] Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje përveç me frymëzimin: “Nuk ka asnjë zot përveç Meje; të më adhuroni vetëm Mua.”

[26] Prapëseprapë, ata thanë, “Mirëbërësi ka lindur djalë!” I madhëruar qoftë Ai. Të gjithë (të dërguarit) janë shërbëtorët e nderuar (të Tij).

[27] Ata nuk flasin nga vetja, dhe i ndjekin urdhrat e Tij me përpikëri.

Miti i ndërmjetësimit

[28] Ai din të ardhmen e tyre dhe të kaluarën e tyre. Ata nuk ndërmjetësojnë, përveç atyre që tashmë janë pranuar nga Ai, dhe ata brengosen për shpirtrat e vet.*

[29] Nëse ndonjëri prej tyre pretendon të jetë zot përkrah Tij, e paguajmë me Ferr; kështu i paguajmë shpirtligjtë.

*Teoria e eksplodimit të madh (Big Beng) konfirmohet**

[30] A nuk e kuptojnë mosbesimtarët që qiejt dhe toka dikur ishin një masë e vetme që e eksploduan në ekzistencë? Dhe prej ujit i bëmë të gjitha gjërat e gjalla. A nuk besojnë?

[31] Dhe vumë në tokë stabilizues, se mos gremiset me ta, dhe vumë udhë të drejta në të, që të mund të udhëzohen.

[32] Dhe e bëmë qiellin tavan të mbrojtur. Prapëseprapë, ata janë plotësisht të pavëmendshëm ndaj të gjitha shenjave aty.

[33] Dhe Ai është Ai që krijoi natën dhe ditën, dhe diellin dhe hënën; secili duke lundruar në orbitën e vet.

[34] Nuk shpallëm pavdekshmëri për askënd para teje; po të vdesësh ti, a janë ata të pavdekshëm?

[35] Secili person do të shijojë vdekjen, pasi që t’ju vëmë në test me vështirësi dhe përparim, pastaj te ne përfundimisht ktheheni.

Të gjithë të dërguarit përqeshen

[36] Kur ata që nuk besojnë të shohin ty, të përqeshin: “A është ky ai që ua sfidon zotat tuaj?” Ndërsa, ata mbeten tërësisht të pavëmendshëm ndaj lajmit nga Mirëbërësi.

[37] Qenia njerëzore është e padurueshme për nga natyra. Unë patjetër do t’jua tregoj shenjat e Mía; mos u ngutni edhe aq.

[38] Ata sfidojnë: “Ku është (ndëshkimi), nëse jeni të sinqertë?”

[39] Vetëm sikur ata që nuk besojnë të mund ta përfytyronin veten kur mundohen ta heqin zjarrin – nga fytyrat e tyre dhe shpinat e tyre! Askush nuk do i ndihmojë ata atëherë.

[40] Në të vërtetë, atyre do tu vijë papritmas, dhe ata do të jenë krejtësisht të shtangur. Ata as nuk mund t’i shmangen, as nuk iu lejohet shtyrja e afatit.

[41] Të dërguarë para teje janë përqeshur, dhe, si pasojë, ata që i përqeshën vetëshkaktuan ndëshkimin për përqeshjen e tyre.

Prioritetet e ngatërruara

[42] Thuaj, “Kush mund t’ju mbrojë nga Mirëbërësi gjatë natës ose gjatë ditës?” Në të vërtetë, ata

* 21:28 Miti i ndërmjetësimit është karremi më efikas i Dreqit (shih Shtojcën 8).

* 21:30 Teoria e Eksplodimit të Madh tash përkrahet nga kodi matematikor i pagabueshëm i Krijuesit (Shtojca 1). Pra, nuk është më teori; është ligj, fakt i vërtetuar.

janë tërësisht të pavëmendshëm ndaj lajmit të Zotëruesit të tyre.

[43] A kanë ata zota që mund t'i mbrojnë ata prej nesh? Ata as vetes nuk mund t'i ndihmojnë. As nuk mund ta shoqërojnë njëri tjetrin kur mblidhen para nesh.

[44] I kemi furnizuar këta njerëz dhe paraardhësit e tyre, deri në një moshë të vjetër. A nuk shohin që çdo ditë në tokë i sjell më afër fundit? A mund ta kthejnë mbrapsht këtë proces?

[45] Thuaj, "Po ju paralajmëroj në përputhje me frymëzim hyjnor." Megjithatë, shurdhat nuk mund ta dëgjojnë thirrjen, kur ata paralajmërohen.

[46] Kur një mostër e ndëshkimit të Zotëruesit tënd i pllakos ata, ata menjëherë thonë, "Vërtetë ishim shpirtligj."

[47] Do i vendosim peshoret e drejtësisë në Ditën e Ringjalljes. Asnjë shpirt nuk do të vuaj as më të voglën padrejtësi. Edhe sa kokrra e sinapit do të llogaritet. Ne jemi llogaritësit më të shkathët.

Profetët Moisiu dhe Aroni

[48] Ia dhamë Moisiut dhe Aronit Kodin Ligjor, fener, dhe kujtesë për të drejtit.

[49] Që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre, edhe kur janë vetë, dhe ata brengosen për Orën.

[50] Ky gjithashtu është kujtesë e bekuar që e zbritëm. A jeni duke e mohuar?

Ibrahimi

[51] Më parë, i dhuruam Ibrahimit udhëzimin dhe të kuptuarit e tij, se ishim tërësisht të vetëdijshëm për të.*

[52] Ai i tha babait të tij dhe njerëzve të tij, "Çka janë këto statuja të cilave po ua kushtoni veten?"

[53] Thanë, "I gjetëm prindërit tanë duke i adhuruar ato."

[54] Tha, "Në të vërtetë, ju dhe prindërit tuaj keni humbur krejt."

[55] Thanë, "A po na thua të vërtetën, apo po luan?"

[56] Tha, "Zotëruesi juaj i vetëm është Zotëruesi i qiejve dhe tokës, që i krijoi. Kjo është dëshmia për të cilën jam dëshmitar.

[57] "Pasha Zotin, kam për t'ua treguar qejfin statujave tuaja, sapo të largoheni."

[58] Ai i theu ato copa-copa, përveç një të madhes, që ata të mund t'i drejtohen asaj.

[59] Thanë, "Kushdo që ia bëri këtë zotave tanë është vërtetë shkelës."

[60] Thanë, "Dëgjuam një të ri që i kërcënonte ato; ai quhet Ibrahim."

[61] Thanë, "Sillnie atë para syve të të gjithë njerëzve, që të mund të jenë dëshmitarë."

[62] Thanë, "A ia bëre këtë zotave tanë, o Ibrahim?"

Ibrahimi e vërteton argumentin e tij

[63] Tha, "Është ai i madhi që e bëri. Shkoni pyetni, nëse mund të flasin."

[64] Ata nuk patën tjetër, vetëm të thonë, "Në të vërtetë, ju jeni ata që keni qenë duke shkelur."

[65] Prapëseprapë, ata iu rikthyen mendimeve të tyre të vjetra: "Ti e din fare mirë që këta nuk mund të flasin."

[66] Ai tha, "A adhuronit atëherë përkrah Zotit çka nuk ka aspak fuqi t'ju bëjë dobi as t'ju dëmtojë?"

[67] "Keni vetëshkaktuar turp duke adhuruar idhuj përkrah Zotit. A nuk kuptoni?"

Mrekulli e thellë

[68] Thanë, "Digjnie atë dhe përkrahni zotat tuaj, nëse kjo është çka vendosni të bëni."

* 21:51 A ishte Ibrahim i aq i mençur sa që ta zbulonte Zotin, apo, Zoti ia dhuroi atij inteligjencën sepse Ai e dinte që ai meritonte të shpëtohet? Siç del, e tërë kjo botë është krijuar për t'i shpënguar ata mes nesh që meritojnë shpengim. Kur engjëjt propozuan që të gjithë kryengritësit, njerëz dhe xhin, duhet të dëbohen jashtë nga mbretëria e Zotit, Ai tha, 'Unë di çka ju nuk dini' (2:30). Në të njëjtën kohë, kjo botë e vërteton pazotësinë e Dreqit si zot (Shtojca 7).

[69] Ne thamë, “O zjarr, ji i ftohtë dhe i sigurt për Ibrahimin.”*

[70] Pra, ata planifikuan kundër tij, por i bëmë ata humbësa.

[71] E shpëtuam atë, dhe e shpëtuam Lutin, në tokën që e bekuam për të gjithë njerëzit.

[72] Dhe i dhamë atij Isakun dhe Jakobin si dhuratë, dhe i bëmë që të dy të drejtë.

Ibrahimi dorëzoi të gjitha detyrat fetare të nënshtrimit (islamit)

[73] I bëmë ata imamë që udhëzuan në përputhje me urdhrat tona, dhe iu mësuam atyre si të veprojnë drejt, dhe si t’i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe bamirësinë e obligueshme (Zeqat).*

Te ne, ata ishin adhurues të devotshëm.

Luti

[74] Sa për Lutin, i dhuruam atij mençuri dhe njohuri, dhe e shpëtuam atë nga shoqëria që praktikonte neveri; ata ishin njerëz shpirtligj dhe të këqij.

[75] E pranua atë në mëshirën tonë, se ai ishte i drejtë.

Nuhu

[76] Dhe, para asaj, Nuhu thirri dhe ne iu përgjigjëm. E shpëtuam atë dhe familjen e tij nga katastrofa e madhe.

[77] E përkrahëm atë kundër njerëzve që refuzuan shpalljet tona. Ata ishin njerëz të këqij, kështu që i mbytëm të gjithë.

Davidi dhe Salomoni

[78] Dhe Davidi dhe Salomoni, kur ata njëherë vendosën në lidhje me të mbjellat e dikujt që ishin shkatërruar nga delet e tjetrit, ne ishim dëshmitarë të vendimit të tyre.

[79] I dhuruam Salomonit të kuptuarit e saktë, edhe pse i pajisëm që të dy me mençuri dhe njohuri. I parashtruam malet që t’i shërbejnë Davidit në madhërimin (e Zotit), si dhe zogjtë. Kështu bëmë.

[80] Dhe i mësuam atij mjeshtërinë e bërjes së mburojave për t’ju mbrojtur në luftë. A jeni pra falënderues?

[81] Për Salomonin e parashtruam erën duke fryrë në dispozicion të tij. Ai mund ta drejtonte kah të donte, në cilëndo tokë ai zgjidhte, dhe e bekuam një tokë të tillë për të. Jemi tërësisht të vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[82] Dhe prej djajve kishte që do të zhyteshin për të (për të vjelë detin), ose për të bërë çfarëdo tjetër që i urdhëronte të bënin. I parashtruam ata në shërbimin e tij.

Jobi

[83] Dhe Jobi iu lut Zotëruesit të tij: “Fatkeqësi më ka rënë mua, dhe, nga gjithë të mëshirshmit, Ti je më i Mëshirshmi.”

[84] Iu përgjigjëm atij, lehtësuam fatkeqësinë e tij, dhe ia ndreqëm familjen për të, madje edhe dy herë aq. Ajo ishte mëshirë prej nesh, dhe kujtesë për adhuruesit.

[85] Gjithashtu Ismaili, Idrizi, Dhul-Kifli; të gjithë ishin të palëkundur, të durueshëm.

[86] I pranua ata në mëshirën tonë, se ishin të drejtë.

Jona

[87] Dhe Dhun-Nuni (Jona, “ai me ‘n’ në emrin e tij”), braktisi misionin e tij duke protestuar, duke menduar që nuk e kemi në dorë. Ai përfundoi duke u lutur nga errësira (e barkut të peshkut të madh): “Nuk ka asnjë zot tjetër pos Teje. Qofsh i madhëruar. Kam bërë një mëkat të tepërt.”

* 21:69 "I ftohtë," pa "dhe i sigurt" do e bënte Ibrahimin të ngrijë.

* 21:73 Kur Kurani u shpall, të gjitha detyrat fetare ishin veç të themeluara nëpërmjet Ibrahimit (2:128, 16:123, 22:78).

[88] Iu përgjigjëm, dhe e shpëtua nga kriza; kështu pra i shpëtojmë besimtarët.

Zekeria dhe Gjonin

[89] Dhe Zekeria iu përgjërue Zotëruesit të tij: “Zotëruesi im, mos më mbaj pa trashëgimtar, edhe pse Ti je trashëgimtari më i mirë.”

[90] Ne* iu përgjigjëm atij dhe i dhuruam Gjonin; e ndreqëm gruan e tij për të. Kjo është për shkak se ata nguteshin për të punuar drejtësi, dhe na u lutën në situata gëzimi, si dhe frike. Te ne, ata ishin respektues.

Maria dhe Jezusi

[91] Sa për atë që mbajti virgjërinë e saj, ne frymë në të nga fryma jonë, dhe kështu, e bëmë atë dhe djalin e saj shenjë për tërë botën.

Një Zot/ Një fe

[92] Asambleja juaj nuk është tjetër pos një asamble, dhe vetëm Unë jam Zotëruesi juaj; të më adhuroni vetëm Mua.

[93] Por ata e ndanë veten në sekte të përçara. Të gjithë do të kthehen te ne (për gjykim).

[94] Sa për ata që punojnë drejtësi, përderisa besojnë, puna e tyre nuk do të shkojë huq; ne po e incizojmë atë.

[95] Është e ndaluar për cilëndo shoqëri që e kishim asgjësuar që të kthehen.

Fundi i botës

[96] Jo derisa Gogu dhe Magogu të rishfaqen,* e atëherë do të kthehen – do të vijnë nga secila anë.

[97] Atëherë do i vij koha profecisë së pashmangshme, dhe mosbesimtarët do i ngulisin sytë në tmerr: “Mjerë ne; kemi qenë të pavëmendshëm. Vërtetë, kemi qenë shpirtligj.”

Përjetësia

[98] Ju dhe idhujt tuaj që i adhuroni përveç Zotit do të jeni lëndë djegëse Ferri; ky është përfundimi juaj i pashmangshëm.

[99] Sikur ata të ishin zota, nuk do të kishin përfunduar në Ferr. Të gjithë banuesit e tij qëndrojnë në të përgjithmonë.

[100] Ata do të rënkojnë aty, dhe nuk do të kenë qasje në asnjë lajm.

[101] Sa për ata që merituan shpërblimet tona të shkëlqyeshme, ata do të mbrohen nga ai.

Të drejtit

[102] Ata nuk do të dëgjojnë fishkëllimën e tij. Ata do të gëzojnë banesë ku mund të kenë çfarëdo që dëshirojnë, përgjithmonë.

[103] Tmerri i madh nuk do i brengosë ata, dhe engjëjt do i pranojnë ata me gëzim: “Kjo është dita juaj, që ju është premtuar.”

Dita e Ringjalljes

[104] Atë ditë, do e palosim qiellin, siç paloset një libër. Ashtu si e nisëm krijimin e parë, do e përsërisim. Ky është premtimi ynë; padyshim do e zbatojmë.

* 21:90 Përdorimi i shumësit në gramatikë përgjatë Kuranit tregon pjesëmarrjen e engjëjve. Është e qartë nga 3:39 dhe nga Bibla që engjëjt u morën me Zekerian gjerësisht, përderisa i dhanë atij lajmin e mirë për Gjonin. Shih Shtojcën 10.

* 21:96 Nga viti 2270 Pas Lindjes së Krishtit, falë mrekullisë matematikore në Kuran të Zotit (Shtojca 1), Amerika do të jetë qendra e Islamit, dhe me biliona përgjatë globit do të kenë besuar në Kuran (9:33, 41:53, 48:28, 61:9). Gogu dhe Magogu (emra alegorik të shoqërive zullumqare), do të jenë fortesat e vetme të paganizmit, dhe ata do i sulmojnë të nënshtruarit. Atëherë do i vij fundi botës (15:87, 18:94, Shtojca 25). Gogu dhe Magogu përmenden në 18:94 & 21:96, 17 strofa para fundit të secilës sure; kjo mund të tregojë kohën e shfaqjes së tyre.

- [105] Kemi shpallur në Psalme, si dhe në shkrime tjera, që toka të trashëgohet nga adhuruesit e Mi të drejtë.
- [106] Kjo është shpallje për njerëzit që janë adhurues.
- [107] Të kemi dërguar ty nga mëshira prej nesh ndaj gjithë botës.
- [108] Deklaro, "Më është dhënë frymëzim hyjnor që zot i juaji është një zot. A do të nënshtroheni pra?"
- [109] Nëse kthehen prapa, atëherë thuaj, "Ju kam paralajmëruar mjaftueshëm, dhe nuk e kam idenë sa shpejt ose ngadalë do t'ju vij (ndëshkimi).
- [110] "Ai është tërësisht i vetëdijshëm për shprehjet tuaja publike, dhe Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që fshihni.
- [111] "Për sa di unë, kjo botë është test për ju, dhe kënaqësi e përkohshme."
- [112] Thuaj, "Zotëruesi im, gjykimi Yt është drejtësia absolute. Zotëruesi ynë është Mirëbërësi; vetëm ndihma e tij kërkohet përballë pretendimeve tuaja."

Surja 22: Shtegtimi (El-Haxh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] O njerëz, t'ia keni dronë Zotëruetit tuaj, se dridhja e Orës është diçka e llahtarshme.
- [2] Ditën kur jeni dëshmitarë të saj, edhe një nënë gjidhënese do të braktisë foshnjën e saj, dhe një grua shtatzënë do të abortojë fetusin e saj. Do i shihni njerëzit duke u tundur, sikur të jenë të dehur, edhe pse ata nuk janë të dehur. Kjo është për shkak se ndëshkimi i Zotit është aq i hatashëm.
- [3] Mes njerëzve, ka prej atyre që grinden pa dije në lidhje me Zotin, dhe ndjekin çdo djall kryengritës.
- [4] Është shpallur që kushdo që e shoqëron veten me të, ai do ta çorientojë atë dhe ta udhëzojë te agonia e Ferrit.

Prej nga jemi?

- [5] O njerëz, nëse keni ndonjë dyshim për ringjalljen, (përkujtoni që) ju krijuam prej dheu, dhe më pas nga një pikël, që shndërrohet në (embrion) të varur, pastaj bëhet fetus që i jepet jetë ose jo. Kështu i sqarojmë gjërat për ju. Vëmë në mitra çfarëdo që duam për një kohë të caktuar.* Pastaj ju nxjerrim si foshnje, pastaj arrini maturinë. Përderisa disa prej jush vdesin të ri, të tjerët jetojnë deri në pleqërinë më të thellë, vetëm për ta kuptuar që nuk mund të fitohet më njohuri përtej një kufiri të caktuar. Gjithashtu, ju e shikoni një tokë që është e vdekur, dhe pastaj sapo i lëshojmë shi, gjallërohet dhe rritet të gjitha llojet e bimëve të bukura.
- [6] Kjo vërteton se Zoti është e Vërteta, dhe se Ai i ngjallë të vdekurit, dhe se Ai është i Gjithëfuqishmi.
- [7] Dhe se Ora po vjen, nuk ka dyshim për të, dhe se Zoti i ringjallë ata që janë në varre.

Ngjarje e zakonshme

- [8] Mes njerëzve ka që grinden pa dije në lidhje me Zotin, dhe pa udhëzim, dhe pa shkrim ndriçues.
- [9] Me mendjemadhësi ai përpiqet t'i largojë njerëzit nga rruga e Zotit. Ai kështu vetëshkakton poshtërim në këtë jetë, dhe e parashtrijmë në Ditën e Ringjalljes në agoninë e djegies.

* 22:5 Mrekullia matematikore e Kuranit është e bazuar në numrin 19. Siç del, ky numër përfaqëson nënshkrimin e Krijuesit në krijesën e Tij. Pra, ti dhe unë kemi 209 eshtra në trupat tonë (209=19x11). Gjatësia e shtatzënisë për një fetus me kohëzgjatje të plotë është 266 ditë (19x14) (Langman's Medical Embryology, T. W. Sadler, Faqe 88, 1985).

[10] Këto janë veprat e duarve tuaja. Zoti nuk është i padrejtë ndaj njerëzve.

Shokë për interes

[11] Mes njerëzve ka që adhurojnë Zotin me kusht. Nëse gjërat i shkojnë mbarë, ai është i kënaqur. Por nëse ndonjë vështirësi i bie, ai e prishë fytyrën. Kështu, ai e humbë edhe këtë jetë edhe Përjetësinë. E tillë është humbja e vërtetë.

[12] Ai idolizon përkrah Zotit çka nuk posedon aspak fuqi për ta dëmtuar ose për t'i sjellë dobi; e tillë është humbja e vërtetë.

[13] Ai idolizon çka është më e prirë për ta dëmtuar sesa për t'i sjellë dobi. Çfarë zotëruesi i tmerrshëm! Çfarë shoqëruesi i tmerrshëm!

[14] Zoti pranon ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë në kopshte me prroje që rrjedhin. Çdo gjë është në përputhje me vullnetin e Zotit.

Lumturi tash, dhe përgjithmonë

[15] Nëse dikush mendon që Zoti nuk mund ta përkrahë në këtë jetë dhe në Përjetësi, le të kthehet krejtësisht nga (Krijuesi i tij) në qiell, dhe ta shkapëtojë (varësinë e tij nga kushdo tjetër). Ai pastaj do të shohë që ky plan eliminon çfarëdo që e shqetëson.

[16] Kështu kemi shpallur shpallje të qarta këtu, dhe Zoti udhëzon kë do (të jetë i udhëzuar).

Zoti: Gjykatësi i vetëm

[17] Ata që besojnë, ata që janë Jahudi, të konvertuarit, të Krishterët, Zoroastrianët, dhe adhuruesit e idhujve, Zoti është Ai që do të gjykojë mes tyre në Ditën e Ringjalljes. Zoti është dëshmitar i të gjitha gjërave.

[18] A nuk e kupton që Zotit i bie në përlulje çdokush në qiej dhe tokë, dhe dielli, dhe hëna, dhe yjet, dhe malet, dhe lisat, dhe kafshët, dhe shumë njerëz? Shumë të tjerë mes njerëzve parashtrihen në dënim. Këdo që Zoti e turpëron, askush nuk do e nderojë. Çdo gjë është në përputhje me vullnetin e Zotit.

*Sa i tmerrshëm është Ferri!**

[19] Ja ku janë dy parti duke u grindur në lidhje me Zotëruesin e tyre. Sa për ata që nuk besojnë, ata do të kenë rroba zjarri të qepura për ta. Vlim do të derdhet mbi kokat e tyre.

[20] Do e bëjë brendësinë e tyre të shkrihet, si dhe lëkurat e tyre.

[21] Do të jenë të mbyllur në kazanë hekuri.

[22] Sa herë që mundohen të dalin nga një vuajtje e tillë, do të kthehen në të me dhunë: "Shijojeni agoninë e djegies."

Hareja e Parajsës

[23] Zoti do i pranojë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë në kopshte me prroje që rrjedhin. Ata do të stolisen aty me byzlykë ari, dhe perlash, dhe aty do të jenë me veshje mëndafshi.

[24] Ata janë udhëzuar drejt fjalëve të mira; janë udhëzuar në rrugën e Më të Lartmadhëruarit.

[25] Padyshim, ata që nuk besojnë dhe zmbrahsin të tjerët nga rruga e Zotit, dhe nga Vendlutja e Shenjtë që e përcaktuam për të gjithë njerëzit – qofshin vendas apo vizitorë – dhe kërkojnë ta ndotin dhe ta korruptojnë, ne do i pllakosim me ndëshkim që dhemb.

Shtegtimi, si të gjitha detyrat në Islam, u shpall nëpërmjet Ibrahimit

[26] E caktuam Ibrahimin për ta themeluar Faltoren: "Të mos idolizosh asnjë zot tjetër përkrah

* 22:19-22 Njerëzit që kanë këmbëngulur të shkojnë në Ferr do të ankohen patjetër: 'Sikur ta dinim sa keq është kjo, do të sillleshim ndryshe.' Atyre do tu thuhet që tmerrret e Ferrit janë theksuar për ta me terme përshkruese, edhe pse simbolike. Duhet theksuar që Parajsa dhe Ferri përmenden gati secilën herë së bashku në Kuran.

Meje, dhe pastroje faltoren Time për ata që e vizitojnë, ata që jetojnë afër saj, dhe ata që përkulen dhe përuken.

[27] "Dhe shpall që njerëzit të zbatojnë shtegtimin Haxh.* Ata do të vinë te ti duke ecur dhe me (mjete) të ndryshme të përdorura (të transportit). Ata do të vijnë prej vendeve të largëta."

[28] Mund të kërkojnë dobi komerciale, dhe do e përkujtojnë emrin e Zotit gjatë ditëve të caktuara se i furnizoi me bagëti. "Hani nga to dhe ushqeni të dëshpëruarit dhe të varfrit."

[29] T'i përmbushin detyrimet e tyre, t'i përmbushin betimet, dhe të vizitojnë faltoren e lashtë.

[30] Ata që i respektojnë ritet e shpallura nga Zoti kanë merituar shpërblim të mirë te Zotëruesi i tyre. E gjithë bagëtia është bërë e ligjshme për ushqimin tuaj, përveç atyre që saktësisht ndalohen këtu. T'i shmangeni neverisë së adhurimit të idhujve, dhe t'i shmangeni dëshmimit të rremë.

[31] Ta mbani devotshmërinë absolutisht ndaj vetëm Zotit. Kushdo që ngritë ndonjë idhull përkrah Zotit është si dikush që ra nga qielli, pastaj grabitet nga shpendë grabitqarë, ose e hedhë era në greminë të thellë.

[32] Vërtetë, ata që respektojnë ritet e shpallura nga Zoti demonstrojnë drejtësinë e zemrave të tyre.

*Ofertat e bagëtive gjatë shtegtimt**

[33] (Bagëtitë) ju furnizojnë me shumë dobi për një kohë, para se të dhurohen te faltorja e shenjtë.

[34] Për secilën asamble kemi shpallur rite me të cilat e përkujtojnë emrin e Zotit se i ka furnizuar me bagëti. Zoti juaj është një dhe i njëjti zot; të gjithë ju t'i nënshtroheni Atij. Jepu lajme të mira të bindurve.

[35] Ata janë ata zemrat e të cilëve dridhen kur përmendin Zotin, ata me këmbëngulje durojnë gjatë fatkeqësive, i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe nga furnizimet tona te ta, japin bamirësi.

[36] Ofertat shtazore janë mes riteve të shpallura nga Zoti për të mirën tuaj*. Ta përmendni emrin e Zotit kur ato janë duke qëndruar në rend. Kur ofrohen për sakrificë, të hani prej tyre dhe ushqeni të varfrit dhe nevojtarët. Kjo është pse i zbutëm për ju, që të mund të tregoni mirënjohjen tuaj.

[37] As mishi i tyre, as gjaku i tyre nuk arrin te Zoti. Çka arrin te Ai është drejtësia juaj. Ai i ka zbutur ato për ju, që të mund ta tregoni mirënjohjen duke e madhëruar Zotin që ju udhëzoi. Jepu lajme të mira bamirësve.

Zoti i mbron besimtarët

[38] Zoti mbron ata që besojnë. Zoti nuk do tradhtar, mosmirënjohës.

Sinagogat, kishat, dhe xhamitë

[39] Leje iu jepet atyre që janë duke u keqtrajtuar, pasi që padrejtësi ka rënë mbi ta, dhe Zoti është padyshim i aftë për t'i përkrahur ata.

[40] Ata u dëbuan nga shtëpitë e tyre padrejtësisht, për asnjë arsye përveç që thanë, "Zotëruesi ynë është Zoti." Sikur të mos ishte përkrahja e Zotit ndaj disa njerëzve kundër të tjerëve, manastiret, kishat, sinagogat, dhe xhamitë – ku emri i Zotit përmendet shpesh – do të ishin shkatërruar. Absolutisht, Zoti i përkrahë ata që e përkrahin Atë. Zoti është i Fuqishëm, i Plotfuqishëm.

[41] Ata janë ata që, nëse i caktojmë si sundues në tokë, ata do të kishin themeluar Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe do të kishin përkrahur drejtësi dhe

* 22:26-27 Ibrahim i ishte i dërguari fillestar i Nënshtrimit (Islamit). Shih 22:78 dhe Shtojcën 9.

* 22:33,36 Ofertat shtazore nga shtegtarët konservojnë burimet në vendin e shtegtimt. Vini re që gati 2,000,000 shtegtarë mblidhen në Mekë gjatë shtegtimt.

ndaluar të keqe. Zoti është sunduesi përfundimtar.

[42] Nëse të refuzojnë ty, ashtu bënë para këtyre edhe njerëzit e Nuhut, Adit, dhe Themudit.

[43] Gjithashtu njerëzit e Ibrahimit, dhe njerëzit e Lutit.

[44] Dhe banuesit e Medjenit. Edhe Moisiu u refuzua. Unë ua bëra rrafsh të gjithë atyre njerëzve, pastaj i thirra në llogaridhënie; sa (shkretues) ishte shpagimi Im!

[45] Mori shoqëri i kemi asgjësuar për shkak të shpirtligësisë së tyre. Ata përfunduan në gërmadha, puse të mbetura, dhe pallate të mëdha të zbrazëta.

[46] A nuk u endën nëpër tokë, dhe përdorën mendjet e tyre për të kuptuar, dhe përdorën veshët e tyre për të dëgjuar? Në të vërtetë, verbërimi i vërtetë nuk është verbërimi i syve, por verbërimi i zemrave brenda kraharorëve.

[47] Të sfidojnë ty të sjellësh ndëshkim, dhe Zoti nuk dështon ta përmbushë profecinë e Tij. Një ditë e Zotëruesit tënd është si një mijë vjet tuajat.

[48] Mori shoqëri në të kaluarën kryen të këqija, dhe ua bëra rrafsh për një kohë, pastaj i ndëshkova. Te Unë është fati përfundimtar.

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[49] Thuaj, “O njerëz, jam dërguar te ju si paralajmërues i qartë.”*

[50] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë kanë merituar falje dhe shpërblim bujar.

[51] Sa për ata që përpiqen t’i sfidojnë shpalljet tona, ata vetëshkaktojnë Ferr.

Sistemi

[52] Nuk dërguam para teje asnjë të dërguar, as profet, pa e lënë djallin të ndërhyjë në dëshirat e tij. Zoti pastaj asgjëson çka djalli ka bërë. Zoti i përkryen shpalljet e Tij. Zoti është i Gjithëdijshëm, Më i Mençuri.*

Hipokritët ngelin

[53] Ai kështu e ujdís planifikimin e drejtë për ata që ushqejnë dyshime në zemrat e tyre, dhe ata zemrat e të cilëve janë të ngurtësuara. Të këqijtë duhet të mbesin me kundërshtarët.

[54] Ata që janë të bekuar me dituri do të njohin të vërtetën nga Zotëruesi yt, pastaj të besojnë në të, dhe zemrat e tyre do e pranojnë atë me gatishmëri. Patjetër, Zoti i udhëzon besimtarët në rrugën e drejtë.

[55] Sa për ata që nuk besojnë, ata do të vazhdojnë të ushqejnë dyshime derisa Ora të vijë te ta papritmas, ose ndëshkimi i një dite të tmerrshme të vij te ta.

Mbretërimi i përkohshëm i Dreqit

[56] I gjithë sovraniteti në atë ditë i takon Zotit, dhe Ai do të gjykojë mes tyre. Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, kanë merituar kopshtet e haresh.

[57] Përderisa ata që nuk besojnë dhe refuzojnë shpalljet tona kanë vetëshkakuar ndëshkim turpi.

Përpjekja në rrugën e Zotit

[58] Ata që emigrojnë për hatër të Zotit, pastaj vriten, ose vdesin, Zoti padyshim do iu derdhë

* 22:49 Ky urdhër i drejtohej posaçërisht të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes. Ky fakt, dhe emri i specifik i të dërguarit janë të koduar matematikisht në Kuran. Shih hollësisht, së bashku me provat e pakundërshtueshme, në Shtojcat 2 dhe 26.

* 22:52 Përgjatë testit të kësaj bote, Dreqi lejohet ta paraqesë pikëvështrimin e tij (ne jemi të lindur me përfaqësues të Dreqit në trupat tonë). Kjo i lejon njerëzit të bëjnë zgjedhje në mes të dëshmisë së Zotit dhe dëshmisë së Dreqit. Dëshmia e Dreqit është pandashëm e bazuar në gënjeshtër. Ky sistem e shpjegon faktin që agjentët e djallit vazhdimisht shpikin edhe gënjeshtër më absurde, fyerjet dhe akuzat kundër secilit të dërguar. (shih 6:33-34, 8:30, 17:76-77, 27:70).

furnizime të mira. Zoti është padyshim Furnizuesi më i mirë.

[59] Patjetër, Ai do i pranojë ata në pranim që do i kënaqë. Zoti është i Gjithëdijsëm, i Butë.

Ndihmë Hyjnore për të shtypurit

[60] Është shpallur që nëse dikush merr hakun për një padrejtësi që i është shkaktuar, me barazi, pastaj ai keqtrajtohet për shkak të kësaj, Zoti patjetër do e përkrahë atë. Zoti është Shlyes Mëkatesh, Falës.

Gjithëfuqishmëria e Zotit

[61] Është fakt se Zoti shkrinë natën në ditë, dhe shkrinë ditën në natë, dhe se Zoti është Dëgjues, Pamës.

[62] Është fakt se Zoti është e Vërteta, përderisa ngritja e idhujve përkrah Tij përbën gënjeshtër, dhe se Zoti është Më i Larti, Supremi.

[63] A nuk e sheh që Zoti derdhë nga qielli ujë që e bën tokën blerinë? Zoti është Preciz, Njohës.

[64] E atij është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Absolutisht, Zoti është Më i Pasuri, Më i Falënderuari.

[65] A nuk e sheh që Zoti ka parashtruar në shërbimin tuaj çdo gjë në tokë? Anijet lëvizin në oqean me urdhrin e Tij. Ai i ndalon trupat qiellor nga rënia në tokë, përveç në përputhje me urdhrin e Tij. Zoti është Më i Dashuri ndaj njerëzve, i Mëshirshmi.

[66] Ai është ai që ju dha jetë, pastaj Ai ju vë në vdekje, pastaj Ai ju sjell prapë në jetë. Padyshim, qenia njerëzore është mosmirënjohëse.

[67] Për secilën asamble, kemi shpallur bashkësi ritesh që duhet t'i përmbahen. Prandaj, ata nuk duhet të grinden me ty. Të vazhdosh t'i ftosh të gjithë te Zotëruesi yt. Padyshim, ti je në rrugën e drejtë.

[68] Nëse grinden me ty, atëherë thuaj, "Zoti është tërësisht i vetëdijsëm për çdo gjë që bëni."

[69] Zoti do të gjykojë mes jush në Ditën e Ringjalljes sa i përket të gjitha grindjeve tuaja.

[70] A nuk e kupton se Zoti di çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë? E gjithë kjo është e regjistruar në regjistër. Kjo është lehtë për Zotin që ta bëjë.

[71] Prapëseprapë, ata idhujtarizojnë përkrah Zotit idhuj në të cilët Ai nuk vuri fuqi, dhe ata nuk dinë asgjë për ta. Shkelësit nuk kanë ndihmues.

Dhuna & kacafytja: Shenja mosbesimi

[72] Kur shpalljet tona iu recitohen atyre, qartë, vëren keqdashje në fytyrat e atyre që nuk besojnë. Ata gati sa nuk i sulmojnë ata që ua recitojnë shpalljet tona. Thuaj, "A t'ju njoftoj për diçka shumë më të keqe? Ferr premtohet nga Zoti për ata që nuk besojnë; çfarë fati i tmerrshëm."

A mund të krijojnë një mizë?

[73] O njerëz, ja një shembull që duhet ta mendoni thellë: idhujt që i ngritni përkrah Zotit nuk mund të krijojnë një mizë, edhe sikur të bëheshin së bashku për të bërë ashtu. Aq më shumë, nëse miza vjedh diçka prej tyre, ata nuk mund ta rimarrin; i dobët është ndjekësi dhe e ndjekura.

[74] Ata nuk e vlerësojnë Zotin siç duhet të vlerësohet. Zoti është Më i Fuqishmi, i Plotfuqishmi.

[75] Zoti zgjedhë nga mes engjëjve të dërguarë, si dhe nga mes njerëzve. Zoti është Dëgjues, Pamës.

[76] Ai di të kaluarën e tyre dhe të ardhmen e tyre. Zotit i takon rregullimi përfundimtar i të gjitha çështjeve.

[77] O ju që besoni, të përkuleni, të përuleni, adhuroni Zotëruenin tuaj, dhe punoni drejtësi, që të mund të keni sukses.

*Ibrahimi: I dërguar fillestar i Islamit**

[78] Të përpigëni për Zotin siç duhet të përpigëni për Të. Ai ju ka zgjedhur juve dhe nuk ka vënë vështirësi në zbatimin e fesë suaj – fesë së babait tuaj Ibrahimit. Ai është ai që ju emëroi “të Nënshtruar” fillimisht. Kështu, i dërguari të shërbejë si dëshmitar mes jush, dhe ju të shërbeni si dëshmitarë mes njerëzve. Prandaj, t’i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe mbështetuni te Zoti; Ai është Zotëruesi juaj; Zotëruesi më i mirë dhe Përkrahësi më i mirë.

Surja 23: Besimtarët (El-Mu'minun)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Vërtetë të suksesshëm janë besimtarët;

[2] që janë të kujdesshëm gjatë Lutjeve të tyre të Kontaktit (Salat).

[3] Dhe i shmangen fjalëve të kota.

[4] Dhe japin bamirësinë e tyre të obligueshme (Zeqat).

[5] Dhe e mbajnë dëlirësinë.

[6] Vetëm me bashkëshortet e tyre, ose ato që janë me të drejtë të tyre, kanë ata marrëdhënie seksuale; ata nuk janë për tu fajësuar.

[7] Ata që i shkelin këta kufij janë shkelësit.

[8] Kur vjen puna te depozitat që iu besohen, si dhe ndonjë marrëveshje që bëjnë, ata janë të besueshëm.

[9] Dhe i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat) rregullisht.

[10] Të tillë janë trashëguesit.

[11] Do të trashëgojnë Parajsën, ku qëndrojnë përgjithmonë.

Embrionologji e saktë

[12] E krijuam qenien njerëzore prej një lloji të caktuar balte.

[13] Më pas, e riprodhojmë atë nga një pikël, që vendoset në vend të ruajtur mirë.

[14] Pastaj e zhvilluam piklën në (embrion) të varur, pastaj e zhvilluam (embrionin) e varur sa një copë (fetusi), pastaj e krijuam copën (fetusin) në eshtra, pastaj i mbuluam eshtrat me mish. Kështu prodhojmë një krijesë të re. Më i bekuari është Zoti, më i miri Krijues.

[15] Pastaj, më vonë, vdisni.

[16] Pastaj, në Ditën e Ringjalljes, do të ringjalleni.

Shtatë gjithësitë

[17] Krijuam mbi ju shtatë gjithësi në shtresa, dhe nuk jemi kurrë të pavëmendshëm për asnjë krijesë në to.

Bekime të panumërta nga Zoti

[18] Zbritëm nga qielli ujë, në masë të saktë, pastaj e deponojmë në tokë. Padyshim, mund ta lëmë të rrjedhë.

[19] Me të, ne prodhojmë për ju kopshte dhe palma hurmash, hardhi, të gjitha llojet e frutave, dhe ushqime të llojllojshme.

* 22:78 Edhe pse të gjithë të dërguarit predikuan një dhe të njëjtin lajm, “Adhurimin e vetëm Zotit,” Ibrahimi ishte i dërguari i parë që e nxori termin “Nënshtrim” (Islam) dhe “i Nënshtruar” (Mysliman) (2:128). Çka kontribuoi Ibrahimi në Nënshtrim? Mësojmë prej 16:123 që të gjitha obligimet fetare në Nënshtrim janë shpallur nëpërmjet Ibrahimit (shih Shtojcat 9 & 26).

[20] Gjithashtu, një pemë që rritet në Sinai prodhon vaj, si dhe mëlmesë për ngrënësit.

[21] Dhe bagëtia duhet t'ju japë mësim. Ju lëmë të pini (qumësht) nga barqet e tyre, nxirrni dobi të tjera prej tyre, dhe disa prej tyre i përdorni për ushqim.

[22] Në to, dhe në anijet, ju hipni.

Nuhu

[23] E dërguam Nuhun te njerëzit e tij, duke thënë, "O njerëzit e mi, adhuroni Zotin. Nuk keni asnjë zot tjetër përkrah Tij. A nuk do të jeni të drejtë?"

[24] Udhëheqësit që nuk besuan mes njerëzve të tij thanë, "Ky nuk është asgjë më shumë se një njeri si ju, që dëshiron të arrijë dominim mes jush. Sikur të donte Zoti, ai do të dërgonte engjëj. Nuk kemi dëgjuar diçka të këstillë nga stërgjyshërit tanë.

[25] "Ai është thjeshtë një njeri që është çmendur. Thjeshtë injoroni për pak kohë."

[26] Ai tha, "Zotëruesi im, më jep fitore, se ata nuk më kanë besuar mua."

[27] Ne pastaj e frymëzuam atë: "ndërto lundrën* nën sytë tanë vigjilent, dhe në përputhje me frymëzimin tonë. Kur të vij urdhri ynë, dhe atmosfera të fryhet, vendos në të një çift të secilit lloj (të kafshëve tua shtëpiake) së bashku me familjen tënde, përveç atyre që janë mallkuar të dënohen. Mos fol me Mua në emër të atyre që shkelën; ata do të mbyten.

[28] "Kur të vendosesh, së bashku me ata që janë me ty, në lundër, të thuash, 'I lartmadhëruar qoftë Zoti se na shpëtoi nga njerëzit shpirtligj.'

[29] "Dhe thuaj, 'Zotëruesi im, le të zbarkoj në një vend të bekuar; T'i je dërguesi më i mirë.'"

[30] Këto duhet të furnizojnë prova të mjaftueshme për ju. Padyshim do t'ju vëmë në test.

[31] Më pas, ne vendosëm gjeneratë tjetër pas tyre.

[32] Dërguam te ta një të dërguar nga mesi i tyre, duke thënë, "Ta adhuroni Zotin. Nuk keni asnjë zot tjetër përkrah Tij. A nuk do të jeni të drejtë?"

[33] Udhëheqësit mes njerëzve të tij që nuk besuan dhe refuzuan mendimin e Përjetësisë – edhe pse i furnizuam bujarisht në këtë jetë – thanë, "Ky nuk është asgjë më shumë se qenie njerëzore si ju. Ai ha nga çka hani ju, dhe pi si pini ju.

[34] "Nëse i bindeni një qenieje njerëzore si ju, atëherë ju jeni vërtetë humbës.

[35] "A ju premtan ai juve që, pasi të vdisni dhe të ktheheni në pluhur dhe eshtra, do të nxirreni prapë?

[36] "E pamundur, e pamundur vërtetë është çka ju premtohet juve.

[37] "Ne vetëm jetojmë këtë jetë – jetojmë dhe vdesim – dhe nuk do të ringjallemi.

[38] "Ai është thjeshtë një njeri që trilloi rrena dhe ia mveshi ato Zotit. Nuk do i besojmë atij."

[39] Ai tha, "Zotëruesi im, më jep fitore, se nuk më kanë besuar."

[40] Ai tha, "Së shpejti do i bien pishman."

[41] Ndëshkimi i goditi, me barazi, dhe kështu, i shndërruam në gërmadha. Njerëzit shpirtligj u prishën.

[42] Më pas, vendosëm gjenerata tjera pas tyre.

[43] Asnjë shoqëri nuk mund ta ngusë fatin e saj të paracaktuar, as ta shtyjë.

[44] Pastaj dërguam të dërguarit tonë varg. Sa herë që një i dërguar shkoi te shoqëria e vet, ata nuk i besuan. Si pasojë, i asgjësuam ata, njërin pas tjetrit, dhe i bëmë histori. Njerëzit që nuk besuan

* 23:27 Tregimtarët kanë krijuar tallje nga historia e Nuhut. Arka e Nuhut ishte lundër e rrafshët e ndërtuar nga trunje, të lidhur së bashku me litarë primitiv (54:13), vërshimi ishte në atë regjion, rreth rajonit të Detit të Vdekur, dhe kafshët ishin kafshët shtëpiake të Nuhut.

janë prishur.

Moisiu dhe Aroni

[45] Pastaj dërguam Moisiun dhe vëllanë e tij Aronin me shpalljet tona dhe provë të thellë.

[46] Te Faraoni dhe këshilltarët e tij, por ata u bënë mendjemëdhenj. Ata ishin njerëz shtypës.

[47] Thanë, “A të besojmë për hatër të dy njerëzve, njerëzit e të cilëve janë sklevërit tanë?”

[48] Ata i refuzuan të dy, dhe si pasojë, u asgjësuan.

[49] I dhamë Moisiut shkrimin, që të mund të udhëzohen.

[50] E bëmë të birin e Marisë dhe nënën e tij shenjë, dhe iu dhamë strehim në një rrafshnaltë me ushqim dhe pije.

Një Zot/ Një fe

[51] O ju të dërguarë, hani prej furnizimeve të mira, dhe punoni drejtësi. Unë jam tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëni.

[52] E tillë është asambleja juaj – një asamble – dhe Unë jam Zotëruesi juaj; të ma keni dronë Mua.

[53] Por ata u ndanë në grupe që grinden; secila parti të kënaqur me çka kanë.

[54] Prandaj, thjeshtë lëri ata në hutinë e tyre, për ca kohë.

[55] A mendojnë ata që, pasi që i furnizua me para dhe fëmijë,

[56] duhet të derdhim edhe bekimet mbi ta? Në të vërtetë, as idenë nuk e kanë.

[57] Padyshim, ata që janë të vetëdijshëm për Zotëruesin e tyre,

[58] Dhe që besojnë në shpalljet e Zotëruesit të tyre,

[59] Dhe që nuk ngritin idhuj përkrah Zotëruesit të tyre,

[60] Përderisa japin bamirësitë e tyre zemrat e tyre dridhen. Se ata e kuptojnë që do të mblidhen para Zotëruesit të tyre,

[61] Ata nxitojnë të bëjnë punë të drejta; Garojnë në bërjen e tyre.

Mosbesimtarët mosmirënjohës

[62] Nuk e ngarkojmë asnjë shpirt përtej mundësive të veta, dhe mbajmë regjistër që shprehë të vërtetën. Askush nuk do të vuaj padrejtësi.

[63] Për shkak se mendjet e tyre janë të pavëmendshme ndaj kësaj, ata kryejnë punë që nuk janë në përputhje me këtë; punët e tyre janë të këqija.

[64] Pastaj, kur i shpaguajmë udhëheqësit e tyre me ndëshkim, ata ankohen.

[65] Mos u ankoni tash; keni hequr dorë nga ndihma jonë.

[66] Provat e Mia u janë paraqitur juve, por ju ua kthyet shpinën.

[67] Ishit tepër mendjemëdhenj për t'i pranuar, dhe me shkujdesje i shpërfillët.

[68] Pse nuk pasqyrojnë në këtë shkrim? A nuk e kuptojnë që kanë pranuar diçka që nuk e kanë pasur paraardhësit e tyre?

[69] A nuk kanë arritur ta njohin të dërguarin e tyre? A është kjo pse po e shpërfillin atë?

[70] A kanë vendosur që ai është i çmendur? Në të vërtetë, ai e ka sjellë të vërtetën te ta, por shumica e tyre e urrejnë të vërtetën.

[71] Në të vërtetë, sikur e vërteta të përputhej me dëshirat e tyre, do të kishte kaos në qiej dhe tokë; çdo gjë në to do të ishte e korruptuar. U kemi dhënë atyre provën e tyre, por ata po e shpërfillin provën e tyre.

[72] A po iu kërkon atyre pagë? Rroga e Zotëruesit tënd është shumë më e mirë. Ai është Furnizuesi më i mirë.

[73] Padyshim, je duke i ftuar në rrugë të drejtë.

[74] Ata që nuk besojnë në Përjetësinë patjetër do të devijojnë nga rruga e drejtë.

[75] Edhe kur derdhëm mbi ta mëshirën, dhe ua hoqëm problemet e tyre, ata u futën më thellë në shkelje, dhe vazhduan të bredhin.

[76] Edhe kur i pllakosëm me ndëshkim, ata nuk iu kthyen Zotëruesit të tyre me përgjërime.

[77] Më pas, kur i shpaguam me ndëshkimin e rëndë që kishin vetëshkaktuar, ata u tronditën.

[78] Ai është Ai që jua dhuroi dëgjimin, shikimin, dhe mendjen. Rrallë jeni mirënjohës.

[79] Ai është Ai që ju vendosi në tokë, dhe para Tij do të mblidheni.

[80] Ai është Ai që ka në dorë jetë dhe vdekje, dhe Ai është Ai që e ndërron natën dhe ditën. A nuk kuptoni?

[81] Ata thanë çka thanë paraardhësit e tyre.

[82] Ata thanë, "Pasi të vdesim dhe të bëhemi pluhur e eshtra, ringjallemi?"

[83] "Premtime të tilla na janë dhënë neve dhe prindërve tanë në të kaluarën. Këto nuk janë asgjë më shumë se përralla të moçme."

*Shumica e besimtarëve janë të paracaktuar për Ferr**

[84] Thuaj, "E kujt është toka dhe çdokush në të, nëse dini?"

[85] Ata do të thonë, "E Zotit." Thuaj, "Pse atëherë nuk merrni vesh?"

[86] Thuaj, "Kush është Zotëruesi i të shtatë gjithësive; Zotëruesi i pushtetit të madh?"

[87] Do të thonë, "Zoti." Thuaj, "Pse atëherë nuk po bëheni të drejtë?"

[88] Thuaj, "Kush e ka në dorë gjithë sovranitetin mbi të gjitha gjërat, dhe Ai është i vetmi që mund të japë ndihmë, por nuk ka nevojë për ndihmë, nëse dini?"

[89] Do të thonë, "Zoti." Thuaj, "Çka nuk është në rregull me ju?"

[90] U kemi dhënë atyre të vërtetën, përderisa ata janë gënjeshtarë.

[91] Zoti nuk ka lindë djalë. As nuk ka pasur kurrë ndonjë zot përkrah Tij. Përndryshe, secili zot do të kishte deklaruar pavarësi me krijesat e veta, dhe do të kishin garuar me njëri tjetrin për dominim. I madhëruar qoftë Zoti; shumë larg nga pretendimet e tyre.

[92] Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve; qoftë i lartësuar Ai, shumë larg nga të pasurit e ndonjë partneri.

[93] Thuaj, "Zotëruesi im, nëse ma tregon (ndëshkimin) që e kanë vetëshkaktuar

[94] "Zotëruesi im, le të mos jem njëri prej njerëzve shkelës."

[95] Të të tregojmë (ndëshkimin) që e kemi rezervuar për ta është diçka që mund ta bëjmë lehtë.

[96] Prandaj, ktheji punët e këqija të tyre me të mirë; ne jemi tërësisht të vetëdijshëm për pretendimet e tyre.

Për tu mbrojtur nga Dreqi

[97] Thuaj, "Zotëruesi im, kërkoj strehim te Ti prej pëshpëritjeve të dajve.

[98] "Dhe kërkoj strehim te Ti, Zotëruesi im, se mos më afrohen afër."

Të vdekurit nuk kthehen deri në Ditën e Ringjalljes

[99] Kur vdekja vjen te dikush prej tyre, ai thotë, "Zotëruesi im, më kthe prapa.

[100] "Unë pastaj do të punoj drejtësi në çdo gjë që kam lënë." Nuk është e vërtetë. Ky është vetëm një pretendim i rremë që e bën ai. Një barrierë do të ndajë shpirtin e tij nga kjo botë deri në ringjallje.

* 23:84-89 Besimi në Zot është i vlefshëm vetëm nëse i njeh cilësitë e Zotit, siç është fakti që Zoti i drejton të gjitha gjërat (8:17). Besimtarët që nuk e njohin Zotin nuk janë vërtetë besimtarë. Shumica e besimtarëve asgjësojnë besimin e tyre duke idolizuar idhuj të tillë të pafuqi siç janë profetët dhe të shenjtët (6:106).

- [101] Kur t'i bihet bririt, asnjë lidhje familjare mes tyre nuk do të ekzistojë në atë ditë, as nuk do të pyesin për njëri tjetrin.
- [102] Sa për ata peshat e të cilëve janë të rënda, ata do të jenë fituesit.
- [103] Ata peshat e të cilëve janë të lehta janë ata që i humbën shpirtrat e tyre; ata qëndrojnë në Ferr përgjithmonë.
- [104] Zjarr do i kaplojë fytyrat e tyre, dhe vazhdojnë me vuajtje në të.
- [105] A nuk ju recituan juve shpalljet e Mia, dhe ju vazhduat t'i refuzoni?
- [106] Ata do të thonë, "Zotëruesi ynë, shpirtligësia jonë na kaploi, dhe ishim njerëz të humbur.
- [107] "Zotëruesi ynë, nxirrna nga kjo; nëse i kthehemi (sjelljeve të vjetra) atëherë vërtetë jemi shpirtligj."
- [108] Ai do të thotë, "Rrini aty, të poshtëruar, dhe mos më flisni Mua.

Ata i përqeshën besimtarët

- [109] "Një grup i shërbëtorëve të Mi thoshte, 'Zotëruesi ynë, kemi besuar, prandaj falna dhe derdh mbi ne mëshirë. Nga të gjithë të mëshirshmit, Ti je më i Mëshirshmi.'
- [110] "Por ju i përqeshët dhe u tallët me ta, aq sa më harruat Mua. Dikur i qeshnit ata.
- [111] "I kam shpërblyer ata sot, si shpërblim për durimin e tyre, duke i bërë ata fituesit."
- [112] Ai tha, "Sa keni zgjatur në tokë? Sa vjet?"
- [113] Ata thanë, "Zgjatëm një ditë ose një pjesë të ditës. Pyeti ata që numëruan."
- [114] Ai tha, "Në të vërtetë, ju ndenjtë vetëm për një periudhë të shkurtër, veç sikur ta dinit.
- [115] "A menduat se ju krijuam së koti; se nuk kishit për tu kthyer te ne?"
- [116] Më i lartësuar është Zoti, Sunduesi i vërtetë. Nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij; Më i Nderuari Zotëruesi, posedues i gjithë autoritetit.
- [117] Kushdo që idolizon përkrah Zotit ndonjë zot tjetër, dhe pa asnjë lloj prove, llogaridhënia e tij është me Zotëruesin e tij. Mosbesimtarët nuk ia dalin.
- [118] Thuaj, "Zotëruesi im, derdh mbi ne falje dhe mëshirë. Nga të gjithë të mëshirshmit, Ti je më i Mëshirshmi."

Surja 24: Drita (El-Nur)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Sure që e kemi zbritur, dhe e kemi shpallur ligj. Kemi shpallur në të shpallje të qarta, që të mund të merrni vesh.

Marrëdhënia jashtëmartesore

- [2] Gruan dhe burrin që bëjnë marrëdhënie jashtëmartesore t'i fshikulloni secilin prej tyre me njëqind fshikullima. Mos u lëkundni nga keqardhja nga zbatimi i ligjit të Zotit, nëse vërtetë besoni në Zotin dhe Ditën e Fundit. Dhe le të jetë një grup besimtarësh dëshmitar i dënimit të tyre.*
- [3] Burri që ka bërë marrëdhënie jashtëmartesore do të përfundojë i martuar me grua që ka bërë marrëdhënie jashtëmartesore ose me adhuruese idhujsh, dhe gruaja që ka bërë marrëdhënie jashtëmartesore do të përfundojë e martuar me burrë që ka bërë marrëdhënie jashtëmartesore ose adhurues idhujsh. Kjo është e ndaluar për besimtarët.
- [4] Ata që i akuzojnë gratë e martuara për marrëdhënie jashtëmartesore, pastaj nuk arrijnë të sjellin katër dëshmitarë, t'i fshikulloni ata me tetëdhjetë fshikullima, dhe mos pranoni asnjë dëshmi

* 24:2 Trysnia shoqërore, d.m.th. dëshmimi publik i dënimit, është dënimi themelor (shih gjithashtu 5:38). Fshikullimat të jenë simbolike, jo të rënda.

prej tyre; ata janë shpirtligj.

[5] Nëse pendohen më pas dhe përmirësohen, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[6] Sa për ata që i akuzojnë bashkëshortet e veta, pa asnjë dëshmitar tjetër, atëherë dëshmia mund të pranohet nëse betohet në Zotin katër herë që ai po e tregon të vërtetën.

[7] Betimi i pestë të jetë për ta pësuar ai dënimin e Zotit, nëse po gënjen.

[8] Ajo të konsiderohet e pafajshme nëse betohet në Zotin katër herë që ai është gënjeshtarë.

[9] Betimi i pestë të jetë për ta pësuar ajo zemërimin e Zotit nëse ai po e thoshte të vërtetën.

[10] Kjo është hirësi dhe mëshirë e Zotit ndaj jush. Zoti është Shpengues, Më i Mençuri.

Si të silleni me thashethemet dhe akuzat e pavërtetuara

[11] Një bandë mes jush nxori një gënjeshtër* të madhe. Mos mendoni se ishte keq për ju; në fakt, ishte mirë për ju. Ndërkohë, secili prej tyre e ka mbledhur hisen e vet të fajit. Sa për atë që e nisi tërë incidentin, ai ka vetëshkaktuar ndëshkim të tmerrshëm.

[12] Kur e dëgjuat, besimtarët dhe besimtare të dashur të kishin mendime më të mira për veten, dhe të kishin thënë, “Kjo është qartazi gënjeshtër e madhe.”

[13] Vetëm nëse i sjellin katër dëshmitarë (mund t’iu besoni). Nëse nuk arrijnë të sjellin dëshmitarët, atëherë ata janë, sipas Zotit, gënjeshtarë.

[14] Po të mos ishte hirësi e Zotit ndaj jush, dhe mëshirë e Tij në këtë botë dhe në Përjetësi, do të kishit vuajtur ndëshkim të madh për shkak të këtij incidenti.

[15] E trilluat me gjuhët tuaja, dhe të tjerët e përsëritët me gojët tuaja pa provë. Ju e morët si gjë të lehtë, kur, sipas Zotit, ishte e tepërt.

Çka të bëni

[16] Kur e dëgjuat, është dashur të thoni, “Ne nuk e ritregojmë këtë. I madhëruar qofsh Ti. Kjo është gënjeshtër e tepërt.”

[17] Zoti ju këshillon që të mos e bëni më, nëse jeni besimtarë.

[18] Zoti kështu shpjegon shpalljet për ju. Zoti është i Gjithëdijshtëm, i Mençur.

[19] Ata që duan të shohin imoralitet të përhapet mes besimtarëve kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb në këtë jetë dhe në Përjetësi. Zoti di, përderisa ju nuk dini.

[20] Zoti derdhë mbi ju hirësinë dhe mëshirën e Tij. Zoti është Më i Dashuri ndaj besimtarëve, i Mëshirshmi.

Djalli inkurajon akuza të pabaza

[21] O ju që besoni, mos i ndiqni hapat e Dreqit. Kushdo që ndjek hapat e Dreqit duhet ta di që ai përkräh të këqija dhe vese. Po të mos ishte hirësi e Zotit ndaj jush, dhe mëshirë e Tij, askush prej jush nuk do të ishte pastruar. Por Zoti pastron këdo Ai do. Zoti është Dëgjues, Njohës.

[22] Ata mes jush që janë të bekuar me burime dhe pasuri të jenë bamirës ndaj të afërmve të tyre, të varfërve, dhe atyre që kanë imigruar për hir të Zotit. T’i trajtojnë ata me dashamirësi dhe tolerancë; a nuk dëshironi të arrini faljen e Zotit? Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

Mëkat i tepërt

[23] Padyshim, ata që i akuzojnë gabimisht gratë e martuara që janë besimtare të ndershme kanë vetëshkaktuar dënim në këtë jetë dhe në Përjetësi; ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të tmerrshëm.

* 24:11 Kjo i referohet një incidenti historik ku e shoqja e Profetit Muhamed, Ajshja ishte lënë në shkretëtirë pa dashje, dhe më vonë u gjet nga një burrë i ri që i ndihmoi asaj që të arrijë karvanin e Profetit. Kjo e nisi “Gënjeshtërën e Madhe” të famshme kundër Ajshes.

[24] Do të vij dita kur gjuhët, duart, dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë për gjithçka që kishin bërë.

[25] Atë ditë, Zoti do i paguaj ata tërësisht për punët e tyre, dhe do të kuptojnë që Zoti është e Vërteta.

[26] Të këqijat për të këqijtë, dhe të këqijtë për të këqijat, dhe të mirat për të mirit, dhe të mirit për të mirat. Këta të fundit janë të pafajshëm nga akuzat e tilla. Ata kanë arritur falje dhe shpërblim bujar.

Etiketë Hyjnore

[27] O ju që besoni, mos hyni në shtëpi pos tuajave pa leje nga banuesit e tyre, dhe pa i përshëndetur. Kjo është më mirë për ju, që të mund të jeni të vëmendshëm.

[28] Nëse nuk gjeni askënd në to, mos hyni në to derisa të merrni leje. Nëse ju thuhet, "Kthehuni," duhet të ktheheni. Kjo është më pastër për ju. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëni.

[29] Nuk bëni gabim duke hyrë në shtëpi të pabanuara ku ka diçka që ju takon juve. Zoti di çdo gjë që tregoni, dhe çdo gjë që fshihni.

Kodi i veshjes për besimtarët

[30] Thuaju besimtarëve që t'i ulin shikimet e tyre (dhe të mos ua ngulin sytë grave), dhe ta mbajnë dëlirësinë. Kjo është më pastër për ta. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëjnë.

[31] Dhe thuaju besimtareve t'i ulin shikimet e tyre, dhe ta mbajnë dëlirësinë. Të mos e shfaqin asnjë pjesë të trupave të tyre, përveç asaj që është e nevojshme. T'i mbulojnë kraharorët e tyre, dhe të mos e çlirojnë këtë uniformë në prani të tjetërkujt pos burrave të vet, baballarëve të vet, baballarëve të burrave të vet, bijve të vet, bijve të burrave të vet, vëllezërve të vet, bijve të vëllezërve të vet, bijve të motrave të veta, grave tjera, shërbëtorëve meshkuj vrulli seksual i të cilëve është asgjësuar, ose fëmijëve të cilët nuk kanë arritur pubertetin. Të mos i kërcasin këmbët e tyre kur ecin për tu dridhur dhe për të shfaqur hollësi të caktuara të trupave të tyre. Të gjithë ju të pendoheni te Zoti, o ju besimtarë, që të mund t'ia dilni.*

Inkurajoni martesë për të dekurajuar imoralitet

[32] T'i inkurajoni ata mes jush që janë beqarë apo beqare që të martohen. Ata mund të martohen me të drejtit mes shërbëtorëve meshkuj dhe femra tuaja, nëse janë të varfër. Zoti do i pasurojë prej hirësisë së Tij. Zoti është Bujar, Njohës.

[33] Ata që nuk kanë mundësi të martohen ta mbajnë moralin derisa Zoti të furnizojë për ta prej hirësisë së Tij. Ata mes shërbëtorëve tuaj që dëshirojnë të lirohen që të martohen, t'ua plotësoni dëshirën, pasi që ta kuptoni që janë të sinqertë. Dhe jepni prej parave të Zotit që Ai ju ka dhuruar. Të mos i detyroni vajzat tuaja të bëjnë prostitucion, duke kërkuar gjërat materiale të kësaj bote, nëse ato dëshirojnë të jenë të dëlira. Nëse cilido i detyron ato, atëherë Zoti, duke e parë që janë të detyruara, është Falës, i Mëshirshëm.

[34] U kemi shpallur juve shpallje sqaruese, dhe shembuj nga gjeneratat e kaluara, dhe ndriçim për të drejtit.

Zoti

[35] Zoti është drita e qiejve dhe tokës. Alegoria e dritës së Tij është ajo e një pasqyre konkave pas

* 24:30-31 Veshja e përmbajtur, pra, është veti e besimtarëve dhe besimtareve. Kushti minimal për veshjen e një gruaje është që ta zgjasë veshjen e saj (33:59) dhe ta mbulojë kraharorin e saj. Traditat tiranike arabe kanë dhënë një përshtypje të gabuar që gratë duhet të mbulojnë nga maja e kokës deri në fund të këmbëve; e tillë nuk është veshja Kuranore ose Islamike.

një llambe që është e vendosur brenda një vazoje qelqi. Vazoja e qelqit është si një yll i ndritshëm. Vaji për të furnizohet nga një lis i bekuar vaj-nxjerrës, që nuk është as lindor, as perëndimor. Vaji i tij është gati vetë-ndriçues; nuk i nevojitet zjarr për ta ndezur. Dritë mbi dritë. Zoti udhëzon te drita e Tij kë do (që të jetë i udhëzuar). Zoti kështu përmendë shembujt për njerëzit. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[36] (Udhëzimi i Zotit gjendet) në shtëpitë e lartësuara nga Zoti, se emri i Tij përkujtohet në to. Duke e madhëruar Atë në to, ditë e natë -

Ata që frekuentojnë vendlutjen

[37] Njerëzve që nuk iu tërhiqet vëmendja nga punët ose tregtia prej përkujtimit të Zotit; i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe janë të vetëdijshëm për ditën kur mendjet dhe sytë do të tmerrohen.

[38] Zoti padyshim do i japë shpërblime për punët e mira të tyre, dhe do të derdhë mbi ta hirësinë e Tij. Zoti furnizon pa kufi për këdo që Ai do.

Ndjekin mirazh

[39] Sa për ata që nuk besojnë, punët e tyre janë si një mirazh në shkretëtirë. Një person i etur mendon që është ujë. Por kur arrin te ai, e gjen që nuk është asgjë, dhe e gjen Zotin në vend të tij, për ta paguar tërësisht për punët e tij. Zoti është llogaritësi më i shkathët.

Mërgimi nga Zoti: Errësi e plotë

[40] Alegori tjetër është të qenit në errësi të plotë në mes të një oqeani të dhunshëm, me valë mbi valë, plus mjegull të dendur. Errësi mbi errësi - sikur ai të shikonte dorën e vet, mezi se do e shihte. Kujtdo që Zoti nuk i lëshon dritë, nuk do të ketë dritë.

[41] A nuk e kuptoni që çdokush në qiej dhe tokë e madhëron Zotin, madje edhe zogjtë përderisa fluturojnë në kolonë? Secili e di lutjen dhe madhërimin e tij. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për gjithçka që ata bëjnë.

[42] I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës, dhe te Zoti është fati përfundimtar.

[43] A nuk e kuptoni që Zoti i lëvizë retë, pastaj i mbledhë së bashku, pastaj i grumbullon mbi njëra tjetrën, pastaj e shihni shiun duke dalë nga to? Ai zbret nga qielli borë për ta mbuluar këdo Ai, përderisa ia largon kujtdo Ai. Shkëlqimi i borës gati i verbon sytë.

[44] Zoti drejton natën dhe ditën. Ky duhet të jetë mësim për ata që kanë sy.

[45] Dhe Zoti krijoi çdo krijesë të gjallë nga uji. Disa prej tyre ecin me barqet e tyre, disa ecin me dy këmbë, dhe disa ecin me katër. Zoti krijon çka do Ai. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[46] Ju kemi zbritur shpallje sqaruese, pastaj Zoti udhëzon këdo që do (të jetë i udhëzuar) në rrugë të drejtë.

Zoti dërgon mësim nëpërmjet të dërguarit të Tij

[47] Ata thonë, "Besojmë në Zotin dhe në të dërguarin, dhe bindemi," por pastaj disa prej tyre tërhiqen prapa më pas. Këta nuk janë besimtarë.

[48] Kur thirren te Zoti dhe i dërguari i Tij për të gjykuar mes tyre, disa prej tyre mërzhiten.

[49] Mirëpo, nëse vendimi është në favor të tyre, ata e pranojnë me gatishtëri!

[50] A kanë sëmundje në zemrat e tyre? A po dyshojnë? A po frikësohen që Zoti dhe i dërguari i Tij mund t'i trajtojnë padrejtësisht? Në të vërtetë, janë ata që janë të padrejtë.

Besimtarët pa ngurrim i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij

[51] Shprehja e vetme e besimtarëve, sa herë që thirren te Zoti dhe i dërguari i Tij që të gjykojnë në çështjet e tyre, është të thonë, "Dëgjojmë dhe bindemi." Këta janë fituesit.

[52] Ata që i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe e respektojnë Zotin dhe ia kanë dronë Atij, janë triumfuesit.

[53] Ata bëjnë be në Zotin, solemnisht, që nëse i urdhëron të mobilizohen, do të mobilizoheshin. Thuaj, “Mos bëni be. Bindja është obligim. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.”

[54] Thuaj, “Bindjuni Zotit, dhe bindjuni të dërguarit.” Nëse refuzojnë, atëherë ai është përgjegjës për obligimet e tij, dhe ju jeni përgjegjës për obligimet tuaja. Nëse i bindeni atij, do të udhëzoheni. Detyra e vetme e të dërguarit është të transmetojë (lajmin).

Premtimi i Zotit: Mbretër dhe mbretëresha në tokë

[55] Zoti iu premtonte atyre që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, që Ai do i bëjë sundues në tokë, ashtu siç bëri për ata para tyre, dhe do të vendosë për ta fenë që Ai ka zgjedhur për ta, dhe do të zëvendësojë paqe dhe siguri për ta në vend të frikës. E gjithë kjo sepse ata më adhurojnë vetëm Mua; ata nuk ngritin asnjë idhull përkrah Meje. Ata që nuk besojnë pas kësaj janë vërtetë shpirtlligjtë.

Receta për sukses

[56] T’i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat) dhe të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe t’i bindeni të dërguarit, që të mund të arrini mëshirë.

[57] Mos mendo që ata që nuk besojnë do të shpëtojnë. Vendbanimi i tyre përfundimtar është Ferr; çfarë fati i tmerrshëm.

Rregulla mirësjelljeje - Dy Lutje të përmendura me emër

[58] O ju që besoni, shërbëtorët tuaj dhe fëmijët që nuk kanë arritur pubertetin duhet të kërkojnë leje (para se të hynë në dhomat tuaja). Kjo duhet të bëhet në tre raste - para Lutjes së Agimit, në mesditë kur i ndërroni rrobat për të pushuar, dhe pas Lutjes së Natës. Këto janë tri kohë private për ju. Në kohë të tjera, nuk është gabim për ju ose ata që të përziheni me njëri tjetrin. Zoti kështu sqaron shpalljet për ju. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Më i Mençuri.

[59] Kur fëmijët të arrijnë pubertetin, ata duhet të kërkojnë leje (para se të hynë) ashtu siç kanë kërkuar leje (para se të hynë) ata që u bënë të rritur para tyre. Zoti kështu sqaron shpalljet e Tij për ju. Zoti është i Gjithëdijshtëm. Më i Mençuri.

Të visheni me modesti

[60] Gratë e moshuara që nuk presin të martohen nuk bëjnë asgjë gabim duke e çliruar kodin e veshjes së tyre, me kusht që të mos shfaqin tepër nga trupat e tyre. Mbajtja e modestisë është më mirë për to. Zoti është Dëgjues, Njohës.

Jini të sigurt që ushqimi juaj është i ligjshëm

[61] I verbëri nuk ka për tu fajësuar, sakati nuk ka për tu fajësuar, as invalidi nuk ka për tu fajësuar, ashtu si ju nuk keni për tu fajësuar për ngrënien në shtëpitë tuaja, ose në shtëpitë e baballarëve tuaj, ose në shtëpitë e nënave tuaja, ose shtëpitë e vëllezërve tuaj, ose shtëpitë e motrave tuaja, ose shtëpitë e vëllezërve të baballarëve tuaj, ose shtëpitë e motrave të baballarëve tuaj ose shtëpitë e vëllezërve të nënave tuaja, ose shtëpitë e motrave të nënave tuaja, ose shtëpitë që ju takojnë juve dhe i keni çelësat e tyre, ose shtëpitë e shokëve tuaj. Nuk bëni asgjë gabim duke ngrënë së bashku ose vetë. Kur hyni në ndonjë shtëpi, ta përshëndetni njëri tjetrin me përshëndetje prej Zotit që është e bekuar dhe e mirë. Zoti kështu shpjegon shpalljet për ju, që të mund të kuptoni.

[62] Besimtarët e vërtetë janë ata që besojnë në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe kur janë me të në një mbledhje të përbashkët, ata nuk e lënë pa lejen e tij. Ata që kërkojnë leje janë ata që besojnë

në Zotin dhe të dërguarin e Tij. Nëse kërkojnë leje prej teje, për tu kujdesur për ndonjë çështje të tyre, mund t'iu japësh leje kujt do që dëshiron, dhe kërko nga Zoti që t'i falë. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.

[63] Mos i trajtoni porositë e të dërguarit siç i trajtoni porositë e njëri tjetrit. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për ata mes jush që ikin tinëz duke përdorur arsyetime të liga. Le të ruhen - ata që nuk i binden urdhrave të tij - se një fatkeqësi mund t'i godasë ata, ose një ndëshkim i rëndë.

[64] Absolutisht, e Zotit është çdo gjë në qiej dhe tokë. Ai e di tërësisht çdo gjendje në të cilën mund të jeni. Ditën kur kthehen te Ai, Ai do i njoftojë për çdo gjë që kishin bërë. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Surja 25: Kodi ligjor (El-Furkan)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Më i bekuari është Ai që shpalli Kodin Ligjor te shërbëtori i Tij, që ai të shërbejë si paralajmërues për krejt botën.

[2] Ai të cilit i takon i gjithë sovraniteti i qiejve dhe tokës. Ai kurrë nuk pati të bir, as nuk pati asnjë partner në sovranitet. Ai krijoi çdo gjë në masë të saktë. Ai e dizajnoi saktësisht çdo gjë.*

[3] Prapëseprapë, ata ngritin përkrah Tij zota që nuk krijojnë asgjë - vetë janë të krijuar – dhe që nuk kanë aspak fuqi as ta dëmtojnë as t'i sjellin dobi vetes, as nuk kanë aspak fuqi të drejtojnë jetë, ose vdekje, ose ringjallje.

Mosbesimtarët kundërshtohen nga Kodi Matematikor i Kuranit

[4] Ata që nuk besuan thanë, “Ky është trillim që ai e nxori, me ndihmën e disa njerëzve tjerë.” Ata kanë shprehur një blasfemi dhe pavërtetësi.

[5] Ata gjithashtu thanë, “Përralla të moçme që ai i shkroi; ato iu diktuan atij ditë e natë.”*

[6] Thuaj, “Ky u shpall nga Ai që e di Sekretin* në qiej dhe tokë. Ai është Falës, i Mëshirshmi.”

Shprehjet tipike të mosbesimtarëve

[7] Dhe ata thanë, “Ç’është me këtë të dërguar që ha ushqim dhe ecë nëpër tregje? Veç sikur një engjëll të mund të zbriste te ai, që të shërbejë me të si predikues!”

[8] Ose, “Veç sikur një thesar të mund t’i jepej atij!” Ose, “Veç sikur ai të mund të kishte një kopsht prej të cilit ai han!” Shkelësit gjithashtu thanë, “Ju po ndiqni një njeri të magjepsur.”

[9] Vëreje se si të thirrën me lloj lloj emrash, dhe si kjo i çoi në humbje, për të mos e gjetur kurrë më rrugën e drejtë.

[10] Më i bekuari është Ai që mund, nëse Ai do, të të japë shumë më mirë se kërkesat e tyre – kopshte me proje që rrjedhin, dhe shumë pallate.

Arsyeja e vërtetë

[11] Në fakt, ata nuk kanë besuar në Orën (Ditën e Ringjalljes), dhe kemi përgatitur për ata që nuk

* 25:2 Kur ne lëshojmë astronautë në hapësirë, e masim saktësisht sasinë e ushqimit, ujit, oksigjenit, dhe nevojave tjera përgjatë udhëtimit. Ngjashëm, Zoti na ka lëshuar neve në hapësirë - të hipur në anijen kozmike Toka – dhe Ai ka dizajnuar të gjitha llojet e furnizimeve të ripërtërishtme për ne dhe krijesat tjera, dizajn i përkryer. Mendo, për shembull, për lidhshmërinë simbiotike mes nesh dhe bimëve; ne përdorim oksigjeni që ato prodhojnë me fotosintezë, përderisa ato përdorin dioksidin e karbonit që ne prodhojmë me frymëmarrje.

* 25:5 Bashkëkohësit e Muhamedit e dinin që ai ishte njeri i shkolluar që mund të lexonte dhe të shkruante; ai i shkroi shpalljet e Zotit me dorën e vet. (shih Shtojcën 28).

* 25:6 Kodi i mrekullueshëm matematikor i Kuranit, përgjigjja e pakundërshtueshme ndaj pretendimeve të mosbesimtarëve, mbeti sekret i ruajtur hyjnisht për 1400 vjet. I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes ishte paracaktuar që ta zbulojë atë me lejen e Zotit (Shtojcat 1, 2, & 26).

besojnë në Orën një Ferr flakë.

Ndëshkim për mosbesimtarët

[12] Kur ai i sheh ata nga larg, do të dëgjojnë shkulmin dhe tymin e tij.

[13] Dhe kur të hidhen në të, nëpërmjet një vendi të ngushtë, krejt të prangosur, do të deklarojnë brejtjen e ndërgjegjes së tyre.

[14] Ju nuk do të deklaroni vetëm një brejtje ndërgjegjeje, atë ditë; do të vuani nëpër një numër të madh brejtjesh ndërgjegjeje.

Shpërblim për të drejtit

[15] Thuaj, "A është kjo më mirë apo Parajsa e përhershme që është premtuar për të drejtit? Është shpërblimi i tyre fare mirë i merituar; fat fare mirë i merituar."

[16] Ata kanë çfarëdo që dëshirojnë aty, përgjithmonë. Ky është premtimi i pakthyesëm i Zotëruesit tënd.

[17] Ditën kur Ai i mbledhë ata, së bashku me idhujt që kishin ngritur përkrah Zotit, Ai do të thotë, "A i keni çorientuar këta shërbëtorët e Mi, apo ata shkuan në humbje vet?"

[18] Ata do të thonë, "Qofsh i madhëruar, nuk ishte e drejtë për ne që të ngrisim zotëruesë përkrah Teje. Por Ti i lejove ata të kënaqen, së bashku me prindërit e tyre. Si pasojë, ata e shpërfillën lajmin dhe kështu u bënë njerëz shpirtligj."

[19] Ata nuk kanë besuar në lajmin që ua keni dhënë atyre, dhe, si pasojë, nuk mund as t'i mbronin nga ndëshkimi që kanë vetëshkaktuar, as nuk mund t'iu ndihmoni në asnjë mënyrë. Kushdo prej jush që vepron keq, ne do e parashtrojmë në ndëshkim të rëndë.

Të dërguarit janë thjeshtë qenie njerëzore

[20] Nuk dërguam asnjë të dërguar para teje që nuk hëngri ushqim dhe eci nëpër tregje. Kështu ju testojmë me njëri tjetrin; a do të duroni me këmbëngulje? Zotëruesi yt është Pamës.

[21] Ata që nuk presin të na takojnë, thanë, "Veç sikur engjëjt të mund të zbritnin te ne, ose të mund ta shihnim Zotëruesin tonë (atëherë do të besonim)!" Në fakt, ata kanë kryer një mendjemadhësi të tepërt, dhe kanë prodhuar një blasfemi të tepërt.

[22] Ditën kur ata i shohin engjëjt, nuk do të jetë lajm i mirë për fajtorët; do të thonë, "Tash jemi të mbyllur pakthyesëm."

[23] Do i shikojmë të gjitha punët që i kanë bërë, dhe t'i bëjmë ato të pavlefshme dhe të asgjësuar.

[24] Banuesit e Parajsës janë shumë më mirë atë ditë; ata do të dëgjojnë lajme më të mira.

[25] Qielli do të çahet, në masa resh, dhe mori engjëjsh do të zbrasin.

[26] I gjithë sovraniteti në atë ditë është i Mirëbërësit. Për mosbesimtarët, do të jetë ditë e vështirë.

*I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes**

[27] Do të vij dita kur shkelësi do të kafshojë dorën e tij (në ankth) dhe të thotë, "Vaj, ah sikur ta kisha ndjekur rrugën me të dërguarin.

[28] "Vaj, mjerë unë, ah sikur të mos e kisha bërë shok atë person.

[29] "Ai më ka çuar larg nga lajmi pasi që më erdhi. Në të vërtetë, djalli e braktisë viktimën e tij

* 25:27-30 Kjo strofë gjithashtu i referohet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes emri i të cilit është matematikisht i koduar në Kuran si "Rashad Khalifa". Nëse e shkruani vlerën gërmore të "Rashad" (505), të ndjekur me vlerën gërmore "Khalifa" (725), të ndjekur me numrin e kësaj sure (25), të ndjekur me strofat 27, 28, 29, dhe 30, numri i fundit (5057252527282930) është shumëfish i 19-tës (shih Shtojcat 2 & 26 për hollësitat). Profeti Muhamed do të bëjë gjithashtu një pohim të tillë si në 25:30 në Ditën e Gjykimit.

njerëzore.”

[30] I dërguari tha, “Zotëruesi im, njerëzit e mi e kanë braktisur këtë Kuran.”

[31] Ne gjithashtu ngrisim kundër secilit profet armiq nga fajtorët. Zotëruesi yt mjafton si udhëzues, sundues.

[32] Ata që nuk besuan thanë, “Pse nuk erdhi Kurani nëpërmjet tij i tëri përnjëherë?” E kemi lëshuar te ti gradualisht, në mënyrë që ta ngulitim në memorien tënde. E kemi recituar në rend të caktuar.

Evidenca e Zotit është e pakalueshme

[33] Çfarëdo argumenti që të sjellin, ne të japim të vërtetën, dhe kuptueshmëri më të mirë.

[34] Ata që shtyhen me dhunë në Ferr janë në gjendjen më të keqe; ata janë më së largu nga rruga e drejtë.

[35] I kemi dhënë Moisiut shkrimin, dhe e caktuam vëllanë e tij Aronin të jetë ndihmësi i tij.

[36] U thamë, “Shkoni të dy ju, te njerëzit që refuzuan shpalljet tona,” dhe më pas, ne i asgjësua refuzuesit krejtësisht.

[37] Ngjashëm, kur njerëzit e Nuhut nuk iu besuan të dërguarve, i mbytëm, dhe i uadisëm si shenjë për njerëzit. Kemi përgatitur për shkelësit ndëshkim që dhemb.

[38] Gjithashtu Adin, Themudin, banorët e Resit, dhe shumë gjenerata ndërmjet tyre.

[39] Te secili prej këtyre grupeve, ne çuam shembuj të mjaftueshëm, para se t’i asgjësonim.

[40] Ata kanë kaluar nga shoqëria që mbi të u derdh breshëri e tmerrshme (Sodoma). A nuk e panë? Por nuk besuan në ringjallje.

Të dërguarit përqeshen

[41] Kur ata të shihnin, gjithmonë të përqeshnin: “A është ky ai i zgjedhuri nga Zoti për të qenë i dërguar?

[42] “Ai gati na largoi nga zotat tanë, po të mos ishte që do të këmbëngulnim me durim me ta.” Ata padyshim do të marrin vesh, kur ta shohin ndëshkimin se kush janë ata që kanë humbur rrugën e vërtetë.

Uni si zot

[43] A e ke parë atë zot i të cilit është uni i vet. A do të jesh përkrahës i tij?

[44] A mendon se shumica e tyre dëgjojnë, ose kuptojnë? Ata janë si kafshët; jo, ata janë shumë më të këqij.

Bekime të pakufi nga Zoti

[45] A nuk e ke parë se si Zotëruesi yt e dizajnoi hijen? Po të donte Ai do e bënte të palëvizshme, atëherë ne do e kishim dizajnuar diellin në përputhje me të.

[46] Por ne e dizajnuam që të lëvizë ngadalë.

[47] Ai është Ai që dizajnoi natën që të jetë mbulesë, dhe për ju që të flini dhe të çlodheni. Dhe e bëri ditën ringjallje.

[48] Ai është Ai që dërgon erërat me ogure të mira për mëshirën e Tij, dhe lëshojmë nga qielli ujë të pastër.

[49] Me të, ngjallim tokat e vdekura dhe furnizojmë ujë për krijesat tona - mori kafshësh dhe njerëzish.

[50] E kemi shpërndarë mes tyre në përmasë të saktë, që të mund të jenë të vëmendshëm. Por shumica e njerëzve insistojnë të mos besojnë.

[51] Sikur të donim, do të kishim mundur të dërgojmë në çdo shoqëri paralajmërues.

- [52] Prandaj, mos iu bind mosbesimtarëve, dhe përpiqu kundër tyre me këtë, përpjekje e madhe.
- [53] Ai është Ai që i shkrinë dy detet; njëri është i freskët dhe i ëmbël, përderisa tjetri është i njelmët dhe i papijshëm. Dhe Ai i ndau ata me barrierë të fortë të qëndrueshme (avullim).
- [54] Ai është Ai që krijoi prej uji qenien njerëzore, pastaj e bëri që të riprodhojë nëpërmjet martesës dhe çiftëzimit. Zotëruesi yt është i Gjithëfuqishëm.
- [55] Prapëseprapë, ata ende ngritin përkrah Zotit idhuj që nuk mund t'iu sjellin dobi, as t'i dëmtojnë. Në të vërtetë, mosbesimtari është armik i Zotëruesit të vet.
- [56] Të kemi dërguar ty si dërgues lajmi të mirë, si dhe si paralajmërues.*
- [57] Thuaj, "Unë nuk kërkoj para nga ju. Krejt çka kërkoj është t'ju ndihmoj që ta gjeni rrugën drejt Zotëruesit tuaj, nëse kjo është çka zgjidhni."

Profetët dhe të shenjtët janë të vdekur

- [58] Të kesh besim në Atë që është i Gjallë – Atë që nuk vdes kurrë – dhe lartmadhëroje Atë dhe madhëroje Atë. Ai është Njohës i tërësishëm i mëkateve të krijesave të Tij.
- [59] Ai është Ai që krijoi qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë ndërmjet tyre, për gjashtë ditë, dhe mori të gjitha në dorë. Mirëbërësi; pyeti për Të ata që janë mirë të bazuar në dije.

Njeriu mosmirënjohës

- [60] Kur atyre iu thuhet, "Bini në përlulje para Mirëbërësit," ata thonë, "Çka është Mirëbërësi? A të përulemi para çka na thua ti?" Kështu, ajo vetëm ua shton neverinë.
- [61] Më i bekuari është Ai që vuri yjësi në qiell, dhe vuri në të një llambë, dhe një hënë të ndritshme.
- [62] Ai është Ai që e dizajnoi natën dhe ditën që të ndërrohen: provë e mjaftueshme për ata që dëshirojnë të jenë të vëmendshëm, ose të jenë mirënjohës.

Vetitë e të drejtëve

- [63] Adhuresit e Mirëbërësit janë ata që trajtojnë tokën butësisht, dhe kur të padijshmit iu flasin, ata vetëm shprehin paqe.
- [64] Kur janë vetë natën, ata meditojnë për Zotëruesin e tyre, dhe bien në përlulje.
- [65] Dhe thonë, "Zotëruesi ynë, kursena nga agonia e Ferrit; ndëshkimi i tij është i tmerrshëm.
- [66] "Është vendbanimi më i keq; përfundimi më i keq."
- [67] Kur ata japin, nuk janë as dorëshpuar as dorështrënguar; ata japin me përmbajtje.
- [68] Ata nuk i luten përkrah Zotit asnjë zoti tjetër, as nuk vrasin ndokënd – se Zoti e ka bërë jetën të shenjtë – përveç për drejtësi. As nuk bëjnë marrëdhënie jashtëmartesore. Ata që bëjnë këto shkelje kanë për të paguar.
- [69] Ndëshkimi dyfishohet për ta në Ditën e Ringjalljes, dhe ata qëndrojnë në të të poshtëruar.
- [70] Me përjashtim të atyre që pendohen, besojnë, dhe çojnë jetë të drejtë. Zoti ua shndërron mëkatet e tyre në të mira. Zoti është Falës, i Mëshirshmi.
- [71] Ata që pendohen dhe çojnë jetë të drejtë, Zoti i shpengon ata; shpengim të plotë.

Veti plotësuese të të drejtëve

- [72] Ata nuk dëshmojnë rrejshëm. Kur hasin në biseda të kota, i shpërfillin.
- [73] Kur iu kujtohen shpalljet e Zotëruesit të tyre, ata nuk reagojnë ndaj tyre sikur të ishin të shurdhër dhe të verbër.
- [74] Dhe thonë, "Zotëruesi ynë, le të jenë bashkëshortet dhe fëmijët tanë burim kënaqësie për ne,

* 25:56 Kjo strofë i drejtohej edhe Rashad Khalifës kur ishte në këtë botë. Vlera gormore e "Rashad Khalifa" (1230), plus numri i sures dhe strofës (25+56) japin shumën 1230+25+56=1311=19x69.

dhe na mbaj në ballë të të drejtëve.”

[75] Këta janë ata që arrijnë Parajsë si shpërblim për durimin e tyre; ata pranohen aty me përshëndetje gazmore dhe paqe.

[76] Përgjithmonë qëndrojnë aty; çfarë vendbanimi i bukur.

[77] Thuaj, “Ju arrini vlerë te Zotëruesi im vetëm nëpërmjet adhurimit. Por nëse nuk besoni, vetëshkaktoni pasojat e pashmangshme.”

Surja 26: Poetët (Esh-Shu`ara')

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] T. S. M.* (Ta, Sinë, Mimë)

[2] Këto (shkronja) përbëjnë prova të këtij shkrimi sqarues.

[3] Mund të ndodhë ta fajësosh veten që ata nuk janë besimtarë.

[4] Nëse duam, mund të dërgojmë nga qielli një shenjë që i detyron qafat e tyre të përkulen.

Kodi Matematikor i Kuranit

[5] Sa herë që një kujtesë nga Mirëbërësi vjen te ta, që është e re, ata ia kthejnë shpinën me neveri.

[6] Pasi që nuk besuan, kanë vetëshkaktuar pasojat e mosvëmendjes së tyre.

[7] A nuk e kanë parë tokën, dhe sa shumë lloje bimësh të bukura kemi rritur në të?

[8] Kjo duhet të jetë provë e mjaftueshme për ta, por shumica e tyre nuk janë besimtarë.

[9] Nuk ka dyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Moisiu

[10] Kujtohu që Zotëruesi yt thirri Moisiun: “Shko te njerëzit shkelës.

[11] “Njerëzit e Faraonit; ndoshta përmirësohen.”

[12] Ai tha, “Zotëruesi im, kam frikë se mos nuk më besojnë.

[13] “Mund të më humbë fryma. Gjuha më lidhet; ma dërgo vëllanë tim Aronin.

[14] “Gjithashtu, ata më konsiderojnë të arratisur; Kam frikë se mos më vrasin.”

[15] Ai tha, “Jo, (nuk të vrasin). Shkoni me provat e Mia. Do të jemi me ju, duke dëgjuar.

[16] “Shkoni te Faraoni dhe thoni, ‘Jemi të dërguarë prej Zotëruesit të gjithësisë.’

[17] “`Lërin Fëmijët e Izraelit të shkojnë.”

[18] Ai tha, “A nuk të rritëm që kur ishe foshnje, dhe ti kalove shumë vite me ne?

[19] “Pastaj e bëre krimin që bëre, dhe ishe mosmirënjohës.”

[20] Ai tha, “Vërtetë, unë e bëra atë kur isha i humbur.

[21] “Pastaj ika, kur u frikësova nga ju, dhe Zotëruesi im më pajisi me mençuri dhe më bëri një prej të dërguarve.

[22] “Ti po mburresh që më ke bërë një të mirë, përderisa i skllavëron Fëmijët e Izraelit!”

[23] Faraoni tha, “Çka është Zotëruesi i gjithësisë?”

[24] Ai tha, “Zotëruesi i qiejve dhe tokës, dhe çdo gjëje ndërmjet tyre. Duhet të jeni të sigurt për këtë.”

[25] Ai u tha atyre rreth vetes, “A e dëgjuat këtë?”

[26] Ai tha, “Zotëruesi juaj dhe Zotëruesi i paraardhësve tuaj.”

[27] Ai tha, “I dërguari i juaj që është dërguar te ju është çmendur.”

[28] Ai tha, “Zotëruesi i lindjes dhe perëndimit, dhe çdo gjëje ndërmjet tyre, nëse kuptoni.”

* 26:1 Shih Shtojcën 1 për rëndësinë e këtyre shkronjave paraparakisht misterioze.

[29] Ai tha, “Nëse ti pranon ndonjë zot, tjetër pos meje, unë do të fus në burg.”

[30] Ai tha, “Çka nëse të tregoj diçka të thellë?”

[31] Ai tha, “Atëherë tregoje, nëse je i sinqertë.”

[32] Ai pastaj e hodhi shkopin e vet, ku u bë gjarpër i vërtetë.

[33] Dhe nxori dorën e vet, dhe ishte e bardhë për spektatorët.

[34] Ai i tha këshilltarëve rreth tij, “Ky është një magjistar me përvojë.

[35] “Dëshiron t’ju nxjerrë nga toka juaj, me magjinë e tij. Çka propozoni?”

[36] Ata thanë, “Jepu afat atij dhe vëllait të tij, dhe dërgo mbledhës te çdo qytezë.

[37] “Le të mbledhin çdo magjistar me përvojë.”

[38] Magjistarët u mbledhën në kohën e caktuar, ditën e caktuar.

[39] Njerëzve iu tha: “Ejani të gjithë; le të mblidhemi së bashku këtu.

[40] “Ndoshta do i ndjekim magjistarët, nëse janë fituesit.”

[41] Kur magjistarët erdhën, ata i thanë Faraonit, “A paguhemi, nëse jemi fituesit?”

[42] Ai tha, “Po; madje edhe do të jeni të afërm me mua.”

[43] Moisiu iu tha atyre “Hidhni çka keni për të hedhur.”

[44] Ata i hodhën litarët dhe thuprat e tyre, dhe thanë, “Pasha madhësitinë e Faraonit, do të jemi fituesit.”

[45] Moisiu hodhi shkopin e tij, ku edhe gëlltiti çka ata trilluan.

Ekspertët e shohin të vërtetën

[46] Magjistarët ranë në përlulje.

[47] Ata thanë, “Besojmë në Zotëruesin e gjithësisë.

[48] “Zotëruesin e Moisiut dhe Aronit.”

[49] Ai tha, “A besuat në të para se t’ju jap unë leje? Ai na qenka mësuesi juaj, që ju mësoi magjinë. Patjetër do e shihni. Do t’jua cungoj duart dhe këmbët tuaja në anë të kundërta. Do t’ju kryqëzoj të gjithëve.”

[50] Ata thanë, “Kjo nuk do të ndryshojë vendimin tonë; te Zotëruesi ynë do të kthehemi.

[51] “Shpresojmë që Zotëruesi ynë do të na falë mëkatet tona, posaçërisht se jemi besimtarët e parë.”

[52] E frymëzuam Moisiun: “Udhëto me shërbëtorët e Mi; do t’ju ndjekin.”

[53] Faraoni dërgoi në qytete thirrës.

[54] (Duke thënë,) “Kjo është një bandë e vogël.

[55] “Ata tani po na kundërshtojnë.

[56] “Le të ruhemi të gjithë prej tyre.”

Ndëshkimi i pashmangshëm

[57] Si pasojë, hoqëm nga ta kopshtet dhe burimet.

[58] Dhe thesare dhe pozitë të nderuar.

[59] Pastaj e bëmë atë trashëgim për Fëmijët e Izraelit.

[60] Ata i ndoqën ata kah lindja.

[61] Kur të dyja palët e panë njëra tjetrën, njerëzit e Moisiut thanë, “Do të na zënë.”

[62] Ai tha, “S’ka shanse. Zotëruesi im është me mua; Ai do të më udhëzojë.”

[63] Atëherë e frymëzuam Moisiun: “Bjeri detit me shkopin tënd,” ku edhe u nda. Secila pjesë ishte si një kodër e madhe.

[64] Pastaj i çlirua ata të gjithë.

[65] Kështu e shpëtuam Moisiun dhe të gjithë ata që ishin me të.

[66] Dhe i mbytëm të tjerët.

[67] Kjo duhet të jetë provë e mjaftueshme, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.

[68] Padyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Ibrahimi

[69] Ua kallëzo atyre historinë e Ibrahimit.

[70] Ai i tha babait të tij dhe njerëzve të tij, “Çka është kjo që po e adhuroni?”

[71] Ata thanë, “Ne adhurojmë statuja; ia kushtojmë veten krejtësisht atyre.”

[72] Ai tha, “A mund t’ju dëgjojnë kur luteni?”

[73] “A mund t’ju sjellin dobi, ose t’ju dëmtojnë?”

[74] Ata thanë, “Jo; por i gjetëm prindërit tanë duke bërë kështu.”

[75] Ai tha, “A i shihni këta idhuj që i adhuroni.

[76] “Ju dhe paraardhësit tuaj.

[77] “Unë jam kundër tyre, se ia kam kushtuar veten vetëm Zotëruesit të gjithësisë.

[78] “Atij që më krijoi, dhe më udhëzoi.

[79] “Atij që më ushqen dhe më shuan etjen.

[80] “Dhe kur sëmurem, Ai më shëron.

[81] “Atij që më vë në vdekje, pastaj më sjell prapë në jetë.

[82] “Atij që shpresoj që do të falë mëkatet e mia në Ditën e Gjykimit.

[83] “Zotëruesi im, më dhuro mençuri, dhe më përfshij me të drejtë.

[84] “Le të jetë shembulli im për gjeneratat e ardhshme shembull i mirë.

[85] “Më bë një prej trashëgimtarëve të Parajsës së hareshme.

[86] “Dhe fale babain tim, se ai ka shkuar në humbje.

[87] “Dhe mos më braktis në Ditën e Ringjalljes.”

[88] Ajo është dita kur as paratë, as fëmijët, nuk mund të ndihmojnë.

[89] Vetëm ata që vijnë me gjithë zemër te Zoti (do të shpëtohen).

[90] Parajsa do iu paraqitet të drejtëve.

[91] Ferri do përgatitet për humbësit.

Do i mohojnë idhujt e vet

[92] Do të pyeten, “Ku janë idhujt që i kishit adhuruar

[93] “përkrah Zotit? A mund t’ju ndihmojnë? A mund ta ndihmojnë veten?”

[94] Ata do të hidhen në të, së bashku me humbësit.

[95] Dhe të gjithë ushtarët e Dreqit.

[96] Do të thonë përderisa grinden në të,

[97] “Pasha Zotin, ishim larg në humbje.

[98] “Si kemi mundur t’ju ngrisim në rang me Zotëruesin e gjithësisë?

[99] “Ata që na çorientuan janë shpirtligj.

[100] “Tash nuk kemi asnjë ndërmjetësues.

[101] “As ndonjë shok të ngushtë.

[102] “Vetëm sikur të kishim edhe një shans tjetër, atëherë do të besonim.”

[103] Në këtë ka mësim të mirë. Por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.

[104] Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Nuhu

- [105] Njerëzit e Nuhut nuk iu besuan të dërguarve.
 [106] Vëllai i tyre Nuhu iu tha atyre, "A nuk do të jeni të drejtë?
 [107] "Unë sinqerisht jam dërguar te ju.
 [108] "T'ia keni dronë Zotit dhe të më bindeni mua.
 [109] "Nuk kërkoj pagë nga ju. Rroga ime vjen nga Zotëruesi i gjithësisë.
 [110] "T'ia keni dronë Zotit dhe të më bindeni mua."
 [111] Ata thanë, "Si mund të besojmë me ty, kur më të këqijtë prej nesh të kanë ndjekur?"
 [112] Ai tha, "Si mund ta di unë çka bënë ata?
 [113] "Gjykimi i tyre është vetëm me Zotëruesin tim, sikur të mund ta merrni me mend.
 [114] "Nuk do i largoj besimtarët.
 [115] "Nuk jam asgjë më shumë se një paralajmërues sqarues."
 [116] Ata thanë, "Në mos u ndalsh, o Nuh, do të gurëzohesh për vdekje."
 [117] Ai tha, "Zotëruesi im, njerëzit e mi nuk më kanë besuar.
 [118] "Më dhuro fitore kundër tyre, dhe më çliro mua dhe shoqëruesit e mi besimtarë."
 [119] E dërguam atë dhe ata që e shoqëruan në arkën e ngarkuar.
 [120] Pastaj i mbytëm të tjerët.
 [121] Ky duhet të jetë mësim, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.
 [122] Padyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Hudi

- [123] Adi nuk i besuan të dërguarit.
 [124] Vëllai i tyre Hudi iu tha atyre "A nuk do të jeni të drejtë?
 [125] "Unë sinqerisht jam dërguar te ju.
 [126] "T'ia keni dronë Zotit, dhe të më bindeni mua.
 [127] "Unë nuk kërkoj pagë nga ju; rroga ime vjen nga Zotëruesi i gjithësisë.
 [128] "Ju ndërtoni në secilën kodër pallate për së koti.
 [129] "Ju ndërtoni ndërtesa sikur të zgjatnit përgjithmonë.
 [130] "Dhe kur goditni, ju goditni pa mëshirë.
 [131] "T'ia keni dronë Zotit dhe të më bindeni mua.
 [132] "T'ia keni dronë Atij që ju furnizoi me të gjitha gjërat që i njihni.
 [133] "Ai ju furnizoi me bagëti dhe fëmijë.
 [134] "Dhe kopshte dhe burime.
 [135] "Kam frikë për ju ndëshkimin e një dite të hatashme."
 [136] Ata thanë, "Është njëjtë, qoftë na predikove apo nuk na predikove.
 [137] "Ajo e keqe ndodhi vetëm te paraardhësit tanë.
 [138] "Asnjë ndëshkim nuk do të na bie neve."
 [139] Kështu nuk besuan dhe, si pasojë, i asgjësuan. Ky duhet të jetë mësim, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.
 [140] Padyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Salihu

- [141] Themudi nuk iu besuan të dërguarve.
 [142] Vëllai i tyre Salihu iu tha, "A nuk do të jeni të drejtë?
 [143] "Unë jam i dërguar i sinqertë te ju.
 [144] "T'ia keni dronë Zotit, dhe të më bindeni mua.

- [145] "Unë nuk ju kërkoi pagë; rroga ime vjen vetëm prej Zotëruesit të gjithësisë.
 [146] "A mendoni se do të liheni përgjithmonë, të sigurt në këtë gjendje?
 [147] "Ju gëzoni kopshte dhe burime.
 [148] "Dhe të korra dhe palma hurmash me fruta të shijshëm.
 [149] "Ju gdhendni nga malet pallate luksoze.
 [150] "T'ia keni dronë Zotit, dhe të më bindeni mua.
 [151] "Mos iu bindni shkelësve.
 [152] "Që bëjnë të këqija, jo punë të mira."
 [153] Ata thanë, "Ti je i magjepsur.
 [154] "Ti nuk je asgjë më shumë se një njeri si ne. Prodhoje një mrekulli, nëse je i sinqertë."
 [155] Ai tha, "Ja ku është një deve që do të pijë vetëm në një ditë që i është caktuar asaj; një ditë që është tjetër nga ditët tuaja të caktuara të pijes.
 [156] "Mos i bëni ndonjë dëm, se mos po vetëshkaktoni ndëshkim në një ditë të hatashme."
 [157] Ata e therën atë, dhe kështu vetëshkaktuan pikëllim.
 [158] Ndëshkimi i kaploi ata. Ky (rast) duhet të jetë mësim, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.
 [159] Padyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Luti

- [160] Njerëzit e Lutit nuk iu besuan të dërguarve.
 [161] Vëllai i tyre Luti iu tha atyre, "A nuk do të jeni të drejtë?
 [162] "Unë sinqerisht jam dërguar te ju.
 [163] "T'ia keni dronë Zotit, dhe të më bindeni mua.
 [164] "Unë nuk kërkoi pagë nga ju; rroga ime vjen vetëm prej Zotëruesit të gjithësisë.
 [165] "A praktikoni seks me meshkujt, e gjithë njerëzve?
 [166] "Ju i braktisni bashkëshortet që Zotëruesi juaj i ka krijuar për ju! Vërtetë, jeni njerëz shkelës."
 [167] Ata thanë, "Në mos u ndalsh, o Lut, do të dëbohesh."
 [168] Ai tha, "Veprimet tuaja më neverisin."
 [169] "Zotëruesi im, më shpëto mua dhe familjen time nga punët e tyre."
 [170] E shpëtuam atë dhe gjithë familjen e tij.
 [171] Por jo gruan e vjetër; ajo ishte mallkuar.
 [172] Pastaj i shkatërruam të tjerët.
 [173] Lëshuam mbi ta një breshëri të tmerrshme; çfarë breshërie e tmerrshme për ata që ishin paralajmëruar!
 [174] Ky (rast) duhet të jetë mësim, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.
 [175] Padyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Shuajbi

- [176] Njerëzit e Pyllit nuk iu besuan të dërguarve.
 [177] Shuajbi iu tha atyre, "A nuk do të jeni të drejtë?
 [178] "Unë sinqerisht jam dërguar te ju.
 [179] "T'ia keni dronë Zotit, dhe të më bindeni mua.
 [180] "Unë nuk kërkoi pagë nga ju; rroga ime vjen vetëm nga Zotëruesi i gjithësisë.
 [181] "Të jepni masë të plotë kur të bëni shitblerje; mos bëni hile.
 [182] "Të peshoni me peshore të drejtë.

- [183] "Mos i mashtroni njerëzit nga të drejtat e tyre, dhe mos u endni të korruptuar nëpër tokë.
 [184] "Kini dronë Atij që ju krijoi juve dhe gjeneratat paraprake."
 [185] Ata thanë, "Ti je i magjepsur.
 [186] "Ti nuk je asgjë më shumë se qenie njerëzore si ne. Në fakt, mendojmë se je gënjeshtar.
 [187] "Le të bien mbi ne masa nga qielli, nëse je i sinqertë."
 [188] Ai tha, "Zotëruesi im është Ai që di çdo gjë që bëni."
 [189] Ata nuk i besuan atij dhe, si pasojë, vetëshkaktuan ndëshkimin e Ditës së Mbulimit. Ishte ndëshkimi i një dite të hatashme.
 [190] Ky (rast) duhet të jetë mësim, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.
 [191] Padyshim, Zotëruesi yt është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Kurani

- [192] Kjo është shpallje nga Zotëruesi i gjithësisë.
 [193] Shpirti i Sinqertë (Gabrieli) zbriti me të.
 [194] Për ta shpallur atë në zemrën tënde, që të mund të jesh një prej paralajmëruesve.
 [195] Në gjuhë arabe të përkryer.
 [196] Është profetizuar në librat e gjeneratave paraprake.
 [197] A nuk është shenjë e mjaftueshme për ta që njëhej te dijetarët mes Fëmijëve të Izraelit?

Kurani duhet të përkthehet

- [198] Po ta shpallnim këtë te njerëz që nuk dinë arabisht.
 [199] Dhe ta recitonte ai (arabisht), ata nuk do të kishin mundur të besojnë në të.
 [200] Kështu e bëjmë (si gjuhë të huaj) në zemrat e fajtorëve.
 [201] Pra, ata nuk mund të besojnë në të; jo derisa ta shohin ndëshkimin që dhemb.
 [202] Do tu bijë atyre papritmas, kur më së paku e presin.
 [203] Ata pastaj do të thonë, "A mund të na shtyhet afati?"
 [204] A nuk e sfiduan ata ndëshkimin tonë?
 [205] Siç e sheh, i lejuam ata të kënaqen me vite.
 [206] Pastaj ndëshkimi iu erdhi, ashtu siç u premtua.
 [207] Rezervat e tyre të mëdha nuk iu ndihmuan atyre aspak.
 [208] Nuk asgjësua asnjë shoqëri pa dërguar paralajmërues.
 [209] Prandaj, ky është kujtesë, se ne nuk jemi të padrejtë.

*Të dërguarit e rremë të paaftë që të predikojnë adhurimin e VETËM Zotit**

- [210] Djajtë nuk mund ta shpallin këtë.
 [211] As nuk do të bënin, as nuk do të mundeshin.
 [212] Se ata ndalohen nga dëgjimi.
 [213] Prandaj, mos idolizo përkrah Zotit asnjë zot tjetër, se vetëshkakton ndëshkimin.

*I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes**

- [214] Tu predikosh njerëzve që janë më së afërmi teje.
 [215] Dhe të jesh i butë me besimtarët që të ndjekin.
 [216] Nëse nuk të binden, atëherë thuaj, "Unë nuk jam përgjegjës për atë që bëni."

* 26:210 Një i dërguar i rremë është i dërguar i Dreqit, se ai është trillues i rrenës më të urryer. Një i dërguar i tillë nuk mund ta flakë idhujtarinë, ose të predikojë adhurimin e VETËM Zotit.

* 26:214-223 Këto strofa i referoheshin të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes: shuma e vlerës germore të "Rashad Khalifa" (1230), plus numri i strofës (214) është $1230+214=1444=19 \times 76=19 \times 19 \times 4$, dhe shuma e numrave të strofave nga 214 deri te 223 është $2185=19 \times 115$ (Shtojca 1).

- [217] Dhe ki besim te i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.
 [218] Që të sheh kur mediton gjatë natës.
 [219] Dhe përkuljet tua të shpeshta.
 [220] Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.
 [221] A t'ju tregoj mbi kënd zbresin djajtë?
 [222] Ata zbresin mbi çdo trillues fajtor.
 [223] Ata shtihen kinse dëgjojnë, por shumica e tyre janë gënjeshtarë.
 [224] Sa për poetët, ata ndiqen vetëm nga humbësit.
 [225] A nuk e sheh që besnikëria e tyre ndryshon varësisht prej situatës?
 [226] Dhe që ata thonë çka nuk bëjnë?
 [227] Me përjashtim të atyre që besojnë, çojnë jetë të drejtë, përkujtojnë Zotin shpesh, dhe ngriten për të drejtat e tyre. Padyshim, shkelësit do të shohin se si është përfundimi i tyre.

Surja 27: Milingona (An-Neml)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] T. S.* Këto (shkronja) janë prova të Kuranit; shkrim i thellë.
 [2] Fener, dhe lajm i mirë, për besimtarët.
 [3] Që zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe janë, sa i përket Përjetësisë, absolutisht të sigurt.
 [4] Ata që nuk besojnë në Përjetësi, ne ua zbukurojmë punët e tyre para syve të tyre. Kështu, ata vazhdojnë të enden.
 [5] Janë ata që vetëshkaktojnë ndëshkimin më të keq, dhe në Përjetësi, ata do të jenë me humbësit më të këqij.
 [6] Padyshim, po e pranon Kuranin nga Më i Mençuri, i Gjithëdijshmi.

Moisiu

- [7] Kujtohu që Moisiu i tha familjes së vet, "Shoh një zjarr; le t'ju sjell lajm nga aty, ose ndonjë pishtar për t'ju ngrohur."
 [8] Kur ai erdhi te ai, u thirr: "I bekuar është Ai (që po flet) brenda zjarrit, dhe ata rreth tij." I madhëruar qoftë Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.
 [9] "O Moisi, Unë jam, Zoti, i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.
 [10] "Hidhe poshtë shkopin tënd." Kur e pa duke lëvizur si një demon, ai u kthye dhe iku. "O Moisi, mos u frikëso. Të dërguarit e Mi të mos frikësohen.
 [11] "Me përjashtim të atyre që bëjnë një shkelje, e pastaj mëkatin e zëvendësojnë me drejtësi; Unë jam Falës, i Mëshirshmi.
 [12] "Fute dorën në xhepin tënd; do të dalë e bardhë, pa asnjë të metë. Këto janë mes nëntë mrekullive për te Faraoni dhe njerëzit e tij, se ata janë njerëz shpirtligj."
 [13] Kur mrekullitë tona iu paraqitën atyre, të qarta dhe të thella, ata thanë, "Kjo është qartazi magji."
 [14] Ata i refuzuan ato dhe u bindën krejtësisht për rrugët e tyre të gabueshme, për shkak të mendjemadhësisë së tyre. Vëreni pasojat për keqbërësit.

Davidi dhe Salomoni

- [15] E pajisëm Davidin dhe Salomonin me dituri, dhe thanë, "Lavdi Zotit se na bekoi më shumë se

* 27:1 Shih Shtojcën 1 për domethënien e këtyre iniciave Kuranore.

shumë prej shërbëtorëve të Tij besimtarë.”

[16] Salomoni ishte trashëgimtari i Davidit. Ai tha, “O njerëz, ne jemi pajisur me të kuptueshmit e gjuhës së zogjve, dhe lloj lloj gjërash na janë dhuruar. Ky është vërtetë bekim i vërtetë.”

[17] Të mobilizuar në shërbim të Salomonit ishin ushtarët e dëgjueshëm të tij nga xhinët dhe njerëzit, si dhe zogjtë; të gjitha në dispozicion të tij.

[18] Kur ata iu afruan luginës së milingonave, një milingonë tha, “O ju milingona, hyni në shtëpitë tuaja, se mos iu shtypin Salomoni dhe ushtarët e tij, pa e vërejtur.”*

[19] Ai buzëqeshi dhe qeshi me thënien e saj, dhe tha, “Zotëruesi im, më drejto të jem mirënjohës për bekimet që ke dhuruar mbi mua dhe prindërit e mi, dhe të bëj punët e drejta që të kënaqin Ty. Më prano me mëshirën Tënde në shoqërinë e shërbëtorëve Tu të drejtë.”

[20] Ai i këqyri zogjtë, dhe vërejt: “Pse nuk e shoh pupëzën? Pse po mungon?”

[21] “Do e ndëshkoj rëndë ose ta flijoj, në mos më dhëntë një arsye të mirë.”

[22] Ai nuk priti gjatë. (Pupëza) tha, “Kam lajme që ti nuk i ke. Solla te ti nga Sheba, ca informata të rëndësishme.

[23] “Gjeta një grua që i sundonte ata, e cila ishte bekuar me çdo gjë, dhe kishte një pallat të pamasë.

[24] “E gjeta atë dhe njerëzit e saj duke u përlulur para diellit, në vend të Zotit. Djalli i ka zbukuruar punët e tyre në sytë e tyre, dhe i ka zmbrapsur nga rruga; si pasojë, ata nuk janë të udhëzuar.”

[25] Ata është dashur të jenë përlulur para Zotit, Ai që i manifeston të gjitha misteret në qiej dhe tokë, dhe Ai që njuh çdo gjë që fshihni dhe çdo gjë që deklaroni.

[26] Zoti: nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij; Zotëruesi me pushtetin e madh.

[27] (Salomoni) tha, “Do të shohim nëse e the të vërtetën, ose nëse je gënjeshtar.

[28] “Merre këtë letër nga unë, ua jep atyre, pastaj vëzhgo për reagimin e tyre.”

Prapë në Shebë

[29] Ajo tha, “O këshilltarët e mi, kam pranuar një letër të nderuar.

[30] “Është nga Salomoni, dhe është, ‘Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit.’”*

[31] “Duke shpallur: ‘Mos u bëni mendjemëdhenj; ejani te unë si të nënshtuar.’”

[32] Ajo tha, “O këshilltarët e mi, më këshilloni në këtë çështje. Unë nuk po vendosë asgjë derisa të më këshilloni.”

[33] Ata thanë, “Ne kemi fuqinë, ne kemi aftësitë e luftimit, dhe komanda përfundimtare është në duart tua. Ti vendos çka të bësh.”

[34] Ajo tha, “Mbretërit korruptojnë cilëndo tokë që e pushtojnë, dhe i nënshtrojnë njerëzit e dinjitetshëm të saj. Kjo është çka ata zakonisht bëjnë.

[35] “Po dërgoj një dhuratë te ta; le të shohim me çka do të kthehen të dërguarit.”

[36] Kur pupëza u kthye te Salomoni (ai ia tregoi atij lajmin), dhe ai iu përgjigj (njerëzve të Shebas): “A ju po më jepni para? Çka Zoti më ka dhënë është shumë më e mirë se çka ju ka dhënë juve. Ju

* 27:18-19 Sa më të pazakonshme ngjarjet në një sure të caktuar, aq më e fortë evidenca matematikore që i përkrahë ato. Kjo ndihmon që të na sigurojë që fenomene të tilla të çuditshme janë treguese të fuqisë së Zotit. Inicialet e kësaj sureje, T.S., përbëjnë një pjesë të ndërlikuar të mrekullive matematikore të ndërlidhura me inicialet Kuranore. Lindja e pazakontë dhe mrekullitë e Jezusit janë në Suren 19, e cila ka përpara pesë Inicialet Kuranore. Shih Shtojcën 1 për hollësitat.

* 27:30 ‘Bismilahu’ i përfshirë në këtë strofë kompenson ‘Bismilahun’ që mungon nga Surja 9, 19 sure më herët. Kjo e kthen shpeshësinë totale të ndodhje së ‘Bismilahun’ në 114, 19x6. Shih Shtojcën 29 për hollësitat e një mrekulli të gjërë dhe të thellë të lidhur më këtë ‘Bismilah.’

jeni ata që gëzoheni nga dhurata të tilla.”

[37] (Pupëzës i tha,) “Kthehu te ta (dhe ua bë me dije që) do të shkojmë te ta me forca që nuk mund t’i imagjinojnë. Do i dëbojmë, të poshtëruar dhe të përlulur.”

Më shpejt se shpejtësia e dritës

[38] Ai tha, “O ju këshilltarë, cili prej jush mund të ma sjellë pallatin e saj, para se të arrijnë këtu si të nënshtruar?”

[39] Një nga xhinët (Ifriti) tha, “Unë mund ta sjell te ti para se të ngritesh. Jam mjaft i fuqishëm për ta bërë këtë.”

[40] Ai që kishte njohuri nga libri tha, “Unë mund ta sjell te ti sa çel e mbyll sytë.” Kur ai e pa të vënë para tij, tha, “Është bekim nga Zotëruesi im, me të cilin Ai më teston mua, që të tregoj nëse jam mirënjohës ose mosmirënjohës. Kushdo që është mirënjohës është mirënjohës për të mirën e vet, dhe nëse dikush bëhet mosmirënjohës, atëherë Zotëruesi im nuk ka nevojë për të, Më i Nderuari.”

[41] Ai tha, “Rimodelonie pallatin e saj për të. Le të shohim nëse ajo do të udhëzohet, ose të vazhdojë me të keqduhëzuarit.”

[42] Kur ajo arriti, u pyet, “A duket pallati yt kështu?” Ajo tha, “Duket se ky është ai.” (Salomoni tha,) “E dinim që më parë çka do të bënte ajo, dhe ne ishim tashmë të nënshtruar.”

[43] Ajo ishte larguar duke adhuruar idhuj në vend të Zotit; ajo i përkiste njerëzve mosbesimtarë.

[44] Asaj iu tha, “Hy në pallat.” Kur ajo pa në të, ajo mendoi që ishte një pishinë uji, dhe përvoli (fustanin) te këmbët. Ajo tha, “Ky pallat është tash i shtruar me kristal brenda.” Ajo tha, “Zotëruesi im, i kam bërë keq vetes. Tash nënshtrhem me Salomonin te Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.”

Salihu

[45] Kemi dërguar te Themudi vëllanë e tyre Salihun, duke thënë, “Ta adhuroni Zotin.” Por ata u kthyen në dy grupe që grindeshin.

[46] Ai tha, “O njerëzit e mi, pse po nguteni të bëni të këqija në vend të punëve të mira? Vetëm sikur t’i luteshit Zotit për falje, mund të arrini mëshirë.”

[47] Ata thanë, “Të konsiderojmë ogur të keq për ne, ty dhe ata që tu bashkangjitën.” Ai tha, “Oguri juaj është tërësisht i drejtuar nga Zoti. Në të vërtetë, ju jeni njerëz devijues.”

[48] Kishte nëntë banditë në qytet që ishin të këqij, dhe nuk bënë asgjë të mirë.

[49] Ata thanë, “Le të bëjmë be në Zotin që do e vrasim atë dhe njerëzit e tij, pastaj t’i themi fisit të tij, ‘Ne nuk dimë asgjë për vdekjen e tyre. Po e themi të vërtetën.’”

Zoti i mbron besimtarët

[50] Ata thurën kurthe dhe planifikuan, por ne gjithashtu thurëm kurthe dhe planifikuam, përderisa ata nuk e vërenin.

[51] Vini re pasojat e kurtheve të tyre; i asgjësuaam ata dhe të gjithë njerëzit e tyre.

[52] Ja ku janë shtëpitë e tyre të rrënuara krejtësisht, për shkak të shkeljes së tyre. Ky duhet të jetë mësim për njerëzit që dinë.

[53] I shpëtojmë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë.

Luti

[54] Luti iu tha njerëzve të tij, “Si mund të kryeni një neveri të tillë, publikisht, përderisa shihni?

[55] “Ju praktikoni seks me meshkuj, me epshe, në vend të grave. Në të vërtetë, ju jeni njerëz të paditur.”

[56] E vetmja përgjigje nga njerëzit e tij ishte thënia e tyre, “Dëbonie familjen e Lutit nga qyteti

juaj; ata janë njerëz që dëshirojnë të jenë të pastër.”

[57] Si pasojë, e shpëtuam atë dhe familjen e tij, përveç bashkëshortes së tij; e numëruam atë me të dënuarit.

[58] Iu derdhëm atyre një breshëri të caktuar. Ishte breshëri e trishtueshme mbi njerëzit që ishin paralajmëruar.

Mos bë asnjë dallim mes të dërguarve të Zotit

[59] Thuaj, “I lartmadhëruar qoftë Zoti dhe paqe qoftë mbi shërbëtorët e Tij që Ai i zgjodhi. A është Zoti më mirë, apo idhujt që disa njerëz i ngritin?”

VETËM Zoti ia vlen të adhurohet

[60] Kush është Ai që krijoi qiejt dhe tokën? Kush është Ai që zbret te ju nga qielli ujë, me të cilin prodhojmë kopshte plot bukuri – ju nuk do të kishit shanse t’i prodhoni pemët e tij? A është ndonjë zot tjetër me Zotin? Në të vërtetë, ata janë njerëz që kanë devijuar.

Jezusi, Maria, Muhamedi, të shenjtët, etj. nuk krijuan asgjë

[61] Kush është Ai që bëri tokën të banueshme, bëri lumenj të rrjedhin nëpër të, vuri në të male, dhe krijoi barrierë mes dy ujërave? A është ndonjë zot tjetër me Zotin? Në të vërtetë, shumica e tyre nuk dinë.

[62] Kush është Ai që shpëton ata që bëhen të dëshpëruar dhe e thirrin Atë, lehtëson vështirësitë, dhe ju bën trashëgimtarë të tokës? A është ndonjë zot me Zotin? Rrallë jeni të vëmendshëm.

[63] Kush është Ai që ju udhëzon në errësirë të tokës dhe detit? Kush është Ai që dërgon erërat me lajme të mira, që sinjalizojnë mëshirën e Tij? A është ndonjë zot me Zotin? Më i lartësuar është Zoti, larg të pasurit e ndonjë partneri.

[64] Kush është Ai që e nisë krijimin, pastaj e përsërit? Kush është Ai që furnizon për ju nga qielli dhe toka? A është ndonjë zot me Zotin? Thuaj, “Më tregoni provat tuaja, nëse jeni të sinqertë.”

[65] Thuaj, “Askush në qiej as tokë nuk e din të ardhmen përveç Zotit. Atyre madje as nuk ua merr mendja si ose kur do të ringjallen.”

Besimi në Përjetësi: Kleçkë e madhe për shumicën e njerëzve

[66] Në fakt, njohuria e tyre sa i përket Përjetësisë është e hutuar. Në fakt, ata ushqejnë dyshime për të. Në fakt, ata janë plotësisht të pavëmendshëm për të.

[67] Ata që nuk besuan thanë, “Pasi të kthehemi në pluhur, dhe gjithashtu prindërit tanë, a ringjallemi?”

[68] “Na është dhënë premtimi i njëjtë në të kaluarën. Këto nuk janë asgjë pos përralla të moçme.”

[69] Thuaj, “Enduni nëpër tokë dhe vëreni pasojat e fajtorëve.”

[70] Mos u pikëlloni për ta, dhe mos u inatosni nga planifikimi i tyre.

[71] Ata thonë, “Kur do i vij koha atij premtimi, nëse jeni të sinqertë?”

[72] Thuaj, “Ju tashmë po e vuani pak nga ndëshkimi që e sfidoni.”

[73] Zotëruesi yt është plot hirësi ndaj njerëzve, por shumica e tyre janë mosmirënjohës.

[74] Zotëruesi yt e din plotësisht çka fshehin kraharorët e tyre, dhe çka deklarojnë ata.

[75] Nuk ka asgjë në qiej dhe tokë që është e fshehur (nga Zoti); çdo gjë është në një regjistër të qartë.

[76] Ky Kuran zgjidhë shumë çështje për Fëmijët e Izraelit; çështje për të cilat ata ende po grinden.

[77] Dhe padyshim, është udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.

[78] Zotëruesi yt është Ai që gjykon mes tyre në përputhje me rregullat e Tij. Ai është i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi.

[79] Prandaj, kij besim në Zotin; po e ndjek të vërtetën e dukshme.

[80] Nuk mund t'i bësh të vdekurit, as të shurdhrit, ta dëgjojnë thirrjen, nëse kthehen prapa.

[81] As nuk mund t'i udhëzosh të verbrit nga humbja e tyre. Të vetmit që do të dëgjojnë janë ata që besojnë në shpalljet tona, dhe vendosin të jenë të nënshtruar.

*Kompjuteri është krijesa**

[82] Në kohën e duhur, do të prodhojmë për ta një krijesë, të bërë nga materialet tokësore, duke deklaruar që njerëzit nuk janë të sigurt për shpalljet tona.

[83] Do të vij dita kur ne mbledhim nga secila shoqëri disa prej atyre që nuk besuan në provat tona, me forcë.

Studio Kodin Matematikor të Kuranit

[84] Kur ata arrijnë, Ai do të thotë, "Ju i keni refuzuar shpalljet e Mia, para se të fitoni njohuri për to. A nuk është kjo çka bëtë?"

[85] Ata do të vetëshkaktojnë pagesën për shpirtligësinë e tyre; nuk do të thonë asgjë.

[86] A nuk e kanë parë që e kemi bërë natën për pushimin e tyre, dhe ditën të ndriçuar? Këto duhet të jenë prova të mjaftueshme për njerëzit që besojnë.

[87] Ditën kur t'i bihet birit, çdokush në qiej dhe tokë do të tmerrohet, përveç atyre të zgjedhurve nga Zoti. E gjitha do të vij para Tij, me forcë.

Lëvizja e tokës: Mrekulli shkencore

[88] Kur i shikon malet, mendon se ato po qëndrojnë të palëvizura. Por ato po lëvizin, sikur retë. I tillë është përpunimi i Zotit, që përkreu çdo gjë. Ai është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

Dita e Gjykimit

[89] Ata që sjellin punë të mira (në regjistrat e tyre) do të pranojnë shpërblime shumë më të mira, dhe do të jenë krejtësisht të sigurt nga tmerret e asaj dite.

[90] Sa për ata që sjellin punë të këqija, ata do të shtyhen në Ferr. A nuk paguheni për çka bëtë?

[91] Unë thjeshtë jam urdhëruar ta adhuroj Zotëruesin e këtij qyteti – Ai e ka bërë atë strehë të sigurt – dhe Ai posedon të gjitha gjërat. Jam i urdhëruar të jem i nënshtruar.

[92] Dhe ta recitoj Kuranin. Kushdo që udhëzohet është i udhëzuar për të mirën e vet, dhe nëse ata shkojnë në humbje, atëherë thuaj, "Unë jam thjeshtë paralajmëruar."

[93] Dhe thuaj, "I lartmadhëruar qoftë Zoti; Ai do t'jua tregojë provat e Tij, deri sa t'i njihni. Zotëruesi yt nuk është i pavetëdijshëm për çfarëdo që bëni."

Surja 28: Histori (El-Kasas)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] T. S. M.*

[2] Këto (shkronja) përbëjnë prova të këtij libri të thellë.

[3] Të recitojmë ty pak histori të vërtetë të Moisiut dhe Faraonit, për dobinë e njerëzve që besojnë.

[4] Faraoni u bë tiran në tokë, dhe diskriminoi kundër disa njerëzve. Ai keqtrajtoi një grup të pandihmë të tyre, duke ua masakruar djemtë, përderisa ua kurseu vajzat. Ai ishte vërtetë shpirtlig.

Zoti dëmshpërblen të shtypurit

* 27:82 (2+7+8+2 = 19) Kompjuteri u nevojiti për të zbuluar mrekullinë matematikore të Kuranit, dhe vërtetoi që shumica e njerëzve e kanë hedhur poshtë lajmin e Zotit. (Shih Shtojcat 1 & 19).

* 28:1 Shih Shtojcën 1 për hollësitë e kodit matematikor të Kuranit, dhe domethënien ose rëndësinë e këtyre Inicialeve Kuranore.

[5] Dëshëm t'i dëmshpërblejmë ata që ishin të shtypur në tokë, dhe t'i bëjmë udhëheqës, dhe t'i bëjmë ata trashëguesit.

[6] Dhe t'i vendosim ata në tokë, dhe ta bëjmë Faraonin, Hamanin, dhe trupat e tyre të bien në kurthin e vet.

Besimi në Zotin

[7] E frymëzua nënën e Moisiut: "Jepi gji atij, dhe kur të frikësohesh për jetën e tij, hidhe në lum pa frikë apo pikëllim. Do e kthejmë atë te ti, dhe do e bëjmë një prej të dërguarve."

[8] Familja e Faraonit e mori, ashtu që ta bënim atë ta udhëheqë opozitën dhe të jetë burim pikëllimi për ta. Kjo është për shkak se Faraoni, Hamani, dhe trupat e tyre ishin shkelës.

Brenda strofullës së luanit

[9] Gruaja e Faraonit tha, "Ky mund të jetë gjetje e gëzueshme për mua dhe ty. Mos e vrisni, se ai mund të jetë me dobi për ne, ose mund ta adoptojmë që të jetë djali ynë." Atyre nuk ua mori mendja.

[10] Mendja e nënës së Moisiut u bë aq e merakosur sa që ajo gati sa nuk tregoi haptas identitetin e tij. Por ne e forcuam zemrën e saj, për ta bërë besimtare.

[11] Ajo i tha motrës së tij, "Shko pas tij." Ajo e shikoi atë nga larg, përderisa ata nuk e vërenin.

Foshnja kthehet te nëna e tij

[12] Ne e ndalua nga pranimi i të gjitha nënave gjidhënese. (Motra e tij) pastaj tha, "Unë mund t'ju tregoj një familje që mund ta rritë atë për ju, dhe të kujdeset mirë për të."

[13] Kështu, ne e kthyem atë te nëna e tij, në mënyrë që ta kënaqim, t'i heqim brengat e saj, dhe ta lëmë atë të dijë që premtimi i Zotit është e vërteta. Megjithatë, shumica e tyre nuk dinë.

[14] Kur ai arriti maturi dhe forcë, e pajisëm me mençuri dhe njohuri. Kështu i shpërblejmë të drejtit.

Moisiu bën vrasje pa paramendim

[15] Një herë ai hyri në qytet papandehur, pa u vërejtur nga njerëzit. Ai gjeti dy burra duke u rrahur; njëri ishte (Hebre) nga njerëzit e tij, dhe tjetri ishte (Egjiptas) nga armiqët e tij. Ai nga njerëzit e tij e thirri për ndihmë kundër armikut të tij. Moisiu e qëlloi me grusht, duke e vvarë. Ai tha, "Kjo është puna e djallit; ai është armik i vërtetë, dhe çorientues i madh."

[16] Tha, "Zotëruesi im, i kam bërë keq vetes. Të lutem më fal," dhe Ai e fali. Ai është Falësi, i Mëshirshmi.

[17] Tha, "Zotëruesi im, si reagim ndaj bekimeve Tua mbi mua, Unë nuk do të jem përkrahës i fajtorëve."

[18] Në mëngjes, ai ishte në qytet, i frikësuar dhe vigjilent. Ai që kërkoi ndihmën e tij dje, kërkoi ndihmën e tij përsëri. Moisiu i tha, "Ti je vërtetë belaxhi."

Krimi i Moisiut del në shesh

[19] Para se ai të tentonte ta qëllonte armikun e tyre të përbashkët, ai tha, "O Moisi, a dëshiron të më vrasësh, ashtu siç e vrave dje burrin tjetër? Po shihet, që ti dëshiron të jesh tiran në tokë; ti nuk dëshiron të jesh i drejtë."

[20] Një njeri erdhi duke vrapuar nga ana tjetër e qytetit, duke thënë, "O Moisi, njerëzit po thurin kurthe të të vrasin. Më mirë të ikësh menjëherë. Po të jap këshillë të mirë."

[21] Ai u arratis nga qyteti, i frikësuar dhe vigjilent. Tha, "Zotëruesi im, më shpëto nga njerëzit shtypës."

Në Medjen

[22] Përderisa ai udhëtoi kah Medjeni, tha, “Le të më udhëzojë Zotëruesi im në rrugën e drejtë.”

[23] Kur ai arriti ujin e Medjenit, gjeti një turmë njerëzish duke ujitur, dhe vërejtí dy gra duke pritur anash. Ai tha, “Çka po ju duhet?” Ato thanë, “Nuk kemi mundësi të ujsim, derisa të shpërndahet turma, dhe babai ynë është i moshuar.”

[24] Ai ujiti për to, pastaj u kthye nën hije, duke thënë, “Zotëruesi im, çfarëdo furnizimi që të më dërgosh, unë kam shumë nevojë për të.”

[25] Pas pak, njëra prej dy grave iu afrua atij, e marrueshme, dhe tha, “Babai im të fton ty që të të paguaj për ujitjen për ne.” Kur ai u takua me të dhe ia tregoi atij tregimin e tij ai tha, “Mos kij frikë. Je shpëtuar nga njerëzit shtypës.”

Moisiu martohet

[26] Njëra prej atyre dyjave tha, “O babai im, punësoje atë. Ai është më i miri për ta punësuar, se është i fortë dhe i sinqertë.”

[27] Ai tha, “Unë dëshiroj të të propozoj njërin prej dy vajzave të mia për martesë për ty, në punofsh për mua për tetë shtegtime; nëse i bën dhjetë, do të jetë punë vullnetare nga ana jote. Nuk dëshiroj ta bëj këtë çështje tepër të vështirë për ty. Do të më gjes, dashtë Zoti, të drejtë.”

[28] Ai tha, “U morëm vesh unë dhe ti. Cilindo afat që unë e përmbushë, nuk do të jesh kundër asnjërit. Zoti është garantues për çka thamë.”

Prapë në Egjipt

[29] Kur e kishte përmbushur obligimin e tij, ai udhëtoi me familjen e vet (drejt Egjiptit). Ai pa nga pjerrësia e Malit Sinai një zjarr. I tha familjes së vet, “Rrini këtu. Kam parë një zjarr. Ndoshta mund t’ju sjell ndonjë lajm, ose një pjesë të zjarrit për t’ju ngrohur.”

Moisiu emërohet

[30] Kur arriti te ai, u thirr nga skaji i anës së djathtë të luginës, në vendin e bekuar ku ishte shkurrja që digjej: “O Moisi, Unë jam. Zoti; Zotëruesi i gjithësisë.

[31] “Hidhe shkopin tënd.” Kur ai e pa atë duke lëvizur si një demon, ai u kthye mbrapa dhe iku. “O Moisi, kthehu; mos u frikëso. Je krejtësisht i sigurt.

[32] “Fute dorën tënde në xhepin tënd; do të dalë e bardhë pa asnjë të metë. Mblidhi krahët dhe qetësohu nga frika jote. Këto janë dy prova nga Zotëruesi yt, që t’i tregohen Faraonit dhe këshilltarëve të tij; ata kanë qenë njerëz shpirtligj.”

[33] Ai tha, “Zotëruesi im, unë vrava njërin prej tyre, dhe kam frikë se mos më vrasin.

[34] “Gjithashtu, vëllai im Aroni është më i rrjedhshëm në të folur se unë. Dërgoje atë me mua si ndihmues që të vërtetojë fjalët që them. Kam frikë se nuk më besojnë.”

[35] Ai tha, “Ne do të përforcojmë ty me vëllanë tënd, dhe do t’ju furnizojmë të dyve me autoritet të dukshëm. Pra, ata nuk do të kenë mundësi ta prekin asnjërin prej jush. Me mrekullitë tuaja, të dy ju, së bashku me ata që ju ndjekin juve, do të jeni fituesit.”

Mendjemadhësia e Faraonit

[36] Kur Moisiu shkoi te ta me provat tona, të qarta dhe të thella, ata thanë, “Kjo është magji e trilluar. Nuk kemi dëgjuar kurrë për këtë nga paraardhësit tanë të lashtë.”

[37] Moisiu tha, “Zotëruesi im e di më së miri kush e solli udhëzimin prej Tij, dhe kush do të jenë fituesit përfundimtarë. Padyshim, shkelësit nuk ia dalin.”

[38] Faraoni tha, “O ju këshilltarë, unë nuk kam ditur për asnjë zot për ju pos meje. Prandaj, ndize furrën (e tullave), o Haman, për të ndërtuar një kullë, që unë të mund të shikoj zotin e Moisiut. Jam i sigurt që ai është gënjeshtar.”

[39] Kështu, ai dhe trupat e tij vazhduan të bëjnë mendjemadhësi në tokë, pa të drejtë, dhe menduan që nuk do të kthehen te ne.

[40] Si pasojë, e ndëshkuam atë dhe trupat e tij, duke i hedhur në det. Vini re pasojat për shkelësit.

[41] I bëmë ata imamë që udhëhoqën njerëzit e tyre për në Ferr. Aq më shumë, në Ditën e Ringjalljes, ata nuk do të kenë ndihmë.

[42] Ata vetëshkaktuan në këtë jetë dënim, dhe në Ditën e Ringjalljes ata do të jenë të përbuzur.

*Libri i Moisiut**

[43] I dhamë Moisiut shkrimin – pas asgjësimit të gjeneratave paraprake, dhe pas ujdijes së shembujve nëpërmjet tyre – për të furnizuar ndriçim për njerëzit, dhe udhëzim, dhe mëshirë, që të mund të jenë të vëmendshëm.

[44] Ti nuk ishe i pranishëm në pjerrësinë perëndimore të malit, kur ne ia dhamë urdhrin Moisiut; nuk ishe dëshmitar.

[45] Por ne themeluam shumë gjenerata, dhe, për shkak të gjatësisë së kohës, (ata devijuan). As nuk ishe mes njerëzve të Medjenit, duke ua recituar shpalljet tona atyre. Por ne dërguam të dërguarë.

[46] As nuk ishe në pjerrësinë e Malit Sinai kur e thirrëm (Moisiun). Por është mëshirë nga Zotëruesi yt, (ndaj njerëzve), për t'i paralajmëruar njerëzit që nuk pranuan paralajmërues para teje, që të mund të marrin vesh.

S'ka arsyetime

[47] Kështu, ata nuk mund të thonë, kur një katastrofë i godet ata si pasojë e vetë veprave të tyre, "Zotëruesi ynë, sikur të na kishe dërguar një të dërguar, ne do i kishim ndjekur shpalljet Tua, dhe do të kishim qenë besimtarë."

Torah dhe Kurani

[48] Tash që e vërteta ka ardhur te ta prej nesh, ata thanë, "Veç sikur të na jepej çka iu dha Moisiut!" A nuk e refuzuan çka iu dha Moisiut në të kaluarën? Ata thanë, "Të dy (shkrimet) janë punë magjie që kopjuan njëri tjetrin." Ata gjithashtu thanë, "Ne nuk besojmë në asnjërin prej tyre."

[49] Thuaj, "Atëherë prodhoni një shkrim nga Zoti me udhëzim më të mirë se ata dy, që unë të mund ta ndjekë, nëse jeni të sinqertë."

Zoti na jep mësim nëpërmjet të dërguarve të Tij

[50] Nëse nuk arrijnë të të përgjigjen ty, atëherë dije që ata ndjekin vetëm mendimet e veta. Kush është më larg në humbje se ata që ndjekin mendimet e veta, pa udhëzim prej Zotit? Zoti nuk udhëzon njerëz të tillë shpirtligj.

Të gjithë besimtarët e vërtetë bien dakord me Kuranin

[51] Kemi çuar lajmin te ta, që të mund të marrin vesh.

[52] Ata që i bekuam me shkrimet paraprake do të besojnë në këtë.

[53] Kur iu recitohet atyre, do thonë, "Ne besojmë në të. Kjo është e vërteta prej Zotëruesit tonë. Edhe para se të kishim dëgjuar për të, ne ishim të nënshtruar."

Shpërblim të dyfishtë për të Krishterët & Jahuditë që kuptojnë të vërtetën

[54] Këtyre iu japim dyfish shpërblim, sepse ata durojnë me këmbëngulje. Kundërshtojnë punët e këqija me punë të mira, dhe nga furnizimet tona te ta, japin.

* 28:43 Torah është grumbulli i të gjitha shkrimeve të shpallur te të gjithë profetët e Izraelit, duke përfshirë edhe librin e Moisiut. Kurani vazhdimisht thotë që Moisiut iu dha një libër, ose "Kodi Ligjor." Askund në Kuran nuk e shohim që Moisiut iu dha "Torah." Besëlidhja e Vjetër e sotshme, pra, është Torah (shih 3:50, 5:46).

[55] Kur kalojnë nëpër bisedë të kotë, e shpërfillin dhe thonë, “Ne jemi përgjegjës për veprat tona, dhe ju jeni përgjegjës për veprat tuaja. Paqe qoftë mbi ju. Nuk dëshirojmë të sillemi sikur të padijshmit.”

Vetëm Zoti udhëzon

[56] Nuk mund t’i udhëzosh ata që i do. Zoti është Ai i vetmi që udhëzon në përputhje me vullnetin e Tij, dhe në përputhje me njohurinë e Tij për ata që meritojnë udhëzimin.

[57] Ata thanë, “Nëse ndjekim udhëzimin tënd, do të vuajmë keqtrajtim.” A nuk themelua për ta një Strehimore të Shenjtë, në të cilën të gjitha llojet e frutave ofrohen, si furnizim prej nesh? Në të vërtetë, shumica e tyre nuk dinë.

[58] Mori shoqëri i asgjësua se u bënë mosmirënjohës të jetëve të tyre. Si pasojë, ja ku janë shtëpitë e tyre, asgjë pos rrënoja të pabanueshme pas tyre, përveç një pakice. Ne ishim trashëgimtarët.

[59] Se Zotëruesi yt nuk asgjëson asnjë shoqëri pa dërguar një të dërguar në mes të tyre, për të recituar shpalljet tona te ta. Nuk asgjësojmë asnjë shoqëri, në mos qofshin njerëzit e saj shpirtligj.

[60] Çdo gjë që u është dhënë juve është vetëm lëndë e kësaj jete, dhe kotësi e saj. Çka është me Zotin është shumë më e mirë, dhe e përhershme. A nuk kuptoni?

[61] A është dikush që i premtua premtim të mirë që do i vij koha patjetër, i barabartë me dikë që e furnizojmë me gjërat materiale të përkohshme të kësaj jete, pastaj vuan dënim të përjetshëm në Ditën e Ringjalljes?

Idhujt mohojnë idhujtarët e vet

[62] Do të vij dita kur Ai i thërret ata, duke thënë, “Ku janë ata idhuj që i kishit ngritur për krahu Meje?”

[63] Ata që vetëshkaktuan gjykimin do të thonë, “Zotëruesi ynë, këta janë ata që na çorientuan; ne i çorientua ata vetëm sepse ne vetë kishim shkuar në humbje. Ne tani të përkushtohemi plotësisht vetëm Ty. Ata nuk ishin duke na adhuruar neve në realitet.”

[64] Do të thuhet, “Thirrni idhujt tuaj (t’ju ndihmojnë).” Ata do i thërrasin, por nuk do të përgjigjen. Ata do të vuajnë ndëshkimin, dhe të dëshirojnë të ishin të udhëzuar!

Reagimi ynë ndaj të dërguarve

[65] Në atë ditë, Ai do e pyes çdonjërin, “Si reaguat ndaj të dërguarve?”

[66] Ata do të tronditen nga faktet në atë ditë, do të mbesin pa tekst.

[67] Sa për ata që pendohen, besojnë, dhe çojnë jetë të drejtë, ata do të përfundojnë me fituesit.

[68] Zotëruesi yt është Ai që krijon çfarëdo Ai do, dhe zgjedhë; askush tjetër nuk bën zgjedhje. I madhëruar qoftë Zoti, Më i Lartësuar. Ai është larg nga nevoja për partnerë.

[69] Zotëruesi yt di mendimet më të thella të fshehura në kraharorët e tyre, si dhe çdo gjë që deklarojnë.

[70] Ai është i vetmi Zot; nuk ka asnjë zot tjetër për krahu Tij. Atij i takon i gjithë lartmadhërimi në këtë jetë e parë, dhe në Përjetësinë. I gjithë gjykimi i takon Atij, dhe te Ai do të ktheheni.

Bekimet e Zotit

[71] Thuaj, “Po sikur Zoti ta bënte natën të përhershme, deri në Ditën e Ringjalljes? Cili zot tjetër pos Zotit mund t’ju furnizojë me dritë? A nuk dëgjoni?”

[72] Thuaj, “Po sikur Zoti ta bënte ditën të përhershme, deri në Ditën e Ringjalljes? Cili zot, tjetër pos Zotit, mund t’ju furnizojë me natë për pushimin tuaj? A nuk shihni?”

[73] Është mëshirë prej Tij që Ai krijoi për ju natën dhe ditën në mënyrë që të pushoni (gjatë

natës), dhe të kërkoni furnizimet e Tij (gjatë ditës), që të mund të jeni mirënjohës.

Idhujt nuk kanë aspak fuqi

[74] Do të vij dita kur Ai i pyet ata, “Ku janë idhujt që i kishit trilluar si të radhitur me Mua?”

[75] Do të përzgjedhim nga secila shoqëri një dëshmitar, pastaj të themi, “Paraqite provën tënde.” Ata do të kuptojnë atëherë që e tërë e vërteta është e Zotit, përderisa idhujt që ata i kishin trilluar do i braktisin.

Karuni

[76] Karuni (drejtuesi i skllëvërve) ishte njëri prej njerëzve të Moisiut i cili i tradhtoi ata dhe i shtypi. I dhamë atij aq shumë thesare sa që çelësat për to ishin gati tepër të rënda për grupin më të fortë. Njerëzit e tij i thanë, “Mos u bë aq mendjemadh; Zoti nuk i do ata që janë mendjemëdhenj.

[77] “Përdori furnizimet që të janë dhuruar ty nga Zoti për të kërkuar vendbanimin e Përjetësisë, pa e lënë pas dore hisen në këtë botë. Ji bamirës, si ka qenë Zoti bamirës ndaj teje. Mos vazhdo ta korruptosh tokën. Zoti nuk i do korruptuesit.”

[78] Ai tha, “Unë e arrita gjithë këtë për shkak të vetë dijenisë time.” A nuk e kuptoi ai që Zoti kishte asgjësuar para tij gjenerata që ishin shumë më të forta se ai, dhe më të shumta në numër? Shkelësit (e asgjësuar) nuk u pyetën për krimet e tyre.

[79] Një ditë, ai doli te njerëzit e tij i stolitur plot. Ata që parapëlqenin jetën e kësaj bote thanë, “Ah sikur të arrinim çka Karuni ka arritur. Vërtetë, ai është shumë fatlum.”

Pasuria e vërtetë

[80] Sa për ata që ishin bekuar me njohuri, thanë, “Mjerë ju, shpërblimi i Zotit është shumë më i mirë për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë.” Askush nuk e arrin këtë përveç të durueshmëve.

Fati i pashmangshëm i tiranit

[81] Ne pastaj e bëmë tokën që ta gëlltisë atë dhe pallatin e tij. Asnjë ushtri nuk do të kishte mundur t’i ndihmonte atij kundër Zotit; ai nuk ishte i paracaktuar të jetë fitues.

[82] Ata që ia kishin lakmi një ditë më parë thanë, “Tash e kuptojmë që Zoti është Ai që furnizon për këdo Ai zgjedhë nga shërbëtorët e Tij, dhe mbanë. Po të mos ishte hirësi e Zotit ndaj nesh, Ai do të mund ta bënte tokën të na gëlltisë edhe neve. Tash e kuptojmë që mosbesimtarët nuk ia dalin.”

Fituesit përfundimtarë

[83] E rezervojmë vendbanimin e Përjetësisë për ata që nuk kërkojnë lartësim në tokë, as korrupsion. Fitorja përfundimtare është e të drejtëve.

[84] Kushdo që punon drejtësi pranon shpërblim shumë më të mirë. Sa për ata që bëjnë mëkate, ndëshkimi për mëkatet e tyre është saktësisht i barabartë me punët e tyre.

[85] Padyshim, Ai që shpalli Kuranin për ju do t’ju mbledhë në një takim të paracaktuar. Thuaj, “Zotëruesi im është tërësisht i vetëdijshëm për ata që i përmbahen udhëzimit, dhe ata që kanë shkuar në humbje.”

[86] Ti as që e ke pritur të të shpallet ky shkrim; por ky është mëshirë nga Zotëruesi yt. Prandaj, të mos anosh kah mosbesimtarët.

[87] As të mos largohesh nga shpalljet e Zotit, pasi që të kanë ardhur, dhe i fto të tjerët te Zotëruesi yt. Dhe kurrë të mos biesh në adhurim idhujsh.

[88] Të mos adhurosh përkrah Zotit asnjë zot tjetër. Nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij. Çdo gjë priset përveç pranisë së Tij. I Tij është i gjithë sovraniteti, dhe te Ai do të ktheheni.

Surja 29: Merimanga (El-'Ankebut)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A. L. M.*

Test patjetër

[2] A mendojnë njerëzit se ata do të lihen të thonë, “Besojmë,” pa u vënë në test?

[3] I kemi testuar ata para tyre, se Zoti duhet t’i shquaj ata që janë të sinqertë, dhe duhet t’i ekspozojë gënjeshtarët.

[4] A mendojnë ata që bëjnë mëkate që mund të na mashtrojnë? Vërtetë gabim është gjykimi i tyre.

[5] Kushdo që shpreson ta takojë Zotin, (duhet ta dijë që) një takim i tillë me Zotin do të vij patjetër. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[6] Ata që përpiqen, përpiqen për të mirën e tyre. Zoti nuk ka nevojë për askënd.

[7] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ne padyshim do t’ua heqim mëkatet, dhe padyshim do i shpërblejmë bujarisht për punët e tyre.

T’i nderosh prindërit e tu

[8] E urdhëruam qenien njerëzore t’i nderojë prindërit e vet. Por nëse mundohen të të detyrojnë të ngritësh idhuj përkrah Meje, mos iu bind atyre. Te Unë është kthimi juaj përfundimtar, pastaj do t’ju njoftoj për çdo gjë që kishit bërë.

[9] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ne padyshim do i pranojmë me të drejtët.

Shokë për interes

[10] Mes njerëzve ka prej tyre që thonë, “Besojmë në Zotin,” por sapo të vuajnë ndonjë vështirësi për shkak të Zotit, ata e barazojnë keqtrajtimin e njerëzve me ndëshkimin e Zotit. Por nëse ndonjë bekim nga Zotëruesi yt vjen te ti, ata thonë, “Ne ishim me ju.” A nuk është Zoti tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella të njerëzve?

[11] Zoti patjetër do i shquaj ata që besojnë, dhe Ai patjetër do i ekspozojë hipokritët.

[12] Ata që nuk besuan iu thanë atyre që besuan, “Nëse ndiqni rrugën tonë, ne do të marrim përgjegjësinë për mëkatet tuaja.” Nuk është e vërtetë; ata nuk mund ta bartin asnjë mëkat të tyre. Ata janë gënjeshtarë.

[13] Në fakt, ata do i bartin mëkatet e veta, plus barrët e mëkateve të njerëzve të tjerë për të cilit ishin përgjegjës. Padyshim, ata do të pyeten në Ditën e Ringjalljes për pretendimet e tyre të rrejshme.

Nuhu

[14] E dërguam Nahun te njerëzit e tij, dhe ai ndeji me ta njëmijë vjet, pa pesëdhjetë.* E ata vetëshkaktuan vërshimin për shkak të shkeljeve të tyre.

[15] E shpëtuam atë dhe ata që e shoqëruan atë në arkë, dhe i ujdisë si mësim për të gjithë njerëzit.

Ibrahimi

[16] Ibrahimi i tha njerëzve të tij, “Ta adhuroni Zotin, dhe t’ia keni dronë Atij. Kjo është më mirë për

* 29:1 Shih Shtojcën 1 për hollësitat e hartimit matematikor të Kuranit, dhe domethënien e këtyre Inicialeve Kuranore që në të kaluarën ishin misterioze.

* 29:14 Pasi që mrekullia e Kuranit është matematikore, numrat në veçanti përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kodit të bazuar në 19. Kështu, numrat e përmendur në Kuran japin shumën 162146, ose 19x8534 (shih Shtojcën 1 për hollësitat).

ju, veç sikur ta dinit.

Zoti: I vetmi burim i furnizimeve

[17] "Çka ju adhuron në vend të Zotit janë idhuj të pafuqi; keni shpikur një gënjeshtër." Idhujt që i adhuron përkrah Zotit nuk kanë asnjë furnizim për ju. Prandaj, të kërkon furnizime vetëm nga Zoti. Ta adhuron vetëm Atë, dhe të jeni mirënjohës për Të; te Ai është kthimi juaj përfundimtar.

[18] Nëse nuk besoni, gjenerata para jush nuk kanë besuar gjithashtu. Funkzioni i vetëm i të dërguarit është të japë (lajmin).

*Studio prejardhjen e jetës**

[19] A nuk e kanë parë ata si Zoti e nisë krijimin, pastaj e përsërit? Kjo është lehtë për Zotin.

[20] Thuaj, "Enduni nëpër tokë dhe gjeni prejardhjen e jetës." Se Zoti kështu do të nisë krijimin në Përjetësi. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[21] Ai mallkon në ndëshkim këdo Ai vendosë, dhe derdhë mëshirën e Tij mbi këdo Ai do. Përfundimisht, te Ai do të dorëzoheni.

[22] Askush prej jush nuk mund të ikë prej këtyre fakteve, në tokë as në qiej, dhe nuk keni askënd përkrah Zotit si Zotërues dhe Sundues.

[23] Ata që nuk besojnë në shpalljet e Zotit, dhe në takimin me Të, kanë humbur shpresat nga mëshira Ime. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

Prapë te Ibrahim

[24] Përgjigja e vetme nga njerëzit e tij ishte thënia e tyre, "Vritnie, ose digjnie." Por Zoti e shpëtoi nga zjarri. Kjo duhet të japë mësim për njerëzit që besojnë.

Trysnia shoqërore: Katastrofë e thellë

[25] Ai tha, "Ju adhuron përkrah Zotit idhuj të pafuqi për shkak të trysnisë shoqërore, vetëm sa për të ruajtur miqësinë mes jush në jetën e kësaj bote. Por pastaj, në Ditën e Ringjalljes, do të bëni hasha njëri tjetrin, dhe ta mallkoni njëri tjetrin. Përfundimi juaj është Ferri, ku nuk mund ta ndihmoni njëri tjetrin."

[26] Luti besoi me të dhe tha, "Unë po emigroj te Zotëruesi im. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri."

[27] I dhamë atij Isakun dhe Jakobin, caktuam te pasardhësit e tij profetllëk dhe shkrimet, e pajisëm atë me shpërblimin e tij të duhur në këtë jetë, dhe në Përjetësi ai padyshim do të jetë me të drejtë.

Luti

[28] Luti i tha njerëzve të tij, "Ju bëni një neveri të tillë, askush në botë nuk e ka bërë më parë.

[29] "Ju praktikoni seks me burra, bëni plaçkitje rrugëve, dhe lejoni të gjitha llojet e veseve në shoqërinë tuaj." Përgjigja e vetme nga njerëzit e tij ishte të thonë, "Sille te ne ndëshkimin e Zotit, nëse je i sinqertë."

[30] Ai tha, "Zotëruesi im, më dhuro fitore kundër këtyre njerëzve shpirtligj."

Engjëjt vizitojnë Ibrahimin dhe Lutin

[31] Kur të dërguarit tonë shkuan te Ibrahim me lajm të mirë (për lindjen e Isakut), ata gjithashtu thanë, "Jemi rrugës për te asgjësimi i njerëzve të asaj qyteze (Sodomës), se njerëzit e saj kanë qenë shpirtligj."

[32] Ai tha, "Por Luti po jeton atje." Ata thanë, "Ne jemi tërësisht të vetëdijshëm për cilindo që jeton në të. Ne natyrisht që do e shpëtojmë atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij; ajo është e

* 29:19-20 Mësojmë nga Kurani që evolucioni është proces i udhëhequr hyjnisht. Shih Shtojcën 31 për hollësitat.

mallkuar.”

[33] Kur të dërguarit tonë arritën te vendi i Lutit, ata u keqtrajtuat, dhe ai u ngushtua nga prania e tyre. Por ata thanë, “Mos kij frikë, dhe mos u brengos. Ne do të të shpëtojmë ty dhe familjen tënde, përveç gruas tënde; ajo është e mallkuar.

[34] “Do të derdhim mbi njerëzit e kësaj qyteze katastrofë nga qielli, si pasojë e shpirtligësisë së tyre.”

[35] I lam të qëndrojnë disa prej gërmadhave të tyre, për të shërbyer si mësim i thellë për njerëzit që kuptojnë.

Shuajbi

[36] Në Medjen dërguam vëllanë e tyre Shuajbin. Ai tha, “O njerëzit e mi, ta adhuroni Zotin dhe kërkonit Ditën e Fundit, dhe mos u endni nëpër tokë të korruptuar.”

[37] Ata nuk i besuan atij dhe, si pasojë, tërmeti i asgjësoi ata; u lan të vdekur në shtëpitë e tyre në mëngjes.

[38] Ngjashëm, Adi dhe Themudi (u asgjësuan). Kjo është bërë e dukshme për ju nëpërmjet gërmadhave të tyre. Djalli kishte zbukuruar punët e tyre në sytë e tyre, dhe kishte larguar ata nga rruga, edhe pse ata kishin sy.

Sistemi i pandryshueshëm i Zotit

[39] Gjithashtu, Karuni, Faraoni, dhe Hamani; Moisiu shkoi te ta me shenja të qarta. Por ata vazhduan të kryejnë tirani në tokë. Si pasojë, ata nuk mundën t’i shmangen (ndëshkimit).

[40] Të gjithë ata mosbesimtarë u dënuan si pasojë e mëkateve të tyre. Disa prej tyre i asgjësua me erëra të forta, disa u asgjësuan me tërmet, disa i bëmë që të gëlltiten nga toka, dhe disa i mbytëm. Zoti nuk është Ai që iu bëri keq atyre; janë ata që i bënë keq vetes.

Merimanga

[41] Alegoria e atyre që pranojnë sundues tjerë përkrah Zotit është si ajo e merimangës dhe shtëpisë së saj; shtëpia më e ligë është shtëpia e merimangës, veç sikur ta dinin.*

[42] Zoti e di shumë mirë që çfarëdo që ata adhurojnë përkrah Tij nuk janë asgjë në të vërtetë. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[43] I përmendim këta shembuj për njerëzit, dhe askush nuk i vlerëson ato përveç të dijshtëmëve.

[44] Zoti krijoi qiejt dhe tokën, me qëllim. Kjo furnizon provë të mjaftueshme për besimtarët.

Lutjet e Kontaktit (Salat)

[45] Të recitosh çka të është shpallur nga shkrimi, dhe zbato Lutjet e Kontaktit (Salat), se Lutjet e Kontaktit ndalojnë të këqija dhe vese. Por përkujtimi i Zotit (nëpërmjet Salatit) është synimi më i rëndësishëm.* Zoti di çfarëdo që bëni.

Një Zot/ Një fe

[46] Mos argumentoni me njerëzit e shkrimit (Jahuditë, të Krishterët, dhe Myslimanët) përveç në mënyrën më të mirë të mundshme – në mos shkelshin – dhe thoni, “Ne besojmë në çka na është shpallur neve dhe çka u është shpallur juve, dhe zoti ynë dhe zoti juaj është një dhe i vetmi; Atij i nënshtrohemi.”

[47] E kemi shpallur te ti këtë shkrim, dhe ata të cilët i kemi bekuar me shkrimin paraprak do të

* 29:41-43 Duhet një person i ditur për ta ditur që merimanga Vejusha e Zezë e vret bashkëshortin e saj. Përdorja e gjinisë femërore për t’iu referuar merimangës në 29:41 është pra e rëndësishme. Veç kësaj, rrjeta e merimangës është fizikisht shumë e dobët.

* 29:45 Zotëruesi yt është kushdo që ta preokupon mendjen shumicën e kohës (shih 20:14 & Shtojcën 27).

besojnë në të. Gjithashtu, disa prej njerëzve të tu do të besojnë në të. Në të vërtetë, ata që shpërfillin shpalljet tona janë mosbesimtarët e vërtetë.

*Kurani: Mrekullia e Muhamedit**

[48] Ti nuk i lexove shkrimet paraprake, as nuk i shkrove me dorën tënde. Në atë rast, refuzuesit do të kishin pasur arsye që të ushqejnë dyshime.

[49] Në fakt, këto shpallje janë të qarta në kraharorët e atyre që posedojnë dijeni. Vetëm shpirtligjtë do i shpërfillin shpalljet tona.

[50] Ata thanë, “Veç sikur një mrekulli të mund t’i zbriste atij nga Zotëruesi i tij!” Thuaj, “Të gjitha mrekullitë vijnë vetëm nga Zoti; Unë nuk jam asgjë më shumë se një paralajmërues sqarues.”

[51] A nuk është mjaft e mrekullueshme që ne zbritëm te ti këtë libër, që po iu recitohet atyre? Kjo është në të vërtetë mëshirë dhe kujtesë për njerëzit që besojnë.

[52] Thuaj, “Zoti mjafton si dëshmitar mes meje dhe jush. Ai di çdo gjë në qiej dhe tokë. Padyshim, ata që besojnë në gënjeshtër dhe nuk besojnë në Zotin janë humbësit e vërtetë.”

Ata janë në Ferr

[53] Të sfidojnë ty që t’ua sjellësh ndëshkimin! Po të mos ishte për një kohë të paracaktuar, ndëshkimi do i kishte ardhur atyre menjëherë.* Patjetër, do iu vij atyre papritmas, kur ata më së paku e presin.

[54] Të sfidojnë ty të sjellësh ndëshkimin! Ferri tashmë i rrethon mosbesimtarët.

[55] Do të vij dita kur ndëshkimi i kaplon ata, nga lart tyre dhe nga poshtë këmbëve të tyre; Ai do të thotë, “Vuani pasojat e punëve tuaja.”

Imigro për Zotin

[56] O shërbëtorët e Mi që besuat, toka Ime është e gjerë, prandaj më adhuron Mua.

[57] Çdokush do të shijojë vdekjen, pastaj te ne do të ktheheni përfundimisht.

[58] Ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ne padyshim do i vëmë në Parajsë, me pallate dhe prroje që rrjedhin. Përgjithmonë qëndrojnë aty. Çfarë shpërblimi i bukur për punuesit.

[59] Ata janë ata që durojnë me këmbëngulje, dhe kanë besim në Zotëruesin e tyre.

[60] Për sa e sa krijesa që nuk i bartin furnizimet e veta, Zoti furnizon, si edhe për ju. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

Shumica e besimtarëve të paracaktuar për Ferr

[61] Nëse i pyet ata, “Kush krijoi qiejt dhe tokën, dhe vuri diellin dhe hënën në shërbimin tuaj,” ata do të thonë, “Zoti.” Pse atëherë ata devijuan?

[62] Zoti është Ai që e shton furnizimin për këdo që Ai zgjedhë nga mes krijesave të Tij, dhe e mbanë. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[63] Nëse i pyet ata, “Kush zbrit nga qielli ujë, për të ngjallur tokë të vdekur,” ata do të thonë, “Zoti.” Thuaj, “Lavdi Zotit.” Shumica e tyre nuk kuptojnë.

Rirregullo prioritetet tua

* 29:48-51 Ishte vullneti i Më të Mençurit që ta ndajë Kuranin nga mrekullia e tij mbresëlënëse matematikore për 1400 vjet. Duke e parë se si Myslimanët në përgjithësi e kanë idhujtarizuar Muhamedin, është e qartë që sikur mrekullia matematikore e Kuranit të ishte shpallur nëpërmjet Muhamedit gjithashtu, shumë njerëz do të kishin adhurar atë si Zot të mishëruar. Ashtu siç ndodhi, Zoti deshi që mrekullia e madhe e Kuranit (74:30-35) të presë për kohën e kompjuterëve, dhe ta zbulojë atë nëpërmjet të Dërguarit të Tij të Besëlidhjes (shih Shtojcat 1, 2, & 26).

* 29:53 Kushdo që vdes para moshës 40 vjeçare shkon në Parajsë, dhe gjithkush nuk e meriton këtë. Njerëzit nganjëherë qahen për ngadalshmerinë e drejtësisë kur ndonjë kriminel i ligë nuk ekzekutohet me shpejtësi. Zoti e di kush meriton Parajsë (shih 46:15 dhe Shtojcën 32).

- [64] Jeta e kësaj bote nuk është asgjë më shumë se kotësi dhe lojë, përderisa vendbanimi i Përjetësisë është jeta e vërtetë, veç sikur ta dinin.
- [65] Kur udhëtojnë mbi një anije, ata i luten Zotit, duke ia kushtuar lutjet e tyre Atij. Por sapo Ai t'i shpëtojë ata te bregu, ata i kthehen idhujtarisë.
- [66] Lëri të mos besojnë në çka iu kemi dhënë atyre, dhe lëri le të kënaqen përkohësisht; ata padyshim do e marrin vesh.
- [67] A nuk e kanë parë që ne kemi themeluar një Strehimore të Shenjtë që e bëmë të sigurt, përderisa përreth tyre njerëzit janë në rrezik të vazhdueshëm? A do të besojnë ende në gënjeshtër, dhe të refuzojnë bekimet e Zotit?
- [68] Kush është më i keq se ai që trillon rrena dhe ia mveshë ato Zotit, ose refuzon të vërtetën kur i vjen atij? A nuk është Ferri ndëshkimi i drejtë për mosbesimtarët?
- [69] Sa për ata që përpiqen në rrugën tonë, ne patjetër do i udhëzojmë në rrugët tona. Padyshim, Zoti është me besimtarët.

Surja 30: Romakët (Er-Rum)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] A. L. M.*
- [2] Padyshim, Romakët do të munden.
- [3] Në tokën më të afërt. Pas mundjes së tyre, ata do ngriten sërish dhe të fitojnë.
- [4] Brenda disa viteve. I tillë është vendimi i Zotit, edhe në profecinë e parë, edhe në të dytën. Në atë ditë, besimtarët të gëzohen.
- [5] Në fitoren e Zotit. Ai i dhuron fitore kujtdo që Ai do. Ai është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.
- Preokupimi me jetën e gabueshme*
- [6] I tillë është premtimi i Zotit – dhe Zoti nuk e shkelë premtimin e Tij – por shumica e njerëzve nuk dinë.
- [7] Ata merakosen vetëm për gjërat e kësaj bote që janë të dukshme për ta, përderisa janë krejtësisht të pavëmendshëm ndaj Përjetësisë.
- [8] Pse nuk po pasqyrojnë në veten e tyre? Zoti nuk krijoi qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë ndërmjet tyre, përveç për një qëllim specifik, dhe për një afat kohor specifik. Megjithatë, shumica e njerëzve, sa i përket takimit me Zotëruetin e tyre, janë mosbesimtarë.
- [9] A nuk janë endur nëpër tokë dhe kanë vënë re pasojat për ata që iu paraprinë atyre? Ata dikur ishin më të fuqishëm, më të begatë, dhe më produktiv në tokë. Të dërguarit e tyre shkuan te ta me shenja të qarta. Si pasojë, Zoti nuk është Ai që iu bëri keq atyre; ata janë ata që i bënë keq vetes.
- [10] Pasojat për ata që bënë të këqija duhej të ishin të këqija. Kjo është për shkak se ata refuzuan shpalljet e Zotit, dhe i përqeshën ato.
- Adhuresit e idhujve bëjnë hasha idhujt e vet*
- [11] Zoti është Ai që nisë krijimin dhe e përsëritë. Përfundimisht, te Ai do të ktheheni.
- [12] Në Ditën kur i vjen koha Orës, fajtorët do të tronditen.
- [13] Idhujt e tyre nuk do të kenë aspak fuqi për të ndërmjetësuar në emër të tyre; përkundrazi, ata do i bëjnë hasha idhujt e tyre.
- [14] Ditën kur i vjen koha Orës, ata do të ndahen.
- [15] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ata do të jenë në Parajsë, të gëzuar.

* 30:1 Shih Shtojcën 1 për shpjegimin e hollësishtëm të këtyre inicialeve që dikur ishin misterioze.

[16] Sa për ata që nuk besojnë, dhe refuzojnë shpalljet tona dhe takimin e Përjetësisë, ata do të zgjasin në ndëshkim përgjithmonë.

Përkujto Zotin, përherë

[17] Prandaj, ta madhëroni Zotin kur bini gjatë natës, dhe kur ngriteni në mëngjes.

[18] I gjithë lartmadhërimi i përket Atij në qiej dhe tokë, gjatë natës, si dhe në mes të ditës.

[19] Ai prodhon të gjallin nga i vdekuri, dhe prodhon të vdekurin nga i gjalli, dhe Ai ngjallë tokën pasi që të kishte vdekur; ju ringjalleni ngjashëm.

Martesa: Rregullim Hyjnor

[20] Mes provave të Tij është që Ai ju krijoi prej dheu, pastaj u bëtë njerëz riprodhues.

[21] Mes provave të Tij është që Ai krijoi për ju bashkëshorte nga vetë ju, në mënyrë që të keni qetësi dhe kënaqësi me njëri tjetrin, dhe Ai vuri në zemrat tuaja dashuri dhe kujdes për njëri tjetrin. Në këtë, ka prova të mjaftueshme për njerëzit që mendojnë.

Më shumë prova

[22] Mes provave të Tij janë krijimi i qiejve dhe tokës, dhe ndryshimet në gjuhët tuaja dhe ngjyrat tuaja. Në këto ka shenja për të dijsmit.

[23] Mes provave të Tij është gjumi juaj gjatë natës ose ditës, dhe puna juaj në kërkim të furnizimeve të Tij. Në këtë, ka prova të mjaftueshme për njerëzit që mund të dëgjojnë.

[24] Mes provave të Tij është që Ai ju tregon vetëtimën si burim frike, si dhe shprese, pastaj Ai zbret nga qielli ujë për të ngjallur tokë që ka qenë e vdekur. Në këto, ka prova të mjaftueshme për njerëzit që kuptojnë.

[25] Mes provave të tij është që qielli dhe toka janë duke qëndruar në dispozicion të Tij. Përfundimisht, kur Ai ju thërret jashtë tokës, një thirrje, ju menjëherë do të dilni.

[26] Atij i takon çdokush në qiej dhe tokë; të gjithë janë të nënshtruar ndaj Tij.

[27] Dhe Ai është Ai që nisë krijimin, dhe e përsëritë; kjo është madje edhe më lehtë për Atë. Atij i përket ngjashmëria më madhështore, në qiej dhe tokë, dhe Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Absurditeti i adhurimit të idhujve

[28] Ai përmendë për ju këtu shembull nga mesi juaj: A i lartësoni shërbëtorët ose ata nën ju deri në shkallën ku ata ju rivalizojnë juve, dhe deri në pikën që të tregoni besnikëri ndaj tyre aq sa tregohet ndaj jush? Kështu i shpjegojmë shpalljet për njerëzit që kuptojnë.

[29] Vërtetë, shkelësit kanë ndjekur mendimet e veta, pa dije. Kush pra mund t'i udhëzojë ata që janë dërguar në humbje nga Zoti? Askush nuk mund t'iu ndihmojë atyre.

*Monoteizmi: Instinkt natyral**

[30] Prandaj, t'ia kushtoni veten me gjithë zemër fesë së monoteizmit. I tillë është instinkti natyral i vënë në njerëz nga Zoti. Krijim i tillë nga Zoti nuk do të ndryshojë. Kjo është feja e përkryer, por shumica e njerëzve nuk dinë.

[31] T'i nënshtroheni Atij, t'ia keni dronë Atij, zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe – çfarëdo që të bëni – mos bini kurrë në adhurim idhujsh.

Sektarizmi mallkohet

[32] (Mos bini në adhurim idhujsh,) si ata që ndajnë fenë e tyre në sekte; secila palë e kënaqur me atë që kanë ata.

Shokë për interes

* 30:30 Njohja e VETËM Zotit si Zotërues dhe Sundues është instinkt natyral. Ne jemi të lindur në këtë botë me një instinkt të tillë. Shih 7:172-173 dhe Shtojcën 7.

[33] Kur fatkeqësi i pllakosë njerëzit, ata i kthehen Zotëruesit të tyre, duke ia kushtuar veten plotësisht Atij. Por pastaj, sapo Ai iu derdhë atyre mëshirë, disa prej tyre rikthehen në adhurim idhujsh.*

[34] Lëri të jenë mosmirënjohës për atë që iu kemi dhënë atyre. Le të kënaqen përkohësisht; patjetër do e marrin vesh.

[35] A iu kemi dhënë atyre autorizim që justifikon idhujtarinë e tyre?

[36] Kur dhurojmë mëshirë mbi njerëzit, ata gëzohen me të. Por kur iu bie fatkeqësi, si pasojë e vetë punëve të tyre, ata bëhen të dëshpëruar.

[37] A nuk e kuptojnë që Zoti shton furnizimin për kë do Ai, ose e zvogëlon? Prej këtyre duhet të marrin mësim njerëzit që besojnë.

[38] Prandaj, t'ia jepni të afërmve hisen (e bamirësisë) me të drejtë të tyre, si dhe të varfrit, dhe udhëtarit të huaj. Kjo është më mirë për ata që sinqerisht kërkojnë kënaqësinë e Zotit; ata janë fituesit.

[39] Fajdeja që ushtrohet për të rritur pasurinë e disa njerëzve, nuk fiton asgjë te Zoti. Por nëse jepni bamirësi, duke kërkuar kënaqësinë e Zotit, këta janë ata që pranojnë shpërblimin e tyre shumëfish.

Kush ia vlen të adhurohet?

[40] Zoti është Ai që ju krijoi. Ai është Ai që furnizon për ju. Ai është Ai që ju vë në vdekje. Ai është Ai që ju ringjallë. A munden idhujt tuaj t'i bëjnë këto? I madhëruar qoftë Ai. Ai është tepër i lartësuar për të pasur ndonjë ortak.

[41] Fatkeqësi janë përhapur nëpër tokë dhe det, për shkak të asaj që kanë bërë njerëzit. Ai kështu i lë ata të shijojnë pasojat e ca punëve të tyre, që të mund të kthehen (në punët e drejta).

Mësime nga e kaluara

[42] Thuaj, "Enduni nëpër tokë dhe vëreni pasojat për ata para jush." Shumica e tyre ishin adhurues idhujsh.

[43] Prandaj, t'ia kushtoni veten krejtësisht kësaj feje të përkryer, para se të vij një ditë të cilën Zoti e ka bërë të pashmangshme. Në atë ditë, ata do të tronditen.

[44] Kushdo që nuk beson, nuk beson në dëm të shpirtit të vet, përderisa ata që çojnë jetë të drejtë, bëjnë ashtu për t'i forcuar dhe zhvilluar shpirtat e vet.

[45] Se Ai do i shpërblejë bujarisht ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë me dhuratat e Tij. Ai nuk i do mosbesimtarët.

[46] Mes provave të Tij është që Ai dërgon erërat me myzhde, që të derdhë mbi ju mëshirën e Tij, dhe t'i lejojë anijet të lëvizin në det në përputhje me rregullat e Tij, dhe për ju që të kërkonin dhuratat e Tij (nëpërmjet tregtisë), që të mund të jeni mirënjohës.

Fitore të garantuar për besimtarët

[47] Kemi dërguar të dërguarë para teje te njerëzit e tyre, me shenja të qarta. Më pas, i ndëshkuam ata që shkelën. Është detyrë e jona që t'i japim fitore besimtarëve.

[48] Zoti është Ai që dërgon erërat, për t'i tundur retë, që të shpërndahen nëpër qiell në përputhje me vullnetin e Tij. Ai pastaj grumbullon retë, pastaj e shihni shiun duke rënë prej tyre. Kur bie mbi këdo që Ai zgjedhë nga mes shërbëtorëve të Tij, ata gëzohen.

* 30:33 Shembull i zakonshëm janë reklammat që i vëmë re në gazeta, të vëna nga njerëzit duke falënderuar Shën Judën për shërimin e tyre. Para se të hynë në operacion kirurgjik, ata sinqerisht i luten Zotit për t'i shëruar ata. Por sapo operacioni të ketë sukses, ata e falënderojnë Shën Judën!!!

[49] Para se të binte te ta, ata kishin mbetur në dëshpërim.

[50] Të jesh mirënjohës për mëshirën e vazhdueshme të Zotit, dhe si Ai ngjall tokën që ka qenë e vdekur. Ai po ashtu do i ringjallë të vdekurit. Ai është i Gjithëfuqishëm.

[51] Sikur të dërgonim mbi ta një stuhi rëre të verdhë, ata do të kishin vazhduar të mos besonin.

[52] Nuk mund t'i bësh të vdekurit, as të shurdhrit, që ta dëgjojnë thirrjen, kur ata kthehen prapa.

[53] As nuk mund t'i nxjerrësh të verbrit jashtë humbjes së tyre. Mund vetëm të dëgjoresh nga ata që besojnë në shpalljet tona, dhe vendosin të bëhen të nënshtruar.

Kjo jetë është shumë e shkurtër

[54] Zoti është Ai që ju krijoi të dobët, pastaj ju dhuroi pas dobësisë forcë, pastaj zëvendësoi forcën me dobësi dhe flokë të thinjur. Ai krijon çka do Ai. Ai është i Gjithëdijsmi, i Gjithëfuqishmi.

[55] Ditën kur i vjen koha Orës, fajtorët do të bëjnë be që zgjatën (në këtë botë) vetëm një orë. Kaq gabim ishin ata.

[56] Ata që janë të bekuar me njohuri dhe besim do të thonë, “Keni zgjatur, sipas vendimit të Zotit, deri në Ditën e Ringjalljes. Tash, kjo është Dita e Ringjalljes, por ju nuk arritët ta njihni.”

[57] Prandaj, asnjë arsyetim, atë ditë, nuk do iu bëjë dobi shkelësve, as nuk do të falen.

[58] Kështu pra, kemi përmendur për njerëzit në këtë Kuran lloj lloj shembujsh. Prapëseprapë, pa marrë parasysh çfarë prove iu paraqet mosbesimtarëve, ata thonë, “Po mundoheni të na mashtroni.”

Ndërhyrje Hyjnore

[59] Zoti kështu i mbyllë zemrat e atyre që nuk dinë.

[60] Prandaj, të durosh me këmbëngulje – se premtimi i Zotit është e vërteta – dhe mos u ndje i kanosur nga ata që nuk kanë arritur sigurinë.

Surja 31: Llukmani (Lukman)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A. L. M.*

[2] Këto (shkronja) janë prova të këtij libri mençurie.

[3] Fener dhe mëshirë për të drejtë.

[4] Që zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe sa i përket Përjetësisë, ata janë absolutisht të sigurt.

[5] Ata po ndjekin udhëzimin nga Zotëruesi i tyre, dhe ata janë fituesit.

[6] Mes njerëzve, ka që i përmbahen Hadithit të pabazë, dhe kështu i largojnë të tjerët nga rruga e Zotit pa e ditur, dhe e marrin së koti. Këta kanë vetëshkaktuar ndëshkim të turpshëm.

[7] Dhe kur shpalljet tona i recitohen ndonjërit prej tyre, ai kthehet prapa me mendjemadhësi sikur të mos i kishte dëgjuar kurrë, sikur veshët e tij të jenë të shurdhër. Premtoi atij ndëshkim që dhemb.

[8] Padyshim, ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë kanë merituar kopshtet e hareshë.

[9] Përgjithmonë qëndrojnë aty. Ky është premtimi i vërtetë i Zotit. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[10] Ai krijoi qiejt pa shtylla që të mund të shihni. Ai themeloi në tokë stabilizues (male) se mos gremiset me ju, dhe Ai përhapë në të të gjitha llojet e krijesave. Ne zbresim nga qielli ujë për të rritur të gjitha llojet e bimëve të bukura.

* 31:1 Shih Shtojcën 1 për rolin e rëndësishëm të këtyre inicialeve.

[11] I tillë është krijimi i Zotit; më tregoni çka kanë krijuar idhujt të cilit i ngritni përkrah Tij. Në të vërtetë, shkelësit janë larg në humbje.

Mençuria e Llukmanit

[12] E pajisëm Llukmanin me mençuri: “T’i jesh mirënjohës Zotit.” Kushdo që është mirënjohës është mirënjohës për të mirën e vet. Sa për ata që bëhen mosmirënjohës, Zoti nuk ka aspak nevojë, i Falënderuari.

[13] Kujtohu që Llukmani i tha të birit të vet, përderisa e ndriçoi, “O djali im, mos ngrit asnjë idhull përkrah Zotit; idhujtaria është padrejtësi e tepërt.”*

Urdhri i dytë

[14] E urdhëruam qenien njerëzore t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e tij e barti, dhe ngarkesa u bë rëndë e më rëndë. Duhet dy vite (kujdesi intensiv) deri në zvjerdhje. Të jesh mirënjohës ndaj Meje, dhe prindërve tu. Te Unë është fati përfundimtar.

[15] Nëse ata tentojnë të të detyrojnë të ngritësh ndonjë idhull përkrah Meje, mos iu bind atyre. Por vazhdo t’i trajtosh miqësisht në këtë botë. Të ndjekësh vetëm rrugën e atyre që më janë nënshtruar Mua. Përfundimisht, të gjithë më ktheheni Mua, pastaj Unë ju njoftoj për çdo gjë që keni bërë.

Këshilla e Llukmanit

[16] "O djali im, dije që edhe diçka aq e vogël sa një kokërr sinapi, thellë në një shkëmb, qoftë në qiej ose tokë, Zoti do e sjellë. Zoti është Preciz, Njohës.

[17] "O djali im, t’i zbatosh Lutjet e Kontaktit (Salat). Të përkrahësh drejtësi dhe ndalosh të keqen, dhe vazhdo të mbetesh i durueshëm përballë fatkeqësisë. Këto janë tiparet më të nderuara.

[18] "Të mos i trajtosh njerëzit me mendjemadhësi, as të mos endesh nëpër tokë krenarë. Zoti nuk i do mburraveçet e mendjemëdhenjtë.

[19] "Ec thjeshtë dhe ule zërin tënd – zëri më i shëmtuar është zëri i gomarit."

[20] A nuk e shihni që Zoti ka parashtruar në shërbimin tuaj çdo gjë në qiej dhe tokë, dhe ka derdhur mbi ju bekimet e Tij – të dukshme dhe të fshehta? Prapëseprapë, disa njerëz grinden në lidhje me Zotin pa dijeni, pa udhëzim, dhe pa shkrimin ndriçues.

Ndjekja e prindërve verbërisht: tragjedi e zakonshme

[21] Kur iu thuhet atyre, “Ndiqni këto shpallje të Zotit,” thonë, “Jo, ne ndjekim vetëm çka i gjetëm prindërit tanë duke bërë.” Çka nëse djalli është duke i çuar ata në agoninë e Ferrit?

Lidhja më e fortë

[22] Ata që i nënshtrohen plotësisht Zotit, përderisa çojnë jetë të drejtë, janë kapur për lidhjes më të fortë. Se Zoti i ka në dorë të gjitha gjërat.

[23] Sa për ata që nuk besojnë, mos u pikëllo nga mosbesimi i tyre. Te ne është kthimi i tyre përfundimtar, pastaj do i njoftojmë për çdo gjë që kishin bërë. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[24] I lëmë ata të kënaqen përkohësisht, pastaj i parashtrojmë në ndëshkim të rëndë.

Ata besojnë në Zot

[25] Nëse i pyet ata, “Kush krijoi qiejt dhe tokën,” do të thonë, “Zoti.” Thuaj, “Lavdi Zotit.” Prapëseprapë, shumica e tyre nuk dinë.

[26] E Zotit është çdo gjë në qiej dhe tokë. Zoti është Më i Pasuri, Më i Falënderuari.

* 31:13 Si do të ndjehesh nëse kujdesesh për një fëmijë, i jep edukimin më të mirë, dhe e përgatit për jetë, vetëm për ta parë që i falënderohet dikujt tjetër? E tillë është idhujtaria; padrejtësi.

Këto janë të gjitha fjalët që na duhen

[27] Sikur të gjithë lisat në tokë të bëheshin lapsa, dhe oqeani të bëhej ngjyrë, duke shtuar edhe shtatë oqeane më shumë, fjalët e Zotit nuk do të kishin të sosur. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[28] Krijimi dhe ringjallja e të gjithë juve është e njëjtë si ajo e një personi. Zoti është Dëgjues, Pamës.

VETËM Zoti ia vlen të adhurohet

[29] A nuk e kuptoni që Zoti shkrinë natën në ditë dhe shkrinë ditën në natë, dhe që Ai ka parashtruar diellin dhe hënën në shërbimin tuaj, secili duke udhëtuar në orbitën e vet për një kohëzgjatje specifike, dhe që Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni?

[30] Kjo vërteton që Zoti është e vërteta, përderisa ndonjë idhull që ata e ngritin përkrah Tij është gënjeshtër, dhe që Zoti është Më i Larti, Më i Madhi.

[31] A nuk e shihni që anijet enden nëpër det, duke bartur furnizimet e Zotit, për t'ju treguar juve disa nga provat e Tij? Vërtetë, këto duhet të jenë prova të mjaftueshme për cilindo që është i durueshëm, mirënjohës.

[32] Kur valë të fuqishme i rrethojnë ata, i luten Zotit sinqerisht duke ia kushtuar lutjet e tyre vetëm Atij. Por sapo Ai t'i shpëtojë ata në bregdet, disa prej tyre kthehen. Askush nuk i hedhë mbrapa shpalljet tona përveç atyre që janë tradhtarë, mosmirënjohës.

[33] O njerëz, t'ia keni dronë Zotëruesit tuaj, dhe frikësojuni një dite kur një baba nuk mund t'i ndihmojë fëmijës së vet, e as fëmija nuk mund t'i ndihmojë babait të vet. Padyshim, premtimi i Zotit është e vërteta. Prandaj, mos t'ju tërhiqet vëmendja nga kjo jetë; mos t'ju tërhiqet vëmendja nga iluzione të thjeshta prej Zotit.

Gjërat që mund t'i dimë dhe nuk mund t'i Dimë

[34] Me Zotin është njohuria për Orën (fundin e botës).^{*} Ai është Ai që zbret shiun, dhe Ai din përmbajtjet e mitrës. Asnjë shpirt nuk di çka do i ndodhë nesër, dhe askush nuk e di në cilën tokë ai ose ajo do të vdesë. Zoti është i Gjithëdijshtëm, Njohës.

Surja 32: Përluja (Es-Sexhde)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A. L. M.*

[2] Libri është, pa asnjë dyshim, shpallje prej Zotëruesit të gjithësisë.

[3] Ata thanë, "Ai e trilloi atë." Në të vërtetë, ky është e vërteta nga Zotëruesi yt, për t'i paralajmëruar njerëzit që nuk pranuan paralajmëruet para teje, që të mund të jenë të udhëzuar.

Asnjë ndërmjetësues dërmjet teje dhe Zotit

[4] Zoti është Ai që krijoi qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë ndërmjet tyre për gjashtë ditë, dhe mori çdo gjë në dorë. Nuk keni asnjë përkrah Tij si Zotërues, e as nuk keni ndërmjetësues. A nuk do të merni vesh?

[5] Të gjitha çështjet drejtohen nga Ai nga qielli në tokë. Te Ai, dita është e barabartë me njëmijë

^{*} 31:34 Zoti e shpallë njohurinë e Tij kurdo Ai do. Mësojmë nga kjo strofë se mund të jemi në gjendje ta parashikojmë shiun, dhe gjininë e fetusit. Por nuk mund ta dimë kohën dhe vendin e vdekjes. Në përputhje me 72:27, Zoti ka shpallur fundin e botës nëpërmjet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes. Shih 15:87, 20:15, dhe Shtojcën 25 për hollësitat.

^{*} 32:1 Domethënia e këtyre shkronjave jepet në strofën e ardhshme: "Ky libër është, pa asnjë dyshim, shpallje prej Zotëruesit të gjithësisë." Shih Shtojcën 1 për hollësitat.

vjet tuajat.

[6] Njohës i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve; i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Zanafilla e njeriut

[7] Ai është Ai që përkreu çdo gjë që krijoi, dhe filloi krijimin e njeriut nga balta.

[8] Pastaj Ai vazhdoi riprodhimin e tij nëpërmjet një lëngu të caktuar të ulët.

[9] Ai e formoi atë dhe fryu në të nga fryma e Tij. Dhe Ai ju dha dëgjimin, shikimin, dhe mendjen; rrallë jeni falënderues.

[10] Pyesin veten, “Pasi që të zhdukemi në tokë, a krijohemi sërish?” Pra, sa i përket takimit me Zotëruesin e tyre, ata janë mosbesimtarë.

[11] Thuaj, “Do të viheni në vdekje nga engjëlli në detyrë të të cilit jeni vendosur, pastaj te Zotëruesi juaj do të ktheheni.”

Tepër vonë

[12] Po t’i shihje fajtorët kur i përkulin kokat e tyre para Zotëruesit të tyre: “Zotëruesi ynë, tash kemi parë dhe kemi dëgjuar. Dërgona prapë dhe do të jemi të drejtë. Tash kemi arritur të bindemi.”*

[13] Sikur të donim, do të kishim mundur t’i jepnim çdo shpirti udhëzimin e tij, por veç është e paracaktuar që Unë do të mbushë Ferrin me xhinë dhe njerëz, të gjithë së bashku.*

[14] Vuani pasojat e harresës tuaj të kësaj dite; tash ju harrojmë juve. Keni vetëshkaktuar ndëshkim të përhershëm si shpagim për vetë punët tuaja.

[15] Njerëzit e vetëm që vërtetë besojnë në shpalljet tona janë ata që bien në përlulje kur i dëgjojnë ato. Ata e madhërojnë dhe lavdërojnë Zotëruesin e tyre, pa aspak mendjemadhësi.

[16] Anët e tyre me gatishmëri i braktisin shtretërit e tyre, për të adhuruar Zotëruesin e tyre, nga respekti dhe shpresa, dhe nga furnizimet tona te ta, ata japin.

Parajsa: Papërshkrueshmërisht e bukur

[17] Nuk e keni idenë sa shumë kënaqësi dhe lumturi po ju presin si shpërblim për punët tuaja (të drejta).

[18] A është dikush që është besimtar i njëjtë si dikush që është shpirtligë? Ata nuk janë të barabartë.

[19] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, kanë merituar Parajsën e përhershme. E tillë është banesa e tyre, si shpërblim për punët e tyre.

[20] Sa për shpirtligjtë, përfundimi i tyre është Ferr. Sa herë që mundohen të dalin prej aty, do të shtyhen prapa. Do iu thuhet, “Vuanie agoninë e Ferrit në të cilin dikur nuk besonit.”

[21] I lejojmë ata të vuajnë ndëshkimin më të vogël (të kësaj bote), para se ta vetëshkaktojnë ndëshkimin më të madh (të Përrjetësisë), që të mund (të ua rrokë dhe) të përmirësohen.

[22] Kush është më i keq se dikush që i kujtohen këto shpallje të Zotëruesit të tij, pastaj insiston që t’i shpërfillë ato? Patjetër do i ndëshkojmë fajtorët.

[23] I kemi dhënë Moisiut shkrimin – mos ushqe asnjë dyshim për takimin me Të – dhe e bëmë atë udhëzim për Fëmijët e Izraelit.

* 32:12 Nëse dërgohen prapë, ata do të kryenin shkeljet e njëjta. Shih Shënimin 6:28.

* 32:13 Shumica e njerëzve “insistojnë” që të shkojnë në Ferr, duke zgjedhur t’i injorojnë ftesat e Zotit për t’i shpenguar ata. Zoti nuk do të vë asnjë person në Ferr. Ata që nuk arrijnë ta shpengojnë veten duke e mohuar idhujtarinë dhe duke ia kushtuar veten VETËM Zotit, dhe nuk arrijnë t’i zhvillojnë shpirtat e vet nëpërmjet praktikave të porositura nga Krijuesi jonë, do iu duhet të ikin në Ferr me vullnetin e vet. Ata do të jenë tepër të ligë për të përbulluar prezencën fizike të energjisë së Zotit.

- [24] Caktuam prej mes tyre imamë që udhëzuan në përputhje me urdhrat tona, sepse ata duruan me këmbëngulje dhe arritën të jenë të sigurt për shpalljet tona.
- [25] Zotëruesi yt është Ai që do i gjykojë ata në Ditën e Ringjalljes, sa i përket çdo gjëje për të cilën u grindën.
- [26] A iu shkon mendja ndonjëherë atyre sa shumë gjenerata i kemi asgjësuar para tyre? Ata tash jetojnë dhe ecin në shtëpitë e paraardhësve të tyre. Kjo duhet të furnizojë prova të mjaftueshme. A nuk dëgjojnë?
- [27] A nuk e kuptojnë që ne e çojmë ujin në toka shterpë, dhe prodhojmë me të të korra për t'i ushqyer bagëtitë e tyre, si dhe ata? A nuk shohin.
- [28] Ata sfidojnë: "Ku është ajo fitore, nëse jeni të sinqertë?"
- [29] Thuaj, "Dita kur fitorja e tillë vjen, besimi nuk do iu sjellë dobi atyre që nuk besuan para saj, e as nuk do iu jepet tjetër mundësi."
- [30] Prandaj, shpërfilli ata dhe prit, edhe ata po presin.

Surja 33: Grupet e armatosura (El-Ahzab)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] O ti profet, t'ia kesh dronë Zotit dhe mos iu bind mosbesimtarëve dhe hipokritëve. Zoti është i Gjithëdijsëm, Më i Mençuri.
- [2] Ndiq çka të është shpallur ty prej Zotëruesit tënd. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që ju të gjithë bëni.
- [3] Dhe kij besim në Zotin. Zoti mjafton si përkrahës.

Devotshmëria ndaj Zotit është e pandashme

- [4] Zoti nuk i dha asnjë burri dy zemra në kraharorin e tij. As nuk i shndërroi gratë tuaja të cilat i largoni (sipas zakoneve tuaja) në nëna tuaja*. As nuk i shndërroi fëmijët tuaj të adaptuar në pasardhës gjenetik. Të gjitha këto janë veç shprehje që i keni shpikur. Zoti flet të vërtetën, dhe Ai udhëzon në rrugën (e drejtë).

Mos i ndërroni emrat tuaj

- [5] Jepuni fëmijëve tuaj të adaptuar emra që ruajnë lidhjet familjare me prindërit e tyre gjenetik. Kjo është më e drejtë para Zotit. Nëse nuk i njihni prindërit e tyre, atëherë, si vëllezër në fe, t'i trajtoni si anëtarë të familjes suaj. Nuk bëni mëkat nëse bëni gabim sa i përket kësaj; jeni përgjegjës për qëllimet tuaja. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.
- [6] Profeti është më i afërt me besimtarët se ata me njëri tjetrin, dhe gratë e tij janë si nëna për ta. Të afërmit duhet të kujdesen për njëri tjetrin në përputhje me shkrimin e Zotit. Kështu, besimtarët të kujdesen për të afërmit e tyre që imigrojnë te ta, pasi që të jenë siguruar që janë kujdesur për familjet e veta së pari. Këta janë urdhrat e këtij shkrimi.

*Muhamedi betohet të përkrahë të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes**

- [7] Kujtohu që e lidhëm besën me profetët, përfshirë edhe ty (o Muhamed), Nuhun, Ibrahimin,

* 33:4 Ishte zakon në Arabi që të largohej gruaja duke deklaruar që ajo ishte si nëna e burrit. Një zakon i tillë i padrejtë anulohet këtu.

* 33:7 Besëlidhja jepet hollësisht në 3:81. Zoti lidhi besën me profetët që ata ta përkrahin të Dërguarin e Tij të Besëlidhjes i cili do të vinte pas Muhamedit për ta pastruar dhe bashkuar lajmin e tyre. Besëlidhja u lidh para krijimit të tokës, dhe u përmbush në Mekë Dhyl-Hixhxhe 3, 1391 (21 Dhjetor, 1971). Shuma e muajit Islamik (12), plus ditës (3), plus vitit (1391) jep 1406, 19x74. Provë dërrmuese që e identifikon të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes si Rashad Khalifa furnizohet përgjatë Kuranit (Shtojcat 2 & 26).

Moisiun, dhe Jezusin të birin e Marisë. Morëm prej tyre zotim solemn.

[8] Më pas, Ai patjetër do i marrë në pyetje të sinqertit për sinqeritetin e tyre, dhe ka përgatitur për mosbesimtarët (në këtë fakt Kuranor) ndëshkim që dhemb.

Beteja e partive

[9] O ju që besoni, përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju; kur ushtarët ju sulmuan, ne dërguam mbi ta erë të fortë dhe ushtarë të padukshëm. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

[10] Kur ata ju erdhën prej së larti, dhe nga poshtë, sytë tuaj u tmerruan, zemrat tuaja ju erdhën deri në fyt, dhe ushqyet mendime për Zotin që nuk i kanë hije.

[11] Atëherë besimtarët u testuan vërtetë; ata u tronditën fort.

[12] Hipokritët dhe ata me dyshime në zemrat e tyre thanë, “Çka na premtoi Zoti dhe i dërguari i Tij nuk ishte asgjë më shumë se një iluzion!”

[13] Një grup prej tyre thanë, “O njerëz të Jethribit, nuk mund të arrini fitore; kthehuni.” Të tjerët i shpikën arsyetime profetit: “Shtëpitë tona janë të cenueshme,” kur ato nuk ishin të cenueshme. Ata vetëm dëshiruan të ikin.

[14] Sikur t’i pushtonte armiku dhe të kërkonte nga ta që t’iu bashkëngjiteshin, ata do i bashkëngjiteshin armikut pa ngurrim.

[15] Ata iu kishin betuar Zotit më parë që ata nuk do të ktheheshin prapa dhe të iknin; betimi ndaj Zotit përfshinë përgjegjësi të madhe.

[16] Thuaj, “Nëse ikni, nuk mund të ikni kurrë nga vdekja ose nga vrasja. Çfarëdo që të ndodhë, vetëm do të jetoni krejt pak më gjatë.”

[17] Thuaj, “Kush do i mbronte nga Zoti nëse vullneti i tij do të ishte për fatkeqësi, ose të ishte për bekim për ju?” Ata nuk mund të gjejnë, përkrah Zotit, asnjë Zotërues dhe Sundues tjetër.

[18] Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për penguesit mes jush, dhe ata që iu thonë bashkëluftëtarëve të tyre, “Le të rrimë të gjithë mbrapa.” Rrallë ata mobilizohen për mbrojtje.

[19] Gjithashtu, ata janë tepër dorështrënguar kur kanë të bëjnë me ju. Nëse çfarëdo e kërcënon shoqërinë, i sheh sytë e tyre duke u rrotulluar me frikë, sikur vdekja t’iu kishte ardhur tashmë. Kur të përfundojë kriza, ju fshikullojnë me gjuhë të ashpër. Ata janë tepër dorështrënguar me pasurinë e tyre. Këta nuk janë besimtarë, dhe, si pasojë, Zoti ka asgjësuar punët e tyre. Kjo është lehtë për Zotin që ta bëjë.

[20] Ata menduan se grupet e armatosura mund të vijjnë përsëri. Në atë rast, ata do të dëshironin që të kishin humbur në shkretëtirë, duke pyetur për lajmet nga larg. Sikur t’ju sulmonin grupet e armatosura juve përderisa ata ishin me ju, ata rrallë do t’ju përkrahnin.

*Guximi i Profetit**

[21] I dërguari i Zotit ka dhënë shembull të mirë për ata mes jush që kërkojnë Zotin dhe Ditën e Fundit, dhe vazhdimisht mendojnë për Zotin.

[22] Kur besimtarët e vërtetë i panë grupet e armatosura (të gatshme për sulm), ata thanë, “Kjo është çka Zoti dhe i dërguari i Tij na ka premtuar, dhe Zoti dhe i dërguari i Tij janë të sinqertë.” Kjo (situatë e rrezikshme) vetëm ua forcoi besimin dhe ua shtoi nënshtrimin e tyre.

[23] Mes besimtarëve ka njerëz që i përmbushën betimet e tyre ndaj Zotit. Disa prej tyre vdiqën, përderisa të tjerët qëndrojnë të gatshëm, pa u luhatur.

* 33:21 Dreqi e nxori këtë strofë jashtë kontekstit, dhe u mbështet në faktin që njerëzit e idolizonin Muhamedin, për të shpikur një bashkësi të tërë të rregullave të paautorizuara dhe të paarsyeshme të quajtura “Suneti i Profetit.” Kjo krijoi një fe krejtësisht tjetër (shih 42:21 dhe Shtojcën 18).

[24] Zoti patjetër do i paguaj të sinqertit për sinqeritetin e tyre, dhe do i ndëshkojë hipokritët, nëse Ai do, ose do i shpengojë. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

Gjatë kohës së Muhamedit

[25] Zoti zmbropsi ata që nuk besuan me tërbimin e tyre, dhe u larguan duarthatë. Zoti kështu i kurseu besimtarët nga ndonjë luftim. Zoti është i Fuqishëm, i Plotfuqishëm.

[26] Ai gjithashtu i zbriti aleatët e tyre mes njerëzve të shkrimit nga pozitat e tyre të sigurta, dhe hodhi tmerr në zemrat e tyre. Disa prej tyre i vratë, dhe disa i zutë rob.

[27] Ai ju bëri të trashëgoni tokën e tyre, shtëpitë e tyre, paratë e tyre, dhe toka në të cilat nuk keni shkelur. Zoti i ka të gjitha gjërat në dorë.

Përgjegjësi e posaçme për të qenit i afërt

[28] O profet, thuaju grave tua, "Nëse jeni duke e kërkuar këtë jetë dhe kotësitë e saj, atëherë le të ju kompensoj dhe t'ju lejoj të shkoni në mënyrë miqësore.

[29] "Por nëse po e kërkon Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe vendbanimin e Përjetësisë, atëherë Zoti ka përgatitur për të drejtat mes jush shpërblim shumë të madh."

Përgjegjësi e posaçme

[30] O gra të profetit, nëse ndonjëra prej jush kryen mëkat të tepërt, ndëshkimi do i dyfishohet asaj. Kjo është lehtë për Zotin që ta bëjë.

[31] Cilado prej jush që i bindet Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe çon jetë të drejtë, ne do i japim asaj shpërblim të dyfishtë, dhe kemi përgatitur për të furnizim bujar.

Shembull për të tjerat

[32] O gra të profetit, ju nuk jeni të njëjta si cilado grua tjetër, nëse zbatoni drejtësinë. (Ju keni përgjegjësi më të madhe.) Prandaj, të mos flisni me lajka, se mos ata me sëmundje në zemrat e tyre marrin mendimet e gabueshme; të flisni vetëm drejtësi.

[33] Qëndroni në shtëpitë tuaja, dhe mos u përzieni fort me njerëzit, siç bënit dikur gjatë ditëve të hershme të injorancës. T'i zbatoni Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe t'i bindeni Zotit dhe të dërguarit të Tij. Zoti dëshiron të heqë gjithë pashenjtinë nga ju, o ju që jetoni rreth Faltores së Shenjtë, dhe t'ju pastrojë krejtësisht.

[34] Përkujtoni çka po recitohet në shtëpitë tuaja nga shpalljet e Zotit dhe mençurinë e pandashme aty. Zoti është Preciz, Njohës.

Barazia e burrave dhe grave

[35] Të nënshtruarit, të nënshtruarat, besimtarët, besimtare, të dëgjueshmit, të dëgjueshmet, të sinqertit, të sinqertat, të durueshmit, të durueshmet, të ndershmit, të ndershmet, bamirësit, bamirëset, agjëruesit, agjërueset, të dëlirit, të dëlirat, dhe përkujtuesit e shpeshtë të Zotit, dhe përkujtueset e shpeshta; Zoti ka përgatitur për ta falje dhe shpërblim shumë të madh.

Gabim i madh kryhet nga Muhamedi: Muhamedi njeri nuk i bindet Muhamedit të dërguar

[36] Asnjë besimtar ose besimtare, nëse Zoti dhe i dërguari i Tij lëshojnë ndonjë urdhër, nuk ka zgjidhje tjetër sa i përket atij urdhri. Kushdo që nuk i bindet Zotit dhe të dërguarit të Tij ka shkuar larg në humbje.

[37] Kujtohu që i the atij që ishte i bekuar nga Zoti, dhe i bekuar nga ti, "Mbaje gruan tënde dhe ia kij dronë Zotit," dhe ti fshehe brenda teje çka Zoti dëshiroi të shpallë. Kështu, ti iu frikësove njerëzve, kur me të drejtë duhej t'i frikësoheshe vetëm Zotit. Kur Zejdi hoqi krejtësisht duar nga bashkëshortja e tij, ne të bëmë ty që të martohesh me të, për të themeluar precedentin që një burrë mund të martohet me bashkëshorten e shkurorëzuar nga djali i adoptuar i tij. Urdhrat e Zotit

të zbatohen.

[38] Profeti nuk bën gabim duke bërë çfarëdo që është bërë e lejueshme nga Zoti. I tillë është sistemi i Zotit që nga gjeneratat e hershme. Urdhri i Zotit është detyrë e shenjtë.

[39] Ata që japin lajmet e Zotit, dhe ia kanë dronë vetëm Atij, të mos i frikësohen kurrë askujt pos Zotit. Zoti është llogaritësi më i shkathët.

*Jo i dërguari i fundit**

[40] Muhamedi nuk ishte babai i asnjë burri mes jush. Ai ishte i dërguar i Zotit dhe profeti i fundit. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[41] O ju që besoni, ta përkujtoni Zotin shpesh.*

[42] Ta madhëroni Atë ditë e natë.

[43] Ai është Ai që iu ndihmon juve, së bashku me engjëjt e Tij, për t'ju çuar nga errësira në dritë. Ai është i Mëshirshëm ndaj besimtarëve.

[44] Përshëndetja e tyre ditën kur e takojnë Atë është, "Paqe," dhe Ai ka përgatitur për ta shpërblim bujarë.

[45] O profet, të kemi dërguar si dëshmitar, bartës të lajmeve të mira, si dhe paralajmërues.

[46] Duke ftuar te Zoti, në përputhje me vullnetin e Tij, dhe fener udhëzues.

[47] Jepu lajme të mira besimtarëve, që ata kanë merituar nga Zoti bekim shumë të madh.

[48] Mos iu bind mosbesimtarëve dhe hipokritëve, shpërfilli fyerjet e tyre, dhe kij besim në Zotin; Zoti mjafton si përkrahës.

Ligje martesore

[49] O ju që besoni, nëse u martuat me gra besimtare, pastaj u shkurorëzuat me to para se të keni marrëdhënie me to, ato nuk ju detyrohen juve me asnjë afat kohor (para se të martohen me burrë tjetër). T'i kompensoni me barazi, dhe lërinë të shkojnë miqësisht.

[50] O profet, i kemi bërë të ligjshme për ty gratë tua të cilave ua ke paguar pajën e tyre të duhur, ose ato që tashmë i ke, siç të janë dhënë nga Zoti. Gjithashtu të lejuara për ty për martesë janë vajzat e vëllezërve të babait tënd, vajzat e motrave të babait tënd, vajzat e vëllezërve të nënës tënde, vajzat e motrave të nënës tënde, të cilat kanë emigruar me ty. Gjithashtu, nëse një besimtare jep veten te profeti – duke hequr dorë nga paja – profeti mund të martohet me të pa pajë, nëse ai do ashtu. Megjithatë, heqja e dorës nga paja nga ana e saj vlen vetëm për profetin, dhe jo për besimtarët e tjerë. Ne tashmë i kemi shpallur të drejtat e tyre në lidhje me bashkëshortet e tyre ose me çka ata tashmë kanë. Kjo është për të të kursyer nga marrja. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[51] Mund t'i shmangesh butësisht cilësdo prej tyre, dhe mund ta sjellësh më afër teje cilëndo prej tyre. Nëse pajtohesh me cilëndo që e kishë larguar, nuk bën gabim. Në këtë mënyrë, ato do të jenë të kënaqura, nuk do të kenë brenga, dhe do të jenë të kënaqura me çka iu ofron të gjitha atyre me barazi. Zoti e di çka ka në zemrat tuaja. Zoti është i Gjithëdijshëm, i Butë.

[52] Përtej kategorive që të janë përshkruar, je i ndaluar të martohesh me gra të tjera, as nuk mund t'i zëvendësosh me një grua të re (nga kategoritë e ndaluara), pa marrë parasysh sa shumë e

* 33:40 Përkundër këtij definicioni të qartë për Muhamedin, shumica e Myslimanëve insistojnë që ai ishte profeti i fundit dhe gjithashtu i dërguari i fundit. Kjo është tipar tragjik i njerëzve siç e shohim në 40:34. Ata që me gatishmëri i besojnë Zotit e kuptojnë që Zoti e dërgoi të Dërguarin e Tij të Besëlidhjes, si pastrues dhe bashkues pas profetit të fundit Muhamedit (3:81, 33:7).

* 33:41-42 Zot i yti është kushdo që t'i preokupon mendimet shumicën e kohës. Prandaj ekziston urdhri që ta përkujtojë Zotin dhe madhërojmë Atë ditë e natë. Shih Shtojcën 27.

admiron bukurinë e tyre. Të jesh i kënaqur me ato që tashmë të janë bërë të lejuara. Zoti është pamës i të gjitha gjërave.

[53] O ju që besoni, mos hyni në shtëpitë e profetit në mos ju dhëntë leje të hani, as të mos detyroni një ftesë të tillë në asnjë mënyrë. Nëse ftoheni, mund të hyni. Kur të përfundoni së ngrëni, të largoheni; mos e angazhoni atë në biseda të gjata. Kjo dikur e lëndonte profetin, dhe ai ishte tepër i marruar t'ju tregonte. Por Zotit nuk i vjen marre nga e vërteta. Nëse ju duhet të kërkonte diçka nga gratë e tij, pyetni ato nga pas një barriere. Kjo është më çiltër për zemrat tuaja dhe zemrat e tyre. Nuk jeni për ta lënduar të dërguarin e Zotit. Të mos martoheni me të shoqet e tij pas tij, se kjo do të ishte fyerje e tepërt para Zotit.*

[54] Qoftë e deklaruar diçka, ose e fshehtë, Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[55] Gratë mund të çlirojnë (veshjen e tyre) rreth baballarëve të vet, bijve të vet, vëllezërve të vet, bijve të vëllezërve të vet, bijve të motrave të veta, grave tjera, dhe shërbëtorëve të veta. T'ia kenë dronë Zotit. Zoti është dëshmitar i të gjitha gjërave.

*Gjatë jetës së Profetit**

[56] Zoti dhe engjëjt e Tij e ndihmojnë dhe përkrahin profetin. O ju që besoni, ta ndihmoni dhe përkrahni atë, dhe të keni kujdes ndaj tij ashtu siç duhet t'i kihet kujdes.

[57] Padyshim, ata që kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij, Zoti i pllakosë ata me mallkim në këtë jetë, dhe në Përrjetësi; Ai ka përgatitur për ta ndëshkim të turpshëm.

[58] Ata që keqtrajtojnë besimtarët dhe besimtare, që nuk kishin bërë asgjë gabim, kanë bërë jo vetëm një shpifje, por gjithashtu një mëkat të tepërt.

Kodi i veshjes për gratë

[59] O profet, tregoju grave tua, vajzave tua, dhe grave të besimtarëve që t'i zgjasin veshjet e tyre. Kështu, ato do të njihen (si gra të drejta) dhe do i shmangen ofendimeve. Zoti është Falës, i Mëshirshëmi.

[60] Në mos u ndalshin (së keqtrajtuari juve), hipokritët, dhe ata me sëmundje në zemrat e tyre, dhe gënjeshtarët keqdashës të qytetit, ne patjetër do t'ju japim juve epërsi, pastaj ata do të detyrohen të largohen brenda një kohe të shkurtër.

[61] Ata kanë vetëshkaktuar dënim kudo që shkojnë; (në mos u ndalshin së sulmuari juve,) ata mund të kapen dhe të vriten.

[62] Ky është sistemi i përhershëm i Zotit, dhe do e gjeni që sistemi i Zotit është i pandryshueshëm.

*Fundi i botës zbulohet**

[63] Njerëzit ju pyesin për Orën. Thuaj, "Njohuria për të është vetëm me Zotin. Për sa din ti, Ora mund të jetë afër."

[64] Zoti i ka dënuar mosbesimtarët, dhe ka përgatitur për ta Ferr.

* 33:53 Jemi të ndaluar në 4:22 nga martesja me gra që ishin paraprakisht të martuara me etërit tanë. E as ati nuk mund të martohet me të shoqen e shkurorëzuar të të birit të tij gjenetik (4:23). Ky urdhër hyjnor ruan respektin tonë për etërit tanë dhe lidhjet e tyre më private. Ngjashëm, profeti ishte figurë atërore për besimtarët e kohës së tij. Për të mirën e atyre besimtarëve, Zoti i ndaloi që të martohen me gra që ishin paraprakisht të martuara me profetin. Martesa është marrëdhënie e shenjtë dhe shumë private, dhe jeta e private e profetit më mirë ishte të mbetej private.

* 33:56 Fjala "profet" (Nabi) vazhdimisht i referohet Muhamedit vetëm kur ishte gjallë. Dreqi e përdori këtë strofë për t'i joshur Myslimanët në përkujtimin e Muhamedit, vazhdimisht, në vend që të përkujtojnë Zotin siç urdhërohen në 33:41-42.

* 33:63 Më pak se një shekull më parë, vetëm Zoti kishte njohuri për televizorin dhe satelitët hapësinore, për shembull. Ai zbulon këtë njohuri në kohën e paracaktuar. Ngjashëm, Zoti ka zbuluar kohën e caktuar për fundin e kësaj bote (Shtojca 25).

[65] Përgjithmonë qëndrojnë në të. Nuk do të gjejnë asnjë zotërues, as përkrahës.

[66] Ditën kur ata hidhen në Ferr, do të thonë, “Ah sikur t’i bindeshim Zotit, dhe t’i bindeshim të dërguarit.”

[67] Ata gjithashtu do të thonë, “Zotëruesi ynë, iu kemi bindur sunduesve dhe udhëheqësve tanë, por ata na çuan në humbje.

[68] “Zotëruesi ynë, jepu atyre dyfish ndëshkim, dhe mallkoi ata me mallkim të llahtarshëm.”

[69] O ju që besoni, mos u bëni si ata që lënduan Moisiun, pastaj Zoti e çliroi atë nga çka ata thanë. Ai ishte, para Zotit, i nderuar.

[70] O ju që besoni, kini dronë Zotit dhe shprehni vetëm shprehjet e sakta.

[71] Ai pastaj do t’jua ndreqë punët, dhe t’jua falë mëkatet. Ata që i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij kanë ngadhënjyer me një triumf të madh.

Liria e zgjedhjes

[72] Ia kemi ofruar përgjegjësinë (lirinë e zgjedhjes) qiejve dhe tokës, dhe maleve, por ato refuzuan ta mbajnë atë, dhe ishin të frikësuar nga ajo. Por qenia njerëzore e pranoi atë; ai ishte shkelës, i paditur.*

[73] Se Zoti patjetër do i ndëshkojë hipokritët dhe hipokritet, dhe adhuruesit e idhujve dhe adhurueset e idhujve. Zoti shpengon besimtarët dhe besimtare. Zoti është Falës, i Mëshirshëmi.

Surja 34: Sheba (Sebe')

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] I lartmadhëruar qoftë Zoti – të cilit i takon çdo gjë në qiej dhe tokë; i gjithë lartmadhërimi gjithashtu i takon Atij në Përjetësi. Ai është Më i Mençuri, Njohësi.

[2] Ai di çdo gjë që hyn në tokë, dhe çdo gjë që del prej saj, dhe çdo gjë që zbret nga qielli, dhe çdo gjë që ngjitet në të. Ai është i Mëshirshmi, Falësi.

[3] Ata që nuk besojnë kanë thënë, “Orës nuk do i vijë koha!” Thuaj, “Absolutisht – pasha Zotëruesin tim – patjetër do t’ju vijë. Ai është Njohësi i të ardhmes. As sa pesha e atomit nuk është e fshehur prej Tij, qoftë në qiej apo tokë. Madje as më e vogël se aq, as më e madhe (nuk mund të fshihet). Të gjitha janë në regjistër të qartë.”

[4] Patjetër, Ai do i shpërblejë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë. Këta kanë merituar falje dhe furnizim bujar.

[5] Sa për ata që vazhdimisht i sfidojnë shpalljet tona, ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim poshtërimi që dhemb.

[6] Është e dukshme për ata që janë të bekuar me njohuri se kjo shpallje nga Zotëruesi yt te ti është e vërteta, dhe se ajo udhëzon në rrugën e të Plotfuqishmit, Më të Falënderuarit.

[7] Ata që nuk besojnë kanë thënë, “Le t’ju tregojmë një njeri që ju thotë që pasi të jeni bërë copë e hi do të krijoheni përsëri.

[8] “Ose ka trilluar rrena për Zotin, ose është i çmendur.” Në të vërtetë, ata që nuk besojnë në Përjetësinë kanë vetëshkaktuar ndëshkimin më të keq; ata kanë humbur larg në humbje.

[9] A nuk i kanë parë gjithë ato gjëra para tyre dhe pas tyre, në qiell dhe tokë? Sikur të donim, do e bënim tokën t’i përpijë ata, ose të bënim masa të binin mbi ta nga qielli. Kjo duhet të jetë provë e mjaftueshme për çdo shërbëtorë të bindur.

Davidi dhe Salomoni

* 33:72 Kafshët, lisat, yjet, etj. e shfrytëzuan këtë rast.

[10] E pajisëm Davidin me bekime prej nesh: “O male, nënshtroheni me të, dhe ju gjithashtu, o zogj.” E zbutëm hekurin për të.

[11] “Mund të bësh mburoja që përshtaten tamam, dhe puno drejtësi. Çfarëdo që të bëni, Unë jam Pamës i saj.”

Fusha e parë e naftës

[12] Salomonit ia dhamë erën nën kontroll, duke udhëtuar një muaj në ardhje dhe një muaj në shkuarje. Dhe ne e bëmë një burim naftë të shpërthejë për të. Gjithashtu, xhinët punuan për të, me lejen e Zotëruesit të tij. Cilido prej tyre që i shpërfillë urdhrat tona, e parashtrijmë në ndëshkim të rreptë.

[13] Ata bënë për të çfarëdo që dëshironte – kamare, statuja, basene të thella, dhe tenxhere të rënda. O familje e Davidit, punoni (drejtësi) për të treguar mirënjohjen tuaj. Vetëm një pakicë e shërbëtorëve të Mi janë mirënjohës.

Njohuria e xhinëve është e kufizuar

[14] Kur koha e caktuar për vdekjen e tij erdhi, ata nuk e kishin idenë që ai kishte vdekur. Derisa njëra prej kafshëve u mundua ta hajë shkopin e tij, dhe ai ra poshtë, xhinët nuk e kuptuan që ai ishte i vdekur. Ata kështu e kuptuan që sikur ata vërtetë ta kishin ditur të paparën, ata do të ishin ndalur së munduari aq shumë sapo ai vdiq.

[15] Mëmëdheu i Shebas dikur ishte i mahnitshëm, me dy kopshte në të djathtë dhe në të majtë. Hani prej furnizimeve të Zotëruesit tuaj, dhe i jini mirënjohës Atij – tokë e mirë, dhe Zotërues që falë.

[16] Ata u kthyen prapa dhe, si pasojë, derdhëm mbi ta një vërshim shkatërrues, dhe i zëvendësuam dy kopshtet e tyre me dy kopshte frutash të hidhët, ferra, dhe të korra tek tuk.

[17] Kështu i paguam ata për mosbesimin e tyre. A nuk i paguajmë vetëm mosbesimtarët.

[18] Vumë ndërmjet tyre dhe shoqërive që i bekuam oaza të tjera, dhe e siguroam rrugëtimin ndërmjet tyre: “Udhëtoni aty ditë e natë në siguri të plotë.”

[19] Por ata (u bënë mosmirënjohës dhe) sfiduan: Zotëruesi ynë, nuk na ndien nëse Ti e rritë largësinë e rrugëtimeve tona (pa stacione).” Ata kështu i bënë keq vetes. Si pasojë, i bëmë ata histori, dhe i shpërndamë ata në shoqëri të vogla nëpër tokë. Kjo duhet të furnizojë mësim për ata që janë të durueshëm, mirënjohës.

Dreqi i kapë shumicën

[20] Dreqi i gjeti ata duke i përmbushur shpresat e tij me gatishmëri. Ata e ndoqën atë, përveç një pakice besimtarësh.

Synimi: A besojmë në Përjetësinë?

[21] Ai nuk kishte aspak fuqi mbi ta. Por kështu i shquajmë ata që besojnë në Përjetësinë nga ata që kanë dyshime për të.* Zotëruesi yt i drejton krejtësisht të gjitha gjërat.

[22] Thuaj, “Lutjuni idhujve që i keni ngritur përkrah Zotit. Ata nuk kanë as sa një atom i vetëm në qiej, ose tokë. Ata nuk kanë aspak ortakëri aty, e as nuk i lejon Ai ata që të jenë ndihmësit e Tij.”

S’ka ndërmjetësim

[23] Ndërmjetësimi me Të do të jetë i kotë, në mos qoftë në përputhje me vullnetin e Tij. Kur mendjet e tyre më në fund qetësohen, dhe ata pyesin, “Çka tha Zotëruesi juaj,” ata do të thonë, “Të vërtetën.” Ai është Më i Larti, Më i Madhi.

* 34:21 Kriteret që na njoftojnë nëse besojmë ose jo në Përjetësinë janë në 6:113, 17:45, & 39:45. Këto tri kriterë nxjerrin jashtë bindjet tona të vërteta, pa marrë parasysh pohimet tona gojore.

[24] Thuaj, “Kush furnizon për ju, nga qiejt dhe toka?” Thuaj, “Zoti,” dhe “Ose ne ose ju jemi të udhëzuar, ose kemi shkuar në humbje.”

[25] Thuaj, “Ju nuk jeni përgjegjës për krimet tona, as ne nuk jemi përgjegjës për çka ju bëni.”

[26] Thuaj, “Zotëruesi ynë do të na mbledhë të gjithë neve së bashku para Tij pastaj Ai do të gjykojë mes nesh me barazi. Ai është Gjykatësi, i Gjithëdijshmi.”

[27] Thuaj, “Më tregoni idhujt që i keni ngritur si ortakë me Të!” Thuaj, “Jo; Ai është i vetmi Zot, i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.”

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[28] Të kemi dërguar ty* te të gjithë njerëzit, bartës të lajmit të mirë, si dhe paralajmërues, por shumica e njerëzve nuk dinë.

[29] Ata sfidojnë, “Kur do i vij koha këtij premtimi, nëse jeni të sigurt?”

[30] Thuaj, “Ju keni një kohë të caktuar, në një ditë të caktuar, që nuk mund ta shtyni as për një orë, as ta shpejtoni.”

[31] Ata që nuk besojnë kanë thënë, “Nuk do të besojmë në këtë Kuran, as në shkrimet paraprake.” Vetëm sikur të mund t’i paramendonit këta shkelës kur ata qëndrojnë para Zotëruetit të tyre! Ata do të grinden me njëri tjetrin. Ndjekësit do iu thonë udhëheqësve të vet, “Po të mos ishit ju, do të kishim qenë besimtarë.”

Në Ditën e Ringjalljes

[32] Udhëheqësit do iu thonë atyre që i ndoqën, “A jemi ne ata që ju larguam nga udhëzimi pasi që erdhi te ju? Jo; ishit ju ata që ishit shpirtligj.”

[33] Ndjekësit do iu thonë udhëheqësve të tyre, “Ishit ju që planifikuat natë e ditë, pastaj na urdhëruat neve t’i jemi mosmirënjohës Zotit, dhe të ngrisim idhuj për ta rivalizuar Atë.” Ata do i brejë ndërgjegjja, kur e shohin ndëshkimin, se do të vëmë pranga rreth qafave të atyre që nuk besuan. A nuk janë të paguar ata me drejtësi për atë që ata bënë?

Secilën herë!

[34] Secilën herë që dërguam një paralajmërues te një shoqëri, udhëheqësit e asaj shoqërie thanë, “Ne e refuzojmë lajmin me të cilin jeni dërguar.”

[35] Ata gjithashtu thanë, “Ne jemi më të fuqishëm, me më shumë para dhe fëmijë, dhe nuk do të ndëshkohemi.”

[36] Thuaj, “Zotëruesi im është Ai që i drejton të gjitha furnizimet; Ai ia dhuron furnizimet kujt do Ai, ose i zvogëlon ato, por shumica e njerëzve nuk dinë.”

[37] Nuk janë paratë tuaja ose fëmijët tuaj që ju sjellin më afër nesh. Vetëm ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë do të pranojnë shpërblimin për punët e tyre, të shumëfishuar shumëfish. Në vendbanimin e Parajsës ata do të jetojnë në paqe të përkryer.

[38] Sa për ata që vazhdimisht i sfidojnë shpalljet tona, ata do të qëndrojnë në ndëshkim.

[39] Thuaj, “Zotëruesi im është Ai që i ka në dorë të gjitha furnizimet; Ai i rritë furnizimet për këdo Ai zgjedhë nga mes shërbëtorëve të Tij, ose i zvogëlon ato. Çfarëdo që shpenzoni (në rrugë të Zotit), Ai do t’ju shpërblejë për të; Ai është Furnizuesi Më i Mirë.”

[40] Në Ditën kur Ai i mbledhë ata të gjithë, Ai do iu thotë engjëjve, “A ju adhuruan këta njerëz?”

* 34:28 Siç detajohet në Shtojcën 2, emri i këtij të dërguari është matematikisht i koduar në Kuran si “Rashad Khalifa.” Duke e mbledhur vlerën numerike të emrit “Rashad” (505), plus vlerën numerike të emrit “Khalifa” (725), plus numrin e sures (34), plus numrin e strofës (28), marrim shumën që përputhet me mrekullinë matematikore të Kuranit të bazuar në 19, e cila u zbulua nëpërmjet Rashad Khalifës. (505+725+34+28=1292=19x68). Më shumë informata jepen në 5:19 dhe në shënimin e saj.

[41] Ata do të përgjigjen, “Qofsh Ti i madhëruar. Ti je Zotëruesi dhe Sunduesi ynë, jo ata. Në të vërtetë, ata ishin duke adhuruar xhinët; shumica e tyre ishin besimtarë në ta.”

[42] Në atë ditë, nuk keni aspak fuqi për ta ndihmuar ose dëmtuar njëri tjetrin, dhe do iu themi shkelësve, “Vuanie ndëshkimin e Ferrit që dikur e mohoni.”

*Mrekullia Matematikore e Kuranit**

[43] Kur provat tona iu recituan atyre, krejtësisht të qarta, ata thanë, “Ky është thjeshtë një njeri që dëshiron t’ju largojë nga mënyra që prindërit tuaj po adhurojnë.” Ata gjithashtu thanë, “Këto janë rrena të shpikura.” Ata që nuk besuan gjithashtu thanë për të vërtetën që erdhi te ta, “Kjo është qartazi magji.”

[44] Nuk iu dhamë atyre libra tjerë për të studiuar, as nuk dërguam te ta para teje paralajmërues tjetër.

[45] Ata para tyre nuk besuan, dhe edhe pse ata nuk e panë një të dhjetën* e (mrekullisë) që i kemi dhënë kësaj gjenerate, kur ata nuk iu besuan të dërguarve të Mi, sa i rëndë ishte ndëshkimi Im!

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[46] Thuaj, “Unë ju thërras juve të bëni një gjë: T’ia kushtoni veten Zotit, në çifte ose vetë, pastaj të pasqyroni. Shoku juaj* nuk është i çmendur. Ai është paralajmërues i qartë te ju, pak para ardhjes së një ndëshkimi të tmerrshëm.”

[47] Thuaj, “Unë nuk kërkoj nga ju pagë; mund ta mbani. Rroga ime vjen vetëm prej Zotit. Ai është dëshmitar i të gjitha gjërave.

[48] Thuaj, “Zotëruesi im e bën të vërtetën të ngadhënjejë. Ai është Njohësi i të gjitha të fshehtave.”

[49] Thuaj, “E vërteta ka ardhur; përderisa e pavërteta as nuk mund të nisë asgjë, as ta përsërisë.”

[50] Thuaj, “Nëse unë shkoj në humbje, shkoj në humbje për shkak të vetë të metave të mia. Dhe nëse jam i udhëzuar, është për shkak të frymëzimit të Zotëruesit tim. Ai është Dëgjues, Afër.”

[51] Veç sikur t’i shihje ata kur tmerri i madh i godet ata; nuk do të mund t’i shpëtojnë atëherë, dhe do kapen me forcë.

[52] Atëherë do të thonë, “Ne tash besojmë në të,” por do të jetë shumë vonë.

[53] Ata e kanë refuzuar atë në të kaluarën; në vend të saj kanë vendosur t’iu përmbahen hamendjeve dhe supozimeve.*

[54] Si pasojë, ata u hoqën nga çdo gjë që e lakmonin. Ky është i njëjti fat si i homologëve të tyre në gjeneratat paraprake. Ata ushqyen tepër shumë dyshime.

* 34:43 Duke e mbledhur vlerën gormore të “Rashad” (505), plus vlerën e “Khalifa” (725), plus numrin e kësaj strofe (43), marrim $505+725+43=1273=19 \times 67$. Shih Shtojcën 1 & 2.

* 34:45 Mrekullitë e mëdha që iu dhanë Moisiut dhe Jezusit ishin të kufizuara në kohë dhe hapësirë; për to ishin dëshmitarë disa njerëz që u ndodhën aty në atë vend dhe në atë kohë. Por mrekullia matematikore e Kuranit është e përhershme (shih 74:30-35 dhe Shtojcën 1).

* 34:46 Frazja “shoku juaj” i referohej edhe Rashad Khalifës kur ishte në këtë botë. Duke e vënë vlerën gormore të “Rashad” (505) pranë vlerës “Khalifa” (725), pastaj numrin e sures (34), dhe numrin e strofës (46), marrim $5057253446=19 \times 266171234$.

* 34:53 Njerëzit e të gjitha feve priren që ta braktisin fjalën e Zotit dhe t’iu përmbahen fjalëve të njerëzve. Jahuditë dhe Myslimanët iu përmbahen Mishnës (Hadithit) dhe Gëmarras (Sunet), përderisa të Krishterët i përmbahen trinisë të shpikur nga Konferenca e Nicës, 325 vite pas Jezusit.

Surja 35: Nismëtari (Fatir)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] I lartmadhëruar qoftë Zoti, Nismëtari i qiejve dhe tokës, dhe caktuesi i engjëjve për të qenë të dërguar me krahë – dy, tre, dhe katër (krahë). Ai e rritë krijimin si do Ai. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

[2] Kur Zoti derdhë mbi njerëzit mëshirë, asnjë forcë nuk mund ta ndalë. Dhe nëse ai e mbanë atë, asnjë forcë, përveç Atij, nuk mund ta dërgojë. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[3] O njerëz, përkujtoni bekimet e Zotit mbi ju. A ka ndonjë krijues përveç Zotit që furnizon për ju nga qielli dhe toka? Nuk ka asnjë zot përkrah Tij. Si mund të devijoni?

[4] Nëse nuk të besojnë ty, të dërguarë para teje nuk janë besuar. Zoti i ka në dorë të gjitha gjërat.

[5] O njerëz, premtimi i Zotit është e vërteta; prandaj, mos t'ju tërhiqet vëmendja nga kjo jetë e ulët. Nga iluzionet e thjeshta mos u largoni nga Zoti.

[6] Djalli është armiku juaj, pra trajtonie si armik. Ai vetëm e fton partinë e tij që të jenë banues të Ferrit.

[7] Ata që nuk besojnë kanë vetëshkaktuar ndëshkim të rreptë, dhe ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë kanë merituar falje dhe shpërblim shumë të madh.

[8] Vini re atë puna djallëzore e të cilit zbukurohet në sytë e tij, derisa ai mendon se është e drejtë. Zoti e dërgon në humbje këdo që do (të shkojë në humbje), dhe Ai e udhëzon këdo që do (të udhëzohet). Prandaj, mos u dëshpëro për ta. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëjnë.

[9] Zoti është Ai që dërgon erërat për t'i përzier retë, dhe pastaj i çojmë drejt tokave shterpë, dhe ngjallim toka të tilla pasi të ishin të vdekura. Kështu është ringjallja.

I gjithë dinjiteti i takon Zotit

[10] Kushdo që kërkon dinjitet duhet ta dijë që Zotit i takon i gjithë dinjiteti. Te ai ngriten fjalët e mira, dhe Ai i ngritë punët e drejta. Sa për ata që planifikojnë punë të këqija, ata vetëshkaktojnë ndëshkim të rreptë; planifikimi i njerëzve të tillë është i paracaktuar të dështojë.

Zoti i ka gjërat në dorë

[11] Zoti ju krijoi nga dheu, pastaj prej një pikle, pastaj ju bën të riprodhoni nëpërmjet bashkëshorteve tuaja. Asnjë femër nuk mbetet shtatzënë, as nuk lindë, pa dijen e Tij. Askush nuk mbijeton një jetë të gjatë, dhe jeta e askujt nuk këputet shkurt, përveç në përputhje me një regjistër të paracaktuar. Kjo është lehtë për Zotin.

*Çmuarja e madhështisë së Zotit**

[12] Dy detet nuk janë të njëjtë; njëri është i ëmbël dhe i shijshëm, përderisa tjetri është i njelmët dhe i papijshëm. Prej secilit prej tyre hani mish të butë, dhe nxirrni stoli për t'i mbajtur. Dhe i shihni anijet duke lundruar nëpërmjet tyre, duke kërkuar furnizimet e Tij, që të mund të jeni mirënjohës.

[13] Ai e shkrinë natën në ditë, dhe e shkrinë ditën në natë. Ai e ka parashtruar diellin dhe hënën për të lëvizur për një kohë të paracaktuar. I tillë është Zoti Zotëruesi juaj; i Tij është i gjithë mbretërimi. Cilëtdo idhuj që i ngrisni përkrah Tij nuk posedojnë as sa një lëvozhgë fare.

* 35:12-13 Kur i dërgojmë astronautët tanë në gjithësi, i furnizojmë me nevojat e tyre minimale të ushqimit, ujit, dhe oksigjenit. Kur anuam nga blasfemia e Drejt bilonja vjet më parë (Shtojca 7), Zoti na lëshoi në gjithësi të hipur në anijen kozmike të quajtur Toka. Por Zoti e ka furnizuar anijen tonë kozmike me sisteme mbresëlënëse të riciklimit që furnizojnë llojllojshmëri të madhe të ushqimeve të freskëta, ujit, oksigjenit, madje edhe riprodhimin e neve astronautëve.

*Idhujt krejtësisht të pafuqi**

[14] Nëse i thërrisni ata nuk mund t'ju dëgjojnë. Edhe nëse ju dëgjojnë, nuk mund t'ju përgjigjen. Në Ditën e Ringjalljes, do t'ju mohojnë. Askush nuk mund t'ju njoftojë si Më Njohësi.

[15] O njerëz, ju jeni ata që keni nevojë për Zotin, përderisa Zotit nuk i nevojitet askush, Më i Falënderuari.

[16] Nëse Ai do, Ai mund t'ju heqë dhe zëvendësojë me krijim të ri.

[17] Kjo nuk është vështirë për Zotin.

[18] Asnjë shpirt nuk mund t'i bartë mëkatet e shpirtit tjetër. Nëse një shpirt që është i ngarkuar me mëkate i lutet tjetrit që t'ia bartë një pjesë të barrës, asnjë shpirt tjetër nuk mund të bartë ndonjë pjesë të saj, edhe sikur të ishin të afërt. Të vetmit njerëz që marrin vesh nga paralajmërimet tua janë ata që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre, edhe kur janë vetë, dhe i zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat). Kushdo që e pastron shpirtin e vet, e bën për të mirën e vet. Te Zoti është fati përfundimtar.

[19] I verbëri dhe pamësi nuk janë të barabartë.

[20] As errësira dhe drita.

[21] As freskia e hijes dhe nxehtësia e diellit.

[22] As të gjallit dhe të vdekurit; Zoti e bën kë do Ai dëgjues. Nuk mund t'i bësh të dëgjojnë ata që janë në varre.

[23] Ti nuk je asgjë më shumë se paralajmërues.

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[24] Të kemi dërguar ty* me të vërtetën, bartës lajmesh të mira, si dhe si paralajmërues. Çdo shoqëri duhet të pranojë paralajmërues.

[25] Nëse nuk besojnë, ata para tyre gjithashtu nuk kanë besuar. Të dërguarit e tyre shkuan te ta me prova të qarta, dhe Psalmet, dhe shkrimet ndriçuese.

[26] Më pas, i shkatërrova ata që nuk besuan; sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im!

Krijimet e ngjyrshme të Zotit

[27] A nuk e kuptoni se Zoti zbret nga qielli ujë, me të cilin prodhojmë fruta lloj lloj ngjyrash? Madje edhe malet kanë ngjyra të ndryshme; majat janë të bardha, ose të kuqe, ose ndonjë ngjyrë tjetër. E korbat janë të zi.

[28] Gjithashtu, njerëzit, kafshët, dhe bagëtitë janë lloj lloj ngjyrash. Kjo është pse njerëzit që ia kanë vërtetë dronë Zotit janë ata që janë të dijshtëm. Zoti është i Plotfuqishëm, Falës.

[29] Padyshim, ata që recitojnë librin e Zotit, zbatojnë Lutjet e Kontaktit (Salat), dhe nga furnizimet tona te ta shpenzojnë - fshehtë dhe publikisht - merren me investim që nuk humbë.

[30] Ai do i paguaj ata me bujari, dhe do i shumëfishojë bekimet e Tij mbi ta. Ai është Falës, Mirënjohës.

Kurani: Përbushja e të gjitha shkrimeve

[31] Çka të shpallëm ty në këtë shkrim është e vërteta, duke i përbushur të gjitha shkrimet paraprake. Zoti është Njohës i tërësishëm i shërbëtorëve të Tij, Pamës.

* 35:14 Njerëzit idolizojnë Jezusin, Marinë, Muhamedin, Alin, dhe/ose të shenjtit; idhujt e tillë nuk janë në dijeni dhe krejtësisht të pafuqi. Edhe kur ishin të gjallë në këtë tokë ishin të pafuqi.

* 35:24 Vlera germore e "Rashad Khalifa" (1230), plus numri i strofës (24) japin shumën që është shumëfish i 19-tës (1230+24=1254=19x66).

[32] E kaluam shkrimin nga gjenerata në gjeneratë, dhe e lejuam këdo që zgjodhëm nga shërbëtorët tonë ta pranojnë atë. Më pas, disa prej tyre i bënë keq shpirttrave të vet, disa iu përmbajtën atij vetëm një pjesë të kohës, përderisa të tjerët ishin të etur për të punuar drejtësi në përputhje me vullnetin e Zotit; ky është triumfi më i madh.

Besimtarët

[33] Ata do të hynë në kopshtet e Edenit, ku do të stolisen me byzylykë ari dhe margaritarësh, dhe veshjet e tyre aty do të jenë nga mëndafshi.

[34] Ata do të thonë, “Lartmadhëri Zotit që na i hoqi të gjitha brengat. Zotëruesi ynë është Falës, Mirënjohës.

[35] “Ai na ka pranuar në vendbanim hareje të përhershme, nga hirësia e Tij. Kurrë nuk mërzitemi këtu, as kurrë nuk lodhemi.”

Mosbesimtarët

[36] Sa për ata që nuk besojnë, kanë vetëshkaktuar zjarrin e Ferrit, ku nuk iu mbaron vdekja, as ndëshkimi nuk iu zbutet kurrë. Kështu i paguajmë mosmirënjohësit.

[37] Do të klithin në të, “Zotëruesi ynë, nëse na nxjerr nga këtu, do të punojmë drejtësi, në vend të punëve që dikur i bëmë.” A nuk ua dhamë krejt jetën si shans, me kujtesa të vazhdueshme për ata që do të ishin të vëmendshëm? A nuk e pranuat paralajmëruesin? Prandaj, vuani (pasojat). Shkelësit nuk do të kenë askënd që t’iu ndihmojë.

[38] Zoti është Njohësi i të ardhmes së qiejve dhe tokës. Ai është Njohësi i të gjitha mendimeve më të thella.

Fituesit dhe humbësit

[39] Ai është Ai që ju bëri trashëgimtarë të tokës. Më pas, kushdo që zgjedhë të mos besojë bën kështu në dëm të vet. Mosbesimi i mosbesimtarëve vetëm shkakton neverinë e Zotëruesit të tyre ndaj tyre. Mosbesimi i mosbesimtarëve i zhytë më thellë në humbje.

[40] Thuaj, “Vini re idhujt që i keni ngritur përkrah Zotit; më tregoni çka në tokë kanë krijuar.” A është ndonjë pjesë në qiej e tyre? A u kemi dhënë atyre libër ku nuk ka dyshim? Në të vërtetë, çka shkelësit i premtojnë njëri tjetrit nuk është asgjë më shumë se një iluzion.

[41] Zoti është Ai që i mbanë qiejt dhe tokën, se mos zhduken. Sikur dikush tjetër t’i mbante, ato patjetër do të zhdukeshin. Ai është i Butë, Falës.

Vënia në test

[42] Ata u betuan në Zotin që po tu shkante një paralajmërues atyre, do udhëzoheshin më mirë se ndonjë asamble e caktuar! Megjithatë, tash që paralajmëruesi erdhi te ta, kjo vetëm i zhyti ata më thellë në neveri.

[43] Ata u mbajtën me mendjemadhësi në tokë, dhe me planifikim djallëzor, dhe planifikimet djallëzore vetëm iu kthehen atyre që i planifikojnë. A të presin ata atëherë ndonjë gjë pos fatit të atyre që i bënë gjërat e njëjta në të kaluarën? Do e shihni se sistemi i Zotit është i përhershëm; do e shihni se sistemi i Zotit është i pandryshueshëm.

[44] A nuk janë endur nëpër tokë dhe i kanë vërejtur pasojat për ata që iu paraprinë? Ata ishin edhe më të fortë se ta. Asgjë nuk mund të fshihet prej Zotit në qiej, as në tokë. Ai është i Gjithëdijshëm, i Gjithëfuqishëm.

[45] Sikur Zoti t’i ndëshkonte njerëzit për mëkatet e tyre, Ai nuk do të linte asnjë krijesë në tokë. Por Ai u jep afat atyre për një kohë të paracaktuar. Kur të përmbushet afati i tyre, atëherë Zoti është Pamës i shërbëtorëve të Tij.

Surja 36: J.S. (Ja Sin)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] J. S.* (Ja Sin)
- [2] Dhe Kurani që është plot mençuri.
- [3] Padyshim, ti je një prej të dërguarve.*
- [4] Në rrugë të drejtë.
- [5] Kjo shpallje është nga i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.
- [6] Për t'i paralajmëruar njerëzit prindërit e të cilëve nuk ishin paralajmëruar, dhe prandaj, ata nuk janë në dijeni.
- [7] Është paracaktuar që shumica e tyre nuk besojnë.
- [8] Se ne vendosim rreth qafave të tyre pranga, deri në mjekrat e tyre. Si pasojë, ata mbesin të kyçur në mosbesimin e tyre.
- [9] Dhe ne vendosim barrierë para tyre, dhe barrierë pas tyre, dhe kështu, ne ua mbulojmë sytë; nuk mund të shohin.
- [10] Është njëjtë për ta, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove, ata nuk mund të besojnë.*
- [11] Ty do të marrin vesh vetëm ata që i përmbahen këtij lajmi, dhe ia kanë dronë Mirëbërësit - edhe kur janë vetë. Jepu lajme të mira të faljes dhe pagesës bujare.
- [12] Patjetër do i ngjallim të vdekurit, dhe kemi incizuar çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë, si dhe pasojat që vazhdojnë pas vdekjes së tyre. Çdo gjë e kemi numëruar në një regjistër të qartë.
- Refuzimi i të dërguarve: Tipar tragjik i njeriut**
- [13] Përmend për ta shembullin e njerëzve në një shoqëri që pranoi të dërguarit.
- [14] Kur dërguam te ta dy (të dërguarë), nuk iu besuan. Ne pastaj i përkrahëm ata me një të tretë. Ata thanë, "Ne jemi të dërguarit (e Zotit) për ju."
- [15] Ata thanë, "Ju nuk jeni asgjë më shumë se qenie njerëzore si ne. Mirëbërësi nuk ka zbritur asgjë. Jeni gënjeshtarë."
- [16] Ata thanë, "Zotëruesi ynë e di që ne jemi të dërguar te ju.
- [17] "Misioni ynë i vetëm është të japim lajmin."
- [18] Ata thanë, "Sipas nesh jeni ogurzi. Në mos u ndalshi, do t'ju gjuajmë me gurë, ose t'ju shkaktojmë ndëshkim që dhemb."
- [19] Ata thanë, "Oguri juaj varet nga reagimi juaj, tash që ua kemi sjellë ndërmend. Në të vërtetë, ju jeni njerëz shkelës."
- [20] Një njeri erdhi nga ana tjetër e qytetit, duke thënë, "O njerëzit e mi, ndiqni të dërguarit.
- [21] "Ndiqni ata që nuk ju kërkojnë pagë, dhe janë të udhëzuar.
- [22] "Pse të mos e adhuroj Atë që më nisi mua, dhe te Ai është kthimi juaj përfundimtar?"
- [23] "A të ngris përkrah Tij tjerë zota? Sikur të donte Mirëbërësi ndonjë të keqe për mua, ndërhyrja e tyre nuk mund të më ndihmojë aspak, as nuk mund të më shpëtojnë.
- [24] "Në atë rast do të isha krejtësisht i humbur.
- [25] "Unë kam besuar në Zotëruenin tuaj; Më dëgjoni."

* 36:1 Shih Shtojcën 1 për shpjegimin e hollësishëm të këtyre inicialeve.

* 36:3 Shih Shtojcat 2 & 26 për provën materiale të pakundërshtueshme.

* 36:10 Secili njeri tashmë është i vulosur si besimtar ose mosbesimtar. Shih Shtojcën 14.

* 36:13-27 Të dërguarit e Zotit kanë prova, predikojnë vetëm Zotin, dhe nuk kërkojnë para.

*Të drejtit shkojnë drejt në Parajsë**

[26] (Në kohën e vdekjes së tij) atij iu tha, “Hy në Parajsë.” Ai tha, “Ah sikur ta dinin njerëzit e mi.

[27] “Që Zotëruesi im më ka falur, dhe më ka bërë të nderuar.”

[28] Ne nuk zbritëm mbi njerëzit e tij, pas tij, ushtarë nga qielli; nuk kishim nevojë t’i zbresim.

[29] Krejt çka u nevojiti ishte një e rënë, ku ata mbetën të palëvizshëm.

*Përqeshja e të dërguarve: Tipar tragjik i njeriut**

[30] Sa e mjerë është gjendja e njerëzve! Sa herë që një i dërguar shkoi te ta, e përqeshën.

[31] A nuk e panë ata sa gjenerata i asgjësuam para tyre, dhe si ata nuk kthehen te ta?

[32] Secili prej tyre do të mblidhet para nesh.

Shenjat e Zotit

[33] Një shenjë për ta është toka e vdekur; e ngjallim dhe prodhojmë prej saj drithë për ushqimin e tyre.

[34] Rrisim në të kopshte me palma hurmash, dhe hardhi, dhe bëjmë burime të shpërthejnë aty.

[35] Kjo është për t’i furnizuar ata me fruta, dhe t’i lëmë ata të përpunojnë me duart e veta çfarëdo që iu nevojitet. A do të jenë falënderues?

[36] I madhëruar qoftë Ai që krijoi të gjitha llojet e bimëve nga toka, si dhe vetë ata, dhe krijesa të tjera që as nuk i njohin.

[37] Shenjë tjetër për ta është nata; e heqim ditën prej saj, ku janë në errësirë.

[38] Dielli perëndon në pozicion të caktuar, sipas dizajnit të Plotfuqishmit, të Gjithëdijshmit.

[39] Hënën e dizajnuam të duket në faza, deri sa të bëhet si një rrem i vjetër i lakuar.

[40] Dielli nuk mund të zë hënën – nata dhe dita nuk devijojnë – secili prej tyre duke udhëtuar në orbitën e vet.

Shpikja e anijes së parë

[41] Shenjë tjetër për ta është që i bartëm paraardhësit e tyre në arkën e ngarkuar.

[42] Pastaj krijuam të njëjta për ta për të hipur në to.

[43] Po të donim, do të kishim mundur t’i mbysim, ashtu që britma e tyre nuk do të dëgjohej, e as nuk do të kishin mundur të shpëtohen.

[44] Në vend të kësaj, iu derdhim atyre mëshirë, dhe i lëmë të kënaqen për pak kohë.

[45] Prapëseprapë, kur iu thuhet atyre, “Mësoni nga e kaluara juaj, për të punuar drejtësi për të ardhmen tuaj, që të mund të arrini mëshirë,”

[46] Pa marrë parasysh çfarë lloj prove iu jepet atyre nga Zotëruesi i tyre, ata vazhdimisht e shpërfillin.

[47] Kur iu thuhet “Jepni nga furnizimet e Zotit te ju,” ata që nuk besojnë iu thonë atyre që besojnë, “Pse duhet të iu japim atyre që Zoti ka mundur t’i ushqejë, po të donte Ai? Ju jeni vërtetë larg në humbje.”

[48] Ata gjithashtu sfidojnë, “Kur do i vij koha atij premtimi, nëse jeni të singertë?”

[49] Krejt çka do të shohin ata është një e rënë që i kaplon ata, përdërisa grinden.

[50] Ata madje nuk do të kenë as kohë të lënë testament, as nuk do të kenë mundësi të kthehen te njerëzit e tyre.

* 36:26 Të drejtit nuk vdesin vërtetë; ata thjeshtë kalojnë në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva jetuan. Ata iu bashkohen profetëve, të shenjtëve dhe dëshmorëve në një jetë aktive dhe utopike. (shih Shtojcën 17).

* 36:30 Nëse i dërguari paraqet provë të qëndrueshme të dërguarësisë së tij, predikon adhurimin e vetëm Zotit, dhe nuk na kërkon para, pse të mos besojmë? (Shih Shtojcën 2.)

- [51] Bririt do i bihet, ku ata do të ngriten nga varri dhe të shkojnë te Zotëruesi i tyre
- [52] Ata do të thonë, “Mjerë ne. Kush na ringjalli nga vdekja jonë? Kjo është çka Mirëbërësi ka premtuar. Të dërguarit kishin të drejtë.”
- [53] Krejt çka duhet është një e rënë, ku ata mblidhen para nesh.
- [54] Në atë ditë, asnjë shpirti nuk do i bëhet me hile aspak. Do të paguheni saktësisht për çfarëdo që bëtetë.
- [55] Banuesit e Parajsës do të jenë, në atë ditë, të zënë me lumturi.
- [56] Ata banojnë me të shoqet e tyre në hije të bukur, duke gëzuar mobilie të rehatshme.
- [57] Ata do të kenë fruta aty; do të kenë çfarëdo që dëshirojnë.
- [58] Përshëndetje paqeje nga Zotëruesi i Mëshirshëm.
- [59] Sa për ju, o fajtorë, do të liheni anash.

Djalli është alternativa tjetër

- [60] A nuk lidha besën me ju, o Fëmijë të Ademit, që të mos e adhuronit djallin? Që ai është armiku juaj më i flaktë?
- [61] Dhe që të më adhuronit vetëm Mua? Kjo është rruga e drejtë.
- [62] Ai ka çorientuar shumë prej jush. A nuk kishit aspak mendje?
- [63] Ky është Ferri që ishte premtuar për ju.
- [64] Sot do të digjeni në të, si pasojë e mosbesimit tuaj.
- [65] Atë ditë ne do t’ua mbyllim gojët e tyre; duart dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë për çdo gjë që kishin bërë.
- [66] Po të duam, mund t’ua mbulojmë sytë dhe, si pasojë, kur ata e kërkojnë rrugën, nuk do të shohin.
- [67] Po të duam, mund t’i ngrijmë në vend; kështu, ata as nuk mund të lëvizin para, as mbrapa.
- [68] Këdo që e lejojmë të jetojë për një kohë të gjatë, e bëjmë prapë të dobët. A nuk kuptojnë?
- [69] Çka i mësuam atij (të dërguarit) nuk ishte poezi, e as nuk është ai (poet). Kjo nuk është tjetër pos provë e fortë.* dhe Kuran i thellë.
- [70] Për t’iu predikuar atyre që janë të gjallë, dhe për t’i ekspozuar mosbesimtarët.
- [71] A nuk e kanë parë ata që kemi krijuar për ta, me vetë duart tona, bagëti që ata i kanë?
- [72] Dhe i zbutëm ato për ta; disa i ngasin, dhe disa i hanë.
- [73] Ata nxjerrin edhe dobi tjera prej tyre, si edhe pije. A nuk do të jenë mirënjohës?

Idhuj të pafuqi

- [74] Ata ngritin përkrah Zotit zota tjerë, mbase mund t’iu ndihmojnë atyre!
- [75] Përkundrazi, ata nuk mund t’iu ndihmojnë atyre; ata përfundojnë duke iu shërbyer atyre si ushtarë të përkushtuar.
- [76] Prandaj, mos u pikëllo nga shprehjet e tyre. Ne jemi tërësisht të vetëdijsëm për çdo gjë që ata fshehin dhe çdo gjë që deklarojnë.
- [77] A nuk e sheh qenia njerëzore që e krijuam atë nga një pikël, pastaj ai shndërrohet në armik të flaktë?
- [78] Ai na parashton një pyetje – përderisa e harron krijimin e tij fillestar – “Kush mund t’i ringjallë eshtrat pasi që të jenë kalbur?”
- [79] Thuaj, “Ai që i nisi ato pikë së pari do i ringjallë ato. Ai është tërësisht i vetëdijsëm për çdo

* 36:69 Fjala “Dhikr” i referohet shpesh kodit matematikor të madh të Kuranit, i cili padyshim nuk është letrar, as poetik. Shih 38:1,8; 15:6,9; 16:44; 21:2, 24; 26:5; & 36:11.

krijesë.”

[80] Ai është Ai që krijon për ju, nga lisat e blertë, lëndë djegëse që e digjni për dritë.

[81] A nuk është Ai që krijoi qiejt dhe tokën i zoti që të rikrijojë të njëjtën? Normal që po; Ai është Krijuesi, i Gjithëdijshmi.

[82] Krejt çka i duhet atij për të kryer ndonjë urdhër është t’i thotë, “Ji,” dhe është.

[83] Prandaj, i madhëruar qoftë Ai në dorën e të cilit është sovraniteti mbi të gjitha gjërat, dhe te Ai do të ktheheni.*

Surja 37: Renditësit (Es-Saffat)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Pasha renditësit në kolona.

[2] Fajësuesit e atyre për tu fajësuar.

[3] Recituesit e lajmeve.

[4] Zot i juaji është vetëm një zot.

[5] Zotëruesi i qiejve dhe tokës, dhe çdo gjëje mes tyre, dhe Zotëruesi i lindjeve.*

[6] E kemi zbukuruar qiellin më të ulët me yje të stolisura.*

[7] E ruajtëm atë nga çdo djall i djallëzuar.

[8] Ata nuk mund të përgjojnë në Shoqërinë e Lartë; bombardohen nga çdo anë.

[9] Ata janë mallkuar; kanë vetëshkaktuar ndëshkim të përhershëm.

[10] Nëse ndonjëri prej tyre provon t’iu mësyhet kufijve të jashtëm, ai goditet me predhë të fortë.

[11] Pyeti ata, “A janë ata më vështirë për t’i krijuar, apo krijesat tjera?” I krijuam ata nga balta e lagët.

[12] Përderisa ti mahnitesh, ata tallen.

[13] Kur ua kujton, nuk janë të vëmendshëm.

[14] Kur shohin provë, e përqeshin.

[15] Thonë, “Kjo është qartazi magji!

[16] “Pasi të vdesim dhe bëhemi pluhur e eshtra, a ringjallemi?

[17] “A edhe paraardhësit tonë të lashtë?”

[18] Thuaj, “Po, do të mblidheni me forcë.”

[19] Krejt çka duhet është një shtytje e lehtë, ku ata (ngriten) duke shikuar.

[20] Do të thonë, “Mjerë ne; kjo është Dita e Gjykimit.”

[21] Kjo është dita e vendimit në të cilën dikur nuk besonit.

[22] Mblidhni shkelësit, dhe shoqet e tyre, dhe idhujt që ata adhuruan

[23] përkrah Zotit, dhe udhëzoni te rruga e Ferrit.

[24] Ndalni ata, dhe pyetni:

[25] “Pse nuk i ndihmoni njëri tjetrit?”

[26] Ata do të jenë, atë ditë, duke u nënshtruar plotësisht.

Fajësim i dyanshëm

[27] Do të vijnë te njëri tjetri, duke e hetuar dhe fajësuar njëri tjetrin.

* 36:83 Vlen të përmendet që vlera germore e “Rashad” (505), plus vlera germore e “Khalifa” (725), plus numri i sures (36), plus numri i strofës (83), japin shumën që është shumëfish i 19-tës (505+725+36+83=1349=19x71). Gjithashtu, Surja 36 është numër 19 mes 29 sureve me iniciale.

* 37:5 Çdo trup qiellor lindë në planetin tokë, dhe perëndon. Çdo lindje quhet “lindje.”

* 37:6 Ne jetojmë në gjithësinë më të brendshme dhe më të vogël. Xhinët janë të mbyllur me këtë gjithësi.

- [28] Do iu thonë (udhëheqësve të tyre), “Ju dikur na vinit nga ana e djathtë.”
 [29] Ata do të përgjigjen, “Ishit ju ata që nuk ishit besimtarë.
 [30] “Ne nuk patëm aspak fuqi mbi ju; ishit ju që ishit shpirtligj.
 [31] “Me të drejtë pësuam gjykimin e Zotëruesit tonë; tash duhet të vuajmë.
 [32] “Ju çorientuam juve, vetëm sepse vetë ishim të humbur.”
 [33] Pra, së bashku të gjithë ata do të pësojnë ndëshkimin në atë ditë.
 [34] Kështu i paguajmë fajtorët.

Urdhri i parë

- [35] Kur iu tha atyre, “La Ilahe Ila Allah Nuk ka zot tjetër përkrah Zotit. ,” ata u bënë mendjemëdhenj.
 [36] Ata thanë, “A t’i lëmë zotat tanë për hatër të një poeti të çmendur?”
 [37] Në fakt, ai e ka sjellë të vërtetën, dhe i ka konfirmuar të dërguarit.
 [38] Patjetër, do të shijoni ndëshkimin që dhemb më së shumti.
 [39] Ju paguheni vetëm për çka keni bërë.
 [40] Vetëm shërbëtorët e Zotit që ia kushtojnë veten absolutisht vetëm Atij (do të shpëtohen).
 [41] Ata kanë merituar furnizime që janë të rezervuara posaçërisht për ta.
 [42] Të gjitha llojet e frutave. Ata do të jenë të nderuar.
 [43] Në kopshtet e haresë.
 [44] Në mobilie afër njëra tjetrës.
 [45] Gota me pije të pastra do iu ofrohen atyre.
 [46] Të kthjellëta dhe të shijshme për pirësit.
 [47] Të pandotura, të pashtershme.
 [48] Me ta do të jenë shoqëruese të mahnitshme.
 [49] Të ruajtura si vezë të ndjeshme.

Banuesit e Parajsës vizitojnë banuesit e Ferrit

- [50] Do të vijnë te njëri tjetri, dhe të diskutojnë me njëri tjetrin.
 [51] Njëri prej tyre do të thotë, “Dikur kisha një shok.
 [52] “Ai talleshte: ‘A e beson gjithë këtë?’
 [53] “ ‘Pasi që të vdesim dhe të shndërrohemi në pluhur e eshtra, a thirremi në llogaridhënie?’ “
 [54] Ai do të thotë, “Thjeshtë shikoni!”
 [55] Kur ai shikon, do të shohë shokun e tij në zemër të Ferrit.*
 [56] Ai (do të shkojë te ai dhe) thotë, “Pasha Zotin, gati sa nuk më prishe.
 [57] “Po të mos ishte për bekimet e Zotëruesit tim, do të kisha qenë me ty tani.
 [58] “(A beson ende) që vdesim,
 [59] “vetëm vdekjen e parë, dhe nuk paguhemi?”

Shpengimi: Triumfi më i madh

- [60] I tillë është triumfi më i madh.
 [61] Kjo është për çka çdo punëtor duhet të punojë.
 [62] A është ky fat më i mirë, apo pema e hidhërimit?
 [63] E kemi bërë ndëshkim për shkelësit.

* 37:55 Njerëzit që ia dalin në Parajsë do të kenë mundësi t’i vizitojnë të afërmit dhe shokët e tyre në Ferr, pa pasoja të këqija. Në Përjetësi, kushdo mund të lëvizë teposhtë, por jo përpjetë përtej një kufiri të caktuar. Kufiri caktohet nga shkalla e rritjes dhe zhvillimit të tij (Shtojca 5).

- [64] Është pemë që rritet në zemër të Ferrit.
 [65] Lulet e saj duken si kokat e djajve.
 [66] Ata do të hanë prej saj deri sa t'iu mbushen barqet.
 [67] Pastaj do i mbushin me pije ferri.
 [68] Pastaj do të kthehen në Ferr.

Ata i ndoqën prindërit e tyre verbërisht

- [69] Ata i gjetën prindërit e tyre të humbur.
 [70] Dhe verbërisht shkuan pas hapave të tyre.

Fitorja e garantuar për të dërguarit

- [71] Shumica e gjeneratave paraprake kanë humbur në mënyrën e njëjtë.
 [72] Kemi dërguar te ta paralajmërues.
 [73] Vini re pasojat për ata që kanë qenë të paralajmëruar.
 [74] Vetëm shërbëtorët e Zotit që ia kushtojnë veten absolutisht vetëm Atij (shpëtohen).

Nuhu

- [75] Kështu, Nuhu na thirri, dhe ne ishim më të mirët përgjegjës.
 [76] E shpëtuam atë dhe familjen e tij nga katastrofa e madhe.
 [77] I bëmë shoqëruesit e tij shpëtimtarët.
 [78] Dhe e ruajtëm historinë e tij për gjeneratat pasuese.
 [79] Paqe qoftë mbi Nuhun mes njerëzve.
 [80] Kështu i shpërblejmë të drejtit.
 [81] Ai është një prej shërbëtorëve tanë besimtarë.
 [82] I mbytëm të gjithë të tjerët.

Ibrahimi

- [83] Mes ndjekësve të tij ishte Ibrahimi.
 [84] Ai i erdhi Zotëruesit të tij me gjithë zemër.
 [85] Ai i tha babait të tij dhe njerëzve të tij, "Çka po adhuroni?
 [86] "A doni ju zota të rremë në vend të Zotit?
 [87] "Çka mendoni për Zotëruesin e gjithësisë?"
 [88] Ai i këqyri yjet me kujdes.
 [89] Pastaj u dorëzua dhe tha, "Jam lodhur me këtë!"
 [90] Ata u larguan prej tij.
 [91] Ai pastaj iu kthye idhujve të tyre, duke thënë, "A dëshironi të hani?
 [92] "Pse nuk po flisni?"
 [93] Pastaj i shkatërroi.
 [94] Ata i shkuan atij me tërbim të madh.
 [95] Ai tha, "Si mund të adhuroni çka e gdhendni?
 [96] "Kur Zoti ju ka krijuar juve, dhe çdo gjë që bëni ju!"
 [97] Ata thanë, "Le të ndërtojmë një zjarr të madh, dhe ta hedhim atë në të."
 [98] Ata planifikuan kundër tij, por ata i bëmë humbësit.
 [99] Ai tha, "Unë po shkoj te Zotëruesi im; Ai do të më udhëzojë."
 [100] "Zotëruesi im, më dhuro fëmijë të drejtë."
 [101] I dhamë atij lajm të mirë për një fëmijë të mirë.

*Ëndërr djallëzore**

[102] Kur ai u rrit mjaft për të punuar me të, tha, “Djali im, shoh në ëndërr që po të flijoj ty. Çka po ta merr mendja?” Ai tha, “O babai im, bë çka je i urdhëruar të bësh. Do të më gjesh, dashtë Zoti, të durueshëm.”

[103] Ata të dy u nënshtruan, dhe ai e vuri ballin e tij poshtë (për ta sakrifikuar).

Zoti ddërhynë për ta shpëtuar Ibrahimin dhe Ismailin

[104] E thirrëm: “O Ibrahim.

[105] "I ke besuar ëndrrës." Kështu i shpërblejmë të drejtit.

[106] Ai ishte vërtetë test i përpiktë.

[107] E çliruem (Ismailin) duke zëvendësuar një sakrificë shtazore.

[108] Dhe e ruajtëm historinë e tij për gjeneratat pasuese.

[109] Paqe qoftë mbi Ibrahimin.

[110] Kështu i shpërblejmë të drejtit.

[111] Ai është një prej shërbëtorëve tanë besimtarë.

Lindja e Isakut

[112] Dhe i dhamë atij lajmin e mirë për lindjen e Isakut, që të jetë një prej profetëve të drejtë.

[113] E bekuam atë dhe Isakun. Mes pasardhësve të tyre, disa janë të drejtë, dhe disa janë shkelës shpirtligj.

Moisiu dhe Aroni

[114] Gjithashtu e bekuam Moisiun dhe Aronin.

[115] I çliruem ata dhe njerëzit e tyre nga katastrofa e madhe.

[116] I përkrahëm ata, derisa u bënë fituesit.

[117] I dhamë që të dyve shkrimin e thellë.

[118] I udhëzuam në rrugën e drejtë.

[119] E ruajtëm historinë e tyre për gjeneratat pasuese.

[120] Paqe qoftë mbi Moisiun dhe Aronin.

[121] Kështu i shpërblejmë të drejtit.

[122] Që të dy ishin mes shërbëtorëve tanë të drejtë.

Iljazi

[123] Iljazi ishte një prej të dërguarve.

[124] I tha njerëzve të tij, “A nuk do të punoni drejtësi?

[125] "A adhuroni statujë, në vend të Krijuesit Suprem?

[126] "Zotit; Zotëruesit tuaj, dhe Zotëruesit të stërgjyshërve tuaj!”

[127] Nuk i besuan atij. Si pasojë, ata u desh të thirren në llogaridhënie.

[128] Vetëm shërbëtorët e Zotit që ia kushtojnë veten absolutisht vetëm Atij (shpëtohen).

[129] E ruajtëm historinë e tij për gjeneratat pasuese.

[130] Paqe qoftë mbi Iljazin, dhe të gjithë ata si Iljazi.

[131] Kështu i shpërblejmë të drejtit.

[132] Ai ishte një prej shërbëtorëve tanë besimtarë.

Luti

[133] Luti ishte një prej të dërguarve.

* 37:102 Më i Miri nuk përkrahë të këqija (7:28. Si me Jobin, Dreqi pretendoi që Ibrahimimi e deshi djalin e tij tepër shumë, dhe u lejua që ta vë Ibrahimin në atë test të vështirë.)

- [134] E shpëtuam atë dhe të gjithë familjen e tij.
 [135] Vetëm plaka u dënua.
 [136] I asgjësuam të gjithë të tjerët.
 [137] Ende kaloni pranë rrënojave të tyre ditën.
 [138] Dhe natën. A nuk kuptoni?

Jona

- [139] Jona ishte një prej të dërguarve.
 [140] Ai iku te anija e ngarkuar.
 [141] Ngriti krye dhe kështu, iu bashkua humbësve.
 [142] Si pasojë, peshku e gëlltiti atë, dhe ai ishte për tu fajësuar.
 [143] Po të mos ishte që ai u kthye në meditim (në Zotin),
 [144] ai do të kishte qëndruar në barkun e tij deri në Ditën e Ringjalljes.
 [145] E hodhëm atë në shkretëtirë, krejt i rraskapitur.
 [146] E rritëm një pemë me fruta të ngrënshëm për të.
 [147] Pastaj e dërguam te njëqind mijë,* ose më shumë.
 [148] Ata besuan, dhe i lam ta gëzojnë këtë jetë.
 [149] Pyeti ata nëse Zotëruesi yt ka vajza, përderisa ata kanë djem!
 [150] A i krijuam engjëjt të jenë femra? A ishin dëshmitarë për atë?
 [151] Në të vërtetë, ata blasfemojnë vrazhdë kur thonë -
 [152] "Zoti ka lindur djalë." Në të vërtetë, ata janë gënjeshtarë.
 [153] A zgjodhi Ai vajzat mbi djemtë?
 [154] Çka nuk është në rregull me logjikën tuaj?

Duke iu drejtuar mosbesimtarëve

- [155] Pse nuk merrni vesh?
 [156] A keni ndonjë provë?
 [157] Na tregoni librin tuaj, nëse jeni të sigurtë.
 [158] Ata madje edhe shpikën marrëdhënie të posaçme ndërmjet Atij dhe xhinëve. Xhinët e dinë që janë servil.
 [159] I madhëruar qoftë Zoti; larg nga pretendimet e tyre.
 [160] Vetëm shërbëtorët e Zotit që ia kushtojnë veten vetëm Atij (shpëtohen).
 [161] Në të vërtetë, ju dhe çka adhuronit ju.
 [162] Nuk mund ta detyroni Atë për asgjë.
 [163] Vetëm ju do të digjeni në Ferr.

Engjëjt

- [164] Secili prej nesh ka punë të posaçme.
 [165] Ne jemi renditësit.
 [166] Kemi madhëruar (Zotëruenin tonë) siç duhet.

Ndjekja e prindërve verbërisht

- [167] Ata dikur thoshin,
 [168] "Po t'i kishim pranuar mësimet e duhura nga prindërit tanë,
 [169] "do të kishim qenë adhurues; të përkushtuar ndaj vetëm Zotit."

* 37:147 Kurani përmend 30 numra: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 19, 20, 30, 40, 50, 60, 70, 80, 99, 100, 200, 300, 1000, 2000, 3000, 5000, 50000, dhe 100000. Shuma e këtyre numrave është 162146, ose 19x8534 (shih Sht.1).

- [170] Por ata nuk besuan, dhe patjetër do e marrin vesh.
- [171] Vendimi ynë tashmë është marrë për shërbëtorët tanë të dërguarit.
- [172] Ata janë patjetër fituesit.
- [173] Ushtarët tanë janë ngadhënjyeshit.
- [174] Pra shpërfilli për një kohë të shkurtër.
- [175] I shiko ata; edhe ata do të shikojnë.
- [176] A e sfidojnë ata ndëshkimin tonë?
- [177] Kur i godet ata një ditë, do të jetë ditë e tmerrshme; ata kanë qenë të paralajmëruar mjaftueshëm.
- [178] Shpërfilli ata për një kohë të shkurtër.
- [179] I shiko ata; edhe ata do të shikojnë.
- [180] I madhëruar qoftë Zotëruesi yt, Zotëruesi i madh; larg nga pretendimet e tyre.
- [181] Paqe qoftë mbi të dërguarit.
- [182] Lartmadhëruar qoftë Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.

Surja 38: S. (Sad)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] S. (Sad),* dhe Kurani që përmban provën.*
- [2] Ata që nuk besojnë janë zhytur në mendjemadhësi dhe mohim.
- [3] Mori gjeneratash para tyre i asgjësuar. Ata thirrën për ndihmë, së koti.
- [4] Ata u çuditën që një paralajmërues tu vijë atyre, nga mesi i tyre. Mosbesimtarët thanë, “Magjistat, gënjeshtar.
- [5] “A i shndërroi ai zotat në një zot? Kjo është vërtet e çuditshme.”
- [6] Udhëheqësit shpallën, “Shkoni dhe këmbëngulni me durim në adhurimin e zotave tuaj. Kjo është çka pritet prej jush.
- [7] “Nuk kemi dëgjuar për këtë nga feja e baballarëve tanë. Kjo është rrenë.
- [8] “Pse prova iu zbrit atij, në vend nesh?” Vërtetë, ata kanë dyshime për provën Time. Në të vërtetë, ata nuk e kanë shijuar ndëshkimin Tim ende.
- [9] A i zotërojnë ata thesaret e mëshirës të Zotëruetit tënd, të Plotfuqishmit, Dhuruesit.
- [10] A e posedojnë ata sovranitetin e qiejve dhe tokës, dhe çdo gjëje ndërmjet tyre? Le t’i ndihmojnë vetes.
- [11] Në fakt, çfarëdo forcash që mund t’i grumbullojnë – edhe sikur të gjitha forcat ushtarake të tyre të bashkoheshin së bashku – do të mposhten.
- [12] Duke mos besuar para tyre ishin njerëzit e Nuhut, Adit, dhe Faraonit të fuqishëm.
- [13] Gjithashtu, Themudi, njerëzit e Lutit, banuesit e Pyllit (të Medjenit); ata ishin kundërshtarët.
- [14] Secili prej tyre nuk iu besuan të dërguarve dhe kështu, ndëshkimi Im ishte i pashmangshëm.
- [15] Këta njerëz mund të presin një të rënë të vetme, prej të cilës nuk shërohen kurrë.
- [16] Ata sfidojnë: “Zotëruesi ynë, pse nuk e ngutë ndëshkimin për ne, para Ditës së Llogaridhënies.”
- [17] Ji i durueshëm përballë shprehjeve të tyre, dhe përkuju shërbëtorin tonë Davidin, të shkathëtin; ishte i bindur.

* 38:1 Ky inicial (Sad) ndodhet në suret 7, 19, & 38 krejtësisht 152 herë, 19x8 (Shtojca 1).

* 38:1 Fjala “Dhikr” është e dallueshme në Kuran dhe qartë tregon kah kodin matematikor i mrekullueshëm i Kuranit. Shih 15:6, 9; 16:44; 21:2, 24; 26:5; & 36:11, 69.

[18] I parashtrua malet në shërbimin e tij, duke madhëruar me të natë e ditë.

[19] Gjithashtu zogjtë u parashtruan t'i shërbejnë atij; të gjithë i bindeshin atij.

[20] E forcuam mbretërimin e tij, dhe e pajisëm me mençuri dhe logjikë të mirë.

[21] A ke pranuar lajm për burrat që u grindën dhe u përvodhën në faltoren e tij?

[22] Kur ata hynë në dhomën e tij, ai u tremb. Ata thanë, "Mos kij frikë. Ne po grindemi me njëri tjetrin, dhe po kërkojmë gjykimin tënd të drejtë. Mos na bë të padrejtë, dhe udhëzونا në rrugën e drejtë.

[23] "Ky vëllai im ka nëntëdhjetë e nëntë* dele, ndërsa unë kam një dele. Ai dëshiron ta përziej delen time me të tija, dhe vazhdon të më bëjë trysni."

Përkushtimi shembullor i Davidit

[24] Ai tha, "Ai po bëka padrejtësi ndaj teje duke kërkuar që ta bashkosh delen tënde me të tija. Shumica e njerëzve që i bashkojnë pronat e tyre e trajtojnë njëri tjetrin padrejtësisht, përveç atyre që besojnë dhe punojnë drejtësi, dhe këta janë shumë pak." Më pas, Davidi e pyeti veten nëse e kishte marrë vendimin e duhur. Ai mendoi se po e testonim. Ai pastaj iu lut Zotëruesit të tij për falje, u përkul, dhe u pendua.*

[25] E falëm në këtë çështje. I dhuruam atij pozitë të nderuar me ne, dhe një vendbanim të bukur.

[26] O David, të kemi bërë sundues në tokë. Prandaj, të gjykosësh mes njerëzve me barazi, dhe mos e ndiq mendimin tënd personal, se mos të largon nga rruga e Zotit. Padyshim, ata që largohen nga rruga e Zotit vetëshkaktojnë ndëshkim të rëndë se e harruan Ditën e Llogaridhënies.

[27] Nuk i krijuam qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë ndërmjet tyre, së koti. I tillë është mendimi i atyre që nuk besojnë. Prandaj, mjerë ata që nuk besojnë; do të vuajnë në Ferr.

[28] A t'i trajtojmë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë siç i trajtojmë ata që bëjnë të këqija në tokë? A t'i trajtojmë të drejtë siç i trajtojmë shpirtligjtë?

[29] Ky është shkrim që e zbritëm te ti, që është i shenjtë – ndoshta ata pasqyrojnë në strofat e tij. Ata që posedojnë inteligjencë do të marrin vesh.

Përkushtimi shembullor i Salomonit

[30] Davidit i dhuruam Salomonin; shërbëtor i mirë dhe i bindur.

[31] Një ditë ai u preokupua me kuaj të bukur, deri sa ra nata.

[32] Ai pastaj tha, "U kënaqa me gjërat materiale më shumë se që u kënaqa duke adhuruar Zotëruesin tim, derisa dielli shkoi.*

[33] "Sillni te unë." (Për lamtumirë,) ai fërkoji këmbët dhe qafat e tyre.

[34] Kështu e vumë Salomonin në test; e bekuam me pasuri materiale të mëdha, por ai me durim u nënshtrua.*

[35] Ai tha, "Zotëruesi im, më fal, dhe më dhuro mbretërim që nuk është arritur kurrë nga askush tjetër. Ti je Dhuruesi."

[36] Ne (iu përgjigjëm lutjes së tij) dhe parashtrua erën në dispozicion të tij, duke derdhur shi

* 38:23 Ky është i vetmi vend ku numri 99 ndodhet. Tridhjetë numra të ndryshëm përmenden në Kuran, dhe shuma e tyre është 162146, 19x8534. Shih Shtojcën 1.

* 38:24 Në këtë shembull të qartë, 99 në njërin anë kundër 1 në anën tjetër, kujdesi i skajshëm i Davidit për ta marrë vendimin e duhur e bëri atë që të kërkojë falje. A jemi ne kaq të kujdesshëm?

* 38:32 Salomonit i iku lutja e tij e pasdites për shkak të kuajve të tij. Për ta anuluar pretendimin e mundshëm të Dreqit që Salomoni i deshi kuajt e tij më shumë se që deshi Zotin, ai i hoqi kuajt.

* 38:34 & 41 Salomoni dhe Jobi përfaqësojnë të dy skajet e spektrit të testimit. Ne vihemi në test nëpërmjet pasurisë, shëndetit, apo mungesës së tyre, që të shohim nëse e adhurojmë vetëm Zotin nën të gjitha rrethanat.

kudo që ai dëshironte.

[37] Dhe djajtë, duke ndërtuar dhe u zhytur në ujë.

[38] Të tjerë u vunë në dispozicion të tij.

[39] "Ky është furnizimi ynë te ti; mund të japësh me bujari, ose të mbash, pa kufizime."

[40] Ai ka merituar pozitë të nderuar me ne, dhe vendbanim të mrekullueshëm.

*Djali legendis Jobin**

[41] Përkujtoje shërbëtorin tonë Jobin; ai i thirri Zotëruesit të tij, "Djali më ka leqendisur me vështirësi dhe dhimbje."

[42] "Bjeri tokës me këmbën tënde. Një burim do të të japë ty shërim dhe pije."

Zoti i kompenson besimtarët

[43] E ndreqëm familjen e tij për të; edhe dy herë aq. E tillë është mëshira jonë; kujtesë për ata që posedojnë inteligjencë.

[44] "Tash, të udhëtosh nëpër tokë dhe të predikosh lajmin, për ta përmbushur premtimin." E gjetëm atë të durueshëm. Çfarë shërbëtori i mirë! Ai ishte i nënshtruar.

[45] Përkujtoje gjithashtu shërbëtorin tonë Ibrahimin, Isakun, dhe Jakobin. Ata ishin të shkathët, dhe kishin vizion.

[46] Dhuruam mbi ta bekim të madh: vetëdije për Përjetësinë.

[47] Ata u zgjodhën, se ishin prej më të drejtëve.

[48] Përkujtoje, Ismailin, Eliseun, dhe Dhul-Kiflin; prej më të drejtëve.

Të drejtit

[49] Ky është kujtim: të drejtit kanë merituar fat të mrekullueshëm.

[50] Kopshtet e Edenit do i hapin portat e tyre për ta.

[51] Duke u çliruar aty, atyre do iu jepen shumë lloje frutash dhe pijesh.

[52] Do të kenë të shoqe të mahnitshme.

[53] Kjo është çka keni merituar në Ditën e Llogaridhënies.

[54] Furnizimet tona janë të pashtershme.

Mosbesimtarët: Grinden me njëri tjetrin

[55] Sa për shkelësit, ata kanë vetëshkaktuar fat të tmerrshëm.

[56] Ferri është ku ata digjen; çfarë vendbanimi i tmerrshëm!

[57] Çka ata shijojnë në të do të jenë pije ferri dhe ushqim i hidhur.

[58] Dhe më shumë prej llojit të njëjtë.

[59] "Ky është një grup për tu hedhur në Ferr me ju." Ata nuk do të mirëpriten (nga banorët e Ferrit). Kanë merituar të digjen në zjarr.

[60] Të porsaardhurit do të përgjigjen, "As ju nuk jeni të mirëpritur. Ju jeni ata që na parapritë dhe na çorientuat. Prandaj, vuanie këtë mbarim të tmerrshëm."

[61] Ata gjithashtu do të thonë, "Zotëruesi ynë, këta janë ata që na çuan në këtë; dyfishoje ndëshkimin e zjarrit për ta."

[62] Ata do të thonë, "Si është e mundur që nuk i shohim (në Ferr) njerëzit që dikur i numëronim si shpirtligj?"

[63] "Dikur i përqeshnim; i largonim sytë tonë prej tyre."

[64] Ky është fakt i paracaktuar: njerëzit e Ferrit do të grinden me njëri tjetrin.

* 38:34 & 41 Salomoni dhe Jobi përfaqësojnë të dy skajet e spektrit të testimit. Ne vihemi në test nëpërmjet pasurisë, shëndetit, ose mungesës së tyre, që të shohim nëse e adhurojmë vetëm Zotin nën të gjitha rrethanat.

[65] Thuaj, "Ju paralajmëro; nuk ka zot tjetër përkrah Zotit, të Vetmit, Supremit.

[66] "Zotëruesit të qiejve dhe tokës, dhe çdo gjë ndërmjet tyre; të Plotfuqishmit, Falësit."

Grindja e madhe

[67] Thuaj, "Ja lajm mbresëlënës.

[68] "Të cilin e keni harruar krejtësisht.

[69] "Unë nuk pata njohuri më parë, për grindjen në Shoqërinë e Lartë.*

[70] "Jam i frymëzuar që misioni im i vetëm është për t'i dorëzuar paralajmërimet te ju."

[71] Zotëruesi yt iu tha engjëjve, "Po e krijoj një qenie njerëzore nga balta.

[72] "Kur ta konstruktoj, dhe të fry në të nga fryma lme, të bini në përulje para tij."

[73] Engjëjt ranë në përulje, të gjithë ata,

[74] përveç Dreqit, ai refuzoi, dhe ishte tepër mendjemadh, mosmirënjohës.

[75] Ai tha, "O Dreq, çka të parandaloi nga përulja para çka Unë krijova me duart e Mia? A je tepër mendjemadh? A ke ngritur krye?"

[76] Ai tha, "Unë jam më i mirë se ai; Mua më krijove prej zjarri, e atë e krijove prej balte."

[77] Ai tha, "Prandaj, duhet të mërgohesh, do të jesh i dëbuar.

[78] "Ke vetëshkaktuar mallkimin Tim deri në Ditën e Gjykimit."

[79] Ai tha, "Zotëruesi im, më jep afat deri në Ditën e Ringjalljes."

[80] Ai tha, "Të është dhënë afat.

[81] "Deri në ditën e caktuar."

[82] Ai tha, "Betohem në madhësinë Tënde, që do i dërgoj të gjithë ata në humbje.

[83] "Përveç adhuruesve Tu që të janë përkushtuar absolutisht vetëm Ty."

[84] Ai tha, "Kjo është e vërteta, dhe e vërteta është krejt çka Unë shpreh.

[85] "Unë do të mbush Ferrin me ty dhe të gjithë ata që të ndjekin ty."

[86] Thuaj, "Unë nuk ju kërkoj pagë, dhe nuk jam mashtrues.

[87] "Kjo është kujtesë për botën.

[88] "Dhe patjetër do e merrni vesh pas pak."

Surja 39: Turmat (Ez-Zumer)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Ky është shpallje shkrimi, nga Zoti, i Plotfuqishmi, i Mençuri.

[2] E zbritëm te ti këtë shkrim, sinqerisht; ta adhurosh Zotin, duke ia kushtuar fenë tënde vetëm Atij.

Idhujt si ndërmjetësues - Mit i zakonshëm

[3] Absolutisht, feja t'i kushtohet vetëm Zotit. Ata që ngritin idhuj përkrah Tij thonë, "I idolizojmë ata vetëm për të na sjellë më afër Zotit; se ata janë në pozitë më të mirë!" Zoti do i gjykojë ata në lidhje me polemikat e tyre. Zoti nuk udhëzon gënjeshtarë të tillë, mosbesimtarë.

[4] Po të donte Zoti të ketë djalë, Ai ka mundur të zgjidhte këdo Ai të dëshironte nga mes krijesave të Tij. I madhëruar qoftë Ai; Ai është Zoti, i Vetmi, Supremi.

Forma e tokës

* 38:69 Grindja në Shoqërinë e Lartë u shkreh nga sfida e Dreqit ndaj autoritetit absolut të Zotit. Kjo është padyshim ngjarja më e rëndësishme në histori të racës njerëzore. Ne nuk arritëm që të jemi të vendosur sa i përket autoritetit absolut të Zotit. Kjo jetë përfaqëson shansin e tretë dhe të fundit që ta shpengojmë veten (Shih Hyrjen dhe Shtojcën 7).

[5] Ai krijoi qiejt dhe tokën me të vërtetë. Ai e rrotullon natën sipër ditës, dhe rrotullon ditën sipër natës.* Ai parashtrroi diellin dhe hënën, secili duke udhëtuar për një periudhë të kufizuar. Absolutisht, Ai është i Plotfuqishmi, Falësi.

[6] Ai ju krijoi nga një vetë, pastaj krijoi prej tij shoqen e tij. Ai zbriti te ju tetë lloje bagëtish. Ai ju krijon në barqet e nënave tuaja, krijim pas krijimi, në tri errësira. I tillë është Zoti Zotëruesi juaj. Atij i përket i gjithë sovraniteti. Nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij. Si mund të devijoni?

Beso për të mirën tënde

[7] Nëse nuk besoni, Zotit nuk i nevojitet askush. Por Atij nuk i pëlqen t'i shohë shërbëtorët e Tij duke marrë vendimin e gabuar. Nëse vendosni të jeni mirënjohës, Ai është i kënaqur me ju. Asnjë shpirt nuk i bartë mëkatet e asnjë shpirti tjetër. Përfundimisht, te Zotëruesi juaj është kthimi juaj, pastaj Ai do t'ju njoftojë për çdo gjë që kishit bërë. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[8] Kur qenia njerëzore leqendiset, ai i lutet Zotëruesit të tij, sinqerisht i përkushtuar ndaj Tij. Por sapo Ai ta bekojë atë, ai e harron lutjen paraprake të tij, ngritë idhuj për të rivalizuar Zotin dhe largon të tjerët nga rruga e Tij. Thuaj, "Kënaquni me mosbesimin tuaj përkohësisht; keni vetëshkaktuar zjarrin."

[9] A nuk është më mirë të jesh një prej atyre që meditojnë natën, duke u përlurur dhe duke qëndruar zgjuar, duke qenë të vetëdijshëm për Përjetësinë, dhe duke kërkuar mëshirën e Zotëruesit të tyre?" Vetëm ata që posedojnë inteligjencë do të jenë të vëmendshëm.

[10] Thuaj, "O shërbëtorët e Mi që besuat, t'ia keni dronë Zotëruesit tuaj." Për ata që punuan drejtësi në këtë botë, shpërblim të mirë. Toka e Zotit është e gjerë, dhe ata që durojnë me këmbëngulje do e pranojnë shpërblimin e tyre bujarisht, pa kufizime.

VETËM Zotin

[11] Thuaj, "Unë jam urdhëruar ta adhuroj Zotin, duke ia kushtuar fenë absolutisht vetëm Atij.

[12] "Dhe u urdhërova të jem më i nënshtruar."

[13] Thuaj, "I frikësohem, nëse nuk iu binda Zotëruesit tim, ndëshkimit të një dite të madhe."

[14] Thuaj, "Zoti është i Vetmi që adhuroj, duke ia kushtuar fenë time absolutisht vetëm Atij.

[15] "Prandaj, adhuroni çfarëdo që dëshironi përkrah Tij." Thuaj, "Humbësit e vërtetë janë ata që i humbin shpirtrat e vet, dhe familjet e veta, në Ditën e Ringjalljes." Padyshim, kjo është humbja e vërtetë.

[16] Ata do të kenë masa zjarri mbi ta, dhe nën ta. Zoti kështu i alarmon shërbëtorët e Tij: O shërbëtorët e Mi, të më keni dronë Mua.

[17] Sa për ata që flakin adhurimin e të gjithë idhujve, dhe ia kushtojnë veten plotësisht vetëm Zotit, ata kanë merituar lumturi. Jepu lajm të mirë shërbëtorëve të Mi.

Ndiq fjalën e Zotit

[18] Ata janë ata që shqyrtojnë të gjitha fjalët, pastaj e ndjekin më të mirën. Këta janë ata që Zoti i ka udhëzuar; këta janë ata që posedojnë inteligjencë.

[19] Sa i përket atyre që kanë merituar ndëshkim, a mund t'i shpëtosh ata që tashmë janë në Ferr?

[20] Sa për ata që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre, ata do të kenë pallate mbi pallate të ndërtuar

* 39:5 Kjo strofë qartë na njofton që toka është e rrumbullakët. Fjala arabe "Ai rrotullon" (Jukauir) buron nga fjala arabe "rruzull" (Kurah). Pasi që Toka nuk është saktësisht e rrumbullakët, përmendje e posaçme ndaj formës së saj jepet në 79:30. Kurani është përplot informata shkencore që u bënë të njohura për ne me shekuj pas shpalljes së Kuranit. Shih Shtojcën 20.

për ta, me prroje që rrjedhin. Ky është premtimi i Zotit, dhe Zoti nuk e shkelë premtimin e Tij.

[21] A nuk e sheh që Zoti zbret nga qielli ujë, pastaj e vë atë në puset e nëntokës, pastaj prodhon me të bimë ngjyrash të ndryshme, pastaj ato rriten derisa të bëhen të verdha, pastaj Ai i shndërron ato në kashtë? Kjo duhet të jetë kujtesë për ata që posedojnë inteligjencë.

[22] Nëse Zoti e bën zemrën e dikujt të kënaqur me Nënshtrim, ai do të jetë duke ndjekur dritë nga Zotëruesi i tij. Prandaj, mjerë ata zemrat e të cilëve ngurtësohen kundër lajmit të Zotit; ata kanë shkuar larg në humbje.

Hadithi më i mirë

[23] Zoti ka shpallur këtu Hadithin më të mirë; libër që përputhet logjikisht, dhe tregon të dyja rrugët (Parajsën dhe Ferrin). Lëkurat e atyre që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre rrëqethen prej tij, pastaj lëkurat e tyre dhe zemrat e tyre zbuten për lajmin e Zotit. I tillë është udhëzimi i Zotit; Ai e dhuron atë mbi këdo që do (të jetë i udhëzuar). Sa për ata të dërguarit në humbje nga Zoti, asgjë nuk mund t'i udhëzojë ata.

[24] Çka është më mirë sesa dikush ta ruajë fytyrën e vet nga ndëshkimi i tmerrshëm në Ditën e Ringjalljes? Shkelësve do iu thuhet, "Vuani pasojat e asaj që mblodhët."

[25] Të tjerë para tyre nuk kanë besuar dhe, si pasojë, ndëshkimi i leqendisi prej nga nuk e pritën.

[26] Zoti i ka mallkuar ata në poshtërim në këtë jetë, dhe ndëshkimi në Përjetësi do të jetë shumë më i keq, veç sikur ta dinin.

Kurani: Pa paqartësi

[27] Kemi përmendur për njerëzit çdo lloj shembulli në këtë Kuran, që të mund të marrin vesh.

[28] Kuran arabisht, pa asnjë paqartësi, që të mund të jenë të drejtë.

[29] Zoti përmendë shembullin e një njeriu që merret me ortakë polemizues (Hadithet), në krahasim me një njeri që merret me vetëm një burim që përputhet logjikisht (Kuranin). A janë ata të njëjtë? I lartmadhëruar qoftë Zoti; shumica e tyre nuk dinë.

Hadithet: Blasfemi të tepërta

[30] Ti (Muhamed) patjetër do të vdesësh, dhe do të vdesin edhe ata.

[31] Në Ditën e Ringjalljes, para Zotëruesit tuaj, ju njerëz do të grindeni me njëri tjetrin.

[32] Kush është më i keq se dikush që i mvëshë rrena Zotit, përderisa nuk beson në të vërtetën që ka ardhur te ai? A nuk është Ferri pagesë e drejtë për mosbesimtarët?

Kurani: E vërtetë absolute

[33] Sa për ata që përkrasin të vërtetën, dhe besojnë në të, ata janë të drejtit.

[34] Ata do të kenë çfarëdo që dëshirojnë, te Zotëruesi i tyre. I tillë është shpërblimi për të drejtit.

[35] Zoti i lanë punët e tyre mëkatuese, dhe i shpërblen ata bujarisht për punët e tyre të mira.

Pyetje e thellë

[36] A nuk është Zoti i mjaftueshëm për shërbëtorin e Tij? Ata të frikësojnë ty me idhujt që ata i ngritin përkrah Tij. Këdo që Zoti dërgon në humbje, asgjë nuk mund ta udhëzojë atë.

[37] Dhe këdo Zoti udhëzon, asgjë nuk mund ta dërgojë në humbje. A nuk është Zoti i Plotfuqishëm, Shpagues?

Ata besojnë në Zot por po shkojnë në Ferr

[38] Nëse i pyet ata, "Kush krijoi qiejt dhe tokën?" ata do të thonë, "Zoti." Thuaj, "Pse atëherë ngritni idhuj përkrah Zotit? Po të donte Zoti ndonjë fatkeqësi për mua, a mund ta zvogëlojnë ata një fatkeqësi të tillë? Dhe po të donte Ai një bekim për mua, a mund ta parandalojnë ata një bekim të tillë?" Thuaj, "Zoti mjafton për mua." Në të besimtarët të kenë besim.

[39] Thuaj, "O njerëzit e mi, veproni si të mundeni edhe unë do të veproj si të mundem; padyshim do e merrni vesh.

[40] "(Do e merrni vesh) kush ka vetëshkaktuar dënim të turpshëm, dhe ka merituar ndëshkim të përhershëm."

[41] E kemi shpallur shkrimin nëpërmjet teje për njerëzit, me të vërtetë. Pastaj, kushdo që udhëzohet është i udhëzuar për të mirën e vet, dhe kushdo që shkon në humbje shkon në humbje në dëm të vet. Ti nuk je avokati i tyre.

[42] Zoti i vë shpirtat në vdekje kur fundi i jetës së tyre vjen, dhe gjithashtu gjatë gjumit. Kështu, Ai i merr prapa disa gjatë gjumit, përderisa të tjerët lejohen të vazhdojnë deri në fund të afatit të tyre të paracaktuar. Kjo duhet të japë mësim për njerëzit që pasqyrojnë.

Miti i ndërmjetësimit

[43] A kanë shpikur ata ndërmjetësues për të ndërmjetësuar ndërmjet atyre dhe Zotit? Thuaj, "Çka nëse ata nuk janë aspak të fuqishëm, as nuk kuptojnë?"

[44] Thuaj, "I gjithë ndërmjetësimi i përket Zotit." Atij i përket i gjithë sovraniteti i qiejve dhe tokës, pastaj te Ai do të ktheheni.

Kriteri më i madh

[45] Kur VETËM Zoti përmendet, zemrat e atyre që nuk besojnë në Përjetësi tkurren me neveri. Por kur të tjerët përmenden përkrah Tij, ata janë të kënaqur.*

[46] Deklaro: "Zoti ynë, Nismëtari i qiejve dhe tokës, Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve, Ti je i Vetmi që gjykon mes shërbëtorëve Tu sa i përket grindjeve të tyre."

[47] Sikur ata që shkelën të kishin pasur çdo gjë në tokë, madje edhe dy herë aq, me gatishmëri do të hiqnin dorë prej saj për t'iu shmangur ndëshkimit të tmerrshëm në Ditën e Ringjalljes. Atyre do iu tregohet nga Zoti çka nuk e pritën.

[48] Punët e këqija që i kishin mbledhur do iu tregohen, dhe pikërisht ato gjëra që dikur i tallën do iu kthehen t'i kaplojnë.

Paqëndrueshmëria njerëzore

[49] Nëse njeriu preket me fatkeqësi, ai na lutet, por sapo të dhurojmë bekim mbi të, ai thotë, "E arrita këtë për shkak të zgjuarsisë sime!" Në të vërtetë, ky është vetëm një test, por shumica e tyre nuk dinë.

[50] Ata para tyre kanë shprehur të njëjtën gjë, dhe gjërat materiale që i mblodhën nuk iu ndihmuan atyre aspak.

[51] Ata i vuajtën pasojat e punëve të tyre të këqija. Ngjashëm, shkelësit mes gjeneratave të tanishme do të vuajnë pasojat e punëve të tyre të këqija; nuk mund të shpëtojnë.

[52] A nuk e kuptojnë që Zoti është Ai që rritë furnizimet për këdo ai zgjedhë, dhe mbanë? Këto janë mësim për njerëzit që besojnë.

Mëshira e pakufi e Zotit

[53] Deklaro: "O shërbëtorët e Mi që i tejkaluat kufijtë, mos humbni shpresat nga mëshira e Zotit. Se Zoti i falë të gjitha mëkatet. Ai është Falësi, i Mëshirshmi."

[54] T'i bindeni Zotëruesit tuaj, dhe t'i nënshtroheni Atij plotësisht, para se t'ju kaplojë ndëshkimi;

* 39:45 Përkundër urdhrin të qartë në 3:18 që Shtylla e Parë e Islamit është deklarimi: "Esh-hedu En La Ilahe Illa Allah (nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Zotit)," shumica e "Myslimanëve" këmbëngulin të shtojnë emrin e Muhamedit. Ky Më i Madhi Kriter na paralajmëron që nëse kënaqemi me shtimin e emrit të Muhamedit, ose cilitdo emri tjetër, kjo nxjerr në shesh mosbesimin në Përjetësinë. Shih gjithashtu Shtojcën 17:46.

atëherë nuk mund të ndihmoheni.

[55] Dhe ndiqni rrugën më të mirë që ju është treguar juve nga Zotëruesi juaj, para se t'ju kaplojë ndëshkimi papritmas kur më së paku e pritni.

[56] Se mos thotë ndonjë shpirt, "Sa pishman jam që shpërfilla urdhrat e Zotit; Isha padyshim një prej tallësve."

[57] Ose thotë, "Sikur të më udhëzonte Zoti, do të kisha qenë me të drejtit."

[58] Ose thotë, kur e sheh ndëshkimin, "Nëse më jepet një rast tjetër, do të punoj drejtësi."

[59] Por jo! (të janë dhënë mjaft raste). Provat e mia të erdhën, por i refuzove, u bëre mendjemadh, dhe u bëre mosbesimtar.

[60] Në Ditën e Ringjalljes do i shohësh fytyrat e atyre që gënjen kundër Zotit të mbuluara me trishtim. A nuk është Ferri ndëshkimi i drejtë për mendjemëdhenjtë?

[61] Dhe Zoti do i shpëtojë ata që u mbajtën me drejtësi; Ai do i shpërblejë ata. Asnjë dëm nuk do i prekë ata, as nuk do të kenë asnjë brengë.

[62] Zoti është Krijuesi i të gjitha gjërave, dhe Ai po i drejton të gjitha gjërat.

[63] Atij i përkasin të gjitha vendimet në qiej dhe tokë, dhe ata që nuk besojnë në shpalljet e Zotit janë humbësit e vërtetë.

[64] Thuaj, "A më shtyni të adhuroj tjetër pos Zotit, o ju të padijshëm?"

Adhurimi i idhujve asgjëson krejt punën

[65] Të është shpallur ty, dhe atyre para teje që nëse kryen adhurim idhujsh, të gjitha punët tua do të asgjësohen, dhe do të jesh me humbësit.

[66] Prandaj, ta adhurosh vetëm Zotin, dhe të jesh mirënjohës.

Madhështia e Zotit

[67] Ata nuk mund ta marrin me mend madhësinë e Zotit. E gjithë toka është brenda grushtit të Tij në Ditën e Ringjalljes. Në fakt, gjithësitë janë të mbështjella brenda dorës së Tij të djathtë.* Qoftë i madhëruar; Ai është larg nga nevoja për ndonjë ortak.

Dita e Gjykimit

[68] Bririt do i bihet, ku çdokujt në qiej dhe tokë do i bie të fiktë, përveç atyre që do të kursehen nga Zoti. Pastaj do i bihet edhe një herë, ku ata të gjithë do të ngriten, duke shikuar.*

[69] Pastaj toka do të shkëlqejë me dritën e Zotëruesit të saj. Regjistri do të shpallet, dhe profetët dhe dëshmitarët do të sillen para. Secili do të gjykohet me barazi, pa as më të voglën padrejtësi.

[70] Çdo shpirt do të paguhet për çfarëdo që ka bërë, se Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çfarëdo që ata kanë bërë.

Mosbesimtarët

[71] Ata që nuk besuan do të çohen në Ferr në turma. Kur arrijnë te ai, dhe portat e tij hapen, rojat e tij do të thonë, "A nuk pranuat të dërguarë nga mes jush, që ju recituan juve shpalljet e Zotëruesit tuaj, dhe ju paralajmëruan për takimin e kësaj dite?" Do të përgjigjen, "Po vërtetë. Por fjala 'ndëshkim' ishte tashmë e vulosur mbi mosbesimtarët."

* 39:67 Gjithësia jonë, me biliona galaktikat e saj, një bilion trilion yje, deciliona të panumërueshëm të trupave qiellorë, duke u shtrirë në biliona vjet drite, është më e vogla dhe më e brendshme e shtatë gjithësive. Kjo gjerësi e pakapshme e shtatë gjithësive është brenda dorës së Zotit. E tillë është madhështia e Zotit. Shih Shtojcën 6.

* 39:68 Rendi i ngjarjeve në Ditën e Ringjalljes fillon me rënien simbolike të bririt. Rënia e dytë e bririt – nga një krijesë që ishte kursyer nga pavetëdija – shënon ringjalljen e të gjithë njerëzve; ata do të ringjallen në tokën e sotshme. Kjo tokë pastaj do të shkatërrohet nga ardhja fizike e Zotit, pastaj një tokë e re dhe qiej të ri do të krijohen (14:48). Ne pastaj do të shtresohemi varësisht sipas shkallës tonë të zhvillimit (Shtojca 11).

[72] Do të thuhet, “Hyni në portat e Ferrit, ku qëndroni përgjithmonë.” Çfarë përfundimi i tmerrshëm për mendjemëdhenjtë.

Besimtarët

[73] Ata që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre do të çohen në Parajsë në turma. Kur ata arrijnë te ajo, dhe portat e saj hapen, rojat e saj do të thonë, “Paqe qoftë mbi ju; keni fituar. Prandaj, qëndroni këtu përjetësisht.”

[74] Do të thonë, “Lartmadhëruar qoftë Zoti, që përmbushi premtimin e Tij ndaj nesh, dhe na bëri ta trashëgojmë tokën, duke e gëzuar Parajsën si të duam.” Çfarë shpërblimi i bukur për punëtorët!

[75] Do i shihni engjëjt duke lundruar rreth fronit, duke e madhëruar dhe lartmadhëruar Zotëruesin e tyre. Pasi që gjykimi me barazi iu lëshohet të gjithëve, do të deklarohet: “Lartmadhëruar qoftë Zoti, Zotërues i gjithësisë.”

Surja 40: Falësi (Gafir)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.*

[2] Kjo shpallje e këtij shkrimi është nga Zoti, i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi.

[3] Falës i mëkateve, pranues i pendimit, i rreptë në zbatimin e ndëshkimit, dhe posedues i gjithë fuqisë. Nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij. Te Ai është fati përfundimtar.

[4] Askush nuk shtyhet kundër shpalljeve të Zotit përveç atyre që nuk besojnë. Mos u magjeps nga çka duket si sukses i tyre.

[5] Duke mos besuar para tyre ishin njerëzit e Nuhut, dhe shumë kundërshtarë të tjerë pas tyre. Secila shoqëri e keqtrajtoi të dërguarin e tyre që ta asnjansojë. Dhe ata u grindën me të me të pavërteta, për ta mposhtur të vërtetën. Si pasojë, Unë i ndëshkova ata; sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im!

[6] Pra, gjykimi i Zotëruesit tënd tashmë është i vulosur mbi ata që nuk besojnë, që ata janë banuesit e Ferrit.

Engjëjt luten për besimtarët

[7] Ata që i shërbejnë fronit dhe të gjithë ata rreth tij e madhërojnë dhe lartmadhërojnë Zotëruesin e tyre, dhe besojnë në Të. Dhe ata kërkojnë falje për ata që besojnë: “Zotëruesi ynë, mëshira Jote dhe njohuria Jote përfshijnë të gjitha gjërat. Fali ata që pendohen dhe ndjekin rrugën Tënde, dhe i kurse nga ndëshkimi i Ferrit.

[8] "Zotëruesi ynë, dhe pranoi ata në kopshtet e Edenit që i premtove për ta dhe për të drejtin mes prindërve, të shoqeve, dhe fëmijëve të tyre. Ti je i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[9] "Dhe mbroj ata që të mos bien në mëkat. Këdo që Ti e mbron nga të rënit në mëkat, në atë ditë, ka arritur mëshirë prej Teje. Ky është triumfi më i madh."

VETËM Zoti: Mosbesimtarët e pranojnë

[10] Atyre që nuk besojnë do iu thuhet, “Neveria e Zotit ndaj jush është edhe më e madhe se neveria e juaj ndaj vetes. Se ju u ftuat të besoni, por zgjodhët të mos besoni.”

VETËM Zoti: Mosbesimtarët vuajnë dy vdekje

[11] Ata do të thonë, “Zotëruesi ynë, na keni vënë në vdekje dy herë,* dhe na ke dhënë dy jetë;

* 40:1 Inicialet “Ha Mim” ndodhen në Suret 40-46. Ndodhja totale e këtyre shkronjave “Ha” dhe “Mim” në shtatë suret është 2147, ose 19x113 (Shtojca 1).

* 40:11-12 Mosbesimtarët kalojnë nëpër dy vdekje, përderisa besimtarët e drejtë nuk e shijojnë vdekjen, përtej vdekjes

tash i kemi pranuar mëkatet tona. A ka ndonjë mënyrë për të shpëtuar?”

VETËM Zoti: Vini re arsyen

[12] Kjo është për shkak se kur bëhej thirrje për VETËM Zotin, nuk besuat, por kur të tjerët përmendeshin përkrah Tij, besuat. Prandaj, gjykimi i Zotit është lëshuar; Ai është Më i Larti, i Madhi.

[13] Ai është Ai që vazhdimisht jua tregon provat e Tij, dhe zbret poshtë te ju nga qielli furnizime. Vetëm ata që nënshtrohen plotësisht do të mund të jenë të vëmendshëm.

[14] Prandaj, t'ia kushtoni adhurimin tuaj absolutisht VETËM Zotit, edhe nëse nuk iu pëlqen mosbesimtarëve.

[15] Poseduesit të rangjeve më të larta, dhe Sundimtarit të gjithë pushtetit. Ai dërgon frymëzim, duke bartur urdhrat e Tij, te kushdo që Ai zgjedhë nga mes shërbëtorëve të Tij, për të paralajmëruar për Ditën e Mbledhjes.

[16] Ajo është dita kur secili do të jetë plotësisht i ekspozuar; asnjëri prej tyre nuk do të fshehë asgjë prej Zotit. Kujt i takon i gjithë sovraniteti atë ditë? Zotit, të Vetmit, Supremit.

Përgatitu për ditën e madhe

[17] Atë ditë, secili shpirt do të paguhet për çfarëdo që kishte mbledhur. Nuk do të ketë aspak padrejtësi në atë ditë. Zoti është më i shkathëti në llogaritje.

Pa ndërmjetësim

[18] Paralajmëroi ata për ditën e afërt, kur zemrat do të tmerrohen, dhe shumë do i brejë ndërgjegjja. Shkelësit nuk do të kenë asnjë shok as ndonjë ndërmjetësues për t'iu bindur.

[19] Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çka sytë nuk mund të shohin, dhe çdo gjë që mendjet fshehin.

[20] Zoti gjykon me barazi, përderisa idhujt të cilëve ata iu luten përkrah Tij nuk mund të gjykojnë asgjë. Zoti është Ai që është Dëgjuesi, Pamësi.

[21] A nuk u endën ata nëpër tokë dhe vërejtën pasojat për ata para tyre? Ata dikur ishin më të fuqishëm se ta, dhe më produktiv në tokë. Por Zoti i ndëshkoi ata për mëkatet e tyre, dhe asgjë nuk do të kishte mundur t'i mbronte nga Zoti.

[22] Kjo është për shkak se të dërguarit e tyre iu shkuan atyre me prova të qarta, por ata nuk besuan. Si pasojë, Zoti i ndëshkoi ata. Ai është i Fuqishëm, i rreptë në zbatimin e ndëshkimit.

Moisiu

[23] E dërguam Moisiun me shenjat tona dhe autoritet të qartë.

[24] Te Faraoni, Hamani, dhe Karuni. Por ata thanë, “Magjistat; gënjeshtar.”

[25] Dhe kur ai ua tregoi atyre të vërtetën prej nesh, thanë, “Vrisni djemtë e atyre që besuan me të, dhe ua kurseni vajzat e tyre.” Kështu, planifikimi i mosbesimtarëve është gjithmonë i ligë.

Moisiu kundër Faraonit

[26] Faraoni tha, “Le ta vras Moisiun, e le t'i lutet ai Zotëruesit të tij. Brengosem se mos ua korrupton fenë tuaj, ose përhapë të këqija nëpër tokë.”

[27] Moisiu tha, “Kërkoj strehim në Zotëruesin tim dhe Zotëruesin tuaj, nga secili mendjemadh që nuk beson në Ditën e Llogaridhënies.”

Zoti nuk udhëzon gënjeshtarë

[28] Një njeri besimtar mes njerëzve të Faraonit, i cili e fshehu besimin e tij, tha, “Si mund ta

që tashmë e kemi përjetuar (44:56). Shih Shtojcën 17. Arsyeya e shkuarjes në Ferr është e qartë; edhe ata që besojnë në Zotin ia shoqërojnë të tjerët Atij. (shih 39:45).

mbytni një njeri vetëm sepse tha, 'Zotëruesi im është Zoti,' dhe ai ju ka treguar prova të qarta nga Zotëruesi juaj? Nëse ai është gënjeshtar, ai është problemi i tij, dhe nëse ai është i sinqertë, ju përfitoni prej premtimeve të tij. Padyshim, Zoti nuk udhëzon shkelës, gënjeshtar.

[29] "O njerëzit e mi, sot ju keni mbretërim dhe epërsi. Por kush do të na ndihmojë neve kundër gjykimit të Zotit, po të vij te ne?" Faraoni tha, "Ju keni për të ndjekur vetëm çka ju them unë; unë do t'ju udhëzoj vetëm në rrugën e drejtë."

[30] Ai që besoi tha, "O njerëzit e mi, kam frikë se do t'ju përcjellë fati i njëjtë si i kundërshtarëve paraprak.

[31] "Kundërshtarëve të Nuhut, dhe Adit, Themudit, dhe të tjerëve që erdhën pas tyre. Zoti nuk dëshiron ndonjë padrejtësi për njerëzit.

[32] "O njerëzit e mi, kam frikë për ju Ditën e Mbledhjes.

[33] "Ajo është dita kur mund të dëshironi të ktheheni dhe të ikni. Por asgjë nuk do t'ju mbrojë atëherë nga Zoti. Këdo që Zoti e dërgon në humbje, asgjë nuk mund ta udhëzojë atë."

*Kush është i dërguari i fundit?**

Veti tragjike e njerëzve

[34] Jozefi kishte ardhur te ju më parë me shpallje të qarta, por vazhduat të dyshoni në lajmin e tij. Pastaj, kur ai vdiq thatë, "Zoti nuk do të dërgojë asnjë të dërguar tjetër pas tij. (Ai ishte i dërguari i fundit!)"* Zoti kështu pra i dërgon në humbje ata që janë shkelës, dyshues.

[35] Ata polemizojnë kundër shpalljeve të Zotit, pa asnjë bazë. Kjo është veti që urrehet më së shumti nga Zoti dhe nga ata që besojnë. Zoti pra e mbyllë zemrën e secilit tiran mendjemadh.

[36] Faraoni tha, "O Haman, ndërto për mua një kullë të lartë, që të mund të zgjatem dhe zbuloj.

[37] "Dua ta arrij qiellin, dhe ta shoh zotin e Moisiut. Unë besoj që ai është gënjeshtar." Kështu u zbukuruan punët e këqija të Faraonit në sytë e tij, dhe kështu u mbajt ai larg nga ndjekja e rrugës (së drejtë). Planifikimi i Faraonit ishte vërtetë i keq.

[38] Ai që besoi tha, "O njerëzit e mi, më ndiqni, dhe do t'ju udhëzoj në rrugën e drejtë.

[39] "O njerëzit e mi, kjo jeta e parë është iluzion i përkohshëm, përderisa Përjetësia është vendbanimi i përhershëm."

Tregtia më e mirë

[40] Kushdo që bën mëkat paguhet për vetëm atë, dhe kushdo që punon drejtësi – mashkull apo femër – përderisa beson, këta do të hyjnë në Parajsë ku pranojnë furnizime pakufi.

Egjiptasi besimtar diskuton me njerëzit e tij

[41] "O njerëzit e mi, përderisa unë ju ftoj të shpëtoheni, ju më ftoni në zjarr.

[42] "Ju më ftoni t'i jem mosmirënjohës Zotit, dhe të ngreh përkrah Tij idhuj që unë nuk i njoh. Unë po ju ftoj te i Plotfuqishmi, Falësi.

[43] "Nuk ka dyshim se çka ju më ftoni të bëj nuk ka baza në këtë botë, as në Përjetësi, se kthimi ynë përfundimtar është te Zoti, dhe që shkelësit kanë vetëshkaktuar zjarr.

[44] "Do t'ju bie juve në mend çka po ju them tash. E lë gjykimin e kësaj çështje te Zoti; Zoti është

* 40:34 Jahuditë refuzuan të besojnë në Mesinë kur ai erdhi te ta, të Krishterët refuzuan të besojnë në Muhamedin kur ai erdhi te ta, dhe shumica e Myslimanëve të sotshëm besojnë që Muhamedi ishte i dërguari i fundit. Mbi atë bazë të gabuar, ata refuzuan ta pranojnë të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes. Mësojmë nga 3:81-90 dhe 33:7 që ata të cilët nuk arrijnë ta pranojnë urdhrin Kuranor "për të përkrahur dhe besuar në të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes" nuk janë më besimtarë. *Shih Shtojcat 2 & 26.*

* 40:34 Vlen të përmendet që e gjejmë emrin "Rashad" në tekstin arabisht saktësisht katër strofa para urdhrin kundër thënies "i dërguari i fundit," dhe gjithashtu katër strofa pas tij.

Pamësi i të gjithë njerëzve.”

[45] Zoti pastaj e mbrojti atë nga planifikimet e tyre të këqija, përderisa njerëzit e Faraonit kanë vetëshkaktuar ndëshkimin më të keq.

Përderisa në varr: Ankth i vazhdueshëm

[46] Ferri do i tregohet atyre ditë e natë, dhe në Ditën e Ringjalljes: “Pranoni njerëzit e Faraonit në ndëshkimin më të keq.”

[47] Përderisa ata grinden në ferr, ndjekësit do iu thonë udhëheqësve, “Ne dikur ishim ndjekësit tuaj, a mund të na kurseni nga ndonjë pjesë e këtij Ferri?”

[48] Udhëheqësit do të thonë, “Ne jemi të gjithë në këtë së bashku. Zoti ka gjykuar mes njerëzve.”

Tepër vonë

[49] Ata në zjarr do iu thonë rojave të Ferrit, “Thirreni Zotëruesin tuaj për të na zvogëluar ndëshkimin, madje edhe vetëm për një ditë.”

[50] Ata do të thonë, “A nuk i pranuat të dërguarit tuaj që dërguan te ju lajme të qarta?” Ata do të përgjigjen, “Po vërtetë.” Ata do të thonë, “Atëherë lutuni (sa të dëshironi); lutja e mosbesimtarëve është gjithmonë e kotë.”

Fitore të garantuar; Këtu dhe përgjithmonë

[51] Patjetër, do i japim fitore të dërguarve tonë dhe atyre që besojnë, edhe në këtë botë edhe në ditën kur dëshmitarët mblidhen.

[52] Atë ditë, kur mosbesimtarët kërkojnë falje nuk do iu sjellë dobi. Ata kanë vetëshkaktuar mallkim; ata kanë vetëshkaktuar përfundimin më të keq.

Merrni mësim nga e kaluara

[53] I kemi dhënë Moisiut udhëzimin, dhe i bëmë Fëmijët e Izraelit që ta trashëgojnë shkrimin.

[54] (Historia e tyre) është mësim dhe kujtesë për ata që posedojnë inteligjencë.

[55] Prandaj, ji i durueshëm, se premtimi i Zotit është i vërtetë, dhe kërko falje për mëkatin tënd, dhe madhëroje dhe lartmadhëroje Zotëruesin tënd natë e ditë.

[56] Padyshim, ata që polemizojnë kundër shpalljeve të Zotit pa pasur provë po e shfaqin mendjemadhësinë që është e fshehur brenda kraharorëve të tyre, dhe ata madje as nuk janë të vetëdijshëm për të. Prandaj, kërko strehim në Zotin; Ai është Dëgjuesi, Pamësi.

Ndërtimi mbresëlënës i gjithësisë

[57] Krijimi i qiejve dhe tokës është madje edhe më mbresëlënës sesa krijimi i qenies njerëzore, por shumica e njerëzve nuk dinë.

[58] Nuk është i barabartë i verbëri me pamësin. As ata që besojnë dhe punojnë drejtësi të barabartë me mëkatarët. Rrallë merrni vesh.

[59] Patjetër, Ora (Dita e Gjykimit) po vjen, nuk ka dyshim për të, por shumica e njerëzve nuk besojnë.

*Lutja: Mënyrë adhurimi**

[60] Zotëruesi juaj thotë, “Më luteni Mua, dhe do t’ju përgjigjem. Patjetër, ata që janë tepër mendjemadhënj për të më adhuruar Mua do të hynë në Xhehenem, me forcë.”

[61] Zoti është Ai që e dizajnoi natën që të mund të pushoni, dhe ditën të ndriçuar. Zoti dhuron shumë bekime mbi njerëzit, por shumica e njerëzve nuk janë falënderues.

[62] I tillë është Zoti Zotëruesi juaj, Krijuesi i të gjitha gjërave. Nuk ka asnjë zot përveç Tij. Si mund

* 40:60 Lutja, përgjërimi te Zoti për ndonjë gjë, madje edhe për lukse materiale, është formë e adhurimit. Prandaj ekziston urdhri për t’iu lutur Zotit sa herë që kemi ndonjë nevojë. Ateisti nuk i lutet Zotit për asgjë.

të devijoni?

[63] Duke devijuar janë ata që shpërfillin shpalljet e Zotit.

[64] Zoti është Ai që e bëri tokën të banueshme për ju, dhe qiellin mbulojë të fortë, dhe Ai ju dizajnoi juve, dhe ju dizajnoi mirë. Ai është Ai që ju furnizon me furnizime të mira.* I tillë është Zoti, Zotëruesi juaj; Më i Lartësuar është Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.

[65] Ai është i Gjalli; nuk ka zot përveç Tij. Ta adhuron vetëm Atë, duke ia kushtuar fenë tuaj absolutisht vetëm Atij. Lartmadhëruar qoftë Zoti, Zotëruesi i gjithësisë.

Para se ta bekonte Zoti, Muhamedi adhuronte idhuj

[66] Thuaj, "Unë jam ndaluar së adhuruari idhujt që ju i adhuron përkrah Zotit, kur shpalljet e qarta më erdhën mua nga Zotëruesi im. U urdhërova t'i nënshtrohem Zotëruesit të gjithësisë."*

[67] Ai është Ai që ju krijoi nga dheu, dhe më pas nga një pikël, pastaj nga një embrion i varur, pastaj Ai ju nxjerr si fëmijë, pastaj ju lë të arrini pjekuri, pastaj bëheni të vjetër – disa prej jush vdisni më herët. Ju arrini një moshë të paracaktuar, që të mund të kuptoni.

[68] Ai është i Vetmi që drejton jetë dhe vdekje. Për të kryer diçka, Ai thjeshtë i thotë, "Ji," dhe është.

[69] A i ke vënë re ata që polemizojnë kundër provave të Zotit, dhe si ata kanë devijuar?

[70] Ata janë ata që nuk kanë besuar në shkrimin, dhe në lajmet që i kemi dërguar me të dërguarit tonë. Prandaj, ata patjetër do e marrin vesh.

[71] Prangat do të jenë rreth qafave të tyre, dhe zinxhirët do të përdoren për t'i zvarritur.

[72] Në Vlim,* pastaj në Zjarr, ata do të digjen.

[73] Ata do të pyeten, "Ku janë idhujt që dikur i adhuronit,

Ata adhuruan hiçin

[74] "përkrah Zotit?" Ata do të thonë, "Na kanë braktisur. Në fakt, kur i adhuroam ata, ne ishim duke adhuruar hiç." Kështu pra Zoti i dërgon mosbesimtarët në humbje.

[75] Kjo është për shkak se dikur kënaqeshit me doktrina të rreme në tokë, dhe i përhapnit ato.

[76] Hyni në portat e Xhehenemit, ku qëndroni përgjithmonë. Çfarë fati i tmerrshëm për mendjemëdhenjtë.

[77] Të jesh i durueshëm, se premtimi i Zotit është e vërteta. Qoftë nëse të tregojmë ca nga (ndëshkimi) që kemi premtuar për ta, ose ta përfundojmë jetën para saj, ata do të kthehen te ne.

*Autorizimi i Zotit për Mrekullinë Matematikore të Kuranit**

[78] Kemi dërguar të dërguarë para teje – disa prej tyre t'i kemi përmendur, disa nuk t'i kemi përmendur. Nuk i takon të dërguarit të sjellë ndonjë mrekulli përveç kur Zoti lëshon (urdhër). Kur urdhri i Zotit lëshohet, e vërteta dominon, dhe ata që shtihen dalin në shesh dhe poshtërohen.

[79] Zoti është Ai që krijoi bagëtinë për ju; disa i ngisni, dhe disa i hani.

[80] Ato gjithashtu ju furnizojnë edhe me dobi tjera që kënaqin shumë nga nevojat tuaja. Mbi to, si

* 40:64 Shih Shënimet 15:20, 20:54, 25:2, dhe 35:12-13.

* 40:66 Fjala arabe "Nahaa" e përdorur në këtë strofë tregon ndalimin e diçkaje që po ndodhte më parë. Shih për shembull fjalën e njëjtë në 4:171. Shih gjithashtu 93:7.

* 40:72 Ata që nuk e përgatitën veten do të vuajnë tepër në prani të Zotit, në Ditën e Gjykimit. Ata nuk mund ta durojnë afërsinë me Zotin për shkak të mungesës së rritjes dhe zhvillimit të mjaftueshëm të shpirtit të tyre. Unë po përdor fjalën "Vlim" për të përshkruar këtë situatë të veçantë (55:44). Përgatitja e shpirtit arrihet me ritet e shpallura nga Zoti, siç janë Lutjet e Kontaktit.

* 40:78 Mësojmë nga 17:45:46, 18:57, dhe 56:79 që pabesimtarët nuk kanë qasje në Kuran; vetëm besimtarët dhe kërkuesit e sinqertë lejohen nga Zoti që ta kuptojnë atë. Kodi matematikor i Kuranit, "Njëra prej mrekullive të mëdha" (74:30-35), ishte i autorizuar nga Zoti, dhe u zbulua nëpërmjet të Dërguarit të Tij të Besëlidhjes (Shtojca 2).

dhe mbi anijet, ju barteni.

[81] Ai kështu jua tregon provat e Tij. Cilat nga provat e Zotit mund t'i mohoni?

[82] A nuk janë endur ata nëpër tokë dhe kanë vërejtur pasojat për ata që iu paraprinë atyre? Ata dikur ishin më të mëdhenj në numër, më të mëdhenj në fuqi, dhe kishin më shumë ndikim në tokë. Por, të gjitha arritjet e tyre nuk iu ndihmuan aspak.

[83] Kur të dërguarit e tyre shkuan te ta me prova të qarta, ata u dëfryen me njohurinë që kishin trashëguar, dhe pikërisht gjërat që i përqeshën ishin shkak i rënies së tyre.

VETËM Zoti

[84] Më pas, kur ata panë ndëshkimin tonë thanë, "Tash besojmë në VETËM Zotin, dhe tash nuk besojmë në adhurimin e idhujve që dikur e praktikonim."

Tepër vonë

[85] Besimi i tyre atëherë nuk mund t'iu ndihmonte aspak, kur e panë ndëshkimin tonë. I tillë është sistemi i Zotit që është themeluar për tu marrë me krijesat e Tij; mosbesimtarët gjithmonë dënohen.

Surja 41: Hollësishëm (Fussilet)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.*

[2] Shpallje nga Mirëbërësi, i Mëshirshmi.

[3] Shkrim strofat e të cilit furnizojnë krejt hollësitat, në Kuran arabisht, për njerëzit që dinë.

[4] Bartës i lajmit të mirë, si dhe paralajmërues. Megjithatë, shumica e tyre ia kthejnë shpinën; ata nuk dëgjojnë.

[5] Ata thanë, "Mendjet tona janë të kurdisura, veshët tanë janë shurdh për lajmin tënd, dhe një barrierë na ndanë neve prej teje. Bë çka të duash, edhe ne do të bëjmë ashtu."

[6] Thuaj, "Unë nuk jam asgjë më shumë se një qenie njerëzore si ju, që është frymëzuar që zoti juaj është një zot. Të jeni të përkushtuar ndaj Tij, dhe kërkoni faljen e Tij. Mjerë adhuresit e idhujve.

[7] "Që nuk japin bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe sa i përket Përjetësisë, ata janë mosbesimtarë."

[8] Sa për ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, ata pranojnë shpërblim fare mirë të merituar.

[9] Thuaj, "Ju nuk besoni në Atë që krijoi tokën për dy ditë,* dhe ngritni idhuj që ta rivalizoni Atë, edhe pse Ai është Zotërues i gjithësisë."

[10] Ai vuri në të stabilizues (male), e bëri të frytshme, dhe kalkuloi furnizimet e saj për katër ditë, për të kënaqur nevojat e të gjithë banorëve.

[11] Pastaj Ai iu kthye qiellit, kur ai ishte ende gaz, dhe i tha atij, dhe tokës, "Ejani në ekzistencë, me vullnet ose pa vullnet." Ata thanë, "Vijmë me vullnet."

[12] Kështu, Ai* i kreu të shtatë gjithësitë për dy ditë, dhe ujdisi ligjet për secilën gjithësi. Dhe ne e

* 41:1 Për domethënien e këtyre Inicialeve Kuranore, shih Shënimin 40:1.

* 41:9-10 "Ditët" e krijimit përfaqësojnë metër matëse. Pra, gjithësia fizike u krijua për dy ditë, përderisa për kalkulimin e furnizimeve për të gjitha krijesat në tokë u deshën katër. Kjo gjithashtu na mëson që ka jetë vetëm në këtë planet – në Tokë.

* 41:12 Zoti vetë e krijoi gjithësinë (18:51), por engjëjt u morën me punë të caktuara në gjithësinë më të ulët. Gjithësia jonë nuk mund ta durojë praninë fizike të Zotit (7:143). Shumësi në gramatikë njihet rolin e engjëjve në gjithësinë tonë (Shtojca 10).

stolisëm gjithësinë më të ulët me llamba, dhe vumë roje rreth saj. I tillë është dizajni i të Plotfuqishmit, të Gjithëdijshmit.

Paralajmërim

[13] Nëse kthehen prapa, atëherë thuaj, “Po ju paralajmëroj për një katastrofë si katastrofa që asgjësoi Adin dhe Themudin.”

[14] Të dërguarit e tyre shkuan te ta, si edhe para tyre dhe pas tyre, duke thënë, “Të mos adhuronit përveç Zotit.” Ata thanë, ‘Po të donte Zotëruesi ynë, Ai ka mundur të dërgojë engjëj. Ne nuk besojmë në çka thoni ju.’

[15] Sa për Adin, ata u bënë mendjemdhenj në tokë, e kundërshtuan të vërtetën, dhe thanë, “Kush është më i fuqishëm se ne?” A nuk e kuptuan ata që Zoti, i cili i krijoi ata, është më i fuqishëm se ata? Ata ishin mosmirënjohës të shpalljeve tona.

[16] Si pasojë, dërguam mbi ta erë të fortë, për pak ditë të trishtueshme. Kështu i pllakosëm me ndëshkim poshtërues në këtë jetë, dhe ndëshkimi i Përjetësisë është më poshtërues; ata nuk mund të fitojnë.

[17] Sa për Themudin, i furnizua me udhëzim, por preferuan verbërinë mbi udhëzimin. Si pasojë, ndëshkimi katastrofik dhe i turpshëm i asgjësoi ata, për shkak të asaj që kishin mbledhur.

[18] Ne gjithmonë i shpëtojmë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë.

[19] Do të vij dita kur armiqtë e Zotit do të mblidhen në zjarr, me forcë.

[20] Kur ata arrijnë atje, vetë dëgjimi, sytë, dhe lëkurat e tyre do të dëshmojnë për çdo gjë që kishin bërë.

Incizimi

[21] Ata do iu thonë lëkurave të tyre, “Pse dëshmuat kundër nesh?” Do të përgjigjen, “Zoti na bëri të flasim; Ai është Ai që e bën çdo gjë të flasë. Ai është Ai që ju krijoi juve herën e parë, dhe tash ju jeni kthyer te Ai.”

[22] Nuk ka asnjë mënyrë që të mund të fshihen nga vetë dëgjimi juaj, sytë tuaj, ose lëkurat tuaja. Në fakt, ju menduat që Zoti ishte i pavetëdijshëm për shumë gjëra që i bëni.

[23] Kjo mënyrë e të menduarit për Zotëruenin tuaj do t’ju bëjë të bini, dhe pastaj bëheni humbës.

[24] Nëse ata vazhdojnë në mënyrën e tyre, Ferr do të jetë përfundimi i tyre, dhe nëse trillojnë arsyetime, nuk do të shfajësohen.

Shoqëruesit xhin

[25] Ne u caktojmë atyre shoqërues që e zbukurojnë çdo gjë që ata bëjnë në sytë e tyre. Kështu, ata përfundojnë duke vetëshkaktuar fatin e njëjtë si shoqëritë paraprake të xhinëve dhe njerëzve, të cilët ishin gjithashtu humbës.

[26] Ata që nuk besuan thanë, “Mos e dëgjoni këtë Kuran dhe shtrembërojeni atë, që të mund të fitoni.”

[27] Ne patjetër do i pllakosim këta mosbesimtarë me ndëshkim të rëndë. Ne patjetër do i paguajmë ata për punët e tyre të këqija.

[28] E tillë është pagesa që i pret armiqtë e Zotit. Ferr do të jetë vendbanimi i tyre i përhershëm; pagesë e drejtë për që i morën nëpër këmbë shpalljet tona.

Në Ditën e Gjykimit

[29] Ata që nuk besuan do të thonë, “Zotëruesi ynë, na trego ata mes dy llojeve – xhinëve dhe njerëzve – që na çorientuan, që të mund t’i shtypim me këmbët tona, dhe t’i bëjmë më të poshtrit.”

Lumturi e përkryer: Tash dhe përgjithmonë

[30] Ata që deklarojnë: “Zotëruesi ynë është Zoti,” pastaj çojnë jetë të drejtë, engjëjt zbresin mbi ta: “Të mos keni aspak frikë, as të mos brengoseni. Gëzohuni me lajmin e mirë që Parajsa është rezervuar për ju.

[31] "Ne jemi aleatët tuaj në këtë jetë, dhe në Përjetësi. Do të keni në të çfarëdo që të dëshironi; do të keni atë që doni.

[32] "banesë përfundimtare, nga Falësi, i Mëshirshmi."

Të nënshtruarit

[33] Kush mund të shprehë fjalë më të mira se dikush që fton te Zoti, punon drejtësi, dhe thotë, “Unë jam një prej të nënshtruarve”?

[34] Nuk është i barabartë reagimi i mirë dhe reagimi i keq. Të drejtohesh me reagimin më të mirë të mundshëm. Kështu, ai që dikur ishte armiku yt, mund të bëhet shoku yt i ngushtë.

[35] Askush nuk mund ta arrijë këtë përveç atyre që durojnë me këmbëngulje. Askush nuk mund ta arrijë këtë përveç atyre që janë tejet fatlum.

Kur Djalli joshë

[36] Kur djalli të pëshpëritë ty një ide, të kërkosh strehim te Zoti. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

Prova të Zotit

[37] Mes provave të Tij janë nata dhe dita, dhe dielli dhe hëna. Mos u përujni para diellit, as hënës; të bini në përujje para Zotit që i krijoi ata, nëse vërtetë e adhuroni vetëm Atë.

[38] Nëse ata janë tepër mendjemëdhenj që ta bëjnë këtë, atëherë ata te Zotëruesi yt e madhërojnë Atë natë e ditë, pa u lodhur kurrë.

[39] Mes provave të Tij është që e shihni tokën të shkretë, pastaj, sapo derdhim mbi të ujë, ngazëlleshet me jetë. Padyshim, Ai që e ngjalli atë mund t’i ngjallë të vdekurit. Ai është i Gjithëfuqishëm.

[40] Padyshim, ata që shtrembërojnë shpalljet tona nuk janë të fshehur prej nesh. A është më mirë dikush që hidhet në Ferr, apo dikush që vjen i sigurt në Ditën e Ringjalljes? Bëni çfarëdo që dëshironi; Ai është Pamës i çdo gjëje që bëni.

*Mrekullia Matematikore e Kuranit**

[41] Ata që e kanë refuzuar provën e Kuranit kur ajo iu erdh atyre, gjithashtu kanë refuzuar një libër të Nderuar.

[42] Asnjë e pavërtetë nuk mundi të hy në të, as në të kaluarën as në të ardhmen;* shpallje nga Më i Mençuri, i Falënderuari.

*I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes**

[43] Çka të thuhet ty është saktësisht çka iu tha të dërguarve paraprak. Zotëruesi yt posedon falje, dhe Ai gjithashtu posedon ndëshkim që dhemb.

S’ka rëndësi gjuha

[44] Po ta bënim atë Kuran jo-arabisht do të kishin thënë, “Pse zbriti në atë gjuhë?” Qoftë është arabisht ose jo-arabisht, thuaj, “Për ata që besojnë, është udhëzim dhe shërim. Sa për ata që nuk

* 41:41 Fjala “Dhikr” i referohet kodit matematikor të Kuranit, siç bëhet e qartë në 38:1.

* 41:42 Njëri prej funksioneve madhore të mrekullisë matematikore të Kuranit është që të ruajë çdo shkronjë dhe çdo aspekt të Kuranit. Kështu, çfarëdo futje e duarve në të vërehet menjëherë (Sht. 1 & 24).

* 41:43 Prova matematikore tregon që kjo strofë i referohet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes. Duke mbledhur vlerën gërmore të “Rashad” (505), plus vlerën e “Khalifa” (725), plus numrin e kësaj strofe (43), marrim $505+725+43=1273=19 \times 67$. Shih Shtojcën 2.

besojnë, ata do të jenë të shurdhër dhe të verbër ndaj tij, sikur të jenë duke u thirrur nga një vend shumë i largët.”

[45] I kemi dhënë Moisiut shkrimin dhe u polemizua gjithashtu. Po të mos ishte për vendimin e paracaktuar të Zotëruesit tënd, ata do të ishin gjykuar menjëherë. Me të vërtetën, ata ushqejnë tepër shumë dyshime.

[46] Kushdo që vepron drejt bën ashtu për të mirën e vet, dhe kushdo që bën të këqija bën ashtu në dëm të vetes. Zotëruesi yt nuk është i padrejtë ndaj njerëzve.

Idhujt i mohojnë ndjekësit e tyre

[47] Me Të është njohuria për Orën (fundin e botës).^{*} Asnjë fryt nuk del nga lëvozhga e vet, as ndonjë femër nuk mbetet shtatzënë as nuk lindë, pa njohurinë e Tij. Do të vij dita kur Ai i pyet ata: “Ku janë ata idhuj që i ngritët përkrah Meje?” Ata do të thonë, “Deklarojmë para Teje që askush prej nesh nuk dëshmon për atë.”

[48] Idhujt që ata i kishin idolizuar do i mohojnë ata, dhe ata do e kuptojnë që nuk do të kenë kah të shpëtojnë.

Shokë për interes

[49] Qenia njerëzore nuk lodhet duke u lutur për gjëra të mira. Dhe kur vështirësi i bie, bëhet i dëshpëruar, i pashpresë.

[50] Dhe kur e bekojmë atë pasi të ketë vuajtur pak vështirësi, ai thotë, “Kjo më takon mua. Nuk besoj që Orës do i vij koha ndonjëherë. Edhe nëse kthehem te Zotëruesi im, do të gjej te Ai gjëra më të mira.” Padyshim, do i njoftojmë mosbesimtarët për të gjitha punët e tyre, dhe do i parashtrijmë në ndëshkim të rëndë.

[51] Kur e bekojmë qenien njerëzore, ai kthehet prapa, dhe largohet larg e më larg, dhe kur ai vuan ndonjë fatkeqësi, ai lutet fort.

[52] Deklaro: “Çka nëse ky (Kuran) është vërtetë nga Zoti, e ju vendosni ta refuzoni? Kush janë më larg në humbje se ata që vendosin ta kundërshtojnë këtë?”

Profeci shumë e madhe

[53] Do t’ua tregojmë atyre provat tona në fushëpamjet, dhe brenda vetes, derisa ta kuptojnë që ky është e vërteta.^{*} A nuk mjafton Zotëruesi yt si dëshmitar i të gjitha gjërave?

[54] Vërtetë, ata janë në dyshim për takimin me Zotëruesin e tyre. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Surja 42: Konsultimi (Esh-Shura)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.*

[2] `A. S. K.*

[3] Duke të frymëzuar ty, dhe ata para teje, është Zoti, i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

^{*} 41:47 Zoti e ka zbuluar këtë njohuri nëpërmjet të Dërguarit të Tij të Besëlidhjes (Shtojca 25).

^{*} 41:53 Janë 19 fjalë që përbëjnë këtë strofë, dhe vlerat e tyre germore japin shumën 1387, 19x73. Kjo profeci shumë e madhe, së bashku me 9:33, 48:28, 61:9 & 110:2 na njoftojnë që e tërë bota është e paracaktuar ta pranojë Kuranin si lajmin e pandryshuar të Zotit (Shih Shtojcën 38).

^{*} 42:1 Këto inicialet përbëjnë një pjesë të rëndësishme të mrekullisë së Kuranit (Shënimi 40:1).

^{*} 42:2 Kjo është e vetmja sure ku shohim inicialet `A.S.K. (`Ajn Sin Kaf), dhe ndodhja totale e këtyre tri shkronjave në këtë sure është 209, 19x11. Gjithashtu, shkronja “K” ndodhet në këtë sure 57 herë, 19x3. E vetmja sure ku e shohim inicialin “K” është Surja 50, dhe kjo shkronjë ndodhet në atë sure gjithashtu 57 herë (Shih Shtojcën 1).

[4] Atij i përket çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë, dhe Ai është Më i Larti, i Madhi.

[5] Qiejt mbi ta gati shpartallohen, nga respekti për Atë, dhe engjëjt lartmadhërojnë dhe madhërojnë Zotëruesin e tyre, dhe ata kërkojnë falje për ata në tokë. Absolutisht, Zoti është Falësi, i Mëshirshmi.

[6] Ata që ngritin zota tjerë përkrah Tij, Zoti është Ai që i kontrollon ata; ti nuk je avokati i tyre.

[7] Ne kështu shpallim te ti Kuran arabisht për të paralajmëruar shoqërinë qendrore dhe të gjithë rreth saj, dhe për të paralajmëruar për Ditën e Mbledhjes që është e pashmangshme. Disa do të përfundojnë në Parajsë, dhe disa në Ferr.

[8] Po të donte Zoti, Ai ka mundur t'i bëjë ata një shoqëri. Por Ai shpengon në mëshirën e Tij këdo Ai do. Sa për shkelësit, ata nuk kanë sundues, as ndihmues.

[9] A gjetën ata zotëruesë tjerë përkrah Tij? Zoti është i vetmi Zotërues dhe Sundues. Ai është Ai që ringjallë të vdekurit, dhe Ai është Ai i Gjithëfuqishmi.

[10] Nëse polemizoni cilëndo pjesë të këtij lajmi, gjykimi për që e bëtë këtë prehet me Zotin. I tillë është Zoti Zotëruesi im. Në Të kam besim, dhe Atij i nënshtrohem.

Asgjë e barabartë me Zotin

[11] Nismëtari i qiejve dhe tokës. Ai krijoi për ju nga vetë ju të shoqe – dhe gjithashtu edhe për kafshët. Ai kështu ju furnizon me mjetet e shumimit. Nuk ka asgjë që është e barabartë me Atë. Ai është Dëgjuesi, Pamësi.

[12] Atij i përket komanda absolute e qiejve dhe tokës. Ai është Ai që rritë furnizimin për këdo Ai do, ose e zvogëlon atë. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Vetëm një fe

Monoteistët kundër adhuruesve të idhujve

[13] Ai shpalli për ju të njëjtën fe që shpalli për Nuhun, dhe atë që ta frymëzuam ty, dhe atë që shpallëm për Ibrahimin, Moisiun, dhe Jezusin: “T’i përmbaheni kësaj feje të vetme, dhe mos e përçani.” Adhuruesit e idhujve do ia kenë inati asaj që i ftoni të bëjnë. Zoti shpengon te Vetja këdo Ai do; Ai udhëzon për te Vetja vetëm ata që nënshtrohen plotësisht.

[14] Për ironi, ata u përçanë në sekte vetëm pasi që njohuria kishte ardhur te ta, për shkak të xhelozisë dhe inatit mes tyre. Po të mos ishte për një vendim të paracaktuar nga Zotëruesi yt për t’iu dhënë afat atyre për një kohë të caktuar, ata do të ishin gjykuar menjëherë. Në të vërtetë, gjeneratat e mëvonshme që trashëguan shkrimin janë plot dyshime.

Lajm të krishterëve dhe jahudive

[15] Kjo është ajo që duhet të predikosh, dhe vazhdo me durim çka je urdhëruar të bësh, dhe mos i ndiq dëshirat e tyre. Dhe shpall: “Unë besoj në të gjitha shkrimet e zbritura nga Zoti. U urdhërova të gjykoj mes jush me barazi. Zoti është Zotëruesi ynë dhe Zotëruesi juaj. Ne kemi veprat tona dhe ju keni veprat tuaja. Nuk ka polemikë mes nesh dhe jush. Zoti do të na mbledhë të gjithëve së bashku; te Ai është fati përfundimtar.”

[16] Ata që polemizojnë në lidhje me Zotin, pasi që e pranojnë lajmin e Tij, argumenti i tyre asgjësohet te Zotëruesi i tyre. Ata kanë vetëshkaktuar dënim, dhe kanë merituar ndëshkim të rëndë.

[17] Zoti është Ai që zbriti shkrimin me të vërtetën dhe ligjin. Për sa din ti, Ora mund të jetë shumë afër.

Besimtarët të ndërgjegjshëm për Ditën e Gjykimit

[18] Duke e sfiduar atë janë ata që nuk besojnë në të. Sa për ata që besojnë, ata janë të

ndërgjegjshëm për të, dhe e dinë që është e vërteta. Absolutisht, ata që mohojnë Orën kanë shkuar larg në humbje.

[19] Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha krijesat e Tij; Ai furnizon për këdo Ai do. Ai është i Fuqishmi, i Plotfuqishmi.

[20] Kushdo që kërkon shpërblimet e Përjetësisë, i shumëfishojmë shpërblimet për të. Dhe kushdo që kërkon gjërat materiale të kësaj bote, i japim prej saj, pastaj ai nuk ka hise në Përjetësinë.

Idhujt: Duke shpikur ligje të reja fetare

[21] Ata ndjekin idhuj që shpallin për ta ligje fetare të paautorizuara nga Zoti. Po të mos ishte për vendimin e paracaktuar, ata do të ishin gjykuar menjëherë. Vërtetë, shkelësit kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.*

[22] Do i shohësh shkelësit të brengosur për çdo gjë që kishin bërë; çdo gjë do iu kthehet që t'i kaplojë. Sa për ata që besuan dhe çuan jetë të drejtë, ata do të jenë në kopshte Parajse. Ata do të pranojnë çfarëdo që dëshirojnë nga Zotëruesi i tyre. Ky është bekimi i madh.

[23] Ky është lajmi i mirë nga Zoti te shërbëtorët e Tij që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë. Thuaj, "Unë nuk ju kërkoj pagë. Ju them juve që të kujdeseni për të afërmit tuaj." Kushdo që bën një punë të drejtë, ne do ia shumëfishojmë shpërblimin e tij për të. Zoti është Falës, Mirënjohës.

Zoti fshinë të pavërtetën dhe konfirmon të vërtetën

[24] A po thonë ata, "Ai (Rashadi)* ka trilluar rrena për Zotin!"? Po të donte Zoti, Ai ka mundur t'ju mbyllë mendjet tuaja, por Zoti fshinë të pavërtetën dhe konfirmon të vërtetën me fjalët e Tij. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[25] Ai është Ai që pranon pendimin nga shërbëtorët e Tij, dhe largon mëkatet. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që bëni.

[26] Duke iu përgjigjur Atij janë ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë. Ai do të derdhë bekimet e Tij mbi ta. Sa për mosbesimtarët, ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të rreptë.

[27] Sikur Zoti të rriste furnizimin për shërbëtorët e Tij, ata do të ishin bërë shkelës në tokë. Kjo është pse Ai e dërgon atë të matur saktësisht te kush do Ai. Ai është Njohës i tërësishtëm dhe Pamës i shërbëtorëve të Tij.

[28] Ai është Ai që lëshon shiun pasi ata të ishin dëshpëruar, dhe shpërndan mëshirën e Tij. Ai është Sunduesi i vetëm, Më i Falënderuari.

[29] Mes provave të Tij është krijimi i qiejve dhe tokës, dhe krijesave që Ai i përhapë në to. Ai është i aftë t'i mbledhë ato, kur Ai do.

Vetëm pasojë

[30] Çfarëdo e keqe që ju ndodhë juve është pasojë e vetë veprave tuaja, dhe Ai tejkalon shumë (nga mëkatet tuaja).

[31] Nuk mund t'i ikni, dhe nuk keni askënd përkrah Zotit si Zotëruesi dhe Sundues.

[32] Mes provave të Tij janë anijet që lundrojnë nëpër det me vela si flamuj.

* 42:21 Islami i botës së sotme Myslimane është shtrembëruar, është bërë kult Dreqnor. Ulematë, apo shkollarët fetarë, kanë shtuar shumë ligje palidhje, ndalesa, rregulla të veshjes, rregulla diete, dhe zakone fetare të paautorizuara nga Zoti. Kjo është njëra prej arsyeve kryesore për dërgimin e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes (9:31, 33:67, dhe Shtojca 33).

* 42:24 Mosbesimtarët shtuan 2 thënie të pavërteta në fund të Sures 9 për ta përkujtuar idhullin e tyre, profetin Muhamed. Zoti ka zbuluar evidencë të pakalueshme për ta fshirë këtë blasfemi dhe për ta vendosur të vërtetën. Duke mbledhur vlerën germore të "Rashad Khalifa" (1230), plus numrin e strofës (24), marrim 1254, 19x66 (shih Shtojcat 2 & 24 për hollësitrat).

[33] Po të donte Ai, Ai ka mundur t'i qetësojë erërat, duke i lënë të palëvizshme mbi ujë. Këto janë prova për ata që janë të durueshëm, mirënjohës.

[34] Ai mund t'i asgjësojë ata, si pasojë e vetë veprave të tyre. Por, Ai tejkalon shumë (nga mëkatet e tyre).

[35] Ata që grinden kundër provave tona do e marrin vesh që nuk kanë bazë.

[36] Çfarëdo që ju jepet juve nuk është asgjë më shumë se gjë materiale e përkohshme e kësaj jete. Çka Zoti posedon është shumë më e mirë dhe e përhershme, për ata që besojnë dhe kanë besim në Zotëruesin e tyre.

Tiparet e besimtarëve

[37] Ata iu shmangen mëkateve të tepërta dhe veseve, dhe kur zemërohen falin.

[38] Ata i përgjigjen Zotëruesit të tyre duke i zbatuar Lutjet e Kontaktit (Salat). Çështjet e tyre vendosen pas këshillimit të duhur mes tyre, dhe nga furnizimet tona te ta japin (bamirësi).

[39] Kur padrejtësi e tepërt iu bie atyre, ngriten për të drejtat e tyre.

[40] Edhe pse shpagimi i drejtë për një padrejtësi është ndëshkim i barabartë, ata që falin dhe mbajnë drejtësi shpërblehen nga Zoti. Ai nuk i do të padrejtësit.

[41] Padyshim, ata që ngriten për të drejtat e tyre, kur padrejtësi iu bie atyre, nuk janë duke bërë asnjë gabim.

[42] Të padrejtësit janë ata që trajtojnë njerëzit padrejtësisht, dhe kthehen në agresion pa u provokuar. Këta kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[43] Strehimi në durim dhe falje pasqyron karakter vërtetë të fortë.

[44] Këdo që Zoti e dërgon në humbje nuk do të gjejë kurrë asnjë zotërues tjetër, dhe do të shohësh shkelës të tillë, kur ata shohin ndëshkimin, duke thënë, "A mund të na jepet edhe një rast?"

[45] Do i shohësh përballë tij, të poshtëruar dhe përbuzur, dhe duke shikuar, por duke u munduar të mos shikojnë. Ata që besuan do të shpallin: "Humbësit e vërtetë janë ata që i humbën shpirtat e tyre dhe familjet e tyre në Ditën e Ringjalljes. Shkelësit kanë merituar ndëshkim të përhershëm."

[46] Nuk do të ketë asnjë aleat për t'iu ndihmuar atyre kundër Zotit. Këdo që Zoti e dërgon në humbje nuk mund të udhëzohet.

[47] T'i përgjigjeni Zotëruesit tuaj para se të vij një ditë e cila është shpallur e pashmangshme nga Zoti. Nuk do të ketë asnjë strehim për ju në atë ditë, as avokat.

Misioni i vetëm i të dërguarit

[48] Nëse ata kthehen prapa, ne nuk të dërguam ty si kujdestar të tyre. Misioni yt i vetëm është dorëzimi i lajmit. Kur derdhim mëshirë mbi qeniet njerëzore, ata bëhen krenarë, dhe kur vështirësi i pllakosë ata, si pasojë e vetë punëve të tyre, qeniet njerëzore shndërrohen në mosbesimtarë.

[49] I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës. Ai krijon çfarëdo Ai do, duke i dhuruar vajza kujtdo Ai do, dhe duke i dhuruar djem kujtdo Ai do.

[50] Ose, Ai mund t'i bëjë meshkujt dhe femrat të martohen me njëri tjetrin, dhe ta bëjë këdo Ai do steril. Ai është i Gjithëdijshtëm, i Gjithëfuqishëm.

Si komunikon Zoti me ne

[51] Asnjë qenie njerëzore nuk mund të komunikojë me Zotin përveç nëpërmjet frymëzimit, ose nga pas një barriere, ose duke dërguar një të dërguar nëpërmjet të cilit Ai zbulon çka Ai do. Ai është Më i Larti, Më i Mençuri.

[52] Kështu, ne frymëzuar te ti shpallje që shpallë urdhrat tona. Ti as nuk e kishe idenë për

shkrimin, ose besimin. Por, ne e bëmë këtë fener për të udhëzuar këdo ne zgjedhim nga mes shërbëtorëve tanë. Padyshim, ti udhëzon në rrugë të drejtë.

[53] Në rrugën e Zotit, e të cilit është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Absolutisht, të gjitha çështjet drejtohen nga Zoti.

Surja 43: Stolitë (El-Zuhruf)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.*

[2] Dhe shkrimi ndriçues.

[3] E kemi bërë Kuran arabisht, që të mund të kuptoni.*

[4] Është i ruajtur me ne në amzën origjinale, të nderuar dhe plot mençuri.

[5] A ta injorojmë faktin që i keni tejkalluar kufijtë?*

Plani për shpengim

[6] Kemi dërguar mori profetësh te gjeneratat paraprake.

[7] Sa herë që një profet shkoi te ta, e përqeshën.

[8] Si pasojë, asgjësua njerëz që ishin edhe më të fuqishëm se këta. Kështu u jdisim shembujt nga shoqëritë paraprake.

[9] Po t'i pyesje ata, "Kush i krijoi qiejt dhe tokën," ata do të thoshin, "I Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi i ka krijuar ato."

[10] Ai është Ai që bëri tokën të banueshme për ju, dhe krijoi për ju rrugë në të, që të mund të ndiqni rrugën e drejtë.

[11] Ai është Ai që zbret nga qielli ujë, në masë të saktë, për të ngjallur toka të vdekura me të. Ngjashëm, ju do të ringjallen.

[12] Ai është Ai që krijoi të gjitha llojet, në çifte (mashkull dhe femër), dhe Ai krijoi për ju anije dhe bagëti për ngasje.

[13] Përderisa pushoni mbi to, të çmoni një bekim të tillë nga Zotëruesi juaj, dhe thoni, "I madhëruar qoftë Ai që i zbuti këto për ne. Nuk do të kishim mundur t'i merrnim në duart tona vetë.

[14] "Përfundimisht kthehemi te Zotëruesi ynë."

Engjëjt si bija: Blasfemi

[15] Ata madje edhe caktuan për Të një hise të krijimit të Tij! Padyshim, qenia njerëzore është thellë mosmirënjohës.

[16] A ka zgjedhur Ai nga mes krijesave të Tij vajza për Vete, përderisa ju ka bekuar juve me djem?

[17] Kur dikujt prej tyre i jepet myzhde (për vajzë) siç pretenduan për Mirëbërësin, fytyra e tij errësohet me trishtim dhe zemërim!

[18] (Ata thonë,) "Çka ka të mirë në një pasardhës që rritet për të qenë e bukur, dhe nuk mund të ndihmojë në luftë?"

[19] Ata pretenduan që engjëjt, që janë shërbëtorë të Mirëbërësit, janë femra! A kanë qenë

* 43:1 *Shih Shënimin 40:1. Shpeshtësia e ndodhjes së shkronjave "H" (Haa) dhe "M" (Mim) në shtatë suret me iniciale H.M. është 292, dhe 1855, përkatësisht. Kjo jep shumën 2147, ose 19x113.*

* 43:3 *Arabishtja është gjuha më efikase, posaçërisht në shprehjen e urdhrave, ligjeve dhe në saktësinë e tyre. Prandaj është bërë shpallja e Kuranit në arabisht për të kuptuarit e qartë për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh gjuhën e tyre. Shih Shtojcën 4 për hollësitat.*

* 43:5 *Kjo i referohet mëkatit tonë fillestar siç detajohet në Hyrje dhe Shtojcën 7.*

dëshmitarë të krijimit të tyre? Pretendimet e tyre incizohen, dhe ata do të pyeten.

[20] Ata madje thanë, “Po të donte Mirëbërësi, nuk do i kishim adhuruar ato.” Ata nuk kanë bazë për një pretendim të tillë; vetëm hamenden.*

[21] A iu kemi dhënë atyre libër para këtij dhe ata po i përmbahen?

Traditat e trashëguara dënohen

[22] Puna është që thanë, “I gjetëm prindërit tanë duke zbatuar zakone të caktuara, dhe ne po i ndjekim hapat e tyre.”

[23] Sa herë që dërguam një paralajmërues te ndonjë shoqëri, udhëheqësit e asaj shoqërie do të thoshin, “I gjetëm prindërit tanë duke ndjekur zakone të caktuara, dhe ne do vazhdojmë në hapat e tyre.”

[24] (I dërguari) do thoshte, “Çka nëse ju kam sjellë udhëzim më të mirë sesa ai që trashëguat nga prindërit tuaj?” Do thoshin, “Nuk besojmë në lajmin që sollët.”

[25] Si pasojë, i paguam ata. Vini re pasojat për refuzuesit.

Shembulli i Ibrahimit

[26] Ibrahim i tha babait të tij dhe njerëzve të tij, “Unë bëj hasha çka ju adhuronit.

[27] “Vetëm Ai që më nisi mund të më udhëzojë.”

[28] Ky shembull (i Ibrahimit) u bë mësim i përhershëm për gjeneratat pasuese; ndoshta i shpengojnë shpirtat e tyre.

[29] Në të vërtetë, Unë iu kam dhënë këtyre njerëzve dhe paraardhësve të tyre raste të mjaftueshme, pastaj e vërteta erdhi te ta, dhe një i dërguar sqarues.

[30] Kur e vërteta iu erdhi atyre, thanë, “Kjo është magji, dhe ne nuk besojmë në të.”

Muhamedi përqeshet

[31] Ata thanë, “Veç sikur ky Kuran të zbritej nëpërmjet një njeriu tjetër nga dy shoqëritë (Meka ose Yathribi) që është i mrrimë!”

[32] A janë ata që caktojnë mëshirën e Zotëruesit tënd? Ne i kemi caktuar hiset e tyre në këtë jetë, duke i ngritur disa prej tyre mbi të tjerët në shkallë më të larta, në mënyrë që t’i lëmë t’i shërbejnë njëri tjetrit. Mëshira nga Zotëruesi yt është shumë më e mirë sesa cilado gjë materiale që ata mund të mbledhin.

Gjërat materiale të kësaj bote - krejt çka marrin mosbesimtarët

[33] Po të mos ishte që të gjithë njerëzit mund të bëheshin një asamble (mosbesimtarësh), ne do i kishim dhënë secilit që nuk beson në Mirëbërësin pallate me çati të argjendta, dhe shkallë mbi të cilat ata do të mund të ngjiteshin.

[34] Pallatet e tyre do të kishin pasur porta madhështore, dhe orendi luksoze.

[35] Gjithashtu shumë stoli. Të gjitha këto janë gjëra materiale të përkohshme të kësaj jete të ulët. Përjetësia – te Zotëruesi yt – është shumë më e mirë për të drejtit.

Shoqërues të padukshëm djallëzor

[36] Kujtdo që e shpërfillë lajmin e Mirëbërësit, i caktojmë një djall që të jetë shoqërues i tij i pandarë.*

[37] Shoqërues të tillë do i largojnë ata nga rruga, por do i bëjnë të besojnë që janë të udhëzuar.

* 43:20 Adhuresit e idhujve nuk mund ta fajësojnë Zotin për idhujtarinë e tyre, pasi që kemi liri absolute të zgjedhjes për ta adhuruar vetëm Zotin, ose jo.

* 43:36-39 Secili prej nesh ka përfaqësues të Drejit si shoqërues të pandarë (Shtojca 7).

[38] Kur ai vjen para nesh do të thotë, “Ah sikur të ishe aq larg prej meje sa të dy lindjet.* Çfarë shoqëruesi i tmerrshëm!”

[39] Nuk do t’ju ngushëllojë juve atë ditë, si shkelës, fakti që të dy do të ndani ndëshkimin.

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

[40] A mund t’i bësh shurdhat të dëgjojnë; a mund t’i bësh të verbrit të shohin, ose ata që janë larg në humbje?

[41] Qoftë të lëmë të vdesësh para asaj ose jo, patjetër do i paguajmë ata.

[42] Ose, mund të të tregojmë (ndëshkimin) që premtuam për ta. Ne i sillim ata krejtësisht.

[43] Të predikosh me durim çka të është shpallur ty; je në rrugën e drejtë.*

[44] Ky është lajm për ty dhe njerëzit e tu; të gjithë ju do të merreni në pyetje.

[45] Verifiko të dërguarit që dërguam para teje: “A kemi caktuar ndonjëherë zota të tjerë – përkrah Mirëbërësit – për tu adhuruar?”

[46] Për shembull, dërguam Moisiun me provat tona te Faraoni dhe këshilltarët e tij, duke shpallur: “Unë jam i dërguar nga Zotëruesi i gjithësisë.”

[47] Kur ne ua treguam atyre provat tona, ata qeshën me to.

Moisiu dhe Faraoni

[48] Secila shenjë që iu treguam atyre ishte më e madhe se ajo para saj. I pllakosëm me fatkeqësi, mbase pendohen.

[49] Ata thanë, “O ti magjistar, lutju Zotëruesit tënd në emër tonë (për të na hequr këtë fatkeqësi), pasi që ti ke marrëveshje me Të; pastaj do udhëzohemi.”

[50] Por sapo e hoqëm fatkeqësinë e tyre, ata u kthyen prapa.

[51] Faraoni iu shpalli njerëzve të tij, “O njerëzit e mi, a nuk mbretëroj unë mbi Egjiptin, dhe këta lumenj rrjedhës janë të mijtë? A nuk shihni?”

[52] “Kush është më i mirë; unë apo ai që është i varfër dhe mezi flet?”

[53] “Si është e mundur që ai nuk ka asnjë thesar ari; si është e mundur që engjëjt nuk po e shoqërojnë?”

[54] Ai kështu i mashtrroi njerëzit e tij, dhe ata iu bindën atij; ata ishin njerëz shpirtligj.

[55] Kur ata këmbëngulën që të na kundërshtonin, i ndëshkuam dhe i mbytëm të gjithë ata.

[56] I bëmë precedent dhe shembull për të tjerët.

Jezusi: Shembull tjetër

[57] Kur i biri i Marisë u përmend si shembull, njerëzit e tu e shpërfillën atë.

[58] Thanë, “A është më mirë t’i adhurojmë zotat tanë, apo ta adhurojmë atë?” E thanë këtë vetëm për tu grindur me ty. Vërtetë, ata janë njerëz që iu kanë bashkangjitur kundërshtarëve.

[59] Ai nuk ishte asgjë më shumë se një shërbëtor që e bekuam, dhe e dërguam si shembull për Fëmijët e Izraelit.

[60] Po të donim, do t’ju kishim bërë juve engjëj që vendosen dhe riprodhohen në tokë.

*Jezusi dhe fundi i botës**

[61] Ai është për të shërbyer si shenjë për të ditur fundin e botës, që të mos ushqeni më asnjë

* 43:38 “Lindjet” përfshijnë vendet e lindjes së diellit, lindjes së hënës, dhe lindjeve të trupave qiellor.

* 43:43 Shuma e vlerës gormore të “Rashad Khalifa” (1230) plus 43 është 1273, 19x67.

* 43:61 Siç detajohet në Shtojcën 25, Fundi i Botës jepet në Kuran, dhe ditëlindja e Jezusit dha një prej shenjave të rëndësishme që kalkulimet janë të sakta. Mësojmë që bota do të përfundojë në vitin 2280 (19x120) pas lindjes së Jezusit (shih 47:18). Aq më shumë, edhe viti hënor (1710) & viti diellor (2280) janë të plotpjesëtueshëm me 570 (19x30), numri i viteve nga lindja e Jezusit deri te lindja e Muhamedit. Pra, ditëlindja e Jezusit është shenjë.

dyshim për atë. Të më ndiqni Mua; kjo është rruga e drejtë.

[62] Le të mos ju zbrapsë djalli; ai është armiku juaj më i flaktë.

[63] Kur Jezusi shkoi me provat, ai tha, “Unë sjell te ju mençuri, dhe që të qartësoj disa nga çështjet për të cilat grindeni. T’ia keni dronë Zotit dhe më bindeni mua.

[64] “Zoti është Zotëruesi im dhe Zotëruesi juaj, ta adhuroni vetëm Atë. Kjo është rruga e drejtë.”

[65] Kundërshtarët u grindën mes vete. Mjerë ata që shkelin nga ndëshkimi i një dite që dhemb.

[66] A po presin ata që Ora (Dita e Gjykimit) t’iu vij atyre papritmas kur më së paku e presin?

[67] Shokët e ngushtë atë ditë do të bëhen armiq të njëri tjetrit, përveç të drejtëve.

Të drejtë

[68] O shërbëtorët e Mi, ju nuk do të keni aspak frikë atë ditë, as nuk do të brengoseni.

[69] Ata janë ata që besuan në shpalljet tona, dhe ishin të nënshtruar.

[70] Hyni në Parajsë, së bashku me të shoqet tuaja, dhe kënaquni.

[71] Atyre iu ofrohen tabaka dhe gota të arta, dhe ata do të gjejnë çfarëdo që dëshirojnë zemrat dhe pëlqejnë sytë. Ju jetoni aty përgjithmonë.

[72] E tillë është Parajsa që e trashëgoni, si shpërblim për punët tuaja.

[73] Do të keni në të të gjitha llojet e frutave, prej të cilave hani.

[74] Patjetër, fajtorët do të qëndrojnë në ndëshkimin e Xhehenemit përgjithmonë.

[75] Kurrë nuk do iu zbutet ndëshkimi atyre; do jenë të mbyllur në të.

[76] Nuk jemi ne ata që iu bëmë keq atyre; janë vetë ata që i bënë keq vetes.

[77] Ata do të përgjërohen: “O Malik, le të na përfundojë Zotëruesi yt.” Ai do të thotë, “Do të qëndroni përgjithmonë.

E urrejnë të vërtetën

[78] “Ju kemi dhënë të vërtetën, por shumica e urreni të vërtetën.”

[79] A kanë planifikuar ndonjë planifikim? Edhe ne po planifikojmë.

[80] A mendojnë ata që nuk ua dëgjojmë fshehtësitë dhe komplotet e tyre? Por jo! Të dërguarit tanë janë me ta, duke incizuar.

[81] Shpall: “Po të kishte Mirëbërësi të birë, unë ende do të isha më i pari adhurues.”

[82] Qoftë i madhëruar Ai; Ai është Zotëruesi i qiejve dhe tokës, Zotëruesi me pushtetin e madh, larg nga pretendimet e tyre.

[83] Lëri të bredhin dhe luajnë derisa ta takojnë ditën e tyre që po i pret.

[84] Ai është i Vetmi që është hyjni në qiell dhe hyjni në tokë. Ai është Më i Mençuri, i Gjithëdijshmi.

[85] Më i Lartësuar është Ai që posedon gjithë sovranitetin e qiejve dhe tokës, dhe çdo gjë ndërmjet tyre. Me të është njohuria për Orën (fundin e botës), dhe te Ai do të ktheheni.

[86] Askush prej atyre që ata e idolizojnë përkrah Tij nuk ka aspak fuqi të ndërmjetësorë, në mos qoftë ndërmjetësimi i tyre në përputhje me të vërtetën, dhe e dinë mirë.

[87] Po t’i pyetje ata kush i krijoi, do të thoshin, “Zoti.” Pse atëherë devijuan?

[88] Do të deklarohet: “O Zotëruesi im, këta njerëz nuk besojnë.”

[89] T’i shpërfillësh ata dhe thuaj, “Paqe;” ata do e marrin vesh.

Surja 44: Tymi (Ed-Duhan)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.

[2] Dhe ky shkrim ndriçues.

[3] E kemi zbritur në një natë të bekuar, se kemi për të paralajmëruar.

[4] Në të (shkrimin), çdo çështje mençurie është e sqaruar.

[5] Është urdhër i paracaktuar prej nesh që të dërgojmë të dërguarë.

[6] Kjo është Mëshirë nga Zotëruesi yt. Ai është Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi.

[7] Zotëruesi i qiejve dhe tokës, dhe çdo gjëje ndërmjet tyre. Veç sikur të ishit të sigurt!

[8] Nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij. Ai e ka në dorë jetën dhe vdekjen; Zotëruesi juaj dhe Zotëruesi i stërgjyshërve tuaj.

[9] Vërtetë, ata janë dyshues, të pavëmendshëm.

Tymi: Profeci madhore

[10] Prandaj, pritnie ditën kur qielli të sjellë një tym të thellë.*

[11] Do i mbështjellë njerëzit; ky është ndëshkim që dhemb.

[12] "Zotëruesi ynë, lehtësona këtë ndëshkim; ne jemi besimtarë."

[13] Tash që është shumë vonë, atyre iu bie në mend! Një i dërguar sqarues ka ardhur te ta.

[14] Por e refuzuan atë, duke thënë "Mirë i arsimuar, por i çmendur!"

[15] Ne do të lehtësojmë ndëshkimin për një kohë; shpejt do të riktheheni mbrapa.

[16] Ditën kur godasim goditjen e madhe, do të hakmerremi.

[17] I kemi testuar para tyre njerëzit e Faraonit; një i dërguar i ndershëm shkoi te ta.

[18] Duke deklaruar: "Dëgjomëni mua, shërbëtorë të Zotit. Unë jam një i dërguar i sinqertë te ju."

[19] Dhe, "Mos shkëlmi kundër Zotit. Unë sjell te ju prova të fuqishme.

[20] "Kërkoj strehim te Zotëruesi im dhe Zotëruesi juaj, nëse më kundërshtoni.

[21] "Nëse nuk dëshironi të besoni, atëherë thjeshtë lërmëni rehat."

[22] Më pas, ai iu përgjërua Zotëruesit të tij: "Këta janë njerëz shpirtligj."

[23] (Zoti tha,) "Udhëto me shërbëtorët e Mi gjatë natës; do të ndiqeni.

[24] "Kalonie detin shpejt; trupat e tyre do të mbyten."

[25] Kështu, ata lan pas shumë kopshte dhe burime.

[26] Të mbjella dhe jetë luksoze.

[27] Bekime që i gëzonin.

[28] Të gjitha këto ne i bëmë të trashëgohen nga njerëz të tjerë.

[29] As qielli, as toka nuk qau për ta, dhe atyre nuk iu shty afati.

[30] Ndërkohë, i shpëtuam Fëmijët e Izraelit nga keqtrajtimi poshtërues.

[31] Nga Faraoni; ai ishte tiran.

[32] I kemi zgjedhur ata nga mesi i të gjithë njerëzve, me qëllim.

[33] U treguam atyre aq shumë prova, të cilat përbënin një test të madh.

Pritni pasojat e njëjta

[34] Gjeneratat e tanishme thonë,

[35] "Ne vetëm vdesim vdekjen e parë; kurrë nuk do të ringjallemi!

[36] "Ktheni stërgjyshërit tanë, nëse jeni të sinqertë."

* 44:10 Vetëm dy shenja kanë mbetur për tu përmbushur, ky tym dhe Gogu dhe Magogu (Shtojca 25).

[37] A janë ata më të mirë se njerëzit e Tubas dhe të tjerët para tyre? Ne i asgjësuam ata për krimet e tyre.

[38] Nuk i krijuam qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë mes tyre, sa për lojë.

[39] I krijuam ato për një qëllim të posaçëm, por shumica e tyre nuk dinë.

[40] Dita e Vendimit i pret të gjithë ata.

[41] Ajo është dita kur asnjë shok nuk mund t'i ndihmojë shokut të vet në asnjë mënyrë; askush nuk mund të ndihmohet.

[42] Vetëm ata që arrijnë mëshirë nga Zoti. Ai është i Plotfuqishmi, i Mëshirshmi.

Mosbesimtarët

[43] Padyshim, lisi i hidhërimit -

[44] do të furnizojë ushqimin për mëkatarët.

[45] Si finjë, do të vlojë në barqe.

[46] Sikur vlimi i pijeve të ferrit.

[47] Merrnie atë dhe hidhnie në qendër të Ferrit.

[48] Pastaj derdhni mbi kokën e tij ndëshkimin e Vlimit.

[49] "Shijojë këtë; t'i ishe shumë i fuqishëm, shumë i nderuar."

[50] Kjo është çka dikur e dyshoje.

Të Drejtis

[51] Të drejtis do të jenë në pozitë të sigurt.

[52] Duke gëzuar kopshte dhe burime.

[53] Duke veshur kadife dhe saten; afër njëri tjetrit.

[54] U japim atyre bashkëshorte të mrekullueshme.

[55] Ata gëzojnë aty të gjitha llojet e frutave, në paqe të përsosur.

Të drejtis nuk vdesin vërtetë

[56] Ata nuk shijojnë vdekje aty – veç vdekjes së parë* - dhe Ai i kurseu ata nga ndëshkimi i Ferrit.

[57] I tillë është bekimi nga Zotëruesi yt. I tillë është triumfi i madh.

[58] Ne kështu e kemi sqaruar atë në gjuhën tënde, që të mund të marrin vesh.

[59] Prandaj, prit; edhe atyre do iu duhet të presin.

Surja 45: Gjunjëzimi (El-Xhathije)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.

[2] Shpallja e këtij shkrimi është prej Zotit, të Plotfuqishmit, Më të Mençurit.

[3] Qiejt dhe toka janë plot prova për besimtarët.

[4] Gjithashtu në krijimin tuaj, dhe krijimin e të gjitha kafshëve, ka prova për njerëz që janë të sigurt.

[5] Gjithashtu, ndryshimi i natës dhe ditës, dhe furnizimet që Zoti zbret nga qielli për të ngjallur tokë të vdekur, dhe manipulimi i erërave; të gjitha këto janë prova për njerëzit që kuptojnë.

Cilin hadith?

[6] Këto janë shpalljet e Zotit që t'i recitojmë ty sinqerisht. Në cilin Hadith tjetër pos Zotit dhe shpalljeve të Tij besojnë ata?

* 44:56 Siç detajohet në Shtojcën 17, të drejtis nuk vdesin vërtetë; ata shkojnë drejtë në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva dikur jetuan. Krahasoni këtë pohim me pohimin e mosbesimtarëve në 40:11.

[7] Mjerë çdo trillues, fajtor.*

[8] Ai që i dëgjon shpalljet e Zotit t'i recitohen atij, pastaj insiston me mendjemadhësi në rrugën e tij, sikur të mos i ketë dëgjuar kurrë. Premtoi atij ndëshkim që dhemb.

[9] Kur ai mëson ndonjë gjë në lidhje me shpalljet tona, ai i tallë ato. Këta kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[10] Duke i pritur ata është Xhehenemi. Çka mbledhën nuk do i ndihmojë ata, as idhujt që i kishin ngritur përkrah Zotit. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të tmerrshëm.

[11] Ky është fener, dhe ata që nuk besojnë në këto shpallje nga Zotëruesi i tyre kanë vetëshkaktuar mallkim dhe ndëshkim që dhemb.

[12] Zoti është Ai që e parashtrori detin në shërbimin tuaj, ashtu që anijet të mund të enden nëpër të në përputhje me ligjet e Tij. Ju pra kështu kërkonte furnizimet e Tij, që të mund të jeni mirënjohës.

[13] Ai e parashtrori në shërbimin tuaj çdo gjë në qiej dhe tokë; e gjithë prej Tij. Këto janë prova për njerëzit që pasqyrojnë.

[14] Thuaju atyre që besojnë t'i falin ata që nuk i presin ditët e Zotit. Ai do të paguaj secilin për çfarëdo që kanë mbledhur.

[15] Kushdo që punon drejtësi bën ashtu për të mirën e vet, dhe kushdo që punon të këqija bën ashtu në dëm të vet. Te Zotëruesi juaj do të ktheheni.

[16] I kemi dhënë Fëmijëve të Izraelit shkrimin, mençuri, dhe profetllëk, dhe i kemi furnizuar ata me furnizime të mira; ne kemi dhuruar mbi ta më shumë bekime sesa mbi cilindo popull tjetër.

[17] U kemi dhënë atyre këtu urdhra të qarta. Për ironi, ata nuk e polemizuan këtë derisa u erdhi njohuria. Kjo është për shkak të xhelozisë nga ana e tyre. Padyshim, Zotëruesi yt do i gjykojë ata në Ditën e Ringjalljes në lidhje me gjithçka që kanë polemizuar.

[18] Ne pastaj të caktuam ty që të vësh ligjet e sakta; ta ndjekësh këtë, dhe mos shko pas dëshirave të atyre që nuk dinë.

[19] Ata nuk mund të të ndihmojnë ty aspak kundër Zotit. Janë shkelësit ata që e shoqërojnë veten me njëri tjetrin, përderisa Zoti është Zotëruesi i të drejtëve.

[20] Ky furnizon ndriçime për njerëzit, dhe udhëzim, dhe mëshirë për ata që janë të sigurt.

[21] A presin ata që punojnë të këqija që ne do i trajtojmë në të njëjtën mënyrë si ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë? A mund jeta dhe vdekja e tyre të jetë e njëjtë? Vërtetë gabim është gjykimi i tyre.

[22] Zoti krijoi qiejt dhe tokën për një qëllim të posaçëm, për të paguar secilin shpirt për çfarëdo që ka mbledhur, pa as më të voglën padrejtësi.*

Formë e zakonshme e idhujtarisë: Egoja si zot

[23] A e ke vënë re atë zot i të cilit është egoja e vet? Si pasojë, Zoti e dërgon atë në humbje, përkundër njohurisë së tij, ia mbyll dëgjimin dhe mendjen, dhe vë mbulesë në sytë e tij. Kush pra mund ta udhëzojë atë, pas një vendimi të tillë nga Zoti? A nuk doni të merrni vesh?

[24] Ata thanë, "Ne vetëm jetojmë këtë jetë; jetojmë dhe vdesim dhe vetëm koha e shkakton vdekjen tonë!" Ata nuk kanë asnjë njohuri të sigurt për këtë; vetëm hamenden.

* 45:6-7 Zoti mallkon "Hadithin" me emër, dhe na informon që është trillim blasfemues.

* 45:21 Ne tash e kuptojmë që të drejtët nuk vdesin vërtetë - ata shkojnë drejtë e në Parajsë (16:32) – përderisa të padrejtët rrehen keq nga engjëjt e vdekjes (8:50 & 47:27).

* 45:22 Zoti na dhuroi neve këtë jetë si shans të çmuar që ta shpengojmë veten, ta mohojmë aleancën e lashtë me Dreqin, dhe t'i ribashkohemi mbretërisë së Zotit. Shih Hyrjen dhe Shtojcën 7.

[25] Kur shpalljet tona iu recitohen atyre, qartë, argumenti i tyre i vetëm është të thonë, “Kthëna stërgjyshërit, nëse jeni të sinqertë.”

[26] Thuaj, “Zoti ju ka dhuruar juve jetë, pastaj Ai ju vë në vdekje, pastaj Ai do t’ju mbledhë te Dita e Ringjalljes, e cila është e pashmangshme. Por shumica e njerëzve nuk dinë.”

[27] I Zotit është i gjithë sovraniteti i qiejve dhe tokës. Ditën kur Orës (Gjykimit) i vjen koha, atëherë humbin ata që shtihen.

Gjunjëzimi

[28] Do të shohësh çdo shoqëri duke u gjunjëzuar. Çdo shoqëri do të thirret që ta shohë regjistrin e vet. Sot, paguheni për çdo gjë që keni bërë.

[29] Ky është regjistri ynë; e shprehë të vërtetën për ju. Kemi regjistruar çdo gjë që bëtë.

[30] Sa për ata që besojnë dhe punojnë drejtësi, Zotëruesi i tyre do i pranojë në mëshirën e Tij. Ky është triumfi i madh.

[31] Sa për ata që nuk besojnë: “A nuk ju recituan juve shpalljet e Mia, por u bëtë mendjemëdhenj dhe ishit njerëz shpirtligj?”

[32] Kur deklarohet që premtimi i Zotit është e vërteta dhe që Ora (e Gjykimit) është e pashmangshme, ju thatë, “Ne nuk dimë çka është Ora! Jemi plot hamendje për të; nuk jemi të sigurt.”

[33] Të këqijat e punëve të tyre do tu dalin në shesh atyre, dhe pikërisht ato që i tallnin do tu kthehen për t’i kapluar.

[34] Do të deklarohet: “Sot ju harrojmë juve, ashtu si ju e harruat takimin e kësaj dite. Vendbanim i juaji është zjarri, dhe nuk do të keni asnjë ndihmues.

[35] “Kjo është sepse i morët shpalljet e Zotit si të kota, dhe ishit të preokupuar me jetën e parë.” Si pasojë, ata kurrë nuk do të dalin nga ferri, as nuk do të shfajësohen.

[36] Zotit i takon i gjithë lavdërimi; Zotëruesi i qiejve, Zotëruesi i tokës, Zotëruesi i gjithësisë.

[37] Atij i takon e gjithë epërsia në qiej dhe tokë. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Surja 46: Kodrat e rërës (El-Ahkaf)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] H. M.

[2] Shpallja e këtij shkrimi është nga Zoti, i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[3] Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë mes tyre përveç për një qëllim specifik, dhe për një afat kohor të kufizuar. Ata që nuk besojnë janë plotësisht të pavëmendshëm për paralajmërimet që u janë dhënë atyre.

[4] Thuaj, “Merrni parasysh idhujt që i keni ngritur përkrah Zotit. Më tregoni çka në tokë ata krijuan. Mos është një pjesë e qiejve e tyre? Më tregoni ndonjë shkrim tjetër para këtij, apo ndonjë pjesë të njohurisë së vërtetuar që përkrahë idhujtarinë tuaj, nëse jeni të sinqertë.”

Idhujt nuk e dinë aspak

[5] Kush është më larg në humbje se ata që idhujtarizojnë përkrah Zotit idhujt që nuk mund t’iu përgjigjen atyre deri në Ditën e Ringjalljes, dhe nuk e dinë aspak që po adhurohen?

Idhujt i mohojnë adhuruesit e tyre

[6] Dhe kur njerëzit të mblidhen (Ditën e Gjykimit), idhujt e tyre do të bëhen armiqtë e tyre, dhe do e mohojnë adhurimin e tyre.*

* 46:6 Shih gjithashtu Mateu 7:21-23: Jezusi qartë i mohon ata që e thërrasin atë “Zot.”

[7] Kur shpalljet e jona iu recituan atyre, krejtësisht të qarta, ata që nuk besuan thanë për të vërtetën që erdhi te ta, “Kjo është qartazi magji!”

[8] Kur ata thonë, “Ai e trilloi këtë,” thuaj, “Nëse e trillova, atëherë ju nuk mund të më mbroni nga Zoti. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që planifikoni. Ai mjafton si dëshmitar mes meje dhe jush. Ai është Falësi, i Mëshirshmi.”

[9] Thuaj, “Unë nuk jam ndryshe nga të dërguarit e tjerë. Nuk e di aspak se çka do të më ndodhë mua apo juve. Unë vetëm ndjekë çka më është shpallur mua. Nuk jam asgjë më shumë se një paralajmërues i qartë.”

Rabini Juda Besimtari

[10] Thuaj, “Çka nëse është prej Zotit dhe ju nuk besuat në të? Një dëshmitar prej Fëmijëve të Izraelit ka qenë dëshmitar i një fenomeni të ngjashëm,* dhe ai ka besuar, përderisa ju jeni bërë mendjemëdhenj. Padyshim Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.”

[11] Ata që nuk besuan thanë për ata që besuan, “Sikur të ishte diçka e mirë nuk do e pranonin atë para nesh.” Ata thanë, “Ky është trillim i lashtë!” sepse nuk ishin të udhëzuar kah ai.

[12] Para kësaj, libri i Moisiut furnizoi udhëzim dhe mëshirë. Ky gjithashtu është shkrim që konfirmon, në arabisht, për të paralajmëruar ata që shkelën, dhe për t’iu dhënë myzhde të drejtëve.

Myzhde

[13] Padyshim, ata që thonë, “Zotëruesi ynë është Zoti,” pastaj çojnë jetë të drejtë, nuk kanë pse të frikësohen, as nuk do të brengosen.

[14] Ata kanë merituar Parajsë, ku qëndrojnë përgjithmonë; shpërblim për punët e tyre.

40: Mosha e vendimit

[15] E urdhëruam njeriun që t’i nderojë prindërit e tij. Nëna e tij e barti rëndë, e lindi rëndë, dhe u kujdes nga afër për të për tridhjetë muaj. Kur ai arrin pjekurinë, dhe arrin moshën dyzet vjeçare,* ai duhet të thotë, “Zotëruesi im, më drejto të çmoj bekimet që Ti ke dhuruar mbi mua dhe mbi prindërit e mi, dhe të bëj punët e drejta që të kënaqin Ty. Le të jenë edhe fëmijët e mi të drejtë po ashtu. Jam penduar te Ti; Unë jam i nënshtruar.”

[16] Prej tyre i pranojmë punët e drejta dhe ua tejkalojmë mëkatet. Ata kanë merituar Parajsë. Ky është premtimi i vërtetë që u është premtuar atyre.

[17] E ai që u thotë prindërve të vet, “Mjerë ju; a po më tregoni mua që (pas vdekjes) do të kthehem prapë në jetë? E si atëherë ata që vdiqën para nesh nuk kthehen?” Prindërit do të qanin për ndihmën e Zotit dhe të thoshin, “Mjerë ti; të lutem beso! Premtimi i Zotit është e vërteta.” Ai do të thoshte, “Përralla të moçme!”

[18] Ata janë vulosur si mosbesimtarë mes çdo gjenerate të xhinëve dhe njerëzve; janë humbës.

[19] Ata të gjithë arrijnë rangjet që i kanë merituar, në përputhje me punët e tyre. Ai do i paguaj ata për punët e tyre, pa as më të voglën padrejtësi.

[20] Do të vij dita kur ata që nuk besuan do të parashtrihen në zjarr: “I shkuat kot shanset e mira që ju dhanë juve gjatë jetës suaj të botës, dhe u ngazëllyet me to. Si pasojë, sot ju pësoni ndëshkim

* 46:10 Ky dëshmitar është Rabini Juda Besimtari (Shekulli i XI Pas Lindjes së Krishtit), që zbuloi kodin e njëjtë matematikor të bazuar në 19 në fragmente të pacenuara të shkrimit (shih Shtojcën 1).

* 46:15 Zoti e din fare mirë kush meriton të shkojë në Parajsë dhe kush meriton të shkojë në Ferr. Është ligj i tij që këdo që Ai e vë në vdekje para moshës 40 vjeçare të shkojë në Parajsë. Mëshira e jashtëzakonshme e Zotit pasqyrohet në faktin që shumica e njerëzve kanë vështirësi që ta pranojnë këtë mëshirë hyjnore; ata argumentojnë: “Futni në Ferr!” Shih Shtojcën 32.

të turpshëm si pagesë për mendjemadhësinë që kryet në tokë pa asnjë bazë, dhe për punët e juaja të këqija.”

Hudi

[21] Kujtohuni që vëllai i Adit i paralajmëroi njerëzit e tij te kodrat e rërës – paralajmërimet e shumta gjithashtu ishin dërguar para tij dhe pas tij: “Të mos adhuronit përveç Zotit. Kam frikë për ju ndëshkimin e një dite të madhe.”

[22] Ata thanë, “A ke ardhur të na largosh nga zotat tanë? Ne të sfidojmë ty të sjellësh (ndëshkimin) me të cilin na kërcënon, nëse je i sigurtë.”

[23] Ai tha, “Njohuria për këtë është me Zotin; Unë veç po ju dorëzoj juve çka u dërgova të dorëzoj. Megjithatë, e shoh se ju njerëz jeni të padijshëm.”

[24] Kur e panë stuhinë duke shkuar kah ata, thanë, “Kjo stuhi do të na sjellë shumë shi të nevojshëm.” Jo, kjo është çka e sfidonit (Hudin) të sjellë; erë të fortë ku ka ndëshkim që dhemb.

[25] Shkatërroi çdo gjë, si u komandua nga Zotëruesi i saj. Në mëngjes, asgjë nuk shihej përveç shtëpive të tyre. Kështu i paguajmë njerëzit fajtorë.

I përqeshën paralajmërimet e të dërguarit

[26] I patëm vënë ata në të njëjtën mënyrë si ju vumë juve, dhe i furnizua ata me dëgjim, sy, dhe mendje. Por dëgjimi, sytë, dhe mendjet e tyre nuk iu ndihmuan aspak, sepse ata vendosën t’i shpërfillin shpalljet e Zotit. Kështu, profecitë dhe paralajmërimet që ata i kishin përqeshur e kanë shkaktuar përfundimin e tyre.

[27] Kemi asgjësuar shumë shoqëri rreth jush, pasi që i patëm shpjeguar provat, që të mund të pendohen.

[28] Pse atëherë idhujt që i ngritën për t’i sjellë më afër Zotit nuk arritën t’iu ndihmojnë atyre? Në fakt, ata i braktisën ata. Të tillë ishin zotat e rremë që ata idolizuan; të tilla ishin shpikjet që ata trilluan.

Besimtarë mes xhinëve

[29] Kujtohu që drejtuam një numër xhinësh te ti, në mënyrë që t’i lëmë ata të dëgjojnë Kurandin. Kur ata arritën atje, thanë, “Dëgjoni.” Sapo mbaroi, ata vrapuan te njerëzit e tyre, duke paralajmëruar.*

[30] Ata thanë, “O njerëzit tanë, kemi dëgjuar një libër që u shpall pas Moisiut, dhe konfirmon shkrimet paraprake. Udhëzon te e vërteta; te rruga e drejtë.

[31] “O njerëzit tanë, përgjigjuni thirrjes së Zotit, dhe besoni në Të. Ai pastaj do t’ju falë mëkatet tuaja, dhe t’ju kursejë nga ndëshkimi që dhemb.”

[32] Ata që nuk arrijnë t’i përgjigjen thirrjes së Zotit nuk mund të shpëtojnë, dhe nuk do të kenë asnjë Zotërues tjetër përveç Tij; ata kanë shkuar shumë larg në humbje.

[33] A nuk e kuptojnë ata që Zoti, që krijoi qiejt dhe tokën pa u munduar aspak, është i zoti t’i ngjallë të vdekurit? Po vërtetë; Ai është i Gjithëfuqishëm.

[34] Ditën kur mosbesimtarët parashtrohen në Zjarr, ata do të pyeten, “A nuk është kjo e vërteta?” Ata do të përgjigjen, “Po vërtetë, pasha Zotëruesin tonë.” Ai do të thotë, “Atëherë vuanie ndëshkimin se nuk besuat.”

* 46:29 Xhinët janë krijesat që u pajtuan plotësisht me Dreqin kur ai e filloi blasfeminë e famshme të tij biliona vjet më parë. Ata janë të sjellë në këtë botë si pasardhës të Dreqit. Një xhin është i lindur sa herë që një qenie njerëzore është e lindur. Xhini i sapo lindur caktohet te i njëjti trup si njeriu i sapo lindur, dhe vazhdimisht nxit pikëvështrimin e Dreqit (Shtojca 7).

*I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes**

[35] Prandaj, ji i durueshëm si të dërguarit para teje që poseduan forcë dhe u mbajtën me durim. Mos u ngut që ta shohësh ndëshkimin që do tu vij atyre patjetër. Ditën kur ata e shohin atë, do tu duket sikur të kenë zgjatur një orë të ditës. Kjo është shpallje: A nuk janë shpirtligjtë që po asgjësohen vazhdimisht?

Surja 47: Muhamedi (Muhammed)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Ata që nuk besojnë dhe zbrapsin nga rruga e Zotit, Ai ua asgjëson punët e tyre.
- [2] Ata që besojnë dhe punojnë drejtësi, dhe besojnë në çka i është zbritur Muhamedit - që është e vërteta nga Zotëruesi i tyre – Ai ua heqë mëkatet e tyre, dhe i bekon me kënaqësi.
- [3] Kjo është për shkak se ata që nuk besojnë po ndjekin pavërtetësi, përderisa ata që besojnë po ndjekin të vërtetën nga Zotëruesi i tyre. Zoti kështu i përmend për njerëzit shembujt e tyre.
- [4] Nëse ndeshesh (në luftë) me ata që nuk besojnë, mund t'i godasësh në qafë. Nëse i merr si rob lufte mund t'i lirosh pa ose me pagesë, derisa të përfundojë lufta. Sikur të donte Zoti, Ai do t'ju kishte dhuruar juve fitore, pa luftë. Por Ai ju teston me njëri tjetrin. Sa për ata që vriten në rrugën e Zotit, Ai nuk do e shkojë kot sakrificën e tyre.
- [5] Ai do i udhëzojë ata, dhe do i bekojë me qetësim shpirtëror.
- [6] Ai do i pranojë ata te Parajsa, që Ai ua përshkroi.
- [7] O ju që besoni, nëse e përkrahni Zotin, Ai do t'ju përkrahë juve, dhe t'ju përforcojë këmbët.
- [8] Ata që nuk besojnë vetëshkaktojnë vuajtje; Ai i bën punët e tyre të jenë krejtësisht të kota.
- [9] Sepse ata urryen çka Zoti shpalli dhe si pasojë, Ai asgjëson punët e tyre.
- [10] A nuk u endën nëpër tokë dhe panë pasojat që pësuan ata para tyre? Zoti i shkatërroi punët e tyre; të gjithë mosbesimtarët do të vuajnë fatin e njëjtë.
- [11] Kjo është për shkak se Zoti është Zotëruesi i atyre që besuan, përderisa mosbesimtarët nuk kanë asnjë zotërues.
- [12] Zoti i pranon ata që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë në kopshte me prroje që rrjedhin. Sa për ata që nuk besojnë, ata jetojnë dhe hanë si hanë kafshët, pastaj përfundojnë në zjarr.
- [13] Sa e sa shoqëria ishte më e fortë se shoqëria që të dëboi ty nga qyteti yt; kur ne i asgjësua, askush nuk mund t'i ndihmonte ata.
- [14] A janë ata të ndriçuarit nga Zotëruesi i tyre njëjtë si ata punët e këqija të të cilëve janë të zbukuruara në sytë e tyre, dhe i ndjekin mendimet e tyre?
- [15] Alegoria e Parajsës që premtohet për të drejtë është kjo: ka lumenj me ujë të kthjellët, dhe lumenj qumështi të freskët, dhe lumenj vere – të shijshme për pirësit – dhe lumenj mjalti të kulluar. Ata kanë të gjitha llojet e frutave aty, dhe falje nga Zotëruesi i tyre. (A janë ata më mirë) apo ata që qëndrojnë përgjithmonë në zjarr, dhe pijnë ujë ferri që ua shqyen zorrët?
- [16] Disa prej tyre të dëgjojnë ty, pastaj sapo të largohen i pyesin ata që u ndriçuan, “Çka deshi të thotë ai?” Zoti kështu i mbyllë zemrat e tyre dhe, si pasojë, ata ndjekin vetëm mendimet e tyre.
- [17] Sa për ata që janë të udhëzuar, Ai ua shton udhëzimin, dhe ua dhuron drejtësinë.

Fundi i botës

* 46:35 Evidenca Kuranore dhe matematikore vërteton që i dërguari i adresuar këtu është Rashad Khalifa. Duke e mbledhur vlerën gormore të “Rashad Khalifa” (1230), dhe numrin e sures (46), dhe numrin e strofës (35), marrim 1311, ose 19x69. Kjo është në përputhje me kodin e Kuranit (Sht. 2).

[18] A po presin ata derisa tu vij Ora atyre papritmas? Të gjitha shenjat për të veç kanë ardhur.* Kur tu vij Ora atyre, si do të kenë dobi nga lajmi i tyre?

*La Ilahë Illa Allah: Urdhri i parë**

[19] Ta dish që: “Nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Zotit,” dhe kërko falje për mëkatet tua dhe mëkatet e të gjithë besimtarëve dhe besimtareve. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për vendimet tuaja dhe fatin tuaj përfundimtar.

Ekspozimi i hipokritëve

[20] Ata që besuan thanë: “Kur do të shpallet një sure e re?” Por kur një sure u shpall, ku haptas u përmend luftimi, do i shihje ata që ushqyen dyshime në zemrat e tyre duke të shikuar ty, sikur vdekja tashmë të kishte ardhur te ta. Ata kështu u ekspozuan.

Provë e besimit gjatë epokës së Muhamedit

[21] Bindje dhe shprehje të drejta priten prej tyre. Vetëm sikur të tregonin besim në Zotin, kur u bë thirrje për mobilizim, do të kishte qenë më mirë për ta.

[22] A është gjithashtu qëllimi juaj që sapo të largoheni të kryeni të këqija dhe t’i keqtrajtoni të afërmit tuaj?

[23] Janë ata që vetëshkaktuan mallkim nga Zoti, me të cilin ai i bën të shurdhër dhe të verbër.

Studioje Kuranin

[24] Pse nuk e studiojnë Kuranin me kujdes? A kanë dry në mendjet e tyre?

[25] Padyshim, ata që tërhiqen prapa, pasi që udhëzimi u është shfaqur atyre, djalli i ka joshur dhe i ka tërhequr për kapistre.

[26] Kjo është për shkak se ata u thanë atyre që urrenin çka Zoti kishte zbritur, “Ne do t’ju bindemi juve në çështje të caktuara.” Zoti i di plotësisht fshehtësitë e tyre.

[27] Si do të jetë për ta kur engjëjt i vënë në vdekje? Do i rrahin në fytyrat e tyre dhe prapanicat e tyre.

[28] Kjo është për shkak se ata ndoqën çka zemëroi Zotin dhe urreyen gjërat që e kënaqin Atë. Si pasojë, Ai i ka asgjësuar punët e tyre.

[29] A menduan ata që ushqejnë dyshime në zemrat e tyre që Zoti nuk do i nxjerrë jashtë mendimet e tyre të këqija?

[30] Nëse dëshirojmë, mund t’i ekspozojmë për ty, që të mund t’i njohësh vetëm duke i shikuar. Megjithatë, mund t’i njohësh nga mënyra e të folurit. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha punët tuaja.

[31] Patjetër do t’ju vëmë në test, për të dalluar ata mes jush që përpiqen, dhe durojnë me këmbëngulje. Duhet t’i ekspozojmë cilësitë tuaja të vërteta.

[32] Ata që nuk besojnë dhe zbrapsin nga rruga e Zotit, dhe kundërshtojnë të dërguarin pasi që udhëzimi u është shfaqur atyre, nuk e dëmtojnë Zotin aspak, e Ai i asgjëson punët e tyre.

[33] O ju që besoni, t’i bindeni Zotit, dhe t’i bindeni të dërguarit. Përndryshe, të gjitha punët tuaja do të jenë të kota.

Katastrofa e madhe

[34] Ata që nuk besojnë dhe zbrapsin nga rruga e Zotit, pastaj vdesin si mosbesimtarë, Zoti nuk

* 47:18 Kurani, duke qenë Besëlidhja e Fundit, furnizon të gjitha shenjat e nevojshme për ta gjetur fundit e botës; 2280 Pas Lindjes së Krishtit. Shih Shtojcën 25 për hollësitat.

* 47:19 “Shtylla e Parë” e fesë thuhet në suren e titulluar Muhamed, dhe i është kushtuar krejtësisht vetëm Zotit. Emri i Muhamedit ishte shtuar nga idhujtarët e tij, kundër vullnetit të tij.

do i falë.

[35] Prandaj, të mos luhateni dhe të mos dorëzoheni në kërkim të paqes, se u është garantuar fitorja, dhe Zoti është me ju. Ai nuk do i shkojë kot përpjekjet tuaja.

[36] Jeta e kësaj bote nuk është asgjë më shumë se lojë dhe kotësi. Por nëse besoni dhe çoni jetë të drejtë, Ai do t'ju shpërblejë, pa ju kërkuar aspak para.

[37] Po t'ju kërkonte Ai para, deri në atë masë sa që të krijonte vështirësi për ju, mund të ishit bërë dorështrënguar, dhe e keqja juaj e brendshme mund të ekspozohet.

*Paralajmërim arabëve**

[38] Ftoheni që të shpenzoni në rrugën e Zotit, por disa prej jush bëheni dorështrënguar. Dorështrënguarit janë dorështrënguar ndaj shpirtrave të vet. Zoti është i Pasur, përderisa ju jeni të varfër. Nëse refuzoni, Ai do të zëvendësojë njerëz të tjerë në vendin tuaj, dhe ata nuk do të jenë si ju.

Surja 48: Fitore (El-Fet'h)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Kemi dhuruar mbi ty (o i dërguar) fitore të madhe.*

[2] Me të cilën Zoti falë mëkatet tua të mëparshme, si dhe mëkatet e ardhshme, dhe përkryen bekimet e Tij mbi ty dhe të udhëzon në rrugë të drejtë.

[3] Plus, Zoti do të të përkrahë me përkrahje të paluhatshme.

[4] Ai është Ai që vë qetësim në zemrat e besimtarëve për të shtuar më shumë besim, plus besimit të tyre. Të Zotit janë të gjitha forcat e qiejve dhe tokës. Zoti është i Gjithëdijsëm, Më i Mençuri.

[5] Ai padyshim do i pranojë besimtarët dhe besimtare në kopshte me prroje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë. Ai do t'ua falë mëkatet e tyre. Kjo është, para Zotit, triumf i madh.

[6] Dhe Ai do i paguaj hipokritët dhe hipokritet dhe adhuruesit e idhujve dhe adhurueset e idhujve, se ata kanë ushqyer mendime të këqija për Zotin. E keqja e tyre do të kthehet kundër tyre. Se Zoti është i zemëruar me ta, i mallkon ata, dhe ka përgatitur për ta Xhehenem. Çfarë fati i tmerrshëm!

[7] Të Zotit janë të gjitha forcat në qiej dhe tokë. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[8] Të dërguam ty si dëshmitar, si bartës të lajmeve të mira, dhe paralajmërues.

[9] Që ju njerëz të mund të besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe ta respektoni Atë, dhe t'ia keni dronë Atij, dhe ta madhëroni Atë, ditë e natë.

Ta përkrahni të dërguarin e Zotit

[10] Padyshim, ata që betohen për besnikëri ndaj teje, betohen për besnikëri ndaj Zotit. Zoti e miraton betimin e tyre; Ai e vë dorën e Tij mbi duart e tyre. Ata që shkelin një betim të tillë, e kryejnë shkeljen në dëm të vetvetes. Sa për ata që e përmbushin betimin e tyre me Zotin, Ai do iu dhurojë atyre shpërblim shumë të madh.

[11] Ndenjësit arab që rrinë mbrapa do të thonë, "Kemi qenë të preokupuar me paratë tona dhe familjet tona, pra kërko falje për ne!" Ata shprehin me gjuhët e tyre çka nuk është në zemrat e tyre. Thuaj, "Kush mund t'ju mbrojë juve nga Zoti, nëse Ai dëshiron ndonjë vështirësi për ju, ose nëse Ai dëshiron ndonjë bekim për ju? Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

* 47:38 Kurani iu dha arabëve, në gjuhën e tyre, për 1400 vjet, por ata qartë e refuzuan atë dhe refuzuan të besojnë që është komplet; ata trilluan Hadith dhe Sunet.

* 48:1 Ky pohim i thellë përbëhet nga 19 shkronja, duke treguar që gjenerata jonë është gjenerata e fitores për fenë e pastruar, dhe të bashkuar të Zotit – Nënshtrimin (3:19, 85). Është gjenerata jonë që ishte dëshmitare e zbulimeve të mrekullisë së madhe të Zotit në Kuran (Shtojca 1).

[12] Ju besuat fshehtë që i dërguari dhe besimtarët do të mposhten dhe të mos kthehen kurrë te familjet e tyre, dhe kjo ishte ngulur fort në zemrat tuaja. Ju ushqyet mendime djallëzore dhe u bëtë njerëz shpirtligj.

[13] Kushdo që refuzon të besojë në Zotin dhe të dërguarin e Tij, ne kemi përgatitur për mosbesimtarët zjarr.

[14] I Zotit është sovraniteti i qiejve dhe tokës. Ai falë këdo Ai do, dhe ndëshkon këdo Ai do. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[15] Ndenjësit që rrinë mbrapa do të thonë, kur pritet që t'i mblidhni plaçkat e luftës, "Le të vijmë pas jush që të marrim edhe ne diçka!" Ata kështu dëshirojnë t'i ndryshojnë fjalët e Zotit. Thuaj, "Ju nuk do të na ndiqni neve. Ky është vendimi i Zotit." Ata pastaj do të thonë, "Na paskeni zili (se ndenjëm mbrapa)." Ata rrallë kuptuan ndonjë gjë.

Testi për gjeneratat e hershme

[16] Thuaju arabëve ndenjës që rrinë mbrapa, "Do të ftoheni të përballeni me njerëz të fuqishëm dhe t'i luftoni ata, në mos u nënshtrofshin. Nëse bindeni, Zoti do t'ju shpërblejë me shpërblim bujar. Por nëse refuzoni prapë, siç bëtë në të kaluarën, ai do t'ju paguaj me ndëshkim që dhemb."

[17] I verbëri nuk ka për tu fajësuar, sakati nuk ka për tu fajësuar, dhe i sëmuri nuk ka për tu fajësuar. Ata që i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij, Ai do i pranojë në kopshte me proje që rrjedhin. Sa për ata që refuzojnë, Ai do i paguajë me ndëshkim që dhemb.

[18] Zoti është i kënaqur me besimtarët që u betuan nën lis për besnikëri ndaj teje. Ai e dinte çka kishte në zemrat e tyre dhe, si pasojë, Ai i bekoj me qetësim shpirtëror, dhe i shpërbleu me fitore të menjëhershme.

[19] Plus, ata përfituan shumë plaçka. Zoti është i Plotfuqishëm, Më i Mençuri.

[20] Zoti ka premtuar për ju shumë plaçka që do i fitoni. Ai kështu i ka përshpejtuar disa dobi për ju në këtë jetë, dhe ai ka ndaluar duart sulmuese të njerëzve kundër jush, dhe e ka bërë këtë shenjë për besimtarët. Ai kështu ju udhëzon në rrugë të drejtë.

[21] Sa për grupin që nuk kishit mundësi ta mposhtnit, Zoti u mor me ta; Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Fitorja e garantuar për besimtarët

[22] Po t'ju luftonin mosbesimtarët kurdoherë, ata do të ktheheshin mbrapa dhe të iknin. Ata nuk kanë asnjë Zotërues dhe Sundues; ata nuk kanë asnjë ndihmues.

[23] E tillë është metoda e Zotit përgjatë historisë, dhe do e gjeni se metoda e Zotit është e pandryshueshme.

[24] Ai është Ai që i pengoi duart sulmuese të tyre kundër jush, dhe pengoi duart tuaja sulmuese kundër tyre në luginën e Mekës, dhe pasi që ju kishte garantuar fitore mbi ta. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

[25] Janë ata që nuk besuan dhe ju penguan nga Vendlutja e Shenjtë, madje edhe i ndaluan ofertat tuaja të arrinin cakun e tyre. Kishte besimtarë dhe besimtare (brenda kampit të armikut) që nuk i njihnit ju, dhe ishit gati për t'i lënduar, pa e ditur. Zoti kështu pranon në mëshirën e Tij këdo që Ai do. Nëse këmbëngulin, Ai do i paguaj ata mes tyre që nuk besuan me ndëshkim që dhemb.

[26] Përderisa ata që nuk besuan u tërbuan, dhe zemrat e tyre ishin të mbushura me krenarinë e ditëve të injorancës, Zoti e bekoj të dërguarin e Tij dhe besimtarët me qetësim shpirtëror, dhe i drejtoi për t'iu përmbajtur fjalës së drejtë. Kjo është çka ata e merituan fare mirë. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[27] Zoti e ka përmbushur vizionin e vërtetë të të dërguarit të Tij: “Do të hyni te Vendlutja e Shenjtë, dashtë Zoti, krejtësisht të sigurt, dhe do i qethni flokët tuaja apo t’i shkurtoni (përderisa i përmbushni ritualet e shtegtimit) atje. Nuk do të keni aspak frikë. Pasi që Ai diti çka ju nuk ditët, Ai për më tepër ju dha një fitore të menjëhershme.”

*Profecia e madhe**

[28] Ai është Ai që e dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e së vërtetës, që ta bëjë atë të mbizotërojë mbi të gjitha fetë tjera. Zoti mjafton si dëshmitar.

Cilësitë e besimtarëve

[29] Muhamedi - i dërguari i Zotit – dhe ata me të janë të ashpër dhe të rreptë kundër mosbesimtarëve, por të dashur dhe të dhembshëm mes vete. I sheh ata duke u përkulur dhe përlurur, përderisa kërkojnë bekimet dhe miratimin e Zotit. Shenjat e tyre janë në fytyrat e tyre, sepse përlulen. Ky është shembulli i njëjtë si në Torah. Shembulli i tyre në Ungjill është si bimë që rriten më të gjata dhe më të forta, dhe i kënaqin bujqit. Ai kështu i tërbon mosbesimtarët. Zoti iu premtonte atyre mes tyre që besojnë, dhe çojnë jetë të drejtë, falje dhe shpërblim shumë të madh.

Surja 49: Muret (El-Huxhurat)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] O ju që besoni, mos e vendosni mendimin tuaj mbi atë të Zotit dhe të dërguarit të Tij. T’ia keni dronë Zotit. Zoti është Dëgjues, i Gjithëdijsëm.

[2] O ju që besoni, mos i ngritni zërat tuaj mbi zërin e profetit,* as të mos i bërtisni atij si i bërtisni njëri tjetrit, se mos bëhen punët tuaja të asgjësuar përderisa nuk e vëreni.

[3] Padyshim, ata që i ulin zërat e tyre ndaj të dërguarit të Zotit janë ata zemrat e të cilëve janë të përgatitura nga Zoti që të bëhen të drejta.* Ata kanë merituar falje dhe shpërblim shumë të madh.

[4] Sa për ata që të thërrasin nga jashtë mureve, shumica e tyre nuk kuptojnë.

[5] Sikur të ishin të durueshëm derisa të dilje te ta, do të ishte më mirë për ta. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

Heto thashethemet para se t’i besosh

[6] O ju që besoni, nëse ndonjë person shpirtlig sjell ndonjë lajm te ju, së pari ta hetoni, se mos kryeni padrejtësi ndaj disa njerëzve, nga padituria, pastaj bëheni pishman dhe ju bren ndërgjegjja për çka keni bërë.

[7] E tash që i dërguari i Zotit ka ardhur në mesin tuaj. Sikur t’ju dëgjonte ai në shumë gjëra, do i vështirësonit gjërat për vete. Por Zoti ju bëri ta doni besimin dhe e zbukuroi atë në zemrat tuaja, dhe ai ju bëri ta urreni mosbesimin, shpirtligësinë, dhe mosbindjen. Këta janë të udhëzuarit.

[8] E tillë është hirësi prej Zotit dhe bekimet e Tij. Zoti është i Gjithëdijsëm, Më i Mençuri.

Pajtoni besimtarët

[9] Nëse dy grupe besimtarësh luftuan me njëri tjetrin, t’i pajtoni ata. Nëse njëri grup sulmon kundër tjetrit, ta luftoni grupin sulmues derisa t’i nënshtrohen urdhrit të Zotit. Kur të nënshtrohen,

* 48:28 Kjo profeci e rëndësishme na njofton që Nënshtrimi do e dominojë dikur patjetër tërë botën. Kjo së bashku me Strofat 9:33, 41:53, dhe 61:9 nuk lënë asnjë dyshim që mrekullia matematikore e Zotit në Kuran do të luaj një rol madhor në këtë profeci. Shih Shtojcat 2 dhe 26 për dëshmitë dhe hollësitat e veçanta.

* 49:2 Sa herë që fjala “profet” (Nabi) përdoret duke iu referuar Muhamedit, ajo pa ndryshim i referohet atij gjatë jetës së tij, e jo pas vdekjes së tij. Qartazi, ne nuk mund t’i ngrisim zërat tonë mbi zërin e Muhamedit, tash që ai është i vdekur. Shih gjithashtu 33:56.

* 49:3 Respektimi i të dërguarit i ndihmon të jashtëmit dhe vizitorët për të ardhur te lajmi i Zotit.

t'i pajtoni dy grupet me barazi. Të mbani drejtësi. Zoti i do ata që janë të drejtë.

Familja e vërtetë

[10] Besimtarët janë anëtarë të një familjeje; ta mbani paqen brenda familjes suaj dhe t'ia keni dronë Zotit, që të mund të arrini mëshirë.

Besimtarët shembull

[11] O ju që besoni, asnjë grup njerëzish të mos i përqeshë grupin tjetër, se ata mund të jenë më të mirë se ta. As ndonjë grup grash të mos e përqeshë grupin tjetër të grave, se ato mund të jenë më të mira se to. As të mos e tallni njëri tjetrin, ose të talleni me emrat tuaj. I keq vërtetë është rikthimi në shpirtligësi pas arritjes së besimit. Kushdo që nuk pendohet pas kësaj, këta janë shkelësit.

Dyshimi është mëkat

[12] O ju që besoni, t'i shmangeni çfarëdo dyshimi, se edhe fare pak dyshim është mëkat. Të mos përgjoni njëri tjetrin, as të mos përgojoni njëri tjetrin; kjo është aq e neveritshme sa ngrënia e mishit të vëllait tuaj të vdekur. Ju pa dyshim e urreni këtë. T'ia keni dronë Zotit. Zoti është Shpengues, i Mëshirshëm.

Kriteri i vetëm për dallim mes njerëzve

[13] O njerëz, ju krijuam nga i njëjti mashkull dhe femër, dhe ju bëmë njerëz dhe fise të ndryshme, që të mund ta njihni njëri tjetrin. Më i miri mes jush para Zotit është më i drejti. Zoti është i Gjithëdijshëm, Njohës.

Mysliman apo Mu'min

[14] Arabët thanë, "Jemi Mu'min (besimtarë)." Thuaj, "Ju nuk keni besuar; ajo që duhet të thoni është, 'Jemi Mysliman (të nënshtruar),' derisa besimi të përforcohet në zemrat tuaja." Nëse i bindeni Zotit dhe të dërguarit të Tij, Ai nuk do t'jua shkojë kot asnjë nga punët tuaja. Zoti është Falësi, i Mëshirshmi.

[15] Mu'minët (besimtarët) janë ata që besojnë në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe e arrijnë gjendjen e të mos pasurit asnjë dyshim çfarëdo qoftë ai, dhe përpiqen me paratë e tyre, dhe jetët e tyre për Zotin. Këta janë të sinqertit.

[16] Thuaj, "A mos po e njoftoni Zotin për fenë tuaj? Zoti di çdo gjë në qiej dhe tokë. Zoti është i Gjithëdijshëm."

Kush po ia bën kujt të mirën?

[17] Ata sillen sikur po të bëjnë një të mirë duke e përqaftuar Nënshtrimin! Thuaj, "Ju nuk po më bëni mua asnjë të mirë duke e përqaftuar Nënshtrimin. Zoti është Ai që po ju bën juve një të mirë shumë të madhe duke ju udhëzuar në besim, nëse jeni të sinqertë."

[18] Zoti i di të gjitha të fshehtat në qiej dhe tokë; Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

Surja 50: K. (Kaf)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] K., dhe Kurani i madhërishtëm.*

[2] Atyre iu duk çudi që një paralajmërues prej mes tyre erdhi te ta! Mosbesimtarët thanë, "Kjo është vërtetë çudi;

[3] "Pasi që të vdesim dhe të bëhemi pluhur; kjo është e pamundur."

[4] Ne jemi tërësisht të vetëdijshëm për cilindo prej tyre që konsumohet nga toka; kemi regjistër të

* 50:1 Shih Shtojcën 1 për mrekullitë mbresëlënëse të ndërlidhura me inicialin "K."

saktë.

[5] Ata e refuzuan të vërtetën kur iu erdhi atyre; janë krejtësisht të hutuar.

[6] A nuk e kanë shikuar qiellin mbi ta, dhe si e ndërtoam dhe e stolisëm, pa asnjë të metë?

[7] Dhe e krijuam tokën, dhe shpërndamë mbi të male, dhe rritëm në të lloj lloj bimësh të bukura.

[8] Ky është ndriçim, dhe kujtesë për cilindo adhurues besimtarë.

[9] Dhe dërguam nga qielli ujë të bekuar, për të rritur me të kopshte dhe drithëra për tu korrur.

[10] Palma të gjata hurmash, me kalaveshë frutash.

[11] Furnizime për njerëzit. Dhe ngjallim me të tokat e vdekura; edhe ju ngjalleni ngjashëm.

[12] Duke mos besuar para tyre ishin njerëzit e Nuhut, banuesit e Resit, dhe Themudi.

[13] Dhe Adi, Faraoni, dhe vëllazëria e Lutit.

[14] Dhe banuesit e pyllit, dhe njerëzit e Tubas. Të gjithë ata nuk iu besuan të dërguarve dhe, si pasojë, ndëshkimi Im iu ra atyre.

[15] A mos ishim tepër të ngarkuar me krijimin e parë? A është kjo pse dyshojnë në ringjallje?

[16] E krijuam njeriun, dhe e dimë çka ai i pëshpëritë vetvetes. Ne jemi më afër tij se damari i qafës së tij.

[17] Dy (engjëj) që incizojnë, në të djathtë dhe në të majtë, janë duke incizuar vazhdimisht.

[18] Asnjë shprehje nuk e shpreh ai pa një dëshmitar vigilent.

[19] Më në fund, koma e pashmangshme e vdekjes vjen; kjo është ajo që përpiqeshe t'i shmangesh.

[20] I bihet bririt; kjo është dita e premtuar.

[21] Çdo shpirt vjen me një grahës dhe një dëshmitar.

[22] Ti ishe i pavëmendshëm për këtë. Tash ta heqim vellon tënde; sot, shikimi yt është (i mprehtë) si shigjetë.

[23] Shoqëruesi tha, "Ja ku është dëshmia ime e vështirë."*

[24] Flake në Xhehenem çdo mosbesimtar kokëfortë.

[25] Ndalues të bamirësisë, agresor, plot dyshime.

[26] Ai ngritë përkrah Zotit tjetër zot. Flake në ndëshkim të rreptë.

[27] Shoqëruesi i tij tha, "Zotëruesi ynë, unë nuk e çorientova; ai kishte humbur larg."

[28] Ai tha, "Mos u grindni para Meje; Ju kam paralajmëruar mjaftueshëm.

[29] "Asgjë nuk mund të ndryshohet tani. Unë nuk jam i padrejtë ndaj njerëzve."

[30] Ajo është dita kur pyesim Ferrin, "A je ngi?" Do të thotë, "Më jep ende."

[31] Parajsa do iu ofrohet të drejtëve, e gatshme.

[32] Kjo është çka i ishte premtuar çdo të penduari, të durueshmi.

[33] Ata ia kishin dronë Mirëbërësit, në vetmi, dhe erdhën me gjithë zemër.

[34] Hyni aty në paqe; kjo është Dita e Përjetësisë.

[35] Ata kanë çfarëdo që dëshirojnë aty, dhe kemi madje edhe më shumë.

[36] Sa e sa gjenerata para tyre, që ishin më të fuqishme, i asgjësua. Kërkuan nëpër tokë; a gjetën ndonjë rrugëdalje?

[37] Ky duhet të jetë mësim për këdo që ka mend, ose është i aftë të dëgjojë dhe të dëshmojë.

[38] Kemi krijuar qiejt dhe tokën, dhe çdo gjë në mes tyre për gjashtë ditë, dhe nuk na preku lodhja.

[39] Prandaj, ji i durueshëm përballë shprehjeve të tyre, dhe lavdëro dhe madhëro Zotëruenin tënd

* 50:23-28 Shoqëruesi yt gjatë tërë jetës është dëshmitar i çdo gjëje që bën. Shih Shtojcën 7.

para lindjes së diellit, dhe para perëndimit të tij.

[40] Gjatë natës të meditosh në emrin e Tij, dhe pas përljes.

[41] Përgatituni për ditën kur thirrësi thërret nga një vend që është afër.

[42] Kur ata e dëgjojnë britmën e pashmangshme; ajo është dita e daljes.

[43] Ne jemi ata që japim jetë dhe vdekje; te ne është fati përfundimtar.

[44] Do të vij dita kur toka çahet me ngut, duke nxjerrë ata. Një mbledhje e tillë është lehtë për ne për ta bërë.

[45] Jemi tërësisht të vetëdijshëm për çdo gjë që shprehin, përderisa ti nuk ke aspak fuqi mbi ta. Prandaj, ua kujto me këtë Kuran, atyre që ia kanë dronë paralajmërimeve të Mia.

Surja 51: Drejtuesit e erërave (Edh-Dharijat)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Erërat që fryjnë.

[2] Bartin shi.

[3] Sjellin furnizime.

[4] I shpërndajnë siç urdhërohen.

[5] Çka ju është premtuar do të vij patjetër.

[6] Dita e Gjykimit është e pashmangshme.

[7] Përkundër qiellit përsosmërisht të krijuar.

[8] Ju vazhdoni ta vëni në dyshim të vërtetën.

[9] Prej saj devijojnë devijuesit.

[10] Mjerë falsifikuesit.

[11] Në bredhjen e tyre, ata janë plotësisht të pavëmendshëm.

[12] Ata e vënë në dyshim Ditën e Gjykimit.

[13] Ditën kur parashtrohen në zjarr.

[14] Vuanie ndëshkimit; kjo është çka dikur sfidonit.

[15] Të drejtit kanë merituar kopshte dhe burime.

[16] Ata pranojnë shpërblimet e Zotëruesit të tyre, se dikur ishin besimtarë.

[17] Rrallë fjetën tërë natën.

[18] Në agim, u lutën për falje.

[19] Një pjesë të parave të tyre e lan anash për lypësin dhe nevojtarin.

[20] Toka është plot shenja për ata që janë të sigurt.

[21] Dhe brenda vet juve; a mund të shihni?

[22] Në qiell është furnizimi juaj, dhe çdo gjë që ju premtohet juve.

[23] Pasha Zotëruesin e qiellit dhe tokës, kjo është aq e vërtetë sa fakti që ju flisni.

[24] A e ke vërejtur historinë e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit?

[25] Ata e vizituan atë, duke thënë, "Paqe." Ai tha, "Paqe juve, të huaj!"

[26] Ai kërkoi nga familja e tij për të përgatitur një viç të majm.

[27] Kur ua ofroi atyre, tha, "A nuk hani ju?"

[28] Ai ushqeui frikë nga ta. Thanë, "Mos kij frikë," dhe i dhanë myzhde për një djalë të dijshtëm.

[29] Bashkëshortja e tij u mahnit. Duke treguar kah fytyra e saj e rrudhur: "Unë jam grua e vjetër sterile."

[30] Thanë, "Kështu tha Zotëruesi yt. Ai është Më i Mençuri, i Gjithëdijshmi."

- [31] Tha, "Çka është puna juaj, o të dërguarë?"
- [32] Thanë, "Jemi të nisur te njerëz kriminelë.
- [33] "Do iu lëshojmë rrebesh gurësh balte.
- [34] "Të shënuar nga Zotëruesi yt për shpirtligjtë."
- [35] Ne pastaj i shpëtuam të gjithë besimtarët nga aty.
- [36] Nuk gjetëm aty përveç një shtëpie të nënshtruarish.
- [37] E ujdisë si mësim për ata që kanë frikë ndëshkimit që dhemb.
- [38] Në Moisiun (ka mësim). E dërguam te Faraoni me prova të qarta.
- [39] Por ai kundërshtoi me mendjemadhësi, dhe tha, "Magjistar, ose i çmendur."
- [40] Si pasojë, e ndëshkuam atë dhe trupat e tij. I hodhëm në det, dhe ai vet e ka fajin.
- [41] Në Adin (ka mësim). Dërguam mbi ta erë shkatërruese.
- [42] Mbi çfarëdo që ra ajo e shkatërroi krejt.
- [43] Në Themudin (ka mësim). Atyre iu tha, "Kënaquni përkohësisht."
- [44] Ata u rebeluan kundër urdhrit të Zotëruesit të tyre. Si pasojë, vetëtimia i goditi ata përderisa e shikuan.
- [45] Ata nuk mundën të ngriten, as nuk u ndihmuan.
- [46] Dhe njerëzit e Nuhut më parë; ata ishin njerëz shpirtligj.
- "Teoria e zgjerimit të gjithësisë" konfirmohet*
- [47] E ndërtoam qiellin me duart tona, dhe do të vazhdojmë ta zgjerojmë.
- [48] Dhe e bëmë tokën të banueshme; dizajnim i përkryer.
- [49] Krijuam çift (mashkull dhe femër) të çdo gjëje, që të mund të jeni të vëmendshëm.
- [50] Të ikni te Zoti. Jam i dërguar nga Ai te ju si paralajmërues i qartë.
- [51] Mos ngritni përkrah Zotit asnjë zot tjetër. Jam i dërguar nga Ai te ju si paralajmërues i qartë.
- [52] Sa herë që një i dërguar shkoi te gjeneratat paraprake, thanë, "Magjistar," ose, "I çmendur."
- [53] A mos janë marrë vesh me njëri tjetrin? Vërtetë, janë shkelës.
- [54] Mund t'i shpërfillësh; nuk mund të fajësohesh.
- [55] Dhe ua kujto, se kujtesa u bën dobi besimtarëve.
- Qëllimi i ekzistencës tonë*
- [56] Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit përveç që të më adhurojnë vetëm Mua.
- [57] Unë nuk kam nevojë për asnjë furnizim prej tyre, as nuk kam nevojë që të më ushqejnë.
- [58] Zoti është Furnizuesi, Poseduesi i gjithë fuqisë, Më i Larti.
- [59] Shkelësit kanë vetëshkaktuar fatin e njëjtë si homologët e tyre paraprak; ata nuk duhet të sfidojnë.
- [60] Mjerë ata që nuk besuan prej ditës që po i pret.

Surja 52: Mali Sinai (Et-Tur)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha Malin Sinai.
- [2] Shkrimin e regjistruar.
- [3] Të botuar në libra.
- [4] Faltoren e frekuentuar.
- [5] Tavanin e lartësuar.
- [6] Detin flakë.

- [7] Pagesa e Zotëruesit tënd është e pashmangshme.
- [8] Asnjë forcë në gjithësi nuk mund ta ndalë.
- [9] Do të vij dita kur qielli do të gjëmojë fort.
- [10] Malet do të fshihen.
- [11] Mjerë në atë ditë mosbesimtarët -
- [12] që janë në endjen e tyre, të pavëmendshëm.
- [13] Do të shtyhen në Xhehenem, me dhunë.
- [14] Ky është Zjarri në të cilin dikur nuk besonit.
- [15] A është magji, apo nuk po shihni?
- [16] Vuanie djegien. Duroni apo nuk duroni, është njëjtë për ju. Kjo është pagesa e drejtë për çka bëtë ju.
- [17] Të drejtit kanë merituar kopshte dhe hare.
- [18] Ata gëzojnë çka Zotëruesi i tyre ka rezervuar për ta; Zotëruesi i tyre i ka kursyer nga ndëshkimi i Ferrit.
- [19] Hani e pini në lumturi, si shpërblim për punët tuaja.
- [20] Ata rrinë në mobilie luksoze, dhe i shoqërojmë me bashkëshorte të bukura.
- [21] Për ata që besuan, dhe fëmijët e tyre gjithashtu i ndoqën në besim, do t'ua bashkëngjisim fëmijët. Nuk ngelim së shpërblyeri ata për ndonjë punë. Çdo person paguhet për çka bëri.
- [22] Do i furnizojmë me fruta dhe mishra që i duan.
- [23] Do gëzojnë pije të pandotura, të pamëkat për t'i pirë.
- [24] Duke iu shërbyer atyre do jenë shërbëtorë si perla të ruajtura.
- [25] Do të takohen me njëri tjetrin dhe të rikujtohen mes vete.
- [26] Do të thonë, "Ne ishim të dashur dhe kokulur mes njerëzve tanë.
- [27] "Zoti na ka bekuar, dhe na ka kursyer nga agonja e frymëve të këqija.
- [28] "Ne i luteshim Atij; Ai është Më i Dashuri, i Mëshirshmi."

I dërguari

- [29] T'ua kujtosh njerëzve. Me bekimet e Zotëruesit tënd mbi ty, nuk je as fallxhi, as i çmendur.
- [30] Mund të thonë, "Ai është poet; le të presim derisa të jetë i vdekur."
- [31] Thuaj, "Vazhdoni të prisni; po pres së bashku me ju."
- [32] A janë ëndrrat e tyre që e diktojnë sjelljen e tyre, apo janë shpirtligj prej natyre?
- [33] A thonë, "Ai e trilloi të tërën?" Në realitet, thjeshtë janë mosbesimtarë.
- "Muhamedanët" sfidojnë Zotin dhe prodhojnë Hadith*
- [34] Le të prodhojnë Hadith si ky, nëse janë të sinqertë.
- [35] A u krijuan ata prej asgjëje? A janë ata krijuesit?
- [36] A i krijuan ata qiejt dhe tokën? Vërtetë, nuk janë të sigurt.
- [37] A i posedojnë thesaret e Zotëruesit tënd? A i kanë gjërat në duar?
- [38] A ngjiten në një shkallë që ua mundëson të dëgjojnë? Le të tregojnë dëgjuesit e tyre provë të tyre.
- [39] A ka Ai vajza, përderisa ju keni djem?
- [40] A mos po iu kërkon ti atyre ndonjë pagë, dhe ata po ngarkohen nga ajo?
- [41] A e dinë të ardhmen, dhe e kanë të regjistruar?
- [42] A po thurin kurthe dhe planifikojnë? Planifikimet e mosbesimtarëve kthehen kundër vet atyre.
- [43] A kanë zot tjetër përkrah Zotit? Qoftë i madhëruar Zoti, shumë larg nga të pasurit e

partnerëve.

[44] Kur të shohin masa duke rënë nga qielli, do të thonë, “Re të grumbulluara!”

[45] Shpërfilli ata derisa të hasin në ditën në të cilën goditen.

[46] Atë ditë, planifikimet e tyre nuk do i mbrojnë, as nuk do të ndihmohen.

[47] Ata që shkelin vuajnë ndëshkim këtu, por shumica e tyre nuk e dinë.

[48] Të durosh me këmbëngulje në zbatimin e urdhrave të Zotëruesit tënd – je para syve tonë – dhe madhëroje dhe lavdëroje Zotëruesin tënd kur të ngritesh.

[49] Gjithashtu gjatë natës madhëroje Atë, dhe në agim përderisa veniten yjet.

Surja 53: Yjet (En-Nexhm)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Përderisa yjet ranë.*

[2] Shoku juaj (Muhamedi) nuk ishte i humbur, as nuk u mashtrua.

[3] As nuk ishte duke folur nga dëshira e vet.

[4] Ishte frymëzim hyjnor.

[5] I diktuar nga Më i Fuqishmi.

[6] Posedues i gjithë autoritetit. Nga lartësia më e lartë e Tij.

[7] Te horizonti më i lartë.

[8] U afrua duke lëvizur teposhtë.

[9] Derisa u gjend sa më afër që ishte e mundur.

[10] Ai pastaj e shpalli te shërbëtori i Tij çka kishte për tu shpallur.

[11] Mendja nuk e shpiku çka pa.

[12] A po dyshoni çka pa?

[13] Ai e pa atë në një zbritje tjetër.

[14] Te pika përfundimtare.

[15] Ku Parajsa e përhershme gjendet.

[16] I tërë vendi u kaplua.

[17] Sytë nuk u luhatën, as nuk u verbuan.

[18] Ai pa shenja të mëdha të Zotëruesit të tij.

Idhujt picimula

[19] Krahasonie këtë me idhujt femëror Alatën dhe Al-Uzahnë.

[20] Dhe Menatën, të tretën.

[21] A keni ju djem, përderisa Ai ka këto si vajza?

[22] Çfarë ndarje e turpshme!

[23] Këto nuk janë tjetër pos emra që i shpikët, ju dhe stërgjyshërit tuaj. Zoti nuk autorizoi blasfemi të tillë. Ata ndjekin hamendje, dhe dëshirat e veta, kur udhëzimi i vërtetë ka ardhur te ta këtu nga Zotëruesi i tyre.

[24] Çfarë është ajo që qenia njerëzore dëshiron?

[25] E Zotit është edhe Përjetësia, edhe kjo botë.

* 53:1-18 Muhamedi u mblodh në gjithësinë më të lartë për të pranuar këtë Kuran në zemrën e tij. Yjet ranë përderisa ai udhëtoi përmes tyre me miliona herë sa shpejtësia e dritës. Më pas, Kurani gradualisht u lëshua në memorien e tij. Lirisht shih Shtojcën 28.

[26] Madje as engjëjt në qiell nuk posedojnë autoritet për të ndërhyrë. Të vetmit që lejohen nga Zoti janë ata që veprojnë në përputhje me vullnetin e Tij dhe miratimin e Tij.

[27] Ata që nuk besojnë në Përjetësinë iu kanë dhënë engjëjve emra femrash.

[28] Ata nuk kishin aspak njohuri për këtë; vetëm hamenden. Hamendja nuk është zëvendësim për të vërtetën.

Zgjedhi shokët me kujdes

[29] T'i shpërfillësh ata që ia kthejnë shpinën lajmit tonë, dhe preokupohen me jetën e kësaj bote.

[30] Aq dinë ata. Zotëruesi yt është tërësisht i vetëdijshëm për ata që u humbën larg në humbje nga rruga e Tij, dhe Ai është tërësisht i vetëdijshëm për ata që janë të udhëzuar.

[31] E Zotit është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Ai do i paguaj ata që bëjnë të këqija për punët e tyre, dhe do i shpërblejë të drejtit për drejtësinë e tyre.

[32] Ata iu shmangen mëkateve dhe shkeljeve të tepërta, përveç kundërvajtjeve të vogla. Falja e Zotëruesit tënd është e jashtëzakonshme. Ai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për ju që kur ju nisi nga toka, dhe përderisa ishit embrione në barqet e nënave tuaja. Prandaj, mos e lartësoni vetveten; Ai është tërësisht i vetëdijshëm për të drejtit.

[33] A ke vërejtur atë që u zmbrops?

[34] Rrallë dha bamirësi, edhe atëherë shumë pak.

[35] A posedonte njohuri për të ardhmen? A mund ta shihte?

[36] A nuk u njoftua ai për mësimet në shkrimin e Moisiut?

[37] Dhe Ibrahimit që përmbushi?

[38] Asnjë shpirt nuk i bart mëkatet e shpirtit tjetër.

[39] Çdo qenie njerëzore është përgjegjëse për punët e veta.

[40] Dhe punët e secilit do të tregohen.

[41] Pastaj ata do të paguhen plotësisht për punët e tilla.

[42] Te Zotëruesi yt është fati përfundimtar.

[43] Ai është Ai që të bën të qeshësh ose qash.

[44] Ai është Ai që ka në dorë vdekje dhe jetë.

Burri e përcakton gjininë e bebes

[45] Ai është Ai që krijoi dy llojet, mashkullin dhe femrën -

[46] nga një pikël e vogël fare.

[47] Ai do të kryej rikrijimin.

[48] Ai është Ai që ju bën të pasur ose të varfër.

[49] Ai është Zotëruesi i galaktikave.

[50] Ai është Ai që asgjësoi Adin e lashtë.

[51] Dhe fshiu Themudin.

[52] Gjithashtu njerëzit e Nuhut më parë; ata ishin shkelës të këqij.

[53] Shoqëritë e këqija (të Sodomës dhe Gomorës) ishin më të poshtrit.

[54] Si pasojë, ata u zhdukën krejt.

[55] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?

[56] Ky është paralajmërim si më të hershmit.

[57] E pashmangshmja po afrohet.

[58] Askush përkrah Zotit nuk mund ta heqë.

[59] A po e vëni në pikëpyetje këtë çështje?

[60] A po qeshni, në vend që të qani?

[61] A po insistoni në mënyrat tuaja?

[62] Të bini në përrulje para Zotit, dhe ta adhuroni.

Surja 54: Hëna (El-Kamer)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Ora është afruar, dhe hëna është çarë.*

[2] Atëherë ata panë një mrekulli; por ia kthyen shpinën dhe thanë, "Magji e vjetër."

[3] Nuk besuan, ndoqën mendimet e veta, dhe i qëndruan besnik traditave të tyre të vjetra.

[4] Paralajmërimet të mjaftueshme janë dërguar për t'i alarmuar ata.

[5] Mençuri e madhe; por të gjitha paralajmërimet kanë qenë të kota.

[6] Injoroi ata; do të vij dita kur thirrësi do të shpallë katastrofë të tmerrshme.

[7] Me sytë e tyre të poshtëruar, ata dalin nga varret si karkaleca të shpërndarë.

[8] Përderisa i përgjigjen thirrësit, mosbesimtarët do të thonë, "Kjo është ditë e vështirë."

[9] Njerëzit e Nuhut nuk besuan para tyre. Nuk i besuan shërbëtorit tonë dhe thanë, "I çmendur!" Ai u keqtrajtua.

[10] Lu përgjyerua Zotëruesit të tij, "Jam i shtypur; më jep fitore."

[11] Pastaj i hapëm portat e qiellit, duke derdhur ujë.

[12] Dhe i bëmë burimet të shpërthejnë nga toka. Ujërat u takuan për të kryer një vendim të paracaktuar.

Arka

[13] E bartëm atë në lundër të bërë nga trungje dhe litarë.

[14] Lundroi nën sytë tanë; shpërblim për një që u refuzua.

[15] E kemi ujdísur si mësim. A dëshiron ndokush prej jush të mësojë?

[16] Sa e tmerrshme ishte pagesa Ime pas paralajmërimëve!

[17] E bëmë Kuranin të lehtë për tu mësuar. A dëshiron ndokush prej jush të mësojë?

[18] Adi nuk besuan. Si pasojë, sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im pas paralajmërimëve.

[19] Dërguam mbi ta erë të fortë, në një ditë vuajtjesh të vazhdueshme.

[20] I hodhi njerëzit përreth si të ishin trungje palmash të kalbura.

[21] Sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im pas paralajmërimëve!

[22] E bëmë Kuranin të lehtë për tu mësuar. A dëshiron ndokush prej jush të mësojë?

[23] Themudi i refuzuan paralajmërimet.

[24] Ata thanë, "A të ndjekim një prej nesh; qenie njerëzore? Pastaj do të humbemi, dhe të përfundojmë në Ferr.

[25] "A i zbriti lajmi atij, në vend të neve? Ai është gënjeshtar i pafytyrë."

[26] Ata do të kuptojnë nesër kush është gënjeshtari i pafytyrë.

[27] Po dërgojmë devenë si test për ta. Vështroji dhe ji i durueshëm.

[28] Njoftoji ata që uji të ndahet mes tyre; (deveja) të lejohet të pijë në ditën e saj të caktuar.

[29] Por ata e bindën shokun e tyre ta vrasë (devenë), dhe ai u detyrua.

* 54:1 Kësaj shenje të rëndësishme të afrimit të fundit të botës i erdhi koha më 1969 kur njerëzit zbarkuan në hënë dhe sollën copa të hënës në tokë. Në të njëjtën kohë, Mrekullia matematikore e Zotit në Kuran po zbulohet gradualisht. Myslimanët Tradicional e kundërshtuan atë, pasi që i ekspozonte gabimet e zakoneve të tyre (Shtojca 25).

- [30] Si pasojë, sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im! Ishin paralajmëruar.
- [31] Dërguam mbi ta një të rënë, ku u bënë si kashtë e shtruar.
- [32] E bëmë Kuranin të lehtë për tu mësuar. A dëshiron ndokush prej jush të mësojë?
- [33] Njerëzit e Lutit i refuzuan paralajmërimet.
- [34] Iu lëshuam rrebesh gurësh. Vetëm familja e Lutit u shpëtua në agim.
- [35] E bekuam atë dhe familjen e tij; kështu i shpërblejmë mirënjohësit.
- [36] I paralajmëruam ata për pagesën tonë, por i përqeshën paralajmërimet.
- [37] Ata negociuan me të për mysafirët e tij; i verbuam. Vuanie ndëshkimit Tim; ishit të paralajmëruar.
- [38] Herët në mëngjesin e ardhshëm, ndëshkim shkretues iu ra atyre.
- [39] Vuanie ndëshkimit Tim; ishit të paralajmëruar.
- [40] E bëmë Kuranin të lehtë për tu mësuar. A dëshiron ndokush prej jush të mësojë?
- [41] Njerëzit e Faraonit u paralajmëruan.
- [42] Ata i refuzuan të gjitha shenjat tona. Si pasojë, i paguam ashtu si një i Plotfuqishëm, Gjithëfuqishëm duhet t'i paguaj.
- [43] A jeni ju mosbesimtarë më të mirë se ata mosbesimtarë? A jeni shfajësuar nga shkrimi?
- [44] Ndoshta ata mendojnë, "Do të jemi fituesit."
- [45] Të gjithë ata do të mposhten; do të kthehen mbrapa dhe të ikin.
- [46] Ora po i pret, dhe Ora është shumë më e keqe dhe dhemb më shumë.
- [47] Patjetër, fajtorët kanë humbur, dhe do të përfundojnë në Ferr.
- [48] Ata do të jenë të zvarritur në zjarr, me forcë. Vuanie agoninë e ndëshkimit.
- [49] Çdo gjë që krijuam është saktësisht e matur.
- [50] Urdhrat tona kryhen sa çel e mbyll sytë.
- [51] I asgjësuam njerëzit që ishin si ju. A dëshiron ndokush prej jush të mësojë?
- [52] Çdo gjë që bënë është e regjistruar në shkrime.
- [53] Çdo gjë, e vogël apo e madhe, është e shkruar.
- [54] Padyshim, të drejtit kanë merituar kopshte dhe lumenj.
- [55] Në pozitë të nderuar, te i Gjithëfuqishmi Mbret.

Surja 55: Mirëbërësi (El-Rrahman)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Mirëbërësi.
- [2] Arsimtari i Kuranit.
- [3] Krijuesi i qenieve njerëzore.
- [4] Ai u mësoi atyre si të dallojnë.
- [5] Dielli dhe hëna janë të llogaritura në mënyrë të përkryer.
- [6] Yjet dhe lisat përulen.
- [7] Ai e ndërtoi qiellin dhe e themeloi ligjin.
- [8] Të mos e shkelni ligjin.
- [9] Të vendosni drejtësi; mos e thyeni ligjin.
- [10] Ai e krijoi tokën për të gjitha krijesat.
- [11] Në të ka fruta, dhe palma hurmash me frutat e tyre të kalavarur.
- [12] Edhe drithëra dhe erëza.

- [13] (O njerëz dhe xhin,) cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [14] Ai e krijoi njeriun nga balta e tharë, si balta e poçarit.
- [15] Dhe krijoi xhinët nga zjarri flakë.
- [16] (O njerëz dhe xhin,) cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [17] Zotëruesit të dy lindjeve dhe dy perëndimeve.
- [18] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [19] Ai i ndanë dy detet ku takohen.
- [20] Një barrierë është e vendosur ndërmjet tyre, për t'i parandaluar që të mos kalojnë.
- [21] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [22] Prej secilit nga ta ju merrni margaritarë dhe korale.
- [23] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [24] Ai ju dha juve anije që lëvizin nëpër det si flamuj.
- [25] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [26] Çdokush në tokë kalbet.
- [27] Vetëm prania e Zotëruesit tënd zgjatë. Poseduesi i Madhërisë dhe Nderit.
- [28] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [29] Duke iu lutur Atij është çdokush në qiej dhe tokë. Çdo ditë Ai është në komandë të plotë.
- [30] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [31] Do t'ju thërrasim në llogaridhënie, o njerëz dhe xhin.
- [32] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [33] O ju xhin dhe njerëz, nëse mund të depërtoni tej kufijve të jashtëm të qiejve dhe tokës, lirisht depërtoni. Nuk mund të depërtoni pa autorizim.
- [34] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [35] Bombardoheni me predha zjarri dhe metali, dhe nuk mund të fitoni.
- [36] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [37] Kur qielli të shpërbëhet, dhe të bëhet bojëtrëndafili si ngjyrë.
- [38] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [39] Atë ditë, asnjë njeri, asnjë xhin, nuk do të pyetet për mëkatet e veta.
- [40] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [41] (Sepse) fajtorët do të njihen nga pamja e tyre; ata do të kapen për ballukesh dhe këmbësh.
- [42] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [43] Ky është Xhehenemi që fajtorët dikur e mohanin.
- [44] Ata do të qarkullojnë ndërmjet tij dhe një vlimi të padurueshëm.*
- [45] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [46] Për ata që ia kanë dronë madhërisë së Zotëruesit të tyre, dy kopshte (një për xhinët dhe një për njerëzit).
- [47] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [48] Plot furnizime.
- [49] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
- [50] Dy burime janë në to, që rrjedhin.
- [51] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?

* 55:44 Hollësirat e plota për Qiellin e Lartë, Qiellin e Ulët, Purgatorin, Ferrin, dhe vlimin e padurueshëm jepen në Shtojcat 5 dhe 11.

- [52] Prej secilit fryt në to, dy lloje.
[53] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[54] Përderisa qëndrojnë në mobilie të shtruara me saten, frutat janë të arritshme lehtë.
[55] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[56] Të shoqet e tyre të bukura nuk janë prekur nga ndonjë njeri apo xhin.
[57] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[58] Ato duken si xhevahire dhe korale.
[59] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[60] A është shpërblimi i të mirës diçka tjetër pos të mirës?
[61] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[62] Nën to janë dy kopshte (një për xhinët dhe një për njerëzit).
[63] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[64] Breg më breg.
[65] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[66] Në to, puse për tu nxjerrë.
[67] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[68] Në to ka fruta, palma hurmash, dhe shegë.
[69] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[70] Në to ka të shoqe të bukura.
[71] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[72] Të kufizuara te tendat.
[73] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[74] Asnjë njeri nuk i preku ato kurrë, as ndonjë xhin.
[75] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[76] Ato çlirohen në qilima të blertë, në mjedise të bukura.
[77] Cilën prej çudive të Zotëruesit tuaj mund ta mohoni?
[78] Më i lartësuar është emri i Zotëruesit tënd, Poseduesit të Madhërisë dhe Nderit.

Surja 56: E Pashmangshmja (El-Vakia)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Kur të pashmangshmes i vjen koha.
[2] Asgjë nuk mund ta ndalë atë që të ndodhë.
[3] Do të poshtërojë disa, dhe të ngritë të tjerë.
[4] Toka do të tundet.
[5] Malet do të fshihen.
[6] Sikur të mos kishin ekzistuar.
[7] Ju do të shtresoheni në tre lloje.
[8] Ata që merituan hare do të jenë në hare.
[9] Ata që merituan vuajtje do të jenë në vuajtje.
[10] Pastaj është elita e elitës.
[11] Ata janë ata që do të jenë më së afërmi (me Zotin).
[12] Në kopshtet e haresë.

- [13] Shumë prej gjeneratave të para*.
 [14] Pak prej gjeneratave të mëvonshme.
 [15] Në mobilie luksoze.
 [16] Duke u kënaqur me gjithçka, do të jenë fqinjë.
 [17] Atyre do të jenë duke iu shërbyer shërbëtorë të pavdekshëm.
 [18] Me gota, shtamba dhe pije të pastra.
 [19] Kurrë nuk harxhohen, as nuk lodhen.
 [20] Fruta sipas qejfit.
 [21] Mish zogjsh që ua ka ënda.
 [22] Të shoqe të bukura.
 [23] Si perla të ruajtura.
 [24] Shpërblime për punët e tyre.
 [25] Ata kurrë nuk dëgjojnë gjeputura aty, as shprehje mëkatare.
 [26] Vetëm shprehjen: "Paqe, paqe."

Qielli i poshtëm

- [27] Ata të anës së djathtë, do të jenë në anën e djathtë.
 [28] Në kopshte të harlisura.
 [29] Fruta aromatike.
 [30] Hije të zgjatur.
 [31] Ujë të bollshëm.
 [32] Shumë fruta.
 [33] Të pambarueshme; të pandalueshme.
 [34] Mobilie luksoze.
 [35] Krijua për ta të shoqe.
 [36] Kurrë më parë të prekura.
 [37] Çift i përkryer.
 [38] Për ata në anën e djathtë.
 [39] Shumë prej gjeneratave të hershme.
 [40] Shumë prej gjeneratave të mëvonshme.*

Ferri

- [41] Ata të së majtës, do të jenë në të majtë.
 [42] Në vuajtje dhe vlim.
 [43] Edhe hija e tyre është e nxehtë.
 [44] E pafreskët, e padurueshme.
 [45] Ata dikur ishin të pasur.
 [46] Ata insistonin në blasfeminë e madhe.

* 56:13-40 Njerëzit që besojnë dhe ushqejnë shpirtat e tyre nëpërmjet adhurimit të vetëm Zotit janë të paracaktuar për Qiellin e Lartë. Ndjekësit bashkëkohës të secilit të dërguar pa ndryshim vuajnë keqtrajtme nga tradicionalistët dhe pasuesit e fesë së korruptuar. Kështu, ata kanë vend të posaçëm të rezervuar për ta në Qiellin e Lartë. Të gjithë njerëzit që vdesin para moshës 40 vjeçare shkojnë në Qiellin e Ulët, së paku (46:15).

* 56:13-40 Njerëzit që besojnë dhe i ushqejnë shpirtat e tyre nëpërmjet adhurimit të vetëm Zotit janë të paracaktuar për Qiellin e Lartë. Ndjekësit bashkëkohës të secilit të dërguar pa ndryshim vuajnë keqtrajtme nga tradicionalistët dhe pasuesit e fesë së korruptuar. Kështu, ata kanë vend të posaçëm të rezervuar për ta në Qiellin e Lartë. Të gjithë njerëzit që vdesin para moshës 40 vjeçare shkojnë në Qiellin e Poshtëm, së paku (46:15).

- [47] Ata thanë, "Pasi të vdesim dhe të bëhemi pluhur e eshtra, ringjallemi?
 [48] "A përfshinë kjo edhe stërgjyshërit tanë?"
 [49] Thuaj, "Gjeneratat e hershme dhe gjeneratat e mëvonshme.
 [50] "Do të mblidhen në një takim në një ditë të paracaktuar.
 [51] "Pastaj ju, o mosbesimtarë humbës.
 [52] "Do të hani nga lisat e hidhërimit.
 [53] "Duke i mbushur barqet tuaja prej tyre.
 [54] "Pastaj duke pirë pije ferri.
 [55] "Pastaj duke shtuar pije rëre."
 [56] E tillë është hisja e tyre në Ditën e Gjykimit.

Reflektime

- [57] Ne ju kemi krijuar juve, sikur të mund të besonit!
 [58] A e keni vërejtur farën që e prodhoni?
 [59] A e krijuat ju, apo ne?
 [60] E kemi paracaktuar vdekjen për ju. Asgjë nuk mund të na ndalë -
 [61] që të zëvendësojmë gjenerata të reja në vendin tuaj, dhe të themelojmë çka nuk dini.
 [62] Ju dini për krijimin e parë. A nuk ju kujtohet?
 [63] A i keni vërejtur të korrat që i korrni?
 [64] A i rritët ju ato, apo ne?
 [65] Nëse duam, mund ta shndërrojmë në kashtë. Pastaj do të vajtoni:
 [66] "Humbëm.
 [67] "Mbetëm pa të."
 [68] A e keni vërejtur ujin që e pini?
 [69] A e lëshuat poshtë nga retë ju, apo ne?
 [70] Nëse duam, mund ta bëjmë të njelmët. Duhet të jeni falënderues.
 [71] A e keni vërejtur zjarrin që ndizni?
 [72] A e nisët ju lisin e tij, apo ne?
 [73] E bëmë atë tërheqje vërejtjeje, dhe mjet të përdorshëm për përdoruesit.
 [74] Ta madhërosh emrin e Zotëruesit tënd, të Madhit.

Vetëm të sinqertit mund ta kuptojnë Kuranin

- [75] Beto hem me pozitat e yjeve.
 [76] Ky është një betim i madh, veç sikur ta dinit.*
 [77] Ky është Kuran i nderuar.
 [78] Në libër të mbrojtur.
 [79] Askush nuk e kupton përveç të sinqertëve.*
 [80] Shpallje nga Zotëruesi i gjithësisë.
 [81] A po e shpërfillni këtë kallëzim?

* 56:75-76 Gjithësia jonë, më e vogla dhe më e brendshme e shtatë gjithësive, përmban një bilion galaktika, një bilion trilion yje, të përhapur nëpër biliona vjet drite. Këta deciliona të panumërueshëm të trupave qiellor i mbajnë orbitat e tyre me saktësi të komanduar hyjnisht. Sa më shumë që mësojmë, aq më shumë e kuptojmë sa mbresëlënëse ky betim është. *Shih Shtojcën 6.*

* 56:79 Të pasinqertit që nuk janë të kënaqur me vetëm Kuranin parandalohen hyjnisht nga të kuptuarit e Kuranit. Ky koncept përsëritet përgjatë Kuranit (17:45-46, 18:57). Si pasojë, ata nuk mund ta kuptojnë këtë strofë. Për shembull, krahasojë këtë përkthim të 7:3, 17:46, 41:44, dhe 56:79 me përkthimet e tjera.

- [82] A po e bëni zakon që të mos besoni?
 [83] Kur të vjen koha dhe ai (shpirti yt) të vjen në fyt -
 [84] atëherë do të shikoni përreth.
 [85] Ne jemi më afër tij sesa ju, por ju nuk shihni.
 [86] Nëse është e vërtetë se nuk jeni të detyruar për llogaridhënie -
 [87] pse nuk e ktheni (shpirtin tuaj), nëse jeni të singurtë?
 [88] Nëse ai është një prej atyre afër Meje -
 [89] atëherë gëzim, lule, dhe kopshte hareje.
 [90] Dhe nëse ai është një i të djathtës -
 [91] paqja është ngastra e atyre në të djathtë.
 [92] Por nëse ai është një prej mosbesimtarëve, humbësve -
 [93] atëherë një vendbanim vlimi -
 [94] dhe djegie në Ferr.
 [95] Kjo është e vërteta absolute.
 [96] Ta madhërosh emrin e Zotëruesit tënd, të Madhit.

Surja 57: Hekuri (El-Hadid)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Duke e madhëruar Zotin është çdo gjë në qiej dhe tokë. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.
 [2] I tij është mbretërimi i qiejve dhe tokës. Ai ka në dorë jetë dhe vdekje. Ai është i Gjithëfuqishëm.
 [3] Ai është Alfa dhe Omega. Ai është Më i Jashtëmi dhe Më i Brendshmi. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.
 [4] Ai është Ai që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë,* dhe i mori të gjitha në dorë. Ai din çdo gjë që hyn në tokë, dhe çdo gjë që del prej saj, dhe çdo gjë që zbret nga qielli, dhe çdo gjë që ngjitet në të. Ai është me ju kudo që mund të jeni. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.
 [5] I tij është mbretërimi i qiejve dhe tokës. Të gjitha çështjet i ka në dorë Zoti.
 [6] Ai e shkrinë natën në ditë, dhe e shkrinë ditën në natë. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.
 [7] Besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe jepni nga çka Ai ju ka dhënë. Ata mes jush që besojnë dhe japin (bamirësi) kanë merituar pagesë shumë të madhe.
 [8] Pse të mos besoni në Zotin kur i dërguari është duke ju ftuar juve të besoni në Zotëruesin tuaj? Ai ka marrë betim nga ju, nëse jeni besimtarë.
 [9] Ai është Ai që zbret te shërbëtori i Tij shpallje të qarta, që t'ju çojë juve nga errësira në dritë. Zoti është i Dhembshëm ndaj jush, i Mëshirshëm.

Nderë i veçantë

- [10] Pse nuk shpenzoni për Zotin, kur Zoti e posedon të gjithë pasurinë në qiej dhe tokë? Të shquar nga të tjerët janë ata mes jush që shpenzojnë para fitores dhe përpiqen. Ata arrijnë shkallë më të lartë sesa ata që shpenzojnë pas fitores dhe përpiqen. Për secilin, Zoti premton shpëtim. Zoti është Njohës i tërësishtëm i çdo gjëje që bëni.

* 57:4 Gjashtë ditët e krijimit janë thjeshtë metër për të na informuar rëndësinë relative të përbërësve të ndryshëm, për të theksuar rëndësinë e planetit Tokë, dhe për të na bërë me dije se Toka është planeti i vetëm i populluar. Shih Shtojcën 41:9-10.

[11] Kush do i japë Zotit hua të drejtësisë, për ta pasur të shumëfishuar shumëfish për vete, dhe për të përfunduar me shpërblim bujar?

Triumfi i madh

[12] Do të vij dita kur i sheh besimtarët dhe besimtare me dritat e tyre që rrezatojnë para tyre dhe në të djathtën e tyre. Lajmi i mirë është i juaji që, në atë ditë, ju do të keni kopshte me proje që rrjedhin. Aty do të qëndroni përgjithmonë. Ky është triumfi i madh.

Humbësit më të këqij

[13] Në atë ditë, hipokritët dhe hipokritet do tu thonë atyre që besuan, "Ju lutemi na lejoni të absorbojmë pak nga drita juaj." Do tu thuhet, "Kthehuni pas jush, dhe kërkoni dritë." Një barrierë do të vendoset ndërmjet tyre, porta e të cilës e ndanë mëshirën në anën e brendshme, nga ndëshkimi në anën e jashtme.

[14] Ata do i thirrin ata, "A nuk ishim me ju?" Ata do të përgjigjen, "Po, por ju i mashtruat shpirtrat tuaj, ngurruat, dyshuat, dhe u bëtë të çorientuar duke parë ëndrra me sy qelë, derisa gjykimi i Zotit erdhi. Me iluzionet tuaja e larguat veten nga Zoti.

[15] "Prandaj, asnjë haraç nuk mund të merret prej jush, as prej atyre që nuk besuan. Vendbanimi juaj është zjarri; ai është zotërues i juaji, dhe vendbanim i trishtuar."

Degjenerimi i fesë

[16] A nuk është koha për ata që besuan t'i hapin zemrat e tyre për lajmin e Zotit, dhe të vërtetën që është shpallur këtu? Ata nuk duhet të jenë si ndjekësit e shkrimeve paraprake zemrat e të cilëve u bënë të ngurtësuar me kohë dhe, si pasojë, shumë prej tyre u bënë shpirtligj.

[17] Dijeni se Zoti e gjallëron tokën pasi të ketë vdekur. Kështu ai i shpjegon shpalljet për ju, që të mund të kuptoni.

[18] Padyshim, bamirësit dhe bamirëset, i kanë dhënë Zotit një hua të mirësisë. Ata do e pranojnë shpërblimin e tyre të shumëfishuar shumëfish; kanë merituar pagesë bujare.

[19] Ata që besuan në Zotin dhe të dërguarit e tij janë të shenjtët dhe dëshmorët. Të rezervuara për ta te Zotëruesi i tyre janë shpërblimet e tyre dhe drita e tyre. Sa për ata që nuk besuan dhe refuzuan shpalljet tona, kanë vetëshkaktuar Ferr.

Preokupimi me këtë jetë mallkohet

[20] Dijeni se jeta e kësaj bote nuk është asgjë më shumë se lojë e muhabet, dhe mburrje mes jush, dhe mbledhje e parave dhe fëmijëve. Është si shi i begatë që prodhon bimë dhe i kënaqë mosbesimtarët. Por pastaj bimët shndërrohen në kashtë të papërdorshme, dhe bahen nga era në humbje. Në Përjetësi ka ose ndëshkim të rëndë, ose falje nga Zoti dhe miratim. Jeta e kësaj bote nuk është asgjë më shumë se një iluzion i përkohshëm.

Alternativa inteligjente

[21] Prandaj, të garoni drejt faljes prej Zotëruesit tuaj, dhe një Parajse gjerësia e të cilës përfshinë qiejt dhe tokën. I pret ata që besuan në Zotin dhe të dërguarit e Tij. E tillë është hirësia e Zotit që ai e dhuron mbi këdo që Ai do. Zoti është Posedues i Hirësisë Pakufi.

*Fakt i thellë**

[22] Çfarëdo që të ndodhë në tokë, ose ty, tashmë ka qenë e regjistruar, madje edhe para krijimit. Kjo është lehtë për Zotin.

[23] Pra, nuk duhet të dëshpëroheni për gjërat që ju ikin, e as të krenoheni me gjërat që Ai ka

* 57:22 Ne jemi absolutisht të lirë të anojmë kah Zoti, apo kah Dreqi. Zoti e din saktësisht çfarë lloj vendimi secili prej nesh do të marrë. Video kasete e jetës tënde, nga lindja deri në vdekje, tashmë është e incizuar. Shih Shtojcën 14.

dhuruar mbi ju. Zoti nuk i do ata që janë mburracakë, krenarë.

[24] Ata janë dorështrënguar, dhe i shtyjnë njerëzit të jenë dorështrënguar. Nëse dikush refuzon, atëherë Zoti është i Pasur, i Falënderuar.

Hekuri: Metali më i përdorshëm

[25] I dërguam të dërguarit tonë të përkrahur me prova të qarta, dhe zbritëm te ta shkrimin dhe ligjin, që njerëzit të mund t'i përmbahen drejtësisë. Dhe e zbritëm hekurin, ku ka forcë, dhe shumë dobi për njerëzit. Krejt kjo në mënyrë që Zoti t'i dallojë ata që do të përkrahin Atë dhe të dërguarit e Tij, me besim. Zoti është i Fuqishëm, i Plotfuqishëm.

Profetët

[26] Ne dërguam Nuhun dhe Ibrahimin, dhe iu dhuruam pasardhësve të tyre profetllëk dhe shkrimin. Disa prej tyre ishin të udhëzuar, përderisa shumë prej tyre ishin shpirtligj.

Degjenerimi i fesë

[27] Pas tyre, dërguam të dërguarit tonë. Dërguam Jezusin të birin e Marisë, dhe i dhamë atij Ungjillin, dhe vendosëm në zemrat e ndjekësve të tij dashamirësi dhe mëshirë. Por ata shpikën oshënarinë të cilën nuk e shpallëm për ta. Krejt çka kërkuam prej tyre që të bëjnë ishte që t'iu përmbahen urdhrave të miratuar nga Zoti. Por ata nuk iu përmbajtën lajmit ashtu si duhej. Si pasojë, ne i dhamë atyre që besuan mes tyre pagesën e tyre, ndërsa shumë prej tyre ishin shpirtligj.

[28] O ju që besoni, t'ia keni dronë Zotit dhe të besoni në të dërguarin e Tij. Ai pastaj do t'ju dhurojë juve shpërblim të dyfishtë nga mëshira e Tij, t'ju pajisë me dritë për t'ju udhëzuar, dhe t'ju falë. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[29] Pra, ndjekësit e shkrimit paraprak duhet ta dinë se ata nuk e kanë monopolizuar mëshirën dhe hirësinë e Zotit, dhe se e gjithë hirësia është në dorën e Zotit. Ai e dhuron atë mbi këdo që Ai do. Zoti është Posedues i Hirësisë Pakufi.

Surja 58: Debati (El-Muxhadile)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Zoti e ka dëgjuar gruan që debatoi me ty për burrin e saj, dhe u ankua te Zoti. Zoti dëgjoi çdo gjë që ju të dy diskutuat. Zoti është Dëgjues, Pamës.

[2] Ata mes jush që i largojnë gratë e veta (duke i shpallur të ndaluara në seks) si nënat e veta e dinë shumë mirë që ato nuk janë nënat e tyre.* Nënat e tyre janë gratë që i lindën ata. Vërtetë, ata po kryejnë blasfemi dhe gënjeshtër. Zoti është Shlyes Mëkatesh, Falës.

[3] Ata që i largojnë gratë e veta në këtë mënyrë, e më pas pajtohen, ta lajnë fajin duke e liruuar një skllav para se të rifillojnë marrëdhëniet seksuale. Kjo është për t'ju këshilluar juve. Zoti është Njohës i çdo gjëje që bëni.

[4] Nëse nuk mund të gjeni një skllav për të liruuar, të agjëroni dy muaj rresht para se t'i rifilloni marrëdhëniet seksuale. Nëse nuk mund të agjëroni, atëherë t'i ushqeni gjashtëdhjetë njerëz të varfër. Të besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij. Këto janë ligjet e Zotit. Mosbesimtarët kanë vetëshkaktuar një ndëshkim që dhemb.

[5] Padyshim, ata që e luftojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij pësojnë disfatë, sikur homologët e tyre të mëparshëm që pësuan disfatë. Ne kemi zbritur prova të qarta, dhe refuzuesit kanë

* 58:2 Largimi i gruas duke e shpallur atë si nënë e dikujt ishte traditë e lashtë në Arabi. Kjo është surja e vetme ku fjala "Allah" ndodhet në secilën strofë.

vetëshkaktuar ndëshkim të turpshëm.

[6] Do të vij dita kur Zoti do i ringjallë ata të gjithë, dhe t'i njoftojë për të gjitha që i kishin bërë. Zoti ka incizuar çdo gjë, përderisa ata e kanë harruar atë. Zoti është dëshmitar i të gjitha gjërave.

Zoti është me ty tani

[7] A nuk e kupton se Zoti di çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë? Nuk mund tre njerëz të bisedojnë fshehtë pa qenë Ai i katërti, as pesë pa qenë Ai i gjashti, as më pak se aq, as më shumë, pa qenë Ai atje me ta kudo që mund të jenë ata. Pastaj në Ditën e Ringjalljes, Ai do i njoftojë ata për çdo gjë që kishin bërë. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[8] A i ke vërejtur ata që u ishte ndaluar të konspironin fshehtë, pastaj insistuan në konspiracion? Ata konspirojnë për të kryer mëkate, shkelje, dhe mosbindje ndaj të dërguarit. Kur vijnë te ti, ata të përshëndesin me përshëndetje jo të shpallur nga Zoti. Ata thonë vet me vete, "Zoti nuk do të na ndëshkojë për shprehjet tona." PAGESA E TYRE E VETME ËSHTË XHEHENEMI, KU ATA DIGJEN; ÇFARË FATI I TMERRSHËM.

[9] O ju që besoni, nëse duhet të diskutoni fshehtë, të mos diskutoni për të kryer mëkate, shkelje, dhe mosbindje ndaj të dërguarit. Të diskutoni për të punuar drejtësi dhe të mbara. T'ia keni dronë Zotit, para të cilit do të mblidheni.

[10] Komploti i fshehtë është ideja e djallit, nëpërmjet të cilit ai kërkon t'i lëndojë ata që besuan. Megjithatë, ai nuk mund t'i lëndojë ata përkundër vullnetit të Zotit. Në Zotin besimtarët të kenë besim.

[11] O ju që besoni, nëse ju thuhet, "Ju lutem bëni vend," të bëni vend për njëri tjetrin për tu ulur. Zoti pastaj do të bëjë vend për ju. Nëse kërkohet nga ju që të ngriteni dhe të lëvizni, ngrituni dhe lëvizni. Zoti i ngritë ata mes jush që besojnë, dhe ata që fitojnë dituri në rangje më të larta. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

[12] O ju që besoni, kur të dëshironi të diskutoni me të dërguarin, të ofroni një bamirësi (për të varfrit) para se të bëni ashtu. Kjo është më mirë për ju, dhe më pastër. Nëse nuk keni mundësi për këtë, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[13] Nëse nuk arritët të jepni bamirësi para se të diskutoni, pastaj u penduat pas saj, Zoti pranon pendimin tuaj. T'i zbatoni lutjet e kontaktit (Salat), të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe t'i bindeni Zotit dhe të dërguarit të Tij. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

Zgjidhni shokët tuaj

[14] A i ke vërejtur ata që i bëjnë shokë njerëzit me të cilët Zoti është i zemëruar? Ata as nuk përkasin me ty, as me ata. Ata qëllimisht betohen rrejshëm!

[15] Zoti ka përgatitur për ta ndëshkim të rreptë. E tmerrshme vërtetë është çka ata bënin.

[16] Ata i përdorën betimet e tyre si mjet për të zbrapsur nga rruga e Zotit. Si pasojë, ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim të turpshëm.

[17] As paratë e tyre, as fëmijët e tyre nuk do i ndihmojnë ata kundër Zotit. Ata kanë vetëshkaktuar zjarrin, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[18] Do të vijë Dita kur Zoti i ringjall të gjithë ata. Ata do i betohen Atij atëherë, ashtu si të betohen ty tani, duke menduar se ata vërtetë kanë të drejtë! Vërtetë, ata janë gënjeshtarët e vërtetë.

[19] Djalli i ka pushtuar ata, dhe i ka bërë ta shpërfillin lajmin e Zotit. Ata janë pala e djallit. Patjetër, pala e djallit janë humbësit.

[20] Padyshim, ata që kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij do të jenë me më të poshtëruarit.

[21] Zoti ka shpallur: "Unë dhe të dërguarit e Mi do të fitojmë patjetër." Zoti është i Fuqishëm, i

Plotfuqishëm.

Ik për të shpëtuar

[22] Nuk do të gjesh njerëz që besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit duke i bërë shokë ata që e kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur ata të ishin prindërit e tyre, apo fëmijët e tyre, apo vëllezërit e tyre, apo fisi i tyre. Për këta, Ai vendosë besim në zemrat e tyre, dhe i përkrahë me frymëzim nga Ai, dhe i pranon në kopshte me proje që rrjedhin ku qëndrojnë përgjithmonë. Zoti është i kënaqur me ta, dhe ata janë të kënaqur me Të. Këta janë pala e Zotit. Patjetër, pala e Zotit janë fituesit.

Surja 59: Eksodi (El-Hashr)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Duke e madhëruar Zotin është çdo gjë në qiej dhe tokë, dhe Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Zoti i mbron besimtarët

[2] Ai është Ai që i dëboi ata që nuk besuan mes njerëzve të shkrimit prej shtëpive të tyre në një eksod masiv. Ju nuk menduat se ata do të largohen, dhe ata menduan se përgatitjet e tyre do i mbronin ata prej Zotit. Por pastaj Zoti erdhi te ta nga nuk e pritën, dhe hodhi tmerr në zemrat e tyre. Kështu, ata i braktisën shtëpitë e tyre me vullnetin e vet, plus nga presioni prej besimtarëve. Ju duhet të mësoni nga kjo, o ju që posedoni vizion.

[3] Nëse Zoti nuk do i detyronte të largoheshin, Ai do i paguante ata në këtë jetë (madje edhe më keq se sa t'i detyronte të largoheshin). Në Përjetësi Ai do i parashtrijë në ndëshkimin e Ferrit.

[4] Kjo është për shkak se e kundërshtuan Zotin dhe të dërguarin e Tij. Për ata që kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij, Zoti është më i rrepti në zbatimin e ndëshkimit.

[5] E pretë një lis ose e latë të qëndrojnë mbi trungun e vet është në përputhje me vullnetin e Zotit. Ai padyshim do i poshtërojë shpirtligjtë.

[6] Çfarëdo që Zoti ktheu te i dërguari i Tij nuk ishte rezultat i përpjekjeve tuaja në luftë, qoftë nëse luftuat me kuaj apo në këmbë. Zoti është Ai që dërgon të dërguarit e Tij kundër kujtdo Ai. Zoti është i Gjithëfuqishëm.

Plaçkat e luftës

[7] Çfarëdo që Zoti ktheu te i dërguari i Tij nga shoqëritë (e mposhtura) të shkojë te Zoti dhe i dërguari i Tij (në formë bamirësie). T'ia jepni të afërmve, jetimëve, të varfërve, dhe udhëtarit të huaj. Kështu, nuk do të mbetet e monopolizuar nga të fortit mes jush. Mund t'i mbani plaçkat që ju jepen nga i dërguari, por mos merrni çka nuk ju lejon të merrni. T'ia keni dronë Zotit. Zoti është i rreptë në zbatimin e ndëshkimit.

[8] (Tu jepni) nevojtarëve që imigruan. Ata u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u hoqën nga pronat e tyre, sepse ata kërkuan hirësinë dhe kënaqësinë e Zotit, dhe sepse ata e përkrahën Zotin dhe të dërguarin e Tij. Ata janë të sinqertit.

[9] Sa për ata që i furnizuan me shtëpi dhe strehë, dhe ishin besimtarë para tyre, ata i duan ata që imigruan te ta, dhe nuk gjejnë asnjë ngurrim në zemrat e tyre për t'iu ndihmuar. Në fakt, ata me gatishmëri iu japin atyre përparësi mbi veten, edhe kur ata vetë kanë nevojë për atë që e japin. Vërtetë, ata që e kapërcejnë dorështrënguarinë e natyrshme të tyre janë të suksesshmit.

[10] Ata që u bënë besimtarë pas tyre thanë, "Zotëruesi ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që na paraprinë në besim, dhe ruana zemrat nga ushqimi i ndonjë urrejtjeje ndaj atyre që besuan.

Zotëruesi ynë, Ti je i Dhimbshëm, i Mëshirshëm.”

[11] A i ke vërejtur ata që janë të pllakosur me hipokrizi, dhe si ata iu thanë shoqëruesve të tyre në mosbesim mes njerëzve të shkrimit, “Nëse dëboheni ne do të dalim me ju dhe nuk do i bindemi askujt që ju kundërshton juve. Nëse dikush ju lufton juve, ne do të luftojmë në anën tuaj.” Zoti dëshmon se ata janë gënjeshtarë.

[12] Në fakt, po të dëboheshin, nuk do të dilnin me ta, dhe po t’i luftonte ndokush, ata nuk do i përkrahnin. Edhe sikur t’i përkrahnin, do të ishin kthyer prapa dhe të iknin. Nuk do të mund të fitonin.

[13] Vërtetë, ju shkaktoni më shumë tmerr në zemrat e tyre sesa frika e tyre nga Zoti. Kjo është për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

[14] Ata nuk bëhen bashkë për t’ju luftuar juve në mos qofshin në ndërtesa të mbrojtura mirë, ose pas muresh. Fuqia e tyre duket e fortë mes tyre. Ju do të mendonit se ata janë të bashkuar kur në fakt zemrat e tyre janë të ndara. Kjo është për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

[15] Fati i tyre është i njëjtë si i homologëve të tyre që iu paraprinë. Ata vuajtën pasojat e vendimeve të tyre. Ata kanë vetëshkaktuar ndëshkim që dhemb.

[16] Ata janë si djalli: ai i thotë qenies njerëzore, “Mos beso,” pastaj sapo ai të mos besojë, ai thotë, “Unë të bëj hasha ty. E kam frikë Zotin, Zotëruesin e gjithësisë.”

[17] Përfundimi për të dy ata është Zjarri, ku qëndrojnë përgjithmonë. Kjo është pagesa për shkelësit.

[18] O ju që besoni, t’ia keni dronë Zotit, dhe le të ekzaminojë secili shpirt çka ka dërguar përpara për nesër. T’ia keni dronë Zotit; Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

[19] Mos u bëni si ata që harruan Zotin, kështu që Ai i bëri ta harrojnë veten. Këta janë shpirtligjtë.

[20] Nuk janë të barabartë banuesit e Zjarrit dhe banuesit e Parajsës; banuesit e Parajsës janë fituesit.

Madhështia e Kuranit

[21] Sikur t’ia shpallnim këtë Kuran një mali, do e shihje duke u dridhur, duke u thërrmuar, nga respekti për Zotin. Ne i përmendim këta shembuj për njerëzit, që të mund të pasqyrojnë.

Zoti

[22] Ai është Zoti Një; nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij. Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve. Ai është Mirëbërësi, i Mëshirshmi.

[23] Ai është Zoti Një; nuk ka asnjë zot tjetër përkrah Tij. Mbreti, Më i Shenjti, Paqja, Më i Besueshmi, Më i Larti, i Plotfuqishmi, Më i Fuqishmi, Më i Madhëruari. Zoti qoftë i madhëruar; larg nga të pasurit e partnerëve.

[24] Ai është Zoti Një; Krijuesi, Nismëtari, Dizajnuesi. Të Tij janë emrat më të bukur. Atë është duke e madhëruar çdo gjë në qiej dhe tokë. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Surja 60: Testi (El-Mumtehineh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] O ju që besoni, të mos shoqëroheni me armiqtë e Mi dhe armiqtë e juaj, duke iu shprehur dashuri dhe miqësi, edhe pse ata nuk kanë besuar në të vërtetën që ka ardhur te ju. Ata e keqtrajtojnë të dërguarin, dhe juve, vetëm sepse ju besoni në Zotin, Zotëruesin tuaj. Nëse mobilizoheni për të luftuar për kauzën Time, duke kërkuar bekimet e Mia, si mund t’i doni ata fshehurazi? Unë jam tërësisht i vetëdijshëm për çdo gjë që fshihni, dhe çdo gjë që deklaroni. Ata

mes jush që e bëjnë këtë në të vërtetë janë humbur nga rruga e drejtë.

[2] Sa herë që ju hasin juve, ata ju trajtojnë si armiq, dhe ju lëndojnë me duart dhe gjuhët e tyre. Ata dëshirojnë që ju të mos besoni.

[3] Të afërmit tuaj dhe paratë tuaja nuk mund t'ju ndihmojnë. Në Ditën e Ringjalljes, Ai do të gjykojë mes jush. Zoti është Pamës i çdo gjëje që bëni.

Ibrahimi: Shembull

[4] Një shembull i mirë është vënë për ju nga Ibrahimi dhe ata me të. Ata iu thanë njerëzve të tyre, "Ne ju bëjmë hasha juve dhe idhujve që ju i adhuroni përveç Zotit. Ne prishemi me ju, dhe ju nuk do të shihni asgjë prej nesh përveç armiqësi dhe urrejtje derisa të besoni në VETËM Zotin."* Megjithatë, një gabim u bë nga Ibrahimi kur ai i tha babait të tij, "Unë do të lutem që ti të jesh i falur,* por unë nuk posedoj aspak fuqi të të mbroj nga Zoti." "Zotëruesi ynë, ne besojmë në Ty, dhe të nënshtrohemi Ty; te Ti është përfundimi.

[5] "Zotëruesi ynë, mos na le të jemi të shtypur nga ata që nuk besuan, dhe falna. Ti je i Plotfuqishmi, Më i Mençuri."

[6] Një shembull i mirë është vënë nga ta për ata që kërkojnë Zotin dhe Ditën e Fundit. Sa për ata që refuzojnë, Zoti nuk ka nevojë (për ta), Më i Falënderuari.

[7] Zoti mund ta ndryshojë armiqësinë mes jush dhe atyre në dashuri. Zoti është i Gjithëfuqishëm. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

Ligj themelor i rregullimit të marrëdhënieve me pabesimtarë

[8] Zoti nuk ua ndalon juve të shoqëroheni me ata që nuk ju luftojnë për shkak të fesë, dhe nuk ju dëbojnë nga shtëpitë tuaja. Ju mund të shoqëroheni me ta dhe të jeni të drejtë ndaj tyre. Zoti i do të drejtit.

[9] Zoti ju ndalon juve nga shoqërimi me ata që ju luftojnë për shkak të fesë, ju dëbojnë nga shtëpitë tuaja, dhe lidhen së bashku me të tjerët për t'ju syrgjynosur juve. Të mos shoqëroheni me ta. Ata që shoqërohen me ta janë shkelësit.

Në rast lufte

[10] O ju që besoni, kur gra besimtare (braktisin armikun dhe) kërkojnë azil me ju, t'i testoni ato. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për besimin e tyre. Kur të vlerësoni që ato janë besimtare, të mos i ktheni ato te mosbesimtarët. Ato nuk janë të ligjshme të mbeten të martuara me ta, e as nuk duhet që mosbesimtarët të lejohen të martohen me to. Ktheni prapa pajat që mosbesimtarët kanë paguar. Nuk bëni gabim nëse martoheni me to, përderisa ua keni paguar pajën e duhur. Mos i mbani gratë mosbesimtare (nëse dëshirojnë t'i bashkangjiten armikut). Mund të kërkonin nga to pajën që kishin paguar, dhe ata mund të kërkojnë çka ata paguan. Kjo është rregull e Zotit; Ai rregullon mes jush. Zoti është i Gjithëdijshëm, Më i Mençuri.

[11] Nëse gratë tuaja i bashkangjiten kampit të armikut, dhe ju jeni të detyruar të luftoni, ta detyroni armikun t'i kompensojë burrat që i humbën gratë e tyre, duke iu dhënë atyre atë që kishin shpenzuar për gratë e tyre. T'ia keni dronë Zotit, në të cilin besoni.

[12] O ti profet, kur besimtarët (që i braktisën mosbesimtarët) për të kërkuar azil te ti të të zotohen

* 60:4 Fjala arabe për "I VETËM" (VAHDAHU) ndodhet vetëm gjashtë herë në Kuran, njëra prej tyre i referohet zbatimit të VETËM Kuranit (17:46). Referimi për Zotin E VETËM ndodhet në 7:70, 39:45, 40:12 & 84, dhe 60:4. Shuma e këtyre numrave (7+70+39+45+40+ 12+84+60+4) është e barabartë me 361, ose 19x19. Kjo thekson se tema kryesore e Kuranit është "Adhurimi i Zotit të VETËM." Shih Shtojcën 1.

* 60:4 Ne mund të lutemi për udhëzimin e idhujtarëve, jo faljen, pasi që ligji i Zotit është që idhujtaria është krimi i vetëm jo i falshëm (4:48 & 116).

ty që ato nuk do të ngritin asnjë idhull përveç Zotit, as nuk do të vjedhin, as nuk do të kryejnë marrëdhënie jashtëmartesore, as nuk do i vrasin fëmijët e tyre, as të trillojnë gënjeshtër, as të jenë të pabindura ndaj fjalëve tua të drejta, ta pranosh zotimin e tyre, dhe lutju Zotit që t'i falë ato. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[13] O ju që besoni, mos u shoqëroni me njerëz me të cilët Zoti është i zemëruar, dhe që janë të ngulur në mosbesim në mënyrë të pashpresë; ata janë po aq të pashpresë sa mosbesimtarët që janë tashmë në varre.

Surja 61: Kolona (Es-Saff)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Duke e madhëruar Zotin është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[2] O ju që besuat, pse thoni çka nuk bëni?

[3] Më e neveritshmja para Zotit është që të thoni çka nuk bëni.

[4] Zoti i do ata që luftojnë për kauzën e Tij të bashkuar në një kolonë, si tullat në një mur.

[5] Kujtohuni që Moisiu i tha njerëzve të tij, "O njerëzit e mi, pse po më lëndoni, edhe pse e dini që jam i dërguari i Zotit te ju?" Kur ata devijuan, Zoti i devijoi zemrat e tyre. Se Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

I dërguar pas Jezusit

[6] Kujtohuni që Jezusi, i biri i Marisë, tha, "O Fëmijët e Izraelit, unë jam i dërguari i Zotit te ju, duke e konfirmuar Torahin dhe duke sjellë myzhde për një të dërguar që do të vijë mas meje emri i të cilit do të jetë edhe më i lavdëruar (Ahmed)." Pastaj, kur ai ua tregoi atyre provat e qarta, ata thanë, "Kjo është magji e shkathët."

[7] Kush është më i keq se ai që trillon rrena kundër Zotit, dhe është duke u ftuar në Nënshtrim? Zoti nuk i udhëzon njerëzit e këqij.

[8] Ata dëshirojnë ta shuajnë dritën e Zotit me gojë të tyre. Por Zoti insiston në përkryerjen e dritës së Tij, përkundër mosbesimtarëve.

Profecia e madhe

[9] Ai e ka dërguar të dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, dhe do e bëjë t'i dominojë të gjitha fetë, përkundër adhuruesve të idhujve.

Tregtia më e mirë

[10] O ju që besoni, le t'ju njoftoj Unë për një tregti që do t'ju shpëtojë prej një ndëshkimi që dhemb.

[11] Besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij dhe përpiquni për Zotin me paratë tuaja, dhe jetët tuaja. Kjo është tregtia më e mirë për ju, veç sikur ta dinit.

[12] Si shpërblim, Ai falë mëkatet tuaja, dhe ju pranon në kopshte me proje që rrjedhin, me pallate të bukura në kopshtet e Edenit. Ky është triumfi më i madh.

[13] Veç kësaj, ju merrni diçka që vërtetë e doni; përkrahje nga Zoti dhe fitore të garantuar. Jepu myzhde besimtarëve.

[14] O ju që besoni, jini përkrahësit e Zotit, sikur dishepujt e Jezusit, të birit të Marisë. Kur ai iu tha atyre, "Kush janë përkrahësit e mi drejt Zotit," thanë, "Ne jemi përkrahësit e Zotit." Pra, një grup prej Fëmijëve të Izraelit besoi, dhe një grup tjetër nuk besoi. Ne i ndihmuam ata që besuan kundër armikut të tyre, derisa fituan.

Surja 62: E Premtja (El-Xhumua)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Duke e madhëruar Zotin është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë; Mbretin, Më të Shenjtin, të Plotfuqishmin, Më të Mençurin.

[2] Ai është Ai që dërgoi te ata të pa shkrim një të dërguar nga mesi i tyre, për t'ua recituar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar ata, dhe mësuar atyre shkrimin dhe mençuri. Para kësaj, ata kishin shkuar shumë larg në humbje.

[3] Dhe shumë gjeneratave pasuese të tyre. Ai është i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

[4] E tillë është hirësia e Zotit që ai e dhuron mbi këdo Ai do. Zoti është Posedues i Hirësisë Pakufi.

[5] Shembulli i atyre që u është dhënë Torah, pastaj nuk arrijnë t'i përmbahen asaj, është si gomari duke bartur vepra të mëdha letërsie. I mjerë vërtetë është shembulli i njerëzve që refuzuan shpalljet e Zotit. Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

[6] Thuaj, "O ju që jeni Jahudi, nëse pretendoni se jeni të zgjedhurit e Zotit, me përjashtim të të gjithë njerëzve të tjerë, atëherë duhet të dëshironi vdekjen nëse jeni të sinqertë!"

[7] Ata nuk e dëshirojnë, për shkak të asaj që kanë kryer. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për shpirtligjtë.

[8] Thuaj, "Vdekja të cilës po përpiqeni t'i shmangeni do t'ju zë herët a vonë. Pastaj do të ktheheni te Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve, pastaj Ai do t'ju njoftojë për çdo gjë që kishit bërë."

Urdhër i rëndësishëm për të gjithë besimtarët

[9] O ju që besoni, kur të bëhet thirrja për Lutjen e Asamblesë (Salat El-Xhuma) të Premten, të shpejtoni për te përkujtimi i Zotit, dhe lëshojeni krejt punën. Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit.

[10] E kur të kryhet lutja, mund të shpërndaheni nëpër tokë për të kërkuar dhuratat e Zotit, dhe vazhdoni ta përkujtoni Zotin shpesh, që të mund t'ia dilni.

[11] Kur disa prej tyre kalojnë nëpër ndonjë pazar, ose ndonjë argëtim, ata mësyhen drejt saj dhe të lënë duke qëndruar! Thuaj, "Çka Zoti posedon është shumë më e mirë sesa argëtimi ose shitblerja. Zoti është Furnizuesi më i mirë."

Surja 63: Hipokritët (El-Munafikun)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Kur hipokritët vijnë te ti thonë, "Dëshmojmë që ti je i dërguari i Zotit."* Zoti e din që ti je i dërguari i Tij, dhe Zoti dëshmon që hipokritët janë gënjeshtarë.

[2] Duke u paraqitur si fetarë, ata i zmbropsin njerëzit nga rruga e Zotit. E tmerrshme vërtetë është çka ata bëjnë.

[3] Kjo është për shkak se ata besuan, pastaj nuk besuan. Kështu që, mendjet e tyre janë të bllokuara; nuk kuptojnë.

Një pullë në ballin e tyre

[4] Kur i sheh ata, mund të të lë përshtypje pamja e jashtme e tyre. Dhe kur flasin, mund të dëgjosh

* 63:1 "Shtylla e parë e Islamit," siç formulohet në 3:18 është që të dëshmojmë që Zoti është zoti i vetëm. Por shkollarët e korruptuar "Mysliman" shtojnë "Muhamedi është i dërguari i Zotit," dhe kjo shkelë një numër urdhrash (shih 2:285). Strofa 63:1 është vendi i vetëm në Kuran ku bëhet një thënie e tillë. Veç hipokritët bëjnë thënie të tillë.

elokuencën e tyre. Ata janë si trungje që qëndrojnë. Ata mendojnë që çdo thirrje është kundër tyre. Këta janë armiqtë e vërtetë; ruajuni prej tyre. Zoti i mallkon ata; ata kanë devijuar.

[5] Kur u thuhet atyre, “Ejani le të lutet i dërguari i Zotit për faljen tuaj,” ata me tallje i kthejnë kokat e tyre, dhe i shihni se si i zbrapsin të tjerët dhe sillen me mendjemadhësi.

*Miti i ndërmjetësimit shkatërrohet**

[6] Është e njëjtë për ta, qoftë u lute për faljen e tyre, apo nuk u lute për faljen e tyre; Zoti nuk do i falë ata. Se Zoti nuk i udhëzon njerëzit shpirtligj.

[7] Ata janë ata që thonë, “Mos iu jepni para atyre që ndoqën të dërguarin e Zotit, ndoshta e braktisin!” Megjithatë, Zoti i posedon thesaret e qiejve dhe tokës, por hipokritët nuk kuptojnë.

[8] Ata thonë, “Nëse kthehem te qyteti, të fuqishmit aty do i dëbojnë të dobët (dhe ne do të bëhemi viktimë).” (Ata duhet ta dinë se) i gjithë dinjiteti i takon Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe besimtarëve. Megjithatë, hipokritët nuk dinë.

[9] O ju që besoni, të mos iu tërhiqet vëmendja nga paratë tuaja dhe fëmijët tuaj prej përkujtimit të Zotit. Ata që e bëjnë këtë janë humbësit.

[10] Të jepni prej furnizimeve tona te ju para se të vijë vdekja te ju, se mos po thoni, “Zotëruesi im, vetëm sikur të mund ta shtyje këtë për një kohë të shkurtër! Atëherë do të jem bamirës dhe t’iu bashkangjitem të drejtëve!”

[11] Zoti nuk e shtynë kohën e caktuar të vdekjes për asnjë shpirt. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

Surja 64: Fajësim i dyanshëm (Et-Teghabun)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Duke e madhëruar Zotin është çdo gjë në qiej dhe çdo gjë në tokë. Atij i takon i gjithë mbretërimi, dhe Atij i takon i gjithë lavdërimi, dhe Ai është i Gjithëfuqishëm.

[2] Ai është Ai që ju krijoi juve, pastaj mes jush ka mosbesimtarë, dhe besimtarë. Zoti është krejtësisht Pamës i çdo gjëje që bëni.

[3] Ai krijoi qiejt dhe tokën për një qëllim specifik,* ju dizajnoi dhe përkreu dizajnin tuaj, pastaj te Ai është kthimi përfundimtar.

[4] Ai di çdo gjë në qiej dhe tokë, dhe Ai di çdo gjë që fshihni dhe çdo gjë që deklaroni. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[5] A i ke vërejtur ata që nuk besuan në të kaluarën, pastaj i vuajtën pasojat e vendimit të tyre? Ata vetëshkaktuan ndëshkim që dhemb.

[6] Kjo është sepse të dërguarit e tyre shkuan te ta me prova të qarta, por ata thanë, “A të ndjekim njerëz si ne?” Ata nuk besuan dhe refuzuan. Zoti nuk ka nevojë për ta; Zoti nuk ka asnjë nevojë, i Falënderuari.

[7] Ata që nuk besuan pretendojnë se nuk do të ringjallen! Gjithsesi, pasha Zotëruenin tim, do të ringjallen, dhe do të mbaheni përgjegjës për çdo gjë që keni bërë. Kjo është e lehtë për Zotin.

[8] Prandaj, të besoni në Zotin dhe të dërguarin e Tij, dhe dritën që e kemi shpallur këtu. Zoti është Njohës i tërësishëm i çdo gjëje që bëni.

[9] Do të vijë dita kur Ai ju mbledhë në Ditën e Mbledhjes. Ajo është Dita e Fajësimit të Dyanshëm.

* 63:6 Miliona njerëz i idhujtarizojnë profetët e tyre për shkak të këtij miti (Shtojca 8).

* 64:3 Ne jemi në këtë botë për shkak të mëshirës së pafund të Zotit. Mirëbërësi na ka dhënë një shans që ta shpengojmë veten. Shih Hyrjen dhe Shtojcën 7.

Kushdo që beson në Zotin dhe çon jetë të drejtë, Ai do ia heqë mëkatet e tij, dhe do e pranojë në kopshte me proje që rrjedhin. Ata qëndrojnë aty përgjithmonë. Ky është më i madhi triumf.

[10] Sa për ata që nuk besojnë dhe refuzojnë shpalljet tona, ata janë banuesit e Zjarrit; në të qëndrojnë përgjithmonë. Çfarë fati i tmerrshëm!

Ligj Hyjnor

[11] Asgjë nuk ju ndodhë përveç në përputhje me vullnetin e Zotit. Kushdo që beson në Zotin, Ai do ia udhëzojë zemrën. Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

[12] T'i bindeni Zotit dhe t'i bindeni të dërguarit. Nëse refuzoni, atëherë misioni i vetëm i të dërguarit tonë është që të japë lajmin.

[13] Zoti: nuk ka asnjë zot tjetër përveç Tij. Në Zotin besimtarët të kenë besim.

[14] O ju që besoni, bashkëshortet tuaja dhe fëmijët tuaj mund të jenë armiqtë e juaj; ruajuni. Nëse kini ndjesë, harroni, dhe falni, atëherë Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

[15] Paratë tuaja dhe fëmijët janë një test, dhe Zoti posedon një shpërblim të madh.

[16] Prandaj, t'ia keni dronë Zotit sa më shumë që mundeni, dhe dëgjoni, dhe binduni, dhe jepni bamirësi për të mirën tuaj. Kushdo që mbrohet nga dorështrënguarsia e vet, këta janë të suksesshmit.

[17] Nëse i jepni Zotit hua drejtësie, Ai do e shumëfishojë shpërblimin për ju shumëfish, dhe t'ju falë. Zoti është Mirënjohës, i Butë.

[18] Njohësi i të gjitha të fshehtave dhe deklarimeve; i Plotfuqishmi, Më i Mençuri.

Surja 65: Shkurorëzimi (Et-Talaq)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] O ti profet, kur ju njerëzit shkurorëzoheni prej grave, të siguroheni që të përmbushet një afat i shkurorëzimit. Ta matni afatin e tillë saktësisht.* T'ia keni dronë Zotit Zotëruesit tuaj. Mos i dëboni ato prej shtëpive të tyre, e as mos ua keqësoni jetën, për t'i detyruar që të largohen vet, në mos kryefshin marrëdhënie jashtëmartesore të vërtetuar. Këto janë ligjet e Zotit. Kushdo që i shkelë ligjet e Zotit kryen padrejtësi kundër vetes. Ku mund ta dish, ndoshta Zoti dëshiron që diçka e mirë të dalë prej kësaj.

[2] Kur të përmbushet afati, mund të pajtoheni me to me barazi, ose të shkoni deri në fund me ndarjen me barazi. Të keni dy dëshmitarë të drejtë që ta dëshmojnë shkurorëzimin para Zotit. Kjo është për t'i lehtësuar ata që besojnë në Zotin dhe Ditën e Fundit. Kushdo që ia ka dronë Zotit, Ai do të krijojë një dalje për të.

[3] Dhe do të furnizojë për të kah nuk e ka pritur. Kushdo që ka besim te Zoti, Ai i mjafton atij. Urdhrat e Zotit kryhen. Zoti e ka vendosur fatin e secilës gjë.

[4] Sa për gratë që kanë arritur menopauzën, nëse keni ndonjë dyshim, afati i tyre të jetë tre muaj. Sa për ato që nuk kanë menstruacion, dhe zbulojnë që janë shtatzënë, afati i tyre përfundon kur lindin. Kushdo që ia ka dronë Zotit, Ai e bën çdo gjë të lehtë për të.

[5] Ky është urdhri i Zotit që Ai zbret te ju. Kushdo që ia ka dronë Zotit, Ai ia largon mëkatet e tij, dhe e shpërblen me bujari.

[6] T'i lejoni ato të jetojnë në të njëjtën shtëpi në të cilën ato jetuan me ju, dhe mos ua vështirësoni aq shumë jetën që të largohen vetë. Nëse janë shtatzënë, të shpenzoni për to derisa të lindin. Nëse

* 65:1 Afati i të shkurorëzuarës, para se të bëhet e pranueshme për rimartesë, është një periudhë pritjeje e tre menstruacioneve. Kjo siguron që e shkurorëzuara nuk ishte shtatzënë (2:228).

e ushqejnë foshnjën, t'i paguani ato për këtë shërbim. T'i mbani marrëdhëniet miqësore mes jush. Nëse nuk pajtoheni, mund të punësoni një grua tjetër për ta ushqyer fëmijën.

[7] Bashkëshorti i pasur të furnizojë përkrashje sipas mundësive të veta, dhe i varfëri të furnizojë sipas mundësive që Zoti dhuroi mbi të. Zoti nuk ngarkon në asnjë shpirt më shumë se që i ka dhënë. Zoti do të furnizojë lehtësim pas vështirësisë.

[8] Mori shoqëri ngritën krye kundër urdhrave të Zotëruesit të vet dhe kundër të dërguarve të Tij. Si pasojë, i mbajtëm përgjegjës rreptësisht, dhe i paguam me pagesë të tmerrshme.

[9] Ata vuajtën pasojat e vendimeve të tyre; humbje e thellë.

[10] Zoti ka përgatitur për ta ndëshkim të rëndë. Prandaj, t'ia keni dronë Zotit, o ju që posedoni inteligjencë dhe besuat. Zoti ka zbritur te ju një lajm -

[11] një të dërguar* që reciton te ju shpalljet e Zotit, qartë, për t'i çuar ata që besojnë dhe punojnë drejt nga errësira te drita. Kushdo që beson në Zotin dhe çon jetë të drejtë, Ai do e pranojë në kopshte me proje që rrjedhin; aty qëndrojnë përgjithmonë. Zoti do e shpërblejë atë bujarisht.

*Shtatë gjithësi dhe shtatë toka**

[12] Zoti krijoi shtatë gjithësi dhe numër të njëjtë tokash. Urdhurat rrjedhin mes tyre. Kjo është për t'jua bërë me dije se Zoti është i Gjithëfuqishëm, dhe se Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për të gjitha gjërat.

Surja 66: Ndalea (Et-Tahrim)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] O ti profet, pse ndalon çka Zoti e ka bërë të lejueshme për ty, vetëm për t'i kënaqur gratë tua? Zoti është Falës, i Mëshirshëm.*

[2] Zoti ka shpallur për ju ligjet në lidhje me betimet tuaja. Zoti është Zotëruesi juaj, dhe Ai është i Gjithëdijshmi, Më i Mençuri.

[3] Profeti ia kishte besuar një pohim ca grave të tij, pastaj njëra prej tyre e përhap, dhe Zoti ia bëri me dije atij. Ai pastaj i njoftoi gratë e tij me një pjesë të çështjes, dhe e shpërfilli një pjesë. Ajo e pyeti, "Kush të njoftoi ty për këtë?" Ai tha, "U njoftova nga i Gjithëdijshmi, Më Njohësi."

[4] Nëse ju dyja pendoheni te Zoti, atëherë zemrat tuaja kanë dëgjuar. Por nëse bashkoheni kundër tij, atëherë Zoti është aleati i tij, dhe po ashtu Gabrieli dhe besimtarët e drejtë. Gjithashtu, engjëjt janë ndihmuesit e tij.

[5] Nëse shkurorëzohet me ju, Zotëruesi i tij do të zëvendësojë gra të tjera në vend tuajin që janë më të mira se ju; të nënshtruara (Myslimane), besimtare (Mu'mine), të dëgjueshme, të penduara, adhuese, të devotshme, ose të martuara më parë, ose virgjëresha.

[6] O ju që besoni, mbrojeni veten dhe familjet tuaja nga Zjarri që ushqehet me njerëz dhe gurë. Aty bëjnë roje engjëjt të rreptë dhe të fuqishëm që kurrë nuk janë të pabindur ndaj Zotit; ata bëjnë çfarëdo që urdhërohen të bëjnë.

[7] O ju që nuk besuat, mos kërkonit falje sot. Ju po paguheni vetëm për çka bëtë.

* 65:10-11 "I dërguari" këtu është qartë Kurani Strofa 10 flet për "zbritjen e një lajmi," dhe kjo thekson te Kurani si i dërguari në 65:11 (Shtojca 20).

* 65:12 Edhe pse Zoti krijoi gjashtë planetë tjerë që janë identik me Tokën tonë, vetëm në planetin tonë ka jetë. Kështu, evolucionistëve do tu tregohet në Ditën e Gjykimit që jeta nuk "evoluo" në planet veç për shkak të rrethanave të posaçme të saj.

* 66:1 Muhamedanët përreth botës besojnë se Muhamedi ishte i pagabueshëm. Kjo strofë na mëson se ai në fakt ishte qenie njerëzore e gabueshme (18:110, 33:37, 40:66, 80:1).

Besimtarët pendohen

[8] O ju që besoni, të pendoheni te Zoti me një pendim me vendosmëri. Zotëruesi juaj pastaj do t'ju largojë mëkatet tuaja dhe t'ju pranojë në kopshte me prroje që rrjedhin. Në atë ditë, Zoti nuk do të zhgënjejë profetin dhe ata që besuan me të. Drita e tyre do të rrezatojë para tyre dhe djathtas tyre. Ata do të thonë, "Zotëruesi ynë, përkryena dritën tonë, dhe falna; Ti je i Gjithëfuqishëm."

[9] O profet, lufto kundër mosbesimtarëve dhe hipokritëve dhe ji i rreptë me ta. Vendbanim i tyre është Xhehenemi, dhe një fat i tmerrshëm.

Miti i ndërmjetësimit rrënohet

[10] Zoti citon si shembuj të atyre që nuk besuan gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga shërbëtorët tonë të drejtë, por i tradhtuan dhe, si pasojë, ata nuk mund t'iu ndihmonin atyre aspak kundër Zotit. Atyre djave iu tha, "Hyni në Zjarr me ata që e merituan atë."

Shembuj të besimtareve: Gruaja e Faraonit

[11] Dhe Zoti citon si shembull i atyre që besuan gruan e Faraonit. Ajo tha, "Zotëruesi im, ndërto një shtëpi për mua te Ti në Parajsë, dhe më shpëto nga Faraoni dhe punët e tij; më shpëto nga njerëzit shkelës."

Maria

[12] Gjithashtu, Maria, Amramitja. Ajo mbrojti nderin e saj, pastaj ne frymë në të nga fryma jonë. Ajo besoi në fjalët e Zotëruesit të saj dhe shkrimet e Tij; ajo ishte e dëgjueshme.

Surja 67: Mbretërimi (El-Mulk)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Më i lartësuar është Ai në dorë të të cilit është i gjithë mbretërimi, dhe Ai është i Gjithëfuqishëm.

*Qëllimi i jetës sonë**

[2] Ai që krijoi vdekje dhe jetë me qëllim që të dallojë ata mes jush që do të bënin më mirë. Ai është i Plotfuqishmi, Falësi.

[3] Ai krijoi shtatë gjithësi në shtresa. Ti nuk sheh asnjë papërsosmëri në krijimin nga Mirëbërësi. Këqyr sa të duash; a e sheh ndonjë të metë?

[4] Këqyr për së dyti; sytë e tu do të kthehen të shastisur dhe të mposhtur.

[5] Zbukuroam gjithësinë më të ulët me llamba, dhe i mbrojtëm kufijtë e saj me predha kundër djave; përgatitëm për ta ndëshkim në Ferr.

[6] Për ata që nuk besuan në Zotëruesin e tyre, ndëshkimin e Xhehenemit. Çfarë fati i tmerrshëm.

[7] Kur flaken në të, e dëgjojnë përderisa shpërthen në tym.

[8] Gati sa nuk eksplodon nga vrulli. Sa herë një grup flaket në të, rojat e tij do i pyesin, "A nuk pranuat paralajmërues?"

[9] Ata do të përgjigjen, "Po vërtetë; një paralajmërues na erdhi, por nuk besuam dhe thamë, 'Zoti nuk shpalli asgjë. Ju jeni plotësisht të humbur.'"

[10] Ata gjithashtu thanë, "Po të dëgjonim ose të kuptonim, nuk do të ishim mes banuesve të Ferrit!"

[11] Kështu, ata i rrëfyan mëkatet e tyre. Mjerë banuesit e Ferrit.

[12] Sa për ata që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre, edhe kur janë vetë, kanë arritur falje dhe

* 67:2 Shih Hyrjen dhe Shtojcën 7 për hollësitat e qëllimit të kësaj bote.

shpërblim shumë të madh.

[13] I mbajtët shprehjet fshehtë, apo i deklaruat, Ai është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet më të thella.

[14] A nuk duhet ta njohë Ai çka ka krijuar? Ai është Preciz, Më Njohësi.

[15] Ai është Ai që e vuri Tokën në shërbimin tuaj. Enduni nëpër skaje të saj, dhe hani nga furnizimet e Tij. Te Ai është mbledhja përfundimtare.

[16] A keni garantuar se Ai në qiell nuk do të godasë tokën dhe ta bëjë të gremiset?

[17] A keni garantuar se Ai në qiell nuk do të dërgojë mbi ju një stuhi të fortë? A do të vlerësoni atëherë vlerën e paralajmërimeve të Mia?

[18] Të tjerë para tyre nuk kanë besuar; sa e tmerrshme ishte pagesa Ime!

[19] A nuk i kanë parë zogjtë mbi ta të renditur në rreshta dhe me krahë të hapur? Mirëbërësi është Ai që i mbanë ata në ajër. Ai është Pamës i të gjitha gjërave.

[20] Ku janë ata ushtarë që mund t'ju ndihmojnë kundër Mirëbërësit? Vërtetë, mosbesimtarët po mashtrohen.

[21] Kush është ai që ju furnizon, nëse Ai mban furnizimet e Tij? Vërtetë, ata janë zhytur thellë në shkelje dhe neveri.

[22] A është ai që ecë përderisa është i rrëzuar me fytyrë për balte më mirë i udhëzuar, apo ai që ecë në rrugën e drejtë?

[23] Thuaj, "Ai është Ai që ju nisi juve, dhe ju bëri me veshë, sy, dhe mendje. Sa rrallë jeni mirënjohës."

[24] Thuaj, "Ai është Ai që ju vendosi në tokë, dhe para Tij do të mblidheni."

[25] Ata sfidojnë: "Kur do të vijë ajo profeci, nëse jeni të sinqertë?"

[26] Thuaj, "Njohuria e tillë është me Zotin; unë nuk jam më shumë se një paralajmërues i qartë."

[27] Kur ata ta shohin duke ndodhur, fytyrat e atyre që nuk besuan do të bëhen të vrerosura, dhe do të shpallet: "Kjo është me çka dikur talleshit."

[28] Thuaj, "Nëse Zoti vendosë të më asgjësojë mua dhe ata me mua, ose të derdhë mëshirën e Tij mbi ne, kush është ai që mund t'i mbrojë mosbesimtarët nga një ndëshkim që dhemb?"

[29] Thuaj, "Ai është Mirëbërësi; besojmë në Të, dhe kemi besim në Të. Padyshim do e merrni vesh kush është vërtetë larg në humbje."

[30] Thuaj, "Çka nëse uji juaj fundoset larg, kush do t'ju furnizojë me ujë të pastër?"

Surja 68: Lapsi (El-Kalem)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] NuN,* lapsi, dhe çka ata (njerëzit) shkruajnë.

[2] Ti ke arritur bekim shumë të madh nga Zotëruesi yt; nuk je i çmendur.

[3] Ke arritur shpërblim që është fare mirë i merituar.

[4] Je i bekuar me karakter shumë të moralshëm.

[5] Do të shohësh, dhe do e shohin.

[6] Cili prej jush jeni të mallkuar.

[7] Zotëruesi yt është tërësisht i vetëdijshëm për ata që humbën larg rrugës së Tij, dhe Ai është tërësisht i vetëdijshëm për ata që janë të udhëzuar.

[8] Mos iu bind refuzuesve.

* 68:1 "NuN" është e veçantë mes inicialeve të mrekullueshme të Kuranit. Shih Shtojcën 1.

- [9] Ata dëshirojnë të bësh kompromis, që edhe ata të mund të bëjnë kompromis.
- [10] Mos iu bind asnjë të poshtrit që bën be.
- [11] Shpifësit, përgojuesit.
- [12] Ndaluesit të bamirësisë, shkelësit, mëkatarit.
- [13] Jo mirënjohës, dhe lakmues.
- [14] Edhe pse ai posedon mjaft para dhe fëmijë.
- [15] Kur shpalljet tona i recitohen atij, thotë, "Përralla të moçme!"
- [16] Do ia shënojmë fytyrën.
- [17] I kemi testuar ata si i kemi testuar pronarët e kopshtit që bënë be se do e vjelin në mëngjes.
- [18] Ata ishin aq absolutisht të sigurt.
- [19] Një (stuhi) kalimtare nga Zotëruesi yt kaloi nga ai përderisa ata ishin në gjumë.
- [20] Në mëngjes, ishte shkret.
- [21] E thirrën njëri tjetrin në mëngjes.
- [22] "Le të shkojmë t'i vjelim të mbjellat."
- [23] Rrugës, i thanë njëri tjetrit në fshehtësi.
- [24] Se prej atëherë e tutje, asnjëri prej tyre nuk do të ishte i varfër.
- [25] Ata ishin aq krejtësisht të sigurt për vjeljen e tyre.
- [26] Por kur e panë, thanë, "Sa gabim ishim!"
- [27] "Tash, nuk kemi asgjë!"
- Është dashur të thonë: "Dashtë Zoti."*
- [28] Të drejtit mes tyre thanë, "Vetëm sikur të madhëronit (Zotin)!"
- [29] Ata thanë, "I madhëruar qoftë Zotëruesi ynë. Kemi bërë shkelje."
- [30] Filluan ta fajësojnë njëri tjetrin.
- [31] Thanë, "Mjerë ne. Mëkatuam.
- [32] "Na dhuroftë Zotëruesi ynë një më të mirë. Pendohemi te Zotëruesi ynë."
- [33] E tillë ishte pagesa. Por ndëshkimi i Përjetësisë është shumë më i keq, veç sikur ta dinin.
- [34] Të drejtit kanë merituar, te Zotëruesi i tyre, kopshte hareje.
- [35] A t'i trajtojmë të Nënshtruarit si kriminelët?
- [36] Çka nuk është në rregull me logjikën tuaj?
- [37] A keni libër tjetër për t'iu përmbajtur?
- [38] Në të, a gjeni çfarëdo që dëshironi?
- [39] Apo, mos keni pranuar garancion të sigurt nga ne që ju dhuron çfarëdo që dëshironi në Ditën e Ringjalljes?
- [40] Pyeti ata, "Kush e garanton këtë për ju?"
- [41] A kanë idhuj? Le t'i ndihmojnë idhujt e tyre, nëse janë të sinqertë.
- [42] Do të vijë dita kur ata do të ekspozohen, dhe do të kërkohet nga ta që të bien në përlulje, por ata nuk do të munden.
- [43] Me sytë e tyre të ulur, poshtërimi do i mbulojë. U ftuan të bien në përlulje kur ishin të pacenuar dhe të aftë.
- [44] Prandaj, le të merrem Unë me ata që refuzuan këtë Hadith; do i çojmë kah nuk ua merr mendja.
- [45] Do të lëshoj pe mjaft; Planifikimi im është i fortë.
- [46] A po iu kërkon atyre para, e ata po ngarkohen nga gjoba?

[47] A e dinë ata të ardhmen? A e kanë të regjistruar?

[48] Të këmbëngulësh me durim në zbatimin e urdhrave të Zotëruesit tënd. Mos u bë si (Jona) që thirri nga brendësia e peshkut.

[49] Po të mos ishte hirësi e Zotëruesit të tij, ai do të nxirrej në shkretëtirë si mëkatar.

[50] Por Zotëruesi i tij e bekoji atë, dhe e bëri të drejtë.

[51] Ata që nuk besuan e shfaqin përqeshjen e tyre në sytë e tyre kur e dëgjojë lajmin dhe thonë, "Ai është i çmendur!"

[52] Në fakt është lajm për botën.

Surja 69: E pakontestueshme (El-Hakah)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] E pakontestueshmja (ngjarje).

[2] Çka është e pakontestueshmja!

[3] Është vërtetë e pakontestueshme.

[4] Themudi dhe Adi nuk besuan në Tronditjen.

[5] Sa për Themudin, ata u asgjësuan nga (tërmeti) shkretues.

[6] Sa për Adin, ata u asgjësuan nga një stuhi e fortë, e vazhdueshme.

[7] Ai e lëshoi atë mbi ta për shtatë net e tetë ditë, me forcë. Mund t'i shihje njerëzit të hedhur përreth si të ishin trungje palmash të kalbura.

[8] A mund të gjesh ndonjë gjurmë të tyre?

[9] Faraoni, të tjerët para tij, dhe mëkatuesit (e Sodomës) ishin shpirtligj.

[10] Ata nuk iu bindën të dërguarit të Zotëruesit të tyre. Si pasojë, Ai ua pagoi atyre një pagesë shkretuese.

[11] Vërshimi ishte shkretues, kështu që ju bartëm në (arkën) lundruese.

[12] Atë e bëmë mësim për ju, që cilido vesh që dëgjon të mund të kuptojë.

[13] Kur t'i bihet bririt një herë.

[14] Toka dhe malet do të fluturisen dhe të thërrmohen; krejtësisht të thërrmuara.

[15] Atëherë i vjen dita ngjarjes së pashmangshme.

[16] Qielli do të çahet, dhe të priset.

[17] Engjëjt do të qëndrojnë skaj më skaj, dhe pushteti i Zotëruesit tënd pastaj do të përfshijë tetë (gjithësi).*

[18] Në atë ditë, do të ekspozoheni, asgjë e juaja nuk mund të fshihet.

Besimtarët

[19] Sa për atë që pranon regjistrin e tij me dorën e tij të djathtë, do të thotë, "Ejani lexojeni regjistrin tim.

[20] "Unë besova se do të jepja llogari."

[21] Ai ka merituar jetë të lumtur.

[22] Në Parajsë të lartësuar.

[23] Frutat e saj janë lehtë të arritshme.

[24] Hani e pini në lumturi si shpërblim për punët tuaja në ditët e kaluara.

* 69:17 Kjo tokë është plot vuajtje për shkak të largësisë fizike të saj nga Zoti, pasi që ajo është në gjithësinë e shtatë (7:143). Në Përrjetësi, një gjithësi e tetë do të krijohet që do të jetë edhe më larg se gjithësia jonë e shtatë; ajo do të quhet "Ferr" (89:23).

Mosbesimtarët

- [25] Sa për atë që i jepet regjistri i tij në dorën e tij të majtë, ai do të thotë, "Ah sikur të mos pranoja regjistrin tim kurrë.
- [26] "Ah sikur të mos e dija kurrë llogarinë time.
- [27] "Ah sikur vdekja ime të ishte e përhershme.
- [28] "Paratë e mia nuk mund të më ndihmojnë.
- [29] "E gjithë fuqia ime iku."
- [30] Merrnie atë dhe prangosnie.
- [31] Digjnie atë në Ferr.
- [32] Në një zinxhirë që është i gjatë shtatëdhjetë kutë, lidheni.
- [33] Se ai nuk besoi në Zotin, Më të Madhin.
- [34] As nuk e përkrahu të ushqyerit e të varfërve.
- [35] Si pasojë, ai nuk ka asnjë shok këtu.
- [36] As ndonjë ushqim, përveç llojit të hidhur.
- [37] Ushqim për mëkatarët.
- [38] Beto hem me çka shihni.
- [39] Dhe çka nuk shihni.
- [40] Ky (Kuran) është shprehja e një të dërguari të nderuar.
- [41] E jo shprehja e një poeti; rrallë besoni.
- [42] As shprehja e një fallxhiu; rrallë merrni vesh.
- [43] Shpallje prej Zotëruesit të gjithësisë.

Muhamedit nuk i lejohej të nxjerrë asnjë mësim fetar

- [44] Po të shprehte ai ndonjë mësim tjetër.
- [45] Do e kishim ndëshkuar.
- [46] Do i kishim ndërprerë shpalljet te ai.
- [47] Askush prej jush nuk do të mund t'i ndihmonte.
- [48] Ky është një kujtim për të drejtit.
- [49] E dimë; disa prej jush janë refuzues.
- [50] Nuk është tjetër pos pikëllim për mosbesimtarët.
- [51] Është e vërteta absolute.
- [52] Prandaj, ta madhërosh emrin e Zotëruesit tënd, Më të Madhit.

Surja 70: Lartësitë (El-Me'arixh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Një pyetës mund ta vë në pikëpyetje ndëshkimin e pashmangshëm.
- [2] Për mosbesimtarët, askush nuk mund ta ndalë.
- [3] Nga Zoti; Poseduesi i Lartësisë më të lartë.
- [4] Engjëjt, me raportet e tyre, ngjiten te Ai në një ditë që është baras me pesëdhjetë mijë vjet.
- [5] Prandaj, të mbahesh me durim të këndshëm.
- [6] Se ata e shohin shumë larg.
- [7] Përderisa ne e shohim shumë afër.
- [8] Do të vij dita kur qielli do të jetë si gurë të shkrirë.
- [9] Malet do të jenë si lesh e li.

- [10] Asnjë shok nuk ka gajle për shokun e tij të ngushtë.
- [11] Kur i shohin ata, fajtori do të dëshirojë që të mund t'i jepte fëmijët e vet si haraç, për ta kursyer atë nga ndëshkimi i asaj dite.
- [12] Edhe bashkëshorten e vete, dhe vëllanë e vet.
- [13] Madje tërë fisin e vet që e rriti.
- [14] Madje të gjithë njerëzit në tokë, nëse ajo do e shpëtonte.
- [15] Jo; ajo është flakë.
- [16] E etur për të djegur.
- [17] I thërret ata që refuzuan.
- [18] Ata që mblodhën dhe numëruan.
- [19] Vërtetë, qenia njerëzore është e shqetësuar.
- [20] Nëse preket me fatkeqësi, e dëshpëruar.
- [21] Nëse bekohet me pasuri, dorështrënguar.
- [22] Përveç adhuruesve.
- [23] Që gjithmonë i zbatojnë lutjet e tyre të kontaktit (Salat).
- [24] Një pjesë e parave të tyre lihet anash.
- [25] Për të varfrit dhe nevojtarët.
- [26] Ata besojnë në Ditën e Gjykimit.
- [27] Ia kanë dronë shpagimit të Zotëruesit të tyre.
- [28] Shpagimin e Zotëruesit të tyre nuk e marrin për tallje.
- [29] E mbajnë dëlirësinë e tyre.
- [30] (Kanë marrëdhënie) vetëm me bashkëshortet, ose çka është ligjërishit e tyre -
- [31] kushdo që i shkelë këto kufizime është mëkatar.
- [32] Dhe besimtarët e mbajnë fjalën; ata janë të besueshëm.
- [33] Dëshmia e tyre është e vërtetë.
- [34] Ata vazhdimisht i zbatojnë lutjet e tyre të kontaktit (Salat) me kohë.
- [35] Ata kanë merituar pozita të ndershme në Parajsë.
- [36] Çka po i shtynë ata që nuk besuan për tu mos bashkangjitur ty?
- [37] Në të djathtë, dhe në të majtë, ikin.
- [38] Si mundet cilido prej tyre të presë të hyjë në Parajsën e hareshme?
- [39] Kurrë; i krijuam ata, dhe e dinë nga çka.
- [40] Beto hem solemnisht në Zotëruesin e lindjeve dhe perëndimeve; ne jemi të aftë -
- [41] të zëvendësojmë njerëz më të mirë në vend tuajin; nuk mund të mposhtemi.
- [42] Prandaj, le të enden e bredhin, derisa të hasin në ditën që po i pret.
- [43] Ajo është dita kur ata dalin nga varret me ngut, sikur shtyhen te altarët (e flijimit).
- [44] Me sytë e tyre të ulur, turpi do i mbulojë. Ajo është dita që po i pret.

Surja 71: Nuhu (Nuh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] E dërguam Nuhun te njerëzit e tij: "T'i paralajmërosh njerëzit e tu para se një ndëshkim që dhemb t'i godasë."
- [2] Ai tha, "O njerëzit e mi, unë jam një paralajmërues i qartë te ju.
- [3] "Për t'ju alarmuar që ta adhuroni Zotin, t'ia keni dronë Atij, dhe të më bindeni.

- [4] "Ai pastaj do t'jua falë mëkatet tuaja dhe t'ju japë afat për një kohë të paracaktuar. Gjithsesi, caktimi i Zotit nuk mund të shtyhet kurrë, kur i vjen koha, veç sikur ta dinit."
- [5] Ai tha, "Zotëruesi im, i ftova njerëzit e mi natë e ditë."
- [6] "Por ftesa ime vetëm e rritë neverinë e tyre."
- [7] "Sa herë që i ftova të falen prej Teje, ata i vunë gishtat e tyre në veshët e tyre, e mbuluan veten me rrobat e tyre, këmbëngulën, dhe u bënë mendjemëdhenj."
- [8] "Pastaj i ftova publikisht."
- [9] "Pastaj iu thash me zë të lartë, dhe fola me ta privatisht."
- [10] "Thash, 'Lutjuni Zotëruesit tuaj për falje; Ai është Falës."
- [11] "Ai pastaj do t'ju derdhë juve shi me bollëk."
- [12] "Dhe t'ju furnizojë me para dhe fëmijë, dhe kopshte, dhe proje."
- [13] Pse të mos përqipeni t'ia keni dronë Zotit?
- [14] Ai është Ai që ju krijoi në faza."
- [15] A nuk e kuptoni se Zoti krijoi shtatë gjithësi në shtresa?
- [16] Ai e dizajnoi hënën në to për të qenë një dritë, dhe vuri diellin për të qenë llambë."
- [17] Dhe Zoti ju mbiu juve nga toka si bimë."
- [18] Pastaj Ai ju kthen në të, dhe Ai padyshim do t'ju nxjerrë."
- [19] Zoti e bëri tokën të banueshme për ju."
- [20] Që të mund të ndërtoni rrugë në të."
- [21] Nuhu tha, "Zotëruesi im, ata nuk mu bindën, dhe i ndoqën ata që ishin edhe më të korruptuar kur u bekuan me para dhe fëmijë."
- [22] "Ata planifikuan plane të tmerrshme."
- [23] "Ata thanë, 'Mos braktisni zotat tuaj. Mos braktisni Vedin, Suvën, Jeguthin, Jeukën, dhe Nesrin.'
- [24] "Ata çorientuan shumë. Prandaj, le të zhyten shpirtligjtë më thellë në humbje."
- [25] Për shkak të mëkateve të tyre ata u mbytën dhe u caktuan për te zjarri. Nuk gjetën asnjë ndihmues për t'i mbrojtur nga Zoti."
- [26] Nuhu gjithashtu tha, "Zotëruesi im, mos e le asnjë mosbesimtar në tokë."
- [27] "Se nëse i lë, ata vetëm do i çorientojnë shërbëtorët tuaj dhe të lindin asgjë tjetër pos mosbesimtarë shpirtligj."
- [28] "Zotëruesi im, më fal mua dhe prindërit e mi, dhe këdo që hyn në shtëpinë time si besimtar, dhe të gjithë besimtarët dhe besimtare. Por mos iu jep mosbesimtarëve asgjë pos asgjësim."

Surja 72: Xhinët (El-Xhinn)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Thuaj, "U frymëzova që një grup xhinësh dëgjuan, pastaj thanë, 'Kemi dëgjuar një Kuran të mrekullueshëm."
- [2] "Ai udhëzon në drejtësi, dhe ne kemi besuar në të; nuk do të ngrisim asnjë idhull përkrah Zotëruesit tonë."
- [3] "Më i Larti është Zotëruesi ynë i vetëm. Ai kurrë nuk pati bashkëshorte, as djalë."
- [4] "Janë budallenjtë mes nesh që dikur shprehnin gjeputura të tilla kundër Zotit."
- [5] "Mendua se as njerëzit, as xhinët, nuk do të mund të shprehnin gënjeshtër kundër Zotit."
- [6] "Qeniet njerëzore dikur kërkonin fuqi nëpërmjet qenieve xhin, por ata vetëm iu sillnin atyre

fatkeqësi të shumta.

[7] " `Ata menduan, ashtu si menduat ju, se Zoti nuk do të dërgonte tjetër (të dërguar).

[8] " `E prekëm qiellin dhe e gjetëm me roje të forta dhe predha.

[9] " `Uleshim atje në mënyrë që të përgjonim. Kushdo që dëgjon ndiqet nga një predhë e fuqishme.

[10] " `Nuk kemi asnjë ide nëse diçka e keqe është caktuar për banuesit e Tokës, ose nëse Zotëruesi i tyre do që t'i shpengojë ata.

[11] " `Disa prej nesh janë të drejtë, dhe disa janë më pak se të drejtë; ndjekim rrugë të ndryshme.

[12] " `E dinim fare mirë se nuk mund të ikim nga Zoti në Tokë; nuk mund të ikim dhe t'i shpëtojmë Atij.

[13] " `Kur e dëgjuam udhëzimin, besuam në të. Kushdo që beson në Zotëruesin e tij nuk do i frikësohet asnjë padrejtësie, as vuajtjeve.

[14] " `Mes nesh janë të nënshtruarit, dhe mes nesh janë ata që bëjnë kompromis.' " Sa për ata që u nënshtruan, ata janë në rrugën e drejtë.

[15] Sa për ata që bënë kompromis, ata do të jenë lëndë djegëse për Xhehenem.

[16] Nëse mbesin në rrugën e drejtë, do i bekojmë me ujë të bollshëm.

[17] Padyshim do i testojmë të gjithë. Sa për atë që e shpërfillë lajmin e Zotëruesit të tij, Ai do e çojë atë në ndëshkim që shtohet pa ndalë.

[18] Vendet e adhurimit i takojnë Zotit; mos thirrni në askënd tjetër përkrah Zotit.

[19] Kur shërbëtori i Zotit e përkrah vetëm Atë, gati të gjithë prej tyre u bënë bashkë për ta kundërshtuar atë.

[20] Thuaj, "Unë e adhuroj vetëm Zotëruesin tim; nuk ngre asnjë idhull përkrah Tij."

[21] Thuaj, "Unë nuk posedoj aspak fuqi që t'ju dëmtoj juve, e as t'ju udhëzoj juve."

[22] Thuaj, "Askush nuk mund të më mbrojë mua nga Zoti, as nuk mund të gjej një strehim tjetër përkrah Tij.

[23] "Unë shpallë shpalljet dhe lajmet e Zotit." Ata që nuk i binden Zotit dhe të dërguarit të Tij vetëshkaktojnë zjarrin e Ferrit, ku qëndrojnë përgjithmonë.

[24] Kur të shohin se çka po i pret, do e marrin vesh se kush është më i dobët në fuqi, dhe më pak në numër.

[25] Thuaj, "Unë nuk e di nëse çka u është premtuar juve do të ndodhë së shpejti, apo nëse Zotëruesi im do e shtyjë për më vonë."

[26] Ai është Njohësi i të ardhmes; Ai nuk ia shpallë të ardhmen askujt.

[27] Vetëm te një i dërguar që Ai zgjedhë, Ai zbulon nga e kaluara dhe e ardhmja, lajme të posaçme.*

[28] Kjo është për tu siguruar se i kanë përhapur lajmet e Zotëruesit të tyre. Ai është tërësisht i vetëdijshëm për çka kanë ata. Ai i ka numëruar numrat e të gjitha gjërave.

* 72:1-28 I dërguari këtu emërohet, matematikisht, si "Rashad Khalifa," të cilit Zoti ia zbuloi fundin e botës (Shtojca 25). Numri i strofave prej 1:1 deri te 72:27, ku i dërguari përmendet, është 5472, 19x72x4. Fjala "Rashada" ndodhet 4 herë në Suren 72. Vlera e "Rashada" është 504, dhe 504+28 (strofat e Sures 72) bëjnë 532, 19x28. Vlera e "Rashad Khalifa" (1230)+72+28=1330=19x70. Shifrat e Sures 72 dhe numri i strofave të saj (28) japin 7+2+2+8=19. Gjithashtu, shprehja kritike, "vetëm te një i dërguar që Ai zgjedhë" ka vlerën 361, 19x19.

Surja 73: I Mbuluar (El-Muzzemmil)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] O ti i mbuluar.
- [2] Medito gjatë natës, përveç rrallë herë.
- [3] Gjysmën e saj, ose pak më pak.
- [4] Ose pak më shumë. Dhe lexoje Kuranin skaj më skaj.
- [5] Do të japim ty lajm të rëndë.
- [6] Meditimi gjatë natës është më i efektshëm, dhe më i drejtë.
- [7] Ke shumë kohë gjatë ditës për çështje tjera.
- [8] Ta përkujtosh emrin e Zotëruesit tënd, për të ardhur afër e më afër Tij.
- [9] Zotëruesit të lindjes dhe të perëndimit; nuk ka zot tjetër përkrah Tij. Ta zgjedhësh Atë si mbrojtës tëndin.
- [10] Dhe qëndro i palëkundur përballë shprehjeve të tyre, dhe shpërfilli në mënyrë të sjellshme.
- [11] Dhe më le Mua të merrem me refuzuesit, që u bekuan bollshëm; jepu atyre pak kohë.
- [12] Kemi ndëshkime të rrepta, dhe Ferr.
- [13] Ushqim që vështirë se gëlltitet, dhe ndëshkim që dhemb.
- [14] Do të vij dita kur toka dhe malet do të dridhen, dhe malet do të shndërrohen në turrë të papeshë.
- [15] Kemi dërguar te ju të dërguar, ashtu si dërguam te Faraoni të dërguar.
- [16] Faraoni nuk iu bind të dërguarit dhe, si pasojë, e ndëshkuam rëndë.
- [17] Nëse nuk besoni, si mund t'i shmangeni një dite aq të tmerrshme sa që i bën foshnjat flokëthinjur?
- [18] Qielli do të thërrmohet prej saj. Premtimi i Tij është i vërtetë.
- [19] Ky (Kuran) është një vërejtje; kushdo që do, le ta zgjedhë rrugën për te Zotëruesi i tij.
- [20] Zotëruesi yt e din se ti mediton gjatë dy të tretës së natës, ose gjysmës së saj, ose një të tretës së saj, edhe ashtu bëjnë edhe disa prej atyre që besuan me ty. Zoti e ka dizajnuar natën dhe ditën, dhe Ai e din se ju nuk mund ta bëni këtë përherë. Ai ju ka falur juve. Andaj, të lexoni çka të mundeni prej Kuranit. Ai e din se disa prej jush mund të jeni të sëmurë, të tjerë mund të jeni duke udhëtuar në ndjekje të furnizimeve të Zotit, dhe të tjerë mund të jeni duke u përpjekur për Zotin. Të lexoni çka të mundeni prej tij, dhe të zbatoni lutjet e kontaktit (Salat), të jepni bamirësinë e obligueshme (Zeqat), dhe jepni Zotit hua të drejtësisë. Çfarëdo të mire që e dërgoni për shpirtat tuaj, do e gjeni te Zoti shumë më të mirë dhe të shpërblyer me bujari. Dhe lutjuni Zotit për falje. Zoti është Falës, i Mëshirshëm.

Surja 74: Sekreti i mbuluar (El-Muddeththir)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] O ti sekret i mbuluar.*
- [2] Dil dhe paralajmëro.

* 74:1 Mençuria e pakufi e Zotit deshi që ta zbulojë Kuranin nëpërmjet Muhamedit, përderisa mrekullia mbresëlënëse matematikore e Kuranit e bazuar në 19 u zbulua nëpërmjet të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes 1406 vite hënore pas zbulimit të Kuranit (1406=1974 & 1974 Pas Lindjes së Krishtit ishte viti i zbulimit). Në prapavështrim, e kuptojmë se e tërë surja i referohet mrekullisë së Kuranit të bazuar në 19 (Shih 1& 2).

- [3] Lavdëroje Zotëruesin tënd.
 [4] Pastroje veshjen tënde.*
 [5] Braktise çka është gabim.
 [6] Ji i kënaqur me ngastrën tënde.
 [7] Me durim përkujto Zotëruesin tënd.
 [8] Pastaj, kur t'i bihet birit.
 [9] Ajo do të jetë ditë e vështirë.
 [10] Për mosbesimtarët, jo e lehtë.
 [11] Më le Mua të merrem me atë që e krijova si individ.
 [12] E furnizova me shumë para.
 [13] Dhe fëmijë për t'i shikuar.
 [14] E bëra gjithçka të lehtë për të.
 [15] Prapëseprapë, ai lakmon për më shumë.
 [16] Me kokëfortësi refuzoi t'i pranojë këto prova.
 [17] Do e ndëshkoj gjithnjë e më shumë.
 [18] Se ai pasqyroj, pastaj vendosi.
 [19] E trishtueshme është çka vendosi.
 [20] E trishtueshme vërtetë është çka vendosi.
 [21] Shikoi.
 [22] U mrrol dhe rënkoj.
 [23] Pastaj refuzoi me mendjemadhësi.
 [24] Tha, "Ky është qartazi magji e shkathët!
 [25] "Ky është i bërë nga njeriu."
 [26] Do e parashtroj atë në ndëshkim.
 [27] Çfarë ndëshkimi!
 [28] I hollësishëm dhe gjithëpërfshirës.
 [29] I qartë për të gjithë njerëzit.

Emëruesi i Përbashkët i Kuranit

- [30] Sipër tij është nëntëmbëdhjetë.*
 [31] I caktuam engjëjt për të qenë roje Ferri, dhe e përcaktuam numrin e tyre (19-shin) (1) për t'i trazuar mosbesimtarët, (2) për t'i bindur të Krishterët dhe Jahuditë (se ky është shkrim hyjnor), (3) për të forcuar besimin e besimtarëve, (4) për të hequr të gjitha gjurmët e dyshimit prej zemrave të të Krishterëve, Jahudive, si dhe besimtarëve, dhe (5) për t'i ekspozuar ata që ushqejnë dyshime në zemrat e tyre, dhe mosbesimtarët; ata do të thonë, "Çka deshi të thotë Zoti me këtë alegori?" Zoti kështu e dërgon në humbje këdo që Ai vendosë, dhe e udhëzon këdo që Ai do. Askush nuk i njeh ushtarët e Zotëruesit tënd përveç Tij. Kjo është vërejtje për njerëzit.
 [32] Patjetër, (betohem) me hënën.
 [33] Dhe natën përderisa kalon.
 [34] Dhe mëngjesin përderisa shkëlqen.

Njëra prej mrekullive madhështore

* 74:4 Kurani është veshja që përmban kodin e fshehtë. Kjo i referohet heqjes së 9:128-129.

* 74:30-35 Kjo "Njëra prej mrekullive madhështore" furnizon provat e para materiale se Kurani është lajmi i Zotit për botën. Kjo mrekulli e bazuar në 19 është e detajuar në Shtojcën 1.

- [35] Kjo është njëra prej mrekullive madhështore.
 [36] Paralajmërim për racën njerëzore.
 [37] Për ata mes jush që dëshirojnë të përparojnë, ose të zmbarsen.
 [38] Çdo shpirt zihet në grackë të mëkateve të veta.
 [39] Përveç atyre në të djathtë.
 [40] Ndërsa në Parajsë, ata do të pyesin.
 [41] Për fajtorët.
 [42] "Çka ju solli juve në këtë ndëshkim?"
 [43] Ata do të thonë, "Ne nuk zbatuam lutjet e kontaktit (Salat).
 [44] "Nuk ushqyem të varfrit.
 [45] "U endëm me bredhësit.
 [46] "Nuk besuam në Ditën e Gjykimit.
 [47] "Derisa e sigurta na erdhi tani."
 [48] Ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve nuk do i ndihmojë ata kurrë.
 [49] Pse janë aq kundërshtues të kësaj vërejtjeje?
 [50] Duke vrapuar si zebrat.
 [51] Që janë duke ikur nga luani!
 [52] A do secili prej tyre ta pranojë shkrimin personalisht?
 [53] Vërtetë, ata nuk i frikësohen Përjetësisë.
 [54] Vërtetë, kjo është vërejtje.
 [55] Për ata që dëshirojnë të marrin vesh.
 [56] Ata nuk mund të marrin vesh kundër vullnetit të Zotit. Ai është burimi i drejtësisë; Ai është burimi i faljes.

Surja 75: Ringjallja (El-Kijame)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Beto hem me Ditën e Ringjalljes.
 [2] Dhe betohem me shpirtin fajësues.
 [3] A mendon qenia njerëzore se nuk do ia rindërtojme eshtrat e tij?
 [4] Po; ne jemi të zotit t'ia ndërtojme majën e gishtit.
 [5] Por qenia njerëzore priret të besojë vetëm çka ajo sheh para vetes.
 [6] Ai dyshon në Ditën e Ringjalljes!
 [7] Kur shikimi të mbrehet.
 [8] Dhe hëna të zihet.
 [9] Dhe dielli e hëna të përplasen në njëri tjetrin.
 [10] Qenia njerëzore do të thotë atë ditë, "Ku është dalja?"
 [11] Absolutisht, nuk ka asnjë dalje.
 [12] Te Zotëruesi yt, atë ditë, është fati përfundimtar.
 [13] Qenia njerëzore do të njoftohet, atë ditë, për të gjitha që i bëri për ta çuar veten përpara, dhe të gjitha që i bëri për ta zmbarsur veten.
 [14] Qenia njerëzore do të jetë gjykatës i vetvetes.
 [15] Asnjë arsyetim nuk do të pranohet.

Muhamedit i ndalohet ta shpjegojë Kuranin

- [16] Mos e lëviz gjuhën për ta ngutur atë.
 [17] Jemi ne ata që do e mbledhim në Kuran.
 [18] Kur ta recitojmë, ta ndjekësh një Kuran të tillë.
 [19] Pastaj jemi ne ata që do e shpjegojmë atë.
 [20] Vërtetë, ju e doni këtë jetë të shkurtër.
 [21] Përderisa e shpërfillni Përjetësinë.
 [22] Disa fytyra, atë ditë, do të jenë të lumtura.
 [23] Duke e shikuar Zotëruesin e tyre.
 [24] Fytyra të tjera, atë ditë, do të jenë të trishtuara.
 [25] Duke pritur më të keqen.
 [26] Vërtetë, kur (shpirti) vjen në fyt.
 [27] Dhe urdhërohet: "Lëshoje!"
 [28] Ai e din që është fundi.
 [29] Secila këmbë do të shtrihet e palëvizshme pranë këmbës tjetër.
 [30] Te Zotëruesi yt, atë ditë, është mbledhja.
 [31] Se ai nuk zbatoi as bamirësinë, as lutjet e kontaktit (Salat).
 [32] Por ai nuk besoi dhe refuzoi.
 [33] Me familjen e tij, ai sillej me mendjemadhësi.
 [34] E ke merituar këtë.
 [35] Vërtetë, e ke merituar këtë.
 [36] A mendon qenia njerëzore se ai do të shkojë në paekzistencë?
 [37] A nuk ishte ai një pikël fare e derdhur?
 [38] Pastaj Ai e krijoi një embrion prej saj!
 [39] E shndërroi në mashkull ose femër!
 [40] A është atëherë Ai i pazoti që t'i ngjallë të vdekurit?

Surja 76: Njeriu (El-Insan)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] A nuk është e vërtetë se ishte një kohë kur qenia njerëzore nuk ishte asgjë për tu përmendur?
 [2] E krijuam njeriun prej një përzierje të lëngshme, prej dy prindërve, në mënyrë që ta testojmë.
 Pra, e bëmë dëgjues dhe pamës.
 [3] Ia treguam dy rrugët, pastaj ai ose është mirënjohës, ose mosmirënjohës.
 [4] Përgatitëm për mosbesimtarët zinxhirë, pranga, dhe Ferr flakë.
 [5] Sa për të virtytshmit, ata do të pinë nga gota me nuanca nektari.
 [6] Një burim që është i rezervuar për shërbëtorët e Zotit; do të buron si të duan.
 [7] Ata përmbushin zotimet e tyre, dhe ia kanë dronë një dite që është tejet e vështirë.
 [8] Ata ia dhurojnë ushqimin e tyre të preferuar të varfërve, jetimëve, dhe të zënëve rob.
 [9] "Ju ushqejmë për hir të Zotit; nuk presim asnjë shpërblim nga ju, as falënderime.
 [10] "I frikësohemi nga Zotëruesi ynë ditës që është plot vuajtje dhe mundime."
 [11] Si pasojë, Zoti i mbron ata nga të këqijat e asaj dite dhe i shpërblen me gëzim dhe kënaqësi.
 [12] Ai i shpërblen ata për durimin e tyre me Parajsë, dhe mëndafsh.
 [13] Ata qëndrojnë aty në mobilie luksoze. Nuk vuajnë as nxehtësinë e diellit, as të ftohtë.
 [14] Hija i mbulon aty ata, dhe frutat janë të sjella afër, lehtë për tu arritur.

- [15] Atyre u shërbehen pije në enë të argjendta dhe gota që janë të tejudkshme.
- [16] Gota të tejudkshme, ndonëse të bëra nga argjendi; ata i merituan me të drejtë të gjitha këto.
- [17] Ata gëzojnë pije me shije të lezetshme.
- [18] Nga një burim aty i njohur si "Selsebil."
- [19] Atyre do të jenë duke iu shërbyer shërbëtorë të pavdekshëm. Kur i sheh ata, ata do të duken si margaritarë të derdhur.
- [20] Ngado që të shikoni, do të shihni hare, dhe pushtet të mrekullueshëm.
- [21] Mbi ta do të ketë rroba kadifeje të gjelbër, saten, dhe stoli argjendi. Zotëruesi i tyre do i furnizojë ata me pije të pastra.
- [22] Ky është shpërblimi që ju pret juve, se mundimet tuaja kanë qenë të çmuara.
- [23] E kemi shpallur këtë Kuran te ti; një shpallje e posaçme nga ne.
- [24] T'i zbatosh me durim urdhrat e Zotëruesit tënd, dhe mos iu bind asnjë mosbesimtari mëkatar mes tyre.
- [25] Dhe përkujto emrin e Zotëruesit tënd ditë e natë.
- [26] Gjatë natës, bjer në përulje para Tij, dhe madhëroje Atë sa e sa natën.
- [27] Këta njerëz janë të preokupuar me këtë jetë të shkurtër, përderisa po e shpërfillin – krejt pak më tutje – një ditë të rëndë.
- [28] I krijuam ata, i themelua, dhe kurdo që dëshirojmë, ne mund të zëvendësojmë të tjerë në vend të tyre.
- [29] Kjo është një vërejtje; kushdo që do, le ta zgjedhë rrugën për te Zotëruesi i tij.
- [30] Çfarëdo që doni është në përputhje me dashjen e Zotit. Zoti është i Gjithëdijshtëm, i Mençur.
- [31] Ai pranon këdo që Ai do në mëshirën e Tij. Sa për shpirtligjtë, Ai ka përgatitur për ta një ndëshkim që dhemb.

Surja 77: Të Nisur (El-Murselat)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] (Engjëjt) e nisur varg.
- [2] Për t'i shtyrë erërat.
- [3] Përzier retë.
- [4] Shpërndarë furnizimet.
- [5] Dërguar lajmet.
- [6] Lajme të mira, si dhe paralajmërime.
- [7] Çka ju është premtuar do të vij.
- [8] Pra, kur yjet shuhen.
- [9] Qielli çilet.
- [10] Malet shpërthejnë.
- [11] Të dërguarit mblidhen.
- [12] Ajo është dita e paracaktuar.
- [13] Dita e Vendimit.
- [14] Çfarë Dite e Vendimit!
- [15] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
- [16] A nuk i asgjësuam gjeneratat e mëhershme?
- [17] Pastaj i bëmë të tjerët t'i ndjekin ato?

- [18] Kjo është çka iu bëjmë kriminelëve.
 [19] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [20] A nuk ju krijuam juve prej një lëngu të ulët?
 [21] Pastaj e vendosëm atë në një depo të mbrojtur mirë.
 [22] Për një kohë të caktuar.
 [23] E matëm saktësisht.* Ne jemi projektuesit më të mirë.
 [24] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [25] A nuk e bëmë tokën vendbanim?
 [26] Për të gjallit dhe të vdekurit?
 [27] Vendosëm në të male të larta, dhe ju furnizuam me ujë të pijshëm.
 [28] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [29] Shkoni te çka e konsideroni rrenë.
 [30] Shkoni te një hije me tri dendësi të ndryshme.
 [31] Sidoqoftë, as nuk furnizon freski, as mbrojtje nga nxehtësia.
 [32] Hedhë xixa sa një shtëpi.
 [33] Të verdha si ngjyra e deveve.
 [34] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [35] Ajo është dita kur nuk flasin.
 [36] As nuk iu jepet leje të kërkojnë falje.
 [37] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [38] Kjo është Dita e Vendimit. Ju kemi mbledhur me gjeneratat paraprake.
 [39] Nëse keni ndonjë kurth, lirisht provoni kurthin.
 [40] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [41] Të drejtit do të gëzojnë hije dhe burime.
 [42] Dhe fruta që ua ka ënda.
 [43] Hani dhe pini në lumturi si shpërblim për punët tuaja.
 [44] Kështu i shpërblejmë të virtytshmit.
 [45] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [46] Hani dhe kënaquni përkohësisht; jeni fajtorë.
 [47] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [48] Kur u thuhet atyre, "Përkuluni," ata nuk përkulen.
 [49] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
 [50] Cilit Hadith, pos këtij, i përmbahen?

Surja 78: Ngjarja (El-Nebe')

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Çka po parashtrojnë në pyetje?
 [2] Ngjarjen e madhe.
 [3] Që polemizohet nga ata.
 [4] Vërtetë do e marrin vesh.

* 77:20-23 Sipas Embriologjisë Mjekësore të Langmanit, nga T.W. Sadler (Edicioni i Pestë, Faqe 88): "Në përgjithësi kohëzgjatja e shtatzënisë për një fetus me afat të plotë është 266 ditë ose 38 javë pas fekondimit." Edhe numri 266 edhe numri 38 janë shumëfisha të numrit 19 (Shtojca 1).

- [5] Sigurisht, do e marrin vesh.
- [6] A nuk e bëmë tokën të banueshme?
- [7] Dhe malet stabilizues?
- [8] Ju krijuam çifte (për njëri tjetrin).
- [9] Krijuam gjumin që të mund të pushoni.
- [10] E bëmë natën mbulesë.
- [11] Dhe ditën për të kërkuar furnizime.
- [12] Ndërtuam mbi ju shtatë gjithësi.
- [13] Krijuam llambë të ndritshme.
- [14] Lëshuam poshtë nga retë shi të madh.
- [15] Për të prodhuar me të drithëra dhe bimë.
- [16] Dhe lloj lloj kopshtesh.
- [17] Dita e Vendimit është e paracaktuar.
- [18] Dita kur i bihet bririt, dhe vini në turma.
- [19] Qielli do të hapet si porta.
- [20] Malet do të hiqen, sikur të ishin mirazh.
- [21] Xhehenemi është i pashmangshëm.
- [22] Për shkelësit; do të jetë vendbanim i tyre.
- [23] Qëndrojnë në të përherë.
- [24] Ata kurrë nuk shijojnë në të freski, as pije.
- [25] Vetëm vlim, dhe ushqim të hidhët.
- [26] Pagim i drejtë.
- [27] Ata nuk pritnin të japin llogari.
- [28] Dhe refuzuan shenjat tona krejtësisht.
- [29] Ne numëruam çdo gjë në regjistër.
- [30] Vuani pasojat; ne vetëm do t'jua shtojmë ndëshkimin.
- [31] Të drejtit kanë merituar shpërblim.
- [32] Kopshte dhe rrush.
- [33] Bashkëshorte të mahnitshme.
- [34] Pije të shijshme.
- [35] Ata kurrë nuk do të dëgjojnë në të gjepura apo gënjeshtër.
- [36] Shpërblim nga Zotëruesi yt; shpërblim bujarë.
- [37] Zotëruesi i qiejve dhe tokës dhe çdo gjë mes tyre. Mirëbërësi. Askush nuk mund t'i shfuqizojë vendimet e Tij.
- [38] Do të vij dita kur Shpirti dhe engjëjt do të qëndrojnë rresht. Askush nuk do të flasë përveç atyre që lejohen nga Mirëbërësi, dhe ata do të shprehin vetëm çka është e drejtë.
- [39] E tillë është dita e pashmangshme. Kushdo që do le të marrë strehim te Zotëruesi i tij.
- [40] Ju kemi paralajmëruar mjaftueshëm rreth një ndëshkimi të afërt. Ajo është dita kur çdokush do të shikojë veprat e veta të kryera, dhe mosbesimtari do të thotë, "Ah, sikur të isha dhe."

Surja 79: Rrëmbyesit (El-Nazi`at)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] (Engjëjt që) rrëmbejnë (shpirtrat e mosbesimtarëve) me forcë.

- [2] Dhe ata që butësisht marrin (shpirtrat e besimtarëve) me gëzim.
- [3] Dhe ata që lundrojnë ngado.
- [4] Duke garuar vullshëm me njëri tjetrin -
- [5] për të bartur urdhra të ndryshme.
- [6] Ditën kur tërmeti dridh.
- [7] I pasuar me rënien e dytë.
- [8] Mendje të caktuara do të tmerrohen.
- [9] Sytë e tyre do të ulen.
- [10] Ata do të thonë, "Ne jemi rikrijuar nga varri!
- [11] "Si ndodhi kjo pasi që ishim shndërruar në eshtra të kalbura?"
- [12] Ata kishin thënë, "Ky është një rikthim i pamundur."
- [13] Krejt çka duhet është një shtytje e lehtë.
- [14] Pas së cilës ngriten.
- [15] A ke ditur për historinë e Moisiut?
- [16] Zotëruesi i tij e thirri te lugina e shenjtë e Tuvës.
- [17] "Shko te Faraoni; ai ka shkelur."
- [18] Thuaji, "A nuk do të përmirësohesh?
- [19] "Le të të udhëzoj te Zotëruesi yt, që të mund të bëhesh i ndershëm."
- [20] Ai pastaj ia tregoi atij mrekullinë e madhe.
- [21] Por ai nuk besoi dhe kundërshtoi.
- [22] Pastaj ia ktheu shpinën me ngut.
- [23] Mblodhi dhe deklaroi.
- [24] Tha, "Unë jam Zotëruesi juaj; më i larti."
- [25] Si pasojë, Zoti e parashtrroi atë në ndëshkim në Përjetësi, si dhe në jetën e parë.
- [26] Ky është mësim për të ndershmit.
- [27] A jeni ju më të vështirë për tu krijuar se qielli? Ai e ndërtoi atë.
- [28] Ngriti masat e tij, dhe e përkreu.
- [29] Ia bëri natën e errët, dhe ia ndriçoi mëngjesin.
- [30] E bëri tokën në formë veze.*
- [31] Prej saj, Ai prodhoi ujin e saj dhe kullotat.
- [32] Themeloi malet.
- [33] E gjithë kjo për të furnizuar mbështetje për jetesën tuaj dhe kafshët tuaja.
- [34] Pastaj, kur goditja e madhe vjen.
- [35] Ajo është dita kur njeriut do i kujtohet çdo gjë që bëri.
- [36] Ferri do të sillet në ekzistencë.
- [37] Sa për atë që shkeli.
- [38] Që u preokupua me këtë jetë.
- [39] Ferri do i jetë vendbanim.
- [40] Sa për atë që nderoi madhërinë e Zotëruesit të tij, dhe e ndaloi veten nga epshet mëkatare.
- [41] Parajsa do i jetë vendbanim.
- [42] Të pyesin për Orën, dhe kur do të ndodhë!
- [43] Nuk je ti (Muhamed) që je i paracaktuar për ta lajmëruar kohën e saj.

* 79:30 Fjala arabe "dahhaha" rrjedh nga fjala "Dahhajah" që do të thotë "vezë."

- [44] Zotëruesi yt e vendosë fatin e saj.
[45] Misioni yt është t'i paralajmërosh ata që e presin.
[46] Ditën kur ata e shohin, do të ndihen sikur të kenë zgjatur një mbrëmje ose gjysmë dite.

Surja 80: U Mrrol (`Abese)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] (Muhamedi) u mrrol dhe ia ktheu shpinën.
[2] Kur njeriu i verbër erdhi te ai.
[3] Ku e din ti? Ai mund ta pastrojë veten.
[4] Ose mund të marrë vesh, dhe të ketë dobi nga lajmi.
[5] Sa për njeriun e pasur.
[6] Ia kushtove vëmendjen.
[7] Edhe pse nuk mund ta garantoje shpëtimin e tij.
[8] Ai që erdhi te ti me nxitim.
[9] Dhe është vërtetë i ndershëm.
[10] E injorove.
[11] Vërtetë, ky është kujtim.
[12] Kushdo që do ka për të qenë i vëmendshëm.
[13] Në shkrime të nderuara.
[14] Të lartësuara dhe të pastra.
[15] (Të shkruara) me duart e të dërguarve.
[16] Që janë të ndershëm dhe të drejtë.
[17] Mjerë qenia njerëzore; sa mosmirënjohës është ai!
[18] Nga çka Ai e krijoi atë?
[19] Nga një pikël, Ai e krijon dhe e konstrukton.
[20] Pastaj Ai ia tregon rrugën.
[21] Pastaj e vë në vdekje, dhe në varr.
[22] Kur Ai do, Ai e ringjallë.
[23] T'iu përmbahet urdhreve të Tij.
[24] Le ta marrë parasysh njeriu ushqimin e tij!
[25] Lëshojmë ujë me bollëk.
[26] Pastaj e çajmë dheun.
[27] Rrisim në të drithëra.
[28] Hardhi dhe kullota.
[29] Ullinj dhe palma.
[30] Lloj lloj kopshtesh.
[31] Fruta dhe perime.
[32] Për të furnizuar mbështetje për jetesë për ju dhe kafshët tuaja.
[33] Pastaj, kur goditjes i vjen koha.
[34] Ajo është dita kur njeriu ikë nga vëllai i vet.
[35] Nga nëna dhe babai i vet.
[36] Nga bashkëshortja dhe fëmijët e vet.
[37] Secili prej tyre, atë ditë, brengoset për fatin e vet.

- [38] Disa fytyra atë ditë do të jenë të lumtura.
 [39] Të qeshura dhe të gëzuara.
 [40] Fytyra të tjera, atë ditë, do të jenë të mbuluara me trishtim.
 [41] Të pushtuara nga brejtja e ndërgjegjes.
 [42] Këta janë mosbesimtarët shpirtligj.

Surja 81: Mbështjellja (Et-Tekuir)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Kur dielli të mbështillet.
 [2] Yjet të përplasen në njëri tjetrin.
 [3] Malet të jenë fshirë.
 [4] Riprodhimi të ndalohej.
 [5] Bishat të mblidhen.
 [6] Oqeanet të ngriten flakë.
 [7] Shpirtrat të rikthehen te trupat e tyre.
 [8] Vajza që u varros e gjallë të pyetet:
 [9] Për çfarë krimi ishte vrarë?
 [10] Regjistrat të hapen.
 [11] Qielli të hiqet.
 [12] Ferri të ndizet.
 [13] Parajsa të paraqitet.
 [14] Çdo shpirt do e dijë çdo gjë që ka sjellë.

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

- [15] Beto hem solemnisht me galaktika.
 [16] Që udhëtojnë me saktësi në orbitat e tyre.
 [17] Pasha natën kur bie.
 [18] Dhe mëngjesin kur frymon.
 [19] Kjo është shprehja e një të dërguari të nderuar.*
 [20] I autorizuar nga Poseduesi i Fronit, tërësisht i përkrahur.
 [21] Atij t'i bindeni dhe t'i kihet besim.
 [22] Shoku juaj (Rashadi) nuk ishte i çmendur.
 [23] Ai e pa atë te horizonti i lartë.*
 [24] Ai nuk fshehu ndonjë lajm.
 [25] Nuk është thënie e një djalli të mallkuar.
 [26] Tash pra, ku do të shkoni?
 [27] Ky është lajm për të gjithë njerëzit.
 [28] Për ata që dëshirojnë të shkojnë drejtë.
 [29] Çfarëdo që doni është në përputhje me vullnetin e Zotit, Zotëruesin e gjithësisë.

* 81:19 Duke mbledhur numrin e sures, dhe numrin e strofës, dhe vlerën germore të emrit "Rashad" (505), dhe vlerën e "Khalifa" (725), marrim 1330, 19x70. Kjo jep provë matematikore Kuranore se ky i dërguar ishte Rashad Khalifa.

* 81:23 Rashad Khalifa u mblodh te horizonti i lartë siç tregohet hollësisht te Shtojca 2.

Surja 82: Çarja (El-Infitar)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Kur qielli të çahet.
- [2] Planetët të hallakaten.
- [3] Oqeanet të shpërthejnë.
- [4] Varret të hapen.
- [5] Çdo shpirt do e marrë vesh çka e bëri të përparojë, dhe çka e bëri të zbrapset.
- [6] O ti qenie njerëzore, çka të largoi ty nga Zotëruesi yt Më i Nderuari?
- [7] Ai që të krijoj, të dizajnoi, dhe të përkreu.
- [8] Në cilindo dizajn që Ai zgjodhi, Ai e konstruktoi.
- [9] Vërtetë, ju nuk besoni në fenë.
- [10] Të pavëmendshëm për faktin se ka roje (të padukshme) rreth jush.
- [11] Ata janë regjistruar të sinqertë.
- [12] Regjistrojnë çdo gjë që bëni.
- [13] Padyshim, besimtarët kanë merituar hare.
- [14] Kurse shpirtligjtë kanë merituar Ferr.
- [15] Do e pësojnë atë në Ditën e Gjykimit.
- [16] Kurrë nuk dalin prej aty.
- [17] E hatashme është Dita e Gjykimit.
- [18] Çfarë dite; Dita e Gjykimit!
- [19] Ajo është dita kur asnjë shpirt nuk mund t'i ndihmojë një shpirti tjetër, dhe të gjitha vendimet, atë ditë, do i takojnë Zotit.

Surja 83: Mashtruesit (El-Mutaffifin)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Mjerë mashtruesit.
- [2] Që kërkojnë masë të plotë kur pranojnë prej njerëzve.
- [3] Por kur ua japin atyre masat ose peshat, ata mashtrojnë.
- [4] A nuk e dinë se do të ringjallen?
- [5] Në një ditë të llahtarshme?
- [6] Ajo është dita kur të gjithë njerëzit do të qëndrojnë para Zotëruesit të gjithësisë.

Libra numerikisht të qëndisur

- [7] Vërtetë, libri i shpirtligjve është në Sixhin.
- [8] A e din ti çka është Sixhini?
- [9] Libër numerikisht i qëndisur.
- [10] Mjerë refuzuesit në atë ditë.
- [11] Ata nuk besojnë në Ditën e Gjykimit.
- [12] Askush nuk e mohon atë përveç shkelësit, mëkatuesit.
- [13] Kur shpalljet tona i recitohen atij, thotë, "Përralla të moçme!"
- [14] Vërtetë, zemrat e tyre janë mbështjellë me mëkatet e tyre.
- [15] Vërtetë, ata do të izoloohen, atë ditë, prej Zotëruesit të tyre.
- [16] Pastaj do të hidhen në Ferr.

- [17] Do tu thuhet, “Kjo është çka dikur e mohonit.”
 [18] Vërtetë, libri i të drejtëve do të jetë në Illijin.
 [19] A e din ti çka është Illijini?
 [20] Libër numerikisht i qëndisur.
 [21] Për tu dëshmuar nga ata afër Meje.
 [22] Të drejtit kanë merituar hare.
 [23] Mbi mobilie luksoze shikojnë.
 [24] Në fytyrat e tyre vërehet kënaqësia e haresë.
 [25] Pijet e tyre do të jenë me nuanca nektari.
 [26] Nuanca e saj është si myshk. Kjo është për të cilën duhet të garojnë garuesit.
 [27] Të përziera në të do të jenë shije të posaçme.
 [28] Nga një burim që është i rezervuar për ata afër Meje.
 [29] Shpirtligjtë dikur qeshnin me ata që besuan.
 [30] Kur kalonin pranë tyre, ia bënin me sy njëri tjetrit.
 [31] Kur bëheshin bashkë me njerëzit e tyre, bënin shaka.
 [32] Kurdoherë që i shihnin, thoshin, “Këta njerëz janë të humbur!
 [33] “Ata nuk kanë gjëra të tilla si roje (të padukshme).”
 [34] Sot, ata që besuan po qeshin me mosbesimtarët.
 [35] Në mobilie luksoze shikojnë.
 [36] Padyshim, mosbesimtarët paguhen për çka bënë.

Surja 84: Plasja (El-Inshikak)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Do të vij koha kur të plasë qielli.
 [2] Do i nënshtrohet Zotëruesit të tij dhe të mbarojë.
 [3] Toka do të sheshohet.
 [4] Do të nxjerrë jashtë përmbajtjen, përderisa shpërthen.
 [5] Do i nënshtrohet Zotëruesit të saj dhe të mbarojë.
 [6] O njerëz, jeni duke shkuar pakthyesëm për te takimi me Zotëruesin tuaj.
 [7] Sa për atë që e pranon regjistrin e vet në dorën e tij të djathtë,
 [8] Njehsimi i tij do të jetë lehtë.
 [9] Ai do të kthehet te njerëzit e tij me gëzim.
 [10] Sa për atë që pranon regjistrin e vet prapa shpinës së tij,
 [11] Atë do e brejë ndërgjegjja.
 [12] Dhe do të digjet në Ferr.
 [13] Ai sillej me kryelartësi mes njerëzve të tij.
 [14] Ai mendoi se nuk do të thirret në llogaridhënie.
 [15] Me të vërtetë po; Zotëruesi i tij ishte Pamës i tij.
 [16] Beto hem solemnisht me të kuqërremtin muzg.
 [17] Dhe natën kur përhapet.
 [18] Dhe hënën dhe fazat e saj.
 [19] Do të kaloni gjendje më gjendje.
 [20] Pse nuk besojnë?

- [21] Dhe kur Kurani iu recitohet atyre, nuk bien në përulje.
[22] Kjo është për shkak se ata që nuk besuan po e refuzojnë (Kuranin).
[23] Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për mendimet e tyre më të thella.
[24] Premtoju atyre ndëshkim që dhemb.
[25] Sa për ata që besuan dhe çuan jetë të drejtë, pranojnë shpërblim që është fare mirë i merituar.

Surja 85: Galaktikat (El-Buruxh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha qiellin dhe galaktikat e tij.
[2] Ditën e premtuar.
[3] Dëshmitarin dhe çka dëshmohet.
[4] Mjerë njerëzit e kanionit.
[5] Ndezën një zjarr flakë.
[6] Dhe u ulën rreth tij.
[7] Për të shikuar djegien e besimtarëve.
[8] Ata nuk i urrenin ata për asnjë arsye tjetër pos që besonin në Zotin, të Plotfuqishmin, të Falënderuarin.
[9] I Atij është mbretërimi i qiejve dhe tokës. Dhe Zoti është dëshmitar i të gjitha gjërave.
[10] Padyshim, ata që keqtrajtojnë burrat dhe gratë besimtare, dhe nuk arrijnë të pendohen, kanë vetëshkaktuar ndëshkimin e Xhehenemit; kanë vetëshkaktuar ndëshkimin e djegies.
[11] Padyshim, ata që besuan dhe çuan jetë të drejtë, kanë merituar kopshte me prroje që rrjedhin. Ky është më i madhi triumf.
[12] Vërtetë, goditja e Zotëruesit tënd është e rëndë.
[13] Ai është Ai që nisë dhe përsëritë.
[14] Dhe Ai është Falës, Më i Dashuri.
[15] Poseduesi i fronit të madhërishtëm.
[16] Bërës i çfarëdo që Ai do.
[17] A e ke vërejtur historinë e trupave?
[18] Të Faraonit dhe të Themudit?
[19] Ata që nuk besojnë pllakosen me mohim.
[20] Zoti është tërësisht i vetëdijshëm për ta.
[21] Vërtetë, është Kuran i madhërishtëm.
[22] Në pllakë të ruajtur mirë.

Surja 86: Ylli i ndritshëm (Et-Tarik)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha qiellin dhe Al-Tarikun.
[2] A e din ti çka është Al-Tariku?
[3] Ylli i ndritshëm.
[4] Absolutisht, secili është i ruajtur mirë.
[5] Le të pasqyrojë njeriu mbi krijimin e tij.
[6] U krijua nga lëng që derdhet.

- [7] Nga mes shtyllës kurrizore dhe organeve të brendshme.
- [8] Ai padyshim mundet ta ringjallë atë.
- [9] Ditën kur të gjitha të fshehtat bëhen të ditura.
- [10] Ai nuk do të ketë aspak fuqi, as ndihmues.
- [11] Pasha qiellin që kthen (ujin).
- [12] Pasha tokën që çahet (për tu rritur bimët).
- [13] Ky është kallëzim serioz.
- [14] Për të mos u marrë me të lehtë.
- [15] Ata thurin kurthe dhe planifikojnë.
- [16] Por edhe Unë planifikoj.
- [17] Shtyjau afatin mosbesimtarëve edhe pak.

Surja 87: Më i Larti (El-A`la)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Madhëroje emrin e Zotëruesit tënd, Më të Lartit.
- [2] Ai krijon dhe formon.
- [3] Ai dizajnon dhe udhëzon.
- [4] Ai prodhon kullotën.
- [5] Pastaj e kthen në kashtë të lehtë.
- [6] Ne do të recitojmë ty; mos harro.
- [7] Çdo gjë është në përputhje me vullnetin e Zotit; Ai din çka deklarohet, dhe çka fshihet.
- [8] Do të drejtojmë ty në rrugën më të lehtë.
- [9] Prandaj, t'ua kujtosh; ndoshta të kujtuarit do të jetë i dobishëm.
- [10] I ndershmi do të marrë vesh.
- [11] Shpirtligu do i shmanget.
- [12] Si pasojë, ai do të vuaj të madhin Zjarr.
- [13] Në të cilin nuk vdes kurrë, as nuk mbetet gjallë.
- [14] I suksesshëm vërtetë është ai që e shpengon shpirtin e vet.
- [15] Duke e përkujtuar emrin e Zotëruesit të tij dhe duke zbatuar lutjet e kontaktit (Salat).
- [16] Vërtetë, jeni të preokupuar me jetën e kësaj bote.
- [17] Edhe pse Përjetësia është shumë më e mirë dhe e përhershme.
- [18] Kjo është e regjistruar në mësimet e mëhershme.
- [19] Mësimet e Ibrahimit dhe të Moisiut.

Surja 88: Kaplimi (El-Ghashije)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] A je i vetëdijshëm për Kaplimin?
- [2] Fytyrat në atë ditë do të jenë me turp.
- [3] Me mundim dhe rraskapitje.
- [4] Duke vuajtur në Zjarr flakë.
- [5] Duke pirë nga një burim i zjarrtë.
- [6] Nuk do të kenë ushqim përveç llojit të papërdorshëm.
- [7] që as nuk mban, as nuk shuan uri.

- [8] Fytyra të tjera atë ditë do të jenë plot gëzim.
 [9] Të kënaqura me punën e tyre.
 [10] Në Parajsë të lartësuar.
 [11] Aty asnjë gjepur nuk dëgjohet.
 [12] Aty rrjedh burim.
 [13] Aty ka mobilie luksoze.
 [14] Dhe pije në dispozicion.
 [15] Edhe shtamba varg.
 [16] Dhe qilima kudo.
 [17] Pse nuk po pasqyrojnë mbi devetë dhe si janë krijuar?
 [18] Dhe qiellin dhe si është ngritur.
 [19] Dhe malet dhe si janë konstruktuar.
 [20] Dhe tokën dhe si është ndërtuar.
 [21] T'ua kujtosh, se misioni yt është ta çosh këtë kujtesë.
 [22] Nuk ke aspak fuqi mbi ta.
 [23] Sa për ata që kundërshtojnë dhe nuk besojnë.
 [24] Zoti do i parashtrijë në të madhin ndëshkim.
 [25] Te ne është fati i tyre përfundimtar.
 [26] Pastaj do i thërrasim në llogaridhënie.

Surja 89: Agimi (El-Fexhr)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha agimin.
 [2] Dhe dhjetë netët.*
 [3] Pasha çiftin dhe tekun.*
 [4] Pasha natën përderisa kalon.
 [5] Betim i thellë, për atë që posedon inteligjencë.
 [6] A e ke vërejtur çka i bëri Zotëruesi yt Adit?
 [7] Iramit; qytezës me ndërtesa të larta.
 [8] Nuk kishte askund si ajo.
 [9] Gjithashtu Themudit, që gdhendën gurët në luginën e tyre.
 [10] Dhe Faraonit që posedonte fuqi.
 [11] Të gjithë shkelën në tokë.
 [12] Përhapën të këqija gjithandej.
 [13] Si pasojë, Zotëruesi yt derdhi mbi ta ndëshkim fshikullues.
 [14] Zotëruesi yt është përherë syhapur.
 [15] Kur qenia njerëzore testohet nga Zotëruesi i saj, nëpërmjet bekimeve dhe gëzimeve, thotë, "Zotëruesi im është bujar ndaj meje."
 [16] Por nëse Ai e teston nëpërmjet pakësimit të furnizimeve, thotë, "Zotëruesi im po më poshtëron!"
 [17] Jo! Jeni ju ata që ia sollët këtë vetes duke mos pasur kujdes ndaj jetimit.

* 89:2 Dhjetë netët e fundit të Ramazanit, ku shumë besimtarë strehohen në xhami (2:187).

* 89:3 Shih Shtojcën 1 për rolin e numrave çift dhe numrave tek.

- [18] Dhe duke mos përkrahur bamirësi ndaj të varfërve.
 [19] Dhe duke konsumuar trashëgiminë e jetimëve të pandihmë.
 [20] Dhe duke e dashur paranë së tepërmi.
 [21] Vërtetë, kur toka të thërrmohet, krejtësisht e thërrmuar.
 [22] Dhe Zotëruesi yt vjen, së bashku me engjëjt e rreshtuar rresht pas rreshti.
 [23] Atë ditë, Xhehenemi do të sillet përpara. Atë ditë, qenia njerëzore do të kujtohet – por çfarë kujtimi – do të jetë tepër vonë.
 [24] Ai do të thotë, “Ah, sikur të isha përgatitur për jetën time (të përhershme).”
 [25] Atë ditë, asnjë ndëshkim nuk do të mund të ishte më i keq se ndëshkimi i Tij.
 [26] Dhe asnjë mbyllje nuk është aq e efektshme sa mbyllja e Tij.
 [27] Sa për ty, o shpirt i kënaqur.
 [28] Kthehu te Zotëruesi yt, i kënaqur dhe i kënaqshëm.
 [29] Mirëserdhe brenda shërbëtorëve të Mi.
 [30] Mirëserdhe brenda Parajsës Time.

Surja 90: Qyteza (El-Beled)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Beto hem solemnisht me këtë qytezë.
 [2] Qytezën ku ti jeton.
 [3] Lindësin dhe të lindurin.
 [4] E krijuam qenien njerëzore për të punuar fort (për ta shpenguar veten).
 [5] A mendon ai se askush nuk do e thërrasë në llogaridhënie?
 [6] Mburret, “Shpenzova aq shumë para!”
 [7] A mendon ai se askush nuk e sheh?
 [8] A nuk i dhamë atij dy sy?
 [9] Një gjuhë dhe dy buzë?
 [10] A nuk i treguam atij dy rrugët?
 [11] Ai duhet ta zgjedhë rrugën e vështirë.
 [12] Cila është rruga e vështirë?
 [13] Lirimi i skllëvërve.
 [14] Të ushqyerit, gjatë kohëve të vështira.
 [15] E jetimëve që janë të afërm.
 [16] E të varfrit që ka nevojë.
 [17] Dhe të qenit një prej atyre që besojnë, dhe nxitja e njëri tjetrit për të qenë të durueshëm, dhe nxitja e njëri tjetrit për të qenë mirësjellës.
 [18] Këta kanë merituar lumturi.
 [19] Sa për ata që nuk besuan në shpalljet tona, ata kanë vetëshkaktuar mjerim.
 [20] Do të jenë të mbyllur në Zjarr.

* 90:4 Shih Hyrjen dhe Shtojcën 7 për qëllimin e krijimit tonë.

Surja 91: Dielli (El-Shems)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha diellin dhe shkëlqimin e tij.
- [2] Hënën që e ndjekë.
- [3] Ditën që e zbulon.
- [4] Natën që e mbulon.
- [5] Qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë.
- [6] Tokën dhe Atë që e mbanë atë.
- [7] Shpirtin dhe Atë që e krijoi atë.
- [8] Pastaj i tregoi çka është e keqe dhe çka është e mirë.
- [9] I suksesshëm është ai që e shpengon atë.
- [10] Dështak është ai që e shpërfillë atë.
- [11] Mosbesimi i Themudit i bëri ata të shkelin.
- [12] E ndoqën më të keqin mes tyre.
- [13] I dërguari i Zotit iu tha, “Kjo është deveja e Zotit; lëreni të pijë.”
- [14] Ata nuk i besuan atij dhe e therën atë. Zotëruesi i tyre pastaj i pagoi për mëkatin e tyre dhe i asgjësoi.
- [15] Prapëseprapë, ata që erdhën pas tyre vazhdojnë të mbesin të pavëmendshëm.

Surja 92: Nata (El-Lejl)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha natën kur mbulon.
- [2] Ditën kur zbulon.
- [3] Dhe Atë që krijoi mashkullin dhe femrën.
- [4] Punët tuaja janë të llojlojshme.
- [5] Sa për atë që jep bamirësi dhe mban drejtësinë.
- [6] Dhe i përmbahet shkrimit.
- [7] Do e drejtojmë drejt lumturisë.
- [8] Por ai që është dorështrënguar, edhe pse është i pasur.
- [9] Dhe nuk beson në shkrimin.
- [10] Do e çojmë drejt vuajtjes.
- [11] Paraja e tij nuk mund ta ndihmojë kur ai të bie.
- [12] Ne e sjellim udhëzimin.
- [13] Ne e kemi në dorë Përjetësinë, si dhe këtë jetë.
- [14] Ju kam paralajmëruar për Zjarrin flakë.
- [15] Askush nuk digjet në të përveç shpirtligut.
- [16] Që nuk beson dhe kundërshton.
- [17] Prej tij do të jetë larg i drejti.
- [18] Që jep bamirësi nga paratë e veta.
- [19] Duke mos kërkuar asgjë si shpërblim.
- [20] Duke kërkuar vetëm Zotëruesin e tij, Më të Lartin.
- [21] Ai padyshim do të arrijë shpëtim.

Surja 93: Paradija (Ed-Duha)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha paraditen.
- [2] Pasha natën kur bie.
- [3] Zotëruesi yt nuk të braktisi, as nuk të harroi.
- [4] Përjetësia është shumë më e mirë për ty sesa (jeta) e kësaj bote.
- [5] Dhe Zotëruesi yt do të të japë mjaft; do të jesh i kënaqur.
- [6] A nuk të gjeti jetim dhe të dha strehë?
- [7] Të gjeti të humbur, dhe të udhëzoi.
- [8] Të gjeti të varfër, dhe të bëri të pasur.
- [9] Prandaj, të mos e braktisësh jetimin.
- [10] As të mos e qortosh lypësin.
- [11] T'i deklarosh bekimet që Zotëruesi yt ka dhuruar mbi ty.

Surja 94: Qetësimi shpirtëror (El-Inshirah)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] A nuk ta qetësuam gjendjen shpirtërore?
- [2] Dhe ta zbrazëm barrën tënde (të mëkateve).
- [3] Atë që ta rëndonte shpinën.
- [4] Të ngritëm në pozitë të ndershme.
- [5] Me dhimbje ka fitim.
- [6] Vërtetë, me dhimbje ka fitim.
- [7] Sa herë që është e mundur, të përpiqesh.
- [8] Duke kërkuar vetëm Zotëruesin tënd.

Surja 95: Fiku (Et-Tin)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Pasha fikun dhe ullirin.
- [2] Malin Sinai.
- [3] Dhe këtë qytezë të nderuar (Mekën).*
- [4] E krijuam njeriun në dizajnin më të bukur.
- [5] Pastaj e shndërruam në më të ulëtën e të ulëtëve.
- [6] Përveç atyre që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë; ata pranojnë shpërblim që është fare mirë i merituar.
- [7] Pse e refuzojnë besimin prapëseprapë?
- [8] A nuk është Zoti Më i Mençuri, prej të gjithë të mençurve?

* 95:1-3 Fiku, ulliri, Sinai dhe Meka mund të simbolizojnë Ademin, Jezusin, Moisiun, Ibrahimin dhe Muhamedin, përkatësisht. Pra, përfaqësohen të gjitha fetë e mëdha.

Surja 96: Embrioni (El-`Alak)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Lexo, në emrin e Zotëruesit tënd, që krijoi.*
- [2] Krijoi njeriun prej një embrioni.
- [3] Lexo, dhe Zotëruesi yt, Më i Lartësuar.
- [4] Na mëson me anën e lapsit.
- [5] Ai i mëson njeriut çka ai nuk diti.
- [6] Vërtetë, njeriu shkelë.
- [7] Kur ai bëhet i pasur.
- [8] Te Zotëruesi yt është fati përfundimtar.
- [9] A e ke parë atë që i ndalon.
- [10] Të tjerët që të luten?
- [11] A nuk është më mirë për të ta ndjekë udhëzimin?
- [12] Ose të përkrahë drejtësi?
- [13] Nëse ai nuk beson dhe kundërshton.
- [14] A nuk e kupton ai se Zoti sheh?
- [15] Vërtetë, po të mos tërhiqet, do e zëmë për ballukeje.
- [16] Balluke që është e pabesë dhe mëkatore.
- [17] Le t'i thërrasë ai ndihmuesit e tij.
- [18] Ne do i thërrasim rojet e Ferrit.
- [19] Të mos i bindesh atij; të biesh në përlulje dhe të avitesh më afër.

Surja 97: Paracaktimi (El-Kadr)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] E shpallëm në Natën e Paracaktimit.*
- [2] A e din çka është Nata e Paracaktimit?
- [3] Nata e Paracaktimit është më e mirë se njëmijë muaj.
- [4] Engjëjt dhe Shpirti zbresin në të, me lejen e Zotëruesit të tyre, për të bartur çdo urdhër.
- [5] Paqësore është deri në ardhjen e agimit.

Surja 98: Prova (El-Bejjine)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Ata që nuk besuan mes njerëzve të shkrimit, si dhe adhuruesit e idhujve, këmbëngulin në rrugët e tyre, përkundër provës që u është dhënë.*
- [2] Një i dërguar prej Zotit po u reciton atyre mësim të shenjtë.
- [3] Në to ka mësim të vlefshme.
- [4] Në fakt, ata që pranuan shkrimin nuk polemizuan derisa prova iu dha atyre.

* 96:1-19 Prej 96-shit deri te 114-shi janë 19 sure. Shpallja e parë (96:1-5) përbëhet prej 19 fjalëve arabe, 76 shkronja (19x4). Surja përmban 19 strofa dhe 304 shkronja arabe (Shtojcat 1 & 23).

* 97:1 Kurani u vendos në shpirtin e Muhamedit në natën e 27 të Ramazanit, viti 13 Para Hixhrës. Shih gjithashtu 17:1, 44:3, 53:1-18, dhe Shtojcën 28.

* 98:1-2 Prova është kodi matematikor i Kuranit (Shtojca 1) dhe i dërguar ishte Rashad Khalifa. Numri i sures (98), plus numri i strofës (2), plus vlera numerike e "Rashad Khalifa" (1230) japin shumën 1330 (19x70). (Shtojca 2)

[5] Krejt çka kërkohet prej tyre ishte ta adhuronin Zotin, duke ia kushtuar fenë absolutisht vetëm Atij, t'i zbatonin lutjet e kontaktit (Salat), dhe të jepnin bamirësinë e obligueshme (Zeqat). E tillë është feja e përsosur.

[6] Ata që nuk besuan mes njerëzve të shkrimit, dhe adhuresit e idhujve, kanë vetëshkaktuar zjarrin e Xhehenemit përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.

[7] Ata që besuan dhe çuan jetë të drejtë janë krijesat më të mira.

[8] Shpërblimi i tyre te Zotëruesi i tyre është kopshte Edeni me prroje që rrjedhin, ku qëndrojnë përgjithmonë. Zoti është i kënaqur me ta, dhe ata janë të kënaqur me Të. I tillë është shpërblimi për ata që ia kanë dronë Zotëruesit të tyre.

Surja 99: Dridhja (El-Zelzeleh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Kur toka të dridhet ashpër.

[2] Dhe toka t'i nxjerrë barrët e saj.

[3] Njeriu do të pyesë veten: "Çka po ndodh?"

[4] Atë ditë, ajo do të tregojë lajmin e saj.

[5] Se Zotëruesi yt e ka urdhëruar.

[6] Atë ditë, njerëzit do të lëshohen nga çdo drejtim, për t'iu treguar punët e tyre.

[7] Kushdo që bën një peshë atomi të të mirës do e shohë.

[8] Dhe kushdo që bën një peshë atomi të të keqes ai do e shohë.

Surja 100: Vringëlluesit (El-`Adijat)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Pasha vringëlluesit e shpejtë.

[2] Që qesin xixa.

[3] Sulen (te armiku) që në agim.

[4] Gjuajnë tmerr aty.

[5] Depërtojnë në zemër të territorit të tyre.

[6] Njeriu është mosmirënjohës i Zotëruesit të tij.

[7] Dëshmon për këtë fakt.

[8] I do gjërat materiale së tepërmi.

[9] A nuk e kupton ai se do të vij dita kur hapen varret?

[10] Dhe të gjitha fshehtësitë nxirren.

[11] Do ta marrin vesh, atë ditë, se Zotëruesi i tyre ka qenë Njohës i tërësishëm i tyre.

Surja 101: Tronditja (El-Kari`ah)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Tronditja.

[2] Çfarë tronditje!

[3] A ke ndonjë ide se çka është Tronditja?

[4] Ajo është dita kur njerëzit dalin si turma fluturash.

[5] Malet do të jenë si lesh e li.

[6] Sa për atë peshat e të cilit janë të rënda.

[7] Ai do të çojë jetë të lumtur (të përjetshme).

[8] Sa për atë peshat e të cilit janë të lehta.

[9] Fati i tij është i ulët.

[10] A e din çka është??

[11] Zjarri flakë!

Surja 102: Grumbullim (Al-Takaathur)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Mbeteni të preokupuar me grumbullim.

[2] Derisa të shkoni në varre.

[3] Vërtetë, do e merrni vesh.

[4] Sigurisht, do e merrni vesh.

[5] Vetëm sikur të mund ta merrnit vesh sigurt.

[6] Do të përfytyronit Ferrin.

[7] Pastaj do e shihnit me sy të sigurt.

[8] Pastaj do të merreni në pyetje, në atë ditë, për bekimet që kishit gëzuar.

Surja 103: Pasdita (El-`Asr)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Pasha pasditen.

[2] Qenia njerëzore është krejt i humbur.

[3] Përveç atyre që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë, dhe nxisin njëri tjetrin për t'iu përmbajtur të vërtetës, dhe nxisin njëri tjetrin të jenë të durueshëm.

Surja 104: Përgojuesi (El-Humezeh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] Mjerë çdo përgojues, shpifës.

[2] Ai grumbullon para dhe i numëron.

[3] Ai mendon se paratë e tij do e bëjnë të pavdekshëm.

[4] Jo; ai do të flaket në Shkretim.

[5] A e din ti çka është Shkretimi?

[6] Zjarri flakë i Zotit.

[7] Që i djegë ata nga brenda jashtë.

[8] Ata do të mbyllen në të.

[9] Në kolona të zgjatura.

Surja 105: Elefanti (El-Fil)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

[1] A e ke vërejtur çka iu bëri Zotëruesi yt njerëzve të elefantit?

[2] A nuk i bëri Ai kurthet e tyre të dështojnë?

[3] Ai dërgoi mbi ta tufa zogjsh.

[4] Që lëshuan rrebesh me gurë të fortë mbi ta.

[5] Ai i bëri ata si kashtë e përtypur.

Surja 106: Fisi Kurejsh (Kurejsh)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Ky duhet të gëzohet nga Kurejshët.
- [2] Ashtu si i gëzojnë karvanët e dimrit dhe të verës.
- [3] Ta adhurojnë Zotëruesin e kësaj faltoreje.
- [4] Se Ai është Ai që i ushqeu pas urisë, dhe i furnizoi me siguri pas frikës.

Surja 107: Bamirësia (El-Ma`un)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] A e din ti kush vërtetë e refuzon besimin?
- [2] Është ai që keqtrajton jetimët.
- [3] Dhe ai nuk përkrahë të ushqyerit e të varfrit.
- [4] E mjerë ata që zbatojnë lutjet e kontaktit (Salat) -
- [5] që janë plotësisht të pavëmendshëm gjatë lutjeve të tyre.
- [6] Ata (i zbatojnë) vetëm sa për tu treguar.
- [7] Dhe ndalojnë bamirësinë.

Surja 108: Dhurata (El-Keuther)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Të kemi bekuar me mori dhuratash.
- [2] Prandaj, t'i lutesh Zotëruesit tënd (Salat), dhe të japësh bamirësi.
- [3] Kundërshtari yt do të jetë humbësi.

Surja 109: Mosbesimtarët (El-Kafirun)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Thuaj, "O ju mosbesimtarë.
- [2] "Nuk adhuroj çka adhuroni.
- [3] "As nuk adhuroni çka adhuroj.
- [4] "As nuk do adhuroj çka adhuroni.
- [5] "As nuk do adhuroni çka adhuroj.
- [6] "Për ju është feja juaj, dhe për mua është feja ime."

Surja 110: Triumfi (En-Nasr)

*Surja e fundit e shpallur. **

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Kur triumfi prej Zotit të vij dhe fitorja.
- [2] Do i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Zotit në turma.
- [3] Ta madhërosh dhe falënderosh Zotëruesin tënd, dhe ta lutësh për falje. Ai është Shpenguesi.

* 110:1-3 Kjo, surja e fundit kronologjikisht, përmban 19 fjalë arabe (shih 96:1), dhe strofa e parë përmban 19 shkronja. Kjo tregon se kjo gjeneratë e besimtarëve do e arrijë fitoren e premtuar.

Surja 111: Ferrat (El-Mesed)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Të mallkuara janë punët e Ebi Lehebit, edhe ai është i mallkuar.*
- [2] Paratë e tij dhe çfarëdo që ka arritur nuk do e ndihmojnë kurrë.
- [3] Ai ka vetëshkaktuar Ferrin flakë.
- [4] Gjithashtu gruaja e tij, që e udhëhoqi keqtrajtimin.
- [5] Ajo do të jetë (e ringjallur) me një litar ferrash rreth qafës së saj.

Surja 112: Absolutësia (El-Ihlas)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Deklaro, "Ai është Një dhe i vetmi Zot.
- [2] "Zoti Absolut.
- [3] "Ai kurrë nuk ka lindur. As nuk është i lindur.
- [4] "Askush nuk barazohet me Të."

Surja 113: Agu (El-Felek)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Thuaj, "Kërkoj strehim në Zotëruesin e agut.
- [2] "Nga të këqijat mes krijesave të Tij.
- [3] "Nga të këqijat e errësirës kur mbulon.
- [4] "Nga të këqijat e belaxhinjve.
- [5] "Nga të këqijat e ziliqarëve kur ata kanë zili."

Surja 114: Njerëzit (El-Nas)

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit

- [1] Thuaj, "Kërkoj strehim në Zotëruesin e njerëzve.
- [2] "Mbretin e njerëzve.
- [3] "Zotin e njerëzve.
- [4] "Nga të këqijat e pëshpëritësve tinëzar.
- [5] "Që pëshpërisin në gjokset e njerëzve.
- [6] "Qofshin nga xhinët, ose njerëzit."*

* 111:1 Ebi Lehebi ishte axha i Muhamedit dhe udhëheqësi i opozitës. Gruaja e tij barti një fushatë keqtrajtimi kundër Muhamedit dhe besimtarëve. Sikur të gjitha përshkrimet e Parajsës dhe Ferrit, litari me ferra është alegori.

* Pra, përsëritja totale e fjalës "Zot" (Allah) në të gjithë Kuranin është 2698 herë, ose 19 x 142. Gjithashtu, nëse mbledhim numrat e strofave kudo që fjala "Zot" ndodhet, shuma del të jetë 118123, gjithashtu shumëfish i 19-tës (118123 = 19 6217). Hollësitë e hartimit të veçantë matematikor të Kuranit jepen në Shtojcat 1, 2, 24, 25, 26, dhe 29.

SHTOJCAT

**SHTOJCAT NË VIJIM JANË SHKRUAR NGA DR. RASHAD KHALIFA, I DËRGUARI I ZOTIT I BESËLIDHJES NË VITIN 1989
NË PËRKTHIMIN E AUTORIZUAR TË KURANIT NË GJUHËN ANGLEZE.
NË VIJIM GJENDET PËRKTHIMI I TYRE NË GJUHËN SHQIPE.**

SHTOJCA 1:

“Njëra prej mrekullive më të mëdha” [74:35]

Kurani karakterizohet me një fenomen të veçantë që nuk gjendet në asnjë libër tjetër me autor njerëzor. Çdo element i Kuranit është i hartuar matematikisht – suret, strofat, fjalët, numri i shkronjave të caktuara, numri i fjalëve nga e njëjta rrënjë, numri dhe shumëllojshmëria e emrave hyjnor, shkrimi i veçantë i fjalëve të caktuara, mungesa apo ndryshimi i qëllimshëm i shkronjave të caktuara brenda fjalëve të caktuara, dhe shumë elemente të tjera të Kuranit, e edhe më shumë përmbajtja e tij. Janë dy aspekte madhore të sistemit matematikor të Kuranit: (1) Hartimi letrar-matematikor, dhe (2) Ndërtimi matematikor që përfshinë numrat e sureve dhe strofave. Për shkak të këtij kodimi matematikor gjithëpërfshirës, edhe shtrembërimi më i vogël i tekstit të Kuranit ose renditjes fizike menjëherë del në shesh.

E thjeshtë për ta kuptuar, e pamundur për ta imituar

Për herë të parë në histori kemi një shkrim me provë të ndërthurur në brendësi për autorësi hyjnore – hartimin matematikor mbinjerëzor.

Faqja e fundit e tekstit tregon që ndodhja totale e fjalës “Zot” është 2698, ose 19×142 . Shuma totale e numrave të strofave për të gjithë strofat që përmbajnë fjalën “Zot” është 118123, gjithashtu shumëfish i numrit 19 ($118123 = 19 \times 6217$).

Numri nëntëmbëdhjetë është emëruesi i përbashkët përgjatë sistemit matematikor të Kuranit.

Edhe i vetëm, ky fenomen mjafton si provë e pakundërshtueshme që Kurani është lajmi i Zotit për botën. Asnjë qenie njerëzore nuk do të kishte mundur t’i mbajë në ‘binarë’ 2698 ndodhje të fjalës “Zot,” dhe numrat e strofave ku ato ndodhen. Kjo është posaçërisht e pamundur kur marrim parasysh (1) kohën e paditurisë gjatë të cilës Kurani u shpall, dhe (2) faktin që suret dhe strofat ishin shumë gjerë të ndara nga njëra tjetra me kohë dhe vend të shpalljes. Rendi kronologjik i shpalljes ishte gjerësisht i ndryshëm nga formati i fundit (Shtojca 23). Megjithatë, sistemi matematikor i Kuranit nuk mbaron me fjalën “Zot,” është tejet i gjerë, tejet i ndërlidhur dhe i ndërlikuar, dhe krejtësisht gjithëpërfshirës.

Faktet e thjeshta

Si vetë Kurani, kodimi matematikor i Kuranit shtrihet që nga faktet më të thjeshta, deri te ato më të ndërlikuarat. Faktet e Thjeshta janë ato vrojtme që mund të gjenden pa përdorur ndonjë vegël. Faktet e ndërlikuara kërkojnë ndihmën e një kalkulatori ose kompjuteri. Faktet në vijim nuk kanë nevojë për ndonjë vegël për tu verifikuar, por mbani mend që ato i referohen tekstit origjinal arabisht:

1. Strofa e parë (1:1), e njohur si “Bismilahu,” përbëhet nga 19 shkronja.
2. Kurani përbëhet nga 114 sure, që është 19×6 .
3. Numri total i strofave në Kuran është 6346, ose 19×334 . [6234 strofa të numëruara & 112 strofa të panumëruara (Bismilahe) $6234 + 112 = 6346$] Vini re që $6 + 3 + 4 + 6 = 19$.
4. Bismilahu ndodhet 114 herë, përkundër mungesës së dukshme nga Surja 9 (ndodhet dy herë në Suren 27) & $114 = 19 \times 6$.
5. Nga Bismilahu që mungon në Suren 9 deri te Bismilahu shtesë në Suren 27, janë saktësisht 19 sure.
6. Rrjedh që totali i numrave të sureve nga 9 deri te 27 ($9 + 10 + 11 + 12 + \dots + 26 + 27$) është 342, ose 19×18 .
7. Ky total (342) gjithashtu është i barabartë me numrin e fjalëve ndërmjet dy Bismilaheve të Sures 27, dhe $342 = 19 \times 18$.
8. Shpallja e parë e famshme (96:1-5) përbëhet nga 19 fjalë.
9. Kjo shpallje e parë 19 fjalëshe përbëhet nga 76 shkronja 19×4 .
10. Surja 96, e para në renditjen kronologjike, përbëhet nga 19 strofa.
11. Kjo sure e parë kronologjikisht është e vendosur mbi 19 suret e fundit.
12. Surja 96 përbëhet nga 304 shkronja arabe, dhe 304 është e barabartë me 19×16 .
13. Shpallja e fundit (Surja 110) përbëhet nga 19 fjalë.
14. Strofa e parë e shpalljes së fundit (110:1) përbëhet nga 19 shkronja.
15. 14 shkronja të ndryshme arabe, formojnë 14 bashkësi të ndryshme të “Inicialeve Kuranore” (siç është A.L.M. në 2:1), dhe gjenden para 29 sureve. Këta numra japin shumën $14 + 14 + 29 = 57 = 19 \times 3$.
16. Totali i numrave të 29 sureve ku Inicialet Kuranore ndodhen është $2 + 3 + 7 + \dots + 50 + 68 = 822$, dhe $822 + 14$ (14 bashkësi inicialesh) është 836, ose 19×44 .
17. Ndërmjet sures së parë me inicial (Sures 2) dhe sures së fundit me inicial (Sures 68) janë 38 sure pa iniciale. Pra 19×2 .
18. Ndërmjet sures së parë dhe të fundit me iniciale ka 19 bashkësi ndërrimesh mes sureve të “inicializuara” dhe “të pa inicializuara”.
19. Kurani përmend 30 numra të ndryshëm: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 19, 20, 30, 40, 50, 60, 70, 80, 99, 100, 200, 300, 1000, 2000, 3000, 5000, 50,000, & 100,000. Shuma e këtyre numrave është 162146, që është e barabartë me 19×8534 .

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e Fakteve të Thjeshta.

Hartimi letraro-matematikor

Kurani karakterizohet me një fenomen të veçantë që nuk është gjetur kurrë në ndonjë libër tjetër: 29 sure kanë parashtesat me 14 bashkësi të ndryshme të "Inicialeve Kuranore," që përbëhen nga një deri në pesë shkronja për secilën bashkësi.

Katërmbëdhjetë shkronja, gjysma e alfabetit arab, marrim pjesë në këto iniciale. Rëndësia e inicialeve Kuranore mbeti sekret i ruajtur hyjnisht për 14 shekuj.

Kurani thotë në 10:20 dhe 25:4-6 që mrekullia e tij, d.m.th., prova e autorësisë hyjnore, ishte paracaktuar të mbetet sekret për një afat specifik të përcaktuar:

Ata thanë, "Pse nuk i ka zbritur një mrekulli atij nga Zotëruesi i tij?" Thuaj, "Vetëm Zoti e di të ardhmen. Prandaj, prisni, dhe unë po pres së bashku me ju." [10:20]

Ata që nuk besuan thanë, "Kjo nuk është asgjë më shumë se trillim nga ai, me ndihmën e njerëzve tjerë." Në të vërtetë, ata shprehin një blasfemi; një gënjeshtër. Të tjerët thanë, "Përralla të moçme që ai i shkroi; ato iu diktuan atij ditë e natë." Thuaj, "Ky është zbritur nga Ai që din 'sekretin' në qiej dhe tokë." Padyshim, Ai është Falës, i Mëshirshëm. [25:4-6]

Inicialet Kuranore përbëjnë një pjesë të madhe të mrekullisë matematikore të Kuranit të bazuar në numrin 19.

Prapaskena historike

Në 1968, e kuptova që përkthimet e Kuranit në gjuhën Angleze që ekzistonin nuk e paraqitnin lajmin e vërtetë të Besëlidhjes së Fundit të Zotit. Për shembull, dy përkthyesit më të popullarizuar, Jusuf Ali dhe Marmaduke Pickthall, nuk kishin arritur t'i tejkalojnë traditat e tyre fetare të korruptuara kur vinte puna te kriteri i madh i Kuranit në strofën 39:45.

Kur VETËM Zoti përmendet, zemrat e atyre që nuk besojnë në Përjetësinë tkurren me neveri. Por kur të tjerët përmenden përkrah Tij, ata kënaqen. [39:45]

Përkthyesi Jusuf Ali e hoqi fjalën kyçe "VETËM" nga përkthimi i tij, dhe ndryshoi pjesën tjetër të strofës duke shtuar fjalën "(zotat)." Pra, e shkatërroi krejtësisht këtë më të rëndësishmin kriter Kuranor. Ai e përktheu 39:45 si në vijim:

Kur Zoti, Një dhe i Vetmi, përmendet, zemrat e atyre që nuk besojnë në Përjetësinë mbushen me pakënaqësi dhe tmerr; por kur (zotat) tjerë pos Tij përmenden, ja, ato mbushen me gëzim. [39:45] (sipas A. Jusuf Ali)

Tabela 1: Lista e inicialeve Kuranore dhe suret e tyre

Nr.	Nr. i sures	Titulli i sures	Inicialet Kuranore
1	2	Mëshjtjerra	A.L.M.
2	3	Amramitët	A.L.M.
3	7	Purgatori	A.L.M.S.
4	10	Jona	A.L.R.
5	11	Hudi	A.L.R.
6	12	Jozefi	A.L.R.
7	13	Bubullimë	A.L.M.R.
8	14	Ibrahimi	A.L.R.
9	15	Lugina El-Hixhr	A.L.R.
10	19	Maria	Q.H.J.'A.S
11	20	T.H.	T.H.
12	26	Poetët	T.S.M.
13	27	Milingona	T.S.
14	28	Histori	T.S.M.
15	29	Merimanga	A.L.M.
16	30	Romakët	A.L.M.
17	31	Llukmani	A.L.M.
18	32	Përulja	A.L.M.
19	36	J.S.	J.S.
20	38	S.	S.
21	40	Falësi	H.M.
22	41	Hollësishtëm	H.M.
23	42	Konsultimi	H.M.'A.S.
24	43	Stolitë	H.M.
25	44	Tym	H.M.
26	45	Gjunjëzimi	H.M.
27	46	Dunat	H.M.
28	50	K.	K.
29	68	Lapsi	NuN

Shprehja “Kur Zoti, Një dhe i Vetmi, përmendet,” nuk është e njëjtë si thënia, “Kur vetëm Zoti përmendet.” Dikush mund ta përmendë “Zotin, Një dhe të Vetmin,” dhe gjithashtu ta përmendë Muhamedin ose Jezusin, dhe askush nuk do të mërzitet. Por nëse “VETËM Zoti përmendet,” nuk mund ta përmendni dikë tjetër, dhe shumë njerëzve – ata që idhujtarizojnë Muhamedin ose Jezusin – do iu prishet qejfi. Pra, Jusuf Aliu nuk mundi ta sjellë veten në atë pikë që të paraqesë të vërtetën e Kuranit, nëse ajo e ekspozonte besimin e tij të korruptuar.

Marmaduke Pickthall e ka përkthyer fjalën “VETËM” saktë, por e prishi kriterin duke futur besimin e tij personal në kllapa; ai përktheu 39:45 si në vijim:

Dhe kur vetëm Allahu përmendet, zemrat e atyre që nuk besojnë në Përrjetësinë zbrapsen, dhe kur ata (që ata i adhurojnë) përkrah Tij përmenden, ja! ata janë të kënaqur. [39:45] (sipas Marmaduke Pickthall)

Kur e pashë të vërtetën e fjalës së Zotit të shtrembëruar në atë mënyrë vendosa ta përkthej Kuranin, së paku për të mirën e fëmijëve të mi. Pasi që isha kimist me profesion, dhe pavarësisht nga prapavija e gjerë fetare e imja – babai im ishte udhëheqës Sufi me nam në Egjipt – iu betova Zotit që nuk do të lëvizja nga njëra strofë në tjetrën në mos e kuptofsha plotësisht atë.

I bleva të gjitha librat në dispozicion të përkthimeve të Kuranit dhe interpretimet (Tefsiret) që munda t’i gjejë, i vura në nja tavolinë të madhe, dhe fillova përkthimin tim. Surja e parë, Çelësi, u përfundua për pak ditë. Strofa e parë në Suren 2 është “A.L.M.” Për të përkthyer këtë strofë mu deshën katër vite, dhe kjo përkoi me zbulimin hyjnor të “sekretit”, Mrekullisë së madhe Matematikore të Kuranit. Librat e interpretimeve Kuranore unanimisht pajtoheshin që “askush nuk e din domethënien ose rëndësinë e Inicialeve Kuranore A.L.M., ose ndonjë iniciali tjetër.” Vendosa të shkruaj Kuranin në kompjuter, të analizoj krejt tekstin, dhe të shoh nëse kishte ndonjë ndërthurje matematikore ndërmjet këtyre inicialeve Kuranore. Përdora një terminal time-share, të lidhur me telefon në një kompjuter të madh. Për të testuar hipotezën, vendosa të shikoj Inicialet Kuranore me vetëm një shkronjë – “K” (Kaf) të Sureve 42 dhe 50, “S” (Sad) të Sureve 7, 19, dhe 38, dhe “N” (Nun) të Sures 68. Siç është treguar hollësisht në librin tim të parë MREKULLIA E KURANIT: RËNDËSIA E SHKRONJAVE MISTERIOZE (Islamic Productions, 1973), shumë përpjekje të mëparshme për të zgjidhur misterin kishin dështuar.

Iniciali Kuranor “K” (Kaf)

Të dhënat e kompjuterit treguan që teksti i të vetmeve sure me inicialin “K”, 42 dhe 50, përmbante numrin e njëjtë të K-ve, 57 dhe 57. Ai ishte aluzioni i parë që ndoshta një sistem matematikor i qëllimshëm ekziston në Kuran.

Surja 50 titullohet “K,” me prefiksin “K,” dhe strofa e parë shkruan, “K, dhe Kurani i madhërishëm.” Kjo sugjeronte që “K” paraqiste “Kuranin,” dhe numri total i K-ve në dy suret me iniciale “K” paraqiste 114 suret e Kuranit ($57+57 = 114 = 19 \times 6$). Kjo ide u përforcua nga fakti që fjala “Kurani” ndodh në Kuran 57 herë.

Kurani përshkruhet në Suren “K” si “Mexhid” (i madhërueshëm), dhe fjala arabe “Mexhid” ka vlerën germore $57: M(40)+XH(3)+I(10)+D(4) = 57$.

Surja 42 përbëhet nga 53 strofa, dhe $42+53 = 95 = 19 \times 5$.

Surja 50 përbëhet nga 45 strofa, dhe $50+45 = 95$, i njëjti total si në Suren 42.

Duke numëruar shkronjën “K” në secilën “Strofë 19” përgjatë Kuranit, totali del 76, 19×4 . Ja një përmbledhje e të dhënave që kanë lidhje me K-në:

- 1 Shpeshtësia e ndodhjes së “K” në Suren “K” (Nr. 50) është 57, 19×3 .
- 2 Shkronja “K” ndodh në suren tjetër me inicial “K” (Nr. 42) saktësisht po aq herë, 57.

- | | |
|---|--|
| 3 | Ndodhja totale e shkronjës “K” në dy suret me inicial “K” është 114, gjë që është e barabartë me numrat e sureve në Kuran. |
| 4 | “Kurani” përmendet në Kuran 57 herë. |
| 5 | Përshkrimi i Kuranit si “Mexhid” (Madhështor) ka lidhje me shpeshtësinë e ndodhjes së shkronjës “K” në secilën nga suret me inicial “K”. Fjala “Mexhid” ka vlerë germore 57. |
| 6 | Surja 42 përbëhet nga 53 strofa, dhe 42+53 është 95, ose 19x5. |
| 7 | Surja 50 përbëhet nga 45 strofa, dhe 50+45 bën 95, 19x5. |
| 8 | Numri i K-ve në të gjitha strofat me numër “19” përgjatë Kuranit është 76, 19x4. |

Dukuritë e para të hartimit matematikor të Kuranit filluan të shfaqen. Për shembull, u vërejt që njerëzit që nuk i besuan Lutit përmenden në 50:13 dhe ndodhin në Kuran 13 herë - 7:80; 11:70, 74, 89; 21:74; 22:43; 26:160; 27:54, 56; 29:28; 38:13; 50:13; dhe 54:33. Vazhdimisht, atyre iu referohet si “Kaum,” me të vetmin përjashtim në Suren me inicial “K”, në Suren 50 ku atyre iu referohet si “Ikhuun.” Natyrisht, nëse fjala e rregullt që përmbante “K-në” do të përdorej, numri i shkronjave “K” në Suren 50 do të ishte bërë 58, dhe i tërë ky fenomen do të ishte zhdukur. Me saktësinë absolute të matematikës që tashmë dihet, ndryshimi i vetëm një shkronje e shkatërron sistemin. Një shembull tjetër i rëndësishëm është përmendja e Mekës në 3:96 si “Beka”! Ky shqiptim i çuditshëm i qytetit me nam ka qenë enigmë për studiuesit Islamik për shumë shekuj. Edhe pse Meka përmendet në Kuran e shqiptuar si duhet në strofën 48:24, shkronja “M” zëvendësohet me “B-në” në strofën 3:96. Shihet që Surja 3 është sure me inicial “M”, dhe numri i shkronjës “M” do të kishte devijuar nga kodi i Kuranit nëse “Meka” do të ishte shqiptuar si duhet në 3:96.

NuN (Nun)

Ky inicial është i veçantë; ndodhë vetëm në suren 68, dhe emri i shkronjës është i shqiptuar si tre shkronja – *Nun U Nun* – në tekstin origjinal, dhe prandaj numërohet si dy N-ja. Numri total i kësaj shkronje në suren me inicial N është 133, 19x7. Fakti që “N-ja” është Iniciali i fundit Kuranor (shih Tabelën 1) nxjerr në pah një numër të dukurive të veçanta. Për shembull, numri i strofave nga Iniciali i parë Kuranor (A.L.M. i 2:1) deri te iniciali i fundit (N-ja e 68:1) është 5263, ose 19x277.

Fjala “Zot” (Allah) ndodh 2641 (19x139) herë ndërmjet inicialit të parë dhe inicialit të fundit. Pasi që ndodhja totale e fjalës “Zot” është 2698, rrjedh që ndodhja e saj jashtë inicialeve “A.L.M.” të strofës 2:1 në njërën anë, dhe inicialit “N” të strofës 68:1 në anën tjetër, është 57, 19x3. Tabelat 9 deri në 18 vërtetojnë që iniciali “NuN” duhet të shkruhet në atë mënyrë që të paraqesë dy N-ja.

S (Sad)

Ky inicial është para tre sureve, 7, 19, dhe 38, dhe ndodhja totale e shkronjës “S” (Sad) në këto tre sure është 152, 19x8 (Tabela 2). Vlen të përmendet që në 7:69, fjala “Bastatan” shkruhet në disa printime me “Sad,” në vend të “Sin.”

Tabela 2: Shpeshtësia e ndodhjes së shkronjës “S” në suret me inicial Sad

Surja	Shpeshtësia e shkronjës "S"
7	97
19	26
38	29
	152 (19x8)

Ky është një shtrembërim i gabuar që shkelë kodin e Kuranit. Duke e shikuar kopjen më të vjetër të Kuranit në dispozicion, Kopjen Tashkent, u gjet që fjala “Bastatan” shqiptohet në mënyrë të saktë me shkronjën “Sin” (shih fotokopjen më poshtë).



Shënim historik

Zbulimi shumë i rëndësishëm që numri “19” është plotpjesëtuesi i përbashkët i Kuranit u bë realitet në Janar të 1974, që përkon me Dhyl-Hixhe 1393 Pas Hixhrës. Kurani u shpall në vitin 13 (Para Hixhrës). Kjo e bën numrin e viteve nga shpallja e Kuranit deri te shpallja e mrekullisë së tij $1393 + 13 = 1406 = 19 \times 74$. Siç është shënuar më lartë, zbulimi i Mrekullisë ndodhi në Janar 1974. Lidhja ndërmjet 19×74 viteve hënore dhe 1974 viteve diellore nuk na shpëtoi pa e vërejtur. Kjo është posaçërisht e misterhme duke marrë parasysh faktin që numri “19” përmendet në Suren 74.

J. S. (Ja Sin)

Këto dy shkronja janë para Sures 36. Shkronja “J” ndodh në këtë sure 237 herë, përderisa “S-ja” (Sin) ndodh 48 herë. Shuma e të dy shkronjave është 285, 19×15 .

Vlen të përmendet që shkronja “J” është e shkruar në Kuran në dy forma; njëra është e fortë kurse tjetra e butë. Forma e butë e shkronjës mund të iu përzihet atyre që nuk janë të njoftuar mirë me gjuhën arabe. Një shembull i mirë është fjala “Araanj” **أَرَانِي** që përmendet dy herë në 12:36. Shkronja “J” përdoret dy herë në këtë fjalë, e para “J” është e butë dhe e dyta e fortë. Surja 36 nuk përmban asnjë “J” që është e llojit të butë. Ky është fenomen i mrekullueshëm, dhe që zakonisht nuk ndodh në një sure të gjatë si Surja 36. Në librin tim KURANI: PREZANTIMI VIZUEL I MREKULLISË (Islamic Productions, 1982) secila “J” dhe “S” në Suren 36 shënohet me një yll.

H.M. (Ha Mim)

Shtatë sure kanë parashtesa me shkronjat “H” **ح** dhe “M” **م**; suret prej 40 deri në 46. Ndodhja totale e këtyre dy shkronjave në shtatë suret me initiale H.M. është 2147, ose 19×113 . Detajet paraqiten në Tabelën 3. Natyrisht, ndryshimi i edhe një shkronje të vetme “H” ose “M” në cilëndo nga shtatë suret me inicialet H.M. do e kishte shkatërruar këtë fenomen të ndërthurur.

Tabela 3: Ndodhja e shkronjave “H” dhe “M” në shtatë suret me initiale H.M.

Nr.	Shpeshësia e Ndodhjes		
	"H"	"M"	"H+M"
40	64	380	444
41	48	276	324
42	53	300	353
43	44	324	368
44	16	150	166
45	31	200	231
46	36	225	261
	292	1855	2147
			(19x113)

`A.S.K. (`Ajn Sin Kaf)

Këto inicialet përbëjnë Strofën 2 të Sures 42, dhe ndodhja totale e këtyre shkronjave në këtë sure është 209, ose 19x11. Shkronja "A" (`Ajn) ndodhet 98 herë, shkronja "S" (Sin) ndodhet 54 herë, dhe shkronja "K" (Kaf) ndodhet 57 herë.

A.L.M. (Alif Lam Mim)

Shkronjat "A," "L," dhe "M" janë shkronjat më të shpeshta në përdorim në gjuhën arabe, dhe në të njëjtin rend siç i shohim në Inicialet Kuranore – "A," pastaj "L," pastaj "M." Këto shkronja janë para gjashtë sureve – 2, 3, 29, 30, 31, dhe 32 – dhe ndodhja totale e tre shkronjave në secilën nga gjashtë suret është shumëfish i 19-tës [9899 (19x521), 5662 (19x 298), 1672 (19x88), 1254 (19x66), 817 (19x43), dhe 570 (19x30), përkatësisht]. Pra, ndodhja totale e tre shkronjave në gjashtë suret është 19874 (19x1046), dhe ndryshimi i njëjës nga këto shkronja e shkatërron këtë fenomen.

Tabela 4: Ndodhja e shkronjës "A," "L," dhe "M" në suret me inicialet A.L.M.

Surja	Shpeshtësia e Ndodhjes			
Nr.	"A"	"L"	"M"	Totali
2	4502	3202	2195	9899 (19x521)
3	2521	1892	1249	5662 (19x298)
29	774	554	344	1672 (19x88)
30	544	393	317	1254 (19x66)
31	347	297	173	817 (19x43)
32	257	155	158	570 (19x30)
	8945	6493	4436	19874 (19x1046)

A.L.R. (Alif Lam Ra)

Këto inicialet gjenden në Suret 10, 11, 12, 14, dhe 15. Ndodhja totale e këtyre shkronjave në këto sure është 2489 (19x131), 2489 (19x131), 2375 (19x 125), 1197 (19x63), dhe 912 (19x48), përkatësisht (Tabela 5).

Tabela 5: Ndodhja e shkronjave "A," "L," dhe "R" në suret me inicialet A.L.R.

Surja	Shpeshtësia e ndodhjes			
Nr.	"A"	"L"	"R"	
10	1319	913	257	2489 (19x131)
11	1370	794	325	2489 (19x131)
12	1306	812	257	2375 (19x125)
14	585	452	160	1197 (19x63)
15	493	323	96	912 (19x48)
	5073	3294	1095	9462 (19x498)

A.L.M.R. (Alif Lam Mim Ra)

Këto inicialet gjenden vetëm para sures nr. 13, dhe shpeshtësia totale e ndodhjes së katër shkronjave është 1482, ose 19x78. Shkronja "A" ndodhë 605 herë, "L" ndodhë 480 herë, "M" ndodhë 260 herë, dhe "R" ndodhë 137 herë.

A.L.M.S. (Alif Lam Mim Sad)

Vetëm një sure ka si prefiks këto iniciale, Surja 7, dhe shkronja "A" gjendet në këtë sure 2529 herë, "L" gjendet 1530 herë, "M" gjendet 1164 herë, dhe "S" (Sad) gjendet 97 herë. Pra, ndodhja totale e katër shkronjave në këtë sure është $2529+1530+1164+97 = 5320 = 19 \times 280$.

Një vrojtim i rëndësishëm këtu është marrëdhënia e ngërthyer që përfshinë shkronjën "S" (Sad). Ky inicial gjithashtu gjendet në Suret 19 dhe 38. Përderisa plotëson shkronjat e saj motra në Suren 7 për të dhënë totalin që është i plotpjesëtueshëm me 19, shpeshtësia e kësaj shkronje gjithashtu plotëson shkronjat motra të saj në Suret 19 dhe 38 për të dhënë shumëfish të 19-tës.

Aq më shumë, Iniciali Kuranor "S" (Sad) bashkëvepron me Inicialet Kuranore "Q.H.J.`A." (Qaf Haa Ja `Ajn) në Suren 19 për të dhënë një total tjetër që është gjithashtu shumëfish i 19-tës. Kjo marrëdhënie ndërlidhëse – që nuk është e veçantë vetëm për inicialin "S" (Sad) – kontribuon në ndërthurjen e kodit numerik të Kuranit.

Q.H.J.`A.S. (Qaf Ha Ja `Ajn Sad)

Kjo është bashkësia më e gjatë e inicialeve, që përbëhet nga pesë shkronja, dhe gjendet në një sure, në Suren 19. Shkronja "Q" në Suren 19 gjendet 137 herë, "H" gjendet 175 herë, "J" gjendet 343 herë, "`A" gjendet 117 herë, dhe "S" (Sad) gjendet 26 herë. Pra, ndodhja totale e pesë shkronjave është $137+175+343+117+26 = 798 = 19 \times 42$.

H., T.H. (Ta Ha), T.S. (Ta Sin), & T.S.M. (Ta Sin Mim)

Një marrëdhënie e ndërthurur i lidhë këto Inicialet Kuranore për të nxjerrë një total që është gjithashtu shumëfish i 19-tës. Iniciali "H." gjendet në Suret 19 dhe 20. Inicialet "T.H." gjenden te Surja 20. Inicialet "T.S." gjenden në Suren 27, përderisa inicialet "T.S.M." gjenden në Suret rreth saj 26 & 28.

Duhet të thuhet tashmë që inicialet më të gjata, më komplekse, dhe më të ndërlidhura dhe gjithëpërfshirëse gjenden në suret ku mrekulli të fuqishme të pazakonshme kallëzohen. Për shembull, lindja e Jezusit nga virgjëresha jepet në Suren 19, në të cilën gjendet bashkësia më e gjatë e inicialeve, Q.H.J.`A.S.

Inicialet e ndërlidhura "H.," "T.H.," "T.S.," dhe "T.S.M." gjenden në fillim të sureve që përshkruajnë mrekullitë e Moisiut, Jezusit, dhe ngjarjet e pazakonta që kanë të bëjnë me Salomonin dhe xhinët e tij. Zoti kështu furnizon evidencë më të fuqishme për të përkrahur mrekulli të fuqishme. Shpeshtësitë e ndodhjes së këtyre inicialeve paraqiten në Tabelën 6.

Tabela 6: Ndodhja e inicialeve Kuranore "H.," "T.H.," "T.S.," dhe "T.S.M." në suret e tyre

Surja	Shpeshtësia e			
	"H"	"T"	"S"	"M"
19	175	-	-	-
20	251	28	-	-
26	-	33	94	484
27	-	27	94	-
28	-	19	102	460
	426	107	290	944
$426+107+290+944 = 1767 = (19 \times 93)$				

Çka është “Vlera Germore”?

Kur u shpall Kurani, 14 shekuj më parë, numrat që i njohim sot nuk ekzistonin.

Një sistem i përgjithshëm përdorej ku shkronjat e alfabeve arabe, hebreje, aramaike, dhe greke përdoshin si shifra. Numri që i caktohej secilës shkronjë është “Vlera Germore” e saj. Vlerat numerike të alfabetit arab paraqiten në Tabelën 7.

								ا	1
ي	ط	ح	ز	و	ه	د	ج	ب	2
10	9	8	7	6	5	4	3		
ق	ص	ف	ع	س	ن	م	ل	ك	20
100	90	80	70	60	50	40	30		
غ	ظ	ض	ذ	خ	ث	ت	ش	ر	200
1000	900	800	700	600	500	400	300		

Tabela 7: Vlerat germore të alfabetit arab

Tipare të tjera matematike të sureve me iniziale

Katërmbëdhjetë shkronja arabe, gjysma e alfabetit arab, marrin pjesë në formimin e 14 bashkësive të ndryshme të Inicialeve Kuranore. Duke mbledhur vlerën germore të secilës prej këtyre shkronjave, plus numrin e sureve të cilat kanë Inicialet Kuranore (29), marrim shumën 722, ose $19 \times 19 \times 2$.

Aq më shumë, nëse mbledhim vlerën totale germore të të gjitha 14 inicialeve, me numrin e surses së parë ku iniciali ndodh, marrim shumën totale 988, 19×52 . Tabela 8 paraqet këto të dhëna.

Tabela 8: 14 Shkronjat e përdorura në formimin e inicialeve Kuranore

Shkronja	Vlera	Surja e parë
A (Alif)	1	2
L (Lam)	30	2
M (Mim)	40	2
S (Sad)	90	7
R (Ra)	200	10
Q (Qaf)	20	19
H (Ha)	5	19
J (Ja)	10	19
`A (`Ajn)	70	19
T (Ta)	9	20
S (Sin)	60	26
H (HHa)	8	40
K (Kaf)	100	42
N (Nun)	<u>50</u>	<u>68</u>
	693	295
	$693 + 295 = 988 = 19 \times 52$	
	gjithashtu $693 + 29$ (suras) = $722 = 19 \times 19 \times 2$.	

Nëse e mbledhim numrin e ndodhjeve për secilën nga 14 shkronjat e renditura në Tabelën 8 si iniziale, plus numrin e sureve ku ajo ndodh si inicial, totali del 2033, 19×107 . Shih Tabelën 9.

Tabela 9: Shpërndarja e ndërtuar matematikisht e inicialeve Kuranore

Iniciali	Numri i ndodhjeve	Suret ku ndodhet	Totali
A (Alif)	13	[+ 2 + 3 + 7 + 10 + 11 + 12 + 13 + 14 + 15 + 29 + 30 + 31 + 32]	222
L (Lam)	13	[+ 2 + 3 + 7 + 10 + 11 + 12 + 13 + 14 + 15 + 29 + 30 + 31 + 32]	222
M (Mim)	17	[+ 2 + 3 + 7 + 13 + 26 + 28 + 29 + 30 + 31 + 32 + 40 + 41 + 42 + 43 + 44 + 45 + 46]	519
S (Sad)	3	+7+19+38	67
R (Ra)	6	+10+11+12+13+14+15	81
Q (Qaf)	1	+ 19	20
H (Ha)	2	+ 19 + 20	41
J (Ja)	2	+ 19 + 36	57
`A (`Ajn)	2	+ 19 + 42	63
T (Ta)	4	+ 20 + 26 + 27 + 28	105
S (Sin)	5	+ 26 + 27 + 28 + 36 + 42	164
H (Hha)	7	+ 40 + 41 + 42 + 43 + 44 + 45 + 46	308
K (Kaf)	2	+ 42 + 50	94
N (Nun)	2	+ 68	70
	79	1954	2033

(19x107)

Tabela 10: Vlera totale germore e të gjitha inicialeve Kuranore në suret e tyre

Tabela 10 paraqet shpeshhtësinë totale të Inicialeve Kuranore, plus vlerën totale germore të këtyre shkronjave në tërësi. Shuma Totale për të gjitha suret me iniciale është 1089479. Ky numër, më i madh se një milion, është shumëfish i 19-tës (1089479 = 19 x 57341). Edhe ndryshimi apo shtrembërimi më i vogël e shkatërron sistemin.

Vini re: Vlera totale germore e Inicialeve Kuranore në një sure të caktuar është e barabartë me vlerën germore të secilit inicial i shumëzuar me shpeshhtësinë e ndodhjes të atij iniciali në sure.

Surja	Inicialet	Shpeshhtësia e inicialeve	Vlera totale germore në sure
2	A.L.M.	9899	188362
3	A.L.M.	5662	109241
7	A.L.M.S	5320	103719
10	A.L.R.	2489	80109
11	A.L.R.	2489	90190
12	A.L.R.	2375	77066
13	A.L.M.R.	1482	52805
14	A.L.R.	1197	46145
15	A.L.R.	912	29383
19	Q.H.J.`A.S.	798	17575
20	T.H.	279	1507
26	T.S.M.	611	25297
27	T.S.	121	5883
28	T.S.M.	581	24691
29	A.L.M.	1672	31154
30	A.L.M.	1254	25014
31	A.L.M.	817	16177
32	A.L.M.	570	11227
36	J.S.	285	5250
38	S.	29	2610
40	H.M.	444	15712
41	H.M.	324	11424
42	H.M.-`A.S.K.	562	28224
43	H.M.	368	13312
44	H.M.	166	6128
45	H.M.	231	8248
46	H.M.	261	9288
50	K	57	5700
68	N,N	133	6650
		41388	1048091

41388 + 1048091 = 1089479 (19 x 57341)

Parametra madhor të inicialeve Kuranore (Suret, strofat, shpeshësia, surja e parë, & surja e fundit)

Tabela 11 tregon që shuma e numrave të sureve dhe strofave ku Inicialet Kuranore gjenden, plus shpeshësia e ndodhjes së inicialit në atë sure, plus numri i sures së parë ku inicialet ndodhen, plus numri i sures së fundit ku inicialet ndodhen, jep një total që është i barabartë me 44232, ose 19×2348 . Pra, shpërndarja e Inicialeve Kuranore në suret me iniciale është aq e ndërlidhur sa që numri i tyre dhe vendosja e tyre përbrenda sureve janë të ndërlidhura që të japin një shumë totale që është shumëfish i 19-tës.

Vlen të përmendet që iniciali “N” duhet të numërohet si dy N-ja. Kjo pasqyron faktin që teksti original Kuranor e shqipton këtë inicial me 2 N-ja.

Tabela 11: Parametrat e 14 inicialeve individuale Kuranore

Iniciali	Surja, strofa, & (shpeshësia) e inicialit në secilën sure	Surja e parë	Surja e fundit
A (Alif)	2:1 (4502), 3:1 (2521), 7:1 (2529), 10:1 (1319) 11:1 (1370), 12:1 (1306), 13:1 (605), 14:1 (585), 15:1 (493), 29:1 (774), 30:1 (544), 31:1 (347), 32:1 (257)	2	32
L (Lam)	2:1 (3202), 3:1 (1892), 7:1 (1530), 10:1 (913), 11:1 (794), 12:1 (812), 13:1 (480), 14:1 (452), 15:1 (323), 29:1 (554), 30:1 (393), 31:1 (297), 32:1 (155)	2	32
M (Mim)	2:1 (2195), 3:1 (1249), 7:1 (1164), 13:1 (260) 26:1 (484), 28:1 (460), 29:1 (344), 30:1 (317), 31:1 (173), 32:1 (158), 40:1 (380), 41:1 (276), 42:1 (300), 43:1 (324), 44:1 (150), 45:1 (200), 46:1 (225)	2	46
S (Sad)	7:1 (97), 19:1 (26), 38:1 (29)	7	38
R (Ra)	10:1 (257), 11:1 (325), 12:1 (257), 13:1 (137), 14:1 (160), 15:1 (96)	10	15
Q (Qaf)	19:1 (137)	19	19
H (Ha)	19:1 (175), 20:1 (251)	19	20
J (Ja)	19:1 (343), 36:1 (237)	19	36
ʾA (ʾAjn)	19:1 (117), 42:2 (98)	19	42
T (Ta)	20:1 (28), 26:1 (33), 27:1 (27), 28:1 (19)	20	28
S (Sin)	26:1 (94), 27:1 (94), 28:1 (102), 36:1 (48), 42:2 (54)	26	42
H (Hha)	40:1 (64), 41:1 (48), 42:1 (53), 43:1 (44) 44:1 (16), 45:1 (31), 46:1 (36)	40	46
K (Kaf)	42:2 (57), 50:1 (57)	42	50
N (NuN)	68:1 (133)	68	68
	43423	295	514
Shuma Totale = $43423 + 295 + 514 = 44232 = 19 \times 2328$.			

Një kodim matematikor i posaçëm vërteton numrin e strofave ku vetë Inicialet Kuranore gjenden. Siç paraqitet hollësisht në Tabelën 11, të gjitha Inicialet Kuranore ndodhen në Strofën 1, përveç në Suren 42 (inicialet në Strofat 1 dhe 2). Ky fakt përkrahet nga fenomeni matematikor i mrekullueshëm i paraqitur hollësisht në Tabelën 12. Nëse i shumëzojmë dy kolonat e para të Tabelës 12, në vend që t'i mbledhim, prapë se prapë përfundojmë me Shumë që është e plotpjesëtueshme me 19 (shih Tabelën 13).

Tabela 12: Kodimi matematikor i numrave të strofave me iniale

Nr. i sures	Nr. i inialeve	Strofat me iniale
2	3	1
3	3	1
7	4	1
10	3	1
11	3	1
12	3	1
13	4	1
14	3	1
15	3	1
19	5	1
20	2	1
26	3	1
27	2	1
28	3	1
29	3	1
30	3	1
31	3	1
32	3	1
36	2	1
38	1	1
40	2	1
41	2	1
42	5	2
43	2	1
44	2	1
45	2	1
46	2	1
50	1	1
68	2	1
822	79	30
$822 + 79 + 30 = 931 (19 \times 49)$		

Tabela 13: Shumëzimi i dy kolonave të para të Tabelës 12, në vend të mbledhjes

Nr. i sures		Nr. i inialeve	Nr. i strofave me iniale
2	x	3	1
3	x	3	1
7	x	4	1
-		-	-
42	x	5	2
-		-	-
50	x	1	1
68	x	2	1
	2022		30
$2022 + 30 = 2052 (19 \times 108)$			

Natyrisht, është me rëndësi të kemi dy strofa të ndryshme me iniale në Suren 42 në mënyrë që të përputhen me kodin matematikor të Kuranit. Fakti që Strofa 1 e Sures 42 përbëhet nga dy Iniale Kuranore “H.M.” dhe strofa e dytë përbëhet nga tre Iniale “A.S.K.” i ka hutuar studiuesit dhe orientalistët Mysliman për 14 shekuj.

Nga fundi i kësaj Shtojce, lexuesi do të shohë që çdo element i Kuranit është i vërtetuar matematikisht. Elementet me të cilat po merremi ne tani janë “numri i Inialeve Kuranore në secilën sure me iniale” dhe “numri i strofave që

përmbajnë Iniale Kuranore.” Tabelat 11 deri në 13 merren me këto dy elemente.

Vërtetim shtesë matematikor paraqitet në Tabelat 14 dhe 15. Në Tabelën 14, i kemi numrat e të gjitha sureve me iniale të mbledhura me numrat e strofave në secilën sure, plus numrin e strofave që përmbajnë iniale, plus vlerat germore të atyre inialeve. Shuma Totale është 7030, ose 19×370 .

Tabela 14: Karakteristikat matematikore të sureve me iniciale

<u>Numri i sures</u>	<u>Nr. i strofave</u>	<u>Numri i strofave me iniciale</u>	<u>Vlera gormore e inicialeve</u>	<u>TOTALI</u>
2	286	1	71	360
3	200	1	71	275
7	206	1	161	375
10	109	1	231	351
11	123	1	231	366
12	111	1	231	355
13	43	1	271	328
14	52	1	231	298
15	99	1	231	346
19	98	1	195	313
20	135	1	14	170
26	227	1	109	363
27	93	1	69	190
28	88	1	109	226
29	69	1	71	170
30	60	1	71	162
31	34	1	71	137
32	30	1	71	134
36	83	1	70	190
38	88	1	90	217
40	85	1	48	174
41	54	1	48	144
42	53	2	278	375
43	89	1	48	181
44	59	1	48	152
45	37	1	48	131
46	35	1	48	130
50	45	1	100	196
68	52	1	50 + 50	221
822	+ 2743	+ 30	+ 3435	= 7030 (19x370)

Për mrekulli, nëse i shumëzojmë dy kolonat e para të Tabelës 14, në vend që t'i mbledhim, **prapë se prapë del një Shumë Totale që është e plotpjesëtueshme me 19** (Tabela 15).

Tabela 15: Shumëzimi i 2 kolonave të para të tabelës 14, në vend që ti mbledhim

<u>Numri i sures</u>		<u>Numri i strofave</u>		<u>Numri i strofave me iniciale</u>		<u>Vlera gormore e inicialeve</u>		<u>TOTALI</u>
2	x	286	+	1	+	71	=	644
3	x	200	+	1	+	71	=	672
7	x	206	+	1	+	161	=	1604
-		-		-	-	-		-
50	x	45	+	1	+	100	=	2351
68	x	52	+	1	+	(50+50)	=	3637
		60071		30		3435	=	63536
								(19x3344)

Numri i strofave për sure, dhe numrat e caktuar për secilën strofë janë mes elementeve themelore të Kuranit. Jo vetëm që këto elemente janë të vërtetuara matematikisht, por të dyja suret me iniciale dhe pa iniciale janë të koduara edhe veç e veç. Pasi që ne po merremi me suret me iniciale, Tabela 16 paraqet numrat e caktuar për këta sure, të mbledhur me numrat e strofave në secilën sure, plus shumën numrave të strofave $(1+2+3+ \dots + n)$. Shuma totale është 190133, apo 19×10007 .

Tabela 16: Strukturimi matematikor i strofave të sureve me inicialet

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e Nr. të strofave	Totali
2	286	41041	41329
3	200	20100	20303
7	206	21321	21534
-	-	-	-
50	45	1035	1130
68	52	1378	1498
822	2743	186568	190133

(19x10007)

Tabela 17: Vlerat e arritura duke mbledhur një pas një numrat e sureve.

Nr. i sures	Vlera e njehsuar
2	3
3	6
7	28
10	55
11	66
12	78
13	91
14	105
15	120
19	190
20	210
-	-
44	990
45	1035
46	1081
50	1275
68	2346
	15675
	(19x825)

Duke mbledhur numrin e secilës sure me numrin e sures së ardhshme, dhe duke akumuluar shumën e numrave të sureve përdorisa vazhdojmë këtë proces deri në fund të Kuranit, do të kemi vlerë që korrespondon me secilën sure. Pra, Surja 1 do të ketë vlerë korresponduese 1, Surja 2 do të ketë vlerë $1+2=3$, Surja 3 do të ketë vlerë $3+3=6$, Surja 4 do të ketë vlerë $6+4=10$, dhe kështu me radhë deri në fund të Kuranit. Vlerat totale të sureve me inicialet dhe pa inicialet janë veç e veç të plotpjesëtueshme me 19. Vlerat për suret e pa inicialet paraqiten në Tabelën 17.

Vlerat e njehsuara për suret e painicializuara japin shumën totale 237785, e cila është gjithashtu shumëfish i 19-tës ($237785 = 19 \times 12515$).

Kodimi matematikor i fjalëve të posaçme: Fjala “Zot” (Allah)

[1] Siç u tregua më herët fjala “Zot” gjendet në Kuran 2698 herë, 19×142 .

[2] Numri i strofave ku fjala “Zot” gjendet jep shumën 118123, gjithashtu shumëfish i 19-tës ($118123 = 19 \times 6217$).

Këto fenomene të thjeshta na sollën shumë vështirësi përdorisa thjeshtë e numëruam fjalën “Zot.” Ishim një grup hulumtuesish, të pajisur me kompjuterë, dhe të gjithë ne të diplomuar. Prapë se prapë, ne bëmë shumë gabime kur i numëruam, llogaritëm, ose thjeshtë kur i shkruamë numërimet e fjalës “Zot.” Ata që ende pretendojnë që Muhamedi ishte autori i Kuranit janë krejtësisht të palogjikshëm; ai nuk shkoi në universitet, dhe ai nuk kishte kompjuter.

[3] Nga iniciali i parë Kuranor (A.L.M. 2:1) deri te iniciali i fundit (N. 68:1), janë 2641, 19×139 , ndodhje të fjalës “Zot.”

[4] Fjala “Zot” ndodh 57 herë në pjesën jashtë Inicialeve (Tabela 18).

[5] Duke i shtuar numrat e sureve dhe strofave ku këto 57 ndodhje të fjalëve “Zot” gjenden, marrim një total 2432, ose 19×128 . Shih Tabelën 18.

[6] Fjala “Zot” ndodh në 85 sure. Nëse e mbledhim numrin e secilës sure me numrin e strofave ndërmjet ndodhjes së parë dhe të fundit të fjalës “Zot,” duke përfshirë edhe ato dy strofa, Shuma Totale del 8170 ose 19×430 . Një paraqitje e shkurtër e të dhënave është në Tabelën 19.

Këto karakteristika matematikore përfshijnë të gjitha ndodhjet e fjalës “Zot.”

[7] Lajmi dominues i Kuranit është që është vetëm “Një Zot.” Fjala “Një,” në arabisht “Vahid” ndodh në Kuran 25 herë. Gjashtë prej këtyre ndodhjeve iu referohen tjetër pos Zotit (një lloj ushqimi, një derë, etj.). 19 ndodhjet e tjera i referohen Zotit. Këto të dhëna gjenden në referencën klasike INDEKSI I FJALËVE TË KURANIT.

Tabela 19: Të gjitha suret në të cilat fjala “Zot” (Allah) përmendet

	<u>Nr. i sures</u>	<u>Strofa e parë</u>	<u>Strofa e fundit</u>	<u>Strofat prej të parës deri të fundit</u>
1.	1	1	2	2
2.	2	7	286	280
3.	3	2	200	199
-	-	-	-	-
84.	110	1	2	2
85.	112	1	2	2
	3910			4260
	$3910 + 4260 = 8170 = 19 \times 430$			

Tabela 18: Ndodhja e fjalës “Zot” jashtë pjesës së inicializuar

Nr. i sures	Nr. i strofave	Sa herë ndodhë
1	1,2	2
69	33	1
70	3	1
71	3,4,13,15,17,19,25	7
72	4,5,7,12,18,19,22,23	10
73	20	7
74	31,56	3
76	6,9,11,30	5
79	25	1
81	29	1
82	19	1
84	23	1
85	8,9,20	3
87	7	1
88	24	1
91	13	2
95	8	1
96	14	1
98	2,5,8	3
104	6	1
110	1,2	2
112	1,2	2
1798	634	57
		(19x3)
Shuma e numrave të sureve & strofave = $1798 + 634 = 2432 = 19 \times 128$		
Ndodhja totale e fjalës “Zot” jashtë pjesës së inicializuar = $57 (19 \times 3)$.		

PSE 19!

Siç u theksua më vonë në këtë shtojcë, të gjitha shkrimet e Zotit, jo vetëm Kurani, ishin matematikisht të koduara me numrin “19.” Madje edhe gjithësia në përgjithësi e mbanë këtë shenjë hyjnore. Numrin 19 mund ta shohim si nënshkrim të Krijuesit të Plotfuqishëm në çdo gjë që Ai krijoi (shih Shtojcën 38). Numri “19” posedon karakteristika të posaçme matematikore përtej kufijve të kësaj Shtojce. Për shembull:

[1] Është numër i thjeshtë (prim).

[2] Përfshin numrin e parë (1) dhe numrin fundit (9), sikur të donte të thoshte vetinë e Zotit në 57:3 si “Alfa dhe Omega.”

[3] Duket ngjashëm në të gjitha gjuhët e botës. Të dy përbërësit, 1 dhe 9, janë të vetmit numra që duken të ngjashëm në të gjitha gjuhët.

[4] Posedon karakteristika të veçanta matematikore. Për shembull, 19-shi është shuma e fuqive të para të 9 dhe 10, dhe diferenca ndërmjet fuqive të dyta të 9 dhe 10.

Tabela 20: Pse "19!"

Shkronja		
Hebraisht	Arabisht	Vlera
V	U	6
A	A	1
H	H	8
D	D	4
		19

Zoti, Zotëruesi ynë është NJË!
Prandaj, ta adhuroni
Zotin Zotëruesin tuaj
me gjithë zemër, me gjithë shpirt,
me gjithë mendje, dhe me gjithë forcën tuaj.

[Ligji i Përtërirë 6:4-5]

[Marku 12:29]

[Kuran 12:163, 17:22-23]

Tash e kuptojmë që kodimi i përbotshëm i krijesave të Zotit me numrin 19 mbështetet në faktin që është vlera germore e fjalës "NJË" në të gjitha gjuhët e shkrimeve – aramaike, hebreje, dhe arabishte.

Numri 19, pra, deklaron Urdhrin e Parë në të gjitha shkrimet: është vetëm NJË Zot.

Siç paraqitet në Tabelën 7, alfabeti aramaik, hebre, dhe arab përdorej edhe për shifra sipas një sistem të themeluar univerzalisht. Fjala Hebreje "NJË" është "VAHD" (shqiptohet V-EHED). Në arabisht, fjala "NJË" është "UAHD" (shqiptohet UAHD). Shih Tabelën 20.

Tabela 21: Suret dhe strofat ku fjala "Kuran" ndodhet

Surja	Strofa	Surja	Strofa
2	185	28	85
4	82	30	58
5	101	34	31
6	19	36	2
7	204	-	69
9	111	38	1
10	37	39	27
-	61	-	28
12	2	41	3
-	3	-	26
15	1	42	7
-	87	43	3
-	91	-	31
16	98	46	29
17	9	47	24
-	41	50	1
-	45	-	45
-	46	54	17
-	60	-	22
-	78	-	32
-	82	-	40
-	88	55	2
-	89	56	77
-	106	59	21
18	54	72	1
20	2	73	4
-	113	-	20
-	114	75	17
25	30	-	18
-	32	76	23
27	1	84	21
-	6	85	21
-	76	1356	3052
-	92	-	-

1356+3052=4408 = 19 x 232

Fjala "Kuran"

Fjala "Kuran" ndodh në Kuran 58 herë, me njëren prej tyre, në 10:15, që i referohet një "Kurani tjetër." Kjo ndodhje e veçantë, pra, duhet të përjashtohet. Pra, shpeshësia e ndodhjes së "këtij Kurani" në Kuran është 57, ose 19x3.

Dy forma tjera gramatikore të fjalës "Kuran" ndodhen në 12 strofa. Këto përfshijnë fjalën "Kuranun" dhe fjalën "Kuranahu." Njëra prej këtyre ndodhjeve, në 13:31 i referohet një "Kurani tjetër" që bën malet të shemben. Një ndodhje tjetër, në 41:44, i referohet "një Kurani jo-arabisht." Këto dy ndodhje, pra, përjashtohen. Tabela 21 tregon një listë të sureve dhe strofave ku fjala "Kuran," në të gjitha format e saj gramatikore gjendet.

THEMEL I FORTË


Strofa e parë e Kuranit, "Në Emër të Zotit, Mirëbërësit, Më të Mëshirshmit," e njohur si *Bismilahu*, përbëhet nga 19 shkronja arabe. Fjalët e saj përbërëse në Kuran ndodhen vazhdimisht në shumëfisha të 19-tës.

Fjala e parë	“Ism”	(Emër)	19 herë.
Fjala e dytë	“Allah”	(Zot)	2698 herë (19x142).
Fjala e tretë	“Al-Rrahman”	(Mirëbërësi)	57 herë, 19x3.
Fjala e katërt	“Al-Rrahim”	(i Mëshirshmi)	114 herë, 19x6.

Profesori Cesar Majul shikoi vlerat germore të më shumë se 400 vetive të Zotit, dhe gjeti që vetëm katër emra kishin vlera germore me shumëfish të numrit 19:

Emri Hyjnor	Vlera germore
1. “Uahed” (Një)	19
2. “Dhyl Fadl Al-`Adhim” (Posedues i Hirësisë së Pakufi)	2698
3. “Mexhid” (I Madhërishtëm)	57
4. “Xhami` “ (Mbledhës)	114

Siç ceket më lartë, të vetmit Emra Hyjnor vlerat germore të të cilëve janë të plotpjesëtueshëm me 19 korrespondojnë saktësisht me shpeshhtësinë e ndodhjes së katër fjalëve të Bismilahut. Figura më poshtë ilustron këtë fenomen të çuditshëm:



Katër fjalët e Bismilahit tregohen në anën e majtë, dhe katër emrat hyjnor të vetmit me vlera germore të plotpjesëtueshme me 19 janë në anën e djathtë. Numrat në mes janë shpeshhtësitë e ndodhjes së fjalëve të Bismilahit, dhe në të njëjtën kohë, vlerat germore të katër emrave hyjnor.

Pesë shtyllat e Islamit

Edhe pse Kurani jep urdhra të shumtë të rëndësishëm që rregullojnë të gjitha aspektet e jetëve tona (shih për shembull 17:22-38), pesë “shtylla” themelore janë theksuar tradicionalisht. Ato janë:

1. *Shehadeti*: Dëshmia që nuk ka asnjë zot tjetër përveç Zotit.

2. *Salati*: Zbatimi i pesë Lutjeve të përditshme të Kontaktit.

3. *Sejami*: Agjërimi gjatë muajit të nëntë të kalendarit Islamik (Ramazanit).

4. *Zeqati*: Dhënia e 2.5% të të ardhurave neto si bamirësi për njerëz të posaçëm.

5. *Haxhi*: Shtegtimi në Mekë një herë në jetë për ata që kanë mundësi.

Si çdo gjë tjetër në Kuran, këto janë matematikisht të ndërtuara.

Tabela 22: Të gjitha suret dhe strofat nga ndodhja e parë e LA ILAHE ILA HU deri te ndodhja e fundit.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
2	123	27675	27800
3	200	20100	20303
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
72	28	406	506
73	9	45	127
2700	5312	308490	316502
		(19x16658)	

1. Një Zot (Shehadeti):

Siç u përmend më herët, fjala “NJË” që i referohet Zotit ndodhet në Kuran 19 herë. Përmendja e fjalës “VETËM” sa i përket Zotit ndodhet 5 herë, dhe shuma e numrave të sureve dhe strofave ku gjejmë këto pesë ndodhje është 361, 19x19.

“Shtylla e Parë e Islamit” thuhet në 3:18 si “LA ILAHE ILA HU” (Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Tij). Kjo shprehje si më e rëndësishmja ndodhet në 19 sure. Ndodhja e parë është në 2:163, dhe ndodhja e fundit është në 73:9. Tabela 22 tregon që totali i numrave të sureve, plus numri i strofave ndërmjet ndodhjes së parë dhe të fundit, plus shuma e numrave të këtyre strofave është 316502, ose 19x16658.

Gjithashtu, duke mbledhur numrat e 19 sureve ku **LA ILAHE ILA HU** ndodhet, plus numrat e strofave ku kjo shprehje kyçe gjendet, plus numri total i ndodhjeve (29), Shuma Totale del 2128, ose 19x112. Detajet paraqiten në Tabela 23.

2. Lutjet e Kontaktit “Salat”:

Fjala “Salat” ndodh në Kuran 67 herë, dhe kur i mbledhim numrat e sureve dhe strofave të këtyre 67 ndodhjeve, totali del 4674, ose 19x246.

3. Agjërimi (Sejami):

Urdhri për të agjëruar përmendet në 2:183, 184, 185, 187, 196; 4:92; 5:89, 95; 33:35, 35; & 58:4. Totali i këtyre numrave është 1387, ose 19x73. Vlen të përmendet që 33:35 e përmend agjërimin dy herë, njëherë për besimtarët, dhe tjetrën për besimtare.

4. Bamirësia e Obligueshme (Zeqati):& 5. Shtegtimi Haxh në Mekë:

Përderisa tre të parat “Shtylla të Islamit” janë të obligueshme për të gjithë Myslimanët dhe Myslimanet, Zeqati dhe Haxhi janë shpallur vetëm për ata që kanë mundësi për to. Kjo shpjegon fenomenin interesant matematikor të ndërlidhur me Zeqatin dhe Haxhin.

Bamirësia *Zeqat* përmendet në 2:43, 83, 110, 177, 277; 4:77, 162; 5:12, 55, 7:156; 9:5, 11, 18, 71; 18:81; 19:13, 31, 55; 21:73; 22:41, 78; 23:4; 24:37, 56; 27:3; 30:39; 31:4; 33:33; 41:7; 58:13; 73:20; dhe 98:5. Këta numra japin shumën 2395. Ky total nuk ia del që të jetë shumëfish i 19-tës; është 1 më shumë.

Shtegtimi Haxh ndodh në 2:189, 196, 197; 9:3; dhe 22:27. Këta numra japin shumën 645, dhe kjo shumë nuk ia del të jetë shumëfish i 19-tës; është 1 më pak.

Pra, *Zeqati* dhe Haxhi, së bashku, japin shumën $2395+645 = 3040 = 19 \times 160$.

Tabela 23: Lista e të gjitha ndodhjeve të frazës kyçe: “LA ILAHE ILA HU” (Nuk ka zot tjetër përveç Tij)

Nr.	Nr. i sures	Strofat me shehadet	Shpeshtësia e shehadetit
1	2	163,255 2,6,18 (dy herë)	2
2	3	87	4
3	4	102,106	1
4	6	158	2
5	7	31	1
6	9	14	1
7	11	30	1
8	13	8,98	1
9	20	116	2
10	23	26	1
11	27	70,88	1
12	28	3	2
13	35	6	1
14	39	3,62,65	1
15	40	8	3
16	44	22,23	1
17	59	13	2
18	64	9	1
19	73		1
	507	1592	29
$507 + 1592 + 29 = 2128 = 19 \times 112$			

STRUKTURA MATEMATIKORE E KURANIT

Suret, strofat, fjalët, dhe shkronjat e Kuranit jo vetëm që janë të hartuara matematikisht, por gjithashtu rregullohen në një strukturë mbinjerëzore që është krejtësisht matematikore, d.m.th., përmbajtja letrare nuk ka asgjë të bëj me një rregullim të tillë.

Pasi që ndërtimi material i Kuranit është krejtësisht matematikor, do të pritej që numrat e përmendur në Kuran duhet të përputhen me kodin Kuranor të bazuar në 19.

Një total i 30 numrave të veçantë përmendet përgjatë Kuranit, dhe shuma e të gjithë këtyre numrave është 162146, shumëfish i 19-tës ($162146 = 19 \times 8534$). Tabela 24 rendit të gjithë numrat e përmendur në Kuran, pa përsëritje.

Numrat që përmenden vetëm një herë në Kuran janë: 11, 19, 20, 50, 60, 80, 99, 300, 2000, 3000, 5000, 50000, dhe 100000. Të gjithë numrat e përmendur në Kuran, me përsëritje, ndodhin 285 herë, dhe ky numër është shumëfish i 19-tës; $285 = 19 \times 15$.

Numrat e sureve dhe strofave

Sistemi i numrave të sureve dhe strofave të Kuranit është ruajtur në mënyrë të përkryer. Vetëm disa botime të paautorizuara dhe lehtë të zbuluara devijojnë nga sistemi standard që është i ruajtur hyjnisht.

Kur i mbledhim numrat e të gjitha sureve, plus numrin e strofave në secilën sure, plus shumën e numrave të strofave, Shuma totale për tërë Kuranin del 346199, $19 \times 19 \times 959$. Tabela 25 është paraqitje e shkurtër e këtyre të dhënave. Pra, edhe ndryshimi më i vogël i një sureje ose strofe të vetme do e kishte shkatërruar këtë sistem. Siç paraqitet në Tabelën 16, nëse i konsiderojmë vetëm 29 suret me iniciale, këto të dhëna të njëjta japin Shumën Totale e cila është gjithashtu shumëfish i 19-tës. Pason që të dhënat e sureve të painingualizuara janë gjithashtu të plotpjesëtueshme me 19.

Tabela 24: Të gjithë numrat Kuranor.

Numri	Shembull i vendit
1	2:163
2	4:11
3	4:171
4	9:2
5	18:22
6	25:59
7	41:12
8	69:17
9	27:48
10	2:196
11	12:4
12	9:36
19	74:30
20	8:65
30	7:141
40	7:142
50	29:14
60	58:4
70	9:80
80	24:4
99	38:23
100	2:259
200	8:65
300	18:25
1000	2:96
2000	8:66
3000	3:124
5000	3:125
50000	70:4
100000	37:147
162146 (19 x 8534)	

Tabela 25: Kodimi matematikor i numrave të sureve dhe strofave.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	TOTALI
1	7	28	36
2	286	41041	41329
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
113	5	15	133
114	6	21	141
6555	6234	333410	346199
		($19 \times 19 \times 959$)	

Tabela 26 është paraqitje e shkurtuar e të dhënave të njëjta që kanë lidhje me 85 suret pa initiale. Tash le të shikojmë një bashkësi tjetër të mrekullive që përfshijnë numrat e sureve dhe strofave.

Shkruaj numrat e sureve, të ndjekur me numrin e strofave në atë sure, pastaj numrin e secilës strofë, dhe më në fund, shumën e numrave të strofave. Pra, për Suren 1 do të shkruaje 1 për suren, pastaj 7 për numrin e strofave, 1234567 për numrin e secilës strofë, dhe më në fund 28 për shumën e numrave të strofave, d.m.th. 1 7 1234567 28. Numri i Sures 2 do të duket kështu: 2 286 123456... 286 41041. Bëjeni të njëjtën për të gjitha 114 suret, dhe pastaj mblidhni këta numra. Totali përbëhet nga 759 shifra, dhe është shumëfish i 19-tës.

Tani shkruani numrin total të strofave në sure, të ndjekur me shumën e numrave të strofave, dhe mbani të gjithë numrat në të majtë. Për shembull, numri i strofave në Suren 1 është 7, dhe shuma e numrave të strofave është 28. Pra, numri i kombinuar për Suren 1 do të jetë 7 28, për Suren 2 do të jetë 286 41041, për Suren 3 do të jetë 200 20100; dhe kështu me radhë deri te Surja 114 për të cilën numri i kombinuar është 6 21. Mos harroni që këta numra janë të shkruar krejtësisht në të majtë, siç paraqiten në Tabelën 28. Pastaj mblidhni ata në mënyrën e zakonshme, nga e djathta në të majtë. Totali i të gjithë këtyre numrave të drejtuar në të majtë është 4,859,309,774, ose 19×255753146 .

Më në fund, bëjeni të njëjtën gjë si më lartë (duke vazhduar t'i mbani të gjithë numrat të drejtuar në të majtë), përveç që i shkruani numrat e secilës strofë, në vend të numrit total të strofave. Për shembull, numri për Suren 1 përbëhet nga shtatë numra të strofave (1234567) i kombinuar me shumën e atyre numrave (28). Pra, numri i kombinuar i Sures 1 do të jetë 1234567 28. Numri i kombinuar për Suren 114 do të jetë 123456 21. Tabela 29 demonstroi këtë proces. Totali i të gjithë këtyre numrave të drejtuar në të majtë përbëhet nga 757 shifra, dhe prapë se prapë është shumëfish i 19-tës.

Tabela 26: Kodimi matematikor i 85 sureve të pa-inicializuara

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	TOTALI
1	7	28	36
4	176	15576	15756
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
113	5	15	133
114	6	21	141
5733	3491	146842 (19×8214)	156066

Tabela 27: Surja, numri total i strofave, numrat e strofave dhe shuma e numrave të strofave për secilën sure.

Surja	Surja, nr. i strofave, numrat e strofave & shuma e numrave të strofave
1	17123456728
2	228612345.....28641041
-	-
114	114612345621
Totali është 759 shifror & shumëfish i 19-tës	

Tabela 28: Numri i strofave për secilën sure & shuma e numrave të strofave, të drejtuar në të majtë

Surja	Strofat totale & shuma e strofave
1	728
2	28641041
3	20020100
-	-
114	621
$4859309774 = 19 \times 255753146$	

Tabela 29: Numrat e strofave dhe shuma e numrave të strofave, në të majtë

Surja	Numrat e strofave & shuma e strofave
1	123456728
2	1234...28641041
-	-
114	12345621
Totali është 757 shifror & shumëfish i 19-tës	

Ndërthurjet numerike mbinjerëzore

Le të shkruajmë numrin e secilës strofë në Kuran, për secilën sure pas numrit të strofave të asaj sureje. Pra, Surja 1, e cila përbëhet nga shtatë strofa, do të përfaqësohet nga numri 7 1234567. Çka ne po bëjmë këtu është që po formojmë numra të gjatë duke shkruar numrat e strofave afër njëra tjetrës. Për të gjetur numrin që përfaqëson Suren 2, shkruaje numrin e strofave në këtë sure, 286, të ndjekur nga numri i secilës strofë, të shkruara afër njëra tjetrës. Pra, numri që përfaqëson Suren 2 do të duket kështu: 286 12345.....284285286. Dy numrat që përfaqësojnë dy suret e para janë:

7 1 2 3 4 5 6 7 & 286 1 2 3 4 5.....284 285 286.

Duke i vendosur këta dy numra së bashku për të formuar një numër që përfaqëson dy suret e para, marrim këtë numër:

7 1 2 3 4 5 6 7 286 1 2 3 4 5.....284 285 286.

Ky proces vazhdohet derisa secila strofë në Kuran shkruhet, kështu duke formuar një numër shumë të gjatë që përfshinë numrin e secilës strofë në Kuran. Numri që përfaqëson tërë Kuranin **është shumëfish i 19-tës & përbëhet nga 12692 shifra, që është gjithashtu shumëfish i 19-tës.**

7 1234567 286 12345...286 ...5 12345 6 123456

Nr. I PARË: Ky numër shumë i gjatë përbëhet nga 12692 shifra (19x668) dhe përfshinë çdo strofë në Kuran. Numri i strofave në secilën sure është para strofave të saj. Një program i veçantë kompjuterik që pjesëton numra shumë të gjatë ka treguar që ky numër është shumëfish i 19-tës.

Në vend që të vihet numri total i strofave në secilën sure para sures, le ta vëmë atë në fund të secilës sure. Pra, numri që përfaqëson Suren 1 do të duket kështu: 1234567 7, në vend të 7 1234567. Numri që përfaqëson Suren 2 do të duket kështu: 12345.....284 285 286 286 në vend të 286 12345.....284285286. Numri që përfaqëson dy suret e para do të duket kështu:

1 2 3 4 5 6 7 7 & 1 2 3 4 5.....284 285 286 286.

Vendosja e këtyre dy numrave së bashku për të formuar një numër të gjatë që përfaqëson dy suret e para, na jep një numër që duket kështu:

1 2 3 4 5 6 7 7 1 2 3 4 5.....284 285 286 286.

Pasi që po e vendosim numrin total të strofave për sure në fund të secilës sure, duhet ta vendosim numrin total të strofave me numra (6234) në fund të Kuranit. Numrat e fundit, pra, përfaqësojnë suren e fundit (123456 6), të ndjekur me numrin total të strofave me numra në Kuran (6234):

1 2 3 4 5 6 6 & 6234 >>>>>1 2 3 4 5 6 6 6234.

Vendosja së bashku e të gjitha strofave, jep një numër të gjatë që përbëhet nga 12696 shifra, dhe është **shumëfish i 19.**

1234567 7 12345...286 286 12345 5...123456 6 6234

Nr. I DYTË: Numri i secilës strofë në secilën sure ndiqet nga numri i strofave për sure. 11 shifrat e fundit të treguara këtu janë 6 strofat e sures së fundit, të ndjekur me numrin e saj të strofave (6), të ndjekur nga numri total i strofave me numra në Kuran (6234). Numri i plotë, shumë i gjatë, është shumëfish i 19-tës.

Tani le të përfshijmë numrin e secilës sure.

Shkruaj numrin e secilës strofë në secilën sure, të ndjekur me numrin e sures, të ndjekur me numrin e strofave në sure. Pra, numri që përfaqëson Suren 1 duket kështu: 1 2 3 4 5 6 7 1 7. Numri që përfaqëson Suren 2 duket kështu: 1 2 3 4 5284 285 286 2 286. Numri që përfaqëson suren e

fundit (Nr. 114) duket kështu: 1 2 3 4 5 6 114 6. Përsëri, numri total i strofave me numra (6234) shtohet në fund. Ky numër, që përfaqëson tërë Kuranin, **është shumëfish i 19-tës**; duket kështu:

1234567 1 7 12345...286 2 286 ...123456 114 6 6234

Nr. I TRETË: Numri i secilës strofë, i ndjekur me numrin e sures, pastaj me numrin e strofave në sure. Numri total i strofave me numra shtohet në fund. Numri i gjatë (12930 shifror) është shumëfish i 19-tës.

Në vend që të vendosim numrin total të strofave në secilën sure pas sures, le ta vendosim atë para sures. Pra, numri që përfaqëson Suren 1 duket kështu: 7 1234567 1, në vend të 1234567 1 7, dhe numri që përfaqëson Suren 2 duket kështu: 286 12345.....284 285 286 2, në vend të 12345.....284 285 286 2 286. Ky numër shumë i gjatë që përfaqëson tërë Kuranin **është shumëfish i 19-tës**.

7 1234567 1 286 12345...286 2...6 123456 114 6234

Nr. I KATËRT: Numri total i strofave në secilën sure ndiqet nga numri i secilës strofë, pastaj nga numri i sures. 14 shifrat e fundit të paraqitura më lartë janë numri i strofave në suren e fundit (6), i ndjekur nga numrat e gjashtë strofave (123456), i ndjekur nga numri i sures (114), pastaj nga numri total i strofave në Kuran.

Numri shumë i gjatë (që përbëhet nga 12930 shifra) është shumëfish i 19-tës

Tani, le të shkruajmë numrin e secilës strofë në secilën sure, të ndjekur nga shuma e numrave të strofave të secilës sure. Surja 1 përbëhet nga 7 strofa, dhe shuma e numrave të strofave është $1+2+3+4+5+6+7 = 28$. Pra, numri që përfaqëson Suren 1 duket kështu: 1234567 28.

Shuma e numrave të strofave për Suren 2 është 41041 ($1+2+3+...+286$). Pra, numri që përfaqëson Suren 2 duket kështu: 12345...284 285 286 41041.

Numri që përfaqëson suren e fundit, që përbëhet nga 6 strofa, duket kështu: 123456 21, pasi që $1+2+3+4+5+6 = 21$.

Numri i plotë, që përfaqëson tërë Kuranin, përbëhet nga 12836 shifra dhe **është shumëfish i 19-tës**. Duket kështu:

1234567 28 12345...284285286 41041...123456 21

Nr. I PESTË: Numri i secilës strofë në secilën sure ndiqet nga shuma e numrave të strofave. Numri i gjatë përbëhet nga 12836 shifra, dhe është shumëfish i 19-tës.

Për çudi, nëse e marrim "Nr. e Pestë" të treguar më lartë dhe e kthejmë mbrapsht rendin e numrave të strofave dhe shumës së numrave të strofave, d.m.th., të lëvizim shumën e numrave të strofave, dhe ta vëmë atë para sures, numri i gjatë që del **është ende shumëfish i 19-tës**.

28 1234567 41041 12345....285286.....21 123456

Nr. i GJASHTË: Vendosja e shumës së numrave të strofave para secilës sure, në vend që të vendoset pas saj, jep një numër të gjatë (12836 shifror) që është gjithashtu shumëfish i 19-tës.

Madje edhe nëse i shkruajmë suret mbrapshtë, d.m.th. e kthejmë renditjen e sureve duke filluar me suren e fundit dhe duke përfunduar me suren e parë, dhe duke vënë shumën e numrave të strofave pas strofave të secilës sure, rezultati **është ende shumëfish i 19-tës**.

123456 21 12345 15..12345..286 41041 1234567 28

Nr. I SHTATË: Kthimi mbrapsht i renditjes së sureve – duke filluar nga surja e fundit dhe duke përfunduar me suren e parë – dhe duke shkruar numrin e secilës strofë, me shumën e numrave të strofave për secilën sure pas strofave të saj, shuma është një numër i gjatë që përbëhet nga 12836. Ky numër i gjatë është shumëfish i 19-tës.

Shkruani shumën e numrave të strofave për tërë Kuranin (333410), të ndjekur nga numri total i strofave me numra në Kuran (6234), pastaj numrin e sureve (114). Secila sure pastaj përfaqësohet nga numri i saj i ndjekur me numrin e strofave të saj. Numrat që përfaqësojnë Suren 1 dhe 2 janë 1 7 dhe 2 286. Numri i plotë, që përfshin të gjitha suret në Kuran, përbëhet nga 474 shifra, dhe **është shumëfish i 19-tës** – duket kështu:

333410 6234 114 1 7 2 286 3 200..113 5 114 6

Nr. I TETË: Shuma Totale e numrave të strofave (333410) ndiqet nga numri total i strofave me numra (6234), numri i sureve (114), pastaj numrat e sureve dhe numrat e strofave të secilës sure.

Tani le të kthejmë mbrapshtë rendin e numrit të sureve dhe numrit të strofave të saj siç paraqitet në “Nr. e Tetë” Pra, numri që përfaqëson dy suret e para duket kështu: 7 1 & 286 2, në vend të 1 7 & 2 286. Numri i plotë gjithashtu përbëhet nga 474 shifra dhe **është shumëfish i 19-tës**. Duket kështu:

333410 6234 114 7 1 286 2 200 3...5 113 6 114

Nr. i NËNTË: Kthimi mbrapshtë i rendit të numrit të sureve dhe numrit të strofave ende jep një numër të gjatë që është shumëfish i 19-tës

Nëse e shkruajmë shumën e numrave të strofave për Suren 1 (28), të ndjekur nga shuma e numrave të strofave për Suren 2 (41041), dhe kështu me radhë deri në fund të Kuranit, dhe vendosim Shumën Totale të numrave të sureve (333410) në fund, numri i gjatë që rrjedh (Nr. i Dhjetë) përbëhet nga 377 shifra, dhe **është shumëfish i 19-tës**.

28 41041 20100 15 21 333410

Nr. I DHJETË: Shumat e numrave të strofave për secilën sure në Kuran të shkruara afër njëra tjetrës, të ndjekura në fund me Shumën Totale të numrave të strofave (333410). Ky numër i gjatë (377 shifror) është shumëfish i 19-tës.

Nëse shkruajmë numrin e sureve në Kuran (114), të ndjekur me numrin total të strofave me numra (6234), të ndjekur me numrin e secilës sure dhe shumën e numrave të strofave të saj, numri i gjatë që del (612 shifror) **është shumëfish i 19**.

114 6234 1 28 2 41041 3 20100...113 15 114 21

Nr. i NJËMBËDHJETË: Numri i sureve, i ndjekur nga numri total i strofave me numra, e pastaj nga numri i secilës sure dhe shuma e numrave të strofave të saj, japin këtë numër të gjatë (612 shifror) që është shumëfish i 19-tës.

Që të mos mendojë ndokush që ndonjë parametër Kuranor është i paruaritur me këtë kod mbresëlënës matematikor, le të shikojmë më shumë parametra.

Nëse shkruajmë numrin e sureve (114), të ndjekur nga numri total i strofave me numra, të ndjekur nga Shuma Totale e numrave të strofave në tërë Kuranin (333410), të ndjekur nga numri i secilës sure dhe strofave të saj, përfundojmë me një numër shumë të gjatë (12712 shifror) që është shumëfish i 19-tës.

114 6234 333410 1 1 2 3 4 5 6 7...114 1 2 3 4 5 6

NUMRI I DYMËDHJETË

Nëse i shkruajmë numrat e strofave në secilën sure afër njëra tjetrës, përfundojmë me numër 235 shifror që **është shumëfish i 19-tës**. Për të bërë këtë, shkruaje numrin total të strofave me numra në Kuran (6234), të ndjekur me numrin strofave në secilën sure, pastaj afër me numrin total të strofave me numra në Kuran. Numri i fundit i gjatë duket kështu:

6234	7 286 200	176 127	5 4 5 6	6234
(strofat totale)	(4 suret e para)		(Surja 9)		(4 suret e fundit)	(Nr. total i strofave)
NUMRI I TREMBËDHJETË						

Nëse e shkruajmë numrin e strofave me numra në Kuran (6234), të ndjekur me numrin e sureve (114), të ndjekur me numrin e secilës strofë në secilën strofë, pastaj edhe me numrin e strofave me numra në Kuran (6234) dhe numrin e sureve (114), numri përfundimtar përbëhet nga 12479 shifra, dhe **është shumëfish i 19-tës**.

6234	114	1234567	12345...286...123456	6234	114
NUMRI I KATËRMBËDHJETË					

Një numër tjetër i gjatë që përbëhet nga 12774 shifra formohet duke shkruar numrin e secilës strofë në secilën sure, të ndjekur nga numri i secilës sure të shtuar te numri i strofave të saj. Surja 1 përbëhet nga 7 strofa, dhe totali 1+7 është 8. Prandaj, numri që përfaqëson Suren 1 duket kështu: 1234567 8. Pasi që Surja 2 përbëhet nga 286 strofa, numri që përfaqëson Suren 2 duket kështu: 12345...286 288. Kjo bëhet për secilën sure në Kuran. Numri përfundimtar i ndërthurur përbëhet nga 12774 shifra, dhe **është shumëfish i 19-tës**.

1234567	8	12345	286	288	123456	120
		(1+7)		(2+286)		(114+6)		
NUMRI I PESËMBËDHEJTË								

Tipare më të veçanta gjenden në Shtojcat 2, 9, 19, 24, 25, 26, 29, dhe 37.

Një dëshmitar nga Fëmijët e Izraelit [46:10]

Deklaro: “Çka nëse është prej Zotit, dhe ju nuk besuat në të? Një dëshmitar nga Fëmijët e Izraelit ka dëshmuar për një fenomen të ngjashëm, dhe ai ka besuar, përderisa ju jeni bërë shumë mendjemëdhenj për të besuar. Zoti nuk udhëzon shpirtligj.” [46:10]

Citimi në vijim është marrë nga *STUDIME MBI MISTICIZMIN JAHUDI*, (Shoqata për Studime Hebreje, Kembrixh, Mass., Joseph Dan & Frank Talmage, eds., Faqe 88, 1982). Citimi i referohet veprës së Rabinut Judah Besimtarit (Shekulli i XII):

Njerëzit [Jahuditë] në Francë e bënë zakon të shtojnë [në lutjen e mëngjesit] fjalët: “Ashrei temimei derekh [të bekuar janë ata që ecin rrugës së drejtë],” dhe Rabini ynë, Besimtari, qoftë i bekuar, shkroi që ata ishin plotësisht dhe krejtësisht gabim. Është krejt falsifikim i tepërt, sepse janë vetëm nëntëmbëdhjetë herë që Emri i Shenjtë përmendet [në atë pjesë të lutjes së mëngjesit]... dhe ngjashëm gjejmë fjalën ‘Elohim nëntëmbëdhjetë herë në perikopenë [kapitullin] e Ve-`vleth shemot ... Ngjashëm, gjejmë që Izraelitët u quajtën “bijë” nëntëmbëdhjetë herë, dhe ka shumë shembuj të tjerë. Të gjitha këto bashkësi nëntëmbëdhjetash janë të ndërthura dhe gërshetuara, dhe ato përmbajnë shumë sekrete dhe kuptime të brendshme, që përmbahen në më shumë se tetë vëllime të mëdha... Aq më shumë, në këtë pjesë ka 152 (19x8) fjalë.

Mirënjohje

Të gjitha lëvdatat dhe falënderimet i takojnë Zotit që ka dashur që mrekullia e Tij e Kuranit të zbulohet në këtë kohë. Ai i ka shquar individët në vijim dhe i ka bekuar ata duke zbuluar nëpërmjet tyre shumë pjesë të këtij zbulimi shumë të rëndësishëm: Abdullah Arik, Mohamoud Ali Abib, Lisa Spray, Edip Yuksel, Ihsan Ramadan, Feroz Karmally, Ismail Barakat, Gatut Adisoma, Ahmed Yusuf, Cesar A. Majul, Muhtesem Erisen, dhe Emily Kay Sterrett.

SHTOJCA 2:

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes është i dërguar konsolidues. Misioni i tij është që të pastrojë dhe bashkojë të gjitha fetë ekzistuese në një: Islam (Nënshtrim).

Islami NUK është emër; është përshkrim i nënshtrimit dhe përkushtimit të plotë të dikujt ndaj VETËM Zotit, pa e idolizuar Jezusin, Marinë, Muhamedin, ose të shenjtit. Kushdo që e përmbushë këtë kriter është "Mysliman" (i Nënshtruar). Pra, dikush mund të jetë Jahudi Mysliman, i Krishterë Mysliman, Hindu Mysliman, Budist Mysliman, ose Mysliman Mysliman. I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes dorëzon deklaratën e Zotit që "E vetmja fe e pranueshme nga Zoti është Nënshtrimi" (3:19) dhe që "Kushdo që kërkon tjetër pos Nënshtrimit si fe, nuk do të pranohet prej tij/saj" (3:85).

Një i dërguar i Zotit duhet të paraqesë prova që ai është i dërguar i Zotit. Çdo i dërguar i Zotit përkrahet nga shenja të pakundërshtueshme hyjnore që ai është i autorizuar nga i Plotfuqishmi që të dorëzojë lajmin e Tij. Moisiu e hodhi shkopin e tij dhe u shndërrua në gjarpër, Jezusi i shëroi të lebrosurit dhe ngjalli të vdekurin me lejen e Zotit, shenja e Salihut ishte deveja e famshme, Ibrahim i shpëtoi nga zjarri, dhe mrekullia e Muhamedit ishte Kurani (29:50-51).

Kurani (3:81, 33:7, 33:40) dhe Bibla (Malakia 3:1-3) kanë profetizuar ardhjen e të dërguarit konsolidues, të Dërguarin e Zotit të Besëlidhjes. Është e natyrshme që një i dërguar me një mision aq kyç duhet të përkrahet me mrekullinë më të fuqishme (74:30-35). Përderisa mrekullitë e të dërguarve paraprak ishin të limituara në kohë dhe hapësirë, Mrekullia e Zotit që e përkrahë të Dërguarin e Tij të Besëlidhjes është e përhershme; mund të shihet nga kushdo, në cilëndo kohë, në cilindo vend.

Kjo Shtojcë paraqet provë materiale, të ekzaminueshme, të verifikueshme, dhe të pakundërshtueshme që Rashad Khalifa është I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes.

E vërtetë Kuranore

Një prej profecive madhore në Kuran është që I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes do të dërgohet pasi që të gjithë profetët të kenë ardhur në këtë botë, dhe pasi që të gjitha shkrimet e Zotit të jenë dorëzuar.

Zoti lidhi besën me profetët, duke thënë, "Unë do t'ju jap shkrimin dhe mençuri. Pastaj, një i dërguar do të vijë t'i konfirmojë të gjitha shkrimet ekzistuese. Të besoni në atë dhe ta përkrahni." Tha, "A pajtoheni me këtë, dhe betoheni ta përmbushni këtë besëlidhje?" Ata thanë, "Pajtohemi." Tha, "Keni qenë pra dëshmitarë, dhe jam dëshmitar bashkë me ju." [3:81]

Muhammad Marmaduke Pickthall e përktheu strofën 3:81 si në vijim:

Kur Allahu lidhi besën e (Tij) me Profetët, (Ai tha): Mbajeni atë që ju kam dhënë nga shkrimi dhe njohuria. Dhe pastaj do të vij te ju një i dërguar, duke konfirmuar atë që e keni. Të besoni në atë dhe ta ndihmoni atë. Ai tha: A pajtoheni, dhe a do të merrni këtë përgjegjësi (që po ua jap juve) në këtë (çështje)? Ata u përgjigjën: Pajtohemi. Ai tha: Atëherë jini dëshmitarë. Unë do të jem dëshmitar me ju.

Mësojmë nga Surja 33 që Muhamedi ishte njëri prej profetëve që bëri besëlidhjen solemne me Zotin.

Dhe kur e morëm besëlidhjen nga Profetët, dhe nga ti (o Muhamed) dhe nga Nuhu dhe Ibrahim i dhe Moisiu dhe Jezusi i biri i Marisë, morëm prej tyre një besëlidhje solemne. [33:7] (sipas Muhammad Marmaduke Pickthall)

Strofa 3:81, mes shumë strofave të tjera, jep definicionin e “Nabi” (Profet) dhe “Resul” (I dërguar). Pra, “Nabi” është i dërguar i Zotit që dorëzon shkrim të ri, përderisa “Resul” është i dërguar me mandat nga Zoti për të konfirmuar shkrimin ekzistues; ai nuk sjell shkrim të ri. Sipas Kuranit, çdo “Nabi” është “Resul,” por jo çdo “Resul” është “Nabi.”

Jo çdo të dërguari iu dha një shkrim i ri. Nuk është logjike që Zoti t’i japë një shkrim një profeti, pastaj të kërkojë nga ai që ta mbajë vetëm për vete, siç thuhet nga disa “studiuues” Mysliman (2:42, 146, 159). Ata që nuk kanë njohuri sa duhet nga Kurani janë të prirë të mendojnë që Aroni ishte “Nabi,” siç thuhet në 19:53, që nuk pranoi shkrim. Megjithatë, Kurani qartë e thotë që Torah iu dha saktësisht “edhe Moisiut edhe Aronit” (21:48, 37:117).

Mësojmë nga Kurani, 33:40, që Muhamedi ishte profeti (Nabi) i fundit, por jo i dërguari (Resuli) i fundit:

Muhamedi nuk ishte babai i asnjë burri mes jush. Ai ishte i dërguar (Resul) i Zotit dhe profeti (Nabi) i fundit. [33:40]

Definicioni kyç konfirmohet me kodin matematikor të Kuranit. Shprehja e përdorur në 33:40, “Muhamed Khatum El-Nabijin” (profeti i fundit) ka vlerën gërmore 1349, 19x71, përderisa vlera e shprehjes së gabuar “Muhamed Khatum El-Murselin” (i dërguari i fundit) nuk është shumëfish i 19-tës.

Që nga kohët e lashta, ka qenë veti njerëzore që të refuzohet një i dërguar bashkëkohës i gjallë. Jozefin e shpallën “të dërguarin e fundit” (40:34). Por, shumë të dërguar erdhën pas tij, duke përfshirë Moisiun, Davidin, Salomonin, Jezusin, dhe Muhamedin.

Besëlidhja u përmbush

Edhe pse profetët kanë vdekur, sa i përket kësaj bote, e dimë që shpirtat e tyre, personat e vërtetë, janë tani në Kopshtin e Edenit ku Ademi & Eva jetuan. Disa strofa na ndalojnë që të mendojmë që besimtarët që dolën nga trupat e tyre dhe lanë këtë botë janë të vdekur (2:154, 3:169, 4:69). Edhe pse ata nuk mund të kthehen në botën tonë (23:100), ata janë “gjallë” në Parajsë. Shih Shtojcën 17.

Gjatë shtegtimit tim Haxh në Mekë, para lindjes së diellit të Martën, Dhyl-Hixhxe 3, 1391, 21 Dhjetor, 1971, unë, Rashad Khalifa, shpirti, personi i vërtetë, jo trupi, u morra në një vend në gjithësi ku u njoftova me të gjithë profetët si i Dërguar i Zotit i Besëlidhjes. Nuk u informova me hollësitat dhe rëndësinë e vërtetë të kësaj ngjarjeje deri në Ramazan 1408.

Çka unë pash, me vetëdije të mprehtë, ishte që isha duke u ulur i palëvizshëm, përderisa profetët një nga një, erdhën kah unë, shikuan fytyrën time, dhe pohuan me kokat e tyre. Zoti mi tregoi ata

mua ashtu siç ishin dukur në këtë botë, të veshur me mënyrën e tyre përkatëse të veshjes. Ishte një atmosferë mbresëlënëse, kënaqësie, dhe respekti të madh.

Përveç Ibrahimit, asnjë nga profetët nuk mu identifikua mua. E dija që të gjithë profetët ishin aty, duke përfshirë Moisiun, Jezusin, Muhamedin, Aronin, Davidin, Nuhun, dhe të tjerët. Besoj që arsyeja për zbulimin e identitetit të Ibrahimit ishte që unë pyeta për të. U habita nga ngjashmëria e madhe që kishte ai me familjen time – mua, babanë tim, dhe xhaxhallarët e mi. Ishte e vetmja herë që pyeta veten, “Kush është ky profet që duket si të afërmit e mi?” Përgjigja erdh: “Ibrahimi.” Asnjë gjuhë nuk u fol. I tërë komunikimi u bë mentalisht.

Vlen të përmendet që data e përmbushjes së besëlidhjes së profetëve ishte Dhyl-Hixhxe 3, 1391. Nëse e mbledhim muajin (12), plus ditën (3), plus vitin (1391), del shuma 1406, 19x74. Surja 74 është ku emëruesi i përbashkët i Kuranit, numri 19, përmendet. Vini re që numri 1406 është gjithashtu numri i viteve nga shfaqja e Kuranit deri te shfaqja e mrekullisë së tij (Shtojca 1).

Misioni i të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes është që të konfirmojë shkrimet ekzistuese, t’i pastrojë ato, dhe t’i konsolidojë ato në një lajm hyjnor. Kurani thotë që një i dërguar i tillë ngarkohet me riparimin e lajmit të Zotit në pastërtinë e tij origjinale, për t’i çuar besimtarët e drejtë – Jahudi, të Krishterë, Mysliman, Budist, Hindu, dhe të tjerë – nga errësira në dritë (5:19 & 65:11). Ai është për të deklaruar që Islami (nënshtrim i plotë ndaj Zotit) është e vetmja fe e pranueshme nga Zoti (3:19).

"Ja, po e dërgoj të dërguarin tim për të përgatitur rrugën para meje; dhe papritmas do të vij në tempull Zoti që e kërkoni dhe i dërguari i besëlidhjes që e dëshironi. Po, ai po vjen, thotë Zotëruesi i ushtrive. Por kush do të durojë ditën e ardhjes së tij? Dhe kush do të qëndrojë kur ai shfaqet? Se ai është si zjarri i rafinuesit, ose si soda e larësve."

[Malakia 3:1-2]

Prova

Emri i të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes është i koduar matematikisht në Kuran si “Rashad Khalifa.” Kjo është pa dyshim metoda më e përshtatshme për t’ia njoftuar të dërguarin e Zotit botës në epokën e kompjuterëve.

(1) Siç paraqitet në Shtojcën 1, mrekullia e madhe e Zotit në Kuran bazohet në numrin e thjeshtë 19, dhe mbeti e fshehur për 1406 vite (19x74). Kjo mrekulli mbresëlënëse u paracaktua nga Zoti i Plotfuqishëm që të zbulohet nëpërmjet Rashad Khalifës. Me qindra studiues Mysliman dhe Orientalist gjatë 14 shekujve të fundit janë përpjekur së koti, por askujt nuk iu lejua që të deshifrojnë domethënien e Inicialeve Kuranore.

(2) Kurani është bërë i lehtë për besimtarët dhe kërkuesit e sinqertë (54:17, 22, 32, 40 & 39:28). Është ligj i pathyeshëm i Zotit që askujt nuk i lejohet qasja në Kuran, e le më në mrekullinë e tij të madhe, në mos qoftë ai ose ajo një besimtarë i sinqertë që i jepet autorizim i posaçëm hyjnor (17:45:46, 18:57, 41:44, 56:79). Zbulimi i mrekullisë së Kuranit nëpërmjet Rashad Khalifas është shenjë e madhe e lajmtarllëkut të tij.

(3) Fjala rrënjë e emrit “Rashad” është “Rashada” (mbajtja e udhëzimit të drejtë). Kjo fjalë rrënjë përmendet në Kuran 19 herë. Nëntëmbëdhjeta është emëruesi i përbashkët i Kuranit.

Tabela 1: Suret dhe strofat e fjalëve "Rashada" dhe "Khalifa"

Nr.	"Rashada"		"Khalifa"	
	Surja	Strofa	Surja	Strofa
1	2	186	(2)	30
2	-	256	38	26
3	4	6		
4	7	146		
5	11	78		
6	-	87		
7	-	97		
8	18	10		
9	-	17		
10	-	24		
11	-	66		
12	21	51		
13	40	29		
14	-	38		
15	49	7		
16	72	2		
17	-	10		
18	-	14	(Surja	2
			është	
19	-	21	Përsëritje)	
	224	1145	38	56
	224+1145+38+56 = 1463 = 19x77			

(4) Fjala "Rashad" ndodh në 40:29 & 38. Fjala "Khalifa" ndodh në 2:30 dhe 38:26. "Khalifa" i parë i referohet një "Khalife" jo-njerëzor, pra, Dreqit, përderisa ndodhja e dytë (Surja 38), i referohet një "Khalife" njeri. Nëse i mbledhim numrat e sureve dhe strofave "Rashad" (40:29, 38) dhe "Khalifa" (38:26) marrim $40+29+38+38+26 = 171 = 19 \times 9$.

(5) Shuma e të gjithë numrave të sureve dhe strofave ku të gjitha "Rashada" dhe të gjitha "Khalifat" ndodhin pa dallim, japin shumën 1463, 19×77 (Tabela 1).

(6) Totali i të gjitha sureve dhe strofave ku fjala rrënjë "Rashada" ndodhet është 1369, ose $(19 \times 72) + 1$, përderisa totali për të gjitha ndodhjet e "Khalifas" është 94 $(19 \times 5) - 1$.

Fakti që "Rashada" është për një më shumë dhe "Khalifa" është për një më pak e lokalizon emrin si "Rashad Khalifa," dhe jo cilido "Rashad" ose cilido "Khalifa."

(7) Vlera germore e "Rashad" është 505 dhe vlera e "Khalifa" është 725 (Tabela 7, Shtojca 1). Nëse e mbledhim vlerën e "Rashad Khalifa" (1230) me numrat e sureve, dhe numrin e strofave, nga fillimi i Kuranit deri te ndodhja e parë e "Rashada," shuma del 1425, 19×75 . Hollësitat jepen në Tabelën 2.

Tabela 2: Suret dhe strofat nga fillimi i Kuranit deri te ndodhja e parë e fjalës rrënjë "Rashada"

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave
1	7	28
2	185	17205
3	192	17233
		(19x907)
Gjithashtu "Rashada (505) + "Khalifa" (725)+ Totali i Sures (3) + Totali i Strofave (192) = 1425 (19x75)		
505 + 725 + 3 + 192 = 1425 = 19x75		

(8) Nëse i mbledhim numrat e të gjitha strofave në secilën sure, d.m.th. shumën e numrave të strofave $(1+2+3+...+n)$ nga fillimi i Kuranit deri te ndodhja e parë e fjalës rrënjë "Rashada," totali del 17233, 19×907 (Tabela 2).

Tabela 3: Suret ku fjala rrënjë "Rashada" ndodhet

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
2	286	288
4	176	180
7	206	213
11	123	134
18	110	128
21	112	133
40	85	125
49	18	67
72	28	100
224	1144	1368
		(19x72)

(9) Inicialet Kuranore përbëjnë bazën themelore të mrekullisë së Kuranit. Këto inicialet ndodhin në suret 2, 3, 7, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 19, 20, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 36, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 50, dhe 68. Nëse e mbledhim shumën e këtyre numrave (822) me vlerën e "Rashad Khalifa" (1230), totali është 2052, 19×108 .

(10) Siç paraqitet në Tabelën 3, nëse i mbledhim numrat e të gjitha sureve ku fjala rrënjë "Rashada" ndodh, plus numrin e strofave, marrim 1368, ose 19×72 .

(11) Nëse e shkruajmë numrin e sures, të ndjekur me numrin e strofave për sure, të ndjekur me numrat individual të strofave, nga ndodhja e parë e fjalës rrënjë "Rashada" (2:186) deri te ndodhja e fundit e "Rashada" (72:21), dhe i vendosim këta numra njërin pas tjetrit, marrim një

numër shumë të gjatë që përbëhet nga 11087 shifra, dhe është shumëfish i 19-tës. Ky numër shumë i gjatë fillon me numrin e Sures 2, të ndjekur me numrin e strofave në Suren 2 nga ndodhja e parë e fjalës “Rashada” në strofën 186 deri te fundi i sures (100 strofa). Pra, fillimi i numrit duket kështu: 2 100. Numrat e këtyre 100 strofave individuale (187 deri në 286) vendosen afër këtij numri. Pra, numri që përfaqëson Suren 2 duket kështu: 2 100 187 188 189 285 286. I njëjti proces vazhdohet deri te 72:21, te ndodhja e fundit e rrënjës “Rashada.” Numri i plotë duket kështu:

2 100 187 188 189 72 21 1 2 3 19 20 21

Numri i Sures ndiqet nga numri i strofave, pastaj numri i strofave individuale, nga ndodhja e parë deri te e fundit e “Rashada” (2:187 deri te 72:21).

Numri i plotë përbëhet nga 11087 shifra, dhe është i plotpjesëtueshëm me 19.

(12) Nëse i ekzaminojmë suret dhe strofat nga ndodhja e parë e fjalës rrënjë “Rashada” deri te fjala “Khalifa” në 38:26, gjejmë që shuma e numrave të sureve dhe numrave të strofave të tyre është 4541, ose 19×239 . Hollësitat janë në Tabelën 4.

(13) Kur e shkruajmë vlerën e “Rashad” (505), të ndjekur me vlerën e “Khalifa” 725, të ndjekur nga secili numër i sures ku fjala rrënjë “Rashada” ndodhet, të ndjekur me numrat e strofave të saj, nga “Rashada” e parë (2:186) deri te fjala “Khalifa” (38:26), marrim një numër të gjatë që është i plotpjesëtueshëm me 19.

Tabela 4: Suret dhe strofat nga “Rashada” i parë deri te “Khalifa.”

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
2	100 (187-286)	102
3	200	203
4	176	180
5	120	125
-	-	-
36	83	119
37	182	219
38	26	64
740	3801	4541 (19×239)

Ndodhja e parë e “Rashada” është në 2:186. Pra, e shkruajmë 2 186. Ndodhja e dytë është në 2:256, kështu që shkruajmë 256. Ndodhja e ardhshme është në 4:6, kështu që shkruajmë 4 6, dhe kështu me radhë, deri sa të shkruajmë 38 26 (“Khalifa” ndodhet në 38:26). Numri i plotë duket kështu:

505	725	2	286	256	4	6	38	26
Vlera gërmore e “Rashad” e ndjekur nga vlera e “Khalifa,” e ndjekur nga numri i sures dhe numrat e strofave të secilës ndodhje të fjalës rrënjë “Rashada” nga ndodhja e parë e “Rashada” deri te ndodhja e “Khalifa” në 38:26.									

E vetmja fe e miratuar nga Zoti është Islami [3:19]

(14) Kurani specifikon tre të dërguarë të Islamit (Nënshttrim):

- **Ibrahimi** dorëzoi të gjitha zakonet e Islamit. Vlera e emrit të tij = 258
- **Muhamedi** dorëzoi Kuranin. Vlera e emrit të tij = 92
- **Rashadi** dorëzoi provën e vërtetësisë së Islamit. Vlera e emrit të tij = 505

Vlera totale gërmore e 3 emrave = $258+92+505 = 855$. (19×45)

Judaizmi, Krishterimi, dhe Islami i vërtetë do të konsolidohen në një fe – nënshttrim të plotë dhe përkushtim absolut ndaj VETËM Zotit.

Fetë ekzistuese, duke përfshirë Judaizmin, Krishterimin, dhe Islamin janë korruptuar së tepërmi dhe thjeshtë do të shuhen (9:33, 48:28, 61:9).

(15) Pasi që Kurani disa herë iu referohet “Ibrahimit, Ismailit, dhe Isakut,” u propozua që Ismaili dhe Isaku duhet të përfshihen. Për çudi, shtimi i Ismailit dhe Isakut dha një shumë që është prapë se prapë e plotpjesëtueshme me 19. Siç paraqitet në Tabelën 5, shumta e re është 1235, ose 19×65 . Plotpjesëtueshmëria me 19 nuk është e mundur nëse cilido nga 3 emrat Ibrahim, Muhamed, ose Rashad hiqet.

Pse 81: Strofa 81 & surja 81

(16) I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes profetizohet në Strofën 81 të Sures 3. Mbledhja e vlerës germore të “Rashad” (505), plus vlerës germore të “Khalifa” (725), plus numrit të Strofës (81), jep shumën $505 + 725 + 81 = 1311 = 19 \times 69$.

(17) Nëse e shikojmë Suren 81, lexojmë për një të dërguar të Zotit që është fuqishëm i përkrahur dhe i autorizuar nga i Plotfuqishmi (Strofa 19). Pra, Strofa 81 e Sures 3, dhe Surja 81, Strofa 19 janë të lidhura fuqishëm me emrin “Rashad Khalifa” $505 + 725 + 81 = 1311 = 19 \times 69$

(18) Nëse i mbledhim numrat e sureve dhe numrin e strofave nga fillimi i Kuranit deri te Strofa 3:81, ku profetizohet i Dërguari i Besëlidhjes, shumta del 380, 19×20 . Këto të dhëna janë në Tabelën 6.

(19) Vlera germore e Strofës 3:81 është 13148, 19×692 . Kjo vlerë arrihet duke mbledhur vlerat germore të secilës shkronjë në strofë.

(20) Nëse e shikojmë atë pjesë të Strofës 3:81 që i referohet në veçanti të dërguarit të Besëlidhjes: “Një i dërguar do të vij te ju, duke konfirmuar atë që keni,” në arabisht:

“JAA`KUM RESULUN MUSADDIKUN LEMA MA`AQUM” gjejmë që vlera germore e kësaj fraze kyçe është 836, 19×44 .

"Padyshim, ti je një prej të dërguarve" (36:3)

(21) Më është thënë kategorikisht, nëpërmjet engjëllit Gabriel, që Strofa 3 e Sures 36 më referohet posaçërisht mua. Nëse i rendisim vetëm suret me initiale, duke filluar me Suren 2, pastaj Surja 3, pastaj Surja 7, dhe kështu me radhë, gjejmë që Surja 36, Ja Sin, zë vendin e 19.

(22) Strofa 3 e Sures 36 thotë, “Padyshim, ti je një prej të dërguarve.” Vlera germore e kësaj fraze është 612. Duke e mbledhur këtë vlerë (612), plus numrin e sures (36), plus numrin e strofës (3), plus vlerën germore të “Rashad Khalifa” ($505 + 725$), marrim $36 + 3 + 612 + 505 + 725 = 1881 = 19 \times 99$.

(23) Surja 36 përbëhet nga 83 strofa. Nëse e mbledhim numrin e sures (36), plus numrin e strofave të saj (83), plus vlerën germore të “Rashad Khalifa” ($505 + 725$), marrim $36 + 83 + 505 + 725 = 1349 = 19 \times 71$.

(24) Nga 3:81 ku i Dërguari i Besëlidhjes profetizohet, deri te Surja 36, janë 3330 strofa. Duke e mbledhur vlerën e “Rashad Khalifa” (1230), me këtë numër të strofave (3330), marrim $505 + 725 + 3330 = 4560, 19 \times 240$.

Tabela 5: Vlera germore e 5 të dërguarve

Emri	Vlera e shkronjave individuale	Totali
Ibrahim	$1+2+200+5+10+40$	258
Ismail	$1+60+40+70+10+30$	211
Isak	$1+60+8+100$	169
Muhamed	$40+8+40+4$	92
Rashad	$200+300+1+4$	505
	1235	1235
		(19×65)

Tabela 6: Suret dhe strofat nga 1:1 deri te 3:81

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
1	7	8
2	286	288
3	81	84
6	374	380
		(19×20)

(25) Nga 3:81 deri te 36:3 janë 3333 strofa. Duke mbledhur këtë numër me vlerën germore të "Rashad" (505), marrim $3333+505 = 3838 = 19 \times 202$.

(26) Numri i strofave nga 1:1 deri te 36:3 është 3705, 19×195 (Tabela 7).

(27) Shuma e numrave të strofave të secilës sure nga 1:1 deri te 36:3 është 257925, 19×13575 (Tabela 7).

(28) Shuma e numrave të sureve nga Surja 1 deri te Surja 36 është 666 (Tabela 7). Nëse e mbledhim këtë shumë me vlerën germore të "Rashad Khalifa" ($505+725$), plus vlerën germore të strofës 36:3 "Pa dyshim, ti je një prej të dërguarve," (612), totali është: $666+505+725+612=2508=19 \times 132$.

(29) Nëse mbledhim shumën e numrave të strofave ($1+2+3+ \dots +n$) nga ndodhja e parë e fjalës rrënjë "Rashada" (2:186) deri te 36:3 (Ti je një prej të dërguarve) me shumën e sureve (35), plus vetë numrat e sureve, totali është 241395, ose 19×12705 (Tabela 8).

(30) Shuma e numrave të sureve nga ndodhja e parë e fjalës rrënjë "Rashada" deri te 36:3 është 665, 19×35 . Vini re që këto janë 35 sure (Tabela 8).

Tabela 7: Suret dhe strofat nga surja 1 deri te strofa 3 e sures 36

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave
1	7	28
2	286	41041
3	200	20100
-	-	-
9	127	8128
-	-	-
34	54	1485
35	45	1035
36	2	3
666	3705	257925
	(19x195)	(19x13575)

Tabela 8: Suret dhe strofat nga "Rashada" e para deri te 36:3

Nr.	Nr. i sureve	Shuma e nr.-ve të strofave
1	2(186-286)	23836
2	3	20100
3	4	15576
4	5	7260
-	-	-
10	9	8128
-	-	-
33	34	1485
34	35	1035
35	36 (1-3)	6
35	665	240695
	$35+665+240695=241395$	(19x12705)

"Një i dërguar te njerëzit e shkrimit" (Jahuditë, të Krishterët, dhe Myslimanët)

O njerëz të shkrimit, i dërguari ynë ka ardhur te ju, për të sqaruar gjërat për ju, pas një periudhe kohore pa të dërguarë, që të mos thoni, "Nuk na erdhi ndonjë predikues ose paralajmërues." Një predikues dhe paralajmërues ka ardhur te ju. Zoti është i Gjithëfuqishëm [5:19]

(31) Natyrisht, numri i kësaj strofe është 19, emëruesi i përbashkët i Kuranit i zbuluar nga Rashadi, dhe numri i ndodhjes së "Rashada" në Kuran.

(32) Nëse e mbledhim vlerën e "Rashad Khalifa" (1230), plus numrin e sures (5), plus numrin e strofës (19), marrim $1230+5+19 = 1254 = 19 \times 66$.

(33) Shuma e numrave të sureve dhe numri i strofave nga fillimi i Kuranit deri te kjo strofë (5:19) është 703, 19×37 . Shih Tabelën 9.

(34) Surja 98, "Prova," Strofa 2, deklaroi ardhjen e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes për të mirën e "Njerëzve të shkrimit (Jahudive, të Krishterëve, dhe Myslimanëve)." Duke mbledhur vlerën germore të "Rashad Khalifa" ($505+725$) me numrin e sures (98), plus numrin e strofës (2), marrim: $505+725+98+2 = 1330 = 19 \times 70$.

Tabela 9: Suret dhe strofat nga fillimi i 5:19

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
1	7	8
2	286	288
3	200	203
4	176	180
5	19	24
15	688	703
		(19x37)

Ata që nuk besuan mes njerëzve të shkrimit (Jahuditë, të Krishterët, Myslimanët), dhe idhujtarët, nuk do të besojnë, përkundër shenjës së thellë që iu është dhënë atyre. [98:1]

Një i dërguar nga Zoti, duke recituar shkrime të shenjta. [98:2]

(35) Vlen të përmendet që fjala “Bajinah,” që do të thotë “Shenjë e Thellë” dhe është titulli i Sures 98, gjendet në Kuran 19 herë. Ky është edhe një konfirmim matematikor që prova e autorësisë hyjnore të Kuranit është e bazuar në numrin prim 19, dhe që “Rashad Khalifa” është i dërguari në 98:2.

FUNDI I BOTËS

(38) Zoti është Njohësi i vetëm i të ardhmes; Ai e di saktësisht kur do të përfundojë bota (7:187, 31:34, 33:63, 41:47, 43:85). Mësojmë nga Kurani që Zoti u zbulon aspekte të caktuara të të ardhmes të dërguarve të zgjedhur të tij. Në Shtojcën 25, jepet provë që Rashad Khalifa u bekua me zbulimin e Fundit të Botës, në përputhshmëri me 72:27.

Tabela 10: Vlera gërmore e të dërguarit të zgjedhur

Shkronja	Vlera gërmore
A	1
L	30
A	1
M	40
N	50
A	1
R	200
T	400
D	800
J	10
M	40
N	50
R	200
S	60
U	6
L	<u>30</u>
	1919

(39) Numri i strofave nga fillimi i Kuranit deri te Strofa 72:27 është 5472, ose $19 \times 72 \times 4$. Vini re që të dërguarit që i jepen informata për të ardhmen paraqitet në 72:27, dhe që kjo sure përmban fjalën “Rashada” (72;2, 10, 14, & 21). Duke e mbledhur vlerën e “Rashad Khalifa” (1230), plus numrin e sures (72), plus numrin e 4 strofave ku “Rashada” përmendet, marrim $1230+72+2+10+14+21=1349=19 \times 71$.

(40) Strofa 72:27 fillon me thënien: (Vetëm te i dërguari që Ai zgjedhë). Ky referim ndaj të dërguarit që është zgjedhur nga Zoti për të pranuar lajme për të ardhmen ka vlerën gërmore 1919. Tabela 10 paraqet të dhënat.

SI TË DALLOHET I DËRGUARI I ZOTIT NGA NJË I DËRGUAR I RREJSHËM

Kurani jep kritere të qarta si të dallohen të dërguarit e vërtetë të Zotit nga të dërguarit e rrejshëm:

[1] I dërguari i Zotit përkrahë (predikon) adhurimin e VETËM Zotit, dhe heqjen e të gjitha formave të adhurimit të idhujve.

[2] I dërguari i Zotit nuk kërkon rrogë për vete.

[3] I dërguari i Zotit përkrahet me provë hyjnore, të pakundërshtueshme të dërguarësisë së tij.

Kushdo që thotë që është i dërguar i Zotit, dhe nuk i përmbush tre kriteret minimale të renditura më lartë është pretendues i rrejshëm.

Dallimi më i rëndësishëm ndërmjet të dërguarit të Zotit dhe të dërguarit të rrejshëm është që i dërguari i Zotit është i përkrahur nga Zoti, përderisa i dërguari i rrejshëm jo:

I dërguari i Zotit përkrahet nga ushtarët e padukshëm të Zotit (3:124-126, 9:26 & 40, 33:9, 37:171-173, 48:4 & 7, 74:31).

I dërguari i Zotit përkrahet nga thesari i Zotit (63:7-8).

I dërguari i Zotit, si edhe besimtarët, e kanë të garantuar fitoren dhe dinjitetin, në këtë botë dhe përgjithmonë (40:51 & 58:21).

Pra, sinqeriteti i të dërguarit të Zotit patjetër fiton, përderisa të pavërtetat e një të dërguari të rrejshëm, patjetër, herët a vonë, dalin në shesh.

DETYRAT KRYESORE TË DËRGUARIT TË ZOTIT TË BESËLIDHJES

Siç thuhet në Kuran, 3:81, i Dërguari i Zotit i Besëlidhjes ka për t'i konfirmuar të gjitha shkrimet, të cilat u dorëzuan nga të gjithë profetët, dhe për t'i restauruar në pastërtinë e tyre origjinale.

MËSHIRË NGA ZOTI [21:107]

Kur besimtarët përballen me një problem, ata zhvillojnë një numër të zgjidhjeve të mundshme, dhe kjo patjetër çon drejt grindjeve të vogla, përçarjeve, çrregullimeve. Mësojmë nga 2:151, 3:164, dhe 21:107 që është mëshirë nga Zoti që Ai dërgon te ne të dërguarë për të dhënë zgjidhjet përfundimtare për problemet tona. Mësojmë nga 42:51 që Zoti dërgon të dërguarit e Tij për të komunikuar me ne, dhe për të përhapur informata të reja. Për këtë është urdhri i fortë në 4:65, 80 për të pranuar, pa as hezitimin më të vogël, mësimet e dorëzuara te ne nëpërmjet të dërguarve të Zotit.

Në vijim është një listë e detyrave kryesore të të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes:

1. Zbulimi dhe shpallja e mrekullisë matematikore të Kuranit (Shtojca 1).
2. Nxjerrja në shesh dhe heqja e dy strofave të rrejshme 9:128-129 nga Kurani (Shtojca 24).
3. Shpjegimi i qëllimit të jetëve tona; pse jemi këtu (Shtojca 7).
4. Deklarimi i një feje për të gjithë njerëzit, dhe lokalizimi dhe spastrimi i të gjitha prishjeve që e pllakosin Judaizmin, Krishterimin, dhe Islamin (Shtojcat 13, 15, 19).
5. Deklarimi që Zeqati (bamirësia e obligueshme) është parakusht për shpengim (7:156), dhe shpjegimi i metodës së saktë të zbatimit të Zeqatit (Shtojca 15).
6. Zbulimi i fundit të botës (Shtojca 25).
7. Deklarimi që ata që vdesin para moshës 40 vjeçare shkojnë në Parajsë (Shtojca 32).
8. Shpjegimi i vdekjes së Jezusit (Shtojca 22).
9. Shpjegimi i shpalljes së Kuranit te, pastaj nëpërmjet Muhamedit (Shtojca 28).
10. Njoftimi që Muhamedi shkroi shpalljet e Zotit (Kuranin) me dorën e vetë (Shtojca 28).
11. Shpjegimi pse shumica e besimtarëve në Zot nuk arrijnë në Parajsë (Shtojca 27).
12. Deklarimi që Zoti nuk e urdhëroi Ibrahimin që të vrasë djalin e vet (Shtojca 9).
13. Deklarimi i sekretit të lumturisë së përkryer (Hyrja).
14. Vendosja e sistemit të drejtësisë penale (Shtojca 37).

SHTOJCA 3: *E bëmë Kuranin të lehtë [54:17]*

Strofa 11:1 na informon që Mrekullia e Kuranit përfshinë [1] dizajnin matematikor mbinjerëzor të strukturës së tij materiale dhe [2] njëherësh hartimin e një veprë letrare të jashtëzakonshme.

Dikush mund të përmbushë kushtet e shpërndarjes numerike të një strukture të thjeshtë matematikore. Megjithatë, kjo arrihet pandryshueshëm duke paguar me cilësi letrare shumë të dobët. Rregullimi i njëkohshëm i stilit letrar dhe shpërndarjes së ndërlidhur matematikore të shkronjave individuale përgjatë Kuranit (Shtojca 1) është evident në faktin që Kurani është bërë i lehtë që të mbahet mend, të kuptohet, dhe të na kënaqë. Ndryshe nga cilido libër i shkruar nga njeriu, Kurani sjell kënaqësi edhe nëse përsëritet leximi i tij pakufi herë.

Titulli i kësaj Shtojce përsëritet në Suren 54, strofat 17, 22, 32, dhe 40. Siç shihet, teksti arabisht i Kuranit është i hartuar në aso mënyre që të kujtojë lexuesin ose memorizuesin për shprehjen e ardhshme të saktë, ose strofën e ardhshme. Zoti na krijoi neve dhe Ai e di mënyrën më efikase se si futet në memorien tonë lënda letrare. Mësimi përmendsh i Kuranit ka luajtur një rol jetësor në ruajtjen e tekstit origjinal gjeneratë pas gjenerate në një kohë kur librat e shkruar ishin gjë e rrallë. Pa e kuptuar as vetë, personi që e mbanë mend Kuranin ndihmohet hyjnisht nga një sistem i ndërlidhur letrar përderisa ai i shpreh tingujt e fjalëve Kuranore. Gati secila strofë në Kuran përmban çka unë i quaj "Zile Kujtese." Funkzioni i tyre është që ta kujtojë lexuesin se çka vjen më pas. Ky sistem është aq i gjerë, kështu që unë do t'ju japë vetëm dy shembuj sa për ilustrim:

1. Në Suren 2, Strofat 127, 128 dhe 129 përfundojnë me dy emra të ndryshëm të Zotit secila. Këta çifte emrash janë "El-Sami` El-`Alim (Dëgjuesi, i Gjithëdijshmi)," "El-Tavab El-Rrahim (Shpenguesi, i Mëshirshmi)", dhe "El-`Aziz El-Hakim (I Plotfuqishmi, Më i Mençuri)," përkatësisht. Sikur ky të ishte libër i zakonshëm, dikush lehtë do i përziente këta gjashtë emra. Nuk është kështu edhe në Kuran. Secilit prej këtyre çifteve iu paraprinë në strofën e njëjtë një "Zile Kujtese" që na kujton për çiftin e saktë të emrave. Pra, Strofa 127 flet për Ibrahimin dhe Ismailin duke ngritur themelet e Qabes. Strofa përfundon me emrat "El-Sami` El-`Alim." Tingujt e dukshëm këtu janë "S," "M," dhe " `Ajn." Këto tre shkronja janë të dukshme në fjalën "Ismail." Gjejmë që kjo fjalë në mënyrë të dukshme është vonuar në fjali, përderisa e rritë cilësinë letrare të saj. Pra, gjejmë që strofa shkon kështu: "Kur Ibrahim i ngriti themelet e Qabes, së bashku me Ismailin ..." Zakonisht, një shkrimtar njeri do të thoshte "Kur Ibrahim dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes..." Por vonesa e tingujve në "Ismail" i sjell ato më afër fundit të strofës, dhe kështu na kujton se emrat e saktë të Zotit në këtë strofë janë "El-Sami` El-`Alim." Strofa 128 ka fjalën e spikatur "Tubb" pak para emrave "El-Tavab El-Rrahim." Fjala "Tubb" pra shërben si zile kujtese. Emrat e Zotit në fund të 2:129 janë "Aziz, Hakim." Tingujt e spikatur këtu janë "Z" dhe "K." Interesant, zile e kujtesës në këtë strofë është fjala "Juzakihim."

2. Një shembull tjetër i mirë gjendet në 3:176, 177, & 178, ku ndëshkimi për mosbesimtarët përshkruhet si " `Azim (i Tmerrshëm)," "Alim (që Dhemb)," dhe "Muhin (Poshtërues)," përkatësisht. Në një libër njerëzor, ai që do e mbante mend lehtë do i kishte përzier këto tre përshkrime. Por gjejmë që secilit nga këto mbiemra iu paraprijnë zile të fuqishme kujtese që parandalojnë një përzjerje të tillë. Fjala " `Azim" e Strofës 176 paraprihet nga fjala "Huzun," që karakterizohet nga shkronja e theksuar "Z." Kjo shërben për të na kujtuar për mbiemrin e veçantë në fund të kësaj sureje. Fjala "Alim" e Strofës 177 paraprihet nga tingulli i fjalës "Iman" që shërben si zile kujtese, dhe fjala "Muhin" e 3:178 paraprihet nga një bollëk "M"-jash dhe "H"-jash përgjatë kësaj strofe.

Shembuj të tjerë të zileve të kujtesës përfshijnë fundin e 3:173 dhe fillimin e 3:174, fundin e 4:52 dhe fillimin e 4:53, fundin e 4:61 dhe fillimin e 4:62, dhe fundin e 18:53 dhe fillimin e 18:54, dhe shumë të tjerë.

SHTOJCA 4:

Pse u shpall Kurani në gjuhën arabe?

Mësojmë nga 41:44 se besimtarët e sinqertë kanë qasje në Kuran, pa marrë parasysh gjuhën e tyre amtare. Mosbesimtarëve, në anën tjetër, nuk iu lejohet qasja në Kuran, edhe nëse ata janë profesorë të gjuhës arabe (17:45, 18:57, 41:44, & 56:79).

Arabishtja është gjuha më efikase në botë, posaçërisht kur vjen puna te formulimi i saktë i ligjeve. Pasi që Kurani është Kod Ligjor, ishte me rëndësi që ligje të tilla të formuloheshin qartë. Zoti zgjodhi arabishten për Besëlidhjen e Tij të Fundit për shkak të arsyes së dallueshme që ajo është gjuha më e përshtatshme për atë qëllim. Arabishtja është e veçantë në efikasitetin dhe saktësinë e saj. Për shembull fjala "they (ata, ato)" në Anglisht nuk të tregon nëse "they (ata, ato)" janë meshkuj ose femra. Në arabisht ekziston "they (ata)" për meshkuj, "HUM," dhe "they (ata)" për femra, "HUNA." Madje ekziston edhe një "they (ata)" për dy meshkuj, "HUMA," dhe "they (ato)" për dy femra, "HATAN." Kjo veti nuk ekziston në asnjë gjuhë tjetër në botë. Arrita ta çmoj efikasitetin e gjuhës arabe kur e përktheva, për shembull, 2:228. Kjo strofë e urdhëron të shkurorëzuarën që të heqë dorë nga dëshirat e veta për tu shkurorëzuar nga burri i saj, nëse ajo kupton që është shtatzënë, dhe i shoqi dëshiron të pajtohen – mirëqenia e bebes ka përparësi. Efikasiteti i gjuhës arabe ishte tejet i dobishëm në formulimin e këtij ligji. Cilado gjuhë do e bënte atë gati të pamundur që të theksohet dëshirat e kujt duhej të zëvendësohen, së paku jo në aq pak fjalë siç e shohim në 2:228.

Fjala "kalata", e 28:23, që është vetëm një fjalë për shembull, përkthehet në katër fjalë të Anglishtes: "the two women said. (ato dyja thanë)" I tillë është efikasiteti i gjuhës arabe.

Një arsye tjetër e mundshme për zgjedhjen e arabishtes është fakti që fjalët "Ai" dhe "Ajo" nuk nënkuptojnë patjetër gjini. Pra, kur përmendet Zoti si "Ai," kjo nuk nënkupton gjini aspak. I madhëruar qoftë Zoti; Ai nuk është as mashkull, as femër. Përdorimi i "Ai" për ta përmendur Zotit në gjuhën Angleze, për shembull, ka kontribuar në një përfytyrim të gabueshëm të Zotit. Aq më shumë, kjo nuk u ndihmua aspak nga shprehjet e shtrembëruar të tilla si "Ati" kur i referohen Zotit. Askund në Kuran Zoti nuk përmendet me "Ati".

SHTOJCA 5:

Parajsa dhe Ferri

Përshkrimet e Parajsës dhe Ferrit përgjatë Kuranit janë alegorike. Kurani na tregon për këtë sa herë që përshkrimet e tilla ndodhin si fjali të pavarura, jo brenda një teme të përgjithshme. Shih 2:24-26, 13:35, dhe 47:15. Fjala "Mathal" (alegori) përdoret në këto strofa. Në aspektin gjuhësor, fjala "Mathal" në këto strofa mund të hiqet, dhe ende kemi fjali të përkryera. Por ajo është aty sepse përshkrimet e Parajsës dhe Ferrit janë alegorike.

Se si janë Parajsa dhe Ferri ne as nuk mund ta paramendojmë. Prandaj ekziston nevoja për alegori. Si mund t'ia përshkruaj dikush, për shembull, shijen e çokollatës një personi që kurrë nuk ka shijuar çokollatë? Alegoria do të duhej të përdorej. Personi duhet të presë që në realitet ta shijojë çokollatën për ta ditur se si e ka shijen çokollata. Çfarëdo alegorie që e përdorim për të përshkruar shijen e çokollatës nuk mund t'i për afrohem gjësë së vërtetë.

Parajsa tashmë ekziston, pasi që Ademi dhe Eva u vendosën në të gjatë ditëve të tyre të pafajësisë (2:35). Mësojmë nga Surja 55 që ka dy "Parajsa të Larta" – një për njerëzit dhe një për xhinët – dhe

dy “Parajsa të Ulëta” – një për njerëzit dhe një për xhinët (shih Shtojcën 11 për më shumë hollësi).

Ferri nuk është krijuar ende. Do të krijohet në Ditën e Gjykimit (69:17 & 89:23). Më shumë hollësi jepen në Shtojcën 11.

Parajsa e lartë dhe Parajsa e ulët

Ka dallime të theksuara ndërmjet Parajsës së Lartë dhe Parajsës së Ulët. Alegorikisht, uji në Parajsën e Lartë rrjedh lirshëm (55:50), përderisa uji i Parajsës së Ulët duhet të nxirret (55:66).

Alegorikisht, Parajsa e Lartë i ka të gjitha llojet e frutave (55:52), përderisa Parajsa e Ulët ka numër të limituar frutash (55:68)

Alegorikisht, të shoqet e dëlira me gatishmëri iu bashkëngjiten bashkëshortëve të tyre në Parajsën e Lartë (55:56), përderisa banuesit e Parajsës së Ulët duhet të shkojnë t’i marrin të shoqet e tyre (55:72).

Megjithatë, edhe Parajsa e Ulët është një shpërblim jashtëzakonisht i shkëlqyeshëm për ata që janë mjaft fatlum t’i shpëtojnë Ferrit dhe të përfundojnë në Parajsën e Ulët (3:185) – shkuarja në Parajsën e Ulët është triumf i madh. Njerëzit që largohen nga kjo jetë para se të arrijnë moshën 40 vjeçare, dhe nuk i kanë zhvilluar mjaft shpirtrat e tyre, do të shkojnë në Parajsën e Ulët (46:15, Shtojcat 11 & 32). Parajsa e Lartë është e rezervuar për ata që besuan, çuan jetë të drejtë, dhe i zhvilluan shpirtrat e tyre mjaftueshëm.

SHTOJCA 6:

Madhështia e Zotit

Mësojmë nga Strofa 39:67 që madhështia e Zotit është shumë përtej imagjinatës së njeriut – strofa thotë që të shtatë gjithësitë janë “të mbështjella brenda dorës së Zotit.”

Me përkrahjen e kodit matematikor të Kuranit, mësojmë që gjithësia jonë është më e vogla dhe më e brendshme e shtatë gjithësive (41:12, 55:33, 67:5, & 72:8-12). Ndërkohë, përparimet tona shkencore na kanë treguar që galaktika jonë, Rruga e Qumështit, është e gjerë 100,000 vjet dritë, dhe që gjithësia jonë përmban me biliona galaktika të tilla dhe me biliona trilionë yje, plus decilionat e panumëruara të trupave qiellor. Gjithësia jonë vlerësohet të jetë më e gjerë se 20,000,000,000 vjet drite.

Të numërosh yjet!

Nëse e marrim vetëm një kuintilion [1,000,000,000,000,000,000] yje dhe thjeshtë i numërojmë ata [nga 0 deri në kuintilion] një numërim në sekondë, ditë e natë, kjo do të zgjasë 32 bilion vjet (më shumë se mosha e gjithësisë). Kjo është sa gjatë do të duhej që thjeshtë t’i “numërojmë” ata; por Zoti “i krijoj” ata. E tillë është madhështia e Zotit.

Mund ta çmojmë gjerësinë e gjithësisë tonë nëse e paramendojmë që po udhëtojmë në një odise në hapësirë. Kur largohemi nga planeti Tokë drejt diellit, me shpejtësinë e dritës, e arrijmë diellin pas 150,000,000 km ose 8 minuta. Do të na duhen më shumë se 50,000 vjet me shpejtësinë e dritës për të dalë nga galaktika jonë. Nga skaji i jashtëm i Rrugës së Qumështit, planeti ynë Tokë është i padukshëm. Madje edhe teleskopi më i fuqishëm nuk mund ta vërej “Tokën” tonë të imët.

Na duhet të kalojmë më shumë se 2,000,000 vite me shpejtësinë e dritës për të arritur te galaktika jonë fqinje. Së paku 10,000,000,000 vjet, me shpejtësinë e dritës, duhet të kalohen për të arritur

skajin më të largët të gjithësisë tonë. Nga skaji më i largët i gjithësisë tonë, madje edhe Rruga e Qumështit është më e vogël se një pikël pluhuri në një dhomë shumë të madhe.

Gjithësia e dytë rrethon gjithësinë tonë. Gjithësia e tretë është më e madhe se e dyta, dhe kështu me radhë. Më saktësisht, gjithësia jonë duhet të konsiderohet gjithësia e shtatë, e rrethuar nga gjithësia e gjashtë, e cila rrethohet nga gjithësia e pestë, dhe kështu me radhë. A mund ta paramendonin gjerësinë e gjithësisë së parë, më të jashtme? Nuk ekziston asnjë numër për të përshkruar perimetrin e gjithësisë së parë. Kjo gjerësi e paparamendueshme është “brenda grushtit të dorës së Zotit.” Nga skaji më i largët i gjithësisë më të jashtme, ku është planeti Tokë? Sa e rëndësishme është ajo? Në grimcën pakufi-të-vogël të quajtur Tokë, krijesa të tilla të vockla si Maria, Jezusi, dhe Muhamedi jetuan. Prapë se prapë, disa njerëz i ngritin këta njerëz të pafuqi si zota!

Madhështia e Zotit përfaqësohet jo vetëm me faktin që Ai i mban të shtatë gjithësitë në dorën e Tij, por gjithashtu me faktin që Ai e drejton tërësisht çdo atom, madje edhe përbërësit nënatomik, gjithkrah edhe në gjithësinë më të madhe (6:59, 10:61, & 34:3).

SHTOJCA 7: ***Pse u krijuam?***

Ne jemi në këtë botë sepse kryem një krim të tmerrshëm, dhe kjo jetë është shansi ynë për ta shpenguar veten, ta dënojmë krimin tonë, dhe t'i ribashkohemi mbretërisë së Zotit.

E tëra filloi disa biliona vjet më parë kur “një grindje u shkaktua në Shoqërinë Qiellore” (38:69). Njëra prej krijesave me gradë të lartë, Dreqi, ushqe mendime kryelarta që fuqitë e tij të dhëna nga Zoti e kualifikonin atë të jetë zot përveç Zotit. Ai pra e sfidoi autoritetin absolut të Zotit. Jo vetëm që ishte ideja e Dreqit blasfemi, ishte e pavërtetë – vetëm Zoti, dhe askush tjetër, posedon kualifikimet dhe aftësinë për të qenë zot. Si rrjedhojë e blasfemisë së Dreqit, një ndarje ndodhi në Shoqërinë Qiellore, dhe të gjithë përbërësit e mbretërisë së Zotit u bënë të kategorizuar në katër kategori: 1. Engjëj: Krijesa që iu përmbajtën autoritetit absolut të Zotit. 2. Kafshë: Krijesa që ngritën krye por pastaj pranuan ftesën e Zotit për tu penduar. 3. Xhin: Krijesa që u pajtuan me Dreqin; që ai është i aftë për të qenë “zot.” 4. Njerëz: Krijesa që nuk arritën të vendosin; ata nuk arritën të marrin qëndrim të paluhatshtëm për autoritetin absolut të Zotit.

Më i Mëshirshmi

Engjëjt pritën nga Zoti që t'i dëbonte krijesat që nuk iu përmbajtën autoritetit absolut të Tij (2:30). Por Zoti është Më i Mëshirshmi; Ai vendosi të na japë një shans që ta denoncojmë gabimin tonë, dhe i noftoi engjëjt që Ai dinte çka ata nuk dinin (2:30). Zoti e dinte që disa krijesa merituan një rast që të shpengohen.

Nëse pretendon se je i aftë që të pilotosh një aeroplan, mënyra më e mirë për të testuar pretendimin tënd është të të

*Ti, Lucifer, the në zemrën tënde:
“Do të ngjitem në qiej. Mbi yjet e
Zotit. Unë do e ngris fronin tim.
Do të ulem lartë mbi Malin e
Asamblesë, në përfundim të
Veriut. Do të lartësohem mbi
pjesët më të larta të reve; unë
do të jem si Më i Larti!”*
[Isaia 14:13-15]

*Djalli pastaj e mori Jezusin mbi
një mal shumë të lartë dhe
paraqiti para tij të gjitha
mbretëritë e botës në
madhësinë e tyre, duke
premtuar: “Të gjitha këto do të
t'i jap ty nëse përulesh në
nderim timin.” Atëherë, Jezusi i
tha, “Shporru, Dreqi! Shkrimi e
thotë: ‘Ta adhurosh Zotin
Zotëruesin tënd; VETËM Atë ta
adhurosh.’”*
[Mateu 4:8-10] & [Luka 4:5-8]

jepet një aeroplan dhe të kërkohet nga t'i që ta pilotosh. Kjo është saktësisht çka Zoti vendosi të bëjë si reagim ndaj pretendimit të Dreqit. Zoti krijoi shtatë gjithësi të gjera, pastaj i informoi engjëjt që Ai po e caktonte Dreqin si zot në grimcën e imët të quajtur "Tokë" (2:30). Të dhënat Kuranore që kanë të bëjnë me caktimin e Dreqit si "zot" të përkohshëm (36:60) konfirmojnë Shkrimin paraprak.

Planit të Zotit i duhej krijimi i vdekjes (67:1-2), pastaj sjellja e njerëzve dhe xhinëve në këtë botë. Kështu, ata fillojnë sërish pa asnjë njëanshmëri, dhe përdorin lirinë e plotë që t'i përmbahen autoritetit absolut të Zotit ose teorisë politeiste të Dreqit. Për ta ndër marrë këtë vendim kyç, çdo qenie njerëzore pranon lajm nga Zoti që përkrahë autoritetin absolut të Tij, si dhe lajm nga Dreqi duke u munduar të bëjë ndikim me idetë e tij politeiste. Për të na dhënë një avantazh, Më i Mëshirshmi i mblodhi të gjitha qeniet njerëzore para Tij, para se të na dërgonte në këtë botë, dhe ne ishim dëshmitarë që vetëm Ai është Zotëruesi dhe Sunduesi ynë (7:172). Pra, përmbajtja ndaj autoritetit absolut të Zotit është instinkt natyral që është pjesë përbërëse e secilës qenie njerëzore. Pas vënies së kryengritësve në vdekje, shpirtat e njerëzve dhe xhinëve u vendosën në një depo të posaçme. Zoti pastaj i krijoi trupat e përshtatshëm për t'iu bërë vend shpirtave të xhinëve dhe njerëzve gjatë periudhës së testimit. Trupi i parë i xhinit u bë prej zjarri, dhe Dreqi iu caktua atij trupi (15:27). Trupi i parë i njeriut u krijua nga material tokësor, balta (15:26), dhe Zoti ia caktoi shpirtin e njeriut të parë atij trupi. Planit hyjnor i duheshin engjëjt për t'iu shërbyer njerëzve në tokë – t'i ruajnë ata, lëvizin erërat dhe shiun për ta, t'i shpërndajnë furnizimet, etj. Ky fakt thuhet në Kuran alegorikisht: "Zotëruesi juaj iu tha engjëjve, 'Bini në përlujë para Ademit.'" Dreqi natyrisht refuzoi që të kishte të bënte diçka me shërbimin ndaj njerëzve (2:34, 7:11, 17:61, 18:50, 20:116).

Përderisa trupi i Ademit mbeti në tokë, personi i vërtetë, shpirti, u pranua në Parajsë në gjithësinë më të jashtme. Zoti i dha Ademit urdhra të caktuara, të përfaqësuar me pemën e ndaluar, dhe Dreqi u caktua si shoqëruesi i Ademit për të çuar te Ademi lajmin e tij dreqnor. Pjesa tjetër është histori.

Sa herë që një qenie njerëzore lindë, personi njeri i caktohet bebes së re nga depoja e shpirtave. Zoti i cakton shpirtat në përputhje me njohurinë e Tij (28:68). Secili shpirt meriton të caktohet te një trup i caktuar, dhe të jetojë nën rrethana të caktuara. Vetëm Zoti e di cilët shpirta janë të mirë dhe cilët shpirta janë të këqij. Fëmijët tanë caktohen në shtëpitë tona në përputhje me planin e Zotit.

Një shpirt i pavarur xhin gjithashtu caktohet te qenia njerëzore e re për të përfaqësuar pikëvështrimin e Dreqit. Përderisa trupi fizik i secilit xhin riprodhohet nga xhini prind, shpirti xhin është i një individi te pavarur. Xhinët janë pasardhës të Dreqit (7:27, 18:50). Xhini i caktuar mbetet me qenien njerëzore nga lindja deri në vdekje, dhe shërben si dëshmitar kryesor në Ditën e Gjykimit (50:23). Një debat i vazhdueshëm ndodhë në mendjet tona ndërmjet shpirtit njeri dhe shpirtit xhin derisa të dy prej tyre binden për një pikëvështrim.

Mëkati fillestar

Përkundër besimit të zakonshëm, "Mëkati Fillestar" nuk ishte shkelja e ligjit të Zotit nga Ademi kur ai hëngri nga pema e ndaluar. Mëkat fillestar ishte mos arritja jonë që t'i përmbahemi autoritetit absolut të Zotit gjatë Grindjes së Madhe. Nëse personi njeri e bindë shoqëruesin e tij ose saj xhin për ta dënuar atë mëkat fillestar, dhe për t'iu përmbajtur autoritetit absolut të Zotit, të dyja krijesat shpengohen në mbretërinë e përhershme të Zotit në Ditën e Gjykimit. Por nëse shoqëruesi xhin e bind qenien njerëzore që t'i përmbahet vështrimit idhujtaresk të Dreqit, atëherë të dy krijesat dëbohen përgjithmonë nga mbretëria e Zotit.

Për ta reklamuar pikëvështrimin e tij, Dreqi dhe përfaqësuesit e tij përkrahin idolizimin e krijesave të tilla të pafuqi si Muhamedi, Jezusi, Maria, dhe të shenjtit. Pasi që ne jemi këtu për shkak të prirjeve tona politeiste, shumica prej nesh jemi gjah i lehtë për Dreqin.

Paaftësia e Dreqit si “zot” tashmë është vërtetuar me përhapjen e kaosit, sëmundjeve, aksidenteve, vuajtjeve, dhe luftërave përgjatë fushëveprimit të tij (36:66). Në anën tjetër, qeniet njerëzore që e bëjnë hasha Dreqin, i përmbahen autoritetit absolut të Zotit, dhe ndalen së idolizuari krijesa të pafuqi dhe të vdekura si Jezusi dhe Muhamedi, rikthehen në mbrojtjen e Zotit – ata gëzojnë jetë të përkryer këtu në këtë botë dhe përgjithmonë.

Për shkak se jeta jonë në këtë botë është radhë testesh të dizajnuara për të nxjerrë në shesh idetë tona politeiste, adhurimi i idhujve është krimi i vetëm i pafalshëm (4:48, 116). Bota është hyjnisht e dizajnuar për të manifestuar vendimin tonë që t’i përmbahemi ose autoritetit absolut të Zotit, ose pikëpamjeve idhujtareske të Dreqit (67:1-2). Dita dhe nata ndërrojnë vazhdimisht për të testuar vullnetin tonë që t’i përmbahemi ligjeve të Zotit duke e zbatuar Lutjen e Agimit dhe duke agjëruar gjatë ditëve më të nxehta dhe më të gjata. Vetëm ata që janë plotësisht të sigurt për autoritetin absolut të Zotit shpengohen (26:89).

SHTOJCA 8:

Miti i ndërmjetësimit

Besimi që kushdo tjetër pos Zotit mund të ndërmjetësojë në emër tonin për të na falur mëkatet tona ose për të na plotësuar dëshirat tona, është ngritje e ortakëve me Zotin. Kjo është idhujtari. Kurani deklaron që “I gjithë ndërmjetësimi i takon Zotit” (39:44), dhe që nuk do të ketë “asnjë ndërmjetësues në Ditën e Gjykimit” (2:254).

Miti i ndërmjetësimit është një prej dredhive më efektive të Dreqit për të mashtruar miliona njerëz në adhurim idhujsh. Miliona të Krishterë besojnë që Jezusi do të ndërmjetësojë për ta te Zoti, dhe miliona Mysliman besojnë që Muhamedi do të ndërmjetësojë në emër të tyre. Si pasojë, këta njerëz idolizojnë Jezusin dhe Muhamedin.

Koncepti i ndërmjetësimit është krejtësisht i palogjikshëm. Ata që besojnë në ndërmjetësimin e Muhamedit, për shembull, pretendojnë që ai do të kërkojë nga Zoti që t’i falë ata dhe t’i pranojë ata në Parajsë. Ata e paramendojnë Muhamedin në Ditën e Gjykimit duke i zgjedhur kandidatët për ndërmjetësimin e tij. Nëse i pyet ata që besojnë në ndërmjetësim: “Si do i njohë Muhamedi ata që meritojnë ndërmjetësim?” ata të thonë, “Zoti do i tregojë atij!” Sipas këtij koncepti, personi do të shkojë të Muhamedi dhe të kërkojë ndërmjetësimin e tij. Muhamedi pastaj do e pyes Zotin nëse personi meriton ndërmjetësimin e tij ose jo. Zoti do e njoftojë Muhamedin që personi meriton të shkojë në Parajsë. Muhamedi pastaj do të kthehet dhe t’i thotë Zotit që ai person meriton të shkojë në Parajsë! Blasfemia është e dukshme; ata që besojnë në ndërmjetësim e bëjnë Zotin sekretar të idhullit të tyre Muhamed. Qoftë i madhëruar Zoti.

Pasi që Kurani është libri më i saktë, ai e njeh faktin që secili në Parajsë do të ndërmjetësojë në emër të të dashurve të tij apo saj: “Të lutem Zot, pranoje nënën time në Parajsë.” Ky ndërmjetësim do të funksionojë nëse nëna e personit meriton të shkojë në Parajsë (2:255, 20:109, 21:28). Pra, ndërmjetësimi, edhe pse do të ndodhë në këtë mënyrë, është krejtësisht i papërdorshëm.

Mësojmë nga Kurani që Ibrahim, shërbëtori i dashur i Zotit, nuk mundi të ndërmjetësojë në emër të babait të tij (9:114). Nuhu nuk mundi të ndërmjetësojë në emër të djalit të vet (11:46). Muhamedi nuk mundi të ndërmjetësojë në emër të xhaxhait të vet (111:1-3) ose të afërmeve (9:80).

Çka ju shtyn juve të mendoni që një profet apo i shenjtë do të ndërmjetësojë në emër të një të huaji që nuk e njihet aspak?! Shih 2:48, 123; 6:51, 70, 94; 7:53; 10:3; 19:87; 26:100; 30:13; 32:4; 36:23; 39:44; 40:18; 43:86; 53:26 & 74:48. Ndërmjetësimi i Muhamedit është në 25:30.

SHTOJCA 9:

Ibrahimi: I dërguari fillestar i Islamit

Një nga mitet e përhapura është që Muhamedi ishte themeluesi i Islamit. Edhe pse Islami, nënshtrimi i plotë ndaj vetëm Zotit, është e vetmja fe që pranohet nga Zotit që nga koha e Ademit (3:19, 85), Ibrahimi raportohet në Kuran si përdoruesi i parë i fjalës “Islam” dhe ai që na thirri “Mysliman” (22:78). Nënshtrimi shembullor i Ibrahimit ndaj Zotit demonstron në vullnetin e tij me nam që ta sakrifikojë djalin e tij të vetëm, Ismailin, kur ai mendoi që ashtu ishte urdhri i Zotit. Siç del, një urdhër i tillë ishte në fakt nga Dreqi.

Zoti nuk e porositi Ibrahimin ta sakrifikojë djalin e vet

Zoti është Më i Mëshirshmi. Ai kurrë nuk i shkel ligjet e Veta (7:28). Cilido person që beson që Më i Mëshirshmi e porositi Ibrahimin të vrasë djalin e tij nuk mund të arrijë në Parajsën e Zotit. Një mendim i tillë djallëzor në lidhje me Zotin është tepër blasfemues. Askund në Kuran nuk shohim që Zoti porositi Ibrahimin të vrasë djalin e vet. Në të kundërtën, Zoti ndërhyri për të shpëtuar Ibrahimin dhe Ismailin nga kurthi i Dreqit (37:107), dhe Ai i tha Ibrahimit: “I besove ëndrrës” (37:105). Pa dyshim, ajo ishte ëndërr e inspiruar nga Dreqi. Ligji i pathyeshëm i Zotit është: “Zoti kurrë nuk përkrahë mëkat” (7:28).

Mileti i Ibrahimit

Islami quhet “Mileti i Ibrahimit” (Feja e Ibrahimit) përgjatë Kuranit (2:130, 135; 3:95; 4:125; 6:161; 12:37-38; 16:123; 21:73; 22:78). Aq më shumë, Kurani na informon që Muhamedi ishte ndjekës i Ibrahimit (16:123).

Për shkak të mosdijes së përgjithshme në lidhje me faktin që Ibrahimi ishte i dërguari fillestar i Islamit, shumë të ashtuquajtur Mysliman e sfidojnë Zotin: “Nëse Kurani është komplet dhe krejtësisht i hollësishëm (siç pretendon Zoti), ku mund ta gjejmë numrin e Reqateve (njësive) në secilën lutje të kontaktit (Salat)?” Mësojmë nga Kurani që të gjitha zakonet fetare të Islamit veç ishin të themeluara para shpalljes së Kuranit (8:35, 9:54, 16:123, 21:73, 22:27, 28:27). Strofa 16:123 është provë e drejtpërdrejtë që të gjitha zakonet fetare në Islam ishin të vendosura kur Muhamedi u lind. Muhamedi u urdhërua të “ndiqte fenë e Ibrahimit.” Nëse kërkoj nga t’i të blesh një televizor, supozohet që ti e di çka është televizori. Ngjashëm, kur Zoti e urdhëroi Muhamedin të ndjekë zakonet e Ibrahimit (16:123), zakonet e tilla është dashur të jenë popullore (të njohura).

Një provë tjetër e ruajtjes hyjnore të zakoneve Islamike që iu dhanë Ibrahimit është “Pranimi i Gjithanshëm” i zakoneve të tilla. Nuk ka grindje sa i përket numrit të Reqateve në të gjitha pesë lutjet e kontaktit. Kjo vërteton ruajtjen hyjnore të Salatit. Kodi matematikor i Kuranit konfirmon numrin e Reqateve në pesë lutjet 2, 4, 4, 3, dhe 4, përkatësisht. Numri 24434 është shumëfish i 19-tës.

Kurani merret vetëm me zakonet që u shtrembëruan. Për shembull, avdesi i shtrembëruar riparohet në strofën 5:6 në katër hapat origjinal të tij. Lartësia e zërit gjatë lutjeve të kontaktit (Salat) u shtrembërua – shumë Mysliman luten pa zë. Kjo u përmirësua në Kuran, 17:110. Agjërimi gjatë Ramazanit u modifikua në Kuran për të lejuar marrëdhënie seksuale gjatë natës (2:187). Zeqati riparohet në 6:141, dhe Haxhi riparohet në katër muajt e saktë (shih Shtojcën 15).

SHTOJCA 10:***Përdorimi i shumësit nga Zoti***

Në botën Anglisht folëse, ku doktrina e trinisë është e përhapur, disa njerëz habiten me përdorimin e shumësit (në gramatikë) nga Zoti në Kuran. Lajmi i pandryshueshëm i Kuranit ku nuk ka aspak kompromis është që “Zoti ËSHTË NJË” (2:133, 163; 4:171; 5:73; 6:19; 9:31; 12:39; 13:16; 14:48, 52; 16:22, 51; 18:110; 21:108; 22:34; 37:4; 38:65; 39:4; 40:16; 41:6; 112:1).

Sa herë që veta e parë shumës përdoret nga i Plotfuqishmi, ajo vazhdimisht tregon pjesëmarrjen e entiteteve të tjera, siç janë engjëjt. Për shembull, shpallja e këtij Kurani përfshiu pjesëmarrjen e engjëllit Gabriel dhe profetit Muhamed. Prandaj ekziston përdorimi i shumësit në 15:9: “Ne e shpallëm këtë shkrim, dhe ne do e ruajmë.” Shumësi këtu thjeshtë pasqyron faktin që engjëlli Gabriel dhe profeti Muhamed morën pjesë në procesin e dorëzimit të Kuranit.

Një shembull tjetër ka të bëjë me fryrjen e frymës së jetës në Ademin dhe Jezusin. Krijimi i Ademit ndodhi në parajsë dhe Zoti fryu drejtpërdrejt në të frymën e jetës. Pra, veta e parë njëjës përdoret vazhdimisht: “Unë fryva në Ademin nga fryma Ime” (15:29, 38:72). Krijimi i Jezusit, në anën tjetër, ndodhi në tokë, dhe Gabrieli barti “fjalën” e Zotit te Maria. Shumësi vazhdimisht përdoret kur i referohet krijimit të Jezusit (21:91, 66:12).

Kur Zoti i foli Moisiut drejtpërdrejt, pa ndërhyrjen e engjëjve, e shohim që Zoti flet në veçanti në njëjës: “Unë jam Zoti. Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Meje. Të më adhuron vetëm Mua, dhe zbatoni lutjet e kontaktit (Salat) rregullisht për të më përkujtuar Mua.” (20:12-14).

Sa herë që adhurimi i Zotit përmendet, njëjësi përdoret (51:56).

SHTOJCA 11:***Dita e Ringjalljes***

Birit i bihet, dhe të gjithëve në qiej dhe tokë iu bie të fiktë, përveç atyre që kursehen nga Zoti. Pastaj i bihet së dyti, dhe ata ngriten. [39:68]

Të gjitha gjeneratat e njerëzve dhe xhinëve do të ringjallen në këtë tokë; rreth 150 bilion prej tyre. Por nuk do të jemi të lidhur për toke. Zoti na mëson nëpërmjet shembullit të larvës; ajo shndërrohet në krizalid brenda fshikëzës (varrit), pastaj del nga fshikëza si një flutur fluturuese. Ngjashëm, ne jetojmë këtu në tokë, dhe kur dalim nga varri në Ditën e Ringjalljes nuk do të jemi të lidhur për toke; sikur flutura (101:4).

Toka do të shkëlqejë me dritën e Zotit (39:69) përderisa Ai vjen në gjithësinë tonë, së bashku me engjëjt (89:22). Pasi që gjithësia jonë është fushëveprim i përkohshëm i Dreqit, ajo nuk mund ta durojë praninë fizike të Zotit (7:143). Përderisa i Plotfuqishmi afrohet, vjet do të përplasen në njëri tjetrin (77:8, 81:2), dhe toka do të shkatërrohet nën këmbët tona (69:14, 89:21). Këto tmerre nuk do i brengosin besimtarët (21:103).

Parajsa e lartë

Me arritjen e të Plotfuqishmit Zot, të gjithë njerëzit dhe xhinët do të shtresohen automatikisht varësisht sipas shkallës së rritjes dhe zhvillimit të tyre. Ata që i ushqyen shpirtrat e tyre duke adhuruar vetëm Zotit, duke besuar në Përjetësinë, dhe duke çuar jetë të drejtë do të jenë të fortë mjaft për të qëndruar afër Zotit; ata do i zënë vendet apo rangjet më të larta (shih Shtojcën 5).

Parajsa e ulët

Ata që i zhvilluan shpirtat e tyre në një shkallë më të ulët, si dhe ata që vdesin para moshës dyzet vjeçare, do të lëvizin më poshtë në Parajsën e Ulët. Ata do të shkojnë në vendin ku ata mund të jenë afër Zotit aq sa i lejon shkalla e rritjes dhe zhvillimit të tyre që të jenë.

Purgatori

Do të ketë njerëz që i kanë ushqyer shpirtat e vet aq sa për t'i kursyer ata nga Ferri, por jo edhe sa duhet për të hyrë në Parajsën e Ulët. Ata nuk janë as në Ferr, as në Parajsë. Ata do i luten Zotit që t'i pranojë ata në Parajsën e Ulët (7:46-50). Zoti do të jetë i mëshirshëm ndaj tyre, dhe do të bashkëngjisë Purgatorin në Parajsën e Ulët.

Ferri

Një gjithësi e tetë, e re do të krijohet për t'i strehuar ata që ikin nga Zoti për shkak të dobësisë së tyre; ata dështuan që t'i ushqejnë dhe zhvillojnë shpirtat e tyre (69:17). Zoti nuk e fut asnjë qenie në Ferr; ata shkojnë në të me vetë vullnetin e tyre (Shtojca 5).

SHTOJCA 12:

Roli i Profetit Muhamed

Misioni i vetëm i Profetit ishte që të dorëzojë Kuranin, tërë Kuranin, dhe asgjë përveç Kuranit (3:20; 5:48-50, 92, 99; 6:19; 13:40; 16:35, 82; 24:54; 29:18; 42:48; 64:12).

Dorëzimi i Kuranit ishte një mision aq i rëndësishëm dhe fisnik sa që Profeti nuk pati pak kohë të bëjë ndonjë gjë tjetër. Aq më shumë, Profeti u ndalua me fjalët më të rrepta nga lëshimi i ndonjë mësim fetar përveç Kuranit (69:38-47). Atij madje edhe iu ndalua që ta shpjegojë Kuranin (75:15-19) – Zoti është mësuesi i Kuranit (55:1-2) dhe Kurani është Hadithi më i mirë (39:23 & 45:6).

Këto fakte Kuranore manifestohen në realitetin historik që fjalët dhe veprat (Hadith & Suna) që i janë mveshur Profetit nuk u shfaqën deri në shekullin e dytë pas vdekjes së tij. Kurani ka profetizuar trillimet e Hadithit dhe Sunës nga armiqtë e Profetit (6:112-115). Kurani na mëson që ishte vullneti i Zotit që të lejojë shpikjen e Hadithit dhe Sunës për t'i shërbyer një kriteri që i ekspozon ata që besojnë vetëm me fjalë goje, jo në zemrat e tyre. Ata që i tërheqë Hadithi dhe Suna vërtetohet të jenë besimtarë të pavërtetë (6:113). Për ironi, librat e Hadithit raportojnë porosinë e Profetit që të mos shkruajnë asgjë nga ai përveç Kuranit! Të paraqitura më poshtë janë dy Hadithe të tilla të marra nga burimet më të besueshme të Hadithistëve, Sahih Muslim dhe Is-haah Ahmad Ibn Hanbal:

عَنْ أَبِي سَعِيدٍ الْخَدْرِيِّ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ : قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ : «لَا تَكْتُبُوا عَلَيَّ سِوَى الْقُرْآنِ ، مَنْ كَتَبَ سِوَى سِوَى الْقُرْآنِ فَلْيَسْحَهُ» (1)

Profeti tha, “Mos shkruani asgjë prej meje përveç Kuranit.” [Ahmed, Vëllimi. 1, Faqe 171, dhe Sahih Muslim]

عَنْ عَبْدِ الْمَلِكِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ قَالَ : «دَخَلَ زَيْدُ بْنُ قَابَسٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ عَلَى مُنَابِقَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ ، فَصَدَّقَهُ حَدِيثًا ، فَأَمَرَ إِنْشَاءً أَنْ يَكْتُبَ ، فَقَالَ زَيْدٌ : إِنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ نَهَى أَنْ يَكْتُبَ سِوَى الْقُرْآنِ ، فَسَمِعَهُ» (2)

Ky Hadith thotë që Profeti e mbajti qëndrimin e tij anti-Hadithist deri në vdekje. [Ahmed, Vëllimi. 1, Faqe 192]

SHTOJCA 13:***Shtylla e parë e Islamit (Nënshtimit):
"La Ilahe Ila Allah" (Asnjë zot përveç Zotit)***


Strofa 3:18 thotë Shtyllën e Parë të Islamit (Nënshtimit): “Zoti dëshmon që nuk ka asnjë zot tjetër përveç Atij, dhe gjithashtu dëshmojnë edhe engjëjt dhe ata që posedojnë dije.”

Kjo më e rëndësishmja shtyllë është shtrembëruar. Miliona Myslimanë e kanë përvetësuar versionin politeist të Dreqit, dhe këmbëngulin që ta përmendin emrin e Muhamedit përveç emrit të Zotit. Por, kriteri shumë i madh i Kuranit në 39:45 i vulosë Myslimanët e tillë si mosbesimtarë: “Kur VETËM Zoti përmendet, zemrat e atyre që nuk besojnë në Përjetësi tkurren me neveri, por kur të tjerët përmenden me Të, ata bëhen të kënaqur.”

Kam bërë hulumtim të gjerë për këtë kriter, dhe kam arritur në një përfundim befasues: adhuruesit e idhujve që nuk i përmbahen Shtyllës së Parë të Islamit siç diktohet në 3:18 ndalohen nga Zoti që të shprehin Shehadetin e saktë. Ata thjeshtë nuk mund të thonë: “Esh-hedu Ela Ilahe Ila Allah.” Ata nuk mund ta thonë atë. Pasi që kjo është feja e Ibrahimit (2:130, 135; 3:95; 4:125; 6:161; 12:37-38; 16:123; 22:78; Shtojca 9), e VETMJA kredo duhet të jetë “LA ILAHE ILA ALLAH (nuk ka zot përveç TË VETMIT Zot)”. Muhamedi nuk ekzistoi në tokë para Ibrahimit.

Blasfemi e tepërt

Nuk ka blasfemi më të madhe sesa shtrembërimi i Kuranit për të idolizuar profetin Muhammed kundër vullnetit të tij. Strofa 19 e Sures “Muhammed” (47:19) thotë: “Ta dini që nuk ka zot përveç të vetmit Zot.” E paraqitur më poshtë është një fotokopje e logos (shenjës dalluese) të një botimit Mysliman *RISHIKIMI I FEVE* (Xhamia e Londrës, 16 Gressenhall Road, London SW18 5QL, Angli.) Duke e përdorur stilin e bukurshkrimit të Kuranit, botuesit e *RISHIKIMI I FEVE* shtuan frazën “Muhammed Resul Allah” në atë mënyrë që jep përshtypje të gabueshme që e tillë është thënia Kuranore e 47:19. Çfarë blasfemie!



Shembull tipik i Islamit të shtrembëruar

SHTOJCA 14:***Paracaktimi (Fati)***

Ne jemi absolutisht të lirë të besojmë ose të mos besojmë në Zotin. Është vullneti i Zotit që ne do të bëjmë ashtu (18:29, 25:57, 73:19, 74:37, 76:29, 78:39, 80:12).

Pas kryerjes së mëkatit fillestar (Shtojca 7), Zoti na dha një shans për të dënuar haptas krimin tonë dhe ta pranojmë autoritetin absolut të Tij (33:72). Por ne vendosëm që deshëm të shohim një demonstrim të kompetencës së Dreqit si zot. Shumë njerëzve nuk iu pëlqen fakti që Zoti i ka krijuar, për t'i vënë ata nëpër këtë test të tmerrshëm. Shihet qartë që njerëzit e tillë nuk janë të vetëdijshëm që [1] kanë kryer një krim të tmerrshëm (Hyrja & Shtojca 7), dhe [2] që atyre iu është

dhënë shansi për ta dënuar krimin e tyre dhe ta shpengojnë veten, por zgjodhën të përjetojnë testin.

Mësojmë nga 57:22 që jetët tona, së bashku me gjithçka tjetër rreth nesh, janë të para-incizuara në diçka si videokasetë. Zoti e di tërësisht çfarë lloj vendimi secili prej nesh është i paracaktuar të marrë; Ai e di cilët prej nesh po shkojnë në Parajsë dhe cilët po shkojnë në Ferr. Madje edhe para se të kishim lindur në këtë botë, Zoti e dinte cilët shpirtra janë të mirë dhe cilët shpirtra janë të këqij. Sa i përket gjithdijshmërisë së Zotit, ne mund ta paramendojmë një vulë në ballin e secilit që thotë “Parajsë” ose “Ferr.” Por, sa na përket neve, ne jemi plotësisht të lirë të anojmë kah autoriteti absolut i Zotit, ose kah pikëvështrimet politeiste të Dreqit. Paracaktimi, pra, është fakt sa i përket Zotit, jo sa na përket neve.

Kjo mënyrë e të kuptuarit shpjegon strofat e shumta që thonë që “Zoti udhëzon këdo Ai vendosë, dhe çorienton këdo Ai vendosë.” Duke u bazuar në njohurinë e Tij, Zoti i cakton shpirtrat tanë në rrethanat që i meritojmë. Kur Zoti iu tha engjëjve, “Unë di çka ju nuk dini” (2:30), kjo do të thoshte që disa prej nesh merituan një shans për ta shpenguar veten. Një shembull i udhëzimit të Zotit për ata që meritojnë udhëzim gjendet në 21:51: “I dhamë Ibrahimit udhëzimin e tij, se ishim tërësisht të vetëdijshëm për të.” Me fjalë të tjera, Zoti e dinte që Ibrahim i ishte shpirt i mirë që meritonte të jetë i udhëzuar, dhe Zoti ia dhuroi atij udhëzimin e tij dhe të kuptueshmërisë. Një shembull tjetër thuhet në 12:24. Jozefi anoi nga bashkëshortja e fisnikut Egjiptas, dhe gati sa nuk kreu marrëdhënie jashtëmartesore “po të mos ishte që ai pa një shenjë nga Zotëruesi i tij.” Zoti na mëson në 12:24 që Ai “largoj të keqen dhe mëkatin nga Jozefi, se ai ishte një prej adhuruesve të Mi të përkushtuar.” A ishte Jozefi ai që e përmbajti epshin e tij? Apo, a ishte mbrojtja e Zotit nga mëkati që e bëri atë të dëlirë? I tillë është paracaktimi.

SHTOJCA 15:

Detyrat fetare: Dhuratë nga Zoti

Kur Ibrahim iu lut Zotit në strofën 14:40, ai nuk kërkoi pasuri ose shëndet; dhurata për të cilën ai u lut ishte: “Të lutem Zot, më bë një prej atyre që zbaton lutjet e kontaktit (Salat).” Detyrat fetare të themeluara nga Zoti janë në fakt një dhuratë shumë e madhe nga Ai. Ato përbëjnë ushqimin e duhur për të rritur dhe zhvilluar Shpirtrat tanë. Pa një ushqim të tillë, nuk mund ta përballojmë energjinë e jashtëzakonshme të shoqëruar me praninë fizike të Zotit në Ditën e Gjykimit. Besimi në Zotin nuk na garanton shpengim vetvetiu; ne gjithashtu duhet t’i ushqejmë shpirtrat tanë (6:158, 10:90-92). Aq më tepër, 15:99 thotë që zbatimi i detyrave fetare të themeluara nga Zoti është mënyra jonë për të arritur siguri: “Adhurojeni Zotëruenin tuaj në mënyrë që të arrini siguri.”

Lutjet e Kontaktit (Salat)

Të pesë lutjet e përditshme të kontaktit janë ushqimet kryesore për shpirtin. Përderisa shpirti mund të arrijë ca rritje dhe zhvillim duke çuar jetë të drejtë, edhe pa i zbatuar lutjet e kontaktit, kjo do të ishte sikur të mbijetoje me sheqerka pa ushqime të rregullta.

Mësojmë nga 2:37 që mund të vëmë kontakt me Zotin duke shprehur fjalët specifike arabe që na janë dhënë nga Zoti. Surja 1, Çelësi, është një kombinim zërash të hartuar matematikisht që e çelë derën ndërmjet nesh dhe Zotit:

1. Lutja e Agimit duhet të zbatohet gjatë dy orëve para lindjes së diellit (11:114, 24:58).
2. Lutjes së Mesditës i vjen koha kur dielli zbret nga pika më e lartë e tij në mesditë (17:78).
3. Lutja e Pasdites mund të zbatohet gjatë 3-4 orëve para perëndimit të diellit (2:238).

4. Lutjes së Mbrëmjes i vjen koha pas perëndimit të diellit (11:114).
5. Lutja e Natës mund të zbatohet pasi që muzgu hiqet nga qielli (24:58).

Lutja e të Premtes e Asamblesë në mesditë është detyrë e obligueshme për secilin burrë dhe grua të Nënshtruar (62:9). Mosarritja e zbatimit të Lutjes së të Premtes është shkelje e tepërt.

Secila lutje e kontaktit është e vlefshme nëse zbatohet në cilëndo kohë gjatë periudhës kohore që i vjen koha deri sa t'i vijë koha lutjes së ardhshme. Kur na ik një lutje e caktuar e kontaktit është rast i humbur që nuk mund të kompenzohet; vetëm mund të kërkohet falje. Pesë lutjet përbëhen nga 2, 4, 4, 3, dhe 4 njësi (Reqate), përkatësisht.

Prova që Salati veç ishte themeluar nëpërmjet Ibrahimit gjendet në 8:35, 9:54, 16:123, & 21:73. Kjo detyrë më e rëndësishme në Islam (Nënshtrim) është shtrembëruar aq shumë sa që lutjet e kontaktit (Salat) janë bërë një zakon në idhujtari për shumicën e gjerë të Myslimanëve. Edhe pse Kurani na urdhëron që lutjet tona të kontaktit t'i kushtohen vetëm Zotit (20:14; 39:3, 45), Myslimanët e sotshëm këmbëngulin në përkujtimin e "Muhamedit dhe familjes së tij" dhe "Ibrahimit dhe familjes së tij" gjatë lutjeve të tyre. Kjo e bën lutjen të pavlefshme dhe boshe (39:65).

Teksti në vijim, në lidhje me mrekullitë që konfirmojnë lutjet e kontaktit, është nxjerrë nga numri (botimi) i Janarit 1990 të revistës "Pikëvështrimi të të Nënshtruarve" (numrat e rregullt dhe të posaçëm shtesë), siç janë shkruar nga Dr. Rashad Khalifa:

MREKULLIA MBRESËLËNËSE MATEMATIKORE KONFIRMON 5 LUTJET E KONTAKTIT

[1] Surja 1 është dhuratë e Zotit për ne, për të vënë kontakt me Të (Salat). Nëse shkruani numrin e sures dhe numrin e strofave njërin pranë tjetrit del 17, që është numri total i njërive në 5 lutjet e përditshme.

[2] Le të shkruajmë numrin e sures, duke u ndjekur nga numri i secilës strofë në sure. Ja çka del:

1 1 2 3 4 5 6 7. Ky numër është shumëfish i 19-tës.

[3] Tash, le të zëvendësojmë numrin e secilës strofë me numrin e shkronjave në atë strofë. Ja çka del: **1 19 17 12 11 19 18 43** gjithashtu shumëfish i 19-tës. Teorikisht, mund t'i ndryshojmë shkronjat e Sures 1, dhe prapë të kemi numrin e njëjtë të shkronjave, megjithatë, fenomenet matematikore në vijim e përjashtojnë një mundësi të tillë. Se vlera germore e secilës shkronjë merret parasysht. Ja ku është:

Karakteristikat e Sures 1, Çelësi		
Nr. i strofës	Nr. i shkronjave	Vlera germore
1	19	786
2	17	581
3	12	618
4	11	241
5	19	836
6	18	1072
7	43	6009

[4] Le të përfshijmë vlerën germore të secilës strofë, dhe ta shkruajmë në vijim të numrit të shkronjave në secilën strofë: **1 19 786 17 581 12 618 11 241 19 836 18 1072 43 6009** gjithashtu shumëfish i 19-tës.

[5] Tash, le të shtojmë numrin e secilës strofë, të ndjekur me numrin e shkronjave në atë strofë, pastaj vlerën germore të asaj strofe. Ja çka del: **1 1 19 786 2 17 581 3 12 618 4 11 241 5 19 836 6 18 1072 7 43 6009** shumëfish i 19-tës.

[6] Në vend të vlerës germore të secilës strofë, le të shkruajmë vlerën germore të secilës shkronjë individuale në Suren 1. Kjo mrekulli vërtetë mbresëlënëse, tregon që numri i gjatë që rrjedh, i përbërë nga 274 shifra, është gjithashtu shumëfish i 19-tës. **ALLAHU EKBER. 1 7 1 19 2 60 40 1 30 30 5 1 30 200 8 40 50 1 30 200 8 10 40 2 17 ... 50**

Ky numër fillon me numrin e sures, i ndjekur me numrin e strofave në sure, i ndjekur nga numri i strofës, i ndjekur nga numri i shkronjave në këtë strofë, i ndjekur nga vlera gormore e secilës shkronjë në këtë strofë, i ndjekur nga vlerat gormore të secilës shkronjë në këtë strofë, dhe kështu me radhë deri në fund të sures. Pra, përbërësi i fundit është 50, vlera e “N”-së (shkronjës së fundit).

[7] Pasi që nuk mund të shkruaj numra shumë të gjatë këtu, le t’i zëvendësojmë me një [] këta numra që përbëhen nga numri i secilës strofë, i ndjekur nga numri i shkronjave në atë strofë, i ndjekur nga vlera gormore e secilës shkronjë individuale në atë strofë. Nëse e shkruajmë numrin e sures, të ndjekur nga numri i strofave të saj, marrim 17, numrin e njësive (Reqateve) në 5 lutjet e përditshme. Afër numrit 17, shkruajmë numrin e lutjes së parë (1), të ndjekur nga numri i Reqateve të saj, që është 2, pastaj dy [], të ndjekur nga numri i lutjes së dytë (2), i ndjekur nga numri i Reqateve në lutjen e dytë (4), i ndjekur nga katër [], dhe kështu me radhë. Jo vetëm që numri i gjatë që del është shumëfish i 19-tës, por numri i shifrave të tij përbërëse është 4636 (19x244)...Vini re që cilido përfaqësim i Sures 1 mund ta zëvendësojë [] pa e ndryshuar rezultatin; të gjitha ato japin shumëfisha të 19-tës. Për shembull, përfaqësimi i shkurtër i “Çelësit” përbëhet nga numri i Sures (1), i ndjekur nga strofat (7), i ndjekur nga numri total i shkronjave në Suren 1 (139), i ndjekur nga vlera totale gormore e të gjithë sures (10143). Numri që del (1713910143) gjithashtu mund ta përfaqësojë [].

1712[][]24[][][]34[][][]43[][][]54[][][]

KONFIRMIMI I LUTJEVE TË TË PREMTE

[8] Pasi që lutja e të Premtes përbëhet nga dy predikime dhe dy Reqate (totali është 4 njësi po ashtu), pra lexojmë vetëm 15 “Çelësa” të Premten, në krahasim me 17 ditëve të tjera. Abdullah Ariku zbuloi që nëse e zëvendësojmë 17-shin me 15 në numrin e gjatë në [7] dhe heqim dy “Çelësa” nga lutja e mesditës, del shumëfish i 19-tës po ashtu. Kjo e konfirmon Lutjen e të Premtes, në mesditë, me 2 “Çelësa.” Numri i gjatë i paraqitur më poshtë përfaqëson pesë lutjet e të Premtes; është shumëfish i 19-tës.

1512[][]24[][]34[][][]43[][][]54[][][]

"ÇELËSI" (EI-Fatiha) DUHET TË RECITOHET ARABISHT

[9] Surja e parë në Kuran është matematikisht e hartuar në atë mënyrë që sfidon dhe ndalë matematicientët më të mëdhenj në tokë. Tash e çmojmë faktin që kur e recitojmë Suren 1, “Çelësin,” gjatë Lutjeve tona të Kontaktit, diçka ndodhë në gjithësi, dhe vëmë kontakt me Krijuesin tonë. Rezultati është lumturi e përsosur, tash dhe përgjithmonë. Duke e kontaktuar Krijuesin tonë të Plotfuqishëm 5 herë në ditë, i ushqejmë dhe zhvillojmë shpirtrat tonë për t’i përgatitur për Ditën e Madhe kur e takojmë Zotin. Vetëm ata që i ushqejnë shpirtrat e vet do të jenë në gjendje të përballojnë dhe gëzojnë praninë fizike të Zotit të Plotfuqishëm.

Të gjithë të nënshtruarit, nga të gjitha kombësitë, i recitojnë fjalët e “Çelësit” të cilat u shkruan nga Vetë Zoti, dhe na u dhanë që të vëmë kontakt me Të (2:37).

Zbulimi i Edip Yukselit shton mbresëlënien e “Çelësit” dhe tregon qartë që duhet të recitohet arabisht.

Kur e reciton “Çelësin” arabisht, buzët e tua prekin njëra tjetrën saktësisht 19 herë.

Buzët tua e prekin njëra tjetrën ku ndodhen shkronjat “B” dhe “M”. Janë 4 “B-ja” dhe 15 “M-ja” dhe kjo jep shumën 19. Vlera germore e 4 “B-ve” është $4 \times 2 = 8$, dhe vlera germore e 15 “M-ve” është $15 \times 40 = 600$. Vlera germore totale e 4 “B-ve” dhe 15 “M-ve” është 608, që është 19×32 .

KONFIRMIMI I 5 LUTJEVE DITORE, NUMRI I PËRKULJEVE (Ruku), PËRULJEVE (Suxhud), dhe TESHEHUDEVE

[10] Njëri prej sfidimeve të zakonshme...është: “Nëse Kurani është i plotë dhe krejtësisht i hollësishëm (siç thuhet në 6:19, 38 & 114), ku janë hollësitat e Lutjeve të Kontaktit (Salatit)?” Këta njerëz e pyesin këtë pyetje sepse ata nuk janë të vetëdijshëm që Kurani na njofton që Lutjet e Kontaktit erdhën nga Ibrahim (21:73 & 22:78). Nëse i shkruajmë numrat e lutjeve me përkuljet, përluljet dhe Teshehudet e tyre, marrim:

	Fjala	Shkronja	Vlera
1	Bism	B	2
2	Bism	M	40
3	Rrahman	M	40
4	Rrahim	M	40
5	El-Hamdu	M	40
6	Rab	B	2
7	`Alemin	M	40
8	Rrahman	M	40
9	Rrahim	M	40
10	Malik	M	40
11	Yaum	M	40
12	Na'budu	B	2
13	Mustekim	M	40
14	Mustekim	M	40
15	En`amte	M	40
16	`Alejhim	M	40
17	Maghdub	M	40
18	Maghdub	B	2
19	`Alejhim	M	40
	Total:		608 (19x32)

1 1 2 2 4 1 2 4 4 8 2 3 4 4 8 2 4 3 3 6 2 5 4 4 8 2

Ky numër i gjatë përbëhet nga surja që e recitojmë në të pesë lutjet (1) të ndjekur nga numri i lutjes së parë (1), pastaj numri i “Çelësave” që i recitojmë në këtë lutje (2), pastaj numri i përkuljeve (Ruku’) (2), pastaj numri i përluljeve (4), pastaj numri i Teshehudeve (në pozitën e ulur) (1), pastaj numri i lutjes së dytë (2), pastaj numri i “Çelësit” që e recitojmë në lutjen e dytë (4), pastaj numri i përkuljeve (Ruku) në këtë lutje (4), pastaj numri i përluljeve (8), pastaj numri i Teshehudeve (2), pastaj numri i lutjes së tretë (3), dhe kështu me radhë deri në lutjen e fundit. Ky numër i gjatë është shumëfish i 19-tës, dhe kjo konfirmon edhe hollësitat më të vogla të lutjeve, madje edhe numrin e Rukuve, Suxhudeve, dhe Teshehudeve.

Bamirësia e Obligueshme (Zeqati)

Zeqati duhet të jepet “në ditën e vjeljes” (6:141). Sa herë që pranojmë “të ardhura neto,” duhet të ndajmë 2.5% dhe t’ia japim marrësve të specifikuar – prindërve, të afërmeve, jetimëve, të varfërve, udhëtarit të huaj, në këtë radhë (2:215). Rëndësia jetike e Zeqatit pasqyrohet në ligjin e Zotit: “Mëshira lme i përfshinë të gjitha gjërat, por Unë do të përcaktoj atë për të drejtin që japin Zeqat” (7:156).

Zeqati duhet të njehsohet me kujdes dhe të jepet rregullisht sa herë që pranojmë ndonjë të ardhur. Tatimet e qeverisë duhet të zbriten, por jo shpenzimet e tjera siç janë borxhet, dhe shpenzimet jetësore. Nëse dikush nuk njeh persona që kanë nevojë, ai ose ajo mund të japë Zeqat te një xhami ose organizatë bamirësie me qëllimin e veçantë për t’i ndihmuar njerëzit e varfër. Bamirësitë që iu jepen xhamive ose spitaleve ose organizatave nuk mund të konsiderohen Zeqat.

Agjërimi

Hollësitat e plota të agjëritit jepen në 2:183-187.

Shtegtimi: Haxh & Umreh

Një herë në jetë, Haxhi dhe Umreh janë të shpallura për ata që kanë mundësi për to. Shtegtimi përkujton nënshtrimin shembullor të Ibrahimit ndaj Zotit (Shtojca 9), dhe duhet të zbatohet gjatë katër Muajve të Shenjtë – Dhyl-Hixhxhe, Muharrem, Safer, dhe Rebi I (muaji i 12-të, i parë, i 2-të dhe i 3-të) (2:197, 9:2, 36). Umrah mund të zbatohet në cilëndo kohë. Si të gjitha detyrat tjera në Islam, Haxhi është shtrembëruar. Shumica e Myslimanëve zbatojnë Haxhin vetëm gjatë pak ditëve në Dhyl-Hixhxhe, dhe ata i konsiderojnë Rexhebin, Dhyl-Ka'den, Dhyl-Hixhxhen, dhe Muharremin (muajin e 7-të, 11-të, 12-të dhe të parë) të jenë Muajt e Shenjtë. Ky është shtrembërim që dënohet fuqishëm. (9:37).

Shtegtimi fillon me banjë ose dush, i ndjekur nga gjendja e shenjtërisë e quajtur "Ihram," kur shtegtari mashkull veshë çarçafë të paqepur, dhe gruaja veshë fustan modest (2:196). Përgjatë Haxhit, shtegtari abstenon nga marrëdhënia seksuale, kotësitë si ruajtja dhe prerja e flokëve, grindjet, sjelljet e këqija, dhe fjalët e këqija (ndyta) (2:197). Pastërtia, banjat, dhe praktikat e rregullta higjienike inkurajohen. Me arritjen në Xhaminë e Shenjtë në Mekë, shtegtari ecë rreth Qabes shtatë herë, përderisa e madhëron dhe lartmadhëron Zotin (2:125, 22:26-29). Formulimi i zakonshëm është: "Lebejke Allahuma Lebejk" (Zoti im, të jam përgjigjur Ty). "Lebejke Le Sherike Leke Lebejk" (të jam përgjigjur Ty, dhe deklaroj që nuk ka zot tjetër përveç Teje: të jam përgjigjur Ty). Hapi i ardhshëm është të ecësh në distancën prej rreth gjysmë kilometri ndërmjet kodrinave të Safas dhe Merves shtatë herë, me ecje të shpejta të herëpashershme (2:158). Kjo përfundon pjesën Umre të shtegtimit.

Shtegtari pastaj shkon në Arafat për të kaluar një ditë adhurimi, meditimi, dhe madhërimi të Zotit, nga agimi deri në perëndim të diellit (2:198). Pas perëndimit të diellit, shtegtari shkon në Muzdelife ku zbatohet Lutja e Natës, dhe 21 guralecë mblidhen për gurëzimin simbolik të Dreqit në Mine. Nga Muzdelifah, shtegtari shkon në Mine për të kaluar dy ose tre ditë (2:203). Në mëngjesin e parë në Mine, shtegtari ofron sakrificë shtazore (kurban) për t'i ushqyer të varfrit dhe për të përkujtuar ndërhyrjen e Zotit për të shpëtuar Ismailin dhe Ibrahimin nga dredhia e Dreqit (37:107, Shtojca 9). Ceremonitë e gurëzimit simbolizojnë refuzimin e politeizmit të Dreqit dhe bëhen duke gjuajtur shtatë guralecë në secilin prej tre stacioneve, përderisa madhërohet Zoti (15:34). Shtegtari pastaj kthehet në Mekë dhe zbaton silljen lamtumirëse rreth Qabes shtatë herë.

Fatkeqësisht, shumica e shtegtarëve Mysliman të sotshëm e bëjnë zakon që të vizitojnë varrin e profetit Muhammed ku ata bëjnë veprën me skandaloze të idhujtarisë dhe kështu asgjësojnë Haxhin e tyre. Kurani vazhdimisht flet për "Xhaminë e Shenjtë", përderisa Myslimanët e sotshëm flasin për "Dy Xhami të Shenjta!" E sikur nuk shihet sa duhet idhujtaria e Myslimanëve të korruptuar, kështu që ata kanë ngritur varrin e Muhamedit si një tjetër "Xhami të Shenjtë!" Kjo është shkelje blasfemuese e Kuranit, dhe ironikisht, madje edhe e shkelë Hadithin. Hadithi i paraqitur më poshtë e ilustron këtë shkallë të ironisë:

لَعْنَةُ اللَّهِ عَلَى الْيَهُودِ وَالنَّصَارَى اتَّخَذُوا قُبُورَ أَنْبِيَائِهِمْ مَسَاجِدَ

Përkthimi i kësaj thënie të rreme është: "Zoti i ka mallkuar jahuditë dhe të krishterët se i kanë shndërruar varret e profetëve të tyre në xhami." [Bukhari, Botimi Nauau Edition, Vëllimi. 6, faqe 14]

Dobitë materiale

Përveç dobive tejet të çmueshme shpirtërore, ka bollëk dobish trupore, ekonomike, dhe shëndetësore prej zbatimit të lutjeve të kontaktit (Salatit), bamirësisë së obligueshme (Zeqatit), agjërimit gjatë muajit Ramazan, dhe Haxhit.

Zbatimi i lutjes së Agimit ndërpret periudhat e gjata të palëvizshmërisë gjatë gjumit; kjo tash është vërtetuar që ndihmon në parandalimin e artritit ose reumës. Gjithashtu, zgjimi herët në mëngjes ndihmon në luftimin e depresionit dhe problemeve të tjera psikologjike. Pozita e përluljes e cila përsëritet gjatë lutjeve të kontaktit i zgjeron enët e gjakut në trurin tonë për të përshtatur më shumë gjak, dhe kjo parandalon kokë-dhimbjet. Përkulja e përsëritshme e shpinës dhe nyejve është ushtrim i shëndetshëm. Të gjitha këto janë fakte të përkrahura në mënyrë shkencore.

Avdesi që nevojitet para lutjes së kontaktit na inkurajon të përdorim tualetin më shpesh. Kjo shprehi na mbron nga një kancer i zakonshëm dhe shumë i rrezikshëm, kanceri i zorrës së trashë. Substancat e dëmshme sekretohen në urinë dhe materie fekale. Nëse këto sekretime mbahen në zorrë për periudha të zgjatura kohore, materiet e dëmshme ri-absorbohen në trup, dhe shkaktojnë kancer.

Agjërimi gjatë muajit Ramazan na kthen barkun tonë të zgjeruar në madhësinë e tij normale, zvogëlon shtypjen e gjakut tonë nëpërmjet dehidrimit të përkohshëm, e liron trupin nga toksina (helme) të dëmshme, i jep veshkave tona pushimin shumë të nevojshëm, dhe zvogëlon peshën tonë duke hequr dhjamin e tepërt dhe të dëmshëm.

Bamirësia Zeqat dhe shtegtimi Haxh kanë dobi tejet të gjera ekonomike dhe sociale.

SHTOJCA 16: *Ndalesat ushqimore*

Kurani na mëson që Zoti është jashtëzakonisht i inatosur me ata që ndalojnë çfarëdo që nuk është e ndaluar saktësisht në Kuran (16:112-116). Përkrahja e cilësdo ndalesë që nuk përmendet saktësisht në Kuran është e barasvlershme me idhujtari (6:142-152). Ndalesat e tilla përfaqësojnë ndonjë zot tjetër përveç Zotit. Nëse e adhuron VETËM Zotin, do iu përmbahesh VETËM mësimëve të Tij dhe t'i respektosh urdhrat dhe ndalesat e themeluar vetëm nga Ai.

Saktësia apo veçantia absolute e ndalesave ushqimore në Kuran ilustron më së miri në 6:145-146. Mësojmë nga këto dy strofa që kur Zoti ndalon “mishin,” Ai ndalon “mishin” dhe asgjë tjetër, dhe kur Ai ndalon “dhjamin,” atëherë ajo është çka ai ndalon saktësisht. Këto dy strofa na njoftojnë që “mishi” i derrave është i ndaluar, e jo “dhjami.” Natyrisht, Zoti e dinte që në shumë vende, yndyra e derri (dhjami) do të përdorej në furra (të bukës) dhe në produkte të tjera ushqimore, dhe një përdorim i tillë nuk e bën ushqimin haram (të ndaluar). Kurani ndalon saktësisht vetëm katër mishra (2:173, 5:3, 6:142-145, dhe 16:112):

Thuaj, “unë nuk gjej në çka më është shpallur mua asgjë të ndaluar për ndonjë ngrënës në mos qoftë (1) ngordhësirë, (2) gjak që rrjedh, (3) mish derri, se është i papastër, dhe (4) mish që i dedikohet blasfemisht tjetërkujt pos Zotit.” Nëse dikush detyrohet t'i hajë këto pa qenë me qëllim ose me dashje, atëherë Zotëruesi yt është Falës, i Mëshirshëm. [6:145]

SHTOJCA 17:

Vdekja

Vdekja është mister i madh për shumicën e njerëzve, por jo për nxënësit e Kuranit. Mësojmë që vdekja është saktësisht si gjumi; përplot me ëndrra (6:60, 40:46). Periudha ndërmjet vdekjes dhe ringjalljes kalon si një natë gjumë (2:259; 6:60; 10:45; 16:21; 18:11, 19, 25; 30:55).

Në momentin e vdekjes, secili e di përfundimin e vet; Parajsë ose Ferr. Për mosbesimtarët, vdekja është ngjarje e frikshme; engjëjt i rrahin ata në fytyrat dhe prapnicat e tyre përderisa ua shkulin shpirtrat e tyre (8:50, 47:27, 79:1).

Vazhdimisht, Kurani flet për dy vdekje, vdekja e parë ndodhi kur ne dështuam të marrim qëndrim të palëkundur me autoritetin absolut të Zotit (Shtojca 7). Ajo vdekje e parë zgjati derisa u lindëm në këtë botë. Vdekja e dytë i përfundon jetët tona në këtë botë (2:28, 22:66, 40:11).

Vini re: Shkrimi në vijim është kopje e artikullit kryesor nga numri (botimi) i Shkurtit të vitit 1990 të Pikëpamjes së të Nënshtruarve, buletinit mujor të të Nënshtruarve të Bashkuar Ndërkombëtarë. Ky ishte numri i para para fundit që u shkrua nga Dr. Khalifa. U përfundua dhe u dërgua me postë para kohe, në Dhjetor të vitit 1989. Dr. Khalifa ra dëshmor në 31 Janar, 1990 dhe shpirti i tij shkoi drejtë e në Parajsë.

Të Drejtë nuk vdesin vërtetë

Ata shkojnë drejtë e në Parajsë

Jepu lajme të mira atyre që besojnë dhe punojnë drejtësi që do të kenë kopshte me proje që rrjedhin. Kur furnizohen me furnizime të frutave aty, ata do të thonë, “Kjo është çka na u është dhënë neve në të kaluarën.” Atyre do iu jepen furnizime të ngjashme, dhe do të kenë të shoqe të çiltra aty. Ata qëndrojnë aty përgjithmonë. (2:25)

Mos mendo që ata që vriten në rrugën e Zotit janë të vdekur; ata janë të gjallë te Zotëruesi i tyre, duke u furnizuar. (3:169)

MOS thoni për ata që janë të vrarë në rrugën e Zotit, “Janë të vdekur.” Se ata janë të gjallë, por nuk e kuptoni. (2:154)

O ju që besoni, t’i përgjigjeni Zotit dhe të dërguarit kur ai fton te çka ju mbanë të gjallë. (8:24)

Ata që emigrojnë për Zotin, pastaj vriten ose vdesin, Zoti patjetër do të furnizojë për ta furnizim të mirë. (22:58)

Ata nuk shijojnë vdekjen, përtej vdekjes së parë, dhe Zoti i kursen ata nga ndëshkimi i Ferrit. (44:56)

Atij iu tha, “Hy në Parajsë.” Ai tha, “Ah sikur njerëzit e mi (në tokë) ta dinin; që Zotëruesi im më ka falur dhe më ka nderuar mua.” (36:26-27)

Paga e mëkatit është vdekja [Romakëve 6:23]

Siç thuhet në 3:81 dhe 46:9, i Dërguari i Zotit i Besëlidhjes nuk sjell asgjë të re; çdo gjë që pranoj dhe kaloj te ju është tashmë në Kuran. Megjithatë, Kurani është plot informata që mbahen nga Zoti i Plotfuqishëm për tu shpallur në një kohë të caktuar. Tash është koha të shikojmë te strofat e paraqitura më lartë dhe të mësojmë lajmin e mrekullueshëm: TË DREJTIT NUK VDESIN; kur jetët e tyre në këtë tokë vijnë në fundin e paracaktuar, engjëjli i vdekjes thjeshtë i fton ata që t’i lënë

trupat e tyre tokësor dhe të vazhdojnë në Qiell, në Parajsën e njëjtë ku Ademi dhe Eva dikur jetuan. Parajsa ka qenë në ekzistencë që nga Ademi dhe Eva. Mësojmë nga 89:27-30 që Zoti i fton shpirtrat e besimtarëve: “Hyni në Parajsën Time.”

PËRJETIMI IM

Kur besëlidhja e Zotit me profetët u përmbush në përputhje me 3:81, u morra në Qiell ku të drejtit jetojnë TANI (4:69). Përderisa trupi im ishte këtu poshtë në tokë, unë isha në të njëjtën Parajsë të Ademit & Evës.

MOSBESIMTARËT

Sa për mosbesimtarët, ata e dinë në momentin e vdekjes që ata janë të paracaktuar për Ferr. Engjëjt i rrahin ata në fytyra dhe prapanica (8:50 & 47:27), i urdhërojnë t’i dëbojnë shpirtrat e tyre (6:93), pastaj “i shkulin shpirtrat e tyre” (79:1). Kurani na mëson që mosbesimtarët kalojnë nëpër 2 vdekje (2:28 & 40:11). Ata do të vihen në vdekje – gjendje e hiçit gjatë të cilës ata do të shohin Ferr ditë e natë në një ankth të vazhdueshëm që zgjatë deri në Ditën e Gjykimit (40:46). Ferri ende nuk është në ekzistencë (40:46, 89:23).

Natyrisht, të drejtit largohen nga këtu

Sa i përket njerëzve, të drejtit “vdesin.” Njerëzit nuk e kuptojnë që të drejtit thjeshtë i lënë trupat e tyre, dhe vazhdojnë në Parajsë. Strofa e paraqitura më lart e shpjegojnë vetë. Ato na tregojnë që të drejtit vdesin vetëm një herë – atë vdekjen që tashmë e kemi përjetuar si pasojë e grindjes së madhe (38:69). Në 36:26-27, shohim evidencën më të mirë që të drejtit shkojnë në Parajsë, përderisa shokët dhe të afërmit e tyre janë ende duke jetuar në tokë. Sikur kur shkon në Havaje dhe na pret atje. Shih gjithashtu 16:32 & 6:60-62.

SHTOJCA 18:

Kurani: Krejt çka të duhet për shpëtim

Fjalët e Kuranit flasin në 19:64, duke thënë, “Ne vijmë poshtë në përputhje me urdhrat e Zotëruesit tënd. Atij i takon e kaluara, e tashmja, dhe e ardhmja. Zotëruesi yt nuk harron.” Zoti nuk harroi, për shembull, të na tregojë si të flemë (18:109, 31:27). Prapë se prapë, trilluesit e doktrinave të pavërteta të tilla si Hadithi & Suna kanë nxjerrë mësim fetare duke iu diktuar ndjekësve të tyre si të flenë, dhe madje edhe si t’i presin thonjtë. Xhamia e Shenjtë në Mekë dhe “Xhamia e Shenjtë” ilegale e Medinës, punësojnë persona për të kërkuar vizitorët e lodhur dhe t’i rrahin ata me shkop nëse i zë gjumi në anën e gabuar!

Kurani deklaron që Kurani është i plotë, i përkryer, dhe krejtësisht i hollësishëm (6:19, 38, 114, 115; 50:45), dhe rregullat fetare që nuk gjenden në Kuran, përbëjnë një fe tjetër pos Islamit, d.m.th., pos Nënshtrimit (42:21, 17:46). Besimtarët e vërtetë i përmbahen Kuranit, tërë Kuranit, dhe asgjë përveç Kuranit. Ky parim konfirmohet me kodin matematikor të Kuranit. Strofa 46 e Sures 17 deklaron që ne duhet t’i përmbahemi VETËM Kuranit. Fjala “VETËM” ndodhet në Kuran 6 herë: 7:70, 17:46, 39:45, 40: 12 & 84, dhe 60:4. Të gjitha këto ndodhi i referohen Zotit, përveç 17:46. Kur i shtojmë numrat e sureve dhe strofave të cilat i referohen “VETËM Zotit,” marrim 361, 19x19. Kjo vërteton që 17:46 i referohet “VETËM Kuranit.”

SHTOJCA 19: *Hadithi & Suna: Shpikje dreqnore*

Cilit Hadith, pos Zotit dhe shpalljeve të Tij, i përmbahen ata? [45:6]

Kurani nuk është Hadith i shpikur; ...ai sqaron hollësisht çdo gjë. [12:111]

Disa njerëz i përmbahen Hadithit të kotë për t'i larguar të tjerët nga rruga e Zotit. [31:6]

Suna e vetme për tu ndjekur duhet të jetë Suna e Zotit. [17:77, 33:62, 48:23, 6:114]

Kurani na informon që disa armiq të Profetit, të përshkruar si “djaj njerëz dhe xhin,” do të trillojnë rrena dhe t’ia mveshin ato Profetit (6:112, 25:31). Kjo është saktësisht çka ndodhi pas vdekjes së profetit Muhamed; Hadithet (gojëdhënat) dhe Sunat (veprat) u shpikën dhe iu mveshën Profetit. Hadithi dhe Suna janë shpikje dreqnore sepse ato: [1] hedhin poshtë pohimin hyjnor që Kurani është i plotë, i përkryer, dhe krejtësisht i hollësishëm, dhe që duhet të jetë i vetmi burim i udhëzimit fetar (6:19, 38, 114 & 45:6-7), [2] blasfemojnë kundër Profetit dhe e përshkruajnë atë si tiran të egër që nuk iu përmbajt Kuranit, dhe [3] krijojnë doktrina të pavërteta të bazuara në besëtytni, padituri, dhe tradita të papërligjshme dhe të pakuptimta. Profetit Muhamed iu ndalua, me fjalë shumë të ashpra, që të japë mësimet fetare përveç Kuranit (69:38-48).

Disa Myslimanë bëjnë kompromis: “Nëse Hadithi pajtohet me Kuranin ne do e pranojmë, dhe nëse bie në kundërshtim me Kuranin, do e refuzojmë!” Një kusht i tillë vërteton që këta njerëz nuk besojnë në pohimin e Zotit që Kurani është “komplet, i përsosur, dhe krejtësisht i hollësishëm.” Në momentin kur ata kërkojnë udhëzim nga çfarëdo tjetër përveç Kuranit, pa marrë parasysh sa “e drejtë” ajo duket, ata bien në kurthin e Dreqit (shih 63:1). Se ata kanë refuzuar fjalën e Zotit dhe kanë ngritur zot tjetër përveç Zotit (18:57). Shih Shtojcën 33.

Mrekullia matematikore e Kuranit jep evidencë matematikore që Kurani duhet të jetë burimi ynë i vetëm i mësimave fetare. Këtu janë vetëm 2 shembuj:

1. “Nuk lamë asgjë jashtë këtij libri,” është në Strofën 38 (19x2) dhe përbëhet nga 19 shkronja arabe (6:38).
2. “Ai zbriti këtë libër krejtësisht të hollësishëm,” është në Strofën 114 (19x6) dhe përbëhet nga 19 shkronja arabe (6:114).

SHTOJCA 20: *Kurani: Si asnjë libër tjetër*

Kurani është Besëlidhja e Fundit e Zotit për botën, dhe Ai është zotuar ta ruajë atë edhe nga shtrembërimi më i vogël (15:9). Pra, Kurani është i rrethuar me forca të padukshme që e ruajnë atë dhe i shërbejnë atij (13:39, 41:42, 42:24).

Si asnjë libër tjetër, Kuranin na mëson Zoti (55:1-2); Ai na mëson neve çka kemi nevojë në kohën kur kemi nevojë për të. Kjo është pse e lexojmë Kuranin me qindra herë pa u mërzitur. Mund ta lexojmë një roman, për shembull, vetëm një herë. Por Kurani mund të lexohet pakufi herë, dhe të nxjerrim informata të reja të vlefshme nga ai secilën herë. Në anën tjetër, lexuesit e pasinqertë – ata që lexojnë Kuranin për të gjetur gabim në të – largohen nga Kurani (7:146, 17:45, 18:57, 41:44). Në fakt, forcat e padukshme të Zotit iu ndihmojnë atyre t’i gjejnë gabimet që i kërkojnë. Pasi që Kurani është i përsosur, “gabimet” e tilla vetëm shërbejnë për të zbuluar budallallëkun e armiqve të Zotit.

Zoti i përdorë tiparet e Veta për ta përshkruar Kuranin; Ai e quan Kuranin “Adhim = i Madh” (15:87), “Hakim = Plot mençuri” (36:2), “Mexhid = Madhështor” (50:1), dhe “Kerim = i Nderuar” (56:77). Çka mbetet të thuhet?

Pasi që Kurani është lajmi i Zotit për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh gjuhën e tyre, në Kuran kanë qasje besimtarët, pa marrë parasysh gjuhën e tyre (41:44). Kjo shpjegon fenomenin e thellë: besimtarët që nuk dinë arabisht e dinë Kuranin më mirë sesa pabesimtarët arab-folës. Për shkak të forcave të padukshme që i shërbejnë Kuranit, në të kanë qasje besimtarët me gatishmëri dhe kënaqësi, dhe nuk kanë qasje aspak mosbesimtarët (17:45, 18:57, 56:79).

SHTOJCA 21:

Dreqi: Engjell i rënë

Në mbretërinë e Zotit, krijesave të caktuara u jepen medoemos fuqitë e nevojshme për të kryer detyrat e tyre. Dreqi besoi që fuqitë e tij të dhëna nga Zoti e kualifikuan atë të funksionojë si zot i pavarur. Siç është vërtetuar nga mbizotërimi i vuajtjeve, sëmundjeve, aksidenteve, dhe luftërave në pushtetin e tij, ne tash e dimë që Dreqi nuk është i kualifikuar dhe është i pazoti.

Kurani qartazi pohon që Dreqi ishte një engjell, i krijuar me fuqi vigane dhe rang që i ishte dhuruar atij. Kjo është pse atij i drejtohet si engjell (2:34, 7:11, 15:29, 17:61, 18:50, 20:116, 38:71) para rënies së tij. Me definicion, një xhin është engjell i rënë (18:50). Kryengritja e Dreqit na mëson që engjëjt u krijuan me mendje të tyre, dhe liri absolute të zgjedhjes (2:34).

SHTOJCA 22:

Jezusi

Kurani, na informon që Jezusi ishte i dërguar njerëzor i Zotit misioni i vetëm i të cilit ishte të dorëzojë lajmin e Zotit; ai nuk posedoi asnjë fuqi, dhe tash ka vdekur (4:171, 5:75, 117). Ata që e konsiderojnë Jezusin të jetë Zot, ose të Birin e Zotit, ose pjesë të trinisë janë “pagan” (5:17, 72, 73). Studiues të Shquar të Krishterë kanë arritur në këto konkluzione të ngjashme (*MITI I ZOTIT TË MISHËRUAR*, John Hick, ed., The Westminster Press, Philadelphia, 1977 & *MIT BËRËSI*, Hyam Maccoby, Harper & Row 1986). Krishterimi është prodhim i Nicës (Konferencës në vitin 325 Pas Krishtit).

Jezusi i Biblës

Jezusi thirri dhe tha: “Kush beson në mua, nuk beson në mua, por në atë që më ka dërguar;...Sepse unë nuk kam folur nga vetja ime, por Ati që më ka dërguar më ka urdhëruar çka duhet të them e të shpall. Pasi që unë e di se urdhërimi i tij është jetë e përjetshme, gjërat, pra, që them unë, i them ashtu siç m’i ka thënë Ai.” [Gjoni 12:44-50]

“Unë s’mund të bëj asgjë nga vetja ime; gjykoj sipas asaj që dëgjoj dhe gjykimi im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar.” [Gjoni 5:30]

Jezusi tha: “Doktrina ime nuk është imja, por e atij që më ka dërguar.” [Gjoni 7:16]

“Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjalë! Jezusi Nazareas ishte njeri i dërguar nga Zoti ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja si kredenciale të tij. Këto Zoti i bëri me anë të tij në mesin tuaj, siç edhe vet e dini.” [Veprat e Apostujve 2:22]

“...Njeriu që dëgjon fjalën time dhe beson në atë që më ka dërguar ka jetë të përjetshme.” [Gjoni 5:24]

“Kushdo që më mirëpret nuk më mirëpret mua por atë që më dërgoi mua.” [Mateu 10:40, Marku 9:37, Luka 9:48, & Gjoni 13:20]

“...Unë s’kam ardhur nga vetja. U dërgova nga Ai që ka të drejtë të dërgojë, dhe ju nuk e njihni atë. Unë e njoh atë sepse është prej tij që unë vij; ai më dërgoi mua.” [Gjoni 7:28-29]

Jezusi i ngriti sytë drejt qiellit dhe tha, “...Jeta e përjetshme është kjo: të të njoh ty, të vetmin Zot të vërtetë, dhe atë që ti ke dërguar, Jezu Krishtin.” [Gjoni 17:1-3]

Të gjithë ata që udhëhiqen nga Fryma e Zotit janë bij të Zotit. [Romakëve 8:14]

Jezusi i ngriti sytë lart dhe tha, “Atë, të falënderoj që më ke dëgjuar. Unë e di mirë se ti gjithnjë më dëgjon, por i kam thënë këto për turmën që është përreth, që të besojnë se ti më ke dërguar”. [Gjoni 11:41-42]

Kur po bëhej gati për rrugë, i doli përpara dikush me vrap; u gjuhëzua para tij dhe e pyeti; “Mësues i mirë, çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetën e përjetshme?”. Jezusi iu përgjigj, “Përse më quan i mirë? Askush nuk është i mirë, përveç të vetmit Zot.” [Marku 10:17-18]

“Askush prej tyre që më quajnë ‘Zot’ nuk do të hyjë në mbretërinë e Zotit, por vetëm ai që bën vullnetin e Atit tim në qiell.” [Mateu 7:21]

“...Shko te vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre, `unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Zoti im dhe Zoti juaj.’ ” [Gjoni 20:17]

“Zoti është Zotëruesi im dhe Zotëruesi juaj; ta adhuroni vetëm Atë. Kjo është rruga e drejtë.” [Kuran 3:51, 19:36, & 43:64]

Trinia, doktrina për Zotin që mësojnë të Krishterët që shpall që Zoti është në thelb një por tre në “vetë,” Ati, Biri, dhe Shpirti i Shenjtë - as fjala Trini, as doktrina e qartë si e tillë, nuk gjenden në Besëlidhjen e Re, e as Jezusi dhe ndjekësit e tij nuk kishin për qëllim të kundërshtojnë Shema-në në Besëlidhjen e Vjetër: “Dëgjo o Izrael: Zoti Perëndia ynë është një” (Ligji i Përtërirë 6:4). [Enciklopedia Britanika, 1975]

Vdekja e Jezusit

Kjo ka qenë tema më kontroverse në botë. Kodi matematikor i mrekullueshëm i Kuranit tash ka dhënë përgjigjen përfundimtar për këtë temë:

Shpirti i Jezusit u ngrit, d.m.th., ai u vu në vdekje para arrestimit dhe kryqëzimit të trupit të tij. Pra, keqtrajtuesit e tij e arrestuan, torturuan, dhe kryqëzuan një trup të zbrazët – Jezusi veç kishte shkuar në botën e shpirtave (3:55, 4:157).

Ata thurën kurthe dhe planifikuan, por gjithashtu bëri edhe Zoti, dhe Zoti është planifikuesi më i mirë. Pra, Zoti tha, “O Jezus, Unë po të vë në vdekje, dhe po të ngris te Unë; do të të shpëtoj nga mosbesimtarët.” [Kuran 3:54-55]

Ata pretenduan që e vranë Mesinë, Jezusin, të birin e Marisë, të dërguarin e Zotit! Në fakt, ata nuk e vranë atë; nuk e kryqëzuan atë; ata u bënë të besojnë që bënë ashtu. [Kuran 4:157]

Sa mirë që Zoti i ka dhënë gjeneratës tonë një shembull të sotshëm të një personi shpirti i të cilit e la këtë botë, por trupi i tij vazhdoi të jetojnë për 19 muaj. Më 25 Nëntor, 1984, mjekët te Spitali Humana të Louisville, Kentucky hoqën zemrën e sëmurë të Z. William Schroeder-it dhe e

zëvendësuan me një pompë plastike dhe metalike (*THE NEW YORK TIMES*, e Hënë, 26 Nëntor, 1984).

Në ditën e 19 pas këtij operacioni historik – të Enjten, 13 Dhjetor, 1984 – Z. Schroeder, shpirti, personi i vërtetë, e la këtë botë. Z. Schroeder vdiq. Por trupi i tij vazhdoi të funksionojë me zemrën artificiale të futur në trupin e tij. Botës iu tha që “ai mbase pati infarkt” (*THE NEW YORK TIMES*, 14 Dhjetor, 1984). Vetëm një ditë para largimit të Z. Schroeder, ai bisedoi me Presidentin Ronald Reagan në Televizionin kombëtar [SHBA], dhe kërkoi që Administrata e Sigurimit Social t’ia dërgoj atij çekun e vonuar. Ai ishte krejtësisht vigjilent. Nga momenti “që pësoi infarkt,” ai nuk njihte ditën as kohën, as anëtarët e familjes së tij. Në fakt, Z. Schroeder nuk ishte më në këtë botë.

Ungjillët e thonë qartë që trupi i arrestuar i Jezusit ishte i pavëmendshëm për ngjarjet rreth tij:

Ndërkohë krerët e priftërinjve e akuzonin Jezusin për shumë gjëra; Pilati e morri në pyetje përsëri: “Nuk po përgjigjesh fare? Shih për sa gjëra të akuzojnë!” Por për çudi të Pilatit, Jezusi nuk u përgjigj më asgjë. [Marku 15:3-5]

Kur Herodi pa Jezusin, u gëzua shumë; prej shumë kohësh ai donte ta shihte, sepse kishte dëgjuar shumë për të dhe shpresonte të shihte ndonjë mrekulli të kryer prej tij. Ai i drejtoi shumë pyetje, por Jezusi nuk u përgjigj fare. Ndërkaq krerët e priftërinjve dhe skribët rrinin aty dhe e paditnin me furi. Atëherë Herodi, me ushtarët e vet e trajtuan me fyerje dhe tallje. [Luka 23:8-11]

Shpëtimtari më tha, “Atë që e ke parë në lis, të kënaqur dhe duke qeshur është Jezusi i gjallë. Por ky në duart dhe këmbët e të cilat ata ngulin gozhdët është pjesa trupore. [Apocalypse of Peter, VII, 3, 81] nga LIBRARIA NAG HAMMADI (Harper & Row, 1977, James M. Robinson, ed, Faqe 339).

Faktet që (1) shpirti i Z. Schroeder iku në ditën e 19 pas operimit, dhe (2) trupi i tij mbijetoi për 19 muaj, janë kujtesa të çuditshme që Zoti deshi që bota të dijë ngjashmërinë mes situatës së Schroeder, dhe dokumentacionit të vërtetuar për ikjen e Jezusit para arrestimit, torturimit, dhe kryqëzimit të trupit të tij të pa shpirt.

SHTOJCA 23:

Rendi kronologjik i shpalljes

Rendi...Surja	17...107	34...50	51...10	68...88	85...29	102...24
1....96	18...109	35...90	52...11	69...18	86...83	103...22
2....68	19...105	36...86	53...12	70...16	87...2	104...63
3....73	20...113	37...54	54...15	71...71	88...8	105...58
4....74	21...114	38...38	55...61	72...14	89...3	106...49
5.....1	22...112	39...7	56...37	73...21	90...33	107...66
6....111	23...53	40...72	57...31	74...23	91...60	108...64
7....81	24...80	41...36	58...34	75...32	92...4	109...61
8....87	25...97	42...25	59...39	76...52	93...99	110...62
9....92	26...91	43...35	60...40	77...67	94...57	111...48
10...89	27...85	44...19	61...41	78...69	95...47	112...5
11...93	28...95	45...20	62...42	79...70	96...13	113...9
12...94	29...106	46...56	63...43	80...78	97...55	114...110
13...103	30...101	47...26	64...44	81...79	98...76	
14...100	31...75	48...27	65...45	82...82	99...65	
15...108	32...104	49...28	66...46	83...84	100...98	
16...102	33...77	50...17	67...51	84...30	101...59	

SHTOJCA 24: Futja e duarve në fjalën e Zotit

Një sistem matematikor mbinjerëzor përshkon Kuranin dhe shërben për të ruajtur dhe vërtetuar çdo element në të.

Nëntëmbëdhjetë vite pas vdekjes së Profetit, disa shkrues futën dy strofa të rrejtme në fund të Sures 9, sures së fundit të shpallur në Medinë. Evidenca e paraqitur në këtë Shtojcë i heqë në mënyrë të pakundërshtueshme këto futje njerëzore, e riparon Kuranin në pastërtinë e tij origjinale, dhe ilustron një funksion madhor të kodit matematikor të Kuranit, domethënë, që ta mbrojë Kuranin edhe nga ndryshimi më i vogël. Pra, kodi i përjashton VETËM futjet e rrejtme 9:128-129.

"Padyshim, e kemi shpallur këtë shkrim, dhe padyshim, do e ruajmë." [15:9]

Kurani është Besëlidhja e Fundit e Zotit. Për këtë arsye është bërë zotimi hyjnor për ta mbajtur plotësisht të ruajtur. Për të na siguruar edhe me autorësinë hyjnore, edhe me ruajtjen e përkryer të Kuranit, autori i Plotfuqishëm e ka bërë Kuranin të hartuar matematikisht. Siç është vërtetuar me evidencën materiale në Shtojcën 1, një hartim i tillë matematikor është përtej aftësie njerëzore. Edhe dhunimi më i vogël i Besëlidhjes së Fundit të Zotit është i paracaktuar të vërehet si disharmoni që dallohet. Një ndryshim i vetëm – një sureje, një strofe, një fjale, madje edhe një shkronje – menjëherë del në shesh.

Nëntëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së Profetit Muhamed, gjatë sundimit të Khalifa Uthmanit, një komision shkruesish u caktua për të bërë disa kopje të Kuranit që të dërgohen në vendet e reja Myslimane. Kopjet kishin për tu bërë nga Kurani origjinal i cili u shkrua nga dora e Muhamedit (Shtojca 28).

Ky komision u mbikëqyr nga `Uthman Ibn `Affaan, `Ali Ibn Abi Taaleb, Zeid Ibn Thaabet, Ubayy Ibn Ka`ab, `Abdullah Ibn Al-Zubair, Sa`eed Ibn Al-`Aas, dhe `Abdul Rahman Ibn Al-Haareth Ibn Heshaaam. Profeti, natyrisht, e kishte shkruar Kuranin në rendin e tij kronologjik të shpalljes (Shtojca 23), së bashku me porositë e nevojshme për vendosjen e secilës pjesë në vendin e duhur. Surja e fundit e shpallur në Medinë ishte Surja 9. Vetëm Surja 110, sure shumë e shkurtër, u shpall pas Sures 9, në Mine.

Komisioni i shkruesve më në fund arriti te Surja 9, dhe e vuri atë në vendin e duhur. Njëri prej shkruesve propozoi që të shtoheshin dy strofa për të nderuar Profetin. Shumica e shkruesve u pajtuan. Aliu u inatos. Ai me pasion mbrojti pozitën që fjala e Zotit, e shkruar nga dora e profetit të fundit të Tij, nuk duhet kurrë të ndryshohet.

Kundërshtimi i Aliut dokumentohet në shumë citime, por unë citoj dhe riprodhoj këtu citimin klasik *AL ITQAAN FEE 'ULUM AL QURAN* nga Jalaluddin Al-Suyuty, Al-Azhareyyah Press, Kairo, Egjipt, 1318 Pas Hixhrës, Faqe 59 [shih Shtesën 1].

قَدَعَىٰ بِنَ أَبِي مَالِبٍ فِي بَيْتِهِ فَقِيلَ مَا أَتَعْلَمُ قَالَ رَأَيْتُ كِتَابَ اللَّهِ يَزَادُنِيهِ
فَخَذْتُ نَفْعِي أَنْ لَا أَلْبِسَ رِدَائِي إِلَّا الصَّلَاةَ حَتَّىٰ أَجْعُمَهُ

Përkthim: Aliun e pyetën: "Pse po rri në shtëpi?" Ai tha, "Diçka i është shtuar Kuranit, dhe unë jam zotuar të mos i vesh më rrobat e rrugës, përveç për lutje, derisa të riparohet Kurani." [Shtesa 1]

Dimensionet tronditëse të këtij krimi mund të përfytyrohen nëse i shikojmë pasojat:


- (1) `Uthmanin e vranë, dhe Aliu u caktua si Khalifa i katërt.
- (2) Një luftë 50 vjeçare shpërtheu ndërmjet Khalifas së ri dhe përkrahësve të tij në njërën anë, dhe shtrembëruesve Muhamedan të Kuranit në anën tjetër.
- (3) Aliu ra dëshmor, dhe përfundimisht edhe familja e tij, familja e profetit Muhamed, përveç disa grave dhe fëmijëve, u vranë.
- (4) Zënka arriti kulmin në Betejën Famëkeqe të Qerbelasë, ku djali i Aliut, Hyseni, dhe familja e tij u masakruan.
- (5) Myslimanëve iu mor Kurani i pastër i pandryshuar, për 1400 vjet.

Shtrembëruesit e Kuranit më në fund e fituan luftën, dhe historia “zyrtare” që arriti te ne paraqet pikëvështrimin e fituesve. Kjo fitore-(në shikim të jashtëm) për armiqtë e Zotit ishte, natyrisht, në përputhje me vullnetin e Zotit. Për vetëm dy dekada pas vdekjes së Profetit, adhuresit e idhujve që u mposhtën nga Profeti në pushtimin e Mekës (632 Pas Krishtit) u rikthyen në idhujtari. Për ironi, kësaj radhe idhulli i tyre ishte vetë Profeti. Adhuresit e tillë të idhujve natyrisht nuk merituan ta kenë Kuranin e pastër. Për këtë arsye ndodhi rënia e bekuar e dëshmorëve si besimtarë të vërtetë që u përpoqën ta riparonin Kuranin, dhe fitorja-(në shikim të jashtëm) për shtrembëruesit e fjalës së Zotit.

Sunduesi i parë gjatë kohës së paqes pas kësaj lufte të gjatë dhe shkatërrimtare ishte Marvan Ibn Al Hakam (vdiq 65 Pas Hixhrës/684 Pas Krishtit). Njëra prej detyrave të para që ekzekutoi ai ishte shkatërrimi i Kuranit origjinal, i atij që ishte shkruar aq me përpikëri nga vetë dora e Profetit, “duke u frikësuar që mund të bëhet shkak i grindjeve TË REJA” [shih `ULUM AL-QURAN, nga Ahmad von Denffer, Islamic Foundation, Leicester, Mbretëria e Bashkuar, 1983, Faqe 56.]. Pyetjen që një person inteligjent duhet ta pyes është: “Sikur Kurani origjinal të ishte identik me Kuranin në qarkullim në atë kohë, pse Marwan Ibn Al-Hakam u desh ta shkatërroj?!”

Me shqyrtimin e citimeve më të vjetra Islamike, e kuptojmë që futjet e rrejshe, 9:128-129, ishin gjithmonë të dyshimta. Për shembull, lexojmë në Hadithin e famshëm të Bukharit, dhe Itkanin e famshëm të Al-Sujutjit, që secila strofë në Kuran u verifikua nga më shumë se një dëshmitar “me përjashtim të Strofave 128 dhe 129 të Sures 9; ato u gjetën vetëm me Khuzeimah Ibn Thaabet Al-Ansari.” Kur disa njerëz e vunë në dyshim këtë përjashtim të pavend, dikush doli me një Hadith që thotë që “dëshmia e Khuzeimas është e barabartë me dëshminë e dy njerëzve!!!” (shih çfarë gjendet te Hadithi *Bukhari* për këtë. Vëllimi 6, Libri 61, Numër 511)

Për çudi, futjet e rrejshe 9:128-129 klasifikohen në botimet tradicionale të Kuranit si “Mekase” [shih Shtesën 2].



Paraqitja e titullit të Sures 9 nga Kurani standard, që tregon që kjo sure është Medinase, “me përjashtim të dy strofave të fundit; ato janë Mekase”!!! [Shtesa 2]

Si mund këto strofa Mekase të gjenden me Khuzeiman, një Mysliman ‘Medinas’ i vonshëm?! Si ka mundur një sure Medinase të ketë strofa Mekase, kur tradita e gjithanshme ka qenë që të emërohen si ‘Medinase’ të gjitha shpalljet pas Hixhrës së Profetit nga Meka??!! Përkundër këtyre mospërputhjeve, plus edhe shumë kundërthëniet e tjera të dukshme të ndërlidhura me Strofat 9:128-129, askush nuk guxoi që ta vë në dyshim autorësinë e tyre. Zbulimi i kodit matematikor të

Kuranit në vitin 1974, megjithatë na futi në një epokë të re ku autorësia e secilit element në Kuran vërtetohet (Shtojca 1).

Siç del, futja e dy Strofave të rrejtshme, 9:128-129, rezultoi në:

- (1) demonstrimin e funksionit madhor të sistemit matematikor të Kuranit, dhe
 - (2) prodhimin e një mrekullie mbresëlënëse edhe si e veçuar nga të tjerat, dhe
 - (3) dallimin e besimtarëve të vërtetë nga hipokritët (që iu përmbahen traditave).
- Përkthimi i dy strofave të rrejtshme tregohet në Shtesën 3:

"Një i dërguar ka ardhur te ju nga mes jush që nuk dëshiron vështirësitë të ju pllakosin juve, dhe kujdeset për ju, dhe është i butë ndaj besimtarëve, i mëshirshëm. Nëse ata kthehen prapa, atëherë thuaj, "Për mua mjafton Zoti, nuk ka zot përveç Atij. Unë kam besim në Atë. Ai është Zotëruesi me fronin e madh." [Shtesa 3]

PROVA MATERIALE

[1] Shkelja e parë e kodit të Kuranit nga Strofat 9:128-129 u shfaq kur numërimi i fjalës "Zot" (Allah) në Kuran u gjet të jetë 2699, që nuk është shumëfish i 19-tës, po të mos e heqim një.

Numërimi i fjalës "Zot" tregohet në fund të secilës faqe në këtë përkthim. Totali i paraqitur në fund të Kuranit është 2698, 19x142, sepse futjet e rrejtshme 9:128-129 janë hequr.

[2] Shuma e të gjithë numrave të strofave ku fjala "Zot" ndodhë është 118123, ose 19x6217. Ky total arrihet duke i mbledhur numrat e strofave kudo që fjala "Zot" gjendet. Nëse Strofa e rrejtshme 9:129 përfshihet, ky fenomen zhduket.

[3] Siç paraqitet në fund të Sures 9 në këtë përkthim, ndodhja totale e fjalës "Zot" në

fund të Sures 9 është 1273, 19x67. Nëse futja e rrejtshme 9:128-129 përfshihet, totali do të bëhej 1274, që nuk është shumëfish i 19-tës.

[4] Ndodhja e fjalës "Zot" nga iniciali i parë Kuranor ("A.L.M." i sures 2:1) deri te iniciali i fundit ("N." i 68:1) jep shumën 2641, ose 19x139. Pasi që është më lehtë të shfaqen në listë suret jashtë pjesës të inicializuar të Kuranit, Tabela 1 tregon të 57 ndodhjet e fjalës "Zot" në atë pjesë. Me zbritjen e numrit 57 nga ndodhja totale e fjalës "Zot" marrim $2698 - 57 = 2641 = 19 \times 139$, nga iniciali i parë deri te iniciali i fundit. Nëse futjet njerëzore 9:128 dhe 129 përfshihen, numërimi i fjalës "Zot" në pjesën e inicializuar do të bëhej 2642,

[5] Surja 9 është sure pa iniciale dhe nëse i shikojmë 85 suret e pa inicializuara, gjejmë që fjala "Zot" ndodhë në 57 nga këto sure, 19x3. Numri total i strofave në ato sure ku fjala "Zot" gjendet është 1045, 19x55. Nëse 9:128-129 do të përfshiheshin, strofat që përmbajnë fjalën "Zot" do rriteshin për 1.

Tabela 1: Ndodhja e fjalës "Zot" jashtë seksionit të inicializuar

Nr. i sures	Nr. i fjalës "Zot"	Nr. i sures	Nr. i fjalës "Zot"
1	2	84	1
69	1	85	3
70	1	87	1
71	7	88	1
72	10	91	2
73	7	95	1
74	3	96	1
76	5	98	3
79	1	104	1
81	1	110	2
82	1	112	2
			57
			19x3

[6] Fjala “Zot” nga Bismilahu që mungon (Surja 9) deri te Bismilahu shtesë (Surja 27) ndodhet në 513 strofa, 19x27, përbrenda 19 sureve (Tabela 2). Nëse Strofat e rrejshe 9:128-129 përfshihen, numri i strofave që përmbajnë fjalën “Zot” do të bëhej 514, dhe ky fenomen do të ishte zhdukur.

[7] Fjala “llah” që do të thotë “zot” ndodhet në Strofat 9:129. Ndodhja totale e kësaj fjale në Kuran është 95, 19x5. Përfshirja e 9:128-129 e bën këtë fjalë të rritet për një, pra 96.

[8] INDEKSI PËR FJALËT E KURANIT, tregon 116 fjalë “Resul” (i dërguar). Njëra prej këtyre fjalëve është në 9:128. Duke e hequr këtë strofë të rrejshe, 115 fjalë “Rasul” mbesin. Një tjetër fjalë “Rasul” që duhet të përjashtohet nga numërimi është në 12:50, pasi që ajo i referohet “të dërguarit të Faraonit” e jo të dërguarit të Zotit. Pra, ndodhja totale e “Rasul”-ve të Zotit është 114, 19x6.

[9] Një fjalë tjetër e rëndësishme që ndodhet në Strofat e rrejshe 9:128-129 është fjala “Rrahim” (i Mëshirshëm). Kjo fjalë përdoret në Kuran në veçanti si emër i Zotit, dhe numri total i saj është 114, 19x6, pas heqjes së fjalës “Rrahim” nga 9:128, e cila i referohet profetit. Sipas 7:188, 10:49, dhe 72:21 Profeti nuk kishte aspak fuqi mëshire.

[10] INDEKSI tregon 22 ndodhje të fjalës “Arsh” (Fron). Pas heqjes së futjes së rrejshe 9:129, dhe “Arshit” të Jozefit që ndodhet në 12:100, dhe “Arshit” të Mbretëreshës Sheba (27:23), përfundojmë me 19 fjalë “Arsh”. Kjo vërtetohet që fjala “Arsh” e 9:129 nuk përket në Kuran.

[11] Urdhri Kuranor “Kul” (Thuaj) ndodhet në Kuran 332 herë. Gjithashtu, fjala “Kalu” (Thanë) ndodhet po aq herë, 332. Pasi që Strofa e rrejshe 9:129 përmban fjalën “Kul” (Thuaj), përfshirja e saj do e shkatërronte këtë fenomen tipik Kuranor.

[12] Kurani përmban 6234 strofa me numra dhe 112 strofa pa numra (Bismilahe). Pra, numri total i strofave në Kuran është 6346, 19x334. Strofat e rrejshe 9:128-129 e shkelin këtë kriter të rëndësishëm të kodit të Kuranit.

[13] Aq më shumë, përveç shkeljes së numrave të fjalëve siç tregohen më lartë, 9:128-129 shkelin strukturën matematikore të Kuranit. Kur i mbledhim numrat e strofave në secilën sure, plus shumën e numrave të strofave (1+2+3+... +n, ku n=numri i strofave), plus numri i secilës sure, totali i akumuluar për tërë Kurantin del 346199, ose 19x19x959. Ky fenomen konfirmon autencitetin e secilës strofë në Kuran, përderisa përjashton 9:128-129. Tabela 3 është ilustrim i shkurtuar i Artikullit 13. Ky fenomen është i pamundur nëse Strofat e rrejshe 9:128-129 përfshihen.

Tabela 2: Fjala “Zot” nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë.

Nr.	Nr. i sures	Nr. i strofave me “Zot”
1	9	100
2	10	49
3	11	33
4	12	34
5	13	23
6	14	28
7	15	2
8	16	64
9	17	10
10	18	14
11	19	8
12	20	6
13	21	5
14	22	50
15	23	12
16	24	50
17	25	6
18	26	13
19	27	6
----	----	----
19	342	513
Nr. i sureve = 19		
Totali i numrave të sureve = 342 = 19x18		
Totali i strofave = 513 = 19 x 27		

[14] Kur i bëjmë njehsimet e njëjta si në Artikullin 13 më lartë, por vetëm për 85 suret pa iniciale, të cilat përfshijnë Suren 9, totali i akumuluar është gjithashtu shumëfish i 19-tës. Totali i akumuluar për të gjitha suret pa iniciale është 156066, ose 19×8214 . Ky rezultat varet nga fakti që Surja 9 përbëhet nga 127 strofa, e jo 129. Të dhënat paraqiten në Tabelën 4. Strofat e rrejshme do e kishin shkatërruar këtë kriter.

[15] Duke i mbledhur numrat e sureve të të gjitha sureve pa iniciale (85 sure), plus numrin e strofave të tyre, nga fillimi i Kuranit deri te fundi i Sures 9 marrim

Tabela 4: Kodimi matematikor i 85 sureve pa iniciale të Kuranit.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
1	7	28	36
4	176	15576	15756
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
114	6	21	141
			156066
			$= (19 \times 8214)$

Tabela 5: Suret pa iniciale dhe strofat e tyre nga fillimi deri te Surja 9

Surja	Nr. i strofave	Totali
1	7	8
4	176	180
5	120	125
6	165	171
8	75	83
9	127	136
		703 (19x37)

Tabela 6: Suret pa iniciale & strofat e tyre nga Bismilahu që mungon (Surja 9) deri te fundi i Kuranit

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr. të strofave	Totali
9	127	8128	8264
16	128	8256	8400
-	-	-	-
113	5	15	133
114	6	21	141
			116090
			(19×6110)

Tabela 3: Kodimi matematikor i sureve & strofave të Kuranit, i bazuar në "19"

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
1	7	28	36
2	286	41041	41329
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
114	6	21	141
----	----	----	----
6555	6234	333410	346199
			$(19 \times 19 \times 959)$

Të dhënat e hollësishme paraqiten në Tabelën 5. Ky fenomen varet nga fakti që Surja 9 përbëhet nga 127 strofa.

[16] Duke mbledhur numrin e sures të sureve pa iniciale, plus numrin e strofave, plus shumë të numrave të strofave nga Bismilahu që mungon (9:1) deri në fund të Kuranit, shuma totale del 116090, ose 19×6110 . Këto të dhëna janë në Tabelën 6. Nëse Strofat 9:128-129 përfshihen, numri i strofave për Suren 9 bëhet 129, dhe shuma totale bëhet 116349, që nuk është shumëfish i 19-tës.

[17] Kur të njëjtat njehsime të Artikullit 16 bëhen për të gjitha strofat nga Bismilahu që mungon i Sures 9 deri te Bismilahu shtesë i Sures 27, shuma totale del 119966, ose 19×6314 . Ky fenomen do të shkatërrohej, dhe totali nuk do të ishte i plotpjesëtueshëm me 19, nëse numri i strofave në Suren 9 do të ishte 129. Pasi që ky fenomen është gjithashtu i ndërlidhur me mungesën e Bismilahut nga Surja 9, ai shpjegohet dhe të dhënat e hollësishme jepen në formë tabelare në Shtojcën 29.

[18] Kur të njëjtat njehsime të Artikullit 16 dhe 17 bëhen nga Bismilahu që mungon (9:1) deri te strofa ku numri 19 përmendet (74:30), gjejmë që shuma totale del 207670, ose 19×10930 (Tabela 7). Surja 9 duhet të përbëhet nga 127 strofa.

Tabela 7: Suret dhe strofat nga Bismilahu që mungon deri te 74:30.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e numrave të strofave	Totali
9	127	8128	8264
10	109	5995	6114
-	-	-	-
73	20	210	303
74	30	465	569
			207670
2739	4288	200643	(19x10930)

Tabela 8: Strofat shifrat e të cilave japin shumën 10 nga 9:1 deri te 27:29.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Sa prej tyre japin shumën 10	Nr. i totalit
9	127	12	148
10	109	10	129
11	123	11	145
12	111	10	133
13	43	3	59
14	52	4	70
15	99	9	123
16	128	12	156
17	111	10	138
18	110	10	138
19	98	9	126
20	135	12	167
21	112	10	143
22	78	7	107
23	118	11	152
24	64	6	94
25	77	7	109
6	227	22	275
27	29	2	58
--	---	---	-----
342	1951	177	2470

342 = 19x18 & 2470 = 19x130

Tabela 9: Të gjitha suret numri i strofave të të cilave përfundon me "9."

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
10	109	5995	6114
15	99	4950	5064
29	69	2415	2513
43	89	4005	4137
44	59	1770	1873
48	29	435	512
52	49	1225	1326
57	29	435	521
81	29	435	545
82	19	190	291
87	19	190	296
96	19	190	305
104	9	45	158
			23655
748	627	22280	(19x1245)

[19] Surja 9 përbëhet nga 127 strofa. Shifrat e numrit 127 japin shumën $1+2+7=10$. Le t'i shikojmë të gjithë strofat ku shifrat japin shumën 10, nga Bismilahu që mungon në Suren 9, deri te Bismilahu shtesë i Sures 27. Po të kishte Surja 9 129 strofa, shuma totale do të ishte 2472, në vend të 2470 (19×130); 2472 nuk është shumëfish i 19-tës, dhe ky fenomen do të ishte zhdukur. Të dhënat janë në Tabelën 8.

[20] Falsifikuesit dëshiruan që ne të besonim që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa. Numri 129 përfundon me shifrën "9." Le të shikojmë suren e parë dhe suren e fundit numri i strofave të të cilës përfundon me shifrën "9." Këto janë Surja 10 dhe Surja 104. Duke mbledhur numrin e sures, plus numrin e strofave, plus shumën e numrave të strofave, nga Surja 10 deri te Surja 104, marrim shumën totale që është e barabartë me 23655, ose 19×1245 . Hollësitat paraqiten në Tabelën 9.

Përfshirja e Sures 9 me numrin e gabuar të strofave, 129, do të ndryshonte edhe shumën e numrave të strofave edhe totalin e akumuluar – shuma e numrave të strofave do të kishte qenë $627+129=756$, dhe totali i akumuluar nuk do të ishte 23655 – dhe kodi i Kuranit do të ishte shkelur (Tabela 9).

[21] Futjet e rrejtshme përbëheshin nga Strofkat 128 dhe 129 në fund të Sures 9. Nëse i shikojmë numrat 128 dhe 129, shohim dy 1-sha, dy 2-sha dhe një 8-she, dhe një 9-she.

Tash le t'i shikojmë të gjitha strofat në Kuran, dhe t'i numërojmë të gjithë 1-shat që i shohim. Kjo do të thotë 1-shat i shohim në strofat 1, 10, 11, 12, 13... 21, 31, dhe kështu me radhë.

Numri total i 1-shave është 2546 (19x134), nëse e përdorim numrin e saktë të sureve në Suren 9, 127-shin. Nëse përfshihen 128-shi dhe 129-shi, shuma totale bëhet 2548, gjë që nuk është shumëfish i 19-tës (Tabela 11).

[22] Pasi që Surja 9 është sure pa initiale, le t'i shikojmë të gjithë numrat e strofave në 85 suret pa initiale dhe t'i numërojmë të gjithë 1-shat që shohim.

Siç paraqitet në Tabelën 10, numri total i shifrës "1" në suret pa initiale është 1406, ose 19x74. Siç shihet, nëse Surja 9 do të përbëhej nga 129 strofa, ne do i shihnim 1-shat shtesë nga 128-shi dhe 129-shi, dhe kodi do të prishej.

Tabela 10: Numërimi i të gjithë 1-shave në 85 suret pa initiale.

Surja	Nr. i strofës	Nr. i 1-shave
1	7	1
4	176	115
-	-	-
9	127	61
-	-	-
113	5	1
114	6	1

		1406
		(19x74)

[23] Duke e ndjekur të njëjtin proces të shpjeguar në Artikullin 22 dhe 23 për shifrën "1," le t'i numërojmë të gjithë 2-shat, 8-at dhe 9-at në të gjithë numrat e strofave të tërë Kuranit. Siç paraqitet në Tabelën 11, numri total i të gjithë 2-shave, 8-ve, dhe 9-ve është 3382, ose 19x178. Kjo e bën shumën totale të të gjitha 1-ve, 2-ve, 8-ve, dhe 9-ve 2546+3382 = 5928, 19x312.

Tabela 11: Numërimi i shifrave që formojnë 128-shin dhe 129-shin në tërë Kuranin.

Surja	Nr. i 1-shave	Nr i 2-shave	Nr i 8-ve	Nr. i 9-ve	Totali
1	1	1	0	0	2
2	159	146	55	48	408
-	-	-	-	-	-
9	61	31	22	22	136
10	31	21	21	21	94
-	-	-	-	-	-
114	1	1	0	0	2
	----	----	----	----	----
	2546	1641	908	833	5928
	(19 x 134)				(19 x 312)

Në këtë fenomen të shquar, e morëm parasysh çdo strofë në Kuran, dhe shqyrtuam shifrat individuale që formojnë Strofkat 128 dhe 129. Pasi që 128-shi dhe 129-shi përmbajnë 6 shifra, përfshirja e këtyre futjeve njerëzore e bën numrin total të këtyre shifrave në tërë Kuranin të jetë 5928+6 = 5934, jo shumëfish i 19-tës.

[24] Numri total i të gjitha shifrave (1 deri në 9) në të gjithë numrat e strofave të 85 sureve pa initiale, duke përfshirë Suren 9 me 127 strofa, është 27075, ose 19x19x75.

[25] Mbledhja e shifrave të sureve dhe strofave të Kuranit jep shumëfish të 19-tës, me kusht që numri i saktë i strofave për Suren 9, 127, të merret. Për ta bërë këtë, bëhet lista e 114 sureve të Kuranit dhe numri i strofave në secilën sure. Mbledhni shifrat e numrit të secilës sure. Shuma e shifrave të 10=1, 11=2, 12=3, 99=18, dhe kështu me radhë. Totali për të

Tabela 12: Shuma e shifrave të të gjitha sureve & numrave të strofave në tërë Kuranin.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e sureve	Shifrat e strofave
1	7	1	7
2	286	2	16
3	200	3	2
-	-	-	-
9	127	9	10
-	-	-	-
114	6	6	6
		---	---
		975	906
		975+906 = 1881 = 19x99	

gjithë suret është 975. E njëjta gjë bëhet për numrat e strofave në secilën sure. Për shembull, Surja 2 përbëhet nga 286 strofave. Shifrat e 286-shit japin $2+8+6=16$. Për Suren 9, shifrat e numrit të strofave të saj japin $1+2+7=10$. Totali për të gjithë 114 suret është 906. Pra, shuma totale për shumën e shifrave të të gjithë sureve dhe strofave është $975+906 = 1881 = 19 \times 99$. Natyrisht, ky vrojtim nuk do të ishte i mundur sikur Surja 9 të kishte 129 strofa. Tabela 12 është shkurtuar për të ilustruar njehsimet.

[26] Nëse njehsojmë shumën e shifrave për secilën sure në Kuran, dhe e shumëzojmë shumën për secilën sure me shumën e shifrave të numrit të strofave të saj, në vend që t'i mbledhim, prapë se prapë përfundojmë me shumë totale që është shumëfish i 19-tës. Për shembull, Surja 2 ka 286 strofa. Shuma e shifrave të $2+8+6=16$. Pra nëse e shumëzoni 2-shin me 16, dhe merr 32, në vend që t'i mbledhni $2+16$ siç bëmë në Artikullin 26. Kjo është bërë për secilën sure në Kuran. Shuma totale për të gjitha suret është 7771, ose 19×409 . Edhe një herë, secila strofë në Kuran konfirmohet, përdërisa strofat e rrejtshme përjashtohen krejtësisht. Shih Tabelën 13.

Tabela 13: Shumëzimi i shumës së shifrave të sureve dhe strofave të Kuranit.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e shifrave të			Prodhimi
		sureve		strofave	
1	7	1	x	7	= 7
2	286	2	x	16	= 32
3	200	3	x	2	= 6
-	-	-	-	-	-
9	127	9	x	10	= 90
-	-	-	-	-	-
114	6	6	x	6	= 36
		-----		-----	
		975		906	7771 (19x409)

[27] Një tjetër fenomen vërtetë mbresëlënës: Surja 9 është sure me numër tek, dhe nëse i bëjmë njehsimet e përshkruara më lart vetëm për suret tek, gjejmë që totali për suret është 513 (19×27), totali për strofat është 437 (19×23), dhe shuma totale për të dyja është $513+437 = 950$ (19×50).

Tabela 14 ilustron këtë fenomen të shquar.

Tabela 14: Të njëjtat të dhëna si në Tabelën 12, por vetëm për suret tek.

Nr. i sures.	Nr. i strofave	Shuma e sureve	Shifrat e strofave	Totali
1	7	1	7	8
3	200	3	2	5
-	-	-	-	-
9	127	9	10	19
-	-	-	-	-
113	5	5	5	10
		---	---	---
		513	437	950
		(19x27)	(19x23)	(19x50)

[28] Le t'i marrim të gjitha suret që përbëhen nga 127 strofa ose më pak. Janë 105 sure të tilla. Shuma e numrave të sureve për këto 105 sure, plus shuma e numrave të strofave të tyre është 10963, ose 19×577 . Surja 9 është surja e vetme që ka 127 strofa. Shih Tabelën 15.

Sikur surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, nuk do të përfshihej në këtë listë të sureve, totali do të ishte 10827 ($10963-136$), ky fenomen do të ishte zhdukur, dhe kodi i Kuranit do të ishte shkelur.

[29] Pasi që Surja 9 është tek, dhe numri i strofave të saj është gjithashtu tek, le të shikojmë te të

Tabela 15: Kodimi matematikor i të gjitha sureve që përbëhen nga 127 strofa ose më pak.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
1	7	8
5	120	125
8	75	83
9	127	136
-	-	-
113	5	118
114	6	120
---	---	---
		10963
6434	4529	(19x577)

gjithë suret me numër tek numri i strofave të të cilës është gjithashtu tek. Kjo na jep 27 sure: 1, 9, 11, 13, 15, 17, 25, 27, 29, 33, 35, 39, 43, 45, 57, 63, 81, 87, 91, 93, 97, 101, 103, 105, 107, 111, dhe 113. Ato përbëhen nga 7, 127, 123, 43, 99, 111, 77, 93, 69, 73, 45, 75, 89, 37, 29, 11, 29, 19, 15, 11, 5, 11, 3, 5, 7, 5, dhe 5 strofa, përkatësisht. Shuma e numrave të këtyre sureve, plus shuma e numrave të tyre të strofave është 2774, 19×146 . Nëse e marrim numrin jo të saktë të strofave nga Surja 9, d.m.th. 129, kjo mrekulli zhduket.

[30] Numri i saktë i strofave në Suren 9 është 127, dhe ky është numër i thjeshtë (prim) – nuk është i plotpjesëtueshëm me asnjë numër përveç me 1-shin, dhe veten.

Le t'i shikojmë të gjitha suret numri i strofave të të cilave është numër i thjeshtë. Këto janë Suret 1, 9, 13, 33, 43, 45, 57, 63, 81, 87, 93, 97, 101, 103, 105, 107, 111, dhe 113. Numrat e strofave në këto sure janë 7, 127, 43, 73, 89, 37, 29, 11, 29, 19, 11, 5, 11, 3, 5, 7, 5, dhe 5, përkatësisht. Nëse i mbledhim shifrat e këtyre sureve, atëherë del 137, përderisa shifrat e strofave japin shumën 129. Kjo e bën shumën totale të të gjithë shifrave $137 + 129 = 266 = 19 \times 14$.

[31] Shtrembëruesit shtuan dy strofa të rrejshme në Suren 9, dhe kjo bëri që surja të ketë 129 strofa. Pasi që 129-shi përbëhet nga 3 shifra, dhe është i plotpjesëtueshëm me 3, le t'i shikojmë suret numri i strofave të të cilave është i plotpjesëtueshëm me 3, dhe përbëhet nga 3 shifra. Totali i këtyre sureve është 71, dhe numri total i strofave është 765. Kjo jep shumën totale $71 + 765 = 836$, ose 19×44 . Të dhënat paraqiten në Tabelën 16.

Sikur Surja 9 të kishte 129 strofa, do të ishte përfshirë në këtë tabelë, dhe do të kishte shkatërruar këtë fenomen.

[32] Sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, siç dëshirojnë falsifikuesit që të besojmë, atëherë le t'i shikojmë të gjitha suret të cilat përbëhen nga 129 strofa ose më shumë. Ekzistojnë 8 sure të tilla. Të dhënat e tyre janë të paraqitura në Tabelën 17.

Sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, numri total i strofave do të kishte qenë $1577 + 129 = 1706$, jo shumëfish i 19-tës.

[33] Numrat 127, 128, dhe 129 kanë dy shifra të përbashkëta, "1" dhe "2." Le t'i marrim parasysh të gjitha suret numri i strofave të të cilave përmban shifrat 1 dhe 2. Duke i mbledhur numrat e sureve plus numrat e strofave, marrim 1159, 19×61 . Shih Tabelën 18. Nëse Surja 9 përbëhet nga 129 strofa, totali do të ishte bërë $1159 + 2 = 1161$, jo shumëfish i 19-tës.

[34] Surja 9 është sure njëshifrore numri i strofave të të cilës përmban shifrat 1 dhe 2. Është vetëm një sure tjetër që posedon këto veti: Surja 5 është sure njëshifrore, dhe

përbëhet nga 120 strofa. Siç paraqitet në Tabelën 19, numri i strofave në këto dy sure është $120 + 127 = 247 = 19 \times 13$.

Tabela 16: Të gjitha suret numri i strofave të të cilave është 3 shifror, dhe është i plotpjesëtueshëm me 3

Surja	Nr. i strofave	Totali
5	120	125
6	165	171
11	123	134
12	111	123
17	111	128
20	135	155
---	---	---
		836
71	765	(19×44)

Tabela 17: Të gjitha suret që përbëhen nga 129 strofa ose më shumë.

Nr. i sures	Nr. i strofave
2	286
3	200
4	176
6	165
7	206
20	135
26	227
37	182

	1577
	(19×83)

Tabela 18: Suret strofat e fundit të të cilave kanë numrat "1" dhe "2" të përbashkët me strofat në fjalë (127, 128, dhe 129).

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
5	120	125
9	127	136
11	123	134
16	128	144
21	112	133
37	182	219
65	12	77
66	12	78
92	21	113
---	---	---
322	837	1159 (19x61)

Tabela 19: E vetmja sure numri i të cilës është njëshifror, dhe numri i strofave përmban numrat "1" dhe "2."

Nr. i sures	Nr. i strofave
5	120
9	127

	247 (19x13)

kualitet: Suret 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 16, 17, 18, 20, 21, 23, 37, 49, 60,61, 62, 63, 64, 65, 66, 82, 86, 87, 91, 93, 96, 100, dhe 101.

Numrat e strofave të tyre janë 176, 120, 165, 127, 109, 123, 111, 128, 111, 110, 135, 112, 118, 182, 18, 13, 14, 11, 11, 18, 12, 12, 19, 17, 19, 15, 11, 19, 11, dhe 11. Shuma e numrave të strofave $(1+2+3+...+n)$ për këto 30 sure është 126122, ose 19×6638 .

Sikur Surja 9 të kishte 129 strofa, shuma e numrave të strofave të tyre do të kishte qenë $126122 + 128 + 129 = 126379$, dhe ky total nuk është shumëfish i 19-tës.

[36] Surja 9 përbëhet nga 127 strofa, dhe $9+1+2+7$ është e barabartë me 19. Le t'i shikojmë të gjitha suret shifrat e sures dhe strofave të të cilave japin shumën 19. Janë 10 sure që përmbushin këtë karakteristikë, dhe totali i numrave të sureve dhe numrave të strofave të tyre është 1216, ose 19×64 . Të dhënat paraqiten në Tabelën 20.

Z. Gatut Adisoma nga Xhamia Tucson bëri dy zbulimet në vijim.

[37] Surja 9 përbëhet nga 127 strofa, dhe (9) plus $(1+2+7)$ japin shumën 19. Ekzistojnë tre sure tjera në tërë Kuranin shifrat e sureve të të cilave japin shumën 9 dhe shifrat e numrit të strofave japin shumën 10. Këto janë suret 9, 45, 54, dhe 72. Ato përbëhen nga 127, 37, 55, dhe 28 strofa, përkatësisht. Numri total i strofave në këto tre sure është 247, 19×13 .

Nëse Surja 9 do të përbëhej nga 129 strofa, totali do të ishte $247+2 = 249$, jo shumëfish i 19-tës.

Tabela 20: Të gjitha suret ku shifrat e numrit të sures dhe numri i strofave japin shumën 19.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
9	127	136
22	78	100
26	227	253
45	37	82
54	55	109
64	18	82
72	28	100
77	50	127
78	40	118
84	25	109
---	---	---
		1216
531	685	(19x64)

[35] I shikuar të gjitha suret numri i strofave të të cilave përmban "1" dhe "2." Le t'i shikojmë të gjitha suret numri i strofave të të cilave fillon me shifrën "1." Ekzistojnë 30 sure që posedojnë këtë

Tabela 21: Të gjithë suret ku shifrat e numrit të sures japin shumën 9 dhe shifrat e numrit të strofave japin shumën 10

Nr. i sures	Nr. i strofave
9	127
45	37
54	55
72	28

	247 (19x13)

Nëse Surja 9 përbëhet nga 129 strofa, nuk do të përfshihej në këtë tabelë pikë së pari. Shih Tabelën 21.

[38] Nëse Surja 9 përbëhet nga 129 strofa siç pretenduan shtrembëruesit, atëherë ekziston vetëm një sure tjetër në tërë Kuranin shifrat e sures të të cilës japin shumën 9, dhe shifrat e numrit të strofave japin shumën 12, d.m.th. Surja 27.

Siç paraqitet në Tabelën 22, ky kombinim, me 129 strofa për Suren 9, nuk përputhet me kodin e Kuranit.

[39] Le të supozojmë për pak kohë që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa. Pasi që numri 129 përfundon me shifrën "9," le t'i shikojmë të gjitha suret ku numri i strofave përfundon me shifrën "9."

Tabela 23: Të gjitha suret numri i strofave të të cilave përfundon me numrin "9."

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e numrave të strofave	Totali
10	109	5995	6114
15	99	4950	5064
29	69	2415	2513
43	89	4005	4137
44	59	1770	1873
48	29	435	512
52	49	1225	1326
57	29	435	521
81	29	435	545
82	19	190	291
87	19	190	296
96	19	190	305
104	9	45	158
---	---	---	---
748	627	22280	23655
(19x33)			(19x1245)

[40] Surja 9 është sure me numër tek numri i strofave të të cilës përfundon me shifrën "9." Le t'i shikojmë të gjithë suret me numër tek numri i strofave të të cilës përfundon me "9." Siç paraqitet në Tabelën 24, totali i numrit të sures dhe numrit të strofave në këto sure është 646, ose 19×34 . Sikur Surja 9 të kishte 129 strofa, do të ishte përfshirë në këtë grup, dhe totali do të kishte qenë $646 + 129 + 9 = 784$, gjë që nuk është shumëfish i 19-tës.

[41] Deri më tani, është vërtetuar pakundërshtueshëm që Surja 9 përbëhet nga 127 strofa. Le t'i shikojmë suret numri i strofave të të cilave përfundon me "7."

Ekzistojnë 7 sure të tilla; ato janë Suret 1, 9, 25, 26, 45, 86, dhe 107. Numrat e strofave të tyre janë 7, 127, 77, 227, 37, 17, dhe 7 strofa, përkatësisht. Shuma totale e numrave të sureve plus numri i strofave për këto shtatë sure është 798, 19×42 . Hollësisht janë të paraqitura në Tabelën 25. Pra, secila sure numri i strofave të të cilës përfundon me shifrën "7," duke përfshirë Suren 9, është në përputhje me kodin.

Tabela 22: Suret ku shifrat e numrit të sures japin shumën 9, dhe shifrat e numrit të strofave japin shumën 12, duke supozuar që Surja 9 është me 129 strofa.

Nr. i sures	Nr. i strofave
9	129
27	93

	222
	(nuk është shumëfish i 19-tës)

Gjejmë 13 sure në Kuran numri i strofave të të cilave përfundon me shifrën "9." Ato janë Suret 10, 15, 29, 43, 44, 48, 52, 57, 81, 82, 87, 96, dhe 104. Numrat e tyre të strofave janë 109, 99, 69, 89, 59, 29, 49, 29, 29, 19, 19, 19, dhe 9, përkatësisht.

Siç ilustron me Tabelën 23, shumë prej tyre përputhen me kodin e Kuranit vetëm nëse Surja 9 përjashtohet; ajo nuk përbëhet nga 129 strofa. Pa Suren 9, numri total i strofave në këto 13 sure është 627, 19×33 .

Aq më shumë, numri i sures, plus numri i strofave, plus shuma e numrave të strofave, japin shumën 23655, ose 19×1245 . Këto fenomene do të ishin zhdukur nëse Surja 9 përbëhet nga 129 strofa.

Tabela 24: Suret me numër tek numri i strofave të të cilave përfundon me "9."

Nr. i sures	Nr. i strofave	Totali
15	99	114
29	69	98
43	89	132
57	29	86
81	29	110
87	19	106
--	--	--
		646
312	334	(19x34)

[42] Dy strofat e fundit të Sures 9 janë 126 dhe 127. Pasi që falsifikuesit shtuan dy strofa, le t'i shikojmë dy strofat e fundit të

Tabela 26: Numri total i shifrës "7" prej dy strofave të fundit të secilës sure në Kuran.

Nr. i sures	2 Strofat e fundit	7-shet në 2 strofat e fundit
1	6,7	1
2	285,286	0
3	199,200	0
4	175,176	2
9	126,127	1
-	-	-
25	76,77	3
-	-	-
114	5,6	0

		38

secilës sure në Kuran, dhe të numërojmë shifrën "7," të gjitha ato, mes këtyre dy strofave të fundit.

Siç tregohet në Tabelën 26, numri total i shifrës "7" mes dy strofave të fundit të secilës sure në Kuran është 38, 19×2 . Sikur strofa e fundit e Sures 9 të ishte 129 në vend të 127, numri i

ndodhjeve i shifrës "7" do të ishte 37, jo 38, dhe ky kriter do të ishte shkatërruar.

[43] Nëse supozojmë që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa, le t'i shikojmë të gjitha suret që përmbajnë një strofë me Nr. 129. Kjo do të thotë që do i shikojmë të gjitha suret që përbëhen nga 129 ose më shumë strofa. Për shembull, Surja 2 përbëhet nga 286 strofa. Prandaj, ajo e përmban një strofë që e ka numrin "129." Pastaj e marrim këtë strofë dhe e shtojmë atë të të gjitha strofat tjera që kanë numrin 129 përgjatë Kuranit.

Me këtë supozim, ka 9 sure që përmbajnë Nr. 129. Gjejmë që totali i numrave të sureve i këtyre 9 sureve është shumëfish i 19-tës (114), përderisa totali i nëntë 129-ëve mund të jetë shumëfish i 19 nëse 2-shi zbritet nga totali i tyre. Me fjalë të tjera, na tregohet që njëra prej këtyre 9 sureve përmban 2 strofa shtesë. Hollësisht janë në Tabelën 27.

Kur e mbledhim 114, plus 1161, dhe zbresim 2, marrim 1273, ose 19×67 . Krahasojeni këtë shumë (1273) me totalin e raportuar në Artikullin 44 më poshtë. Nga 9 suret e listuara në Tabelën 27, cila ka 2 strofat shtesë? Përgjigja jepet në Artikullin 44.

[44] Për të lokalizuar vendin e këtyre dy strofave të rrejtshme, le t'i shikojmë të gjitha suret që përmbajnë një strofë me numër 128, përderisa vazhdojmë të supozojmë që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa. Kjo do të na japë listën e njëjtë të sureve si në Tabelën 27, dhe gjithashtu të sjellë Suren 16 e cila ka saktësisht 128 strofa.

Siç tregohet në Tabelën 28, Surja 9 del jashtë si mos-harmoni e dukshme; dallohet si surja që përmban dy strofat e rrejtshme. Totali i sureve dhe strofave bëhet i plotpjesëtueshëm me 19 vetëm nëse Surja 9 hiqet. Vini re që totali i plotpjesëtueshëm, pasi që të heqim Suren 9, është 1273, 19×67 , gjë që është totali i njëjtë i arritur në Artikullin 43 më lartë pas heqjes së 2 strofave. Ky fenomen i mrekullueshëm vërteton që Surja 9 nuk do të kishte mundur të ketë një strofë që përmban numrin

Tabela 25: Suret numri i strofave të të cilave përfundon me shifrën "7."

Nr. i	Nr. i strofave	Totali
1	7	8
9	127	136
25	77	102
26	227	253
45	37	82
86	17	103
107	7	114
----	---	---
		798
299	499	(19×42)

Tabela 27: Të gjitha suret të cilat përmbajnë një numër strofe "129"

Nr. i sures	Nr i strofës
2	129
3	129
4	129
6	129
7	129
9	129
20	129
26	129
37	129
---	---
114	1161
	($114 + 1161 - 2 = 1273 = 19 \times 67$)

Tabela 28: Të gjitha suret që përmbajnë një numër strofeje "128."

Nr. i sures	Nr. i strofës
2	128
3	128
4	128
6	128
7	128
9	128
16	128
20	128
26	128
37	128
---	---
130	1280
	($130 + 1280 = 1410$)
	nuk është shumëfish i 19-tës)
	Nëse heqim Suren 9, me 128 strofat e saj, marrim $1410 - 9 - 128 = 1273 = 19 \times 67$

128.

[45] Surja 9 është sure pa inicial dy strofat e fundit të të cilës janë 126 dhe 127. Le t'i marrim 85 suret pa iniziale, dhe t'i shtojmë numrat e dy strofave të fundit në secilën sure. Për shembull, dy strofat e fundit në Suren 1 janë 6 dhe 7. Mblidhni 6+7 dhe fitoni 13. Surja e ardhshme pa iniziale është Surja 4;

dy strofat e fundit të saj janë 175 dhe 176. Mblidhni 175+176 dhe fitoni 351. Bëjeni këtë për të gjithë suret pa iniziale. Të dhënat janë në Tabelën 29. Pra, dy strofat e fundit të Sures 9 konfirmohet të jenë 126 dhe 127.

[46] Le t'i marrim tash dy strofat e fundit në secilën sure në Kuran, me iniziale dhe pa iniziale, dhe të shtojmë shifrat e dy strofave të fundit në

secilën sure (Tabela 30). Duket qartë që dy strofat e fundit të secilës sure në Kuran janë të vendosura hyjnisht, dhe të ruajtura hyjnisht nëpërmjet këtij kodi matematikor të ndërlydhur. Dy strofat e fundit të Sures 9 konfirmohet të jenë 126 & 127, jo 128 & 129.

[47] Surja 9 përbëhet nga 127 strofa, dhe 127-shi përbëhet nga 3-shifra. Le t'i shikojmë të gjitha suret numri i strofave të të cilave përbëhet nga 3 shifra; këto janë suret 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 16, 17, 18, 20, 21, 23, 26, dhe 37. Numrat e strofave të tyre janë 286, 200, 176, 120, 165, 206, 127, 109, 123, 111, 128, 111, 110, 135, 112, 118, 227, dhe 182, përkatësisht. Duke marrë shifrën e fundit në secilin numër të strofave, dhe duke mbledhur këto shifra, marrim $6+0+6+0+5+6+7+9+3+1+8+1+0+5+2+8+7+2 = 76 = 19 \times 4$.

Nëse Surja 9 përbëhet nga 129 strofa, shifra e fundit në numrin e saj të strofave do të ishte 9 në vend të 7, dhe totali i shifrave të fundit do të ishte 78 në vend 76, dhe ky fenomen do të zhdukej.

[48] Le ta shikojmë listën e sureve të paraqitur në Artikullin 47 më lartë. Pasi që numri i strofave në Suren 9 është numër tek, le t'i konsiderojmë tash numrat e strofave tek. Këto janë 8 sure me një strofë me numër me 3 shifra dhe tek: Surja 6, 9, 10, 11, 12, 17, 20, dhe 26. Numrat e strofave të tyre janë 165, 127, 109, 123, 111, 111, 135, & 227.

Shifrat e fundit në këta numra të strofave janë 5, 7, 9, 3, 1, 1, 5, dhe 7, përkatësisht, dhe shuma e këtyre shifrave është 38, ose 19×2 . Siç duket, sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, shifra e saj e fundit do të ishte 9, e jo 7, dhe shuma shifrave të fundit do të ishte 40, që nuk është shumëfish i 19-tës. Të dhënat e hollësishme paraqiten në Tabelën 31. Kështu, ne po bëhemi specifik e më specifik, përderisa e ngushtojmë diapazonin kah shifra e fundit në numrin e strofave.

[49] Le të vazhdojmë të punojmë me grupin e njëjtë të sureve të Artikullit 47 dhe 48. Pasi që Surja 9 është sure me numër tek, le t'i heqim tash të gjitha suret tek nga lista e sureve të paraqitura në Artikullin 47. Tash kemi sure me numër tek, me strofa me numër tek.

Tabela 29: Tabelë e shkurtuar e dy strofave të fundit në suret pa iniziale

Nr. i	2 strofat	Totali
1	6+7	13
4	175+176	351
5	119+120	239
-	-	-
9	126+127	253
-	-	-
114	5+6	11

		6897
		(19x363)

Tabela 30: Shuma e shifrave të dy strofave të fundit të secilës sure në Kuran

Nr i sures	2 strofat e fundit	Shuma shifrave
1	6,7	6 + 7
2	285,286	2+8+5+2+8+6
3	199,200	1+9+9+2+0+0
9	126,127	1+2+6+1+2+7
-	-	-
113	4,5	4 + 5
114	5,6	5 + 6

		1824 = 19x96

Tabela 31: Të gjitha suret numri i strofave të të cilave është tek, dhe përbëhet nga 3 shifra

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shifra e fundit
6	165	5
9	127	7
10	109	9
11	123	3
12	111	1
17	111	1
20	135	5
26	227	7

		38
		(19x2)

Ekzistojnë vetëm tre sure të tilla në tërë Kuranin: 9, 11, dhe 17. Numrat e strofave të tyre janë 127, 123, dhe 111 (Tabela 32). Sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, ky fenomen i mrekullueshëm do të ishte shkatërruar.

Tabela 32: Suret me numër tek numri i strofave të të cilave është tek dhe përbëhet nga 3 shifra.

Nr. i sures	Nr. i strofave
9	127
11	123
17	<u>111</u>
	361
	(19x19)

[50] Le të vazhdojmë të punojmë me tre suret e listuara në Artikullin 49. Këto janë të gjitha suret në Kuran numri i të cilave është tek (si Surja 9), numri i strofave të tyre përbëhet nga 3 shifra (si Surja 9), dhe numri i strofave të tyre është gjithashtu tek (si Surja 9). Siç paraqitet në Tabelën 32, numrat e strofave të këtyre 3 sureve janë 127, 123, dhe 111. Thjeshtë mbledhni shifrat individuale, dhe fitoni $1 + 2 + 7 + 1 + 2 + 3 + 1 + 1 + 1 = 19$.

Siç shihet, ky fenomen varet nga e vërteta e vërtetuar tashmë që Surja 9 përbëhet nga 127 strofa. Sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, e vetmja sure në Kuran që posedon kualitetet e përmendura më lartë do të jepte shumën $1+2+9+1+2+3+1+1+1 = 21$. Me fjalë të tjera, ky përbërës i rëndësishëm i kodit matematikor të Kuranit do të ishte zhdukur.

[51] Ekzistojnë tre sure (1) numrat e të cilave janë tek, (2) numrat e strofave të tyre janë tek, dhe (3) numri i strofave përbëhet nga 3 shifra. Ato janë Suret: 9, 11, dhe 17 (shih prej Artikullit 48 deri te 50 për rrjedhën e kësaj pike). Thjeshtë mbledh shifrat individuale që formojnë tre numrat e sureve, dhe fiton $9+1+1+1+7=19$.

[52] Numri 129 është i plotpjesëtueshëm me 3. Sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa siç pretendojnë shtrembëruesit, atëherë ajo do të ishte (1) sure tek që (2) përbëhet nga numër 3 shifrorë i strofave, (3) numri i strofave është tek, dhe (4) numri i strofave është i plotpjesëtueshëm me 3. Janë vetëm 2 sure në tërë Kuranin që posedojnë këto kualitete: Surja 11 me 123 strofa, dhe Surja 17 me 111 strofa. Shuma e shifrave e të dy numrave të sureve dhe numrave të strofave del $1+1+1+2+3+1+7+1+1+1 = 19$. Kjo mund të ndodhë vetëm nëse Surja 9 përbëhet nga 127 strofa.

[53] Surja 9 është (1) tek, (2) me numër strofash tek, (3) numri i strofave të saj është numër i thjeshtë (prim), dhe (5) numri i sures është i plotpjesëtueshëm me 3 & 9. Të vetmet dy sure që posedojnë këto kualitete janë: Surja 9 (127 strofa), dhe Surja 45 (37 strofa). Thjeshtë mbledhni shifrat që i shihni:

$$9+1+2+7=19 \text{ \& } 4+5+3+7=19;$$

$$\text{Totali për të dyja suret} = 19+19 = 38.$$

[54] Le të supozojmë që Surja 9 ka 129 strofa. Në atë rast do të kemi vetëm dy sure në tërë Kuranin numri i të cilave fillon me 9, dhe numri i strofave të tyre përfundon me 9: Surja 9 (129 strofa) dhe Surja 96 (19 strofa). Siç tregohet hollësisht në Tabelën 33, shuma totale e numrit të sures, plus numrit të strofave, plus shumës së numrave të sureve është 8828, gjë që nuk është shumëfish i 19-tës.

Tabela 33: Suret numrat e të cilave fillojnë me "9" dhe numri i strofave të të cilave përfundon me "9."

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e numrave të strofave	Totali
9	129?	8385	8523
<u>96</u>	<u>19</u>	<u>190</u>	<u>305</u>
			8828
105	148	8575	(Nuk është shumëfish i 19-tës)

Tash le t'i heqim strofat e rrejtshme (128 & 129) nga Surja 9, dhe të përsërisim njehsimet e njëjta. Rezultati i këtij korrigjimi tregohet në Tabelën 34. Shuma totale bëhet 8569, 19×451 .

[55] Le të supozojmë që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa. Totali i këtyre shifrave është $9+1+2+9=21$. Le t'i shikojmë të gjitha suret ku shifrat e numrit të strofave të tyre japin shumën 21. Ekzistojnë 7 sure të tilla: 9, 25, 27, 37, 68, 94, dhe 97.

Tabela 35: Suret shifrat e numrave të sureve dhe numrat e strofës të të cilave japin shumën 21, duke supozuar që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
9	129	8385	8523
25	77	3003	3105
27	93	4371	4491
37	182	16653	16872
68	52	1378	1498
94	8	36	138
<u>97</u>	<u>5</u>	<u>15</u>	<u>117</u>
			34744
357	546	33841	(nuk është i plotpjesëtueshëm me 19)

Duke i mbledhur numrat e sureve, plus numrin e strofave në secilën sure, plus numrave të strofave, shuma totale del të jetë 34744, gjë që nuk është shumëfish i 19-tës (Tabela 35).

Tash, le të përdorim numrin e saktë të strofave për Suren 9, 127, dhe të përsërisim të njëjtat njehsime si në Tabelën 35. Kjo e bën shumën totale të jetë 34485, ose 19×1815 . Shih Tabelën 36.

Tabela 34: Të njëjtat të dhëna si në Tabelën 33, pas përmirësimit të numrit të strofave në Suren 9.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
9	127	8128	8264
<u>96</u>	<u>19</u>	<u>190</u>	<u>305</u>
105	146	8318	(19×451)

[56] Për herë të fundit, le të supozojmë që Surja 9 përbëhet nga 129 strofa. Kemi këtu një sure që (1) është sure tek, (2) numri i saj është i plotpjesëtueshëm me 3, (3) numri i strofave, 129, është gjithashtu i plotpjesëtueshëm me 3, dhe (4) numri i strofave përfundon me shifrën "9." Është vetëm një sure që posedon këto kualitete: Surja 15 është e plotpjesëtueshme me 3, numri i strofave të saj është 99, i cili është i plotpjesëtueshëm me 3 dhe përfundon me shifrën "9." Sikur Surja 9 të përbëhej nga 129 strofa, dhe të mblidhnim numrat e sureve dhe strofave për këto dy sure, do të përfundonim me rezultatet në vijim: $9 + 129 + 15 + 99 = 252$ – jo shumëfish i 19-tës.

Nëse e heqim numrin e rrejtshëm 129, kemi një sure në Kuran numri i të cilës është tek, dhe numri i strofave të saj është i plotpjesëtueshëm me 3 dhe përfundon me shifrat 9 – Surja 15. Tash kemi rezultatin në vijim:

$$15 + 99 = 114 = 19 \times 6.$$

[57] Për ca kohë tani, jemi marrë me numra. Le t'i shikojmë tash fjalët dhe shkronjat specifike që ndodhin në futjet e rrejtshme 9:128-129. Thënia e fundit në 9:127 i përshkruan mosbesimtarët si "LAA JAFKAHUN" (ata nuk kuptojnë).

Pra, shkronja e fundit në Suren 9 është "N" (Nun). Sipas falsifikuesve, strofa e fundit është 129, dhe shkronja e fundit është "M" (Mim), pasi që fjala e rrejtshme e fundit është "ADHIM."

Tash le të shikojmë te shkronja e parë dhe shkronja e fundit e secilës sure nga fillimi i Kuranit deri te Surja 9, dhe të njehsojmë vlerat e tyre gormore (numerike). Tabela 37 tregon që shkronja e fundit e vërtetë në Suren 9 duhet të jetë "N," jo "M."

[58] Motra Ihsan Ramadan e Xhamisë Tucson numëroi të gjitha suret në Kuran të cilat përfundojnë me shkronjën "N" (Nun), shkronjën e fundit në Suren 9. Ajo gjeti që 43 sure përfundojnë me

Tabela 36: Njehsimet e Tabelës 35, pas korigjimit të strofave në Suren 9.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
9	127	8128	8264
25	77	3003	3105
27	93	4371	4491
37	182	16653	16872
68	52	1378	1498
94	8	36	138
<u>97</u>	<u>5</u>	<u>15</u>	<u>117</u>
			34485
357	544	33584	(19×1815)

Tabela 37: Vlera gormore e shkronjave të para dhe të fundit të secilës sure nga fillimi i Kuranit deri te Surja 9.

Nr. i sures.	Shkronja e parë	Shkronja e fundit	Totali
1	B = 2	N = 50	52
2	A = 1	N = 50	51
3	A = 1	N = 50	51
4	J = 10	M = 40	50
5	J = 10	R = 200	210
6	A = 1	M = 40	41
7	A = 1	N = 50	51
8	J = 10	M = 40	50
9	<u>B = 2</u>	<u>N = 50</u>	<u>52</u>
	38	570	608
	(19×2)	(19×30)	(19×32)

shkronjën e njëjtë si të Sures 9 (N) – suret 1, 2, 3, 7, 9, 10, 11, 12, 15, 16, 21, 23, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 36, 37, 38, 39, 40, 43, 44, 46, 49, 51, 58, 61, 62, 63, 66, 67, 68, 70, 77, 81, 83, 84, 95, 107, dhe 109. Thjeshtë mblidhni numrat e sureve + numrin e sureve që përfundojnë me "N", dhe fitoni:

1919

Pra, shkronja e fundit në Suren 9 konfirmohet edhe një herë që është "N," e jo "M."

[59] Tash le të shikojmë shprehjen kyçe "LA ILAHE ILA HU" (Nuk ka asnjë zot përveç Atij). Kjo frazë ndodhë në futjen e rrejtshme 9:129. Kjo shprehje shumë e rëndësishme ndodhë 29 herë në 19 sure (Tabela 38).

Duke mbledhur numrat e sureve të 19 sureve, plus numrat e strofave ku fraza "LA ILAHE ILA HU" ndodhë, plus numri i ndodhjeve të kësaj fraze kyçe, shuma totale del të jetë

Tabela 39: Të gjitha suret dhe strofat nga ndodhja e parë deri te ndodhja e fundit në "LA ILAHE ILA HU"

Nr. i sures	Nr. strofave	Shuma e nr.-ve të strofave	Totali
	123		
2	(286-163)	27675	27800
3	200	20100	20303
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
72	28	406	506
<u>73</u>	<u>9</u>	<u>45</u>	<u>127</u>
			316502
2700	5312	308490	(19x16658)

Tabela 40: Ndodhjet e frazës "LA ILAHE ILA HU" nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë.

Nr. i sures	Numrat e strofave me frazën
9	31
11	14
13	30
20	8
20	98
23	116
<u>27</u>	<u>26</u>
	323
	(19x17)

Sikur 9:129 të ishte pjesë e Kuranit, totali në Tabelën 40 do të kishte qenë: 323 + 129 = 452, gjë që nuk është i plotpjesëtueshëm me 19. Zoti nuk ua pranon çka shprehin hipokritët, edhe nëse është e vërteta (63:1).

dhënat e hollësishme tregohen në Tabelën 40.

Tabela 38: Lista e të gjitha ndodhjeve të frazës kyçe: "LA ILAHE ILA HU" (Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Tij), pas heqjes 9:129

Nr.	Nr. i sures	Strofat me frazën kyçe	Shpeshtësia e frazës
1	2	163,255	2
2	3	2,6,18(2x)	4
3	4	87	1
4	6	102, 106	2
5	7	158	1
6	9	31	1
7	11	14	1
8	13	30	1
9	20	8,98	2
10	23	116	1
11	27	26	1
12	28	70,88	2
13	35	3	1
14	39	6	1
15	40	3,62,65	3
16	44	8	1
17	59	22,23	2
18	64	13	1
19	<u>73</u>	<u>9</u>	<u>1</u>
	507	1592	29

507+1592+29 = 2128 = 19x112

2128,
ose
19x112.
Ky
rezultat
është i
varur në
faktin që
strofat
9:128-
129 nuk
përkasin
në Kuran.

Natyrisht, sikur 9:129 të përfshihej, shprehja kyçe "LA ILAHE ILA HU," Shtylla e Parë e Islamit, nuk do të përputhej me kodin matematikor.

[60] Ndodhja e parë e "LA ILAHE ILA HU" është në 2:163, dhe ndodhja e fundit është në 73:9. Nëse mbledhim numrin e sures, plus numrin strofave, plus shumën e numrave të strofave nga ndodhja e parë deri te ndodhja e fundit, shuma totale del të jetë 316502, ose 19x16658.

Tabela 39 paraqet të dhënat e hollësishme. Natyrisht, nëse "LA ILAHE ILA HU" e strofës së rrejtshme 129 do të ishte përfshirë, ky fenomen do të ishte zhdukur.

[61] Fraza "LA ILAHE ILA HU" ndodh 7 herë ndërmjet Bismilahun që mungon në Suren 9 dhe Bismilahun shtesë të Sures 27, në 9:31, 11:14, 13:30, 20:8, 20:98, 23:116, dhe 27:26. Duke mbledhur numrat e 7 strofave, marrim 323, ose 19x17. Të

Mrekullia përfundimtare Kuranore

[62] Vëllai Abdullah Arik ka zbuluar çka unë e konsideroj të jetë mrekullia përfundimtare Kuranore. Ky fenomen i mrekullueshëm pakundërshtueshëm vërteton secilën strofë në Kuran – numrin e strofave në secilën sure, dhe numrat e caktuar për secilën strofë në Kuran – përderisa ekspozon dhe përjashton futjet e rrejtshme, 9:128-129. Për të dëshmuar këtë fenomen të madh, shih Shtojcën 1 (nën titullin: Kombinacionet Numerike Mbinjerëzore). Vënia e numrit të secilës strofë në Kuran në rend nga fillimi deri në fund, me numrat e strofave në secilën sure para numrave të strofave të secilës sure, numri i fundit përbëhet nga 12692 shifra (19x668), dhe vetë numri është shumëfish i 19-tës. Nëse numri i gabuar i strofave për Suren 9 do të përdorej – 129 në vend të 127 – as numri i shifrave, as numri vetë nuk do të ishte i plotpjesëtueshëm me 19.

[63] Pasi që tema e kësaj Shtojce është Surja 9 dhe numri i vërtetë i strofave të saj, vlen të përmendet që nëse shkruajmë numrin e sures, 9, të ndjekur nga numri i saktë i strofave, 127, i ndjekur nga numri i të gjitha strofave nga 1 deri në 127, rezulton numri i gjatë që është i plotpjesëtueshëm me 19. Madje, nëse numri i gabuar i strofave përdoret, d.m.th., 129 në vend të 127, kjo mrekulli e mahnitshme do të ishte zhdukur:

9	127	1	2	3	4	5	122	123	124	125	126	127.
---	-----	---	---	---	---	---	-------	-----	-----	-----	-----	-----	------

Numri total i strofave në Suren 9 është i ndjekur nga numrat e secilës strofë në sure nga 1 deri në 127. Pra, rezulton numri që është shumëfish i 19-tës.

[64] Numri i strofave në Suren 9, 127, është numër tek. Falsifikuesit shtuan dy strofa të rrejtshme, dhe kjo e bëri numrin e strofave 129, i cili gjithashtu është numër tek. Z. Arik përdori të njëjtin program kompjuterik që ai e programoi për Artikullin 62 më lartë për të kontrolluar të gjithë strofat me numra tek në Kuran. Pra, numri i strofave në secilën sure u shkrua, i ndjekur vetëm me shifrën e fundit të secilës nga strofat me numër tek në atë sure. Surja 1 u përfaqësua me numrin 71357. Surja 2 u përfaqësua me numrin 28613579.....5, dhe kështu me radhë deri në suren e fundit. Rezultati është një numër i gjatë, me 3371 shifra, që është i plotpjesëtueshëm me 19. Natyrisht, Surja 9 u përfaqësua me numrin 12713579.....7:

7	1	3	5	7	286	1	3	5	...	3	5	5	1	3	5	6	1	3	5.
---	---	---	---	---	-----	---	---	---	-----	---	---	-------	---	---	---	---	---	---	---	----

Numri i strofave në secilën sure i ndjekur nga strofat me numër tek. Rezulton numri i gjatë, me 3371 shifra, që është shumëfish i 19-tës.

[65] Pasi që Surja 9 është sure pa-iniciale, Z. Arik zbatoi të njëjtin program kompjuterik të të gjithë 85 suret pa iniciale. Numri i secilës sure në secilën nga 85 suret u shkrua, pa numrin e strofave në sure. Pra, Surja 1 u përfaqësua nga numri 1234567, e jo 71234567. Kjo u bë me të gjitha suret pa iniciale. Rezultati përfundimtar është numër që përbëhet nga 6635 shifra, dhe është shumëfish i 19-tës. Këto fenomene mbresëlënëse do të ishin shkatërruar nëse do i kishim përdorur numrat e gabuar për Suren 9, d.m.th., 129 në vend të 127.

Tabela 41: Numri i strofave nga 3:81 deri te Surja 9.

Nr. i sures	Nr. i strofave	Shuma e nr.-ve të strofave
3	119	16860
4	176	15576
5	120	7260
6	165	13695
7	206	21321
8	75	2850
9	<u>127</u>	<u>8128</u>
	988	85690
	(19x52)	(19x4510)

I Dërguari i Zotit i Besëlidhjes

I paracaktuar të pastrojë Kuranin

[66] Përfundimisht, në një demonstrim të theksuar të njohurisë paraprake të Autorit të Plotfuqishëm të Kuranit, është koduar matematikisht që "Personi i paracaktuar për të vërtetuar që Surja 9 përbëhet nga 127 strofa është

Rashad Khalifa, i Dërguari i Zotit i Besëlidhjes (shih Shtojcën 2). Artikulli i paraqitur këtu është një tjetër prej provave të shumta; është zgjedhur për arsye të lidhshmërisë me këtë Shtojcë.

Vlera gërmore e fjalës “Rashad,” siç është shkruar në Kuran (40:29, 38) është 505 (R=200, Sh=300, A=1, dhe D=4). Vlera gërmore e fjalës “Khalifa,” siç shkruhet në Kuran (38:26) është 725 (Kh=600, L=30, I=10, F=80, dhe H=5). Duke e shkruar vlerën e “Rashad,” të ndjekur me vlerën e “Khalifa,” të ndjekur me numrin e Sures 9, të ndjekur me numrin e saktë të kësaj sureje, del numri 5057259127. Ky numër është shumëfish i 19-tës; pra, 19x266171533.

[67] Numri i strofave nga 3:81, ku profetizohet i Dërguari i Zotit i Besëlidhjes, deri te 9:127, fundi i Sures 9, është 988 (19x52). Tabela 41.

[68] Shuma e numrave të strofave nga 3:81 deri te 9:127 është gjithashtu shumëfish i 19-tës (Tabela 41).

[69] Në Strofën 3:78, vetëm 3 strofa para shpalljes së të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes, fjala “Zot” numër 361 (19x19) ndodhë. Kjo strofë (3:78) na informon që disa falsifikues do të “shtojnë të pavërteta në Kuran, dhe pastaj të pretendojnë që është pjesë e Kuranit; ata i mveshin gënjeshtër Zotit, me dije.”

[70] Fjala “Zot” ndodhë 912 herë (19x48) nga Strofa 3:78, që i nxjerrë në shesh falsifikuesit, deri te 9:127.

[71] Numri i shkronjave, plus numri i fjalëve në 3:78 dhe në strofat e rrejtshme 9:128-129, japin totalin e njëjtë, 143. Strofa 3:78 përbëhet nga 27 fjalë dhe 116 shkronja, & 9:128-129 përbëhen nga 115 shkronja dhe 28 fjalë.

Tabela 42: Ndodhja e fjalës “Zot” nga 3:78 deri te fundi i Sures 9

Nr. i sures	Shpeshtësia e fjalës “Zot”
3	132
4	229
5	147
6	87
7	61
8	88
<u>9</u>	<u>168</u>
	912
	(19x48)

وَأَن مِّنْهُمْ لَمَرْيَمَ إِتَمَّتْ
 بِالْكِتَابِ لَتَتَّبِعُنَّ مِن الْكِتَابِ وَمَا هُوَ مِن الْكِتَابِ وَقَوْلُون هُوَ مِن
 عِنْدَ اللَّهِ وَمَا هُوَ مِن عِنْدَ اللَّهِ وَقَوْلُون عَلَى اللَّهِ الْكِتَابِ وَهُوَ يَلْمُونَ ﴿٣٧﴾

Cka mund të themi?

Evidenca materiale e pakalueshme e furnizuar nga i Plotfuqishmi për të mbrojtur dhe vërtetuar lajmin e Tij nuk lë asnjë dyshim që: (1) asnjë shtrembërim i asnjë lloji nuk mund të futet në Kuran, (2) Strofat 9:128-129 nuk përkasin në Kuran, dhe (3) çdo element në Kuran është i ndërtuar matematikisht përtej mundësive njerëzore – numri i sureve, numri i strofave, numrat e caktuar për suret dhe strofat, shpeshtësia e ndodhjes së shprehjeve kyçe, numri i fjalëve, numri i shkronjave, dhe shqiptimi i veçantë dhe shpesh i pazakontë i fjalëve të caktuara.

Kjo Shtojcë dokumenton një mrekulli të thellë edhe vetë. E gjerë dhe krejtësisht e pakalueshme siç është, nuk e tejkalon as nuk barazohet me mrekullinë e përgjithshme matematikore të Kuranit që është e detajuar në Shtojcën Një. Kjo thjeshtë e konfirmon faktin që Autori i Plotfuqishëm i Kuranit ka lejuar me qëllim shtesën blasfemuese të dy strofave në Suren 9 në mënyrë që:

- | |
|---|
| <p>(1) Të demonstrojë një funksion themelor të hartimit matematikor të Kuranit.</p> <p>(2) Të vërtetojë pamundësinë e futjes së duarve në Kuran.</p> <p>(3) Të përmbushë premtimin e Zotit që t’i dallojë besimtarët dhe t’i nxjerrë në shesh hipokritët.</p> |
|---|

Pse e lejoj Zoti për 1400 vite??

Për shkak të korruptimit të Islamit në masë të madhe pas vdekjes së profetit Muhamed, Zoti natyrisht e ka përmbushur zotimin e Tij në 47:38. Një vendim hyjnor i lëshuar në Suren 47, që është e titulluar “Muhamed,” Strofa 38 (19x2), përcakton që “nëse arabët nuk arrijnë t’i

përmbahen Kuranit, Zoti do i përjashtojë ata nga hirësia e Tij, dhe të zëvendësojë njerëz të tjerë në vendin e tyre.”

Kur arabët shtrembëruan Kuranin pak vite pas vdekjes së Profetit, dhe farosën familjen e Profetit gjatë procesit, ata pësuan zotimin e Zotit në 47:38, dhe nuk merituan më që të kenë Kuranin; Kuranin e vërtetë. Ka evidencë të pakundërshtueshme që arabët e kanë braktisur Kuranin në masë të madhe.

Për shembull, nuk ka asnjë xhami të vetme në të ashtuquajturën botë Myslimane sot (1989) që i përmbahet urdhrit kyç: “Xhamitë i përkasin Zotit; të mos thirrni askënd tjetër përveç Zotit” (72:18).

Thirrja për në lutje (Ezani) dhe vetë lutja nuk i kushtohen më vetëm Zotit; Emri i Muhamedit thirret pandarë së bashku me emrin e Zotit.

“Shtylla e Parë e Islamit” thuhet qartë në Kuran, 3:18 & 47:19, dhe fjalët e saj deklarohet të jenë: LA ILAHE ILA ALLAH (Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Zotit). Por Myslimanët, madje edhe aq herët sa në shekullin e parë Pas Hixhrës, nuk e duan Zotin nëse Muhamedi nuk përmendet së bashku me Të. Kjo është lehtë e provueshme sot duke hyrë në cilëndo xhami dhe duke deklaruar “LA ILAHE ILA ALLAH;” kjo në realitet do i zemërojë Myslimanët e sotshëm. Kjo sjellje dokumentohet në Kuran, 39:45. Aq më shumë, hulumtimi im tash më ka bindur që Myslimanëve tradicional iu ndalohej nga Zoti që të shprehin Shehadetin Kuranor të diktuar hyjnisht: “Esh-hedu Ela llahe lla Allah.” Ata nuk mund ta thonë këtë Shehadet (pa e përmendur emrin e Muhamedit). Testoni ata edhe vetë. Shtylla e Parë e Islamit e shtrembëruar, LA ILAHE ILA ALLAH, MUHAMED RESUL ALLAH, nuk është në përputhje me urdhrat e Zotit që erdhën te ne nëpërmjet Muhamedit (shih Shtojcën 13).

Një numër i urdhrave tjerë shkelen gjithashtu nga ky Shehadet Muhamedan. Për shembull, Kurani na urdhëron vazhdimisht që të mos bëjmë dallime mes të dërguarve të Zotit (2:136, 285; 3:84). Shehadeti i shtrembëruar i jep më shumë dallim (shquarje) Muhamedit, kundër vullnetit të tij. Përkundër pohimeve të përsëritura të Kuranit që është “i plotë, i përkryer, dhe tërësisht i hollësishëm” (6:19, 38, & 114), “Myslimanët” kanë refuzuar të besojnë në Krijuesin e tyre; ata iu përmbahen burimeve aq qesharake dhe të paarsyeshme si Hadithi dhe Suna. Kjo kryengritje e njëzëshme kundër Zotit dhe të dërguarit të Tij, dhe kthimi i masës në idhujtari të qartë – duke idolizuar Profetin dhe të shenjtët – kërkoi përmbushjen e zotimit të Zotit në 47:38.

Në vështrim të evidencës hyjnore të pakundërshtueshme të paraqitur këtu, dhe në Shtojcat 1, 2, dhe 26, dikush vërtetë mund t’i çmojë strofat në vijim:

Padyshim, e kemi shpallur këtë lajm, dhe padyshim, do e ruajmë. [15:9]

Thuaj, “Nëse të gjithë njerëzit, dhe të gjithë xhinët, bëhen bashkë, në mënyrë që të prodhojnë një Kuran si ky, ata padyshim do të dështojnë, pa marrë parasysh sa shumë i ndihmojnë njëri tjetrit.” [17:88]

Mosbesimtarët e refuzuan këtë lajm kur erdhi te ta, edhe pse është shkrim i thellë. Asnjë gënjeshtër nuk mund të futet në të, nëpërmjet shtimit ose fshirjes. Se është shpallje nga Më i Mençuri, i Falënderuari. [41:41-42]

Po t’ia shpallnim këtë Kuran malit, do e shihnit duke u thërrmuar, nga respekti për Zotin. [59:21]

Çmuj kontributet e vlefshme të Mahmoud Ali Abib, Gatut Adisoma, Abdullah Arik, Ihsan Ramadan, Lisa Spray, dhe Edip Yuksel. Disa nga faktet mahnitëse matematikore në këtë Shtojcë u zbuluan nga këta hulumtues të Masxhid (Xhamisë) Tucson [Arizona, SHBA].

SHTOJCA 25: *Fundi i botës*

(Zoti është) Njohësi i të ardhmes; Ai nuk e lejon askënd që të zbulojë një njohuri të tillë. Vetëm nëpërmjet të dërguarve që Ai zgjedhë Ai zbulon ngjarjet nga e ardhmja dhe e kaluara.” [72:27]

Mes detyrave që më janë ngarkuar mua si i Dërguar i Zotit i Besëlidhjes është zbulimi i fundit të botës (Faqe 415). Mësojmë nga 18:7-8 dhe 69:13-15 që kësaj bote do i vij fundi. Një tokë e re dhe qiej të ri do të zëvendësojnë tokën dhe qiejt e tanishëm (14:48).

Shenjat e afrimit të fundit të botës

Kurani furnizon shumë shenja, dhe deklaroi që mjetet për zbulimin e fundit të botës janë dhënë (47:18). Shenjat e dhëna në Kuran përfshijnë:

1. **Ndarja e hënës:** Kjo tashmë ndodhi në Qershor të vitit 1969 kur ateruam në hënë dhe ndamë nga ajo dhe sollëm gurët në tokë. Njerëzit në tokë tash mund të shkojnë në shumë muze, kolegje dhe observatorë që të shikojnë copat e hënës.
2. **Zbulimi i kodit matematikor të Kuranit të bazuar në 19** (74:30-37): U përbush më 1969-1974.
3. **Krijesa** (27:82): "E bërë nga toka, i alarmon njerëzit që ata kanë qenë të pavëmendshëm ndaj Krijuesit të tyre." Krijesa, e bërë nga toka, u shfaq dhe ishte pjesë ndihmuese në zbulimin e kodit numerik të Kuranit, dhe në shpalljen që bota e ka braktisur lajmin e Zotit; krijesa është kompjuteri. Vini re që shifrat që formojnë 27:82 japin shumën 19.
4. **Shfaqja e të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes** (3:81): Siç tregohet hollësisht në Shtojcën 2, një i dërguar konsolidues, i profetizuar në Kuran, vjen pasi të kenë dorëzuar shkrimin të gjithë profetët, për ta pastruar dhe bashkuar. Kjo profeci u përbush në Ramazan 1408.
5. **Tymi** (44:10): ndodh pasi që i Dërguari i Zotit i Besëlidhjes të ketë dorëzuar lajmin e bashkuar dhe të ketë deklaruar Islamin (Nënshtrimin) si të vetmen fe të pranueshme nga Zoti.
6. **Gogu and Magogu:** ata riparaqiten, në përputhje me planin e Zotit, në vitin 1700 Pas Hixhrës (2271 Pas Krishtit). Gogu dhe Magogu përmenden në 18:94 dhe 21:96. Nëse i numëroni strofat nga 18:94 deri te fundi i Sures 18, i gjeni ato 17. Nëse i numëroni strofat nga 21:96 deri në fund të Sures 21, i gjeni ato gjithashtu 17. Kjo është shenja e Kuranit që Gogu dhe Magogu do të rishfaqen në 1700 Pas Hixhrës.

Nuk do të mbesë e fshehur [20:15]

Strofa 15 e Sures 20 na informon që fundi i botës do të zbulohet nga Zoti para fundit të botës, dhe Surja 15, Strofa 87, e japin kohën për atë ngjarje:

"Të kemi dhënë shtatë palët, dhe Kuranin madhështor." [15:87]

Shtatë palët janë 14 Inicialet Kuranore. Vlera totale germore e këtyre shtyllave të thella të mrekullisë së Kuranit lokalizon vitin e fundit të botës.

Vlen të përmendet që Strofa 85 e Sures 15 thotë: “Fundit të botës do i vij koha patjetër.” Strofa e ardhshme, 15:86, na tregon që Zoti është Krijuesi i kësaj bote, dhe, natyrisht, Ai e di se kur do të përfundojë ajo. Strofa në vijim, 15:87, na tregon kur do i vij fundi botës. Siç paraqitet në Tabelën 1,

Tabela 1: Vlera totale germore e “Shtatë Palëve” të inicialeve Kuranore

	Iniciali Kuranor	Vlera germore
1	K	100
2	N	50
3	S (Sad)	90
4	H.M.	48
5	J.S.	70
6	T.H.	14
7	T.S.	69
8	A.L.M.	71
9	A.L.R.	231
10	T.S.M.	109
11	`A.S.K.	230
12	A.L.M.S.	161
13	A.L.M.R.	271
14	Q.H.J.`A.S.	195
		1709

totali i vlerës germore të “Shtatë Palëve” të Inicialeve Kuranore është 1709 (shih gjithashtu Tabelën 1 të Shtojcës 1). Sipas 15:87, bota do të mbijetojë për 1709 vite hënore nga koha kur kjo profeci thuhet në Kuran. Kjo do të thotë që bota do të përfundojë në vitin 1710 Pas Hixhrës. Ky numër është shumëfish i 19-tës; 1710 = 19x90.

Zbulimi i kësaj informate ndodhi në vitin 1400 Pas Hixhrës, 309 vite para fundit të profetizuar të botës (1709-1400=309). Numri 309 është numër Kuranor (18:25), dhe është i lidhur me fundin e botës (18:21). Mënyra e çuditshme e shkrimit të 309-shit në 18:25, “Treqind vite, plus nëntë,” tregon që 309 janë vite hënore. Dallimi mes 300 viteve diellore dhe 300 viteve hënore është 9 vite.

Viti i këtij zbulimi, 1400 Pas Hixhrës, përkoi me 1980 Pas Krishtit, dhe 1980 plus 300 vite diellore është 2280, gjithashtu shumëfish i 19-tës, 19x120. Pra bota përfundon në vitin 1710 Pas Hixhrës, 19x90, që përkon me 2280 Pas Krishtit, 19x120. Për mosbesimtarët që nuk i pranojnë këto prova të fuqishme Kuranore, fundi i botës do të vij papritmas (6:31, 44, 47; 7:95, 187; 12:107; 21:40, 22:55; 26:202; 29:53; 39:55; 43:66; dhe 47:18).

Përderisa Hadithi është i ndaluar si burim i mësimave fetare (Shtojca 19), ai mund të jetë burim i përdorshëm për histori. Mund të nxjerrim shumë informata për ngjarje historike dhe zakonet dhe traditat e vendit gjatë shekujve të hershëm të Islamit. Librat e Hadithit sugjerojnë që Inicialet Kuranore u besua që e përcaktonin jetëgjatësinë e Umah-së (Kombit) Mysliman. Interpretimi klasik i *Al-Bajdav* e përmendë ngjarjen historike në vijim si shpjegim të mundshëm të Inicialeve Kuranore. E njëjta ngjarje jepet hollësisht në *Al-Sujuty's ITKAN*, Printimi i Parë, 1318 Pas Hixhrës, Vëllimi 2, Faqe 10:

Jahuditë e Medinës shkuan te Profeti dhe thanë, “Kurani yt është i inicializuar me A.L.M., dhe këto Inicialet përcaktojnë jetëgjatësinë e fesë suaj. Pasi që ‘A’ është 1, ‘L’ është 30, dhe ‘M’ është 40, kjo do të thotë që feja jote do të mbijetojë vetëm 71 vite.” Muhamedi tha, “Ne gjithashtu kemi A.L.M.S.” Ata thanë ‘A’ është 1, ‘L’ është 30, ‘M’ është 40 dhe ‘S’ është 90. Kjo jep shumën 161. A ke diçka tjetër?” Profeti tha, “Po, A.L.M.R.” Ata thanë, “Kjo është më e gjatë dhe më e rëndë; ‘A’ është 1, ‘L’ është ‘30’, ‘M’ është 40, dhe ‘R’ është 200 që e bën totalin 271.” Ata më në fund u dorëzuan, duke thënë “Ne nuk e dimë sa prej këtyre Inicialeve i janë dhënë atij!”
[Referenca e Famshme e Al-Sujuty's ITKAN]

Edhe pse ky tregim është i popullarizuar, shumë studiues kanë ngurruar që ta pranojnë lidhjen e pagabueshme ndërmjet Inicialeve Kuranore dhe fundit të botës. Ata nuk mundën ta sjellin veten që të merren me këtë temë për arsyen e thjeshtë që njehsimi e bën fundin e botës, dhe gjykimin, realitet.

SHTOJCA 26:

Tre të dërguarit e Islamit

Kjo Shtojcë furnizon evidencën matematikore Kuranore që [1] Ibrahim i ishte i dërguari fillestar i Islamit, d.m.th. Nënshtrimit (22:78), [2] Muhamedi ishte i dërguari shkrim-dorëzues (47:2), dhe [3] Rashadi ishte i dërguari pastrues dhe konsolidues që dorëzoi provën vërtetuese të fesë (3:81, & Shtojca 2).

Evidencë e përhershme dhe e verifikueshme

[1] Siç tregohet në Shtojcën 2, vlera germore e “Ibrahim” është 258, vlera germore e “Muhamed” është 92, vlera germore e “Rashad” është 505, dhe $258+92+505 = 855 = 19 \times 45$.

[2] Nëse e përfshijmë “Ismailin,” vlera germore e të cilit është 211 dhe “Isakun,” vlera germore e të cilit është 169, prapë se prapë përfundojmë me vlerë totale germore $855+211+169 = 1235 = 19 \times 65$. Vlera totale germore e tre të dërguarve, ose pesëve, nuk mund të përputhet me kodin matematikor të Kuranit të bazuar në 19 nëse ose Ibrahim, Muhamedi, ose Rashadi nuk përfshihen.

Tabela 1: Suret & strofat nga ndodhja e parë deri te ndodhja e fundit e fjalës “Ibrahim”

Numri i sures	Nr. i strofave	Shuma e numrave të	
		strofave	Totali
2	163	33415	33580
3	200	20100	20303
4	176	15576	15756
5	120	7260	7385
-	-	-	-
9	127	8128	8264
-	-	-	-
84	25	325	434
85	22	253	360
86	17	153	256
87	19	190	296
3827	5835	323598	333260 (19x17540)

[3] Ndodhjet e para dhe të fundit të emrit “Ibrahim” janë në 2:124 dhe 87:19. Duke i mbledhur numrat e sureve, plus numrin e strofave, plus shumën e numrave të strofave nga ndodhja e parë deri te ndodhja e fundit, del $333260, 19 \times 17540$ (Tabela 1).

[4] Siç tregohet në Shtojcën 2, emri i të Dërguarit të Zotit të Besëlidhjes i prezantohet epokës së kompjuterëve nëpërmjet kodimit matematikor. Sikur emri të specifikohet në Kuran, si në rastin me të dërguarit e kaluar, miliona njerëz do i emëronin fëmijët e tyre “Rashad Khalifa.”

Për këtë arsye fjala rrënjë “Rashada” përmendet në Kuran 19 herë (Shtojca 2).

[5] “Ibrahimi” përmendet në 25 sure, “Muhamedi” përmendet në 4 sure, dhe “Rashada” ndodhet në 9 sure. Totali i këtyre sureve është $25+4+9 = 38 = 19 \times 2$ (INDEKSI I FJALËVE TË KURANIT, Abdul Baki).

[6] Nëse i mbledhim numrat e sureve ku fjalët Ibrahim, Muhamed, dhe Rashada ndodhin, plus numrin e ndodhjeve për sure, totali është $1083, 19 \times 19 \times 3$ (Tabela 2).

[7] Nëse i marrim të gjitha suret ku fjala Ibrahim, Muhamed, dhe fjala rrënjë “Rashada” përmendet, dhe i shtojmë numrat e sureve, dhe numrin e strofës së parë në secilën sure ku secila nga tre fjalët përmendet, totali del $2793, 19 \times 147$ (Tabela 3).

[8] Shuma e të gjithë numrave të sureve ku tre fjalët ndodhen, pa përsëritje, plus shuma e të gjithë numrave të strofave, pa përsëritje, japin shumën $6479, 19 \times 341$. Suret janë 2, 3, 4, 6, 7, 9, 11, 12, 14, 15, 16, 18, 19, 21, 22, 26, 29, 33, 37, 38, 40, 42, 43, 47, 48, 49, 51, 53, 57, 60, 72, dhe 87. Shuma e këtyre numrave është 991 (shih Tabelën 3). Strofat ku tre fjalët përmenden, pa përsëritje, janë 2, 4, 6, 7, 10, 13, 14, 16, 17, 19, 21, 24, 26, 29, 31, 33, 35, 37, 38, 40, 41, 43, 45, 46, 51, 54, 58, 60, 62, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 74, 75, 76, 78, 83, 84, 87, 95, 97, 104, 109, 114, 120, 123, 124, 125, 126, 127,

130, 132, 133, 135, 136, 140, 144, 146, 161, 163, 186, 256, 258, dhe 260. Shuma e këtyre numrave është 5488, dhe: $5488 + 991 = 6479 = 19 \times 341$.

Tabela 2: Suret dhe ndodhjet e fjalëve Ibrahim, Muhamed, dhe Rashada.

Nr. i sures	Numri i ndodhjeve		
	Ibrahim	Muhamed	Rashada
2	15	-	2
3	7	1	-
4	4	-	1
6	4	-	-
7	-	-	1
9	3	-	-
11	4	-	3
12	2	-	-
14	1	-	-
15	1	-	-
16	2	-	-
18	-	-	4
19	3	-	-
21	4	-	1
22	3	-	-
26	1	-	-
29	2	-	-
33	1	1	-
37	3	-	-
38	1	-	-
40	-	-	2
42	1	-	-
43	1	-	-
47	-	1	-
48	-	1	-
49	-	-	1
51	1	-	-
53	1	-	-
57	1	-	-
60	2	-	-
72	-	-	4
87	1	-	-
---	---	---	---
991	69	4	19

$991 + 69 + 4 + 19 = 1083 = 19 \times 19 \times 3$
*Fjala "Rashada" ndodhet 19 herë.

Tabela 3: Surja dhe strofa e parë ku fjalët Ibrahim, Muhammad, & Rashada ndodhen.

Nr. i sures	Strofa e ndodhjes së parë		
	Ibrahim	Muhamed	Rashada
2	124	-	186
3	33	144	-
4	54	-	6
6	74	-	-
7	-	-	146
9	70	-	-
11	69	-	78
12	6	-	-
14	35	-	-
15	51	-	-
16	120	-	-
18	-	-	10
19	41	-	-
21	-51	-	-51
22	26	-	-
26	69	-	-
29	16	-	-
33	7	40	-
37	83	-	-
38	45	-	-
40	-	-	29
42	13	-	-
43	26	-	-
47	-	2	-
48	-	29	-
49	-	-	7
51	24	-	-
53	37	-	-
57	26	-	-
60	4	-	-
72	-	-	2
87	19	-	-
---	---	---	---
991	1123	215	464

$991+1123+215+464 = 2793 = 19 \times 147$
Strofa 21:51 nuk mund të mblidhet dy herë.

[9] Nëse e mbledhim numrin e sures, plus numrin e strofës, plus numrin e strofave ku emrat Ibrahim, Muhamed, dhe Rashad ndodhen, marrim totalin që është i barabartë me 7505, 19×395 (Tabela 4).

Pra, është matematikisht e koduar në Kuran që Ibrahim, Muhamedi, dhe Rashadi janë tre të dërguarit e Islamit (Nënshtrimi).

Tabela 4: Suret, strofat, dhe ndodhja e "Ibrahim," "Muhamed, dhe "Rashada."

Nr. i sures	Strofat ku 3 fjalët përmenden			Nr. i Strofave
	Ibrahim	Muhamed	Rashada	
2	124,125,126,127 130,132,133,135 136,140,258,260	-	186,256	14
3	33,65,67,68 84,95,97	144	-	8
4	54,125,163	-	6	4
6	74,75,83,161	-	-	4
7	-	-	146	1
9	70,114	-	-	2
11	69,74,75,76	-	78,87,97	7
12	6,38	-	-	2
14	35	-	-	1
15	51	-	-	1
16	120,123	-	-	2
18	-	-	10,17,24,66	4
19	41,46,58	-	-	3
21	51,60,62,69	-	51	5
22	26,43,78	-	-	3
26	69	-	-	1
29	16,31	-	-	2
33	7	40	-	2
37	83,104,109	-	-	3
38	45	-	-	1
40	-	-	29,38	2
42	13	-	-	1
43	26	-	-	1
47	-	2	-	1
48	-	29	-	1
49	-	-	7	1
51	24	-	-	1
53	37	-	-	1
57	26	-	-	1
60	4	-	-	1
72	-	-	2,10,14,21	4
87	19	-	-	1
---	---	---	---	---
991	5068	215	1145	86
	991+5068+215+1145+86 = 7505 = 19x395			

[10] Siç paraqitet në Tabelën 4, 19 ndodhjet e fjalës rrënjë "Rashada" janë në strofat 186, 256, 6, 146, 78, 87, 97, 10, 17, 24, 66, 51, 29, 38, 7, 2, 20, 14, dhe 21. Këto janë 38 shifra, 19x2.

[11] Tabela 4 paraqet që shuma e numrave të strofave ku i shohim 19 ndodhjet e fjalës rrënjë "Rashada" është 1145. Duke e mbledhur këtë total të numrave të strofave (1145), me vlerën germore të emrit "Rashad" (505), plus me vlerën germore të emrit "Khalifa" (725), marrim $1145+505+725 = 2375$, 19×125 .

[12] Nëse i shkruajmë këta numra afër njëri tjetrit, pra totalin e numrave të strofave (1145), të ndjekur nga vlera germore e emrit "Rashad" (505), të ndjekur nga vlera germore e emrit "Khalifa" (725), atëherë gjithashtu del një numër që është shumëfish i 19-tës: $1145505725 = 19 \times 60289775$.

Shuma e numrave të strofave ku 19 "Rashadat" ndodhen = 1145

Vlera germore e emrit "Rashad" = 505

Vlera germore e emrit "Khalifa" = 725

$1145 + 505 + 725 = 2375 = 19 \times 125$

$1145 \ 505 \ 725 = 1145505725 = 19 \times 60289775$

SHTOJCA 27: *Kush është Zoti yt?*

Shumica e njerëzve fyhen kur e dëgjojnë këtë pyetje. “Çka mendon, ‘Kush është zoti yt?’ pyesin ata, ‘Zoti im është Krijuesi i qiejve dhe tokës.’ “Dhe shumica e këtyre njerëzve do të tronditen kur ta kuptojnë që deklarata e tyre që zoti i tyre është Krijuesi i qiejve dhe tokës nuk është asgjë më shumë se fjalë goje, dhe që ata në fakt janë të paracaktuar për Ferr (12:106).

Zoti yt është kushdo ose çfarëdo që ta preokupon mendjen shumicën e kohës.

Zoti yt mund të jenë fëmijët tuaj (7:190), bashkëshortja jote (9:24), puna jote (18:35), ose uni yt (25:43). Kjo është pse vëmë re që njëri prej urdhrave më të rëndësishëm dhe më të përsëritur në Kuran është:

"O ju që besoni, ta përkujtoni Zotin shpesh; duke e madhëruar Atë ditë e natë." [33:41]

Për ta vënë këtë urdhër në praktikë, duhet të themelojmë shprehi të caktuara me të cilat garantojmë që Zoti na preokupon mendjet tona më shumë se gjithçka tjetër. Kurani na ndihmon të themelojmë shprehi të tilla që na shpëtojnë shpirtin:

1. Lutjet e Kontaktit (Salat): ata që i zbatojnë 5 lutjet ditore arrijnë një proporcion të madh të orëve të tyre të vetëdijshme kah përkujtimi i Zotit. Salati na ndihmon të përkujtojmë Zotin jo vetëm gjatë pak minutave të lutjes, por gjithashtu gjatë kohëve të pritjes. Në ora 11:00 paradite, dikush mund ta shikojë orën e tij ose saj për të parë nëse i ka ardhur koha lutjes së mesditës. Ky veprim e bënë dikë që të mendojë për Zotin, dhe kjo i numërohet si e mirë në përputhje me atë (20:14).

2. Përkujto Zotin para ngrënies: Strofa 6:121 na urdhëron të përmendim emrin e Zotit para se të hamë: “Të mos hani prej asaj mbi të cilën emri i Zotit nuk është përmendur.”

3. Dashtë Zoti (IN SHA ALLAH): “Të mos thoni, ‘Do të bëj këtë ose atë nesër,’ pa thënë, ‘Dashtë Zoti’ (IN SHA ALLAH). Nëse harron ta bësh këtë, atëherë kërko falje dhe thuaj, ‘Më udhëzoftë Zotëruesi im të bëj më mirë herën e ardhshme.’” [18:24]. Ky është urdhër i drejtpërdrejtë që duhet ta zbatojmë, pa marrë parasysht me kënd po flasim.

4. Dhuratë e Zotit (MA SHA ALLAH): Për të kërkuar mbrojtjen e Zotit për gjërat tona të dashura – fëmijët tanë, veturat tona, shtëpitë tona, etj. – urdhërohemi në 18:39 të themi “MA SHA ALLAH” (Kjo është dhuratë e Zotit).

5. Madhëroje Zotin ditë e natë: Kur të hamë ndonjë gjë, nuk duhet të jemi si kafshë; duhet të pasqyrojmë në krijimin e Zotit të ushqimit që po e hamë – shijen, kënaqësinë tonë për shkak të shqisave që na ka dhënë Zoti, paketimin e përkryer të bananes ose portokallit, llojllojshmërisë së ushqimeve të detit të krijuara nga Zoti, etj. – dhe ta madhërojmë Atë përderisa i gëzojmë furnizimet e Tij. Kur e shohim një lule të bukur, një kafshë, ose perëndimin e diellit, duhet ta madhërojmë Zotin. Duhet ta zëmë çdo rast të mundshëm për të përkujtuar dhe madhëruar Zotin, ashtu që Zoti të jetë Zoti ynë.

6. Shprehja e parë: Bëjeni shprehi të thoni: “Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit. Nuk ka zot tjetër përveç Zotit,” në momentin që zgjoheni secilin mëngjes. Nëse e themeloni këtë shprehi të mirë, kjo është çka do të shprehni kur ringjalleni.

SHTOJCA 28:***Muhamedi i shkroi shpalljet e Zotit me dorën e vet***

Shpallja e parë ishte “Lexo,” dhe përfshinte pohimin “Zoti jep mësim me anën e lapsit” (96:1-4), dhe shpallja e dytë ishte “Lapsi” (68:1). Funkzioni i vetëm i lapsit është për të shkruar.

Studiuesit Mysliman të padijsëm të dy shekujve të parë pas Kuranit nuk mund ta kuptonin sfidën e Kuranit për të prodhuar diçka si ai. Ata as nuk ditën për hartimin matematikor të Kuranit, dhe ata e ditën që shumë gjigantë letrarë kanë mundur të hartojnë vepra të krahasueshme me Kuranin. Në fakt, shumë gjigantë të tillë letrarë pretenduan që janë të zotit të prodhojnë vepër letrare aq të shkëlqyeshme sa Kurani. Pretendimi më i fundit erdhi nga Taha Hussein, shkrimtari Egjiptas me nam.

Studiuesit e padijsëm Mysliman atëherë vendosën ta shpallin Muhamedin njeri analfabet! Atyre ua morri mendja që kjo do të bënte cilësinë jashtëzakonisht të shkëlqyer të Kuranit vërtetë të mrekullueshme. Fjala në të cilën ata u mbështetën për t’i dhënë analfabetizmin Profetit ishte “UMI.” Fatkeqësisht për ata “studiues,” kjo fjalë qartazi do të thotë “i pa shkrim” ose dikush që nuk ndjek ndonjë shkrim (Torahn, Ingjilin, ose Kuranin) [shih 2:78, 3:20 & 75, 62:2]; ajo NUK do të thotë “analfabet.”

Profeti ishte tregtar i suksesshëm. “Studiuesit Mysliman” që e trilluan rrenën e analfabetizmit harruan që nuk kishte numra gjatë kohës së Profetit; shkronjat e alfabetit përdorshin si numra. Si tregtar që merrej me numra çdo ditë, Profetit duhej ta dinte alfabetin, nga një deri në një mijë.

Kurani na tregon që Muhamedi e shkroi Kuranin – Bashkëkohësit e Muhamedit citohen për thënien e tyre, “Këto janë përralla të moçme që ai i shkroi. Ato po i diktohen atij ditë e natë” (25:5). Natyrisht, që nuk mund t’i “diktoni” personit analfabet. Armiqtë e Profetit që e akuzojnë atë për analfabetizëm e keqpërdorin Strofën 29:48, që ka të bëjë në veçanti me shkrimet paraprahe.

Në natën e 27 të Ramazanit 13 (Para Hixhres), Muhamedi shpirti, personi i vërtetë, jo trupi, u mblodh në gjithësinë më të lartë dhe Kurani iu dha atij (2:97, 17:1, 44:3, 53:1-18, 97:1-5). Më pas, engjëlli Gabriel i ndihmoi Muhamedit që t’i nxjerrë nga disa strofa të Kuranit në kohë të caktuar, nga shpirti në memorien e Muhamedit. Profeti i shkroi dhe i mbajti mend strofat që sapo iu zbuluan në mendjen e tij. Kur Profeti vdiq, ai e la Kuranin e plotë të shkruar me dorën e vet në rendin kronologjik të shpalljes, së bashku me instruksionet specifike se ku të vendosej secila Strofë. Instruksionet hyjnore të regjistruara nga Profeti u dizajnuan për të mbledhur Kuranin së bashku në formatin e final të duhur për Besëlidhjen e Fundit të Zotit për botën (75:17). Myslimanët e hershëm nuk arritën ta bashkojnë Kuranin deri në kohën e Khalifa Rashed ‘Uthmanit. Një komision u caktua për ta zbatuar këtë detyrë. Lexo Shtojcën 24 për hollësitat.

SHTOJCA 29:***Bismilahu që mungon***

Secila sure në Kuran fillon me thënien “Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit,” e cila njihet si Bismilah, me përjashtim të Sures 9. Kjo mungesë e dukshme e Bismilahut nga Surja 9 ka qenë veçori që ka ngjallur kureshtje për 14 shekuj. Shumë teori ishin ngritur për ta shpjeguar këtë fenomen.

Tash mësojmë që Bismilahu që mungon luan një rol të rëndësishëm si [1] përbërës i rëndësishëm i mrekullisë matematikore të Kuranit, dhe [2] shenjë e dalluar nga Mirëbërësi, i Mëshirshmi, që janë

futur duart në Suren 9 dhe duhet të pastrohet (Shtojca 24). Të dy rolet e Bismilahut që mungon u zbuluan me zbulimin e kodit matematikor të Kuranit. Lista në vijim e vrojtimeve faktike ilustron vetitë e mrekullueshme të Bismilahut që mungon:

[1] Pasi që Bismilahu përbëhet nga 19 shkronja arabe, dhe gjendet para të gjitha sureve përveç njëjës, mund të konsiderohet si themeli mbi të cilën kodi i Kuranit i bazuar në 19 është ndërtuar. Por mungesa e Bismilahut nga Surja 9 shkakton numrin e thënies hyrëse kyçe që të jetë 113, numër i cili nuk përputhet me kodin Kuranit. Megjithatë, gjejmë që kjo mungesë kompensohet në Suren 27. Dy Bismilahe ndodhen në Suren 27, njëri si fjalë hyrëse dhe njëri në Strofën 30. Kjo e rikthen numrin total të Bismilaheve në Kuran në 114, 19×6 .

[2] Nga Bismilahu që mungon në Suren 9 deri te Bismilahu shtesë i Sures 27, ka 19 sure.

Tabela 1: Strofkat që përmbajnë fjalën "Allah" nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë.

Surja numër	Strofkat me fjalën "Allah"
9	100
10	49
11	33
12	34
13	23
14	28
15	2
16	64
17	10
18	14
19	8
20	6
21	5
22	50
23	12
24	50
25	6
26	13
27	6
---	---
342	513
(19x18)	(19x27)

[3] Shuma e numrave të sures nga Bismilahu që mungon (Surja 9) deri te Bismilahu shtesë (Surja 27) është $9+10+11+12+\dots+25+26+27 = 342$, 19×18 . Kjo është karakteristikë matematikore, cilitdo 19 numra të njëpasnjëshëm japin shumë që është shumëfish i 19-tës. Por fenomeni i mrekullueshëm qëndron në atë se ky numër, 342, është i barabartë me numrin e fjalëve nga Bismilahu i parë në Suren 27 deri te Bismilahu i dytë në 27:30.

[4] Ndodhja e Bismilahut shtesë në 27:30 është në përputhje me kodin e Kuranit në atë që numri i sures, plus numri i strofës është shumëfish i 19-tës ($27+30 = 57 = 19 \times 3$).

[5] Ndodhja e Bismilahut shtesë në Strofën 30 krahasohet me ndodhjen e vetë numrit 19 në Strofën 30 (Surja 74).

[6] Kurani përmban 6234 strofa me numra. Mungesa e Bismilahut nga Surja 9, dhe kompensimi për të në Strofën 30 të Sures 27 na jep dy Bismilahe me numra, 1:1 & 27:30, dhe 112 Bismilahe pa numra. Kjo e bënë numrin total të strofave në Kuran të jetë $6234+112 = 6346$, 19×334 .

[7] Nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë, numri i strofave që përmbajnë fjalën "Allah" është 513, 19×27 . Vini re që 27 është numri i sures ku Bismilahu shtesë gjendet. Të dhënat janë në Tabelën 1.

Tabela 2: Suret & strofat nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë

Surja	Strofkat	Shuma e nr. të strofave
9	127	8128
10	109	5995
11	123	7626
12	111	6216
13	43	946
14	52	1378
15	99	4950
16	128	8256
17	111	6216
18	110	6105
19	98	4851
20	135	9180
21	112	6328
22	78	3081
23	118	7021
24	64	2080
25	77	3003
26	227	25878
27	29	435
342	1951	117673

[8] Shuma e numrave të strofave ($1+2+3+\dots+n$), plus numri i strofave, nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë është 119624, 19×6296 . Shih Tabelën 2.

[9] Kjo gjë gjithashtu vërteton që Surja 9 përbëhet nga 127 strofa, jo 129 (shih Shtojcën 24). Shuma e shifrave të 127-shit është $1+2+7=10$. Duke i gjetur të gjitha strofat shifrat e të cilave japin shumën 10, nga Bismilahu që mungon i Sures 9 deri te Bismilahu shtesë i Sures 27, pastaj duke ia shtuar numrin e këtyre strofave numrit total të strofave nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë, marrim 2128, ose 19×112 (Tabela 3).

[10] Surja 9 është sure me numër tek numri i strofave të të cilës (127) është gjithashtu tek. Nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë, ka 7 sure që kanë këtë karakteristikë; ato janë sure me numër tek numri i strofave të të cilave është gjithashtu tek. Siç tregohet hollësisht në Tabelën 4, këto janë Surja 9, 11, 13, 15, 17, 25, dhe 27. Duke i mbledhur shifrat që formojnë numrat e sureve dhe numrat e strofave, shuma totale është 114, 19×6 .

Tabela 4: Suret me numër tek numri i strofave të të cilave është gjithashtu tek

Nr. i sures	Shuma e shifrave	Nr. i strofave	Shuma e shifrave
9	9	127	10
11	2	123	6
13	4	43	7
15	6	99	18
17	8	111	3
25	7	77	14
27	9	29	11
	--		--
	45		69
$45+69 = 114 = 19 \times 6$			

Tabela 3: Strofot shifrat e të cilave japin shumën 10, nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë

Nr. i sures	Nr. i strofave	Nr. i ndodhjeve
9	127	12
10	109	10
11	123	11
12	111	10
13	43	3
14	52	4
15	99	9
16	128	12
17	111	10
18	110	10
19	98	9
20	135	12
21	112	10
22	78	7
23	118	11
24	64	6
25	77	7
26	227	22
27	29	2
---	----	---
342	1951	177
$(19 \times 18) \& 1951+177=2128=19 \times 112$		

[11] Dy veçoritë e ardhshme vërtetojnë edhe Bismilahun që mungon edhe numrin e strofave në Suren 9 (ku dy strofa të rrejtshme ishin futur). Nëse i marrim suret e njëjta të renditura në Tabelën 4, suret me numër tek numrat e strofave të të cilave janë gjithashtu tek, dhe shkruajmë numrin e secilës sure, duke u ndjekur nga numri i strofave të saj, numri i gjatë që rrjedh (30 shifror) është shumëfish i 19-tës (Figura 1).

[12] Le të marrim shifrën e fundit të të gjitha strofave nga Bismilahu që mungon deri te Bismilahu shtesë. Nëse e shkruajmë numrin e secilës sure, duke u ndjekur me shifrën e fundit në secilin strofë në atë sure, na del një numër i gjatë, me 1988 shifra, i cili është i plotpjesëtueshëm me 19 (Figura 2).

9 127 11 123 13 43 15 99 17 111 25 77 27 29

Secili numër i sures ndiqet nga numri i strofave në atë sure. Ky numër i gjatë është i barabartë me $19 \times 48037427533385052195322409091$.

[Figura 1]

9 1234567890123... .. 27 1234567890 ... 789

Numri i sures ndiqet nga shifra e fundit në secilin numër të strofës nga Surja 9 deri te Surja 27, Strofa 29.

[Figura 2]

SHTOJCA 30:

Poligamia

Poligamia ishte mënyrë e jetesës derisa Kurani u shpall 1400 vjet më parë. Kur toka ishte e re dhe e populluar pak, poligamia ishte një mënyrë për ta populluar atë dhe për t'i sjellë qeniet njerëzore që duheshin për të kryer planin e Zotit. Prej kohës kur Kurani u shpall, bota ishte populluar mjaftueshëm, dhe Kurani vuri kufizimet e para kundër poligamisë.

Poligamia lejohet në Kuran, por nën rrethana rreptësisht të vrojtuar. Çfarëdo keqpërdorimi i kësaj leje hyjnore pëson ndëshkim të rreptë. Pra, edhe pse poligamia lejohet nga Zoti, neve na duhet t'i shqyrtojmë rrethanat tona me kujdes para se të themi që një marrëdhënie poligamiste e caktuar është e lejuar.

Shembulli ynë i përkryer këtu është profeti Muhamed. Ai ishte i martuar me një grua, Khadixhen, derisa ajo vdiq. Ai i pati të gjithë fëmijët e tij, përveç njërit, prej Khatixhes. Pra, ajo dhe fëmijët e saj gëzuan vëmendjen e plotë të Profetit për aq gjatë sa ajo ishte e martuar me të; njëzet e pesë vjet. Praktikisht, Muhamedi kishte një grua – nga mosha 25 vjeçare deri në 50. Gjatë 13 vjetëve të mbetura të jetës së tij, ai u martua me vejusha të moshuara të shokëve të tij që lanë pas shumë fëmijë. Fëmijët kishin nevojë për shtëpi të plotë, me figurë atërore, dhe Profeti e furnizoi atë. Furnizimi i figurës atërore për jetimët është rrethana e vetme e posaçme në përkrahje të poligamisë e përmendur në Kuran (4:3).

Përveç martesës me vejushat nëna të jetimëve, kishte tre martesë politike në jetën e Profetit. Shokët e tij të ngushtë Ebu Bekri dhe Omari këmbëngulën që ai të martohej me vajzat e tyre, Ajshen dhe Hafsahn, për të themeluar lidhje tradicionale familjare mes tyre. Martesa e tretë ishte me Marinë Egjiptasen; ajo iu dha atij si shenjë politike e miqësisë nga sunduesi i Egjiptit.

Ky shembull i përkryer na tregon që një burrë duhet t'i japë vëmendjen dhe besnikërinë e plotë në martesë bashkëshortes dhe fëmijëve të vet në mënyrë që të rrisë një familje të lumtur dhe të shëndetshme.

Kurani thekson kufizimet kundër poligamisë me fjalë shumë të forta: “Nëse frikësoheni se mund të mos jeni krejtësisht të barabartë në trajtimin e më shumë se një gruaje, atëherë duhet të jeni të kënaqur me një.” (4:3) “Nuk mund të jeni të barabartë në një marrëdhënie poligamiste, pa marrë parasysh sa shumë përpiqeni.” (4:129)

Kufizimet Kuranore kundër poligamisë tregojnë mundësinë e keqpërdorimit të ligjit të Zotit. Prandaj, në mos qofshim absolutisht të sigurt që ligji i Zotit nuk do të keqpërdoret, më mirë ta rezistojmë epshin tonë dhe të rrimë larg poligamisë. Nëse rrethanat nuk diktojnë poligami, më mirë t'ia japim vëmendjen e tonë të plotë të shoqes dhe një palë fëmijëve. Mirëqenia psikologjike dhe sociale e fëmijëve, posaçërisht në vendet ku poligamia është e ndaluar, gati gjithmonë diktojnë monogami. Disa kritere themelore duhet të vrojtohen në sjelljen ndër mend të poligamisë:

1. Duhet të lehtësojë dhimbje dhe vuajtje dhe jo të shkaktojë dhimbje dhe vuajtje.
2. Nëse ke familje të re, është gati e sigurt që poligamia është keqpërdorim.
3. Poligamia për të zëvendësuar grua më të re është keqpërdorim i ligjit të Zotit (4:19).

SHTOJCA 32: *Mosha vendimtare 40 vjeçare*

Cila është mosha e përgjegjësisë? Nëse një fëmijë vdes në moshën 12 vjeçare, madje edhe pa dëgjuar për Zotin, a shkon ky fëmijë në Parajsë apo në Ferr? Çka nëse fëmija ka 15 vjet, ose 21, ose 25? Në cilën moshë do të mbahet përgjegjës qenia njerëzore për besimet e tij apo saj? Kjo pyetje i ka hutuar hulumtuesit e të gjitha feve për një kohë të gjatë.

Kurani e vendos moshën e përgjegjësisë në moshën 40 vjeçare; kushdo që vdes para kësaj moshe shkon në Parajsë (46:15). Nëse personi besoi në Zotin dhe pati dobi nga besimi duke ushqyer dhe zhvilluar shpirtin (shih Shtojcën 15), ai ose ajo shkon në Parajsën e Lartë. Përndryshe, personi shkon në Parajsën e Ulët.

Reagimi yt i parë ndaj kësaj pjese të informatës është mospranim: “Çka nëse personi ishte shumë i keq, djallëzor, dhe ateist, a do të shkojë Ai në Parajsë po të vdiste ai para moshës 40 vjeçare?” Kjo është për shkak se ti je zemërngushtë, përderisa Zoti është i Mëshirshmi. Prirja jonë është “ti fusim të gjithë ata në Ferr.”

Njerëzit që e kundërshtojnë fort këtë mëshirë Hyjnore nuk mund të dalin me një moshë të saktë të përgjegjësisë. Ata pyesin pyetje si, “Çka nëse personi ishte shumë shpirtligë?” Përgjigja është, “A e di Zoti që ky person është shpirtligë?” “Po.” “A e di Zoti që ky person nuk meriton të shkojë në Parajsë?” “Po.” “Pra, ky person nuk do të vdesë para moshës 40 vjeçare.” Aq thjeshtë. Zoti është i vetmi që i përfundon jetët tona në këtë tokë. Ai e din saktësisht kush meriton të shkojë në Parajsë dhe kush meriton të shkojë në Ferr.

Kah fillimi i vitit 1989 një njeri i quajtur Theodore Robert Bundy u ekzekutua për vrasjen e një numri grash. I tërë kombi u pajtua që ai ishte një prej kriminelëve më të këqij në histori. Aq shumë konsiderohej i keq sa që ekzekutimi i tij ishte një prej rasteve të rralla ku kundërshtarët e dënimit me vdekje nuk protestuan. Në të kundërtën, shumë njerëz në realitet e festuan ekzekutimin e tij. Shumë gazetarë, redaktues, dhe politikanë u qanë për faktin që drejtësisë iu deshën njëmbëdhjetë vjet për ta ekzekutuar Ted Bundy-in. Ata thanë që Bundy është dashur të jetë ekzekutuar brenda më së shumti gjashtë vitesh pas dënimit të tij. Sipas Kuranit, kjo do të ishte dhurata më e madhe që cilido do të kishte mundur t’i bënte Bundy-it. Ai ishte 42 vjeç kur u ekzekutua. Po të ishte ekzekutuar ai pesë vjet më herët, në moshën 37 vjeçare, ai do të kishte shkuar drejtë e në Parajsë, dhe ai nuk e meritoi atë.

Siç del, Bundy ishte një prej shenjave që Zoti na ka dhënë neve që të konfirmojë që kushdo që vdes para moshës 40 vjeçare shkon në Parajsë. Emri i Bundy-it, Theodore Robert Bundy, përbëhet nga 19 shkronja, dhe ai pranoi që kishte vranë 19 gra vetëm një ditë para ekzekutimit të tij. Kishte edhe shumë shenja të tjera nga Zoti.

Dorëzimi i kësaj pjese të rëndësishme të informatës është një prej përgjegjësive që më është dhënë mua si i Dërguar i Zotit i Besëlidhjes. Nuk është mendimi im personal.

Vlen të përmendet që që të dy Martin Luther King-u dhe Malcolm X-i u vranë vetëm ca muaj para ditëlindjeve të tyre 40 vjeçare.

SHTOJCA 33:

Pse dërgoi Zoti të dërguar tani?

Siç thuhet në 3:81, dhe në Shtojcën 2, Zoti ka dërguar të dërguar për t'i konsoliduar lajmet e dorëzuara nga të gjithë profetët, t'i pastrojë ato, dhe t'i bashkojë ato në një fe: Nënshtrim. Pa dyshim, tani është koha e duhur për përmbushjen e kësaj profecie të madhe, për arsyet në vijim:

1. Judaizmi, Krishterimi, dhe Islami janë prishur aq sa nuk njihen më.
2. Të gjitha lajmet e Zotit janë dorëzuar; Kurani është Besëlidhja e Fundit.
3. Më shumë se rreth 90% e qenieve njerëzore që janë paracaktuar të jetojnë në këtë botë ende nuk kanë ardhur. Siç ilustron në Hyrje, njerëzit që kanë jetuar në këtë tokë që nga Ademi janë vetëm një e pesëmbëdhjeta e popullatës njerëzore totale të projektuar.

Judaizmi

Ilustrimi më i mirë i Judaizmit të degjeneruar të sotshëm mund të gjendet në librat e një Rabini të famshëm; Harold S. Kushner. Në librin e tij më të shitur KUR GJËRAT E KËQJIA IU NDODHIN NJERËZVE TË MIRË, Avon Books, 1981, Rabini Kushner thotë gjërat në vijim:

..., ne do të këshilloheshim ta marrim këtë botë aq seriozisht sa mundemi, për çdo rast nëse del që kjo është e vetmja që do të kemi ndonjëherë, dhe të kërkojmë domethënie dhe drejtësi këtu. (F. 29)

Gjërat e këqija u ndodhin njerëzve të mirë në këtë botë, por nuk është vullneti i Zotit ashtu. Zoti do të dëshironte që njerëzit të arrinin çka ata meritojnë, por Ai nuk mundet gjithmonë ta bëjë këtë. (F. 42)

Zoti nuk ndërhyr poshtë për të penguar punën e ligjeve të natyrës për të mbrojtur të drejtën nga dëmi. Kjo është një fushë e dytë e botës që i bën gjërat e këqija t'iu ndodhin njerëzve të mirë, dhe Zoti nuk e shkakton këtë dhe as nuk mund ta ndalë. (F. 58)

Zoti nuk mund të bëjë çdo gjë, por Ai mund të bëjë disa gjëra të rëndësishme. (F. 113)

Ne nuk mund të kërkojmë nga Ai që të na bëjë imun ndaj sëmundjes, sepse Ai nuk mund ta bëjë atë. (F. 125)

Unë i njoh kufizimet e Tij. Ai është i kufizuar nga ligji i natyrës në atë se çka mund të bëjë, dhe nga evolucioni i natyrës njerëzore dhe lirisë morale njerëzore. (F. 134)

Krishterimi

Po të kthehej Jezusi në jetë sot, të Krishterët do e kryqëzonin atë. Studiues të shquar të Krishterë kanë arritur përfundime të qëndrueshme që Krishterimi i sotëm nuk ka asgjë të bëjë me Jezusin, dhe që doktrina e tij ishte shtrembëruar për vdekje te Konferenca e turpshme e Nicenës (viti 325 Pas Krishtit). Shih *MITI I ZOTIT TË MISHËRUAR (THE MYTH OF GOD INCARNATE)*, Westminster Press, Philadelphia, 1977.

Islami

Po të kthehej Muhamedi në këtë botë, "Myslimanët" do e gurëzonin për vdekje. Feja që ndjekin ata sot nuk ka asgjë të bëjë me Islamin e predikuar nga Ibrahim dhe Muhamedi. Çdo gjë që bëjnë "Myslimanët" është gabim si: Shtyllën e Parë (Shehadetin), thirrjen për lutjen Salat (Ezanin), avdesin (Vudu), lutjen e përditshme Salat, bamirësinë Zeqat, Haxhin, dhe të gjitha zakonet tjera të Islamit (shih Shtojcat 2, 13, & 15).

"Një Fe Që Nuk Është Autorizuar Nga Zoti" (42:21)

Shkalla deri në cilën Islami (Nënshtrimi) është degjeneruar ilustron në tabelën në vijim:

Shpikja	Parimet Kuranore të Shkelura
Hadith & Suna	6:19, 38, 114; 7:1-3; 12:111; 17:46; 31:6; 45:6; 69:38-47; etj.
Vrasja e kujtdo që e konsiderojnë të pafe	2:256; 4:90; 10:99; 18:29; 88:21-22.
Sistem të egër të drejtësisë penale: <ul style="list-style-type: none"> • Cungimi i dorës së vjedhësit • Gurëzimi për vdekje i atyre që kanë bërë marrëdhënie jashtëmartesore • Vrasja e kujtdo që nuk zbaton Salat& • Vrasja e dikujt që pi alkool për herë të katërt 	5:38, 12:31. 4:25, 24:2. 2:256, 18:29. 2:256, 18:29.
Ndalimi i grave në menstruacion nga adhurimi	2:222
Ndalimi i grave nga Lutja e të Premtes	62:9
Idolizimi i Muhamedit kundër vullnetit të tij: <ul style="list-style-type: none"> • Thirrja e tij “i dërguari më i nderuar” • Pretendimi që ai ishte i pagabueshëm • Ngritja e varrit të tij si “Xhami e Shenjtë” • Pretendimi që ai posedon fuqi ndërmjetësimi • Shpikja e tregimit të pabazë për ngritjen e tij në qiej në një kalë, me shpejtësinë e dritës, dhe që e ka bindë Zotin të mos na japë 50 lutje salat por vetëm 5. Me shpejtësinë e dritës ai ende do të ishte duke udhëtuar brenda Galaktikës së Rrugës së Qumështit • Shtimi i emrit të tij në lutjet Salat & Ezan • Shtimi i emrit të tij në Shtyllën e Parë të Islamit 	2:285. 4:79; 9:117; 17:73-74; 33:37; 40:66, 66:1; 80:1-10; 93:7. 2:149-150. 2:48,123,254;6:70,94;7:53; 10:3; 39:44; 43:86; 74:48. 17:1; 53:1-18. 20:14; 72:18. 3:18; 37:35; 39:45
Fyerja e Muhamedit duke e përshkruar atë si njeri të egër: <ul style="list-style-type: none"> • Ata pretendojnë që ua nxirrte sytë njerëzve • Pretendimi që ai kishte fuqi seksuale të 30 burrave 	3:159; 68:4. 18:110; 25:20.
Anulimi i faktit që Muhamedi ishte profeti i fundit duke thënë që Jezusi do të kthehet në këtë botë. Kjo e bën Jezusin profetin e fundit.	33:40
Pretendimi që Muhamedi ishte analfabet, jo-inteligjent.	Shih Shtojcën 28
Sistem të çuditshëm të të ushqyerit me mori ndalesash	6:145-150; 16:115,116
Ndryshimi i Muajve të Shenjtë	9:37.
Neglizhenca e bamirësisë Zeqat nëpërmjet ndryshimit të saj	6:141, Shtojca 15.
Shtypja e grave dhe detyrimi i tyre që të veshin shami në koka dhe rroba të paarsyeshme, dhe ndalimi nga të drejtat në martesë, shkurorëzim, trashëgimi, etj.	2:228; 3:195; 4:19,32; 9:71.
Fyerja e grave duke i shkolluar të tjerët që “nëse një majmun, qen, ose grua kalon para një personi që lutet, lutja e tij asgjësohet” (Hadith)	
Shpikja e shumë rregullave që nga avdesi, te lutja, te gjumi, deri te prerja e thonjve	2:67-71; 5:101; 42:21.
Ndalimi i arit dhe mëndafshit për meshkuj	5:48-49; 7:31-32.
Ndalimi i muzikës dhe arteve	7:32; 34:13; 42:21.
Tallja e Islamit duke thënë që toka është e ndërtuar mbi një balenë të madhe!! (Ibn Kathir, 1200 AD & Ben Baz, 1975 AD)	79:30;

Kjo është vetëm një mostër e vogël e shkeljeve të kryera nga “Myslimanët” ditë për ditë. Kjo është pse Zoti e ka dërguar të Dërguarin e Tij të Besëlidhjes.

SHTOJCA 34: *Virgjëria*

Djemtë dhe vajzat e besimtarëve të vërtetë duhet të mësohen që lumturia e tyre përgjatë jetëve të tyre varet në ndjekjen e ligjit të Zotit dhe në ruajtjen e dëlirësisë së tyre. Kjo do të thotë që ata duhet ta mbajnë veten vetëm për bashkëshortet/bashkëshortët e vet, dhe të mos e lejojnë askënd tjetër t'i prekë ata në mënyrë seksuale (23:5-6, 24:30, 33:35, 70:29-30).

Shoqëria e sotme është përplot joshje të fuqishme. Në shoqërinë Shqiptare të fillimit të mileniumit të ri, madje edhe prindërit fillojnë të flasin për 'frajera' për vajzat e tyre dhe 'femna' për djemtë e tyre. Kur ata arrijnë adoleshencën, shumë prindër madje edhe furnizojnë mënyra të ndalimit të shtatzënisë për fëmijët e tyre. Një përqindje alarmante e adoleshentëve janë seksualisht aktiv, edhe pse ata nuk janë fiziologjikisht të pjekur, dhe pa kurrfarë kufizimesh morale. Mijëra shtatzëni të paligjshme dhe tragjedi të ndërlydhura me to, plus mijëra aborte tragjike, ndodhin çdo muaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mes rrjedhëve të kësaj prishjeje morale janë: fëmijë pa dashje dhe pa përkrahje, baballarë fajtor dhe të papërgjegjshëm, kriminelë që nuk kanë respekt për jetët dhe pronat e njerëzve, miliona mospërshtatjesh shoqërore, urdhje gjenitale të pashërueshme, lythe gjenitale të pashërueshme, frëngjyza (STD-ja) dhe gonorre shkatërrimtare, displasia, SIDA vrasëse, dhe sëmundje të reja që nuk janë njohur më parë.

Çka shumica e njerëzve nuk e dinë është që kjo prishje morale iu kushton atyre shtrenjtë dhe ku dhemb shumë përgjatë jetëve të tyre. Se ligji i vetëm që e sundon botën është ligji i Zotit, dhe këto shkelje flagrante të ligjit të Zotit iu kushtojnë atyre me shumë vuajtje dhe probleme (20:124).

Besimtarët e vërtetë që ua ndien për fëmijët e vet do i këshillojnë ata dhe t'ua kujtojnë shpesh dhe me këmbëngulësi (20:132) që ta mbajnë dëlirësinë. Kjo do të thotë të rrinë të virgjër deri në natën e tyre të martesës, pastaj të rrinë besnik ndaj të shoqes apo të shoqit të vet – duke mos kryer marrëdhënie jashtëmartesore – për të mirën dhe lumturinë e vet. Këshilla e Zotit për ta mbajtur dëlirësinë tonë, para dhe pas martesës, është në dobi tonën. Zoti është ai që e ka në dorë shëndetin, pasurinë, dhe lumturinë ose vuajtjen (53:43, 48).

SHTOJCA 35: *Drogat & alkooli*

Nuk ka aspak kompromis, çfarëdo qoftë ai, sa i përket drogave të paligjshme dhe pijeve alkoolike; ato quhen "neveri dhe punët e Dreqit" (5:90). Në 2:219 dhe 5:90, shohim që "dehësit, bixhozi, altarët e idhujve, dhe lojërat e fatit" ndalohen rreptësisht. Fjala e përdorur për dehësit është "Khamr" nga fjala rrënjë "Khamara" që do të thotë "të mbulosh." Pra, çfarëdo që mbulon ose pengon mendjen ndalohet. Kjo përfshinë çfarëdo që e ndryshon mendjen, siç është marihuana, heroina, kokaina, alkooli, hashishi, dhe çdo gjë tjetër që e ndryshon mendjen.

SHTOJCA 36: *Çfarë çmimi duhet për një komb të madh*

"Nëse njerëzit e shkrimit (Jahuditë, të Krishterët, dhe Myslimanët) besojnë dhe mbajnë jetë të drejtë, do t'ua heqim mëkatet e tyre dhe t'i pranojmë në Qiellin e hareshëm. Po ta zbatonin ata Torahn, Ungjillin, dhe çka është shpallur këtu nga Zotëruesi i tyre, do të kishin gëzuar furnizime nga lartë tyre, dhe nga poshtë këmbëve të tyre. Disa prej tyre janë të drejtë, por shumica e tyre janë keqbërës." [5:65-66]

"Veç sikur njerëzit e shoqërive të ndryshme të besonin dhe të mbanin jetë të drejtë, do të kishim derdhur mbi ta bekime nga qielli dhe toka" [7:96]

***"Zoti është Ai që drejton lumturinë tuaj, ose vuajtjen.....Zoti është Ai që ju bën të pasur ose të varfër."* [53:43, 48]**

Një komb që i përmbahet ligjeve të Zotit e ka të garantuar dominim mes kombeve të botës, fitoren, përparimin, dhe lumturinë (10:62-64, 16:97, 24:55, 41:30-31). Në anën tjetër, një komb që i shkel ligjet e Zotit vetëshkakton jetë të përvuajtur (20:124). Një komb që iu përmbahet ligjeve të Zotit është i garantuar të jetë komb madhështor. Kjo nuk është thjeshtë një ëndërr idealiste; pasi që Zoti i ka gjërat në dorë (10:61), garancionet dhe premtimet e Tij kryhen. Një komb që iu përmbahet ligjeve të Zotit karakterizohet me:

1. Liri maksimale për njerëzit – liri fetare, liri të shprehjes, liri të udhëtimit, dhe liri të ekonomisë (2:256, 10:99, 88:21-22).
2. Të drejta njerëzore të garantuara për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, besimin, gjendjen sociale, gjendjen financiare, apo përkatësinë politike (5:8, 49:13).
3. Përparim për të gjithë njerëzit. Sistemi ekonomik i Zotit bazohet në qarkullim të vazhdueshëm të pasurisë, pa fajde, dhe me investime produktive. Ekonomia jo produktive siç është bixhozi, lotaria, dhe huaja me interes të lartë nuk lejohen (2:275-7, 59:7).
4. Drejtësi sociale për të gjithë. Për shkak të bamirësisë së obligueshme (Zeqatit), askush nuk do të mbetet i uritur ose i pastrehë (2:215, 70:24-25, 107:1-7).
5. Sistem politik që bazohet në konsensus unanim. Njëpërmjet këshillimeve të dyanshme dhe lirisë së shprehjes, njëra palë e cilëso çështje i bind të gjithë pjesëmarrësit në diskutim. Rezultati përfundimtar është një marrëveshje unanime, e jo mendimi i shumicës 51%-she ta ngulfat minoritetin 49%-sh (42:38).
6. Një shoqëri që përkrahë dhe mbanë standardet më të larta të sjelljes morale. Do të ketë familje të fortë, pa alkoolizëm, pa droga ilegale, pa shtatzëni të paligjshme, pa abort, dhe praktikisht pa shkurorëzim.
7. Kujdes maksimal për jetët dhe pronat e njerëzve. Pra, nuk do të ketë krim kundër jetëve dhe pronave të njerëzve.
8. Mbizotërim i dashurisë, mirësjelljes, paqes, dhe respektit të dyanshëm mes njerëzve, dhe ndërmjet këtij kombi dhe shoqërive të tjera të botës (3:110, 60:80-9).
9. Mbrojtja e ambientit garantohet njëpërmjet ruajtjes dhe ndalimit të praktikave të shpërdorimit (30:41).

SHTOJCA 37: *E drejta penale*

Nëse një vjedhës vjedh njëmijë lek nga ti, dhe ata e fusin atë në burg, çka përfiton ti? Nëse vjedhësi ka bashkëshorte dhe fëmijë, cili është krimi i tyre? Pse duhet ata të grabiten larg nga babai i tyre?

Kurani e zgjedhë këtë problem, si edhe problemet e ndërlidhura me sistemin e drejtësisë penale që mbizotëron në botën e sotshme.

Barazia është ligji [2:178-179]

Sipas të drejtës penale Kuranore, vjedhësi që shpallet fajtor për vjedhjen e njëmijë lekëve nga ti duhet të punojë për ty derisa të kompensohesh krejtësisht për njëmijë lekët që i ke humbur, plus dëmit dhe bezdisë që vjedhja ka mundur të të shkaktojë. Në të njëjtën kohë, bashkëshortja dhe fëmijët e pafajshëm të vjedhësit nuk ka nevojë të heqin dorë nga burri i saj, dhe sistemi i shtrenjtë i burgjeve eliminohet. Burgimi është ndëshkim i egër dhe jonjerëzor që është vërtetuar i padobishëm për të gjithë që kanë të bëjnë me të.

Përkundër besimit të zakonshëm, dora e vjedhësit të mos cungohet. Lavdi Zotit për mëshirën e Tij dhe mrekullinë matematikore të Tij në Kuran, ne tash e dimë që dora e vjedhësit ka për tu shënuar. Shënimi i dorës së vjedhësit thuhet në 5:38. Numrat e sures dhe strofave japin shumën $5+38 = 43$. Vendi tjetër në Kuran ku “dora prehet” gjendet në 12:31. Kjo është ku i shohim gratë që e admiruan Jozefin aq shumë, sa që “i prenë” duart e tyre. Qartazi, ata nuk i cunguan duart e tyre. Askush nuk mund ta bëjë atë. Numrat e sureve dhe strofave japin shumën $12+31$, shuma e njëjtë si në 5:38. Kjo jep konfirmim matematikor që ligji Kuranor bën thirrje për shënimin e dorës së vjedhësit, e jo cungimin e saj. Konfirmim shtesë matematikor jepet: 19 strofa pas 12:31, shohim “prerjen e dorës” përsëri. Dënimi në Islam (Nënshttrim) bazohet në barazi dhe trysni shoqërore (2:178, 5:38, 24:2).

Blasfemia e quajtur “Hadith & Suna” ka themeluar gurëzimin për vdekje si ndëshkim për kurorëshkelësit-et. Ky nuk është ligji i Zotit. Siç thuhet në 24:2, ndëshkimi për marrëdhënie jashtëmartesore është fshikullimi në publik; njëqind fshikullima simbolike. Siç u theksua më lartë, ndëshkimi themelor është trysnia shoqërore dhe skandalizimi i kriminelit. Fshikullimi në publik e arrin këtë synim.

Kur kemi të bëjmë me vrasje, Kurani dekurajon kategorikisht dënimin me vdekje (2:179). “I liri për të lirin, skllavi për skllavin, dhe femra për femrën” (2:178). Për shkak të zemërngushtësisë dhe padrejtësisë së njerëzve, shumë njerëz madje as nuk mund ta paramendojnë çka thotë ky ligj Kuranor. Ata refuzojnë të pranojnë urdhrin e qartë që barazia e saktë duhet të zbatohet – nëse një grua e vret një burrë, ose një burrë vret një grua, ose një skllav vret një person të lirë, ose një person i lirë vret një skllav, dënimi me vdekje nuk mund të zbatohet. Kurani parapëlqen që vrasësi ta kompensojë familjen e viktimës. Nëse e vrasim vrasësin, kjo nuk e sjell prapa viktimën, e as nuk ka dobi familja e viktimës nga ekzekutimi (vrasja) e vrasësit. Kompensimi, megjithatë, duhet të jetë i mjaftueshëm për të qenë parandalues tmerrues për të tjerët. Në Islam (Nënshttrim), viktima dhe/ose familja e viktimës janë gjykatësit për të gjitha krimet; ata vendosin çfarë duhet të jetë dënimi nën mbikëqyrjen e një personi që e njeh Kuranin.

SHTOJCA 38:

19: Nënshkrimi i Krijuesit

Shkrimet nuk janë të vetmet krijime matematikisht të hartuara nga Zoti ku numri 19 është emëruesi i përbashkët. Vërtetë ia vlen të përmendet që Galileu tha thënien e tij të famshme: “Matematika është gjuha me të cilën Zoti e krijoi gjithësinë.” Një numër i madh i gjetjeve shkencore tani ka treguar që numri 19 përfaqëson nënshkrimin e Zotit mbi krijime të caktuara. Kjo vullë hyjnore duket përgjatë gjithësisë në mënyrë pothuajse të njëjtë ashtu si nënshkrimi i Mikelandelos ose Pikasos që identifikon veprat e tyre.

Për shembull:

1. Dielli, hëna, dhe toka radhiten në të njëjtën pozitë relative një herë çdo 19 vjet (shih ENCYCLOPEDIA JUDAICA nën “Calendar”).
2. Kometa e Halleyt, fenomen i thellë qiellor, viziton sistemin tonë diellor çdo 76 vjet, 19x4.
3. Vula e Zotit në ty dhe mua manifestohet në faktin që qenia njerëzore përmban 209 eshtra, 19x11.
4. EMBRIOLOGJIA MJEKËSORE E LANGMANIT, nga T.W. Sadler, përdoret si libër mësimi në shumicën e Shkollave Mjekësore në SH.B.A. Në Faqe 88 të botimit të pestë, lexojmë fjalinë në vijim: “Në përgjithësi gjatësia e shtatzënisë për një fetus me afat të plotë konsiderohet të jetë 280 ditë ose 40 javë pas fillimit të menstruacionit të fundit, ose më saktësisht, 266 ditë ose 38 javë pas fekondimit.” Numrat 266 dhe 38 janë që të dy shumëfisha të 19-tës.

LARTMADHËRUAR QOFTË ZOTI

TERMINOLOGJIA

=====

<i>`Ad:</i>	Njerëz kryengritës të Iramit. Shoqëri te e cila u dërgua Hudi.
<i>Ahzab:</i>	Grup; Beteja e Al-Ahzabit.
<i>`Alem:</i>	Shkollar fetar. Shkencëtar. Person i ditur. Shumësi është Ulama
<i>El-Hamdu Lilah:</i>	Lartmadhëri Zotit.
<i>Allah:</i>	Zoti, Perëndia, Hyu, i vetmi Zot.
<i>Allahu Ekber:</i>	Zoti është i Madh.
<i>Allat:</i>	Idhull i Arabisë Idhujtareske para Muhamedit; pretenduan që ishte "e bija e Zotit!"
<i>Arafat:</i>	Kodrinë afër Mekës ku shtegtarët kalojnë një ditë përkujtimi të Zotit gjatë shtegtimimit Haxh ose Umreh.
<i>Ensar:</i>	Mikpritës ose aleatë. Banorë të Medinës që ishin të parit që përvetësuan Islamin. Ata i ofruan ndihmë imigrantëve që ikën nga Meka (shih Muhaxhirin)
<i>Ajeh:</i>	Shenjë. Mrekulli. Strofë.
<i>Ajet:</i>	Shumës i Ajah.
<i>Ejub:</i>	Jobi, një i dërguar i Zotit.
<i>Ezan:</i>	Thirrja për lutjen Salat.
<i>Bedr:</i>	Emër vendi afër Mekës. Beteja e parë ndërmjet ndjekësve të Muhamedit dhe idhujtarëve.
<i>Bismilahu:</i>	Strofa e parë. Fjalë hyrëse për secilën sure, përveç Sures 9.
<i>Bismilah:</i>	Në emër të Zotit.
<i>Gabriel:</i>	Engjëll përgjegjës për bartjen e lajmeve dhe shpalljeve të Zotit në planetin Tokë.
<i>Germore:</i>	Vlerat numerike të shkronjave të alfabetit para shpikjes së shifrave.
<i>Hadith:</i>	Gojëdhëna ose shprehje që i janë mveshur rrejtshëm Muhamedit. U paraqitën 250 vite pas vdekjes së Muhamedit. 45:6 i ndalon besimtarët t'i përmbahen ndonjë hadithi përveç Kuranit.
<i>Haxh:</i>	Shtegtim në Mekë gjatë Muajve të Shenjtë (shih Muajt e Shenjtë)
<i>Hallall:</i>	E ligjshme; e lejuar.
<i>Haram:</i>	E paligjshme; e ndaluar
<i>Herem:</i>	I Shenjtë. "Al-Masjid Al-Haram" është Xhamia e Shenjtë e Mekës.
<i>Hava:</i>	Eva.
<i>Hixhra:</i>	Imigrimi i Muhamedit nga Meka në Medinë. Kalendari Islamik filloi atë vit.
<i>Hixhra Kalendari:</i>	Kalendar Hënor. Emrat dhe numrat e muajve janë: 1. Muharrem. 7. Rexheb. 2. Safer. 8. Sha`ban. 3. Rebi I. 9. Ramazan. 4. Rebi II. 10. Shevval. 5. Xhumadel I. 11. Dhyl-Ka`de. 6. Xhumadel II. 12. Dhyl-Hixhe.
<i>Hud:</i>	I dërguar i Zotit. U dërgua te Adi.
<i>Hunejn:</i>	Beteja e Hunejnit; vend.
<i>Iblis:</i>	Dreq.
<i>Imam:</i>	Udhëheqës fetarë. Udhëheqës.
<i>In Sha Allah:</i>	Dashtë Zoti.
<i>Ingjil:</i>	Ungjëlli. Shkrimi i Jezusit.
<i>Irum:</i>	Qytet ku shoqëria e Adit jetoi, dhe te e cila u dërgua Hudi.
<i>Islam:</i>	Nënshtrim dhe përkushtim ndaj vetëm Zotit. E vetmja fe e pranueshme nga Zoti (3:19).
<i>Isra':</i>	Nata e 27 e Ramazanit, 13 vite Para Hixhrës. Nata e udhëtimit të Muhamedit në Qiellin më të lartë ku Kurani u vu në shpirtin e tij. Shih "Nata e Fuqisë."
<i>Xhenet:</i>	Parajsë. Qiell.
<i>Xhehenem:</i>	Ferr; Gehenë
<i>Xhin:</i>	Pasardhës të Dreqit. Shoqërues të padukshëm dhe të vazhdueshëm të secilës qenieje njerëzore nga lindja deri në vdekje. Kur lirohen me rastin e vdekjes së qenies njerëzore, ata bëhen Xhin.
<i>Xhuma:</i>	E Premte. Lutja e Asamblesë së Premtes. E detyrueshme për secilin burrë ose grua Mysliman çdo të Premte në mesditë.
<i>Qabeh:</i>	Ndërtesë në formë kubi. Faltorja në formë kubi e ndërtuar nga Ibrahim në Mekë. Pika kah e cila kthehen Myslimanët gjatë lutjeve të tyre të kontaktit (Salat).
<i>Qafir:</i>	Mosbesimtar. I Pafe. Ateist.

<i>Qitab:</i>	Libër. Shkrim.
<i>La Ilahë Illa Allah.:</i>	Kredoja e Islamit: "Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Zotit." Urdhri i Parë në të gjitha shkrimet.
<i>Lejlet Al-Kadr:</i>	(shih Nata e Fuqisë)
<i>Ma Sha Allah:</i>	Ky është vullneti i Zotit.
<i>Manaat:</i>	Idhull i Arabisë idhujtareske para Muhamedit; pretenduan që ishte "e bija e Zotit."
<i>Medjen:</i>	Shoqëri e lashtë në veri të Sinait. Shoqëria e Shuajbit.
<i>Mu'adhin:</i>	Dikush që këndon Ezanin. Thirrës për lutjen Salat.
<i>Muhaxhirin:</i>	Shumës i Muhaxhir; imigrantë që ikën nga Meka në Medinë sepse u keqtrajtuuan.
<i>Mulla:</i>	Mësuesit fetarë.
<i>Mymin:</i>	Besimtarë që hoqën të gjitha dyshimet; shkallë më e lartë se "Mysliman."
<i>Munafik:</i>	Hipokrit.
<i>Mushrik:</i>	Adhures idhujsh. Idhujtar. (Shih Shirk.)
<i>Mysliman:</i>	Dikush që vendosë t'i nënshtrohet Zotit dhe t'i përmbahet urdhreve të Tij, por ai ende mund të ketë dyshime.
<i>Nabi:</i>	Profet; i dërguar i Zotit që dorëzon shkrim të ri. Muhamedi ishte Nabi i fundit, sepse ai dorëzoi shkrimin e fundit.
<i>Nata e Fuqisë:</i>	Nata e Paracaktimit ose Lejlet Al-Kadr. Nata e 27 e Ramazanit në 13 Para Hixhrës. Natë gjatë të cilës u shpall Kuran. Muhamedi u mor në Qiellin më të lartë për të pranuar Kuranin.
<i>Karun:</i>	Drejtues i pasur i skllëvërve. Tradhtar hebre që i shërbeu Faraonit duke i skllavëruar njerëzit e vet.
<i>Kiblah:</i>	Drejtim kah kthehen Myslimanët gjatë lutjeve të tyre të kontaktit (Salat).
<i>Reqah:</i>	Një njësi e lutjes së kontaktit (Salat).
<i>Resul:</i>	I dërguar i Zotit, ose profet, që mund ose jo të dorëzojë një shkrim të ri (shih Nabi). Secili Nabi ishte Resul, por jo secili Resul ishte Nabi. Shih definicionet në 3:81.
<i>Salih:</i>	Një i dërguar i Zotit.
<i>Muajt e Shenjtë:</i>	Muaji me numër 12, 1, 2, dhe 3 të Kalendarit Islamik. Muaj gjatë të cilëve Myslimanët zbatojnë Haxhin.
<i>Xhamia e Shenjtë:</i>	Al-Mesxhid Al-Herem. Xhamia e madhe në Mekë, ku gjendet Qabja.
<i>Selam:</i>	Paqe. Përshëndetje.
<i>Selamun Aleikum:</i>	Paqe qoftë mbi ty; përshëndetje.
<i>Salat:</i>	Lutje të përditshme të kontaktit – lutjet e agimit, mesditës, pasdites, mbrëmjes & natës.
<i>Sejem:</i>	Agjërimit; zakonisht gjatë muajit Ramazan. Abstenim nga ushqimi, pija, dhe seksi nga agimi deri në përfundim të diellit. Gjithashtu zotime heshtjeje.
<i>Sheikh:</i>	Njeri i moshuar, ose mësues fetarë, ose kreu i fisit.
<i>Shirk:</i>	Idhujtari. Adhurim idhujsh. Shoqërimi i ndonjë emri tjetër me emrin e Zotit. Të besuarit që ndonjë krijesë posedon ndonjë fuqi që të sjellë dobi ose dëmtojë.
<i>Subhan Allah:</i>	Madhëri Zotit.
<i>Subhanahu Ua Ta`aale:</i>	Madhëri Më të Lartit.
<i>Suna:</i>	Zakone që i janë mveshur rrethshëm profetit Muhamed; zakone të atyre që idhujtarizojnë Muhamedin kundër vullnetit të tij. Në Kuran, Zoti i ndalon të gjitha Sunat, përveç Sunas së Tij.
<i>Shuejb:</i>	i Medjenit. I dërguar i Zotit.
<i>Sure:</i>	Kapitull në Kuran.
<i>Talut:</i>	Sauli.
<i>Texhemum:</i>	Avdes, i thatë, pa ujë.
<i>Themud:</i>	Njerëz kryengritës të Salihut.
<i>Uhud:</i>	Mal afër Medinës. Betejë e.
<i>Ulama:</i>	Shkollarë fetarë; shumës i "Alem."
<i>Umreh:</i>	Shtegtim në Mekë në çfarëdo kohe të vitit, duke i përfshirë Muajt e Shenjtë (shih Haxh & Muajt e Shenjtë).
<i>Udhdhah:</i>	Idhull i Arabisë idhujtareske para Muhamedit; pretenduan që ishte "vajza e Zotit."
<i>Udu':</i>	Avdes.
<i>Jahja:</i>	Gjoni
<i>Jethrib:</i>	Emër i lashtë i Medinës.
<i>Jusuf:</i>	Jozefi
<i>Zeqat:</i>	Bamirësi e obligueshme; 2.5% e të ardhurave neto të dikujt që duhet tu jepet kur merret një e ardhur e tillë njerëzve nevojtarë sipas një sistemi specifik të shpërndarjes.
<i>Dhyl Kernejn:</i>	Ai me dy brirë. I dërguar i Zotit që ndihmoi në kufizimin e Gogut & Magogut. Mbas gjase Buda.

Faqja në internet:
www.masjdtucson.org/albanian

E-mail adresa:
xhamiashiptare@gmail.com

Gusht, 2012